HYJNORJA DHE NJERËZORJA

/Përmbledhje artikujsh të ndyshëm/

Përgatiti: **SHEFKI OLLOMANI**

Editor
Azam DAUTI

HYJNORJA
DHE NJERËZORJA

/Përmbledhje artikujsh të ndyshëm/

Përgatiti:
SHEFKI OLLOMANI

SHKUPI
Shkup, 2019

I. MISTIKA, MAGJIA DHE BUKURIA E UNIVERSIT

1. John Dobson

Çka thonë shkenca dhe religjionet për fillimin dhe krijimin e botës, pak a shumë dihen.

Tani do të shkruajmë për njërin nga të "krisurit", i cili jo tamam me anë të shkences, por më shumë me anë të "magjisë"ka guxuar të shpjegojë fillimin, bile edhe të shkoj më tej, ku mbase asnjëri s'ka për të shkuar dot ndonjëherë.

Ky mjeshtri quhet John Dobson.

Gjyshi i tij ka themeluar universitetin e Pekinit, e vetë është i famshem për shpikjen e një teleskopi të lire e funksional qe mban emrin e tij (Dobsonian).

Dobson niset nga niveli i lartë i energjisë që na rrethon. Sipas llogarive të tij, një kilogram lëndë përmban energjinë e njëmijë bombave atomike.

Kuptohet po të merren parasysh përmasat e universit që njohim, sasia e energjisë është jashtëzakonisht e madhe.

Dhe pyetje është: nga erdhi gjithë kjo energji? Aq më shumë që ne nuk njohim asnjë proces natyror që krijon energji.

Ne fakt, gjithë dynjaja jonë bazohet vetëm në transformime energjish, por në asnjë rast energjia nuk krijohet. Mesa duket Prometeu i vodhi Mjeshtrit zjarrin, por jo formulën e tij.

Nje pjesë e mirë e shkencës thotë që gjithë kjo energji u çlirua ne Big Bang, por kuptohet, pa mundur të thotë nga u gjet si fillim. Kurse feja ia lë Zotit misterin.

Kurse Dobson, gjen një rrugë të mesme, dmth "magjinë"për të shpjeguar super çudinë.

Nga llojet e energjisë që njohim, dy më të konsiderueshmet jane ajo e gravitetit dhe ajo elektricitetit. E para na bën të peshojme mbi dysheme, siç bën të tërhiqet çdo gjë në dynja, dhe e dyta na pengon që të mos biem nëpër dysheme, siç bën të shtyhen objektet me ngarkesa të njejtë, apo të tërhiqen ato me ngarkesë të kundërt.

Përpara se të bëjmë (dmth. Dobson) kërcimin magjik për shpjegimin e origjinës se gravitetit dhe elektricitetit, le ta shohim çeshtjen nga një anë tjetër.

Po sikur të gjithë gjërat në univers të bashkohen në një gjë të vetme, a do të kemi më energji graviteti? Pjesa më e madhe e kësaj energjie do të shndërrohej në forma të tjera.

Në mënyrë të ngjashme, do të transformohej edhe energjia elektrike. Për ta sqaruar me një shembull "magjinë"le të mendojmë në suste, që

dikush e terheq nga të dy anët. Le të themi se susta shërben si univers për disa qenie nanoskropike, le t'i quajme sustore.

Pra, sustoret do të mund të venin re se universi i tyre (susta) ka energji qv tenton ta mbledhi sustën. Dhe mbasi susta lëshohet, ajo vërtetë mblidhet, dhe energjia mbledhëse transformohet në të tjera.

Në mënyrë të ngjashme, në universin tonë, graviteti, thotë Dobson, është energjia që tenton të cojë gjënë në gjendjen fillestare, atë të bashkuar. Po ashtu energjia elektrike bën që gjëja e pafundme të paraqitet si gjëra të ndara në grimca.

Pra, sipas Dobsonit, gjithë kjo energji shërben për të paraqitur të pandashmen e të pafundmen si të ndashme e të fundme, siç e shofim në kasollen tonë.

Më tej, Dobsoni e shtrin magjinë e tij dhe mbi hapësirën e kohën, këto pjesë përbërëse të dynjasë. Gjithmonë sipas tij, hapësira duhet për të paraqitur të ndashmet, dhe koha për ndryshimet, apo transformimet e energjisë.

Pa hapësirë gjërat nuk mund të ndahen, dhe pa kohë ato nuk mund të ndryshojnë.

Magjisë së tij të "krijimit, “Donsoni i ka gjetur edhe një emër: "apparitional causation, “apo shkakëtar paraqitës (ndoshta ka ndonje përkthim edhe më të mirë).

Shkenca zyrtare e sheh Dobsonin si heretik apo të krisur. Dhe nuk ka faj, shkenca nuk ka si të merret me magji. Por, nga ana tjeter Dobson thotë se: s'ka rrugë tjeter për të shpjeguar krijimin, apo për të shkuar me tej akoma, veçse me magji apo fantazi.

Edhe unë i prura këtu këto ide jo per t'i përkrahur apo shpjeguar me to boten, se sa për të ndare shijimin e një fluturimi aq të guximshem të fantazisë njerzore, siç është ajo e Dobsonit.

Keto ide te Dobsonit, ngjajnë me ide të feve indiane, dhe kjo nuk është koincidence, Dobson ka kaluar nja 25 vite në një manastir Vedanta.

I pyetur mbi marrëdhëniet shkencë - fe, Dobson thotë se ato duhet të ulen e t'i japin dorën njera tjetrës.

2. Njësitë arkitekturore të Universit

Kështu i përshkruan një enciklopedi shkencore moderne elementet kimike. Mes elementeve të tokës sonë ka një shumëllojshmëri habitëse: disa prej tyre janë të rralla, të tjera janë me bollëk. Elemente si ari mund të tërheqin syrin njerëzor... Të tjerat janë gaze, të cilat ne as që i shohim, si azoti dhe oksigjeni. Qdo element është i përpërë nga një lloj i veqantë atomi. Mënyra se si atomet janë ndërtuar dhe ndërvarur nga njëra - tregon efektshmëri dhe një organizim marramendës në një rregull sistematik.

Rreth 300 vjet më parë, vetëm 12 elemente ishin të njohura: argjendi, arseniku, bismuti, karboni, bakri, ari, hekuri, plumbi, merkuri, antimoni, squfuri dhe kallaji. Ndërkohë që u zbuluan të tjera, shkencëtarët vunë re se elementet pasqyronin një organizim të rregullt. Duke qenë se në këtë organizim kishte vende bosh, shkencëtar si Mendelejevi, Ramsej, Mouzi dhe Bori teorizuan ekzistencën e e;ementeve të panjohura dhe vetitë e tyre. Ato elemente u zbuluan më vonë pikërisht siç ishin parashikuar. Përse patën mundësi këta shkencëtarë të parashikonin se ekzistonin forma të materies, të cilat ishin të panjohura në atë kohë?

Mirë, pra, elementet ndjekin një rregull natyror numerik, i bazuar në strukturën e tyre. Ky është ligj i provuar. Për këtë arsye librat sgkollorë mund të nxjerrin një sistem periodik të elementeve në radhë dhe kolona: hidrogjeni, heliumi... e kështu me radhë.

Një enciklopedi (Mc Graw-Hill Encyklopedia of Science and Technology) vëren: "Janë të pakta sistematizimet në historinë e shkencës që mund të konkurrojnë me sistemin peridik si një zbulim i gjerë i organizimit të botës fizike... Cilatdo elemente të reja të zbulohen në të ardhmen, është e sigurt se ato do të gjejnë një vend në sistemin periodik, duke u përputhur me organizimin e tij dhe duke shfaqur vetitë e duhura familjare. "

Kur elementet rregullohen në radhë e në kolona të sistemit periodik, një marrëdhënie e habitshme shihet mes elementeve të një kolone. Për shembull, në kolonën e fundit ndodhet heliumi (nr. 2), neoni (nr. 10), argoni (nr. 18), kriptoni (nr. 36), ksenoni (nr. 54) dhe radoni (nr. 86). Këto janë gaze që bëhen të ndritshëm kur një shkarkim elektrik kalon përmes tyre dhe përdoren në llambat inkandeshente. Gjithashtu, ato nuk reagojnë me lehtësi me elementet e ndryshme, siç bëjnë disa gaze të tjera.

Po, Universi, deri edhe në grimcat e tij atomike, zbulon harmoni dhe organizim mahnitës. Cfarë është përgjegjëse për një organizim, harmoni dhe shumëllojshmëri të tillë mes blloqeve ndërtuese të Universit?

Organizimi dhe harmonia e elementeve kimike në sistemin peridik pasqyron thjesht një rastësi apo një projektim inteligjent?!

3. Si u krijua Universi?

A është bosh universi? A ka fund? A është i përjetshëm apo koha ka fund? Doli nga diçka apo nga asgjëja - ex nihilo? Kosmologjistët kanv shtruar këtë pyetje që kur Edwin Huble zbuloi në vitin 1929 që universi po zgjerohet. Për gati gjysëm shekulli, teoria e pranuar është që universi filloi nga një shpërthim i fuqishëm energjie - Big Bang. Por sot një teori e re kosmike propozon që universi është një pjesë e vogël e një hapësire shumë-dimencionale dhe të gjere, dmth që Big Bang është vetëm një hap në zhvillimin e pafundtë të krijimit.

Modeli Standart i Sotshëm

Sipas teorisë së Big Bang universi u krijua nga shpërthimi i një pike të nxehtë, të kondensuar pafundësisht. Brenda një pjese të shkurtër të një sekonde universi filloi të zgjerohet (teoria e inflacionit). Pas kalimit të miliarda vjetëve galaksitë, yjet dhe planetet u krijuan për shkak të ftohjes së universit. Sot, 13. 7 miljard vite pas shpërthimit të Big Bangut, pranohet hipoteza që universi jo vetem që po zgjerohet, por edhe po shpejtësohet nën ushtrimin dhe influencën e ca forcave tepër energjitike dhe misterioze. Nëse universi vazhdon të zgjerohet në këtë mënyrë, e ardhmja e universit duket e zezë. Yjet do të shpenzojnë energjinë e tyre, galaksitë do te shpërbëhen, dhe universi do të mbetet i errët dhe pa jetë përgjithmonë. Kjo teori lë shumë pyetje dhe nuk shpjegon se si origjinoi Big Bang dhe se çfarë ekzistonte para shpërthimit të madh. Gjithashtu, teoria nuk shpjegon natyrën e fushës së energjisë misterioze që ndikon në rritjen e shpejtësisë të universit.

Modeli Rrethanor (Ciklor)

Për t'iu drejtuar limiteve dhe paradokseve të Big Bang, kosmoligjistët Paul Steinhardt, profesor në Princeton University, dhe Neil Turok, profesor në Cambridge University, përpunuan një hipotezë të re kozmologjike e cila vendos universin si një pjesë e vogël në përbërjen e gjithësisë, shumica e së cilës qëndron në dimensione të tjera që njeriu nuk mund t'i mendoj dhe përshkruaj, sepse njeriu mendon e shikon në tre dimensione (1) gjatësi, (2) lartësi, (3) gjërësi. Universi i jonë eksiston në një shtresë tre dimensionale e cila qëndron afër një tjetër shtrese, të padukshme që eksiston jashtë dimensioneve që njeriu i kupton. Çdo trilion vjet, të dy shtresat përplasen me njëra tjetrën dhe si pasojë krijojne një stuhi energjie të barabartë me atë të Modelit Standart. Në këtë Model Rrethanor universi zgjerohet, ftohët, krijohen galaksitë, yjet, dhe planetet deri sa zhvillimi natyror i këtyre objekteve vjen në fund dhe e lë universin bosh. Por sipas këtij modeli, përplasja e të dy shtresave fillon përsëri ciklin e krijimit nga fillimi. Në këtë

mënyrë, argumentohet, që koha dhe gjithësia janë të pafundshme, gjë që nuk gjendet në Modelin Standart.

Hapi i Parë: Universi Bosh

Imagjino dy shtresa dy-dimensionale. Shtresa e parë përmban universin tonë dhe shtresa e dytë përmban një univers tjetër (ose asgjë) por është i padukshëm dhe ne nuk e shohim dot sepse është jashtë dimensioneve që mund të kuptojmë. Pas ca kohe -triliona vite- në zgjerim i afrohemi fundit ciklik kosmik ku përbërja e universit tonë është kaq e shpërndarë dhe e ulët sa që hapësira është gati bosh. Megjithatë të dy shtresat jane akoma në lëvizje, edhe pse janë bosh, dhe forcat e tërheqjes midis tyre i afrojnë bashkë.

Hapi i Dyte: Perplasja Energjitike

Gjatë afrimit të shtresave, forcat e tërheqjes i prishin sipërfaqet dhe përberjen e të dy shtresave duke krijuar vale derisa shtresat bashkohet në disa vende dhe në kohë të ndryshme. Prej kësaj përplasjet e te drejtpërdrejtë çlirohet energji e madhe. Si prodhim të çlirimit të energjisë, krijohet një univers i fillestar. Gjithashtu, forca e përplasjes shkakton të dy shtresat të shkëputen dhe të tërhiqen larg njëra tjetrës.

Hapi i Tretë: Universi i Plotë

Shperthimi i mesiperm dhe universi i fillestar zgjerohet dhe ftohet, dhe krijohen valet microwave qe sot jane te dukura ne universin tone. Kronologjia e ngjarjeve eshte e njejta me ate te Modelit Standart: krijohen galaksite dhe objektet e tjera kozmike, dhe universi vazhdon te zgjerohet, e cila sot është e ngjashme me universin tonë.

Hapi i Katërt: Universi i Vjetër

Nga fundi i erës kozmike, universi është zgjeruar kaq shumë saqë galaksitë janë tepër larg me njera-tjetrën. Mbas trilion vjet shumica e yjeve janë shuar dhe universi është bosh në përgjithësi. Por ky është vetëm fillimi. Tërheqja e shtresave kozmike është e vazhdueshme, e pafundtë dhe i përplas shtresat herë pas herë, duke nxitur Modeli Standart i Sotshëm fillimin e vdekjes-rilindjes të universit.

Tani, kjo teori natyrisht nuk mund të provohet akoma, sepse limited tona të kuptimit na pengojnë të shqyrtesojme gjithësinë. Megjithatë teoria u modelua nga llogaritë matematikore shumë komplekse, gjë që ju mori Prof. Steinheardt dhe Prof. Turok gati 18 muaj për të përfunduar. Sot, teoria e tyre po shqyrtohet nga fizicientë, astronomistë, etj.

Sipas teorisë të Big Bang:

-Para Big Bang universi që shumë i nxehtë dhe shumë i vogël, dhe materja ekzistonte veten në formën e kuarkeve të lirë.

-Pas shpërthimit të Big Bang ndodhi:

1. Zgjerim i shpejtë dhe universi gradualisht u ftoh.
2. Kuarket u bashkuan dhe formuan Hadronet.

3. Forcat u ndanë (elektromagnetike, bërthamore dhe graviteti)

4. Materja (atomet) u formua.

5. Materja lindi galaksitë, yjet, planetet, etj.

Doja të ilustroja ndarjen e elementeve themelore dhe të shpjegoja krijimin e universit. Vijon më poshtë:

Elementet Atomike:

Elektron Proton Neutron

Elementet Nen-Atomike:

Fermion - elementet nën-atomike që përbëjnë materjen dhe anti-materjen, përmbledh:

A. Materja - e cila përbëhet nga:

I. Lepton: Element strukturor fillestar pa përmasa dhe struktura të brendshme. Ka masë të ulët dhe udhëton shpejt. Ky element nuk ndikon në mbajtjen e bërthames atomike.

Elektron – ngarkesë negative -1. 6X10e-19 dhe peshë 9. 1X10e-31kg. Rotullohet ½.

Muon – njësoj si elektroni por peshon 206. 77 herë më shumë dhe ka një gjysëm-jetë afërsisht 2. 197 mikroseconda.

Tau – një tjetër elektron i rëndë dhe me gjysëm jetë të 3X10e-13 sekonda.

Neutrino – nuk ka ngarkesë dhe ka masat e 1x10e6 te elektronit dhe rrotullohet ½. Ka tre lloj neutrino:

1. elektro-neutrino
2. muono-nutrino
3. tau-nutrino

II. Kuark: Element strukturor i vogël 10e-15m radii) dhe merr pjesë me forcat e forta bërthamore. Kuarket kanë ngarkesa elektrike fraksionale. Ky element strukturor ndikon në mbajtjen e berthamës atomike. Elementi identifikohet nga këto ngarkesa:

posht (d)= -1/3

lart (u)= +2/3

largues (s)= -1/3

tërheqës (c) = +2/3

mëposhtëm (b)= -1/3

mësipërm (t)= +2/3

III. Hadron - element i përbërë (neutron dhe proton)

Proton: Përbëhet nga 2(u)kuark+1(d)kuark me ngarkesë +1: ((+2/3)+(+2/3)+(-1/3)).

Neutron: Përbëhet nga 2(d)kuark+1(u)kuark me ngarkesë 0: ((-1/3)+(-1/3)+(+2/3)).

IV. Barion – përbërë nga tre kuark. Barionet përbëjnë materien e përditshme:

Proton: Përbëhet nga 2(u)kuark+1(d)kuark me ngarkesë +1: ((+2/3)+(+2/3)+(-1/3)).

Neutron: Përbëhet nga 2(d)kuark+1(u)kuark me ngarkesë 0: ((-1/3)+(-1/3)+(+2/3)).

Mëson: Përbëhet nga një kuark dhe një anti-kuark. Mesohet janë aktive në mbajtjen e nukleoneve në bërthamën atomike. Ka dy tipa: (1)Pion (pi-meson) dhe (2)Kaon (K-Meson).

V. Boson – mbajtësi i forcës. Lehtëson krijimin e elementeve themelore me masa më të mëdhaja. Ka tre lloje:

Foton – s'ka masë, s'ka ngarkesë dhe përmban forcën elektromagnetike. Ka efekt deri në pafundësi.

Gluon – s'ka masë, s'ka ngarkesë dhe përmban forcën e fortë bërthamore. Ka efekt deri në distancën 10e-13 cm.

W+, W- dhe Z0 – s'ka masë, përmban forcën e dobët bërthamore me ngarkesën përkatëse. Ka efekt deri në distancën 10e-15 cm.

Graviton – s'ka masë, s'ka ngarkesë, përmban forcën e gravitetit. Ka efekt deri në pafundësi.

B. Anti-Materja:

Nuk dihet shumë mbi anti-materien po fizicistët besojnë se kanë gjetur një element anti-materie quajtur positron. Ky element është i ngjashëm me elektronin por ka ngarkesë pozitivë. Anti-materiet e tjera janë anti-leptone dhe anti-kuark. Nuk besohet që bosonet vetë të kenë anti-element të përkatshëm.

Natyrisht, marrëdhëniet midis materies, anti-materies dhe zgjerimit drejt pafundësisë si dhe ndikimi i forcave elektromagnetike, gravitore, dhe bërthamore mbas një farë kohe do përfundojnë në prishjen e universit. Të paktën kështu mendohet.

4. Teoritë mbi lindjen e Gjithësisë

Teoritë mbi lindjen e Gjithësisë mund të përmblidhen në dy grupe thelbësore; atë të Bumit të Madh (Big Bang) dhe atë të Përhedhjes së Madhe (Big Bounce).

Sipas teorisë standarde të Bumit të Madh; papritur, në njëfarë mënyre, ndodhi diçka e veçantë me të cilën zuri fill koha, njëkohësisht edhe Gjithësia, e cila më pas u zmadhua.

Një mundësi tjetër për lindjen e Gjithësisë është ajo që mund të quhet Përhedhja e Madhe. Ideja është se përpara asaj ngjarjeje rroposëse që njihet si Bumi i Madh mund të ketë pasur një gjithësi që ishte më e madhe.

Kjo u bë gjithnjë e më e vogël dhe mbërriti në një gjendje të ndërmjetme mekaniko-kuantike të papërmbajtëshme, prej të cilës erdhi një gjithësi tjetër bymuese.

Modeli ekpirotik

Nëse do të kishte grimca në formë pike si strukturë themeltare të gjithçkaje, atëherë sipas teorisë standarde të Bumit të Madh, që në fillimet e Gjithësisë gjithçka duhej të ishte ngjeshur në një shkallë madhësie pafundësisht të imët si dhe temperatura do të kishte qenë e pafundtë. Në këtë mënyrë do të kishe të bëje me gjëra të pafundta dhe andralla që sjellin gjërat e pafundta është se nuk mund të arrish të llogarisësh dot asgjë.

Modeli ekpirotik është një ide e re që nuk do të zëvendësojë atë të Bumit të Madh, i cili prej 50 vjetësh mbizotëron të menduarit e kozmologëve mbi sesi nisi dhe evoluoi Gjithësia. Por në vend të një gjithësie që lind në një çast të dhunshëm nga një pikë pafundësisht të vogël të një dendësie të pafundtë, këndvështrimi i ri arsyeton se Gjithësia jonë u krijua kur një "membranë" paralele me botën tonë katër-dimensionale, u tërhoq nga kjo e fundit dhe u përplas me të në mënyrë kataklizmike pasi që të dyja kishin pasur evoluar ngadalë në hapësirën e një dimensioni të pestë të fshehtë, përgjatë një periudhe kohe tej mase të gjatë. Membrana u puthit pas botës sonë dhe energjia kinetike e përplasjes është kthyer në kuarqe, elektrone, fotone, etj. të cilat janë kufizuar të lëvizin përgjatë tre dimensionesh hapësire. Bumi i Madh, me këtë edhe zanafilla e Gjithësisë nisi në një mënyrë jo edhe aq të pazakonshme si ç'përfytyrohet.

Gjeometria energjitike e parapëlqyer nga këto dy botë është e sheshtë, kështu që përplasja e tyre prodhon një gjithësi të sheshtë Bumi të Madh. Sipas ekuacioneve të Einstein'it, kjo do të thotë se dendësia e përgjithshme e Gjithësisë është e barabartë me dendësinë kritike. Polet teke, të rënda, magnetike që prodhohen me mbitepri në teorinë standarde të Bumit të Madh nuk prodhohen fare në këtë skenar sepse temperatura pas përplasjes është tepër më e vogël për të prodhuar ndonjë nga këto grimca të rënda.

Efektet kuantike bëjnë botën rrjedhonjëse katër-dimensionale të valëzohet përgjatë dimensionit të posaçëm që ndodhej përpara përplasjes

kështu që përplasja në disa vende ndodh në kohë pak më të ndryshme se nga disa të tjera. Në kohën kur përplasja është kryer e tëra, valëzimi çon në ndryshime të vogla të temperaturës, çfarë mbjell luhatje temperature në sfondin e micërvalëve si dhe mbrujtjen e galaksive.

Mund të zëvendësoje Teorinë e Fryerjes (Inflacionit)

Teoria e Fryerjes u zhvillua në vitet 80-të nga Alan Guth (MIT), Andre Linde (Stanford), Andreas Albrecht (UC Davis) dhe Steinhardt. Ajo mbështetet në teorinë e Fushës Kuantike dhe përpiqet të llogarisë njëtrajtshmërinë, në dukje, të Gjithësisë. Po të hedhësh vështrimin në një drejtim në qiell, do të vëresh disa veçori të Gjithësisë - galaksi dhe tufa galaksish - të cilat i përngjajnë atyre që ndodhen në një drejtim tjetër. Teoria e Fryerjes e përllogarit këtë duke vendosur të gjithë materien në një spërkë në fillimet, pastaj duke e shkrehur atë jashtë me shpejtësi më të madhe se të dritës në një periudhë fryerje ku gjithçka u zhvillua nën rregulla të përngjashme pa pasur parasysh se për ku po drejtohej.

Në të njëjtat përfundime të çon edhe modeli i përplasjes së branave. Por Teoria e Fryerjes nuk i drejtohet idesë se mund të ketë dimensione të tjera.

Në koncept, modeli ekpirotik është ndryshe. Nuk është aspak duke ndodhur ndonjë fryerje apo ndryshim i shpejtë. Qasja drejt përplasjes zë vend tepër ngadalë përgjatë një periudhe tepër të gjatë kohe. Gjithësia është e njëtrajtshme sepse përplasja dhe nisja e fazës së Bumit të Madh ndodhin pothuajse njëherësh gjithandej.

Kozmologjia e fryerjes parashikon një spektër valësh gravitacionale që mund të jenë të shqueshme në sfondin kozmik të micërvalëve. Modeli ekpirotik nuk parashikon ndonjë efekt valësh gravitacionale që mund të shquhen në këtë sfond.

Atëherë, çfarë ka përtej kufijve të Gjithësisë ?

Dimensioni i pestë është ajo që ka përtej caqeve të Gjithësisë, thonë krijuesit e kësaj ideje. Ndonëse arsyetojnë se në fakt nuk ka caqe. Membrana, apo "brana"(ang. brane/s) si ç'i quajnë teoricienët, duhet të kenë pluskuar si fletë letre përgjatë këtij dimensioni të pestë të cilin edhe vetë shkencëtarët e pranojnë se e kanë të vështirë ta përfytyrojnë intuitivisht. (Mënyra jonë e rëndomtë e shikimit të hapësirës fizike 3 përmasore, së bashku me kohën, përbëjnë katër dimensionet e njohura).

Çdo fund i dimensionit të pestë është kufizuar nga një branë e pafundtë. E tillë mund të jetë gjithësia jonë e dukshme, e cila përpara përplasjes mund të ketë pasur ose mund të mos ketë pasur materie normale. Në fundin tjetër të dimensionit të pestë gjendet një branë me fizikë të ndryshme nga e jona. Branat në mes, ndonëse mund të përmbajnë materie, nuk janë gjithësi, dhe nuk i ngjajnë branës në të cilën banojmë ne. Këto brana bashkë me hapësirën në mes tyre janë të fshehura pasi grimcat dhe drita nuk munden ta përshkojnë hapësirën në mes branave. Vetëm

graviteti është në gjendje të çiftojë materien e një brane kufizuese me të tjerat. Tjetër, mund të ketë brana të tjera në interval, të cilat janë paralele me branat kufizuese dhe që mund të mbajnë energji.

Kjo teori është e mbështetur në teori të tjera mbi mundësinë e pasjes së dimensioneve të shumëfishta të cilat po pranohen gjithnjë e më tepër. Teoria është zhvilluar nga Neil Turok i Cambridge University, Burt Ovrut i University of Pennsylvania, dhe Paul Steinhardt e Justin Khoury të Princeton University.

Nuk ka arsye të pranojmë si të vërtetë, sipas këtij sistemi konceptual referimi, pasjen e gjithësive të tjera andej, thotë Burt Ovrut.

Nëse në membranën tonë do të kishte pasur materie të ngjeshur përpara Bumit të Madh atëherë imtësia më e vogël do të ishte ajo e një filli, gjë që zbut sjelljen e pafundtë të rastit të teorisë standarde të Bumit të Madh në diçka të fundtë. Që do të thotë se gjithçka ishte shkërmoqur në një shkallë tepër të vogël por jo pafundësisht të vogël. Kjo të jep shpresë të mund të jesh në gjendje të llogarisësh se çfarë ndodhi në fillimet e Gjithësisë. Termi ekpirotik vjen nga fjala e lashtë greke ekpyrosis, që do të thotë flakadan (zjarr apo përleshje shkatërrimtare). Sipas një modeli stoik të lashtë kozmologjik me të njëjtin emër, Gjithësia u krijua nga një shpërthim i vrullshëm zjarri. Teoricienët e ditëve tona thonë se kjo ide e lashtë nuk është e ndryshme nga përplasja e parashtruar në modelin e ri. Sidoqoftë, sipas nocionit stoik, ky proces mund të përsërisë vetvehten në të ardhmen.

5. Krijimi i Universit sipas shkencës

Llogaritjet e probabilitetit e përgënjeshtrojnë "Rastësinë"

Gjithçka që studiuam deri tani tregon haptazi se çdo ekuilibër numerik që u përcaktua menjëherë pas Big Bengut, ka një rëndësi me të vërtetë jetike për vazhdimësinë e racës njerëzore. Pra, si fuqia shpërthyese, vlerat e katër forcave themelore dhe të gjitha ato ndryshore, të cilat do t'i analizojmë në faqet vijuese, janë harmonizuar në atë mënyrë që të formojnë një univers ku të mund të jetohet dhe kjo harmoni është përllogaritur me delikatesën më të madhe.

Në këtë pikë le të marrim në dorë pretendimin e rastësisë (koinçidencës) të materializmit. Rastësia është term matematikor dhe nëse diçka mund të rea-lizohet me anë të rastësisë mund ta llogarisim në saje të matematikës së probabilitetit. Le ta shohim së bashku.

Vallë, sa është mundësia që një univers, i cili na jep mundësinë e jetës, të jetë vetëformuar rastësisht së bashku me të gjitha ndryshoret fizike? Një e bilionta e bilionit? Një e trilionta e trilionit, të trilionit? Apo më tepër?

Këtë shifër e zbuloi matematicieni i njohur anglez Roxher Penrouz, shok i ngushtë pune me Stefan Hauking. Duke futur në llogaritje të gjitha ndryshoret fizike evidentoi se në sa forma të ndryshme mund të rreshtoheshin, dhe për të formuar një mjedis ku mund të jetojnë gjallesat përcaktoi rezultatet e probabiliteteve të tjera të mundshme të Big Bengut.



Probabiliteti për të formuar një Univers ku mund të ketë jetë:

Llogaritjet e matematicienit anglez Roxher Penrouz demostruan se probabiliteti i formimit të rastësishëm të një universi të përshtatshëm për jetesë është 1 në 1010123. Për të përkufizuar këtë numër fjala "e pamundur"mbetet e pafuqishme.

1010000000000000000000000000000000000000000000000000000000000000 00000000000000000000000000000000 00000000000000000000000000000000

Probabiliteti i gjetur nga Penrouz ishte 1010123.

Është e vështirë bile të mendohet se ç'kuptim ka ky numër. Në matematikë një numër i shkruar në formën 10123 do të thotë, 1 i ndjekur nga 123 zero. Kjo është një shifër astronomike, e cila është më e madhe se numri i mbledhjes i të gjithë atomeve të universit, pra, 1078. Por numri i gjetur nga Penrose është shumë herë më i madh se ky i fundit.

Këtë shifër le të mundohemi ta shpjegojmë me disa shembuj: 103 do të thotë 1000. 1010123 do të thotë një numër, i cili formohet nga një 1 i ndjekur nga 1000 zero. Nëse pas 1 vendosim nëntë zero kjo formon 1 miliard, 12 zero, 1 trilion... Por të vendosësh pas numrit 1* 10123 zero nuk mund të përkufizohet apo të ketë një emërtim as në matematikë.

Në termat praktike në matematikë probabilitetet më të vogla se 1 në 1050 nënkuptojnë një "probabilitet zero". Por numri i Penrouz ishte një numër tri-liarda të triliardit herë më i madh se ky. Ai numër formohet nga 1 i pasuar prej 10123 zerosh. Shkurtimisht ky numër na tregon pamundësinë për të shpjeguar universin nëpërmjet rastësisë.

Roger Penrose: Ky numër na tregon edhe njëherë mprehtësinë dhe saktësinë e qëllimit të Krijuesit. Roxher Penrouz bën këtë koment mbi këtë numër që i kalon muret e logjikës:

"Ky numër, na tregon edhe një herë mprehtësinë dhe saktësinë e qëllimit të Krijuesit, pra, një mundësi në 1010123. Ky është me të vërtetë një numër i jashtëzakonshëm. Këtë asnjë njeri nuk mund të arrijë ta shkruajë në formën e një numri natyror sepse i duhet të shtojë pas numrit 1 edhe 10123 zero. Edhe sikur t'i shtojmë nga një zero në vend të të gjithë protoneve dhe neutroneve të universit përsëri do ta kishim të vështirë të përfitonim një numër të tillë. ”

Këto shifra, të cilat përkufizojnë saktësinë e ekuilibreve dhe të projektimit (dizenjimit) luajnë një rol themelor që i tejkalon kufinjtë e inteligjencës sonë. Janë tregues që vërtetojnë se universi kurrë nuk mund të jetë "fryt i rastësisë", por ashtu siç e shprehu edhe Penrouz, "demostrues i mprehtësisë dhe i saktësisë së Krijuesit".

Në fakt për të kuptuar se universi nuk është "fryt i rastësisë", nuk është e nevojshme të dihen këto llogaritje probabiliteti që treguam më lart. Sepse çdo person që hedh një sy përreth mund ta perceptojë kudo në univers këtë krijim të qartë. Padyshim që pas një shpërthimi të rastësishëm me radhitjen vetvetiu të atomeve nuk mund të formohet një univers i përsosur, e brenda tij sisteme, Dielli, Toka, njerëzit në të, kafshët, bimët, insektet dhe gjithçka tjetër. Detajet që evidentojmë kudo nga kthejmë kokën ne, janë një nga një, argumente të ekzistencës së Perëndisë, fuqisë së Tij supreme dhe të një krijimi të vullnetshëm. Por këtë mund ta konceptojnë vetëm ata njerëz që arrijnë të arsyetojnë:

"Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe

përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), ka argumente për një popull që arsyeton". (Bekare, 164)

Katër Forcat

Faktikisht shpejtësia e shpërthimit te Big Bengu është vetëm një nga ato ekuilibra numerikë të formuara në atë çast në univers. Pas Big Bengut dolën në pah "përmasat", të cilat përcaktojnë strukturën e universit tek e cila ne bëjmë pjesë, dhe këto ishin të përcaktuara në vlera të duhura.

Këto përmasa përbëjnë atë që sot fizika moderne i quan "katër forcat themelore". Të gjitha strukturat dhe lëvizjet fizike në univers kryhen në saje të ekuilibrit dhe relacioneve midis këtyre katër forcave.

Këto janë: 1. ***forca tërheqëse e tokës***, 2. ***forca elektromagnetike***, 3. ***forca e fuqishme bërthamore*** dhe 4. ***forca e dobët bërthamore***. Forcat e fuqishme dhe të dobëta bërthamore përcaktojnë vetëm strukturën përbërëse të atomit. Kurse dy të tjerat, pra, forca tërheqëse e tokës dhe forca elektromagnetike, përcaktojnë marrëdhëniet midis atomeve dhe gjithashtu të gjithë ekuilibrat e objekteve materiale (dmth, vetë materien). Këto katër forca kontrollojnë dhe përcaktojnë të gjithë materien e shpërndarë në univers pas Big Bengut.

Tek krahasojmë këto forca me njëra-tjetrën, përpara na del një pamje shumë interesante. Këto katër forca zotërojnë vlera jashtëzakonisht të ndryshme nga njëra-tjetra. Nëse do të kërkojmë të përdorim një njësi të përbashkët për raportet e të gjitha këtyre forcave, do të shkruajmë diçka të tillë: Forca e fuqishme bërthamore : 15 Forca e dobët bërthamore : 7. 03 x 10-3 Forca elekromagnetike: 3. 05 x 10-12 Forca tërheqëse e tokës: 5. 90 x 10-39

Nëse do të shihnim me kujdes numërat e mësipërm, do të vërejmë një dife-rencë shumë e madhe midis tyre. Psh, vlera e forcës së fuqishme bërthamore është 25 e ndjekur kjo nga 38 zero më e madhe se forca tërheqëse e tokës! Vallë, cila është arsyeja e një diference të tillë?

Biologu molekular i njohur Majkëll Denton në librin me titull Fati i Natyrës: Si shfaqin qëllim ligjet biologjike në univers, shpjegon një të vërtetë kështu: Universi është krijuar me një projektim të veçantë që synon jetën e njeriut.

Biologu molekular Majkëll Denton në librin "Nature's Destiny": How the Laws of Biology Reveal Purpose in the Universe (Fati i Natyrës: Si shfaqin që-llim ligjet biologjike në univers), kësaj pyetjeje i kthen këtë përgjigje:

"Në qoftë se forca tërheqëse e tokës do të ishte një trilion herë më e madhe, atëherë universi do të kishte një sipërfaqe më të vogël dhe jetëgjatësia do të ishte më e shkurtër. Përmasa e një ylli përafërsisht do të ishte një trilion herë më i vogël se Dielli ynë dhe jetëgjatësia e tij do të ishte vetëm një vit. Nga ana tjetër nëse forca tërheqëse e tokës do të ishte pak më

e vogël se realja nuk do të arrihej kurr-sesi të krijohej ndonjë yjësi apo galaktikë. Në të njëjtën mënyrë edhe te forcat e tjera vihet re një ndjeshmëri e tillë. Nëse forca e fuqishme bërthamore do të kishte një vlerë paksa më të vogël atëherë i vetmi element statik do të ishte ai atom, i cili në bërthamë përbëhet nga dy protone. Në këtë gjendje në univers nuk do të mbesë fare hidrogjen dhe nëse yjet dhe galaktikat do të ishin të krijuara, do të kishin një strukturë shumë më ndryshe nga ajo ç'kanë sot. Qartësisht nëse këto konstante dhe këto forca themelore nuk do të kishin vlerat preçize, të cilat zotërojnë sot, nuk do të ekzistonte asnjë yll, supernovë, planet apo atom. Me një fjalë nuk do të kishte jetë".

Pol Devis bën një koment të tillë mbi përcaktimin (përpilimin) e ligjeve themelore të fizikës në univers në harmoni me jetesën e njeriut:

"Nëse natyra do të kishte zgjedhur vlera numerike pak më ndryshe, universi do të ishte një vend shumë më ndryshe. Dhe me shumë mundësi ne nuk do të gjendeshim këtu për ta parë... Dhe njeriu me studimin e kozmologjisë, pabesueshmëria sa vjen e bëhet më e dukshme. Zbulimet e fundit mbi zanafillën e universit tregojnë se ky univers, i cili është vazhdimisht në zgjerim përbëhet nga një strukturë shumë preçize, e cila lind një admirim të madh".

Arno Penzias, me zbulimin e argumentit të madh të sfondit kozmik të rrezatimit, së bashku me Robert Uillson më 1965 fituan çmimin Nobel. Penzias mbi këtë projektim të mahnitshëm bën këtë koment:

"Astronomia na shpie në një ngjarje të mahnitshme; një univers i krijuar në mosekzistencë. Është ndërtuar mbi një ekuilibër shumë të ndjeshëm me kushtet e duhura për të lejuar jetën në tokë. Ky është një univers i planifikuar për këtë qëllim".

Te këto pjesë, të cilat i shkëputëm nga thëniet e shkencëtarëve të njohur vërejmë se të gjithë kanë evidentuar të njëjtin realitet. Kjo e vërtetë, i shfaqet çdo personi, i cili studion këto sisteme dhe ekuilibre të universit që na mahnisin pa masë. Është shumë e qartë që në të gjithë universin ekspozohet një projektim superior dhe një sistem i përsosur. Zoti i këtij sistemi padyshim është Allahu që krijon gjithçka të përsosur. Allahu na tërheq vëmendjen në një nga ajetet e Tij mbi përsosmërinë dhe maturinë në krijimin e universit:

"(Ai është që) Vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, Ai nuk ka as fëmijë e as shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur". (Furkan, 2)

6. Origjina e botës

Çdo gjë që ekziston rreth nesh – bota që na rrethon – nga vjen e gjitha kjo? Në radhë të parë, përse është ajo aty? Sa i vjetër është Universi? Apo a është ai gjithmonë aty? A jemi ne me të vërtetë të veçantë në kohë dhe hapësirë? A do të arrimë të kuptojmë se si filloi gjithçka? Nga është bota?

Kozmologjia po punon për të studiuar edhe cepin më të skajshëm të Universit. Për herë të parë mund t'u japim shpjegim pyetjeve rreth fillimit dhe zhvillimit të Universit me anë të vëzhgimeve reale. Me teleskopët e sotshëm, me përshpejtuesit e grimcave dhe me super kompjuterët, shkencëtarët po arrijnë, çdo herë e më tej, ta përplotësojnë imazhin se si u krijua Universi.

Udhëtimet në kohë me anë të dritës

Në Berkeley University të Kalifornisë astrofizikani Saul Perlmutter studion „yjet eksploduese". Imazhet ai i merr nga teleskopi hapësinor Hubble. Astronomët i quajnë këta yje Supernova. Supernovat hyjnë në ngjarjet më të dhunshme të Universit. Ato eksplodojnë me fuqinë e trilion trilionë bombave atomike. Drita e tyre shndrit për një kohë të shkurtër më shumë se e një galaktike të tërë. Për shkak se drita e tyre mund të përllogaritet shumë saktë, Perlmutter mundet të na japë largësinë e tyre nga Toka dhe, në këtë mënyrë, mund të hedhim një vështrim nga e kaluara.

Perlmutter: Të gjithë këto Supernova janë ekplozione që kanë ndodhur para një, dy, tre miliardë vitesh. Në çastin kur studiojmë një nga këto supernova, ato na tregojnë diçka rreth këtij momenti të historisë para një apo dy miliardë vitesh, ndërkohë që ne përpiqemi të qëmtojmë sa më shumë e mundur, për të zbuluar se si ka qenë Universi para dy, pesë apo dhjetë miliardë vitesh.

Pra çdo vëzhgim drejt gjithësisë është po ashtu edhe një udhëtim në kohë, mbrapa në të kaluarën. Yjet, galaktikat, mjegullnajat spirale janë aq larg, saqë dritës i duhet shumë rrugë për të bërë deri në tokë. Një rreze drite për një vit kalon një rrugë prej 9 ½ miliardë kilometrash. Dritës së Diellit tonë i duhet vetëm 8 minuta që të mbërrijë tek ne. Por dritës së Andromedës, galaktikës më të afërt me Rrugën e Qumështit, i duhen 2 ½ milionë vite deri tek ne.

Shkretëtira në Kili. Këtu ndodhet vegla më e madhe e njerëzimit në tokë e bërë për të vëzhguar Gjithësinë. Është Very Large Telescope, shkurt VLT.

Ky teleskop nuk është vetëm një dylbi i fuqishëm, por gjithashtu edhe një makinë kohe. Me të shkencëtarët kanë mundësinë të depërtojnë sa më larg në Kozmos. Në thellësitë e Gjithësisë ata kërkojnë zonat ku u krijuan yjet e para nga gjella kozmike e zanafillës që më pas do të formonin

formacionet komplekse dhe të mrekullueshme: galaktikat, prej të cilave është ndërtuar Universi.

Dr. Natascha Förster Schreiber dhe ekipi saj nga Instituti Max Planck për fizikë extraterrestrale në Garching janë në kërkim të lidhjes mes yjeve të para dhe galaktikave më të hershme. Si qe e mundur që nga strukturat e para difuze të zhvilloheshin forma të qarta të një galaktike? Imazhet e para që morëm nga VLT-ja na shfaqin sisteme yjesh 10 miliardë vit-drite larg. Trajta të paqarta skematike. Tani shkencëtarët duhet të vendosin rreth një njolle drite.

Vetëm atëherë mund t'ia drejtojnë të gjithë forcën e dritës të Teleskopit objektit të përzgjedhur. Po morën një vendim të gabuar, do me thënë Teleskopin ia drejtojnë një mjegullnaje difuze yjesh në vend një galaktike, kjo do të thotë të humbasësh kohë teleskopi shumë të çmueshme.

A ka më shumë se një univers?

Në Stanford University të Kalifornisë fizikani Andrej Linde ka një shpjegim shumë të thjeshtë për ekzistencën e Materies: Universi jonë është thjesht njëri nga pafund shumë universe tjerë paralele me pafund shumë tipare të ndryshme. Ka pafund botë, në të cilat sundojnë mbase ligje krejtësisht tjera fizike, ndryshe nga bota jonë. Dhe krejt rastësisht, ky i yni është krijuar ashtu, që ne të mund të jetojmë.

Andrej Linde: Fill pas Shpërthimit të Madh Universi nis të prodhojë pjesë të tij të veta të ndryshme. Dhe mbasi ky proces po zhvillohet përjetësisht, ka mundësi të lindin gjithë universet e mundshme, madje edhe ato më të pamundshmit. Disa mund të kenë ligje fizike që mund të ngjasojnë me tonat. Dhe disa herë lindin universe me ligje krejtësisht të ndryshme. Ne mund të udhëtonim shumë e shumë larg për të arritur te këta universe dhe të shikonim diçka krejt tjetër. Por për të udhëtuar aq larg nuk jemi në gjendje ta bëjmë fizikisht. Atëherë mendojmë: ky është Universi im dhe ky është një tjetër univers ku jeton dikush tjetër. Këtë unë e quaj imazhin e Multiversit.

Multiversi është më shumë se një ide. Linde e ka përllogaritur këtë dhe fizikanët tjerë nuk e shohin idenë e tij si të pamundur. Por si është krijuar në fakt? Përgjigjja tij: fjalëpërfjashëm nga Hiçi. Nga Hiçi e ka llogaritur formulën e Multiversit. Sipas Teorisë së Lindes ka një Vakuum zanafille me luhatje të vogla. Nga kjo është krijuar Universi. Këto lëvizje kanë qenë shkak për shpërndarjen e parregullt të Materies: në disa vende u formuan galaktika dhe disa të tjera hapësira boshe. Por nga ky vakuum luhatës nuk lindi vetëm një univers, por pafunsisht shumë. Koperniku na mësoi që nuk jemi në qendër të Universit. Giordano Bruno vuri re se yjet janë diej njësoj si yni. Hubble na vërtetoi se Universi zgjerohet. A do të na mësojë Andrej Linde që Universi jonë me qindra miliarda galaktika nuk është i vetmi?

Saul Perlmutter: Në të vërtetë duhet të supozojmë mundësinë e ekzistencës së universeve të të gjithë llojeve dhe sasive të mundshme dhe

se të gjithë këta mund të ekzistojnë në të njëjtën kohë – në qoftëse ekziston diçka e tillë si koha.

Harald Lesch nuk është dakord. Ai mendon se shkenca nuk është në gjendje t'i japë përgjigje një pyetjeje të tillë, sepse sipas parakushteve që shtron, është e pamudur të ketë një përgjigje. Çdo mendim që braktis sistemin e vet për të nuk është më shkencë.

Harald Lesch: Për çdo shkencë natyrore është deçizive që së pari të respektojmë kauzalitetin dhe së dyti kundërvënien midis hipotezës dhe eksperimentit. Kur kjo nuk respektohet, dhe kjo ndodh per Definition në rastin e universeve paralele, atëherë dy pikat e rëndësishme, që shkenca ka zbatuar me aq madhështi dhe triumfalitet në tre shekujt e kaluar, nuk ekzistojnë më.

Në Penn State University të Pennsylvanisë atstofizikanët Martin Bojowald dhe Abhay Ashtekar janë të një mendimi tjetër. Ata kanë llogaritur një formulë, e cila vërteton matematikisht, që nuk ka patur asnjëfarë Shpërthimi të Madh, por çdo gjë ka nisur me një Big Bounce, një proces sustimi. Një tezë e bazuar matematikishit për kohën para Shpërthimit të Madh është e llahtarshme, sepse sipas teorise klasike të Shpërthimit të Madh, nuk duhej të kishte fare kohë para Shperthimit. Koha dhe hapësira do të duhej pra të ishin krijuar vetëm në momentin e Shpërthimit.

Problemi që kemi deri më sot është: sa më larg të zhvendosemi në të kaluarën e Universit, aq më pranë do t'i vijmë çastit, kur e tërë masa e Gjithësisë tkurret shumë e më shumë, deri në momentin që volumi arrin te zeroja, ndërsa trysnia pafund. Por në këtë pikë çdo teori merr fund. Përshkrimi i një gjendjeje të tillë nuk ka qenë i mundur me metodat tona shkencore dhe prandaj rrëzohet edhe teorikisht. Pse Abhay Ashtekar dhe Martin Bojowald vazhdojnë të bëjnë akoma llogari edhe pse fizika e tyre duhej të ndalonte në momentin e Shperthimit të Madh?

Shkanca ka mundur deri më tani ta shpjegojë Universin ose me Teorinë e Relativitetit ose me Teorinë e Kuanteve, por që t'i kombinojë të dy këta principe matematikore s'ka arritur deri më tani askush. Të gjitha llogaritë nuk shkojnë më tej se deri tek momenti i Shpërthimit të Madh. Ashtekar dhe Bojowald mundën për herë të parë të kombinojnë dy teoritë dhe arritën në një ekuacion plotësisht tjetër. Meqenëse nuk do ecnin larg me metodat normale përllogaritëse, ata vet kohës i japin një strukturë hapsinore. Shkurt: llogaritë i bënin në dimensionin e katërt. Kjo lloj llogaritjeje quhet teoria e gravitetit kuantik të lakimit (Loop Quantum Gravity). Në momentin kur të dy shkencëtarët përdorën teorinë dhe përllogaritjet e tyre për kohën para Shpërthimit të Madh, si rezultat fituan diçka apsolutisht të habitshme: llogaritjet nxorrën një univers paraardhës.

Abhay Ashtekar: Megjithatë e papritura më e madhe ishte që me të vërtetë në anën tjetër – pra para Big Bangut – ka patur një tjetër univers.

Këtë nuk e kemi pritur. Në fillim nuk isha i sigurt në mos bëhej fjalë për një efekt artificial. Por me llogaritjet e mëtejme pamë se kishim të bëjmë me një efekt real fizik. Në vend të një fillimi absolut, a mos është fjala për një cikël pa mbarim? A mos vallë Bojowald dhe Ashtekar gjetën përgjigjen e pyetjes „çka përpara"? Gjer më tani thuhej: kujt i ec për dore të kombinojë Terinë e Relativitetit me atë të Kuanteve ai do ta zgjidhi enigmën e Formulës së Botës! A mos ia kanë dalë Ashtekar dhe Bojowald?

Harald Lesch: Ne nuk kemi kurrfarë mundësie për të kuptuar të tërë sistemin. Për këtë duhet të qëndronim jashtë sistemit. Atëherë dhe vetëm atëherë mund t'i përgjigjeshim pyetjes se ç'kishte para Shpërthimit të Madh, apo dhe pyetjes të famshme, se nga po zgjerohet në të vërtetë Universi? Me këtë duhet të pajtohemi. Kozmologjia është një arqitekturë e brendshme, pra mund të na japë vetëm tiparet e brendshme të Universit. Vetëm në qoftë se dalim jashtë tij do të kishim një shansë. Por përderisa jemi brenda, dhe ne jemi brenda, s'kemi asnjë mundësi.

7. Edhe njëherë mbi origjinën e Universit

"Po të kisha mundësine të mbyllesha në lëvoshgën e një arre do të ndihesha mbret i hapësirës së pafundme.. "

(Shekspir, Hamleti, akti II, skena II)

Hamleti ndoshta donte të thoshte që qenia njerëzore duke qenë i kufizuar fizikisht, ka një mendje të lire të eksplorojë të gjithë universin dhe të bëjë dhe udhëtime aventurore, aty ku dhe ëndrrat më fantastike nuk mundin ta pushtojnë.

Sot rreth këtij problemi egzistojnë pyetje të shumta, ku secila kërkon një përgjigje të saktë dhe të kuptueshme.

Universi është me të vërtetë i pafundëm apo është vetëm shumë i madh? Është i përjetshëm, apo ka një jetë shumë të gjatë? A është e mundur që një mendje e kufizuar të kuptojë një univers të pafundëm?

Mos po rrezikojmë të përfundojmë si Prometeu mitik, që i vodhi zjarrin Zeusit për t'ia dhënë njeriut, duke sakrifikuar jetën e tij, duke e lidhur rreth nje shkembi, ku nje shqiponje ushqehej me mëlçine e tij?

Sipas S. Hawkink, që është më i madhi fizikant pas Ajshtajnit, mbase dhe më i madhi i të gjithë kohëve: "... besoj që mundemi dhe duhemi të kërkojmë për të kuptuar universin. Kemi bërë tashme progrese të shënueshme, mbi të gjitha këto vitet e fundit. Akoma nuk kemi përpunuar një tablo të plotë, por ndoshta nuk jemi shumë larg asaj. "

Dijmë që universi nuk ka ekzistuar gjithmonë në gjendjen në të cilën e shohim sot. Në të kaluarën, në një epokë të caktuar, ka ndodhur një ngjarje që bëri të mundur ndezien e yjeve, që do të thotë që drita e ardhur nga yjet më të largëta, akoma nuk kanë patur kohën për të aritur tek ne (në tokë).

Kjo shpjegon atë që përse qielli natën nuk vezullon në të gjitha drejtimet. Por në qoftë se yjet kanë ekzistuar gjithmonë, përse do të ishte e nevojshme akti i ndezies së tyre disa miliarda vitesh më parë? Sipas filozofit Emanual Kanti, universi ka ekzistuar përgjithmonë, kurse për pjesën më të madhe të njerëzve, besojnë që universi është krijuar vetëm pak mijëra vitesh para se ajo të shfaqej.

Por a është i ketij mendimi astronomi E. Hubble? Në vitin 1923, do të zbulonte që shumë nga njollat të quajtura mjegullnaja, ishin në realitet të tjera galagtika (që janë grumbullime yjore që përmbajnv miliarda yje), por të ndodhura në një distancë shumë të madhe ndaj nesh.

Ai llogariti që koha e nevojshme që drita e lëshuar nga yjet e këtyre mjegullnajave të arrinte në tokë do të ishte e rendit të milionave ose miliardave vite. Kjo do të thotë qv universi nuk mund të jetë krijuar disa mijra vitesh më parë siç mendonin disa. E. Hubble do të zbulonte edhe një fenomen tjetër mjaft interesant.

Duke analizuar dritën e galagtikave që i afroheshin ose i largoheshin tokës, ai do të kuptonte që pothuaj të gjitha galagtikat që duke u larguar, përveç kësaj, sa më larg që ato ishin nga Toka aq më shpejt largoheshin.

Hubble arriti ne konkluzionin që në shkalle kozmike çdo galaktike është duke u larguar nga Toka ose nga njëra- tjetra, me fjalë të tjera Universi është duke u zgjeruar.

Zbulimi që Universi zgjerohet vazhdimisht, është zbulimi më i madh intelektual i shekullit të XX. Ky zbulim të çon në një përfundim mjaft të debatushem rreth orgjinës së universit.

Nëse galagtikat largohen njëra nga tjetra, do të thotë që në një të kaluar të largët, ato kanë qenë shumë afër me njëra tjetrën, dhe në bazë të shpejtësisë aktuale të zgjerimit, mund të llogaritim se sa afër kanë qenë ato rreth dhjetë ose pesëmbedhjetë miliarda vitesh më parë.

Sipas mendimit filozofik dhe atij shkencoro- astronomik, çdo ngjarje është shkaktuar nga një ngjarje e mëparshme, pra është "pasojë". Ngjarja "pasojë"shërben si "shkak"për ngjarjen pasardhëse. Me fjalë të tjera vargu i ngjarjeve shkak - pasojë i ngjan një zinzhiri ku çdo hallke e tij simbolizon një ngjarje të caktuar. Por zinzhiri i ngjarjeve ka një hallkë të fillimit. Kush e ka shkaktuar atë?

Ndodhemi perpara një problemi ku shumë shkencëtarë, nuk kanë patur shumë dëshirë t'i afroheshin ose kanë kërkuar t'i shmangen. Disa prej tyre, kryesisht rusët, i përmbaheshin mendimit se Universi nuk ka patur një fillim; disa të tjerë pohonin se çështja e orgjinës së Universit nuk është një problem shkencor por një çështje metafizike ose fetare.

Kurse S. Hawking thotë:"Sipas pikpamjes time, një trajtim i tillë nuk është i denjë për një shkencëtar të vërtetë.

Në qoftë se ligjet e natyrës nuk do të vepronin në fillim të universit, nuk do të ndodhte kjo edhe në të tjera momente të evolimit të Universit?... origjina e universit duhet vënë mbi baza shkencore.

Mbase do të jetë një detyrë mbi mundësitë tona, por ja vlen ta provojmë që t'i afrohemi asaj.

Big Bang ose Shpërthimi i madh

Sipas Hawking, Universi ka patur një fillim, por informacionet mbi natyrën e këtij fillimi janë të pakta. Origjina e Universit mund të shpjegohet me teorinë Big Bang ose i quajtur ndryshe "Shpërthimi i Madh".

Thelbi i kësaj teorie konsiston: gjithçka ka filluar në një moment në të cilin i gjithë universi dhe çdo gjë rreth saj kanë qenë përqendruar në një pikë me një densitet dhe temperaturë të pafundme.

Pas shpërtimit të madh, në një të qindten e sekondës së parë, ku temperatura ka patur vlerën e qindra miliarde grade, universi fillon pak nga pak të zgjerohet.

Fillojnë të lindin grimcat e para të lehta si fotonet, elektronet, neutrinot si dhe antigrimcat e tyre të cilat janë me shumicë, si dhe pak nga grimcat e protonit dhe neutronit.

Pas tre minutave të mëvonshme, temperatura zbret në një miliard gradë, dhe në këtë moment protonet dhe neutronet fillojnë të kombinohen duke formuar bërthamat e elementit helium, hidrogjen si dhe te disa elementeve të tjera të lehta.

Pas qindra dhe mijra vitesh temperatura bëhet më e vogël se njëmijë gradë, dhe elektronet zvogëlojnë shpejtësinë e tyre në një masë të tillë që bërthamat e lehta mund t'i kapni ato duke formuar kështu atomet e elementeve të lehta.

Do të kalonin miliarda vitesh kur do të lindinin elementet e tjerë si karboni dhe oksigjeni që janë elemente bazë prej të cilave jemi përbërë. Këto elemente do të lindnin nga djegia e heliumit në qendrën e çdo ylli. Ky është në vija të përgjithshme shpjegimi i fillimit të universit sipas teorisë Big Bang. Ja vlen të theksojmë që teoria e relativitetit të përgjithshëm të Ajshtajnit, nuk vlen për fillimin e universit, ku dhe vete ai nuk thotë asgjë për këtë çështje.

Ose për të qenë më të saktë, Ajnshtajni kishte përshtypjen që orgjina e universit i tejkalonte kufijtë e kërkimeve shkencore. Në qoftë se teoria e relativitetit të përgjithshëm nuk vlen për shpjegimin e fillimit të universit, cilat ligje të natyrës vlejnë për këtë akt fillimi?

Zoti nuk "luan"me zare

Lindja e mekanikës kuantike, e cila për dallim nga mekanika klasike, ka si objekt të saj sistemet mikroskopike (të nivelit atomik - molekular), mund të japë shpjegimet e munguara.

Dyshimi dhe kundërshtimi i Ajnshtajnit ndaj mekanikës kuantike janë formuluar me shprehjen famoze të tij: "Zoti nuk luan me zare. " Por në realitet fakte të shumta tregojnë që Zoti është një "lojtar"i aftë, në qoftë se do ta krahasonim universin me një kazino të madhe ku hidhen zare dhe rrotollohen rrotullat e fatit; të administrosh një kazino është një aktivitet me shumë rrezik, sepse mund të humbasësh para çdo here që hedh zare dhe rrotullon rruletën e fatit.

Por në qoftë se vëllimi i pikave që shënon dhe numri i rrotullimeve është i lartë, fitimet dhe humbjet janë mesatarisht të parashikueshme, edhe pse është i paparishikueshëm kur shënon ose rrotullon vetëm një herë.

Administratorët e kazinove dinë që mundësitë janë në gjysëm në favor të tyre, kurse klienti-lojtar ka mundësi të fitojë vetëm nëse luan në një numër të caktuar të hedhjeve të zareve ose xhirove të rrotullave. Pak a shumë e njejta gjë ndodh edhe me universin. Kur universi është i madh, siç është sot, një numër i lartë i "hedhjes" së "zareve" është mesatarisht i parashikueshëm.

Është kjo arsyeja që në sistemet relativisht të mëdha funksionojnë ligjet klasike nëpërmjet të cilave bëhen parashikime të sakta të ngjarjeve, kurse kur universi është shumë i vogël, siç ka qenë afër gjendjes Big Bang, futen në lojë ligjet kuantike me parimin e tyre të papërcaktushmërisë, i ngjashëm me fatin e një lojtari të vetem.

Duke vazhduar të hedhësh zare për të parë se çfarë do të ndodh më pas, universi në dallim nga ajo që pret, nuk ka një histori të vetme, por ka të gjitha historitë e mundshme, secila me një probabilitet të dhënë.

Hipoteza që universi ka një histori të shumëfishtë, mund te duket fantastiko-shkencore, por sot ajo konsiderohet nga shkenca një fakt i dhënë, të cilën e ka formuluar për herë të parë fizikanti i madh Richard Feynman.

Për të krijuar një përfytyrim rreth kësaj ideje: sqarojmë që për fizikën klasike çdo grimcë ka një histori të veten (grimca për të kaluar nga pika A në B ka një trajektore të caktuar), kurse sipas modelit të ri të një historie të shumëfishtë, grimcat mund të përshkruajnë të gjitha trajektoret e mundshme në hapësirë dhe në kohë.

Çdo trajektore është e lidhur me një valë që karakterizohet nga dy numra, njëra shpreh gjatësinë e valës dhe tjetra fazën e saj (kreshte apo grope).

Mundësia që një grimcë të kalojë nga A ne B gjendet duke mbledhur valët e "lidhura" me të gjitha trajektoret e mundshme qe kalojnë nga A në B.

Kjo, ndoshta duket pak absurde pasi në jetën e përditshme ne jemi familjarizuar me faktin që objektet shkojnë nga një pikë e fillimit në një tjetër vetëm duke ndjekur një trajektore të vetme.

Në të vërtetë kjo nuk mohon ose nuk bie në kundërshtime me hipotezën Feynman të historisë shumëfishe (ose të mbledhesve të historive), sepse kur objektet janë të dimesioneve të mëdha (sisteme makroskopike) rregullat e përpunuara nga ai, që lidh dy vlera për çdo trajektore, duke kaluar në shumën e historive, të gjitha trajektoret neutralizojnë njëra tjetrën.

Me fjalë të tjera kur kemi të bëjmë me sisteme makroskopike, vetëm njëra nga trajektoret e shumta merret në konsideratë: atë të përkufizuar nga ligjet klasike të Njutnit mbi lëvizjen.

Sot është duke kërkuar të ndërthuren teoria e relativitetit të përgjithshëm të Ajnshtajnit me teorinë e historisë shumëfishe të Feynmanit në një teori të vetme të madhe që do të përshkruante të gjitha fenomenet e universit.

Vetë teoria unike nuk merr përsipër të thotë asgjë për orgjinën dhe gjendjen e fillimit të univesit.

Ajo kërkon të llogarisë se si do të evoluojë universi duke u nisur nga disa të dhëna relative të fillimit. Për të njohur këto janë të nevojshme disa

kushte fillestare, si dhe regullat (ligjet) që do të na informonin se çfarë ndodh në kufijtë e universit në një zonë të caktuar të hapësirës dhe kohës.

Ligjet e evoluimit dhe kushtet fillestare

Ligjet e fizikës sqarojnë se si evoluojnë me kalimin e kohës fenomenet që ndodhin në univers. Per shembull nëse hedhim një gur në ajër, ligjet e gravitetit na japin mundësinë të përcaktojmë me saktësi lëvizjen e mëtejshme të tij.

Por duke u bazuar në këto ligje nuk mund te dime sakte se kur guri do te bjere ne toke dhe ne cilin vend te tokes guri do te bjere. Duhet të njohim dhe shpejtësinë e lëvizjes së tij si dhe drejtimin në momentin kur kemi hedhur gurin. Me fjalë të tjera duhet të njohim kushtet fillestare, ose e thënë ndryshe kushtet rreth fillimit të lëvizjes së gurit.

Meqenëse kozmollogjia merret me përshkrimin e evoluimit të gjithë universit mbi bazën e ligjeve të fizikës, është duke kërkuar se cilat kanë qenë kushtet fillestare të universit në të cilat duam të aplikojmë ligjet e fizikës.

Sot ekziston mendimi shkencor që gjendja fillestare ka patur një ndikim të madh në të gjitha karakeristikat themelore të universit, kryesisht mbi vetitë e grimcave elementare dhe mbi bashkëveprimin e tyre, të cilat kanë çuar në zhvillimin e jetës biologjike.

Kozmollogjistët janë duke vlerësuar të gjitha konfiguracionet e gjendjeve të fillimit, duke evidentuar se cila prej tyre ka evoluar universin në atë drejtim që e vëzhgojmë sot.

Çështjet e diskutueshme mbi origjinën e Universit

Për astronautët është entusiaste të fotografosh tokën nga një anije kozmike kur shohin gjëra të spikatura në qiell.. "Është gjëja më e bukur e udhëtimeve hapësinore "ka thënë një astronaut. Dhe megjithatë planeti ynë duket shumë i vogël në krahasim me sistemin diellor. Imagjinojmë për një moment të udhëtojmë në hapësirë për të patur një ide objektive për përmasat e tokës dhe të diellit. Dielli nuk është gjë tjetër, veçse një ndër yjet e pafundëm që gjënden në një krah të asaj spirale gjigante që është galaktika jone që quhet Ruga e Qumshtit, e cila nga ana e saj është një pjesë e vogel e universit.

(Rruga e Qumshtit ka diameter 1. 000. 000. 000. 000. 000. 000. km dhe drites do t'i duheshin 100. 000 vite per ta pershkuar ate. Ne Rrugen e Qumeshtit ndodhen 100 miliarde yje.) Me sy të lirë arijmë të shohim në një natë të kthjellët disa njolla të ndritshme që në fakt janë të tjera galaktika, si për shëmbull Andromeda që është më e madhja e Rrugës së Qumështit.

Rruga e Qumështit, Andromeda dhe dhjetra galaktika të tjera në sajë të tërheqies gravitacionale janë grupuar në grumbullime që të mara së bashku zënë një pjesë shumë të vogël të supergrumbullimit gjigant. Universi përmban një një numër të pafundem supergrumbullime dhe

gjërat nuk mbarojnë atje. Grumbullimet dhe galaktikat nuk janë shpërndarë në hapësirë në mënyrë uniforme.

Disa prej tyre me një shkallë të madhe ngjashmërie mund të konsiderohen si të përbëra nga një tyl (perde)dhe fije që qakojnë një lëmsh të hapesirës së madhe boshe, kurse disa të tjera janë shumë të zgjatura si një mur i madh gjigand.

Edhe nga ky këndvështrim do të ishte një surprizë për shumë nga ata që mendojnë që Universi të jetë krijuar vetëm nga një shpërthim kozmik rastësor. "Sa më shumë që vëzhgojmë Universin në të gjitha detajet e saja të çuditshme - ka thënë nje shkencëtar- aq më i vështire do të jetë shpjegimi me një teori të thjeshtë se kush e ka bërë të jetë kështu. ”

A ka prova reth ekzistencës së një fillimi?

Astronomë kanë zbuluar një fenomen thelbi i së cilës qëndron në sqarimin e më poshtëm:dukë bërë të kalojë drita e galagtikës nëpërmjet një prizmi, vihet re që valet elektromagnetike të ndritshme do të duken "të zgjatura”gjë që tregon që burimet e tyre (galagtikat) jane duke u larguar nga ne me një shpejtësi shumë të madhe.

Sa më të ndara të jenë galagtikat aq më shpejt ato largohen. Kjo tregon që universi është duke u zgjeruar. Ky fakt tregon që duhet të ketë qënë një "faktor"që ka nisur proçesin, një force shumë e fuqishme për të mposhtur tërheqien e pa fundme gravitacionale të gjithe universit.

Natyrshëm lind pyetja: Nga mund të ketë ardhur kjo energji dinamike? Nuk kërkohet vetëm burimi i kësaj energjie të pafundme. Janë të nëvojshme edhe largpamësia dhe inteligjenca që përse shpejtësia e zgjerimit të universit të jetë kaq e kalibruar me një preçizion kaq të madh. "Nëse shpejtësia e zgjerimit të universit do të ishte kryer me një shpejtësi një të miliardën më të madhe se ajo reale - ka thënë astronomi Lovell- e gjitha lënda e universit to të rezultonte tani e shpërndarë….

Dhe nëse do të ishte paraprire nga një shpejtësi një të miliardën më të vogël se ajo reale, forcat gravitacionale do ta kishin ngurtesuar universin brënda miliardit te parë te jetës së saj. Në këto raste nuk do të kishte patur yje të qëndrueshme dhe për pasojë nuk do të kishte patur jetë”Një tjetër pyetje që vihet:Ekspertët sot a janë në gjëndje të spjegojnë saktësisht orgjinën e universit?

Shumë shkencëtarë që nuk e pranojnë idenë që universi të jetë krijuar nga një inteligjencë superiore, bëjnë hipoteza që disa nga vetitë e proçesit të krijimit të universit të jenë krijuar nga hiçi. Psh modeli i universit inflacionar i konceptuar nga fizikani Alan Guth në vitin 1979, pohon që në fillim universi ka qënë një mikrogrimcë dhe më pas ka filluar të zgjerohet me një shpejtësi më të madhe se ajo e dritës, e cila nuk është verifikuar nga eksperimentet e deri më sotme.

A është kjo e drejte? Astronomi Robert Jastrow ka shkruar:"Pak astronomë kishin parashikuar që kjo ngjarje - lindja e papritur e universit -

do të ishte bërë një fakt shkencor i pranushem, por që më vonë vëzhgimet e qiellit nëpërmjet teleskopëve i ka ngushtuar të tilla konkluzione", dhe më poshtë shton:"prova astronomike e një fillimi i vë shkencetarët në një pozicion jo komod, pasi është bindja e tyre që çdo efekt ka patur nje shkak natyral…"

Një tjetër astronom E. A. Milne ka thënë"Nuk mund të bëjmë asnjë pohim mbi atë se si kanë qenë gjerat në fillim; Në aktin hyjnor të Krijuesit Zot nuk kishte as teleskope dhe as dëshmitarë".

Origjina e universit

Sipas popujve Boshongo të Afrikës Qendrore, në fillim ekzistonte vetëm errësira, uji dhe Zoti i madh Bumba. Bumba një ditë, nga një dhimbje e fortë stomaku, vjell Diellin. Dielli thau një pjesë të ujit, duke nxjerrë në pah pjesë toke. Ende në dhimbje të forta stomaku, Bumba vjell sërish, duke nxjerrë këtë herë Hënën, Yjet dhe pastaj disa kafshë, leopardin, krokodilin, breshkën dhe më në fund njeriun.

Ky mit i krijmit të Gjithësisë, si shumë të tjerë, përpiqet të japë përgjigje për pyetjen që ne të gjithë ngremë. Pse jemi këtu? Nga kemi ardhur ne? Përgjigjja që jepet në përgjithësi është se njerëzit kanë një origjinë relativisht të kohëve të fundit, sepse kjo gjë duhet të ketë qenë e qartë, edhe në kohë të hershme, se raca njerëzore është zhvilluar në sajë të përmirësimit në njohuri dhe teknologji. Kështu që origjina e racës njerëzore nuk mund të ketë qenë shumë e gjatë, sepse në rast të kundërt ajo do të kishte përparuar edhe më shumë. Për shembull, sipas Peshkopit Usher, Libri i Zanafillës vendos krijimin e Gjithësisë në orën 9 në mëngjes, më datë 27 tetor, të vitit 4004 BC.

Nga ana tjetër objekte të tilla si malet dhe lumenjtë, kanë ndryshuar shumë pak gjatë kohës së ekzistencës së racës njerëzore. Këto objekte ishin menduar si një sfond i vazhdueshëm i jetës dhe për më tepër se kanë ekzistuar në shekuj si një peisazh bosh ose është menduar se janë krijuar në të njëjtën kohë sikurse edhe raca njerëzore.

Megjithatë jo gjithkush ishte i lumtur me idenë se Gjithësia kishte një fillim. Për shembull, Aristoteli, më i famshmi prej filozofëve grekë, besonte se Gjithësia kishte ekzistuar përgjithmonë. Diçka e përjetshme është më e përsosur se diçka e krijuar. Ai sugjeroi që arsyeja që ne shohim përparim në racën njerëzore ishte fakti se përmbytjet ose fatkeqësitë e tjera natyrore, e kanë kthyer në mënyrë të përsëritur qytetërimin në fillimet e tij.

Motivimi për të besuar në një Gjithësi të përjetshme është dëshira për të shmangur ndërhyrjen Hyjnore për të krijuar Gjithësinë dhe përparimin e saj. Nga ana tjetër, ata që besonin se Gjithësia kishte një fillim, e përdorin atë si një argument për ekzistencën e Perëndisë, si shkak i parë apo forcë lëvizëse kryesore e Gjithësisë.

Nëse dikush beson se Gjithësia kishte një fillim, pyetja që shtrohet është qartë: Çfarë ka ndodhur para fillimit? Çfarë bënte Zoti përpara se të

krijonte këtë botë? A mos vallë Ai po përgatiste Ferrin për njerëzit që bëjnë pyetje të tilla? Problemi nëse Gjithësia kishte apo jo një fillim, ishte një shqetësim i madh për filozofin gjerman, Immanuel Kant. Ai e ndjeu se kishte kontradikta logjike në këtë gjë. Në qoftë se Gjithësia kishte një fillim, pse u desh të prisnim një kohë të pafund para se të kishim fillimin? Ai e quajti këtë gjë tezë.

Nga ana tjetër, në qoftë se Gjithësia kishte ekzistuar përgjithmonë, pse u desh të prisnim një kohë të pafund për të arritur fazën e tanishme? Ai e quajti këtë gjë antitezë. Qoftë teza, ashtu edhe antiteza, varen thelbësisht nga supozimi i Kantit, së bashku me pothuajse të gjithë bashkohësit e tij, se koha në vetvete ka karakter absolut. Kjo është njëlloj si të thuash se vijmë nga një e kaluar e pafund dhe shkojmë në një të ardhme të pafund, në mënyrë të pavarur nga fakti nëse Gjthësia ekziston apo jo.

Ky parim është ende në mendjen e shumë shkencëtarëve të sotëm. Megjithatë në 1915, Einstein-i paraqiti në qarqet akademike europiane teorinë e tij revolucionare, Relativitetin e Përgjithshëm. Në këtë teori, hapësirë-koha nuk është absolute, pra nuk është më një sfond i fiksuar i ngjarjeve në kontinumin katër-përmasor. Në këtë teori, hapësira dhe koha janë madhësi dinamike të cilat janë formuar nga energjia dhe lënda në Gjithësi. Këto madhësi janë përcaktuar në kuadër të ekzistencës së Gjithësisë, kështu që nuk ka asnjë kuptim logjik të flasim për kohën para krijimit të Gjithësisë. Kjo është njëlloj si të kërkojmë një pikë e cila ndodhet në Jug të Polit të Jugut!!!

Nëse Gjithësia në thelb është e pandryshueshme në kohë, siç përgjithësisht mendohej nga shkencëtarët para viteve 1920, nuk do të kishte arsye që koha të mos përcaktohej në mënyrë arbitrare larg në të kaluarën. Çdo i ashtuquajtur fillim i Gjithësisë do të jetë artificial dhe në këtë kuptim dikush mund të shtrijë historinë e Gjithësisë prapa, në kohë të hershme. Në këtë mënyrë mund të themi se Gjithësia u krijua vitin që shkoi, muajin e kaluar ose dje, por me të gjitha kujtimet dhe dëshmitë fizike, duket si të ishte shumë më e vjetër.

Kjo gjë ngre shqetësime të thella filozofike rreth kuptimit të ekzistencës. Personalisht do të merrem me këtë gjë duke pranuar atë që është quajtur përafrim pozitivist apo filozofi pozitiviste. Thelbi e filozofisë pozitiviste qëndron në faktin se ne interpretojmë të dhënat që marrim nga shqisat tona në bazë të një modeli që ne kemi ngritur për Gjithësinë. Në këtë mënyrë nuk mund të pyesim nëse modeli paraqet realitetin. Pyetja që mund të bëjmë është a funksionon ky model apo jo. Një model thuhet se është një model i mirë, në qoftë se, së pari, ai interpreton një gamë të gjerë të vëzhgimeve të kryera dhe fakteve eksperimentale, në kushtet e një modeli të thjeshtë dhe elegant dhe së dyti, në qoftë se modeli bën parashikime të caktuara që mund të verifikohen apo të hidhen poshtë prej eksperimentit.

Duke u bazuar në filozofinë pozitiviste mund të krahasohen dy modele të Gjithësisë, një model sipas të cilit Gjithësia u krijua vitin e kaluar dhe një model në të cilin Gjithësia ka ekzistuar shumë më gjatë se një vit. Modeli në të cilin Gjithësia ka ekzistuar për shumë kohë mund të shpjegojë gjëra të tilla si binjakët identik, që kanë një kauzë të përbashkët në kohëra të hershme ndërsa modeli në të cilin Gjithësia është krijuar vitin e kaluar nuk mund të shpjegojë këto ngjarje. Pra themi se modeli i parë është më i mirë. Në filozofinë pozitiviste nuk mund të ngremë pyetje të tipit: A ka ekzistuar vërtet Gjithësia përpara apo thjesht na shfaqet kështu. Në filozofinë pozitiviste kjo është e njëjta gjë. Në një Gjithësi statike nuk ka një pikë të përcaktuar natyrshëm si fillim. Situata ndryshoi në mënyrë radikale rreth viteve 1920 kur astrofizikani i famshëm, Edwin Hubble filloi vëzhgimet me një teleskop 10 inç në malin Wilson, California.

Hubble zbuloi se yjet nuk janë të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë hapësirën, por janë mbledhur së bashku në grupe të mëdha të quajtura galaktika. Duke matur dritën që vinte nga galaktikat, Hubble arriti të përcaktojë shpejtësitë e lëvizjes tyre. Ai priste që shumë galaktika të vinin drejt nesh dhe po ashtu shumë të tjera të ishin duke u larguar. Kjo gjë do të sillte si pasojë një Gjithësi të pandryshueshme me kalimin e kohës. Por për habinë e tij, Hubble gjeti se gati të gjitha galaktikat janë duke u larguar nga ne, pasi ai mati zhvendosjen e dritës që vinte nga galaktikat dhe kjo zhvendosje ishte drejt së kuqes dhe referuar efektit Doppler, burimi i dritës largohet nga marrësi me një shpejtësi që përcaktohet nga zhvendosja e frekuencës.

Për më tepër ai zbuloi se sa më larg nesh të ishin galaksitë aq më shpejt ato largoheshin prej nesh. Gjithësia nuk është statike në kohë, sikurse të gjithë mendonin në atë kohë, ajo është në zgjerim. Distanca midis galaktikave të largëta vjen duke u rritur me kalimin e kohës. Zgjerimi i Gjithësisë, ishte një nga zbulimet më të rëndësishme shkencore të shekullit të 20, apo të çdo shekulli. Ky zbulim transformoi në mënyrë radikale debatin nëse Gjithësia kishte një fillim apo jo. Në qoftë se galaktikat janë duke u larguar prej nesh, kohë më parë ato duhet të kenë qenë mjaft afër me njëra-tjetrën. Nëse shpejtësia e tyre konsiderohet konstante, ato do të kenë qënë të gjitha në një vend, rreth 15 miliardë vjet më parë. A ishte ky fillimi i Gjithësisë?

Shumë shkencëtarë janë ende të pakënaqur me një Gjithësi që ka një fillim sepse duket sikur kjo gjë nënkupton se ligjet e fizikës thyhen. Disa mund të angazhojnë një agjenci e jashtme, të cilën për lehtësi e quajmë Zot, për të përcaktuar se si e pati fillimin Gjithësia. Disa të tjerë kanë avancuar duke propozuar teori në të cilat Gjithësia është në zgjerim në kohën e sotme, por nuk ka një fillim. Një nga këto teori është "Steady State Theory", e propozuar nga Bondi, Gold, dhe Hoyle në 1948.

Në "Steady State Theory"ideja është që veç largimit të galaktikave kemi edhe formimin prej materies të galaktikave të reja, të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë hapësirën. Në këtë mënyrë Gjithësia ka ekzistuar përgjithmonë dhe na shfaqet e njëjtë në çdo kohë. Kjo veti e fundit ka një virtyt të madh nga pikëpamja pozitiviste, mund të japë një parashikim të caktuar i cili mund të verifikohet me anë të vëzhgimit. Grupi i radio-astronomisë në Cambridge, nën udhëheqjen e Martin Ryle, në fillim të viteve 1960 bëri një studim të burimeve të radiovalëve. Ata arritën në përfundimin se këto burime janë të shpërndara në mënyrë uniforme nëpër qiell, duke treguar se shumica e burimeve është jashtë galaksisë tonë.

"Steady State Theory"parashikoi formën e grafikut të numrit të burimeve kundrejt fuqisë së tyre. Por vëzhgimet treguan se burimet ishin më të dobëta se sa ishin parashikuar nga teoria, duke arritur në përfundimin se densiteti i burimeve ishte më i lartë në të kaluarën. Kjo është në kundërshtim me supozimin bazë të "Stady State Theory", sipas të cilit çdo gjë ishte konstante në kohë. Për këtë, dhe të tjera arsye, "Steady State Theory"u braktis.

Një tjetër përpjekje për të shmangur një Gjithësi e cila ka një fillim, ishte sugjerimi se ka pasur një fazë të mëparshme kontraktuese të Gjithësisë, por për shkak të rrotullimit dhe parregullsive lokale, materia në Gjithësi nuk është përqendruar e gjitha në të njëjtën pikë. Në këtë mënyrë pjesë të ndryshme të materies do të shmangin njëra-tjetrën dhe Gjithësia do të jetë sërish në zgjerim, me një densitet i cili mbetet i fundëm.

Dy shkencëtarë rusë, Lifshitz dhe Khalatnikov, kanë vërtetuar se një tkurrje të përgjithshme pa praninë e një simetrie të saktë, gjithmonë do të çojë në një fryrje të Gjithësisë, me densitet i cili mbetet i fundëm. Ky rezultat ishte shumë i përshtatshëm për materializmit dialektik Marksist-Leninist sepse shmang mjaft pyetjeve të vështira në lidhje me krijimin e Gjithësisë. Kur Lifshitz dhe Khalatnikov publikuan pohimin e tyre, Hawking ishte një student 21-vjeçar, duke kërkuar diçka për të përfunduar tezën e tij të doktoraturës. Hawking nuk i besoi të ashtuquajturës teorema "Lifshitz-Khalatnikov", dhe së bashku me Roger Penrose vendosën të zhvillonin teknika të reja matematikore për të studiuar këtë çështje. Ata treguan se Gjithësia nuk mund të pësonte fryrje. Në qoftë se Teoria e Përgjithshme e Relativitetit e Einstein-it është e saktë, atëherë do të ketë një singularitet, një pikë me dendësi dhe lakueshmëri të hapësirë-kohës të pafundme, pikë në të cilën koha pati fillimin e saj.

Provat e para eksperimentale për të konfirmuar idenë se Gjithësia kishte një fillim shumë të dendur, erdhën në tetor 1965, disa muaj pas rezultatit të parë të Hawking në lidhje me singularitetet, me anë të zbulimit të një sfondi të dobët mikrovalësh në të gjithë hapësirën. Këto mikrovalë janë të njëjta si ato në furrat tona me mikrovalë, por shumë shumë më pak të fuqishme. Këto mikrovalë do të ngrohnin një pica në vetëm -271. 3 gradë

celsius, gjë që nuk mjafton për të shkrirë pican e jo më gatimin e saj. Të gjithë ne në fakt mund të vëzhgojmë këto mikrovalë duke vendosur televizorin në një kanal bosh. Disa përqind të pikave të bardha që ne shohim në ekran, shkaktohen nga ky sfond i mikrovalëve. I vetmi interpretim i arsyeshëm i këtij sfondi është se ky është një rrezatimit i mbetur nga një gjëndje fillestare tepër e nxehtë dhe e dendur e Gjithësisë. Me zgjerimin e Gjithësisë, rrezatimi është ftohur dhe sot shikojmë vetëm disa mbetje të zbehta të kësaj të kaluare përvëluese.

Edhe pse teorema e singularitetit "Hawking-Penrose"parashikoi se Gjithësia kishte një fillim, ajo nuk e thotë asgjë lidhur me atë se si ka filluar Gjithësia. Ekuacionet e Relativitetit të Përgjithshëm bien poshtë në pikat singulare. Kështu që teoria e Einstein-it nuk mund të parashikojë se si ka filluar Gjithësia por vetëm se si do të zhvillohet pasi ajo ka filluar. Në një pikë të tillë kemi dy mundësi zgjedhje: e para janë përfundimet e arritura nga Hawking-Penrose dhe e dyta është të pranojmë që Perëndia zgjodhi mënyrën së si e pati fillimin Gjithësia, arsyet e të cilës ne nuk mund ti kuptojmë. Kjo ishte pikëpamja e Papa Gjon Palit të II-të. Në një konferencë mbi kozmologjinë të mbajtur në Vatikan, Papa u tha delegatëve se ishte dakord për studimin e Gjithësisë pas fillimit të saj, por ata nuk duhet të hetojnë në lidhje me vetë fillimin e Gjithësisë, për shkak se ky ishte momenti i Krijimit dhe rrjedhimisht është një çështje ekskluzive e Zotit. Hawking, si pjesëmarrës në këtë konferencë, thotë se ishte i kënaqur që Papa nuk e kuptoi letrën që Hawking kishte paraqitur në konferencë ku sugjeronte një skenar se si Gjithësia kishte filluar. Unë nuk dua që mendimet e mia të shërbejnë për të më dorëzuar në "institucionet"e inkuizicionit, si Galileo, shprehet Hawking.

Interpretimi tjetër, ai i përfundimeve të arritura nga rezultatet e Hawking-Penrose, i cili mbështetet nga pjesa më e madhe e shkencëtarëve të sotëm, është se Teoria e Përgjithshme e Relativitetit bie poshtë në fusha shumë të forta gravitacionale, të cilat ekzistonin në Gjithësinë e hershme. Kjo teori duhet të zëvendësohet nga një teori më e plotë. Në këtë përfundim arrijmë edhe nisur nga fakti se Relativiteti i Përgjithshëm nuk e merr në konsideratë strukturën në shkallë të vogël të materies, që qeveriset nga Teoria Kuantike. Kjo gjë në thelb nuk ka rëndësi sepse shkalla e Gjithësisë është shumë e madhe në krahasim me shkallët mikroskopike në të cilat qeveris Teoria Kuantike e Fushës. Por kur Gjithësia ka patur përmasat e Planck-ut, përmasa të rendit 10-33cm, të dy shkallët janë të njëjta dhe Teoria Kuantike duhet domosdoshmërisht të merret në konsideratë. Për të kuptuar origjinën e Gjithësisë, ne kemi nevojë të kombinojmë Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit me Teorinë Kuantike. Mënyra më e mirë për të bërë këtë gjë është të përdorim idenë e Feynman-it të një shume sipas të gjitha historive të mundshme. Richard Feynman ishte një personazh i gjallë, i cili ka luajtur në bateri bongo në një Strip-

Club në Pasadena dhe gjithashtu ishte një fizikan i shkëlqyer në "California Institute of Technology". Ai propozoi që një sistem kalon nga një gjendje A në një gjendje B sipas çdo rruge apo historie të mundshme.

Çdo rrugë apo histori ka një amplitudë apo intensitet të caktuar dhe probabiliteti i kalimit të sistemit nga A në B jepet duke mbledhur amplitudat për çdo rrugë të mundshme kalimi. Mund të kemi një histori në të cilën Hëna është e përbërë prej djathit blu, por amplituda e kësaj gjëje është mjaft e ulët. Sigurisht kjo gjë është një lajm i keq për minjtë.

Probabiliteti për një gjendje të Gjithësisë në kohën e tashme jepet duke mbledhur të gjitha amplitudat sipas të gjitha historive që arrijnë në këtë gjendje. Por si fillojnë këto histori ose rrugë? Kjo është pyetja origjinës së Gjithësisë në një tjetër formë. Do të kërkojmë një dekret nga Krijuesi se si filloi Gjithësia apo gjendjen fillestare të Gjithësisë do e përcaktojmë nga një ligj i shkencës? Në fakt kjo pyetje do të dilte edhe në qoftë se historitë e Gjithësisë i takojnë një të kaluare të pafund. Por kjo pyetje do të lindte shumë më shpejt nëse pranojmë se Gjithësia filloi së ekzistuari vetëm 15 miliardë vjet më parë. Problemi i asaj që ka ndodhur në fillim të gjithçkaje, është pak a shumë si çështja e asaj që ndodhi në mesjetë, kur njerëzit mendonin se bota ishte e sheshtë. A është bota një pjatë të sheshtë, me detin që derdhet nga buzët e kësaj pjate? Unë mendoj se jo. Mjaft njerëz e kanë testuar eksperimentalisht këtë gjë, ndoshta pa e kuptuar. Ata i kanë qënë rreth botës dhe nuk kanë rënë poshtë pasi kanë arritur "buzët e pjatës". Siç e dimë të gjithë, problemi i asaj që mendohej për botën në mesjetë, është zgjidhur kur njerëzit kuptuan se bota nuk ishte një pjatë të sheshtë, por një sipërfaqe të lakuar. Megjithatë problemi i kohës duket sikur është e ndryshe. Duket sikur koha është e ndarë nga hapësira dhe është si një model shinash hekurudhore. Nëse ka një fillim, do të duhet me patjetër të jetë dikush për të vendosur nisjen e "trenave".

Teoria e Përgjithshme e Relativitetit e Einstein-it, unifikoi kohën dhe hapësirën në një të vetme: hapësirë-kohën, por koha ishte ende e ndryshme nga hapësira dhe ngjante si një korridor, i cili ose kishte një fillim dhe një mbarim ose ishte i pafundëm. Megjithatë kur Jim Hartle dhe S. Hawking kombinuan Relativitetin e Përgjithshëm me Teorinë Kuantike, arritën në përfundimin se në kushte ekstreme koha mund të sillet si një drejtim tjetër i hapësirës. Kjo do të thotë se mund të shpëtojmë nga problemi i një kohe që ka një fillim në mënyrë të ngjashme me shpëtimin nga pikpamja mesjetare e një bote me anë. Nëse supozojmë se fillimi i Gjithësisë ishte si Poli i Jugut të Tokës, me gjerësinë gjeografike që luan rolin e kohës, Gjithësia do të fillojë si një pikë në Polin e Jugut. Duke lëvizur në veri rrathët me gjerësi gjeografike konstante, të cilat paraqesin madhësinë e Gjithësisë, do të zgjerohen. Të pyesësh se çfarë ka ndodhur para fillimit të Gjithësisë është një pyetje pa kuptim sepse nuk ka asgjë në jug të Polit të Jugut. Koha, e matur si shkallë e gjerësisë gjeografike, do të ketë fillimin në

Polin e Jugut, por Poli i Jugut është si çdo pikë tjetër. Dikush mund të thotë: unë kam qenë në Antarktidë por jo në Polin e Jugut. Ligjet e Natyrës që veprojnë në Polin e Jugut veprojnë dhe në çdo vend tjetër. Kjo do të heqë kundërshtimin mbi vjetërsinë e fillimit të Gjithësisë, ky do të jetë një vend ku ligjet e fizikës bien poshtë. Fillimi i Gjithësisë, do të qeveriset nga ligjet e fizikës. Tabloja e zhvilluar nga Jim Hartle dhe Stephen Hawking për një krijim spontan kuantik të Gjithësisë është pak a shumë si formimi i flluskave të avullit në ujin që vlon. Ideja është se rrugët më të mundshme të krijmit të Gjithësisë, do të jenë si siperfaqet e flluskave. Shumë flluska të vogla do të shfaqen dhe pastaj do të zhduken sërish. Këto do i korrespondojnë mini-Gjithësive të cilat do të zgjerohen por do të tkurren (kolaps) përsëri, ndërsa kanë ende përmasa mikroskopike. Ato janë Gjithësi alternative të mundshme por nuk janë me interes për shkak se nuk "jetojnë"mjaftueshëm për zhvillimin e yjeve, galaktikave dhe jetës inteligjente. Megjithatë disa nga flluskat e vogla do të rriten në një madhësi të caktuar, në të cilën ato janë të sigurta nga kolapsi. Ato do të vazhdojnë të zgjerohen me një shpejtësi gjithnjë e më të madhe dhe do të formojnë flluskat që ne shohim në ujin që vlon. Ato i korrespondojnë Gjithësive që nisin të zgjerohen me një shpejtësi gjithnjë në rritje. Ky quhet inflacion, sikurse çmimet që rriten çdo vit në ekonomitë botërore. Rekordi botëror për inflacionin ishte në Gjermani pas Luftës së Parë Botërore. Çmimet u rritën me një faktor prej dhjetë milion herësh në një periudhë prej 18 muajsh. Por kjo nuk është asgjë në krahasim me inflacionin në fillimet e Gjithësisë. Gjithësia u zgjerua me një faktor miliarda e miliarda herë në një fraksion sekonde. Ndryshe nga inflacioni në çmime, inflacioni në fillimin e Gjithësisë ishte një gjë shumë e mirë. Ky inflacion prodhoi një Gjithësi shumë të madhe dhe uniforme, ashtu si ne e shohim sot. Megjithatë Gjithësia nuk është plotësisht uniforme. Në shumën sipas të gjitha historive të mundshme të universit, histori të cilat kanë parregullsi shumë të vogla, do të kemi një probabilitet të lartë për një histori të Gjithësisë plotësisht të rregullt dhe uniforme. Teoria parashikon se Gjithësia në fillimin e saj ka të ngjarë të ketë patur jo-uniformitete të vogla. Këto parregullsi të universit të hershëm do të kenë si pasojë variacione të vogla në intensitetin e sfondit të mikrovalëve matur në drejtime të ndryshme. Ky sfond mikrovalësh është vëzhguar nga sateliti MAP dhe rezultati i marrë jep ato lloj variacionesh të cilat janë parashikuar nga teoria. Kjo gjë konfirmon faktin se jemi në rrugë të drejtë. Ekzistenca e jo-uniformiteteve në Gjithësinë e hershme do të thotë se disa zona do të kenë densitet pak më të lartë se disa zona të tjera. Tërheqja gravitacionale suplementare e zonave me densitet më të lartë do të ngadalësojë procesin e zgjerimit të kësaj zone dhe eventualisht mund të shkaktojë një tkurrje të kësaj zone, për të formuar më pas galaktikat dhe yjet. Pra, nëse shikojmë me kujdes hartën e mikrovalëve, ajo ka pika blu në të gjithë strukturën e Gjithësisë. Kjo do të

thotë se Ne jemi produkt i fluktuacioneve kuantike në Gjithësinë e hershme. E parë në këtë formë, Perëndia vërtetë ka luajtur me zare!

Në njëqind vitet e fundit është bërë një progres i jashtëzakonshëm në studimin e Gjithësisë. Teoria e Përgjithshme e Relativitetit, si dhe zbulimin i zgjerimit të Gjithësisë, shkërrmoqi pikëpamjen e vjetër të një Gjithësie statike. Në vend të kësaj, Relativiteti i Përgjithshëm parashikoi se Gjithësia dhe vetë koha do të fillojnë në "Big Bang". Kjo teori gjithashtu parashikoi se koha do të ketë një fund dhe ky fund do të jetë në vrimat e zeza. Zbulimi i sfondit kozmik të mikrovalëve dhe vrojtimi i vrimave të zeza mbështesin këto konkluzione. Ky është një ndryshim radikal në pikëpamjen tonë për Gjithësinë dhe realitetin në vetvete.

Edhe pse Teoria e Përgjithshme e Relativitetit parashikoi se Gjithësia duhet të ketë ardhur nga një e kaluar në të cilën lakimi i hapsirë-kohës arrinte mbyllësinë e saj, nuk mund të parashikojë se si "lindi"Gjithësia prej "Big Bang". Kështu që Relativiteti i Përgjithshëm, i vetëm, nuk mund të japë përgjigje për pyetjen themelore të kozmologjisë: Pse ekziston Gjithësia, në ç'mënyrë ajo ka "lindur"? Megjithatë, në qoftë se Relativiteti i Përgjithshëm kombinohet me Teorinë Kuantike, kjo mund të bëjë të mundur të parashikojmë se si filloi Gjithësia. Fillimisht ajo do të zgjerohet me një shpejtësi gjithnjë e më të madhe. Gjatë kësaj periudhe inflacioniste, "martesa"e dy teorive parashikon krijimin e fluktuacioneve të vogla të cilat do të çojnë në formimin e galaktikave, yjeve dhe të gjitha strukturave të tjera në Gjithësi. Kjo gjë është konfirmuar nga vëzhgimi i jo-uniformiteteve të vogla në sfondin kozmik të mikrovalëve, ekzaktësisht me të njëjtat veti të parashikuara nga teoria. Pra duket se njezëzimi është në rrugë të drejtë për të kuptuar origjinën e Gjithësisë, edhe pse do të duhet akoma shumë punë. Një dritare e re për të kuptuar Gjithësinë e hershme do të hapet kur ne të arrijmë dedektimin e valëve gravitacionale apo kuanteve të bashkëveprimit gravitacional të quajtur gravitone. Valët gravitacionale përhapen lirisht qysh prej kohës së Gjithësisë së hershme, të papenguara nga ndërhyrja e çfarëdo lloj materiali.

Pavarësisht disa sukseseve të mëdha, jo çdo gjë është zgjidhur. Ne ende nuk e kemi arritur të kuptojmë teorikisht zgjerimin e Gjithësisë, do të vazhdojë të zgjerohet në mënyrë të përshpejtuar apo pas një periudhe të gjatë zgjerimi do të ngadalësohet. Pa kuptuar këtë gjë, ne nuk mund të jemi të sigurt për të ardhmen e Gjithësisë. A do të vazhdojë Gjithësia të zgjerohet përgjithmonë? A është inflacioni një ligj i natyrës? A mos vallë Gjithësia do të pësojë një kolaps total duke përfunduar në atë që quhet "Big Crunch"? Rezultatet e reja të marra nga vëzhgimet dhe përparimet në fushën teorike sa vijnë e po bëhen më të dendura. Jemi shumë afër momentit kur mund të japim përgjigje për pyetjet e vjetra sa vetë njerëzimi: Pse jemi këtu? Nga vijmë nga ne?

8. Materia e Errët në Univers

Abstract

Rreth 90% e materies që përmban Universi nuk mund të vëzhgohet në mënyrë të drejpërdrejtë për sa kohë nuk emeton rrezatim elektromagnetik (dritë) dhe nuk bashkëvepron me materien e ndritshme, me përjashtim të bashkëveprimit gravitacional. Në ndryshim nga Yjet dhe gazi ndëryjor të cilët, të ndritshëm, vëzhgohen lehtësisht në galaksitë dhe që marrin emrin e materies së ndritshme (dukshme), lloji i materies që do analizohet quhet materia e errët. Askush nuk mund të vëzhgojë në mënyrë direkte materien e errët por kjo materie prodhon pjesën më të madhe të forcës gravitacionale që mban të bashkuara galaktikat dhe është shumë probabël që të mbajë të bashkuar të gjithë Universin.

Materia e Errët

Për shumë kohë është besuar se çdo objekt prezent në Universin tonë është i dukshëm dhe dërgon në të gjitha drejtimet dritën e emetuar apo reflektuar, në varësi të natyrës së objektit. Kjo dritë, pasi arrin Tokën, mund të dedektohet dhe të studiohet duke kërkuar të merret prej saj i gjithë informacioni i mundshëm mbi objektin i cili e emeton apo reflekton dritën ose të nxirren konkluzione të përgjithshme mbi kozmosin në tërësi. Në fakt detyra kryesore e astronomëve nuk është vetëm të "mbledhin"dritën me anë të teleskopëve, qofshin këta tokësorë apo hapsinorë, por mbi të gjitha detyra e tyre është që prej këtyre objekteve të dukshëm të marrin informacione për gjithçka tjetër që akoma nuk shohim dhe nuk njohim në Universin tonë. Pikërisht nga analizimi i dritës së ardhur nga hapsira 50 vitet e fundit, sot ne jemi në gjendje të pohojmë se 90% e materies prezente në Univers është e përbërë prej objektesh apo grimcash të cilat nuk mund të shikohen. Me fjalë të tjera, pjesa më e madhe e materies në Univers nuk emeton dritë ose më mirë nuk emeton rrezatim elektromagnetik dhe ekzistenca e kësaj materie mund të provohet vetëm nga efektet që ajo shkakton (kryesisht gravitacionale) mbi materien e dukshme.

Kjo "masë e munguar"është quajtur **materie e erret**, emër ky që vjen pikërisht nga vetia themelore e kësaj lënde: të qënit e **padukshme**.

Çfarë kuptojmë me materie të errët?

Edhe pse termi "materie e errët"mund të tingëllojë misterioz, është thjesht termi me të cilin fizikanët, astrofizikanët dhe kozmologët i referohen materies e cila nuk emeton apo reflekton dritë të dukshme, radiovalë, rreze X, rreze gama ose rrezatime të tjera elektromagnetike. Sot mendohet se materia e errët është shumë më e madhe se sa materia e dukshme dhe se është përgjegjëse në një shkallë të lartë për strukturën e Universit që ne shikojmë.



Materia e errët (majtas) dhe materia jo e errët (djathtas)

Evidencat e para të pranisë në Univers të materies së errët vijnë nga studimet e kryera rreth viteve 30 të shekullit të kaluar në lidhje me grupimet e galaktikave. Zwicky në 1933 dhe Smith në 1936 duke studiuar grupimet e mëdha të galaktikave, respektivisht galaksinë Coma *Berenices* dhe atë të *Virgjëreshës*, vëzhguan se shpejtësitë e galaktikave ishin shumë më të mëdha se sa parashikimet teorike për një sistem të lidhur gravitacionalisht masa e të cilit është vetëm ajo e galaktikave të dukshme. Ata arritën në konkluzionin se galaktikat në secilin prej grupimeve duhej të mbaheshin të lidhura prej efekteve gravitacionale që i detyrohen një sasie të madhe të materies së padukshme, të cilën ata e quajtën "masë e munguar". Sot në vend të termit "masë e munguar"përdoret gjërësisht termi **materie e erreët**. Vetëm në vitet 70 të shekullit të kaluar, në sajë të provave të pakundërshtueshme eksperimentale dhe mbi bazën e studimeve të detajuara të lëvizjes së yjeve në galaktika, komuniteti shkencor u detyrua të merrte pjesë në problemin e materies së errët. Vlen të theksohet fakti se të gjitha studimet supozojnë si të vërtetë ligjin e gravitacionit universal edhe në distanca shumë të mëdha. Nëse varësia e forcës gravitacionale prej distancës do ishte e ndryshme nga forma invers kuadratike, shumë prej përfundimeve mbi materien e errët duhen rishikuar.

Përse duhet të ekzistojë materia e errët?

Nga pikëpamja historike ka dy arsye themelore që kanë detyruar fizikanët të ngrenë hipotezën e ekzistencës së një sasie të konsiderueshme të materies jo të dukshme. Në të dyja rastet, njohuritë tona për mekanizmin e veprimit të forcës gravitacionale imponojnë ekzistencën e materies së errët në mënyrë që të mund të shpjegojmë korrektësisht fenomenet e evidentuara në "ambientin kozmik".

Grupimet e Galaktikave

Në Univers ekzistojnë shumë galaktika, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk paraqiten në mënyrë të veçuar prej njëra-tjetrës por janë të vendosura në struktura më të mëdha të cilat përmbajnë shumë e shumë galaktika në një hapësirë të cilën mund ta përcaktojmë si të kufizuar edhe pse kemi të bëjmë me distanca të paimagjinueshme prej nesh, të rendit megaparsec (Mpc1). ***1pc ≈ 3, 26147086 vjet dritë***

Këto struktura janë *grupimet e galaktikave* dhe mes dy grupimeve të galaktikave ekzistojnë boshllëqe gjigande kozmike, të cilat në fakt zënë rreth 80% të hapësirës që ne njohim. Struktura e shpërndarjes së materies së dukshme shfaqet si "hoje bletësh", në të cilat galaktikat organizohen kryesisht në plane dy-dimensionale dhe ndahen prej njëra-tjetrës nga zona kozmike në të cilat nuk është e pranishme materia e ndritshme.

Për shkak të tërheqjes gravitacionale, galaktikat në brendësi të të njëjtit grupim lëvizin me një shpejtësi tyren. Duke analizuar këto shpejtësi, studiuesit kanë arritur në përfundimin se ato janë shumë të mëdha, me një faktor nga 10 në 100 herë më të mëdha se sa shpejtësitë që galaktikat duhet të kishin nëse masa e grupimit do ishte vetëm ajo e dukshme. Rrjedha llogjike e gjithë kësaj të çon në hipotezën se duhet të ekzistojë një sasi e konsiderueshme e materies së padukshme por gravitacionalisht aktive e cila të justifikojë vlerat e matura të shpejtësive.

Galaktikat Spirale

Nga figura e mësipërme galaktikat, struktura e të cilave është *spirale*, kanë një bërthamë qëndrore me dëndësi mjaft të lartë dhe krahë të gjatë rreth kësaj bërthame, të cilat ndjekin kahun e rrotullimit të të gjithë strukturës. Çdo objekt që I përket një galaktike të tillë rrotullohet më një farë shpejtësie rreth qendrës së galaktikës. Vlera e kësaj shpejtësie varet nga distanca e objektit nga qendra e galaktikës si dhe nga masa e saj. Nga figura e mëposhtme galaktikat, struktura e të cilave është *spirale*, kanë një bërthamë qëndrore me dëndësi mjaft të lartë dhe krahë të gjatë rreth kësaj bërthame, të cilat ndjekin kahun e rrotullimit të të gjithë strukturës. Çdo objekt që i përket një galaktike të tillë rrotullohet më një farë shpejtësie rreth qendrës së galaktikës. Vlera e kësaj shpejtësie varet nga distanca e objektit nga qendra e galaktikës si dhe nga masa e saj.

Në figurë paraqitet galaktika spirale M81 me krahët e saj të mbushur me yje, e marrë nga teleskopi SIRTF (Space Infrared Telescope Facility)

Nëse kuptimi ynë për gravitetin është i saktë atëhere intuitivisht themi se një masë galaktike më e madhe do të shkaktonte shpejtësi më të mëdha të lëvizjes së objekteve rreth saj. Duke studiuar vlerat e shpejtësisë së objekteve në galaktika arrihet në përfundimin se shpejtësitë e matura janë shumë të mëdha për të qenë të justifikuara prej sasisë të materies së ndritshme që është prezente në galaktikë. Rrjedhimisht, që të justifikohen këto shpejtësi, duhet të ekzistojë një sasi e konsiderueshme materie e cila është aktive vetëm nga pikëpamja gravitacionale, e cila duke rritur masën e galaktikës justifikon më së miri vlerat e matura të objekteve prezente në galaktikë.

Prania e reve të gazit në pjesët e jashtme të galaktikave dhe në hapësirat ndërgalaktike

Duke studiuar kufijtë e jashtëm të galaktikave, ku ka shumë pak yje prezente dhe pra luminoziteti i shkaktuar prej tyre mund të mos merret në konsideratë, janë vëzhguar re të mëdha gazi në grupimet e galaktikave.

Për të shpjeguar se pse këto re nuk shpërbëhen duhet supozuar ekzistenca e materies së errët me një shpërndarje të ndryshme nga shpërndarja që deduktojmë për materien e ndritshme. A mund të ekzistojnë galaktika me materie të errët? Nga studimet më të fundit rezulton se materia e gaztë luminoze shtrihet përtej kufijve të galaktikave të dukshme. Që një gaz të jetë i dukshëm duhet të ngrohet. Kush apo çfarë e ngroh gazin? Nga kjo arrihet në përfundimin se ekzistojnë mjaft indikacione për praninë e materies së errët të shpërndarë rreth çdo galaktike dhe në hapsirat ndërgalaktike të një grupimi galaktikash.



Imazh me rreze X i marrë nga sateliti ROSAT i mbivendosur një fotografie të një grupi galaktikash. Imazhi tregon, me një ngjyrë rozë artificiale, një re gjigande gazi të "ngrohtë"i cili emeton një sasi të vogël rrezesh X. Prania e këtij gazi na bën të mendojmë një tërheqje gravitacionale që e mban të lidhur atë. Masa e dukshme e galaktikave nuk do ishte e mjaftueshme për të mbajtur të lidhur gazin dhe pra kjo gjë duhet të jetë pasojë e materies së errët të shpërndarë mes galaktikave në një grupim. (Dr. R. Mushotzky, Nasa Goddard Space Flight Center)

Lentet gravitacionale[1)]

Termi *lente gravitacionale* tregon për një efekt, i cili përshkruhet nga pikëpamja e Relativitetit të Përgjithshëm, sipas të cilit fotonet e emetuara nga një burim drite, kur kalojnë në afërsi të një trupi qiellor masiv, i nënshtrohen tërheqjes gravitacionale të tij. Në afërsi të këtij trupi, hapësirë-koha modifikohet duke u kurbuar. Ky perturbim në hapësirë-kohë i shkaktuar prej fushës gravitacionale të trupit qiellor ka për pasojë ndryshimin e trajektores së rrezeve të dritës në lidhje me trajektoren fillestare. Kjo gjë çon në formimin e imazheve të shumëfishta të të njëjtit burim. Në figurën më poshtë tregohet skematikisht formimi i imazheve të shumëfishta.

Pra trupat qiellor masiv do të sillen si lente gravitacionale. Kur një lente gravitacionale përbëhet nga një galaktikë apo një grupim galaktikash, imazhi i burimit përbëhet respektivisht prej dy ose më shumë objektesh "pikësore"ose nga harqe të ndritshëm, siç tregohet në figura.

[1] Fenomen i provokuar nga përkulja e rrezeve të dritës që vijnë nga një burim i largët (p.sh një galaktikë) nga ana e një objekti masiv i vendosur mes burimit dhe marrësit (p.sh një galaktikë e madhe ose një grup galaktikash). Ky fenomen ka për efekt prodhimin e imazheve të shumëfishta të burimit.

Nga se përbëhet materia e errët?

Teleskopi hapsinor Hubble ka treguar se në qiell, në një dimension këndor të barabartë me atë nën të cilin shihet Hëna, ka miliona galaktika. Nga një numër shumë i madh matjesh të kësaj natyrë arrihet të vlerësohet se në Univers ka rreth 100 miliard galaktika dhe se secila prej këtyre galaktikave është e përbërë nga rreth 100 miliard yje.

Kjo sasi kolosale e materies është e vogël nëse e krahësojmë me materien e errët. Sasia e materies barionike[2] në Univers, qoftë e dukshme ose jo, mund të vlerësohet mbi bazën e sasisë relative të deuterit dhe heliumit që janë prezent sot në Univers dhe kanë qenë prezent rreth tre minuta pas Big-Bang-ut. Nëse atëherë do kishte qenë prezente një sasi e madhe materie barionike, fillimisht përplasjet mes nukloneve[3] dhe më pas ato mes bërthamave do ishin shumë probabël në çastet e para të ekzistencës së Universit dhe fraksioni i deuterit duhej të ishte tani shumë më i vogël për arsye se bërthamat e deuterit kthehen në helium. Në rastin e kundërt, nëse materia barionike do kishte qenë e pakët në fillimet e Universit, atëherë sasia e deuterit prezente në Universin e sotëm duhet të jetë relativisht më e madhe.

Nga matjet më të fundit të kryera nga NASA në lidhje me sasitë relative të deuterit dhe heliumit deduktohet se materia barionike prezente në Univers është afërsisht 1/7 e materies së nevojshme për të mbajtur të lidhur yjet në galaktika dhe galaktikat në grupimet e galaktikave. Duke përdorur metoda të tërthorta, astrofizikanët kanë vlerësuar se materia barionike e ila nuk emeton dritë të dukshme është rreth 9 herë më e madhe se sasia e materies barionike që emeton dritë të dukshme. Lind pyetja: nga se përbëhet kjo materie? Këtu kemi të bëjmë me re gjigande gazi në grupimet e mëdha të galaktikave, vrima të zeza që vijnë si pasojë e kolapsit gravitacional të yjeve gjigand, yje të vdekur[4], objekte me dimensione planetare të cilët quhen përgjithësisht MACHO[5] etj.

Nga sa thamë deri tani është e qartë se kemi nevojë për hipotezën e ekzistencës së materies së errët jo-barionike në mënyrë që të kemi një shpjegim të arsyeshëm të gjëndjes së lidhur të yjeve në galaktika. Mendohet se Universi përmban një numër shumë të madhe neutrinosh, grimca mjaft të njohura në fushën e Fizikës së Grimcave Elementare, të cilat janë prodhuar në fazat e para të jetës së Universit. Shpesh neutrinot quhen "grimca fantazëm"për shkak se ato nuk zotërojnë ngarkesë elektrike dhe kanë një masë praktikisht zero. Për këto arsye neutrinot

[2] Materie që përbëhet nga protonet dhe neutronet.
[3] Përbërësit e bërthamës atomike, neutronet dhe protonet.
[4] Të tillë janë Xhuxhat e Bardhë, Yjet Neutronik etj.
[5] Massive Compact Halo Objects.

bashkëveprojnë mjaft rrallë me materien e zakonshme[6]. Matjet me saktësi të lartë të realizuara me përshpejtuesit e grimcave kanë vërtetuar ekzistencën e tre tipeve të ndryshme neutrinosh.

Eksperimentet **Kamiokande** e **Supekamiokande** në Japoni, **Macro** në Gran Sasso (rajoni i Abruzzo, Itali) dhe **Soudan 2** në SHBA kanë dhënë rezultate për të ashtuquajturit "neutrino atmosferike". Këto rezultate na japin një sugjerim të fortë se një neutrino e një tipi mund të transformohet në një neutrino të një tjetër tipi. Megjithatë këto janë vetëm konfirmime të parashikimeve teorike në lidhje me gjeneratat e neutrinove dhe transformimet e tyre, të dhëna në vitet 1965-1980 të shekullit të kaluar, vite në të cilat është shënuar një përparim i jashtëzakonshëm nga pikëpamja teorike në fushën e Fizikës së Grimcave Elementare[7].

Transformimi i neutrinove mund të arrihet vetëm nëse neutrinot kanë një masë të ndryshmë nga zero, gjë që është vërtetuar teorikisht. Në të njëjtin konkluzion arrihet edhe për neutrinot që vijnë nga Dielli, sipas eksperimenteve **Homestake** në SHBA, **GALLEX** në Gran Sasso dhe **SNO** në Kanada. Sipas këtyre eksperimenteve dhe parashikimeve teorike, neutrinot kanë një masë jashtëzakonisht të vogël; dukë shumëzuar këtë masë me sasinë kolosale të neutrinove në Univers merret një kontribut i tyre në masën totale të Universit pak më i vogël se ai i materies së dukshme.

Kontributi i neutrinove që kanë masë nuk e ndryshon shumë situatën, për më tepër që efekti i tyre reduktohet prej faktit se ato lëvizin me një shpejtësi shumë të afërt me shpejtësinë e dritës dhe mund të luajnë një rol vetëm në mbajtjen të lidhur të grupimeve të mëdha të galaktikave, por jo grupimet normale të galaktikave e aq më pak të kontribuojnë në mbajtjen të lidhur të yjeve në një galaktikë. Edhe pse nuk ka qënë akoma e mundur të evidentohet eksperimentalisht, mendohet se energjia mesatare e neutrinove është e madhe në krahësim me masën e tyre dhe pra shpejtësia e tyre është afërsisht sa shpejtësia e dritës. Thuhet se neutrinot janë një pjesë e materies së errët të ngrohtë. Për më tepër duket e nevojshme të hipotizohet që në **halonet**[8] galaktike ka grimca me masa relativisht të mëdha dhe që lëvizin me shpejtësi rreth 1000 herë më të vogël se sa shpejtësia e dritës. Fizikanët prej kohësh kërkojnë të prodhojnë këto grimca në përshpejtuesit e energjive të larta po deri tani nuk kanë arritur akoma ti vëzhgojnë, gjë që implikon se këto grimca duhet të jenë shumë masive.

[6] Neutrinot mund të përshkojnë të gjithë diametrin e Tokës pa bashkëvepruar me grimca të tjera.

[7] "Gauge Theory of Elementary Particle Physics", Ta-Pei Cheng dhe Ling-Fong Li, Oxford University Press

[8] Haloni galaktik është një rajon i hapësirës që rrethon galaktikat spirale. Ai përbëhet kryesisht nga yje të shuar, gaz dhe mendohet edhe materie të errët.

Nga ana tjetër, fizikanë që merren me studimin e astro-grimcave po kërkojnë për këto grimca në rrezatimin kozmik, duke përdorur dedektor të sofistikuar ku këto grimca duhet të hyjnë në bashkëveprim. Nisur nga fakti se këto bashkëveprime ndodhin shumë rrallë është e nevojshme të reduktohet çdo rrezatim i tepërt, si ai i lidhur me rrezatimin kozmik të ngarkuar dhe radioaktivitetin natyror. Dedektorët pra duhen vendosur në laboratore nëntokësor. Por cilat mundtë jenë këto grimca masive "fantazëm"të cilat lëvizin kaq ngadalë? Fizikanët teorikë kanë ngritur hipoteza në lidhje me ekzistencën e disave prej tyre. Më e çuditshmja nga këto është **neutralino**[9]**,** e cila është grimca supersimetrike me elektrikisht neutrale dhe me masën më të vogël. Ekzistenca e super-grimcave (s – particle) bazohet mbi një simetri të mundshmë **boson-fermion**[10], sipas së cilës çdo grimce me spin gjysëm të plotë (si elektronet, kuarket, neutrinot...) duhet ti korrespondojë një s-grimcë e cila ka spin të plotë (s-elektron, skuark, s-neutrino...). Në mënyrë analoge, çdo grimce me spin të plotë (psh fotoni) duhet ti korrespondojë një s-grimcë me spin gjysëm të plotë (psh fotino). Kandidati më i favorizuar për të shpjeguar materien e errët (të ftohtë) është neutralino, një s-grimcë që mund të konsiderohet si një përzierje s-grimcash të cilat janë partnerët supersimetrikë të fotonit, **bosonit Z**[o][11] dhe dy bosoneve të **Higgs**. [12] Një tjetër mundësi do ishte ajo e **nukleariteve**, bashkësi kuarkesh *Up, Down* dhe *Strange*. Bërthamat e zakonshme atomike përbëhen nga një bashkësi protonesh dhe neutronesh, të cilët nga ana e tyre janë bashkësi kuarkesh *Up* dhe *Down*. Në ndryshim nga bërthamat atomike, tek nuklearitët kuarket *u, d* dhe s janë të lirë të lëvizin në brendësi të të gjithë nuklearitit. Nuklearitët do kenë densitet më të lartë se bërthamat e zakonshme dhe do ishin të qëndrushme edhe për masa shumë më të mëdha se sa ajo e bërthamës së uraniumit.

[9] Neutralino është grimcë e predikuar nga Modelet Supersimetrike. Sipas modeleve supersimetrike, neutralino është një grimcë elektrikisht neutrale dhe është grimca supersimetrike më e lehtë. Cilësohet si një përbërës i mundshëm i materies së errët.

[10] Të gjitha grimcat ndahen në bosone dhe fermione. Bosonet janë grimcat të cilat kanë spin të plotë ndërsa fermionet janë grimca me spin gjysëm të plotë. Janë emërtuar në këtë mënyrë për nder të Satyendranath Bose, fizikan dhe matematikan indian, dhe Enrico Fermi, fizikan italian.

[11]Boson elektrikisht neutral i cili është përgjegjës për bashkëveprimin e dobët. Masa e tij është 91.1 GeV

[12] Bosoni i Higgs, apo siç cilësohet "The God Particle", është grimca përgjegjëse për masën e çdo grimce tjetër dhe për "thyerjen" e bashkëveprimit elektro-të dobët në të dobët dhe elektromagnetik. Kjo grimcë evidentohet teorikisht prej teoremës së Goldstone.
Eksperimentalisht nuk është vrojtuar ende, por eksperimentet që kanë nisur tashmë në CERN pritet të dedektojnë këtë grimcë rreth vitit 2013 ose të hedhin poshtë përgjithmonë ekzistencën e saj.

Sa materie e errët ekziston?

Sipas Relativitetit të Përgjithshëm të Einstein, që është sot teoria themelore nëpërmjet të cilës shpjegojmë Universin tonë deri në distancat më të largëta, ekziston një sasi e përcakuar e materies në brendësi të volumit kozmik, i quajtur densitet kritik, i cili bën dallimin formave të ndryshme të Universit dhe evolucionin e tij të mundshmën në të ardhmen. Nisur nga kjo që sapo thamë, është shumë e rëndësishme të vlerësojmë masën totale të Universit për të njohur nëse kjo është më e madhe, e barabartë apo më e vogël se sa ajo e fiksuar prej ekuacioneve të relativitetit.

Për këtë vlerësim, fizikanët përdorin një numër themelor, i quajtur *parametri i densitetit* dhe i shënuar me Ω, i cili jepet nga raporti i sasisë së materies reale të matshme në brendësi të Universit dhe sasisë kritike të përcaktuar nga Einstein në ekuacionet e tij.

- Nëse Ω është e barbartë me 1 atëherë sasia e materies që është prezente në Univers është ekzaktësisht e njëjtë me sasinë e materies të parashikuar nga Relativiteti i Përgjishmëm, gjë që do të thotë se graviteti mes strukturave të Universit lejon një zgjerim të vazhdueshëm të hapësirës, ashtu siç po ndodh në ditët e sotme. Në këtë rast hapësira është Euklidiane dhe kemi të bëjmë me një Univers i cili ka gjeometri **pjatë**.

- Nëse Ω është më e vogël se 1, do të thotë se sasia totale e materies në Univers nuk është e mjaftueshme për të lejuar forcën gravitacionale të veprojë mes strukturave në mënyrë që të frenojë në një farë mase zgjerimin dhe pra fati i Universit në këtë rast do të jetë zgjerimi i përjetshëm. Në këtë rast kemi të bëjmë me një Univers të hapur dhe gjeometria e tij është **hiperbolike**.

- Nëse Ω është me e madhe se 1 do jemi në një situatë të përmbysur me atë që thamë më lart. Pra masa totale e Universit është e mjaftueshme për të shkatuar në të ardhmen mekanizmin e kolapsit gravitacional të Universit, deri sa të arrihet në një situatë analoge me atë të Big-Bang, të quajtur Big-Crunch. Në këtë rast kemi të bëjmë me një Univers të mbyllur dhe gjeometria e tij është **sferike**.

Fizikanët teorikë parashikojnë një vlerë Ω = 1 për shumë arsye që gjenden në modelet e formimit dhe evoluimit të Universit. Pasojat e një gjëje të tillë, pra Ω = 1, janë që Universi është plan (pjatë) dhe përshkruhet nga një gjeometri euklidiane[13]. Duke patur parasysh se disa modele teorike, si psh teoria e inflacionit, disa studime mbi te dhënat e vëzhguara mbi strukturën në shkallë të gjërë të Universit dhe rezultatet më të fundit nga Boomerang[14] konfirmojnë këtë vlerë për Ω, është e nevojshme që

[13] E thënë me gishta: gjeometria euklidiane është ajo gjeometri në të cilën ka vend teorema e Pitagora-s.

[14] Balloon Observations Of Millimetric Extragalactic Radiation and Geophysics (BOOMERANG), është një eksperiment që mat rrezatimin kozmik të një porcioni të hapsirës nëpërmjet tre fluturimeve sub-orbitale të një ballone në lartësi të mëdha. Është

kontributet e "llojeve"të ndryshme të materies tek Ω, duke u mbledhur mes tyre, të japin vlerën 1.

Duke matur kontributin e dhënë nga materia e ndritshme në parametrin e densitetit, merret një vlerë Ω mat. ndritshme=0. 05, që sikurse shihet është shumë larg pragut që është 1. Në këtë mënyrë duhet të këtë një sasi spikatëse e materies duhet të jetë e padukshme; në fakt nuk ka evidenca eksperimentale që të justifikojnë një vlerë më të madhe se Ω mat. errët~0. 35. Pjesa e mbetur e masës, pra rreth 70%, duhet të përbëhet prej asaj që disa shkencëtarë e quajnë **energji e erret**, e cila ndoshta i dedikohet pranisë së konstantes kozmologjike Λ[15].

Nga pikëpamja fizike, konstantja kozmologjike nuk është gjë tjetër veçse një forcë e cila frenon zgjerimin kozmik, ose siç më pëlqen ta quaj: **anti-gravitet**. Për shkak të "sikletit"që sjell, që kur është "shfaqur", qëllimi kryesor i fizikanëve teorikë ka qënë që të vërtetojnë se ky term ka vlerën zero. Me gjithë mundimin gati 90 vjeçar, akoma askush nuk ka arritur të vërtetojë, qoftë dhe teorikisht, se ky term është zero. Kohët e fundit ka patur prova mjaftueshmërisht bindëse[16] për faktin se ky numër nuk është zero dhe për më tepër ai jep një kontribut në parametrin e densitetit me një faktor të rendit 0. 6-0. 7, që është ekzaktësisht pjesa e munguar për të arritur Ω =1.

Ku ndodhet materia e errët?

Pjesa më e madhe e astronomëve pajtohet me mendimin se materia e errët ekziston në afërsitë e bërthamave të galaktikave. Kjo gjë ndodh edhe në galaktikën tonë, Rrugën e Qumështit, ku Nebuloza e Magelanit dhe dy galaktika satelite të galaktikës sonë që ndodhen në hemisferën jugore kanë një lëvizje të influencuar nga prania e materies së errët në qëndër të galaktikës sonë, megjithëse ndodhet mbi 30000 vjet dritë larg tyre. Mendohet gjithashtu se në qëndër të galaktikës sonë ekziston një vrimë e zezë gjigande e cila vazhdon të rritet dhe ndoshta një ditë do "gllabërojë"Rrugën e Qumështit.

Në përgjithësi mund të themi se aty ku ka materie të dukshme ka dhe një farë sasie materie të errët. Problemi që shtrohet është se nëse do kishte sisteme qiellore ku është e pranishme vetëm materia e errët, do ishte e

---

eksperimenti i parë që ishte në gjëndje të jepte një imazh me rezolucion të lartë të anizotropive të temperaturës së rrezatimit kozmik. Nëpërmjet një teleskopi të ngritur deri në kuotën 42 km, u bë e mundur të zvogëlohet absorbimi prej atmosferës tokësore të mikrovalëve, të prodhuara prej rrezatimit kozmik. Fluturimi i parë testues u krye në qiejt e SHBA në 1997. Dy fluturimet pasardhëse kanë qënë në 1998 dhe 2003 nga baza McMurdo në Antarktidë. Balona u rrotullua rreth Polit të Jugut duke shfrytëzuar shtjellat polare, duke u kthyer në pikën e nisjes pas dy javësh. Nga ky efekt (boomerang) mori emrin edhe teleskopi.

[15] Kjo është një konstante e futur artificialisht në ekuacionet e Einstein-it në Relativitetin e Përgjithshëm në mënyrë që të mbahej në këmbë hipoteza e tij e një Universi statik.

[16] P.sh studimi i shpërthimit të disa Yjeve, i quajtur ndryshe Supernova.

pamundur të evidentohej në mënyrë të drejpërdrejtë për shkak të padukshmërisë së saj. Ne mundet vetë të shpresojmë që një sistem i tillë të jetë pranë një sistemi qiellor të dukshëm në mënyrë që të mund të vëzhgojmë efektet që shkakton mbi të.

Deri tani jemi totalisht të pafuqishëm në njohjen e sasisë së materies së errët që përmbahet në sisteme të tilla, dhe si përfundim mund të themi: "ESHTE PAMUNDUR TE PARASHIKOJME TE ARDHMEN E UNIVERSIT DHE TE ASAJ QE PERMBAHET NE TE, DUKE PERFSHIRE EDHE JETEN INTELIGJENTE", ndoshta kjo është një e drejtë ekskluzive e PERENDISE, sikurse është edhe krijimi. E rëndësishme është se nuk do ndalojmë kurrë së kërkuari për zgjidhjen e kësaj të panjohure që prej shekujsh mundon mendjen njerëzore. Nëse një ditë kjo enigëm do zgjidhej, plot probleme do lindnin bashkë me të: "A DO KISHTE ME VEND TE FLISNIM PER PERENDINE? "- NDOSHTA PO, NDOSHTA JO...

9. Errësira në kufijtë e Universit

Pas qindra miliardë vjetësh, çdo galaksi që kemi në fqinjësinë tonë, do të gëlltitet nga hapësira dhe largimi i saj nga ne do të jetë më i madh se shpejtësia e dritës.

Në shumë fusha të mëdha, kërkimet e shkencëtarëve i hedhin dritë të kaluarës, duke analizuar fosile të vjetëruara, objekte të kalbura apo mbetje të mumifikuara. Por, kosmologjia, studimi i origjinës dhe evolucionit të Universit, është ndryshe. Kjo është një fushë ku ne aktualisht mund të jemi dëshmitarë të historisë.

Rrezet e dritës së yjeve që i shohim me sy, janë nisur drejt nesh para mijëra vitesh. Drita nga objektet më të largëta, që kapet nga teleskopët e fuqishëm, udhëton drejt nesh shumë më gjatë, ndonjëherë miliarda vite. Kur e shohim një dritë të tillë, ne në fakt e shohim lashtësinë. Gjatë dekadës së shkuar, vëzhgimet e yjeve kanë bërë që t'i shohim thellësitë e së kaluarës së Universit, por ato çuditërisht mundësuan që ta shohim edhe natyrën e së ardhmes. Kjo ardhmëri, siç sugjerojnë të dhënat, nuk është edhe aq e qetë, për shkak të asaj që quhet energji e errët.

Historia e zbulimit fillon afro një shekull më parë me Albert Ajnshtajnin, i cili e kuptoi se hapësira nuk është një shkallë ku kanë mbirë bimët, siç e kishte parashikuar Isak Njutoni. Në vend të kësaj, Ajnshtajni zbuloi se hapësira, ashtu si edhe koha, mund të ndryshojë, të ndrydhet dhe të rrudhet.

Në fakt, hapësira është aq e lakueshme, saqë, sipas matematikës, madhësia e Universit domosdoshmërisht ndryshon me kalimin e kohës: fabrika e hapësirës duhet të zgjerohet apo të tkurret, nuk mund të mbetet e njëjtë.

Për Ajnshtajnin, ky përfundim ishte i papranueshëm. Ai do të kalonte 10 vjet për të zhvilluar teorinë e relativitetit, duke kërkuar njohuri më të mira për gravitetin, por nocioni i zgjerimit dhe i tkurrjes së hapësirës i dukej gabim. Ai fluturoi mbi krahët e urtësisë së kohës se në shkallë të madhe, Universi është i fiksuar dhe i pandryshuar.

Ajnshtajni reagoi shpejt. Ai e modifikoi ekuacionin e relativitetit të përgjithshëm, ashtu që matematika ta vërtetonte pandryshueshmërinë e hapësirës. Situata statike kërkon që forcat e njëjta me kahje të kundërt ta anulojnë njëra-tjetrën.

Në distanca të mëdha, forca që e formëson hapësirën është forca tërheqëse e gravitetit. Kësisoj, Ajnshtajni gjykoi se nevojitet një forcë baraspeshuese në kah të kundërt për ta dhënë shtytjen e duhur. Por, çfarë force do të ishte kjo?

Ky ishte ndër misteret më të thella. Nëse energjia e errët nuk degradon me kalimin e kohës, atëherë zgjerimi i përshpejtuar i hapësirës do të vazhdojë t'i largojë galaksitë gjithnjë e më shumë.

Pas qindra miliardë vjetësh, çdo galaksi që kemi në fqinjësinë tonë, do të gëlltitet nga hapësira dhe largimi i saj nga ne do të jetë më i madh se shpejtësia e dritës.

Kësisoj, dritat e emituara nga galaksitë e tilla do ta humbin betejën për ta kapërcyer hapësirën që i ndan me ne. Drita kurrë nuk do të mund të arrijë në Tokë, ndërsa galaksitë do të rrëshqasin përgjithmonë përtej kapacitetit tonë për t'i parë, pavarësisht sesa teleskopë të fuqishëm do të kemi.

Për këtë arsye, kur astronomët e ardhshëm do ta shohin qiellin, ata nuk do të mund të jenë më dëshmitarë të së shkuarës. E kaluara do të jetë larguar përtej kufijve të hapësirës. Observimet nuk do të mund të zbulojnë asgjë përveç njollave të zeza në pafundësi.

10. Universi mistik dhe magjik













Mbetjet e dy prej supernova, Keplerit diathtas, dhe G292.0 1.8 maitas

Grupi i galaktikave i njohur si ARP NGC 274 ose 5,679



Duket si nje dore fantazem: eshte pulsar PSR B1509-58, kapur nga sateliti Chandra



Galaksia Ngc4522.

11. Astronomët fotografojnë ''Syrin e Zoti''

Astronomët kanë rrëmbyer nga hapësira kozmike një foto aq qiellore dhe të mrekullueshme që është quajtur si Syri i Zotit. Syri ka një ngjyrë blu të kornizuar me ngjyrë të bardhë që vazhdon me një ngjyrë mishi që nga larg ngjan me një sy gjigand, të cilin astronomët e quajtën Syri i Perëndisë. Por, ky sy është kaq i madh sa përmban në të galaktika më vete dhe drites i duhen 2 1/2 vjet per ta kaluar ate. Objekti që ngjan me një sy në fakt një grumbull gazi që duket sikur zien brenda një ylli që aktualisht ndodhet 700 vjet larg nga kostelacioni i Aquarius. Kjo mund të shihet edhe nga amatorët e astronomisë duke përdorur teleskopa të vegjël. Kurse fotoja e publikuar u realizua nga një teleskop gjigand në Observatorin e Europës Lindore në malin e La Sillas në Kili.

Ekspertët thonë se sistemi ynë diellor do të ketë të njëjtin fat si ylli por vetëm pesë miliard vjet më pas.







Pavarësisht se në çfarë drejtimi shikon me Teleskopin Hubbel,
do të dalë kjo dritë e shndërritshme në mes.



12. Zbulohet "Toka"e re 20 vite drite larg Botës sonë

Shanset që një ditë brezat e ardhshëm të kolonizojnë yjet sa vjen e rritet. Astronomët njoftuan zbulimin e një planeti të ngjashëm me Tokën, një botë shkëmbore tre herë më të madhe se bota jonë. Bëhet fjalë për një yll 20 vjet dritë larg.

Planeti ndodhet në yjësinë e quajtur si "Goldilocks zone", një rajon hapësire ku kushtet nuk janë as shumë ftohtë dhe as shumë ngrohtë, të duhurat për të krijuar ujë që formojnë oqeane, liqene, dete dhe lumenj. Shkencëtarët mendojnë se planeti mund të ketë dhe atmosferë, gjë që rrit mundësitë për ë në këtë planet. Zbulimi i këtij ylli, vjen tre vjet pasi astronomët gjetën një planet të ngjashëm, me mundësi banimi rreth të njëjtit yll, që shkëncëtarët e cilësuan si "oborrin e shtëpisë për Rrugën e Qumshtit.

Me këto dy gjetje, studiuesit shprehen se po vërtetohen mundësitë se Universi është i mbushur së tepërmi me Botë si e jona. "Nëse këto botë janë të rralla atëherë ne do ti kishim gjetur me vështirësi dhe jo kaq shpejt sa i gjetëm", shprehet për këtë pikë, Dr Steven Vogt, i cili udhëhoqi studimet në Universitetin e Kalifornisë, Santa Cruz.

"Numri i sistemeve me planete potencialisht të banueshëm është ndoshta në masën e 10 apo 20 për qind. Mund të ketë dhjetra miliarda të këtyre sistemeve në Galaktikën tonë". , shton Vogt. Ai tha për Discoveri News se "personalisht shanset për jetë janë 100%".

Orbita e planeteve, një yll i kuq i quajtur Gliese 581 ndodhet në konstelacion me Libra. Orbitat e planeteve në sistemin Gliese 581 janë krahasuar me ato të sistemit tonë diellor. Ylli Gliese 581 është sa 30% e masës së diellit tonë, dhe planetet e tij janë afër me yllin e tyre sa jemi ne afër diellit tonë. Planeti katërt, G, është një planet i kësaj orbite në të cilin mund të ketë jetë. Nga matjet mësohet se Planeti i quajtur Glieseg 118, 000, 000, 000, 000 kilometra larg, ose ndryshe aq sa dritës së tij i duhen 20 vjet që të arrijë Tokën.

Planetit i duhen ëm 37 ditë të rrotullojë diellin, gjë që tregon edhe një risi tjetër për planetin, se stinët e tij mbarojnë për pak ditë.

Shkencëtarët kanë arritur gjithashtu në përfundimin se njëra faqe e planetit i tregohet gjithmonë dritës së diellit, kurse ana tjetër qëndron në errësirë të përhershme.

Astronomët kanë qënë gjithmonë në kërkim të risive përtej Galaktikës sonë dhe gjatë këtyre viteve kanë gjetur gati 500 eksoplanetë – ose të quajtur ndyrshe planete jashtë sistemit tonë diellor. Megjithatë, pothuajse të gjitha janë shumë të mëdha, shkëmborë, masa gazi, shumë të nxehtë ose shumë të ftohtë, mdth me kushte të pafavorshme për jetën.

13. Vrimat e Zeza

Studijuesit gjetën provën më të forte
të ekzistimit të vrimave të zeza!

Një ekip studjuesish Anglo-Francez, e kanë paraqitur deri më tani proven më të nxehtë të egzistmit të vrimave të zeza, ata erdhen në përfundim, se bëhet fjalë për një burim radioskopikë shumë të fortë, 290 milionë vjetë drite larg tokes dhe gjendet në një skaij të galaksisë dhe ka 500 herë peshë me të madhe se Dielli jonë.



Siç e dimë të gjithë vrima e zezë është një trup qiellor jashtezakonisht i dendur, me një forcë tërheqëse sa të madhe aq edhe të fuqishme sa që nuk lejonë largimin e asgjejë.

Tezën e egzistimit të vrimave të zeza e ka paraqitur për herë të parë teoria e relativitetit dhe pafundësia e saj mendohet të jetë +infinit, arsyja pse quhet vrimë e zezë është se është në gjendje që dhe driten ta absorbon plotësisht.



Ekzistojnë vrima te zeza të cilat kanë 100 deri në 300 herë peshë më të madhe se dielli, keto quhen zakonisht vrima të vogla te zeza, mirëpo mendohet se ka dhe nga ato që janë miliona ose miliarda herë më të mëdhaja se dielli, mirëpo egzistimi i tyre nuk është vërtetuar akoma.

Nga ana tjetër, shkencëtaret nuk janë akoma të bindur se ky burim radioskopikë i fuqishëm, është më të vërtet një vrimë e zezë, për këte gjë ka dyshime. Shkencëtaret e kishin zbuluar ketë radioskopë të fuqishëm qysh në vitin 2004, me ndihmen e teleskopit hapësinor XMM-Newton dhe rrezeve X, në periferi të galaksisë ESO 243-49, por nuk e dinin saktësisht se per cfarë bëhej fjalë.

Vrimat e zeza jane nder gjerat e quditshme ne hapesiren kozmike, e cila gllaberon qdo gje qe kalon afer saj. asgje nuk mund t`i ike asaj-madje as

edhe drita. Asgje nuk mund ti ike vrimes se zeze sepse graviteti i saj eshte shume i fuqishem. Sa me shume materie eshte e "paketuar"ne yje aq me i fuqishem eshte graviteti. Vrima e zeze eshte me u dendur se qdo gje qe mund te imagjinoni. Ajo mund te kete me miliona gjera me shume se dielli yne, te cilat do te mund te paketoheshin ne nje hapesire me te vogel se qyteti. Forca e gravitetit e ketyre gjerave te paketuara ne nje hapesire aq te vogel eshte tmerresisht e fuqishme.

Vrimë e zezë gjigante në qendër të galaktikës Centaurus A

Astronomet dhe fizikantët mendojnë se vrimat e zeza krijohen nga yjet e vdekura. Ylli i vdekur digjet dhe ndalon së ndriçuari. Gjithçka qe e perben yllin fillon te mblidhet ne vetvete dhe keshtu ylli behet me i dendur. Nese një yll mund të ketë dendësi të mjaftueshme qe te shndërrohet në një vrimë të zezë ateher edhe e ben ate gje. Askush nuk ka mundur t`i shohë vrimat e zeza. Ju nuk mund t`i shihni ato për arsye se nuk japin asnjë lloj sinjali të dritës. Fizikanetët e përdorin matematikën për të parashikuar ekzistimin e vrimave të zeza. Ata studiojnë rreze të fuqishme të cilat vijnë nga yjet thellë në hapësirë. Siç duket yjet rrotullohen rreth vrimës së zezë.

14. Astronomët amerikanë deklarojnë: Vrimat e Zeza mund të mos ekzistojnë

Ato thithin do gjë që u del përpara dhe kanë përfshirë në studimin e tyre mendjet më të ndritura të planetit të cilët kohët e fundit po marrin në konsideratë mundësine që vrimat e zeza mund të jenë inekzistente.

Sipas disa studiuesve, këndvështrimi tradicional mbi universin i mbushur me padukshmëri dhe çdo gjë konsumuese nga vrimat e zeza mund të zëvendesohet me një alternativë që ne vend të tyre vendos topa magnetike plazmore që pluskojnë në hapësirë.

Nëse gjetja vërtetohet, gjë që disa shkenctarë e shikojnë si të pamundur, atëherë do ndryshojë në mënyrë dramatike teoria që u hartua nga llogaritjet e një gjeologu anglez në vitin 1784 dhe që më pas u verifikua nga Einstein dhe katër ligjet e hartuara nga Profesori Stephen Hawking.

Shkenctarët, të drejtuar nga Rudy Schild i Harvard-Smithsonian Centre për Astrofiziken hasen atë që siç deklaruan ata mund të jetë vdekja e teorisë mbi vrimat e zeza. Kjo erdhi gjatë vëzhgimit të një quasari 9 miliard vjet dritë larg Tokës.

Quasaret besohet se kanë vrima të zeza në qendrën e tyre por që të provohet kjo teori shkenctarët programuan 14 teleskope të cilët për herë të parë u koordinuan në një mënyrë të tillë për të vëzhguar pandërprerje një pikë të caktuar në hapësirë.

Ata zbuluan një vrimë në një disk që ishte materiali rrethues i qendrës së quasarit, i gjere 4 mijë herë më shumë se distanca nga Toka në Diell. Vrima, siç besojnë ata, mund të jetë shkaktuar vetëm nga flakja e materialeve prej një force shumë të madhe magnetike.

Pasi vrimat e zeza nuk kanë fusha magnetike, ekipi i Dr Schild sugjeron ne The Astronomical Journal së quasari mund të marr energji nga një sasi e dendur sferash prej plazme që quhen MECO (magnetospheric eternally collapsing object). Por sipas astronomeve teoritë mbi ekzistencën e MECO-ve nuk pranojnë mundësinë e vrimave të zeza.

"Besoj se kjo është prova e parë që paradigma mbi vrimat e zeza është e pasaktë, "thote Darry Leiter, një shkenctar i ekipit i tha New Scientist.

Sipas Gerry Gilmore në Institutin e Astronomisë të Universitetin të Cambridge teoria ka ende rrugë për të bërë që të bindi shumë nga shkenctarët. Ai thekson eksperimentet e kryera vitin e kaluar të cilat mundësuan observimin direkt të një vrime të zezë në qendër të galaktikës sonë, Rruga e Qumështit.

"Më duhet të them që është një këndvështrim monitorues. Dhe ka shumë mundësi që të jetë i gabuar, "thotë Prof Gilmore. "Më përpara në observuam një vrimë të zezë dhe në atë moment pati një debat legjitim por tani është e vështirë të mendosh që në fakt ka qenë diçka tjetër. "

15. Shërimi yjor

Ndërsa kemi pranuar se planete si Dielli, Hëna, Mërkuri, Venusi dhe të tjerët mund të ushtrojnë një ndikim mbi jetët tona, pak kemi dëgjuar mbi një ndikim tjetër më pak të njohur, atë të yjeve dhe të rolit që ata mund të luajnë mbi ndërgjegjen tonë vetiake dhe kolektive.

Ekzistenca e këtij ndikimi bazohet në mesazhet e orientuara të marra nga Xhon C. Foks gjatë mesit të viteve 80-të, kur një entitet me emrin Hilarion kumtoi informacione mbi energjinë e yjeve. Hilarion shpjegoi se si mund të akordohemi me vibrimet individuale të yjeve dhe se si, në qoftë se një teleskop fokuson një yll mbi një sipëfaqe uji, disa nga cilësitë vibruese të atij ylli do t'i transmetoheshin ujit. Vibrimet në ujë çlirohen në sistem, duke ja dhënë marrësit natyrën e vibrimit. Në vitet në vazhdim, orientimi i mëtejshëm çoi në formimin e eliksireve yjore, që zotërohen tashmë në shkallë botërore.

Për vite e vite me radhë njeriu ka kthyer sytë nga yjet. Drita dhe prania e tyre duket se na inkurajon dhe frymëzon. E kush nuk pëlqen të vështrojë nga yjet në një natë të kthjellët dhe të mrekullohet me vezullimin e tyre? Yjet të japin gjithashtu ndjenjën e pranisë kolektive: duke ditur që dikush prej jush, nga i cili ju mund të jeni ndarë ose të cilin ju akoma nuk e keni takuar ndonjëherë, është duke vështruar lart dhe duke parë të njëjtin formacion yjor njëkohësisht. Lemurianët dhe Atlantidasit e moçëm ishin të ndërgjegjshëm mbi yjet dhe kërkonin esencën e tyre shpirtërore si edhe kërkonin përdorimin e energjive të tyre, ashtu siç bënin Egjiptianët, Majanët, Aztekët dhe shumë qytetërime të tjera të hershme.

Energjia e yjeve rrjedh poshtë, drejt nesh, vazhdimisht, megjithëse ne jemi, kryesisht, të pandërgjegjshëm për këtë gjë. Këto energji sjellin ndryshime vibracionale në një nivel të konsiderueshëm mbi çdo gjë të gjallë mbi Tokë. Yjet dhe konstelacionet, brenda të cilëve ato shfaqen, jo vetëm që kanë rëndësi zodiake, legjendare dhe simbolike, por mund të ofrojnë gjithashtu energji unike shërimi (kurimi) si në nivel të brendshëm ashtu edhe në nivel të jashtëm. Ashtu si planetet dhe interpretimet e tyre astrologjike, edhe yjet mund të ofrojnë drejtim, aftësi depërtuese dhe mirëkuptim. Ka disa mënyra për t'u akorduar me një yll: meditimi, eliksiri ose thjesht njohja e të hapurit ndaj energjisë së tij si një përbërës jetësor në jetën tuaj. Vibrimi i dritës nga një yll i përdorur në një eliksir ose në një formë meditimi vepron brenda sistemit të gjendrave dhe, duke u akorduar me një vibracion që është në harmoni me vibracionin tonë, krijon një zgjim të energjive më të thella dhe jetësore brenda nesh.

Në meditim, mendja qetësohet në një pikë të tillë që lejon përqëndrimin mbi disa aspekte të yllit, ndoshta duke dëgjuar një tingull ose duke rikrijuar vizionin e yllit brenda vetes tonë. Pastaj duhet të qëndroni për pak kohë duke medituar në heshtje të plotë mbi ndihmën ose ndriçimin që kërkohet, duke përfytyruar qëllimin tuaj të dëshiruar. Eliksiret mund të përdoren si vajra për masazh ose për banjo ose të merren me pika si në rastin e serumit. Gjatë këtij proçesi ju duhet të jeni i përqëndruar mbi yllin dhe ndihmën që kërkoni prej tij.

Ka shumë yje të cilëve mund t'u drejtoheni për ndihmë, me të cilët mund të punoni, në varësi të nevojës dhe në atë kohë. Më poshtë po japim disa nga më të dobishmet.

VEGA (Alpha Lyrae) - Energjia e VEGES lidhet me shprehjet muzikore dhe prandaj është e dobishme në pastrimin e blloqeve krijuese për ata që punojnë në fushën muzikore. Ajo pastron gjithashtu kanalet për komunikim dhe lidhje më të mirë në nivelet shpirtërore.

ALTAIR (Alpha Aquilae) - Altair karakterizon të kuptuarit, rezistencën dhe rrjedhjen e energjisë. Ai bën që të kuptohen më mirë situatat ku kanë dalë blloqe (pengesa), për të bërë të mundur që personi t'i shohi çështjet me një dritë të re dhe të kuptojë pse janë ato (pengesat) atje dhe si mund të kalohen.

SPICA (Alpha Virginis) - Ky është një yll i mirë për ata që merren me çështje spiritualiste sepse ndihmon në zhvillimin e aftësive pSiçike. Ky yll ndihmon edhe ata që kanë probleme fizike lidhur me shtyllën kurrizore çervike (në qafë ose në shpatulla).

FORMALHAUT (Alpha Piscis Austrini) - Formalhaut mund të ndihmojë shumë mirë ata që vuajnë nga të dhënit pas diçkaje që nga pirja, droga, duhani dhe deri marrëdhëniet e ndryshme.

ADHARA (Epsilon Canis Majoris) - Adhara ndihmon në funksionimin normal të sistemit tretës duke përfshirë edhe përthithjen e mineraleve të ndryshme, vitaminave dhe oksigjenit dhe çlirimin e substancave toksike.

ALIOTH (Epsilon Ursae Majoris) - Ata që punojnë në fushën e shëndetit mjeksor, me pacientë me vështirësi mendore dhe me gjëndje të çrregulluar psikologjike mund t'i rrisin aftësitë e tyre të komunikimit në një mënyrë sa më efektive me ndihmën e këtij ylli. Ky yll ndihmon gjithashtu aftësinë metabolizuese të sheqerit dhe të të kuptuarit subkonshient të ëmbëlsisë. Prandaj mund të jetë me shumë vlerë për këdo që ka çrregullime në ngrënie.

ALPHARD (Alpha Hydrae) - Ky yll është veçanërisht i dobishëm për emocionet, sidomos në manipulimin e inatit, burimit të tij dhe transformimin e tij në dashuri, pasion dhe unitet.

MIRACH (Beta Andromedae) - Mirach simbolizon lidhjen me sensin fizik dhe tingullin. Ndihmon në hapjen e root chakra, një balancim i brendshëm i gjendrave tiroide dhe i atyre endokrine dhe një lidhje më e ngushtë me tingujt e natyrës dhe Tokës.

CAPH (Beta Cassiopeiae) – Shkrimtarët, dhe ata që merren me sfera të tjera krijuese, do të gjejnë një akordim më të thellë me fuqinë e tyre të brendshme krijuese të Caph. Blloqet (pengesat) do të shkrihen dhe idetë do të çlirohen.

WEI (Epsilon Scorpii) - Ky yll do të ndihmojë së tepërmi të gjithë ata që merren me shërimin e të tjerëve. Ai i akordon, gjithashtu, njerëzit me jetët e tyre të shkuara, të lidhura me shërimin dhe mund të ndodhin rikthime të forta të kujtesës mbi jetën e mëparshme, kur ata kanë qënë marrë me shërimin e njerëzve. Ky yll sjell ndriçimin e brendshëm lidhur me atë se pse ata ndjehen të motivuar për t'u bërë shëronjës në këtë jetë.

ALUDRA (Mu Canis Majoris) - Aludra stimulon energjinë e zemrës dhe është e mirë për këdo që ka sëmundje të lidhura me zemrën. Ky yll bën që të përmirësohet shprehja e ndërgjegjshme e dashurisë dhe lidhja më e thellë midis syrit të tretë dhe chakras së parë, të dytë dhe të tretë për projektimin e energjisë së kësaj dashurie në sferat mendore.

ALRISHA (Alpha Piscium) – Në epokën teknologjike, në të cilën jetojmë, shumë veta kanë një frikë të thellë nga shpikjet e reja si kompjuterat dhe videot, psh. Meqë Alrisha ka linja të forta metalike, duke përdorur këtë yll, ju ndihmoheni në drejtim të të kuptuarit dhe të përdorurit më mirë të këtyre pajisjeve. Alrisha mund të përmirësojë gjithashtu përdorimin më mirë të kolinës (vitamin B kompleks - esenciale për funksionimin e mëlçisë) në tru, pra mund të jetë me efekte me vlera të mëdha në shërimin e sëmundjes së Alzheimerit.

16. A ekziston qytetërimi në Mars?

Kërkimi i jetës fillon nga Marsi

Ekzistojnë apo a kanë ekzistuar forma jete inteligjente dhe antropomorfe në planetet e tjera të sistemit tonë diellor?

Sipas autorit, është e mundur dhe jo në rrugë hipotetike, por prej paraqitje - deduksionit rigorozisht logjiko - matematik. Nuk ka pasur asnjë zbulim të rastësishëm, por një kërkim ndërdisiplinor, të kryer sipas rregullash të paracaktuara, në brendësi të një kuadri organik referimi.

Në këtë vëllim të dokumentuar dhe ilustruar me bollëk, fryt 10 vitesh kërkime, autori u jep si lexuesve të motivuar, ashtu dhe studiuesve të fushës, pse jo dhe pedagogëve dhe studentëve universitarë, e gjitha një seri gurësh dhe të vërtetash objektive, duke sqaruar përkufizimin e jo pak termave me dykuptime dhe të po aq teorive kontradiktore dhe duke ju përgjigjur bashkëbiseduesit kërkues që dëshiron të njohë pa rezerva dhe sidomos pa diskutime të errëta e të komplikuara, të vërtetën lidhur me Planetin e Kuq.

1. Jeta në univers

Në të kaluarën mendimtarët e mëdhenj nuhatën se njerëzimi tokësor përfaqësonte një prej shprehjeve të shumta të jetës në univers.

Filozofi Anaksagora (499/98 - 428/27 B. C.) shprehu bindjen se, Hëna ishte jo shumë e ndryshme nga Toka dhe në Greqinë e lashtë, filozofë të caktuar demonstruan se posedonin bindjen e pluralitetit të botëve. Midis këtyre parasokratikët Talesi nga Mileti (624 - 540 B. C.), Ksenofoni nga Kolofoni (570 - 475 B. C.), Heraklidi nga Hefesi (544 - 484 B. C.), Demokriti nga Abdera (460 - 371 B. C.), Epikuri nga Athina (341 - 271 B. C.) dhe Metrodori nga Kio, jetuar midis viteve 330 dhe 278 B. C. , i cili pohonte se "të besosh që mund të ekzistojë një botë e vetme e banuar është po aq e çmendur sa të theksosh se në një fushë të madhe me grurë mund të rritet vetëm një bimë plot me kallëza".

Filozofi Origjen nga Aleksandria (183/85 - 252/53 A. D.) theksonte se Toka "është një prej botëve të vogla midis të tjerave në hapësirat e pafundme qiellore". Tri shekuj pas vdekjes së tij, mendimtari i madh u deklarua heretik dhe shkrimet e tij u vendosën në Indeks.

Në shekullin e XV-të, në një epokë në të cilën kërkimi shkencor kundërshtohej shumë, një gjeni tjetër tentoi që ta daravisë errësirën e imponuar nga obskurantizmi mbytës. Ky njeri qe Kardinali Nicolò da Cusa, i quajtur "Cusano"(1401 - 1464), Peshkop i Bressanone, pararendës i Kopernikut. Cusano pohonte se "nuk ka asnjë yll, për sa është i ndryshëm nga bota jonë, për të cilin mund të ndjehemi të autorizuar të përjashtojmë se mund të jetojnë në të krijesa njerëzore".

Vetë Galileo Galilei (në fillimet e shekullit të XVII-të) pyeste nëse planetët e tjerë prisnin forma jete të ngjashme me ato tokësore dhe, në mënyrë më eksplicite, shprehej gjenia e Xhordano Brunos në veprën e tij "Për universin e pafundëm dhe për botën": "Universi është i pafundëm dhe qendra e tij gjendet në çdo anë dhe në asnjërën në të njëjtën kohë.

Në hapësirën e pamatshme dhe të pafundme ka diej të panumërt, yje të rrethuar nga planetë të ngjashëm me ato që rrotullohen rreth diellit tonë dhe është budallallëk të mendosh, se në këto planete nuk banojnë qenie inteligjente dhe më shumë inteligjente se ne".

Kartezi e gjykoi "të guximshme, por jo absurde"hipotezën e pranisë së jetës inteligjente jashtë Tokës. Nga ana e tij, Kant e mbështeste (bile edhe Goethe), ndërsa astronomi dhe matematikani Pierre La Place, duke i apeluar pikërisht teorive të propozuara nga Kant, arriti në fakt që t'u paraprijë astrofizikanëve modernë, duke pohuar se: "Njeriu i bërë për temperaturën tokësore, sipas çdo gjase, nuk do të mund të jetonte në botë të tjera.

Por, a nuk duhet të ekzistojë një pafundësi organizmash lidhur me temperaturat e ndryshme të globeve dhe të universeve? Nëqoftëse diferenca e vetme e elementëve dhe e klimës provokon kaq shumë larmi në krijesat tokësore, aq më shumë duhet të dalin nga format që njohim ato të planetëve dhe të satelitëve të tjerë!".

At Angelo Secchi (1818 - 1878), Drejtor i Specola Vaticana, në epokën në të cilën operonte pranë Akademisë Parisiane, ku tallej me njerëz që mbështesnin ekzistencën e meteoritëve, pohonte me kurajë: "Kush nuk beson në banueshmërinë e yjeve të tjera, është njëlloj si banori i Perandorisë Qiellore, i cili, i mbyllur brenda Murit të Madh, mendon se në botë ekzistojnë vetëm kinezë".

Veprat apasionante të shkrimtarit Camille Flammarion i kanë dhuruar njerëzimit intuita të mrekullueshme, akoma sot të mbetura shumë të vlefshme: "Guxojmë të shpresojmë - pohon Flammarion në fillimin e librit të tij kushtuar Marsit - se do të vijë dita në të cilën mjete të panjohura për shkencën tonë aktuale do të na japin dëshmi të drejpërdrejta rreth

ekzistencës së banorëve të botëve të tjera", dhe i shtojmë pionierit të aeronautikës dhe të astronautikës, fizikanin dhe matematikanin rus Kostantin Ziolkovskij, gjuha e të cilit, në vitin 1896, mban tashmë përpunime të gjera të tipit shkencor: "Në planete të ndryshëm mund të gjenden të gjitha fazat e evolucionit të jetës (...) Kishte njerëz në Tokë, mijëra e mijëra vjet më parë: do të zhduken pas disa miliona vitesh? I njëjti proces mund të zhvillohet edhe në botë të tjera".

2. Nuk është e mundur, kështu që nuk është!

Vetëdija se në galaktikën tonë, përveç Tokës, ka shumë botë të tjera të banuara nga qenie të gjalla sot është pasuruar nga një seri elementësh shkencorë të fituar nga kërkimi modern. Megjithatë, edhe pse mund të duket e habitshme, një vetëdije e tillë nuk buron nga vëzhgimi i trupave qiellorë të afërt me Tokën, domethënë të planeteve të sistemit diellor, por nga vëzhgimi i planeteve jashtëdiellore.

Tentativa për të studiuar planetet diellore u bë në kohën e saj (dhe me shumë bonsens) nga disa astronomë të shekullit të kaluar, por ajo e kërkimit sot duket sa ka marrë dënimin nga ana më pak e "kulturuar"e shkencës së sotme.

Në pozicione goxha të ndryshëm vendoseshin dy shkencëtarët e mëdhenj, studiues të Marsit, Slovskij e Sagan, sovjetik i pari dhe amerikan i dyti, në veprën (e shkruar sëbashku) "Jeta inteligjente e universit": "Idea se nuk jemi të vetmit, ka rezultuar një prej më pjellorëve të shkencës moderne. Atomet e pranishëm në Tokë janë identikë me ata ekzistues në një galaktikë që gjendet në 3 apo 10 miliard vite drite larg. Njëlloj ndodhin të njëjtat ndërveprime, të njëjtat ligje të natyrës i qeverisin lëvizjet. Formula që shpreh tërheqjen, dhe sfera prej plumbi me masë të madhe në një laborator tokësor mund të përdoret edhe për të parashikuar me saktësi lëvizjet e yjeve binare apo orbitën e Hënës.

Një prej midis intelektualëve revolucionarë kryesorë të Rilindjes, për të cilën luftuan Koperniku e Galileo dhe për të cilën Giordano Bruno humbi jetën, qe ideja se Toka nuk ishte gjë tjetër veçse një prej planetëve të shumtë në sistemin tonë diellor e më tej". Doktor Ludwig Mirzoyan (1973), astronom pranë observatorit Byurakan (Armeni), ka pohuar se, "ekzistojnë 100 miliard yje ose diej vetëm në galaktikën tonë, disa prej këtyre natyrisht që posedon sigurisht planetë si i joni. Në një rreze prej 100 vitesh drite, mund të ekzistojnë të paktën 10 Toka si kjo e jona".

Pavarësisht kësaj, shumë midis shkencëtarëve që e konsiderojnë të mundur dhe shumë probabël praninë e jetës inteligjente në univers, e konsiderojnë megjithatë joprobabël që mund të ndodhë ose që tashmë ka ndodhur një kontakt me Tokën. Ashtu si në shumë raste të tjera, "njeriu i shkencës", duke kundërshtuar premisat galileane, të cilave logjika shkencore duhet t'i referohet, për të justifikuar një paragjykim të sajin,

gjendet e shtrënguar në afirmime falas që ngatërrohen prej paqartësisë së formulimit dhe prej varfërisë së përmbajtjes. Për këtë motiv, në disa raste të veçanta, nuk është e mundur të dallohet opinioni i "arsyeshëm"i një kërkuesi nga mendimi "jokompetent"i një gazetari, duke qenë se si njëri, ashtu dhe tjetri, bëjnë garë se kush t'ia fusë më kot.

Kështu, aspektin e një teksti divulgues, lexojmë: "Për sa i përket mundësisë së një kontakti pakashumë të drejtpërdrejt midis nesh dhe të jashtëtokësorëve eventuale pengesa kryesore, edhe në këtë rast, përbëhet nga distanca e madhe që e ndan Tokën dhe pjesën tjetër të sistemit diellor nga yjet e tjera të pajisur me planetë në gjendje që të presë dhe zhvillojë jetën (...) kështu që mund të pohohet me arsye se asnjë jashtëtokësor nuk ka ardhur ndonjëherë të na gjejë (...) në çdo rast, edhe pse nuk kemi marrë asnjëherë vizita nga ana e jashtëtokësorëve, kjo nuk do të thotë se nuk është interesante të kërkoheshin".

Pa asnjë justifikim, planetet e sistemit diellor, fqinjët tanë të shtëpisë, janë përjashtuar në mënyrë sistematike dhe e gjitha kjo konfiguron një operacion që do të presupozonte të paktën elementë të qëndrueshëm në favor të këtij referimi i pabesueshëm. Dhe, në fakt, kërkimi i jetës fillon pikërisht nga Marsi.

3. Kërkimi i jetës fillon nga Marsi

Njeriu tokësor e ka vëzhguar kozmosin qysh nga kohërat më të lashta. Fillimisht ishte i kufizuar vetëm në përdorimin e syve, nga shekulli i XVII-të e më pas ka përdorur instrumenta dora-dorës gjithnjë e më të përsosura. Akoma në shekullin e XVII-të, instrumenti i vetëm në dispozicion të njeriut për vëzhgimin e qiellit ishte dylbia dhe, në disa raste, teleskopi.

Në atë kohë, njeriu ishte i vetëdijshëm për faktin se, dritarja e vetme nga e cila mund të shikonte kozmosin përfaqësohej nga instrumentat, lidhur me të cilët, nga ana tjetër, ishte absolutisht i bindur se ndodhej përballë mjetesh shumë të kufizuara. Mjafton të konstatosh pakënaqësinë e shprehur nga Schiaparelli, kur profetizonte se të gjithë misteret e Marsit do të mund të zgjidheshin vetëm kur të ishte e mundur të merreshin masa të sakta lidhur me imazhet fotografike të Planetit të Kuq.

Duket e pabesueshme, por Schiaparelli u referohej fotografive të afërta të ardhshme, megjithëse akoma nuk ishte në gjendje të bëhej fjalë për imazhe që do të mund të kryheshin nga instrumenta afër me planetin. Praktikisht, deri në atë moment, astronomët kishin kërkuar të afronin Marsin me Tokën, duke qëndruar në këtë të fundit.

Ishte si të hidhej një litar dhe të lidhej Planeti i Kuq, për të kërkuar që të vëzhgohej më mirë. Kjo ishte bërë me teleskopët dhe gjëja arrinte në mënyrë shumë të përafërt, pasi Marsi mbetet gjithsesi një planet mjaft i vogël dhe distanca megjithëse minimale nga Toka nuk është asnjëherë më e vogël se 55 milion kilometra.

Megjithatë, e gjitha kjo mbetet një pengesë e madhe për atë që do të donte të përdorte instrumentat optike për një studim sistematik (më mirë për një "vëzhgim pa pretendime") i asaj pike ngjyrë të kuqe të vendosur në qiell!

Kështu që duhet pranuar se, puna e kryer nga astronomët e shekujve të kaluar ishte një punë e madhe, një impenjim i madh i kryer me përdorimin maksimal të të gjitha mjeteve në dispozicion të shkencës dhe, jo për faj të tyre, ata pionierë të astronomisë deskriptive (planetologji) siguruan rezultate të ndryshme dhe, shpesh kontradiktore.

Kështu qenë zbuluar tashmë kallotat polare të Marsit, domethënë prania e akullit (jo domosdoshmërisht i përbërë nga uji), ishte vëzhguar ai që më pas do të quhej "Mali Olympus", mali më i lartë i Marsit dhe ndoshta i të gjithë sistemit diellor (që Schiaparelli e pagëzoi "Nix Olimpica", duke i ngatërruar retë me akull, duke qenë se ky vullkan i shuar ngrihej në një lartësi prej rreth 27 kilometrash nga niveli mesatar i Marsit), qenë vërejtur të ashtuquajturit kanale, të gjykuar nga disa me natyrë artificiale, më pas, në një kohë të dytë, të konsideruar joekzistentë, megjithatë më pas të rezultuar, pjesërisht, konsistues në rrugë me origjinë lumore apo në vargmale të mëdha.

Ndodheshim kështu përballë të dhënash që provokonin debate dhe konfuzione, tronditje të mëdha dhe reagime të palidhura kryesisht të markës konservatore, ku vetëm disa kuptonin se ishte e drejtë të qëndrohej në pritje kontrollesh të mëtejshme. Kemi theksuar zbulimin e mëparshëm (të ndodhur në shekullin tonë) e natyrës lumore të disa midis kanaleve të vëzhguara në shekujt e kaluar. Në mënyrë korrekt, pas formulimit të hipotezave të para lidhur me kanalet, është proceduar më pas me zbulimin e shumë strukturave lumore, në meritë të së cilës ekzistenca, në epokën e vëzhgimeve të para, nuk kish qenë e mundur të formulohej asnjë lloj hipoteze. Si ishte arritur në këto zbulime të reja? Ishte tani në posedim teleskopësh të rinj dhe më të fuqishëm? Aspak.

Mjafton të mendosh se sot teleskopi tokësor më i madh, "Hubble", që operon jashtë nga Toka (duke qenë i vendosur në orbitë rreth planetit tonë), nëqoftëse vendoset në drejtim të Marsit, arrin mezi që të dallojë disa prej formacioneve më të mëdha malore e asgjë tjetër, kuptohet me asgjë tjetër të detajuar. Një e dhënë duhet nxjerrë në pah: në zbulimin e natyrës lumore të disa kanaleve, pse jo dhe në zbulimin e të tjerëve, gjithmonë me origjinë lumore, krejtësisht të panjohur nga vëzhgimet e astronomëve të shekujve të kaluar, nuk është arritur nëpërmjet vëzhgimeve astronomike nga Toka (astronomi pozicioni).

Është e mundur kështu të kryhet menjëherë një diferencim i parë: rezultatet e para të referuara studimit të Marsit u siguruan në shekullin e XIX-të prej meritës së disa astronomëve të mëdhenj, pionierë të vërtetë të shkencës moderne dhe pionierë të vërtetë të studimit të planetit Mars.

Momenti i dytë operativ u bë i mundur në fakt nga vëzhgimet e kryera nga instrumenta të vendosur në orbitë rreth Planetit të Kuq. Kështu, fluturimet hapësinore i kanë hequr astronomisë klasike dhe astronomisë deskriptive (që nuk dispononte foto satelitare) monopolin e vëzhgimit të Marsit, megjithëse nuk duhet harruar se, misionet hapësinore u bënë të mundur pikërisht nga përpunimi i masës së madhe të të dhënave të grumbulluara më parë nga astronomët.

Do të dukej e natyrshme të imagjinohej një vijueshmëri metodologjike midis studimeve të kryera (midis fundit të shekullit të XIX-të dhe fillimeve të atij të XX-të) nga kërkuesit nëpërmjet vëzhgimesh astronomike dhe studimeve që astronomët kanë (ose do të kishin pasur) mundësi që të kryenin nëpërmjet përdorimit të instrumentave më të kërkuar të montuara në bordin e anijeve hapësinore të vendosura në orbitën rreth Planetit të Kuq.

Thamë "do të dukej", pasi në fakte kjo vijueshmëri nuk ka ndodhur. Në praktikë, astronomët që në shekujt e kaluar merreshin me Marsin e shtynin kërkimin deri në rezultatet maksimale të mundshme: kjo nuk nënkuptonte braktisjen e ndonjë logjike shkencore, por (siç e ka demonstruar gjerësisht vijimi i ndodhisë) hapja ndaj zgjidhjeve të mundshme të problemeve, gjithmonë duke mbajtur parasysh të dhënat në dispozicion dhe nivelin e arritur nga kërkimi në atë kohë.

Kurse astronomët e sotëm (i referohemi këtu asaj pjese astronomësh që në praktikë vazhdojnë të operojnë me një metodologji tashmë të bërë të kotë nga teknologjitë e reja të vëzhgimit), thjesht kanë hequr dorë nga pranimi i realitetit të ri në vijim të fillimit të erës hapësinore.

Nga vëzhgimi i parë në zbulimet e para shkencore

Marsi është një prej nëntë planeteve të njohur të sistemit diellor dhe i katërti, duke numëruar nga Dielli, duke pasur, në renditje: Mërkur, Afërditë, Tokë dhe Mars. Ka një diametër pak më shumë se gjysma e atij tokësor dhe, midis planeteve të sistemit diellor, është ai që paraqet ngjashmëritë më të mëdha fizike me planetin që banojmë. Ky planet u ka përfaqësuar gjithmonë një enigmë për shkencën dhe, gjatë tri shekujve të fundit, është vëzhguar me ndihmën e instrumentave optikë, ndërsa më parë vëzhgimi i ka qenë besuar vetëm syrit të lirë.

U njoh qysh nga kohërat e lashta, sëbashku me Mërkurin, Afërditën, Jupiterin dhe Saturnin, të tjerët duke qenë të zbuluar (apo rizbuluar!) vetëm më pas: Herschel zbuloi Uranin në vitin 1781 nëpërmjet vëzhgimit, Le Verrier zbuloi Neptunin në vitin 1846, duke llogaritur perturbacionet e Uranit dhe Lowell, studiues i madh i kanaleve të Marsit, në vitet e para të nëntëqindës, llogariti pozicionin e Plutonit, më pas i zbuluar në vitin 1930 nga C. W. Tombaugh. Thuhej më sipër se mund të kemi të bëjmë me zbulime, por me rizbulime.

Praktikisht, duket se sumerët, ashtu si edhe popuj të tjerë, qenë në dijeni "të paktën"të planetëve të sistemit diellor aktualisht të njohur për shkencën tokësore. Disa studiues theksojnë veç të tjerash se në kohërat e lashta disa popuj qenë në dijeni të planeteve të tjerë përveç atyre të zbuluar në kuadrin e sistemit diellor.

Në një epokë të hershme u vëzhgua në Kinë një "vënie në linjë: e Hënës me planetet Mars, Jupiter, Saturn dhe Mërkur. Ishte në kohërat e Perandorit Huang - Ti, në vitin 2441 B. C. Kinezët quanin Mars "yllin e kuq"apo "dritën verbuese".

Në Indi quhej "Angaraka"(qymyr i ndezur) dhe "Lohitanga"(trup i kuq) dhe i atribuohej një influence të keqe. Në Arabi, konsiderohej një luftëtar qiellor gjithmonë në lëvizje për të goditur njerëzit me ushtat e tij të pagabueshme.

Egjiptianët e quanin "Harmakhis"dhe në Persi emërtimi ishte "Pahlavani Siphir", domethënë "luftëtari qiellor". Pranë kaldeasve merrte emrin "Nergal"dhe konsiderohej heroi i lumnueshëm, zot i betejave dhe i vdekjes. Në vitin 1845, arkeologu Henry Layard zbuloi qytetin legjendar të Ninives në afërsi të Mossul (Iraku aktual), qytet i harruar për 2400 vjet nën shtresat e tokës, të shndërruara në kodrina.

Zbulimi më i madh i takoi bibliotekës së tij shumë të madhe të tabelave që përbënin libra në kuptimin e vërtetë të fjalës, shumë prej të cilëve u kushtoheshin yjeve. Një vepër e tërë i ishte kushtuar vëzhgimeve të Marsit. Viti i hartimit ishte llogaritur rreth vitit 1700 B. C. "Libri i Marsit"rezultoi se bënte pjesë në një vepër më të gjerë të mbiquajtur "Vëzhgime të Bel".

Bëhet fjalë për vëzhgimet më të drejtpërdrejta të Marsit, për të cilat ka njoftim lidhur me periudhën e lashtë. Është e njohur se observatorët e përdorur nga kaldeasit qenë tempuj të përbërë nga kulla të mëdha me kopshte të pamata për t'u mundësuar zotave që të zbrisnin midis të vdekshmëve.

Pjesa më e madhe e këtyre monumenteve u ngrit në Babiloni dhe është e njohur me emrin e "Kullës së Babelit"(emri i vërtetë ishte Etenemanki). Kjo kullë qëndroi në funksionim për një periudhë të shkurtër në shekullin e VI-të B. C. sëbashku me qytetin që dominonte. Ishte 90 metra e lartë dhe atje sipër priftërinjtë kaldeas ndiqnin rrugëtimin e planetit Mars. Grekët e quanin "Ares"dhe ky emër ishte në marrëdhënie me pamjen e flakës pulsuese që planeti emeton shpesh kur ndodhet afër vijës së horizontit, njëlloj si yjet. Në shekullin e IV-ët B. C. Aristarchus of Samos, hipotekoi praninë e Diellit në qendër të një sistemi në të cilin Toka ishte e vendosur midis Afërditës dhe Marsit, me tri planetet që rrotulloheshin përreth Diellit.

Në vitin 357 B. C. , sipas llogaritjeve të Kepler, Aristoteli pa Hënën që të kalojë nën Mars: në realitet filozofi grek vëzhgoi një okultim të Marsit

nga ana e Hënës. "Ares”u bë "Mars"-i i latinëve dhe atij ju kushtua muaji mars (i pari i kalendarit romak). Marsi - i konsideruar baba i Romulit, themeluesit mitik të Romës - ishte zoti kombëtar i romakëve dhe, për këtë qëllim, Livi referonte se "ajo romake ishte më e fuqishmja e perandorive, pas asaj të qiellit (...) populli romak pohon se babai i tij, babai i perandorisë, nuk është gjë tjetër veçse Marsi". Kështu që, duhet e arsyeshme të mendohet se, nëqoftëse romakët imagjinonin një fillim të aktivitetit të Marsit në epokën e themelimit të Romës, atëherë kjo mund të nënkuptojë se ata transmetonin një traditë, sipas së cilës qyteti latin do të fillonte të ekzistonte gjatë një brezi dëshmitar i ndonjë evenimenti lidhur me Marsin (planetin) që, aktualisht, ne nuk e njohim.

Përpara shpikjes së dylbisë, studimi i Marsit mbeti i kufizuar në spekulime të pastra filozofike që pushuan me zbulimin e shtypit dhe afirmimin e idesë heliocentrike, e shprehur në vitin 1543 nga abati polak Nikola Kopernik (1473 - 1543). Astronomi gjerman, Johannes Kepler (1571 - 1630) e pranoi dhe e zgjeroi sistemin kopernikian, duke e përsosur nëpërmjet studimit të lëvizjes së Marsit dhe, nëpërmjet kësaj të fundit, i qe e mundur të zbulonte ligjet e lëvizjes së planeteve, domethënë mekanikën qiellore. Koperniku kish parathënë se, shpikja e dylbisë astronomike, e projektuar në shekullin e XVI-të, do të mundësonte të studioheshin planetet.

Megjithëse, askush nuk e ka shkruar kurrë historinë e këtij instrumenti të rëndësishëm, është e qartë se ai u konceptua atëherë kur u bënë të njohur ligjet e thyerjes së dritës. Sipas P. Borel, autor i një vepre të dalë më 1660 ("De vero telescope inventore"), dylbia do të shpikej rastësisht në vitin 1590 nga dy djem të një fabrikuesi syzesh në Middlebourg (Gjermani), njëfarë Zaccaria Jansen. Burime të tjera përmendin si shpikës të dylbisë zotin Jan Lepperskey, me profesion opticien.

I pari, që studioi qiellin me dylbi qe patjetër Galileo Galilei, i cili në vitin 1610, në moshën 46-vjeçare, ndërtoi një model personal, sot i ruajtur pranë Akademisë në Firence. Ai e vëzhgoi Marsin dhe kuptoi se planeti nuk dukej përsosshmërisht i rrumbullakët. Ia komunikoi këtë vëzhgim të tij me një letër të 30 dhjetorit 1610 Benedetto Castelli, një benediktini mësues matematike në Pisa, dishepulli i tij.

Gjithsesi, vëzhgimet e para për të cilat ka njoftim u kryen nga italiani Francesco Fontana (1580 - 1656). Ky studiues u quajt shpikës i dylbisë (dhe i mikroskopit) që do ta realizonte në vitin 1608 (dhe mikroskopin më 1618). Në vitin 1632, realizoi dizenjon e parë të Marsit, zbuloi një njollë të paformë të rrethuar nga një rreth.

Së fundi, në vitin 1636, ndërtoi një model të përsosur dylbie. Zbuloi lëvizjen rrotulluese të Marsit dhe i botoi punimet e tij në vitin 1655. Studime me një rëndësi të caktuar u kryen edhe nga dy jezuitë: Zucchi në vitin 1640 dhe Daniele Bartoli në vitin 1644. Astronomi Evelio (Hevelius), i

cili në kohën e tij kish hartuar hartën e parë hënore, e kuptoi se duhej të hiqte dorë nga paraqitja e Marsit, pasi dylbia e tij nuk e mundësonte që të shikonte detaje domethënëse.

Astronomi holandez, Cristian Huygens (1609 - 1695), me mjetet e veta, ndërtoi një dylbi nëpërmjet të cilës arriti që të dallojë në planet kontraste drite në kuptimin e vërtetë të fjalës. Huygens vëzhgoi se, disa parte të errëta nuk zinin gjithmonë të njëjtin vend: ato lëviznin nga Perëndimi drejt Lindjes. Deduktoi se planeti rrotullohej rreth vetes, sipas një cikli që i ngjante atij tokësor. Për pasojë, Marsi njeh suksesionin e ditëve dhe të netëve. Në një shënim të ditarit të tij të 1 dhjetorit 1659 gjejmë të shkruar: "Debet Martis conversio fieri spatio circiter diurno, sive 24 horarum nostrarum quemadmodum item Telluris"(Rrotullimi i Marsit duket se ndryshon, ashtu si ai i Tokës, në 24 orë). Pasoi ajo që është menduar dizenjoja më e vjetër që paraqet një aspekt të përcaktuar të sipërfaqes së Marsit. Veç kësaj, një dizenjo e vitit 1672 konsiderohet e para që e tregon qartë kallotën polare të Marsit. Astronomi Giandomenico Cassini (1625 - 1712), pasi është interesuar gjatë për kometat, u mor me themel me planetin Mars me një "dylbi prej 25 pëllëmbësh"(rreth 7 metra).

Me këtë instrument arriti që të individualizojë suksesionet e njollave, të cilat përbëjnë një sekuencë mjaftueshmërisht karakteristike për të konfirmuar hipotezat fillestare të Huygens lidhur me kohërat e rrotullimit të Marsit.

Një periudhë të gjatë studimi e shtyu Cassini që të konsideronte se Marsi rrotullohej rreth vetes në 24 orë e 40 minuta. Kohëzgjatja reale do ta kalojë vetëm me 1 minutë atë të llogaritur nga studiues bolonjez. Rezultatet e arritura nga Cassini u përcollën në "Journal de Savants"të 31 majit 1666.

Nja 100 vjet më vonë, nga fundi i Shtatëqindës, u vërejt se aksi i rrotullimit të Marsit paraqiste një vlerë shumë të afërt me atë të Tokës, gjë që bëri të nuhatej se Marsi duhej të posedonte të katra stinët si planeti ynë.

Nga ai moment do të jetë e zakonshme të flitet për mundësinë e jetës në Planetin e Kuq dhe Marsi do të bëhet kokëçarja e shkencës "ortodokse", një enigmë e pazgjidhur, por vetëm në nivel zyrtar, edhe pas fillimit të erës hapësinore.

Vëzhgime të reja interesante u kryen në vitet 1777, 1779, 1781 e 1783 (vite të opozicionit të Marsit) nga studiuesi William Herschel, i cili përdori teleskopë më të fuqishëm të ndërtuar personalisht. Punët e tij u botuan në organin "Philosophical transactions"(1781 - 1784) dhe midis titujve të shumtë kemi: "Mbi konfigurimin e rajoneve polare të planetit Mars, përkulja e aksit të tij, pozicioni i poleve të tij dhe dukja sferoidale e tij, me disa aludime lidhur me diametrin real dhe atmosferën e tij".

Traktatet e Herschel janë më të rëndësishmit përpara studimeve të kryera nga kërkues të ndryshëm të shekullit të XIX-të dhe në kohën e tyre u konsideruan si gurë themeli të vërtetë, të minuara vetëm nga zbulimet e

mëpasme të vitit 1879. Midis viteve 1785 dhe 1802 (vite të opozicionit të Marsit) u kryen disa vëzhgime nga Johann Hieronymus Schroeter, i cili kishte ndërtuar vetë një observator në Lilienthal, në afërsi të Bernës. Duket se ky studiues ka qenë i pari që ka përdorur termin "areografi"(nga Ares: Mars) korrespondues i termit "gjeografi"(nga Gea: Tokë). Në observatorin astronomik funksionues pranë Tiergarten të Berlinit operonte Wilhem Beer, vëllai i kompozitorit Jakob Meyerbeer, i cili, në bashkëpunim me J. H. von Madler, redaktoi një hartë të Hënës (1834) dhe një të Marsit.

Por kjo e fundit ishte patjetër inferiore nga ajo e Hënës, megjithatë përfaqësonte tentativën e parë për të bashkuar në një kuadër të vetëm të gjitha informacionet mbi morfologjinë e Marsit të fituara deri në atë moment.

Në këtë periudhë studiues të tjerë u morën me Marsin: F. Kaiser në Holandë, Sër Joseph Norman Lockyer në Angli, Dominique François Arengo në Francë dhe At Angelo Secchi (i Specola Vaticana) në Itali. Ky i fundit në veçanti është studiuesi i parë që ka përmendur kanalet e Marsit (më pas të marrë nga Schiaparelli e Lowell në vitin 1877).

Në vitin 1864, vit tjetër kundërvënieje të Marsit, planeti u vëzhgua nga rev. W. R. Dawes (i cili operonte në observatorin Hopefield të Haddenham në Buckinghamshire) dhe në vitin 1867, për meritën e një astronomi tjetër anglez, Richard Anthony Proctor, "hartën e parë të Marsit"e kompletuar me emrat e disa veçantive të zbuluara në sipërfaqen e tij. Proctor qe i pari që u atribuoi karakteristikave të sipërfaqes së Marsit (siç ishte bërë tashmë për Hënën) emrat e studiuesve të famshëm të planetit: Kepler, Tycho Brahe, Madler, Cassini dhe Herschel. Astronomi italian, Giovanni Virgilio Schiaparelli përpunoi "toponomastikën e parë të Marsit"të pranuar universalisht. Puna e parë e hartografisë e kryer nga Schiaparelli përcillte pothuajse 62 karakteristika të rëndësishme. Zonat më të qarta që Proctor i kishte quajtur "toka"apo "kontinente"emërtoheshin tani nga Schiaparelli me emrat e vendeve të vërteta apo mitike të Tokës: Arabia, Syria, Arcadia, Utopia, etj. Zonat më të errëta qenë emërtuar me emra detare: Mare Tyrrhenum, Aurorae Sinus, Aonis Sinus, Margaritifer Sinus, etj. Në fund të shekullit të XIX-të, studiuesit më së fundi patën në dispozicion instrumenta optike të fuqishme sa të mund të dallojnë ndonjë karakteristikë të rëndësishme në sipërfaqen e planetit dhe elementët e parë të konsiderueshëm të vërejtur qenë kanalet e famshme (1877), nga disa të konsideruar "artificialë", përveçse një serie fenomenesh drite (1886) të zbuluar deri në ditët tona (1976). Në raport me fuqinë e rritur të rezolucionit të vëzhgimeve teleskopike, u zbuluan veç të tjerash dy satelitë të Marsit, më pas të quajtur Phobos e Deimos (1877). Nga ky moment e prapa, do të shfaqen shumë punime lidhur me planetin Mars. Pothuajse 2 vjet pas vëzhgimeve të rëndësishme të kryera nga Schiaparelli (në vitin 1877), u shfaq në Gjermani libri "Marsi, një Tokë e dytë"e Profesor J. H.

Schmich nga Këlni, klimatolog. Në vitin 1892, astronomi i famshëm francez Flammarion, botoi traktatin e madh "Planeti Mars dhe kushtet e tij të banueshmërisë"dhe, 6 vjet më vonë, realizoi një hartë të përgjithshme të Marsit, në atë kohë e gjetshme nëpër librari, sëbashku me hartat e përgjithshme të Tokës. Një mbështetës i teorisë sipas së cilës Marsi do të ishte një planet i banuar qe Percival Lowell, i cili në vitin 1895 botoi një libër të titulluar "Marsi". Në të njëjtën periudhë, shkrimtari Otto Dross botoi në Austri (1901) librin "Marsi, një botë në luftë për mbijetesën", në sintoni me teorinë që i shikonte "marsianët"të impenjuar në një garë të fortë me natyrën, të prirur që të ruanin në minimum, kushtet e jetueshmërisë së planetit nëpërmjet përdorimit të ujit të pakët ekzistues atje.

Në vitin 1902, M. A. Mercier organizoi një kongres lidhur me planetin Mars, i cili u mbajt pranë Bashkisë së qytetit Orléans (Francë). Gjatë kongresit u propozua që të gjehej një mënyrë për të komunikuar me planetin Mars, por gjithçka përfundoi në hiç nga momenti që nuk u gjet një teknikë e përshtatshme që të mund të arrihej qëllimi.

17.Të rejat e fundit nga Planeti i Kuq (Marsi)

Në muajtë e fundit janë zbuluar një numër i madh anomalish në sipërfaqen e planetit Mars. Ajo që ia vlen më shumë për t'u përmendur është nga fotot e Mars Global Surveyor, ka të bëjë me të ashtuquajtura "Tubat e Xhamit" të zbuluara nga një grup shkenctarësh të "Enterprise Mission, " të cilët punojnë në mënyrë të pavarur nga NASA. Ata mbasi analizuan rreth 20 mijë megabytes me foto të bëra publike nga NASA në vitin 2000, para disa muajsh zbuluan ekzistencën e një strukture në formë tubolare jo natyrale ne planetin Mars. Pamja e tyre e reflektuar të krijon përshtypjen e një sipërfaqeje të xhamtë dhe me linja të shumta në prerje rrethore. Fotoja e mëposhtme tregon atë që mund të quhet me plotë gojen një tub i xhamtë me një diamter prej 200 metrash që reflekton një dritë të fortë, mbase dritën e diellit. Disa kërkues kanë hedhur hipotezat që këto tuba të cilët duken qartë që s'janë natyral mund të jenë një lloj sistem qarkullimi i ujit ose dhe një sistem transporti që shkon nëntokë. Nëse kjo teori del e vërtetë atëherë do të provohet njëherë e mire që Marsi është i banuar dhe civilizimi i tij shtrihet nën sipërfaqen e planetit të kuq.

Dhe më në fund ndodhi ajo që pritej prej kohesh. NASA u detyrua të pranonte që Marsi ka ujë. Këtë lajm e shkruajta dhe tek tema Te Reja Nga Shkenca Dhe Jeta por këtu po e trajtoj në mënyrë tjetër. Një deklaratë e tillë nga ana e NASA-s pritej të bëhej herët a vone si rezultat i presionit të vazhdueshëm nga ana e publikut dhe sidomos i shkenctarëve të pavarur. Shpjegimi i NASA-s për struktura të ndryshme të dala nga fotot e saj si formacione natyrore guresh nuk pinin më ujë dhe kjo gjë ishte kuptuar më

së miri edhe nga vetë administratorët e saj. Shkenctarët si Hoagland me shokë ka kohë që ushtrojnë një presion në të gjitha rrugët e mundshme ligjore që NASA të botojë foto të paprekura dhe të paedituara të misioneve hapësinore dhe sidomos ato në Mars.

Në 10 vitet e fundit çdo formacion i gjetur nëpër fotot e Marsit që tregonin qartë shenja të një ndërtimi inteligjent janë mohuar nga NASA me pretendimin standart që bëhet fjalë thjesht për një formacion natyral. Edhe kur pamjet bërtisnin shumë, përsëri qëndrimi zyrtar i NASA-s ka qenë i tillë. Çdo përpjekje e shkenctarëve dhe e studiuesve, argumentimet e tyre shkencore dhe jashtezakonisht logjike kanë ndeshur në mohimin dhe heshtjen e plotë të NASA-s. Kjo gjendje mbase do vazhdonte për shumë kohë sikur në Maj të këtij viti, pra 2006, nga disa foto të lëshuara zyrtarisht nga NASA u zbulua diçka që nuk mund të mohoj më dhe të kalohej me pretendimin e zakonshëm të një formacioni natyral.



Kafka e Marsit

Pergjigja per pranine e kesaj kafke ne token e planetit Mars ka qene heshtje e plote. Fotot jane analizuar nga shkenctare te ndryshem dhe probabiliteti qe kjo kafke te jete nje formacion natyror guri eshte 1 ne 10 miliarde. Dhe cuditerisht me Marsin probabilitete te tilla ndodhin paska si shpesh. Richard Hoagland dhe studiues te tjere kane kohe qe kane lajmeruar rrethet e brendeshme te konspiracise dhe ufologjise mbi nje mundesi te shpejte te daljes se NASA-s publikisht mbi Marsin dhe deklarata të saj që do ndryshojnë konceptin e imponuar deri më sot mbi masat e njerëzve. Dhe siç pritej më në fund ashtu ndodhi. NASA pranoi zyrtarisht ditën e mërkurë, 6 dhjetor 2006, në një konferencë për shtyp që Mars Rover ka gjetur dhe filmuar rrjedhje të dukshme uji të lëngët. Po si mund të ketë rrjedhje të ujit kur Marsi s'ka atmosferë dhe gravitet siç na kanë mbushur në kokën gjithë këto vite? Ndoshta mbas pak kohe do lexojmë që NASA konfirmon praninë e jetës në Mars pasi siç dihet ku ka

ujë ka dhe jetë. Le të shpresojmë që ata që mbajnë të ngërthyer shkencën e sotme më në fund të thyejnë heshtjen 40 vjeçare dhe të ndajnë me publikun e gjerë njohuritë që kanë për Tokën tonë, planetet dhe vetë sistemin tonë diellor.

18. Strukturë me fytyrë njeriu në Mars

Në vitin 1976, Sonda Viking që po orbitonte planetin Mars të quajtur shpesh si Planeti i Kuq, dërgoi disa foto në tokë që i kanë lënë të gjithë shkenctarët me gojë të hapur dhe krijoi një enigmë që edhe sot e kësaj dite nuk është zgjidhur ende. Fotot e Vikingut ishin bërë në një moment që dielli ishte shumë poshtë në qiellin e Marsit dhe tregojnë një strukturë, që e parë nga larg paraqet fytyrën e një njeriu. Kjo strukturë ndodhet në rajonin e Cydonias dhe nuk është e vetmja.

Fillimisht fotoja që erdhi u përgënjeshtrua si jo e saktë dhe ndoshta rezultat i ndonjë kushti atomsferik të caktuar. Më pas kur foto të tjera pasuan të parën pamje, ishte e qartë dhe në atë moment filluan analizat e detajuara të përmasave dhe pamjes që fotoja paraqiste. E një lartësie prej më shumë se 1500 këmbë nga siperfaqja dhe e një shtrirje prej disa 2.5 km struktura rezultoi të ishte e pamundur rezultat i erozionit apo ndonjë teke gjeologjike. Matja e distancave midis harkimeve, tipareve të vetë fytyrës, buzëve, sytë, hundës ishte shume simetrike dhe probabiliteti që ajo të jetë me origjinë natyrale është 1 në 1 miliard. Pra, e pamundur. Foto të tjera të bëra në pozicione të ndryshme konfirmuan të parën. Ndonëse pamja nuk është aq e qartë sa në foton e parë ato përsëri tregonin fytyrën njerëzore në truallin shkëmbor të Marsit. Por surpriza nuk mbaronte aty. Ndërsa Sonda orbitonte planetin, pamje të tjera filluan të shfaqeshin dhe struktura të tjera akoma dhe më bindëse dukeshin në foto. Përqark të ashtuquajturës tashmë Fytyrë e Marsit u dalluan edhe disa ndërtime në formë piramidale me një distancë dhe një madhësi që ekspertet sa i panë u kujtuan për distancen, formën dhe pozicionimin astronomik të tre piramidave në Egjypt. Është kjo thjesht një rastësi?!

Analiza të shumta, llogaritje matematikore, astronomike dhe gjeologjike nuk kanë lënë më asnjë dyshim. Fytyra e Marsit si dhe piramidat rreth e rrotull nuk janë me origjinë natyrale. Mosha e tyre është e pamundur të përcaktohet, deri në momentin që të merret një analizë fizike dhe strukturale. Të papriturat e Planetit të Kuq nuk mbarojnë. Sa më shumë eksplorohet në distancë aq më shumë fakte dhe pamje të reja turbullojnë mendjen e shkenctarëve. Nëse në Mars nuk ka jetë, kjo s'do të thotë që në një të kaluar jo të larget aty nuk ka patur jetë dhe strukturat e gjetura janë një dëshmi e gjallë e kësaj. Po pse fytyra e gjetur në mars dhe piradimat janë kaq tokësore në pamje? Çfarë lidhje ka midis tyre dhe piramidave në Egjypt apo fytyrës së njerezve të tokës? Kjo është enigma

më e madhe për astronomët sot për sot dhe deri në përfundim të misionit të anijes kozmike që aktualisht ndodhet në orbitën e Marsit, përgjigjet janë thjesht përllogaritje shkencore dhe asgjë më shumë. Edhe sonda e dytë *Mars Global Surveyor spacecraft* e dërguar në prill të vitit 1998, solli të njëjta pamje të planetit, të rajonit të Cydonias me disa ndryshime të vogla të lidhura me kushtet e dritës dhe të pozicionit që janë bërë fotot.

Fotografitë e mëposhtëme nuk janë nje trillim fantastiko-shkencor dhe as pjelle e imagjinates se disa njerezve, por te dhena te marra nga faqet zyrtare te NASA-s qe eshte National Aeronautics and Space Administration, Agjencia Amerikane e Fluturimeve ne Kozmos dhe me e madhja dhe më prestigjozia në botë:



Pamja të sondës Viking



Pamje të sondës Mars Global Surveyor
– Një pamje nga larg e strukturave në Cydonia (Mars),
përfshirë edhe piramidat

NASA: Në Mars ka pasur jetë

Ekipi i ekspertëve të qendrës kozmike Johnson në Houston ka analizuar sërish meteorin qe ka rene ne Antarktik para 13.000 vjetesh.

Duke shfrytezuar mikroskopin elektronik me rezolucion te larte eshte gjetur deshmi e pakontestueshme se ne planetin Mars ka ekzistuar jeta ne forme te bakterieve.Hulumtuesit pohojn se kristalet mikroskopikene shkembin e shkeputur nga Marsi para me shume se 16 milion vjeteve jane

gjetur bakterie te fosilizuara, te cilat u perngjajne shume bakterieve qe mund te gjenden ne planetin tone, rikujton gazeta londineze "Telegraph".

"Deshmite qe tregojne se ne Mars ka patur jete dalengadalë po grumbullohen", ka thene David McKee, shkencëtar kryesor i NASA-s sa u perket hulumtimeve astrobiologjike."Në mesin e dëshmive janë edhe gjurmët për ekzistencën e dikurshme të ujeravë sipërfaqësore, siç janë mbeturinat e lumenjve, liqeneve e mbase edhe oqeaneve, por edhe shenjat që tregojnë për ekzistencën e ujërave rrjedhëse në afërsi të sipërfaqës apo edhe në vetë siperfaqën e Marsit" ka shtuar ai.

19. A e sundon botën kaosi?

Është e vërtetë!!!

Kaos është ajo dukuri që brenda një çasti çrregullon botën e vogël, që ndoshta nuk na bjen në sy, por që pasoja e të cilës në një hapësirë të madhe kohore sjell çrregull në botën e madhe, deri në rastin e vetë Sistemit Tonë Planetar.

Sipas mythologjisë greke kaosi është ajo gjendje fillestare e një çrregulli të pafundtë prej së cilës ka rrjedhur Gjithësia e sotme e rregullt.

Që kaosi bën ligjin edhe sot e kësaj dite na e tregon përvoja e përditëshme duke filluar me rrëmujën tek autobusi, apo treni deri tek vetë dhoma jonë.

Kaosi ka dorë kudo ku shkaktarë të vegjël sjellin pasoja të mëdha. Kur fjollat e borës shkaktojnë orteqe bore, apo kur shtypja e një suste të gabuar e çon trenin në shinën e gabuar.

Edhe në Shkencat e Natyrës sundon kaosi, duke ndikuar në klimën apo në reaksionet kimike.

Sjellja kaotike në rastin e Tokës, bën që moti shpeshherë të mos jetë ashtu si e parashikojnë meteorologët.

Një shembull i njohur mbi sesi vepron kaosi është ai kur rrahja e krahëve të një fluture në Australi sjell si pasojë shkaktimin pas një jave të një stuhie në Europë. Kështu kur flitet mbi kaosin përmendet edhe "efekti flutur".

Nëpërmjet Teorisë Së Kaosit është e mundur që këto proçese të llogariten në mënyrë matematike. Teoria parashikon rolin vendimtar të disa faktorëve tepër të vegjël në mbarëvajtjen e punës.

Për shkak të të ashtuquajturit Kaos Vendimtar nuk mund të bëhet e mundur parashikimi i veprimit së bashku të një numri të madh sistemesh. Por teoricienët e kaosit përpiqen që me anë të modeleve matematikore të kuptojnë problemet që shkakton kaosi.

Edhe ne shoqerine njerzore sundon dukshem kaosi, i cili ne kushte te vecanta eshte pasqyruar me luftera, me ndikime te theksuara ne jeten personale te individit.

Përvoja tregon se në rastin e Tokës kaosi shpërthen si p. sh. në rastin e vërshimeve dhe përmbytjeve nga ujrat.

...Ndërsa Gjithësia është relativisht e siguruar ndaj ndryshimeve që shkaktohen nga proçeset kaotike...

Kështu mund të parashikohet që mijra vjet më parë me një saktësi të madhe se kur do të ndodhë eklipsi i hënës apo diellit.

Vetë rregulli në rrotullimin e Tokës përqark Diellit dhe rrotullimin e Tokës përqark boshtit të vet ka shërbyer si masë për të përcaktuar vitin apo ditën.

20. Hawking: Universi nuk ka nevojë për krijues

Në fillim ishte kaosi, thotë Stephen Hawking. Dhe nuk ka asnjë gjurmë të Zotit. Fjalë të mëdha që, duke qenë se i thotë një prej astrofizikanëve më të mëdhenj që janë ende gjallë, shkaktojnë një bum. Aq më shumë që pikërisht ai, një prej shkencëtarëve më të famshëm në botë, i dënuar me palëvizshmëri dhe mosaftësi të foluri për shkak të një atrofie muskulore progresive, teoricien i fijeve dhe gropave të zeza, në një libër të mëparshëm (Histori e shkurtër e kohës), kishte lënë në fakt pakëz hapur një derë për kreacionistët, duke thënë se prania e Zotit nuk do të ishte e papajtueshme, në vetvete, me një qasje shkencore ndaj universit.

Por këtë herë, jo: The Grand Design, shkruajtur bashkë me fizikanin amerikan Leonard Mlodinow, në 200 faqe të shoqëruara me ilustrime shkon aq larg sa të hedhë edhe hipotezën për universe të tjerë të banuar, për të shtuar më pas konkluzionin që Big Bang është"një pasojë e pashmangshme e ligjeve të fizikës"dhe që ndërhyrja e një dore krijuese duhet të përjashtohet. Më saktë, pyetjes që Hawking e ngre po vetë: "A ka patur nevojë universi për një Krijues?", përgjigjja është e qartë dhe e pakthyeshme: Jo.

Dhe përse jo? "Sepse ekziston një ligj që quhet gravitet dhe universi mundet dhe do të vazhdojë të krijohet vetë, nga asgjëja. Krijimi spontan është arsyeja përse ekziston diçka dhe jo asgjë, përse universi ekziston dhe ne vetë ekzistojmë". Pikë. Për të madhin Stephen Hawking, në pension prej një viti dhe hipur tashmë në katedrën e zënë nga Newton, çështja është e mbyllur. Në Britaninë e Madhe, konkluzionet e tij përfundojnë natyrshëm në faqen e parë - duke filluar nga "Times"- aq më tepër që botimi i librit ndodh pikërisht një javë para vizitës së papës Ratzinger përtej kanalit anglez.

Të menjëhershëm kanë qenë reagimet pozitivë të Richard Dawkins, biologu i deklaruar ateist, i cili përshëndet shtrirjen në univers tëteorive

darviniane mbi qeniet e gjalla. Ndërkohë, në vende të tjerë reagimet kanë qenë në gradë të ndryshme: perpleksitet, skepticizëm, siklet. Filozofi i shkencës, Giulio Giorello, për shembull, pranon se ideja e një krijimi nga hiçi "për shkak të një luhatjeje rastësore shumë të shpejtë dhe shumë energjetike"është një çështje e debatuar nga kozmologët kuantistë, madje "hipotezën e një krijimi pa krijues mund ta gjesh madje edhe mes rreshtave të filozofisë indiane". Megjithatë, thekson ai, është tjetër gjë të "bësh pa Zotin si krijues i jashtëm dhe tjetër gjë është të flasësh si forcë e brendshme e natyrës, në gjurmët e Xhordano Brunos dhe Spinozës". Veç kësaj, sipas mendimit të tij, "nevoja për Zotin nuk bazohet tek kozmologjia. Nga ana tjetër, shkenca është tërësisht e ndarë nga Zoti".

Më i drejtpërdrejtë dhe thuajse injorues ndaj Hawkins është një tjetër filozof, Masimo Kaciari: "Asgjë nuk është më absurde dhe antishkencore se sa të pretendosh që një gjuhë prej specialisti të ofrojë përgjigje universale. Eshtë një kontradiktë logjike, ajo e Hawking, që ka diçka komike në vetvete dhe që as nuk duhet marrë në konsideratë".

Më të artikuluar mendimet e botës shkencore. Tomazo Makakaro, president i Institutit Kombëtar të Astrofizikës në Itali analizon pikat kryesore të teorisë së Hawking (prania e sistemeve të tjerë diellorë të ngjashëm me tonin e universeve të tjerë të mundshëm, ideja që mund të arrihet një ekuilibër mes teorisë kuantistike të botës nënatomike dhe asaj të gravitetit) dhe konkludon: "Asnjë nga këto pika nuk mund të shërbejë si bazë për një diskutim mbi Zotin, sepse gjërat janë krejt të ndara. Më duken pohime aq irracionalë, saqë çdo teolog është në gjendje t'i hedhë poshtë". Biologu evolucionist Telmo Piebvani shton: "Mbi teorinë e fijeve të hedhur nga Hawking nuk ka aspak konsensus. Nëse flasim për evolucionizëm, sigurisht që procesi i jetës nuk duket se vazhdon sipas një projekti. Por prej këtu, deri në demonstrimin që nuk ekziston një entitet mbinatyror, ka shumë rrugë. Dhe, qoftë edhe nëse do të arrinim të njihnim mendimet e Zotit, kjo nuk do të thoshte që Ai nuk ekziston".

"Ashtu sikurse Darvini hodhi poshtë ekzistencën e Zotit me teorinë e tij të evolucionit biologjik të species sonë", komentonte tek "Times"i Londrës, Richard Dawkins, "tashmë Hawking e hedh poshtë këtë teori edhe nga këndvështrimi i fizikës".

21. Sa të vegjël dhe të papërfillshëm që jemi në Univers?!

Këtë më mirë se çfarë do gjë tjetër e tregojnë fotot e mëposhtme. Ato janë bërë duke treguar Tokën në raport me planetet e tjerë të sistemit tonë diellor. Më pas vetë Diellin tonë në raport me yje të tjerë dhe më pas keto yje (jashtëzakonisht te mëdhej) ne raport me yje të tjerë edhe më superiore në madhësi. Është e vështirë të imagjinohet masa e frikshme e këtyre yjeve dhe planeteve. Dhe kjo është vetëm ajo që dimë për momentin.





Pra, kjo foto me dy pjese, paraqet Planetin Toke ne raport me planetet e tjere te sistemit tone diellor. Ndersa pjesa e dyte e fotos tregon madhesine e ketyre planeteve ne raport me vete yllin tone – Diellin.

Tema ska shume nevoje per fjale pasi fotot më poshtë tregojne me se miri per te gjithe te apasionuarit e astronomise, ketu "flet"vetë teleskopi shume i fuqishem - Hubble.





22. Zbulohet Ylli gjigant

Shkencëtarët në universitetin e Sheffiled zbuluan gjigandin stelar R136a1, gjatë vëzhgimit që i bënë këtij të fundit me Teleskopin e Observatorit të Europes Jugore në Kili.

Më parë yjet më të rëndë të njohur ishin rreth 150 here masen e diellit dhe kjo mendohej qe ishte shume afer limitit te madhessise se kozmosit.

Nderkohe qe madhesia e yjeve rritet, sasia e energjise se krijuar ne koret e tyre rritet me shpejt se forca e gravitetit qe i mban ato te bashkuar.

Energjia i ben me te shndritshem. Nen nje shndritshmeri te caktuar, energjia eshte aq e madhe sa qe fillon ta ndaje yllin.

Ky fenomen eshte i njohur si 'Eddington Limit', sipas fizikantit Britanik Arthur Eddington, i cili ne vitin 1919 duke provuar teorine e relativitetit te Einstein-it tregoi qe drita perthyhet nga relativiteti. Besohej qe Eddington Limit arrihej tek rreth 150 masa solare. Por R136a1 eshte matur si 265 masa solare. Meqenëse yjet e rënda humbin masë me shpejtësi ndërkohe që plaken duke e kthyer atë ne energji, R136a1 e ka humbur tashme 20% te mases se tij. Mendohet qe fillimisht ai ka patur nje mase rreth 320 masa solare. Ne krahasim me te, Dielli eshte djegur per rreth 4, 57 bilion vjet dhe ka konvertuar vetem 0. 03% te mases se tij ne energji.

Drejtuesi i kerkimit, Paul Crowther, tha per Astronomy Now: Per shkak te eddington Limit, ato humbasin mase shume shpejt. Kjo do te thote qe ato jane jashtezakonisht te shndritshem dhe te nxehte; R136a1besohet se ka nje temperature te siperfaqes me te madhe se 40, 000 grade Celcius, dhe eshte 10 milion here me i shndritshem se Dielli.

Ndër yjet më të mëdha të njohur nga më parë, ishin Pistol Star, ndërmjet 80 dhe 150 masave solare, dhe Eta Carinae, rreth 100 masa solare. Pistol Star lëshon në 20 sekonda më shumë energji nga sa lëshon Dielli në 1 vit. Megjithatë, të dy këto yje duken shumë të vegjël në krahasim me zbulimin e ri.

Sipas Astronomy Now, R136a1 jep më shumë energji se të gjitha yjet në Orion Nebula dhe se po të ishte në sistemin tonë diellor, do të ishte po

aq i shndritshëm ndaj Diellit, sa është Dielli ndaj Hënës. Ndodhen 4 yje ne RCM 136a, ku ndodhet R136a1, me masën më të madhe se 150 herë masën e Diellit.

Ato 4 yje të vetëm nxjerrin gjysmën e energjisë të të gjithë atij sistemi që përmban gjithsej 100, 000 yje.

Yjet si R136a1 besohet se janë formuar nga disa yje të rinj që shkrihen bashkë. Profesor Crowther dyshon që kjo është madhësia më e madhe që mund të arrijë një yll.

Ai tha: *"Duke parë sa të rrallë janë këto, mendoj se do të ishte gati e pamundur që ky rekord i ri do të mund të thyhet tani shpejt. "*

23. Së shpejti shpërthimi i yllit që do të ndriçojë Tokën dy javë rresht

Toka së shpejti do të mund të fitojë diellin e dytë, por për të paktën një ose dy javë. Njëri nga yjet më të shndritshme të qiellit tonë do të shndërrohet në supernova, ndërsa shpërthimi mund të ndodhë këtë vit, shkruan gazeta londineze "Daily mail". Astro-fizikanët thonë se gjiganti i kuq Betelgez në plejadën Orion, ylli i nëntë për nga madhësia në qiellin tonë, që ndodhet 640 vit dite larg nesh, po e humb masën, e cila është shenjë e kolapsit të gravitacionit.

Bred Karter, fizikan pranë Universitetit të Kuinslendit Jugor, ka shpjeguar se ylli është duke shpenzuar karburantet e domosdoshme të bërthamës. "Ky karburant e bën Betelgezin të ndritshëm dhe e mban atë. Kur të mbetet pa karburant, ylli do të shkatërrohet dhe kjo do të ndodhë shumë shpejt", ka thënë Karter. Shpërthimi, i cili do të pasojë, do të jetë dhjetëra miliona herë më i ndritshëm se sa Dielli, që do të thotë se do të ketë 24 orë dritë në Tokë dhe për dy javë do të duket sikur kemi dy diej.

"Do të shpërthej dhe do të ndriçojë gjithçka. Do të shohim një dritë të pabesueshme për një periudhë të shkurtër, dy javë, dhe pas disa muajve drita do të fillojë të zbehet dhe në fund do të jetë vështirë që të shihet ndonjë gjë", shpjegon Karter. Shpërthimi mund të ndodhë, vetëm është çështje kohe. Kjo mund të ndodhë para përfundimit të vitit të ardhshëm.

Interneti "po vlon"nga parashikimet e fundit të botës, të cilat ndërlidhen me supernovën dhe parashikimet e majave. Ekspertët, megjithatë, pohojnë se shpërthimi i yllit do të ndodhë shumë larg Tokës dhe nuk do të mund të shkaktojë dëme. "Kur të shpërthej, së pari do të shohim një shi të pjesëzave të quajtura neutrin. Ato do të bien në Tokë dhe supernova të cilën e shohim, do të ndriçojë natën në qiell. 99 për qind e energjisë nga shpërthimi i yllit do të lëshohet përmes këtyre pjesëzave, të cilat do të bien në Tokë, por nuk do të ketë pasoja të dëmshme", ka thënë Karter.

24. Asteroidet

Sa herë që ndonjë asteroid e godit ndonjë planet, ai vetëm e forcon atë.



Për shumë njerëz asteroidet janë vetëm shkëmbinj të mëdhenj, dhe janë vende të mrekullueshme për të zhvilluar beteja me armë lazerike. Dituria e shkencës bashkëkohore thotë që ato janë pjesë të mbetura nga formimi i planetëve. Ndërsa, tregimi i plotë për asteroidet është shumë më kompleks dhe ende vetëm pak i shpalosur. Studiuesit e planetëve i bashkon vetëm mendimi se asteroidet janë shumë të llojllojshme – nga një copë dheu, deri te grumbulli notues i zhavorrit e i mini-planetëve me shenja të aktiviteteve të shuara vullkanike e madje edhe me ujë - që të kenë të njëjtën prejardhje.

Asteroidet e mëdha, me gjerësi më të madhe se 100 kilometra, datojnë që nga lindja e sistemit tonë diellor, rreth 4, 6 miliardë vite më parë. Atëherë, gjithësia ishte si një tufë asteroidesh. Se si kishte ardhur në atë gjendje është ende enigmë, por ideja më e qëlluar është ajo se vorbulla e pluhurit të lashtë që rrotullohej përreth diellit ende të paformuar koaguloi në trupa që zmadhoheshin vazhdimisht. Disa nga këta trupa u bënë planetë; disa të tjerë, të përshpejtuar nga graviteti i trupave më të mëdhenj u hodhën në hapësirë të pafund; disa u përplasën në diell; kurse vetëm pak prej tyre mbetën ashtu siç kishin qenë më parë. Këta të mbijetuar ende janë duke qëndruar në boshllëqet e lëna në mes planetëve, saktësisht në hapësirën në mes të orbitës së Marsit dhe Jupiterit. Gradualisht edhe këta po thithen nga planetët. Më pak se një në një mijë, apo ndoshta edhe më pak se një në një milion i asteroideve të këtij lloji mbesin brenda unazës së tyre.

Asteroidet e vogla nuk janë mbeturina, por gërmadha. Ato kanë madhësi e dimensione të ndryshme që na e bëjnë me dije se janë produkt i një reaksioni zinxhirorë: Asteroidet ndeshen me njëra tjetrën dhe

copëtohen, edhe fragmentet e tyre ndeshen me njëra tjetrën dhe copëtohen, e kështu me radhë. Disa janë gurore; disa janë metalore – mund të themi se vijnë nga shtresa të ndryshme të të njëjtit trup. Përafërsisht një e treta e asteroideve i takojnë grupit me orbitë të ngjashme, që nëse shikojmë prapa në kohë, kthehemi në atë pikë në hapësirë, gjegjësisht në vendin e ndeshjes ku kanë lindur. Pasi që familjet e asteroideve shpërndahen pas 10 deri 100 milion vitesh, formimi i tyre duket të jetë proces që ende vazhdon.

Pra, kështu ka ndodhur formimi i planetëve. Sa herë që ndonjë asteroid e godit ndonjë planet, ai vetëm e forcon atë. Asteroidet nuk janë as mbeturina nga formimi i planetëve, dhe as nuk janë shkatërrues për ta.

25. Zbulohet galaktika më e vjetër

Astronomët thonë se besojnë të kenë gjetur galaktikën më të vjetër në gjithësi.



Astronomët thonë se besojnë të kenë gjetur galaktikën më të vjetër në gjithësi, që daton para 13. 1 miliardë vjetësh.

Astronomët evropianë, në bazë të fotove që i ka bërë teleskopi Habl, kanë përcaktuar vjetërsinë e kësaj galaktike që është e kohës kur gjithësia ishte shumë e re, përkatësisht kishte "vetëm 600 milion vite".

Autori kryesor i studimit që është botuar në revistën Nature të Parisit, ka deklaruar se ajo galaktikë aq shumë është vjetruar saqë, sipas të gjitha gjasave, më nuk ekziston në formën e dikurshme.

26. Galaktika jonë – Rruga e Qumështit

Kjo është një hartë e galaksisë sonë Rruga e Qumështit e parë nga sipër. Dielli jonë është njeri prej 200 miliard yjeve në këtë galaksi tipike spirale e cila ka një diametër prej 90 mijë vjet drite.



Kjo hartë tregon shtrirjen e plotë të galaksisë sonë Rruga e Qumështit - një galaksi kjo spirale me të paktën 200 miliard yje. Dielli jonë është i vendosur thellë në brendësi të Krahut të Orionit, rreth 26 mijë vjet dritë larg nga qendra. Drejt qendrës së Galaksisë, yjet janë të mbledhur grup, shumë më afër seç janë këtu ku jemi ne. Vini re, praninë e yjësive të vogla të cilat shtrihen mjaft jashtë planit të Galaksisë dhe dalloni po ashtu praninë e galaksive xhuxhë në afërsi - Xhuxhin Shigjetari i cili është duke u gëlltitur më ngadalë nga galaksia jonë.



Harta e mësipërme është një qoshe e galaksisë sonë Rruga e Qumështit. Dielli është i vendosur në krahun e Orionit - një krah fare i vogël i krahasuar me Krahun e Shigjetarit i cili gjendet më afër qendrës së galaktikës. Harta tregon disa yje të cilët janë të dukshëm me sy dhe që ndodhen në thellësi të krahut të Orionit. Grupi më i dallueshëm i yjeve janë yjet kryesore në konstelacionin e Orionit nga ku krahu spiral merr dhe emrin e tij. Të gjitha këto yje janë gjigande të shndritshëm dhe yje supergjigande, me mijëra herë më të shndritshëm se Dielli. Ylli më i ndritshëm në hartë është Rho Cassiopeia (p Cas) - 4000 vjet drite larg nesh. Me sy duket si zbehte por në fakt është një supergjigand 100 mijë herë më i ndritshëm se dielli jonë.

27. Universi – Pasqyrë e ndjenjave tona

Ne jemi pjesë e pandashme e universit. Ne jemi pjesëmarrës në këtë lojë të madhe që ne e quajmë jetë. Ne jemi ata që luajmë, dhe vetë loja, ne jemi rezultati i lojës dhe shikuesit. Ne jemi të lidhur me gjithçka që ekziston dhe jemi në komunikim të vazhdueshëm me të gjitha pjesët tjera. Nëse ne e shikojmë natyrën atëherë ne e shikojmë një pasqyrim të vetës sonë. Çdo marrëdhënie, çdo ndodhi, çdo arritje në jetën tonë është pasqyrim i asaj se çfarë ne mendojmë dhe besojmë.

Ka shumë kohë që në mendjen time më sillen disa pyetje lidhur me jetën dhe ekzistencën. Vetë fakti që ne jemi prezentë në këtë realitet mëzgjon kureshtjen të di më shumë për prejardhjen e gjithë kësaj qe ne e shohim dhe e përjetojmë tani, për pikënisjen e kësaj që ne e quajmë jetë. E di që ndoshta kjo mund të tingëllonte ndonjëherë edhe si çmenduri, por ja që tani është bërë pjesë e pandashme e mendimeve të mia dhe si duket më përmbush në brendi.

Ka shumë thënie të ndryshme mbi jetën dhe realitetin duke u nisur nga shkrimet e vjetra religjioze e deri tek argumentet e reja shkencore. Thuhet se ne jemi krijesa hyjnore, ne jemi shëmbëlltyra e krijuesit, ne jemi fusha energjike që veprojnë në një fushë më të madhe energjike, ne jemi grimca, ne jemi valë, ne jemi, ne jemi, ne jemi... E cila nga këto pohime mund të jetë më afër realitetit?

Ne të gjithë kemi mësuar në orët e fizikës se universi përbëhet nga grimcat dhe valët. Ne kemi mësuar po ashtu se në universin tonë veprojnë ligjet fizike si: ligji i Njutonit, ligji i gravitetit, ligjet elektromagnetike dhe që këto ligje janë të pathyeshme. Ato veprojnë për të gjithë njësoj. Por çka nëse në fakt vërtetohet e kundërta, çka nëse ekziston diçka që i tejkalon ligjet fizike?

Në njëqind vitet e fundit zbuluan fizikanët që pjesët përbërëse prej të cilave përbëhet trupi ynë dhe i gjithë universi nuk iu përmbahen gjithmonë ligjeve fizike të cilat për ne për 300 vite rresht vlenin si të shenjta. Në fushën ndërbërthamore të ekzistencës duket të jetë gjithçka e lidhur në mes veti dhe kjo na bënë të dimë se ekziston diçka që nuk është e kufizuar nga ligjet fizike, diçka për të cilën koha dhe hapësira nuk kanë vlefshmëri.

Atomet janë pjesa më e vogël prej të cilave përbëhet materia. Atomet përbëhen nga protonet dhe neutronet të cilat gjenden në bërthamën atomike, si dhe nga elektronet të cilat gjenden në mbështjellësin atomik. Elektronet mund ta ndryshojnë gjendjen e tyre energjike dhe të kalojnë nga një shtresë në shtresën tjetër, d. m. th nga një nivel më i ulët energjik në një më të lartë dhe anasjelltas. E çuditshme është se kur një elektron e ndërron gjendjen e vetë energjike, d. m. th kur ai kalon nga një shtresë në shtresën tjetër, ai kalon pa e tejkaluar hapësirën në mes. E si është e mundur kjo që

një elektron nga një shtresë tjetër të ndodhet menjëherë në tjetrën shtresë pa e kaluar hapësirën në mes? Ne i kemi përkufizuar elektronet si grimca materiale e si mundet materia të bëjë një kërcim të tillë? Kjo dukuri njihet në gjuhën e fizikes kuantike si kërcim kuantik. A mundet që një elektron të jetë përnjëherë edhe grimcë edhe valë? E nëse vihet në përfundim që një elektron mund të jetë edhe grimcë edhe valë atëherë çfarë domethënie do të ketë kjo për jetën tonë? Menjëherë do të lind pyetja se a jemi edhe ne grimca dhe valë? A është i gjithë universi përnjëherë edhe grimcë edhe valë? E çuditshme apo jo?

Për të vërtetuar këtë dukuri të elektroneve shkencëtarët bënë shumë eksperimente. Një nga eksperimentet më të njohura është ky qëshihni tani më sipër. Nga një burim drite u hodhën fotonet (fotonet janë pjesë përbërëse të dritës) në drejtim të një tabele para se cilës ndodhej një pengës e cila kishte një vrimë të vogël. Valët e dritës kaluan përmes kësaj vrime dhe u paraqiten në tabelë prapë në mënyrë valore. E njëjta gjë u provua me një pengesë e cila kishte dy vrima të vogla. Valët e dritës u ndanë në afërsi të këtyre dy vrimave, kaluan pengesën dhe u bashkuan përsëri, dhe arritën cakun prapë në mënyrë valore ku në tabelë shihej një mostër interference.

I njëjti eksperiment u provua me elektronet. Elektronet d. m. th janë grimca. Kur u hodhën elektronet përgjatë pengesës me një vrimë, ato filluan rrugën si grimca dhe përfunduan në cak si grimca. Por krejtësisht e kundërta ndodhi kur ato u hodhën përmes pengesës që kishte dy vrima. Elektronet filluan rrugën si grimca, gjatë rrugës së tyre morën gjendje valore, u ndanë para pengesës, kaluan përmes të dy vrimave dhe u bashkuan si valë e përfunduan në cak si valë, ku dhe dhanë të njëjtën mostër interference sikurse edhe valët e dritës. E si është e mundur pra që një elektron të jetë i vetëdijshëm se janë dy vrima apo vetëm një? A është e mundur që vet fakti që shkencëtarët e dinin se janë dy vrima e ka bërë elektronin të niset si grimcë e të përfundojë si valë? Nëse është kjo përgjigja, atëherë si mund ta dinte elektroni se çka mendonin shkencëtarët? Apo ndoshta ekziston një fushë energjike që lidhë gjithçka mes veti dhe kjo fushë ia mundësoi elektronit ta dinte se sa vrima ndodhen?

Max Planck që njihet si babai i fizikes kuantike e formuloi këtë më së miri: "E gjithë materia është krijuar dhe përbëhet nga një forcë inteligjente nga e cila është pikënisja e gjithë kësaj ekzistence"Kjo forcë është shumë reale. Kjo është prezentë dhe lidhë gjithçka në mes veti. Kjo nuk është e ndarë prej nesh, por ekziston në ne dhe përreth nesh.

Dikur supozohej se pjesa më e madhe e universit është e zbrazët, por tani në kohët e fundit shkencëtarët kanë vërtetuar se kjo zbrazëti është e mbushur nga një fushë energjike e cila është prezentë çdo kund. Kjo fushë gjendet në të gjithë universin, në planetin tonë, në trupin tonë. Kjo fushë është ura që e lidhë botën e jashtme me botën e brendshme. Kjo është pasqyra që i reflekton mendimet, besimin dhe bindjet tona.

Çka është më e rëndësishme për jetën tonë është se kjo fushë është inteligjente dhe reagon sipas ndjenjave tona. Ndjenjat, lutjet dhe bindjet tona janë gjuha të cilën e kupton kjo fushë. Në këtë fushë ekzistojnë mundësi të pakufizuara dhe varet nga vet ne se cilën ne e zgjedhim, e zgjedhja jonë bëhet realiteti jonë.

Ju me siguri se keni vështruar ndonjëherë një fëmijë kur luan në kompjuter. Ai sa herë që luan zgjedh rrugë të ndryshme në lojë dhe arrin rezultate të ndryshme. E tëra varet se çka ai zgjedh për momentin. Të gjitha rrugët janë të mundshme dhe të gjitha mundësit janë të ruajtura në kode të ndryshme programuese ne CD. Nëse pastaj ne dëshirojmë taluajmë një lojë atëherë ne zgjedhim rrugë tjera dhe arrijmë rezultate tjera, e në fund të lojës kompjuteri na pyet se a dëshirojmë të luajmë prapë apo jo? Për kompjuterin nuk ka rëndësi se cilin rezultat ne e arrijmë, të gjitha rezultatet janë në CD, për të nuk ka rëndësi se nëse ne dëshirojmë të luajmë edhe një lojë apo jo. Të gjitha këto mundësi janë të ruajtura në vetëm një CD që ka një kapacitet vetëm prej 700 MB. Por ndaluni e mendoni se çfarë kapaciteti ka i gjithë universi? Sa mundësi mund të ekzistojnë në univers?

Në univers ekziston tanimë mundësia që ti të jesh milionerë, në univers ekzistojnë mundësia që ti të kesh një jetë të lumtur bashkëshortore, të kesh shëndet dhe qetësi shpirtërore e një jetë të gjatë. Të gjitha këto janë të ruajtura në univers për ty dhe varet vetëm nga ti se për cilën nga këto mundësi përqendrohesh. Se a do të zgjedhësh humbjen apo fitoren, se a do të zgjedhësh sëmundjen apo shëndetin, për universin nuk ka rëndësi. Në kompjuter bëjmë zgjedhjen përmes tastaturës dhe mjeteve tjera përkatëse, ndërsa në univers bëjmë zgjedhjen përmes ndjenjave, besimit dhe bindjeve tona. Ndjenjat tona janë kodet programuese që i njeh universi ynë. Ato janë shifrat që e programojnë jetën tonë, ndërsa realiteti jonë është pamja që ne shohim në ekran pasi kemi bërë zgjedhjen e duhur. Universin mund ta paramendojmë si një kompjuter të madh, procesori i të cilit ka një shpejtësi të pakufishme. Ndjenjat tona janë kodet programuese që njeh ky kompjuter, ndërsa mendimet tona janë programet të cilat na ndihmojnë t'i zgjedhim kodet për programim.

Ne jemi pjesë e pandashme e universit. Ne jemi pjesëmarrës në këtë lojë të madhe që ne e quajmë jetë. Ne jemi ata që luajmë, dhe vetë loja, ne jemi rezultati i lojës dhe shikuesit. Ne jemi të lidhur me gjithçka që ekziston dhe jemi në komunikim të vazhdueshëm me të gjitha pjesët tjera. Nëse ne e shikojmë natyrën atëherë ne e shikojmë një pasqyrim të vetës sonë. Çdo marrëdhënie, çdo ndodhi, çdo arritje në jetën tonë është pasqyrim i asaj se çfarë ne mendojmë dhe besojmë. Sikur që pasqyra i pasqyron objektet që ndodhen para saj, kështu është edhe kjo që shohim ne një pasqyrim i asaj që ne kemi në brendi. E ne shohim vetëm figurën në pasqyrë, por atë që është para pasqyrës nuk e shohim. Ajo para pasqyrës është brendia jonë, janë mendimet dhe ndjenjat tona.

Pasqyra asnjëherë nuk na gënjen. Ajo çdoherë na pasqyron ashtu si jemi. Nëse kemi flokët e krehura dhe të rregulluara mirë, nëse jemi në disponim të mire dhe buzëqeshemi, atëherë pasqyra padyshim se do të pasqyrojë një fytyrë të qeshur e të hareshme. Por nëse ne ndihemi keq, jemi të zbehur, kemi urrejtje ndaj dikujt, pasqyra padyshim se do të pasqyrojë një fytyrë të zbehur e të vrazhdë. Kështu është edhe me jetën tonë. Atë çfarë ne e ndiejmë brenda nesh, ajo pasqyrohet në jetën tonë. Nëse ndjehemi mirë, nëse ndiejmë dashuri e respekt për të tjerët, nëse jemi të mëshirshëm dhe falënderues, atëherë padyshim se pasqyra universale dotë pasqyrojë në jetën tonë çaste dashurie, gëzimi e hareje. Në jetën tonë do të pasqyrohet respekti e mëshira dhe falënderimi.

Atëherë nëse në jetën tënde ke vështirësi apo nëse ke probleme shëndetësore kujtoje se këto janë pasqyrim i brendisë sate. Asnjeri nuk është shkaktar i asaj se çfarë ti përjeton. Çdo marrëdhënie me të tjerët, çoftë me prindërit, me kolegët e punës apo me partnerin tënd, janë pasqyrim i asaj se çka ti mendon për këta njerëz dhe mendimet e tua reflektohen në realitetin tënd. Po deshe të ndryshosh diçka, mos kërko zgjidhje nga jashtë, mos kërko të ndryshosh të tjerët, por mundohu ta ndryshosh mendimin tënd që ke për të tjerët, mundohu ta ndryshosh atë se çfarë pasqyrohet në pasqyrën tënde. Nëse unë shikohem në mëngjes ne pasqyrë dhe dukem i zbehur, unë nuk kam nevojë të mundohem ta ndryshojë dikë tjetër për tu dukur unë më mirë, por duhet të ndryshojë ndjenjat e mia, t'i buzëqeshëm jetës dhe përjetimeve që i kam krijuar vet me dorën time atëherë edhe pasqyra do t'i reflektojë menjëherë ndjenjat dhe mendimet e mia.

Ulu e shikoj rrethanat në jetën tënde. Ato të tregojnë shumë mirë se çka ti ndien, çka mendon dhe çka beson. Ato ta tregojnë brendinë tënde e cila pasqyrohet në realitetin tënd.

II – PLLAKAT E SMERALDTA TË THOTIT TË ATLANTIDËS

1. Universi mendor

"Universi është mendor, i përfshirë në mendjen e Gjithësisë"
Kybalioni[17]

GJITHËSIA është SHPIRT! Por çfarë është Shpirti? Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet përgjigje, pasi përkufizimi do të ishte vetë GJITHËSIA, çka nuk mund të shpjegohet e as të përkufizohet. Shpirt është thjesht emri të cilin njerëzit i japin konceptit më të lartë të Mendjes së Gjallë të Pafundme; shpirt do të thotë "Thelb i Vërtetë"; do të thotë Mendje e Gjallë më e lartë se Mendja e Jeta që njohim, ashtu siç qëndrojnë këto të fundit më lart se Energjia mekanike dhe Materia. Shpirti e tejkalon botëkuptimin tonë dhe ne e përdorim këtë fjalë thjeshtë që të kemi mundësi të mendojmë apo flasim për GJITHËSINË.

Jemi të justifikuar kur mendojmë për Shpirtin si të ishte një Mendje e Gjallë e Pafundme për arsye studimi e arsyetimi, për sa kohë pranojmë njëkohësisht se nuk mund ta kuptojmë atë plotësisht. Duhet patjetër t'i përmbahemi këtij pohimi, ose përfundimisht të mos mendojmë më mbi këtë çështje.

Le ta trajtojmë tani natyrën e Universit në GJITHËSINË e tij dhe në pjesët përbërëse. Çfarë është Universi? Kemi parë se nuk mund të ketë asgjë jashtë GJITHËSISË. Atëherë a është Universi GJITHËSIA? Jo, ai nuk mund të jetë, pasi Universi duket se përbëhet nga shumë gjëra dhe është në ndryshim të vazhdueshëm, e përfundimisht nuk përputhet as me idetë e formuluara në kapitullin paraardhës mbi GJITHËSINË, të cilat jemi të shtrënguar ti pranojmë.

Nëse Universi nuk është GJITHËSIA, atëherë është "Asgjë"; ky do të ishte përfundimi i menjëhershëm i mendjes pa arsyetuar gjatë. Por as kjo përgjigje nuk mund të jetë e kënaqshme për pyetjen tonë, pasi ne jemi të ndjeshëm ndaj ekzistencës së Universit. Atëherë nëse Universi nuk është as GJITHËSIA e as "Asgjë", çfarë mund të jetë? Le ta shqyrtojmë pyetjen.

Si në rastin kur Universi ekziston vërtetë, ashtu edhe në rastin kur duket sikur ekziston, ai duhet të burojë në ndonjë farë mënyre nga GJITHËSIA, pra duhet të jetë një krijim i GJITHËSISË. Por meqenëse diçka nuk mund të vijë kurrë nga hiçi, nga çfarë mund ta ketë krijuar GJITHËSIA atë? Disa filozofë i janë përgjigjur kësaj pyetjeje duke thënë se GJITHËSIA e

[17] KYBALIONI -, me këtë emër Masonët/Iluminati quajnë Thotin e Atlantidës, Enokun e Shumerisë, Hermesin e Pellazgjisë – i cili është i njëjti personalitet historik, por i lindur dhe i rilindur Tre herë, në Tri Epoka të ndryshme historike të Njerëzimit.

krijoi Universin nga VETEVETJA; domethënë nga qenia dhe nga substanca e vetë GJITHËSISË.

Por kjo nuk mund të jetë e vërtetë pasi siç e pamë, GJITHËSIA nuk mund të ndahet dhe as të hiqet diçka prej saj; e nëse do të qe vërtetë kështu, a nuk do të ishte vallë çdo grimcë në Univers e vetëdijshme për faktin se është GJITHËSIA? GJITHËSIA nuk mund të humbë vetëdijen e as të KTHEHET në atom, forcë të verbër apo gjallesë të rëndomtë.

Njerëz të ndryshëm pasi rrokën idenë se GJITHËSIA është realisht GJITHÇKA, dhe duke pranuar që ata, njerëzit, ekzistonin, u hodhën në përfundimin se ata dhe GJITHËSIA ishin identikë, e kështu nisën të thërrisnin në kupë të qiellit "UNË JAM ZOTI", duke dëfryer turmat e duke pikëlluar të urtët. Pretendimi i një atomi "Unë jam Njeri!"do të ishte më modest krahasuar me deklaratat e tyre.

Por vërtetë, çfarë është Universi nëse nuk është GJITHËSIA, e as krijim i GJITHËSISË duke fragmentuar vetveten në pjesë? Ç'tjetër mund të jetë; prej ç'të jetë krijuar? Kjo është pyetja e madhe. Le ta shqyrtojmë me kujdes. Vërejmë se këtu na vjen në ndihmë "Parimi i Përkimit"(shikoni Kapitullin II). Aksioma e vjetër Hermetike "Si lart, ashtu edhe poshtë"mund të bëhet e dobishme në këtë pikë. Le të përpiqemi të hedhim një shikim në çështjet e rrafsheve të epërme duke shqyrtuar ato në rrafshin tonë. Parimi i Përkimit është i zbatueshëm si në këtë rast, ashtu edhe në të tjerë.

Të shikojmë pak! Si krijon Njeriu në rrafshin e tij ekzistencial? Së pari, ai mund të krijojë duke ndërtuar diçka prej materialeve që e rrethojnë. Por kjo nuk mund të vlejë në rastin tonë, pasi nuk ka materiale jashtë GJITHËSISË me të cilat mund të krijohet diçka. Së dyti, ai shumon apo riprodhon specien e tij nëpërmjet procesit të çiftimit, që është riprodhim i përftuar nëpërmjet transferimit të një pjese të substancës së tij te filizat e rinj.

Por edhe ky nuk mund të jetë rasti që kërkojmë pasi GJITHËSIA as nuk mund të transferojë apo të heqë një pjesë nga vetvetja, e as mund të riprodhojë apo shumëfishojë veten; në rastin e parë diçka do të zbritej apo hiqej prej saj, e në rastin e dytë GJITHËSIA do të shtohej apo shumëfishohej; që të dy rastet pra përbëjnë absurditet. A ka vallë një mënyrë të tretë nëpërmjet të cilës Njeriu mund të krijojë? Patjetër që ka; njeriu KRIJON MENDËRISHT. E duke vepruar në këtë mënyrë, ai nuk përdor materiale të jashtme dhe as shumëfishohet, e megjithatë Shpirti I tij përmbush Krijimin Mendor.

Duke zbatuar Parimin e Përkimit, mbërrijmë në arsyetimin e justifikuar, se GJITHËSIA e krijon Universin MENDËRISHT, në një mënyrë të ngjashme me procesin nëpërmjet të cilit Njeriu krijon Imazhet Mendore. Është pikërisht këtu që zëri i Arsyes përputhet saktësisht me zërin e të Përndriturve, siç dëshmohet edhe nga mësimet e shkrimet e këtyre të fundit. Të tilla janë mësimet e të Urtëve. Të tilla ishin mësimet e Hermesit.

GJITHËSIA nuk mund të krijojë në mënyrë tjetër përveçse mendërisht, pa përdorur material (sepse nuk ka të tillë për t'u përdorur), e pa u riprodhuar (çka është gjithashtu e pamundur). Nuk ka arrati prej këtij konkluzioni të Arsyes, i cili siç e thamë më lart, është në ujdi me mësimet më të rëndësishme të të Përndriturve. Ashtu siç ju, një nxënës, mund të krijoni në mendjen tuaj një Univers tuajin, ashtu edhe GJITHËSIA krijon Universe në Mendjen e saj.

Por Universi juaj është krijim mendor i një Mendjeje të Fundme, ndërkohë që ai i GJITHËSISË është krijim i një Mendjeje të Pafundme. Të dy janë të ngjashëm në natyrën e tyre, por pafundësisht të ndryshëm në gradë. Do ta trajtojmë më nga afër procesin e krijimit dhe manifestimit teksa përparojmë më tej. Por ajo çka duhet të ngulitni në mendje në këtë pikë është: UNIVERSI DHE GJITHÇKA AI PËRMBAN, ËSHTË NJË KRIJIM MENDOR I GJITHËSISË. Pa asnjë pikë dyshimi GJITHËSIA ËSHTË MENDJE!

***"GJITHËSIA krijon në Mendjen e saj të Pafundme Universe të panumërt, të cilët ekzistojnë në amshim; e megjithatë, për GJITHËSINË, krijimi, zhvillimi, rënia dhe vdekja e një milion universeve zgjat sa një pulitje qepallash. "*– Kybalioni**

***"Mendja e Pafundme e GJITHËSISË është gjiri i Universeve. "*–**

Kybalioni

Parimi i Gjinisë (shikoni Kapitullin II dhe të tjerët që vijojnë) manifestohet në të gjitha rrafshet e jetës, materiale, mendore apo shpirtërore qofshin. Por siç e kemi përmendur edhe më lart, "Gjini"nuk do të thotë "Seks"; seksi është thjesht një manifestim material i gjinisë.

"Gjinia"është "ajo çka ka lidhje me gjenerimin apo krijimin". Kurdo që diçka gjenerohet apo krijohet, në cilindo rrafsh, manifestohet doemos Parimi i Gjinisë. Dhe kjo vlen edhe për krijimin e Universeve.

Mos u hidhni në përfundimin e nxituar se po ju mësojmë që ka një Zot ose Krijues mashkull apo femër. Kjo ide nuk është tjetër veçse një shtrembërim i mësimeve të lashta mbi këtë çështje. Doktrina e vërtetë thotë se GJITHËSIA në vetvete, qëndron mbi Gjininë, ashtu siç qëndron mbi çdo Ligj tjetër, përfshirë ata të Hapësirës e Kohës.

GJITHËSIA është LIGJI nga i cili burojnë Ligjet e nuk u nënshtrohet këtyre të fundit. Por kur GJITHËSIA manifestohet në rrafshin e gjenerimit apo Krijimit, atëherë vepron në përputhje me Ligjin dhe Parimet, për vetë faktin se po zhvendoset në një rrafsh më të ulët të Ekzistencës. Si pasojë, GJITHËSIA manifeston Parimin e Gjinisë në aspektin Mashkullor e Femëror, natyrisht në rrafshin mendor.

Kjo ide mund të tingëllojë befasuese për disa nga ju që e dëgjojnë për herë të parë, por në të vërtetë, të gjithë ju e keni pranuar në mënyrë pasive në botëkuptimin e përditshëm. Ju flisni për Atësinë e Zotit dhe Amësinë e Natyrës, për Zotin, Atin e Shenjtë, e për Natyrën, Mëmën Universale, duke

pranuar instinktivisht Parimin e Gjinisë në Univers? A nuk është kështu vallë? Nga ana tjetër, mësimet Hermetike nuk nënkuptojnë një dyzim të vërtetë. GJITHËSIA është NJË; Dy Aspektet nuk janë veçse aspekte të thjeshta të manifestimit. Sipas mësimeve, Parimi Mashkullor I shfaqur nga GJITHËSIA qëndron në një farë mënyre i ndarë nga krijimi mendor ekzistues i Universit. Ai ushtron Vullnetin e tij mbi Parimin Femëror (i cili mund të quhet "Natyrë") e kështu ky i fundit nis punën e vërtetë të evolucionit të Universit, që nga "qendrat e thjeshta të aktivitetit"deri tek njeriu, dhe më tutje e më lart akoma, gjithçka në përputhje me Ligjet e ngahershme e të prera të Natyrës.

Nëse preferoni mënyrën e vjetër figurative të të menduarit, mund ta mendoni Parimin Mashkullor si ZOTI, Ati, dhe Parimin Femëror si NATYRA, Mëma Universale nga gjiri i së cilës ka lindur gjithçka.

Kjo është shumë më tepër se një figurë poetike; është një ide e procesit real të krijimit të Universit. Por mos harroni kurrë se GJITHËSIA është gjithmonë NJË dhe është pikërisht brenda mendjes së saj që Universi gjenerohet, krijohet dhe ekziston.

Zbatimi i Ligjit të Përkimit mbi veten dhe mendjen tuaj, mund t'ju ndihmojë të kuptoni më saktë këtë ide. Ju e dini që pjesa juaj të cilën e quani "Unë", në një farë mënyre qëndron veçmas dhe vështron krijimin e Imazheve Mendore në mendjen tuaj. Pjesa në mendjen tuaj në të cilën kryhet gjenerimi mendor mund të quhet "Mua", e dallueshme nga "Unë"që qëndron veçmas si dëshmitar pasiv dhe këqyr mendimet, idetë dhe imazhet e gjeneruara nga "Mua". Mos harroni "Si lart, ashtu edhe poshtë"dhe fenomenet e njërit rrafsh të jetës mund të shfrytëzohen për të zbardhur misteret në rrafshe të tjera, më të larta apo më të ulëta.

Nuk ju duket vallë e çuditshme që Ju, bijtë, ndjeni një nderim instinktiv për GJITHËSINË, ndjenja të cilat i quajmë "fé", respekt e përulësi për MENDJEN ATËRORE? Nuk ju duket vallë e çuditshme që kur këqyrni veprat dhe mrekullitë e Natyrës, përfshiheni nga një ndjenjë e fuqishme e cila i ka rrënjët thellë brenda qenies suaj?

Kjo ndodh sepse ngjisheni butë pas MENDJES AMËNORE ashtu siç bën një foshnjë pas gjirit. Mos bëni gabimin të mendoni se kjo botë e vogël që shikoni përreth jush, Toka, e cila nuk është veçse një grimcë pluhuri në Univers, është vetë Universi. Ekzistojnë miliona e miliona botë të tilla, e më të mëdha akoma. Dha ka miliona e miliona Universe që ekzistojnë Brenda Mendjes së Pafundme të GJITHËSISË. Madje edhe në sistemin tone të vogël diellor ka zona e rrafshe jetësore shumë më të larta se tonat, e qenie krahasuar me të cilat, ne, të vdekshmit tokësorë, ngjajmë sikundër format baltake jetësore që rrojnë në shtratin e oqeanit kur krahasohen me Njeriun.

Ekzistojnë qenie me fuqi dhe atribute më të larta se ato që Njeriu mund të imagjinojë se vetëm Perënditë i zotërojnë. E megjithatë, këto qenie dikur kanë qenë si ju, madje edhe më poshtë, e ju një ditë do të jeni si ato,

madje edhe më lart me kalimin e kohës, sepse i tillë është shkruar Fati i Njeriut në kumtimet e të Përndriturve.

Vdekja nuk është reale as në kuptimin relativ të fjalës; ajo nuk është veçse Lindja në një jetë të re; Ju do të ngjiteni e ngjiteni, lart e më lart në rrafshe jetësore, në përjetësinë e kohës. Universi është shtëpia juaj dhe ju do të eksploroni edhe skutën më të largët të tij përpara fundit të Kohërave. Ju jetoni në Mendjen e Pafundme të GJITHËSISË dhe keni mundësi e shanse të pafundme si në Kohë ashtu edhe në Hapësirë.

Dhe në fund të Ciklit të Madh të Kohërave, kur GJITHËSIA do të tërheqë pas brenda vetvetes të gjitha krijimet e saj, ju do të shkoni buzagaz sepse atëherë do të jeni të aftë të njihni të Gjithë të Vërtetën e të qenit Një me GJITHËSINË. Ky është kumtimi i të Përndriturve; ata të cilët kanë ecur larg përgjatë Udhës.

Ndërkohë jetoni të qetë e në paqe; ndodheni të sigurt e të mbrojtur nga Fuqia e Pafundme e MENDJES ATËRORE-AMËNORE.

"Brenda Mendjes Atërore-Amënore, bijtë e vdekshëm ndodhen në shtëpinë e tyre."- Kybalioni

"Në Univers askush nuk është pa Atë apo pa Mëmë." **- Kybalioni**

2. Parathënie nga Maurice Dorial

Historia e pllakave që janë të përkthyera në faqet e mëposhtme, është e çuditshme dhe përtej besimit të shkencëtarëve modern. Lashtësia e tyre është e mahnitshme, ato datojnë larg rreth 36. 000 vjet para Krishtit. Autori është Thoti, një Mbret-Prift Atlantidas, i cili, pas fundosjes së vendit amë, themeloi një koloni në Egjiptin e lashtë. Ai ishte ndërtuesi i Piramidës së Madhe të Gizës, e cila gabimisht i është atribuar Keopsit. Në të përmbahet dija e tij e mençurisë antike, gjithashtu dhe dokumentat dhe instrumentat sekrete të Atlantidës së lashtë. Për rreth 16. 000 vjet, ai mbretëroi racën e lashtë të Egjiptit, afërsisht nga 52. 000 para Krishtit deri më 36. 000 para Krishtit. Në atë kohë, raca barbare e lashtë mes të cilëve u vendos ai dhe ndjekësit e tij, u ngritë në një shkallë të lartë qytetërimi. Thoti ishte një i pavdekshëm, domethënë, ai kishte fituar mbi vdekjen, duke kaluar vetëm kur ai e dëshironte, madje dhe atëherë jo nëpërmjet vdekjes. Mençuria e tij e madhe e bëri atë kreun e kolonive të ndryshme të Atlantidës, midis të cilave edhe të atyre që emigruan në Amerikën Qendrore dhe Jugore.

Kur erdhi koha që ta linte Egjiptin, Thoti ngriti Piramidën e Madhe përmbi hyrjen për te Sallat e Mëdha të Ament-it, vendosi regjistrimet e tij në të, dhe caktoi, midis më të zhvilluarve nga njerëzit e tij, roje për të ruajtur sekretet e Piramidës. Në kohët e mëvonshme, pasardhësit e këtyre rojeve, u bënë priftërinjtë e piramidës, në të cilën Thoti adhurohej si Zoti i Mençurisë, Dokumentuesi i tyre në epokën e errësirës që pasoi kalimin e

tij. Sipas legjendës, Sallat e Amenti-t u bënë bota e nëndheshme, Sallat e zotave, ku shpirti kalonte për gjykim pas vdekjes. Gjatë epokave të mëvonshme, egoja e Thotit kaloi në trupat e njerëzve në mënyrën siç është përshkruar në pllakat. Kështu, ai u rimishërua tre herë, në të fundit njihet si Hermes, treherë-i linduri. Në këtë mishërim, ai la dorëshkrimet që nga okultistët modern njihen si Pllakat e Smeraldta, një paraqitje më e vonë dhe nga më të paktat e mistereve antike.

Janë dhjetë pllakat e përkthyera në këtë punim, të cilat iu lanë priftërinjve të piramidës në ruajtje në Piramidën e Madhe. Të dhjetat janë ndarë në trembëdhjetë pjesë për komoditet. Dy të fundit janë kaq madhështore në rëndësinë e tyre, që për momentin është e ndaluar ta publikojmë për të gjithë botën. Megjithatë në këto fakte të këtij libri ndodhen sekrete, të cilat, për studentin serioz, do të dëshmojnë vlera të paçmuara. Ato duhet të lexohen jo një herë, por qindra herë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta zbulojnë kuptimin e vërtetë. Një lexim i rastësishëm do të japë rreze bukurie, por një studim më intensiv do të hapë kanale të mençurisë dhe të dijes kurrë të njohura nga mendja njerëzore.

Ja tani dy fjalë për mënyrën se si këto sekrete të fuqishme iu zbuluan njeriut modern, pasi ishin mbajtur të fshehura për një kohë të gjatë. Rreth 1300 vjet para Krishtit, Egjipti, Khemi i lashtë, ishte në trazira dhe shumë dërgata priftërinjsh u dërguan në pjesë të tjera të botës. Midis tyre ndodheshin disa priftërinj të piramidës të cilët morën me vete Pllakat e Smeraldta si një hajmali nëpërmjet të cilës ata do të ushtronin autoritetin e tyre mbi klerikët më pak të zhvilluar, pasardhës gjithashtu të kolonive të tjera të Atlantidës. Sipas legjendës, Pllakat i jepnin mbartësit autoritetin e Thotit. Grupi i veçantë i priftërinjve, që mbarti pllakat, emigroi në Amerikën Jugore ku ata gjetën një racë të zhvilluar, Maya-t të cilët kishin ruajtur shumë nga mençuria e lashtë. Priftërinjtë u vendosën dhe qëndruan midis tyre. Në shekullin e dhjetë, Mayat ishin të vendosur në krejt Yukatan-in, dhe pllakat ishin vendosur poshtë altarit të njërit prej tempujve të mëdhenj të Zotit Diell.

Pas pushtimit të Maya-s nga Spanjollët, qytetet u braktisën dhe thesaret e tempullit u harruan. Duhet të kuptohet se Piramida e Madhe e Egjiptit ka qënë dhe është akoma një tempull i fillesës i njohjes me ritet e shoqërisë së fshehtë për tek misteret. Jezusi, Solomoni, Apolloni dhe të tjerë i kanë atje fillesat e tyre. Autori i këtyre rreshtave (i cili është i lidhur me Lozhën e Madhe të Bardhë e cila gjithashtu punon nëpërmjet priftërisë së piramidës) u udhëzua t'i gjente dhe t'i kthente pllakat në Piramidën e Madhe. Pas aventurash të cilat nuk është e nevojshme të citohen këtu, kjo punë u krye. Para se t'i kthente, atij iu dha leja t'i përkthente dhe të mbante një kopje të mençurisë së gdhendur në pllakat.

Kjo ndodhi në vitin 1925, dhe vetëm prej pak kohësh është dhënë leja për t'i publikuar. Është parashikuar që shumë njerëz do t'i përqeshin. E

megjithatë student i vërtetë, që do të lexojë përmes rreshtave, do të fitojë mençuri. Nëse drita është tek ti, drita që është gdhendur në këto pllaka do të të përgjigjet.

Ja tani dy fjalë për aspektin material të pllakave. Ato përbëhen nga dymbëdhjetë pllaka smeraldi të gjelbër, të formuar nga një substancë e dalë prej shndërrimeve alkimike. Ato janë të pashkatërrueshme, iu rezistojnë të gjithë elementëve dhe substancave që njohim. Në fakt, struktura atomike dhe molekulare është e qëndrueshme, nuk pësojnë asnjë ndryshim, proceset e kohës nuk ndikojnë mbi to, meqenëse nuk ndikojnë proceset kimike mbi to. Një fenomen i tillë hedh poshtë ligjin e jonizimit. Mbi të janë gdhendur shenja në gjuhën e lashtë të Atlantidës: shenja të cilat iu korrespondojnë valëve të caktuara të mendimit, që çlirojnë vibrimin korrespondues mendor në mendjen e lexuesit. Pllakat janë kapur së bashku më rrathë të një aliazhi (lloj lidhje) ngjyrë të artë, e varur në një purtekë prej të njëjtit material. Kaq për sa i takon aspektit material.

Mençuria që ndodhet në to është themeli i mistereve antike. Kushdo që do t'i lexojë me zemër dhe mendje të hapur, mençuria e tij do të rritet në mënyrë të ndjeshme. Lexo! Beson apo jo, por lexo! Dhe vibrimi i rigjetur do të rizgjojë një përgjigje në shpirtin tënd.

Në faqet e mëposhtme, unë do t'ju zbuloj disa nga misteret të cilat vetëm sa janë prekur lehtë si nga unë, por edhe nga të tjerë mësues apo studentë të së vërtetës. Është i pafund kërkimi njerëzor për kuptimin e ligjeve që rregullojnë jetën, e megjithatë e vërteta ekziston gjithmonë mbas pëlhurës që mbron planet më të larta të ekzistencës nga vizioni material i njeriut, e gatshme të asimilohet nga kushdo që zgjeron vizionin e vet për nga brenda, dhe jo drejt asaj që ndodhet jashtë. Në heshtjen e shqisave fizike ndodhet çelësi për zbulimin e mençurisë. ***Ai që flet, nuk di; ai që di, nuk flet.*** Dija më e lartë është e pashqiptueshme, që s'mund të përshkruhet me fjalë, ajo ekziston si një realitet në pista e cila kapërcen të gjitha kufijtë e logjikës së fjalëve apo simboleve fizike. Të gjitha simbolet janë veç çelësa te dyert që çojnë te të vërtetat, dhe, shumë herë, dera nuk hapet sepse çelësi duket kaq i madh saqë gjërat, të cilat janë përtej, nuk mund të jenë të dukshme. Kur ne të kuptojmë se të gjitha çelësat dhe të gjitha simbolet fizike janë manifestime, shtrirje të një ligji e të vërtete të madhe, atëherë do të fillojmë të zhvillojmë vizionin që do të na lejojë të çajmë errësirën. Të gjitha gjërat, në të gjitha universet, lëvizin në përputhje me ligjin, dhe ligji, i cili rregullon lëvizjen e planeteve nuk është më i pandryshueshëm se ligji që rregullon qënien fizike të njeriut. Një nga ligjet më të mëdha nga të gjitha Ligjet Kozmike, është ai që është përgjegjës për formimin e njeriut si një qënie fizike. Objektivi i madh i shkollave të misterit të të gjitha kohërave ka qënë të zbulojë funksionimet e Ligjit që lidh njeriun si trup fizik dhe njeriun si qënie shpirtërore. Njeriu intelektual është hallka lidhëse ndërmjet njeriut si trup fizik dhe njeriut si qënie shpirtërore, sepse mendja

bën pjesë si në cilësitë fizike ashtu dhe në cilësitë jofizike. Kandidati për dije më të larta duhet të zhvillojë anën intelektuale të natyrës së tij dhe kështu forcon vullnetin e tij në mënyrë që të jetë në gjendje t'i përqëndrojë të gjitha fuqitë e qënies së tij dhe në planin e ekzistencës që ai dëshiron. Kërkimi i madh për dritë, jetë dhe dashuri vetëm sa fillon në planin material. Duke u mbartur në absolutin e vet, qëllimi i tij final është të jetë plotësisht një me ndërgjegjen universale. Hapi i parë është vënia e themeleve në nivelin material; pastaj vjen qëllimi më i lartë i arritjes shpirtërore. Në faqet që vijojnë, unë do të jap një interpretim të Pllakave të Smeraldta dhe sekretin e tyre, kuptimet e fshehta dhe ezoterike. (Bashkë me publikimin e përmbajtjes së pllakave, Doreal ka dhënë edhe një interpretim të tij mbi kuptimin e secilës pllakë – shënim i p¨rkthyesit.) Në pllakat, shumë fjalë të Thotit fshehin kuptime që nuk duken në një lexim sipërfaqësor. Drita e dijes, e aplikuar në Pllakat, do të hapë kanale dhe forma të reja mendimi.

"Lexo dhe bëhu i zgjuar!"Ah sikur drita e ndërgjegjes tënde vetjake të zgjojë aftësinë për të kuptuar, e cila është një cilësi e natyrshme e frymës.

3. Parathënie nga Alessandro Marcon

Shkenca e ka të pamundur t'i pranojë Pllakat e Thotit, sepse po t'i pranojë, do t'i duhet të rishikojë të gjitha teoritë e saj, studimet dhe përfundimet e tyre, aq fort të propaganduara deri në këtë moment. Për shkencën dhe për krerët e diturisë së gënjeshtërt, do të nënkuptonte kthimin në bankat e shkollës, por kësaj radhe si nxënës e jo më si profesorë të nderuar. Personalisht nuk kam besuar kurrë që piramidat të jenë ndërtuar nga egjiptianët. Është po aq e vërtetë se kanë dështuar të gjitha tentativat e arkitektëve më të mëdhenj të kohës sonë për të ndërtuar një piramidë të tillë. Dhjetë pllakat janë ndarë në trembëdhjetë pjesë për komoditet. Për komoditetin e kujt dhe përse? Duhet patjetër t'i ndryshojnë gjërat edhe kur nuk është absolutisht e nevojshme. Pllakat u shfaqën për herë të parë në Mesjetë, por është e panjohur mënyra si u rigjetën. Asnjë nuk e di me saktësi si u gjetën. Disa kërkues hipotezojnë se janë gjetur në një nga dhomat e Piramidës së Keopsit, por janë thjesht supozime, mbetet vetëm fakti që Thoti figuron si një Zot në zbukurimet pikturore të Egjiptit të lashtë. Shkenca nuk e merr në konsideratë faktin që Pllakat nuk pësojnë asnjë ndryshim me kalimin e kohës, njësoj siç bën papa që nuk do që të flitet për ungjillin sipas Judës Iskariot, sepse po ta pranojë si autentik, do të shemben të gjitha gënjeshtrat për Jezusin dhe, bashkë me to, do të shemben edhe ungjijt e Biblës.

PLLAKA I:
HISTORIA E THOT-it –ATLANTIDASIT

Unë, Thot Atlantidasi, zot i mistereve, ruajtës i dokumenteve, mbret madhështor, magjistar që jeton nga brezi në brez, duke qënë gati për të kaluar në Sallat e Ament-it, lë shënim, për ata që do të vijnë më vonë, këto dokumenta madhështore të Atlantidës së Lavdishme. Në qytetin e madh të Keor-it, mbi ishullin Undal, në një kohë shumë të largët, e fillova këtë mishërim. Të mëdhenjtë e Atlantidës jetonin dhe vdisnin jo si njerëzit e vegjël të kohës së sotme, por megjithatë, për shekuj me radhë e rinovonin jetën e tyre në Sallat e Ament-it aty ku lumi i jetës rrjedh përjetësisht. Njëqind herë dhjetë (ndoshta bëhet fjalë për një sistem numërimi që duket të jetë i ndryshëm nga sistemi që përdorim ne sot - shënim i përkthyesit) kam zbritur në botën e errët që çon tek drita, dhe po aq herë jam ngjitur nga errësira në dritë duke ripërtërirë forcën dhe pushtetin tim.

Tani do të zbres për njëfarë kohe, dhe njerëzit e Khem-it (Khem është alkimi në Egjiptin e lashtë) nuk do të më njohin më. Por në një kohë që duhet ende të vijë, unë do të shfaqem sërish, i fuqishëm dhe i pushtetshëm, dhe do të kërkoj llogari për mësimet që iu kam lënë. Prandaj kini kujdes, o njerëz të Khem-it, po qe se do t'i keni falsifikuar mësimet e mia, sepse do t'ju hedh poshtë prej tokave tuaja të larta në errësirën e shpellave prej nga vini. Sekretet e mia mos ua zbuloni njerëzve të Veriut, as njerëzve të Jugut, në mënyrë që mos të bjerë mbi ju mallkimi im.

Kujtojini dhe verjuni veshin fjalëve të mia, sepse është e sigurt që do të kthehem dhe do t'ju kërkoj llogari si i keni ruajtur sekretet e mia. Po, do të kthehem edhe nga përtej kohës dhe nga përtej vullnetit të vdekjes, do të shpërblej ose do të ndëshkoj sipas mënyrës si e keni ruajtur sekretin tim.

I madhërishëm ishte populli im në kohët antike, i madhërishëm përtej botkuptimit të njerëzve të vegjël që janë tani rrotull meje; njihnin mençurinë e vjetër, kërkonin larg në zemrën e dijes së pafundme që i përket rinisë së Tokës. Të mençur ishim ne me mençurinë e Bijve të Dritës që banonin mes nesh. Të fortë ishim ne me fuqinë e nxjerrë nga zjarri i përjetshëm. Dhe, nga gjithë këta, më i madhi mes bijve të njerëzve ishte babai im, Thotme, rojtar i tempullit të madh, ndërlidhës i Bijve të Dritës që banonin në tempull dhe racave të njerëzve që popullonin dhjetë ishujt.

Zëdhënës pas të Tre-ve, i Banorit të Undal-it, duke u folur Mbretërve me zërin e denjë që meriton t'i bindesh. U rrita unë atje që fëmijë deri në burrëri duke marrë nga babai im misteret më antike, derisa u rrita në zjarrin e mençurisë, derisa u dogja në një flakë konsumuese. Asgjë tjetër nuk dëshiroja përveç arritjes së mençurisë. Derisa, një ditë të shënuar, dha urdhrin Banori i Tempullit, që të më sillnin para tij. Mes bijve të njerëzve, të paktë ishin ata që e kishin parë atë fytyrë madhështore dhe kishin jetuar, sepse Bijtë e Dritës nuk janë si bijtë e njerëzve, kur ata nuk janë të

mishëruar në një trup fizik. Unë u zgjodha midis bijve të njerëzve, të merrja mësimet nga Banori, në mënyrë që qëllimet e tij të përmbusheshin, qëllime të cilat ende të pangjizura në barkun e kohës. Një kohë të gjatë banova unë në Tempull, duke mësuar asgjë tjetër përveç mençurisë, derisa, edhe unë, iu afrova Dritës që vinte nga zjarri i madh. Banori më mësoi kalimin e rrugës për tek Amenti, bota e nëndheshme ku mbreti i madh ulet në fronin e tij të fuqisë. Thellë u përkula në gjunjë para Zotave të Jetës dhe Zotave të Vdekjes, dhe si dhuratë mora Çelësin e Jetës. Unë isha i lirë nga Sallat e Ament-it, jo i lidhur me vdekjen tek rrethi i jetës. Larg udhëtova deri tek yjet, deri ku anulohen hapësira dhe koha. Atëherë, si kisha pirë në kupën e thellë të mençurisë, pashë në zemrat e njerëzve dhe atje gjeta misteret më të mëdha, e u gëzova. Sepse vetëm në Kërkimin e së Vërtetës do të mund të qetësohej Shpirti im, dhe brenda saj të shuhej flaka ime.

Jetova përmes kohërave, duke vështruar ata që rrotull meje shijonin kupën e vdekjes dhe riktheheshin në Dritën e Jetës. Gradualisht prej Mbretërive të Atlantidës kalonin valë ndërgjegje që kishin qënë një me mua, vetëm për t'u zëvendësuar nga lindja e një ylli më të vogël. Në bindje ndaj Ligjit, fjala e Zotit u rrit në një lule. Gradualisht zbritën në errësirë mendimet e Atlantidasve, derisa, më në fund, në këtë zemërim, Banori u ngrit nga AGWANTI (kjo fjalë nuk ka ekuivalent; do të thotë një gjendje shkëputje) e tij, duke shqiptuar Fjalën, duke thirrur pushtetin.

Thellë, në zemrën e Tokës, dëgjuan bijtë e Amenti-t, dhe, duke dëgjuar, i dhanë ndryshim lules së zjarrit që digjet përjetësisht, duke ndryshuar dhe duke u lëvizur, duke përdorur Logos-in, derisa ai zjarr i madh ndryshoi drejtimin e tij. Pastaj mbi botën vërshuan ujrat e mëdha, duke mbytur dhe duke zhytur në thellësi, duke ndryshuar ekuilibrin e Tokës derisa vetëm Tempulli i Dritës qëndroi në këmbë mbi malin e madh të Undal-it që përsëri doli lart nga uji, kishte disa që kishin mbetur gjallë atje, që i kishin shpëtuar vërshimit të ujrave. Më thirri pastaj Zoti e tha:

Mblidhi njerëzit e mi! Nëpërmjet arteve që ke mësuar, merri dhe çoji larg përmes ujrave, derisa të mbërrini në tokën e barbarëve leshatorë që banojnë shpellave të shkretëtirës. Zbato atje planin që di!

Atëherë mblodha njerëzit e mi dhe i hipa në anijen e madhe të Zotit. U ngritëm lart në mëngjes. I errët poshtë nesh dergjej Tempulli. Befas mbi të u ngritën ujrat. Ishte Tempulli i madh, u zhduk nga Toka, deri në kohën e caktuar. Ne u arratisëm shpejt drejt diellit të mëngjesit, derisa poshtë nesh mbërritëm tek toka e bijve të Khem-it. Të tërbuar nga zemërimi ata erdhën të armatosur me topuzë dhe heshta, të verbuar nga zemërimi ata kërkonin të shkatërrojnë e të vrasin Bijtë e Atlantidës. Pastaj unë vetë u çova në këmbë, dhe, me skeptrin tim iu drejtova një rreze vibrimi duke i ngrirë në vend si copa gurësh prej mali. Pastaj u fola atyre me fjalë të qeta dhe paqësore duke u folur për forcën e Atlantidës, duke u thënë që ne ishim

bijtë e Diellit dhe lajmëtarët e tij. I frikësova me spektaklin tim të shkencës magjike, derisa u përulën në tokë nën këmbët e mia, pastaj i lëshova.

Banuam për një kohë të gjatë në tokën e Khem-it, për shumë e shumë kohë. Deri kur, duke respektuar urdhrat e Zotit, i cili ndërsa fle, jeton përjetësisht, i dërgova Bijtë e Atlantidës, i dërgova në shumë drejtime me qëllim që, nga barku i kohës, mençuria të lartësohet sërish në bijtë e saj. Banova për një kohë të gjatë në tokën e Khem-it, duke bërë vepra të mëdha mençurie. Bijtë e Khem-it u rritën drejt dritës së dijes, u lagën nga shirat e mençurisë sime. Pastaj hapa një shteg për në Ament, në mënyrë që unë të mbaj fuqitë e mia, duke jetuar epokë pas epoke si një Diell i Atlantidës, duke mbajtur mençurinë, duke ruajtur dokumentat.

U bënë të mëdhenj bijtë e Khem-it, i zotëruan popujt rreth e rrotull tyre, duke u rritur ngadalë në forcën e Shpirtit. Tani, për një farë periudhe po largohem prej tyre, për në sallat e errëta të Ament-it, thellë në sallat e Tokës, përpara Zotave të pushteteve, edhe një herë ballë për ballë me Banorin. Ndërtova një portë mbi hyrjen, një udhëkalim që çon poshtë për tek Amenti. Të paktë do të kenë kurajon të guxojnë, të paktët e kalojnë portalin për tek Amenti i errët. Mbi kalimin, unë ndërtova një piramidë të fuqishme që përdor fuqinë që kapërcen forcën e Tokës (gravitetin). Shumë poshtë në thellësi, unë vendosa një dhomë, apo sallë, të mbushur me energji, prej aty gërmova një kalim rrotullues që mbërrin pothuajse në kulm. Atje, në kulm, unë vendosa kristalin, që dërgon rrezen në "Kohë-Hapësirë", duke tërhequr forcën prej jashtë eterit, duke e përqëndruar mbi hyrjen për tek Amenti. Ndërtova dhoma të tjera dhe i lashë që të duken të zbrazëta, e megjithatë në to fshihen çelësat për tek Amenti. Kushdo, që me kurajo do të guxojë të sfidojë mbretëritë e errëta, le të purifikohet më parë nga një agjërim i gjatë. Le të dergjet në sarkofagun prej guri në dhomën time. Pastaj unë do t'i zbuloj misteret e mëdha. Shumë shpejt ai do të ndjekë udhën ku do ta takoj, madje edhe në errësirën e Tokës, unë, Thoti, Zot i Mençurisë, do ta takoj dhe do ta mbajë si fëmijën që është duke hedhur hapat e parë, dhe do të banoj përgjithmonë me të.

Unë ndërtova Piramidën e Madhe, projektuar sipas piramidës së forcës së Tokës, që digjet përjetësisht, në mënyrë që, të mund të rezistojë nëpër shekuj. Në të unë grumbullova dijen time të "Shkencës Magjike", në mënyrë që të mund të jem këtu kur të kthehem sërish nga Amenti. Po, ndërsa unë fle në Sallat e Ament-it, Shpirti im, që bredh i lirë, do të mund të rimishërohet, duke banuar mes njerëzve në këtë formë apo në një tjetër. (Hermes, tre herë i linduri). Unë jam i Dërguari mbi Tokë i Banorit, duke përmbushur urdhërat e tij, në mënyrë që njeriu të mund të lartësohet. Tani po kthehem në Sallat e Ament-it, duke lënë pas meje pjesë të mençurisë sime. Ruajeni dhe mbajeni urdhërin e Banorit: Ngritni gjithmonë sytë tuaj drejt dritës!

Me kalimin e kohës sigurisht që ke për të qënë një me Zotin, sigurisht që ke për të qënë një me drejtësinë e Zotit, sigurisht që ke për të qënë një me Të Gjithën. Tani po largohem nga ju. Ndiqni urdhërimet e mia! Ruajini të pandryshuara, qofshi me to, dhe unë do të jem me ju, duke ju ndihmuar dhe duke ju udhëhequr në Dritë. Tani para meje hapet portali. Unë po zbres poshtë në errësirën e natës.

PLLAKA II:
SALLAT E AMENTI-T

Thellë në zemër të Tokës ndodhen Sallat e Ament-it, larg, poshtë ishujve të Atlantidës së mbytur, Sallat e Vdekjes dhe Sallat e Jetës, të lara në zjarrin e Gjithësisë së pafundme. Larg, në kohën e shkuar, të humbur në hapësirë-kohë, Bijtë e Dritës vështruan poshtë mbi botën. Panë bijtë e njerëzve në vargonjtë e tyre, të skllavëruar nga forca që erdhi nga përtej. Ata e dinin që vetëm duke i çliruar nga skllavëria, do të mund të ngrihej njeriu nga Toka për tek Dielli. Ata zbritën poshtë dhe krijuan trupa, duke marrë tipare njerëzore. Zotat e çdo gjëje thanë pas formimit të tyre: "Ne jemi ata që u formuam nga pluhuri i hapësirës dhe pjesëtarë të jetës të Gjithësisë së pafund; duke jetuar në botë si bij të njerëzve, të ngjashëm, e megjithatë të ndryshëm nga bijtë e njerëzve"Pastaj, për një vendbanim si shtëpinë e tyre, larg, poshtë kores së tokës, me fuqinë e tyre, ata shpërthyen hapësira të mëdha, hapësira veçmas bijve të njerëzve. I rrethuan me pushtetin dhe fuqinë e tyre, duke i mbrojtur prej dëmit Sallat e të Vdekurve. Krah për krah pastaj, ata vendosën hapësira të tjera, i mbushën me Jetë dhe me Dritën e sipërme. Pastaj ndërtuan Sallat e Ament-it, ku ata të mund të banojnë përjetësisht me jetën deri në fundin e përjetësisë. Tridhjetë e dy ishin atje fëmijët, bijtë e Dritës që kishin ardhur midis njerëzve, duke u përpjekur të çlirojnë nga vargonjtë e errësirës ata që ishin lidhur nga forca që erdhi nga përtej. Thellë në Sallat e Jetës u rrit një lule, duke flakëruar, duke u përhapur, duke e shtyrë mbrapa natën. Në qendër u vendos një rreze e një fuqie të madhe Jetëdhënëse, Dritëdhënëse duke mbushur me fuqinë e vet të gjithë ata që afroheshin pranë saj. Rrotull saj vendosën fronet e tyre, tridhjetë e dy, vendqëndrime për secilin nga Bijtë e Dritës, në mënyrë që të laheshin në rrezatimin e mbushur me Jetën e Dritës së përjetshme. Atje, kohë pas kohe ata vendosën trupat e tyre të parë të krijuar, kështu që ata të mund të mbusheshin me Shpirtin e Jetës. Njëqind vjet çdo njëmijë duhet të shkëlqejë flaka e Dritës Jetëdhënëse para trupave të tyre. Duke përshpejtuar zgjimin e Shpirtit të Jetës. Aty brenda rrethit, për shekuj me radhë, ulen Zotat e mëdhenj duke jetuar një jetë të panjohur mes njerëzish.

Atje në Sallat e Jetës ata ndodhen duke fjetur; Shpirti i tyre rrjedh lirisht përmes trupave të njerëzve. Kohë mbas kohe, ndërsa trupat e tyre

dergjen duke fjetur, ata mishërohen në trupat e njerëzve, duke mësuar e duke udhëhequr përpara dhe drejt lartësimit, për jashtë errësirës, për në dritë. Atje në Sallën e Jetës, e mbushur me mençurinë e tyre, të panjohur nga racat e njerëzve, duke jetuar përgjithmonë poshtë zjarrit të ftohtë të jetës, ulen Bijtë e Dritës. Ka periudha kohe në të cilën ata rilindin, duke ardhur nga thellësitë për të qënë dritë mes njerëzve, të pafundëm midis njerëzve të kufizuar. Ai, që nëpërmjet progresit, është rritur nga errësira, e ka ngritur veten nga nata në Dritë, u bë i lirë prej Sallave të Ament-it, i lirë nga Lulja e Dritës dhe e Jetës. Pastaj, i udhëhequr nga dija dhe mençuria, kalon nga njerëzit tek Zot i Jetës. Atje ai mund të banojë si një me Zotat, i lirë nga kufizimet e errësirës së natës. Të ulur brenda lules së rrezatimit, ulen shtatë Zotat e Hapësirë-Kohës mbi ne, duke ndihmuar dhe duke udhëhequr me Mençuri të pafundme bijtë e njerëzve, kalimin e shtegut përmes kohës. Të pazakonshëm dhe të fuqishëm, ata, të mbuluar nga pushteti i tyre, të heshtur, të gjithëdijshëm, mbartës të forcës së Jetës, të ndryshëm e megjithatë një me bijtë e njerëzve. Po, të ndryshëm, e megjithatë Një me Bijtë e Dritës. Rojtarë dhe vëzhgues të forcës që robëron njeriun, gati për të zgjidhur lidhjet kur të arrihet Drita. I pari dhe më i fuqishmi, ulet Prezenca e Mbuluar, Zoti i Zotave, Nënta i pafundëm, mbi secilin nga Zotat e Cikleve: Tre, Katër, Pesë, dhe Gjashtë, Shtatë, Tetë, secili me misionin e tij, secili me fuqitë e tij, duke udhëhequr, duke dirigjuar fatin e njeriut. Atje ulen ata, të pushtetshëm dhe të fuqishëm, të lirë nga gjithë koha dhe hapësira. Ata nuk janë prej kësaj bote, e megjithatë të ngjashëm me të, ata, Vëllezërit më të Moshuar të bijve të njerëzve. Duke gjykuar dhe duke peshuar, me mençurinë e tyre duke vëzhguar progresin e Dritës mes njerëzve. Atje përpara tyre u solla unë nga Banori, e pashë të bashkohej më Një-shin mbi të. Pastaj nga Ai erdhi një zë që tha:

"I madh je ti Thot midis bijve të njerëzve. I lirë këtej e tutje nga Sallat e Ament-it, Zot i Jetës midis bijve të njerëzve. Nuk do ta shijosh vdekjen, përveçse kur ti ta duash, pi ti nga Jeta deri në fundin e Përjetësisë. Këtej e tutje përgjithmonë ka Jetë për dëshirën tënde. Këtej e tutje Vdekja do të jetë nën urdhërin tënd. Qëndro ose ik si të dëshirosh, i lirë është Amenti për birin e njeriut. Jetoje Jetën në formën që ti e dëshiron, Bir i Dritës që u rrit mes njerëzve. Zgjidh detyrën tënde, sepse për të gjithë duhet të punojnë, mos u çliro kurrë nga shtegu i Dritës! Ke bërë një hap në rrugëtimin e gjatë drejt së lartës, tani është i pafundëm mali i Dritës. Çdo hap që ti bën, e ngre edhe më të lartë malin; gjithçka përparon tek ty, por i largët është qëllimi. Afroju gjithmonë Mençurisë së pafundme, mos u largo kurrë nga qëllimi! Tani je i lirë nga Sallat e Ament-it për të ecur dorë për dore me Zotat e botës, me një qëllim të vetëm, të punoni bashkë për t'u sjellë Dritën bijve të njerëzve. "

Pastaj prej fronit të tij erdhi njëri nga Zotat, më mori dorën dhe më çoi përpara, përmes të gjitha Sallave të tokës së panjohur dhe të thellë. Më

udhëhoqi përmes Sallave të Ament-it, duke më treguar misteret që janë të panjohura nga njerëzit. Më udhëhoqi, përmes kalimit të errët zbritës, për në Sallën ku ndodhet Vdekja e errët. E pamatë si hapësira shtrihej përpara meje Salla e madhe, rrethuar prej territ, e megjithatë, plot e përplot me Dritë. Përpara meje u shfaq një fron i madh i errësirës, mbi të ishte ulur një figurë e mbuluar me natë. Figura e madhe e ulur ishte më e errët se errësira, e errët me një errësirë që nuk ishte e natës. Pastaj Zoti, përpara tij, bëri një pauzë e shqiptoi Fjalën që prodhon Jetën e tha:

"Oh, zot i errësirës, udhëheqës i shtegut nga Jeta në Jetë, përpara teje po sjell një Diell të mëngjesit. Mos e prek kurrë me fuqinë e natës! Flakën e tij mos e thirr në errësirën e natës! Shikoje dhe njihe, një nga vëllezërit tanë, i ngritur nga errësira në Dritë! Çliroje flakën e tij nga skllavëria e saj! Lëre që ajo të ndizet, e lirë le të flakërojë përmes errësirës së natës!"

Figura, atëherë ngriti dorën, erdhi papritmas një flakë që rritej në mënyrë të qartë dhe të shndritshme. Perdja e errësirës u rrokullis mbrapsht me shpejtësi, duke e zbuluar Sallën nga errësira e natës. Pastaj të tjera u rritën në hapësirën përpara meje, flakë pas flake, nga perdja e natës. Miliona të panumërta u shfaqën papritur përpara meje, disa flakërues si lule prej zjarri. Disa të tjera shpërndanin një rrezatim të zbehtë që rridhte dobët nga jashtë natës. Disa të tjera dobësoheshin me shpejtësi; të tjera që rriteshin nga një shkëndijë e vogël drite. Secila e rrethuar nga veli i vet i zbehtë i errësirës duke flakëruar sërish me një dritë që nuk do të mund kurrë të shuhet. Ecejak duke ardhur e duke shkuar si xixëllonjat në pranverë, mbushnin hapësirën me Dritë dhe me Jetë. Pastaj u shqiptua një zë, i pushtetshëm dhe solemn duke thënë:

"Këto drita janë shpirtrat mes njerëzve që rriten dhe dobësohen, duke ekzistuar përgjithmonë, e megjithatë duke ndryshuar jetë nëpërmjet vdekjes në jetë. Kur ata të kenë lulëzuar, të mbërritur në zenitin e rritjes në jetën e tyre, me shpejtësi atëherë unë dërgoj velin tim të errësirës, duke e mbështjellë të vdekurin në qefin dhe duke e ndryshuar në forma të reja të jetës. Vazhdimisht ngjiten, përmes të gjitha kohërave, duke u rritur, duke u zgjeruar në një flakë gjithmonë e më të madhe, duke e ndriçuar errësirën me një fuqi akoma më të madhe, duke u fikur e megjithatë të pashuar nga veli i natës. Kështu rritet gjithmonë shpirti i njeriut, duke u fikur, e megjithatë i pashuar në errësirën e natës. Unë, Vdekja, vij, dhe nuk mbetem, sepse jeta ekziston përjetësisht në të Gjithën; thjesht një pengesë, unë, në rrugëtim, gati për t'u pushtuar nga drita e pafundme. Ngrihu o flakë që digjesh gjithmonë në brendësi, flakëro dhe pushtoje velin e natës!"

Atëherë, në mes të flakëve në errësirë, bëri përpara një që ndriçoi natën, duke flakëruar dhe duke u përhapur, gjithmonë e më i shndritshëm, derisa, më në fund nuk mbeti gjë tjetër përveç Dritës. Atëherë udhëheqësi im foli me zërin e Zotit:

"Shihe shpirtin tënd si rritet në dritë, tani i çliruar përgjithmonë nga Zoti i natës". Ai, pastaj, më udhëhoqi përmes shumë hapësirave të mëdha të mbushura me misteret e Bijve të Dritës; mistere të cilat njeriu nuk do të mund t'i dijë kurrë derisa të mos jetë edhe ai një Diell i Dritës. Pastaj Ai u kthye mbrapsht e më udhëhoqi në Dritën e sallës së Dritës. Unë u ula në gjunjë para Zotave të mëdhenj, Zota të të Gjithë kohërave të cikleve të sipërm. Ai, pastaj, shqiptoi fjalë të një fuqie të madhe e tha:

"Ti je i çliruar prej sallave të Ament-it. Zgjidh punën tënde midis bijve të njerëzve! **Atëherë unë i thashë:** ***O, mjeshtër i madh, le të jem unë një mësues i njerëzve në mënyrë që t'i udhëheq përpara dhe drejt së lartës, derisa edhe ata të bëhen dritë midis njerëzve, të lirë nga veli i natës që i rrethon, dhe të flakërojnë me një dritë që do të shkëlqejë mes njerëzve.*** **Pastaj zëri më tha:** ***Vazhdo si të dëshirosh! Qoftë e bërë! Ti je Padron i fatit tënd, i lirë të marrësh apo të refuzosh siç ti dëshiron. Merre fuqinë, merre mençurinë! Shkëlqe si një dritë mes bijve të njerëzve".***

Pastaj Banori më udhëhoqi drejt lartësimit. Unë banova sërish mes bijve të njerëzve, duke u mësuar dhe duke treguar pjesë të mençurisë sime; Diell i Dritës, një zjarr mes njerëzve. Tani sërish po përshkoj shtegun zbritës duke kërkuar dritën në errësirën e natës. Mbrojini dhe mbajini, ruajini dokumentat e mia, në mënyrë që të jenë udhërrëfyes për bijtë e njerëzve.

PLLAKA III:
ÇELËSI I MENÇURISË

Unë, Thot Atlantidasi, e jap mençurinë time, jap dijet e mia, jap pushtetin tim. Lirisht ua jap bijve të njerëzve. E jap që edhe ata të mbushen me mençuri për të ndriçuar nëpër botë mbi velin e natës. Mençuria është fuqi dhe fuqia është mençuri, dhe të dyja bashkë e bëjnë gjithçka të përsosur. Mos ji krenar, o njeri, për mençurinë tënde! Fol me injorantin me të njëjtën dashamirësi siç flet edhe me të diturin! Nëse dikush vjen tek ti i mbushur me dije, dëgjoje dhe verja veshin fjalëve të tij, sepse mençuria është gjithçka. Mos hesht kur të keqen e flasin si të Vërtetë, sepse drita e diellit shkëlqen mbi të gjitha gjërat! Do të ndëshkohet kushdo që shkel Ligjin, sepse liria vjen vetëm nëpërmjet Ligjit. Mos shkakto frikë, sepse frika është robëri, një zinxhir që i lidh njerëzit në errësirë. Dëgjoje zemrën tënde gjatë gjithë jetës! Bëj më shumë nga sa të është urdhëruar të bësh! Edhe kur të kesh fituar pasuri, dëgjo prapë zemrën tënde, sepse të gjitha pasuritë nuk kanë asnjë vlerë, nëse zemra jote është e vakët. Mos e zvogëlo kohën e gjërave që i bën me qejf; për shpirtin kjo gjë është e neveritshme (të bësh gjëra pa dëshirë). Nuk devijojnë ata që udhëhiqen, por ata që kanë humbur, nuk mund ta gjejnë dot rrugën e drejtë. Po të shkosh tek njerëzit, shko me Dashuri nga thelbi i zemrës tënde. Nëse dikush vjen të të lypë një

kështillë, lëre të shprehet lirshëm, derisa ta thotë gjithçka për të cilën ka ardhur tek ti. Nëse ai heziton të ta hapë zemrën, do të thotë se ti, gjykatësi, ke vepruar gabim. Mos përsërit diskutime ekstravagante, dhe as mos dëgjo diskutime të tilla, sepse janë fjalë të njeriut që nuk është në ekuilibër. Mos fol në mënyrë të tillë, kështu që ai, para teje të mund ta njohë mençurinë. Heshtja është flori. Fjalët e shumta janë fukarallëk. Mos të të rritet mendja mbi bijtë të njerëzve, që mos të të bjerë ajo më poshtë se pluhuri!

Po qe se njerëzit të nderojnë e të respektojnë, qofsh i nderuar për mençuri dhe njerzillëk! Nëse do ta njohësh karakterin e një miku, mos pyet shokun, por rri në shoqëri me të! Bisedo me të, vëzhgoje zemrën e tij nga fjalët që thotë dhe nga veprimet që bën. Duhet të jetë e dobishme çfarë hyn në qilar, dhe gjërat, që janë prona jote, duhet t'i ndash me miq! Budallai, dijen e konsideron si injorancë, dhe gjërat fitimprurëse, budallait i duken të dëmshme. Ai jeton në vdekje. Prandaj dhe ushqehet me ushqimet e saj. Njeriu i mençur e lejon zemrën e tij të rrjedhë e të dalë nga shtrati, por e mban gojën të heshtur. O njeri, dëgjoje zërin e mençurisë, dëgjoje zërin e dritës! Ka mistere në Kozmos, që kur zbulohen, e mbushin botën me dritën e tyre. Kushdo që dëshiron të jetë i lirë nga vargonjtë e errësirës antike, le të bëjë fillimisht ndarjen e materiales prej jomateriales, të zjarrit nga toka; sepse dijeni se ashtu si toka zbret në tokë, po ashtu edhe zjarri ngjitet përpjetë tek zjarri dhe bëhet një me të. Kushdo që e njeh zjarrin që ka brenda, ai do të ngjitet tek zjarri i përjetshëm dhe do të jetojë përjetësisht në të. Zjarri, pikërisht zjarri i brendshëm, është më i fuqishmi, sepse i kalon të gjitha gjërat dhe depërton në të gjitha gjërat e Tokës. Njeriu e mbështet veten vetëm mbi atë që i reziston. Kështu Toka duhet t'i rezistojë njeriut duhet t'i rezistojë Tokës, në të kundërt ai nuk ekziston dot. Jo të gjithë sytë shohin me të njëjtin vizion, sepse njërit një objekt i duket me një formë dhe ngjyrë të caktuar, kurse një syri tjetër i duket tjetërlloj. Po kështu edhe zjarri i përjetshëm ndryshon ngjyrën dhe nuk është njësoj si një ditë dhe tjetrën. Kështu flas unë Thoti, prej mençurisë sime, sepse njeriu është një zjarr që digjet duke ndriçuar në natë; asnjëherë nuk është shuar në velin e errësirës, asnjëherë nuk është shuar nga errësira e natës. Përmes mençurisë sime pashë në zemrat e njerëzve, dhe i gjeta të burgosur nga skllavëria e konflikteve. Liroje, o vëlla, zjarrin tënd, nga mundimi! Nga frika ajo konsumohet në hijen e natës! Dëgjo o njeri dhe vere vath në vesh këtë mençuri nga goja ime: ku rreshtin së ekzistuari emri dhe forma? Vetëm në vetëdije, në të padukshmen, shndrit një forcë e pafundme rrezatimi. Format, që krijon me shkëlqimin e vizionit tënd, janë në të vërtetë pasoja që ndjekin shkakun tënd. Njeriu është një yll i kufizuar në një trup, derisa, në fund, të çlirohet nëpërmjet luftës së tij të brendshme. Vetëm nëpërmjet përpjekjeve dhe duke punuar rëndë deri në maksimum, ylli brenda teje do të mund të çelë sërish në një jetë të re. Ai që njeh zanafillën e të gjitha gjërave, ylli i tij është i lirë prej mbretërisë së natës. Mbaj mend, o njeri, që,

të gjitha gjërat që ekzistojnë, janë vetëm forma tjetër e asaj që nuk ekziston. Gjithçka që ka ekzistuar po transformohet në një tjetër gjë, as ti nuk bën përjashtim. Vëzhgoje Ligjin, sepse gjithçka është Ligj. Mos kërko çfarë është jashtë Ligjit, sepse është diçka që ekziston vetëm në iluzionet e shqisave. Mençuria mbërrin tek të gjithë fëmijët e saj përderisa ata shkojnë drejt mençurisë. Drita ka mbetur e fshehur përmes të gjitha epokave. Zgjohu o njeri dhe bëhu i mençur! Kam udhëtuar thellë në misteret e jetës, duke pyetur e kërkuar të fshehtat. Më dëgjo me vëmendje o njeri, dhe bëhu i mençur! Larg, nën koren e tokës, në Sallat e Ament-it, pashë mistere që iu janë fshehur njerëzve. Kam udhëtuar shpesh në shtegun e thellë të panjohur, kam parë Dritën që është Jeta mes njerëzve. Atje, poshtë Lules së Jetës që jeton gjithmonë, unë kërkova zemrat dhe sekretet e njerëzve. Atje zbulova se njeriu po rritet, por ai jeton në errësirë; dhe drita e zjarrit të madh fshihet në brendësi. Përpara Zotave të Ament-it të fshehtë, unë mësova mençurinë që ua solla njerëzve. Ata janë Zotat e Mençurisë Sekrete të madhe, sjellë prej një të ardhme të pafundme. Shtatë janë ata, Zotat e Ament-it, mbizota supremë të Bijve të Mëngjesit, Diej të Cikleve, Zotër të Mençurisë. Ata nuk janë si bijtë e njerëzve. Tre, Katër, Pesë, dhe Gjashtë, Shtatë, Tetë, Nëntë janë titujt e Zotave të njerëzve. Nga e ardhmja e largët, pa formë, e megjithatë të formuar, erdhën ata si mësues për bijtë e njerëzve.

Ata jetojnë përgjithmonë e megjithatë nuk janë të gjallë, jo të lidhur me jetën dhe në çdo rast të lirë nga vdekja. Ata mbretërojnë përgjithmonë me mençuri të pafund, të kufizuar e megjithatë të lirë prej Sallave të errëta të Vdekjes. Ata kanë Jetë në veten e tyre, e megjithatë është një jetë që nuk është jetë, të lirë nga gjithçka janë Zotat e së Gjithës. Prej tyre rrjedhin Logos-et, mjetet e tyre të pushtetit mbi gjithçka. E pamatë është shprehja e tyre, e megjithatë fshihet në vogëlsi, formuar prej një forme, të njohur, e megjithatë të panjohur.

Treshi ka çelësin e të gjithë magjisë së fshehtë, ai është krijuesi i sallave të të Vdekurve; duke e shtrirë pushtetin përpara, duke e mbështjellë me errësirë në qefin, duke lidhur shpirtrat e bijve të njerëzve; duke dërguar errësirën, duke lidhur forcën e shpirtit; administrator i negatives tek bijtë e njerëzve. **Katra** është ai që shpërndan fuqinë. Ai, Zot i Jetës për bijtë e njerëzve. Prej Drite është trupi i tij, prej flake është shprehja e tij; çlirimtar i shpirtrave të bijve të njerëzve. **Pesa** është mjeshtri, Zot i të gjithë magjisë - Çelës i Fjalës që jehon mes njerëzve. **Gjashta** është Zot i Dritës, shtegu i fshehtë, rrugëtimi i shpirtrave të bijve të njerëzve. **Shtata** është Zot i pafundësisë, mjeshtër i Hapësirës dhe çelës i Kohëve. **Teta** është ai që urdhëron evolucionin; peshon dhe ekuilibron udhëtimin e njerëzve. **Nënta** është ati, e pamatë është shprehja e tij, duke formuar e duke ndryshuar nga jashtë të paformën.

Meditoni mbi simbolet që po ju jap! Ato janë Çelësa edhe pse iu janë fshehur njerëzve. Mbërri gjithmonë e më lart, o Shpirt i mëngjesit! Drejtoji

lart mendimet e tua, lart për tek Drita dhe për tek Jeta! Në çelësat gjej numrat që po të jap, dritë në shtegun e jetës drejt jetës. Kërko me mençuri! Drejtoji për në brendësi mendimet e tua! Mos e mbyll mendjen para Lules së Dritës! Vendos në trupin tënd një imazh të formë- mendimit! Mendo për numrat që do të të çojnë tek Jeta! E qartë është udha për atë që ka mençuri. Hapja portën Mbretërisë së Dritës! Shpërndaje flakën tënde si një Diell i mëngjesit!

Lëre jashtë errësirën dhe jeto në ditën! Merri këta, o njeri, si pjesë të qënies tënde, Të Shtatët që janë por jo ashtu siç duken. Hape veten, o njeri! Ke mençurinë time. Ndiqe rrugën në mënyrën që të tregova! Zota të Mençurisë, Diej të Mëngjesit, Dritë dhe Jetë për bijtë e njerëzve.

PLLAKA IV:
I LINDUR NË HAPËSIRË

Dëgjoje, o njeri, zërin e mençurisë, kushtoji vëmendje zërit të Thotit, Atlantidasit! Lirisht ta jap ty mençurinë time, mbledhur në kohën dhe në hapësirën e këtij cikli; zot i mistereve, Diell i mëngjesit, që jeton përgjithmonë, një bir i Dritës që shkëlqen ndritshëm, yll i mëngjesit, Thoti, mësuesi i njerëzve, është i të Gjithëve.

Shumë kohë më parë, në fëmijërinë time, shtrihesha poshtë yjeve në, tashmë prej kohësh, Atlantidën e përmbytur, duke ëndërruar misteret tepër lart mbi njerëzit. Pastaj në zemrën time u rrit një dëshirë e zjarrtë për të ndjekur shtegun që të çon tek yjet. Vit pas viti kërkova mençuri dhe dije të re, duke ndjekur shtegun, derisa, më në fund, Shpirti im, në cfilitje të madhe, këputi skllavërinë e tij dhe u çlirua prej vargonjve. Unë isha i lirë nga skllavëria e tokës së njerëzve. I lirë nga trupi, vetëtiva në natë. Më në fund për mua ishte hapur hapësira yjore. U lirova nga robëria e natës. Në fund të hapësirës kërkova mençurinë, larg, përtej dijes së kufizuar të njerëzve. Shpirti im udhëtoi lirisht, larg, në hapësirë, në rrethin e pafundëm të dritës. Të pazakonshëm, përtej dijes, ishin disa prej planeteve, të mëdhenj dhe gjigandë përtej ëndrrave të njerëzve. Atëherë unë gjeta Ligjin, në gjithë bukurinë e tij, që punon nëpërmjet dhe midis tyre, njësoj si këtu mes njerëzve. Shpirti im vetëtiu përpara përmes bukurisë së pafundme, me mendimet e mia fluturova larg përmes hapësirës. U çlodha atje mbi një planet bukurie. Melodi harmonike mbushnin gjithë ajrin. Kishte forma që lëviznin në Rregull, të mëdha dhe mjeshtërore si yjet e natës; duke u rritur në harmoni, një ekuilibër i rregulluar, simbole të Kozmosit, ashtu si Ligji. Të shumta janë yjet që kalova në udhëtimin tim, të shumta racat e njerëzve në botët e tyre; disa që zhvilloheshin drejt lartësimit si yjet e mëngjesit, të tjerë që rrëzoheshin poshtë në errësirën e natës.

Secili prej tyre dhe të gjithë së bashku duke u përpjetur për t'u ngjitur lart, duke fituar lartësitë dhe duke matur thellësitë, duke lëvizur, me raste, në mbretëritë e përndritjes, duke jetuar përmes errësirës, duke fituar Dritën. Dije, o njeri, se ajo Dritë është trashëgimia jote! Dije se errësira është vetëm një perde! Vulosur në zemrën tënde është shkëlqimi i përjetshëm që pret momentin të fitojë lirinë, duke pritur të grisi velin e natës.

Gjeta disa që kishin fituar eterin. Ata ishin të lirë nga hapësira ndërsa ishin akoma njerëz. Duke përdorur fuqinë, që është themeli i të Gjitha gjërave, larg në hapësirë ata ndërtuan një planet, tërhequr nga forca që rrjedh përmes Gjithësisë; duke kondensuar, duke kombinuar eterin në forma që rriteshin sipas dëshirës së tyre. Në shkencë, ata ua kalonin të gjitha racave, ata, bijtë e yjeve, të fuqishëm në mençuri. Për një kohë të gjatë ndalova, duke studiuar mençurinë e tyre. I pashë të krijonin, prej nga eteri, qytete gjigande të kuqe dhe të arta. Të formuara nga elementi fillestar bazë e të gjithë materies, eteri projektohej larg. Në një të shkuar të largët, ata e kishin fituar eterin, liruan vetveten nga robëria e mundimit; formonin vetëm një imazh në mendjen e tyre, dhe, me shpejtësi e krijonin, e ajo rritej.

Më pas, shpirti im përparoi me shpejtësi përmes gjithë Kozmosit, duke parë gjëra të papara ndonjëherë, gjëra të reja dhe të vjetra; duke mësuar se njeriu është me të vërtetë i lindur në hapësirë, një Diell i Diellit, një bir i yjeve. Dije, o njeri, se në çfarëdo trupi që jeton ti, sigurisht që je një me yjet! Trupat tuaj nuk janë gjë tjetër veçse planetë që rrotullohen rreth diejve të tyre qëndrorë. Kur të kesh fituar dritën e gjithë mençurisë, do të jesh i lirë të shkëlqesh në eter, një nga Diejt që ndriçojnë errësirën e jashtme – një qënie i lindur në hapësirë dhe i rritur në Dritë. Pikërisht si yjet, që me kalimin e kohës, humbasin shkëlqimin e tyre dhe drita kalon prej tyre tek burimi i madh, po kështu, o njeri, edhe shpirti yt përparon duke lënë pas errësirën e natës. Je formuar nga eteri fillestar, je i mbushur me shkëlqimin që rrjedh nga burimi, i kufizuar nga eteri i pranishëm përreth, e megjithatë gjithmonë flakëron, derisa, më në fund, të jesh i lirë. Çliroje flakën tënde nga errësira, fluturo jashtë natës, dhe do të jesh i lirë!

Unë udhëtova përmes hapësirë-kohës, duke ditur se, më në fund, shpirti im ishte i lirë, duke ditur që tani do të mund të kërkoj të arrij mençurinë. Derisa, më në fund, kalova në një plan, të fshehur nga dija, të panjohur për mençurinë, që shtrihej përtej gjithë çfarë njohim ne. Kur pata këtë dije o njeri, shpirti im u rrit i lumtur, sepse tani isha i lirë. Dëgjo ti, i lindur në hapësirë, dëgjo me vëmendje mençurinë time; ju nuk e dini se edhe ju do të jeni të lirë. Vëre vath në vesh mençurinë time, o njeri, sepse duke më dëgjuar, edhe ti do të mund të jetosh i lirë. Ti, tokësor, nuk je bir i tokës, por je bir i Dritës Kozmike të Pafundme. Nuk di ti o njeri për trashëgiminë tënde? Nuk e di që je në të vërtetë Dritë? Diell i Diellit të Madh, kur ti të përvetësosh mençuri, do të jesh me të vërtetë i vetëdijshëm për farefisninë tënde me Dritën. Tani ty ta jap dijen, mundësinë për të ecur

në rrugën që kam shkelur unë, dhe do të të tregoj me të vërtetë se si, me përpjekjet e mia, kam ecur në shtegun që çon tek yjet. Dëgjo o njeri, dhe njihe skllavërinë tënde, mëso si të çlirohesh nga kjo barrë! Duhet të ngrihesh jashtë nga errësira, dhe të jesh një me Dritën dhe një me yjet. Ndiq gjithmonë udhën e mençurisë! Vetëm në këtë mënyrë ti do të mund të ngrihesh nga poshtë. Fati i njeriut të shtyn gjithmonë përpara në lakoret e Gjithësisë së Pafund. Dije o njeri se e gjithë hapësira është e disiplinuar. Vetëm përmes Rregullit mund të jesh Një me Gjithësinë. Rregulli dhe Ekuilibri janë Ligji i Kozmosit. Ndiqi dhe do të jesh Një me Gjithësinë! Ai që ndjek rrugën e mençurisë, duhet të jetë i hapur për lulen e jetës dhe duhet ta shtrijë vetëdijen e vet jashtë errësirës, për të rrjedhur në Gjithësi nëpërmjet kohës dhe hapësirës. Duhet të pushosh në heshtjen e thellë, e duhet të presësh, derisa, më në fund, të jesh i lirë nga dëshira, i lirë nga dëshira e zjarrtë për të folur në heshtje. Pushto, nëpërmjet heshtjes, robërinë për të folur! Përmbaju të ngrënës, derisa ta kesh dominuar dëshirën për ushqimin, që është robëri e shpirtit. Pastaj dergju në errësirë! Mbylli sytë e tu në rrezet e Dritës! Forcën tënde jetësore përqëndroje në vetëdijen tënde, duke e çliruar nga lidhjet e natës! Në mendjen tënde vendos imazhin e dëshirës tënde!

Vizualizo vendin që ti dëshiron të shohësh! Vibro para e mbrapa me fuqinë tënde! Zgjidhe shpirtin tënd nga nata e vet! Në mënyrë energjike duhet të lëkundesh me gjithë forcën, derisa, më në fund, shpirti yt të jetë i lirë. Madhështore, përtej fjalëve, është flaka e Kozmosit, shtrihet në plane të panjohura për njeriun; e fuqishme dhe e ekuilibruar, duke lëvizur në Rregull, muzikë harmonish, larg përtej njeriut. Duke folur me muzikë, duke kënduar me ngjyrat, flakëron që nga fillimi i Gjithësisë së Përjetshme. Ju jeni shkëndija të flakës, o fëmijët e mi, duke u djegur me ngjyrat dhe duke jetuar me muzikën. Dëgjoje zërin dhe do të jesh i lirë! Vetëdija e lirë shkrihet me Kozmosin, Një me Rregullin dhe me Ligjin e Gjithësisë. Nuk e ke ditur, o njeri, që Drita do të shkëlqejë jashtë errësirës, drita do të flakërojë përpara, një simbol i Gjithësisë. Recitoje këtë lutje për të arritur mençurinë! Lutu për ardhjen e Dritës tek Gjithësia!

Shpirt i fuqishëm i Dritës, që shkëlqen përmes Kozmosit, tërhiqe flakën time më pranë harmonisë tënde! Ngrije lart zjarrin tim, jashtë errësirës, magnet i zjarrit që është Një me Gjithësinë! Ngrije lart shpirtin tim ti, Bir i fuqishëm dhe i pushtetshëm. Bir i Dritës, mos u largo! Më tërhiq në mënyrë që unë të kem fuqi të shkrihem në furrën tënde; Një me të gjitha gjërat dhe të gjitha gjërat në Një, zjarr i tendosjes së jetës dhe Një me Trurin.

Kur ti ta kesh çliruar shpirtin tënd nga skllavëria e tij, dije se, për ty, është zhdukur errësira. Gjithmonë përmes hapësirës ti mund të kërkosh mençuri, jo më i kufizuar nga zinxhirët e farkëtuara në mish. Do të lëvizësh përpara dhe lart në mëngjes, si një flakëronjës i lirë, o Shpirt, për në

mbretëritë e Dritës! Lëviz ti në Rregull, lëviz ti në Harmoni, lirisht ti do të lëvizësh me Bijtë e Dritës. Kërko dhe njihe ti Çelësin tim të Mençurisë! Në këtë mënyrë, o njeri, ti, sigurisht që do të jesh i lirë.

PLLAKA V:
BANORI I UNDAL-it

Shpesh unë ëndërroj Atlantidën e varrosur, e humbur në kohërat që kanë kaluar në errësirë. Për shekuj me radhë ti ekzistove në bukuri, një dritë që shkëlqente në errësirën e natës. E fuqishme në pushtetin tënd, qeverise ti të lindurit e tokës, Zot i Tokës në kohët e arta të Atlantidës. Mbret i kombeve, zot i mençurisë, Dritë që shkëlqen përmes Suntal, rojtar i shtegut, banonte në Tempullin e tij, Padroni i Undal-it, Dritë e Tokës në kohët e Atlantidës. Zot, Ai, nga një cikël përtej nesh, duke jetuar në trupa si një midis njerëzve. Nuk ishte si i lindur nga toka, Ai nga përtej nesh, Diell i një cikli shumë më të përparuar se i njerëzve. Dije, o njeri, se Horlet, Padroni, nuk ishte kurrë një bir i njerëzve. Larg, në të shkuarën, kur Atlantida filloi të rritej në fuqi, u shfaq dikush me Çelësin e Mençurisë dhe u tregoi të gjithëve shtegun e Dritës. Ai u tregoi të gjithë njerëzve rrugën e arritjes së qëllimit, rrugën në të cilën Drita rrjedh mes njerëzve. E sundonte errësirën, duke e udhëhequr Shpirtin Njerëzor drejt lartësive që ishin Një me Dritën. Ai i ndau mbretëritë në pjesë. Dhjetë ishin ato, e qeveriseshin prej bijve të njeriut. Mbi një tjetër (mbretëri), Ai ndërtoi një Tempull, por jo të ndërtuar nga bijtë e njerëzve. Nga Eteri e thirri Ai lëndën e tij, modeloi dhe formoi format që Ai i ndërtoi me mendjen e Tij përmes fuqisë së Ytolan-it. Qoshe më qoshe e mbuloi ishullin, pëllëmbë më pëllëmbë u rrit në fuqinë e vet. I errët, por jo i zi, por i errët si hapësirë-koha, i thellë në zemrën e tij është Esenca e Dritës. Me shpejtësi Tempulli u rrit në formën e vet, modeluar dhe formuar nga Fjala e Banorit, e thirrur në formë nga e paforma. Pastaj Ai ndërtoi, brenda saj, dhoma të mëdha, i mbushi me forma të evokuara nga Eteri, i mbushi me mençurinë e evokuar nga mendja e Tij. Brenda në Tempullin e tij, Ai ishte pa formë, prapëseprapë Ai u formua në imazhin e njeriut. Banonte mes tyre, e megjithatë nuk ishte i ngjashëm, por ishte i veçantë dhe shumë i ndryshëm nga bijtë e njerëzve.

Atëherë Ai zgjodhi, midis njerëzve, Tre që u bënë lajmëtarët e tij. Ai zgjodhi Tre ndër më të Zhvilluarit, në mënyrë që të bëheshin ndërlidhësit e tij me Atlantidën. Ata ishin Lajmëtarët që kështillën e tij ua përcillnin mbretërve të njerëzve. Ai mori të tjerë dhe u mësoi atyre mençurinë; mësues, ata, për bijtë e njerëzve. Ai i vendosi ata në ishullin e Undal-it, për t'i bërë mësues të Dritës për njerëzit. Secili prej atyre që u zgjodh në këtë mënyrë, iu desh të mësonte për pesëmbëdhjetë vjet. Vetëm në këtë mënyrë ai do të mund ta kuptonte dijen për t'u sjellë Dritën bijve të njerëzve. Në këtë mënyrë u ndërtua Tempulli, një vendbanim për Zotin e njerëzve.

Unë, Thoti, gjithmonë e kam kërkuar mençurinë, e kam kërkuar në errësirë dhe e kam kërkuar në Dritë. I etur në rininë time, udhëtova gjatë shtegut duke u përpjekur të fitoja dije të re. Derisa, pas shumë përpjekjesh, njëri pre j të Tre më solli Dritën. Ai më solli urdhëresat e Banorit, më thirri nga errësira në Dritë. Ai më solli përpara Banorit në thellësi të Tempullit, përpara Zjarrit të madh. Atje, mbi fronin e madh, unë pashë Banorin veshur me Dritë dhe duke shkëlqyer me zjarr. Unë u gjunjëzova përballë kësaj mençurie të madhe dhe ndjeva valë Drite që rridhnin përmes meje. Pastaj dëgjova zërin e Banorit:

"O errësirë, hyr në Dritë! Për një kohë të gjatë ti ke kërkuar rrugën e Dritës. Çdo shpirt që liron zinxhirët e vet mbi tokë, së shpejti do të çlirohet nga robëria e natës. Jashtë errësirës ti u ngrite lart, dhe më pranë iu afrove Dritës së qëllimit tënd. Këtu ti do të trajtohesh si njëri prej bijve të mi, rojtar i dokumentave të mbledhura prej mençurisë, vegël ti e Dritës së largët. Je i gatshëm për të bërë atë që është e nevojshme, mbrojtës i mençurisë përmes epokave të errësirës që shpejt do të bien mbi bijtë e njerëzve. Jeto këtu dhe shuaje etjen, pi nga e gjithë mençuria! Sekretet dhe misteret do të të zbulohen. "

Pastaj unë iu përgjigja Padronit të Cikleve duke i thënë:

"O Dritë që zbrite mes njerëzve, ma jep mençurinë tënde, në mënyrë që të mund të jem një mësues i njerëzve. Ma jep Dritën tënde, me qëllim që të mund të jem i lirë!"

Pastaj sërish më foli Zoti:

"Brez pas brezi do të jetosh ti me mençurinë tënde. Po, kur dallgët e oqeanit të shkumbojnë mbi Atlantidën, do të mbash dritën, megjithëse të fshehur në errësirë, e gatshme për t'u manifestuar kur ti ta thërrasësh. Tani shko dhe mëso mençuri më të madhe! Rritu përmes Dritës së Gjithësisë së pafund!"

Për një kohë të gjatë unë banova në Tempullin e Banorit, derisa, më në fund, u bëra Një me Dritën. Pastaj unë ndoqa rrugën për në planet yjore, dhe vazhdova rrugëtimin drejt Dritës. Thellë në zemrën e Tokës ndoqa shtegun, mësova sekretet, si poshtë ashtu edhe lart; mësova shtegun për tek Sallat e Ament-it; duke mësuar Ligjin që ekuilibron botën. Në dhomat e fshehta të Tokës depërtova prej mençurisë sime, thellë, poshtë kores së Tokës, në shtegun që prej kohërash i është fshehur bijve të njerëzve. M'u zbuluan para meje, përvetësova gjithmonë e më shumë mençuri derisa mbërrita në një dije të re: zbulova se çdo gjë është pjesë e një Gjithçkaje, e madhe dhe gjithmonë e më e madhe se ajo që të gjithë ne njohim. Kërkova zemrën e Përjetësisë përmes të gjitha kohërave. Thellë e më thellë unë gjeta gjithmonë e më shumë mistere. Tani, duke parë mbrapa, përmes kohërave, unë di se mençuria është e pakufizuar, rritet gjithmonë e më e madhe në të gjitha kohët, Një me Përjetësinë dhe më e madhe se gjithçka.

Kishte Dritë në Atlantidën e lashtë. Po, por edhe errësira ishte e fshehur në gjithësinë. Disa, midis njerëzve që kishin arritur lart, ranë nga Drita në errësirë. Ata u bënë krenarë për shkak të dijes së tyre, krenarë për pozitën e tyre mes njerëzve. Ata gërmuan thellë në të ndaluarën, hapën portëkalimin që çon poshtë. Kërkuan të fitonin më shumë dije, por kërkuan ta sillnin nga poshtë. Ai që zbret poshtë duhet të ketë ekuilibër, përndryshe kapet për shkak të mungesës së Dritës sonë. Ata, pastaj, hapën përmes dijes së tyre shtigje që u janë ndaluar njerëzve. Por në Tempullin e Tij, prej nga sheh gjithçka, Banori, ish sistemuar në AGWANTI-in e tij, ndërsa përmes Atlantidës shpirti i Tij bridhte lirisht. Ai pa Atlantidasit që, me magjinë e tyre, hapën portëkalimin që do t'i sillte Tokës një vuajtje të madhe. Me shpejtësi u arratis shpirti i Tij, u kthye tek trupi i Tij. Ai u ngrit nga AGWANTI i Tij. Thirri pranë Tij Tre lajmëtarët e fuqishëm. U dha atyre urdhëra që tronditën botën.

Me shpejtësi zbriti Banori, thellë poshtë kores së Tokës për në Sallat e Ament-it. Pastaj, kërkoi që Shtatë Zotat të zotëronin fuqitë; ndryshoi ekuilibrin e Tokës. Atlantida u fundos poshtë valëve të errëta. Shkatërruan portëkalimin që ishte hapur; shkatërruan hyrjekalimin që të çonte poshtë. Të gjithë ishujt u shkatërruan me përjashtim të Undal-it, dhe një pjese të ishullit të bijve të Banorit. Ai i shpëtoi ata në mënyrë që të mund të ishin mësuesit, Drita në rrugën për ata që do të vinin më vonë, Drita për bijtë e vegjël të njerëzve. Ai, pastaj më thirri mua, Thot-in, para tij dhe më dha urdhëra për çfarë do të duhej të bëja, duke më thënë:

"Merre ti, o Thot, gjithë mençurinë tënde! Merri të gjitha dëshmitë e tua! Merre të gjithë magjinë tënde! Shko përpara si një mësues i njerëzve! Shko ti të ruash të pandryshuara dijet, derisa, me kalimin e kohës, Drita të rritet mes njerëzve. Ti do të jesh Drita përmes shekujve, i fshehur, megjithatë do të gjendesh nga njerëzit e ndriçuar. Mbi të gjithë Tokën, Ne të japim ty pushtetin, lirisht ta japësh apo tua heqësh. Mblidhi tani bijtë e Atlantidës! Merri me vete dhe arratisu drejt njerëzve të shpellave! Fluturo për tek toka e Bijve të Khem-it!"

Atëherë mblodha bijtë e Atlantidës. Në anijen hapësinore mora të gjitha dokumentat e mia, dhe ato të Atlantidës së mbytur. Mblodha të gjitha fuqitë e mia, mjete të shumë magjish të fuqishme. Atëherë u ngritëm mbi krahët e mëngjesit. Lart ne u ngritëm, mbi Tempullin, duke lënë pas të Tre dhe Banorin, thellë në Sallat poshtë Tempullit. Atje, poshtë dallgëve, u fundos Tempulli i madh duke mbyllur shtegun për tek Zotat e Cikleve. E megjithatë, kush do të ketë njohuri, do të mund ta hapë shtegun për tek Amenti. Me shpejtësi ne u arratisëm mbi krahët e mëngjesit, u arratisëm për tek toka e Bijve të Khem-it. Atje, me fuqinë time, i mposhta dhe i qeverisa. Bijtë e Khem-it i bëra të lindin në Dritë. Thellë, poshtë shkëmbinjve groposa anijen time hapësinore, duke pritur kohën kur njeriu do mund të jetë i lirë. Mbi anijen hapësinore ngrita një emblemë në formën

e një luani edhe pse të ngjashëm me njeriun (Sfinksi – hamendësimi im). Atje, poshtë atij imazhi qëndron ende anija ime hapësinore, gati për t'u marrë kur të lindë nevoja. Dije, o njeri, që larg në të ardhmen, pushtues do të vijnë nga thellësitë. Prandaj zgjohu ti që ke mençurinë!

Merre anijen time dhe fito qetësisht! Thellë poshtë imazhit ndodhet sekreti im. Kërko dhe gjej në piramidën që ndërtova. Njëra me tjetrën, ky është Gurçelësi; secila është portëkalimi që çon tek Jeta. Ndiq Çelësin që kam lënë pas meje! Kërko dhe rrugëkalimi për tek Jeta do të jetë i yti! Kërko ti në piramidën time, thellë në kalimin që mbaron në një mur! Përdor Çelësin e Shtatës, dhe do të të hapet kalimi, do të ulet për poshtë. Tani ta dhashë mençurinë time. Tani ty ta dhashë mënyrën time të veprimit. Ndiq shtegun! Zgjidhe sekretin tim! Ty ta kam treguar mënyrën.

PLLAKA VI:
ÇELËSI I MAGJISË

O njeri, dëgjo mençurinë e magjisë! Dëgjo dijen e fuqive të harruara! Shumë kohë më parë, në ditët e njerëzve të parë, filloi lufta midis errësirës dhe dritës. Njerëzit, në atë kohë, ashtu siç ndodh edhe sot, u mbushën me errësirë dhe me dritë; e ndërsa disa u prirën drejt errësirës, disa të tjerëve, drita u mbushi shpirtin. Po, është shumë e lashtë kjo luftë, beteja e përjetshme midis dritës dhe errësirës. Ashpër është luftuar përgjatë epokave, duke përdorur fuqi jo të zakonshme, të panjohura nga njeriu. Ekspertë u mbushën me errësirë, duke luftuar gjithmonë kundër dritës; por të tjerë, të mbushur me ndriçim, gjithmonë e kanë nënshtruar errësirën e natës. Kushdo qofsh ti në çfarëdo epoke apo plani ekzistence, është e sigurt që ke dëgjuar për betejën me natën. Shumë kohë më parë, Diejt e Mëngjesit zbritën duke e gjetur botën të mbushur me natë. Atje, në atë kohë të largët, filloi lufta, epoka e lashtë e Betejës midis Errësirës dhe Dritës. Të shumtë në atë kohë u mbushën me errësirë dhe drita ndriçoi shumë e zbehtë në natë. Disa nga padronët e errësirës u përpoqën ta mbulonin gjithçka me errësirën e tyre; u përpoqën të joshnin të tjerë në natën e tyre. Rezistuan trimërisht padronët e dritës: trimërisht e luftuan errësirën e natës. Zotat e territ u përpoqën të shtrëngonin gjithmonë e më shumë prangat e zinxhirët që i lidhin njerëzit me errësirën e natës. Ata gjithmonë përdorën magjinë e zezë, sjellë midis njerëzve nga pushteti i errësirës, magji që e mbështjell shpirtin e njeriut në qefinin e errësirës. Të mbledhur së bashku si në një urdhër, Vëllezërit e Errësirës, ata, përgjatë epokave, kundërshtarë të bijve të njerëzve. Ecën gjithmonë në fshehtësi dhe të panjohur, të gjetshëm, e prapëseprapë të pagjetur prej bijve të njerëzve. Ata gjithmonë ecën dhe punuan në errësirë, duke u fshehur prej dritës, në errësirën e natës. Në heshtje, në mënyrë sekrete e përdorën ata pushtetin e tyre, duke i robëruar dhe duke i lidhur shpirtrat e njerëzve. Të

padukshëm ata vijnë, dhe të padukshëm ata shkojnë. Njeriu, me injorancën e vet, i thërret Ata nga poshtë. E errët është mënyra në të cilën udhëtojnë Vëllezërit e Errët, të errët, mbushur me errësirë, jo me errësirën e natës, duke udhëtuar mbi Tokë, ata depërtojnë nëpër ëndrrat e njerëzve. Ata kanë fituar fuqi nga errësira përreth tyre për të thirrur banorë të tjerë nga jashtë planit të tyre të ekzistencës, në mënyra që janë të errët dhe të padukshëm për njerëzit. Vëllezërit e Errët hyjnë në hapësirën mendore të njeriut. Rreth saj ata hedhin velin e natës së tyre. Atje, gjatë gjithë jetës së vet tokësore, ai shpirt jeton në robëri, i kufizuar nga zinxhirët e velit të natës. Ata janë të fuqishëm në dijen e ndaluar. Quhet e ndaluar sepse është një me natën. Dëgjo, o njeri i vjetër, dhe kije parasysh paralajmërimin tim: çlirohu nga skllavëria e natës! Shpirtin tënd mos ua dorëzo Vëllezërve të Errësirës! Mbaje gjithmonë fytyrën të kthyer nga Drita! A nuk e di, o njeri, që, trishtimi yt, vjen vetëm nga Veli i natës? Po, o njeri, veri veshin paralajmërimit tim: gjithmonë përqëndrohu drejt lartësimit, drejtoje shpirtin tënd për tek Drita! Vëllezërit e errësirës zgjedhin si vëllezër të tyre ata që udhëtuan në shtegun e Dritës. Sepse ata e dinë mirë që kush ka udhëtuar larg drejt Diellit në udhëtimin drejt Dritës, ka një fuqi gjithmonë e më të madhe për t'i lidhur me errësirë bijtë e Dritës. Bëj kujdes o njeri, ndaj atij që vjen tek ti! Peshoji me kujdes nëse fjalët e tij janë të Dritës! Sepse janë të shumtë ata që ecin në Dritën e Errët, por nuk janë bijtë e Dritës. Është e lehtë të ndjekësh shtegun e tyre, është e lehtë të ndjekësh rrugën ku ecin ata. Edhe njëherë të kërkoj t'i vësh veshin paralajmërimit tim: Drita i vjen vetëm atij që mundohet. E vështirë është rruga që shpie tek Mençuria, e vështirë është rruga që shpie tek Drita. Të shumta janë pengesat që do të gjesh në rrugën tënde: të shumta janë malet për t'i ngjitur drejt Dritës. E megjithatë dije, o njeri, se ai që do t'ia dalë mbanë t'i kalojë, i lirë do të jetë në rrugën e Dritës. Mos i ndiq kurrë Vëllezërit e Errët! Qofsh gjithmonë një Bir i Dritës! Sepse duhet ta dish, o njeri, se drita, në Fund, do të fitojë, dhe errësira e nata do të dëbohen nga Drita. Dëgjo, o njeri, dhe kushtoji vëmendje kësaj mençurie; si errësira ashtu është edhe Drita. Kur errësira të dëbohet dhe të gjitha perdet të grisen, jashtë, prej errësirës do të vetëtijë Drita.

Ashtu si midis njerëzve ekzistojnë Vëllezërit e Errët, po kështu, atje, ekzistojnë Vëllezërit e Dritës. Këta janë kundërshtarë të Vëllezërve të Errësirës, duke u përpjekur t'i çlirojnë njerëzit nga nata. Pushtet kanë ata, janë të fuqishëm dhe të pushtetshëm. Duke njohur Ligjin, planetet iu binden. Ata punojnë gjithmonë në harmoni dhe rregull, duke e çliruar shpirtin e njeriut nga skllavëria e natës. Sekrete dhe të panjohura janë edhe rrugët e tyre. Ata janë të panjohur nga bijtë e njerëzve. Ata gjithmonë kanë luftuar kundër Vëllezërve të Errët, duke pushtuar kohën e pafund. Sërish, dhe gjithmonë, Drita do të triumfojë në fund, dhe do të flakë tutje errësirën e natës. Po, o njeri, mësoje edhe këtë: gjithmonë pranë jush ecin Bijtë e

Dritës. Ata janë Zota të fuqisë së Diellit, mbrojtës gjithmonë të padukshëm të njerëzve. E hapur për këdo është rruga e tyre, e hapur për këdo që do të ecë në Dritë. Ata janë të lirë nga Amenti i Errët, të lirë nga Sallat ku Jeta mbretëron absolute. Ata janë Diej dhe Zota të mëngjesit, Bij të Dritës për të ndriçuar mes njerëzve. Ata janë si njeriu, e megjithatë të ndryshëm prej tij. Në të shkuarën, ata nuk ishin kurrë të ndarë. Ata kanë qënë Një me Unitetin e përjetshëm, në të gjithë hapësirën, qysh prej fillimit të kohës. Ata ndodheshin lart të bashkuar me Një të Gjithën, të prejardhur nga hapësira e parë e formuar dhe e paformuar. Ata u kanë dhënë njerëzve sekrete që do t'i mbrojnë nga çdo e keqe. Kushdo që do të udhëtojë në shtegun e mjeshtrit, do të mund të jetë i lirë nga skllavëria e natës. Ai duhet ta mposhtë të paformën dhe të patrajtën, ai duhet ta mposhtë fantazmën e frikës. Duke patur dijen, ai do të mund të arrijë të gjitha sekretet, e të udhëtojë nëpër shtegun përmes errësirës, duke mbajtur gjithmonë para vetes dritën e qëllimit të tij. Ai do të ndeshë pengesa të mëdha në rrugën e tij, por megjithatë këmbëngul në Dritën e Diellit. Dëgjo, o njeri, Dielli është simboli i Dritës që shkëlqen në fund të rrugës tënde. Tani po të zbuloj sekretin: si t'i afrohesh pushtetit të errët, si të ndeshesh dhe ta mposhtësh frikën prej natës. Vetëm nëpërmjet dijes do të mund të fitosh, vetëm përmes dijes do të mund ta kesh Dritën.

Tani po të jap dijen që njohin Zotat, dijen që mposht të gjitha frikat e errëta. Përdore mençurinë që po ta jap. Ti do të sundosh mbi Vëllezërit e Natës.

Kur të provosh një ndjesi që të shpie më afër portës së errët, ekzamino zemrën tënde dhe zbulo nëse ndjesia të ka ardhur nga brenda. Nëse do të gjesh errësirë në mendimet e tua, dëboji ato nga mendja jote. Nëpermjet trupit tënd dërgo një valë vibrimi, në fillim të çrregullt, e pastaj të rregullt duke e përsëritur herë pas here deri sa të jesh i lirë. Në Qendrën e Trurit tënd filloje Forcën e Valës! Drejtoje në valë nga koka jote deri tek këmbët e tua! Por, nëse zbulon që zemra jote nuk është e errësuar, dije me siguri që një forcë e jashtme të ka vënë në shënjestër. Vetëm përmes dijes do të mund ta kapërcesh. Vetëm duke qënë i mençur mund të shpresosh të jesh i lirë. Dija sjell mençuri dhe mençuria është fuqi. Përvetësoje dhe do të kesh pushtet mbi gjithçka! Pikësëpari, kërko një vend të kufizuar nga errësira. Vendos një rreth përqark teje! Qëndro më këmbë në mes të rrethit! Përdore këtë formulë, dhe do të jesh i lirë! Ngriji duart e tua mbi hapësirën e errët rrotull teje! Mbylli sytë dhe tërhiqu në Dritë! Thirr Shpirtin e Dritës, përmes Hapësirë-Kohës, duke përdorur këto fjalë dhe ti do të jesh i lirë:

"Mbushe trupin tim, o Shpirt i Jetës, mbushe trupin tim me Shpirtin e Dritës! Eja prej Lules që shkëlqen nëpër errësirë! Eja prej Sallave ku Shtatë Zotat mbretërojnë! Të Shtatët unë i thërras me emër: Tre, Katër, Pesë, dhe Gjashtë, Shtatë, Tetë- Nëntë. Nëpërmjet emrave të tyre i thërras të më ndihmojnë, liromëni e shpëtomëni nga errësira e natës: Untanas, Quertas, Chietal, dhe Goyana, Huertal, Semveta- Ardal.

Nëpërmjet emrave të tyre lutem, liromëni nga errësira, dhe mbushmëni me Dritë!

Dije, o njeri, se kur ti ta kesh bërë këtë, do të jesh i lirë nga vargonjtë që të lidhin, do t'i hedhësh tutje zinxhirët e vëllezërve të natës. A nuk e sheh që emrat kanë fuqinë që, përmes vibrimit, të të çlirojnë nga zinxhirët që të lidhin? Përdori kur të kesh nevojë për të liruar vëllain tënd, në mënyrë që edhe ai të mund të dalë nga nata. Ti, o njeri, ndihmoje vëllain tënd të jetë i lirë! Mos e ler atë të dergjet në skllavërinë e natës! Tani ty ta jap magjinë time! Merre dhe bano në shtegun e Dritës! Drita është brenda teje, Jeta është brenda teje, ti mund të jesh Diell në ciklin e ardhshëm.

PLLAKA VII:
SHTATË ZOTAT/ZOTËRINJTË

Dëgjo, o njeri, dhe mbaje vesh Zërin tim! Hape mendjen tënde hapësinore dhe pi nga mençuria ime! I Errët është rrugëtimi i Jetës që ti përshkon. Të shumta janë grackat që ndodhen në rrugën tënde. Kërko të përvetësosh një mençuri gjithmonë e më të madhe. Fitoje këtë njohje dhe do të ketë gjithmonë Dritë në rrugën tënde. Hapja Shpirtin tënd Kozmosit, o njeri, dhe lëre që ai të rrjedhë si një e tërë me Shpirtin tënd. Drita është e përjetshme, ndërsa errësira është e përkohshme. Ti, o njeri, kërko gjithmonë Dritën. Dije se, gjithmonë kur Drita e mbush qënien tënde, errësira së shpejti do të zhduket. Hape Shpirtin tënd për Vëllezërit e Ndritshëm! Lejoji të hyjnë tek ti e të të mbushin me Dritë! Ngrije lart shikimin tënd tek Drita e Kozmosit! Ktheje fytyrën gjithmonë për nga qëllimi! Vetëm duke fituar dritën e të gjithë mençurisë, ti do të mund të bëhesh një me qëllimin e Përjetësisë. Kërko gjithmonë Unitetin e përjetshëm! Kërko gjithmonë Dritën e qëllimit! Drita është e pafundme, dhe Drita është e fundme, e ndarë tek njeriu vetëm prej Errësirës. Kërko gjithmonë ta ngresh Velin e Errësirës! Udhëhiqu tek Drita në Një-shi! Dëgjo, o njeri, dëgjoje me vëmendje Zërin tim që këndon melodinë e Dritës dhe të Jetës! Drita është mbizotëruese në të gjithë hapësirën dhe rrethon gjithçka me simbolet e saj të flakës. Kërko gjithmonë e gjithmonë në velin e errësirës, në ndonjë vend, ti sigurisht do ta gjesh Dritën. E fshehur dhe e groposur, e humbur për dijen e njeriut, thellë në të fundmen ekziston Përjetësia. E humbur, por ekzistuese dhe e rrjedhshme të gjitha gjërat, e gjallë në Gjithçka është Mendja e Pafundme. Ka vetëm Një mençuri në të gjithë hapësirën. Edhe pse në dukje të ndarë, ndodhet Një në Një-shin. Gjithçka që ekziston del nga Drita, dhe Drita del nga Gjithçka. E gjithëçka që është krijuar bazohet në Rregull: Ligji sundon hapësirën ku banon Përjetësia. Prej ligjit të ekuilibrit erdhën ciklet e mëdhenj duke lëvizur në harmoni drejt fundit të Përjetësisë. Dije, o njeri, se larg në hapësirë e në kohë, vetë Pafundësia do të ndryshojë. Dëgjo dhe mbaje shënim Zërin e

Mençurisë: Dije se Gjithçka i përket Gjithçkaje akoma më të madhe. Dije se, përmes kohës, ti do të mund të ndjekësh gjithmonë mençurinë, dhe do të gjesh gjithmonë e më shumë Dritë në rrugën tënde. Po, me dorëzimin, ti do ta gjesh gjithmonë këtë gjë, qëllimi yt, ditë pas dite, do të të shpëtojë nga rreziku. Shumë kohë më parë, në Sallat e Ament-itt, unë, Thoti, qëndrova në këmbë para Zotave të cikleve. Të pushtetshëm Ata, në shfaqjet e tyre të fuqisë, të fuqishëm Ata në mençurinë e zbuluar. I udhëhequr nga Banori, i pashë për herë të parë. Por, më pas, unë isha i lirë të ndodhesha në prezencën e tyre, isha i lirë të hyja, në këshillin e tyre me dyer të mbyllura, kur të doja, me vullnet të lirë. Unë kam udhëtuar shpesh poshtë në shtegun e errët në Sallën ku gjithmonë shkëlqen Drita. Prej Padronëve të cikleve mësova mençurinë e sjellë prej cikleve superiore. Në thellësitë e Sallave të Errëta ndodhen Shtatë njësitë e vetëdijes të cikleve superior. Në këtë cikël manifestohen si udhërrëfyes për njeriun në njohjen e Gjithçkasë. Ata janë shtatë, të madhërishëm në fuqi, përmes meje duke u folur njerëzve këto fjalë. Kohë pas kohe qëndrova para tyre duke dëgjuar fjalë që nuk erdhën përmes tingullit. Njëherë ata më thanë:

"O njeri, a dëshiron ti të përvetësosh mençuri? Kërkoje në zemrën e flakës! A dëshiron ti të kesh njohuri si ta përvetësosh fuqinë? Kërkoje në zemrën e flakës! A dëshiron ti të jesh një me zemrën e flakës? Atëherë kërkoje në veten tënde flakën e fshehur!"

Shumë herë Ata më folën, duke më mësuar mençurinë, por jo atë të botës; duke më treguar gjithmonë rrugë të reja për tek përndritja; duke më mësuar mençurinë e sjellë nga lart. Duke më dhënë dijen si të veproj; duke më mësuar Ligjin, rregullin e Gjithësisë. Të Shtatët më folën edhe njëherë duke më thënë:

"Ne vijmë nga larg, o njeri, nga përtej kohës. Ne kemi udhëtuar nga përtej Hapësirë-Koha, po, nga vendi i fundit të së Pafundmes. Kur ti dhe vëllezërit e tu ishit të paformuar, Ne tashmë ishim formuar prej rregullit të Gjithësisë. Ne nuk jemi si njerëzit, edhe pse njëherë e një kohë edhe Ne ishim si njerëzit. Konform Ligjit, Ne u formuam jashtë Zbrazëtisë së Madhe. Sepse dije se ajo që ka formë, në të vërtetë është pa formë, duke patur formë vetëm për sytë e tu. "

Të Shtatët më folën sërish duke më thënë:

"Fëmijë i Dritës, o Thot, ti je i lirë të udhëtosh në shtegun e përndritjes drejt së lartës, deri ku, përfundimisht, Çdonjë bëhet Një. Në fillim ne u formuam sipas rendit tonë: Tre, Katër, Pesë, Gjashtë, Shtatë, Tetë-Nëntë. Dije se këto janë numrat e cikleve prej të cilave Ne zbresim deri tek njeriu. Çdonjëri këtu ka një detyrë për të përmbushur; çdonjëri këtu ka një forcë për ta kontrolluar. Dhe sërish ne jemi Një me Shpirtin e ciklit tonë. E megjithatë, Ne jemi edhe ata që kërkojnë një qëllim. Larg përtej konceptimit të njeriut, Përjetësia zgjerohet në Një diçka që është më e madhe se Gjithçka. Atje, në një kohë, që nuk është as kohë, ne Të Gjithë do të bëhemi Një me diçka më të madhe se Gjithësia. Koha dhe hapësira po

lëvizin në rrathë. Mësoje ligjin e tyre, dhe, edhe ti do të jesh i lirë. Po, do të duhet të jesh i lirë që të lëvizësh përmes cikleve – të kapërcesh rojet që banojnë tek pragu!"

Pastaj më foli Ai, i quajturi Nëntë, e tha:

"Prej shekujsh të panumërt kam ekzistuar unë, duke mos e njohur Jetën, dhe, duke mos e shijuar Vdekjen. Sepse dije, o njeri, që larg, në të ardhmen, jeta dhe vdekja do të jenë Një me Gjithësinë. Në këtë mënyrë njëra ekuilibron tjetrën, saqë asnjëra prej të dyjave nuk do të mund të ekzistojë e vetme në Unitetin e Të Gjithës. Tek njerëzit e këtij cikli, forca e jetës është e papërmbajtur, por jeta në rritjen e saj bëhet një me Gjithësinë. Unë manifestohem këtu, në këtë ciklin tënd, e megjithatë unë jam atje në kohën tënde të ardhme. Nga ana tjetër, për mua nuk ekziston koha, sepse, në botën time, koha nuk ekziston, sepse Ne jemi pa formë. Ne nuk kemi Jetë, e megjithatë ekzistojmë, më të plotë, më të mëdhenj e më të lirë se ti. Njeriu është një flakë e lidhur nga një mal, por Ne, në ciklin tone, do të jemi gjithmonë të lirë. Dije, o njeri, se kur ti të kesh avancuar në ciklin që i paraprin të sipërmes, vetë jeta do të kalojë në errësirë dhe do të mbetet vetëm esenca e Shpirtit. "

Pastaj më foli Zoti i Tetë-s e tha:

"Gjithë sa di ti, nuk është veçse një copëz e vogël. Ti as që e ke prekur shkarazi Të Madhin. Larg, në hapësirë, aty ku Drita mbretëron mbizotëruese, unë erdha në Dritë. Edhe mua më formuan, por jo siç u formove ti. Forma ime ishte prej një trupi Drite pa formë. Unë nuk e njoh Jetën, nuk e njoh as Vdekjen, gjithsesi unë jam zot i gjithçkaje që ekziston. Përpiqu të gjesh kalimin përmes barrierave! Udhëto në rrugën që çon tek Drita!"

Sërish më foli Nënta:

"Përpiqu të gjesh rrugën për përtej! Nuk është e pamundur të rritesh drejt një vetëdije më të lartë. Sepse kur Dy të bëhen Një, dhe Një të bëhet Gjithçka, dije se barriera ka rënë, dhe ti do të mund ta përshkosh lirisht rrugën. Rritu nga forma për tek e paforma! Ti mund të jesh i lirë në udhëtimin tënd. "

Kështu unë dëgjova përmes kohërave, duke mësuar rrugën për tek e Gjitha. Tani unë i ngre mendimet e mia lart tek Gjithësia. Duke mbajtur vesh dhe duke dëgjuar kur thërret.

"O Dritë që zapton çdo gjë. Një me Gjithçka dhe Gjithçka që është Një, rridh tek unë përmes kanalit! Hyr në mënyrë që të jem i lirë! Bëj që unë të jem Një me Frymën Universale duke ndriçuar në errësirën e natës! Lermë të jem i lirë në gjithë hapësirë- kohën, i lirë nga veli i natës! Unë, një fëmijë i Dritës, urdhëroj: qofsh i lirë nga errësira!"

Për Dritë-Frymën, unë jam pa formë, i paformë e megjithatë shkëlqej Dritë. Unë di se zinxhirët e errësirës duhet të copëtohen dhe të bien para Dritës. Tani unë po ta jap këtë mençuri. Mund të jesh i lirë, o njeri, duke jetuar në dritë e në përndritje. Mos e kthe fytyrën tënde larg nga Drita!

Fryma yte banon në mbretëritë e përndritjes. Ti je një bir i Dritës. Ktheji përbrenda mendimet e tua, dhe jo për jashtë! Gjeje brenda vetes Frymën tënde të Dritës! Dije se ti je Zoti! Gjithçka vjen nga brenda. Rritu në mbretëritë e përndritjes! Silli mendimet e tua drejt Dritës! Dije se ti je një me Kozmosin, je një flakë dhe një Fëmijë e Dritës. Tani po të jap një paralajmërim: mos lejo që mendimi yt të të shpërqëndrojë e të bësh hapa mbrapa! Dije se përndritja rrjedh përjetësisht përmes trupit tënd. Mos u kthe tek Ndriçimi i Errët që vjen nga Vëllezërit e Zinj! Por sytë mbaji gjithmonë me vështrimin drejt së lartës, e shpirtin mbaje të sintonizuar me Dritën! Merre këtë mençuri dhe vere vath në vesh! Dëgjoje Zërin tim dhe bindju! Ndiq shtegun e përndritjes dhe ti do të jesh Një me shtegun!

PLLAKA VIII:
ÇELËSI I MISTEREVE

Ty, o njeri, ta kam dhënë dijen time. Ty ta kam dhënë Dritën. Tani dëgjomë dhe merre mençurinë time, të cilën e kam sjellë nga planet e hapësirës që ndodhen lart dhe përtej. Unë nuk jam si një njeri, sepse unë jam i lirë nga dimensionet dhe planet e ekzistencës. Në secilin plan, unë marr një trup të ri. Në secilin plan, unë ndryshoj formën time. Tani e di se mungesa e formës është gjithë çfarë është forma. E madhe është mençuria e të Shtatëve. Të fuqishëm janë Ata të së përtejmes. Ata manifestohen nëpërmjet pushtetit të tyre, të mbushur plot e përplot nga forca që vjen nga përtej. Dëgjoji këto fjalë mençurie! Dëgjoji dhe bëji tëndet! Gjeji në të paformën! Gjej çelësin e së përtejmes! Misteri nuk është gjë tjetër veçse një dije e fshehur. Kupto dhe do të të zbulohet. Kërko mençurinë që është groposur thellë dhe bëhu zot i errësirës dhe i Dritës! Mistere të thella të rrethojnë, mistere që fshehin sekretet e Vjetra. Kërko nëpërmjet Çelësave të Mençurisë sime! Me siguri do ta gjesh rrugën. Hyrja për tek pushteti është sekrete, por kush arrin atje, do ta fitojë fuqinë. Dritën vështro! O vëlla, hape veten dhe drita do të vijë tek ti! Shtyhu përmes luginës së errësirës, kapërceje banorin e natës! Shikimin mbaje drejt Planit të Dritës, dhe do të jesh Një me Dritën! Njeriu po ndryshon në forma që nuk janë të kësaj bote. Rritet me kohën drejt të paformës, një plan i Ciklit më të lartë. Dije se ti duhet të bëhesh pa formë, para se t'i bashkohesh Dritës. Dëgjo, o njeri, zërin tim që të tregon për rrugët për tek Drita, që të tregon rrugën për tek realizimi, kur ti do të jesh Një me Dritën. Kërko misteret e zemrës së Tokës! Mëso për Ligjin që ekziston atje, që mban yjet në ekuilibër nëpërmjet forcës së mjegullave fillestare! Kërko flakën e Jetës së Tokës! Lahu në vezullimin e flakës së saj! Ndiq shtegun trecepësh derisa edhe ti të jesh një flakë! Atyre që banojnë poshtë, folu me fjalë pa tingull! Hyr në tempullin e dritës blu, dhe lahu në zjarrin e jetës së plotë!

Dije, o njeri, se ti je i përbërë, një qënie e bërë prej tokës dhe zjarrit. Lejoje flakën tënde të ndriçojë shkëlqyeshëm! Bëhu vetëm zjarr! Mençuria fshihet tek errësira. Kur të ndriçohesh nga flaka e Shpirtit, do të gjesh mençurinë dhe do të lindësh në Dritë, një Diell Drite pa formë. Kërko gjithmonë e më shumë mençuri! Gjeje në zemrën e flakës! Dije se, vetëm duke u përpjekur vazhdimisht, do të mund Drita të derdhet në mendjen tënde. Tani unë fola me mençuri. Kushtoji vëmendje Zërit tim dhe bindu! Grisi perdet e errësirës! Shkëlqe një Dritë në Udhë! Unë flas për Atlantidën e Lashtë, flas për ditët e Mbretërisë së Hijeve. Flas për ardhjen e bijve të Hijeve. Ata u evokuan nga jashtë, prej thellësish të mëdha, u evokuan nëpërmjet dijes nga njerëzit e tokës, me qëllimin për të patur pushtet më të madh. Larg, në të shkuarën, para se të ekzistonte Atlantida, kishte njerëz që hetuan errësirën, duke përdorur magjinë e zezë, duke thërritur qënie nga thellësitë e mëdha poshtë nesh. Në këtë mënyrë ata erdhën në këtë cikël. Ata përbëheshin nga një vibrim tjetër i paformë, duke jetuar të padukshëm për bijtë e njerëzve të tokës. Vetëm përmes gjakut ata mund të merrnin formë. Vetëm përmes njeriut ata mund të jetonin në botë. Në epokat e shkuara, ata u mundën prej Mjeshtrave, u shkelmuan poshtë, andej nga kishin ardhur. Por disa mbetën, e u fshehën në vende dhe plane të ekzistencës të panjohura nga njeriu. Ata jetuan si hije në Atlantidë, por, me raste, ata shfaqeshin midis njerëzve. Po, kur ofrohej gjak, ata vinin të jetonin mes njerëzve. Ata u shpërndanë mes nesh duke marrë pamjen e njeriut, por vetëm në pamje i ngjanin njeriut. Kur iu zbulohej magjia, dukeshin koka gjarpëri, por, në të kundërt, dukeshin tamam si njerëz mes njerëzish. Ata paraqiteshin vjedhurazi në Asamble, duke marrë forma të ngjashme me njerëzit. Me mjeshtëritë e tyre, ata vranë krerët e Mbretërive, duke marrë pamjen e tyre dhe mbretëruan mbi njerëzit. Vetëm me anë të magjisë mund të zbuloheshin. Vetëm me anë të tingullit mund të shihej fytyra e tyre e vërtetë. Ata erdhën nga Mbretëria e hijeve për të shkatërruar njeriun dhe për të mbretëruar në vend të tij. Por dijeni se, Mjeshtrit ishin magjistarë të fortë, në gjendje t'ua çirrnin Maskën pas së cilës fshihej fytyra e gjarprit, ishin në gjendje t'i degdisnin andej nga kishin ardhur.

Ata erdhën tek njerëzit dhe u mësuan sekretin, Fjalën që vetëm njeriu mund ta shqiptojë. Me shpejtësi ata ia çorrën Maskën gjarprit dhe e hodhën larg tokës së njerëzve. E megjithatë jini vigjilentë, sepse gjarpri jeton në një vend që mund t'i hapet botës. Të padukshëm ata ecin midis njerëzve në vendet ku celebrohen ritet. Edhe njëherë, në të ardhmen, ata do të marrin pamje njerëzore. Ata mund të evokohen nga mjeshtri që njeh të bardhën ose të zezën. Por vetëm Mjeshtri i bardhë mund t'i kontrollojë e t'i lidhë ndërsa janë në mish. Mos e kërkoni mbretërinë e hijve, sepse sigurisht që të ligën do të gjeni! Sepse vetëm Mjeshtri i përndritur do ta mposhtë hijen e frikës. Dije, o vëlla, se frika është një pengesë e madhe. Ji gjithmonë Mjeshtër i Dritës, dhe errësira do të zhduket shpejt! Dëgjomë dhe mbaje

vath në vesh mençurinë time, zëri i Dritës është i qartë! Mos kërko në luginën e hijeve, dhe do të të shfaqet vetëm Drita! Dëgjo me vëmendje, o njeri, sepse nga thellësia e mençurisë unë flas për dije që iu janë fshehur njerëzve. Në udhëtimin tim përmes Hapësirë-Kohës, unë kam shkuar larg, deri në fundin e hapësirës të këtij cikli. Atje kam gjetur Barrierën e Madhe, rezistente ndaj njeriut që tenton të dalë nga ky cikël. Po, i kam dalluar Zagarët e Barrierës që ishin gjithmonë vigjilentë në pritje të atij që do të tentojë t'i kalojë. Në atë hapësirë ku koha nuk ekziston, ndjeva dobët prezencën e rojeve të cikleve. Që lëviznin vetëm përmes këndeve. Duke mos qënë të lirë nga dimensionet harkore. Të çuditshëm dhe të frikshëm Zagarët e Barrierës. Ata ndjekin vetëdijen deri tek limitet e hapësirës. As mos e ço nëpër mend t'ia mbathësh duke hyrë në trupin tënd, sepse ata e ndjekin me shpejtësi Shpirtin përgjatë këndeve. Vetëm rrethi do të mund të të mbrojë, të të shpëtojë nga kthetrat e Banorëve të Këndeve. Njëherë, larg në kohë, unë iu afrova Barrierës së Madhe, dhe pashë në brigjet ku nuk ekziston koha, format e paforma të Zagarëve të barrierës. Po, i gjeta të fshehur në mjegullën përtej kohës, dhe Ata, duke më nuhatur nga larg, u ngritën dhe i ranë këmbanës së madhe që mund të dëgjohet nga cikli në cikël, dhe lëvizën, përmes hapësirës drejt Shpirtit tim. Unë ia mbatha me shpejtësi, duke u kthyer mbrapsht nga ajo kohë e një fundi të pamendueshëm. Por ata më ndoqën, duke lëvizur në mënyra të çuditshme të panjohura për njerëzit. Po, në brigjet e përhimta të fundit të Kohë-Hapësirës, unë gjeta Zagarët e Barrierës, të uritur për Shpirtrat që orvaten të kalojnë përtej. Përmes rrathëve unë ia mbatha mbrapsht tek trupi im. Unë ia mbatha por shpejt më ndoqën edhe ata. Po, pas meje, më ndoqën gllabëruesit, duke kërkuar, përmes këndeve, mënyrën si ta gllabëronin Shpirtin tim. Po, o njeri, dije se Shpirti që sfidon Barrierën, rrezikon të kapet nga Zagarët e përtej kohës, duke e mbajtur derisa të kompletohet ky cikël dhe duke e lëshuar vetëm kur vetëdija të largohet. Unë hyra në trupin tim, krijova rrathë që s'kanë kënde, krijova formën nga e cila u formua forma ime. E vendosa trupin tim në një rreth, dhe i lashë ndjekësit të humbasin në rrathët e kohës. Por, kur unë jam i lirë nga trupi im, duhet të tregohem i kujdesshëm e të mos lëviz përmes këndeve, ose, përndryshe, shpirti im nuk do të jetë kurrë i lirë. Dije se Zagarët e Barrierës lëvizin vetëm përgjatë këndeve dhe nuk lëvizin kurrë përmes lakoreve të hapësirës. Ti mund t'iu shmangesh atyre vetëm po qe se lëviz përgjatë lakoreve, sepse, në të kundërt, nëse lëviz përgjatë këndeve, ata do të të ndjekin. O njeri, kije parasysh paralajmërimin tim! Përpiqu të mos e shkelësh kurrë hyrjen për tek "përtej"! Të paktë janë ata që ia dalin mbanë ta kalojnë Barrierën e të mbërrijnë tek Drita e madhe që shkëlqen në botën e përtejme. Sepse dije që banorët kërkojnë gjithmonë ndonjë Shpirt për ta skllavëruar. Më dëgjo, o njeri, dhe kije parasysh paralajmërimin tim! Përpiqu të lëvizësh përgjatë lakoreve dhe jo përgjatë këndeve! E në qoftë

se, ndërsa je i lirë nga trupi yt, beson se po dëgjon një tingull të ngjashëm me lehjen e një zagari duke skërmitur dhëmbët, dhe një tingull të ngjashëm me një këmbanë përmes trupit tënd, mbathja mbrapsht tek trupi yt duke ndjekur rrathët, dhe mos kërko të hysh në mjegull! Kur të rihysh në formën që banon, përdor kombinimin e kryqit dhe të rrethit! Hape gojën dhe përdor Zërin tënd! Shqiptoje Fjalën, dhe do të jesh i lirë! Vetëm kush është i mbushur maksimalisht me Dritë mund të shpresojë të kalojë rojet e shtegut. Edhe atëherë, ai duhet të lëvizë përmes lakoresh të çuditshme dhe këndeve që janë të formuara në drejtime të panjohura nga njeriu. Dëgjo, o njeri, dhe kije parasysh paralajmërimin tim: mos provo t'i kalosh rojet e shtegut! Në vend të saj kërko të fitosh Dritën tënde dhe të përgatitesh për ta kaluar shtegun! Drita është caku yt i fundit, o vëlla. Kërko dhe gjithmonë do ta gjesh dritën në rrugën tënde!

PLLAKA IX:
ÇELËSI PËR TË QËNË TË LIRË NË HAPËSIRË

Kushtoji vëmendje zërit tim, o njeri, që të mëson Mençurinë dhe Dritën në këtë cikël; që të mëson si ta dëbosh errësirën, që të mëson si ta sjellësh Dritën në jetën tënde! Përpiqu, o njeri, të gjesh rrugën që të çon tek Jeta e Përjetshme si një Diell! Largohu nga veli i errësirës! Përpiqu të jesh një Dritë për botën! Bëje veten tënde një enë për Dritën, bëje veten tënde një vatër për Diellin e kësaj hapësire! Ktheje për nga Kozmosi vështrimin tënd! Ktheje për nga Drita vështrimin tënd! Fol me fjalët e Banorit, këngën që thërret Dritën! Këndo ti këngën e lirisë! Këndo ti këngën e shpirtit! Krijo Vibrimin e lartë që do të të bëjë Ty Një me Gjithësinë! Përzihu me Kozmosin! Rritu Një me Dritën! Qofsh ti një me kanalizimin për rregullin, qofsh një rrugë për Ligjin në botë! Drita jote, o njeri, është Drita e Madhe, që shkëlqen përmes hijeve të mishit. Duhet të ngrihesh nga errësira, para se të jesh Një me Dritën. Hijet e errësirës të rrethojnë. Jeta të mbush me fluksin e saj. Por tani, o njeri, ti duhet të ngrihesh dhe të shkosh larg trupit tënd drejt planeve që të rrethojnë dhe që janë Një me ty. Shih përreth vetes, o njeri! Shih pasqyrimin e dritës tënde! Po deri edhe në errësirën që të rrethon, drita jote vërshon jashë velit.

Kërko gjithmonë mençuri! Mos lejo të të tradhtojë trupi! Procedo në rrugën e valës së Dritës! Ndriçoje rrugën e errët! Dije se mençuria është e përhershme! Ka ekzistuar që kur filloi Shpirti i Madh i Gjithësisë, duke krijuar harmoninë prej Kaosit për Ligjin që ekziston në Rrugën. Dëgjoje, o njeri, mësimin e mençurisë! Vëre vath në vesh Zërin që flet për kohën e shkuar! Po, unë të tregoj për dijen e harruar, të flas për mençurinë e fshehur në kohën e shkuar, e humbur në errësirën që më rrethon. Dije, o njeri, se ti je fundi i të gjitha gjërave! Vetëm se, dija e kësaj gjëje është harruar, humbi kur njeriu u hodh në burgim, i lidhur dhe i prangosur nga

vargonjtë e errësirës. Shumë e shumë kohë më parë, unë e braktisa trupin tim. I mrekulluar unë bridhja i lirë në bollëkun e eterit. Bridhja përqark këndeve që mbanin njeriun në skllavëri, duke përcaktuar motivet që e çuan njeriun në skllavëri.

Dije, o njeri, se ti je vetëm një shpirt. Trupi është asgjë. Shpirti është Gjithçka. Mos lejo që trupi yt të jetë një burg! Çlirohu nga errësira dhe udhëto në Dritë! Çlirohu nga trupi yt, o njeri, dhe do të jesh i lire. Je me të vërtetë një Dritë që është Një me Dritën. Kur të jesh i lirë nga zinxhirët e errësirës, e të udhëtosh në hapësirë si një Diell i Dritës, atëherë do të kuptosh se hapësira nuk është e pakufishme, por efektivisht kufizohet prej këndeve dhe lakoreve. Dije, o njeri, se gjithçka që ekziston është thjesht një aspekt i gjërave më të mëdha që duhet ende të vijnë. Materia është prurja që rrjedh si një korrent, duke ndryshuar në mënyrë konstante nga njëri aspekt në tjetrin. Dija gjithmonë ka ekzistuar në të gjitha epokat, asnjëherë nuk ka ndryshuar, edhe pse e fshehur në errësirë, asnjëherë nuk ka humbur, edhe pse e harruar prej njeriut. Dije se anembanë hapësirës në të cilën banon ti, ka të tjerë që janë po aq të mëdhenj sa ti, të ndërlidhur përmes zemrës së materies tuaj, e megjithatë të veçuar në hapësirën e tyre.

Njëherë, në një kohë tashmë të harruar, unë, Thoti, hapa shtegun, penetrova në hapësira të tjera dhe mësova sekretet e fshehura. Thellë në esencën e materies ndodhen të fshehura shumë sekrete. Nëntë janë dimensionet e ndërlidhura. Nëntë janë edhe ciklet e hapësirës. Nëntë janë përhapjet e ndërgjegjes. Nëntë janë dhe botët brenda botëve. Po, Nëntë janë Zotat e cikleve që vijnë nga lart dhe nga poshtë.

Hapësira është e mbushur nga gjëra të fshehura, sepse hapësira është e ndarë nga koha. Kërko çelësin e kohë-hapësirës, dhe ti do të hapësh portën! Dije se, nga njëri cep në tjetrin të kohë-hapësirës, ekziston me të vërtetë vetëdija. Edhe pse i është fshehur vetëdijes sonë, ajo do të vazhdojë përgjithmonë të ekzistojë. Çelësin për në botët brenda teje mund ta gjesh vetëm në brendësi, sepse është njeriu hyrja për tek misteri dhe çelësi është Një në Njësinë. Kërko në brendësi të rrethit! Përdor Fjalën që do të të jap unë! Hape kalimin për në brendësinë tënde, dhe, me siguri që edhe ti do të jetosh!

Njeri, ti beson se jeton, por dije se jeta është brenda vdekjes. Sepse sigurisht, përderisa ti je skllav i trupit tënd, për ty nuk është jetë. Vetëm shpirti është i lirë në hapësirë, dhe ka një jetë që është me të vërtetë jetë. Çdo gjë tjetër është thjesht skllavëri, një zinxhir për t'u çliruar prej tij. Mos beso se njeriu u lind nga toka, edhe pse i ardhur nga toka mund të jetë. Njeriu është një shpirt i lindur në dritë. Por, pa dijen, nuk do të mund të jetë kurrë i lirë. Errësira e rrethon të lindurin nga Drita. Errësira prangos Shpirtin. Vetëm kush kërkon, mund të shpresojë të jetë ndonjëherë i lirë. Hijet rreth e rrotull teje po bien, errësira mbush gjithë hapësirën. Por ndriço përpara o Dritë e shpirtit njerëzor! Mbushe ti errësirën e hapësirës!

Ti je Bir i Dritës së Madhe. Kujtoje dhe do të jesh i lirë. Mos qëndro në hijet! Brof përpjetë nga errësira e natës! Dritë qoftë Shpirti yt o i Lindur nga Dielli, mbushu me lavdinë e Dritës, çlirohu nga zinxhirët e errësirës, një Shpirt që është Një me Dritën. Ti je çelësi i gjithë mençurisë. Brenda teje ndodhet e gjithë koha dhe hapësira. Mos jeto në skllavërinë e errësirës! Çliroje ti nga nata trupin tënd të Dritës! ***Dritë e Madhe që mbush gjithë Kozmosin, rridh plotësisht tek njeriu! Bëje trupin e tij një pishtar të Dritës që të ndriçojë gjithmonë mes njerëzish!***

Larg, në të shkuarën e largët, kërkova mençurinë, dijen e panjohur për njeriun. Larg, në të shkuarën e largët, unë udhëtova në hapësirën ku filloi koha. Kërkova gjithmonë t'i shtoja dije mençurisë sime. E megjithatë, unë gjeta se vetëm e ardhmja do të mund ta sjellë çelësin e mençurisë që kërkoja. Unë udhëtova poshtë, në Sallat e Ament-it, për të kërkuar dije më të madhe. Ua kërkova Zotave të Cikleve, rrugën për tek mençuria që po kërkoja. Zotave iu shtrova këtë pyetje: ***Ku është burimi i Gjithësisë?*** U përgjigj me një zë potent, Zoti i Nëntës: ***Çliroje shpirtin tënd nga trupi yt dhe eja me mua përpara në Dritë!*** Unë erdha përpara nga trupi im, një flakë e shndritshme në natë. Qëndrova unë para Zotave, i larë në Zjarrin e Jetës. Unë u kapa atëherë nga një forcë e madhe, përtej asaj që njeh njeriu. U flaka tutje në një humnerë nëpërmjet hapësirave të panjohura nga njeriu.

Unë pashë themeluesit e Rregullit nga Kaosi dhe këndet e natës. Pashë unë Dritën, të vërshojë me vrull nga Harmonia dhe dëgjova tingullin e Dritës. Unë pashë flakën e Humnerës duke hedhur përpara Rregull dhe Dritë. Pashë Rregullin të vërshojë nga kaosi. Pashë Dritën të japë Jetë. Pastaj dëgjova zërin:

"Dëgjo dhe kupto! Flaka është burimi i të gjitha gjërave, duke përmbajtur potencialisht çdo gjë. Fjala është harmonia që formon çdo gjë, dhe, nga Fjala vjen Jeta dhe ekzistenca e gjithçkaje. E zëri foli sërish: Fjala është Jeta që është tek ti. Gjeje Jetën brenda teje dhe do të kesh pushtetin të përdorësh Fjalën!"

Pashë për një kohë të gjatë, flakën e Dritës, që buronte nga Esenca e Zjarrit, duke kuptuar që Jeta është Harmoni dhe që njeriu është Një me zjarrin. Unë u ktheva mbrapsht në trupin tim, dhe qëndrova sërish me Nëntën, duke dëgjuar zërin e Cikleve, me një vibrim të fuqishëm, kështu ata folën:

"Dije, o Thot, se Jeta nuk është gjë tjetër veçse Fjala jote me Zjarrin. Jeta që ti po kërkon, pikësëpari, është veçse Fjala si një zjarr në Botë. Kërko rrugën për tek Fjala dhe, me siguri, pushteti do të jetë i yti".

Atëherë unë i kërkova Nëntës:

"O Zot, më trego shtegun! Më jep rrugën për tek mençuria! Më trego rrugën për tek Fjala!"

Atëherë m'u përgjigj Zoti i Nëntës:

"Rrugën do ta gjesh me anë të Ekuilibrit. Nuk e sheh që Fjala vjen nga Kaosi? Po a nuk e sheh Dritën të vijë nga Zjarri? Në jetën tënde largoje çekuilibrin. Balancoje dhe rregulloje jetën tënde! Largoje të gjithë Kaosin e emocioneve dhe do të arrish ekuilibrin në Jetën tënde. Rregulli, i nxjerrë nga Kaosi, do të të sjellë ty Fjalën e Burimit, do të të japë pushtetin e Cikleve, dhe, në Shpirtin tënd do t'i japë një forcë që do të përhapet lirisht përgjatë kohërave, një Diell i përsosur i Burimit".

Unë dëgjova zërin, dhe fjalët zbritën thellë në zemrën time. Gjithmonë unë kisha kërkuar rregullin që do të mund ta kisha nxjerrë nga Fjala. Dije se, kushdo që do ta arrijë këtë, duhet gjithmonë të jetë në ekuilibër për ta përdorur Fjalën, sepse përdorimi i Fjalës në çekuilibër nuk ka qënë kurrë dhe nuk do të mund kurrë të jetë. Merri këto fjalë, o njeri, le të jenë ato pjesë e jetës tënde! Përpiqu të fitosh këtë ekuilibër dhe do të jesh Një me Fjalën!

Shtrëngohu të fitosh Dritën në shtegun e Jetës! Përpiqu të jesh Një me gjendjen e Diellit! Përpiqu të jesh vetëm Dritë! Sille mendimin tënd vetjak drejt bashkimit të Dritës me trupin e njeriut! Kujto që gjithçka është Rregull nga Kaosi që zë fill në Dritë.

PLLAKA X:
ÇELËSI I KOHËS

Dëgjo, o njeri! Dëgjoje mençurinë time! Mëso misteret e thella të fshehura të hapësirës! Mëso për Mendimin që u rrit në humnerë, duke sjellë Rregull dhe Harmoni në hapësirë! Dije, o njeri, se çdo gjë që ekziston, e ka ekzistencën e vet vetëm për pasojë të Ligjit! Njihe Ligjin dhe do të jesh i lirë, dhe nuk do të jesh kurrë i lidhur nga zinxhirët e natës. Larg, përmes hapësirash të çuditshme, kam udhëtuar unë, në thellësitë e humnerave të kohës, derisa në fund çdo gjë u zbulua. Dije se misteri është mister vetëm kur ka një dije të panjohur nga njeriu. Kur ti të kesh kuptuar bërthamën e të gjitha mistereve, dija dhe mençuria do të jenë me siguri të tuat. Kërko dhe mëso që Koha është sekreti, me anë të së cilës ti mund të jesh i lirë nga kjo hapësirë. Për një kohë të gjatë, unë kam kërkuar mençurinë; po, dhe do ta kërkoj deri në fundin e përjetësisë, sepse di se, gjithmonë, para meje lëviz pikëmbërritja, që unë kërkoj të arrij. Deri edhe Zotat e Cikleve, me të gjithë mençurinë e tyre, e dinë që edhe Ata nuk e kanë arritur akoma pikëmbërritjen, sepse E Vërteta gjithmonë rritet. Njëherë, në një kohë të shkuar, unë i fola Banorit. E pyeta për misterin e kohës dhe të hapësirës. Duke i shtruar pyetjen që buronte nga qënia ime:

"O Zot, çfarë është koha?"

Atëherë kështu më foli Ai, Zoti:

"Dije, o Thot, që në fillim ishte Hiçi dhe joekzistenca, një jokohë, një johapësirë dhe një joekzistencë. Dhe brenda joekzistencës mbërriti një mendim kuptimplotë dhe i gjithanshëm, dhe mbushi Zbrazëtinë. Nuk ekzistonte materia, vetëm forca, një lëvizje, një vorbull ose vibrim i mendimit kuptimplotë që mbushi Boshllëkun".

Dhe e pyeta Zotin:

"Çfarë është ky mendim i përjetshëm?"

Dhe u përgjigj Banori duke thënë:

"Në fillim ishte mendimi i përjetshëm, dhe, sepse me qënë mendim i përjetshëm, duhet të ekzistojë koha. Në këtë mënyrë, në brendësi të mendimit gjithëdepërtues u rrit Ligji i Kohës. Po, koha që ekziston përmes gjithë hapësirës, duke pluskuar në një lëvizje ritmike, delikate që është përjetësisht në një gjendje qëndrueshmërie.

Koha nuk ndryshon, por të gjitha gjërat ndryshojnë në kohë. Sepse koha është forca që i mban ngjarjet të ndara, secila në vendin e vet. Koha nuk është në lëvizje, por ti lëviz përmes kohës, sepse vetëdija jote lëviz nga njëra ngjarje në tjetrën. Po, qëkur ekziston, e gjitha në të gjithën, je Një ekzistencë e përjetshme dhe e vetme. Dije, madje se edhe pse në kohën ti je i ndarë, e megjithatë ti je Një, ekzistues në çdo kohë".

Pastaj pushoi zëri i Banorit, dhe unë u largova të bluaja në mendje për kohën. Sepse unë e dija që në ato fjalë ishte vendosur mençuria dhe mënyra për të eksploruar misteret e kohës. Shpesh unë bluaja në mendje fjalët e Banorit. Atëherë kërkova ta zgjidhja misterin e kohës. Unë zbulova se koha lëviz nëpërmjet këndesh të çuditshme. Megjithatë vetëm me anë të lakoreve do të mund të shpresoja të fitoja çelësin që do të më jepte lejekalimin për tek kohë-hapësira. Unë zbulova që vetëm duke lëvizur drejt të lartës dhe sërish duke lëvizur djathtas, do të mund të isha i lirë prej kohës së lëvizjes. Unë bëra përpara duke dalë jashtë nga trupi im, duke lëvizur në mënyrën, që me kalimin e kohës më ndryshoi. Pamje të çuditshme pashë unë në udhëtimet e mia, të shumta misteret që m'u bënë të dukshme për sytë e mi. Po, unë pashë lindjen e njeriut, mësova nga e kaluara që nuk ka asgjë të re. Kërko, o njeri, të mësosh shtegun që të çon përmes hapësirave që janë formuar përpara në kohë. Mos harro, o njeri, me të gjitha kërkimet e tua, që Drita është pikësynimi që duhet të kërkosh të mbërrish. Kërko Dritën në shtegun tënd dhe gjithmonë për ty pikësynimi do të jetë i qëndrueshëm! Mos lejo kurrë që zemra jote të kthehet drejt errësirës! Lejo që Shpirti yt të ndriçojë në Dritë, një Diell në udhë! Dije se Shpirti yt do ta gjejë gjithmonë përndritjen e përjetshme, të fshehur në Dritë, kurrë të mbajtur nga lidhjet e errësirës, gjithmonë do të shkëlqejë si një Diell i Dritës. Po, dije që, edhe pse i fshehur në errësirë, shpirti yt, një shkëndijë e flakës së vërtetë, ekziston. Qofsh Një me më të madhen e të gjitha Dritave! Kërkoje tek Burimi Fundin e qëllimit tënd!

Drita është jetë, sepse, pa Dritën e madhe, asgjë nuk mund të ekzistojë. Dije se në të gjithë materien e formuar, ekziston gjithmonë zemra e Dritës. Po, deri edhe në burgun e errësirës, ekziston e rrënjosur Drita. Një herë unë qëndroja në Sallat e Amen-tit dhe dëgjoja zërin e Zotave të Ament-it, që thoshin, me një tonalitet që tingëllonte në heshtje, fjalë fuqie, të forta dhe të pushtetshme. Ata këndonin melodinë e cikleve, fjalë që hapnin hyrjekalimin për në të përtejmen. Po, unë pashë portalin e madh të hapur, dhe pashë, për një çast, në të përtejmen. Pashë lëvizjet e cikleve, të pamatë si mendimi i Burimit që i udhëhiqte. Atëherë unë mora vesh që madje edhe Përjetësia lëviz drejt një fundi që s'ta merr mendja. Pashë që Kozmosi është Rregull dhe është pjesë e një lëvizjeje që përhapet në të gjithë hapësirën, një festë e një Rregulli të Rregullave, që, në mënyrë konstante lëviz në harmoninë e hapësirës. Pashë rrotullimin e Cikleve si rrathë të pamatë përmes qiellit. Atëherë unë mora vesh që, çdo gjë që ekziston, rritet për të takuar një ekzistencë tjetër në një grupim të largët të hapësirës dhe kohës. Atëherë mësova që në Fjalët ndodhet fuqia për të hapur plane të ekzistencës që janë të fshehura nga njeriu. Po, që madje tek Fjalët fshihet çelësi që do të hapë të sipërmen dhe të poshtmen.

"Dëgjo tani, o njeri, këtë fjalë që po ta le ty! Përdore dhe ti do të gjesh fuqinë në tingullin e saj! Thuaj fjalën "Zin- Uru"dhe do të gjesh fuqinë! Ende ti duhet të kuptosh se njeriu është i Dritës dhe Drita është e njeriut".

Kushtoji vëmendje, o njeri, dhe dëgjo për misterin më të çuditshëm nga të gjitha që shtrihen poshtë Diellit! Dije, o njeri, se e gjithë hapësira është e mbushur nga botë brenda botëve; po, njëra brenda tjetrës, e megjithatë të ndara nga Ligji. Një herë, në kërkimin e mençurisë së groposur thellë, hapa portën që i ndan Ata nga njeriu. Unë thirra nga planet e tjera të ekzistencës, njërën që ishte më e mira e bijave të njerëzve. Po, e thirra nga përtej hapësirës, për të shkëlqyer si një dritë në botën e njerëzve. Unë përdora daullen e Gjarprit. Vesha rroba me ngjyra të purpurta dhe të arta. Vendosa kurorën e Argjendtë mbi kokën time. Rreth e rrotull meje bëra të ndriçonte rrethi prej sulfit mërkuri. Ngrita krahët e mi dhë thërrita lutjen që hap shtegun për tek planet e së përtejmes, u thirra Zotave të Shenjave në vendbanimet e tyre:

"Zota të dy horizonteve, rojtarë të kangjellave të trefishta, që qëndroni njëri në të djathtë e tjetri në të majtë kur Ylli ngrihet për tek froni i tij dhe qeveris mbi shenjën e vet. Po, ti princ i errët i Arulu-t, hapi portat e tokës së fshehur të padallueshme, dhe lëre të shkojë atë që mban të burgosur. Dëgjoni, dëgjoni, dëgjoni Zota të errët dhe Zota të Ndritshëm, dhe, në emër të emrave tuaj sekretë, emra të cilët unë i di dhe mund t'i shqiptoj, dëgjomëni dhe bindjuni vullnetit tim".

Pastaj ndeza me flakë rrethin tim dhe e thirra Atë nga planet dimensionale të përtejme.

"Bijë e Dritës kthehu prej Arulu-t! Shtatë herë dhe shtatë herë kalova unë përmes zjarrit. Nuk kam ngrënë ushqim. Ujë nuk kam pirë. Të thërras ty nga Arulu nga Mbretëritë e Ekershegal-it. Të thërras të shfaqesh, Zonjë e Dritës!"

Atëherë përballë meje u ngritën figurat e errëta; po, figurat e Zotave të Arulu-t. U ndanë përpara meje, dhe përpara doli Zonja e Dritës. Tani ajo ishte e lirë nga Zotat e natës, e lirë të jetojë në Dritën e Diellit të tokës, e lirë të jetojë si një fëmijë e Dritës. Dëgjoni dhe kuptoni, o bijtë e mi! Dija është magji dhe është Ligj i vetëm. Mos kini frikë nga fuqia brenda jush, sepse ajo ndjek Ligjin ashtu si yjet në qiell. Por dijeni se kush është pa njohuri, mënçuria është magji dhe jo e Ligjit. Por dijeni se, gjithmonë përmes dijes, do të mund t'i afroheni një vendi më afër Diellit. Dëgjoni, o bijtë e mi, ndiqeni mësimin tim! Jini gjithmonë kërkues të Dritës! Ndriçoni në botën e njerëzve rrotull jush si një Dritë në shtegun që do të ndriçojë mes njerëzve. Ndiqeni dhe mësojeni magjinë time! Dijeni se e gjithë fuqia është e juaja nëse do ta dëshironi. Mos kini frikë nga shtegu që ju çon tek dija, por më mirë shmangiuni rrugës së errët! Drita është e jotja, o njeri, mund ta marrësh. Flaki tutje prangat dhe ke për të qënë i lirë. Dije se shpirti yt jeton në zinxhirët të shkaktuara nga frika që të bën skllav.

Hapi sytë dhe shiko Dritën e madhe të Diellit! Mos ki frikë sepse gjithçka është e jotja! Frika vjen nga Zoti i Arulu-t të errët, të cilit nuk ia keni kundërshtuar kurrë frikën prej errësirës. Po, dije se frika ekziston sepse është krijuar nga ata që janë të lidhur nga frikat e tyre. Shkunduni nga skllavëria juaj, o bij, dhe ecni në dritën e ditës së lavdishme! Kurrë mos i drejtoni mendimet tuaja drejt errësirës, dhe sigurisht që do të jeni Një me Dritën. Njeriu është vetëm çfarë beson se është, një vëlla i errësirës apo një bir i Dritës. Ejani pra në Dritë bijtë e mi! Ecni në shtegun që ju çon tek Dielli! Dëgjo tani dhe vere vath në vesh mençurinë time! Përdore ti fjalën që të kam dhënë! Përdore dhe sigurisht që do të gjesh fuqi dhe mençuri dhe Dritë për të ecur në rrugë. Kërkoje dhe gjeje çelësin që të kam dhënë dhe ke për të qenë gjithmonë një Bir i Dritës.

PLLAKA XI:
ÇELËSI I TË SIPËRMES DHE TË POSHTMES

Dëgjoni o bij të Khem-it, dhe mbajini mend fjalët që po iu jap e që do t'ju çojnë në Dritë. Dijeni, o njerëz, se unë i njihja baballarët tuaj, po, baballarët tuaj, në një kohë shumë të largët. Unë kam qënë i pavdekshëm në të gjitha epokat, duke jetuar mes jush që nga fillimi i dijes suaj. Gjithmonë jam përpjekur t'ju udhëheq për lart, drejt Dritës së Shpirtit të Madh. E t'ju udhëheq për t'ju nxjerrë nga errësira e natës. Dijeni, o njerëz, mes të cilëve unë ec, se unë, Thoti, zotëroj të gjithë dijen dhe mençurinë që njeh njeriu qysh prej ditëve antike. Kam qënë ruajtës i sekreteve të Racës së

Madhe, mbajtës i çelësit që të çon në jetë. Ju kam nxjerrë edhe ju jashtë errësirës që prej Ditëve Antike, o bijtë e mi. Dëgjojini me vëmendje tani fjalët e mençurisë sime! Kushtojini vëmendje mesazhit që ju sjell! Dëgjojini fjalët që po ju jap dhe ju do të ngriheni nga errësira në Dritë. Larg në të shkuarën, kur për herë të parë u prezantova para jush, ju gjeta në shpellat nëpër shkëmbinj. Iu lartësova me fuqinë dhe me mençurinë time derisa edhe ju shndritët si njerëz mes njerëzve. Po, iu gjeta pa asnjë dije. Vetëm disa prej jush ishin diçka më lart se kafshët. Ndeza shkëndijën e vetëdijes suaj, derisa më në fund ju flakëruat si njerëz. Tani do t'ju flas për dijen antike që shkon përtej botkuptimit të racës suaj. Dijeni se ne, të Racës së Madhe, kishim dhe kemi dije më superior se ato të njeriut. Ne e fituam mençurinë prej racave të lindura nga yjet, mençuri dhe dije prej larg, përtej njeriut. Mjeshtrit e mençurisë zbritën mes nesh, kaq shumë të largët nga ne ashtu siç jam unë nga ju.

Tani dëgjoni me vëmendje ndërsa ju jap mençurinë! Përdoreni dhe do të jeni të lirë! Dijeni se në piramidën që ndërtova, atje ndodhen Çelësat që do t'ju tregojnë Rrugën për tek jeta. Po, gjurmoni një linjë nga imazhi i madh që ndërtova, deri në majë të piramidës, e ndërtuar si një portëkalim. Gjurmoni një tjetër nga pjesa përkarshi me të njëjtin kënd dhe drejtim. Gërmoni atje dhe do të gjeni atë çfarë ju kam fshehur! Atje do të gjeni hyrjen e nëndheshme për në sekretet që u fshehën para se ju të ishit njerëz.

Tani do t'ju rrëfej për misterin e cikleve që lëvizin në mënyra të çuditshme për tek e fundmja, sepse e pafundmja shtrihet përtej dijes së njeriut. Dijeni se ndodhen nëntë cikle; po, nëntë sipër dhe katërmbëdhjetë poshtë që lëvizin harmonikisht drejt pikës së bashkimit që do të ekzistojë në të ardhmen. Dijeni se Zotat e Cikleve janë njësi të vetëdijes dërguar prej të tjerëve për të unifikuar Këtë me Gjithësinë. Ata janë më lart se vetëdija e të gjitha Cikleve, duke punuar në harmoni me Ligjin. Ata e dinë se, me kalimin e kohës, Gjithçka do të jetë e përsosur, duke mos patur asgjë më sipër dhe asgjë më poshtë, por e Gjitha Një në një Përjetësi të përsosur, një harmoni e të Gjithës me Unitetin e Gjithësisë. Thellë poshtë sipërfaqes së tokës, në Sallat e Ament-it, ulen të Shtatët, Zotat e Cikleve, po, dhe një tjetër, Zoti i të poshtmes. E pra, dijeni se në Përjetësi nuk ka as të sipërme dhe as të poshtme. Por çdo gjë është gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë Unitet i Gjithësisë kur e Gjitha të jetë e përfunduar. Shpesh unë kam qëndruar përpara Zotave të Gjithësisë. Shpesh unë kam pirë nga burimi i mençurisë së tyre, dhe e mbusha si trupin tim ashtu edhe Shpirtin tim me Dritën e tyre. Ata më flisnin duke më treguar për Ciklet e për Ligjin që u jep atyre arsyen për të ekzistuar. Po, më foli Zoti i Nëntës e më tha:

"O Thot, ti je i madh midis bijve të Tokës, por ekzistojnë mistere që ti nuk i njeh. Ti di se erdhe nga një hapësirë-kohë poshtë kësaj dhe di që do të udhëtosh drejt një hapësirë-kohe superiore. Por ti di pak për misteret brenda tyre, ti di pak për mençurinë që ekziston përtej. Dije pra, se vetëdija jote e brendshme është vetëm

një qelizë në procesin e rritjes. Vetëdija poshtë teje gjithmonë përhapet në mënyra të ndryshme prej atyre të njohura prej teje. Po, ajo, edhe pse në një hapësirë-kohë poshtë teje, rritet gjithmonë në mënyra të ndryshme prej atyre që ishin pjesë e shtegut tënd. Dije se ajo rritet si rezultat i rritjes tënde, por jo në të njëjtën mënyrë në të cilën ti rriteshe. Rritja që ke patur ti dhe që ke në të tashmen, kanë sjellë në ekzistencë shkaqe dhe pasoja. Asnjë vetëdije nuk ndjek shtegun e atyre para saj, përndryshe gjithçka do të përsëritej dhe do të ishte e kotë. Çdo vetëdije në ciklin që ekziston, ndjek shtegun e vet deri në qëllimin final. Secila luan pjesën e vet në Planin Kozmik. Secila luan pjesën e vet deri në fundin përfundimtar. Sa më larg është cikli, aq më e madhe dija dhe aftësia për t'u shkrirë me Ligjin e Gjithësisë. Dije se ti, në ciklet poshtë nesh, je duke punuar në pjesë shumë të vogël me Ligjin, ndërsa ne, të ciklit që shtrihet deri në Përjetësi, marrim mundimin për ta bërë më të madh Ligjin.

Secili ka pjesën e vet për të luajtur në ciklet. Secili ka punën e vet për të përfunduar në mënyrën e tij. Cikli poshtë teje, prapëseprapë nuk është poshtë teje, por është formuar vetëm nga nevoja për të ekzistuar, sepse dije se burimi i mençurisë, që dërgon përpara ciklet, është përjetësisht në kërkim të fuqisë së re për ta fituar. Dije pra, se dija fitohet vetëm me praktikë, mençuria vjen vetëm me dijen, dhe, në këtë mënyrë janë krijuar ciklet me anë të Ligjit. Ato janë mjete për të arritur dijen për Planin e Ligjit që është Burimi i Gjithësisë. Cikli i poshtëm, nuk është realisht poshtë, por është thjesht i ndryshëm në hapësirë dhe në kohë. Vetëdija atje është duke punuar dhe duke provuar më pak gjëra në raport me aty ku ekziston ti. Dhe, dije se, ashtu si ti je duke punuar në madhështi, po ashtu edhe sipër teje ndodhen ata që janë duke punuar si ti, edhe pse me ligje të tjera. Ndryshimi që ekziston midis cikleve ka të bëjë vetëm në aftësinë për të punuar me Ligjin. Ne, që kemi ekzistuar në ciklet e mëparshëm, jemi ata që të parët kemi dalë nga Burimi, dhe, në kalimin përmes kohë-hapësirës, kemi fituar aftësinë të përdorim Ligjet më të Mëdha që janë larg nga botkuptimi i njeriut. Nuk ka asgjë reale poshtë teje, por janë vetëm shprehje të ndryshme të Ligjit. Vështro në të sipërmen, ose vështro në të poshtmen, do të gjesh gjithmonë të njëjtën gjë. Sepse Gjithçka nuk është tjetër veçse pjesë e Njësisë që është në Burimin e Ligjit. Vetëdija, që është poshtë teje, bën pjesë në vetë veten tënde, ashtu si edhe ne jemi pjesë e jotja. Ti, si fëmijë, nuk e kishe dijen e cila erdhi më pas tek ti, kur u bëre burrë. Krahasoji ciklet tek njeriu në udhëtimin e tij nga lindja deri në vdekje, dhe vështro, në ciklet poshtë teje, fëmijën me dijen e tij; dhe vështro veten tënde si një fëmijë që rritet, duke përparuar në dije me kalimin e kohës. Na vështro edhe Ne, fëmijë të rritur në dijen dhe në mençurinë që ka ardhur bashkë me vitet. Kështu janë, o Thot, edhe ciklet e vetëdijes, fëmijë në faza të ndryshme të rritjes, e megjithatë gjithçka buron nga Burimi i Vetëm, nga Mençuria, dhe e gjitha tek Mençuria do të kthehet".

Pastaj ai pushoi së foluri dhe mbeti në heshtjen që vjen nga Zotat. Pastaj më foli sërish duke më thënë:

"Oh, Thot, për një kohë të gjatë Ne kemi qëndruar në Amenti duke vështruar flakën e jetës në Sallat. E megjithatë dije se Ne jemi ende pjesë e Cikleve tona me Vizionin tonë që përhapet në to dhe përtej. Po, dimë se, midis të gjitha gjërave,

asgjë tjetër nuk na intereson përveç rritjes që mund të fitojmë për Shpirtin tonë. Dimë se trupi është kalimtar. Gjërat që njerëzit i mbajnë si më të rëndësishmet, nuk janë asgjë për ne. Gjërat që ne kërkojmë, nuk bëjnë pjesë tek trupi, por janë vetëm gjendja e përsosur e Shpirtit. Kur ju si njerëz do të mund të mësoni se, në fund, asgjë nuk ka vlerë përveç progresit të Shpirtit, atëherë ju me të vërtetë do të jeni të lirë nga çdo skllavëri, të lirë për të punuar në harmoni me Ligjin. Dije, o njeri, që ti duhet të aspirosh përsosmërinë, sepse vetëm ajo mund të të bëjë të arrish qëllimin. Edhe pse ti duhet ta dish që asgjë nuk është e përsosur, e megjithatë, ajo duhet të jetë aspirata jote dhe qëllimi yt".

Pushoi sërish zëri i Nëntës, dhe fjalët u zhytën në vetëdijen time. Tani unë kërkoj gjithmonë e më shumë mençuri, me qëllim që të mund të jem i përsosur në Ligjin me Gjithësinë. Së shpejti unë do të zbres poshtë në Sallat e Ament-it për të jetuar në lulen e ftohtë të jetës. Ju, të cilëve u kam dhënë mësim, nuk do të më shihni më. E megjithatë unë do të jetoj përgjithmonë në mençurinë që kam dhënë mësim. Gjithë çfarë është njeriu, është për shkak të mençurisë. Gjithë çfarë do të jetë, do të jetë si rezultat i shkakut të tij. Dëgjoje tani zërin tim, dhe bëhu më i madh se njeriu i zakonshëm! Drejtoji sytë lart, le ta mbushë Drita qënien tënde, qofsh gjithmonë Fëmijë i Dritës! Vetëm duke u përpjekur do të mund të rritesh për lart, deri në planin ku Drita është Gjithësia e të Gjithës. Qofsh mjeshtër i gjithçkaje që të rrethon! Mos qofsh kurrë i kontrolluar nga pasojat e jetës tënde! Prandaj krijo pikësynime gjithmonë e më të përsosura, dhe, me kalimin e kohës, do të jesh një Diell i Dritës. Qoftë i lirë Shpirti yt të fluturojë gjithmonë e më lart; qoftë i lirë nga skllavëria dhe nga zinxhirët e natës! Drejtoji sytë e tu tek Dielli në hapësirën e qiellit! Le të jetë për ty një simbol i jetës! Dije se ti je Drita Më e Madhe, i përsosur në vetë sferën tënde, kur ti të jesh i lirë. Mos vështro kurrë brenda errësirës! Drejtoji sytë e tu tek hapësira lart! Le të ngjitet lart e lirë Flaka jote, dhe ti do të jesh një Bir i Dritës!

PLLAKA XII:
ÇELËSI I PROFECISË

Dëgjo me vëmendje, o njeri, fjalët e mençurisë sime, dëgjo me vëmendje zërin e Thotit, Atlantidasit! Unë e kam fituar Ligjin e kohë-hapësirës. Kam përfituar dijen e së ardhmes. Unë di se njeriu në kalimin e tij matanë, përmes hapësirë-kohës, do të mund të jetë Një me Gjithësinë. Dije, o njeri, e gjithë e ardhmja është një libër i hapur për atë që di të lexojë. Të gjitha pasojat prodhojnë shkaqet e tyre, ashtu si të gjitha pasojat vijnë nga shkaku i parë. Dije se e ardhmja nuk është fikse apo e qëndrueshme, por ndryshon sipas shkaqeve që prodhojnë pasojat. Vështro shkakun që do të të shpjerë në pasoja, dhe, me siguri, do të shohësh se gjithçka është një pasojë. Në fillimin e madh u rrit Shkaku i Parë, që solli në jetë gjithçka që ekziston. Ti vetë je pasojë e shkakësisë, dhe, nga ana tjetër, do të jesh

shkaku i pasojave të tjera. Kështu, o njeri, ji i sigurt se, pasojat që ti përcakton, do të jenë shkaqe të pasojave gjithmonë më të përsosura. Dije se e ardhmja nuk është e fiksuar, por ndjek gjithmonë vullnetin e lirë të njeriut ndërsa ai lëviz përmes lëvizjeve të hapësirë-kohës drejt qëllimit të caktuar ku fillon një kohë e re. Njeriu mund ta lexojë të ardhmen vetëm me anë të shkaqeve që prodhojnë pasojat. Kërko në brendësi të shkakësisë dhe sigurisht që do të gjesh pasojat! Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërsa unë të flas për të ardhmen, flas për pasojat që ndjekin shkaqet. Dije se njeriu, në udhëtimin e tij të ndritshëm, kërkon gjithmonë t'i shpëtojë natës që e rrethon, ashtu si hijet rrethojnë yjet e qiellit, dhe ashtu si yjet në hapësirën e qiellit, edhe ai, do të ndriçojë nga hijet e natës. Fati i tij do ta çojë gjithnjë përpara derisa të jetë Një me Dritën. Po, edhe pse rruga e tij do të ndodhet në mes të hijeve, përpara tij rrëzëllin gjithmonë Drita e Madhe. Ndonëse rruga është e errët, prapëseprapë ai do t'i mposhtë hijet që tunden përreth tij si nata. Larg në të ardhmen unë shoh njeriun si të Lindur në Dritë, të lirë nga errësira që i lidh me zinxhirë Shpirtin, duke jetuar në Dritë, pa robëritë e errësirës që fshehin Dritën që është Dritë e Shpirtit të tyre. Dije, o njeri, se para se ti të arrish këtë, shumë nga hijet e errëta do të rrëzohen në Dritën tënde, duke luftuar ta shtypin, me hijet e territ, Dritën e Shpirtit që mundohet të çlirohet. E madhe është lufta midis Dritës dhe Errësirës, antike e megjithatë gjithmonë e re. E megjithatë, unë di që, një ditë, në një të ardhme të largët, Gjithçka do të jetë Dritë, dhe errësira do të bjerë poshtë. Dëgjo me vëmendje, o njeri, fjalët e mia të mençurisë! Përgatitu dhe nuk do të të nënshtrojë errësira! Njeriu është ngritur dhe njeriu është rrëzuar ndërsa valë gjithmonë të reja ndërgjegje vërshojnë, nga humnera e madhe poshtë nesh, drejt Diellit të qëllimit të tyre. Po, bijtë e mi, ju u rritët nga një gjendje që ishte pak më lart se niveli i kafshëve, derisa tani ju jeni më të mëdhenjtë e të gjithë njerëzve. E megjithatë, më parë kishte të tjerë më të mëdhenj se ju. E megjithatë unë u kam treguar se si u rrëzuan të tjerët para jush, në këtë mënyrë do të përfundoni edhe ju. Dhe, mbi tokën ku banoni tani, do të banojnë barbarë dhe sipas radhës do të ngriheni drejt Dritës. Mençuria antike do të harrohet, prapëseprapë ajo gjithmonë do të jetojë edhe pse e fshehur prej njerëzve. Po, në tokën që quani Khem, do të lartësohen raca, dhe raca do të rrëzohen. Ju do të harroheni nga bijtë e njerëzve. Megjithatë ju do të keni lëvizur drejt një hapësire yjore përtej kësaj ekzistence, duke lënë mbrapa këtë vend ku keni jetuar. Shpirti i njeriut lëviz gjithmonë përpara, i lidhur jo nga ndonjë yll dosido. Por lëviz gjithmonë drejt qëllimit të madh përpara tij ku do të tretet në Dritën e Gjithësisë. Dijeni se do duhet të shkoni gjithmonë përpara, të lëvizur nga Ligji i shkak-pasojës, derisa, në fund, të dyja do të bëhen Një. Po, njeri, pasi ti të kesh shkuar, të tjerë do të lëvizin në hapësirat që ke jetuar ti. Dija dhe mençuria do të harrohen të gjitha. Dhe do të mbijetojë vetëm një memorie Perëndish. Ashtu si për ju, unë jam një Zot për dijen time, kështu edhe ju,

do të jeni Zotat e të ardhmes për shkak të dijes suaj, shumë më të lartë se e tyrja. E megjithatë dije që nëpërmjet të gjitha epokave, njeriu do të mund të hyjë në Ligj, kur ta dëshirojë. Epoka të mëvonshme do të shohin rilindjen e mençurisë nga ata që do të trashëgojnë vendin tuaj mbi këtë yll. Ata do të kthehen tek mençuria dhe do të mësojnë ta dëbojnë errësirën me anë të Dritës.

Ata do të duhet të mundohen shumë nëpërmjet të gjitha epokave për të fituar lirinë e Dritës. Të shumtë, të lidhur me errësirën, do të luftojnë për t'i larguar të tjerët nga Drita. Pastaj do të mbërrijë midis njerëzve lufta e madhe që do ta bëjë Tokën të dridhet dhe do ta tundë nga kursi i vet i drejtimit. Po, Vëllezërit e Territ do të provokojnë luftën midis Dritës dhe errësirës. Kur njeriu sërish do ta mposhtë oqeanin, dhe do të fluturojë në ajër me krahë si të zogjve; kur ai të ketë mësuar si ta bëjë zap rrufenë, atëherë do të fillojë koha e luftës. E madhe do të jetë beteja ndërmjet të dy forcave, e madhe beteja midis errësirës dhe Dritës. Kombet do të ngrihen kundër njëri-tjetrit duke përdorur fuqi të errëta për të sunduar Tokën. Armë të fuqishme do ta shfarosin tokësorin, derisa të zhduket gjysma e racave njerëzore. Atëherë do të mbërrijnë Bijtë e Mëngjesit, dhe do t'u japin dekretin e tyre bijve të njerëzve, duke u thënë:

"O njerëz, ndaloni së luftuari kundër vëllezërve tuaj! Vetëm në këtë mënyrë do të mund të arrini tek Drita. Ndale mosbesimin tënd, o vëllai im, ndiqni shtegun dhe dijeni që është i drejtë!"

Atëherë do ta ndalojnë luftën e tyre njerëzit, vëllai kundër vëllait, dhe babai kundër djalit. Atëherë do të lartësohet shtëpia antike e popullit tim nga vendi i tij poshtë valëve të errëta të oqeanit. Atëherë do të përhapet Epoka e Dritës me të gjithë njerëzit që do të kërkojnë të arrijnë Dritën e qëllimit. Atëherë Vëllezërit e Dritës do të mbretërojnë mbi popujt. Do të dëbohet errësira e natës. Po, bijtë e njerëzve do të përparojnë drejt së lartës, drejt qëllimit të madh. Ata do të bëhen Bij të Dritës. Shpirtrat e tyre do të jenë gjithmonë Flakë të Flakës. Dija dhe mençuria do t'i përkasin njeriut në erën e madhe sepse do t'i afrohet flakës së përjetshme, Burimit të të gjithë mençurisë, vendit të fillimit që megjithatë është Një me fundin e çdo gjëje. Po, në një kohë që duhet ende të lindë, E Gjitha do të jetë Një, dhe Një do të jetë e Gjitha. Njeriu, një flakë e e përsosur e këtij Kozmosi, do të lëvizë përpara, drejt një vendi në yjet. Po, do të lëvizë edhe deri jashtë kësaj hapësirë-kohe, në një tjetër përtej yjeve. Për një kohë të gjatë më keni dëgjuar, o bijtë e mi, për një kohë të gjatë e keni dëgjuar mençurinë e Thot-it. Tani unë po largohem prej jush për në errësirë.

Tani unë po shkoj në Sallat e Ament-it, atje për të banuar në të ardhmen kur Drita do të kthehet sërish mes njerëzve. E megjithatë, dijeni se, Shpirti im do të jetë gjithmonë me ju, për të udhëhequr hapat tuaj në shtegun e Dritës. Ruajini sekretet qe iu kam lënë, dhe sigurisht që shpirti im do t'ju mbikqyrë gjatë jetës! Mbajini sytë tuaj gjithmonë në shtegun e

mençurisë! Mbajeni gjithmonë Dritën si qëllimin tuaj! Mos lejoni të kapet Shpirti juaj nga skllavëria e errësirës; le të fluturojë ai në ngjitjen e vet drejt yjeve! Tani po nisem të iki për të banuar në Amenti. Ju do të jeni bijtë e mi në këtë jetë dhe në tjetrën. Koha do të vijë në të cilën edhe ju do të jeni të pavdekshëm, duke jetuar epokë pas epoke si një Dritë midis njerëzve. Mbikqyrni hyrjen për në Sallat e Ament-it! Ruajini sekretet që kam fshehur midis jush! Mos lejoni që mençuria t'u hidhet barbarëve! Do të duhet të mbahet sekret për ata që kërkojnë Dritën. Tani po nisem. Pranoni bekimin tim! Merrni rrugën time dhe ndiqni Dritën!

"Përzjeje Shpirtin tënd me Thelbin e Madh! Vetëdija jote le të jetë Një me Dritën e Madhe! Më thërrit kur të kesh nevojë! Përdor emrin tim tre herë rresht: Chequetet, Arelich, Volmalites".

PLLAKA XIII
ÇELËSAT E JETËS DHE TË VDEKJES

Dëgjo me vëmendje, o njeri, dëgjo mençurinë! Dëgjo Fjalën që do të të mbushë me Jetë! Dëgjo Fjalën që do të dëbojë errësirën! Dëgjo Zërin që do të dëbojë natën! Mister dhe mençuri u kam sjellë bijve të mi; dije dhe fuqi të sjella nga antikiteti. A nuk e dini se gjithçka do të dalë në dritë kur ta gjeni unitetin e së gjithës? Ti ke për të qënë Një me Mjeshtrat e Mistereve, Fitimtarët e Vdekjes dhe Mjeshtrat e Jetës. Po, ti do të njohësh lulen e jetës, zhvillimin e jetës që shndrit në Sallat. Në Shpirt, ti do të zbulosh Sallat e Amenti-it e do të kthesh mbrapsht mençurinë që jeton në Dritë. Dijeni se është sekrete hyrja për tek fuqia. Dijeni se, hyrja për tek jeta, kalon nëpërmjet vdekjes. Po, nëpërmjet vdekjes, por jo siç e njihni ju vdekjen, por një vdekje që është edhe jetë, edhe zjarr, edhe Dritë. Dëshiron ti të njohësh sekretet e thella të fshehura? Vështro në zemrën tënde ku është fshehur dija. Dije se sekreti është fshehur brenda teje, burimi i të gjithë jetës dhe burimi i të gjithë vdekjes. Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërsa unë të tregoj sekretin, të zbuloj sekretin e lashtë. Thellë në zemrën e Tokës është vendosur lulja, burimi i Shpirtit që lidh gjithçka në formën e vet. Sepse dije se Toka jeton në trup ashtu si ti je i gjallë në formën tënde vetjake. Lulja e Jetës, ashtu si ti, ka një vend për Shpirtin dhe rrjedh nëpërmjet Tokës, pikërisht si i yti rrjedh nëpërmjet formës tënde; duke i dhënë Jetë Tokës dhe bijve të saj, duke e rinovuar Shpirtin nga forma në formë. Ky është Shpirti që i jep formë trupit tënd, duke të modeluar dhe duke të formuar brenda formës tënde. Dije, o njeri, se forma jote është e dyfishtë, e ekuilibruar në polaritet gjatë formimit të vet. Mëso këtë: kur Vdekja të të afrohet me shpejtësi, kjo ndodh vetëm sepse ekuilibri yt është prishur. Ndodh vetëm sepse një pol ka humbur. Po, kur trupi yt është në ekuilibër të plotë, nuk do të mund kurrë të të prekin gishtërinjtë e vdekjes. Po, madje

edhe fatkeqësia mund të të prekë vetëm kur nuk ka ekuilibër. Kur je në ekuilibër të plotë, do të jetosh në kohë, dhe nuk do të të prekë vdekja.

Dije se je përsosmëria e ekuilibruar, dhe ekziston për shkak të ekuilibrit të poleve të tua. Kur, tek ty, bie një pol, të largohet me shpejtësi ekuilibri i jetës, dhe prandaj të afrohet vdekja e ftohtë, duke të sjellë ndryshimin e jetës të çekuilibruar. Dije se sekreti i jetës në Amenti është aftësia për të restauruar ekuilibrin e poleve. E gjithë çka ekziston, ka formë dhe jetë falë Shpirtit të jetës në polet e tij. Nuk e sheh ti që në zemrën e Tokës ndodhet ekuilibri i të gjitha gjërave që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë mbi sipërfaqen e saj? Burimi i Shpirtit tënd është nxjerrë nga zemra e Tokës, sepse në formën tënde, ti je një me Tokën. Kur ti të kesh mësuar të kontrollosh ekuilibrin tënd, atëherë do të mund të përdorësh ekuilibrin e Tokës. Ti do të ekzistosh në këtë formë derisa Toka të ekzistojë, një ndryshim në formë do të ndodhë vetëm kur edhe Toka të ndryshojë. Duke mos shijuar vdekjen, por duke qënë një me këtë planetë, duke mbajtur formën tënde derisa gjithçka të zhduket.. Dëgjo me vëmendje, o njeri, ndërsa të jap sekretin kështu që edhe ti, gjithashtu, të mos e shijosh ndryshimin.

Pozicionohu një orë në ditë me fytyrën tënde kthyer drejt polit pozitiv(veri). Një orë çdo ditë ti ktheje fytyrën tënde drejt polit negativ(jug). Ndërsa koka jote është e pozicionuar drejt veriut, sille vetëdijen tënde nga kafazi i kraharorit për tek koka. Kur koka jote është e pozicionuar drejt jugut, silli mendimet e tua nga kafazi i kraharorit tek këmbët. Eja në ekuilibër një herë në çdo shtatë ditë, dhe ekuilibri yt do ta mbajë të gjithë forcën. Po, edhe në qoftë se je i vjetër, trupi yt do të rifreskohet dhe fuqia jote do të jetë si e një të riu. Ky është sekreti i njohur nga Mjeshtrat, përmes të cilit ata ndalojnë gishtërinjtë e Vdekjes.

Mos e lerë pasdore ndjekjen e shtegut që të tregova. Sepse kur t'i afrohesh të njëqind vjetëve, të lesh pasdore këtë gjë, do të thotë që po vjen Vdekja. Dëgjoji fjalët e mia dhe ndiq shtegun! Përvetësoje ekuilibrin tënd dhe vazhdo ta jetosh jetën, o njeri! Dëgjo, o njeri, dhe mbaji në konsideratë fjalët e mia! Dëgjo me vëmendje mençurinë që po të jap në lidhje me Vdekjen!

Kur të jesh në fundin e punës që të është ngarkuar, ti mund të dëshirosh të kalosh nga kjo jetë, për të kaluar në planin e ekzistencës ku jetojnë Bijtë e Mëngjesit, dhe do të jesh si Bijtë e Dritës. Kalo pa dhimbje dhe kalo pa keqardhje në planin ku gjendet Drita e Përjetshme. Si fillim shtrihu në prehje me fytyrën drejtuar për nga Lindja. Palosi duart e tua mbi Burimin e jetës tënde (solar plexus). Vendose vetëdijen tënde në ndenjësen e jetës! Vorbulloje dhe ndaje drejt veriut dhe drejt jugut! Dërgoje ti njërën pjesë drejt veriut! Dërgoje ti pjesën tjetër drejt jugut! Lehtësoje shtrëngimin tënd pas trupit tënd! Përpara formës tënde, do të fluturojë shkëndija jote e argjendtë, përpara dhe përmbi drejt Diellit të mëngjesit, duke u shkrirë me

Dritën, duke u bashkuar me burimin e vet. Atje do të shndritë derisa të krijohet dëshira. Pastaj do të kthehet në një formë tek një vend. Dijeni, o njerëz, se në këtë mënyrë kalojnë tejpërtej Shpirtrat e mëdhenj, duke ndryshuar nga jeta në jetë, sipas vullnetit. Në këtë mënyrë shkon gjithmonë Avatari, duke patur vullnetin mbi Vdekjen e vet, ashtu si ai ka vullnetin mbi jetën e vet. Dëgjo me vëmendje, o njeri, pi nga mençuria ime! Mëso sekretin që është Zoti i Kohës! Mëso njësoj si ata, që ti i quan Mjeshtra, janë në gjendje të kujtojnë jetët e kaluara. I madh është sekreti, e megjithatë i lehtë për ta mësuar, duke të dhënë kontrollin e kohës. Kur vdekja të të afrohet me shpejtësi, mos ki frikë, sepse ti e di që je padron i Vdekjes. Relaksoje trupin tënd, mos rezisto me tension! Vendose flakën e Shpirtit tënd në zemrën tënde! Pastaj me shpejtësi shtyje për në qendrën e trekëndëshit! Mbaje për një moment, pastaj lëvize drejt qëllimit! Ky, qëllimi yt është vendi midis vetullave, vendi ku memoria e jetës duhet të ketë pushtetin. Mbaje flakën tënde këtu, në qendër të trurit tënd, derisa gishtërinjtë e Vdekjes ta shtrëngojnë Shpirtin tënd. Pastaj do të kalosh përmes gjendjes së tranzicionit, dhe sigurisht që do të të vijnë edhe kujtimet e jetës tënde. Atëherë e shkuara do të jetë një me të tashmen. Atëherë do të fiksohet memoria e gjithçkaje. Ti do të jesh i lirë nga të gjitha prapakthimet. Gjërat e të shkuarës do të jetojnë në të sotmen. Njeri, ke dëgjuar zërin e mençurisë sime. Ndiqe dhe do të jetosh përmes kohërave, njësoj si unë.

SHTESË - PLLAKA XIV:
DUKE U BËRË TRE HERË I MADHËRISHËM

Kushtoji vëmendje, o njeri, mençurisë së thellë të fshehur, e humbur në botë që nga koha e Banorëve, e humbur dhe e harruar nga njerëzit e kësaj epoke. Dije se kjo Tokë nuk është tjetër veçse një portal, i mbikqyrur nga fuqi të panjohura nga njeriu. E megjithatë Zotat e Errët fshehin hyrjen që çon tek toka e lindur në Qiell. Dije se rruga për tek sfera e Arulu-t është e mbrojtur nga barrierat që mund të hapen vetëm nga njerëzit e lindur në Dritë. Mbi Tokë, unë jam mbajtësi i çelësave të portave për në Tokën e Shenjtë. Me anë të fuqive që janë pas meje, unë kam urdhëruar që t'ia lë çelësat botës së njerëzve. Para se të nisem për të ikur, do t'ju jap sekretet se si ju do të mund të ngriheni nga lidhjet e errësirës, të flakni tutje zinxhirët e mishit që ju kanë prangosur, të ngriheni nga errësira në Dritë. Dijeni se shpirti juaj duhet të pastrohet nga errësira e tij, në të kundërt nuk do të hyni kurrë në portalet e Dritës. Prandaj unë kam vendosur midis jush Mistere, në mënyrë që Sekretet gjithmonë të mund të gjenden. Po, megjithëse njeriu bie në errësirë, Drita do të shkëlqejë gjithmonë si një udhërrëfyes. Thellë, në errësirën e mbuluar në simbolet, do të mund të gjendet gjithmonë udha për tek portali. Njeriu, në të ardhmen, do t'i

mohojë misteret, por kërkimtari do ta gjejë gjithmonë udhën. Tani unë po ju urdhëroj t'i ruani sekretet e mia, duke ia besuar vetëm kujt ju do ta keni verifikuar, kështu që i pastërti të mos mund të korruptohet, kështu që të mund të mbizotërojë fuqia e të Vërtetës.

Tani dëgjo me vëmendje zbulesën e Misterit! Kushtoji rëndësi simboleve të Misterit që po të jap! Bëjini këto një fe, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të mbetet thelbi. Ndodhen dy zona midis kësaj jete dhe Të Madhit Një, që përshkohen nga Shpirtrat që e lenë këtë Tokë; Duat, shtëpia e fuqive të iluzionit; dhe Sekhet Hetspet, Shtëpia e Perëndive. Osiris është simboli i rojes të portalit, që kthen mbrapsht shpirtrat e njerëzve të padenjë. Përtej gjendet sfera e pushteteve të të lindurve nga qielli, Arulu, toka ku kanë kaluar të Mëdhenjtë. Atje, kur të ketë përfunduar puna ime mes njerëzve, unë do t'u bashkohem të Mëdhenjve të shtëpisë sime Antike. Shtatë janë detyrat e shtëpisë së të Pushtetshmëve; Tre ruan portalin e secilës shtëpi nga errësira; Pesëmbëdhjetë janë rrugët që çojnë në Duat. Dymbëdhjetë janë shtëpitë e Zotave të Iluzionit, që përballojnë katër rrugë, secila e ndryshme nga tjetra. Dyzet e dy janë fuqitë e mëdha që vendosin vdekjen e kujt udhëton drejt portalit. Katër janë bijtë e Horus-it. Dy janë Rojet në Lindje dhe në Perëndim të Isis-it, nënës që lutet për bijtë e saj, Mbretëreshë e Hënës, pasqyrim i Diellit. Ba është Esenca që jeton përgjithmonë. Ka është hija që njeriu e njeh si jetë. Ba nuk vjen derisa nuk është mishëruar Ka. Këto janë misteret për t'i ruajtur nëpërmjet të gjitha epokave. Ato janë çelësat e jetës dhe të vdekjes. Dëgjo tani për misterin e mistereve, mëso për rrethin pa fillim dhe pa fund, forma e Atij që është Një dhe në të gjithën. Dëgjo e dëgjo, dhe ec përpara dhe zbatoje në praktikë, sepse në këtë mënyrë do të udhëtosh në rrugën që kam përshkuar unë. Mister brenda Misterit e prapëseprapë e qartë për të lindurit e Dritës, unë tani do të të zbuloj Sekretin e të gjithës. Do t'u them një sekret fillestarëve, por le të mbyllet me shul porta plotësisht kundër të pafeve.

Tre *është misteri, që vjen nga I Madhi Një. Dëgjo dhe Drita do të agojë tek ti. Në zanafillë banonin tre njësi. Përtej këtyre nuk mund të ekzistonte gjë tjetër. Këta janë ekuilibri, burimi i krijimit: një Zot, një e Vërtetë, një pika e lirisë. Prej të Tre-ve burojnë të tre ekuilibrat: gjithë jeta, gjithë mirësia, gjithë fuqia.*

Tre *janë cilësitë e Zotit në shtëpinë e tij të Dritës: Fuqi e Pafundme, Mençuri e Pafundme, Dashuri e Pafundme.*

Tre *janë fuqitë që u janë dhënë Zotave: të transformojnë të keqen, të asistojnë të mirën, të përdorin dallimin.*

Tre *janë gjërat që Zoti duhet t'i përmbushë në mënyrë të pashmangshme: të manifestojë Fuqi, Mençuri, Dashuri.*

Tre *janë fuqitë që krijojnë çdo gjë: Dashuria Hyjnore që zotëron dije të përsosur, Mençuria Hyjnore që njeh çdo konceptim të mundshëm, Fuqia Hyjnore përfituar nga vullneti i bashkimit të Dashurisë Hyjnore dhe Mençurinë Hyjnore.*

Tre *janë rrathët (gjendjet) e ekzistencës: rrethi i Dritës ku nuk banon askush tjetër përveç Zotit, dhe vetëm Zoti mund ta përshkojë mespërmes; rrethi i Kaosit, prej ku të gjitha gjërat prej natyre rilindin nga vdekja; rrethi i vetëdijes ku të gjitha gjërat çelin sërish nga jeta.*

Të gjitha gjërat frymore kanë tre gjendje ekzistence: kaos ose vdekje, liri në njerëzim dhe lumturinë e qiellit.

Tre *nevoja kontrollojnë të gjitha gjërat: fillimi në Thellësinë e Madhe, rrethi i kaosit, plotësia e qiellit.*

Tre *janë shtigjet e Shpirtit: njeri, liri dhe dritë.*

Tre *janë pengesat: mungesa e përpjekjeve për të fituar dije; mosngjitja pas Zotit; ngjitja pas së keqes.*

Në njeriun të tre janë të manifestuara.

Tre janë Mbretërit e fuqisë së brendshme.

Tre janë dhomat e Mistereve, të ndodhura e megjithatë të pagjendura në trupin e njeriut.

Tani dëgjo për atë që është i zgjidhur nga zinxhirët e jetës për në Dritë. Bashkë me dijen do të hapet burimi i të gjitha botëve. Po, deri edhe Portat e Arulu-t nuk mund të mbyllen. Sërish kushtoji vëmendje, o njeri, kujt nuk mund të hyjë në qiell. Në qoftë se ti nuk do të jesh i denjë, është më mirë të hidhesh në zjarr. Dije se hyjnorët kalojnë përmes flakës së pastër. Në çdo revolucion të qiejve, ata lahen në burimet e Dritës. Dëgjo me vëmendje, o njeri, këtë mister: në një të shkuar të largët, para se ti të lindje si njeri, unë banoja në ***Atlantidën*** antike. Atje, në Tempull, unë piva nga mençuria, e derdhur nga Banori si një çezmë Drite. Po të jap çelësin për t'u ngjitur në Praninë e Dritës në Botën e Madhe. Qëndrova unë përpara Të Shenjtit Një, i lartësuar në fronin në Lulen e Zjarrit. Ai ishte i mbuluar nga rrufetë e errësirës, megjithatë Shpirti im u thërrmua nga Lavdia e Tij.

Përpara këmbëve të Fronit të Tij si diamante, rridhnin katër lumenj zjarri. Rridhnin nëpërmjet kanale resh drejt botës së Njeriut. Salla ishte e mbushur plot me Shpirtra Hyjnorë. Pallati i yjeve ishte mrekulli e mrekullive. Lart në qiell, Shpirtrat ishin formuar si një ylber prej zjarri dhe drite diellore. Këndonin ata Lavdinë e Të Shenjtit Një. Pastaj, nga mesi i Zjarrit, erdhi një zë: ***Vështroni Lavdinë e Shkakut të Parë!*** Unë vështrova atë Dritë, lart mbi të gjitha errësirat, që reflektohej në vetë qënien time. Unë e kuptova atë siç ishte, ***Zoti i të gjithë Zotave, Shpirti i Diellit, Sovrani i Sferave diellore. Është Një, që është edhe i Pari, që nuk ka fillim, që nuk ka fund; që ka bërë çdo gjë, që qeveris gjithçka, që është i mirë, që është i drejtë, që ndriçon, që e mban (çdo gjë).*** Pastaj, nga froni rrodhi një rrezatim i madh, duke e rrethuar dhe duke e lartësuar Shpirtin tim me fuqinë e tij. Me shpejtësi lëviza nëpërmjet hapësirave Qiellore, m'u tregua misteri i mistereve, m'u tregua zemra Sekrete e Kozmosit. U transportova në tokën e Arulu-t, dhe qëndrova përpara Zotave në Shtëpitë e tyre. Ata hapën portëkalimin, kështu që munda t'i hedh një vështrim kaosit fillestar. Shpirti im u rrënqeth nga vizioni i llahtarshëm, e zmbrapsa shpirtin tim nga ai oqean i errësirës. Atëherë kuptova unë domosdoshmërinë e barrierave, kuptova domosdoshmërinë për Zotat e Arulu-t. Vetëm ata, me ekuilibrin e tyre të pafundëm, mund të qëndrojnë në rrugën e derdhjes së kaosit.

Vetëm ata mund ta mbrojnë krijimin e Zotit. Pastaj kalova përqark rrethit të Tetës. Pashë të gjithë shpirtrat që kishin mposhtur errësirën. Pashë shkëlqimin e Dritës ku ata banonin. Shumë dëshirova unë të zija vendin tim në rrethin e tyre, por po me aq zjarr dëshiroja edhe rrugën që kisha zgjedhur, kur qëndrova në Sallat e Amenti-t, dhe bëra zgjedhjen time të punës që do të më duhej të përmbushja. Unë kalova nga Sallat e Arulu-t, poshtë për tek hapësira e tokës ku dergjet trupi im. U ringjalla nga toka ku dergjesha. Qëndrova përpara Banorit, u zotova për të hequr dorë nga e drejta ime e Madhe përderisa të mos përfundoja punën time mbi Tokë, përderisa të mos kalojë Epoka e errësirës. Kushtoji vëmendje, o njeri, fjalëve që po të jap. Në to do të gjesh Thelbin e jetës. Para se të kthehem në Sallat e Amenti-t, do të të mësoj Sekretet e Sekreteve, se si ti të mund të ngrihesh në Dritë. Ruaji të pandryshuara dhe mbroji, fshehi në simbolet, kështu që, ai që është i pafe, të qeshë, të tallet dhe të heqë dorë. Në çdo tokë, jepu forma mistereve! Bëje të vështirë rrugën për kërkuesin që do ta shkelë! Në këtë mënyrë të dobtit dhe të pasigurtët do të kthehen mbrapsht. Në këtë mënyrë sekretet do të jenë të fshehura dhe të mbikqyrura, të ruajtura deri në kohën kur të kthehet rrota. Përmes epokave të errëta, shpirti im do të mbetet në tokën e thellë dhe të fshehur, duke pritur dhe duke vëzhguar. Kur dikush të ketë kaluar të gjitha provat e jashtme, thërritmëni të shfaqem nëpërmjet çelësit që u kam lënë. Pastaj, unë, Nismëtari, do të përgjigjem, do të vij nga Sallat e Perëndive të Amenti-t. Pastaj unë do ta pranoj fillestarin, dhe do t'i jap atij fjalët e pushtetit. Dëgjo dhe mbaji mend këto fjalë paralajmërimi:

"Mos eja tek unë pa u plotësuar me mençuri, i papastër në zemër apo me synime të dobëta! Përndryshe unë do të ta heq pushtetin për të më thirrur të shfaqem nga vendi ku jam duke fjetur".

Tani shko përpara dhe thërriti vëllezërit e tu, kështu që unë të mund t'ju transmetoj mençurinë time, për të ndriçuar udhën e tyre, kur unë të kem shkuar. Eja në Dhomën poshtë tempullit tim! Mos ha ushqim derisa të kalojnë tre ditë! Atje unë do të të jap thelbin e mençurisë, kështu që do të mund të shkëlqesh me fuqi midis njerëzve. Atje unë do të të jap sekretet, në mënyrë që edhe ti, të mund të ngjitesh në ***Qiejt, të njerëzve-Perëndi në të Vërtetë,*** në thelbin që ti je. Tani nisu dhe më lër të thërras ata për të cilët ti di, por që nuk i njeh ende.

SHTESË - PLLAKA XV:
SEKRETI I SEKRETEVE

Mblidhuni tani, bijtë e mi, të dëgjoni ***Sekretin e Sekreteve***, i cili do t'ju japë fuqinë të zbuloni njeriun-Perëndi, sekret që do t'ju tregojë rrugën drejt jetës së Përjetshme! Hapur do t'iu flas për ***Misteret e Zbuluara.*** Nuk do t'ju flas me fjalë me nënkuptime! Hapini veshët bijtë e mi! Dëgjojini dhe

bindjuni fjalëve që po iu jap! Pikësëpari do t'ju flas për zinxhirët e errësirës që ju mbajnë lidhur pas sferës së Tokës. Errësira dhe drita janë të dyja të së njëjtës natyrë, vetëm në dukje të ndryshme, sepse secila ka buruar nga Burimi i gjithçkaje. Errësira është çrregullsi. Drita është rregull. Errësira e transformuar është dritë e Dritës. Ky, bijtë e mi, duhet të jetë edhe qëllimi juaj: ta transformoni errësirën në Dritë. Dëgjomëni tani për misterin e natyrës, për lidhjet e jetës me Tokën ku banoni.

Dijeni se, në natyrën tuaj, ju jeni të trefishtë: **fizik, astral(yjor), dhe mendor**. ***Jeni tre në një.*** **Tre** janë cilësitë e secilës prej tyre: ***gjithsej bëhen nëntë, si lart, ashtu edhe poshtë.*** Në fizikun ndodhen këto kanale: ***gjaku*** që lëviz në lëvizje shtjellore duke reaguar bashkë me zemrën për të provokuar rrahjet e saj. ***Magnetizimi*** që lëviz përmes fijeve nervore, duke iu dhënë energji qelizave dhe indeve. ***Akasha*** që rrjedh përmes fijesh tepër të holla e megjithatë janë fije fizike, duke kompletuar kanalet. Të gjitha së bashku, të harmonizuara njëra me tjetrën, secila duke rritur jetën e trupit, formojnë strukturën e skeletit, përmes të cilit rrjedh eteri i imët. Në kontrollimin e tyre ndodhet ***Sekreti i Jetës*** të trupit. Që braktiset vetëm nga vullneti i ekspertit, atëherë kur ka përfunduar qëllimi i jetës së tij. **Tre** ***janë natyrat e Astralit,*** që është ndërmjetës i të sipërmes me të poshtmen; ***jo fizik, jo shpirtëror, por në gjendje të lëvizë lart dhe poshtë.***

Tre janë natyrat e Mendjes, mbartëse e vullnetit të të Madhit Një. Arbitër i shkakut dhe pasojës në jetën tënde. Në këtë mënyrë është formuar qënia e trefishtë, nga lart e drejtuar nga pushteti i katrës. Mbi natyrën e trefishtë të njeriut, dhe, përtej saj, ndodhet mbretëria e Vetes Shpirtërore. Në të gjenden katër cilësi, që shkëlqejnë në secilin plan të ekzistencës, por trembëdhjetë në një, numri mistik. Bazuar në cilësitë e njeriut janë Vëllezërit: secili do të drejtojë zhvillimin e qënies, secili është kanalizator i të Madhit Një. Në Tokë, njeriu ndodhet në pranga, i burgosur në hapësirë dhe në kohë në planin e tokës. Duke e rrethuar çdo planetë me një valë vibrimi, duke e lidhur kapacitetin e tij për t'u zhvilluar. E megjithatë, çelësi i çlirimit gjendet brenda njeriut. Liria mund të gjendet brenda njeriut. Kur ta çlironi veten tuaj nga trupi, vetëm atëherë do të lehtësoheni nga zinxhirët e shumtë që ju mbajnë të lidhur në planin tuaj tokësor.

Thoni fjalën **Dor-E-Lil-La!** Atëherë, për njëfarë kohe, do të ngrihet Drita juaj, dhe do të mund të kaloni lirisht barrierat e hapësirës. Për kohën sa gjysma e diellit (gjashtë orë), do të kaloni lirisht barrierat e planit tokësor, do të shihni dhe do të kuptoni kush janë ata që janë përtej jush. Po, do të mund të kaloni në botët më të larta. Do të shihni lartësitë e mundshme të zhvillimit tuaj, dhe do të njihni të gjitha ardhmëritë tokësore të Shpirtit. Ju jeni të lidhur në trupin tuaj, por do të mund të bëheni të lirë përmes fuqisë. Ky është sekreti nëpërmjet të cilit do të mund të zëvendësoni prangosjen me lirinë tuaj.

"Qoftë e qetë mendja jote! Qoftë në prehje trupi yt: i vetëdijshëm vetëm për lirinë nga mishi! Përqëndrohu në qëllimin e dëshirës tënde të zjarrtë! Mendo sërish e sërish që ti ke mundësinë të jesh i lirë! Mendo këtë fjalë: La-Um-I-L-Ganoover dhe lëre të tingëllojë vazhdimisht në mendjen tënde! Zhvendosu, nëpërmjet tingullit, drejt vendit të dëshirës tënde të zjarrtë! I lirë nga skllavëria e mishit përmes vullnetit tënd".

Dëgjo ndërsa të jap më të madhin e sekreteve: si të hysh në Sallat e Amenti-t, të hysh siç bëra unë, në pallatin e të pavdekshmëve, të qëndrosh përpara Zotave në vendet e tyre.

Vendosu i shtrirë në shpinë me trupin e relaksuar! Qetësoje mendjen në mënyrë që mos të të shqetësojë asnjë mendim! Duhet të jesh i pastër në mendje dhe në qëllimet e tua, përndryshe do të dështosh. Vizualizo Amenti-n siç ta kam përshkruar unë në Pllakat e mia! Dëshiro me gjithë zemër të jesh atje! Qëndro para Zotave me syrin e mendjes tënde! Shqipto (me mendje) fjalët e fuqisë që po të jap: Mekut-El-Shab-El Hale-Sur-Ben-El-Zabrut Zin-Efrim-Quar-El. Prehe mendjen dhe trupin tënd! E pra, ji i sigurt se do të thërritet fryma jote.

Tani po të jap Çelësin për në Shambala, vendi ku Vëllezërit e mi jetojnë në errësirë: errësirë, por e mbushur përplot me Dritën e Diellit të Errësirës së Tokës, është Dritë e Shpirtit, udhërrëfyesa për ju, atëherë kur do të ketë mbaruar dita ime. Relaksoje trupin tënd siç të kam mësuar! Kapërceji barrierat e thellësisë, tek vendi më i fshehtë. Qëndro përpara kangjellave dhe rojeve të tyre! Komandoji ata të të lejojnë të hysh me këto fjalë: Unë jam Drita. Nuk ka errësirë tek unë. Unë jam i lirë nga prangat e natës. Hapeni rrugën e të Dymbëdhjetëve dhe të Një-shit, kështu që unë të kaloj në mbretërinë e mençurisë! Kur të të refuzojnë, me siguri që kështu do të veprojnë, komandoji ata ta hapin rrugën duke iu thënë këto fjalë fuqie: Unë jam Drita. Nuk ka barriera për mua. Hapuni, ju komandoj në emër të Sekretit të Sekreteve: Edom-El-Ahim-Sabbert-Zur-Adom.

E pra, barrierat do të rrëzohen dhe rruga do të të hapet, vetëm nëse fjalët e tua do të burojnë nga e Vërteta më e lartë. Tani po ju lë, bijtë e mi. Po shkoj poshtë, e megjithatë është lart, tek Sallat do të shkoj. Fitojeni rrugën që ju sjell tek unë, bijtë e mi! Sigurisht që do të bëheni vëllezërit e mi. Kështu po i përfundoj shkrimet e mia.

Le të jenë Çelësa për ata që do të vijnë më pas! Por vetëm për ata që do të kërkojnë mençurinë time, sepse vetëm për ta unë jam Çelësi dhe Rruga.

III – MISTIKA SUFISTE

1. Para Krijimit – Fillimi - Dikur ishim një me Zotin

Zoti është Fuqi
Fuqia bëhet Dritë
Drita bëhet Vibrim
Vibrimi bëhet Zë
Zëri bëhet Fjalë
Fjala bëhet Gjuhë
Gjuha bëhet Shkrim
Njashtu
Kthehu tek Burimi
(Bava M. r. a.)



Në emër të Zotit
Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Në (*enathi)* një periudhë e pakufijshme para fillimit primar, Allahu *teala Najen* ishte i vetëm, në një gjendje të heshtjes dhe errësirës që do të thotë ende nuk ishte manifestuar, ku jetërat ende nuk ishin shfaqur. Ekzistonte ashtu i vetëm, në Vet-vete, pa e zbuluar madhërinë e Tij, duke e adhuruar Vet-veten. Në atë gjendje ekzistoi si një errësirë që përzihej dhe përfshinte të gjithë universat dhe të tërën nga e tëra – e tëra që ekzistonte ishte brenda në Të. Ishte në atë gjendje kur një pulsë filloi të rrahë brenda

në Të, duke u dridhur, flakëruar, xixëlluar, kumbuar, dhe në fund shpërtheu para si një shkëlqim madhështor.

Kur ky shkëlqim u shfaqë, errësira në të cilën Allahu xh. sh. kishte qenë u zhdukë, dhe Ai shëndriti para me një rrezëllim madhështor. Mandej Allahu e pyet shkëlqimin që ishte shfaqur nga Ai, "Kush je ti?"

Shkëlqimi, Hiri që është Nuri (drita e Allahut) ia ktheu, "O Allah! Ti je kompletimi infinitë që përfshinë të tërën nga e tëra. Të gjithë universat dhe çdo gjë aty janë brenda në Ty, të kondensuar, të kompresuar, dhe duke qëndruar, dhe të gjithë këta, duke përfshirë edhe atomet, të gjitha rrezet atomike të jetës (shpirtërat), si dhe të gjitha jetërat e të gjitha sendeve të tjera brenda në to, janë brenda në Ty, duke të adhuruar dhe lavdëruar Ty, megjithatë Ti nuk po i dëgjon ata, O i Mëshirshëm! *O Rrahman*! I Shikon se si të gjitha këto jetëra dhe atomet e gjalla që ekzistojnë brenda në Ty të lavdërojnë dhe të madhërojnë Ty, (bëjnë tesbih). "Kështu tha Nuri, Hir i mëshirës.

Tani *Allahu teala Najen* vë re të gjithë zërat, rezonancat, dhe adhurimin që po vinte nga të gjitha atomet e jetës (shpirtërat) që rrinë të fshehur brenda në Të. Ai që është *Allahu teala Najen* mandej reflekton, "Ah! Duket të jem e tëra nga e tëra! Kam qenë vetëm me kaqë miliona e miliona vite, duke e lavdëruar dhe adhuruar Veten, në harresë për të gjitha atomet e jetës që gjenden të kompresuara dhe të mbajtura brenda në Mua. Unë që është dashur ta bëj Vet-veten time të arritshëm tek të devotshmit e Mi, kisha mbetur në adhurim të Vet-vetes!"

Duke reflektuar në këtë mënyrë, Allahu bëhet i vetëdijshëm për madhërinë e Vetes së Tij. Dhe Ai arrin ta njeh Vet-veten. Tani i vetëdijshëm për të gjitha atomet e jetës në të gjithë universat të mbajtur brenda në Veten e Tij, Ai i drejtohet shkëlqimit që kishte aguar nga brendësia e Tij dhe e pyet, "Kush je ti që më zgjove Mua, më dhe realizim, dhe më bëre ta njohë Vet-veten?"

Kësaj pyetje, Nuri, urtësia e Hirit të Tij, që kishte pulsuar, shkëlqyer, rezonuar, dhe aguar brenda në Të, iu përgjegjë, "O Allah! Ishte unë që shkëlqeva, rezonova, dhe agova brenda në Ty. Unë isha brenda në Ty, i fshehur. Ti je i pashfaquri. Brenda Natyrës Origjinale të pashfaqur, Ai që është i pakrijuar je Ti. Ti më shfaqe mua dhe më mbajte të fshehur. Ishte për mua që emri Ytë hyjnorë i mirësisë, *Nur Muhamed*, kishte folur më herët, në *enathi*, pafillimshmëria e fillimit. Ai thesarë është thesar i Yti. Duke thënë kështu, Nuri i bëri përkulje në shenjë nderimi Allahut, dhe mbeti në gjendje adhurimi.

Me të parë këtë, Ai që është pa fillim (*enathi*) para fillimit primarë (*Athi*) tha: , "O Nur! O urtësi që agove brenda në dashurinë që u ngritë nga hiri i meditimit Tim! Do të të vendos në të githa atomet e jetës që i kam krijuar – brenda në secilat nga krijesat e Mija. Mëtutje, do ta krijojë *insanin* apo njeriun, që është më i lartësuari nga ta gjitha krijesat. Dhe unë do të

vendosë brenda në të në formën më të lartësuar – sikur urtësia e hirit të dashurisë Sime. O Nur! (O Drita ime!) Ashtu sikurse agove brenda në Mua dhe më bëre të vetëdijshëm për atomet e jetës (shpirtërat) që janë krijimi Im, ashtu agofshë brenda në ata që janë qenie njerëzore dhe i bëfshë që ta njohin veten dhe gjithashtu të më njohin Mua.

"Në mos dalësh nga brendësia e tyre, ata nuk do të mund të më njohin Mua. As nuk do të mund ta kuptojnë apo realizojnë vet-veten. Në çdonjërin që ti nuk do të agon do të mbetet në errësirën e krijuar nga lindja e tyre, ashtu sikurse Unë që isha në errësirë në *enathi* para fillimit primarë *athi*. Prandajë, në mënyrë që ta largojnë errësirën dhe tu japë realizim, Unë do të vendosë brenda në ta si një urtësi zgjuarsie. " Kështu shpjegoi *Allahu te ala Najen* tek urtësia e hirit të Tij.

Pafillimshmëria e Fillimit

Toka, Zjarri, Uji, Ajri, dhe Eter. Këto pesë forca përshtaten në kozmologjinë e *jetës* kryesore, dhe të futesh brenda në të duhet lënë pikëpamjen mekanike të botës që e burgosin shpirtin. Ne duhet kuptuar cka Bava e quan *Pafillimshmëria* e *Fillimit*, një dimenzion që nuk është aq shumë *para* kohe si dhe *jashtë* kohe, dhe që është edhe *tani*.

Këto janë mësime të thella-uji të një plaku të urtë. Nuk janë informata të zakonshme, dhe ne duhet të hymë aty sikur kur na bart era thellë në detë, si një shikim i shpejtë nëpërmjet ujërave të kaltërta dhe të gjelbërta të rrymave të vërteta antike që asnjë gjuhë nuk mund ti përshkruaj. Është një shpjegim i treguar nga ai që kurr nuk gënjen, që kurr nuk mund të gjejë fjalë të përshkruaj të vërtetat e parrëfyeshme.

Nga Një Heshtje e Thellë e Pafillimshmërisë Së Fillimit

Lind Një Mallëngjim Hyjnorë

Isha Një Thesarë i Fshehur Dhe Dëshirova Që Të Njihem.

Në përgjegje të këtijë Qëllimi Origjinal, një dritë e madhëruar buron nga lartë, nga brendësia e Mallëngjimit, dhe Zoti vë re se është një shkëlqim i bukur i fytyrës së Tij.

Ky është *Nuri i Muhamedit a. s. konshiencë e dëlirë e vetëdijshme për vet-veten.*

Në atë moment kur Allahu shikon në këtë dritë, të gjitha misteriet që kanë qenë të mbyllura shpërthejnë nga brendësia e Tij si rreze xixëllimash të shkëlqimit të dritës. Këta janë shpirtërat e të gjithë krijimit, dhe vendosen në elementet origjinale: tokë, zjarr, ujë, ajër, dhe eter, duke i mbushur ato me konshiencë jetësore.

Por nga natyra këto pesë forca janë armik i njëra tjetrës: uji shuan zjarrin, zjarri djeg tokën, dhe ashtu me të tjerat. Mandej Allahu vë para tyre Nurin, duke shkëlqyer me ndriçimin e hënës së plotë, duke

rezonuar me të Vërtetën e Madhe: NUK KA KOHERENCË, NUK KA KUPTIM, ASNJË QENDËR TJETËR PËRVEÇ ZOTIT.

Elementet përkulen me nderim dhe nënshtrim. Harrojnë krenarinë e dualitetit, ata janë shkrirë në të tërën nga tërheqja e bukurisë dhe energjisë së NURIT. **Kaosi** ***bëhet*** **Kozmos.**

Prototipi i marrëdhënieve midis krijimit dhe Krijuesit themelohet, një rrjedhje e pandërprerë e adhurimit dhe falënderimit. Në këtë fushë, të gjitha gjërat lulëzojnë. Ky vend quhet **Avual.** ***Sfera e Shpirtërave.***

O Zot! Ti je rrezja e hapur e dritës infinite.
Ti i vetëm je Zot, që transcendon cdo gjë,
Ti je i tëri që Ademi duhet të bëhet.
Ti je fara e imët dhe universi i madhë.
Ti je strehimi, Ti je rruga.
Ti je dora që mban, Ti je fuqia.
Ti je i pa formë, Ti je formë.
Ti je një syth dhe lulja plotësisht e hapur.
Ti je një dritë margaritari brenda në sy.

Nga Aval, *adhurimi i dëlirë, shpirtërat tonë* ***zbresin në sferën e dendur të harresës –*** **bota jonë** ***- dhe bëhen të varrosur në formën e trupit, "hija e dashurisë së Zotit. "Ketu tregimi i Thesarit të Fshehur hapet edhe një herë. Sikurse Nuri që doli nga Zoti, gjithashtu Nuri duhet të dalë nga fshehja brenda në zemrën e njeriut.***

Kur shpirti për herë të parë veshi rrobat e trupit,
Oqeani ngriti lart të gjitha dhuratat.
Kur dashuria për herë të parë shijoi buzët
E të qenurit njeri, filloi të këndojë.
Ne jemi nga një vend përtej këtij universi,
Por prap supozojmë se
Jemi nga toka dhe hiu.
Ne shkojmë duke trokitur tek dyert e të panjohurve
Të kuptojmë se kush jemi.
Ne e kërkojmë këtë botë për zgjidhjen e madhe
Të asaj që u martua me ne gjatë lindjes
Dhe shkurorëzohet në vdekje.

Eventualisht kur mallëngjimi ynë rritet në një thellësi të mjaftueshme, na sjell në prezencën e intelegjencës kulluese që ka për detyrë të rigjej Thesarin e Fshehur, "të vërtetën e thellë brenda në gënjeshtër. "Ky është këshillëdhënësi ynë i brendshëm, i Shenjti. Mendja jonë e shkapërderdhur dhe dëshirat e paplotësuara rrezistojnë, por natyra e Këshillëdhënësit është një dashuri që nuk mund të rrezistohet.

Pse mos të bëhesh i fresket nga butësia e zemrës së pranverës?

Pse mos të buzëqeshësh si një trëndafil? Pse mos të shpërndash aromë?

Në veprimin suprem të njeriut duke iu nënshtruar Këshillëdhënësit, puna e lirimit fillon. Përderisa dinamika e ndarjes së impulseve të elementeve tona kuptohet, nevoja të bëhesh Vetëvete e unifikuar bëhet një obligim që shpërndahet në jetën tonë. Zgjuarsia e lindur nga natyra fillon ta pastrojë zemrën nga papastërtitë në mënyrë që shkëlqimi madhështor i Nurit të Muhamedit a. s. të shkëlqejë përpara. Në prezencën e një parimi më të lartë organizues të dritës, elementet bëhen krijuese të metriksit të jetës. Në fund, thesari i fshehur i Nurit përfundimisht njihet në tokë ashtu si në qiell. Perdet që ndajnë Krijuesin dhe krijesën, shikuesin dhe të dukshmin, zhduken.

Fillimi i Krijimit

Ta dish – Allahu ta bëftë të mundur të arrish çka është e dashur dhe e këndshme për Të! se Allahu (I Lartësuar është Ai) së pari e krijoi shpirtin e Muhamedit (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe) nga drita e Bukurisë së Tij. Ashtu si Allahu (I Gjithëfuqishëm dhe I Lavdëruar është Ai) na ka thënë:

E krijova shpirtin e Muhamedit a. s. nga drita e fytyrës Sime.

Ashtu si Profeti a. s. ka thënë:

Sendi i parë që Allahu e krijoi ishte shpirti im [ruh]. Sendi i parë qe Allahu e krijoi ishte drita ime [nur]. Sendi i parë që Allahu krijoi ishte kalemi [kalem]. Sendi i parë që Allahu krijoi ishte intelekti. [akl].

Kjo do të thotë se ata janë të gjithë një send, që janë Realiteti i Muhamedit [el-Hakikat el-Muhamedija], por quhet "dritë [nur]"sepse është e dëlirë dhe e pamjegullosur nga Madhëria e errësirës. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) ka thënë:

Tani ka ardhur tek ju nga Allahu

Ked ja a-kum mina'llahi

Një Dritë, dhe një Libër e qartë.

Nurun va Kitabun mubin (Kur'an 5:15)

Gjithashtu quhet "intelekt [akl], "sepse i kupton të vërtetat univerzale [kullijat]. Gjithashtu quhet "kalem [kalem], "sepse është një instrument për transmetimin e njohurisë, sikurse kalemi që është një instrument në fushën e germave [të alfabetit].

Shpirti Muhamedan prandaj është fytyra e të gjitha entiteteve, e para e të gjitha qenieve dhe origjina e tyre. Ashtu si ka thënë (bekimi dhe paqja qofshin me të):

Unë jam nga Allahu dhe besimtarët janë nga unë.

Allahu i krijoi të gjithë shpirtërat nga ai në fushën e Hyjnorës [Lahut], dhe në formimin më të mirë real. "Muhamed"është emri i të gjitha qenieve njerëzore në atë fushë, dhe ai është shtëpia origjinale.

Mandej kur kaluan katër mijë vite, Allahu e krijoi Kurorën e Parajsës [Arsh] nga drita e syrit të Muhamedit (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë

paqe), dhe nga Kurora e Parajsës Ai krijoi entitetet e tjera ekzistuese. Mandej Ai i zvogloi shpirtat gjer tek niveli më i ulët i ekzistencës, që do të thotë trupat fizikë. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Mandej Ne e zvogluam atë (qenien njerëzore)
Thumma radadna-hu
Tek të ultit prej më të ultëve.
Asfal safilin. (Kur'an 95:5)

Me fjalë të tjera, zbritja e parë ishte nga fusha e Hyjnores [Lahut] në fushën e Omnipotencës [Gjabarut]. Midis këtyre dy vendeve të shenjta, Allahu (I Lartësuar është Ai) i veshi me dritën e Gjithëfuqishmërisë, që është shpirti madhështor [ruh sultani]. Mandej i dërgoi poshtë, në këtë veshje, tek fusha e Sovranitetit [Malakut], dhe i veshi me dritën e Sovranitetit, që është shpirti i palëndët [ruh ruhani]. Mandej i dërgoi më poshtë tek fusha e Dominimit [Mulk], dhe i veshi me dritën e Dominimit, që është shpirti fizikë. Mandej nga kjo Allahu i krijoi trupat.

Ashtu si ka thënë (I Lartësuar është Ai):
Nga ajo [toka] Ne ju krijuam,
Min-ha khalakna-kum
dhe në të Ne do të ju dërgojmë prap,
va fi-ha nu idu-kum
dhe Ne do të ju nxjerrim nga ajo për të dytën herë.
Wa min-ha nukhriju-kum taratan ukhra. (20:55)

Mandej Allahu (I Lartësuar është Ai) i urdhëroi shpirtërat të hynë në trupa, prandaj hynë me urdhërin e Allahut (I Lartësuar është Ai). Ashtu si ka thënë (I Gjithëfuqishëm dhe i Lavdëruari është Ai):

Dhe i fryva në të nga Shpirti Im.
Va nafakhtu fi-hi min Ruhi (Kur'an 38:72)

Kur shpirtërat u bashkuan me trupat fizikë, ata harruan marrëveshjen që e kishin kontraktuar në ditën kur Allahu i pyeti ata:

"A nuk jam Unë Zoti juaj?"dhe ata thanë: "Po me të vërtetë!"(Kur'an7:172)

Për këtë shkak, ata nuk u kthyen tek shtëpia e tyre origjinale, por i Gjithë-Mëshirshmi Burimi i Ndihmës, tregoi dhembshuri ndaj tyre. Ai dërgoi poshtë Libra Hyjnore që të ia kujtojë atyre shtëpinë origjinale. Ashtu si ka thënë (I Lartësuar është Ai):

Ne e dërguam Musën me shenjat Tona, (duke thënë):
Ve la-qad ersalna Musa bi-ajati-na
"Silli njerëzit e tu jashtë nga errësira në dritë,
En ekhrij kevma-ke mina 'z-zulumati ila' n-nuri
Dhe përkujtoju atyre ditët e Allahut. "
Ve dhekkir-hum bi-ejemi' llah. (Kur'an 14:5)

Me fjalë të tjera: ***Tua kujtosh atyre për ditët e mëparshme të bashkimit shpirtëror me Të, në shoqërinë e shpirtërave. "***

Të gjithë Profetët erdhën në këtë botë dhe u larguan tek Bota e Përtejme vetëm për shkak të këtyre këshillave, por shumë pak qenie njerëzore i kushtuan vëmendje atyre dhe shumë pak u përmalluan për shtëpinë e tyre origjinale, prandaj edhe shumë pak u kthyen në të, derisa Profesia i ishte caktuar shpirtit supremë Muhamedan, vula e Misionit dhe këshilla larg nga gabimi. Allahu e dërgoi tek ata njerëz të humbur, që tua hap sytë nga gjumi i pavëmedshëm, prandaj i tuboi ata te Allahu (I Lartësuar është Ai), të kontaktojnë me Atë, dhe takimin me Bukurinë e Tij të përjetshme. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) i tha atij:

Thuaj: "Kjo është rruga ime: Unë e thërras Allahun
Kur hadhihi sebili ad u ila 'llah:
Me njohurinë intuite, Unë dhe kushdo që më përcjell mua. "
'*ela besiretin ana ve mani 'teba' a-ni.* (Kur'an 12:108)

Profeti (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe) njëherë tha:Shoqëruesit e Mi janë sikur yjet. Cilindo që do ta përcjellni, do të këshilloheni drejtë.

Intuita vie nga syri i shpirtit që hapet brenda në zemrën e të shenjtëve (evliave). Prandaj nuk mund të përfitohet me njohurinë e jashtme të botës, por vetëm me njohurinë e Prezencës së brendshme. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Dhe ne i mësuam atij njohuri nga Prezenca Jonë.
Ve 'allamna-hu min ladun-na 'ilma. (Kur'an 18:65)

Prandaj është e nevojshme për qenien njerëzore ta përfitoj atë sy, dhe kështu të bëhet njëri nga zotëruesit e intuitës, duke marrë instrukcione nga evliaja, këshilluesi shpirtëror mësimet e të cilit kanë të bëjnë me fushën e Hyjnorës [Lahut].

O Vëllezër! Zgjohuni, dhe lutuni tek Zoti juaj për të iu falur përmes pendimit! Ashtu is Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Dhe nxitoni për të kërkuar falje tek Zoti juaj,
Va sari u ila meghfiretin min Rabi-kum
dhe një Kopsht të gjërë sa parajsa dhe toka,
va jennetin 'erdu-he's s-semavatu ve 'l-erdu
që është bërë gati për ata që me të vërtetë janë të devotshëm.
U'iddet li'l-mutekin. (Kur'an 3:133)

Bashkojuni kësaj udhe, dhe kthehuni tek Zoti juaj me këta karavana shpirtërorë. Udha shpejt do të këputet, dhe asnjë shoqërues i udhëtimit nuk do të gjindet. Ne nuk kemi ardhur që të vendosemi në këtë vend të ligë, në këtë botë të copëtuar, jo për hir të ngrënjes, pijes, dhe për ti kënaqur instinktet e vrazhda natyrore. Profeti juaj po pret, i pikëlluar për hir tëndin. Ashtu si ka thënë (Paqja qoftë me të)

Pikëllimi im është për anëtarët e Komunitetit tim që do të vinë në kohën e mëvonshme.

Njohuria që na është dërguar është në dy pjesë: egzoterike (jashtme) dhe ezoterike (brendshme), që do të thotë ligji i shenjtë [sheriati] dhe

kuptimi direkt [ma'rifa]. Allahu (I Lartësuar është Ai) na ka urdhëruar të ushtrojmë ligjin e shenjtë tek qenia jonë e jashtme, dhe kuptimin direktë tek qenia jonë e brendshme, në mënyrë që kombinimi i të dyjave të rezultoj në njohurinë e Realitetit [Hakika], sikurse frutet që prodhohen nga druri dhe gjethet. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Ai i ka ndarë të dy detërat.
mereje 'l-behreini
Ata takohen, [por] në mes tyre është një barrierë
Jeltekijan: beine-huma berzekhun
Që nuk e kalojnë
La jebghijen. (Kur'an 55:19, 20)

Realiteti nuk mund të arrihet, dhe qëllimi nuk mund të arrihet vetëm përmes njohurisë egzoterike (të jashtme). Adhurimi perfektë arrihet përmes të dy formave të njohurisë, jo njëra pa tjetrën. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Nuk i kam krijuar xhindët dhe njeriun
Ve ma khelektu 'l-xhina ve 'l-insa
Për asgjë tjetër veqse të më adhurojnë Mua.
Illa li-ja budun. (Kur'an 51:56)

Me fjalë të tjera: "Të më njohin dhe kuptojnë Mua. " Në qoftë se ndonjëri nuk e njeh dhe nuk e kupton Atë, si do të mundet ai ta adhuron Atë? Njohuria direkte arrihet duke e hequr perden e vetës së ulët (nefs) nga pasqyra e zemrës, dhe duke e pastruar dhe lustruar atë pasqyre. Atëherë do të reflekton bukurinë e thesarit të fshehur mu në sekretin e qendrës së zemrës. Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë në Traditën e Shenjtë [Hadith Kudsi]:

Isha një thesarë i fshehur dhe dëshirova që të njihem, prandaj e krijova krijimin.

Prandaj është e qartë, se Allahu (I Lartësuar është Ai) e krijoi qenien njerëzore ta njeh dhe ta kuptojë Atë.

Njohuria direkte është e dy llojeve: njohuria e atributeve [sifat] të Allahut (I Lartësuar është Ai), dhe njohuria e Esencës së Tij [Dhat]. Njohuria e atributeve përjetohet nga trupi fizikë në të dy fushat (këtë botë dhe botën e Përtejme), përderisa njohuria e Esencës përjetohet nga shpirti i shenjtë në botën e Përtejme. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Dhe ne e mbështetëm atë [Jezusin] me shpirtin e shenjtë.
Ve ejeedna-hu bi-Ruhi'l-Kudus. (Kur'an 2:87)
Ata [që e njohin Esencën] mbështetën gjithashtu me shpirtin e shenjtë.

Këto dy përjetime janë të arritshme vetëm përmes të të dy formave të njohurisë, njohurisë egzoterike (të jashtme) dhe njohurise ezoterike (të brendshme) që i përmendëm më lartë. Ashtu si Profeti (paqja qoftë me të) njëherë tha:

Njohuria [‘ilm] është e dyfishtë: njohuria e përcjellur nga gjuha, që është dëshmia e Allahut tek shërbyesit e Tij, dhe njohuria e përcjellur nga zemra, është njohuria që është e dobishme për të arritur qëllimin.

Pik së pari, qenia njerëzore ka nevojë për njohurinë e ligjit të shenjtë, në mënyrë që ta ushqejë trupin me edukim të mjaftueshëm në fushën e atributeve, që është fusha e stazave të pjekurisë. Atij mandej i duhet njohuri ezoterike (e brendshme), në mënyrë që ta ushqejë shpirtin me edukim në fushën e tij të kuptimit. Ajo mund të arrihet vetëm duke abstenuar nga të gjitha praktikat që janë në papajtueshmëri me ligjin e shenjtë dhe udhën shpirtërore [tarika]. Për të pasur sukses është e detyrueshme qëndresa e personit dhe vështirësitë shpirtërore, vetëm për hir që ta kënaqim Allahun (I Lartësuar është Ai), pa ndonjë shfaqje hipokrite [rija] dhe qëllimit për të arritur famë [sum’a]. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

“Pra kushdo që shpreson për ta takuar Zotin e tij,
Fe-men kana jerju lika a Rabbi-hi
Le të bëjë punë të drejta,
Fe-l-je’mel’emelen salihan
Dhe mos ti japë askujt asnjë copë
Ve la jushrik
Në adhurimin që i takon vetëm Zotit.
Bi-ibadeti Rabbi-hi ehada. (Kur’an 18:110)

Fusha e njohurisë direkte është fusha e Hyjnores [Lahut], dhe ajo është shtëpia origjinale, në të cilën shpirti i shenjtë ishte krijuar në formën më të bukur. Shpirti i shenjtë do të thotë shpirti i vërtetë i njeriut, që është vënë në qendrën e zemrës, dhe që manifestohet përmes pendimit, këshillave, dhe duke deklaruar pandërprerë: “Nuk ka Zot përveq Allahut [la ilaha il l’Allah]. ”Ky deklarim së pari është bërë me gjuhë, mandej me qenien e brendshme, kur zemra është bërë e gjallë.

Sufinjtë e kanë quajtur qenien e brendshme “fëmija i koncepteve shpirtërore [tifl al-me’ani], “sepse buron nga nocionet e shenjta. Quhet fëmijë për disa arsye:

1. Lind nga zemra, ashtu si fëmiu që lindë nga nëna, mandej rritet nga babai derisa gradualisht arrin pjekuri.

2. Ashtu sikurse njohuria e botës mësohet nga fëmijët e zakonshëm, njohuria shpirtërore i mësohet këtij fëmije të veçantë.

3. Fëmija i zakonshëm është i pazhytur në ndytësirat e mëkateve të jashtme, dhe ky fëmijë i veçantë gjithashtu është i pastër dhe i pazhytur në ndytësirat e politeizmit [shirk], pavëmendshmërisë, dhe trupit fizikë.

4. Në rastin e këtij fëmije të veçantë, pastërtia e formës është edhe më e madhe, prandaj shihet në ëndrra në trajtat si të engjujve.

5. Allahu (I Lartësuar është Ai) i ka përshkruar pjesëmarrsit e Kopshtit të Parajsës në terme të fëmijëve [tiflija], në të thënën e Tij (I Gjithëfuqishëm dhe Lavdëruar është Ai):

Atje i presin çunat imortal (të pavdekshem)
Jetufu 'ala-him vildanum mukhalladun. (Kur'an 56:17)
Dhe sillen rrotull, duke i pritur ata,
Ve jetufu 'alai-him
Çunat e rinjë të tyre,
Ghilmanun la-hum
Sikur të ishin margaritar të fshehur.
Ka-annahum lu'lu un maknun (Kur'an 52:24)

6. Emri "fëmijë" do të thotë ndjenjë e butësisë dhe pastërtisë së tij.

7. Emri "fëmijë" është përdorur si alegori apo një metaforë, të dëftoj lidhjen e tij me trupin dhe ngjashmërinë e tij me formën e njeriut, por vetëm për hir të krahasimit, jo për qëllim të nënvlerësimit. E paraqet gjendjen nismëtare të "fëmiut".

Ky "fëmijë"është qenia e njeriut të vërtetë, sepse ai ka një lidhje me Allahun (I Lartësuar është Ai), kështu që trupi dhe fizikaliteti nuk janë të paligjshme për të. Ashtu si Profeti (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe) njëherë tha: E kam një kohë me Allahun, kur nuk ka hapësirë për ndonjë engjull të ngritur afër (te Zoti), as për ndonjë Profet të dërguar si Lajmëtar.

Kjo i referohet (Profet të dërguar si Lajmëtar) natyrës njerëzore të Profetit (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe). Engjulli i ngritur afër (te Zoti), i referohet spiritualitetit të tij, që është krijuar nga drita e Gjithëfuqishmërisë [Gjabarut], ashtu sikur engjulli, prandaj nuk ka hyrje në dritën e Hyjnores [Lahut]. Profeti (bekimi dhe paqja qofshin me të) gjithashtu ka thënë: Allahu ka një Kopsht në të cilin nuk ka hyrija, apo pallate, apo mjaltë, apo qumësht, por ku njëri e shikon vetëm fytyrën e Allahut (I Lartësur është Ai)

Ashtu si Allahu (E Madhëruar është Lartësia e Tij) ka thënë:
Fytyrat atë ditë do të shkëlqejnë,
Vujuhun jevma'idhin nadira:
Duke shikuar drejt Zotit të tyre.
Ila Rabbi-ha nazira. (Kur'an 75-22, 23)

Ashtu si Profeti (paqja qoftë me të) tha:

Do ta shikosh Zotin tënd ashtu si e sheh hënën gjatë natës kur është e plotë. Në qoftë se engjulli dhe trupi fizikë do të hynin në këto fusha, do të bëheshin hi e pluhur. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë në Traditën e Shenjtë [Hadith Kudsi] Po ti hapja shkëlqimet e Madhështisë Sime, do të djegia çdo gjë aq largë sa do të më shihte syri.

Ashtu si Xhebraili (paqja qoftë me të) që tha: "Po të afrohesha edhe një çikë më afër se maja e gishtit, do të më merrte flaka.

2. Harresa - Ndarja nga Zoti

Nga Aval ***(adhurimi i dëlirë), shpirtërat tonë zbresin në sferën e dendur të harresës –* bota jonë *- dhe bëhen të varrosur në formën e trupit, "hija e dashurisë së Zotit. "Ketu tregimi i Thesarit të Fshehur hapet edhe një herë. Sikurse Nuri që doli nga Zoti, gjithashtu Nuri duhet të dal nga fshehja brenda në zemrën e njeriut.***

Kur e Harruam Zotin

Kur shpirtërat u bashkuan me trupat fizikë, ata **harruan** marrëveshjen që e kishin kontraktuar në ditën kur Allahu i pyeti ata:

"A nuk jam Unë Zoti juaj?"dhe ata thanë: "Po me të vërtetë!"(Kur'an7:172)

Për këtë shkak, ata nuk u kthyen tek shtëpia e tyre origjinale, por i Gjithë-Mëshirshmi Burimi i Ndihmës, tregoi dhembshuri ndaj tyre. Ai dërgoi poshtë Libra Hyjnore që të ia kujtojë atyre shtëpinë origjinale. Ashtu si ka thënë (I Lartësuar është Ai):

Ne e dërguam Musën me shenjat Tona, (duke thënë)*:*

Ve la-qad ersalna Musa bi-ajati-na

"Silli njerëzit e tu jashtë nga errësira në dritë,

En ekhrij kevma-ke mina 'z-zulumati ila' n-nuri

Dhe përkujtoju atyre ditët e Allahut. "

Ve dhekkir-hum bi-ejemi' llah. (Kur'an 14:5)

Me fjalë të tjera: **Tua kujtosh atyre për ditët e mëparshme të bashkimit shpirtëror me Të, në shoqërinë e shpirtërave. "**Të gjithë Profetët erdhën në këtë botë dhe u larguan tek Bota e Përtejme vetëm për shkak të këtyre këshillave, por shumë pak qenie njerëzore i kushtuan vëmendje atyre dhe shumë pak u përmalluan për shtëpinë e tyre origjinale, prandaj edhe shumë pak u kthyen në të, derisa Profesia i ishte caktuar shpirtit supremë Muhamedan, vula e Misionit dhe këshilla larg nga gabimi. Allahu e dërgoi tek ata njerëz të humbur, që tua hap sytë nga gjumi i pavëmedshëm, prandaj i tuboi ata te Allahu (I Lartësuar është Ai), të kontaktojnë me Atë, dhe takimin me Bukurinë e Tij të përjetshme.

3. Kujtimi i ZOTIT

Mos e braktis kujtimin veç se nuk e ndien Prezencën e Zotit në të. Harresa jote për ta kujtuar Atë është më keq se sa harresa jote gjatë përpjekjeve për ta kujtuar Atë.

Sa herë që merr frymë thuaj:

"LA ILAHE IL L'ALLAHU"

Thuaj, "La ilahe, il-l'Allahu. "Ç'fardo kohe, kurr mos rri në pauzë. Qoftë këtu apo tjetër vend, këto fjalë duhet të thuhen. Duhet të thuhen me frymën tënde. Nuk ke nevojë të bësh zë. Gjuha jote duhet ti formojë këto

fjalë me butësi brenda në gojën tënde. Duhet të thuash, "La ilahe il l'Allahu. "Kur nxjerr frymën jashtë, La ilahe: Përveq Teje asgjë nuk ekziston, duhet të nxirren me vëmendje. Lëvizja duhet të ndodhë gjatë kësaj kohe. Zëri il l'Allahu duhet të tërhiqet brenda me vëmendje dhe urtësi dhe të mbillet mirë brenda në zemrën e brendshme (kelb). Ç'fardo kohe apo ç'fardo vendi, ti duhet ti thuash këto fjalë.

Qoftë duke ecur, i/e shtrirë, zgjuar, punuar, apo duke fjetur gjatë gjithë kohës fryma, këto fjalë, kujtimi, ndjenja, vëmendja, intelekti, gjykimi, dhe urtësia duhet të funksionojnë pandërprerë. Kuptimi duhet të arrihet përmes urtësisë analitike hyjnore, dhe çdo lëvizje duhet të perceptohet. Njëri duhet të jetë i vëmendshëm për të gjitha lëvizjet. Ardhja dhe largimi i çdo fryme duhet të kuptohet. Duhet të perceptohet përmes urtësisë hyjnore luminare, me të gjithë zërat e sajë, shpjegimet dhe dritat duhet të kuptohen.

Thuaje kështu. Mos e humbë madje as një sekondë! Mendja, ndjenja, vëmendja, intelekti, gjykimi, urtësia, urtësia analitike hyjnore, urtësia luminare hyjnore, duhen të jenë të vëmendshme për këtë. Ti duhet ti sjellësh të shtatë gjendjet e vetëdijes së bashku dhe ti recitosh këto fjalë. Ti thuash këto fjalë qoftë në je ulur këtu apo diku tjetër. Është mirë ti recitosh këto fjalë vazhdimishtë pa marrë parasyshë ç'farë pune tjetër je duke bërë. Mos e kalo gati tërë kohën duke qeshur. Fryma duhet të funksionojë me këtë kujtesë pa marrë parasyshë punën që je duke e bërë. Duhet të vazhdojë kështu.

Derisa fryma vazhdon të funksionojë në këtë mënyrë, ti do të arrishë urtësi, veprimet e Zotit, dhe kualitetet e Tij. Veprimet e Zotit duhet të bëhen veprimet e tua, dhe ti duhet ta kryesh detyrën e Tij. Ju lutem bëjeni këtë.

Mos rri i shtanguar! Mos u ulë në një qosh dhe të qeshësh apo të ulesh në kopshtë dhe ti marrësh njerëzit nëpër gojë. Ç'fardo që të bësh, kjo punë duhet të vazhdojë. Kudo që të jeshë, kjo punë duhet të vazhdojë. Këto fjalë duhet të lundrojnë pandërprerë në zemrën tënde të brendshme përmes vetëdijes dhe zgjuarsisë. Qoftë në parkë apo prapa në oborrë, qoftë se je në të majtë apo në të djathtë, këto fjalë duhet të rezonojnë çdo herë.

Lutja duhet të vazhdojë! Puna për tu bashkuar me Zotin duhet të vazhdojë çdo herë! Ti duhet ta bësh këtë! Secili nga ju duhet ta bëni këtë! Ju nuk bën të qëndroni në pauzë as edhe për një minutë të shpenzimit të kohës suaj.

Kur të vini këtu për të dëgjuar urtësi, kujtesa juaj për Zotin duhet të vazhdojë. Të vini këtu, dëgjoni ligjërimin dhe fjalë urtësie. Kohën tjetër, kudo që të jeni, ju duhet të vazhdoni ti thoni këto fjalë. Ju duhet të vazhdoni ti thoni këto fjalë pa u ndalë. Ju duhet të vazhdoni të bëni këtë punë. Kjo është puna më e rëndësishme që ju mund të bëni. Në qoftë se nuk e bëni këtë dhe mbeteni në pauzë, nuk do të ketë ndonjë përparim. Kjo

punë duhet të vazhdojë çdo herë. Kur të jipet ligjeratë këtu mund të vini dhe të dëgjoni. Herave të tjera, aty ku jeni duhet ta bëni këtë punë. Vetëm atëherë të mbjellurat do të piqen. Vetëm atëherë drita do të shkëlqejë. Vetëm atëherë uniteti mund të ndodhë. Vetëm atëherë mund të bashkohemi me Zotin dhe ti kryejmë obligimet ndaj Tij. Kjo nuk mund të arrihet në ndonjë mënyrë tjetër. Mos e humb kohën! Bëjeni këtë, fëmijët e mijë.

Tregojë çdo fëmiu se kjo duhet të bëhet. Çdo fëmijë duhet tu japë guxim fëmijëve të tjerë dhe të shikon se kjo punë vazhdonë. Dy apo tre fëmijë mund të mbildhen së bashku dhe ta thonë këtë. Bëjuni thirrje atyre që janë në pauzë, dhe ftoni ata ta bëjnë këtë.

Sikurse njëri që e ushqen një foshnje me qumësht dhe ushqim, fëmijët që e dinë këtë njohuri duhet ti ushqejnë të tjerët. Fëmijët që e dinë këtë duhet tu japin qumështin e Zotit fëmijëve të tjerë. U jepni qumështin e Zotit ta pinë. Mos u ulë kotë përrethë duke menduar se unë e di si ta bëjë këtë. Ti duhet ta bësh dhe tu japësh guxim të tjerëve ta bëjnë gjithashtu. Bëjeni kështu. Mos humbë kohë. Ka mbetur vetëm pak kohë. Gjatë kësaj periudhe ne duhet ta bëjmë punën tonë dhe ta arrijmë qëllimin e kësaj pune.

Djali im, vajza ime, dëgjoni me vëmendje këto fjalë. Disa njerëz i dëgjojnë ligjëratat kur ato fliten por mandej qëndrojnë në pauze kohën tjetër. Ky veprim nuk është i mirë. Kjo nuk është mënyra se si bëhen gjërat. Nuk do të thotë se duhet të vish këtu. Ti mund të jesh këtu, atje, apo kudo, por duhet ta bësh punën tënde. Kur urtësia flitet, apo kur e vërteta shpjegohet, ti mund të vish këtu, por megjithatë, ti duhet ta bësh këtë punë kudo që të jesh. Ti duhet ti ndihmosh fëmijëve të tjerë të arrijnë pjekuri, dhe ti vetë duhet të arrishë pjekuri.

Eshtë ajo Fjalë e Vetme. Një pjesë i takonë të majtës dhe një pjesë të djathtës. Recito këto Fjalë! Kjo është Fjalë e Dëlirë: Asgjë përveq Zotit nuk ekziston. Vetëm Zoti ekziston. Unë u thashë dje se Zoti është i përjetshëm. Dhe kjo është mënyra se si të bashkohesh me Atë të Përjetshmin. Bëjeni këtë.

Vetëm në qoftë se vazhdoni ta bëni këtë do të jetë "Mirë Mëngjezi. "Përndryshe është vetëm mëngjezë. Thuaje ashtu si duhet me vendosëshmëri. Vetëm atëherë do të jetë "Mëngjezë i Mirë"për ne.

Bëhu i Vëmendshëm

Prezenca është aftësia ime për të dëshmuar veprimet, ndjenjat dhe mendimet e mia, është hapësira e vetëdijes së ekzistencës sime.

Lufto me të gjitha mendimet e huaja. Rri gjithmonë I vëmendshëm në atë ç'farë mendon dhe atë ç'farë bën, kështu që të mund ta vësh vulën e imortalitetit në çdo incident kalimtarë dhe ngjarje të jetës tënde të përditshme.

Bëhu roje. Vë re ç'farë të tërheq vëmendjen. Mësohu ta largosh vëmendjen nga objektet e padëshiruara. Ose vlen shprehja "*bëhu vigjilent në mendime dhe kujtoje vetë-veten.* "

Nigah do të thotë pamje. Që ka kuptimin se kërkuesi duhet ti bëj roje zemrës dhe ta ruajë atë duke ndaluar hyrjen e mendimeve të këqija. Prirjet e këqija e mbajnë zemrën largë nga bashkimi me Hyjnoren.

Për ta mbajtur zemrën në roje nga prirjet e këqija për pesëmbëdhjetë minuta konsiderohet një arritje e madhe. Kush e arrin fuqinë për ti bërë roje zemrës nga mendimet e këqija dhe ta mbronë atë nga prirjet e ulëta do ta njeh zemrën e tij, dhe kush e njeh zemrën e tij do ta njeh Zotin e tij. Profeti a. s. I shenjtë ka thënë, "*Kushdo që e njeh veten e njeh Zotin e tij.* "

Dëgjo heshtjen e borës. Ndiej të qarat e tokës. Shiko njëri tjetrin në sy.

Bëhu I vëmendshëm në çdo moment dhe vetëm atë moment.

Ndieje. Merre në eshtrat e tua. Lere të të transformojë.

Mësohu të heqësh dorë

Fillo ta thjeshtësosh jetën. Thjeshtëso pronën tënde, mendimet e tua, dëshirat e tua, të priturat e tua.

Kur të mund të heqësh dorë, atëherë krahët e tu happen dhe janë gati të marrin të gjitha të mirat që Zoti me mallë dëshiron të ti dhurojë.

Zhvillo intimitet me Zotin

Merre një mendim të mirë apo një nga emrat më të bukur të Zotit. Lere atë mendim apo atë emër të filtrohet përmes zemrës dhe mendjes tënde gjatë tërë ditës.

Thuaje kur të jesh në shitore duke pritur në rendë, kur të hashë drekë, kur ta gërryesh akull nga dritarja e makinës.

Lere le të vendoset thellë në zemrën tënde që të punojë për nga brenda dhe të të sjellë në një intimitet më të afërt me Zotin.

Tërheqja e përkohshme nga Bota

Ka dy lloje të tërheqjes nga bota materiale. Tërheqja e llojit të parë është e jashtme, në të cilën kërkuesi, largohet nga njerëzit në mënyre që të bie në kontakt me botën shpirtërore. Ky rezultat vie sepse shqisat e jashtme (meqenëse jashte kontaktit me botën e materiale) tërhiqen dhe shqisat e brendshme zgjerohen gjer sa të arrijnë shenjat e botës shpirtërore.

Tërheqja e **llojit të dytë** është ajo e fshehur, ku kërkuesi nga brenda dëshmon sekretet e Realitetit përderisa nga jashtë është i rrethuar nga njerëz. i vetmuar në turmë njerëzish është tërheqja e llojit të dytë.

Jashtë me njerëzit, brenda me Zotin. Në të gjitha aktivitetet mbetet brenda i lirë. Mësohet të mos identifikohet me asnjë send.

Khuaja Evlia Kabir, njëri nga nxënësit e Abd ul Khaliq Ghujduvani e shpjegoi thënien "I vetmuar në turmë njerëzish:"si në vijim:

"Tërheqja në turmë njerëzish' është ajo gjendje ku njëri vazhdimishtë dhe plotësishtë është i përkushtuar në përkujtimin hyjnorë, saqë njëri mund të kalojë përmes sheshit të pazarit pa dëgjuar asnjë fjalë. "

Ata janë me Zotin dhe njëkohësishtë me njerëzit. Sikurse Profeti a. s. tha: "Unë i kam dy fytyra: njëra e kthyer nga Krijuesi dhe tjetra nga krijimi. "

Kur Bahadin Nekshbendi kishte mbërri ne Herat gjatë udhëtimit të tij për në Mekë, Amir Hyseni kishte përgaditur një ndejë për nder të tij. Në atë ndejë Amir e pyet atë:

"Meqenëse me prezencën tuaj nuk bëhet as dhikr (kujtim i Zotit) me zë, as udhëtim, as audicion me muzikë e as poezi, cila është rruga juaj?"

Ai u përgjegj, "Fjalët e pastërta të fisit të 'Abd ul-Khalik Ghujduvani, që janë ' terhiqu në turmënjerëzish" dhe ne përcjellim gjurmët e tyre. "

"C'farë është tërheqja në turmë njerëzish?" pyeti Amiri:

"Nga jashtë të jesh me njerëzit përderisa nga brenda të jesh me Zotin, "tha Nekshbendi. Amiri shprehu cudi dhe pyet, "A është e mundur një gjë e tillë?"

Bahadin Nekshbendi ia ktheu, "po të mos ishte e mundur Zoti Më i Larti nuk do ta kishte cekur në Kuran ajetin që i përshkruan ata që nuk i largon vëmendjen asgjë nga kujtimi i Zotit, madje edhe në sheshin e pazarit:

"Njerëzit që as biznesi e as profiti nuk i largon vëmendjen nga përkujtimi i Allahut"(Ku'ran 24:37)

Abu Said El-Kharrazit, një musliman sufi thotë: "Perfeksioni nuk është shfaqja e mbrekullive, por perfeksioni është të ulesh në mes të njerëzve, të shesësh dhe të blesh, të martohesh dhe të bësh fëmijë: dhe njëkohësishtë kurr të mos humbësh prezencën e Allahut, madje as edhe për një moment".

Lutja e Iluminuar – Namazi

Në këtë udhëtim, veprimet që në fillim hyjnëzohen me fjalët: ***Bismilah er Rrahman er Rrahim,***

NË EMËR TË ZOTIT, MË TË DHIMBËSHMIT, TË PLOTËMËSHIRËSHMIT

Sipas traditës Islame dhe dëshmive të mistikëve Sufinjë, Lutja – Salah apo Namazi – se pari ishte mësuar nga Engjujt, që vetë e praktikonin në adhurimin hyjnorë. Lutja është një dhuratë nga Zoti për të gjithë njerëzimin.

Sa bukur kur mëshira dhe dhembshuria dhurohen si tekste esenciale Të një Krijuesi gjithë- transcedente. Këto kualitete ushqimi e thërrasin Hyjnoren Të Gjithë-Fuqishmin, Zotin, Nënën dhe Atin. Në gramatikën e pasur Arabe, Allah është emër mashkullor, Rrahman dhe Rrahim janë femërore. Dhe rrënja e fjalës për Të dyja Rhahman dhe Rhahim është embrioni, aty ku lind jeta.

E thjeshta **Bismilah** buron nga një shkronjë e dërguar nga Profeti i bekuar Muhamed a. s. Është një dëshmi se Profeti erdhi, sikurse i bekuari Jezus a. s. para tij, si mbajtës të vërtetës dhe ringjalles se linjës antike të profetëve.

Nuk ka asnjë fjalë të vetme në gjuhën Angleze që mund të bart horizontin e fjalës Arabike *Salah (Namaz).* "Lutje, ""bekim, ""Falje, ""Hir, "nënkuptohen, por të gjitha këto fjalë nuk i dalin hak fjalës Salah dhe dështojne të bartin domethënien e saktë integruese të mrekullisë së Namazit (Salah) me devotshmërine e një zemre të nënshtruar me mocionin fizikë. Në Namaz, e tërë qenia jonë është e zënë me një ngjarje të vetme ndricuese.

Namazi që ne praktikojmë fillon me *Miraxh,* natën e fatit, Udhëtimin Nokturn mistikë e të shenjtit Profet, Muhamed a. s. i thirrur nga meditimi në supervetëdije, ai ngritet nëpërmjet qiejve dhe përtej të përzihet dhe bashkohet me Zotin, Krijuesin, *dritë mbi Dritë.*

Kur kthehet, ai sjell me vete trajtat e tokës të këtyre adhurimeve hyjnore. Lutja është një dhuratë jo vetëm për një fis apo një racë apo një fe por për gjithë njerëzimin, dhe ne e paraqesim ketu si të tillë, **një thesare për të gjithë**.

Duke levizur me Lutje si një përgjigje tek një *nevoje e brendshme* njëri tërhiqet anekënd në komunitetin e cmuar të dashuruesve mistike.

Në Thirrje të Ezanit

Thotë Libri i Shpallur:

Lereni tregetine dhe Kthejuni me devotshmeri kujtimit.

Falja të huazon një jetë të re të ditës, të lidhë si zingjire në ritmin e ciklit të shenjtë. Si një rrotë e ujit që pandërprerë e kap ujin nga lumi dhe e hedh në kopsht, Lutja na ngret lart e më lart nga preokupimet dhe na hedh në një kohë të shenjtë. Lutja na fuqizon t'i lëmë anash dhjetëmijë brengat dhe na drejton tek uniteti dhe bekimi i dëlirë në të gjitha gjërat.

Bëhu guximtarë dhe diciplino veten.
Puno. Vazhdo së gropuari, gjej burimin e ujit tënd.
Mos të shkoj mendja të largohesh nga puna.
Uji është aty gjëkundi.
Nënshtrohu praktikës së përditshme.
Besnikshmëria juaj tek ky nënshtrim
Është një këmbanë në derë.
Vazhdo, trokitë, dhe kënaqësia brenda
Eventualisht do të hapë një dritare
Mandej shiko kush është atje.

Lutja është një fushë e një force të thellë psikologjike që na ndihmon ti tejkalojmë rrezistencat e brendshme që na distancojnë nga drita. Lutja

është një shpalosje serike e mocioneve prototipe dhe gjesteve që paraqiten në një cikël

variacionesh kudo nëpër lutjet e devotshme të familjes së njerëzimit.

Namazi është jashtëzakonisht kompakt dhe një lutje e fokusuar. Me butësi na e kthen jetën tek "ajo që ne e duam me sinqeritet"pesë herë cdo ditë, dhe na tokëson këtë kthim në lëvizjet dhe njohurinë trup- zgjuarsi.

Vetë trupi është një ekran që mbronë dhe pjesërisht shfaqë dritën që flakëron brenda në prezencën tënde.

Në përcjellje të ligjit hyjnorë, toka cdo ditë bën një rrotullim komplet. Drita kalon nëpër pesë faza, kur *dielli lind*, *ngritet në zenit*, *zbret poshtë* me rrezet e pjerrëta të pasditës, *perëndon* me skuqje ngjyrash, dhe *zhduket* në errësirë. Për një Sufi, ky cikël pasqyron një periudhë kohore të jetës së njeriut: agimi ynë në këtë bote, zhvillimi ynë, pjekuria, dobësimi, dhe vdekja. Në këto pesë faza, shpirti e bën udhëtimin e tij përreth një tjetër dielli që kurr nuk lind e as perëndon.

Lutja na fton të zgjohemi nga vet-vetja jonë e cekët në këto momente

të ditës. Duke e radhitur punën tonë të devotshme me këto kohëra të fuqisë natyrore ne fillojmë të levizim me ritmet e krijimeve të Zotit në një rrugë të re, të harmonizuar me përputhjet mistike midis të jashtmës dhe të brendshmës dhe stinëve të jetës.

Mendo se si FENOMENI erdhi të trupojë nga Shkretëtira e Mos-ekzistencës në këtë materializëm. Mëngjezi dhe mbrëmja, arrijnë në një linjë të gjatë dhe marrin nga njëri tjetri, "Është radha ime tani. Dil jashtë!"

Djalit i vie mosha, dhe babai mbledh plaqkat. Ky vend i fenomenit është një shkëmbim i gjerë autostradash, me të tëra duke shkuar në drejtime nga më të ndryshmet.

Na duket se jemi ulur dhe po qëndrojmë, por në fakt jemi duke lëvizur, dhe Fantazitë e Fenomenit rrëshqasin përmes nesh si idetë përmes perdeve.

Ky qëllim u plotësoft

Falja e Namazit Pesë Herë në Ditë është e lidhur me pesë elementet e forcës të cilat janë:

Toka, Zjarri, Uji, Ajri, dhe Eter. Këto pesë forca përshtaten në kozmologjinë e *jetës*kryesore, dhe të futesh brenda në të duhet lënë pikëpamjen mekanike të botës që e burgosin shpirtin. Ne duhet kuptuar cka Bava e quan ***Pafillimshmëria*** **e** ***Fillimit***, një dimenzion që nuk është aq shumë *para* kohe si dhe *jashtë* kohe, dhe që është edhe *tani*.

Këto janë mësime të thella-uji të një plaku të urtë. Nuk janë informata të zakonshme, dhe ne duhet të hymë aty sikur kur na bart era thellë në detë, si një shikim i shpejtë nëpërmjet ujërave të kaltërta dhe të gjelbërta të rrymave të vërteta antike që asnjë gjuhë nuk mund ti përshkruaj. Është një

shpjegim i treguar nga ai që kurr nuk gënjen, që kurr nuk mund të gjejë fjalë të përshkruaj të vërtetat e parrëfyeshme.

Nga një heshtje e thellë e pafillimshmërisë së fillimit
lind një mallëngjim Hyjnorë
Isha një thesarë i fshehur dhe dëshirova që të njihem

Në përgjegje të këtijë Qëllimi Origjinal, një dritë e madhëruar buron nga lartë, nga brendësia e Mallëngjimit, dhe Zoti vë re se është një shkëlqim i bukur i fytyrës së Tij.

Ky është *Nuri i Muhamedit a. s. konshiencë e dëlirë e vetëdijshme për vet-veten.*

Në atë moment kur Allahu shikon në këtë dritë, të gjitha misteriet që kanë qenë të mbyllura shpërthejnë nga brendësia e Tij si rreze xixëllimash të shkëlqimit të dritës. Këta janë shpirtërat e të gjithë krijimit, dhe vendosen në elementet origjinale: tokë, zjarr, ujë, ajër, dhe eter, duke i mbushur ato me konshiencë jetësore.

Por nga natyra këto pesë forca janë armik i njëra tjetrës: uji shuan zjarrin, zjarri djeg tokën, dhe ashtu me të tjerat. Mandej Allahu vë para tyre Nurin, duke shkëlqyer me ndricimin e hënës së plotë, duke rezonuar me të Vërtetën e Madhe: ***NUK KA KOHERENCË, NUK KA KUPTIM, ASNJË QENDËR TJETËR PËRVEÇ ZOTIT.***

Elementet përkulen me nderim dhe nënshtrim. Harrojnë krenarinë e dualitetit, ata janë shkrirë në të tërën nga tërheqja e bukurisë dhe energjisë së NURIT. *Kaosi*bëhet *Kozmos*.

Prototipi i marrëdhënieve midis krijimit dhe Krijuesit themelohet, një rrjedhje e pandërprerë e adhurimit dhe falënderimit. Në këtë fushë, të gjitha gjërat lulëzojnë. Ky vend quhet *Avual.* Sfera e Shpirtërave.

O Zot! Ti je rrezja e hapur e dritës infinite.
Ti i vetëm je Zot, që transcendon cdo gjë,
Ti je i tëri që Ademi duhet të bëhet.
Ti je fara e imët dhe universi i madhë.
Ti je strehimi, Ti je rruga.
Ti je dora që mban, Ti je fuqia.
Ti je i pa formë, Ti je formë.
Ti je një syth dhe lulja plotësisht e hapur.
Ti je një dritë margaritari brenda në sy.

Nga *Aval,* adhurimi i dëlirë shpirtërat tonë zbresin në sferën e dendur të harresës –*bota jonë* - dhe bëhen të varrosur në formën e trupit, "hija e dashurisë së Zotit. "Ketu tregimi i Thesarit të Fshehur hapet edhe një herë. Sikurse Nuri që doli nga Zoti, gjithashtu Nuri duhet e dal nga fshehja brenda në zemrën e njeriut.

Kur shpirti për herë të parë veshi rrobat e trupit,
Oqeani ngriti lart të gjitha dhuratat.

Kur dashuria për herë të parë shijoi buzët
E të qenurit njeri, filloi të këndojë.
Ne jemi nga një vend përtej këtij universi,
por prap supozojmë se
Jemi nga toka dhe hiu.
Ne shkojmë duke trokitur tek dyert e të panjohurve
të kuptojmë se kush jemi.
Ne e kërkojmë këtë botë për zgjidhjen e madhe
Të asaj që u martua me ne gjatë lindjes
Dhe shkurorëzohet në vdekje.

Eventualisht kur mallëngjimi ynë rritet në një thellësi të mjaftueshme, na sjell në prezencën e intelegjencës kulluese që ka për detyrë të rigjej Thesarin e Fshehur, "*të vërtetën e thellë brenda në gënjeshtër*. "Ky është këshillëdhënësi ynë i brendshëm, i Shenjti. Mendja jonë e shkapërderdhur dhe dëshirat e paplotësuara rrezistojnë, por natyra e Këshillëdhënësit është një dashuri që nuk mund të rrezistohet.

Pse mos të bëhesh i fresket nga butësia e zemrës së pranverës?

Pse mos të buzëqeshësh si një trëndafil? Pse mos të shpërndash aromë?

Në veprimin suprem të njeriut duke iu nënshtruar Këshillëdhënësit, puna e lirimit fillon. Përderisa dinamika e ndarjes së impulseve të elementeve tona kuptohet, nevoja të bëhesh Vetëvete e unifikuar bëhet një obligim që shpërndahet në jetën tonë. Zgjuarsia e lindur nga natyra fillon ta pastrojë zemrën nga papastërtitë në mënyrë që shkëlqimi madhështor i Nurit të Muhamedit a. s. të shkëlqejë përpara. Në prezencën e një parimi më të lartë organizues të dritës, elementet bëhen krijuese të metriksit të jetës.

Në fund, thesari i fshehur i Nurit përfundimisht njihet *në tokë ashtu si në qiell*. Perdet që ndajnë Krijuesin dhe krijesën, shikuesin dhe të dukshmin, zhduken.

4. Kthimi – Pendimi - Dorëzimi

Qielli u ndriçua
Nga shkëlqimi i hënës
Me aq fuqi saqë u rrëzova në tokë
Dashuria jote më ka bërë të sigurtë
Se jam i gatshëm ta lë
Këtë jetë të botës
Dhe të dorëzohem
Tek Madhëria e Qenies Tënde.
(Rumi)

Rumi dhe Shemsi – Takimi

Takimi i Rumit dhe Shemsit ishte një ndodhi madhështore në evolucionin e misticizmit në planet. Me shoqërinë e tyre, kategoritë mësues dhe student, dashurues dhe I dashur, master dhe dishepuj, u shkrinë.

Xhelaledin Rumi kishte lindur në një vend të quajtur Balkh, ku tani është Afganistani. Ai ka jetuar shumicën e jetës së tij në Konia të Turqisë, ku në shekullin e 13të ishte një qendër takimi të kulturave të ndryshme në tehun Perendimorë te Rrugës së Silkut, një vend ku udhëtarët Muslimanë, Krishterë, Hindusë madje edhe Budistë përziheshin.

Jashtë përtej ideve
Të keqëbërjes dhe mirëbërjes
Ndodhet një fushë.
Do të takoj atje
(Rumi r. a.)

Rumi, në moshën tridhjetë e shtatë vjeqare, kishte arritur të bëhet doktorr I teologjisë në qendrën e shkollës së tij hyjnore. Ai ishte një dashurues venezian I të bukurës dhe të mirës, dijetar dhe artist.

Shemsi ishte një sufi endacak, I rritur në kushte të vështira dhe mendjehollë. Ishte një *bodisatva* I rrugëve që përzihej me punëtorë dhe udhëtarët e deveve, ai nuk kishte asnjë ditë shkollë. Në mënyrë spontane njerëzit tuboheshin rreth tij, edhe pse I ishte bërë shprehi të ikte nga dyert anash pa e hetuar njeri dhe largohej nga vendi, kur ndodhte kjo. Ai nuk donte përcjellës apo famë, ai dëshironte ta gjente vetëm një person që kishte shpirtë të gjërë të bëhej shoqëruesi I tij.

Ai e takoi Rumin në Konia.

Përderisa Rumi i hypur në gomar po kalonte përmes tregut të pazarit, I rrethuar nga dishepujt e tij, një I huaj me sy që shponin doli nga dera në rrugë dhe ia kapi dyzginat. Me te kapur dyzginat e gomarit I panjohuri I bën një pyetje provokuese:

"Kush është më I lartësuar, Muhamedi apo Bistami?"

Rumi ia ktheu përgjigjen e duhur, "Muhamedi. "

"Por Bistami tha, "Unë jam Lavdia!' Muhamedi tha, 'Nuk mund të të falenderoj sa duhet!'"

Përderisa Rumi deshi tia kthente përgjigjen, ai e kuptoi se ky nuk ishte një debatë seminarësh për misteriet. ***Në një treg me pluhur në qendrën jugore të Anatolisë, ai ishte takuar ball për ball me Misterien.***

Një derë tek përjetësia u hap… dhe në një akt të pastërt marramendësh të besimit, Rumit I bie të fikët dhe bie nga gomari. ***Në një instancë të zhdukjes mistike, zjarri takoi zjarrin, oqeani oqeanin, dhe Rumi ra në një qenie të pastërt.***

Kur Rumi u kfjellua, I shtrirë ne tokë, ai u përgjegj, "*Bistami morri vetëm një përtypje të njohurisë dhe mendoi se ajo ishte e tëra, por për Muhamedin madhëria vazhdimishtë shpalosej*. "

Shemsi e ndjeu thellësinë e përgjigjes. *Ky ishte ai që po e kërkonte.*

Të dy filluan seri të tërheqjes me muaj të gjatë në izolim ku hyn në një komunikim të thellë të fjalëve dhe qetësisë e quajtur *sobet.*

Disa nga studentët e Rumit e shikonin mësuesin e tyre të dashur sikur që po shterrohej shpirtërish nga një njeri I cmendur, dhe intrigat e tyre e detyruan Shemsin ta lëshojë Koninë.

Pas ca kohe Rumi e dërgon djalin e tij, Sulltan Veledin, që ta ftoj prapë Shemsin. Ai e gjeti atë në Damaskë, duke luajtur letra në lokal me një djalë të ri nga Perëndimi, që më vonë u bë I njohur me emrin Francis nga Assisi. Djali I ri po mashtronte në lojë. Kur Veledi bëri respektin më të madh për Shemsin si të një perandori të shpirtit, Francisi pranoi se po mashtronte dhe u mundua që të ia kthente të hollat Shemsit.

"Jo, "tha Shemsi, "merri dhe tua dërgosh shokëve tanë në Perëndim. "

Shemsi ishte detyruar disa herë të largohej, por ai gjithnjë kthehej me ftesën e Rumit. Më në fund me 5, Dhjetor, 1247, fanatikët e komunitetit e vranë Shemsin. Trupi u zhdukë. Rumi me muaj të tërë endej gjithandej për ta kërkuar – i vetmuar në pabesim që shoqëruesi i tij me të vërtetë është larguar. Një ditë në Damaskë ai arriti tek realizimi se nuk është e nevojshme ta kërkojë më tutje. Shemsi ishte me të, në të. Rumi e personifikoi shoqërinë. Me këtë iluminim finalë, ai filloi të këndonte poezitë e tij spontane të asaj bukurie dhe perfekcioni që tani duhen dhe cmohet anë e mbanë botës si një zbulim.

Kur Rumi vdiq, ai qe vajtuar nga Muslimanët, Krishterët, Cifutët, dhe Budistët. Përderisa ai e kishte bërë punën e tij shpirtërore sipas Sufizmit Islamik, e tërë jeta e tij ishte një dëshmi tek univerzaliteti i pakufishëm i zemrës. Sufinjtë duhen në botë sepse na kujtojnë se lavdia gjendet në realitetin tonë të brendshëm, qenia e jashtme një lloj i gjuhës që shpjegon SE: **Dashuria është feja. Universi është libri**.

Kthimi i Qenies së Njeriut tek Shtëpia Origjinale
përmes tre Fazave

Jeto në këtë botë sikur të ishe
një udhëtarë, një kalimtarë,
me rrobat dhe këpucët
plot pluhur.
Ndonjëherë i ulur
nën hijen e pemës,
ndonjëherë duke ecur
nëpër shkretëtirë.

Jeto gjithnjë si kalimtarë, sepse kjo botë
nuk është shtëpia jonë.
(Hadith)

Ka dy aspekte të qenies njerëzore: aspekti fizikë [gjusmani] dhe aspekti shpirtërorë [ruhani] Aspekti fizikë është i përbashkët tek qenia e njeriut të rëndomtë, përderisa aspekti shpirtërorë është i vecantë tek qenia e njeriut specialë.

Për qenien e rëndomtë të njeriut, kthimi tek shtëpia e tij duhet kaluar nëpër faza, duke u bazuar në implementimin praktikorë të njohurisë së ligjit të shenjtë [sheriatit], udhës shpirtërore [tarika] dhe përjetimit direktë [marifa]. Ashtu si Profeti a. s. ka thënë:

Zgjuarësia e kuptueshme është përjetimi direktë i së Vërtetës, me kusht që të praktikohet pa shfaqje hipokrite dhe me qëllim të famës.

Fazat janë në tre nivele:

1. Kopshti në fushën e **Dominimit** [Mulk], që është Kopshti i Strehimit [Mawal]

2. Kopshti në fushën e **Sovranitetit** [Malakut], që është Kopshti i Lumturisë [Naim]

3. Kopshti në fushën e **Omnipotencës** [Gjabarut], që është Kopshti i Parajsës [Firdevs]

Këtoj janë pasuritë e aspektit fizikë, kështu që trupi mund ta arrijë qëllimin e tij vetëm përmes tri formave të njohurisë korrespondente: ligji i shenjtë, udha shpirtërore, dhe përjetimi direktë. Ashtu si Profeti (paqja qoftë me të) ka thënë:

Zgjuarsia e kuptueshmërisë është përjetimi direktë i së Vërtetës dhe ta vësh në praktikë, dhe të identifikoshë falsitetin dhe ti mënjanohesh.

Ai gjithashtu ka thënë (paqja qoftë me të):

O Allah, na lejo ta shikojmë të Vërtetën si të vërtetë, dhe na e bë të mundur ta përcjellim atë. Na lejo ta shohim falsitetin si falsë, dhe na e bë të mundur ti largohemi.

Në qoftë dikush e njeh vetë-veten, ai e njeh Zotin e tij dhe Krijuesin e tij dhe i përmbahet komandës së Tij.

Në rastin e qenies speciale të njeriut, fati i tij është afrimi [te Allahu], dhe kthimi i tij përmes njohurisë së Realitetit [Hakika], që është kuptimi i Njëshmërisë [Teudi] në fushën e Hyjnorës [Lahut]. Përmes praktikës së tij të rregullt, ai mund ta përjeton këtë afërsi gjatë jetës së tij në këtë botë, qoftë në gjumë apo i zgjuar. Kur trupi fle, zemra e gjen shancën të ikën tek shtëpia e saj origjinale, ose tërësishtë ose pjesërishtë. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Allahu i merr shpirtërat në kohën e vdekjes së tyre,
dhe ajo që ende nuk ka vdekur por është në gjumë.
Ai e mbanë atë për të cilin i ka caktuar vdekje,
dhe e pushon pjesën tjetër deri tek një kohë e caktuar. (K. 39:42)

Allahu jeteuefe'l-enfuse hine meuti-ha
ue 'lleti lem temut fi menami-ha:
fe-jumsiku 'lleti keda elei-he 'l-meute
ue jusilu 'l-ukhra ila egjelin musema (39:42)

Për këtë arsye Profeti a. s. njëherë tha:

Gjumi i dijetarit është më i mirë se sa adhurimi i injorantit.

Kjo gjendje përjetohet pasi që zemra është gjallëruar nga drita afirmimit të Njëshmërisë, dhe pas përsëritjeve të njëpasnjëshme të Emrave të Unitetit nga gjuha e qenies sekrete, pa germa dhe pa zë. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë në Traditën e Shenjtë [Hadith Kudsi]:

Qenia e njeriut është sekreti Im, dhe Unë jam sekreti i tij.

Ai gjithashtu ka thënë (I Gjithëfuqishëm dhe Madhështorë është Ai):

Njohuria e qenies së brendshme është njëra nga sekretet e mia. E kam vënë në zemrat e shërbyesve të Mi, dhe asnjëri nuk është i vetëdijshëm për të, përveq Meje.

Dhe gjithashtu ka thënë (I Lartësuar është Ai)

Unë jam ashtu si robi im mendon për Mua, unë jam me atë kur ai më kujton Mua. Në qoftë se më kujton Mua kur është i vetëm, Unë e kujtoj atë brenda në veten Time, Në qoftë se më kujton Mua me shoqëri, Unë e kujtoj atë në një shoqëri edhe më të mirë.

Praktika e reflektimit [tefekur] është esenciale në këtë kontekst. Ashtu si Profeti tha (bekimi dhe paqja qofshin me të)

Një moment i reflektimit vlen më shumë se një vit i adhurimit.

Një moment i reflektimit vlen më shumë se shtatëdhjetë vite të adhurimit.

Një moment i reflektimit vlen më shumë se një mijë vite të adhurimit.

Këto të thëna bartin domethënien e qenësishme:

Në qoftë se ndonjëri reflekton në detajet e degëve [të njohurisë], një moment i reflektimit vlen më shumë se një vit i adhurimit.

Në qoftë se ndonjëri reflekton për një moment në rëndësinë e vërtetë të adhurimit të obliguar në personin, ajo vlen më shumë se shtatëdhjetë vite të adhurimit.

Në qoftë se ndonjëri reflekton për një moment në njohurinë intime të Allahut (I Lartësuar është Ai), ajo vlen më shumë se një mijë vite të adhurimit.

Përmes njohurisë intime [irfan], që do të thotë realizimi i Njëshmërisë, arif [njohësi intimë] e mbërrin Ma'rufin e tij [Atë që e njeh intimishtë] dhe të Dashurin e tij, kështu që ai fluturon me krahë shpirtërorë tek fusha e Afërsisë.

Robi që adhuron ecë në këmbë tek Kopshti i Parajsës, përderisa njohësi intimë fluturon me krahë tek Afërsia [e Zotit].

Në fjalët e poetit:

Zemrat e dashuruesve kanë sy.

Ata shohin cka shikuesit e tjerë dështojnë të shohin.
Me krahët pa pendla fluturojnë
tek Fusha e Zotit të Botërave.

Ky fluturim i nxituar zë vend në thelbin e brendshëm të njohësit intimë, që është njeriu i vërtetë, shoku i dashur i Allahut (I Gjithëfuqishëm dhe i Madhëruar është Ai), i shenjtë tek Ai sikur nusja. Sipas Ebu Jezid el-Bistamit: "*Njerëzit e Allahut janë nuset e Allahut. "* Të shenjtit [evliatë] e Allahut gjithashtu janë përshkruar si nuset e Allahut. Qëllimi është se këto "nuse"janë izoluar nga perdja intime, e dukur tek askush tjetër përveq Allahut (I Lartësuar është Ai). Në Traditën e Shenjtë [Hadith Kudsi], Ai ka thënë (I Lartësuar dhe i Madhëruar është Ai):

Të shenjtit e Mi janë nën uniformën Time. Askush nuk i vë re ata përveq Meje.

Krejt cka njerëzit vënë re për nusen është bukuria e shfaqjes së jashtme.

Sipas Jahja ibn Muadh er-Razit: ***"I shenjti [vali] është parfumi i Allahut në tokë. Triumfuesit e së Vërtetës e hetojnë aromën e tyre. "***

Kjo aromë prekë zemrat e tyre, ashtu që i bën të përmallohen për Zotin e tyre. Devotshmëria e tyre rritet në proporcion të zhdukjes së natyrës së tyre të rëndomtë, sepse afërsia rritet derisa zhdukja rritet. I shenjti bëhet i zhdukur tek konditat e tij të botës, dhe mbijeton duke e dëshmuar të Vërtetën. Atij nuk i mbetet vullnet personal, dhe nuk ka banim me askënd tjetër përveqëse me Allahun. Ai ka fuqi tërheqëse/magjike në dispozicion, por nuk ia vë mendjen atyre, sepse ai shikon c'farë të tjerët nuk shohin, dhe e konsideron se ta vë në shesh sekretin e Zotësisë është një aktë pabesimi [kufr].

Derisa lexojmë në librin e quajtur el-Mirsad: "Të gjithë ata që janë të dhënë pas fuqive tërheqëse/magjike u është vënë perde para syve të tyre. Për njerëzit e till, mbrekullia magjike është një formë e menstruacioneve. I shenjti ka njëmijë faza të udhëtojë, ku e para nga ato është porta e mbrekullive magjike. Në qoftë se në mënyrë të shëndoshë e tejkalon atë, ai mund të arrin faza të tjera, por në qoftë se jo, ai nuk mund të përparojë më tutje. "

Ebu Hamid El Gazaliu ra. (1058-1111)
Alkimist i Lumturisë

Në Emër të Zotit Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

"Që nga rinia ime e hershme, që nga atëherë kur nuk i kisha as njëzet vjet gjer më tani që i kam kaluar të pesëdhjetat, pa pritesë u zhyta në thellësite e oqeanit, pa hezitim përqafova detin e hapur duke hedhur anash në tërësi kujdesin e një frikacaku. E shpova errësirën e çdo rresistence. Ia mësyva çdo problemi, U futa në

çdo humnerë, E shqyrtova në hollësi çdo besim të çdo sekti. U mundova të le të zhveshur doktrinat më të fshehura të çdo komuniteti. Të gjithë këtë mundim e bëra në mënyrë që të dalloje ndërmjet të vërtetës dhe falcitetit, ndërmjet traditës së shëndoshë dhe inovimeve heretike. "

Është në Tus Khorasan në veri-lindje të Iranit ku ky udhëtim fillon. Në këtë vend, Gazali kishte lindur në vitin 1058, dhe po në të njëjtin vend eventualisht kthehet ti kaloje vitet e fundit të jetës së tij.

Ai ishte teolog Musliman, jurist, filozofë, psikologë, dhe mistikë i origjinës Persiane dhe mbetet njëri nga dijetarët më të cmuar të botës Muslimane sidomos mendimtarëve Musliman sufi. Ushtroi një ndikim të hatashëm në mendimtarët e Lindjes dhe Perëndimit, si në Musliman ashtu edhe në Jo-Musliman. Jeta e tij i ishte kushtuar provimit të misterieve të ekzistencës dhe duke tejkaluar dyshimet e tija filozofike dhe duke arritur iluminim shpirtërorë ai u bë një model për kërkuesit e së vërtetës kudo në botë.

Ndër figurat më të medha filozofike që ai kishte ndikuar ishin Thomas Aquinas dhe Moses Maimonides, që i dhanë formë filozofisë Latine të Perëndimit. Autor i mëse 250 librave në temat që shtriheshin që nga teologjia dhe etika, gjer tek metafizika dhe filozofia, el-Gazali arriti të bëhet i njohur me emrin "Vërtetuesi i Islamit".

El-Gazali konsiderohet si njëri nga pesë apo gjashte mendimtarët me ndikim më të madhe në historine e njerëzimit. Mesazhi i tij i madhe për prosperitetin, dhe arsyeja kryesore pse ai vlerësohet aq shumë, është se ai tregon që në zemrën e gjalle të çdo besimi dhe të çdo praktike të Islamit qëndron qëllimi shpirtërorë me vendosjen për pendim, ngritje dhe transformim. Për këtë arsye ai quhet "Vërtetuesi i Islamit". Askush tjetër nuk mban këtë titull.

Gazali kontribuoi posaqërisht në zhvillimin e një shikimi sistemtake të Sufizmit, integrimin dhe pranimin e Sufizmit në rrymën kryesore të Islamit, nga statusi margjinal që kishte marrë në atë kohe. Gazali vet ishte një student i Islamit ortodoksë, që i takonte shkollës së jurisprudencës Islamike Shafi dhe shkollës Esharite të teologjisë.

I vdes i ati në një moshe shumë të re fëmijërore. Ai dhe vëllai i tij Ahmedi bëhen studentë të medresës. I ati i tyre i la nën kujdesjen e një shoku të tij. Në vitet e hershme të jetës së tij Gazali ishte dhënë mbas studimeve formale. Vëllai i tij më i ri Ahmedi ishte gjithmonë i interesuar në Sufizëm. Në anën tjetër El-Gazali ishte i dhënë shumë mbas librave gjë që është arsyeja që ai u bë një njeri i shkolluar i një grade të lartë.

E dimë se ai ka qenë një talent i jashtzakonshëm, të gjitha faktet tregojne se ai i kishte mësuar përmendësh tekstet standarde në moshe shumë të re, i kishte shterruar mundësite intelektuale të vendit të tij në një moshe shumë të re, prandaje shkoi në krahinen fqinjë të quajtur

Amnishapur, ku u shfaqe tek këmbet e dijetarit El-Duen që ishte në sytë e mazhorancës juristi udheheqës dhe teologu kryesorë i asaj kohe.

"Prej kur isha në një moshe shumë të re, vazhdimisht kisha një etje për ti kuptuar gjërat në thelb, ashtu si janë. Për mua kjo ishte diqka që më vinte në mënyrë instinkte, një pjesë e natyrës sime ashtu Siç më ka dhuruar Zoti. Ishte një çështje e gjendjes pSiçike në mua, e jo pse unë ashtu vendosa. "

Ai tha se nuk shkruajta asgjë sa i përket teologjisë, përderisa i mësova përmendësh dymbëdhjetë mijë faqe të dijetarëve më të mëdhenjë të Islamit. Ai me të vërtete e morri gjithë këtë njohuri nga një pikëpamje e botës, nga një pikëpamje kozmologjike e bazuar në konceptin Islamik të Teuidit apo të Unitetit kulminante të Zotit. Si ky unitet manifestohet përmes shumllojshmërisë në botë. Ai foli se si dëshironte të arrijë gjer tek rrënjët e problemeve. Prandajë ai kishte zotëruar pik për pik, mësuar përmendësh, e kishte asimiluar këtë mësim brenda në vet-vete, dhe vetëm atëherë filloi të mësonte kur ishte në një moshe shumë të re

Ballafaqimi me bandën e hajdutëve

Një ditë përderisa Gazali po udhëtonte me një grup njerëzish, karavani i tyre sulmohet nga një bandë hajdutësh. Njëri nga hajdutët i afrohet Gazalit për ta plaqkitur dhe ia merr librat që Gazali i mbante.

Gazali i lutet duke i thënë:

"*Ju lutem mi ktheni librat. Nuk kanë asnjë vlerë për ju. Në ato libra gjendet e tëra që kam mësuar që nga udhetimi im në Gurgen, çdo gje që kam mësuar nga mësuesit e mi për dy vitet e fundit. Në këto libra gjendet e tëra që unë di*"

Hajduti ia kthen duke i thënë:

"*Pra, krejt çka duhet të bëjë është vetëm të ti marr këto libra dhe të zhveshë nga njouhuria që ke*", dhe ia kthen librat Gazalit.

Gazali inspirohet nga ky ballafaqim me hajdutin dhe thotë: "*Në zemrën time e kuptova se thënia e hajdutit pati një qëllim. Vendosa se ai ishte i dërguar nga Zoti të më mësoje…Pas ballafaqimit me bandën e hajdutëve vendosa që ti bëjë roje vetës time dhe njohurisë sime nga takimet e mundshme të llojit të till në të ardhshmen. I kalova tre vite duke i mësuar përmendësh të gjitha shënimet që i kisha akumuluar përderisa vazhdoja me studimet e mija nën këshillat e të zgjuarit dhe të cmuarit Imam Haramein el-Gjueini.*

Kriza e parë

"*Zingjiri i autoritetit të traditës dhe besimit të trashëguar ndaloi së qëndruari në mua. I shihja se fëmijet e të krishterëve gjithmonë rriteshin dhe bëheshin të krishterë, fëmijet e Jehudive bëheshin Jehudi, dhe fëmijet e Muslimanëve bëheshin Musliman. Gjithashtu dëgjova fjalët e thëna nga Profeti a. s. se çdo fëmije është i lindur me një natyrë të shëndoshë, janë prindërit e tij që e bëjnë atë Jehudi, Krishterë apo Zoroastrian. "*

Gazali flet për një natyrë të shëndoshë kur ai i referohet hadithit të Profetit a. s. duke përdorur fjalën fitra. Fitra do të thotë natyra njerëzore por është në një origjinalitet rrënjësore apo primordial i natyrës së njeriut. Njeriu ashtu Siç ishte krijuar në fillim nga Zoti. Dhe në qoftë se pyet nga çka përbëhet ky origjinalitet, njëri mund të thotë Dashuria e Zotit, Adhurimi i Zotit, njeriu është krijuar për Zotin. Për një adhurim më të larte ose nga një shkallë më e lartë e adhurimit të Zotit. Në qoftë se, ti shërbesh qenies njerëzore do të thotë ta njohësh Zotin, kjo nënkupton intelektin që Zoti i ka dhuruar njeriut në mënyrë që ai ta njohë Atë. Kjo njohuri natyrisht është identifikimi i të Njohurit dhe njohësit. Njëri mund të thotë kështu: 'njeriu është bërë për këtë bashkim'. Për këtë arsye them natyra primordiale e njeriut. Nga natyra njeriu është adhurues, ashtu si u krijua nga Zoti.

Gazali ishte njëri nga të parët që identifikoi dhe ndau në pesë motive shqisat e jashtme. (dëgjimi, shikimi, nuhatja, shijimi dhe prekja).

*"Pasi që deklarimi i qëllimit tim është të bëhem kërkues i së vërtetës, së pari apo në fillim më duhet të zbuloj themelin e vetë **SIGURISË**. Natyra e njeriut në gjendjen themelore apo të bazës është një zbrazëtirë e injorancës së botërave të padukshme të Zotit. Qenia njerëzore e merr këtë njohuri nepërmjet organeve të perceptimit. Në fakt çdo shqisë na është dhënë në mënyrë që në të kuptojmë botën me sendet e krijuara. Sendi i parë i krijuar në njeriun është shqisa e prekjes, Prekja na lejon të perceptojmë nxehtësine, të ftohtit, lagështine, të thatit, të lëmueshmen dhe të vrazhdën, por duke përdorur vetëm shqisën e prekjes ne nuk jemi në gjendje të perceptojmë ngjyrat dhe zërin. Pra për sa i përket shqisës së prekjes këto nuk kanë realitet."*

"Në radhë vie shqisa e shikimit. Shikimi na lejon të perceptojme ngjyra dhe trajta. Shikimi është shqisa më e thellueshme nga të gjitha shqisat. Mandej vie dëgjimi që na lejon të dëgjojmë zëra të ndryshëm, mandej vie shqisa e shijimit e kështu me radhë, përderisa të gjitha shqisat të janë prezente."

*"Kur ti mbushim përaférsishtë shtatë vjetë, një fuqi me aftësi dalluese zhvillohet në ne. Ky hap i ri në zhvillimin tonë na lejon që të kuptojmë më shumë sesa vetëm botën e shqisave. Në këtë pike ne ngritemi në një fazë më të larte. **ARSYEJA** krijohet në ne. Ne fillojme të kuptojmë gjërat abstrakte që janë të nevojshme, të mundshme apo të pamundshme. Ky është një percepcion që është i pa kapshëm apo i pa kuptuar në fazat e mëparshme. Përtej arsyes gjendet edhe një fazë tjetër; Sy të tjerë hapen me ç'rastë **VËMË RE** botën e padukshme, çka do të ndodhë në të ardhmen, dhe gjëra të tjera që tejkalojnë arsyen."*

"Kur jemi në gjumë dhe ëndërrojme, jemi të sigurtë se ajo që shohim është reale por prap se prap kur zgjohemi çka menduam të jetë një fakt i pamohueshëm ishte në fakt një iluzion. Pra çfarë vërtetimi mund të na sjell filozofia apo teologjia në mënyrë që të na garantojnë se shqisat tona nuk janë duke na mashtruar. Pavarësisht njohurisë që kisha fituar gjer më tani, ende nuk mund të zgjidhja këtë problem të thjeshtë dhe fundamentalë."

"Një luftë zhvillohej midis zemrës dhe kokës sime dhe eventualisht u sëmura fizikisht. Ishte një kohë shumë e vështirë hutimi. Sëmundja më zgjati afër 2 muaj, gjatë së cilës kohë u bëra praktikisht një folës skeptike, edhe pse jo në princip apo në shprehjen e jashtme."

"Por në fund Zoti më shëroi. E gjeta vetën të rikthyer në shëndet dhe balancë, kështu që mu bë e mundur të pranoj të vërteten e nevojshme të intelektit. Fitova besimin në karakterin e sigurisë dhe besimit të intelektit. Ky shërim nuk erdhi pas një demonstrimit sistematik apo të ndonjë argumenti, por nga një Dritë që Zoti i madhërishëm e hodhi mbi gjoksin tim. Kjo Dritë është qelësi i njohurisë më të madhe."

Autoritetet në dyshim

Në kohën e Imam El Gazalit autoriteti ishte vene në dyshim, kujt i takon autoriteti? Njerëzit fetarë nuk e pranonin autoritetin shekullar, dhe fanatikët fetarë filluan ti vrasin ata që i konsideronin pengesë në qëllimet e tyre për të arritur sovranitet fetarë. Në kohen El Gazalit sundonte një lloj rrëmuje, pështjellime. Konfuzion kishte çdo kund. Mendojë se shumë nga ne pajtohemi se në kohërat e tanishme moderne po jetojmë në një situate të ngjashme të kohës së Gazalit. Po jetojme në kohëra konfuze, në kohëra të vështira, ku gati çdo gje është vënë në pikepyetje. Askush nuk mund të shihte një dritë qartësie, dhe El-Gazali jetoi në këto kohëra gjithashtu prandaj ai konsiderohet i jashtzakonshëm me atë që arriti.

Situata politike në kohën e Gazalit ishte në shumë mënyra delikate, sigurisht shumë e komplikuar. Ekzistonte një Kalif në Bagdad, që ishte mësues dhe udhëheqës i botës Islamike Sunni. Fuqia e vërtetë politike ishte në duart e selgjukeve, dhe vezirëve. Dhe i mbeti selgjukeve të mundohen të figurojne çfarë shkolle të Islamit të adaptojne apo përkrahin.

Gazali vazhdimisht na lë të kuptojmë se njëra nga perdet kryesore që i ndalon njerëzit për të parë dritën e Zotit është fanatizmi fetarë. Ai thotë se nuk është shumë me rëndësi se cilën nga shkollat e Islamit i përcjellë. Ekzistojne kënd-vështrime të ndryshme teologjike që vlejnë për ti adoptuar. Disa mundohen të përcjellin Islamin Ortodoksë, gje që është patjetër e nevojshme për ta përcjellur, por cfardo që të bësh mos e shndërro atë besim në fanatizëm, ku e drejta fetare bëhet një rrugë që të bën të ndihesh më superior apo më i mirë se çdo kush tjetër, gje që ky fanatiziëm do të largojë nga afrimi me Zotin.

Arritja e famës

Programi dokumentarë "*Alkimisti i Lumturisë*"paraqiti se si i ra në sy el-Gazali, vezirit të Bagdadit. Gjersa Veziri po shëtiste në qytet, qëlloi afër disa studentëve të cilet po debatonin rreth Islamit. Në mesin e stundentëve ishte Gazali. Biseda ishte si në vijim.

Gazali: "*Janë injorantë Ata që dëgjojnë dikënd duke thënë 'Nuk ka tjetër Zot përveq Zotit dhe Jezusi është profeti i Tij' dhe prape i konsiderojnë ata mosbesimtarë vetëm se janë të Krishterë, . Rreziku ngelet tek ata të cilëve u mungon njohuria. Ata besojnë se edhe argumentet e shëndosha nga filozofët, duhet patjetër që të refuzohen. Pa marrë parasyshë prej nga apo nga kush i degjojnë këto argumente, sepse u mungon drita e diturisë së vërtetë, i refuzojne ato. Mendje ngushtësia e tyre dhe mungesa e njohurisë u jep atyre të drejtën të refuzojnë të gjitha argumentet*".

Një tjetër student thotë:

"*Ata që nuk pranojnë Profetin janë mosbesimtarë. "*

Një tjetër thotë:

"*Ai ka të drejtë, ata që nuk i pranojnë udhëzimet e Profetit janë mosbesimtarë*. "

Gazali:

"Në qoftë se për këtë arsye e konsideroni njërin mosbesimtarë atëherë të mos pranosh ato të thëna që ai tha dhe që janë të drejta, është gabim dhe padrejtësi. "

Studenti:

"*Ti mendon se dituria jote është aq e madhe që të lejon të kontraditosh të gjithë dijetarët e fesë?"*(dhe largohen)

Gazali:

"Një musliman injorante është shumë më I rrezikshëm se sa një mosbesimtarë. Vetëm një injorantë pranon çka është e drejtë duke u bazuar në atë se kush e ka thënë, e jo duke u bazuar në atë se çfarë është thënë"

Me të dëgjuar këtë bisede, vezirit i mbeten në zemër fjalet e Gazalit dhe e fton atë në pallatin e tij, Siç e përshkruan Gazali:

"Isha ftuar të prezentohem para vezirit Nizam Almuk, që ishte ministri kryesorë i selgjukut Sultan Malik Shah. Atje iu bashkangjita teologëve dhe ekspertëve të tij legale. "

Mikëpritja e vezirit shpjegohet si në vijim:

"*Abu Hamid Muhamed, student i ri, mirë se erdhe. Kam dëgjuar shumë për rrugën tënde të drejtësisë, diturisë, dhe filozofisë, dhe nuk e besoja plotësisht derisa e pashë me sytë e mi ku dëgjova debatin që solle argumente të bindshme, ku më binde dhe mua. Ebu Hamid Muhamed, e adhurojë mënyrën se si jeni mendjehapur, aftësinë tënde në fjalime, dhe arsyet të bindshme që ju sillni. Kam dëshirë që dituria juaj të bëhet pjesë e një audience më të gjërë. Kam menduar për këtë punë, dhe sotë jam i bindur që të emërojë udhëheqës të fakultetit të Teologjisë Nizamijah në Bagdad. Që të ju mësosh studentëve dhe atyre që janë të etur për dituri, reflektim të vetëdijshëm dhe mësimin e Unitetit. "*

Teologjia në atë kohë u bë si një *rok-end-roll* i asaj gjenerate, dhe El-Gazali ishte Ylli i madhërishëm. Tërhiqte me qindra nxënës nga vende të ndryshme që grumbulloheshin në turma të mëdha për të dëgjuar mësimet e tij. Ai u mbante ligjërata më shumë se 300 nxënësve, dhe pjesëmarrja e tij në debatet Islamike e popullarizuan atë në të gjitha territoret Islamike.

Kritikë ndaj atyre që bënin lëshime në fe

"…Reflektoja në arsyet përse njerëzit bënin lëshime në fe dhe dobësimin e tyre në besim, dhe i gjeta të jenë katër arsye në numër. "

Arsyeja që buron nga ata të zhytur në shkencën e filozofisë

Filozofët të cilët nuk i merrnin si obligim ritet fetare, ku thonin se përderisa njëri e ka kuptuar thelbin e arsyes së riteve, dhe ka arritur një dituri përtej njerëzve të rëndomte dhe vepron në të mirë të komunitetit gjithmonë, nuk e ka obligim ti mbajë ritet fetare. Ritet fetare janë obligim vetëm për masën e gjërë të njerëzve të rëndomte në mënyrë që të kontrollohen.

(Gazali i denoncon filozofet në njërën nga veprat më të mëdha të tij të quajtur "Inkoherenca e Filozofeve"e cila ndryshoi drejtimin e filozofisë së hershme Islamike, duke e larguar nga ndikimi i Grekëve antik dhe filozofisë së tyre heleniste, dhe duke e dërguar atë në drejtim të shkakut-dhe-efektit që ishin të caktuara nga Zoti apo engjujt ndërmjetësues. Ky libër kishte marrë si shënjestër në "falasifa"një grup të filozofëve Islamike të shekullit 8 deri në shekullin e 11, ku më të njohurit në mes tyre ishin Avicenna (Ibn Sina) dhe El-Farabi, që ishin bazuar tek filozofia Antike Greke. Gazali në mënyrë të rreptë denoncoi Aristotelin, Sokratin dhe shkrimtarët e tjerë Greke si mosbesimtarë dhe i etiketoi ata që u bazuan në metodat dhe idete e tyre si korruptues të besimit Islamike.)

"Shuma që ne e vlerësojme si filozofi autentike të Aristotelit, Siç ishte transmetuar nga el-Farabi dhe Ibn Sina mund të zvoglohet në tri pjesë:

1. Mosbesim,
2. Inovime,
3. dhe ajo pjesë që nuk mund të mohohet aspak"

…Shkenca e filozofëve ndahet në gjashtë pjesë: matematikë, logjikë, fizikale, metafizikë, politikë dhe moral… Në shkencat e metafizikës gjenden gabimet më të medha të filozofëve…shuma e gabimeve të tyre vie në njëzetë pika, në tri të cilat ata taxohen me mosbesim dhe shtatëmbëdhjetë me inovime…

Me mosbesim ata taxohen si në vijim:

a. E para: Se trupat fizikë të njerëzve nuk do të ringjallen në Ditën e Gjykimit, por vetëm shpirtërat do të shpërblehen apo dënohen, dhe këto shpërblime dhe dënime do të jenë vetëm spirituale, jo fizike. Ata me të vërtetë kanë të drejtë kur thonë se shpirtërat do të shpërblehen apo dënohen, se kjo është mëse e vërtetë; por është falsë refuzimi nga ta i shpërblimeve dhe dënimeve të trupit fizikë, dhe kështu blasfemuan Ligjin profetikë në këtë pikëpamje.

b. E dyta: Zoti i njeh universalet (gjërat e mëdha) por jo të imtat. Kjo është ashiqare mosbesim. Përkundrazi e vërteta është se "nga Ai nuk mund të shpëtoje as pesha e një atomi në parajsë dhe në tokë. (34. 3; cf. 10. 62/61).

c. E treta: Qëndrimi i tyre në atë se bota ska pasur fillim por gjithmonë ka ekzistuar, në të kaluarën dhe të ardhshmen.

…Në shkencat e moralit filozofët Islamikë përzien shprehjet profetike dhe të thënat e sufinjëve me shkrimet e tyre dhe nga kjo përzierje **dy gjëra të këqia rrjedhuan**: njëra në rastin e njërit që i pranon mësimet e tyre etike, dhe tjetra në rastin e njërit që i refuzon ato.

E keqja e parë:

Rasti i njërit që i refuzon mësimet etike të filozofëve është shumë seriozë. Për ndonjë person që i mungon kapaciteti mentalë, për të, meqenëse doktrina profetike dhe sufiste ishte huazuar nga filozofët me shkrimet e tyre dhe e përzirë me doktrinat fals të tyre, atëherë këtë doktrinë patjetër duhet refuzuar në tërësi, kurr të mos citohet, dhe të mohohet plotësisht kurdo që ndonjëri e citon… (duke i mohuar në këtë rast edhe të vërtetat në të)

E keqja e dytë:

Është kur njëri i pranon plotësisht mësimet e tyre etike. Për njerëzit që studiojnë librat e tyre Siç është ajo "The Brethren of Purity"dhe të tjera, dhe i shohin shkrimet profetike dhe të thënat e sufinjëve të përziera me mendimet e tyre, shpesh i pranojnë shkrimet e tyre dhe formojnë një mendim të mirë për ta. Në atë mënyrë ata i pranojnë edhe gabimet e tyre që i kanë përzier me të vërtetat e huazuara…Kjo është rruga për ti dërguar njerëzit në gabim…

2. Arsyeja që buron nga ata që janë zhytur në sufizëm

Ata thonë: ne jemi adoptuar në shkencën e sufizmit dhe kemi arritur një gradë të lartë shpirtërore që e kalon nevojën për adhurime formale (ritet fetare). Këta janë ata që janë larguar nga rruga e vërtete e sufizmit, duke keqpërdorur sufizmin.

3. Arsyeja që buron nga ata që janë të lidhur me qëndrimin e tyre për mësim autoritarë

(Batinites). Ky grup besonte vetëm në autoritetin e një imami të fshehur 3 [67 4] Gazali kundërshtoi këtij grupi në librin e tij "The Correct Balance".

4. Ata që bazohen në sjelljet e filozofeve duke thënë:

…meqenëse filozofet janë aq të menqur dhe nuk i mbajnë ritet fetare, përse ne duhet respektuar ato!

Kriza

Pas një kohe bëhet atentatë dhe e vrasin përkrahësin e El-Gazalit vezirin Nizam Almuk. Përderisa ishte e paqartë se kush qëndronte prapa

vrasjes, El-Gazali mund të ketë qenë i ndikuar nga kjo ndodhi që të fillojë dhe ta rivlerësojë mënyrën e jetesës që po bënte në Bagdad.

"*Pavarësisht nga suksesi, pasuria, dhe statusi që kisha arritur dyshimet mu kthyen. Jo në atë se çfarë besojë, por në menyrën se si po jetoja jetën time. Një jetë që isha i rrethuar nga çdo anë me një botë materiale.* "

Një ditë përderisa El-Gazali ishte duke dhënë mësimë, vëllau i tij Ahmedi hyn në klasë ku ia ndërpret mësimin duke i thënë: "*Ti ua zgjatë dorën atyre kur ata nuk kishin vullnet të ecnin përpara, por vetë ke ngelur prapa, përderisa ata kanë përparuar. Ti ke marrë rolin e një këshillëdhënësi, por ti nuk pranon këshilla. Ti flet, por nuk dëgjon. O gurë që mbrehë, edhe sa kohë do të mbrehësh hekurin, por nuk do e len vetën të mbrehet?*

Gazali nuk filloi duke e detyruar vet-vetën që qëllimisht të dyshojë. Dyshimi i vinte vet-vetiu në mendjen e tij. Atëherë ai filloi të vë në pikëpyetje pseudo-sigurine. Ai e kuptoi se duhet ta zh'bëj vet-vetën se i duhet ta riformojë vet-vetën, të kalojë përmes një transformimi shpirtëror, ta ndryshojë jetën e tij, dhe menyrën e të menduarit. Ai dëshiroi të sakrifikojë të gjitha për hir të bindjes, vërtetimit apo sigurisë. Gazali kishte aftësi dhe vullnet të sakrifikoje në mënyrë që të arrin apo merrë iluminim. Njeriu i rëndomtë nuk arrin iluminim. Njëri arrin iluminim vetëm në qoftë se e hapë zemrën te Zoti, që do të thotë **ti vdesësh vetes apo egos, ti vdesësh botës për rreth teje**. Dhe ajo ishte që arriti ta bëjë Gazali.

Ai erdhi te realizimi se e gjithë kjo njohuri intelektuale është në fakt vetëm një kamuflazhë, një maskë e injorancës, sepse ai e kuptoi se ai është **injorant** i sendit më kryesorë që është **vet-vetja**. Ai me të vërtetë e gjenë vetën në atë shkallë të krizës ku e kupton se **ai është mortal, se ai do të vdesë, a jam përgaditur për këtë udhëtimë**. Dhe kjo është e **vetmja krizë reale që ka ndonjë kuptimë për çdo njeri**. Prandaj ai u ndesh përballë një krizë të vërtetë ekzistenciale të gjendjes së njeriut, që është mortaliteti.

"*Për gjashtë muaj me rradhë vazhdimisht hidhesha midis dëshirave të botës, dhe lëngimit për jetën e përhershme. Më në fund kjo çështje nuk varej më nga unë por u bë një detyrim.*

Zoti ma bëri gjuhën time të thahet, kështu që nuk isha në gjendje të ligjëroja. Çdo ditë mundohesha me gjithë fuqinë time që ti kënaq nxënësit e mi duke u dhënë ligjërata por gjuha ime nuk mund të nxirrte asnjë fjalë, dhe as që mund të arrija asgjë!"

Ai ra në një krizë mentale, në një krizë intelektuale, dhe gradualisht u shndërrua në një krizë psikologjike që filloi ti ndikoj në ngrënjen e ushqimit, në apetitin për gjumë dhe ra në një sëmundje të rëndë.

Pendimi, sakrifica, tërheqja, nga bota materiale

I shqyrtova motivet e mia dhe arrita gjer tek përfundimi se puna ime nuk ishte e nxitur nga një dëshirë e çiltër vetëm për të kënaqur Zotin, por në vend të sajë isha i motivuar nga dëshira, për të pasur një pozitë të lartë

dhe famë publike. E kuptova me plot bindje se qëndroja buz një bregu me rërë të thërmuar, buzë një rreziku të pashmangshëm të zjarrit të ferrit, në qoftë se nuk do të ndryshoja mënyrën e jetesës sime.

Prandaj po meditoja pandërprerë në lidhje me këtë çështje për disa kohë, derisa ende kisha liri për të vendosur. Një ditë e ndieja veten të sigurtë se do ta leja Bagdadin dhe ta shkëputja veten nga ato rrethana, dhe një ditë tjetër tërhiqesha nga këto mendime. Sa e vëja një hap përpara, e vëja edhe një hap prapa. Në mëngjezë kisha një dëshirë të sinqertë të kërkoja në sendet e botës së përtejme; por derisa mbrëmja arrinte dëshirat e pasionit e mbytnin atë dhe e shndërronin në pasivitet. Dëshirat monotone filluan të më ngacmonin me zingjirët e tyre që të qëndroja ashtu si isha, derisa lajmëtari I besimit po thërriste: "Largohu! Ngritu dhe largohu! Vetëm edhe pak ka mbetur nga jeta jote, dhe një udhëtim I gjatë shtrihet para teje! Të gjitha teorit dhe praktikat në të cilat je I zhytur janë vetëm shërbim I syrit dhe falsitet! Kur do të përgaditesh për botën e përtejme, në qoftë se nuk do të përgaditesh tani? Dhe kur do ti presh këto lidhje në qoftë se nuk do ti presh tani?

Kur i kisha mendimet e tilla thirrja ishte e sigurtë dhe vendosja me seriozitet që të largohem. Mandej Shejtani/djalli kthehej në sulm dhe thoshte: "Kjo është një gjendje kaluese: prandaj ke kujdes që të mos i nënshtrohesh! Sepse shpejt do të zhduket.

E dija se rruga e Sufinjëve përmbledhë besimin intelektual dhe veprimet në praktikë. Këto veprime marrin formën e pastrimit total të pengesave në shpirtë, për ti zhveshur karakteristikat themelore dhe veset e pamoralshme. Në mënyrë që zemra të arrijë LIRINË nga çdo gje që nuk është Zot.

Besimi intelektuale ishte i lehtë, por u bë e çarte në mua se çka e dallon Sufizmin në veçanti nuk mund të kuptohet vetëm duke e studiuar, por vetëm me një përjetim të drejtpërdrejtë, me ekstazë, dhe me një transformim moral. Sufinjët nuk ishin njerëz të fjalëve por të përjetimit. Nuk më kishte mbetur më shpresë nga një plagë e ardhshme po të mos mund të arrija të jetojë një jetë me vetëdije-Zoti, dhe të tërhiqem nga dëshirat e pafryta.

Arrita të bëjë atë që mjekët e mi nuk mund të bënin, arrita ta shërojë vetën time, dhe ky shërim ishte absolut.

I shpërndava varfjnakëve pasurinë që kisha, duke mbajtur për vete vetëm aq sa të më mjaftojë për udhëtimin që do të merrja dhe për të mbështetur familjen që do e leja mbrapa, pasi që nuk pritja të kthehem më në Bagdad.

(*Ai la mbrapa të gjitha kushtet e mira dhe suksesin që kishte arritur, la mbrapa të qenit afër me khalifin në kryeqytetin e Islamit, la mbrapa famën që kishte arritur, i la të gjitha në mënyrë që të zbulojë të vërtetën, në mënyrë që të bëhet reale me vet-vetën dhe të kupton natyrën e realitetit hyjnore. Kur njëri fillon një*

udhëtim të brendshëm në drejtim të shpirtit, është mirë që njëkohësishtë njëri të fillojë një udhëtim të jashtëm në botë. Nuk është asgjë sikurse turizmi modernë ku njerëzit shpenzojnë të holla në hotele e vende luksoze për tu kënaqur. Kur njëri udhëton me vetëdije, ai arrin tek realizimi se shtëpia e njeriut nuk gjendet në ndonjë rrugë të veqantë, por është në Zotin. Prandaj një udhëtim i jashtëm konsiderohet një mbështetje shumë e mirë udhetimit të brendshëm.)

"Publikisht lajmërova që kisha vendosur të shkojë haxhillek në Mekë. Por privatisht u përgadita të udhetojë për në Siri. Morra këto masa paraprake nga friga që Khalifi dhe kolegët e mi do të kundërshtonin vendimin tim. "

(*El Gazali i kalon dhjetë vitet më të mira të jetës së tij në këtë udhëtim. Nuk e dimë saktësishte se cilat kanë qenë aktivitetet e tij. Ai me siguri bëri haxhillëkun në Mekë një vitë pas largimit nga Bagdadi, kaloi kohë edhe në Jerusalem…E dimë gjithashtu se ai kaloi shumë kohë i tërhequr në një qeli në Damaskë, dhe ky vend është i njohur dhe vizitohet edhe në kohën e tanishme. Me siguri se ai i përcolli gjurmët e të shenjtëve Sufinjë të Islamit, që thjeshtë kishin vendosur ti ndërpresin përkohësishtë lidhjet e tyre me botën dhe ta gjejnë Zotin në natyrë duke udhëtuar nëpër shkretëtirë, pyje dhe regjione malore, duke besuar në Zotë për ti mbajtur ata, dhe pandërprerë duke u munduar për të mbajtur në mendje dhe medituar në bukurinë e krijesave të Zotit, dhe duke u përpjekur për të kujtuar Zotin përmes recitimeve të Kuranit, përmes lutjeve, përmes agjerimit të shumtë, përmes takimit me njerëz të mbrekullueshëm, njerëzve të urtë, të menqur dhe të shenjtë që shpesh jetonin përkohësishtë në shkretëtirë dhe pranonin nxënës.*)

Ia kushtova vetës time tërë kohën për ta pastruar shpirtin, për ta pëmirsuar karakterin, për ta larë zemrën në përkujtim konstantë të Zotit. E vura në praktikë ç'farë kisha mësuar nga studimi i misticizmit …nga leximi I librave Siç ishin "*Ushqim për zemrën*"nga Ebu Talib el-Makki, dhe shkrimet e el-Harith el-Muhasibi, el-Xhunejd, el-Shibli dhe Ebu Jezid el-Bistamit (Mëshira e Zotit qoftë me ta).

Qëndrova në Damaskë për afër dy vite, duke bërë asgjë tjetër përveqë kultivimit të të panjohurës në vetmi. Okupimi I vetëm I imi ishte tërheqja dhe vetmia dhe ushtrimet shpirtërore dhe luftimi me parashikimin tim që tia kushtoj kohën vetes time për ta pastruar shpirtin dhe për të kultivuar virtyte dhe pastrimin e zemrës sime për ta kujtuar Zotin më Të Lartin, në mënyrën se si kisha mësuar nga shkrimet e sufinjëve. Tërhiqësha në xhaminë Umaid, hypja lartë në minare të xhamisë duke kaluar tërë ditën i mbyllur që të isha në vetmi. Mandej udhëtova nga Damaska në Jerusalem, ku shkoja çdo ditë në xhaminë El-Aksa dhe u mbyllësha aty.

Mandej një nxitje e brendëshme më bëri që të shkoj në Haxh dhe të marrë ndihmesë nga bekimet e Mekës dhe Medinës dhe nga vizita e varrit të Profetit të Zotit – Paqja dhe Mëshira e Zotit qofshin me të!- pasi e mbarova vizitën tek I Dashuri I Zotit – Paqja dhe Mëshira e Zotit qofshin me të! Mandej udhëtova në Higjaz…

(*Njëra prej gjërave më me rëndësi sa i përketë udhëtimit në misticizëm apo një përjetimi direktë të realitetit është se për Imam El-Gazalin ky përjetim ishte një shkencë. Sepse në rrënjët e shkencës është aftësia për të duplikuar eksperimentin. Në qoftë se eksperimenti mund të duplikohet apo vërtetohet atëherë si rrjedhojë kemi rezultate shkencore. Ai dëshiroi që të vërtetoje, se a me të vërtetë janë të vërteta këto përjetime që mistikët kanë deklaruar ti kenë përjetuar. Njëri mund të thotë se El-Gazali ishte një shkenctarë experimentues dhe i dha detyrë vetës së tij, se në qoftë se marrë këtë rrugë a mundem të duplikoje atë që mistikët kishin pretenduar, dhe me sakrifica të mëdha ia arriti këtij qëllimi. Pra me një përjetim personalë u bind në vërtetësinë e kësaj çështje*.)

Për dhjetë vite mbeta në atë gjendje. Gjatë kësaj kohe të vetmisë mu shfaqen gjëra të panumëruara dhe të pafundshme. Vetëm kaq do të them në mënyrë që të tjerët të ndihmohen. **E kuptova në mënyrë të sigurtë se mbi të gjithë janë Sufinjtë që mbajnë rrugën e Zotit**. Jeta e tyre është jeta më e mirë, metodat e tyre janë metodat më të shëndosha, karakteri i tyre është karakteri më i pastërt.

Në fakt nëse njëri do ti bashkonte aftësite e intelektualeve, zgjuarsin e të zgjuarve dhe gjithë diturinë e studentëve dhe nga ky bashkim të mundohen të gjithë së bashku për të gjetur dhe ndryshuar vetëm një gjë në sjelljen dhe etiken e sufinjëve dhe ta zëvendësojnë atë gjë me një gjë më të mirë, asnjë mënyrë apo rrugë për të bërë një gjë të tillë nuk do të mund të gjindej. Sepse të gjitha veprimet e tyre të jashtme dhe të brendshme, i kanë mësuar nga drita e qoshit të ngrohtë të Profesisë. Dhe përtej dritës së Profesisë nuk ka asnjë dritë në tokë prej nga iluminimi mund të arrihet. ”

Në përgjithësi si do të mund të përshkruante njëri një rrugë Siç është kjo? **Pastërtia** – detyrimi i parë – është pastërtia totale e zemrës nga çdo gjë që nuk është Zot Më i Larti. Qelësi që është analogjik tek fillimi I Faljes është zhytja e tërësishme e zemrës në kujtimin e Zotit. **Fundi është të jeshë plotësishtë i humbur në Zotin**…

Që nga fillimi I këtij Udhëtimi zbulimet dhe vizionet fillojnë, saqë edhe, kur je zgjuar, sufinjtë I shohin engjujt dhe shpirtërat e profetëve dhe i dëgjojnë zërat e tyre që vinë nga ata dhe mësojnë nga ata. Mandej “gjendja”e tyre ngritet nga vizionet e trajtave dhe ngjasimeve deri tek stazat përtej kufijve të ngushtë të shprehjeve të fjalëve: ashtu që poqëse njëri mundohet ti shprehë ato, fjalët e tij përmbajnë gabime evidente nga të cilat ai nuk do të mund ti bëjë roje vetes. Por po të flasim në përgjithësi, në fund të fundit çështja vie tek afërsia me Zotin…. Por me të vërtetë njëri që është i pushtuar nga ajo gjendje nuk bën të thotë më shumë se këto fjalë:

Ishte çka ishte e asaj çka nuk e them:

Prandaj mendo mirë, dhe mos pyet për llogari!

Arritja e vërtetimeve të pakontestueshme e dërgon njërin në njohuri.

Përjetimi intimë I të po asajë gjendje është një përjetim I frutshëm. (Ndërsa) Pranimi I favorshëm i tij I bazuar në të thëna dhe përjetimin e të

tjerëve është besim. Këto janë pra gradat apo nivelet e njohurisë – "Zoti u ngret në grada juve të cilët besoni dhe ata të cilëve u është dhënë njohuri".

Përveq këtyre njerëzve me shkallë të tilla të njohurisë ka një numër të njerëzve injorant që e refuzojnë vetë themelin e kësaj dhe çuditen nga fjalët e tilla. Ata dëgjojne dhe duke fsharë, thonë:

"E jashtzakonshme! Si guxojnë kështu!"

Për njerëz të tillë Zoti Më I Larti ka thënë:

"Dhe nga ata janë ata që ju dëgjojnë, dhe mandej, kur të largohen nga ju, u thone atyre që u është dhënë njohuria: "Çka tha ky?' Këta janë njerëz qe Zoti ua ka mbyllur Zemrat dhe qe I ndjekin dëshirat e tyre të kota"(Kur'an 47. 16/23) – prandaj Zoti I bënë ata të shurdhër dhe ua verbon sytë.

(*Në praktikë Dhikri apo përkujtimi të Allahut thuhet që Zoti në mënyrë misterioze bëhet prezent në emrin e tij, dhe me kujtimin konstant jemi në gjendje të afrohemi afër hyjnorës. Kjo është alkimia që Gazali kërkonte në mënyrë që ta pastronte zemrën dhe të transformonte vet-vetën.*

Në Sufizëm veqanërisht i kushtohet shumë rëndësi invokimit të Zotit, dhe jo vetëm në Sufizëm gjithashtu Kurani i shenjtë përmban shumë vargje për kujtimin e Zotit. Vet feja është e bazuar në kujtimin e Zotit. Sa më shumë që njëri përmendë Zotin apo thërret Zotin aq më shumë emri i tij aktualizohet në vete. Vet të drejtat fetare dhe praktikore janë të bazuara në Invokimin e Hyjnorës. Njëri mund të thotë se themeli i të gjitha praktikave fetare, rruga më e sigurtë dhe më e shkurtë drejt Zotit është Invokimi i Zotit).

Kthimi

Me kalimin e kohës gjëra të ndryshme dhe gjendja e familjes sime më shtynë që të kthehem në vendëlindje, dhe kështu u ktheva prap tek vendi im, megjithëse më parë nuk e kisha paramenduar kthimin…"

(*El-Gazali i kthehet tek qytetet metropolitane të Islamit dhe i tërë qëllimi kryesorë i këtij tregimi për muslimanët është se ai i kthehet orthodoksisë Islame në vitet e fundit të jetës së tij, por me një vizion të ri. Vizioni i tij është se vërtetimi i Islamit është një përjetim çka ai quan shijimi i realiteteve që ndodhin prapa perdeve të ekzistencës fizike. Ai është argumenti më real i fesë dhe nuk vie nepërmjet një debati sistematik të metafizikës por vie duke e përkujtuar Allahun (Dhikr), duke i pastruar synimet, duke e pastruar zemrën, dhe duke u munduar që të hape njëri vet-vetën tek shkrirja që vie nga lart...*)

Disa herë u konsultova për këtë pune me njerëz të shenjtë të Zotit, të pastër nga zemra…dhe të gjithë ata më këshilluan që largimi im nga tërheqja do të jetë një burim i së mirës së Islamit dhe drejtësisë dhe se kjo punë ishte vendosur nga Zoti – I Madhërishëm qoftë Ai! – për fillimin e këtij shekulli. Se Zoti i madhërueshëm qoftë Ai! – me të vërtete ka premtuar se do të ringjallë fenë e Tij në fillim të çdo shekulli. Kështu që shpresa ime u forcua dhe u bëra mjaft optimist për shkak të këtyre

dëshmive. Zoti më I Larti ma lehtësoi lëvizjen time në Nishapur që ta bëjë këtë punë serioze në muajin Dhu'l – Kada, 499 (Korrik, 1106 A. D.) Largimi im nga Bagdadi zuri vënd në muajin Dhu'l Kada, 488 (Nëntor, 1095 A. D.) Kështu që periudha ime totale e tërheqjes (askete) ishte njëmbëdhjetë vite…

... E di mirë, se edhe pse u ktheva për të ligjëruar, Unë me të vërtete nuk u ktheva. Sepse të kthehesh prapa do të thotë të kthehesh në personalitetin që kisha më parë.

"Teologet filozofët, dhe studentët e fesë akoma vazhdojnë të trokasin tek dera ime. Nuk e dija se çka më shumë mund të ju ofroja, por bëra për ta aq sa kisha mundësi. "

Ndër shkrimet e tij të pavdekshme përfshihen"

"Ringjallja e shkencave fetare", (*Ihya' ulum al-din*),

"Fillimi i Udhëheqjes"(*Bidayat al-hidayah*),

Autobiografia e tij", "Shpëtimi nga Gabimi"(*al-Munqidh min al-dalal*.)

"Inkoherenca e Filozofëve"(*Tahafut al-Falasifa*)

"Alkimisti I Lumturisë"(*Kimiya-ye sa'ādat*) etj.

Vdekja

(Nga Ahmedi vëllau i El-Gazalit)

Të hënën me 18 dhjetorë 1111 vëllau im Gazali u zgjua herët para agimit. Si gjithnjë e fali namazin e sabahut, dhe përgaditi vetën për të ndërruar jetë. Ai më tha të ia sjell qefinin, dhe unë ia solla. Ai e puthi atë, shtriu vetën në të dhe duke thënë: O Zot, të dorëzohem me vullnet"ndërroi jetë.

Testamenti i fundit i El-Gazalit

Nën jastakun e Gazalit, aty ku kishte ndërruar jetë, vëllau i tij, Ahmedi i gjenë vargjet e fundit të shkruara nga Gazali me siguri gjatë natës, ku kishte thënë:

Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë, të shenjtit), nuk kanë frikë e as kurrfarë brengosje? (Kur'an 10:62)

Atyre u jepet lajmërim në jetën e Dunjasë dhe në jetën tjetër. (Kur'an 10:64)

Nën jastëkun e Gazalit, aty ku kishte ndërruar jetë, vëllau i tij Ahmedi i gjenë vargjet e fundit të shkruara nga Gazali me siguri gjatë natës, ku kishte thënë:

"Thuaj shokëve të mi, kur të më shikojnë mua, të vdekur
Duke qarë dhe vajtuar me pikëllim për mua
Mos besoni që ky trup që po e shikoni jam unë
Në emër të Perëndisë, ju them, nuk jam unë,
Unë jam një shpirtë, dhe ky trup nuk është asgjë më shumë se mish
Ishte banimi im dhe rrobat e mija për një kohë
Unë jam një thesarë, që hajmalia e mbante të fshehur,
I formuar nga pluhuri, që më shërbeu si një altar

Unë jam një margaritarë, që la guaskën të braktisur,
Unë jam një zog, dhe ky trup ishte kafazi im
Prej nga kam shkuar unë tani dhe është lënë vetëm shenjë
Falenderimi i takon Zotit, që tani më liroi
Dhe e përgaditi vendin tim për mua në parajsën më të lartë,
Deri sot isha i vdekur, edhe pse i gjallë në mesin tuaj
Tani jetoj me të vërtetën, me varrin – rrobat e hedhura
Sot bisedojë me të shenjtët lartë
Pa perde në mes, E shoh Zotin ball për ball
Shikojë në "Loh – I – Mahfuz"dhe atje lexojë
Të kaluarën, të tanishmën, dhe të ardhshmen.
Ma leni shtëpine të bie në gërmadha, lëshojeni kafazin tim në tokë
Hidheni hajmalinë, nuk është shenjë më tutje
Ma leni anash mantelin, ishte vetëm rroba ime e jashtme.
Vendosni të gjitha në varrë, leni që të harrohen,
Unë kalova në rrugën time dhe ju keni mbetur prapa
Vendbanimi juaj nuk ishte më një vendqëndrim për mua
Mos mendoni se vdekja është vdekje, JO, është JETË,
Një jetë që tejkalon, çdo gje që ne vetëm mund të ëndrrojmë.
Derisa në këtë botë, ne na është lejuar gjumi
Vdekja është një gjumë, një gjumë që do të zgjatet
Mos u frikësoni kur vdekja u është afruar
Është vetëm një udhëtim për këtë shtëpi të bekuar
Kujtoni mëshirën dhe dashurinë e Zotit
Falënderojeni për mëshirën e Tij, dhe ejani pa frikë
Çka jam unë tani, edhe ju do të jeni
Sepse e di se ju jeni ashtu si jam edhe unë
Shpirtërat e gjithë njerëzve burojnë nga Zoti
Trupat e të gjithëve janë përbërë nga njëllojë
E mira dhe e keqja, gjithashtu ishte e jona
Ua solla tani një mesazh gëzimi
Paqja dhe kënaqësia e Zotit qoftë gjithmonë me ju.

***

Mensur Hallaxh r. a. (857-922) - Martir i Dashurisë

E tëra që dashuruesi dëshiron është të mbetet i vetëm me Zotin. (Mensuri El-Hellaxh r. a.)

El-Hellaxh e parashikoi dhe e mirëpriti, sakrifikimin - martirizmin e tij. Ai u lut që të falen armiqtë e tij derisa po e vrisnin.

Ibrahim-b-Fatik tha:

Kur e sollën Hellaxhin për ta kryqëzuar, dhe kur ai e pa gibetin dhe ikserët (masamir), ai qeshi aq shumë saqë sytë e tij lotonin. Mandej u kthye nga turma e njerëzve dhe e njohu Shiblin në mesin e tyre:

"Ebu Bakr, a e ke qilimin e faljes së namazit me vete?"

Shibli I tha "Po"

Hellaxh i tha: "O Shejh, shtrije për mua. "

Shibli ia shtriu qilimin e tij: Mandej Hellaxh I fali dy rekate: dhe unë isha afër tij.

Në rekatin e parë ai e recitoi Fatihen dhe vargjet e Kur'anit (2:155-157):

"Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po ti jepju myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndëshme thonë: "Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!"Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë. "

Në rekatin e dytë ai e recitoi Fatihen dhe vargjet e Kuranit (3:185)

"Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kijametit, e kush shmanget zjarrit e futet në xhennet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues. "

Dhe pasi e përfundoi edhe këtë rekat, dhe selamin final dhe *rukhsen* e tij, ai e bëri një lutje (du'a): Nuk më kujtohen të gjitha fjalët por në mesin e tyre këto:

"O Zoti ynë, Ti je Ai që rrezaton në secilën anë, pa qenë I vendosur në asnjërën anë….. "

"I sheh këta njerëz, adhuruesit e Tu,
janë mbledhur sot së bashku për të më vrarë mua,
nga pasioni për Ty, të afrohen Ty [duke ofruar sakrificë]...
Fali ata! (irhamhum)
Po tu kishe shfaqur atyre çka më ke shfaqur mua,
ata nuk do të bënin ç'farë janë duke bërë.
Dhe po të kishe fshehur nga unë
atë që Ti e ke fshehur nga ata
unë nuk do të përjetoja këtë që jam duke e përjetuar tani.
Lavdia qoftë e Jotja për atë që Ti bën!
Lavdia qoftë e Jotja për atë ç'farë Ti dëshiron!"
Dhe mandej recitoi:
Më vrani, O shokët e mi besimtarë (Uktuluni, je thikati),
Se të më vritni është të më bëni të jetoj;
Jeta ime është në vdekjen time, dhe vdekja ime është në jetën time.

Fjalët e fundit të Hellaxhit ishin:

E tëra që dashuresi dëshiron është të mbetet i vetëm me Zotin.

Vdekja e tij përshkruhet nga Attar si një akt heroik, sikur kur e dërgonin në gjykim, një Sufi e pyet:

"Cka është dashuria?"

Ai I përgjigjet:

"Do ta shikosh sotë, nesër, dhe mbasnesër. "

Ata e vranë atë ditë, e dogjën të nesërmen, dhe të mbasnesërmen e hodhën hirin e trupit të tij në ajër nga minarja e xhamisë.

"Kjo është dashuri"thotë Attar.

Kur ia prenë këmbët, ai buzëqeshi dhe tha, **"dikur ecja tokën me këto këmbë, tash ka mbetur vetëm edhe një hap për në parajsë, preje atë po të mundeni. "**

Dhe kur ia prenë duart ai e ngjyrosë fytyrën e tij me gjakun e vet, kur e pyetën pse, ai tha:

"Kam humbur shumë gjak, dhe e di se fytyra ime është zbehur, nuk dua të dukem ne qehre i zbehur, se mos mendojnë njerëzit që kam frikë".

Jeta dhe veprimtaria e tij

Jeta dhe vdekja e el-Hellaxhit, martirit, mistikut, dhe evliasë, ka qenë subjekti masivë i dy vollumeve të studimeve nga orientalisti Francez Luis Masignon, prandaj më shumë dihet për të në Perëndim sesa figurat e tjera ndikuese të të njëjtit rang.

Një folës i Arabishtes nga Farsi, el-Hellaxh së pari e adoptoi Sufizmin në Basra ku u bë një asket i entuziazmuar. Në udhëtimin e parë (tre herë gjithsej kishte shkuar në Mekë) haxhi për në Mekë, ai qëndroi për një vit të tërë në oborrin Heram, vazhdimisht duke agjëruar dhe duke mbajtur një heshtje të përhershme.

Me tu kthyer në Persi ai largohet formailsht nga Sufizmi - sepse dëshironte të shprehej publikisht për anën e brendshme të Islamit, gjë që Sufinjtë nuk e bënë –duke i nxitur përcjellësit e tij ta kërkojnë 'Zotin përbrenda' duke I dhënë një rëndësi të brendshme akteve rituale.

Armiqtë e tij në mesin e ehl el-zahir e akuzuan atë pa të drejtë sipas Masignonit, kinse ai dëshiron të heqë nga praktimi ritualet e 'jashtme'.

Pas udhëtimeve të shumta dhe të gjata misionare në Indi, përtej kufinjëve të dar el-Islam ai u vendos në Bagdad, ku e shpalli doktrinën e quajtur '*uniteti i dëshmisë'(vehda el-shuhud),* një doktrinë teosefike jo aq e komplikuar sipas së cilës 'bashkimi me Zotin' duhet të kuptohet jo si 'bashkim i substancës', por si një rezultat I 'një akti të besimit dhe dashurisë' në të cilin qëllimi i Sufit të bashkojë intelegjencën e tij, vullnetin e tij, dhe egon me Zotin është një veprim i mëshirës Hyjnore.

Duke lajmëruar se Zoti po e dëshmonte Vet-vetën 'në zemrën e robit të tij', *el-Hellaxh* e rriti dyshimin e ehl el-zahir(legalistët egzoterik) edhe pse ai u kujdes në dogmen e tij teologjike, që mos të largohet nga rrënjët orthodokse Sunnite.

E thëna e tij se ai është 'e vërteta' *(el-hak)* u kuptua nga armiqtë e tij kinse ai bën blasfemi kur e identifikon veten me Hyjnoren.

'Në qoftë se nuk e njeh Zotin, ' Hellaxh tha, *'së paku identifiko shenjat e Tij. Unë jam ajo shenjë, Unë jam e Vërteta kreative [ana el-hak] sepse përmes së Vërtetës unë jam e vërteta përjetësisht…*

"Meqenëse Hellaxh filloi të shprehet publikisht edhe mësuesi i tij shpirtëror Xhuneid Bagdadi (Allahu e bekoftë) u distancua nga ai dhe e kritikoi me dashamirësi për fjalimet e tij në publik, pa e vënë në pikëpyetje vlerën e përjetimit të tij fetarë.

Rumi thotë se, nuk duhet marrë literalisht e thëna ***"unë jam zot",*** ai e shpjegon shumë bukur në këtë mënyrë:

... të thuash "*Unë jam robi I Zotit*", dhe "*Unë jam Zot*"të dyja janë shprehje të një përulje/nënshtrimi të madhë. Njëri që thotë "*Unë jam rob I Zotit*"pranon dy ekzistenca, të veten dhe të Zotit, por ai që thotë "*Unë jam Zot*"vetë ka pushuar së ekzistuari e ka bërë vetë-veten jo-ekzistent dhe e **ka dorëzuar veten tërësishtë tek Zoti** dhe thotë "*Unë jam Zoti*", që nënkupton "**Unë nuk ekzistojë, Ai është I tëri; nuk ka qenie tjetër pos Zotit.** "Ky është një nënshtrim/përulje ekstreme dhe përulje e vetëvetes.

Udhëtimi nga ndarja në bashkim

Sufizmi është nje udhë mistike e dashurisë, në të cilën Zoti, apo e Vërteta, përjetohet me emrin i Dashuri. Marrëdhënia e brendshme në mes të dashuruesit dhe të Dashurit është themeli i rrugës Sufi. Nëpërmjet dashurisë kërkuesi dërgohet tek Zoti. Mistiku kërkon ta realizoj të Vërtetën në këtë jetë dhe Zoti e shfaqë Veten e Tij brenda.

Përjetimi mistikë i Zotit është gjendja e njëshmerise me Zotin. Ky bashkim *unio mystica* është qëllimi i udhëtarit në udhën e mistikut. Brenda në zemer, dashuruesi dhe i Dashuri bashkohen në një ekstaze të dashurisë. Udhëtari fillon këtë udhëtim nga malli për të arritur gjendjen e njëshmërisë. Ky mallëngjim ka lindur brenda në shpirtë, ngase shpirtit i kujtohet ardhja nga Zoti. Shpirtit i *kujtohet* se shtëpia e vërtetë është me Zotin dhe e zgjon kërkuesin me këtë kujtim. Udhëtimi spiritual është nje udhëtim që na dergon prapa në shtëpi, nga ndarja në bashkim. *Kemi ardhur nga Zoti dhe kthehemi tek Zoti.*

Udhëtimi mistikë për në shtëpi është nje udhëtim i brendshëm, tek vet qendra e qenies sonë, atje ku i Dashuri është prezent përjetësisht. Atë që ne kërkojmë nuk është askush tjetër përveqëse natyra jone e përhershme. Shen Augustini tha, "Kthehu përbrenda vet-vetes, sepse në brendësi të njeriut jeton e vërteta. "Përjetimi mistikë se i Dashuri jeton brenda në zemrën e mistikut, nuk është nje koncept por një realitet jetësore. Brenda në thellësi të zemrës nuk ka ndarje midis dashuruesit dhe të Dashurit. Ketu jemi përjetësisht të bashkuar me Zotin, dhe përjetimi mistikë i këtij unioni është shfaqja e asajë që është gjithmonë prezente.

Pengesa më e madhe që na mban nga përjetimi i kësaj gjendje të përjetshme të unitetit është egoja, personaliteti ynë individualë. Në

gjendjen e unitetit nuk ka ego. Në këtë moment vet-vetja individuale mbaron së ekzistuari dhe vetëm i Dashuri ekziston. Sufi thotë, "I Dashuri jeton, dashuruesi është i vdekur. "Prandaj Sufinjtëkanë aspirata të "vdesin para se të vdesin"të tejkalojë veten individuale dhe të përjetojë veten transcedente të natyres hyjnore. Ansari një Sufi që jetoi në shekullin e njëmbëdhjetë shprehu këtë në menyrë të thjeshtë:

"Dije se kur të mësosh ta humbësh vet-vetën,
Do ta arrish të Dashurin. Nuk ka asnjë
Sekret tjetër që të mësohet, dhe më shumë se kaq
Nuk më është bërë e njohur mua. "

Udhëtimi mistik na largon nga egoja në drejtim të Vetës, nga ndarja në bashkim. Duke u larguar nga egoja dhe duke u kthyer prapa tek Zoti, ne marrim një kahje në drejtim të thellësishëm në vet-vetën tonë, tek qendra më e thellë e qenies tonë, cka Sufinjtë e quajnë "Zemra e Zemrave". Ky është një udhëtim individualë i kërkuesit prapa tek burimi, i të "*vetmit tek i Vetmi*. " Megjithatë duhet kaluar disa faza në këtë udhëtim, "*kodra të mëdha udhëtimi*, "nëpërmjet të cilave çdo udhëtarëkalon. Sufit e shenjtë na kanë dhuruar një hartë që përshkruan këto faza dhe gjithashtu vështirësitë dhe rreziqet në të cilat mund të hasim gjatë këtij udhëtimi. Pasi që ata kanë arritur qëllimin, janë në gjendje ti ndihmojnë udhëtarit duke mbajtur shënime se cka mund të pritet gjatë udhëtimit.

Sufizmi githashtu ofron disa mënyra që njëri të hapet tek bota e brendshme dhe ta mban vëmendjen të fokusuar në qëllimin për të padukshmen. Më e cmuara nga këto mënyra është praktikimi i kujtimit, sepse Sufi aspiron ta kujtojë Zotin në çdo moment, me çdo frymëmarrje. Ky nuk është kujtim mental, por një kujtim i zemrës, sepse në zemër ndodhet vetëdija e lartë e Vetë-Vetës. Vet-Vetja është ajo pjesë e jona që kurr nuk është e ndarë nga Zoti, dhe vetëdija e Vetës është kualitet i*njohuris se ne jemi nje me Zotin*. Praktikimi i kujtimit është një menyrë e zgjimit të vetëdijes së Vetes, dhe kështu bëhemi të vetëdijshëm për bashkimin tonë të brendshëm me Atë që ne e duam.

Në qoftë se e don dikënd gjithmonë mbanë mendjen tek ai, dhe kur dashuria e shpirtit për Zotin zgjohet brenda në zemër, vëmendja e dashuruesit merr kahje në drejtim të të Dashurit.

Momenti i zgjimit shpirtërorë është *teuba*, "**pendimi**, "që Sufinjtë e përshkruajnë "kthimi i zemrës ". Momenti *teuba* është gjithmonë njëveprim i mëshirës, dhuratë nga i Dashuri, por Sufizmi ka zhvilluar teknika të ndryshme që ta mbajmë vëmendjen në dashurinë e shpirtit për Zotin, në kujtimin e zemrës. Njëra nga këto teknika është *dhikri*, përsëritja e njërit nga Emrat e Zotit. Nëpërmjet praktikimit të d*hikrit* vëmendja e dashuruesit kthehet nga Zoti dhe e tërë qenia e dashuruesit bëhet e mbushur me kënaqësinë e kujtimit të të Dashurit.

Kjo rrugë e Sufinjëve na ndihmon të na bëjë të vetëdijshëm për vetëdijen hyjnore të Vetës që gjindet brenda në zemër, dhe ku në të njëjtën kohë na kështillon largimin nga vetëdija e kufizuar e egos. Udhëtimi nga egoja në Vet-vete është njëudhëtim i përjetshëm i shpirtit, e mërgimtarit kur kthehet në shtëpi. Në këtë botëne kemi harruar natyrën tonë të vërtetë dhe identifikohemi me egon. Udhëtimi për në shtëpi na liron nga skllavërimi i egos dhe natyrës së iluzionit të dëshirës. Ne drejtohemi tek përmbushja e vërtetë që mund të vie vetëm nga njohja se kush jemi, duke e shijuar të vërtetën e esencës tonë hyjnore. Kur një mesues Sufi, Dhu-l-Nun, ishte pyetur, "Cili është fundi i mistikut"ai u përigjigj, *"Kur ai është ashtu si ka qene ku ka qene para se të ishte, "*

Çdo udhë spirituale i jep kahje kërkuesit të sinqertë tek e vërteta që mund të gjindet vetëm brenda. Sufi thotë se ka aq shumë rrugë në drejtim të Zotit sa ka edhe njerëz, "aq sa ka frymëmarrje të fëmijëve të njeriut. "Sepse secili jemi individual dhe unikë, udhëtimi për ta zbuluar natyrën tonë të vërtetë do të jetë i ndryshëm për secilin nga ne. Njëkohësisht udhëtimet e ndryshme spirituale i jane përshtatur tipave të njerëzve të ndryshem. Sufizmi është i përshtatshëm për ata që ndiejnë nevojën të realizojnë marrëdhënien e tyre me Zotin si një marrëdhënie dashurie, që duhet të tërhiqet nga maja e dashurisë dhe malli për të Dashurin.

Ebu Jezid El-Bistami (804-874 CE)

"Unë kam mbjellur dashuri në zemrën time
dhe nuk do të më largojë vëmendjen askush deri në Ditën e Gjykimit.
Ti ma ke lënduar zemrën kur u afrove afër meje.
Dëshira ime rritet, dashuria ime gumon.
Ai më derdhi një pije.
Ai ma shpejtoi zemrën me një gotë të dashurisë
Që e pat mbushur tek oqeani i shoqërisë. "

Pash se shpirti im i kishte lindur
hyjnores. Nuk shikonte në asgjë dhe pa
interesë, edhe pse Parajsa dhe Ferri i
ishin shfaqur, sepse ishte liruar nga
fenomeni i perdeve.

Mandej u bëra zog, që e kishte trupin e Njëshmërisë dhe që krahët i kishte nga e Përhershmja, dhe vazhdova të fluturojë në ajrin e Absolutit, derisa kalova në sferën e Pastrimit, dhe shikova në fushën e Përjetësisë dhe e përjetova aty pemën e Njëshmërisë. Kur shikova, unë vetë isha të gjitha ato. Thirra O Zot, me egoizmin tim nuk mund të të arrijë Ty, dhe nuk mund të ikë nga vetë-vetja ime. Çka duhet të bëj?O Ebu Jezid, ti duhet të fitosh lirim nga vetë-vetja jote duke e përcjellur të Dashurin tim (Muhamedin a. s.). Fshijë sytë e tu me pluhurin e këmbëve të tij dhe përcillle atë vazhdimishtë?

(Bistami r. a.)

Jeta e Tij

Ebu Jezid El-Bistami, gjithashtu është i njohur me emrin Bajazid Bastami. Kishte lindur në Bostam të Iranit.

Gjyshi i Bajazidit ishte Zoroastrian nga Persia që u konvertua në Islam. Bajazid bëri një studim detale të ligjit Islamik Sheriatit dhe praktikoi me diciplinë të rreptë mohimin e vet-vetës (zuhd). Gjatë gjithë jetës së tijë ai ishte i palodhur në praktimin e obligimeve fetarë dhe në respektimin e adhurimit vullnetar. Ai i lutej studentëve të tijë (murids) ti lënë të gjitha punët në duart e Allahut dhe i inkurajoi ata që të pranojnë sinqerisht doktrinën e ciltër të Unitetit/Njëshmërisë të Zotit (tevhid). Kjo doktrinë përbëhej prej pesë gjërave esenciale: Ti mbajnë të gjitha obligimet sipas Kuranit dhe Sunetit, që gjithmonë të flitet e vërteta, zemra të jetë e lirë nga urrejtja, ti shmangen ushqimeve të ndaluara dhe ti injorojnë risitë (bid a).

Thëniet e tij

Njëra prej thënieve të tijë ishte: "*Arrita ta njohë Allahun nëpërmjet Allahut, dhe kam arritur të njohë cka është tjetër gjë prej Allahut me dritën e Allahut.*

"Ai tha, Allahu u ka dhuruar shërbëtorëve të tijë favor për qëllim që ti ofrojë afër tijë. Në vend që të afrohen afër tijë ata/ato nga mahnitja me favorizimet janë duke u larguar më large prej tijë. "Dhe ai tha, duke iu lutur Allahut, O Allah, Ti e ke krijuar këtë krijim pa dijenin e tyre dhe Ti ke vënë besimin e tyre pa vullnetin e tyre. Në qoftë se ti nuk ju ndihmon kush do të ju ndihmojë?"

Bayazidi tha qëllimi kulminantë i Sufit është të përjetojë vizionin e Allahut në botën e përtejme. Për atë efekte ai tha, "*Ka shërbëtorë special të Allahut që, në qoftë se Allahu fshihet nga ata gjatë pamjes se Parajsës, do ti luteshin Atijë që ti largojë ata nga Parajsa sikurse banorët e zjarrit do ti luteshin Atijë që ti lirojë ata nga Ferri. "*

Ai tha për dashurinë e Allahut ndajë shërbëtorëve të tijë, "*Në qoftë se Allahu i don shërbëtorët e Tijë, Ai do të ju dhurojë atyre* **tre atribute** *që janë vërtetim i dashurisë së tijë:*

Bujaria sikurse bujaria e oqeanit,

Dashamirësi sikurse dashamirësia e Diellit që jep dritën,

Modestin sikurse modestia e Tokës.

Ai/Ajo që dashuron me të vërtetë kurr nuk konsideron për të ekzagjeruar ndonjë pikellim dhe kurr nuk zvoglohet në adhurim, për arsye të besimit të ciltër. "

Njëri e pyeti Bajazidin, "Me trego një veprim që unë mund ta bëjë në mënyrë që ti afrohem Zotit tim"Ai i tha,

"*Duaj të dashurit e Allahut në mënyrë që edhe ata të të duan. Sepse Allahu i shikon zemrat e të shenjtëve të Tijë dhe atje Ai do të shohë emrin tënd të ngulitur në zemrat e të shenjtëve të tijë dhe Ai do të falë. "*

Shumë dijetarë musliman të kohës së tijë, dhe shumë të tjerë më pas, thanë se Bajazid al-Bistami ishte i pari të shpërndajë Realitetin e Shkrirjes (fana'). Bistami ishte i pari që foli haptasi për shkrirjen e vetës në Zotin (fana fi 'Allah') dhe ekzistenca nëpërmjet Zotit (baka 'bi' Allah). Është me rëndësi të cekët se ky realitet i arritur nuk është ndonjë lloj mishërimi. Asnjë krijesë nuk mund të barazohet me Krijuesin Suprem dhe të besohet një gjë e tillë konsiderohet shirk.

Edhe nga dijetarët më të rreptë si, Ibn Tejmije, që jetoi në shekullin e 7'të A. H. e adhuroi Bajazidin për këtë dhe e konsideroi atë të jetë njëri nga mësuesit e tijë. Ibn Tejmije tha për të, "Janë dy kategori të gjendjes FANA': Njëra është për Profetët dhe të shenjtët e perfektë, dhe tjetra është për kërkuesit midis të shenjtëve dhe njerëzve të devotshëm (saliheen). Bajazid al-Bistami i takon kategorisë së parë prej atyre që përjetojnë fana', që do të thotë mohim komplet i cdo gjëje përveq Zotit. Ai nuk pranon asnjë vetëm Zotin. Ai nuk adhuron asgjë tjetër përveq Atijë, dhe nuk kërkon nga askush përveq Atijë, "Ai vazhdon, duke e cituar Bajazidin që tha, Unë nuk dua të dua përveq asaj cka Ai don, "

Ishte raportuar për Bajazidin të ket thënë, "*U shkurorzova nga bota e ulët* ***tre*** *herë në mënyrë që të mos mund të kthehem aty dhe u shpërngula tek Zoti im i vetëm, pa asnjëri, dhe e thirra vetëm Atë për ndihmë duke i thënë,*

'O Allah, O Allah, askush nuk qëndron për mua përveq Teje. '

At kohë e kuptova sinqeritetin e lutjes në zemrën time dhe realitetin kur egoja mbeti e pa ndihmuar. Menjëherë pranimi i asaj lutje u pranua në zemrën time. Ky përjetim më hapi një vizion se nuk isha më në ekzistencë dhe u zhduka kompletë nga vetja ime në vetën e Atijë. ***Dhe Ai i solli para meje të gjitha ato përjetime nga të cilat u shkurorzova më parë****, dhe më veshi me dritë dhe me atributet e tijë. "*Bajazidi tha: "*Me Uroni, për Shkelqimin tim më të madh*!"Dhe ai vazhdoi duke thënë, "*Shkela në një oqean kur profetët e mëhershëm ishin ende pranë bregut*. "Dhe ai tha, "*O Perëndia ime, bindja jote ndaj meje ishte më e madhe se sa bindja ime ndaj teje.* "Kjo do të thotë, "O Zot, ti veq e pranove lutjen time përderisa unë ende duhet të krijojë bindjen ndaj teje. "

Ai tha, "*I kam bërë* **katër** *gabime në hapat e parë të ketijë udhëtimi:*

1. *Unë mendova se unë e kujtojë Atë*
2. *Dhe se unë e njohë Atë*
3. *Dhe se unë e dua Atë*
4. *Dhe se unë e kërkojë Atë,*

por kur e mbërriva Atë e kuptova se

1. *Ai më kishte kujtuar para se unë ta kujtoja Atë,*
2. *Ai më kishte njohur mua para se unë ta njohja Atë,*
3. *dashuria e Tijë ndaj meje ishte me antike sesa dashuria ime ndajë Tijë,*
4. *Ai më kishte kërkuar mua në mënyrë që unë të filloja ta kërkojë Atë. "*

Adh-Dhahabi e kishte cituar atë në shumë gjëra, midis se cilave ishte: "*Me Uroni, për Shkelqimin tim më të madh!"dhe*

"Nuk ka asgjë më shumë në këto rroba që i kam veshur përveq Allahut. "

Mësuesi i Adh-Dhahabit, Ibn Tejmije shpjegonte, "Ai nuk e shifte vetën se ekzistonte më, por vetëm e shikonte ekzistencën e Allahut, për arsye të mohimit të vet-vetës. "

Adh-Dhahabi më tutje thotë,

"Ai tha, O Allah, cili është Zjarri yt?

Është ***asgjëja****.*

Me lëjo të jam i pari të shkojë në Zjarrin tënd dhe cdo kush tjetër do jetë i shpëtuar.

Dhe c'farë është Parajsa jote?

Është një ***lojë femijësh****.*

Dhe kush janë ata jobesimtarë që dëshiron ti torturosh?

Ata janë shërbëtorët e tu. Fali ata. "

Ibn Hegjar tha, në lidhje me shprehjet e famshme të Bajazidit, "Allahu e din sekretin dhe Allahu e njeh zemrën. C'fardo që Bistami foli për Njohurinë e Realiteteve popullata e kohës se tijë nuk e kuptuan. Ata e denuan atë dhe e larguan shtatë herë nga qyteti i tijë. Secilën herë që e largonin, fatkeqësi të tmerrshme qëllonin qytetin derisa popullata do e thirrnin që ai të kthehej, mandej i premtuan besnikërinë atijë, dhe e pranuan atë si një të shenjtë të vërtetë. "

Një herë Bajazidi tha,

"Allahu më i Drejti më thirri në Prezencën e tijë dhe më tha,

'O Bajazid si erdhe në Prezencën time?'

Unë ia ktheva,

'Nëpërmjet zuhd, heqjes dorë nga bota. '

Ai tha,

'Vlera e botës së ulët është sikur një krah i mickonjës. Me cfarë lloj braktisje nga bota erdhe?

' I thashë,

'O Allah, më falë. 'Mandej i thashë,

'O Allah, erdha tek ti nëpërmjet tawakkul, duke u varur nga Ti.

'Mandej Ai tha, 'A të kam tradhtuar ndonjëherë besimin që të kam premtuar?'

I thashë, 'O Allah më falë. ' Mandej i thashë,

'O Allah, unë erdha tek ti nëpërmjet teje. ' Atëherë Allahu tha,

*'****Tani Ne të pranojme ty. ""***

Ai tha (Tadhkiratul-Awliya nga Farid al-Din Attar),

"Ndejta me të devotshmit dhe nuk gjeta ndonjë përparim me ta. Ndejta me luftëtarët në këtë rruge dhe nuk fitova asnjë shkallë përparimi me ta. Ndejta me ata që lutën shumë dhe me ata që agjerojnë së tepërmi dhe nuk mbërrijta asnjë përparim. :p

Mandej i thashë, 'O Allah, cila është rruga tek Ti?' atëherë Allahu tha:

'Lere veten dhe eja. '

"Unë kurr nuk pashë ndonjë dritë të shkelqejë më shumë se sa drita e qetësisë"

"Shkova në shkretëtirë, dashuria kishte rënë dhe e kishte mbuluar token, sikurse kembët që depërtojnë në borë, e gjeta vetën të mbuluar me dashuri. "

Ibrahim Khawas tha, "Rrugen që Allahu i tregoi atijë, me fjalët më delikate dhe me shpjegimin më të thjeshtë, ishte 'lere interesin për vet-vetën në të dy botërat, në dynja dhe në botën e përtejme, leri të gjitha mbrapa përveq Meje. ' Ajo është rruga më e mirë dhe më e lehtë të arrishë tek i Gjithëfuqishmi dhe i Lartëmadhëruari Allah, gjendja më perfekte dhe më e lartë e pohimit të Njëshmërisë, të mos pranosh asgjë apo askend përveq Allahut të Madhërishëm.

Derisa njëri nga nxenësit e Dhul Nun al-Misrit po ndiqte mësimet e Bajazidit, Bazazidi e pyet, *"Kend dëshiron ti?"*Ai u përgjegj, "Bajazidin. "Bajazid i përgjigjet, "*O djali im, Bajazidi e donte Bajazidin për dyzet vite të tëra dhe ende nuk po mund ta gjejë. "*Atëherë nxenësi i Dhul Nunit u kthye tek mësuesi i tijë dhe ia tregoi atijë incidentin që i kishte ndodhur. Kur Dhul Nun e kuptoi se cfarë kishte ndodhur i bie të fikët. Ai shpegoi me vonë duke thënë, "Mësuesi im Bajazid e ka humbur vetën në dashurinë e Allahut. Kjo i ka shkaktuar atijë që të mundohet dhe ta gjejë vetën e tijë prapë. "

Ata e pyetën, "Mësona se si ke arritur tek relaiteti i Vërtetë. "Ai tha,

"*Duke e ushtruar vetën, duke u izoluar. "* Ata thanë, "Si, në c'farë mënyre?"

Ai tha, "I kam bërë thirrje vetës që ta pranojë Allahun e Gjithfuqishëm dhe të Lartësuar, por vetja rrezistoi. U betova se nuk do të pijë ujë dhe nuk do të shijojë gjumë përderisa ta sjell vetën time nën kontroll. "

Ai gjithashtu tha, *"O Allah! Nuk është cudi që unë të Dua sepse unë jam një shërbëtorë i lige, por është cudi kur Ju më doni mua kur Ju jeni Mbret i Mbretërve. "*

Ai tha, "*Për tridhjetë vite, kur dëshiroja ta përkujtoja Allahun dhe të bëja Dhikr e pastroja gjuhën dhe gojën time për të lartmadhëruar Atë. "*

Ai tha, "*Përderisa një shërbëtorë i Allahut mendon se midis Muslimanëve ka më të ulët se ai, atëherë atijë shërbëtori i ka mbetur ende mendjemadhësi. "*

Ata e pyetën atë, "Përshkruana ditën dhe përshkruana natën. "Ai tha,

"*Unë nuk kam ditë e as natë, sepse ditët dhe netët janë për ata që kanë karakteristikat e krijimit. Unë e kam shkulur vetën sikurse gjarpri që e shkule lëkurën e tijë. "*

Për Sufizmin Bajazid tha: "*Të heqësh dorë nga të gjitha dhe të pranosh vuajtjen. "*

Për obligimin që të ndiqesh një mësues, ai tha: "*Ai që nuk ka mësues, mësuesi i tijë është Djalli. "*

Për të kërkuar Zotin ai tha: "*Uritja është re shiu. Në qoftë se shërbëtori bëhet i uritur, Allahu do ti vërshojë zemrën atijë me zgjuarsi. "*

Për ndërmjetesimin ai tha, "*Në qoftë se Allahu do të më lejonte të ndërmjetësojë për të gjithë njerëzit e kohës time unë nuk do të isha fare krenar për*

një privilegj të tillë, sepse unë do të ndërmjetësoja për një copë dheu, "dhe "Në qoftë se Allahu do të më lejonte të ndërmjetësojë, së pari do të ndërmjetësoja për ata që më kanë bërë keq mua dhe për ata që më kanë refuzuar. "

Për një djalë të ri që dëshironte nga Bajazidi një copë të mantelit të tijë për bekim (baraka), Bajazid tha: *"Edhe po ta marrësh të gjithë lëkurën e Bajazidit dhe ta veshësh sikur lëkurën tënde, nuk do të duhet asgjë por vetëm në qoftë se e përcjell shembullin e tijë. "*

Ata i thanë atijë, "Qelsi i Parajsës është **'La ilaha il l'Allah'** (dëshmia që nuk ka tjetër Zot përveq Allahut). "Ai tha, "*Është e vërtetë, por qelësi është për të qelur dryrin; dhe qelësi i një dëshmie të tillë mund të funksionojë vetëm ndër konditat si një vijim:*

1) Një gjuhë që nuk gënjen dhe nuk ia kthen askujt me të keq;
2) Një zemër pa tradhëti;
3) Një stomak pa ushqime haram apo të dyshuara;
4) Veprime pa dëshira apo risi. "

Ai tha, "***Egoja*** *apo vetja gjithmonë e shikon* ***botën*** *dhe* ***shpirti*** *(ruh) gjithmonë shikon* ***jetën e ardhshme*** *dhe* ***njohuria shpirtërore*** *(ma'rifat) gjithmonë shikon* ***Allahun*** *e Gjithëfuqishëm dhe të Lartësuar. Atë të cilin egoja e mund është nga ata që shkatërrohen, dhe ai, shpirti i të cilit del fitmtarë ndaj egos, është besimtari i devotshëm, dhe atijë të cilit njohuria shpirtërore ia mbizotëron egon, ai është nga ata të quajtur vetëdije-Zoti. (God-conscious). "*

Ad-Dailami tha, "Një herë pyeta Abdur Rahman bin Jahja për gjendjen e besimit në Allah (tawakul). Ai tha, ***"Në qoftë se e vë dorën pranë gojës së luanit, mos u frigëso nga askush tjetër përveq Allahut. "***Shkova tek zemra ime të vizitojë dhe pyeta Bajazidin për këtë punë. Trokita dhe degjova për nga brenda, "*A nuk ishte e mjaftueshme ajo që të tha 'Abdur Rahman? Ti erdhe vetëm të bësh pyetje, e jo me qëllim që të më vizitosh mua. "*Kuptova dhe erdha më vonë prapë mbas një viti, trokita në derë. Këtë herë ai u përgjegj, "*Mirseerdhe djali im, kësaj radhe erdhe tek unë si një vizitor dhe jo si një pyetës. "*

Ata e pyetën "Kur një njeri bëhet njeri me të vërtetë?"Ai tha, ***"Kur ai ti kupton gabimet e vetës së tijë dhe kalon kohën për ti përmirsuar ato. "***

Ai tha, "*Unë kam qen për dymbëdhjetë vite farkëtari i vetës sime, dhe pesë vite lustruesi i pasqyrës së zemrës sime, dhe për një vit po shikoja në atë pasqyrë dhe pash në barkun tim rripin e mosbesimit. U mundova fortë që ta pres dhe i kalova dymbëdhjetë vite duke u përpjekur. Mandej shikova në pasqyrë dhe e pashë brenda në trupin tim atë rrip. I kalova pesë vite duke e prerë. Mandej kalova një vit duke shikuar se cka bëra. Dhe Allahu më hapi vizionin e gjithë krijimit. Dhe i pashë të gjithë ata të vdekur. Dhe i fala katër lutje (takbire) të gjenazeve mbi ta. "*

Ai tha njëherë: "*Në qoftë se Kurora dhe cka është përreth saj dhe cka është brenda saj të ishin vendosur në qysh të zemrës së atijë që është i Zgjuar, ato do të tretëshin komplet brenda tij. "*

Për gjendjen e Bajazidit, al-Abbas ibn Hamza tha: "Njëherë kur e fala vaktin e drekës mbrapa Bajazidit, vërejta se kur i ngriti duart të thotë 'Allahu Akbar' ai nuk ishte në gjendje ti shqiptonte fjalët, nga frika e Emrit

të Shenjtë të Allahut, dhe i gjithë trupi i tijë dridhej dhe një zë sikur eshtrat duke u thyer vinte nga ai: Mua më kaploi frika. ”

Munawi tregon kur një ditë Bajazidi morri pjesë në klasën e qujtur shkencë e drejtësisë apo jurisprudencës (faqih) dhe në këtë klasë po shpjegoheshin ligjet e trashëgimisë: “Kur njëri vdes dhe len mbrapa këtë-dhe-atë, djalit të tijë do ti takojë kjo-dhe-ajo etj. ”Bajazid tha:

“*O faqih, O faqih*! *Cka do të thoshe për një njëri që vdiq dhe nuk la asgjë përveq Zotit?”*Njerëzit filluan të qanin, dhe Bajazidi vazhdoi:

“*Robi nuk zotëron asgjë; kur vdes, nuk le asgjë përveq Zotit të tijë. Ai është ashtu Siç e krijoi Allahu në fillim*. ”Dhe recitoi:

“*Ju do të ktheheni tek në të vetëm, ashtu si ju krijuam për të parën herë*”[Kur’an, 6:94].

Sahl at-Tustari i dërgoi një letër Bajazidit në të cilën shkruante: “Këtu është një njeri që piu një pije dhe e la përgjithmonë atë të freskët. ”Bajazidi ia ktheu:

“*Këtu është një njeri që e ka pirë të gjithë ekzistencën, por që goja e tijë është tharë dhe digjet nga etja. ”*

Vdekja e tij

Kur Bajazid vdiq, ai kishte mbi shtatëdhjetë vjet. Para se të vdiste, dikush e pyeti se sa vjet i kishte. Ai tha:

“Unë i kam 4 vjet. Për shatëdhjetë vite kam qenë mbrapa perdes. E hoqa perden time vetëm katër vite më parë.

Shejhu i 39 i Zingjirit të Artë, Sultan al-Awliya Sheikh ‘Abdullah Daghestani, thoshte se kur ishte takuar me Kidr (udhëzues nga bota e përtejme) ai i kishte thënë, deri sa po vizitonin varret Muslimanë të disa dijetarëve të mëdhenjë: “Ky i ka tri vjet; ky tjetri shtatë vjet; Ai tjetri dymbëdhjetë. ”

Bajazidi vdiq në vitin 261 H. Thuhet se është varrosur në dy vende, njëri në Damaske dhe tjetri në Bistam të Persisë. Sekreti i Zingjirit të Artë kishte pasuar nga Bajazid al-Bistami tek Abul Hassan al-Kharqani.

Rabia Adavia (l. 717 - v. 185/801)

Dashuri pa Interesë

Në Emër të Zotit

Më të Dhimbshmit, të Plot-Mëshirshmit

Rabia ishte një grua që kishte lindur në Basra, përafërsisht në vitin 95 ose 99 (717). Attar thotë se në një moshë shumë të re asaj I kishin vdekur prindërit dhe kishte mbetur jetime. Ishte kërkuar disa herë për martesë, nga një numër I njerëzve të urtë, por ajo I refuzoi të gjitha ofertat, duke thënë,

"*Kontrata e martesës është për ata që kanë ekzistencë fenomenale. Por në rastin tim, nuk ka një ekzistencë të tillë, sepse unë kam mbaruar së ekzistuari dhe kam kaluar jashtë nga vet-vetja. Unë ekzistojë në Zotin, dhe e tëra jam e Tij. Unë jetoj nën hijen e komandës së Tij. Kontrata e martesës duhet të kërkohet nga Ai, jo nga unë*".

Rabia ishte e mbushur përplot, me konshiencën e prezencës së afërt me Zotin; njëherë kur ishte sëmurë, ajo I tha një vizitori që e pyeti se c'farë sëmundje kishte,

"*Për Zotin, nuk di asnjë shkak për sëmundjen time, vetëm se Parajsa më është shfaqur mua, dhe u përmallova për të në zemrën time; dhe mendoj se Zoti im u bë xheloz në mua, dhe më ndëshkoi; dhe vetëm Ai mund të më bëjë të lumtur.* "

Afër me këtë të thënë është mënyra e lutjes së sajë të famshme:

"*O Zot! Në qoftë se të adhuroj Ty nga friga e Ferrit, ma vë flakën mua në Ferr; dhe në qoftë se të adhuroj Ty në shpresën për Parajsë, më përjashto nga Parajsa; por në qoftë se të adhuroj Ty vetëm për hir Tëndin, mos e tërhiq Bukurinë Tënde të Përjetshme!*"

Me emrin e saj në përgjithësi asociohet prononcimi I parë në Islamin Shpirtërorë (Sufizëm) doktrina e Dashurisë Hyjnore, që më vonë u bë aq dominante në këtë lëvizje: poema e saj e shkurtër në këtë temë është njëra që më së shumti citohet në literaturën Sufi.

Në dy mënyra të dashuroj Ty: dashuri egoiste,
Dhe mandej, dashuri ashtu si është e vlefshme për Ty.
Sa për dashurinë që është egoiste
me cdo mendim mendoj vetëm për Ty, duke përjashtuar
të gjithë të tjerët
Sa për atë që është me vlerë për Ty
Aty ti e heq perden që të mund të të shikoj Ty
Prap nuk ka asnjë falënderim në mua në këtë apo në atë
Por falënderimi është për Ty, në atë apo në këtë.

Perceptimi Shpirtërorë dhe Rrënja e Rrënjës së Fesë

UNESCO - Simpozium Internacional për Rumin, Maj 2007, Stamboll

O ju që e studioni botën, ju jeni vetëm një punëtor I paguar.
Dhe ju që e dëshironi parajsën, jeni larg nga e Vërteta.
Dhe ju që jeni të kënaqur me të dy botërat, por të pavëmendshëm
Se nuk e keni shijuar lumturinë e pikëllimit të Tij,
Thjesht, ju është falur
(Vargje të Rumit)

Gjatë këtyre festimeve duke e nderuar përvjetorin e 800ndë të lindjes së tij është e përshtatshme të reflektojmë se cka Mevlana I ofron njerëzimit në këtë kohë. Humanizmi është duke ecur përmes një udhe të rrezikshme në mes të një materializmi të cekët dhe një feje një-dimenzionale. Të dyja

janë shkatërruese tek vetë vetja jonë humane. Në njërën anë kemi komercializmin e jetës, privatizimin e burimeve natyrore, dhe tiraninë e fuqisë ekonomike të korporatave transnacionale. Në anën tjetër kemi manifestimin autoritarë të besimit në fe e shkurorzuar nga cdo perceptim real shpirtërorë. Fundamentalizmi ushqehet në një vakum shpirtërorë. Pa perceptim shpirtërorë të realitetit shpirtërorë, feja degjenerohet në më shumë intelektualizëm, formalizëm, legalizëm, dhe më në fund bëhet autoritare, ekstremizëm puritan.

Shkolla (medhebi) Mevlana ashik, apo shkolla e dashurisë, është korrekte tek të dyja: koncepti autoritarë I fesë të cilit I mungon Mëshira, dhe etika materialiste që e ushqen egon e njeriut. Ne nuk na nevoitet një regjim politik i bazuar në një kuptim një-dimenzional të shtrembëruar të fesë që deklaron se është e vetmja e Vërtetë. Ne nuk na nevoitet një forcë urtësie mbi ne nga elita e fuqishme fetare. E as nuk na nevoitet një botë e sunduar gati vetëm nga forcat komerciale dhe të korporatave, sidomos kur ato forca si rezultat kanë koncentrimin e pasurisë dhe fuqisë në duart e vetëm disa personave. Ne nuk na nevoitet një shoqëri që I shërben emëruesit të përbashkët më të vogël dhe që e lejon një racë të bie gjer në fund të pusit. Ne nuk mund ti lejojm vetes një shoqëri të tillë ku vlerat e vërteta të humanizmit shpirtërorë janë varrosur nga një avalanq I kulturave popullore transiente, të shëmtuara, dhe tërheqjeve vulgare. Dhe në qoftë se do ta mbushim fatin njerëzorë ne na nevoitet njohuri shpirtërore që mund ta sjell natyrën tonë shpirtërore në pjekuri brenda konditave të një jete bashkohore.

Urtësinë që ne e duam në mësimet e Mevlanës e kanë aplikimin dhe efektin tek të dyja palët, edhe tek njerëzimi në gjerësi e edhe për individualin që kërkon një udhë të zhvillimit shpirtërorë, apo sejri suluk.

Tek niveli I kërkuesit individual, tema e "perceptimin shpirtërorë"është njëra nga më produktivet dhe një perspektive ndricuese prej nga e shikon punën e Mësuesit Tonë, Mevlana. Perceptimi shpirtërorë është një temë që vazhdimisht shfaqet në punën e tij, ndoshta edhe më shumë sesa tema e 'Dashurisë". Megjithatë perceptimi shpirtërorë është I bashkuar me temën e Dashurisë për dy arsye: njëra se pa perceptimi shpirtërorë dashuria vetëm është e kotë dhe e pakompletuar; Në qoftë se dashuria nuk do të ishte informuar nga perceptimi shpirtërorë mbetet në nivelin e egos, duke prodhuar vetëm dëshira dhe sentimentalizëm.

Ndoshta më me rëndësi është procesi I zhvillimit të perceptimit shpirtërorë që të drejton tek vet Dashuria. Dashuria është e Vërteta. Dashuria e krijoi të tërën. Zbulimi I të Mëshirshmit dhe Dashurisë Hyjnore është qëllimi I ekzistencës. "Asnjë shpirt injorant kurr nuk është ulur tek Kurora e Dashurisë".

Ta thuash në një mënyrë tjetër: Përmbushja e fatit tonë njerëzorë në fund të fundit bëhet përmes zhvillimit të perceptimit shpirtërorë. Shkenca

jonë quhet irfan, që domethënë realizimi përmes njohurisë. Asgjë më pak nuk e kënaq zemrën e njeriut. Qenia njerëzore esencialisht është substancë njohurie, e aftë të dijë të vërtetën esenciale dhe misterien e ekzistencës. Drita e përjetshme ekziston këtu në këtë botë të vuajtjeve, dhimbjeve, dhe konfliktit, por ne dështojmë ta shohim. Qumështi I dëlirë lundron pranë lumit të gjakut, por fëmiu I zemrës dështon ta pranojë ushqimin e saj.

Ashtu si Mevlana na kujton ne, qenia njerëzore esencialisht është një "sy. "Por syri I zemrës mund të mbulohet nga shqisat fizike. Qenia njerëzore potencialisht është shumë më shumë se një krijesë biokimike që e kërkon vetëkënaqësinë. Por një edukim shpirtërorë nevoitet që të na ngre neve lart tek një shkallë e vërtetë njerëzorë.

Organet e shqisave bio-kemikale të qenies njerëzore mund të na verbojnë tek realitetet shpirtërore, por kur shqisat shpirtërore zgjohen madje edhe shqisat fizike bëhen të ndricuara. Kështu që shkenca jonë quhet tesavuf, që simbolizon pastrimin e percepcionit.

Mevlana ishte bylbyli që u bë skifter, një gjuetar I të vërtetave shpirtërore. Mevlana dhe trashëguesit e tij janë dritat që ne duhet tu bashkohemi, se në qoftë se intelekti shpirtërorë bëhet ciftë me një intelekt tjetër shpirtërorë, drita rritet dhe udha bëhet e cartë.

Mevlana duke qenë njëri nga edukatorët më të mëdhenj të zemrës, mundet dhe na ofron ne një njohuri sistematike, një shkencë të shpirtit të njeriut. Ashtu si thotë një kapitull hyrës tek njëra nga librat e tij në Methnevi. Cka ai ofron është rrënja e rrënjës së fesë. Mevlana është një këshillë serioze tek udha e drejtë e zemrës së Traditës Profetike. Me fjalë të tjera urtësia e tij mund të na këshilloj ne tek përmbushja e fatit tonë dhe mundësive tona si qenie njerëzore. Vetëm njohuria e bazuar në urtësi shpirtërore mund ta udhëzoj individin dhe njerëzimin, si një e tërë, tek përmbushja. Përndryshe njerëzimi mbetet I humbur në labirintin e hutimeve të cekëta të tij apo përfundon si një tiran I ideologjive të utopis së falsifikuar.

Dhurata e Mevlanës për ne është se ai na prezenton ne me shpirtëroren që I ka të gjitha nuancat e artit, në vend të dogmave dhe stereotipeve që shpesh I gjejmë në emër të fesë. Ai na flet ne në gjuhën e shpirtit, me poezi imazhesh, metafora dhe muzikë. Në qoftë se Hyjnorja është Fuqia Kreative Kulminante, që na ka sjellur ne gati në nivel fizikë: fruta të ëmbla, trëndafila me aromë, spektaklin e natyrës, dhe bukuritë e marrëdhënieve njerëzore, atëherë e njëjta Fuqi Kreative gjithashtu na ka sjellur ne një jetë të brendshme me dimenzione edhe më të gjëra, me bukuri më delikate, me vyrtyte shpirtërore infinite, dhe përjetime edhe të hollësishme e edhe të thella. Në qoftë se në njërën anë lindja nga mitra fizike na drejton ne tek bukuritë e botës së shqisave, lindja e dytë na sjell ne nga mitra shpirtërore tek universi shpirtërorë me bukuri dhe domethënie mahnitëse.

Mevlana ishte në dashuri me këtë Fuqi Kreative; nganjëherë ai ishte I pirë me të dhe nganjëherë në një c'pirje urtësie e arritur vetëm pas një dehje të tillë.

Rrënja e rrënjës së fesë, bazamenti I Udhës Profetike, I ka dy aspekte fundamentale: Njëra është ta mbash Realitetin Hyjnorë tek qendra e vetëdijes gjatë gjithë kohës dhe nën të gjitha konditat. E dyta është një shpërbërje delikate e vetes, zhveshja nga cdo gjë që është falsitet, nga cdo gjë që egoja ka konstruktuar për ta mbrojtur pozitën e saj. Kjo shpërbërje e vetë vetes bie drejtëpërdrejt në kundërshtim me vlerat dhe mendimet tona me të cilat ne jemi mësuar.

E para, kujtimi I Zotit, do të thotë aftësia e zemrës që të njohë dhe mirënjohë Prezencën Hyjnore. Të mbahet Hyjnorja në qendër të konshiencës sonë do të thotë ta qetësosh mendjën që gjithnjë është e zënë duke folur, ti qetësosh emocionet reaktive të bazuara në ego, dhe të mësosh që thjesht të jesh – të jesh me Prezencën Hyjnore. Dielli I Njohurisë Hyjnore nuk udhëton në ndonjë orbit, por ngritet në shpirtin e brendshëm të qenies së njeriut. Iluminimi I tij pason nga dimenzioni pakohorë dhe pahapsinorë. Kur qenia njerëzore ta ketë arritur atë përjetim, agimi I Dritës së Iluminimit do të jetë me ty kudo që të shkoshë, në c'fardo rrethana që ti të jesh.

Aspekti I dytë, shpërbërja e vetes falso është një punë shumë e ndieshme që të detyron një njohuri mirë të mprehur – një njohuri që Mevlana na ofron ne me një mënyrë të kuptimit të thellë. Shpërbërja e vetes nuk është një program I vetë-krijuar, është pesha finale që e zhyt anijën.

Veq po qe se kërkuesi është tërësish I shlyer,
Në të vërtetën, ai nuk do të vie në bashkim.
Bashkimi nuk është I depërtueshëm. Është shkatërrimi yt.
Përndryshe cdokush do të mund të bëhej e Vërteta.

Zakonisht nevoitet mësim, mësues, dhe një komunitet brenda të cilit njëri I praktikon mësimet. Shpërbërja e vetes nganjëherë përshkruhet si një transformim përmes shtatë niveleve të egos (nefsit) secila më delikate dhe e dëlirë. Është ky tëhollim I perdes së njërit nivel të egos që e lejon tjetrin nivel edhe më delikatë që të përjetohet dhe të shprehet. Në këtë proces cka është falsitet, e bërë shprehi, dhe jo reale gradualisht zvogëlohet dhe një kualitet I ri I vetes lind – një vete e lartësuar. Kjo vetë vete e lartësuar realizohet kur ne zhvishemi nga identifikimet e cekëta dhe qëndrojmë të zhveshur para Hyjnores. Dhe Mevlana është vetja jonë më e lartësuar:

Kjo është çka jam; ndonjëherë I fshehur, ndonjëherë I parë.
Ndonjëherë mumin, ndonjëherë Jehud, ndonjëherë i Krishter,
I aftë të futem në çdo zemër,
Duke marrë fytyrë të re përherë.

Ndoshta ne kemi qenë me fat që ti dimë disa shembuj jetësorë të këtij transformimi. Në qoftë se kemi qenë aq me fat, ne gjithashtu jemi

transformuar duke e njohur edhe vetëm një qenie të tillë. Udha jonë priu nga Mevlana dhe Sufizmi gjer tek Muhamedi, paqja qoftë me të, dhe Islami. Ne u dërguam tek "kopshti në mes të flakëve, "ashtu si Ibn Arabi e ka emëruar.

Vetëm pas shumë viteve në atë kopsht rrethanat më sollën në Xhami. Ta them se ishte vetëm një përjetim shkurajues do të ishte një shfaqje me rezervë. Unë e kundërshtova Imamin tim. Cuditesha athua vall e krijuam një Islam imagjinor, sepse cka pash dhe dëgjova në xhami ishte shumë më ndryshe nga gjendja e bukur që ne e përjetuam në mesin e dashuruesve dhe të dehurve. Vura në pyetje se vall ajo që kisha përjetuar është e njëjta fe me atë që e gjeta në xhami.

Mevlana me siguri se ka ditur dicka për këtë mospërputhje në mes të shkollës së dashurisë (Medhebi Ashk), dhe fesë një dimenzionale që e shtyp shpirtin me komandat e tyre të ngurta dhe preokupimet e jashtme. Disa njerëz janë shumë të merakosur për ta përshtatur Mevlanën tek konceptet e tyre orthodkse. Por sikurse Profeti dhe Kur'ani ofruan sfida tek feja e shpikur nga njerëzit, fuqitë strukturore dhe paragjykimet, prandaj, gjithashtu, Mevlana I jep sfidë manifestimit të fesë që është njollosur me egoizmin e njeriut, do ta lë Mevlanën që ta thotë vetë vërejtjen:

Në qoftë se nuk të pëlqen aroma, mos eja në lagjën tonë.
Dhe në qoftë se nuk mund ti shqyesh rrobat, mos kërce në lumë.
Ky është drejtimi nga I cili të gjitha drejtimet drejtohen,
Në qoftë se kjo nuk është c'farë dëshiron, rri largë nga qendra.

Kam pasur çaste kur I kam pasur dyshimet e mija, por kam arritur të besoj se Shkolla e Dashurisë (Medhebi Ashk) është Dini Kejjim, feja autentike, dhe Din el Hak, feja e Vërtetë, që është e destinuar të shkëlqejë në të gjithë fenë, edhe pse pabesimtarët e urrejnë.

Megjithatë dua të ndajë me ju një pjesë të një teksti që e zbulova në Aflaki, që më në fund më solli rehati në zemrën time.

Veledi dhe Sejjidët Përmbledhur nga Aflaki

Një djalosh I ri e I dalluar, nga Sejjidët e Medinës, biri I kujdestarit të varrit të Profetit, paqja dhe bekimet qofshin me të, erdhi ta vizitonte Sulltan Veledin një ditë.

Ai kishte veshur një turban të jashtzakonshëm që e kishte pështjellur përreth kokës së tij me njërën anë të lëshuar gjer pak përmbi kërthizën, derisa ana tjetër ishte pështjellur në atë mënyrë që Mevlevët e quajn: '*shekker-evis*'. Sulltan Veledi I shfaqi respekt të madhë dhe diskutuan ide të ndryshme të misterieve të Udhës, 'në gjuhën e qartë Arabe'.. *(Kur'an: 26:195)*. Djaloshi I ri tregoi entuziazëm të madhë dhe vullnet të mirë dhe kërkoi me sinqeritetin më të madhë që të bëhet nxënës i tij. Ai kërkoi vërtetim të shkruar (diplomë) dhe dikush ia dha këtë në gjuhën Arabe.

Pas kësaj, Sulltan Veledi e pyeti si në vijim: "Shehët e tjerë nuk e kanë adaptuar këtë model të 'shekker-evis', që ishte përdorur në mënyrë unike nga Mësuesi (Rumi ra.) ynë dhe nga Mevlevët; nga vie ky zakon?

"Nga një lashtësi e madhe, "u përgjegj I riu Sejjid, "Ne jemi pasardhësit e Ibrahimit a. s. dhe I takojm fisit Kurejsh. Ne I kemi mbajtur çelësat e Qabës së shenjtë dhe ato të varrit të Profetit që nga koha e Ibrahimit; dhe ne gjithashtu I kemi çelësat e shtëpisë ku dy këpucët e bekuara të Profetit tonë dhe sende të tjera ruhen.

Mënyra se si Profeti ynë ishte nderuar përshkruhet në Kur'an: Ai ishte lejuar që ti afrohet Zotit tonë dhe ishte shikuar me një sy favorizimi; atij I ishte treguar nga shenjat cka ai kishte nevojë që të shihte, dhe ai I dëgjoi misteriet e zbulimit në mënyrë direkte pa një ndërmjetësues. Ai pa një figurë të bukur mbi Kurorën e Parajsës (*Xhennetit*), një figurë që kurr më parë nuk ishte parë, në gradën më të lartë të engjujve, apo të banorëve të tjerë të Parajsës.

Profeti ishte kapluar me dashuri dhe I dehur me këtë hir dhe bukuri të kësaj figure. Ai pa se kishte veshur një turban të pështjellur në stilin 'Qekker-dviz' dhe një 'borda' nga Jemeni. Thellë I shqetësuar, Profeti e pyet Xhebrailin: "Kam parë shumë gjëra mahnitëse dhe forma të jashtzakonshme në secilën sferë hyjnore. Megjithatë asnjëra nuk më kënaqi më shumë se kjo figurë. A është ky një kryeengjull, një *evlia* I shenjtë perfektë apo profet në detyrë? Kush është ai dhe cili është sekreti I tij?"

Xhebraili ju përgjegj: "Ky vizion I bukur, është I një person, pasardhës I Ebu Bekrit ra, të Vërtetit, që ai do të paraqitet në mesin e njerëzve të tu në kohërat e fundit, dhe do ta mbush botën me dritat dhe të vërtetat e misterieve të tua. Dhe Zoti ynë do ti dhurojë atij këmbë, një penë dhe një zë të tillë saqë gjenerata të njerëzve do ta duan atë dhe do të bëhen nxënësit e tij; ai do të bëhet misteria dhe drita e botës së manifestuar dhe ai do ti sjell pastërti fesë tënde.

Në cdo mënyrë, në sjellje dhe pamje, ai do të jetë sikur ti! Dhe emri I tij gjithashtu do të jetë Muhamed dhe emri tjetër I tij do të jetë, Xhelaledin. Në mësimet e tij ai do ti shpjegon misteriet e traditave tua, dhe do ti ndriçoj idetë e thella të Kur'anit tonë madhështorë. "Xhebraili përfundoi.

Dhe Profeti, paqja dhe bekimet qofshin me të, ishte kapluar me një gëzim të madhë. Kur ishte kthyer tek shtëpia e tij e bekuar, ai filloi ta vishte turbanin e tij në të njëjtën mënyrë që e kishte parë në vizion.

Ky është tregimi që udhëtarët nga Meka na treguan ne, dhe ne i dëgjuam ata ta përsërisin prapë fjalë për fjalë tek Sejjidët e cmuar të Medinës.

Në esencë Mevlana na ofron njohuri që na dërgon tek perceptimi shpirtërorë. Ai na kujton ne për fuqinë transformative të Realitetit Hyjnorë. Është e pashmangshme se kur substanca njerëzore të bie në kontakt me Hyjnoren do të transformohet. A nuk është kjo esenca e një kuptimi të

vërtetë të Zbulimeve Hyjnore? A nuk na thërrasin ne Librat e Shenjta dhe Profetët që të transformohemi nga kjo fuqi shpirtërore? Në Mevlanën ne kemi ilaqin për cdo patologji shpirtërore gjithashtu edhe eliksirin që të transformon, substancën e papërpunuar të vetë veteve tona, ti shndërrojë natyrat tona të ngurta në rubinjë.

Tregimi në Aflaki më bindi se Islami që ne e gjetëm në Kopshtin e Mevlanës ishte në të vërtetë Islami I Profetit, mëshirë për të gjithë botërat, dhe jo ndonjë e bërë qefit të vetes apo një krijim I yni imagjinor. I përsëris këto fjalë nga Aflaki ashtu që e vërteta e tyre të bëj një eko brenda në zemrat tona:

Ai do të paraqitet në mesin e njerëzve të tu në kohërat e fundit, dhe do ta mbush botën me dritat dhe të vërtetat e misterieve tua. Dhe Zoti ynë do ti dhurojë atij këmbë, penë dhe një zë të tillë saqë gjenerata të njerëzve do ta duan atë dhe do të bëhen nxënësit e tij; ai do të bëhet misteria dhe drita e botës së manifestuar dhe ai do ti sjell pastërti fesë tënde. Në cdo mënyrë, në sjellje dhe pamje, ai do të jetë sikur ti!

5. Vdekja klinike

Përjetimi Afër Vdekjes – Përmbledhje

Si është të vdesësh?

Edhe pse ka variacione të gjëra të rastëve rreth personave që kan qen afër vdekjes dhe ne tipat e personave që i kan përjetuar ato, mbetet e vërtetë se ka një ngjashmëri të hatashme ne mes të këtyre përjetimeve vetë. Ne fakt, ngjashmëritë në mes të raporteve të ndryshme janë aq të mëdha saqë njëri shumë lehtë mund të nxjerrë 15 elemente të ndara që përsëritën pandërprerë në këtë masë të tregimeve që unë i kam përmbledhur. Ne bazë të këtyre pikave të ngjashmërisë, më lejoni tani të ndërtoj thjesht, teorikisht "idealen"apo një përjetim "komplet"që mvishet tek të gjitha elementet e përbashkëta, në rendin që është tipikë ato të ndodhin.

Nje njeri po vdes dhe, kur arrin pikën kulminante të shqetësimit fizikë, ai degjon se shpallet i vdekur nga mjeku i tij. Ai fillon të dëgjoj një zë të parehatshëm, si një cingërimë me zë të lartë, apo vetëm zhurmë, dhe njëkohësisht e ndien veten se është duke lëvizur shumë shpejt nëpër një tunel të gjatë dhe të erret. Pas kesaj, ai papritur e gjen veten jashtë nga trupi fizikë, por ende në rrethinën fizike ku kishte qenë, dhe e shikon trupin e tij nga distanca, sikur të ishte një spektator. Ai i shikon perpjekjet e stafit mjekësor per ta ripërtërirë trupin e tij dhe është në një gjendje emocioni të lartësuar.

Pas pak, ai fillon të adaptohet tek kondita e tij e jashtzakonshme dhe fillon ta përmbledh veten. Ai ve re se ende ka "trup"por të një natyre tjetër

dhe me fuqi të tjera nga trupi fizikë që e kishte lënë prapa. Shpejt gjëra të tjera fillojn të ndodhin. Të tjerë vin ta takojn dhe ti ndihmojnë. Ai i vëren shpirtat e të afërmve të tij që veq kan vdekur, gjithashtu vëren një shpirt të ngrohtë dhe të dashur që kurr nuk e ka takuar me parë – një qenie nga drita – paraqitet para tij. Kjo qenie e pyet një pyetje, pa folur, që ta bëjë atë ta vleresonë jetën e tij dhe i ndihmon atij duke e shfaqur jetën e tij si në panorama – kthim instant- tek ndodhitë e mëdha të jetës se tij. Më pas e gjen veten se i eshte afruar një lloj barriere apo kufiri, me siguri prezenton kufirin midis jetës se tokës dhe jetës se ardhshme. Disi, e kupton se duhet të kthehet prapa ne tokë, se koha e vdekjes se tij ende nuk ka arritur. Në këtë pikë ai rreziston të kthehet, se tani veq është mësuar me përjetimin e botës së përtejme dhe nuk dëshiron të kthehet. Ai eshte i mbushur me ndjenja intense të gëzimit, dashurisë, dhe qetësisë. Edhe pse rreziston, disi ai ribashkohet me trupin e tij fizikë dhe jeton.

Me vonë ai mundohet tu tregoj të tjerëve, por ka vështirësi ta bej këtë. Në rend të parë ai nuk mund të gjejë asnjë fjalë njeriu, adekuate ta përshkruaj këtë epizodë jotokësore. Ai gjithashtu e kupton se të tjerët fshajnë me pabesim kur e dëgjojn, prandaj ndalon dhe me nuk i tregon të tjerëve. Por pra se prap ky përjetim i ka bërë një efekt shumë të madh jetës së tij, sidomos pikëpamjet e tij rreth vdekjes dhe marrëdhenien e tij me jetën.

E pashpjeguara me fjalë

Kuptimi i përgjithshëm që kemi për shprehjen gjuhësore varet nga ekzistenca e komunitetit të gjërë të përjetimeve të përbashkëta në të cilat gati të gjithë ne marrim pjesë. Ky fakt krijon një vështirësi të rëndësishme që e komplikon të gjithë diskutimin që do të vijon. Ndodhitë që janë përjetuar nga ata të cilët kanë qenë afër vdekjes, ndodhen jashtë përjetimeve të zakonshme të komunitetit, prandaj njëri mund të kuptojë se ata do të kenë vështirësi gjuhësore për tu shprehur se c'farë u ka ndodhur atyre. … Personat e involvuar në menyrë të përgjithshme i karakterizojnë përjetimet e tyre si të pashpjeguara, të pamundura për tu shprehur.

Shumë njerëz janë shprehur në atë mënyrë që "Nuk ekzistojnë fjalë për të shprehur atë qe dua të them, "…. Nje grua me pak fjalë më tha:

"Tani, është një problem real për mua derisa mundohem të ta them këtë, sepse të gjitha fjalët që unë i di janë tre dimenzionale. Derisa po e studioja, po mendoja, 'Kur mësoja gjeometrinë, gjithmonë më kanë thënë se janë vetëm tre dimenzione, dhe gjithmonë e kam pranuar ashtu. Por ata e kishin gabim. Ka më shumë. ' Dhe, me siguri, bota jonë që ne po jetojmë tani – është tre dimenzionale, por tjetra me radhë definitivishtë nuk është. Prandaj e kam shumë vështire të ta them këtë. Duhet të ta shpjegojë në fjalë që janë tre dimenzionale. Ajo është mënyra më e afërt për tu shprehur por

nuk është adekuate. Në të vërtetë nuk mund të të jap një panoramë të kompletuar".

Afër Vdekjes - Dëgjimi i Lajmit

"Njerëzit janë në gjumë, dhe kur të vdesin do të zgjohen"(Hadith)

Shumë njerëz kanë thënë se I kanë dëgjuar mjekët e tyre apo spektatorët e tjerë në atë efekt, ti shpallin të vdekur. Një grua më tregoi se si, isha në spital, por nuk e dinin se cfarë kisha. Prandaj Dr. Gjejms, mjeku im, më dërgoi një katë më poshtë tek radiologu për të fotografuar mushkëritë në menyrë që të kuptonin se ku ishte problemi me mua. Së pari e testuan një ilaq që do ta përdornin në krahun tim, meqenëse isha shumë alergjike ndaj ilaqeve. Por nuk kishte ndonjë reakcion, prandaj vazhduan më tutje me proceduren e tyre. Kur e përdoren ilaqin këtë herë, unë rash para tyre. E dëgjova radiologun qe po punonte në mua kur shkoi tek telefoni, dhe e dëgjova shumë qartë derisa I shtypte numrat e telefonit. E dëgjova duke thënë, "Dr. Gjejms, të vrava pacienten, Zonjën Martin. "Dhe unë e dija se nuk kisha vdekur. U mundova që të levizja dhe tu tregoja, por nuk munda. Kur u munduan të më rikthejnë, I degjoja duke thënë sa c. c. 's të dickaje të më jepnin, por nuk I ndieja gjilpërat të më qponin. Nuk ndieja asgjë kur më preknin.

Në një rast tjetër një grua që më parë kishte pasur disa herë probleme me zemër, pati sulm në zemër, ku gati e humbi jetën. Ajo thote:

Papritur, fillova të përjetoja shtypje dhe dhimbje në gjoks, sikurse një copë e hekurit të më ishte ngjitur shpejt përreth pjesës së mesme të gjoksit tim dhe të më shtrëngonte. Bashkëshorti dhe një shokë I yni më dëgjuan kur u rrëzova dhe erdhën shpejt për të më ndihmuar. E gjeta veten në një errësirë të thellë, dhe përmes kësaj errësire e dëgjova bashkëshortin tim, sikurse të ishte në një distancë të largët, duke thënë, "Kjo është këtë herë!"Dhe mendimet e mia ishin, "Po, kjo është. "

Raportet e tipit të tillë janë mjaft në pajtim me atë cfarë mjekëve dhe të tjerëve prezent u kujtohet. Për shembull një mjek më tha:

Një grua, paciente e imja pati infarkt pak para se unë dhe një mjek tjetër do të bënim operacion në të. Isha aty, dhe e pash se si bebzat e syve të saj u zgjeruan. U munduam për ca kohë ta rikthejmë, pa ndonjë sukses, prandaj mendova se kishte vdekur. U thash mjekëve të tjerë që ishin me mua të mundohemi vetëm edhe një herë, dhe do e lëmë. Këtë herë zemra filloi ti rrah, dhe ajo erdhi në vete. Më vonë e pyeta në qoftë se iu kishte kujtuar ndonjë gjë për "vdekjen"e saj. Ajo tha se nuk I kujtohej shumë për atë përjetim, vetëm se më kishte dëgjuar duke thënë "Të mundohemi vetëm edhe një herë, dhe do e lëmë. "

Ndjenjat e Paqes dhe Qetësisë

Shumë përjetues të vdekjeve klinike përshkruajnë ndjenja jashtzakonisht të këndshme dhe vetëdijësim gjatë stazave të hershme të ekseriencave të tyre.

Pas nje lëndimi të rëndë të kokës, shenjat vitale të jetës së një njeriu nuk hetoheshin fare. Siç thote ai, mu në castin e lëndimit ishte nje moment shumë I shpejt I dhimbjes, por mandej e gjithë dhimbja u shua. E kisha një ndjenjë sikur po levizja në një hapesirë të errët. Ate ditë ishte shume ftohtë, megjithatë derisa isha në atë errësirë e tëra që ndjeja ishte ngrohtësi dhe kjo ishte ndjenja me e këndshme që kam përjetuar... Me kujtohet kur mendoja, "Duhet të kem vdekur. "

Nje grua që kishte përjetuar infarkt komenton:

Fillova të përjetojë ndjenjat më të mbrekullueshme. Nuk ndjeja asgjë në botë vetëm se paqe, rehati, lehtësim – vetëm qetësi. Ndjeva sikur më ikën të gjitha brengat e mija, dhe mendoja me vet-veten, "Sa qetësi e rehati, dhe nuk kam dhimbje aspak. "

Një njeriu tjetër I kujtohet:

Kisha vetëm një ndjenjë të mirë, madhështore të terheqjes dhe paqes… Ishte bukuri, isha në një qetësi të jashtzakonshme në mendjen time.

Një njeri që "vdiq"pas plagëve të marra në Vietnam se përderisa ishte qëlluar ndjeu, një lirim të hatashëm. Nuk kishte dhimbje, dhe kurr nuk jam ndjerë më i relaksuar. Isha pa brenga, dhe cdo gjë ishte mirë.

"Ti do ta dije sekretin e vdekjes. Por si do ta gjeje po mos të kërkoje në zemrën e jetës. "

Vdekje Klinike – Zhurma

Në shumë raste, variacione të jashtëzakonshme të senseve të zërit janë raportuar të ndodhin në apo afër vdekjes. Nganjëherë keto përjetime janë shumë të pakëndshme. Një njeri që "vdiq"për njëzet minuta gjatë një operacioni (abdominal) përshkruan: "një zë i keq tingëllime vinte nga brendësia e kokës sime. Më bëri shumë të parehatshëm…. Kurr nuk e harroj atë zë. "Një grua tregon se derisa po e humbte vetëdijen ajo dëgjoi "një tingëllimë me zë shumë të lartë. Mund të përshkruhet si një fishkëllimë. Isha në një gjendje sikur rrotullohesha. "

Githashtu e kam dëgjuar këtë sensacion të neveritshëm si një prekje me zë të lartë, si një ulërimë, sikur një goditje, dhe sikur një zë fishkëllime ashtu si kur të fryen era. "

Në raste të tjera efektet e zërit duket sikur marrin një formë të këndshme të muzikës. Për shembull, një njeri që sapo ishte ripërtërirë pasi që ishte prononcuar i vdekur me të arritur në spital i kujtohet se gjatë përjetimit të tij të vdekjes, dëgjoja cka dukej të ishin tingëllima të këmbanave, nga një largësi e madhe, dukej sikur zëri vinte përmes erës. Tingëllonin sikur këmbanat Japoneze të erës. … Ai ishte i vetmi zë që dëgjoja her pas here.

Një grua e re që për pak vdiq nga gjakëderdhja e brendshme e asociuar me një c'rregullim të trashjes së gjakut tha se në momentin që ishte rrëzuar, "Fillova të dëgjoja një lloj të muzikës, magjestike, me të vërtetë një muzikë të një lloji shumë të bukur. "

Tunelli i Errët - Vdekje Klinike

Shpesh herë së bashku me dëgjimin e zhurmës, njerëzit ndjejnë një sensacion sikur tërhiqen shumë shpejt nëpër njëfar lloj hapësire të errët. Shumë fjalë të ndryshme janë përdorur për ta përshkruar këtë hapësirë. Kam dëgjuar që kjo hapësirë të përshkruhet si shpellë, bunarë, kanalë, hapësirë e mbyllur, tunell, mjet me trajtë të konit, vakum, zbrazëti, vadë, luginë, dhe cilindër. Edhe pse njerëzit përdorin terminologji të ndryshme këtu, është e qartë se të gjithë mundohen të shprehin një ide. Le të shikojmë dy ngjarje në të cilat figuron kryesisht "tunelli"

Kjo më ndodhi mua kur isha shumë i ri – nëntë vjeqar. Kjo ka ndodhur para njëzet e shtatë vjetëve, por më ka lënë shumë mbresa saqë kurr nuk e kam harruar. Një mbasdite u sëmura shumë, dhe me të shpejtë më dërguan tek spitali më i afërt. Kur mbërrimë ata vendosën për të më pirë, por nuk e dija pse, sepse isha shumë i ri. Në atë kohë ata përdornin eter. Ma dhanë mua duke e vënë një copë harrni mbi hundën time, dhe kur e bënë, më kanë treguar më vonë, zemra ime pushoi së rrahuri. Në atë kohë nuk e kam ditur se ajo më pat ndodhur mua, megjithatë kur kjo ndodhi pata një përjetim. Sendi i parë që ndodhi – tani do ta përshkruaj mu ashtu si jam ndier – ishte se e kisha një zhurmë cingërruese brrrrrnnnng-brrrrrnnnng-brrrrrnnnng, mjaftë ritmike. Mandej po lëvizja përmes – do të mendoni se kjo është e cuditshme – përmes këtij vendi të gjatë dhe të errët. Dukej sikur kanalë apo dicka e till. Nuk mund ta përshkruaj më mirë. Po lëvizja, bashkë me zhurmën, zërin cingërrues.

Një informues tjetër thotë:

Pata një reakcion alergjik shumë të keq ndaj një anestezioni, dhe thjesht pushova nga frymëmarrja – Pata sulm në frymëmarrje. Sendi i parë që ndodhi – ishte shumë shpejt – ishte se po shkoja përmes këtij vakumi të zi, të errët me super shpejtësi. Mund ta krahasoni me një tunell. Ndjeja sikur kisha hypur në një tren "roller koster"tek ndonjë parkë argëtimi, dhe shkoja përmes këtij tunelli me shpejtësi të hatashme.

Gjatë një sëmundje, njëri ishte shumë afër vdekjes saqë bebzat e syve iu thanë, dhe trupi i tij ftohej. Ai tha:

Isha në një hapësirë të zezë, të errët. E kam shumë vështirë ta shpjegoj, por ndjeja sikur po lëvizja në vakum, përmes errësirës. Megjithatë isha mjaftë i vetëdijshëm. Ishte sikur që njëri të jetë në një cilindër pa ajër në të. Ishte një ndjenjë sikur vetëm gjysma ime ishte këtu, dhe gjysma-largë diku tjetër.

Një njeri që kishte vdekur disa herë pas disa djegieve të rënda dhe lëndimeve gjatë rrëzimit, thotë: Mbeta në shok për një javë, dhe gjatë asaj kohe papritur vetëm kur ika në një hapësirë të errët. Mu dukë sikur qëndrova atje për një kohë shumë të gjatë vetëm duke lëvizur në hapësirë…Aq shumë u dhash pas kësaj hapësire saqë nuk mendoja për asgjë tjetër.

Para kohës së këtij përjetimi, që kishte ndodhur kur ai kishte qenë fëmijë, një njeri e kishte pasur frigë gjithmonë errësirën. Megjithatë kur zemra i kishte pushuar së rrahuri nga lëndimet e brendshme në një aksident me biciklletë ai thotë: E kisha një ndjenjë sikur po lëvizja në një luginë të errët. Errësira ishte aq e thellë dhe e padepërtueshme saqë nuk mund të shihja absolutikisht asgjë, por ky ishte përjetimi më i mahnitshëm që mund ta imagjinosh, pa asnjë gajle.

Në një tjetër rast, një grua kishte pasur peritonitis, dhe tregon: Mjeku im veq e kishte thirrur vëllaun dhe motren time të më shohin për her të fundit. Motra medicinale më dha një injekcion për të më ndihmuar që të vdes më lehtë. Gjërat përreth meje në spital filluan të largohen cdo herë e më shumë. Kur u larguan, hyra me kokë së pari në një udhë shumë të ngushtë dhe të errët. Dukej të ishte e madhe veq sa të më nxe mua aty brenda. Fillova të rrëshqas poshtë, poshtë, poshtë.

Një njeri që kishte qenë shumë afër vdekjes dha një tregim paralel me besimin e tij fetarë. Ai tha: Papritur, isha në një luginë shumë të thellë dhe të errët. Dukej sikur të kishte qenë një udhë, përmes kësaj lugine, dhe po shkoja poshtë kësaj udhe…Më vonë kur bëra më mirë, më erdhi në mendje "Tash e di c'farë bibla don të thotë me fjalët 'lugina e hijes së vdekjes, ' sepse kam qenë atje. "

"Se jeta dhe vdekja janë një, dhe vetëm ata që e konsiderojnë këtë përjetim si Një mund të arrijnë kuptimin se çka me të vërtetë do të thotë paqë. "–
Edgar Cayce

Qenia e Dritës - Vdekje Klinike

Çka është ndoshta elementi më mahnitës I përbashkët në rastet që unë I kam studiuar, dhe me siguri elementi që le mbresa më të mëdha në individin është takimi me një dritë shumë të ndritshme. Zakonisht në fillim të shfaqjes kjo dritë është e dobët, por me shpejtësi ndricohet derisa të arrin një shkëlqim jashtëtokësorë. Megjithatë, edhe pse kjo dritë (zakonisht thuhet të jetë e bardhë ose pa ngjyrë) është e një shkëlqimi të papërshkrueshëm, shumë prej përjetuesve bëhen specifik në këtë pikë duke thënë se në asnjë mënyrë nuk u ka shkaktuar dëm syve të tyre, apo tu shkaktonte marramendje, apo tua humbte shikimin e gjërave përreth. (Ndoshta për arsye se në këtë pikë më nuk kanë sy fizikë).

Pavarësisht nga manifestimi I jashtëzakonshëm I dritës, megjithatë, asnjë person nuk ka shprehur ndonjë dyshim dhe se ishin të bindur se ishte

një qenie, një qenie e dritës. Jo vetëm aq, ishte një qenie personale. Ka një personalitet të definuar. Dashuria dhe ngrohtësia që rrezatojnë nga kjo qenie tek personi që është duke vdekur është e papërshkrueshme me fjalë, dhe ai ndihet komplet I rrethuar nga kjo dritë dhe I tërhequr në të, tërësishtë I relaksuar dhe I pranuar në prezencën e kësaj qenie. Ai e ndjen një tërheqje magnetike të parrezishtueshme tek kjo dritë.

"Zoti e fsheh nga njerëzit lumturinë e vdekjes në mënyrë që ta përballojnë jetën. "*(Anonim)*

Është interesante, se përderisa përshkrimi I mësipërm I qenies së dritës është shumë I ngjashëm në mes të përjetuesve të këtij fenomeni, identifikimi I qenies ndryshon nga individi në individë dhe duket të jetë një funksion I prapavisë fetare, ushtrimeve, apo besimet në personin e involvuar. Prandaj shumë prej atyre që janë të Krishterë në ushtrime apo besim e identifikojnë dritën me Krishtin. Një burrë dhe një grua cifute e identifikojnë dritën si një "engjull. "Megjithatë ishte e cartë, në të dyja rastet, se subjekti nuk ka dashur të thotë, se qenia kishte krahë, apo ka luajtur harpë, apo edhe të ketë trajtën apo dukjen e njeriut. Ishte vetëm drita. Cka secili donin të thonin se ata e kuptuan qenien si një këshilldhënës. Njëri që nuk kishte asnjë besim fetarë apo asnjë ushtrimë para përjetimit thjeshtë e identifikonte c'farë kishte parë si "qenie e dritës. "

Shpejtë pas shfaqjes së dritës, qenia fillon të komunikon me personin që po ndërron jetë. Si shënim, ky komunikim është vetëm me mendje, nuk dëgjohej ndonjë zë fizikë apo zëra të vinin nga qenia, as nuk ia kthyen përgjigjen qenies me zë. Por është raportuar se në mënyrë direkte zë vend një transferim I mendimeve, dhe në një mënyrë shumë të cartë saqë nuk do të kishte asnjë mundësi as për ta keqkuptuar as për ta gënjyer qenien. Më tutje, ky lloj komunikimi nuk zhvillohet fare në gjuhen amtare të personit. Megjithatë, ai kupton të tërën dhe në mënyrë instante është I vëmendshëm. Ai madje nuk mund ti përkthejë komunikimin me mendje që ndodhi derisa kishte qenë afër vdekjes, në gjuhën njerëzore që tani duhet të flasë, pas ripërtëritjes.

Faza e ardhshme e eksperiencës cartë e ilustron vështirësitë e përkthimit nga kjo gjuhë e pa folur. Qenia gati menjëherë e direkton një lloj mendimi tek personi në të cilin prezenca I është ardhur dramatikishtë. Zakonishtë personat me të cilët unë kam biseduar mundohen të formulojnë mendimin në pyetje. Midis përkthimeve që kam dëgjuar janë: "A je i përgaditur të vdesësh?, ""A je I gatshëm të vdesësh?, ""Cka ke berë me jetën tënde që të më tregosh mua?""Cka ke bërë me jetën tënde të jetë e mjaftuar?. "

Dy formulimet e para që e parashtrojnë "përgaditjen, "mund në sy të parë te duken sikur kanë tjetër kuptim nga dy ciftet e dyta, që shprehin "arritje. "Megjithatë, pakë mbështetje për ndjenjat e mia në lidhje me këtë

ceshtje, që secili është duke u munduar të shpreh mendimin e njëjtë vie nga tregimi I një gruaje që e tha kështu:

Sendi I parë që më pyeti, se disi më pyeti a isha e gatshme të vdesë, apo cka kisha bërë me jetën time që do të dëshiroja ti tregoja. Më tutje, edhe në rastet më të jashtzakonshme parashtrimi I "pyetjes", del në përfundim si një sqarim, që ka një forcë të njëjtë. Për shembull, një njeri më tha se gjatë "vdekjes"së tij, Zëri më bëri një pyetje: "A ia vlen?"Cka don të thoshte se, a ia vlente mënyra e jetesës sime që kisha bërë gjer më tani, duke e ditur atë që e dija atëherë.

Si duket, të gjithë insistojnë se kjo pyetje, aq definitive dhe e thellë që duket të jetë në mbresën emocionale, nuk është pyetur aspak në mënyrë akuzuese. Qenia, të gjithë duken të jenë në pajtim, nuk e direkton pyetjen tek ata që ti akuzon apo ti kërcënojë, sepse ata ende e ndiejnë dashurinë totale dhe pranimin që rezonon nga drita, pa marrë parasysh c'farë mund të ishte përgjigja e tyre. Por në vend të akuzimit, qëllimi I pyetjes duket të jetë që ti bëjë ata të mendojnë për jetërat e tyre, që ti shfaqin ato. Janë, po deshe ti quash, pyetje Sokrate, njëri lutet mos të merr informata por ti ndihmojë personit të cilit I bëhet pyetje që vetë të arrin tek caku I së vërtetës. Ti shikojmë disa takime të drejtpërdrejta me këtë qenie fenomenale.

I dëgjova mjekët të thonë se kisha vdekur, dhe atëherë fillova të ndihem sikur po dridhesha, disi si isha zhvendosur dhe po lundroja, përmes një errësire, që ishte si e mbyllur. Me të vërtetë nuk ka fjalë që mund ta përshkruaj këtë përjetim. Cdo gjë ishte shumë e errët, perveq se, largë nga unë, mund ta shihja një dritë. Ishte një dritë shumë shumë e shkëlqyeshme, por jo shumë e madhe në fillim. Rritej më shumë derisa po afrohesha afër saj.

Mundohesha të arrijë tek ajo dritë tek fundi, sepse ndjeja që është Jezusi, dhe mundohesha ta arrijë atë vend. Nuk ishte një përjetim I frikshëm. Ishte pak a shumë një kënaqësi. Sepse menjëherë, paSiçe jam Krishtere, e lidha dritën me Krishtin, që ka thënë, "Unë jam drita e botës. "I thash vetes time, "Në qoftë se kjo është e tëra, në qoftë se do të vdes, atëherë e di kush më pret atje në fund, atje në atë dritë. "

U ngrita dhe eca në korridor që të shkoj ta marr një pije, dhe ishte në atë moment, kur e kishin kuptuar më vonë, se apendiksi im kishte shpërthyer. U bëra shumë e ligë, dhe u rrëzova. Fillova ta ndieja veten si po largohesha, një lëvizje e qenies sime të vërtetë brenda dhe jashtë trupit, dhe po dëgjoja një muzikë të këndshme. Duke ndejtur pezull në ajër fluturova poshtë korridorit dhe jashtë nga dera tek ballkoni I mbyllur. Aty, u dukë sikur retë, një mjegull ngjyrë roze me të vërtetë, filloi të grumbullohet për rreth meje, mandej fluturova direkt përmes rrjetit të ballkonit si të mos ishte aty fare, dhe në kristalë të ciltër drite, një dritë e bardhë e iluminuar. Ishte shumë e bukur dhe shumë e ndritshme, aq

rrezatuese, por nuk mi lëndonte sytë. Nuk është ndonjë dritë që mund ta përshkruash në tokë. Në të vërtetë nuk pashë ndonjë person në këtë dritë, por megjithatë e ka një identitet special, definitivishtë e ka. Eshtë një dritë e dashurisë perfekte dhe e kuptimit perfektë.

Ky mendim më erdhi në mendje, "A më donë mua?"Kjo nuk ishte si një pyetje, por kuptimi cka drita tha ishte, "Në qoftë se më don mua, kthehu prapa dhe mbaro atë që ke filluar në jetën tënde. "Dhe gjatë gjithë kësaj kohe, ndjeja sikur isha rrethuar nga një dashuri dhe dhembshuri e papërshkrueshme.

E dija se po vdes dhe nuk kisha asgjë që do të mund të bëja për atë punë, sepse askush nuk mund të më dëgjonte…Isha jashtë nga trupi im, nuk ka dyshim për atë punë, sepse mund ta shihja trupin tim aty në tavolinë në dhomën e operimit. Shpirti im ishte jashtë! E tëra kjo më bëri të ndihem shumë keq në fillim, por mandej, kjo dritë shumë shkëlqyese erdhi. Dukej se ishte më e dobët në fillim, por më vonë ishte kjo rreze shumë e madhe. Ishte një sasi shumë e madhe e dritës, asgjë sikur dritat e mëdha që ne i përdorim, kishte shumë shumë dritë. Dhe më dha nxehtësi mua; Ndjeja një sensacion të ngrohjes.

Ishte një dritë si e verdhë e qelur – më shumë e bardhë. Ishte një ndricim I jashtzakonshëm; nuk mund ta përshkruaj. Dukej sikur kishte përfshirë cdo gjë, megjithatë nuk më pengonte që të shihja cdo gjë përreth meje – dhomën e operimit, mjekët dhe motrat, cdo gjë. Mund të shihja cartë, dhe nuk ti merrte sytë.

Së pari kur drita erdhi, nuk isha e sigurtë c'farë po ndodhte, por mandej disi pyeti, a isha gati për të vdekur. Ishte sikur po flisja me një person, por personi nuk ishte atje. Drita ishte që më fliste mua, por me zë.

Tani, mendoj se zëri që po më fliste mua e kuptoi se nuk isha gati të vdesë. Disi, sikur po më testonte mua më shumë se cdo gjë tjetër. Megjithatë që nga momenti që drita më foli mua, ndjehem shumë mirë – e sigurtë dhe e dashur. Dashuria që buronte nga kjo dritë është e pa imagjinuar, e papërshkruar. Ishte një person I këndshëm ta kishe pranë! Dhe e kishte një sensë të humorit, gjithashtu – definitivishtë!

Takimi me të tjerët - Vdekje Klinike
"Dhe kur toka do ti kërkojë brinjtë e tu, atëherë me të vërtetë do të vallëzosh. "

(Kahlil Gibran)

Shumë prej tyre më kanë thënë se në një moment gjatë vdekjes së tyre-ndonjëherë herët në eksperiencë, ndonjëherë pasi ngjarje të tjera kanë mbaruar – ata bëhen të vetëdijshëm për prezencën e qenieve të tjera shpirtërore afër tyre, qenie që si duket janë aty që ti lehtësojnë ata/ato gjatë

tranzicionit në vdekje, ose, në dy raste, tu thonë se ende nuk është koha e tyre për të vdekur dhe se duhet të kthehen tek trupat e tyre fizikë.

E pata këtë përjetim në lindje të një fëmiu. Lindja qe shumë e vështirë, dhe humba shumë gjakë. Mjeku u dorëzua, dhe I tha kusherinjëve të mi se po vdisja. Megjithatë, isha mjaftë e kfjelluar gjatë të gjithë procesit madje edhe kur e dëgjova atë duke I thënë këto fjalë e ndjeva veten sikur po largohesha. Derisa kjo po ndodhte, e kuptova se shumë njerëz ishin grumbulluar aty, gati dukeshin si në turma, duke qëndruar rreth tavanit në dhomë. Të gjithë këta njerëz I kisha njohur në jetën e sapo kaluar, por që kishin vdekur më parë. E njoha gjyshën time dhe një vajzë që e kam njohur kur kam qenë në shkollë, dhe shumë kusherinjë të tjerë dhe shoqëri. Dukej sikur kryesisht ua shihja fytyrat dhe e ndjeja prezencën e tyre. Të gjithë dukeshin të kënaqur. Ishte një rast shumë I gëzuar, dhe ndjeja që kanë ardhur të më mbrojnë dhe të më këshillojnë. Dukej gati sikur po kthehesha në shtëpi, dhe ata ishin atje që të më përshëndesin dhe të më bëjnë të ndihem e mirëseardhur. Gjatë gjithë kësaj kohe, e kisha një ndjenjë se cdo gjë është dritë dhe bukuri. Ishte një moment I bukur dhe madhështorë.

Në disa raste, njerëzit arritën të besojnë se qeniet që ata I takonin ishin "rojet shpirtërore"të tyre. Një njeriu I ishte thënë nga një qenie e tillë se, "Të kam ndihmuar deri në këtë fazë të ekzistencës tënde, por tash më duhet të të dorëzoj tek të tjerët. "Një grua më tha se derisa ajo po largohej nga trupi I saj ajo vuri re prezencën e dy qenieve shpirtërore aty, dhe ata e identifikuan veten e tyre si "ndihmësit shpirtërorë"të saj.

Rishikimi i Jetës

"Gjëja e fundit që të tejkalohet është vdekja, dhe njohuria e vdekjes është njohuria e jetës. " - Edgar Cayce

Shfaqja e qenies së dritës dhe testimi I saj, pyetjet pa fjalë paraqesin vetëm një hyrje tek momenti I një intensiteti të hatashëm gjatë të cilit qenia prezenton tek personi një rishikim panoramik të jetës së tij. Shpesh është ashiqare se qenia mund ta shikon tërë jetën e individit të shfaqur dhe se qenies nuk I nevoiten informacione. Qëllimi I vetëm I tij është të provokon një reflektim.

Ky rishikim I jetës mund të përshkruhet vetëm ne terme të memorjes, pasi që ajo është e afërmja më e ngjashme e këtij fenomeni, por ka karakteristika që e dallojnë nga cdo kujtim i tipit normalë. Pikë së pari, ndodhë jashtzakonishtë shpejt. Kujtimet, kur përshkruhen në terme kronologjike, thuhet se përcjellin njëra tjetrën shumë shpejt, në rend kronologjikë. Disa të tjerëve nuk u kujtohet fare një rend kronologjikë. Kujtesa ishte instante/menjëhershme; cdo gjë u shfaqë përnjëherë, dhe mund ta abzorbonin të tërën vetëm me një shikim mental. Sido që të shprehet, të gjithë duket se janë të pajtimit se përjetimi mbaron në një castë të kohës së tokës.

Megjithatë, pa marrë parasysh shpejtësinë, informuesit e mi pajtohen se rishikimi, që gati gjithmonë përshkruhet si një shfaqje e imazheve vizuale, është jashtzakonishtë I çartë dhe real. Në disa raste imazhet raportohen të jenë në ngjyra vibruese, tre dimenzionale, madje edhe lëvizin…. Edhe emocionet dhe ndjenjat të asociuara me imazhet mund të ripërjetohen derisa njëri I shikon ato.

Disa nga ata/ato që janë intervistuar deklarojnë se, përderisa nuk mund ta përshkruajnë në mënyrë ekzakte, cdo gjë që ata/ato kishin bërë ishte atje në atë rishikim të jetës – nga më e parëndësishmja deri tek ajo më e rëndësishmja…

6. Raste të Vdekjeve Klinike

"Ndërdija pSiçike beson në jetën pas vdekjes"- Karl Jung

Në një spital në Zvicerr në vitin 1944, psikiatri i mirënjohur boteror Karl G. Jung, përjetoi një sulm në zemer (infarkt) dhe mandej një përjetim afër-vdekjes. Përballimi i tij i cartë me dritën, plus domethënia intense e pamjes së brendshme e bën që Jung të arrij në përfundim se përjetimi i tij erdhi nga dicka reale dhe e përjetshme. Përjetimi i Jungut është një përjetim unik në atë se ai e pa Token nga një lartësi prej 1600 km përmbi të. Pamja e tij e Tokës nga hapësira ishte përshkruar nga Jung, me një precizitet të hatashëm përafersisht dy dekada para se astronautet e parë në hapësirë së pari e përshkruan atë. Përderisa reflektonte në jetën pas vdekjes, Jungut iu kujtua Hindusi qe meditonte nga përjetimi afer-vdekjes dhe e lexoi si një simbol arkitipi të vet-vetes së lartë, Imazhi i Zotit përbrenda. Karl Jung, qe e themeloi "psikologjinë analitike", u përqendrua në arkitipet e Ndër-dijes kolektive. Shkrimi në vijim është një shkëputje nga autobiografia e tij e quajtur "Memories, Dreams, Reflections"ku e përshkruan përjetimin e tij afër-vdekjes.

Mu duk se isha lart në hapësirë. Larg atje poshtë e pash globin e Tokës, të shpërlarë në lavdin e dritës së kaltërt. E pash detin e thellë të kaltërt dhe kontinentet. Larg nën këmbët e mia shtrihet Sejlon, dhe në distancë më tutje nga unë India. Fusha e vizionit tim nuk përfshinte të gjithë tokën, por trajta globale dallohej cartësisht dhe vijat anësore shkëlqenin me një ndriqim argjendi përmes bukurisë së kaltërt të dritës. Në shumë pjesë globi dukej i ngjyrosur, apo me shenja të ngjyrës së gjelbërt të mbyllur sikurse argjendi i oksiduar. Larg më tej në të majtë shtrihej gjerësisht - e kuqe - në të verdhë shkretëtira e Arabisë; të conte mallin sikur argjendi i Tokës kishte marr një hije të kuqe në të art. Mandej e pash Detin e Kuq, dhe prapa shumë më larg – sikur lart në të majtë të hartës – mezi mund të dalloja Mediteranin. Shikimi im ishte drejtuar kryesisht atje. Cdo gjë tjetër dukej e paqartë. Mund ti shihja Himalajat të mbuluara me borë,

por në ate drejtim ishte mjegull dhe me re. Nuk shikova në të djathtë fare. E dija se isha tek pika e largimit nga Toka.

Më vonë e kuptova se sa lart në hapësirë njëri duhet të jetë të ketë një pamje aq të gjërë – përaferisht 1600 km! Pamja e Tokës nga kjo lartësi ishte gjëja më madhështore qe kam parë ndonjëherë.

Pasi meditova për një kohë për të tërën c'farë po ndodhte, u ktheva rrotull. Kisha qen duke qëndruar me shpindë nga Oqeani Indian, dhe fytyra ime në veri. Mandej mu duk se u ktheva në jug. Dicka e re hyri në fushën e shikimit tim. Në distancë të shkurtë më tej e pash në hapësirë një bllok të hatashëm guri të errët, si një meteor. Ishte përafërsisht i madh sa shtëpia ime, apo edhe më i madh. Po levizte në hapesirë, dhe une po levizja në hapësirë.

Kam parë gurë të ngjashëm në bregun e Golfit të Bengalit. Ato ishin blloqe graniti, dhe disa prej tyre i kishin hapur në tempuj. Guri im ishte një bllok i tillë i errët dhe gjigand. Një hyrje të shpiente tek një paradhomë e vogël. Në anën e djathtë të hyrjes, një Hindus i zi rrinte ulur në gjendjen lotus mbi një ulëse të gurit. Ai kishte veshur një mbulesë të bardhë, dhe e kuptova se ai po më priste mua. Dy shkallë të qonin tek kjo paradhomë, dhe brenda, në të majtë, ishte dera e hyrjes për në tempull. Bira të vogla dhe të panumërta, secila me një formë si konkave të mbushura me vaj kokosi dhe qirinjë të vegjël qe digjeshin, e rrethonin derën me një perde që flakëronte me ndriqim. Në fakt e kisha parë njëherë këtë lloj tempulli tek Dhembi i Shenjtë në Kendy në Seilon; Dera ishte ndërtuar me disa rreshta me llampa të tilla që digjeshin me vaj.

Derisa u afrova afër shkallëve që të dërgonin tek hyrja në guri, një gjë e papritur ndodhi: Ndjeja sikur cdo gjë po zhvishej nga unë; cdo gjë që synoja apo dëshiroja apo ndonjë mendim, e tërë fantazia e ekzistencës së tokës, ra nga unë – ishte një proces jashtzakonisht i vështirë. Megjithatë dicka mbeti; ishte sikur tani unë mbaja me vete cdo gjë që kisha përjetuar apo bërë, cdo gjë që kishte ndodhur përreth meje. Gjithashtu të them: ishte me mua, dhe une isha përjetimi im. Përbëhesha nga e tërë ajo, ashtu të them. Përbëhesha nga historia ime dhe ndihesha shumë i sigurt; kjo është cka unë jam. Unë jam i tëri ky c'farë kam qenë dhe c'farë kam arritur.

Ky përjetim më solli një ndjenjë të madhe zbrazëtie, por njëkohësisht të një mbushje të madhe. Nuk kishte më asgjë që dëshiroja. Ekzistoja në një formë objekive; Isha c'farë kam qenë dhe jetuar. Së pari një ndjenjë e zhdukjes predominonte në mua, pasi qe isha zhveshur; por papritur u bë pa pasojë.

Çdo gjë dukej të ishte e kaluar; cka mbeti ishte "fait accompli", pa ndonjë referencë mbrapa c'farë kishte ndodhur. Nuk kishte më ndonjë pendim se dicka më është hequr mua. Përkundrazi: Une kisha cdo gjë që isha, dhe ajo ishte e tëra.

Dicka tjetër më kapi vëmendjen: përderisa iu afrova tempullit kisha një ndjenjë sigurie se do të hyja në një dhomë të ndricuar dhe do të takoja atje të gjithë ata njerëz tek të cilët unë takoj, në realitet. Atje në fund do të kuptoja – kjo gjithashtu ishte e sigurtë – cilit neksus të jetës unë apo jeta ime i takonte. Do ta dija c'fare ka ndodhur para meje, përse une kam ardhur në ekzistencë, dhe ku po më dërgonte jeta. Jeta ime ashtu si e kisha jetuar shpesh herë më dukej sikur një tregim qe nuk ka as fillim e as mbarim. E kisha një ndjenjë se isha një fragment i historisë, një shkrim në të cilin fillimi dhe fundi i tekstit mungonin. Mu duk sikur jeta ime u hoq nga një zingjir i gjatë i ndodhive, dhe shumë pyetje mbeten pa përgjigje. Pse kisha marrur këtë drejtim? Pse i kam sjellur mu këto supozime me mua? Cka nxorra nga ato? Cka do të vijon më tutje? Ndihesha i sigurt se do të merrja një përgjigje për të gjitha ato pyetje që kisha, posa të hyja në tempullin e gurit. Atje do ti takoja njerëzit që e dinin përgjigjen e pyetjes për atë c'farë ishte më pare dhe cka do të pasonte më tutje.

Përderisa po mendoja për këto cështje, dicka ndodhi që ma tërhoqi vëmendjen. Nga poshtë, nga drejtimi i Evropes, një imazh u ngrit lart. Ishte mjeku im, apo më mirë të them, ajo që i përgjante atij-i rrethuar me një zingjirë ari… e dita menjëherë: 'Aha, ky është mjeku im…, ai qe po më shëronte. Por tani po vie në formën e tij primare. Në jetë ai ishte një avatar i një trupi të përkohshëm që i shërbente formës së tij primare, që ka ekzistuar që nga fillimi. Tani ai po paraqitet në formën e tij primare. '

Me siguri se edhe unë isha në formen time primare, edhe pse kjo ishte një gje qe nuk e kisha vështruar por thjesht e dija në mënyrë instinkte. Përderisa po qëndronte para meje, një shkëmbim i mendimeve (pa folur) ndodhi në mes nesh. Mjeku ishte deleguar nga Toka të sjell një mesazh për mua, të më tregoj se ishte bërë protest kundër largimit tim nga Toka. Unë nuk kisha drejt ta lëshoja Tokën dhe duhej të kthehesha. Në momentin që i dëgjova këto fjalë, vizioni u zhduk.

Isha jashtzakonisht i dëshpëruar, se tani e tëra dukej se u bë për asgjë. Procesi i vështirë i zhveshjes ishte bërë për asgjë, dhe nuk do të më lejohej të hyja në tempull, qe të iu bashakngjitesha njerëzve tek të cilës shoqëri une i takoja.

Në realitet, tre javë të mira kaluan para se të vendosja që të jetoja prapë. Nuk mund të haja sepse të gjitha ushqimet më refuzonin mua. Pamja e qytetit dhe bjeshkëve nga shtrati më dukeshin sikur një perde e vizatuar me bira të zeza në të, apo si një faqe e gazetës së ndrydhur me plot fotografi që nuk përmbanin asnjë kuptim për mua. i dëshpëruar, mendova, "Tani prap duhet të kthehem tek '*sistemi i kutisë*". Sepse me dukej mua sikur prapa horizontit të kozmosit një botë tre-dimenzionale ishte ndërtuar artificialisht, në të cilën cdo person rrinte vet i ulur në një kuti të vogël. E tani duhet ta bind veten prap nga fillimi se kjo është me rëndësi! Tani jeten dhe të gjithë botën po e shikoja si një burg, dhe më mundonte pa masë se

prap me duhet ta pranoj të tërën si krejt në rregull. U pata gëzuar shumë qe u zhvesha nga e tëra, dhe tani prap unë me cdonjërin do të virremi në kuti nga një fije.

Ndjeva një rezistencë të dhunshme për mjekun tim qe më kishte sjellur prapa në jetë. Njëkohësisht isha brengosur për të. "Jeta e tij ishte në rrezik, …! Ai më është paraqitur mua në formën e tij primare! Kushdo që e merr këtë formë do të thotë se do të vdesë, sepse ai veq i takon "shoqërisë më madhështore". Papritur ky mendim i tmerrshëm më erdhi mua se në vend timin mjeku do të vdes. U mundova sa munda të bisedoj me të, por ai nuk më kuptonte. Mandej u zemërova me të.

Në fakt aktual unë kisha pas qen pacienti i tij i fundit. Me 4 prill, 1944 – ende më kujtohet data e saktë, mu lejua që të ulem në anën e shtratit për të parën herë prej fillimit të sëmundjes time, dhe po në atë ditë mjeku im u shtri në shtrat dhe nuk u ngrit më. Dëgjova se kishte pasur sulme të njëpasnjëshme të temperaturës. Shpejt pas asaj ai vdiq nga septicernia. Ai ishte një mjek i mirë; kishte dicka gjeniale për të. Përndryshe nuk do të më ishte shfaqur mua si një avatar i trupit të përkohshem të formës së tij primare.

"Ndërdija pSiçike beson në jetën pas vdekjes"

Beti J. Idi

Me 18 Nëntore, 1973, Beti Idi vdiq nga komplikimet e një operacioni të pjesërishëm të histerektomisë. Pasi që ishte ripërtërirë në jetë, Beti vuajti nga depresioni – aq e dhimbshme ishte ndarja e saj nga drita e dashurisë që ajo e kishte përjetuar gjatë momenteve të vdekjes klinike. Njëzet vite më vonë, pasi që e kishte ndarë tregimin e saj me familjen dhe shoqërinë, dhe me pacientët në gjendjet kritike të sëmurë nga kanceri, Beti ishte ftuar që ta shkruaj përjetimin e saj në mënyrë që një audiencë më e madhe ta shijojë bukurinë e këtij tregimi. Me 1992, "Embraced by the Light""E Përqafuar nga Drita"ishte publikuar në Qytetin Carson, Nevada. E Përqafuar u bë një fixim permanentë në Nju Jork Tajms Best Seller, duke kaluar më shumë se një vit, si numër nje. Ky Përjetim Afër Vdekjes i Betit është njëra nga përjetimet më të detalshme dhe të carta që ndonjëherë është dokumentuar.

Dalja nga Trupi

Beti e lëshon trupin e sajë përmes gjoksit dhe fluturon mbi shtratin e saj. Tri qenie që dukeshin si murgji të mbuluar shfaqen dhe ajo I identifikon ata të jenë engjujt e saj të rojes. Ata I thonë asajë që kanë qenë me të "përjetësishtë"dhe se ajo ka vdekur para kohe. E brengosur për familjen e sajë që e kishte lënë prapa, ajo udhëton në formën e shpirtit ti shohë ata; por ajo e kupton se ajo nuk mund të shihet nga ata. Beti mandej kthehet tek trupi I sajë ku engjujt e saj të rojes po e pritnin.

Hyrja në Dritë

E pashë një pikë të dritës në distancë. Masa e zezë përreth meje filloi të marrë një trajtë të tunellit, dhe e ndjeva veten në udhëtim përmes ti me një shpejtësi edhe më të madhe, në nxitim drejtë dritës. Instinktivishtë isha tërhequr tek ajo, edhe pse, ndjeja se të tjerët mund të mos tërhiqeshin. Derisa u afrova, vëra re figurën e një burri që po qëndronte aty, me një dritë që po rrezatonte çdokund përreth tij. Sa u afroja drita bëhej më e ndriçuar – e ndriçuar përtej përshkrimit, shumë më e ndriçuar se dielli – dhe e dita se asnjë sy I tokës në gjendjen e tyre natyrale nuk do të mund të shikonte në këtë dritë pa u shkatërruar. Vetëm sytë shpirtërorë mund ta përballonin – dhe ta vlerësonin. Derisa afrohesha më afër fillova të qëndroja drejtë.

E pashë që drita fillestare përreth tij ishte ngjyrë ari, sikur I gjithë trupi I tij të kishte një aura ari përreth tij, dhe mund të shihja se kjo aura e arit shpërthente përreth tij dhe shpërndahej në dritë të bardhë madhështore që shtrihej në një distancë. E ndjeva dritën e tij të përzihet me dritën time, literalisht, dhe ndjeja sikur drita ime tërhiqej tek drita e tij. Ishte sikur të ishin dy llampa në dhomë, të dyja duke shëndritur, dhe rrezet e tyre përzihen së bashku. Eshtë shumë vështirë ta dish ku një dritë mbaron dhe ku tjetra fillon; dhe vetëm ashtu ato bëhen një dritë. Edhe pse drita e tij ishte shumë më e ndricuar se e imja, isha e vetëdijshme se drita ime, gjithashtu, na ndriconte. Dhe derisa dritat tona u bashkuan, ndjeva sikur hyra në qenien e tij, dhe ndjeva jasht mase një eksplodim të dashurisë.

Ishte dashuria më e pakushtëzuar që ndonjëherë kam përjetuar, dhe derisa I pashë krahët e tij duke u hapur për të më pranuar mua, shkova tek ai dhe morra komplet përqafimin e tij dhe thoja pandërprerë, "Jamë në shtëpi. Jamë në shtëpi, Më në fund jamë në shtëpi. " E ndjeva shpirtin e tij madhështorë dhe e dita se gjithmonë kamë qenë pjesë e tij, se në realitet unë kurr nuk kam qenë largë nga ai.

Dhe e dija se ia vleja të isha me të, ta përqafoja atë. E dija se ai ishte I vetëdijshëm për të gjitha mëkatet dhe gabimet e mia, por që tani nuk kishin rëndësi. Ai vetëm dëshironte të më përqafonte dhe ta ndante dashurinë e tij me mua, dhe unë desha ta ndaja dashurinë time me të.

Gjithë jetën time ia kam pasur frikën, dhe tani e pashë – e dija – se ai ishte shoku im I zgjedhur. Ngadalë, ai I hapë krahët e tij dhe më lejon të qëndrojë prapa aq sa ti shohë sytë e tij, dhe ai tha, "Vdekja jote është para kohe, ende nuk është koha jote. " Asnjë fjalë që ndonjëherë më janë folur nuk kanë penetruar në mua më mirë se këto. Deri atëherë, nuk kam ndjerë ndonjë qëllim në jetën time; Thjeshtë kam kaluar me kohën duke kërkuar për dashuri dhe mirësi por kurr në fakt nuk e kam ditur në qoftë se veprimet e mia kanë qenë të mira. Tani, brenda në fjalët e tij, ndjeva një detyrë, qëllim; Nuk e dija se çka ishte, por e dija se jeta ime në tokë nuk ka qenë pakuptim. Ende nuk më kishte ardhur koha mua.

Koha ime do të vie kur misioni im, qëllimi im, kuptimi im në këtë jetë, të jetë kryer. E kisha një arsye për të ekzistuar në tokë. Por edhe pse e kuptoja këtë, shpirti im rrebeloi. A do të thotë kjo se duhet të kthehem prapa? I thashë atij, "Jo, tani unë kurr nuk mund të të lë. "

Ai e kuptoi çka do të thoja, dhe dashuria e tij dhe pranimi për mua kurr nuk u zbehen. Mendimet e mia më vërshuan: "A është ky Jezusi, Zoti, qenia që iu kam frikësuar gjatë gjithë jetës sime? Ai nuk është fare ashtu si kisha menduar. Ai është I mbushur me dashuri. "

Mandej pyetjet filluan të vinë në mendjen time. Desha të dija pse kam vdekur në atë mënyrë – jo si parakohe, por si u bë që shpirti im kishte ardhur këtu para ringjalljes. Ende po funksionoja nën mësimet dhe besimin e fëmijërisë time. Drita e tij tani filloi të ma mbushte mendjen, dhe pyetjeve të mie i ipej përgjigje edhe më shpejt se sa që unë mbaroja së pyeturi. Drita e tij ishte njohuri. Kishte fuqi të më mbushte me tërë të vërtetën. Pasi fitova kurajo dhe e lejova dritën të hyjë në mua, pyetjet më vinin më shpejtë se që kam menduar se është e mundur, dhe përgjigja u ipej po me aq shpejtësi. Dhe përgjigjet ishin absolute dhe të kompletuara. Nga frika, e kisha keqinterpretuar vdekjen, kam pritur dicka që nuk është ashtu. Varri kurr nuk kishte qenë i caktuar për shpirtin – por vetëm për trupin. Nuk ndjeja ndonjë gjykim që kam qenë gabim. Ishte vetëm një ndjenjë se një e vërtetë e thjeshtë më ka zëvendësuar gabimin tim….

Por desha ta dija të tërën, që nga fillimi gjer në fund. Kurreshtja ime gjithmonë I kishte torturuar prindërit e mi dhe bashkëshortin tim – dhe nganjëherë mua – por tani ishte një bekim, dhe isha mahnitur me lirinë për të mësuar. Po mësohesha nga mësuesi master! Kuptimshmëria ime ishte asi soji që mund të kuptoja vollume për një cast. Ishte sikur që të shikoja në një libër dhe ta kuptoja vetëm me një të shikuar – sikur të ulesha derisa libra e shfaqte veten tek unë në çdo detalë, përpara dhe prapa, brenda dhe jashtë, çdo nuancë dhe sygjerim të mundshëm.

E tëra në një castë. Derisa e kuptoja një send, më shumë pyetje dhe përgjigje më vinin mua, të gjitha duke u ndërtuar njëra mbi tjetrën, dhe të bashkpunonin sikur e tërë e vërteta të ishte e lidhur qenësishtë…Njohuria më kaploi mua. Në një kuptim u bë unë, dhe u mahnita me aftësinë time që të kuptojë misteriet e universit thjeshtë vetëm duke reflektuar në to.

Desha të dija pse kishte kaq shumë kisha në botë. Pse Zoti nuk na dhuroi vetëm një kishë, një fe të dëlirë? Përgjigja më erdhi mua me kuptimin më të cartë. Secili nga ne, më është thënë, jemi në nivele apo shkallë të ndryshme të pjekurisë shpirtërore dhe kuptimit. Prandaj çdo person është përgaditur për një nivelë tjetër të njohurisë shpirtërore. Secila fe në botë është e nevojshme sepse ka njerëz që kanë nevojë për atë që mësojnë. Njerëzit në një fe ndoshta nuk e kanë kuptuar plotësishtë inxhillin e Zotit dhe kurr nuk do ta kuptojnë derisa janë në atë fe. Por se feja përdoret si një shkallë e gurit për ta bartur njohurinë. Çdo kishë përmbush

nevojat shpirtërore që ndoshta të tjerat nuk do të mund të mbushnin. Asnjë kishë nuk do të mund ti mbushte nevojat e çdonjërit në çdo nivelë. Derisa individi e ngritë nivelin e kuptimit të tij për Zotin dhe progresin e tij të përjetshëm, ai mund të ndihet I ndarë me mësimet e kishës së tij dhe ndoshta do të kërkon një filozofi tjetër apo ndonjë tjetër fe që ta mbushë atë zbrazëtirë. Kur kjo të ndodhë ai ka arritur një tjetër nivelë të kuptimit dhe do të vuan për më shumë njohuri dhe për të vërtetën e mëtejme, dhe për një mundësi tjetër për pjekuri. Dhe në çdo shkallë të rrugës, këto mundësi për të mësuar do të dhurohen.

Pasi e morra këtë njohuri, e kuptova se ne nuk kemi të drejtë, në asnjë mënyrë të kritikojmë ndonjë kishë apo fe. Të gjitha janë të çmuara nga këndvështrimi I Tij. Njerëz shumë special me misione shumë të rëndësishme janë vendosur në të gjitha vendet, në të gjitha fetë, në çdo stacion të jetës, në mënyrë që ata ti prekin të tjerët. E tëra e inxhillit ekziston, por shumica e njerëzve nuk do ta kuptojnë këtu. Në mënyrë që të kuptohet kjo e vërtetë, ne duhet ta dëgjojmë Shpirtin dhe të lirohemi nga egoja. Desha të mësojë qëllimin e jetës në tokë. Pse ne jemi këtu? Derisa isha zhytur në dashurinë e Jezu Krishtit a. s. nuk mund të imagjinoja pse ndonjë shpirtë vullnetarishtë do ta lente këtë parajsë të mbrekullueshme dhe të gjitha që kishte për ti ofruar – sa botëra për të hulumtuar dhe ide për të krijuar dhe njohuri për të fituar. Pse dikush do të dëshironte të vinte këtu? [tokë]. Në përgjigje, më kujtohet krijimi I tokës. Në faktë unë e përjetova atë sikur që po ribëhej para syve të mi. Kjo ishte me rëndësi. Jezusi a. s. dëshironte që unë të interiorizojë këtë njohuri. Ai dëshironte që unë të kuptojë se si isha ndier kur krijimi ndodhi. Dhe e vetmja mënyrë për ta bërë atë ishte për mua që ta shikojë prapë dhe të ndjejë çka kam ndier më parë.

Të gjithë njerëzit si shpirtëra në botën para-mortale morrën pjesë në krijimin e tokës. Ne ishim shumë të entuiziazmuar që ishim pjesë e kësaj. Ne ishim me Zotin, dhe e dinim se Ai na kishte krijuar, se ne ishim vetë fëmijët e Tij. Ai ishte I kënaqur me evoluimin tonë dhe ishte mbushur me dashuri absolute për secilin nga ne. Gjithashtu, Jezu Krishti a. s. ishte atje. U befasova kur e kuptova, se Jezusi a. s. ishte një qenie tjetër nga Zoti, me qëllimin e tij të veçantë hyjnorë, dhe e kuptova se Zoti ishte Ati ynë I përbashkët. Rritja ime në një atmosferë Protestante më kishte mësuar se Zoti si Ati dhe Jezu Krishti a. s. ishin një qenie.

Derisa të gjithë u mbodhëm, Ati shpjegoi se me ardhjen tonë në tokë për një kohë do të arrinim më shumë pjekuri shpirtërore. Secili shpirtë që do të vinte në tokë kishte ndihmuar në planifikimin e kushteve në tokë, duke përfshirë ligjet e mortailitetit që do të na sundonin ne. Këtu përfshiheshin ligjet e fizikës ashtu si I njohim ne, kufizimin e trupave tonë, dhe fuqitë shpirtërore që do të ishim në gjendje ti shfrytëzonim. Ne I ndihmuam Zotit në zhvillimin e pemëve dhe jetës së shtazëve që do të jenë

këtu. Çdo gjë ishte krijuar më parë nga materia e shpirtit mandej ishte krijuar fizikishtë – sistemet solare, yjet, hënat, planetet, jeta në planete, malet, lumenjtë, detërat, etj. E pashë këtë procesë, dhe mandej, që më tutje ta kuptoja, isha treguar nga shpëtuesi se krijimi shpirtërorë mund të krahasohej me fotografitë tona; krijimi shpirtërorë do të ishte si një fotografi shumë e bukur, dhe toka do të ishte sikur negativi I errët I po të njëjtës fotografi. Kjo botë është vetëm një hije e bukurisë dhe madhërisë të krijimit shpirtërorë, por është çka na duhet për pjekurinë tonë. Ishte më rëndësi që të kuptoja se ne të gjithë ndihmuam për të krijuar kushtet e jetesës këtu.

Shumë herë mendjen kreative që e kemi këtu në këtë jetë është rezultat I inspirimeve të padukura. Shumë nga zbulimet e tona të rëndësishme madje edhe zhvillimi I teknologjisë së pari ishin krijuar në shpirtë nga qenie shpirtërore. Mandej individëd në tokë e morrën inspirimin për ti krijuar këto zbulime këtu. E kuptova se gjendet një lidhje vitale, dinamike në mes të botës shpirtërore dhe mortalitetit, dhe se ne kemi nevojë për shpirtërat në anën tjetër për përparimin tonë. Gjithashtu pashë se ata me gjithë qejf na ndihmojnë në c'fardo mënyre që të kenë mundësi.

Pashë se botën para-mortale ne e dinim madje edhe I zgjodhëm misionet e tona në jetë. Kuptova se stacionet tona në jetë bazohen në objektivat e këtyre misioneve. Përmes njohurisë hyjnore ne e dinim se ç'farë teste dhe përjetime do të kishim, dhe ne u përgaditëm në përputhje me këtë. Ne bashkpunuam me të tjerët – anëtarët familjarë dhe shoqërinë – që të na ndihmojnë ti mbarojmë misionet tona. Ne kishim nevojë për ndihmën e tyre. Ne erdhëm si vullnetarë, secili kuriozë që të mësojë dhe përjetojë të tërën që Zoti e kishte krijuar për ne. E dita që secili nga ne që vendosi të vijë këtu ka qenë një shpirtë guximtarë. Edhe më I pazhvilluari në mesin tonë këtu ishte I fortë dhe guximtarë atje. Na është dhënë një agjenci që të veprojmë për veten këtu. Vetë veprimet e tona e caktojnë drejtimin e jetërave tona, dhe ne mund ti ndryshojmë apo ti ridrejtojmë ato në c'fardo kohe. E kuptova se kjo ishte shumë me rëndësi; Zoti na premtoi se ai nuk do të intervenon në jetërat tona pa kërkuar ne vetë intervenimin nga Ai. Dhe mandej përmes njohurisë së Tij të pashterrshme Ai do të na ndihmon të arrijmë dëshirat tona të drejta. Ne ishim shumë falënderues për këtë aftësi që ta shprehim vullnetin tonë të lirë dhe ta ushtrojmë fuqinë e tij. Kjo do të na lejon secilin nga ne të arrijmë kënaqësi të madhe ose të zgjedhim atë që do të na sjell pikëllim. Zgjedhja do të jetë e jona përmes vendimeve tona.

Në fakt më erdhi një lirim kur mësova se toka nuk është shtëpia jonë natyrale, se ne nuk e kishim origjinën këtu. U gëzova kur pashë se toka është vetëm një vendë I përkohshëm për tu shkolluar dhe se mëkati nuk është natyra jonë e vërtetë. Shpirtërishtë, ne jemi në nivele të ndryshme të

dritës – që është njohuri – dhe për shkakë të natyrës tonë hyjnore; shpirtërore ne jemi të mbushur me dëshirën për të bërë mirë.

Megjithatë, Vetja jonë e tokës, është pandërprerë në kundërshtim me shpirtin tonë. E pashë sa I ligë është mishi. Por është këmbëngulës. Edhe pse shpirtërat tonë janë plotë me dritë, vërtetësi, dhe dashuri, duhet të luftojnë pandërprerë që të triumfojnë ndaj mishit, dhe kjo I forcon ata. Ata që me të vërtetë janë të pjekur do të gjejnë një harmoni perfekte në mes të mishit të tyre dhe shpirtit, një harmoni që do ti bekojë ata me paqe dhe do tu dhurojë aftësinë për ti ndihmuar të tjerët.

Derisa mësohemi për tu përshtatur ligjeve të krijimit, ne mësojmë si ti përdorim këto ligje për të mirën tonë. Ne mësojmë si të jetojmë në harmoni me fuqitë krijuese përreth nesh. Zoti na ka dhuruar talente individuale, disa më shumë disa më pak, sipas nevojës. Derisa I përdorim këto talente, ne mësojmë si të punojmë dhe eventualishtë ti kuptojmë ligjet dhe ti mbijetojmë kufizimet e kësaj jete. Duke I kuptuar këto ligje ne jemi më të aftë ti shërbejmë atyre përreth nesh. Ckado që të bëhemi këtu në mortalitet është e pakuptimtë në qoftë se nuk bëhet për dobinë e të tjerëve. Dhuratat tona dhe talentet na janë dhënë që të na ndihmojnë të shërbejmë. Dhe duke I shërbyer të tjerëve ne zhvillohemi shpirtërishtë.

Mbi të gjitha, më është treguar se dashuria është supreme. E pashë se me të vërtetë pa dashuri ne nuk jemi gjë. Ne jemi këtu që ti ndihmojmë njëri tjetrit, të kujdesemi për njëri tjetrin, të kuptojmë, të falim, dhe ti shërbejmë njëri tjetrit. Ne jemi këtu që të kemi dashuri për çdo person të lindur në tokë. Trajta e tyre e tokës mund të jetë e zezë, e verdhë, e kaftë, e bukur, e shëmtuar, e hollë, e trashë, e pasur, e varfër, intelegjente, apo injorante, por ne nuk duhet të gjykojmë nga shfaqja e jashtme. Cdo shpirtë ka kapacitet të mbushet me dashuri dhe energji të përjetshme. Në fillim, secili ka në dispozicion disa shkallë të dritës dhe vërtetësi që mund të zhvillohet më tutje. Ne nuk mund ti masim këto sende. Vetëm Zoti e din zemrën e njerëzve, dhe vetëm Zoti mund të gjykojë në mënyrë perfekte. Ai I njeh shpirtërat tonë; ne shohim vetëm fuqi dhe dobësi të përkohshme. Sepse për shkak të kufizimeve tona, shumë rrallë mund të shohim në zemrën e njeriut.

E dita se ia vlenë çdo gjë që bëjmë për të treguar dashuri: një buzëqeshje, një fjalë kurajuese, një veprim I vogël I sakrificës. Ne piqemi me këto veprime. Jo të gjithë njerëzit janë të dashur, por kur e gjejmë dikënd që e kemi shumë vështirë për ta dashur, kjo shpesh ndodhë sepse ata na kujtojnë dicka brenda në veten tonë që ne nuk na pëlqen. Mësova se duhet ti duam armiqtë tanë – ta lëshojmë zemërimin, urrejtjen, lakminë, hidhërimin dhe refuzimin për të falur. Këto gjëra e shkatërrojnë shpirtin. Ne do të japim llogari se si sillemi me të tjerët.

Me të marrë planin e krijimit, ne kënduam me gëzim dhe ishim mbushur me dashurinë e Zotit. Ne ishim mbushur me kënaqësi derisa e

shihnim pjekurinë që do të arrinim këtu në tokë lidhjet e këndshme që do ti krijonim me njëri tjetrin.

Mandej e pamë si u krijua toka. Ne e pamë se si shpirtat tonë vëllëzërit dhe motrat hynë në trupat fizikë që të mbaronin radhën e tyre në tokë, secili përjetonte dhimbjet dhe gëzimet që do ti ndihmonin ata të përparojnë. Më kujtohet vecanërishtë duke I parë pionerët Amerikan duke e kapërcyer kontinentin dhe kur kremtonin derisa I përballonin dhe I mbaronin detyrat e tyre të vështira. E dita se vetëm ata që kishin nevojë për atë përjetim ishin vendosur aty. I pashë engjujt duke kremtuar për ata që përballonin testet e tyre dhe që kishin suksesë dhe kur mërzitëshin për ata që dështonin. E pashë se disa dështonin për shkak të dobësive të tyre, dhe disa dështonin për shkak të dobësive të tjerëve. Ndjeja se shumë nga ne që nuk ishim atje nuk do të mund ti përballonim ato detyra, se ne do të kishim qenë pioner të dobët, dhe se ne do të bëheshim shkaku I më shumë vuajtjeve për të tjerët. Në të njëjtën mënyrë disa pionerë dhe njerëz nga kohërat e tjera nuk do të mund ti përballonin testimet e sodit. Ne jemi aty ku duhet të jemi.

Përderisa e gjithë kjo më erdhi mua, e kuptova perfekcionin e planit. E pashë se ne të gjithë u bëmë vullnetarë për pozitat dhe stacionet tona në botë, dhe që secili nga ne është duke marrë më shumë ndihmë se sa që ne e dimë. E pashë dashurinë e pakushtëzuar të Zotit, përtej ndonjë dashurie të tokës, që rrezatonte nga Ai tek të gjithë fëmijët e Tij. I pashë engjujt duke qëndruar afër nesh, duke pritur për të na ndihmuar, duke kremtuar në të arriturat dhe gëzimet tona. Por mbi të gjitha e pashë Krishtin, krijuesin, shpëtimtarin e tokës, shokun tim, dhe shokun më të afërt që ndonjëri nga ne mund ta ketë. Dukej sikur isha shkrirë me kënaqësinë derisa isha në krahët e tij dhe ngushëllohesha – më në fund në shtëpi. Do të ipja të tërën në fuqinë time, të tërën çka kam qenë, që prapë të më kaplonte ajo dashuri – të përqafohesha në krahët e dritës së tij të përjetshme.

Udhëtimi në Parajsë

Dy shokë të ngushtë të Betit të cilët ajo i kishte njohur para se të lindte, i shfaqën asaj. Përqafohen dhe shkojnë në një udhëtim në botën e shpirtërore. Ata hynë në një dhomë të madhe dhe shohin njerëz duke krijuar rroba të parajsës…Në një dhomë tjetër, ajo sheh njerëz duke punuar me një makinë të madhe në pamje dukej si një kompjuter. Ata mandej hynë në një dhomë e ngjajshme me një librari. Eshtë libraria e mendjes. Ata dalin jashtë tek një kopshtë ku male dhe lumenjë të bukur mund të shihen në distancë. Eshtë një fushë më e bukur sesa fjalët mund të përshkruajnë.

Para një ujëvare, Beti vështron një trëndafilë madhështorë dhe bëhet një me të përkohësishtë. Një grup njerëzish mblidhen përreth për të festuar gradimin e saj. Engjujt që i bëjn roje janë atje dhe i thonë asajë se ka vdekur para kohe dhe duhet të kthehet prapa. Duke dëshiruar ta hulumtojë

universin, Beti shoqërohet nga dy qenie të dritës në gjerësinë e hapësirës. Ajo udhëton tek botërat e tjera të ngjashme me tokën dhe me qenie intelegjente në to. Ajo kthehet tek kopshti dhe dërgohet tek një vend ku shumë shpirta janë duke u përgaditur për jetën në tokë.

Shoqëruesit e Betit i tregojnë asaj një njeri pijanec i shtrirë në trotuar dhe e pyesin atë se ç'farë sheh. Beti e sheh vetëm një të dehur që rrinte si gjynah në ndytësirën e tij. Shoqëruesit e saj I tregojnë asaj kush është me të vërtetë ai njeri. Ai njeri ishte i mbushur me dritë dhe dashuri dhe ishte shumë i dashur në botën shpirtërore. Ishte bërë në atë mënyrë për tu kujtuar njerëzve nevojën për ti ndihmuar të tjerët.

Betit i tregohet toka ashtu si duket nga hapësira. Asaj i tregohet se si lutjet fluturojnë si rreze të dritës nga toka. Ajo i sheh engjujt duke nxituar përreth për tu përgjigjur lutjeve. Beti e vështron gjithë këtë derisa është në kopshtë.

Mandej dërgohet nga kopshti tek një ndërtesë e madhe para "Këshillit të të Vjetërve"i përbërë nga 12 njerëz dhe Jezusi a. s. Këtu prapë i thuhet se vdekja e saj ka ndodhë para kohe dhe se ajo duhet të kthehet në tokë. Jezusi ia tregon jetën e saj në një rishikim në formë të hologrameve shumë mirë të definuara. Jezusi a. s. e ngushëllon atë kur ajo sheh aspektet negative të jetës së saj dhe kur fillon ta gjykoj rëndë veten e vetë.

Pas rishikimit të jetës së saj, asaj I thuhet se misioni i saj në jetë nuk ka mbaruar dhe se duhet të kthehet. Beti me këmbëngulje refuzon. Jezusi a. s. vendos ti tregon asaj misionin që ka për ta mbaruar me kusht që në qoftë se vendosë të kthehet në tokë, memorja e misionit të saj do të hiqet. Ajo pajtohet me këtë kusht dhe i tregohet misioni. Menjëherë, ajo pajtohet të kthehet prapa. Papritur, me mijëra engjuj shfaqen ti këndojnë lamtumirë. Beti e gjen veten e saj në spital, aty ku e tëra kishte filluar. Misioni i saj në jetë komplet ishte hequr nga memorja e saj.

"Zoti e dinte se ne do të bëjmë gabime. Jeta e tëra ka të bëjë me gabimet. Eshtë një pjekuri dhe ndryshim konstant. Një ditë do të kuptojmë se vështirësitë më të mëdha në jetë kanë qenë mësusesit tanë më madhështorë. "

Vdekje Klinike - Mej Julit (May Eulitt)

Shkrimi në vijim është njëra nga ato Vdekje Klinike (NDEs) që përjetohet përnjëherësh nga disa njerëz. Një pjesë e këtij përjetimi është përshkruar me fjalët e Mej Julit tek Stefen Hojer, PH. D. nga libra e tyre e titulluar "Fireweaver. "

Gjatë vjeshtës në vitin 1970, kur I kisha 21 vjet, përjetuam përnjëherë vdekje klinike unë me kusheririn tim Gjejms dhe shokun e tij më të ngushtë Reshadin, që ishte nga India. Të dy djemt e rinjë ishin në pushim nga shkolla dhe po qëndronin me familjen time tek ferma jonë. Në një mbasdite ne të tre shkuam tek fusha e kallamoqëve të presim sanë. Për të shkuar tek kjo fushë duhej të kalonim përmes një porte të metalit, dhe njëri

nga ne saherë që shkonim me rradhë ngjiteshim tek porta për ta hapur dhe për ta mbyllur. Nga fundi i mbasditës moti filloi të keqësohet në perëndim, dhe vendosëm që të mbarojmë për atë ditë. E kishte radhën Gjejmsi për ta hapur portën, dhe deri sa e bëri atë, ai u mbajt për krahun tim që të ngjitet lart në qerre. Unë po qëndroja në një pozitë të pavolitshme, dhe pesha e tij më tërheqi drejt tij. Reshadi më kapi krahun tjetër që të më mbanë, dhe kur ishim mu në këtë pozitë vetëtima na qëlloi. E pashë kur vetëtima xixëlloi në maje të portës. Mandej veq kur e pamë veten, se ne ishim në një dhomë të madhe apo korridor i bërë nga gurë të errët. Tavani ishte shumë i lartë dhe mjegullina ishte aq e trashë saqë nuk mund ta shihnim majën. Nuk kishte mobile apo sende të varura në murë, vetëm ftohtë, gurë i zi kudo përrethë. E dija se duhet të kisha frikë, por ndihesha e qetë, duke fluturuar aty në mjegullinë me dy shokët e mi në atë korridor të madhë e të zi. Këta murë të mëdhenj të këtij vendi qëndronin mbi ne dhe dukej sikurse rrezatonin edhe fuqi të madhe edhe një fuqi të madhe mashkullore. Më kujtohet kur mendoja se do ti ishte përshtatur Mbretit Artur. Ishte në atë moment kur e kuptova se ne të tre ishim të bashkuar në mendime dhe në trup. Imazhet e Arturit erdhen tek unë nga Gjejmsi dhe Reshadi. Gjejmsi e pa vetëm versionin komik të mbretit të dikurshëm dhe të ardhshëm. Reshadi dukej se e paramendonte veten në kohën e Arturit. Derisa u bëmë të vetëdijshëm për mendimet e njëri tjetrit, papritur e kuptova se tani e njihja Gjejmsin dhe Reshadin më mirë se cdokënd tjetër që e njihja.

Filluam të vërejmë një dritë që po vinte brenda këtu nga një udhë harkore; nga fundi i njërës anë. Ishte më shumë sesa vetëm dritë. Ishte një përqafim i artë ngrohtësie. Lëshoi një ndjenjë të paqës dhe kënaqësisë më të intensifikuar sesa cdo gjë që kemi ndjerë më parë. Ne u tërhoqëm drejt sajë. Nuk po flisnim, por po komunikonim me njëri tjetrin në një nivel tjetër, shihnim përmes syve të njëri tjetrit. Sapo erdhëm tek udha harkore dhe kaluam përmes saj, ne hymë në një luginë të bukur.

Kishte livadhe dhe kodra të renditura me drunjë që të qonin tek një bjeshkë e lartë në distancë. Cdo gjë xixëllonte me grimca të dritës së artë.

Ne i pamë se dritat xixëlluese ishin shumë të vogla, flluska transparente që lëviznin në ajër dhe shkëlqenin në livadhë. Ne e kuptuam që secila xixë e vogës ishte shpirtë. Mua lugina mu dukë të jetë parajsa, por njëkohësisht e dija se Gjejmsi dhe Reshadi po e shihnin ndryshe. Gjejmsi e shihte sikur një Gji e Shpirtave. Reshadi po e shihte si Nirvana, dhe disi e dinim të gjithë këtë pa folur. Drita filloi të grumbullohet nga fundi i luginës, dhe dalngadale, nga mjegulla një dritë e dëlirë filloi të materializohet. E pash një engjull me një fytyrë të fortë dhe të ndritshme, por jo sikur njëri zakonisht e imagjinon. Ajo i përngjante më shumë një Vikingu Valkyrie. E dita se ajo ishte një engjull speciale që po I ruante femrat në familjen time, dhe e perceptova ta kishte emrin Helena. Gjejmsi e

pa të njëjtën qenie sikur babai i tij një oficer me karrierë në Marinë, në një uniformë të bardhë. Reshadi e perceptoi qenien të jetë i Zgjuari apo Buda.

Qenia së pari i foli Reshadit dhe e mirëpriti atë. Ai tha se koha e Reshadit në tokë ka mbaruar. Ai ishte i vlefshëm tani për Nirvana. Reshadi e pyeti, pse Gjejmsi dhe unë ishim aty dhe i ishte thënë se ne ishim një pjesë e arsyes që ai kishte arritur vlerën për Nirvana. Të dy, shoku dhe shoqja e tij e donin aq shumë sa që me dëshirë e kishin shoqëruar atë në udhëtimin e tij të fundit. Megjithatë, njëkohësisht, Gjejmsi morri një tjetër mesazh. Ai brengosej se c'farë babai i tij do të mendonte për aktivitetet me protesta të tij kundër luftës, dhe babai i tij i tha se ai ishte krenar ndaj tij për qëndresën e tij në atë që besonte. Babai e dinte se ai nuk është qyqarë sepse një qyqarë nuk do ta kishte marrë këtë udhëtim me Reshadin. Unë e morra edhe një mesazh tjetër në të cilin Helena më tha se ajo ishte e kënaqur se mua më ishte kujtuar shembulli i qëndresës, drejtësis, urtësis, dhe lojalitetit që më ishte mësuar nga familja ime.

Ne kaluam cka dukej sikur një përjetësi në këtë vend derisa po flisnim tek entitetet tona të ndara megjithatë të bashkuara. Ata na thanë se na u shfaqën në këtë mënyrë sepse prapa në botë ne kishim qenë të prekur me njëri tjetrin kur vetëtima kishte qëlluar. Ata gjithashtu thanë se symbolizon unitetin e të gjitha feve dhe doktrinave. Ata më thanë so do të jetojë të shohë një gjeneratë të re të tolerancës, kur shpirtat dhe zemrat e humanizmit do të bashkohen sikur ne të tre.

Këshilluesit na mësuan se doktrinat, besimet, dhe racat nuk vlenin. Pa marrë parasysh cka ne besojmë, ne të gjithë ishim fëmijë të bashkuar nën një Zot, dhe I vetmi rregull ishte ligji I vërtetë I Zotit – bë për të tjerët cka kishe pasur dëshirë të tjerët të bëjnë për ty. Ne duhet të sillemi me të gjithë njerëzit sikur të ishin pjesë e shpirtit tonë sepse në të vërtetë janë. Të gjitha gjallesat në universë ishin të lidhura njëra me tjetrën. Ata thanë se shpejt humanizmi do të arrij maturitet të mjaftueshëm që të merr një vend më të lartësuar në skemën universale të sendeve, por derisa të arrij kjo kohë ne duhet të mësojmë pranim tolerancë dhe dashuri për njëri tjetrin. Ata thanë se do të vijë një kohë e re kur njerëzit nuk do të jenë në gjendje ti shohin të tjerët pa shtëpi dhe të uritur. Ne do të kuptojmë se vetëm duke I ndihmuar të tjerëve I ndihmojmë vetë-vetes.

Eventualisht na thanë se është koha të shkojmë. Nuk do të na lejohej të qëndrojmë më tutje se tani nuk është koha për mua dhe Gjejmsin por vetëm për Reshadin. I ndricuari I tha Reshadit se ai do të ketë pak kohë në tokë që ti mbarojë ca punë të botës para se të kthehet. Babai I Gjejmsit I tha atij se edhe ai do të kthehet tek vendi I tij shpejt pas Reshadit, por ata të dy sa për tani duhet të kthehen ashtu që të kthehem edhe unë. Unë ju thash se edhe unë dëshiroj të rri në këtë luginë me ta, por Helena më tha se fati im nuk ka mbaruar akoma, unë kisha fëmijë që ende nuk kishin lindur.

Ne lëvizëm ngadalë drejt rrugës harkore. Tërheqja u bë më e fortë dhe literalishtë u dëbuam prapa në botë. Fluturuam një cikë mbi trupat tonë. Disa nga kusherirët e mij kishin qenë në një fushë më tutje dhe kishin parë se c'farë kishte ndodhur. I pamë ata duke vrapuar aty ku kishim mbetur të shtrirë. Duart e Gjejmsit dhe Reshadit ende kishin mbetur mbi krahët e mi. Ne I pamë kusherinjët e mi që I hapen me forcë gishtërinjtë e tyre në mënyrë që ti lironin dhe ti ndihmonin Reshadit.

Kur duart e tona u liruan, Gjejmsi dhe unë hymë në trupat tonë. Ndjenim sikurse të ishim në zjarrë, por e kuptuam se kishim vetëm lëndime të lehta. Si dukej, Reshadi, paSiçë kishte qenë në fund, ishte elektrikuar më së shumti. Mjekët I thanë se vetëtima I kishte shkaktuar dëm në zemër, mushkëri, dhe veshkë. Ai qëndroi në spital për disa javë. Gjatë asaj kohe, rezultatet e testeve mjekësore të Gjejmsit treguan se ai kishte tumor në kokë që eventualisht do tia marrë jetën.

Sapo që Reshadi pati mundësi të udhëtojë, Gjejmsi e dërgoi në shtëpinë e tij në Indi. Gjejmsi deshi të rrinte me Reshadin ti bëjë shoqëri, por Reshadi I tha se dëshironte që kohën e fundit të tij ta kalon në tërheqje/ I vetmuar. Reshadi e morri jetën e një asketi, në traditën Vedike. Ai e luti gruan e tij që të rrijë me familjen e saj sepse ai dëshironte që ditët e tij të fundit ti kalojë në një zgjim shpirtërorë. Pas një viti e gjysmë, në një ditë të ftohtë të Janarit, Reshadi u kthye në Nirvana. Gjejmsi dhe unë e ditëm menjëherë kur shpirti I tij e lëshoi këtë botë pa na treguar askush.

Gjejmsi jetoi përafërsishtë tre vite pasi që e morri vesh se kishte tumor në tru. Ai e dhuroi shumicën e trashëgimisë së tij tek një organizatë bëmirëse që I edukonin të rinjtë në Indi. Unë në anën tjetër, isha në gjendje të jetojë edhe për tridhjetë vite të tjera (gjer tani) me njohurinë e kësaj eksperience që e ndava me shokët e mi më të ngushtë e që ka qenë një forcë këshilluese në jetën time. Mundohem me gjithë fuqinë që kam cdo ditë ta përballoj fatin tim, ckado që të jetë, me të njëjtin dignitet të qetë dhe vendosmërinë që ata treguan kur u përballuan me fatin e tyre. Ata me të vërtetë kanë qenë udhërrëfyesit e mij, dhe e di se lidhjen që e kam ndarë me ta shumë kohë më parë është e njëjta lidhje që ne të gjithë e ndajmë. Vetëm se nganjëherë dështojmë që ta kuptojmë.

"Planifiko për këtë botë sikur pret të jetosh përgjithmonë, por planifiko për botën e përtejme sikur pret që të vdesësh nesër. "

Enxhi Fenimor - Vdekje Klinike

Një grua e martuar dhe nënë e ndjekur nga mendimet e abuzimit që i kishte përjetuar në fëmijëri dhe e mbushur në depresion, Engji e gjen veten në një gjendje dëshpëruese të mendjes. Në vitin 1991 ajo bën vetëvrasje me shpresë që ti ikë ndjenjës së zbrazësirës dhe vështirësive. Por rezultati I vdekjes klinike e dërgon atë në vend të dritës në një fushë të errësirës. Libra e saj, "Beyond the Darkness"(Përtej Errësirës) e përshkruan ferrin që

ajo e përjeton që është shumë më I tmerrshëm dhe personal sesa metaforat me gurë dhe zjarrë. Eshtë një botë e vizioneve të tmerrshme dhe shkëputjeve pSiçike.

Engji bën vetëvrasje dhe kalon nëpër një tunell të ngrohtë dhe e ri-përjeton lindjen e saj. Ajo vë re një ekran të madhë para saj dhe tërhiqet në një shfaqje tre dimenzionale të të gjithë jetës së saj. Në mënyrë spontane ajo e përjeton tërë jetën e saj nga këndvështrimi I të tjerëve, duke përfshirë edhe atë të vetes. Ajo e sheh fëmijërinë e saj nga këndvështrimi I një të rrituri.

Pas rishikimit të jetës së saj, ajo e gjen veten në një errësirë të gjërë. Kur shikoi në të djathtë, ajo e sheh së është krah për krahu me disa të rinjë që gjithashtu kishin bërë vetëvrasje. Ajo zhytet më tutje në errësirë tek një fushë që I thuhet se është purgator. Kishte me mijëra njerëzi atje. Cdonjëri aty ishte futur thellë në mendimet e tyre për mizerien që I kishte kapluar saqë nuk komunikonin njëri me tjetrin. Ajo I dëgjon mendimet e tyre dhe tmerrohet nga izolimi aty. Ajo e kuptoi se ky ishte një vend I pa shpresë.

Arsyeja thotë,
Bota është e kufizuar
në gjashtë drejtime,
Nuk ka rrugëdalje.
Dashuria thotë:
Ka një rrugë, dhe
Unë e kam udhëtuar
disa herë.
(Rumi r. a.)

Papritur një zë rezonon nga një pikë e dritës që ajo e identifikon si Zoti, Ati. I mbushur me fuqi, zemërim, dhe dashuri, Zoti e pyet atë:

"A është kjo c'farë dëshiron?"

"A nuk e din se ky është veprimi më I keq që ke mundur të bësh?"

Ajo ia kthen,

"Por jeta ime është shumë e vështirë. "

Zoti ia kthen asaj,

"Ti mendon se ajo jetë është e vështirë? Nuk është asgjë në krahasim me c'farë të pret në qoftë se e vret e vetë-veten. Jeta është dashur të jetë e vështirë. Nuk mund ti ikësh disa pjesëve. Ne të gjithë e kemi bërë. Ti duhet ta fitosh atë që e merr. "

Jezusi I shfaqet dhe I thotë. "A nuk po kupton? Unë e kam bërë këtë për ty?"Engji bëhet një me Krishtin dhe e kupton në mënyrë perfekte sakrificën e Krishtit. Jezusi ndërmjetëson për rastin e saj te Zoti. Zoti I thotë asaj:

"Unë të kam treguar si duhet ti kalosh vështirësitë. "Duke ju referuar librave të shenjtë.

Asaj I tregohet e ardhmja, ashtu si do të ishte në qoftë se vetëvrasja e saj do të kishte sukses. Ajo e kupton se askush në purgator nuk e shihte Zotin duke folur me të. Kjo ishte për shkak se atyre u mungonte vullneti ta kërkonin Zotin ashtu si ajo e kërkonte. Ajo e kupton se qenie të dritës ka qenë përreth saj gjatë gjithë kohës. Derisa fiton më shumë dritë, ajo ngritet nga fusha e errësirës dhe e gjen veten në trupin e saj fizikë.

Gjorgj Rodonaia - Vdekje Klinike

Gjorgj Rodonaia kishte përjetuar një nga rastet më të gjata të vdekjes klinike që ndonjëherë është dokumentuar. Ishte shpall I vdekur menjëherë pas një aksidenti me makinë në vitin 1976, ai ishte lënë për tre ditë në morg. Ai nuk u "kthye në jetë"derisa mjeku filloi ti bëjë një prerje në barkë si pjesë e një procedure të autopsisë. Para përjetimit të vdekjes klinike ai punonte si neuropatologjist. Ai gjithashtu kishte qenë një ateist I përbetuar. Megjithatë pas këtij përjetimi, ai u dha ekskluzivisht pas studimit të spiritualitetit, duke marrë një doktorraturë të dytë në psikologjinë e fesë. Ai mandej u bë një priftë në Kishën Ortodokse të Lindjes. Ai shërbeu si priftë tek Kisha Unitare Metodiste e Shën Palit, në Baytown, Teksas.

Rev. George Rodonaia kishte M. D. dhe PH. D. (Fakultet dhe doktorraturë) në neuropatologji, dhe PH. D. (doktorraturë) në psikologjinë e fesë. Ai dha një fjalim të rëndësishëm tek Kombet e Bashkuara në temën e "Zgjimi Global Shpirtërorë. "se të emigronte në Amerikë nga Bashkimi Sovjetik në 1989, ai punoi si psikiatristë në Universitetin e Moskës. Në vijim është përjetimi I Dr. Rodonaias me fjalët e tij nga libra e shkëlqyer e Phillip Berman e titulluar, Udhëtimi në Shtëpi.

Bëhu i durueshëm
me të tërën që të mundon
në zemër.
Dhe mundohu ti duash
pyetjet vetë.
Mos kërko për përgjigje
që nuk mund të të ipen tani.
Sepse nuk do të mund
ti përballoje
dhe të jetoje me to...

(Rilke)

Sendi I parë që më kujtohet për Vdekjen Time Klinike është se e gjeta veten në një fushë totale të errësirës. Nuk kisha dhimbje fizike, disi ende isha I vetëdijshëm për ekzistencën time si Gjorgj, dhe e tëra përrreth meje ishte errësirë, një errësirë komplete e jashtëzakonshme – errësira më e madhe, më e errët se ç'fardo terri, më e zezë se ç'fardo e zeze tjetër. Kjo ishte çka më kishte rrethuar dhe çka më bënte presion në mua. Isha I tmerruar. Nuk isha përgaditur për këtë aspak. Isha I shokuar të kuptoja se

ende po ekzistoja, por nuk e dija se ku isha. Një mendim që më sillej vërdallë ishte, "Si mund të jem kur nuk jam?"Ajo ishte çka më mundonte.

Ngadalë fillova të vija në vete dhe fillova të mendojë se ç'farë kishte ndodhur, se çka po ndodhte. Por asgjë e freskët apo relaksuese nuk më erdhi mua. Pse jam në këtë errësirë? Çka duhet të bëjë? Mandej mu kujtua fjalia e famshe e Dekartit: "Unë mendoj, prandaj jam. "Dhe ai mendim ma hoqi një barrë të madhë mua, sepse ishte atëherë kur e dita të sigurtë se ende isha gjallë, edhe pse ashiqare në një dimenzion krejt tjetër. Mandej mendova, në qoftë se jam, pse mos të jem pozitivë? Kjo ishte çka më erdhi mua. Unë jamë Gjorgj dhe gjendem në errësirë, por e di se jam. Unë jamë çka jamë. Nuk mund të jem negativë. Mandej mendova, Si mund ta gjej çka është pozitivë në errësirë? Pozitivë është drita. Kur, papritur, isha në dritë; e bardhë e qeltë, e shkëlqyeshme dhe e fortë; një dritë shumë e shkëlqyeshme. Isha sikur një dritë e blicit, por nuk shuhesha – aq e shëndritshme. Shkëlqim konstant. Në fillim kjo dritë shkëlqyese më solli dhimbje, nuk mund të shikoja direktë në të. Por dalngadalë fillova të relaksohesha. Fillova të ndjeja një ngrohtësi, një mbështetje, dhe papritur çdo gjë dukej në rregull.

Gjëja e ardhshme që ndodhi ishte se fillova ti shohë të gjitha molekulat duke fluturuar përreth, atomet, protonet, neutronet, vetëm fluturonin çdokund. Në njërën anë e tëra ishte kaotike, megjithatë çka më solli aq kënaqësi të madhe se edhe ky kaos e kishte simetrinë e tij. Kjo simetri ishte e bukur e unifikuar dhe e plotë, dhe më vërshoi me një kënaqësi të papërshkruar. E pashë formën universale të jetës dhe të natyrës që shtrihej para syve të mi. Ishte në këtë moment që pushoi çdo brengosje për trupin tim, sepse më ishte bërë e çartë mua se nuk më duhej më, se në faktë ishtevetëm një kufizim.

Çdo gjë në këtë përjetim u bashkua së bashku, prandaj e kam vështirë të vë një sekuencë ekzakte tek ndodhitë. Koha ashtu si e kam njohur ishte ndalur; e kaluara, e tashmja, dhe e ardhmja disi ishin shkrirë së bashku në këtë unitet pakohorë të jetës.

Në një periudhë e përjetova atë që quhet proces i rishikimit të jetës, se e pashë jetën time përnjëherë që nga fillimi gjer në fund. Morra pjesë në skenat reale të jetës sime, gati si një imazh holografikë i jetës sime shfaqej para meje - asnjë ndjenë e të kaluarës, të tanishmës, apo të ardhmes, vetëm tani dhe realiteti i jetës sime. Nuk ishte sikur filloi me lindje dhe kaloi gjatë jetës sime deri tek Universiteti i Moskës. E tëra u shfaqë përnjëherë. Ja ku isha. Kjo ishte jeta ime. Nuk përjetova ndonjë ndjenjë fajësimi apo pendimi për gjërat që i kisha bërë. Nuk ndihesha në ndonjë farë mënyre për disfatat e mija, të metat, apo të arriturat. E tëra që ndjeva ishte jeta ime ashtu si ishte. Dhe isha i kënaqur me atë. E pranova jetën time për çka ishte.

Gjatë kësaj kohe drita rrezatonte një ndjenjë të paqës dhe kënaqësisë në mua. Ishte shumë pozitive. Isha shumë i gëzuar që isha në dritë. Dhe e

kuptova çka do të thoshte drita. Kuptova se të gjitha rregullat fizike për jetën e njeriut ishin një asgjë në krahasim me këtë realitet të unitetit. Gjithashtu arrita ti shohë se vrimat e zeza janë vetëm një pjesë tjetër e atij infiniti që është drita.

Mu bë e mundur të kuptoj se realiteti është çdokund. Se nuk është thjesht jeta tokësore por jeta infinite. Jo vetëm se e tëra është e lidhur së bashku, e tëra gjithashtu është Një. Kështu që ndjeva plotshmëri me dritën, një ndjenjë se çdo gjë është në rregull me mua dhe universin.

Në mënyrë instante mund të shkoja çdo kund, të isha me të vërtetë atje. U mundova të komunikoja me njerëzit që i pashë. Disa e ndjenë prezencën time, por askush nuk reagoi. E ndjeva si të nevojshme që të mësoja për Biblen dhe filozofinë. Po dëshirove, do të marrësh. Mendo dhe do të vie. Kështu që u bëra pjesëmarrës, shkova prapa dhe jetova në mendjen e Jezusit dhe dishepujve të tij. I dëgjova bisedat e tyre, përjetova ngrënjen, duke pasuar venë, erërat, shijet - megjithëse nuk kisha trupë. Isha konshiencë e dëlirë. Në qoftë se nuk kuptoja se çfarë po ndodhte një shpjegim më vinte. Por asnjë mësues nuk foli. E gjurmova Perandorinë Romake, Babilonin, kohën e Nohës dhe Abrahamit. Çdo periudhë që të vie ndër mend, unë isha atje.

Dhe ja ku isha, i vërshuar nga ky përjetim i mbrekullueshëm dhe nga të gjitha ato sende të mira, kur dikush filloi të më priste në barkë. A mund të imagjinosh? Çk kishte ndodhur ishte se isha dërguar në morg, isha shpallur i vdekur dhe më kishin lënë aty për tre ditë. Një hulumtim në rastin e vdekjes sime kishte filluar, ashtu që e kishin dërguar njërin që të bëjë autopsi në trupin tim. erisa filluan të më prenin në barkë, ndjeva sikur një fuqi e madhe më kapi për qafe dhe më shtyu poshtë. Dhe ishte aq e fuqishme saqë i hapa sytë dhe e ndjeva një ndjenjë të një dhimbje të madhe. Trupi im ishte i ftohtë dhe fillova të dridhem. Ata menjëherë e ndaluan autopsin dhe më dërguan në spital, ku qëndrova edhe për nëntë muaj të tjerë, ku të shumtën e kohës e kalova nën respirator.

Dalngadalë mu kthye shëndeti. or kurr më nuk do të isha i njëjti person, sepse e tëra që desha tani të bëja për tërë jetën time ishte ta studioja urtësinë. Ky interes i ri më drejtoi të marrë pjesë në Universitetin e Gjorgjisë, ku e morra doktorraturën time të dytë në psikologjinë e feve. Mandej u bëra priftë në Kishën Orthodokse të Lindjes. Në fund, në vitin 1989, erdhëm në Amerikë, dhe tani punojë si një shoqërues i pastorit në Kishën e Parë Unitare Metodiste në Nederland, Teksas.

Shumë njerëz më kanë pyetur se në ç"ka besoj, se si vdekja klinike më kishte ndryshuar jetën time. E tëra që mund të them është se tani besoj në Zotin e universit. Ndryshe nga shumë njerëz të tjerë, megjithatë, kurr nuk e kam quajtur Zotin dritë, sepse Zoti është përtej mundësisë sonë për ta kuptuar. Zoti që unë e besoj, është më shumë se dritë, sepse Zoti gjithashtu është errësirë. Zot është çdo gjë që ekziston, çdo jë - dhe kjo është përtej

aftësive tona për të kuptuar sadopak. Kështu që unë nuk besoj në Zotin e Judenjëve, apo të Krishterëve, apo të Hindusëve apo të asnjë ideje të feve të tjera për atë se çka është Zoti dhe çka nuk është. Eshtë i njëjti Zot, dhe ky Zot më tregoi se universi në të cilin jetojmë është i bukur dhe një misterie e mbrekullueshme që është i lidhur së bashku përgjithmonë dhe përjetësishtë. Çdokush që ka pasur një përjetim të tillë të Zotit, që ka ndjerë një ndjenjë kaq të fortë të lidhjes me realitetin, e dinë se është vetëm një punë që me të vërtetë është e rëndësishme në jetë, dhe ajo është dashuria; ta duash natyrën, ti duash njerëzit, ti duash kafshët, ta duash vetë krijimin, vetëm pse është. Ti shërbesh krijimit të Zotit me një dorë ngrohtësie dhe dashurie të bujarisë dhe dhembshurisë - ajo është e vetmja ekzistencë që ka kuptim.

Shumë njerëz u drejtohen atyre që kanë përjetuar vdekje klinike sepse ata ndjejnë se ne i kemi përgjigjet. Por unë e di se ajo nuk është e vërtetë, së paku jo tërësishtë. Asnjëri nga ne nuk do ti kuptojë plotësishtë të vërtetat e mëdha të jetës derisa të bashkohemi me përjetësinë në vdekje. Por nganjëherë ne marrim vetëm disa shkëndija të përgjigjeve këtu në Tokë, dhe ajo është e mjaftueshme për mua. Dëshiroj të bëj pyetje dhe ti kërkoj përgjigjet, por e di se në fund më duhet ti jetoj edhe pyetjet edhe përgjigjet. Por kjo është në rregull apo jo? Derisa ne dashurojmë, dashurojmë me gjithë zemër dhe pasion, nuk ka rëndësi, apo jo? Ndoshta mënyra më e mirë për mua që të përcjellë çka dua të them është të ndajë me ju diçka që poeti Rilke njëherë kishte shkruar në një letër një mikut të tij. E pashë këtë letër, origjinalin e shkruar me dorë, në librarinë e Universitetit të Dresdenit në Gjermani. (Ai citon nga memorja ashtu si i kujtohet:)

"Bëhu i durueshëm me të tërën që të mundon në zemër. Dhe mundohu ti duash pyetjet vetë. Mos kërko për përgjigje që nuk mund të të ipen. Sepse nuk do të mund ti përballoje dhe të jetoje me to. Dhe qëllimi është të jetosh të tërën, jeto pyetjet tani, dhe ndoshta pa pritur e pa kujtuar fare, një ditë do ti jetosh përgjigjet. "

Unë e vë besimin tim në këtë. Jeto pyetjet, dhe universi do t'i hapë syte e tij ty.

7. Urtësi

Udha e Drejtë e Zotit nuk është e fshehur,
Por universalisht e manifestuar.
Esencialisht Ai është në të gjitha gjërat të mëdha apo to vogla,
Injorant I së vërtetës apo I vetëdijshëm.
Prandaj ***Mëshira e Tij përqafon secilin send****, (Kur'an 7:156)*
Qofshin të dobët apo të fuqishëm.

…Nuk ka asnjë nga gjallesat, e që Ai të mos e kap për balluket e tyre [ketë nën sundim], vërtetë Zoti im është në rrugë të drejtë. (Kur'an 11:56)

Të gjitha sendet ecin në rrugën e Drejtë të Zotit të tyre dhe, në këtë kuptim ata nuk do të ballafaqohen me Zemërimin hyjnorë as që janë në rrugë të gabuar. Kjo ndodh për shkak se Zemërimi hyjnorë, si gabim, është aksidental [jo esencialë], ku të gjitha sendet rrjedhin përfundimisht nga Mëshira që përqafon secilin send dhe që ka përparësi. E tëra që është tjetër pos Realitetit është qenie në lëvizje [dabbah] [në Udhëtim], paSiçë secila ka shpirtë dhe asnjëra nuk kalon [në Udhëtim] nga vet-vetja por nga një tjetër [Zot]. Vazhdon [nëpër Udhëtim] duke përcjellur, sipas një vendosmërie [të caktuar], Ai që është në Udhë [Zoti]. Nuk do të ishte një udhëtim por një procesion gjatë rrugës.

Në qoftë se krijesa të nënshtrohet ty,
Eshtë [në të vërtetë] Realiteti Që nënshtrohet.
Dhe në qoftë se Realiteti të nënshtrohet ty,
Krijesat nuk mund ta përcjellin Atë aty.
Prandaj kupto ç'farë po themi,
Se krejt çka them është e vërtetë.
Nuk ka asnjë qenie krijuese
Por që është pajisur me fjalim [shprehje]
As nuk ka diçka të krijuar, e parë nga syri,
Por që esencialisht është Realiteti.
Në të vërtetë, Ai është I fshehur aty,
Format e Tij janë të thuash konteiner.

Dije se hyjnorja dhe shkencat e gnozës të zotëruara nga Njerëzit ndryshojnë sipas kapaciteteve të ndryshme shpirtërore, edhe pse ato të gjitha rrjedhin [në fund të fundit] nga një burim. Zoti, Më I Larti, thotë:

"Unë jam dëgjimi I tij me anë të cilit ai dëgjon, dhe shikimi I tij me anë të cilit shikon, dora e tij me anë të cilës ai merr dhe këmba e tij me anë të cilës ai ecën. "(Buhari, LXXXI:38).

Ai deklaron se Ai është, në identitetin e Tij, vetë gjymtyrët janë shërbyesi vetë, edhe pse Identiteti është Një dhe gjymtyrët janë shumë. Për çdo gjymtyrë apo organ është një lloj njohurie e veçantë shpirtërore që rrjedh nga një burim, që është I shumfishuar në respekt të shumë gjymtyrëve dhe organeve, ashtu sikur uji, edhe pse një realitet i vetëm, ndryshon në shijim sipas vendit, diku I ëmbël dhe I këndshëm, diku I kripur dhe si I njelmët. Por edhe pas gjithë kësaj mbetet ujë I pandryshuar në të gjitha rrethanat, me të gjitha ndryshimet në shijim.

Kjo urtësi është e interesuar me njohurinë që ka të bëjë me "këmbët"e referuar në atë çka Më i Larti thotë në lidhje me ushqimin shpirtërorë të dhuruar në ata që ashtu Siç duhet I mbështesin shkrimet e shenjta:

Dhe, sikur ta zbatonin Tevratin, Inxhilin dhe ajo që u zbriti atyre nga Zoti I tyre, ata me siguri se do të kishin ngrënë sipër tyre] dhe nga nën këmbët e tyre. (Kur'an V:66)

Sepse mënyra, që është Udha e [Drejtë], është aty që të udhëtohet përpara dhe të ecet në të, që nuk mund të arrihet ndryshe veq se me këmbët. Eshtë vetëm kjo njohuri e veçantë ezoterike që rezulton në këtë intuite të veçantë nën udhëheqjen nga Ai Që është në Udhë përmes ballukeve me Dorën e Tij.

Dhe Ai I dëbon keqëbërësit, *(Kur'an XIX:86)* që e meritojnë stacionin tek te cili Ai I dëbon, me anë të erës perendimore me anë të së cilës Ai I pastron ata nga vetja e tyre [e ndarë]. Ai I dëbon I tërheq ata përpara përmes ballukeve të tyre, derisa era I shtyen ata [nga prapa] në Ferr, [shoferi] që nuk është askush tjetër pos dëshirat e tyre dhe prirjet, dhe Ferri distanca që ata e imagjinuan [të jetë në mes tyre dhe Realitetit].

PaSiçë është Ai [Zoti i tyre] Që I çonë ata tek ky vendbanim, ata [në të vërtetë] arrijnë afërsi [tek Ai], e gjithë distanca dhe nocioni I Ferrit merr fund për ta. Kështu që ata arrijnë [në realitet] bekimin e afërsisë [tek Ai] sa I përket asaj se ç'farë kanë merituar [në esencat e tyre të përjetshme], duke qenë [përjetësishtë] keqëbërës; as nuk ua plotsonë Ai atyre këtë stacion të lumturisë si një dhuratë falas, paSiçë janë ata vetë që e adaptojnë atë ashtu si realitetet e tyre esenciale I kanë merituar përjetësishtë nga veprat e tyre [të caktuara]. Në të vërtetë, duke I kryer veprat e tyre ata janë, megjithatë, në Udhën e Zotit të tyre, balluket e tyre duke qenë në dorën e Atij që është kualifikuar; ashtu që, ata nuk ecin [në Udhën e tyre] vetë, por nën detyrim derisa të arrijnë afërsinë [e tyre] [tek Ai].

Dhe ne jemi më afër tij [që po vdes] sesa ju, por ju nuk na shihni (Ne). (Kur'an LVI:85)

Njeriu që po vdes ka shikim sepse mbulesa I është tërhequr prapa, dhe pamja e tij është mbrehtë. *(Kur'an L:22)* Në këtë ajet Ai nuk specifikon ndonjë lloj personi të **veçantë**, (për shembull) njëri që është I bekuar e jo njëri që është I mallkuar. Prapë.

Ne jemi më afër tij sesa damari I qafës së tij, *(Kur'an L:16)*

Ku asnjë njeri I **veçantë nuk theksohet**. Afërsia hyjnore është thënë çartë në Zbulesën e Tij. Asnjë afërsi nuk është më afër se ajo që Identiteti I Tij duhet të jetë vetë gjymtyrët dhe zotësitë e shërbyesit, që janë shërbyesi vetë. Sepse shërbyesi është një realitet I dëshmuar në një krijim iluzor.

Për besimtarët dhe njerëzit me vizion shpirtërorë është krijimi që mirret me hamendje dhe Realiteti që shihet dhe perceptohet, derisa në rastin e atyre që nuk janë në këto dy kategori, është Realiteti Që mirret me hamendje dhe krijimi që shihet dhe perceptohet nga shqisat. Këta të fundit janë të kripur, ujë i hidhur, derisa të parët janë të ëmbël, ujë I këndshëm, I pastër për ta pirë.

Njeriu mund të ndahet në dy grupe. Të parët udhëtojnë një udhë që e dinë, dhe ku cakun e udhës e dinë, që është Udha e tyre e Drejtë. Grupi I dytë udhëton një udhë që nuk e dinë dhe që nuk janë të vetëdijshëm për cakun, që është e gjithashtu Udhë e Drejtë. Gnostiku thërret Zotin me perceptim shpirtërorë, derisa ai që nuk është gnostic e thërret Atë në injorancë dhe I lidhur në traditë.

Një njohuri e till është speciale që rrjedhë nga

Të ultit prej më të ultëve (Kur'an XCV:5)

PaSiçë këmbët janë pjesa më e ulët e personit, çka është më e ulët se ato ndodhet udha nën ta. Ai që e din se Realiteti është udha e din të vërtetën, sepse nuk është askush tjetër pos Tij që ti përparon dhe udhëton, paSiçë nuk ka asgjë që të njihet përveq Atij, paSiçë Ai është Qenia Vetë dhe prandajë gjithashtu udhëtari vetë. Më tutje, nuk ka asnjë Njohës përveq Atij; **atëherë kush je ti?** Prandajë, dije realitetin tënd të vërtetë dhe udhën tënde, sepse e vërteta të është bërë e çartë ty në gjuhën e Interpretuesit [Muhamed a. s.], në qoftë se vetëm do të kuptosh. E tij është fjala e vërtetë që askush nuk e kupton, përveqëse kuptimi i tij të jetë i vërtetë; Realiteti ka shumë lidhje dhe shumë apekte.

A nuk e keni konsideruar 'Ad, njerëzit e Hud-it a. s. se si thanë,

Kjo është një re që erdhi të bie shi mbi ne, *(Kur'an XLVI:24)*

Duke menduar shumë mirë për Zotin Që është prezentë në atë ç'farë robi i Tij mendon për Atë. Por Zoti e largoi Vetë-veten nga ajo që ata thanë dhe u tha për atë që është me e kompletuar dhe e lartësuar tek aførsia. Sepse, kur e shkaktoi shiun të bie në ta i pruri shumë të mira tokës dhe maket për farën, derisa ata u kënaqen me frutat e shiut vetëm nga largë [përtej varrit];

Ai u tha atyre, Kjo është në ç'farë kërkuat të nxitoheni, një erë në të cilën është një dënim i dhimbshëm (Kur'an XLVI:24)

Që e bën erën [rib] një tregues e asaj ç'farë është mbajtur në mënyrën e shtyerjes së afatit [raheb], meqenëse nga kjo Ai i liroi ata nga errësira e trupit të tyre, rrugët e tyre të vrazhda, dhe nga errësira [shpirtërore]. Në këtë erë ishte një edhab [dënim ose ëmbëlsi], ajo është diçka që ata do të kënaqeshin në të kur ta përjetonin atë, edhe pse u shkaktoi dhimbje kur i ndau ata nga ajo që ishte [më parë] e njohur për ta.

Ai u solli atyre dënimin [të trashëguar në esencën e tyre të përjetshme] dhe ishte më afër tyre [realitetet e tyre] se sa që ata kishin imagjinuar. E tëra ishte shkatërruar me komandën e Zotit të tij; dhe ata nuk do të shiheshin në mëngjezë, përveq vendbanimet e tyre, *(Kur'an XLVI:25)* ajo do të thotë, trupat e tyre në të cilët shpirtat e tyre esencialë banonin. Me fjalë të tjera lidhja e ve**çantë e shpirtit me trupin mbaroi** dhe trupat vazhduan të jetojnë [jetën pa shpirtë të qenies materiale] jetën e caktuar atyre nga Realiteti, ajo jetë e cila lëkura, duart, dhe këmbët e dëshmojnë, gjithashtu

edhe majat e qepallave dhe kofshët. E tëra kjo është e mbajtur me Urdhërin Hyjnorë.

Zoti Më I Larti e ka përshkruar Veten si Xheloz [që asgjë nuk mund të ekziston përveq Atij], dhe është për shkak të kësaj që Ai "ndaloi tepricat"*(Kur'an VII:33)*që do të thotë atë që është e manifestuar dhe e çartë.

Sa për atë që nuk është e manifestuar, është [tepricë] për atë që është e qartë [në vetë-vete]. Prandaj, Ai e ndaloi tepricën [ekzistencën relative], që do të thotë, Ai e pengoi sekretin e vërtetë që të njihet, domethënë se Ai është Vetë esenca e gjërave. Ai e fsheh përmes tjetërsisë, që është ti [si jo Ai]. Tjetërsia pohon se dëgjimi [I referuar tek Hadith Kudsi] është dëgjimi I Zaidit, përderisa gnostiku [që sheh përtej tek Njëshmëria e Qenies] pohon se është Realiteti Vetë, dhe ngjashmërishtë me organet dhe gjymtyrët e tjera. Të gjithë nuk e njohin Realitetin, disa njerëz ia kalojnë të tjerëve sipas gradave [të njohura] shpirtërore, ashtu që është e çartë kush është superior [në lidhje me këtë] dhe kush nuk është.

Dije se kur Realiteti mu shfaqë mua dhe më bëri që të dëshmojë realitetet esenciale të apostujve të Tij [paqja qoftë me ta] dhe profetëve të njerëzimit që nga Ademi e deri tek Muhamedi [paqja dhe mëshira e Zotit qoftë me të gjithë ata] në një mbledhi në Kordova në vitin 586, asnjëri nuk mu drejtua mua përveq Hud-it, që më informoi për arsyen e këtij mbledhimi bashkarishtë. E pash atë si një njeri të shëndoshë, në një formë të bukur, i hollë në bisedë, gnostik, hapës i realiteteve. Çka më bëri ta vërtetojë këtë është ajeti,

Nuk ka asnjë gjallesë e që Ai nuk e kap për balluket e tyre [ketë nën sundim]. Vërtetë Zoti im është në Rrugë të Drejtë. *(Kur'an XI:56)*

Ç'farë lajmi më të mirë se ky mund të ketë për krijimin? Në të vërtetë, Zoti na përkujton nderin e Tij për ne duke e zbritur këtë [ajet] në Kur'an. Mandej Muhamedi a. s. , që e integroi të tërën, e kompleton lajmin duke na transmetuar neve me Sunnet (Hadith) në të cilin thuhet se Realiteti [esencialishtë] është:

dëgjimi [i robit, gnostikut], shikimi, dora, këmba dhe gjuha, në faktë të gjitha shqisat. *(Buhari, LXXXI:38)*

Më tutje, edhe pse pjesët shpirtërore janë më afër sesa shqisat [e jashtme], Ai pëlqeu Vetë-veten me atë që ishte më largë por e njohur, në vend të asaj që ishte më afër por e panjohur.

Zoti interpreton si lajmërim për ne fjalët e Profetit Hud a. s. tek populli i tij, dhe Apostulli i Zotit i interpreton për ne fjalët e Zotit [me Sunnet].

Kështu që, njohuria është perfeksionuar në zemrat e atyre që u është lejuar njohuria, ... dhe askush nuk i refuzon shenjat Tona përveq atyre që fshehin [kafiruna]. (Kur'an, XXIX:47)

Se këta janë ata që nga lakmia, konkurrenca, dhe padrejtsia do ti fshehin ato [shenjat e Zotit], edhe pse ata vetë kanë njohuri për to, . Sa për pjesën tonë, saherë që Zoti na ka shfaqur apo informuar ne [përmes

Sunnetit të Shenjtë] sa i përket Vetë-vetes, qoftë se ai pohon transcedencën e Tij apo krahasimin, ne gjithmonë e shohim në terme të kufizimit.

Kufizimi i parë [ku Ai e kushtëzon Veten] është

"Reja e Errët që nuk kishte ajër as mbi e as nën të. "(Hanbal, IV:11, 12).

Realiteti ishte në të para se Ai e krijoi krijimin e Tij. Mandej Ai thotë, Ai e vendosi Vetë-Veten në Arsh (Kur'an, VII:54)

... që gjithashtu prezenton Vetë-kufizim. Mandej Ai thotë se

Ai zbriti tek parajsa e ulët, gjithashtu kufizim. Ai më tutje thotë,

... Ai është në Qiell dhe në Tokë... (Kur'an, 43:84)

dhe se

... Ai është me ne kudo që ne jemi... *(Kur'an, 58:7)*

dhe më në fund thotë se Ai është, në esencë, ne. *(Buhari, LXXXI:38)*

Ne jemi qenie të kufizuara, prandaj Ai gjithnjë e përshkruan Veten (shprehet) duke përdorur mënyra që prezentojnë kufizim në Veten e Tij. (Në mënyrë që ne ta kuptojmë) Edhe ajeti

Nuk ka asnjë sikur Ai *(Kur'an, XLII:11)*

përmbanë kufizim në qoftë se e vlerësojmë *kaf-in* thjeshtë vetëm si shprehje, paSiçë njëri që krahasohet nga ajo që është e kufizuar është vetë i kufizuar sepse ai nuk është ai send; ti refuzosh të gjitha [mundësitë] e kufizimit është në vetë-vete kufizim, qenia Absolute [në njëfarë kuptimi] e kufizuar nga Absoluteti i Vetë-Vetes.

Në qoftë se e vlerësojmë *kaf*-in si kualifikim sekondarë, ne e kufizojmë Atë. Në qoftë se e marrim ajetin

Nuk ka asnjë sikur Ai (Kur'an, XLII:11)

Duke refuzuar ngjashmërinë, ne e kemi kuptuar kuptimin e vërtetë dhe domethënien që është synuar, se Ai **esencialishtë** është e tëra. Sendet e krijuara janë të kufizuara, edhe pse kufizimet e tyre janë të ndryshme. Kështu që, Ai është i kufizuar me kufizimin e çdo sendi të kufizuar, secili kufizim që është kufizim i Realitetit. Ai depërton/përshkonë të gjitha qeniet që quhen të krijuara dhe të prejardhura, dhe po të mos ishte kështu, ekzistenca [relative] nuk do të kishte asnjë kuptim.

Ai është Qenia Vetë, Esenca e Qenies, Ai është Ruajtësi i të gjithëve (Kur'an, XI:57) përmes Esencës së Tij, dhe kjo ruajtje nuk E Lodhë Atë (Kur'an, II:255).

Duke i ruajtur të gjitha sendet, Ai e ruan Formën e Tij, veq në qoftë se merrë ndonjë Formë tjetër që nuk është e Tij, **gjë që është e pamundur**. Ai është**vështruesi në vështruesin dhe i vështruari në vështruesin**; Kozmosi është Forma e Tij dhe Ai është Shpirti sundues i Kozmosit, gjë që është Njeriu Madhështorë [Makrokozmosi].

Ai është e tëra që Bëhet dhe Ai është që perms

Bërjes së Tij bëhem unë, prandajë them Ai ushqehet

Në qenien time, kështu që jemi të modeluar në Imazhin e Tij. (Buhari, LXXIX:1)

Gjithashtu, nga një aspektë i vecantë, kërkoj strehim tek Ai nga Ai.

Ishte për shkak të pëlcitjes nga plotshmëria [e realiteteve esenciale në Esencën e padiferencuar] që Ai fryu përpara [Fjalën primordiale/origjinale *kun*]. Ai e lidhë Frymën me të Mëshirshmin, sepse për shkak të kësaj (lidhje) Ai e bëri mëshirën [të ngritur] të jetë në dispozicion të kërkesave të Modeleve hyjnore për krijimin e formave të Kozmosit, që janë Realiteti i manifestuar, duke qenë Ai i Manifestuar. Ai gjithashtu është Esenca e brendshme, që është githashtu i Padukuri. **Ai është i Pari**, paSiçë Ai ishte kur ata nuk ishin, dhe gjithashtu **i Fundit**, paSiçë në manifestimin e tyre Ai është Esenca e tyre; I Fundit është i manifestuar dhe i Pari është i Padukuri. Kështu që, **Ai i dinë të gjitha gjërat** (Kur'an, VI:101) sikur kur e njeh Vetë-veten.

Meqenëse Ai i krijoi format në Frymë, dhe ato u manifestuan në fushën e lidhjeve/relacioneve, të quajtura Emra, lidhja hyjnore me kozmosin u themelua, ku të gjitha qeniet derivojnë - rrjedhin nga Ai.

Ai thotë, "*Këtë ditë ua kam zvogluar marrëdhëniet e juaja dhe e kam ngritur lidhjen Time*, "që do të thotë se ua kam hequr marrëdhënien tuaj me vetë-veten dhe ju kam kthyer tek marrëdhënia [e drejtë] me Mua.

Cilët janë të drejtit? Janë ata që marrin Zotin si mbrojtësin e tyre, Ai duke qenë forma e manifestuar, ashtu sikur është realiteti i brendshëm i formave të tyre të manifestuara. Një i tillë është më i fuqishmi, më i forti prej njerëzve në sytë e të gjithë njerëzve. I drejtë është gjithashtu ai që e bën vetë-veten mbrojtje për Zotin, duke qenë forma e Tij, paSiçë Identiteti i Zotit është, në esencë, aftësitë e robit. Ai e bën atë që është emëruar shërbyes mbrojtës për atë që quhet Realitet, megjithëse e percepton [të vërtetën, kryesishtë se të dyja janë një], ashtu që njohësi çartë dallohet nga injoranti.

Thuaj: A janë ata që dinë të njëjtë sikur ata që nuk dinë, vetëm ata me intuitë të vërtetë reflektojnë, *(Kur, an, XXXIX:9)*

Që do të thotë, ata që shikojnë në realitetin e brendshëm të një sendi, që është objekti realë i njohurisë në lidhje me atë send. Se njëri që është i pakujdesshëm nuk është më i lartësuar se njëri që është i kujdesshëm, e as njëri i paguar nuk mund të krahasohet me shërbyesin/robin. Atëherë, në qoftë se Zoti është mbrojtësi për shërbyesin, nga një aspekt, dhe shërbyes për Zotin nga një aspekt tjetër, mund të thuash për Qenien ç'farë të duash; ose se është krijimi ose se është Realiteti, ose se është njëkohësisht krijimi dhe Realiteti. Gjithashtu mund të thuhet se nuk është as krijimi e as Realiteti, derisa njëri **detyrohet të pranojë sa e ndërlikuar është kjo çështje**, sepse me caktimin e gradave vështirësitë paraqiten. Por për shkak [të parimit] të kufizimit [për ta definuar Realitetin], apostujt nuk do të na kishin mësuar se Realiteti e transformon Vetë-veten në format kozmike e as nuk do ta kishin përshkruar Atë [njëkohësisht] se e shkëput Vetë-veten nga të gjitha format.

Syri nuk percepton asgjë pos Tij
Vetëm Ai është i caktuar [nga Vetë-vetja].
Ne jemi të Tij, përmes Tij ne ekzistojmë dhe përmes Tij ne sundohemi,
Dhe ne jemi në Prezencën e Tij gjithnjë, në të gjitha gjendjet.

Për këtë shkakë [kufizimit të pashmangshëm me definicion] Ai është edhe i refuzuar edhe i njohur, i quajtur i pakrahasueshëm dhe i krahasueshëm. Ai që e sheh Realitetin nga këndvështrimi i Tij, në Të, por me veten e tij si shikuesi, nuk është gnostik. Ai që nuk e sheh Realitetin në këtë mënyrë, por pretë që ta sheh Atë përmes vetë-vetes, është injorant.

Në përgjithësi, shumica e njerëzve kanë, në mënyrë të pashmangshme, një koncept individualë [besim] për Zotin e tyre, në të cilin (koncept) besojnë tek Ai dhe në të cilin (koncept) ata e kërkojnë Atë. Për sa kohë që Realiteti u shfaqet atyre sipas konceptit të tyre ata e njohin Atë dhe e pranojnë Atë, kurse po tu shfaqet në ndonjë formë tjetër, ata e refuzojnë Atë, ikin nga Ai dhe e trajtojnë Atë në mënyrë të pahijshme, derisa njëkohësishtë imagjinojnë se sjelljet e tyre ndaj Tij janë të drejta. Njëri që beson [në mënyrën e zakonshme] beson vetëm në Hyjnorën që ai e ka krijuar në vetë-vete, paSiçë hyjnorja në *"besime"* është një konstruktim [mental]. Ata shohin [në atë që besojnë] vetëm vetë-veten [si qenie relative] dhe konstruksionet e tyre brenda në vetëvete.

Konsideroje këtë çështje, sepse, **ashtu si njerëzit e njohin Zotin [në këtë botë], ashtu do ta shohin Atë në Ditën e Ringjalljes**, arsyeja për të cilën unë ju informova. Prandaj, **vë re (ke kujdes)**, se po qe se e kufizon vetë-veten tek ndonjë doktrinë e veçantë [sa i përket Realitetit] dhe ashtu që të refuzosh çdo doktrinë tjetër [që në mënyrë të barabartë e reflekton Atë], do të humbësh shumë të mira, në të vërtetë ti do të humbësh njohurinë e vërtetë se çka është [Realiteti]. Prandaj, bëhu plotësishtë dhe tërësishtë perceptues i të gjitha formave doktrinore, se **Zoti, Më i Larti, është Githë-përfshirës dhe tepër Madhështor që të kufizohet në një doktrinë** më mirë se në një tjetër, sepse Ai ka thënë, **Ngado që të kthehesh, është fytyra e Zotit**, (Kur'an, II:115) pa e theksuar ndonjë drejtim të veçantë. Ai deklaron se është fytyra e Zotit, fytyra e sendit të qenurit e realitetit.

Me anë të kësaj Ai [synon] ti mbajë në gjendje gadishmërie [shpirtërishtë] Zemrat e gnostikëve, në qoftë se sendet kalimtare të kësaj bote i habisin ata nga reflektimi [konstant] në këtë [të vërtetë]; sepse asnjë shërbyes nuk e din në cilën frymëmarrje do të mirret [nga kjo jetë], dhe mund të ndodhë që ai mund të mirret në një moment kur është i pavëmendshëm, ashtu që ai nuk do të jetë i barabartë [në botën e përtejme] me njërin që është marrë në momentin kur ka qenë prezentë/i vëmendshëm. **Shërbyesi perfektë**, edhe pse ka njohuri për këtë [të vërtetë sa i përket gjithëprezencës së Zotit], megjithatë **e mbanë veten, në formën e tij të jashtme dhe të kufizuar,** në lutje [konstante], fytyra e tij e kthyer

nga Xhamia e Shenjtë, duke besuar se Zoti është në atë drejtim kur ai falet; Xhamia e Shenjtë është, në të vërtetë, reprezentuese e aspektit të Realitetit, sikur në ajetin, **Ngado që të kthehesh, është fytyra e Zotit**, (Kur'an, II:115) dhe [kur i drejtohesh] njëri është ball për ball me Zotin në të. Megjithatë mos i thuaj vetë-vetes se Ai është vetëm në atë drejtim, por më mirë mbajë të dy aspektet, qëndrimin tënd [të veçantë] [të adhurimit] kur i drejtohesh Xhamisë së Shenjtë dhe qëndrimin tënd [më universal] [të njohurisë] për pamundësinë që një vend ta nxe fytyrën e Tij në atë drejtim të veçantë, që është vetëm njëra nga shumë pikat tek e cila njerëzit drejtohen.

Zoti na e ka bërë të çartë se Ai është në çdo drejtim që njëri kthehet, ku secili (drejtim) prezenton perspektivën e një doktrine të veçantë sa i përket Atij. Të gjithë janë [në njëfarë kuptimi] drejtë [në mënyrën e tyre]; çdonjëri që është drejtë e merr shpërblimin e tij, çdonjëri që e merr shpërblimin e Tij është i bekuar, dheçdonjëri që është i bekuar është mirë i kënaqshëm [për Zotin e tij], edhe pse ai mund të dënohet për një kohë në Vendbanimin Finalë. Se [edhe] njerëzit e Providencës (apo njerëzit e mirë) janë të sëmurë dhe vuajnë nga dhimbjet në këtë botë, megjithëse i njohim ata të jenë të bekuar në mes të Njerëzve të Zotit. Kështu që, ka nga ata shërbyes të Zotit që u është shkaktuar vuajtje në botën e përtejme në vendin e quajtur Ferr/Xhehnem. Megjithatë, ata që posedojnë njohuri dhe kanë intuitë shpirtërore në atë çka me të vërtetë është, nuk e mohojnë se ata do të gëzohen me kënaqësit e tyre në atë vend, qoftë me lirim nga dhimbja prej të cilës vuajnë, që do të jetë kënaqësia e tyre, ose [ndoshta] një kënaqësi e veçantë e ngjashme me atë të që e gëzojnë njerëzit e Parajsës/Xhennetit; por Zoti e din më së miri.

Kujdes nga Bota

Kujdes nga kjo botë me dyshimin më të madhë; sepse është sikur një gjarpër, e lëmuar ta prekësh, por helmi është vdekje prurës.

Largohu nga çkado që të sjell kënaqësi, sepse shoqëri të vogël do të sjell kjo kënaqësi;

Heqi nga vet vetja kujdesjen për to, sepse ti e ke parë shancën e papritur, dhe e din të sigurtë se ti do të ndahesh nga ajo;

Qëndro I vendosur vështirësive, sepse lehtësia do të takoj ty.

Sa më shumë që të sjell kënaqësi, aq më shumë bëhu I dyshimtë në të; sepse njeriu I kësaj bote, saherë që ndihet I sigurtë në ç'fardo kënaqësie të till, bota e dërgon tek ndonjë pakënaqësi, dhe saherë që do të merr ndonjë pjesë të saj dhe e shtyn atë në të, bota papritur do ta rrotullon atë poshtë.

Dhe prapë, ke kujdes nga kjo botë, sepse shpresat e saja janë gënjeshtra, të priturat falsitet; lehtësia e saj është vrazhdë, që e ka mjegullosur të çaluarën e saj.

Dhe aty përbrenda je në rrezik: apo në një lumturi kalimtare, ose papritur në tragjedi, ose nën vuajtjen e dhimbjeve, ose përfundim të pashmangshëm.

E vështirë është jeta e njeriut në qoftë se është i kujdesëshëm, në rrezik në qoftë se është rehat, duke qenë gjithnjë në pritje të katastrofës, e sigurtë për fatin e tij përfundimtarë.

Edhe në qoftë se I Gjithëfuqishmi nuk do të ishte lajmëruar në botë fare, as të mos u kishte bërë thirrje njerëzimit, as mos tu kishte vënë obligim njerëzve të largohen nga ajo, prap a do ti kishte zgjuar bota vetë ata që janë në gjumë, dhe a do ti kishte ngritur të pavëmendshmit?; Si pra kur e shohim se Zoti Vetë na ka dërguar vërejtje kundër botës, një tërheqje sa I përket asaj! Se kjo botë nuk ka as vlerë as peshë me Zotin; aq e lehtë është, nuk peshon më shumë për Zotin sesa një gurë I vockël, apo një copë e dheut të tokës;

Si më kanë thënë, Zoti nuk ka krijuar asgjë më të urryer për Të sesa kjo botë, dhe nga dita qe Ai e ka krijuar nuk ka shikuar në të, aq shumë që e urren. I është ofruar Profetit tonë a. s. me të gjithë qelsat dhe thesaret, dhe ajo nuk do ta kishte zvogluar Atë nga pikëpamja e Zotit, aq sa krahu I një mushkonje, por ai refuzoi ta pranoj; dhe asgjë nuk e pengoi atë për ta pranuar – sepse nuk ka asgjë që mund ta zvoglojë Atë nga pikëpamja e Zotit – por e dinte se Zoti e urren një sendë, prandaj edhe ai e urrente, dhe Zoti nuk e donte një sendë dhe ai nuk e donte, dhe Zoti e degradonte një sendë dhe ai e degradonte. Po ta kishte pranuar, pranimi I tij do të ishte evidencë se ai e donte; por ai u largua nga dëshira të donte atë që Krijuesi I tij urrente, dhe të lartëson çka Ai I Pavaruri e ka përulur.

Sa për Muhamedin a. s. ai e lidhte një gurë në barkun e tij kur uritej; sa për Musën a. s. lëkura e barkut të tij duke e gjelbërt si bari nga e tëra: Ai nuk kërkoi asgjë nga Zoti, që nga dita që u strehua nën hije, vetëm ushqim për të ngrënë kur uritej, dhe thuhej për të në tregimet qe Zoti ia ka shfaqur, 'Musë, kur e sheh varfërinë që afrohet, thuaj Mirëseerdhe tek emblema e të drejtëve! Dhe kur e sheh pasurinë qe afrohet, thuaj, Me të vërtetë! Mëkatë të cilit denimi I është dhënë më parë, '

Në qoftë se dëshiron mund ta përmendim të tretin Zotin e Shpirtit dhe të Fjalës (Jezusin a. s.) sepse në punët e tij është një mbrekulli; ai thoshte, 'Buka ime e përditshme është uritja, simboli im është friga, veshja ime është pambuku, ngritja ime është këmba, drita ime natën është hëna, zjarri im ditën është dielli, dhe frutet …. e mija janë ato gjëra që dalin nga toka për shtazët e egra dhe bagëtinë. Gjithë natën nuk kam asgjë, dhe prap askush nuk është më I pasur se une!'

Dhe në qoftë se dëshiron të katërtin mund ta përmendim Davidin a. s. që nuk ka qenë më pak I mbrekullueshëm se këta; Ai hante vetem bukë gruri në dhomën e tij, … dhe kur bëhej natë… I vinte duart në qafën e tij, dhe qante deri në agim; hante ushqim të thatë dhe vishte rroba të leshta.

Të gjithë këta urrenin çka Zoti urren, dhe përulnin atë që Zoti përul; mandej të drejtit më vonë e përcollën rrugën e tyre, dhe qëndruan afër gjurmëve të tyre.

Kjo ishte një Letër e Hasan Basrisë r. a. - një figurë eminente e teologëve të hershëm i njohur për asketizëm - dërguar një shoku të tij. Marrë nga EbuNuaim. *Hilya* II. pp/134-40.

Çka është Dashuria Origjinale?

Dashuria e Besimit; Zoti ka dëshmuar tek dashuria e besimtarëve duke thënë: ***'Dhe ata që besojnë e donë Zotin më së shumti'***(Kur'an 2:160).

Drita e përmallimit është drita e dashurisë (mahhaba); e përmbushura e saj është e dritës së dhembshurisë (widad). Përmallimi depërton në zemër nga drita e dhembshurisë. Kur Zoti e ndez atë llampë në zemrën e shërbyesit të Tij, digjet rreptë në damarët e zemrës së tij derisa të ndricohet nga ajo, dhe llampa kurr nuk shuhet veq në qoftë se njeriu I vlerëson veprimet e tij me syrin e vetkënaqësisë. Sepse në qoftë se njeriu ndihet I sigurtë në veprimet e tij ndaj të ligës së oponentit (Djallit) të tij, ai do të shfaqë atë veprim pa ndonjë frigë se mund ti largohet mëshira e Zotit; krenaria atëherë ia okupon zemrën; shpirti I tij vrapon si I egër në përfitim të kotë; dhe zemërimi I Zotit zbret në të. Eshtë sikur, ndonjë njeriu të cilit I është besuar nga Zoti dashuria e Tij, e ai shkon dhe i dorëzon dyzgijtë e shpirtit vet-kënaqësisë, atëherë humbja e mëshirës së Zotit do ta shpie atë në shkatërrim.

Një grua e urtë njëherë tha, 'Ah! Po tu kishte vendosur Zoti atyre që janë të përmalluar për ta takuar Atë një gjendje të tillë që, po ta humbnin, do të largoheshin nga lumturia e përjetëshme. ' Ajo ishte pyetur, 'Ç'farë gjendje është ajo?' Ajo ua ktheu, 'Ti vlerësojnë vyrtytet e tyre të mëdha si të vogla, dhe të cuditen se si ndodhi që u bë që zemrat e tyre të jenë receptorët e këtyre Favorizimeve Hyjnore. ' Një njeri I urtë ishte pyetur, 'Na trego për përmallimin tënd ndaj Zotit – sa peshon në zemrën tënde?' Ai u përgjegjë, 'A po flitet kështu për mua? Nuk ka asgjë në zemrën time që mund të peshohet, përveqë se në prezencën e shpirtit; dhe në qoftë se shpirti bëhet prezent derisa zemra kënaqet në ndonjë trashëgim të afrimit me Zotin, kënaqësia e saj menjëherë pengohet dhe shndërrohet në shqetësim. '

Mudar, Lexuesi ishte pyetur, 'Cila është më e mirë për dashuruesin – **frika apo përmallimi?**' Ai u përgjegjë, 'Kjo është një pyetje që nuk mund të përgjigjem; shpirti nuk ka shikuar në asgjë pa mos e korruptuar. '

Abd el-Aziz b. Abd Allah mi recitoi këto vargje në të njëjtën temë:

Më së miri lere mëkatarin të vuaj dhe frikësohet
Kur të kthehet tek Zoti në lutje;
Zemra e përkulur dhe e pastërt
Vetëm në Dashuri mund të qëndroj I sigurtë;

Por ata që janë të ngritur dhe të zgjuar
Shikojnë në Zotin me sy të përmalluar.

Për këtë arsye thuhet se **dashuria është përmallim**, sepse njëri nuk përmallohet përveqëse për të dashurin/ën. Nuk ka dallim në mes të dashurisë dhe përmallimit, kur përmallimi është degë e dashurisë origjinale.

Thuhet gjithashtu se dashuria dihet nga faktet e saja në trupa të dashuruesve, dhe në fjalimet e tyre, dhe gjithashtu nga favorizimet e shumta që I shfrytëzojnë përmes unioni konstant me të Dashurin e tyre. Kur Zoti I bën shoqëri atyre, Ai e vë Favorizimin e Tij në ta; dhe kur këto Favorizime manifestohen, ata njihen për dashurinë e tyre ndaj Zotit. Vetë dashuria nuk ka ndonjë trajtë apo formë të manifestimit, për natyrën dhe formën e tyre që të njihen; është dashuruesi që njihet me karakterin e tij, dhe me shumë Favorizime që Zoti I shfaqë në gjuhën e tij, duke e këshilluar me butësi, dhe çka I zbulohet zemrës së tij.

Kur rrënjët e këtyre Favorizimeve janë bërë me një temel të fortë në zemër, gjuha flet për degëzimet e saj; dhe Favorizimet e Zotit arrijnë në zemrat e atyre që Atë e duan. Shenja më e çartë e dashurisë së Zotit është zbehja e tepruar, që është e asociuar me meditimin e vazhdueshëm, dhe me një zgjerim të manifestimit të heshtur të shoqëruar me vetë-nënshtrim total, I dorëzuar me nxitim të madhë para se vdekja e tmerrshme të vie në të; dhe dashuruesi flet për dashurinë në proporcion të Dritës që I është dhuruar atij. Prandaj thuhet, se shenja e dashurisë së Zotit është vendbanimi brenda I Favorizimeve të Zotit në zemrat e atyre që Zoti I ka zgjedhur për Dashurinë e Tij.

Një dijetar I citon këto vargje në lidhje me këtë temë.
Ai I ka disa nga të zgjedhurit e Tij
Të inspiruar ta duan Atë me të vërtetë;
Të zgjedhur posaqërisht ashtu
Shumë kohë më parë;
Të zgjedhur, apo vetëm për Të
I bëri që të jenë anije të Dashurisë së Tij,
Ti vërtetojnë Benefitet e Tij.
(El Muhasibi r. a.)

Thjeshtësia e Katër Khalifëve të Parë

Kur Ebu Bakri ra. e kishte marrë udhëheqjen, dhe e tërë bota erdhi tek ai në përulje, ai nuk e ngriti kokën lartë për këtë pozitë kryesorë që kishte marrë, apo të bëhej mendjemadhë; ai vishej me një rrobë, që zakonisht e lidhte së bashku me një gjilpërë me kokë, ashtu që ishte i njohur si 'njeriu i dy gjilpërave. '

Dijeni (o ju njerëz) se jeta e kësaj bote është vetëm lojë, dhe biseda kot, dhe stoli, lavdërime mes jush, dhe rivalitet për pasuri dhe fëmijë, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer, e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; **pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se iluzion.** (Kur'an 57-20)

Omar B. el-Khatab r. a. , që gjithashtu e sundonte botën në tërësi, jetonte vetëm me bukë dhe vaj ulliri; rrobat e tij ishin të harrnuara në disa vende, disa nga harrnat ishin të lëkurës; edhe pse ai kishte në dorën e tij thesarin e Kosres dhe Cezarit.

Sa për Uthmanin ra. ai dukej sikur të ishte njëri nga skllavët e tij në rroba dhe në pamje; për të tregohet si ishte parë duke dalur nga njëri prej kopshteve të tij me plotë drunjë [për të ndezur zjarrë] në krahët e tij, dhe kur e pyetën për këtë punë ai tha: 'Desha të provoja a mos do të refuzonte shpirti'

Kur Aliu r. a. e kishte marrë udhëheqjen ai kishte blerë një shokë për katër dirhams dhe një bluzë për pese dirhams; kur e kuptoi se mangët e bluzës i binin të gjata, ai shkoi tek një këpuctarë ia morri thikën dhe i preu mangët e bluzës baraz me majet gishtave të tij; edhe pse ky, i njëjti njeri e ndante botën në dysh, djathtas dhe majtas.

Me të vërtetë këta të nënshtruar ndaj Zotit (Paqja dhe Mëshira e Zotit qoftë me ta) kurr nuk ranë në kurthën e kësaj dynjaje. Edhe pse kishin të gjithë pasurinë e botës në duart e tyre, kurr nuk u bënë skllevër të sajë. Profeti a. s. dhe katër khalifët e parë janë ndër shembujt më të mirë të muslimanëve; të nënshtruarve ndaj Zotit. Edhe pse kishin mundësi më shumë se çdokush tjetër të qonin jetë luksoze, ata e kujtuan dhe e besuan Allahum me shpirtë e me zemër, thjeshtësia dhe urtësia e jetesës së tyre është e pakrahasueshme. Allahu I bekoftë.

Ehli et Tesavufi – Sufizmi

Sufinjtë [ehli at-tesavuf] quhen kështu për një apo më shumë arsye si në vijim:

1. Për shkak të *tesfije's* [pastërtisë] të qenies së tyre të brendshme, që pastrohet nga drita e njohurisë direkte [ma'rifet] dhe të pohimit të Njëshmërisë [Teuidit].

2. Sepse janë të afërm me Shoqëruesit e Bankës [As'hab es-Suffa].

3. Sepse veshjet e tyre janë të bëra nga leshërat [suf]: rroba me lesh të deles për të rinjtë, rroba me lesh të cjapit për ata në fazat mesatare,

Ne jemi më afër tij se damari (që rrah) i qafës së tij. (Kur'an 50-16)

dhe lesh të butë [mer'ez] të dhisë për ata në fazat finale.

Ashtu sikur që rrobat e tyre të jashtme janë të harrnuara së bashku me leshëra të ndryshme, konsumimi i tyre i ushqimeve dhe pijeve është

gjithashtu në proporcion me gjendjen e tyre të progresit të brendshëm. Sipas autorit të *et-Tefsir el-Mejme* "Për asketët [ehl az-zuhd], vështirësia është e duhur në të gjitha ato çështje Siç janë veshja, ngrënja, dhe pirja. Për udhëzuesit e njohurisë direkte [ehl el-ma'rifa], në anën tjetër, butësia është e duhur në çdo rastë. Ata duhet ti trajtojnë njerëzit sipas Sunnetit [shembulli i praktikës së Profetit (Allahu e bekoftë dhe i dhuroftë paqe)], ashtu që asnjëri prej tyre mos të kalojë rolin e tij të duhur, sepse janë në rangun e parë në prezencën e Njëshmërisë. "

Fjala Tesevuf [Sufizëm] shkruhet në Arabishtë me katër germa bashkëtingëllore: ta, sad, vav, dhe fa:

1. Germa ***ta*** qëndron për teuba [pendim], që ka dy aspekte: pendimi i qenies së jashtme, dhe pendimi i qenies së brendshme. **Pendimi i qenies së jashtme** do të thotë kthimi, me të gjithë anëtarët e trupit të jashtëm, nga mëkatet/gjynahet dhe veprimet fajësuese tek veprimet adhurimit nënshtrues, dhe nga opozita dhe kontraditat e pajtueshmërisë dhe përshtatjes në fjalë dhe veprim. Sa për **pendimin e brendshëm**, do të thotë kthimi tek pajtueshmëria dhe përshtatja përmes pastrimit [tesfia] të zemrës. Menjëherë paSiçë ai që fajëson transformohet në atë që lavdëron, faza e germës ***ta*** është kompletuar.

2. Germat ***sad*** qëndron për sefa [pastërti], që ka gjithashtu dy aspekte: **pastërtia e zemrës** dhe **pastërtia përbrenda e qenies sekrete më të thellësishme**. **Pastërtia e zemrës** do të thotë se Sufi duhet ta pastrojë zemrën duke i hedhur ndytësit e njeriut, sikur lidhjet që shtohen në zemër nga ngrënja e tepërt, pirja, gjumi, dhe folja, dhe intereset e botës sikur dëshira për sa më shumë pronë, sa më shumë marrëdhënie seksuale, sa më shumë dashuri për fëmijë dhe familje, e kështu me radhë.

Në mënyrë që të pastrohet zemra nga këto vese, nuk ka asnjë alternativë tjetër pos përkujtimit konstant të Allahut (I Lartësuar është Ai). Në fazën nismëtare, ky përkujtim duhet të praktikohet me zë të çartë, derisa të arrihet faza përkutjimit të fshehur privatë. Ashtu si Allahu (I Lartësuar është Ai) ka thënë:

Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve zemrat u dridhen kur Allahu të përmendet. *(K. 8:2)*

innama 'l-mu'minuna 'lledhina
idha dhukire 'llahu uegjilet kulubu-hum (8:2)

Me fjalë të tjera, [zemrat e tyre dridhen] nga frika. Një frikë e tillë përjetohet vetëm pasë zgjimit të zemrës nga gjumi i pavëmendjes, dhe pasi të lëmohet. Të reflektuara në të atëherë bëhen trajtat e të Padukurës, të dyja e mira dhe e keqja. Ashtu si Profeti (bekimi dhe paqja qofshin me të) njëherë tha:

Dijetari i gdhendë imazhet dhe njohësi direktë lustron.

Sa për pastërtinë përbrenda qenies sekrete më të thellësishme, nevoitet largim nga çdo gjë përveqë Allahut (I Lartësuar është Ai) dhe dashurisë së

Tij, duke përsëritur në mënyrë konstante pohimn e Njëshmërisë me gjuhën sekrete të qenies më të brendshme. Sa të arrihet kjo gjendje, faza e germës ***sad*** është kompletuar.

3. Germa ***vav*** qëndron për *vilaje* [shenjtëri], që pason si rezultat i pastërtimit. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) ka thënë:

Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evliatë, të shenjtit), nuk kanë frikë e as kurrfarë brengosje? (Kur'an 10:62)

e-la inna evlija a 'llahi
la khevfun elei-him
ve la hum jehzenum. (10:62)

Atyre u jepet myzhde në jetën e Dunjasë dhe në jetën tjetër (10:64)

le-humu 'l-bushra fi'l-hejati 'd-dunja
ve fi 'l-akhira (10:64)

Rezultati i shenjtërisë [vilaje] është se receptuesi i saj sillet në pajtim me standardet e vëna nga Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai). Ashtu si Profeti (paqja dhe bekimi qofshin me të) njëherë tha:

Ju duhet të silleni në pajtim me standarded e vëna nga Allahu (I Lartësuar është Ai).

Kjo është sikur kur i vesh rrobat e atributeve të Allahut (I Lartësuar është Ai), pasë rrobave të atributeved të njeriut. Ashtu si Ai ka thënë (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) në Hadith Kudsi:

Kur e dua robin, Unë bëhem për atë një veshë, një sy, gjuhë, dorë dhe këmbë, kështu që përmes Meje ai dëgjon, përmes Meje ai shikon, përmes Meje ai fletë, përmes Meje ai prekë, dhe përmes Meje ai ecën.

Prandajë duhet të abstenosh nga çdo gjë përveqë Allahut (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai). Ashtu si Ai ka thënë (Triumfues dhe i Lartësuar është Ai):

Erdhi e vërteta dhe u zhdukë e kota.
E kota është destinuar të zhduket. (Kur'an 17:81)
ue kul ja e'l-Haku ue zeheke 'l-batil:
inna 'l-batile kane zehuka (17:81)

Faza e germës ***vav*** këtu kompletohet.

4. Sa për germën ***fa***, qëndron për ***fana*** [shkrirje] në Allah (E Mbrekullueshme është Madhëria e Tij). Kur dikush i shkrinë atributet e njerëzimit, atij i kujtohen dhe depërton në atributet e Njëshmërisë [Ahadija]. Allahu (Triumfi është i Tij) kurr nuk shkrihet dhe kurr nuk zhduket, kështu që robi i larguar shpëton/mbijetonë përgjithmonë me Zotin të Përhershmin dhe kënaqësinë e Tij të mirë, dhe zemra që fluturoi mbijeton përgjithmonë me Sekretin e Përhershëm. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) ka thënë:

Çdo gjë do të zhduket përveq fytyrës së Tij
(kullu shei'in haliju illa vejhe-h) (Kur'an 28:88)

Përmes kënaqësisë së Tij të mirë, robi mund të kthehet [nga shkrirja] tek veprat e tij të mira tek të cilat ai ishte i devotshëm për hir të shprehjes së Tij dhe kënaqësisë së Tij të mirë, ashtu që Ai që është Kënaqur do të mbetet me atë që e kënaqë Atë. Rezultati i punëve të mbara është jetë për realitetin e qenies njerëzore, që quhet fëmiu i domethënieve të brendshme. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe (Lartësuar është Ai) ka thënë:

Tek Ai veprat e mira mbërrijnë,
dhe të bërat e mira Ai i ngret lartë.
ilai-hi jes'edu 'l-kelimu 't-tejibu
ue 'l-emelu 's-salihu jerfe'-u-h (Kur'an 35:10)

Çdo punë që kryhet për dikënd tjetër e jo për Allahun (I Lartësuar është Ai), aty bëhet një atribuim i partnerëve për Të [Shirka], ashtu që e mallkon atë që e kryen atë punë në shkatërrim.

Kur shkrirja në Atë kompletohet, robi e fiton kujtimin në fushën e Afërsisë. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe (Lartësuar është Ai) ka thënë:

Me të vërtetë të drejtit do të banojnë…
në një vend të sigurtë, në prezencën
e Mbretit Gjithë-Fuqishmit.
inna'l-mutekine...
fi mek'adi sidkin
inda Malikin Muktadir, (Kur'an 54:55, 55)

Ekziston stacioni i Profetëve dhe i të shenjtëve në fushën e Hyjnorës [Lahut]. Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe (Lartësuar është Ai) ka thënë:

Dhe bëhuni bashkë me të vërtetët.
ue kunu ma a 's-sadikin. (Kur'an 9:119)

Në qoftë se novela fenomenale arrinë në kontaktë me të përhershmen, nuk mund të ketë një ekzistencë të përhershme. Ashtu si poeti ka thënë:

Atributet dhe veprimet e Esencës, të gjitha ato,
janë të përhershme, tërësishtë imune nga zhdukja.

Kur varfëria shpirtërore [fakr] të kompletohet, Sufi mbetet përgjithmonë me Zotin e së Vërtetës (Triumfi është i Tij dhe i Lartësuar është Ai). Ashtu si Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) ka thënë:

Të tillët me të drejtë janë pronarët e Parajsës;
ula ika ashabu 'l-xheneti
Ata jetojnë aty përgjithmonë.
hum fi-ha khalidun. (Kur'an 7:42)
Allahu (I Bekuar dhe Lartësuar është Ai) gjithashtu ka thënë:
Dhe Allahu është me ata që me durim përballojnë.
ue'llahu me a's-sabirin. (Kur'an 8:66).

Sufizmi - Mënyrë e Jetesës

Sufizmi është një mënyrë e jetesës në të cilën një identitet më i thelluar identifikohet dhe jetohet. Ky identitet më i thelluar, apo esenca e vet-vetes,

ndodhet përtej personalitetit të njohur dhe është në harmoni me çdo gjë që ekziston. Ka aftësi të vetëdijes, veprimit, kreativitetit, dhe dashurisë që janë largë përtej personaliteteve sipërfaqësore. Eventualisht kuptohet që këto aftësi i takojnë një Qenie më të lartë që secili nga ne e individualizon me mënyrën tonë unike përderisa kurr nuk jemi të ndarë nga ajo.

Sufizmi është më pak një doktrinë apo sistem i besimit sesa një përjetim dhe një mënyrë e jetesës. Është një traditë e ndricimit që e përcjellë esencën e së vërtetës përpara nëpër kohë. Megjithatë tradita duhet të jetë formuar në një sensë vital dhe dinamik. Shprehja e tij nuk duhet patjetër që të mbetet e kufizuar tek format fetare dhe kulturore të së kaluarës. E vërteta në Sufizëm kërkon riformulim dhe shprehje të freskëta në çdo gjeneratë.

Kjo nuk do të thotë që Sufizmi do të rrezikohet nga sfidat e kokëfortësisë së shoqërisë materialiste. Është dhe do të mbetet kritik i botës materiale – që do të thotë se Sufizmi mbetet kritike i çdo gjëje që shkakton harresën e Realitetit Hyjnorë. Është dhe duhet të jetë një rrugë që të sjellë jashtë labirintit të një kulture të falimentuar materialiste. Megjithëse, më e rëndësishmja është se të fton tek kuptimi dhe mirëqenia.

Sufizmin si e njohim, është zhvilluar në metriksin kulturor të Islamit. Islami e prezentoi veten si shprehja e fundit e esencës së mesazhit të sjellur njerezimit nga profetët e të gjitha gjeneratave. Islami njeh vlefshmërinë e 120, 000 profetëve, apo të dërguarve, që kanë ardhur të na zgjojnë nga egoizmi ynë vetjak dhe të na kujtojnë për natyrën tonë shpirtërore. Kurani e konfirmoi vlefshmërinë e librave të tjera të dërguara nga Zoti, njëkohësisht duke pohuar se mesazhi origjinalë shpesh ka qenë i shtrembëruar pas një periudhe të kohës.

Deklarimi i Sufizmit në universalitet është i themeluar në njohjen e gjerë se ekziston vetëm një Zot, Zoti i të gjithë njerëzve dhe të gjitha feve të vërteta. Sufizmi e kupton vet-veten të jetë zgjuarsia e realizuar nga profetët e mëdhenjë – veçanërishtë duke përfshirë Jezusin, Musain, Davidin, Solomonin, dhe Ibrahimin (a. s.), midis të tjerëve, dhe absolutikisht duke përfshirë edhe qenie të tjera të pa emërtuara që kanë arritur ndriçim në çdo kulturë.

Në botën perendimore sot ekzistojnë grupe të ndryshme nën emrin e Sufizmit. Në njërën anë kemi ata që thonë se asnjë Sufizëm i vërtetë nuk mund të ekzistojë pa vlerësuar dhe praktikuar principet e Islamit. Në anën tjetër disa grupe pak a shumë i ignorojnë rrënjët që Sufizmi i ka në Islam dhe i marrin mësimet edhe më poshtë lumit, nga Sufinjtë që mund të ken patur pak apo mund të mos ken patur fare kontakt me mësimet specifike të Islamit. Mëtutje, kemi ata që e pranojnë Sufizmin si formë dhe esencë, përderisa kemi të tjerët që janë Sufi në esencë por jo në formë. Sipas mendimit tim, vlefshmëria dhe kuptimi i Kuranit, të thënat e Muhamedit a.

s. dhe historia e Sufizmit janë jashtzakonishtë të çmuara tek udhëtari në rrugën e Sufizmit.

Historikisht Sufizmi nuk ishte formuar si i ndarë nga esenca e Islamit. Të gjithë mësuesit e Sufizmit mund ti përcillnin gjurmët e ndriçimt të tyre nëpërmjet zingjirit të transmetimit duke u kthyer prapa tek profeti Muhamed a. s. Përderisa ata mund të mos jenë pajtuar me disa interpretime të Islamit, ata kurr nuk e vunë në pyetje vlefshmerinë esenciale të Kuranit, as nuk ishin fundamentalistë në kuptimin e interpretimit të rreptë të Kuranit apo ti diskreditojnë besimet e tjera. Shpesh herë ata prezentuan të arriturat me vlera të larta në kulturën Islamike dhe ishin një forcë e tolerancës dhe moderimit.

Për katër-mbëdhjetë shekuj tradita e gjerë Sufi ka kontribuar me një trup të literaturës si asnjë në bote. Disi principet e këshillave të Kuranit, dhe virtytet heroike të Muhamedit a. s. dhe përcjellësve të tij prodhuan një stimul që lejoi spiritualitetin e dashurisë dhe vetëdijes të lulëzojë. Ata që sot përcjellin udhën e Sufinjëve janë trashegimtarët e një thesari vigan të zgjuarsisë dhe literaturës.

Duke filluar nga rrënjët në kohën e Profetit Muhamed a. s. Sufizmi është rritur në mënyrë organike sikur një pemë me shumë degë. Shkaku kryesorë i degësimeve ka qenë paraqitja e një mësuesi të ndriçuar ku metodat dhe kontributi i tij kanë qenë të mjaftueshme për të inicuar një linjë të re të zhvillimit. Keto degë zakonisht nuk e shohin njëra tjetrën si rivale. Një Sufi në shumë raste mund të inicohet në më shumë se një degë në mënyrë që të marrë mëshirën dhe njohurinë e ndonjë dege të veçantë.

Në qoftë se Sufizmi njeh një të vërtetë qëndrore, ajo është Uniteti i Qenies, se nuk jemi të ndarë nga Hyjnorja. Kjo është një e vërtetë ku gjenerata jonë është në një pozitë të shkëlqyer ta vlerësojë – emocionalisht, për shkak të ngushtimit të botës sonë nëpërmjet komunikimit, transportimit, dhe intelektit, për shkak të avancimit të fizikës moderne.

Ne jemi NJË: Një Njerëzim, Një ekologji, Një universë, Një Qenie. Në qoftë se është Një e vërtetë që ia vlen të emërtohet, është, se ne të gjithë jemi pjesë e integrimit në të Vërtetën, jo të ndarë.

Realizimi i kësaj të vërtete i ka efektet e sajë në ndjeshmërinë tonë se kush jemi, në marrëdhëniet me të tjerët dhe në të gjitha aspektet e jetës. Sufizmi është për të realizuar rrymën e dashurisë që lëvizë nëpër të gjitha jetërat, uniteti prapa formës.

Në qoftë se Sufizmi ka një metodë qëndrore, ajo është zhvillimi i prezencës dhe dashurisë. Vetëm prezenca mund të na zgjojë nga robërimi i botës dhe proceseve tona psikologjike, dhe vetëm dashuria kozmike mund ta kuptojë Hyjnoren. Dashuria është intelekti më i lartë i aktivizuar, sepse pa të asgjë e çmuar nuk do të mund të arrihej, si në mënyrë shpirtërore, ashtu edhe në atë artistike, sociale apo shkencore.

Sufizmi është një atribut i atyre që dashurojnë. Të dashuruarit janë njerëz që pastrohen me dashuri, të lirë nga vet-vetja dhe kualitetet e tyre dhe gjithmonë të vëmendshëm për të Dashurin (Zotin). Me këtë mund të themi që Sufinjtë nuk mbahen në skllavëri nga asnjë kualitet i tyre sepse ata shohin çdo gjë që janë dhe kanë ti takonë Burimit. Një Sufi i hershëm, Shebli, tha: "Një Sufi nuk sheh asgjë tjetër përveq Zotit në të dy botërat."

Abu Muhamed Muteish tha: "*Sufi është ai që mendja e tij e mban hapin e ritmit të këmbës, ai është i tëri prezent: shpirti i tij është aty ku është trupi i tij, dhe trupi i tij është aty ku është shpirti i tij, dhe shpirti i tij është aty ku shkel këmba e tij, dhe aty ku shkel këmba e tij është shpirti i tij*". Kjo është një shenjë e prezencës pa mungesë.

Tani jetojmë në një kulturë që është përshkruar si materialiste, vetjake, nevrotikisht individuale, narcisiste, dhe e dergjur me siklet, turp, dhe faj. Nga pikëpamja Sufiste, njerëzimi sot po vuan nën tiranin më të madhe, tiraninë e egos. Të panumëruara janë idhujt falso që ne adhurojmë, por të gjitha ato adhurime janë vetëm forma të egos.

Ka shumë mënyra që egoja e njeriut të uzurpojë edhe vlerat më të pastërta shpirtërore. Sufi i vërtetë është ai që nuk deklaron virtytet apo të vërtetën, por jeton një jetë në prezencë dhe dashuri pa interes personal. Më me rëndësi se çka ne besojmë është mënyra se si ne jetojmë. Në qoftë se disa besime të veçanta të dërgojnë në veçori, drejtësi të vet-vetes, dhe fanatizëm, problemi qëndron tek kotësia e besimtarit. Në qoftë se ilaqi vetëm e shton sëmundjen, një ilaq edhe më themelor nevoitet.

Ideja e prezencës me dashuri mund të jetë ilaqi më themelor për të mbijetuar materializmin, egoizmin, dhe pavedijesimin në këtë gjeneratë. Nën ankthin tonë me vetet tona falso, duke ia kthyer shpinën Zotit, ne gjithashtu e kemi humbur esencën e Vetes sonë, shkëndijen tonë hyjnore. Me harresën e Zotit, ne kemi harruar vet-veten. Ta kujtosh Zotin është fillimi i kujtimit të vet-vetes.

Udhëtimi nga ndarja në bashkim

Sufizmi është nje udhë mistike e dashurisë, në të cilën Zoti, apo e Vërteta, përjetohet me emrin i Dashuri. Marrëdhënia e brendshme në mes të dashuruesit dhe të Dashurit është themeli i rrugës Sufi. Nëpërmjet dashurisë kërkuesi dërgohet tek Zoti. Mistiku kërkon ta realizoj të Vërtetën në këtë jetë dhe Zoti e shfaqë Veten e Tij brenda në zemrat e atyre që Atë e donë. Përjetimi mistikë i Zotit është gjendja e njëshmerise me Zotin. Ky bashkim *unio mystica* është qëllimi i udhëtarit në udhën e mistikut. Brenda në zemer, dashuruesi dhe i Dashuri bashkohen në një ekstaze të dashurisë. Udhëtari fillon këtë udhëtim nga malli për të arritur gjendjen e njëshmërisë. Ky mallëngjim ka lindur brenda në shpirtë, ngase shpirtit i kujtohet ardhja nga Zoti. Shpirtit i *kujtohet* se shtëpia e vërtetë është me Zotin dhe e zgjon kërkuesin me këtë kujtim. Udhëtimi spiritual është nje

udhëtim që na dergon prapa në shtëpi, nga ndarja në bashkim. *Kemi ardhur nga Zoti dhe kthehemi tek Zoti.*

Udhëtimi mistikë për në shtëpi është nje udhëtim i brendshëm, tek vet qendra e qenies sonë, atje ku i Dashuri është prezent përjetësisht. Atë që ne kërkojmë nuk është askush tjetër përveqëse natyra jone e përhershme. Shen Augustini tha, "Kthehu përbrenda vet-vetes, sepse në brendësi të njeriut jeton e vërteta. "Përjetimi mistikë se i Dashuri jeton brenda në zemrën e mistikut, nuk është nje koncept por një realitet jetësore. Brenda në thellësi të zemrës nuk ka ndarje midis dashuruesit dhe të Dashurit. Ketu jemi përjetësisht të bashkuar me Zotin, dhe përjetimi mistikë i këtij unioni është shfaqja e asajë që është gjithmonë prezente.

Pengesa më e madhe që na mban nga përjetimi i kësaj gjendje të përjetshme të unitetit është egoja, personaliteti ynë individualë. Në gjendjen e unitetit nuk ka ego. Në këtë moment vet-vetja individuale mbaron së ekzistuari dhe vetëm i Dashuri ekziston. Sufi thotë, "I Dashuri jeton, dashuruesi është i vdekur. "Prandaj Sufinjtëkanë aspirata të "vdesin para se të vdesin"të tejkalojë veten individuale dhe të përjetojë veten transcedente të natyres hyjnore. Ansari një Sufi që jetoi në shekullin e njëmbëdhjetë shprehu këtë në menyrë të thjeshtë:

"Dije se kur të mësosh ta humbësh vet-vetën,
Do ta arrish të Dashurin. Nuk ka asnjë
Sekret tjetër që të mësohet, dhe më shumë se kaq
Nuk më është bërë e njohur mua. "

Udhëtimi mistik na largon nga egoja në drejtim të Vetës, nga ndarja në bashkim. Duke u larguar nga egoja dhe duke u kthyer prapa tek Zoti, ne marrim një kahje në drejtim të thellësishëm në vet-vetën tonë, tek qendra më e thellë e qenies tonë, cka Sufinjtë e quajnë "Zemra e Zemrave". Ky është një udhëtim individualë i kërkuesit prapa tek burimi, i të "*vetmit tek i Vetmi*. " Megjithatë duhet kaluar disa faza në këtë udhëtim, "*kodra të mëdha udhëtimi*, "nëpërmjet të cilave çdo udhëtarëkalon. Sufit e shenjtë na kanë dhuruar një hartë që përshkruan këto faza dhe gjithashtu vështirësitë dhe rreziqet në të cilat mund të hasim gjatë këtij udhëtimi. Pasi që ata kanë arritur qëllimin, janë në gjendje ti ndihmojnë udhëtarit duke mbajtur shënime se cka mund të pritet gjatë udhëtimit.

Sufizmi githashtu ofron disa mënyra që njëri të hapet tek bota e brendshme dhe ta mban vëmendjen të fokusuar në qëllimin për të padukshmen. Më e cmuara nga këto mënyra është praktikimi i kujtimit, sepse Sufi aspiron ta kujtojë Zotin në çdo moment, me çdo frymëmarrje. Ky nuk është kujtim mental, por një kujtim i zemrës, sepse në zemër ndodhet vetëdija e lartë e Vetë-Vetës. Vet-Vetja është ajo pjesë e jona që kurr nuk është e ndarë nga Zoti, dhe vetëdija e Vetës është kualitet i*njohuris se ne jemi nje me Zotin*. Praktikimi i kujtimit është një menyrë e

zgjimit të vetëdijes së Vetes, dhe kështu bëhemi të vetëdijshëm për bashkimin tonë të brendshëm me Atë që ne e duam.

Në qoftë se e don dikënd gjithmonë mbanë mendjen tek ai, dhe kur dashuria e shpirtit për Zotin zgjohet brenda në zemër, vëmendja e dashuruesit merr kahje në drejtim të të Dashurit. **Momenti i zgjimit shpirtërorë është** *teuba*, "**pendimi**, "që Sufinjtë e përshkruajnë "kthimi i zemrës "Momenti *teuba* është gjithmonë njëveprim i mëshirës, dhuratë nga i Dashuri, por Sufizmi ka zhvilluar teknika të ndryshme që ta mbajmë vëmendjen në dashurinë e shpirtit për Zotin, në kujtimin e zemrës. Njëra nga këto teknika është *dhikri*, përsëritja e njërit nga Emrat e Zotit. Nëpërmjet praktikimit të d*hikrit* vëmendja e dashuruesit kthehet nga Zoti dhe e tërë qenia e dashuruesit bëhet e mbushur me kënaqësinë e kujtimit të të Dashurit.

Kjo rrugë e Sufinjëve na ndihmon të na bëjë të vetëdijshëm për vetëdijen hyjnore të Vetës që gjindet brenda në zemër, dhe ku në të njëjtën kohë na kështillon largimin nga vetëdija e kufizuar e egos. Udhëtimi nga egoja në Vet-vete është njëudhëtim i përjetshëm i shpirtit, e mërgimtarit kur kthehet në shtëpi. Në këtë botëne kemi harruar natyrën tonë të vërtetë dhe identifikohemi me egon. Udhëtimi për në shtëpi na liron nga skllavërimi i egos dhe natyrës së iluzionit të dëshirës. Ne drejtohemi tek përmbushja e vërtetë që mund të vie vetëm nga njohja se kush jemi, duke e shijuar të vërtetën e esencës tonë hyjnore. Kur një mesues Sufi, Dhu-l-Nun, ishte pyetur, "Cili është fundi i mistikut"ai u përigjigj, "*Kur ai është ashtu si ka qene ku ka qene para se të ishte, "*

Çdo udhë spirituale i jep kahje kërkuesit të sinqertë tek e vërteta që mund të gjindet vetëm brenda. Sufi thotë se ka aq shumë rrugë në drejtim të Zotit sa ka edhe njerëz, "aq sa ka frymëmarrje të fëmijëve të njeriut. "Sepse secili jemi individual dhe unikë, udhëtimi për ta zbuluar natyrën tonë të vërtetë do të jetë i ndryshëm për secilin nga ne. Njëkohësisht udhëtimet e ndryshme spirituale i jane përshtatur tipave të njerëzve të ndryshem. Sufizmi është i përshtatshëm për ata që ndiejnë nevojën të realizojnë marrëdhënien e tyre me Zotin si një marrëdhënie dashurie, që duhet të tërhiqet nga maja e dashurisë dhe malli për të Dashurin.

Të besosh apo mos të besosh - Peshorja e Paskalit

Matematicienti Francez Blaise Pascal tregon se si e sheh jetën nga këndvështrimi I tij. Pasi arsyeja nuk ka siguri ai e bën një peshim se cila është më përfituese: "Të besosh apo mos të besosh në Zot".

Pasiguri në çdo gjë – Kjo është ç'farë shoh, dhe çka më mundon mua. Shikoj në të gjitha anët, dhe ngado që shikoj nuk shoh asgjë pos mjegulli. Natyra nuk më ofron asgjë që nuk është një çështje e dyshimit.

Pasiguri në qëllimin e jetës së njeriut – Madje pas të tërës çka është njeriu në natyrë? Një asgjë në relacion të infinitit, dhe e tëra në relacion të

asgjësë, pikë qëndrore në mes të asgjësë dhe të tërës dhe infinitit shumë largë për ti kuptuar ndonjërën.

Pasiguri në arsyen – Asgjë nuk e kënaq më shumë arsyen se sa ta mohoj arsyen.

Pasiguri në shkencë – Ska dyshim se ekzistojnë ligje të natyrës, por paSiçë kjo arsye e ndieshme u korruptua, I korruptoi të tëra me të.

Pasiguri në fe – Po të mos shihja asnjë shenjë të hyjnores, do ta vëja veten në mohim. Po të shihja çdo kund shenjat e Krijuesit, do ti zhytesha I qetë besimit. Por duke parë shumë që ta refuzoj Atë, dhe shumë pak për të më siguruar, jamë në një gjendje të mjerueshme, dhe do të dëshiroja njëqind herë që po qe se Zoti e mbështetë natyrën ta shfaqë Veten e Tij pa ngurrim. Ne nuk mund të kuptojmë asgjë për punët e Zotit po qe se nuk e marrim si parim që Ai dëshiron ti verboj disa dhe ndriçojë disa të tjerë.

Pasiguri edhe në skepticizëm – Nuk është e sigurtë se çdo gjë është e pasigurtë.

Mandej e ve në peshore besimin

1. Është e mundur që Zoti egziston dhe është e mundur që Zoti nuk egziston.

2. Në qoftë se njëri beson në Zot dhe në qoftë se Zoti egziston atëherë përfiton një dhuratë të pafund, por në qoftë se Zoti nuk egziston atëherë njëri humb shumë pak apo asgjë.

3. Në qoftë se njëri nuk beson në Zot dhe në qoftë se Zoti egziston atëherë ai përfiton një dënim të pafund, por në qoftë se Zoti nuk egziston atëherë njëri fiton shumë pak apo asgjë.

4. Është më mirë të fitosh një shpërblim të pafund ose të humbësh pak apo asgjë, sesa të fitosh një dënim të pafund ose të fitosh pak apo asgjë.

5. Si përfundim është më mirë të besosh në Zot sesa mos të besosh në Zot.

6. Në qoftë se një veprim si përfundim është më I mirë sesa tjetri atëhere është e arsyeshme të përcjellësh atë veprim dhe e paarsyeshme të përcjellësh tjetër veprim.

7. Është e arsyeshme të besosh në Zot dhe e paarsyeshme të mos besosh në Zot.

Atëherë përpiqu ta bindësh veten, jo duke ngritur provat për Zotin, por duke I pakësuar ndjenjat e tua. Ti dëshiron të arrish në besim, por nuk e dinë rrugën; ti dëshiron ta shërosh veten nga mosbesimi, dhe kërkon ilaqin për të. Mëso nga ata që kanë qenë në të njëjtën situatë që gjindeni ju tani; nga ata që tani janë në gjendje të japin të gjithë pasurinë për besimin e tyre. Këta janë njerëz që e dinë rrugën të cilën ti mund ta përcjellësh, dhe që janë shëruar prej një sëmundje nga e cila edhe ti do te shërohëshe. Fillo këtë udhëtim ashtu si filluan ata; duke vepruar sikurse besojnë, …… e të tjera; me një proces të thjeshtë dhe natyral kjo do të të bëjë që të besosh, do

të lehtësojë ndjenjat – do të të qetëson intelektin e mendjemadhësisë kritike…

Më mirë të jetoj një jetë duke besuar në Zot, edhe në qoftë se nuk ka Zot, sesa të jetoj një jetë duke mos besuar në Zot e kur të vdes të kuptoj se ka Zot. (Pika 233 e librit ***Pensées***)

Kush mund të quhet Sufi
Kërkoj strehim tek Zoti
Nga errësira e djallit
Në emër të Zotit
Të GjithëMëshirshmit, MëshirëPlotit.

Sufi është nje përjetim i gjendjes transcedente përtej trajtave i shfaqur përbrenda *ehem*, lulëzimit të lulës së zemrës. Është ajo zemër e transformuar që merr, në heshtje, lutjen që është e verteta e *Uehid* e Atij që është NJE dhe që është Allah. Nuk ka ndonjë botë atje, nuk ka libra, nuk ka shkrime, nuk ka mësime, nuk ka këndime, nuk ka vallëzime, nuk ka mendje, nuk ka dëshira, nuk ka sy, nuk ka zë, nuk ka prekje, nuk ka trup, asnjëra nga këto nuk është atje. Te gjitha zhduken. Mbetet vetëm shpirti i vetëdijshëm.

Në këtë gjendje të heshtjes paraqitet *uehi*, shfaqja e perceptuar në gjendjen e *Kutbijet*, Shpjeguesit. Kjo shfaqje shkëlqen nga Rezonanca e Allahut. Rezonanca e Fuqisë së Allahut *uehi* quhet Muhamed, bukuria e Fytyrës së Tij. Kjo Fuqi është Drita e Allahut. Shpjeguesi apo *Muheijedin*, *Kutbijet*, është zeri i Allahut. Shpjegimet e tij janë ajo që quhet Kuran.

Përderisa zëri i heshtur shpjegon, shpirti arrin të ekziston apo përjeton gjendjen e secilit shpjegim. Vetëdijësimi i shpirtit shndërrohet në çdo gjendje të ngritjes së këtij Kurani të heshtur, këtij *uehi*, përderisa shfaq mori të mbretërive të bukurisë së Allahut, Siç janë engjujt, dhe profetët, pa trajta, duke ekzistuar atje si kualitete hyjnore; ata shkëlqejne dhe jetojnë në bukurinë dhe Dritën e Tij. Sa shumë bëhet e njohur, sa shpejtë, është e pamundur ti përserisësh të gjitha.

Mandej me forcë dhe intensitet të hatashëm arrine shfaqja finale: **"Koha dhe hapesira pushojnë së ekzistuari. Mbetet vetëm NJE. 'Une jam Ai'!"**Me këtë vetëdijësim, shpirti i mahnitur, njëherësh shndërrohet në Shpjeguesin, njëkohësisht kur Shpjeguesi shfaqet si Shkëlqim i Dritës së Allahut, Një Qenie Shkëlqyese, Ai që është NJE. Vetëdija e shpirtit zhduket, vetëm Ai mbetet, i vetmuar.

Vetëm ky është Sufi

Në këtë kohë të shkatërrimit që ne po jetojmë, ky mësim do të kërkohet vetëm nga disa persona shumë shumë të rrallë, që me të vërtetë duan të shohin, të zhduken brenda në Atë që është Zot. Sa e çuditshme

është qenia njerëzore! Të kënaqur me imazhin e tyre, Narcisti sheh në pasqyrë reflektimin e tij; dhe prapë, ne adhurojmë mendjen dhe mendja është zoti i vetëm që ne arrijmë të bashkohemi. Kujdes nga mendja! Është mbret i iluzionit, ka shumë gracka. Prodhon pamje të ngjashme; mendojmë se po arrijmë përparim shpirtërorë – mund edhe të bëhet mësues, megjithëse e dimë shumë mirë se ne nuk e kemi parë Atë që është NJË.

Veprimit të kësaj mendje Sufi i vërtetë i bën konkurrencë, dhe për mendjen Sufi duhet të mbahet në periferi apo pa rrezik i nderuar si histori, edhe pse, në fund, imitimi do të mbetet në periferin e botës, dhe kurr të mos arrije Hyjnoren ku egoja kurr nuk do të mund të arrijë. Njëri nga shembujt e evliasë Bava Muheijedin ishte për pulën që e hedh dheun prapa për të kërkuar krimba. Kur të arrin tek një gurë i çmuar dhe me vlerë, ky gur hidhet prapa gjithashtu. Është duke kerkuar vetëm insekte dhe ndytësira për tu ushqyer. Nuk e ka vetëdijen ta njohë gurin e çmuar apo ta kuptojë madhërinë e tij. Kështu vepron edhe mendja. Kërkon vetëm tituj, famë, dhe statutin e botës, ushqimin e sajë.

Sufi i vërtetë nuk do të gjindet aty, sepse: Sufi është një përjetim i gjendjes transcedente përtej trajtave i shfaqur përbrenda *ehem*, lulëzimit të lulës së zemrës. Është ajo zemër e transformuar që merr, në heshtje, lutjen që është e vërteta e *Uehid* e Atij që është NJE dhe qe është Allah.

Lutem qe të gjithë ata qe janë në kërkim të së vërtetës së Tij ta njohin Gurin e çmuar dhe të zhduken brenda ne Dritën e Tij.

Amin

Perceptimi i Unitetit (Njëshmërisë) të Zotit

Për Ibn Arabin kuptimi i vërtetë i Njëshmërisë mbetet misterie, që përfundimisht nuk mund të kuptohet me intelektin e njeriut, , dhe e gjithë puna e tij mund të përshkruhet si një lëvizje e pandarë rrethore vërdallë Atij të Panjohurit, që ndodhet përtejë të gjitha kontrasteve të manifestimit dhe përshkrimit.

Ibn Arabi ishte më i afërt me termin *Wehdet El-Wugjud* që mund ta perkthejme "Uniteti i Qenies". Nuk është dicka e ekzagjeruar të thuhet se formulimi i këtij termi ka një thellësi qartësie të parivalshme. Njëshmëria nuk është thjeshtë të besosh në një Zot si profesohet në fetë e Perëndimit, sepse ajo është një formulim i parimit në përputhje të një kuptimi të vecantë. Një besim i tille në Zot shpesh herë duket se përjashton formulime të tjera Siç janë besimet jo-teiste, doktrina e Budizmit, apo besimi në shpirta të mëdhenjë të Indianëve të Amerikës etj. Ndërsa në anën tjetër "Uniteti i Qenies"është absolutë, parim gjithpërfshirës që fut nën mburojë të gjitha besimet dhe doktrinat. Pa kufije dhe përtej opozitave, është sikur uji që ushqen të gjithë krijimin, pa dallime, …. në perputhje me nevojat e tyre.

As nuk mund të mendohet si koncept filozofike. Fjala Arabe *wujud* gjithashtu do të thotë "përjetime"apo "perceptim"prandaj Qenia nuk

mund të kuptohet apo vleresohet vetëm me ide intelektuale. Është një udhetim i jetes, të gjindet dhe të realizohet. Njëshmëria e Qenies sipas mendimit të Ibn Arabit në të vertete nuk është një doktrine por ndodhet në zemrën e gjerave reale të natyres. Ashtu sikurse jeta edhe Ai nuk mund të futet në një trup apo besim apo të jete i përkufizuar në cfardo përshkrimi. Buron në të gjitha gjërat por prap se prap nuk e nxe asnjë gjë.

Në të vërtetë vet përshkrimi *VEHDET EL-VUGJUD* – Uniteti i Qenies nuk dominon në punën e Ibn Arabit, dhe ai përdorë terme të ndryshme për ta shprehur natyren e realitetit, gati të na sigurojë se tendencën natyrore që kemi për të ndrequr dhe shpjeguar Unitetin e Qenies merr lidhje të shkurte. ”

Këto përshkrime rrjedhin prej nga ai sheh dhe përjeton në termet Islamike, por ai vazhdimishtë në drejton tek kuptimet e pakufizuara, të perceptuara në zemrën e njeriut.

Për Ibn Arabin, Njëshmëria e Zotit fundamentalishtë është cështje e depërtimit dhe përjetimit shpirtërore, që do të thotë një ndryshim radikale në vizion.

Ai përmbyt mënyren tonë normale se si i shohim gjërat, të na sjell më afer tek një kuptim tjetër. Në fakt ai na parashtron një pyetje shumë serioze: Në realitet, kujt i është përmbytur vizioni? Ne si zakonisht besojmë se çka shohim është reale, marrim dukjen e gjërave të jete e tëra ajo që ekziston. Zotin, Njëshmërinë, Burimin Kulminantë të gjerave, mund ti imagjinojmë në mendjet tona duke i hequr nga bota e dukshme.

“Krijimi është i kuptueshem dhe Zoti i Vërteti mund të përceptohet dhe të duket, sipas njerezve të besimit dhe njerëzve që perjetojnë të vëertetën me pamje të brendshme.

Për ata që nuk janë në asnjërën nga këto kategori e Vërteta është e kuptueshme dhe Krijimi është i dukshëm. Këta të fundit janë të hidhur, uje kripe, përderisa të parët janë të ëmbël, uje i këndshem që pihet”

E vetmja ekzistencë e vërtetë i takon Atij të Vetmit

Këndvështrimi i Ibn Arabit në lidhje me gjendjen e vërtetë të marrëdhënieve është mjafte i ndryshëm nga ajo që kuptohet në jetën normale si e vërtetë: E vetmja ekzistencë e vërtetë i takon Atij të Vetmit, NJË, dhe është Ai Një që është i dukshëm në të gjitha manifestimet. “SENDET”nuk ekzistojnë në vet-vete por vetem si vende të manifestimit, apo reflektime të shprehjeve të Unitetit Primordial (Origjinale).

Njëri me të drejtë mund të pyet: Cili pra është ndryshimi në këtë rastë nga ajo që veq besohet? A nuk është kjo pamje e realitetit e njëjtë nga vlera sikurse pikëpamjet e tjera? Ibn Arabi përgjigjet qartë: Ndryshim komplet në shijim. Ata me pamje të brendshme reale e vleresojnë dhe janë të inspiruar me të tërën që është e mirë dhe e vërtetë, prandajë arrijnë kuptimin e lumturisë së vërtetë.

E ëmbëla e pandashme dhe kënaqësia e ekzistencës gjendet e gatshme për cdonjërin që i shikon gjërat ashtu si me të vërtetë janë, ose ka besim në një vizion të tille. Ia vlen të theksojmë se ky "besim"nuk është një vleresim intelektuale apo një bindje e verbuar por një gjë që ndjen-zemra dhe përjetim i ciltër. Tipikisht Ibn Arabi që ishte mbizoterues i Kuranit dhe Hadithit, edhe këtu e ka fjalen tek Imazhi i Kuranit si bazë për atë që shpjegon:

25-53 "Ai është që i lëshoi të dy deterat, njërin të embel dhe këndshëm ta shijosh, njërin të kripur dhe të hidhur për gjuhen, dhe Ai vuri në mes të tyre një Isthmus (barrierë) që ti mbajë të ndarë"

Ky varg i Kuranit mandej përcillet me një tjeter ku përshkruan krijimin e njeriut nga uji. Dhe prandaj Ibn Arabi merr si shembull të dy detërat që ti vë në shënjestër dy grupe të vecanta të njerëzve.

25-54 "Dhe Ai është që ka krijuar njeriun nga uji... "

"Ne që jemi krijuar nga uji – patjeter se i takojme njerit nga këto dy lloje të deterave.

Ata që e marrin krijimin e dukshëm dhe Zotin e padukshëm mbesin me iluzionin e shumëllojshmerise, prandajë e shijojnë ujin e hidhur;

Ata që e kuptojnë Realitetin e Njëshmërisë e perceptojnë Zotin në mënyre direkte dhe e shijojnë kënaqesinë e ujit të ëmbël.

Isthmus apo barriera që i ndan këto dy grupe është diskriminimi, **kapaciteti** i njeriut të dallojë **Realitetin nga Iluzioni**, Njëshmërinë nga shumëllojshmerinë. "

Çka ka dashur të thotë Ibn Arabi me realitetin apo Njëshmërinë? Për atë Njëshmëria është thjeshtë karakteristika e parë ose Emri i kësaj "Origjine"të të gjitha sendeve. Duke e emërtuar Atë si Një është mënyra më e mirë për të ju drejtuar Atij, por as nuk e shpjegon as nuk e përshkruan Atë. Realiteti kulminantë nuk mund të emërtohet dhe as të përshkruhet, dhe mbetet fundamentalisht i panjohur. Për Ibn Arabin Një (Ai) dhe Vetëm Një (Ai) (*El-Uahid El-Ahad*) është përshkrimi më i përshtatshëm i Realitetit kulminantë, vetëm ashtu si është, pra në Vetëvete.

Në gjuhën Arabe ky është një emër i dyfishtë, ku në të dy rastet kuptimi është "Një". Sipas tij ky emër i dyfishtë shpreh një kuptim të Unitetit, ku njëkohësisht e vë në shënjestër dallimin brenda në Njëshmëri.

Emrat e pare janë (*El-Uahid El-Ahad*) Ai që është Një dhe Unik, dhe përbëjnë një emër të kombinuar sikurse *Bad_Bek* ose *Ramburmuz* apo *el-Rrahman el-Rrahim*... Ve në shënjestër vet esencën e vet-vetës, jo sikur një lidhje me të cilin Ai kualifikohet... Emrat *Uahid el-Ahad* përbëjnë një emër esencial të Tij.

Asnjë pershkrim tjeter nuk përmbanë të njëjtën esencë primordiale të origjinës. Është pika fillestare e mësimit të tij, sikurse pa një burim të ujit që del nga toka, nuk do të ekzistonte vendi ku do të mblidheshin kafshët për të pirë. Është kjo njëshmëri që është baze mbështetëse gjithpërfshirëse. Ky

është kuptimi i termit "Ai"(*Hu*) që indikon se realiteti kulminantë është përtej emrave dhe kualifikimeve. Në këtë bazë të Njëshmërisë, Ai është pa gjini, i Lirë nga c'fardo llojë ndjenje mashkullore apo femërore që shfaqet midis krijesave.

Pse ne nuk i shohim gjerat ashtu siç janë në realitet?

Në qoftë se Ai që është Një (Wahid) dhe Unik (Ahad) është origjina e çdo gjëje dy pyetje mund të parashtrohen:

1. Si u bë që shumllojshmëria e dukshme erdhi në ekzistencë?
2. Pse ne nuk i shohim gjerat ashtu Siç janë në realitet?

Për Ibn Arabin shumllojshmëria është e qenësishme brenda në origjinë, ashtu sikurse numrat që janë të qenësishem apo të pandarë nga numri "një". Kjo shumllojshmëri është ajo që ai i referohet si Emra Hyjnore, që përshkruan marrëdhëniet e qenësishme në Qenien vetë. Ato mund të klasifikohen "transcedente"që do të thotë mënyra në të cilën Qenia Absolute është përtej relatives për nga virtyti i interioritetit dhe prioritetit logjik, ose është "Imanent"apo i "Brendshëm"që do të thotë mënyra se si Qenia është e lidhur me relativen.

Ato mund të njihen vetëm nga manifestimi i efekteve të tyre. Për shembull ta pershkruajmë Atë si Absolut e shkrin Atë nga të gjitha përkufizimet dhe konditat e mundshme, por këta kufinje dhe kondita të njëjta duhet veq të ekzistojnë disi në mënyrë që ne të kemi mundësi ta transcend Atë nga ato.

Në të njëjtën mënyre për ta përshkruar Atë si Zot është e domosdoshme ekzistenca e asajë mbi të cilën Ai është Zot, dhe ta thërrasim Atë Zot është e domosdoshme ekzistenca e asajë në të cilën Hyjnorja mund të ushtrohet.

Për të dy këto kategori të Emrave është e domosdoshme ekzistenca e një "Vendi"në të cilen ato manifestohen dhe njihen.

Vendi është bota (toka), një skenë në të cilën Emra të ndryshëm mund të luajnë rolin e tyre, në mënyrë direkte apo indirekte, duke aktruar dramën Hyjnore. Prandaj Ibn Arabi e shikon botën përpikërisht në një drite më pozitive, si një vend të manifestimit, dhe mundësive të pakufishme të Qenies së Zotit.

Emrat janë marredheniet formale të Qenies me Vetëveten dhe nuk e ndajnë realitetin kulminantë. Ia vlen të vërejmë këtu se çka Ibn Arabi don të thotë me emrin Allah është, se Ai emër i bashkon të gjithë Emrat e tjerë, "Tërësinë e Emrave që janë kontraditorë me njëri tjetrin. "Është sikur një lidhje në mes të gjitha lidhjeve apo marrëdhenieve të mundshme të Qenies, dhe Vet Realitetit kulminantë.

Në mënyrë analogjike, një njeri mund të quhet *Gjon*, dhe prap ne mund ta përshkruajmë atë si të mëshirshëm, të ditur, të aftë, e kështu me rradhë. Secili nga këta përemra është i ndryshëm, por ata nuk e ndryshojnë

realitetin esencialë të *Gjonit*, as nuk e bëjne atë të ndryshëm apo të shumllojshëm; por veqse e tregojnë atë në drita të ndryshme; ilustrojnë kualitetet e tij dhe e bëjnë atë të njohur. Tërë kohën, emri i tij origjinalë është *Gjon*.

Të giithë emrat i referohen Atij të emëruarit. Brenda Tij Emrat nuk janë të diferencuar, përderisa nëpërmjet manifestimit ata shfaqen të diferencuar.

Si bëhet që ne nuk e shohim vetën tonë apo botën në këtë mënyrë?

Ibn Arabi shpjegon se na janë bërë **shprehi** iluzionet e pluralitetit deri në atë shkalle sa që ne tani ato i marrim reale. Perballe Njëshmërisë iluzioni i shumllojshmërisë zhduket.

Numrat përmbajnë domethënie shpirtërore

Ai shpesh përdorte analogji matematikore për të pershkruar se si Ai që është Një shfaqet dhe realizohet nga qenia njerëzore.

"Kur Uniteti (vehdanije) shfaqet, ai që dëshmon nuk sheh asgjë tjetër përveq vetës, pa marr parasysh a gjendet njëri në stacionin e unitetit të tij apo të ndonjë tjetri. Në qoftë se ai është në stacionin e Unitetit të tij, ajo është e ngjashme sikur të shumëzosh Një me Një (1 x 1) dhe ky shumëzim rezulton në NJË, duke përdorur terme numrash si një analogji dhe përafërsi. Prandaj shumëzo 1 x 1 dhe rezultati = 1 Në qoftë se ai nuk është në stacionin e unitetit, atëhere ajo është e ngjashme sikur të shumëzosh 1 x 2, që patjetër se rezulton në 2, dhe kështu me radhë të giithë numrat. "

Ibn Arabi përdorë analogji të ndryshme apo shembuj të sqarojë domethënien e Njëshmërisë por ai posaqerisht kishte shprehi të përdorë alfabetin Arab dhe termet matematikore. Shkrimet dhe numrat për atë ishin mbretëri ku të vërtetat janë vet-evidente dhe mjaft të qarta, që përmbajnë domethënie spirituale.

Le të shikojme me afër tek bota e numrave: Numri Një nuk është vetëm fillimi i numrave serik. Në shikim të parë mund të duket si pjesë e numrave serike (1, 2, 3, etj.), por në fakt numri Një është vetë Parimi i numrave në vet-vete. Pa parimin e Njësisë, asnjë numër nuk do të mund të ekzistonte. Si të rritur me numrat, që prej shumë kohe i kemi interiorizuar principet e numrave, dhe shumë rrallë e vleresojmë procesin e jashtzakonshëm që ka të bëjë me këtë kuptim.

A mundet ndonjëri nga ne të kujtohet si do të ishte sikur njëri mos ti dinte numrat apo të mos ishte i dominuar nga mendimi me numra? Si ishte kur mësuam për her të parë të numërojmë si fëmijë?

Shpesh-herë mund të vërehet se një numër i fëmijëve parashkollorë thonë: "NJË"dhe "NJË"tjetër dhe "NJË"tjetër. Ata nuk e kuptojnë konceptin e Njëshit si pjesë serike, por ideja, e Njësisë duket qartë e themeluar. Një "send"ka definicione duke u bazuar në shqisat e shikimit, prekjes, shijimit etj. Dhe tërësia menjëherë perceptohet.

Të numerosh është e domosdoshme që ne të jemi në gjendje ti grupojmë objektet individuale se bashku në ndonjë mënyrë – dy gota duhet të kenë karakteristika të veqanta sa i përket madhësise, trajtës, ngjyrës, apo funkcionit, në mënyrë që të numërohen "dy".

Kur ne përdorim numrat, ne kombinojmë një term që është Njësi, p. sh. "gota"dhe të marrim edhe një term numerik p. sh. numri "dy". Në të gjitha mënyrat e numërimit, Njësia është prezente në dy aspekte, si term i njësisë dhe si parim apo esencë e termit numerik.

Problemi me ne qëndron në atë se na është bërë e zakonshme të mendojmë për numrin "NJË"thjesht si pjesë e numrave serik, prandaj në substancë i ndryshëm nga numri "dy"apo "tre". Ky mendim i tillë serik na dërgon tek përfundimi se ekziston një ndarje fundamentale ndërmjet të giithë numrave, duke përfshirë numrin një. Në termat psikologjikë, është kjo gje që shënon sensin e izolimit në ndjenjat e shumë njerëzve në botën e shumllojshmërise.

Ibn Arabi ndërkohë shpjegon se Ai që është NJË në thelb nuk është i "kundërt"me shumicën. Është parimi fundamentalë që ata veq janë të renditur apo numëruar. Brenda në çdo numër, numri NJË si parim i Njesise rrënjësisht është prezent.

Kur Njesia shfaqet e vetmuar në numrat serik, si numri "NJË", bën negacion të giithë numrat e tjerë, (një është një, jo dy, e as tre) dhe vë në shenjester të vetmin Unik. (ky "NJË"është i pakrahasueshem). Mund të jetë kjo ndoshta ajo që ndodhet prapa asaj që femiu kupton kur thotë "edhe një"?

Vet numrat, nga ana e tyre shfaqen si njësi të mundshme apo shprehje të potencialeve unike brenda në numrin Një. Ata numra mund të shihen si asgjë më shumë se vetem ekzistenca e NJËSHIT në një gjendje të vecantë:

Njëshi shfaqet si dy (një dhe një) apo tre (Një edhe Një edhe Një) apo katër e kështu me rradhë. Çdo numër është një konfigurim unikë i Njësise, me karakteristika speciale që e dallojnë nga numrat e tjerë. Janë këto karakteristika speciale që i japin një grade në relacion me numrat e tjerë, paSiçë një numër për shembull paraqitet të jetë më i madhë se një numër tjetër. Kur numri NJË shfaqet si çdo numër tjetër, tre aspekte njëherësh janë prezent:

1. Ekzistenca unike e kësaj mundësie (p. sh. numri 2 është numer UNIK 2).

2. Vendi në hierarkin e numrave (p. sh. numri 2 është më i vogel se numri 4).

3. Dhe varësia e këtij numri në parimin e Njëshmërisë (p. sh. 2 është NJË plus NJË).

Dallimi në mes të dy aspekteve të Njëshmërisë

Nëshkrimin e mëposhtëm, që përshkruan kuptimin e implikimeve të kësaj njohurie, Ibn Arabi, cartëson dallimin ndërmjet çka ai e quan Atë që është NJË si Esencë, dhe Atë që është NJË si Emër (numri i pare):

"Kur një send që kurr nuk ka qenë largohet, meqenëse është i perkohshëm, dhe Ai që përgjithmonë është mbetet, meqenëse është i përhershëm dhe vet-ekzistent, atëherë Dielli i argumenteve të qarta do të ngritet duke sjellur kuptim evident. Atëherë ndodh transendenca absolute, e realizuar në Bukuri absolute. Është realiteti esencialë i unitetit të syrit dhe ekzistencës, si dhe stacioni i Qetësisë dhe palëvizshmërisë. Numrat shikohen në të njëjtën mënyrë si Ai që është NJË (*Wahid*) – Ky që është NJË udhëton në shumë grada, shkallë apo nivele dhe me anë të ketijë udhetimi realitetet e numrave manifestohen.

Është në këtë stacion ku njëri që deklaron bashkim - unifikim bie në gabim: sepse kur ky person e sheh udhëtimin e Atij që është NJË nëpërmjet gradave apo niveleve imagjinare, ai nuk sheh asnjë numër përveq Atij që është NJË dhe UNIK (Ahad) prandaj ai deklaron identitet.

Tani, po që se Ai shfaqet në Emrin e Tij (NJË), atëherë njëkohësisht Ai nuk shfaqet në Esencën e Tij përveqëse në shkallën e Tij private që është Unitet. Në c'fardo shkalle që Ai të shfaqet në esencën e Tij, Ai nuk e shfaq Emrin e Tij, por Ai emërtohet në atë shkalle me c'fardo që realiteti i asaj shkalle i ofron Atij. Përmes Emrit të Tij në atë shkalle pason asgjësimi, përderisa nëpërmjet Esencës së Tij pason ekzistenca. Prandaj nëse thua "NJË"(*Wahid*), çdo gje tjetër perveq Atij zhduket nëpërmjet realietetit të atij Emri. Por, në anën tjetër në qoftë se thua "dy"atëherë realiteti esencialë i tij (dyshit) shfaqet nëpërmjet Qenies të Një Esence të Tij në atë shkallë, jo përmes Emrit të Tij (NJË). Emri i Tij (NJË) refuzon ekzistencën e kësaj shkalle, përderisa Esenca e Tij nuk e refuzon"

Ajo ç'farë është duke u theksuar këtu është dallimi në mes të dy aspekteve të Njëshmërisë. Këto dy aspekte në gjuhën Arabe quhen *Wahid* dhe *Ahad* që respektivisht mund të përkthehen "NJË"dhe "UNIK". Këta dy Emra të Allahut kane formuar një temë të shumë debateve në mes të teologeve Arab. Këta dy emra njihen si Emra Hyjnore në Kuran: Emri Ahad shfaqet vetëm njëherë, i pa adhuruar nga ndonjë kualifikim tjetër, përderisa Emri *Wahid* shfaqet **tre herë** gjithmonë në lidhje me emrin *Kehhar* – Giithë shkatërrues – Shihet qartë se Ibn Arabi është mjaft vigjilent tek ky bazament i shkrimit.

Ai e barazon "UNIK"(Ahad) tek Esenca, parimi i Njësise, që transcendon numërimin, por prap nuk e mohon ekzistencën e ndonjë numri tjetër, dhe Ai që është "NJË"(*Wahid*) tek Emri, numri i parë, ku realiteti i vet Emrit negacion dhe "asgjëson"të giithë (numrat) të tjeret. Ai na bën të kuptojme se kjo analogji numërore përshkruan, mbi të gjitha, një shkencë të meditimit dhe menjeherë thote:

"Kjo njohuri e brendshme dhe e veqantë duhet të jetë e mbuluar me perde nga mazhoranca e krijesave, për arsye të lartesisë dhe madhështisë që gjendet aty. Është një humnerë e thellë dhe shkatërrimi aty brenda është i paevitueshëm. "

Nga Realiteti i Njëshmërisë ne manifestohemi

Shumë është shkruar për doktrinat e supozuara të Ibn Arabit. Shumë shpesh ai është shpallur panteist, monist, madje edhe heretikë nga njerëz që janë munduar të paraqesin paqartesinë e misteries se Njëshmërisë në dicka më të pershtatshme, dicka që të bën të ndihesh më mirë.

Ta vlerësosh Njëshmërinë në mënyrën se si e ka paraqitur Ibn Arabi është larg nga nocionet e thjeshta si për shembull "Të gjitha gjërat në të vërtetë janë Një. "Për Ibn Arabin ekzistojnë dy lloje të aspekteve fundamentale të Unitetit të lidhura në Emrin *Wahid el-Ahad* – Një dhe Unik. Është e mundur që këto dy aspekte të jenë domethënia origjinale e *Janus*, hyjnorja Romake me dy-krera tek porta, që shikonte në të dy anët e rrugës. Duke qenë edhe "zoti"i fillimit, ai i ka dhënë emrin e tij muajit të fillimit të vitit, Janari.

Kuptimi i vërtetë i Njëshmërisë ka implikime të thella për vizionin tonë të vet-vetës. Për Ibn Arabin, përshkrimi i numrave është në të vërtetë një përshkrim preciz i vet-konshiencës dhe kuptimit.

Ibn Arabi në mënyrë direkte e lidhë këtë njohuri me adhurim, që këtu të kuptohet në sensin universal:

"Ajo që adhurohet nga çdo gjuhë, në të gjitha gjendjet dhe në të gjitha kohërat, është Ai që është NJË. Çdo adhurues, i c'fardo lloji, është Ai që është NJË. Prandaj nuk ka asgjë tjetër përveq Atij që është NJË... dhe nuk ka ekzistencë përveq atij që është NJË. Nuk ekziston një gjë e tille si ngritja: kur Ai që është NJË manifestohet në dy shkallë të kuptueshme, quhet dy, në këtë mënyrë II: kur të manifestohet në tre shkallë, është kështu III... Kjo është Njëshmëria e Zotit Real; nga Realiteti i Njëshmërisë ne manifestohemi. Në qoftë se Ai nuk do të ishte, ne nuk do të ishim, por ekzistenca jonë nuk e bën të nevojshme që Ai, lavdia qoftë e Tij, të mos jet."

Këta rreshta na lejojnë të nxjerrim jashtë disa terme kyqe të paraqitjes se Ibn Arabit. Esenca (dhat) që është themeli i çdo gjëje që ekziston, është NJË, edhe në esence edhe në emër, dhe ky Unitet posedon dy aspekte:

Në njëren anë, Ai që është NJË paraqet origjinen e parrëfyesheme dhe Esencen përtej çdo ideje të numërimit, dhe është pavend ndoshta edhe ta quash NJË apo të flasësh për Njëshmërinë. Është Unik në vet-vete. Symboli me i fuqishëm që tejkalon Uniken është koncepti i zeros, që së pari ishte zhvilluar në Indi në fillimin e periudhës Krishtere, dhe mandej u përdor shumë nga matematecientet Arab të mesjetës. Termi Arab për zeron, *sifr*, do të thotë "zbrazët"apo "hargjuar", që është komplet munges e numrit. Ky parim i njëjtë gjindet edhe në manuskriptin e Manastirit Salem të

shekullit të dymbedhjetë: "Çdo numër ngritet nga numri NJË, dhe ky në anën tjetër ngritet nga Zeroja. Në këtë parim *rri shtrirë misteria e shenjtë dhe madhështore*. "Ta shprehësh këtë në terme të metafizikes, Ibn Arabi shpesh përdorë termin *ehedijet el-ejn*, që mund të përkthehet si Njëshmëria e Burimit apo Uniciteti i Esencës, dhe me dhembje thotë se Ai që është NJË dhe UNIK nuk mund të njihet.

Në anën tjetër, Emri Një në mënyrë të barabarte përcakton një kuptim që në vet-vete nënkupton dhe detyron numërimin – c'fare kuptimi do të kishte një fjale apo idea e numrit "një"në qoftë se nuk do të kishte "dy"dhe "tre"e kështu me rradhë? Këta numrat e "tjerë"ndodhen brenda në Njëshmërinë e Vet Esences, të pa diferencuar për shkak të dominimit të kushtit të Vet-vetës, por duke pritur pezull, sikur ta dinin që do të shprehen. Ata prezentojnë shprehjet e mundshme apo modalitetet e asaj esence, dhe kjo është ajo që që Ibn Arabi e quan –el-e-jan apo el-e-jan-el-thabite, - esencat, realitetet Esenciale të themeluara brenda në Njëshmërinë.

Të dy aspektet janë shpjeguar me Emrin e dyfishte *Wahid el-Ahad*. Dhe sikur të ishin pasqyrë-reflektimesh, këto esenca apo shprehje të mundshme të Emrave Hyjnore gjithashtu zotërojne dy anë.

• Në njërën anë, këto mundesi janë identike tek Vet Esenca – p. sh. : numri tre është një konfigurim i mundshëm i Njëshit, dhe thjeshtë është një rruge që të vëresh parimin e unitetit.

• Në anën tjetër, mundësite janë të diferencuara nga njëra tjetra – p. sh. Numri tre nuk është dy, sikurse kualiteti i mëshires nuk është i njëjtë me kualitetin e hakmarrjes.

Kur këto modalitete shprehen në botën e dukshme ato janë "shkalle"(grada) në të cilën dhe sipas se cilës Ai që është Një manifestohet. Ai që është NJË, përderisa vazhdon të mbetet në Njëshmëri, në nivelin e Tij, manifeston Vetëm në shkallë të ndryshme të shumllojshmërisë. Ai që është NJË nuk shumohet; Thjesht i shfaq mundesitë e Tij të shumta të qenësisë. Sikur Ibn Arabi thote: të shumëzosh një me një është një, përderisa të shumëzosh një me dy është dy. Secili "send"manifeston Njëshmërinë sipas natyres se tij, kapacitetit dhe mundësise, dhe kjo gjithashtu ka dy aspekte:

• Përderisa "sendi"manifeston Atë që është NJË, zotëron një dignitet të pafund dhe të pazbulueshëm, që është Njëshmëria e tij e vërtetë.

• Përderisa "sendi"që paraqitet si vetja, është i përkohshëm, i kufizuar dhe "tjetër"nga Ai që është NJË.

Dashuria është motivi kryesorë i të gjithë krijimit

Sa për shkakun e Vet-shprehjes Hyjnore në trajta, Ibn Arabi shpesh citon fjalet Hyjnore:

"Isha Një Thesarë i Fshehur dhe Dëshirova që të Njihem, Prandaj e Krijova Botën që të Mund të Njihem. "

Thesari i Fshehur janë Emrat dhe mundësite e ekzistencës së tyre në gjendjen e padiferencuar; Dashuria është motivi primar i të giithë krijimit, dhe nga Dashuria për këto mundësi vet-shprehëse Ai e krijoi boten, "skenen", në mënyrë që Ai të njihet në të gjitha këto modalitete të ndryshme.

Krijimi për Ibn Arabin pak a shumë është paraqitja e dukshme e të padukshmes. Nuk ka ndonje zbrazëtire reale apo të përkohshme midis Krijuesit dhe krijesës.

Çdo lami e matematikes i jep shprehje të njëjta parimeve të Njëshmërisë, dhe nganjëherë Ibn Arabi përdor rrethin apo sferën si një analogji gjeometrike: fillimi i një pike është padimenzional dhe mandej zgjatet në një drejtim, duke formuar një vijë. Kjo vijë mandej rrotullohet dhe formon një rreth, prej nga ky rreth rrotullohet dhe formon një sferë. Të gjitha pikat e perimetrit, të rrethit apo sferës në mënyrë direkte janë të lidhura me qendrën pa u prekur apo ngjeshur fare dhe pa pasur ndonjë pështjellim. Pika-qëndrore gjithmonë mbetet e pandryshuar, sikurse gropa e ujit, përreth së cilës kafshët mblidhen, që buron nga toka, dhe mbetet një vendë ku të giithë mund të pijnë. Kjo qender është zemra e Konshiences-Vetëdijes sonë. Ta përshkruash qenien njerëzore si një "kurore"për Zotin, dhe zemrën e njeriut apo vetëdijen më të thelle si një vend për kurorezim, Ibn Arabi me këtë na tregon çka mistiku realizon në vet-vete:

"Shfaqja e Unitetit bëhet atëherë kur Hyjnorja merr në mbizoterim kuroren e njeriut... Kurorezimi Hyjnore ndodhet në pik-qendrën e rrethit, dhe është sipas të Thenes se Tij:

"As toka Ime, as parajsa Ime nuk me nxe dot mua, vetem zemra e sherbyesve të Mi besnik është mjaft e gjere që të me nxe Mua. "

Nganjëhere ai e kthente anasjelltash imazhin e rrethit: bota e dukshme në këtë rast nodhet në qendër të rrethit, e rrethuara nga perimetri që është Zoti, ku "Dhembshuria e Tij perqafon çdo gje. "Është tipike për Ibn Arabin që të përdorë analogji në mori menyrash të ndryshme, ku secila mënyrë shfaq një dritë tjetër apo perceptim, ose në referencë tek një tjetër Emër Hyjnore. Nuk është vetëm një rruge e "drejtë"që ti vështrosh gjërat, por secila rrugë reflekton faktin që i tere universi është një shumëzim i shfaqjeve të vetëm një Drite, që vazhdimisht, ndryshon në formë, që kurr nuk ndryshon në parim, gjithmon e freskët në zbulimin e domethënies.

"Nuk ka asgjë tjetër pos Qenies, tërësisht e dëlire, jo ex nihilo, dhe ajo është Qenia e Zotit Më të Lartit. Qenia ex nihilo është vet esenca e gjërave të krijuara, që është ekzistenca e botës. Nuk ka dallim në mes të dy ekzistencave; dhe nuk ka një "zgjatje"përveq në imagjinate që i klasifikon gjërat, dhe ajo bëhet e riorganizuar nëpërmjet njohurisë, në atë mënyrë që asgje nga kjo nuk mbetet përveq Qenies Absolute dhe Qenies relative, aktive dhe pasive. Në këtë mënyrë realitetet janë dhuruar – paqe përmes perfeksionimit. "(Futuhat)

Në çdo send Ai ka një Shenjë

Ibn Arabi i ve në koncept dy prezenca të vecanta dhe fundamentale.

1. E para është e pakufizuar, e pa-shfaqur dhe e tërësishme. Ekziston pa nevojën e manifestimit, që nuk lejon asnjë shoqërim apo ngjashmëri.

2. E dyta është relative dhe e kufizuar. E shfaqur në shkallë të ndryshme apo trajta, ose "sende"ku njëri send është i lidhur me tjetrin send.

Ky univers relativ përbëhet nga trajtat fizike, trajtat imagjinare, (si p. sh. shfaqja e ëndrrave), dhe trajtat konceptuale, por njëkohësisht mbetet plotësisht i varur nga domethënia transcedente që Absolutesi është.

Çdo send i dukur është një shenjë e të pa-dukures, është një shënjester tek realiteti, përderisa paraqitet të ketë një realitet të substancës se vet-vetës si një send i kufizuar. Në lidhje me këtë Ibn Arabi nganjëhere citon vargjet e poemës se shkruar nga Ebu-El-Etahija.

"Në çdo send Ai ka një Shenjë që na drejton tek fakti që Ai është NJË. "

Bota e shumllojshmerisë dhe bota e Njëshit paraqiten sikur të jenë të kundërta që në themel, dhe këtu Ibn Arabi përdor imazhin e bukur, jashtzakonisht të qëlluar "*Një oqean pa breg dhe një breg pa oqean*"

Sendet e kufizuara të bregut i takojnë bregut dhe nuk kalojnë prapa në oqean, vetëm në qoftë se në një gjendje të transformuar që i zbraps ata tek e vërteta e tyre esenciale. Një transformim i tillë është i dukshem tek njerëzit me pajmje dhe njohuri ezoterike, që e din se dy botërat janë një:

"Universi është një vend i shenjave, dhe çdo realitet në të është shenjë që të drejton tek realiteti hyjnore, mbi të cilin është gjetur ardhja në ekzistencë, dhe në të cilin do të kthehet kur të tërhiqet (nga ekzistenca). "

Dallimi në mes të dy prezencave nuk është askund tjeter më mirë i përshkruar se në ajetin e shkurte të Ikhlas (Pasterti ose Liri) në Kuran, cituar në fillim të ketij shkrimi. Ishte zbuluar atëherë kur Jehudinjte e pyetën Profetin Muhamed a. s. "Përshkruana Perëndine tuaj. "Ky përshkrim formon bazën e mendimit Islamik, dhe është një konfirmim total i të vërtetave të zbuluara në doktrinat e Jehudinjëve dhe të Krishterëve. Për shembull, rreshti i pare ("Thuaj: Ai është Zot, Një dhe Unik") në mënyrë direkte e thot doktrinen e Jehudinjëve: "Dëgjo o Izrael! – Perëndia, Zoti yt, është NJË. "

Dritë mbi Dritë – Interpretim

Në Emër të Allahut

Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Mik i dashur, zemra jote është një pasqyrë e lustruar. Duhet ta pastrosh deri sa të bëhet e pastërt nga perdja e pluhurit që është grumbulluar në të, sepse është destinuar që ti reflekton dritat e sekreteve hyjnore. Kur drita nga Allahu [Që] është Drita e qiejve dhe e tokës të fillon

të shkëlqejë në regjionet e zemrës tënde, kandili i dritës do të ndezet. Kandili i zemrës është në një qelq, qelqi është sikur të ishte një yll flakërues që shkëlqen. Mandej brenda në atë zemër, vetëtima e zbulimeve hyjnore qëllon. Kjo vetëtimë do të gjenerohet nga murmurima e reve të domethënieve as nga Linda e as nga Perendimi, e ndezur nga një pemë e bekuar ulliri dhe hedh dritë në pemën e zbulimeve, aq e dëlirë, aq transparente saqë shkëlqen edhe pse zjarri nuk e prekë. (Nur, 35)

Mandej kandili i urtësisë ndezet nga vetë-vetja. Si do të qëndronte i pandezur kur drita e sekreteve të Allahut shkëlqen mbi të? Në qoftë se vetëm drita e sekreteve hyjnore shkëlqen në të, sekretet e qiellit të natës do të ndezëshin me mijëra yje, dhe nga yjet [ju] gjejeni rrugën [tuaj] (Nahl, 16)

Nuk janë yjet që na udhëzojnë ne, por drita hyjnore. Sepse Allahu e ka mbushur qiellin e ulët me bukuri [në] yje. (Ja Sin, 6)

Në qoftë se vetëm kandili i sekreteve hyjnore të jetë i ndezur në veten tënde të brendshme, të tjerat do të pasojnë, ose përnjëherë ose dalngadalë. Disa ju veq i dini disa do të ju tregojmë ne këtu. Lexo, dëgjo, mundohu të kuptosh. Qiejt e errët të ndërdijes do të ndizen nga prezenca hyjnore dhe nga paqja dhe bukuria e hënës së plotë, që do të lindë nga horizonti duke hedhur Dritë mbi Dritë (Nur, 35) përherë duke u ngritur në qiell, duke kaluar përmes fazës së caktuar, ashtu si Allahu i ka caktuar për atë faza, derisa të (Ja sin, 39) shkëlqen në triumf në qendër të qiellit, duke e hedhur errësirën e pavëmendjes.

(Betohem) në natën kur është e qetë, (Dhuha, 2)Në triumfin e dritës së mëngjezit, (Dhuha, I) nata jote e ndërdijes do ta sheh zbardhjen e ditës. Atëherë do ta inhalosh parfumin e kujtesës dhe do të pendohesh në orët e hershme të mëngjezit (El Imran, 17) të ndërdijes, dhe do të zhgënjehesh për jetën që e ke kaluar në gjumë. Ti do ti dëgjosh këngët e bylbylave të mëngjezit, dhe do ti dëgjosh ata duke thënë Ata e kishin bërë shprehi që të flejnë vetëm pakëz gjatë natës, dhe në orët e hershme të agimit, [ata ishin parë] duke u lutur që të jenë të falur. (Zerijet, 17-18) Allahu e udhëzon Kë të dojë Ai tek Drita e Tij (Nur, 35) Mandej do të shohësh duke lindur nga horizonti i Arsyes Hyjnore diellin e njohurisë së brendshme. Eshtë dielli yt privatë, se ti je ai të cilin Allahu e udhëzon, dhe je në udhën e drejtë, dhe jo ai të cilin Ai e len në gabim. (Eref, 178) Dhe ti do ta kuptosh sekretin se Nuk është e lejuar diellit që ta arrin hënën, e as nata nuk mundet ta zhvesh ditën. Secila noton në orbitën (e tyre të caktuar). (Ja Sin, 40) Në fund, nyja do të zgjidhet sipas alegorive që Allahu i vë para për njerëzimin, dhe Allahu është i dituri i të gjitha gjërave, (Nur, 35) dhe perdet do të hiqen dhe muret do të copëtohen, që do ta tregojnë të njomën nën të vrazhdën; e vërteta do ta shfaqë fytyrën e saj. E tërë kjo do të fillon kur pasqyra e zemrës tënde të pastrohet. Drita e sekreteve hyjnore do të bie në të në qoftë se ti donë dhe kërkon për Atë, nga Ai, me Atë.

8. Pyetje – Përgjigje

Fëmijët Amerikan e Pyesin Bavën (Evlianë)
Muhamed Rrahim Bawa Muhaiyaddeen (Ral.)
(Allahu e bekoftë)

Kush ishte Bava?

Muhamed Rrahim Bava Muheijedin (Ral.), një Musliman/Sufi nga Sri Lanka, ishte një njeri me zgjuarsi dhe dhembshuri të jashtëzakonshme për njerëzimin. Për më shumë se shtatëdhjetë vite ai ndau njohurinë dhe eksperiencën e tij me njerëz nga të gjitha fetë dhe racat.

Ai hyn në historin moderne në vitet e dyzeta, kur ishte zbuluar nga udhëtar spirituale në një vend të shenjtë në xhunglën e Sri Lankës, të quajtur Kataragama. Besohet se ai kishte kaluar shumë vite I vetmuar në këtë vend. Ata e lutën që të vinte dhe ti mësonte, dhe ai iu pergjegj kërkesës së tyre duke I ndihmuar për dyzet vite gjer në vitin 1971, kur ai pranoi një ftesë që të vinte në Amerike në qytetin Filadelfia, prej nga ai mësoi me dashuri deri kur ndërroi jete në Dhjetor të vitit 1986.

Mësimet e Baves shprehin shpjegimin e rrugës Sufi, të Islamit ezoterik; se qenia njerëzore është krijuar në mënyrë unike me aftësinë e Zgjuarsisë, **që ia mundëson njërit të gjurmoj prapa vetëdijen deri tek origjina – Allahu, tek Qenia Hyjnore** që është Një, Krijues I çdo gjëje – dhe ta nënshtroje vetën brenda në atë Burim, duke e lënë Zotin Një, të Vërtetën, si të vetmin realitet në jetën e njërit. Ai foli pandërprerë për këtë të Vërtetë nëpërmjet gje-e-gjezave, ligjërimeve, këngëve dhe tregimeve, ku të gjitha kishin në shënjestër rrugën për tu kthyer tek Zoti.

Njerëzit nga të gjitha fetë dhe racat vërshonin vendbanimin e tij ta dëgjonin atë dhe vetëm të jenë afër tij; ai mësoi çdonjerin, pa marr parasysh origjinën, me dashuri, dhembshuri dhe pranim. Një qenie e jashtzakonshme, ai mësoi nga eksperienca, pasi që vet kishte kaluar Udhëtimin dhe ishte kthyer, me Vetëdije Hyjnore – ishte kthyer prapa të përcjell mesazhin tek të gjithë që lëngojnë me mallëngjim për përjetimin e Zotit, të gjithë që lëngojnë për të gjetur Zgjuarsinë e brendshme, rrugën tek nënshtrimi tek Ai që është NJË.

Në këto kohëra shqetësuese, mësimet e tij janë duke u njohur dhe pranuar çdo ditë e më shumë si një prezentim I synimit origjinal të Islamit që është pastërtia – marrëdhënia në mes të njeriut dhe Zotit ashtu Siç është shpjeguar nga profetët e Zotit, që nga Ademi gjer tek Nuha, Ibrahimi, Musa, Jezusi dhe Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin me ta – të gjithë të dërguar për ti treguar njerëzimit se është një dhe vetëm një Zot, dhe se ky që është Një është burimi I tyre, që mund të arrihet, dhe pret për kthimin e çdo shpirti individual.

Fjalët e tij nuk lanë pa prekur thellë në zemër pothuaj gati të gjithë që patën rastin për ta dëgjuar. Shumë prej tyre braktisën mënyrën e jetesës se mëparshme që e kishin trashëguar me gjenerata të tëra dhe iu bashkangjitën një jetese që mësonte Bava. Përcjellesit e tij formuan një shoqatë në Filadelfi të Amerikës të quajtur "The Bawa Muhaiyaddeen Fellowship". Përcjellesit e Bavës I ndihmuan Bavës dhe e ndërtuan edhe një Xhami në Filadelfi, ku Namazi falet pesë herë në dite rregullisht edhe në kohën e tanishme. Kam pasur rastin ti takoj disa nga ata, madje edhe intelektuale-njerëz të ngritur, dhe të vjetër ku shpreheshin në mënyrën me të sinqertë kur thonin se "*para Baves ne e ndienim veten si fëmijë të vegjël*".

Dhe nga ata që une vetë kam takuar përbënin një diversitet të pasur nga raca, kombe, dhe fe të ndryshme që kishin ndërruar komplet mënyrën e jetesës, dhe e kishin perqafuar me zemër Islamin shpirtërorë që u kishte mësuar Bava, Siç ishte falja e Namazit pesë herë në ditë, Agjerimi I Ramazanit, dhe ditëve të tjera, meditimi, Kujtimi I Allahut (Dhikr), leximin e Kuranit etj.

Sipas të gjitha gjasave sipas Sufinjeve Bava mund të ketë qenë Kutb. Ata e definojne Kutbin si një përputhshmëri e boshtit magnetik të kozmosit dhe boshtit spiritualë të vetëdijes njerëzore.

Kur shfaqet nevoja për një përtëritës të Udhës, atëhere fusha-zgjuarsie së Kutbit mund të paraqitet si person. Duke punuar thellë në lumin e ngjarjeve të njerëzimit, Kutbi ndonjeherë është I fshehur, ndonjëhere jo, por gjithmone është I njohur tek komuniteti I të dashurve te Zotit.

Ai të qonte mallin e një njeriu jashtzakonisht të vjetër, të perjetshëm, edhe pse në pamje të jashtme I imët dukej I ri dhe lëkura e tij e bute si e një femiu. Bawa gjithmonë I ikte pyetjeve që I bënin njerezit për historinë e tij personale, shpesh duke u përgjegjur se tregimi më I rëndësishem është tregimi I Zotit. Saqe kur mbërriu në Amerike në aeroporte autoritetet e kishin pyetur për emrin e prindërve, dhe ai u kishte thëne Ademi dhe Hava. Ai kurr nuk u martua dhe nuk kishte fëmijë.

Kur erdhi në Amerikë/Filadelfi filloi të ekzistojë në mënyrë të thjeshtë në një shtëpi me zhurmë. Ai nuk zotëronte asgjë, dhe nuk ishte I zotëruar nga askush, dhe I dha jetë fjalëve të Rumit: (që tani u be njëri ndër poetët më të famshëm në Amerikë". *Sufi e hapë dorën tek universi dhe dhuron falas në cdo moment. Jo sikur lypësit në rrugë që luten për para në mënyrë që të mbijetojnë, Sufi të lutet që të ta japë jetën. Ai nuk morri asnjëherë para, nuk pranonte asnjë dhuratë, dhe trajtoi cdo kërkues njësojë si të ishin familja e tij.*

Ai gjithmone pyeste një pyetje të thjeshtë shpirtërore: Çka dëshiron ti? Ç'fardo që të ishte përgjigja, Bava e kthente gjithmonë të transformuar. Jonathan Granoff tregon se si kishte dëshmuar punën e ketij mësuesi Sufi në një mbasdite me dy kërkues.

Kërkuesi I parë shprehu dëshirën e flakët ta njohë Zotin. Ndërsa Bava ia ktheu përgjigjen duke I dhënë një recept Aurvedik për ti shëruar

hemorroided. I dyti, që kërkonte një këshille praktikore për një problem të vogël që kishte në familje, ishte këshilluar me zgjuarsinë e perfeksionit më të lartë. Jonathan më vonë intervistoi të dy, dhe kuptoi se Bava ia kishte qëlluar problemit të tyre në mënyrë spektakulare, dhe që të dy ishin ndihmuar.

Bava shpesh në mënyre spontane fillonte ta falënderonte Zotin duke kënduar ajete, duke hyrë në mënyrë intime në kontakt me Zotin që ishte njëherësh transcendent, personal, dhe pjesa më e thellë e jona.

Me shume se një herë pas mbarimit të ndonjë kënge, Bava komenton duke thëne: "**sa numër I madh që kanë ardhur**"Jo ne, ai thoshte për **qeniet e dritës** që kishin ardhur të dëgjonin: engjujt dhe të tjerët, të padukshem për sytë e tonë, por jo për sytë e tij, të gjithë tërhiqeshin tek fusha e vërtetë e një njeriu plotësisht të ndricuar.

Gradualisht agoi kuptimi tek ne se në këtë njeri Vediku më I pastërt I traditës se jo dualitetit ishte **përqafimi I tij I Islamit të Dëlirë**.

Në procesin më të madh të sistemit të zbulesës spirituale, të Vjetrit martojnë të Rinjt, jo simbolikisht, për në mënyrë transformative. Një Cikël I Madh kishte MBARUAR.

Si duket Parajsa?

Në parajsë mungon çdo gjë që të bën të mërzitësh. Paqja, dashuria dhe kënaqësia janë prezente. Parajsa ekziston kudo që secili jeton në unitet. Çdonjëri është në gjendjen e njëjtë, në nivelin e njëjtë. Ajo është parajsë. Secili është I lumtur atje.

Në kopshtin e luleve shumë lule me ngjyra të ndryshme qelin së bashku. Ka lule të kuqe dhe të bardha, trëndafila, dhe shumë gjethe me aromë. Të gjitha ato ngjyra në kopshtin e luleve e bëjnë shumë të bukur. A nuk është ashtu? Ashtu duket një kopsht I luleve. Kur të gjitha lulet me ngjyra të ndryshme të jetojnë së bashku, jo të ndarë në grupe të veçanta, atëherë është shumë bukur.

Njashtu, në qoftë se të gjithë ju jetoni së bashku, pa marrë parasysh sa ngjyra të ndryshme ju mund të keni, do të jetë aromatike, e bukur, dhe e kënaqshme. Kur ju të gjithë të jetoni ashtu si jetojnë lulet, kur të gjithë të jeni në atë gjendje, është kopshti I luleve të Zotit. Ajo është parasja.

Bava u përgjigjet Fëmijëve Amerikan

"Gjërat që ndryshojnë nuk janë jeta jonë e vërtetë. Brenda nesh gjendet një tjetër trupë, një tjetër bukuri. I takon asaj rreze të dritës që kurr nuk ndryshon. Ne duhet të zbulojmë si të përzihemi me të dhe të bëhemi Një me atë send që kurr nuk ndryshon. Ne duhet ta realizojmë dhe kuptojmë këtë thesarë të së vërtetës. Për këtë arsye kemi ardhur në këtë botë. " (Bauva M.)

Pse ne vendosëm të vimë këtu, meqenëse vec ishim pjesë e Zotit?

Kjo është një pyetje shumë e mirë. Shpirti është pjesë e Zotit dhe arsyeja pse ti erdhe këtu është që ta kuptosh Atë dhe ta kuptosh vetë-veten. Ti erdhe këtu ta kuptosh se si është Zoti dhe si je ti. Ti duhet ta dish çka është Zoti, çka je ti, dhe çka është krijimi.

Kjo botë është një shkollë, një universitet. Ti ke ardhur tek kjo shkollë të studiosh sekretet e Zotit dhe sekretet e tua. Zoti e krijoi këtë vend në mënyrë që ti ta kuptosh Atë dhe ta dish se sa I fuqishëm është Ai, ashtu që edhe ta kuptosh vetë-veten dhe të gjithë krijimin. Ti erdhe këtu ta marrësh testin dhe ta kalosh.

A e lind nëna një fëmijë që ta mbajë vetëm në shtëpi? Në qoftë se ti do të ishe e detyruar të rrish vetëm në shtëpi gjatë gjithë kohës, si do ta kuptoje botën dhe çudirat e saja të shumta? Nëna dhe babai yt të dërgojnë në shkollë. Pse? Sepse duan që ti të studiosh, të mësosh, dhe ta kuptosh botën, vetë-veten, dhe të gjitha çudirat. Ata duan që ti ta dish ç'farë është e vërteta. Prandajë prindërit e tu të dërgojnë në shkollë, dhe prandaj shkollat janë ndërtuar. Prindërit e tu dëshirojnë që ti të kuptosh gjërat.

Zoti e bëri të njëjtin gjë. Ai I dërgoi fëmijët e Tij tek kjo shkollë në mënyrë që ata të kuptojnë më shumë për Atë. Kemi botën e shpirtërave, këtë botë, dhe botën e zemrës, që ka brenda në të tetëmbëdhjetë mijë universa, parajsën, Zotin dhe vetë-veten. Duhet ta kuptosh të gjithë këtë.

Bota është një shembull. Zoti është Shkaku i Krijimit të të tërës, zemra e brendshme (kelb) është efekti, dhe ti je parimi themelorë. Nga shembulli I botës, ti je parimi themelorë që kupton shkaqet brenda në vetë-vete dhe Atë që është shkaku I të tërës. Ti duhet ta kuptosh Atin tënd. Për këtë arsye ke ardhur këtu. Babai të dërgoi këtu që të studiosh. Ashtu sikurse prindërit e tu të dërguan në shkollë, Zoti të dërgoi tek kjo botë që të mësosh për tetëmbëdhjetë mijë universat, këtë botë, botën e shpirtit, botën e jetës, botën e zgjuarsisë, botën e zgjuarsisë hyjnore (gnanem), botën paqësore të parajsës, dhe botën e perfeksionit, pastërtisë, dhe shkëlqimit. Ai të dërgoi që ti ta njohësh Babain tënd. Kjo është vetëm shkollë.

Djemtë dhe Vajzat - Sa afër?

Pyetje: Cila është sjellja e duhur në mes të djemëve dhe vajzave nga mosha dhjetë vjeqare deri në atë tetëmbëdhjetë vjeqare?

Përgjigje: Dashuria ime ju, nipërit e mi dhe mbesat e mia, vëllëzërit dhe motrat e mia, djemtë dhe vajzat e mia. Eshtë një periudhë në jetë kur të dy palët fëmijët meshkuj dhe femra tundohen të shkojnë në një udhë të gabuar. Për vajzat kjo periudhë është përafërsishtë nga mosha njëmbëdhjetë vjeqare deri në njëzet e një vjeqare, derisa për djemtë është nga mosha katërmbëdhjetë vjeqare deri në moshën njëzet e pesë vjeqare. Kjo është koha kur kanë dashnorë e dashnore. I gjithë këndimi dhe vallëzimi vinë gjatë kësaj kohe, dhe kualitetet e dashurisë, lakmisë,

pasionit, seksit, xhelozisë, falsitetit, dhe tradhëtisë zhvillohen në ta. Bota e iluzionit (maja), gjashtëdhjetë e katër llojet e lojrave seksuale, dhe katërqind trilion e dhjetëmijë lloje të kualiteteve gjithashtu vinë.

Në qoftë se djemtë dhe vajzat janë shumë afër gjatë një moshe të caktuar, është njësoj sikur ta vësh pambukun afër zjarrit. Kur zjarri e prek pambukun, do ta ndez dhe shkatërrojë atë. Ngjajshmërishtë, në qoftë se gjatë këtyre viteve, këto kualitete I prekin djemtë dhe vajzat, jetërat e tyre do të shkatërrohen. Kufizimi I jetës së tyre, vlera e tyre, potenciali I tyre, dhe studimet e tyre do të rrënohen. Urtësia dhe e vërteta do të rrënohen. Uniteti me prindërit e tyre dhe dashurinë që e kanë për ata do të prishet gjithashtu. Ata do të ndahen nga prindërit dhe do të digjen para se ti mbushin njëzet e një vjet.

Në atë moshë, shumë shokë me shumë kualitete të këqia do të mundohen të hynë në jetërat e tyre, shokë që vjedhin, thonë gënjeshtra, bëjnë dashuri me njëri tjetrin, shokë që tradhëtojnë, shkatërrojnë, dhe prishin jetëra të tjera. Në qoftë se djemtë dhe vajzat me kualitete të tilla mblidhen së bashku gjatë këtyre viteve, do të ketë një rrezik shumë të madhë, dhe ky rrezik do tua shkatërron jetërat e tyre.

Vajza është një gjë shumë e njomë. Ajo është e bukur, e vlefshme, dhe shumë delikate. Vajza është sikur një lule e bukur. Në qoftë se buburreci apo ndonjë insekt tjetër bie në lule kur është gati për të qelur, do të fillojë ta grimcojë/hajë atë. Kur lulja të vyshket dhe kur nuk është më e bukur, vlera e saj do të shuhet. Në këtë kohë kopshtari duhet të jetë shumë I kujdesëshëm që të përdorë insekticide që të jetë I sigurtë se lulet nuk do të hahen nga insektet, ashtu që të kanë vlerë kur të vie koha ti dërgojë në tregë.

Njashtu, në këtë moshë me të vërtetë duhet të përdorni insekticide; përndryshe, bubat do të kërcejnë në ju dhe do të ju hanë. Bukuria juaj, aroma dhe vlera do të shuhen, dhe vlera jote e tregut do të zvogëlohet. Bënu shumë të kujdesëshëm që kjo mos të ndodhë. Ashtu sikurse kopshtari që duhet të kujdeset që lulet të mos e humbin bukurinë e tyre, apo aromën e tyre, prindërit e juaj që ju kanë mbjellur dhe ju fëmijë që jeni vetë lulet, trëndafilat, duhet të jeni shumë të kujdesëshëm. Eshtë në këtë kohë që të gjithë buburrecat dhe insektet do të ngjiten tek ju dhe do të mundohen që të ju shkatërrojnë. Një bubrrec që rri ulur në një lule, ai nuk do të rri vetëm ulur. Ai po vie për të të ngrënë/hangër ty. Kjo është absolutikishtë e sigurtë. Derisa do të piqeni edhe pakë, duhet të jeni shumë të kujdesëshme. Ju duhet ta dini se cdo bubrrec që vie afër ai po vie për të të ngrënë ty. Ai nuk ka ardhur që të jetë shoku yt. Të jeni të sigurtë për këtë punë. Ju duhet të jeni të vëmendshme dhe ta kuptoni këtë. Prandaj djemtë dhe vajzat duhet të jenë shumë të kujdesëshëm njëri me tjetrin. Eshtë sikur të mbash pambukë dhe zjarrë në të njëjtin vend. Nuk është mirë për djemtë dhe vajzat të jenë shumë të afërt.

Pyetje: ***Unë jamë dhjetë vjeqare dhe jamë kurreshtare të di se a bën të lyhem?***

Përgjigje: Dashuria ime ju, rruza të dritës në sytë e mi. Në qoftë se lulja do ta ngjyrosë vetë-veten, origjinalitetin e saj, bukuria natyrore do ti shuhet. Pse Zoti do ta krijonte si lule në qoftë se do të kishte nevojë për tu ngjyrosur? Ajo veq është e bukur dhe aromatike, dhe nuk ka nevojë për tu lyrë.

Nuk ka asnjë, madje as lugatë, që nuk do të joshet nga një vajzë e bukur. Madje edhe një plakë të cilit iu ka afruar vdekja do të joshet tek ajo kur ta shikon atë. Zoti I dha femrës bukuri të tillë natyrore. Ai ty veq të dha atë bukuri, dhe është mirë për ty ta mbashë të bukur. Zgjuarsia jote, kualitetet e tua dhe dashuria do të jenë shumë më të bukura në qoftë se I mban natyrale. Zoti të dha këtë bukuri natyrore si një dhuratë bëmirëse, në mënyrë që ti të mos kesh nevojë ta lyesh atë. Eshtë njësoj sikur të ngjyrosësh arë. Ngjyra e mbulon bukurinë dhe shëndritjen e arit dhe e pengon shkëlqimin e tij.

Kush ka nevojë për tu lyrë? Jo ti. Vetëm plakat kanë nevojë për tu lyrë, plakat me rrudha që I kanë shpenzuar të gjitha vallëzimet dhe aktrimet dhe që nervat u janë harxhuar dhe eshtrat I kanë gati për tu shkrirë. Ato janë të vetmet që kanë nevojë për tu lyrë. Ka madje edhe ca pleqë dhe plaka që ende e dëshirojnë botën dhe që ende dëshirojnë të aktrojnë dhe vallëzojnë, kështu që kanë nevojë të shkojnë për të bërë operacion plastikë që ti lëmojnë rrudhat e lëkurës së tyre. Por Zoti të ka dhuruar ty dhuratën që është e përshtatshme për moshën tënde. Prandaj, nuk mendoj se ti ke nevojë për tu lyrë.

Në qoftë se shkon në ferr/xhehnem, çka e ndien dhimbjen paSiçë nuk e ke trupin tënd?

Dashuria ime ju. Është misterie! Kur fle, ti shehë ëndrra, apo jo? Shumë njerëz shohin ëndrra. Aty ti vështron njerëzit duke kënduar, përqafuar, puthur, duke u sillur andej e këndej, fluturuar, dhe ulur. I sheh të tëra ato në ëndërr. Derisa trupi yt është I shtrirë në shtratë dhe po fle, një tjetër lloj trupi po I përjeton ëndërrat. Ai trup udhëton në vende të ndryshme. Ju të gjithë keni parë ëndërra. Ju I keni parë ato. Ai ka parë trupi juaj ato ëndërra? Jo. Tjetri trupë brenda në këtë trupë I përjeton ato ëndërra. Trupi I jashtëm mbetet palëvizur, përderisa ky trupë I brendshëm lëvizë dhe bën gjëra që ti mbushë dhe ti kënaqë mendimet e mendjes tënde. **Është ky trup i brendshëm që vuan në ferr**.

Kur trupi fizikë vdesë, ti duhet ti ktheshë atë pjesë që I takojnë tokës. Pjesës që I takon zjarrit duhet tia kthesh zjarrit, pjesën e ajrit duhet tia kthesh ajrit, pjesën e ujit duhet tia kthesh ujit, dhe pjesën e eterit duhet tia kthesh eterit. Por trupi që gjendet brenda në trupin fizikë është rezultatë e

asaj ç'farë ka krijuar mendja jote përmes mendimeve dhe dëshirave. Ky është trupi që shkon në ferr/xhehnem.

Trupi fizikë është një shtëpi për ty, por brenda në të gjendet trupi I dytë, që ti e ke krijuar me mendimet negative. Megjithatë është edhe një tjetër trupë – trupi I shpirtit, trupi I së vërtetës. Ky trup përbëhet prej kualiteteve të Zotit dhe zgjuarsisë tënde.

Këta tre lloje të trupave bëjnë tre gjëra të ndryshme.

Së pari është trupi fizikë, që është një shtëpi të cilën Zoti e ndërtoi nga toka për ty. Ky trup duhet të kthehet tek toka dhe elementet.

Së dyti është trupi I përbërë nga mendimet e mendjes tënde. Kjo është çka vuan në ferr/xhehnem, dhe është ky trup tek I cili gjykimi do të vie.

Së treti është trupi që ti e përgaditë me zgjuarsi. Ne qoftë se do ta veshësh këtë trup për shpirtin, drita e Zotit do të vie aty. Ky është trupi që shkon direktë tek Zoti kur ti të vdesësh. Dashuria ime ju.

A ka Parajsë të Kafshëve?

Çka nëna dhe babai e mësojnë fëmiun në djepë, çka mësohet sa është i ri, është sikur të shkruash në gurë. **(Bawa M. ra)**

Mund të ketë. Zoti e krijoi tokën për barin, gjethet, dhe drunjët. Dhe për kafshët Ai bëri shpella në male dhe fole midis pemëve. Për secilin prej krijesave të Tij, Ai ka dhuruar një vendë banim në vende të ndryshme. Ai ka dhuruar ushqim dhe banim për cdo gjë.

Kemi një mbretëri të Zotit dhe mbretërin e ferrit/xhehnemit. Kemi gjashtë jetëra të ndryshme: jetë toke, jetë zjarri, jetë ajri, jetë uji, jetë eteri, dhe jetë njeriu, që është jetë drite, drita e jetës së Zotit. Ka një vendë për të gjashtë llojet e jetërave, por cka quhet parajsë/xhenet është vetëm për njerëzimin, për jetën e njeriut. Jetërat e tokës i kthehen tokës. Disa jetëra kanë vendë në eter dhe disa në tokë. Jetëra të tjera, Siç janë kafshët, ekzistojnë si forma dhe si forma indirekte. E vetmja jetë që ekziston si dritë është jeta e njeriut.

Pra, për pesë llojet e jetërave të para, Zoti i ka mbajtur pesë vende, dhe secila do të khehet tek vendi i vetë. Në qoftë se një kafshë e kryen punën ashtu si duhet, do ta marrë vendin që e meriton, por në qoftë se i shkakton dëm ndonjërit, atëherë do ti dhurohet shtëpia e njohur si ferr, që Zoti e ka krijuar për të. Për jetërat Siç janë insektet, gjethet, gjarpërinjtë, dhe skorpionat, ka një ferrë, por secila jetë që bën mirë do ti dhurohet vendi i caktuar për atë formë-jete të vecantë (ajo nga toka, zjarri, uji, ajri, apo eter). Vetëm në qoftë se shkakton dëm do ti ipet pjesa më e keqe e ferrit, ferri i kapluar nga insektet.

Qeniet njerëzore, që e kanë jetën e shpirtit shëndritës, janë të vetmet jetëra që u është dhuruar analitika e zgjuarsisë hyjnore. Vetëm ata me këtë lloj zgjuarsie kanë të drejtë të shkojnë në parajsë dhe mund të njohin sekretin e parajsës. Secila formë tjetër e jetës e ka vendin e saj. Kafshët hanë

dhe flenë aty ku e bëjnë nevojën (jashtqitjen). Por ti kur të shkosh në banjo, ti e pastron dhe e lanë vetë-veten. Kafshët nuk e bëjnë atë. Kafshët nuk e posedojnë analitikën e zgjuarsisë hyjnore. Ti mund të mbash kalë apo lopë në kushte të mira, por prap se prapë do ta bën nevojën dhe do të shtrihet aty, në vendin e fëlliqur për të fjetur. Kur kafshët të zgjohen, a i pastrojnë duart dhe këmbët? Jo. A e pastrojnë vetë-veten? Jo. Prandajë atyre do tu dhurohet një vendë i përshtatshëm krahas veprimeve të tyre. Pse? Sepse ata nuk e kanë vetëdijen e analitikës së zgjuarsië hyjnore që tu tregojë atyre dallimin në mes të pastërtisë dhe ndytësirës. Ata nuk e posedojnë këtë kuptim, prandaj nuk janë të aftë të bëjnë punën që njeriu mund ta bëjë. Ata nuk e dinë dallimin në mes të keqes dhe të mirës, apo të pastërtës dhe të papastërtës.

Një jetë që nuk është në gjendje të bëj dallimin midis së mirës dhe së keqes banon në ferr pa e kuptuar fare. Njëri mund të kuptojë dallimin midis parajsës dhe ferrit vetëm pasi të kuptojë dallimin midis së mirës dhe së keqes, midis së pastërtës dhe të papastërtës. Në qoftë se një kafshë nuk sheh ndonjë dallim në mes të pastërtës dhe të papastërtës, në qoftë se hanë në një vend të ferrit, fle në një vend të ferrit, dhe jeton në një vend të ferrit, atëherë ai është vendi që do ta marrë në botën e përtejme. Dhe ai vend do të jetë një vend i lumturisë për atë kafshë. Kur të arrin gjendjen e kuptimit, edhe në qoftë se është një lopë, do të marrë një vend të mirë. Por përderisa nuk e ka atë kuptim, do të marrë një vend që i përshtatet nivelit të tij. Kështu është për pesë jetërat.

Megjithatë, në qoftë se mund ta mbani një kafshë në mënyrë të mirë, dhe në qoftë se zgjuarsia e njeriut lindë në atë kafshë dhe në qoftë se mund ta ushtroni të kuptojë dallimin në mes së mirës dhe së keqës, ajo kafshë do të arrijë parajsën e bërë për kafshët, parajsën e përshtatshme për formën e jetës së tij. Ashtu si Zoti u ka dhënë kafshëve një vend këtu, Ai gjithashtu e ka mbajtur një vend për ta atje. Nuk është në të vërtetë parajsë; është një vendë ku pastajë do të mund të jetojnë në paqe. Ai e ka mbajtur një vend për secilën prej gjashtë jetërave të jetojnë në paqe. Ajo është sekreti i Tij. Për njeriun, definitivishtë është parajsa. Cka të tjerët do të mbërrijnë do të varet nga kërkimi i tyre.

Pse është bota gjithnjë kaq e vështirë

Lumturia është kur çka mendon, çka thua dhe çka vepron janë në harmoni me njëra tjetrën. **(Gandi)**

Përgjigje: Bawa Muheijedin ra: Arsyeja është sepse unë dhe ti jemi plakur. Unë dhe ti jemi plakur në zgjuarësi. Sepse bota ka përparuar përmes shkencës, mendja e individid fluturon largë nga Zoti dhe e vërteta. Njeriu po bën të liga derisa duhet të bëj të mira. Ka njerëz tani që do të duhej të jetonin si qenie të vërteta njerëzore por që kanë vendosur të jetojnë si kafshë. Njeriu e ka humbur besimin e tij në Zot.

Kjo gjeneratë nuk jeton si një qenie e mirë njerëzore, në gjendjen e unitetit të vërtetë. Ata nuk jetojnë me dashuri. Ata nuk i konsiderojnë jetërat e tjera të vlefshme sikurse jetërat e tyre apo tu ndihmojnë të tjerëve kur janë në vështirësi. Kur njeriu tani po vepron, ai harron të gjitha ato mendime të mira. Për këtë arsye, bota është bërë e vështirë.

Është mendja e njeriut që e përjeton këtë vështirësi. Bota vetëm shikon. Botën që njeriu e mban brenda në vetë-vete është ajo që i shkakton atij vështirësi. Çdo personi i duket bota që e bartë përbrenda e vështirë. Por në qoftë se njeriu do ta mbante thesarin e mirë dhe botën e mirë përbrenda vetë-vetes, atëherë atij bota përbrenda do ti dukej e lehtë.

Pyetje: ***Kur bebat vdesin, a shkojnë në parasjë apo në ferr?***

"Kur zemra qanë për atë që ka humbur,
shpirti qeshë për atë që ka gjetur. "
(Thënie Sufiste)

Bava Muheijedin: Pyetje me vendë. A je ti Ajshja? Ajshja ra. ka qenë një grua e lartësuar në këtë botë, një evlia (e shenjtë) e lartësuar. Edhe ti duhet të bëhesh evlia në këtë botë, një grua shumë e mirë. Zoti do ta dhuronë atë ty.

Dashuria ime ju, mbesat e mia. Në qoftë se bebat e vogla vdesin apo në qoftë se fëmijët e rinjë vdesin para se ta arrijnë pubertetin, ato/ata bëhen hyrija (qenie qiellore). Deri tek mosha shtatë apo tetë vjeqare, në qoftë se mëkatet/gjynahet dhe të ligat e trashëguara dhe iluzioni i botës nuk i ka prekur ende, dhe në qoftë se mendimet e këqija nuk i kanë prekur ende, ata/ato shkojnë në parajsë/xhenetë. Kur fëmijët vdesin në atë gjendje, ata quhen hyrija. Ata i shërbejnë qenieve të parajsës dhe të gjithë njerëzve të mirë në parajsë, në botën e përtejme. Ata e kryejnë detyrën në këtë botë dhe gjithashtu edhe në parajsë. Këta janë ata që kanë vdekur në një gjendje të mirë. Ato janë kujdestare të parajsës, hyrija. Qoftë djemë apo vajza, ata do të jenë në atë gjendje. Eshtë një vdekje shumë e mirë.

Pyetje: ***Pse Zoti e krijoi djallin/dreqin/shejtanin?***

"Errësira nuk mund ta largon errësirën; vetëm drita mund ta bëjë atë. Urrejtja nuk mund ta largon urrejtjen; vetëm dashuria mund ta largon atë. Urrejtja shumëzon urrejtjen, dhuna shumëzon dhunën, ashpërsia e shumëzon ashpërsinë, në një zbritje spirale të shkatërrimit. Zingjiri e reaksionit të së keqes duhet të thyhet, përndryshe do të futemi në një humnerë të errët të shkatërrimit". (Luther King Jr.)

Bava r. : A e ke parë djallin? Jo, nuk e ke parë. Si, pra mund të pyesësh pse Zoti e krijoi djallin? Nuk e ke parë Zotin, dhe nuk e ke parë shejtanin. Ti ke dëgjuar për ta nga të tjerët. Shiko në këtë çështje me menqurinë tënde.

Ka dy lloje të kualiteteve në njeriun: e mira dhe e keqja. Kualitetet e mira janë kualitetet e Zotit. Kualitetet e këqija janë kualitetet e shejtanit. Në qoftë se ka dritë, nuk do të ketë errësirë. Ky kontrastë të lejon të kuptosh se si janë opozitat. Në qoftë se ka parajsë/xhennet, do të ketë edhe ferr/xhehnem gjithashtu. Në qoftë se ka mashkull do të ketë edhe femër.

Në të njëjtën mënyrë, shejtani është e kundërta e Zotit. Kështu që, në qoftë se i kemi kualitetet e shejtanit brenda nesh, atëherë kualitetet e pastërta të Zotit do të jenë aty gjithashtu, por dikund në ndonjë qoshë. Kualitetet e liga nuk mund ti bëjnë asgjë kualiteteve të Zotit. Ato do të sillen vërdallë përreth kualiteteve të Zotit, ashtu sikurse errësira që është përreth dritës.

Në kohën kur Ademi as. ishte duke u krijuar, shejtani erdhi dhe pështyu në atë formë të tokës. Ishte atëherë që ai u shndërrua në shejtan. Asgjë nuk është krijuar si shejtan. Ai në fillim ishte Ebu, udhëheqësi i xhindëve në botën e parajsës. Kur Ademi a. s. po krijohej, kualitetet e liga të xhelozisë i hynë Ebusë, dhe ishte ajo që e bëri atë të shndërrohet në shejtan. Ai tha, "Ti e krijove Ademin nga toka. Si, unë që jam krijuar nga zjarri, të qëndrojë prapa atij që është krijuar thjeshtë nga toka dhe ta adhurojë?

Zoti i tha, "Mos e adhuro atë. Më adhuro Mua. "

Shejtani tha, "Unë veq e di si të adhuroj Ty, O Zot. Por nuk kam nevojë të qëndrojë prapa tij dhe të adhuroj Ty. ”Ai tha shumë gjëra të tilla.

Mandej Zoti i tha, "O shejtan, shko! Mal'un (i mallkuar), nuk mund të rrish në këtë udhë. Shko!"

Kualitetet e këqija u bënë të njohura si shejtan/djallë/dreqë. Në qoftë se do të mund ti hedhësh ato kualitete, atëherë kualitetet e Zotit do të hynë në ty. Kur kjo të ndodhë, ti do të jeshë aroma e Tij. Zoti është Ai me bukuri perfekte. Si të bëhesh i bukur, Zoti do të jetë aroma. Kualitetet e Tija të bukura përmbajnë një aromë të ëmbël. Kualiteteve dhe veprimeve të këqija u vie era e keqe. Duhet ti transformosh ato kualitete të këqija.

Fëmiu im, nuk ka shejtan, por ka kualitete satanike/djallëzore. Jemi ne ata që e ndryshojmë vetë-veten në shejtan. Zoti na krijoi neve si shpirta të pastër në mënyrë perfekte. Kështu që, ky nuk është faji i Zotit. Ne jemi ata, vetë-vetja jonë, që e krijoi shejtanin/djallin. Ne jemi ata që e krijuam gjynahin/mëkatin dhe që e kërkojmë ferrin/xhehnemin. Por ne jemi gjithashtu ata që e kërkojnë të mirën.

A është e shkruar çdo gjë që ndodhë në jetën tonë?

Në historinë e Islamit ka shkolla të mendimit të ndryshëm. Janë Kederit dhe Xhebrit. Kederit thonë se njeriu është absolutikisht I lirë. Xhebrit thonë se njeriu është absolutikisht nën detyrim – ai nuk është I lirë në asnjë mënyrë. Sipas ehli Sunnetit dhe ehli-xhematit pozita e njeriut gjendet në mes të detyrimit dhe vullnetit.

Në Kuran ceken të dy konditat. Sa I përket lirisë:

Kushdo që dëshiron të bëhet besimtarë, është I lirë. Kushdo që dëshiron të bëhet pabesimtarë, lere le të bëhet ashtu, ai është I lirë. (K. 18:29)

Sa I përket detyrimit, ne na është thënë:

Lajmëroju atyre se c'fardo që na ndodhë ne në këtë botë është caktuar më parë nga Allahu. (K. 9:51)

Eshtë caktuar më parë. Ky është një problem në të cilin mendimtarët kanë ngecur. **Njeriu është moralisht I lirë por fizikishtë I detyruar**. Bota fizike është një botë e para-caktuar. Eshtë një botë e një zingjiri të shkaqeve (causal nexus), që do të thotë, një ndodhi e shkakton një tjetër ndodhi. E tërë bota fizike është një seri e shkaqeve dhe efekteve dhe në atë moment kur nga shkaku ne veprojmë, efekti gjithashtu do të ndodhë. Kështu që është një botë e detyrueshme. Të gjitha veprimet fizike ndodhin në këtë mënyrë, dhe asnjë qenie njerëzore nuk ka kontrollë në të.

Atëherë cka është liria?

Liria është liria e vullnetit, jo liria e veprimit. Eshtë liria e vullnetit që Allahu I Gjithëfuqishmi, me anë të vendimit të Vullnetit të Tij, I ka dhuruar qenies njerëzore. Kjo është e kufizuar vetëm tek fusha e vullnetit, dhe për këtë arsye Profeti I Shenjtë e ka cartësuar këtë punë kur ka thënë.

Vlera e veprimit qëndron tek motivi. Dhe secili person gjykohet sipas qëllimeve të tij.

Kur njëri të analizon cdo veprim pSiçikishtë në faktorët e elementeve të tyre, atëherë gjejmë tre faktorë në cdo veprim: **motivin, formën, dhe pasojat e veprimit**. Shumë lehtë mund ta dallojmë motivin. Për shembull personi "**A**"e nget veturën, e godet një kalimtar dhe ai person vdes. Një tjetër person "**B**"nget veturën, e godet një kalimtar, dhe ky person gjithashtu vdes. Forma e veprimit dhe pasojat e të dyja veprimeve janë të njëjta, por cka mund të themi për motivin? Motivi I personit "A"mund të mos kishte qenë për ta vrarë personin, dhe ishte vetëm një aksident. Motivi I personit "B"mund të ketë qenë që qëllimisht ta vrasë atë njeri në atë mënyrë që ai mund të përfitojë nga dyshimi dhe ti ikën persekutimit.

Motivet (*nijehs*) janë të ndryshme, prandaj, vlera e veprimit qëndron tek motivi e jo tek pasojat, kështu që në atë c'farë qenia e njeriut do të japë llogari është motivi apo qëllimi. Eshtë motivi që do të peshohet në Balancë, jo veprimi. Në këtë motivim, disi, Allahu e din më së miri se si ai mekanizëm të mbahet por është e cartë se qenies njerëzore I është dhuruar liria.

Në qoftë se nuk e pranojmë këtë mendim, atëherë Allahu na del të jetë më I padrejti dhe qenie arbitrare në të cilin ne besojmë. Në qoftë se Ai nuk më ka dhuruar mua liri, atëherë c'farë të drejte ka Ai që ne ti japim llogari. Në qoftë se cdo gjë bëhet nga Ai dhe në qoftë se motivi gjithashtu I takon Atij atëherë unë jam vetëm një vegël. Si është e mundur që vegla të jap

llogari për veprimet e saj? Prandaj ne besojmë në këtë liri, që është e kufizuar tek vullneti.

Le të shikojmë edhe nga aspekti tjetër – që është bukuria e Islamit. Në qoftë se cdo gjë që do të ndodhë në jetën time është paracaktuar, atëherë përpjekjet nga ana ime që të qoj një jetë të drejtë nuk do të ma ndryshojnë fatin tim këtu në tokë. Në këtë pikë qenia njerëzore është e shqetësuar. Ai dëshiron të mirat në këtë botë së pari, prandaj Kurani I shenjtë na mëson. Ne jemi mësuar që të lutemi:

O Zot, dhurona të mira në këtë jetë dhe jetën tjetër… (K. 2:21)

Si mund ta arrijmë këtë? Gjithashtu, ka një dëshirë të intensifikuar në njeriun që ti ikën dështimeve dhe të arrinë sukses, ti ikën dhimbjes dhe të arrin kënaqësi. Ajo është natyra njerëzore. Në c'farë mënyre Islami e përmbush këtë konditë të natyrës njerëzore? Filozofi I madhë Musliman Imam el-Gazaliu (ra) dhe dijetari Shah Veliullah (ra) e kanë cekur një teori të funkcionimit të botës që quhet "*përsëritja e formave*".

Për shembull, të marrim një ngjarje që veq ka ndodhur në historinë e këtij universi, shumë herë dhe në nivele të panumërta. Nuk po ndodhë këtu për të parën herë. Për ta shpjeguar më tutje, kur një person të ëndërron për një ngjarje, dhe kur ajo ngjarje të ndodhë njëmend në jetën aktuale, pesë vite më vonë – atëherë cka ka parë ai person? Imagjinoje – një ngjarje që nuk ka ndodhur ende është një gjë jo-ekzistuese. Mbaje mend, ëndrrat e vërteta janë fakt I jetës. Një numër I njerëzve I kanë përjetuar. Cka është që personi sheh në një ëndërr të vërtetë? Ai e vështron nga "distanca"e pesë viteve nga koha e ngjarjes në një dimension të stacionit të përkohshëm përjetues. Ajo është cka quhet, *texhedul el-emthel.*

Mundohu ta kuptosh në këtë mënyrë. Të gjitha ngjarjet që do të ndodhin janë të para-caktuara dhe ato po ndodhin në nivele të ndryshme të ekzistencës. Kur ato ngjarje arrijnë në këtë nivel të këtij stacioni të përkohshëm dimensional, atëherë ne i përjetojmë të ndodhin në nivelin fizikë. Sendi kryesorë që duhet kuptuar është se nuk është një ngjarje, por një përjetim nga ajo ngjarje, dhe është përjetimi që llogaritet. Ai nuk është I interesuar në formën e ngjarjes, por në përjetim, sepse njeriu është një krijesë përjetuese dhe ai jeton në një botë të përjetimeve. Përjetimet janë ato që e bëjnë atë të pikëlluar apo të lumtur, të kënaqur apo të zemëruar. Patjetër se duhet të ketë stimulime të tipeve të ndryshme – fizike apo pSiçike. Ato ngjarje, që do të ndodhin në përjetimin e njeriut, ndodhin kur ne jemi zgjuar dhe gjithashtu ndodhin kur ne jemi në gjumë, në ëndërr. Kur njëri e sheh një ngjarje në ëndërr - dicka mirë ose keq – emocionalisht, I len një ndikim. Ashtu që ndikimi I atij përjetimi është aty; por pasojat materiale nuk janë aty.

Tani Islami thotë se ti mund ta ndryshosh fatin tënd dhe Allahu xh. sh. nuk është skllavë tek ajo që Ai e ka caktuar. Islami nuk beson në atë që Hinduizmi dhe Budizmi besojnë. Hinduizmi thotë se Brahma apo Vishnu

është skllavë I Karmës. Personi nuk mund ta ndryshon. Kurani I shenjtë thotë:

Allahu mund të fshijë cdo gjë që ka buruar nga Tableta sepse Ai është zotërues I *umm el-kiteb*.

Ai mund të pranojë dhe fshijë cdo gjë. Ai nuk është skllavë I Ligjit; Ai është Krijues I Ligjit dhe ka urtësi dhe fuqi infinite. Cka kërkohet nga ne është ti pastrojmë motivet tona. *Tezkijeh*, qëllimi I Islamit, pastrimi I motivit. Në qoftë se motivi (*nijeh*) është I pastërt atëherë veprimet, mendimet dhe puna jote do të jenë të pastërta. Islami kërkon pastrim në motiv që është I lidhur me vullnetin, dhe në vullnet na është dhënë liria. Prandaj, bëje qëllim (*tezkijeh*) pastrimin e motivit tënd dhe mandej gjërat e këqia që do të duhej të të ndodhin ty do të transformohen në ëndërra. Edhe pse është shkruar më parë që të të ndodhin, do të manifestohen vetëm si gjendje mentale, e jo realitete fizike.

Allah xh. sh. është *dhul-fedhil azim* (K. 57:21). Ai jep më shumë se që ne meritojmë, ashtu që përpjekjet tona për pastrimin tonë do të bëjnë fruta në anën pozitive. C'fardo e mirë që do të vijë tek ne në skenarin universal të gjërave, I Gjithëfuqishmi Allah xh. sh. mund ti shtojë cdo gjë asaj, sepse Ai është Krijuesi dhe Burimi I cdo gjëje. Atributi I Tij realë është *Rabb*. Në Suren *el-Fatihah*, Ai është pesë herë dhurues I mëshirës dhe mirësisë, dhe vetëm atëherë Ai do ta bëjë llogarinë. Dhe kur e bënë llogarinë, Ai thotë: *Mëshira ime përfshinë secilin send* – (këtu në këtë botë dhe ditën e Gjykimit.) (Kur'an 7:156)

Eshtë atributi I Mëshirës së Allahut që transformon edhe sendin më të keq në send të mirë në jetën e njërit dhe I sjell jetës së njeriut sukses. **Qenia njerëzore mund të bëhet zotëruese e fatit të vet** – edhe pse në fakt kjo botë është e detyrueshme. Duke ushtruar lirinë e vullnetit të tij ai mund ta pastron vullnetin e tij (kjo është cka duhet të bëjmë) dhe për të tjerat do të kujdeset Allahu, I Gjithëfuqishmi.

9. Sufizmi në syrin e njeriut modern

Panairi i librit Tirana 2010 solli në vëmendje të publikut ndër të tjerë edhe dy libra mjaft të çmueshëm për kujtesën shqiptare. I pari "Çfarë është sufizmi?"me autor Martin Lings dhe i dyti "Doktrina sufiste e Rumiut"me autor William C. Chittick, përkthyer me dashuri e devocion prej Edin Q. Lohjes dhe botuar nga shtëpia botuese Tradita.

Autorët e tyre janë njëri anglez e tjetri amerikan, profesorë të nderuar dhe trajtesat e tyre kanë një natyrë të stilit analitik, mirëfilli shkencore - nën mbikëqyrjen e një profesori tjetër edhe më të shquar e njohës i drejtpërdrejtë i Islamit, profesor Nasr. Kjo na jep një panoramë të asaj se jo vetëm marrim vesh se çka është doktrina sufiste brenda universit të islamit por edhe se si kjo çështje prezantohet në publikun perëndimor përgjithësisht të krishterë. Spekulimet mediatike e politike pushojnë së ekzistuari - të paktën sa gjendesh përmbi libër - dhe rilidhen edhe një herë urat e fshehta e të hershme mes Lindjes dhe Perëndimit.

Sufizmi në fakt është një rrymë që ka bërë përpjekje të mëdha për njohjen dhe përhapjen e islamit jashtë botës arabe, sepse ky ishte edhe qëllimi i tij qysh kur lindi. Ideja e njeriut universal një ide që mbetet sigurisht në figurën e profetit Muhamet, na bën jo vetëm të mendojmë se fati i njeriut në botë pavarësisht besimit të tij është universal e i njëjtë, por edhe se idetë e islamit po ashtu si të të gjithë besimeve të tjera janë universale, pra një pasuri botërore që i përket njerëzimit.

Uniteti në këtë rast vjen pikërisht prej ngjashmërisë së natyrës njerëzore dhe jo prej llojit të besimit të saj. Shqiptarët më mirë se kushdo duke jetuar në një mikromjedis të përzier besimesh, kanë dhënë shembullin e tyre modest por të ndritshëm pikërisht të kësaj teze universaliste, e këtë e kanë bërë krejt thjesht duke jetuar bashkë në paqe.

Ndryshe nga sa mendon shumica, njerëzimi është nji i vetëm edhe pse i ndarë në shumë parcela besimesh e kombesh, mikrokozmosi dhe makrokozmosi bashkohen pikërisht te natyra e njeriut, te origjina e tij që është e lidhur pikërisht me Krijuesin. Edhe pse shpesh në emër të Zotit janë bërë krime pa fund, kjo nuk fajëson Krijuesin, por konvencionin njerëzor mbi të. Sërish është njeriu që gabon, pikërisht sepse edhe pse me emrin e krijuesit në gojë mu atëherë gjasat për t'iu larguar rrugës së tij janë shpesh të mëdhaja. Në sufizëm përdorimi i emrit të Zotit si një flamur lufte resht së ekzistuari, lufta, pra xhihadi i madh është një luftë e njeriut me nefsin e tij, me egon. Ky mesazh i shpërndarë me kujdes çuditërisht në të gjitha besimet qoftë edhe ato pagane, humbet në botën reale pikërisht se njeriu don ta përdorë fuqinë për të zaptuar e jo për t'u çliruar. Kështu forca kthehet në dobësi. Këtu qëndron edhe ajo që sufistët e cilësojnë si ana e fshehtë e botës, ajo që nuk duket jashtë në pamje të parë e që është përtej realitetit si një realitet që në fakt është i vetmi realitet.

Shpesh ndodh me popujt që janë të zhytur në besim por zemrën e kanë të paprekur prej besimit. Fatkeqësisht. Besimi nuk është një procedurë për të larë duart nga mëkatet e së përditshmes, por për të larë zemrën në mënyrë që ajo të bashkohet me Krijuesin. Zoti nuk do të shohë as fjalët e as veprat, por zemrat tuaja. Hapini zemrat dhe aty do të gjeni Zotin, sepse zemra i përket Zotit.

Sufizmi edhe pse siç autorët sqarojnë është parë shpesh nga perëndimorët si poezi e spektakël vallesh, në fakt është një ngjitje vertikale e ndërgjegjshme dhe e vullnetshme në majat më të larta të idesë mbi unitetin e Zotit me njeriun. Meditimi sufist është i kulluar, një udhë e paqtë dhe e pakompromis drejt së vërtetës mistike, ai ka sivëllezërit e vet sigurisht në të gjitha besimet e tjera, që gjithashtu shpesh kanë arritur të njëjtat maja edhe pse me rrugë të tjera. Kjo sepse rrugët e Zotit janë të pafundme, emrat nuk kanë rëndësi. Ashtu siç në libër thuhet kur sufizmi ekzistonte si thelb ai nuk kishte emër, kur iu vu emri nuk ishte më si thelb. Gjithsesi kur mbërrihen majat ka rëndësi vetëm thelbi, pra idetë e përftuara që sufizmi ka hapur si shtigje nëpërmjet udhës islame.

Muhameti, Imam Aliu, Ibn Arbaiu, Mensur Hallaxhi, Haxhi Bektashi, Xhelaludin Rumiu, etj. , pa të cilët bota do të ishte e mangët, ashtu si bota do të qe e metë pa Jezu Krishtin, Mojsiun, Zarathustrën, Solomonin, Shivën, Shën Françeskun, Budën, Konfucin etj.. Mënyra se si këta njerëz e kanë parë e udhëzuar natyrën njerëzore dhe njeriun është universale pikërisht se kanë arritur të përcjellin në botën e rrëzuar, dritën e pastër të amës zanafillore, të vetë Krijuesit.

Në pikëpamje të së përditshmes vlen të theksohet se Lindja me Perëndimin ndahen jo shumë prej besimit se sa nga pozicioni që kanë gratë në shoqëri. Ndërsa Perëndimi ka mbërritur hapa të rëndësishëm në trajtimin e gruas barabar me burrin, thellë-thellë vuan ende nga prostitucioni, shumë gra shesin seksin rrugëve dhe e vetmja mënyrë për të jetuar është shuarja e urisë seksuale të burrave, nga ana tjetër në Lindje gratë janë ende pronë e burrave dhe barazia shoqërore shihet utopi perëndimore. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për një fushatë emancipimi, por për një shkëputje nga ideja e barazimit të pabarazisë shoqërore me pabarazinë gjinore. Sigurisht që burri e gruaja janë të ndryshëm përballë njëri-tjetrit, por janë barabar para Krijuesit e duhet të jenë të tillë edhe para ligjit e në jetën e përditshme. Nëse në pikëpamje doktrinale Lindja dhe Perëndimi mund të bashkohen kollaj, sa i përket trajtimit të grave për të dyja palët ka ende shumë punë për t'u bërë.

Besimet në këtë rast nuk japin përgjigje, ose ndoshta e ka dhënë qysh në fillim: njerëzimi ndahet në burra dhe gra, njëkohësisht njerëzimi nuk ndahet sepse është një i vetëm i krijuar me dashuri e i lënë i lirë nga Krijuesi për të zgjedhur rrugën që i përshtatet mirëqenies së vet.

10. Vjershërime Sufiste

O Zot!
Bie në gjumë, zgjohem, jetoj dhe vdes përmes Teje
Dhe tek Ti është tubimi final.
Bie në gjumë dhe mbrëmja erdhi
Me Dominimin që I takon Zotit.
I gjithë falënderimi është për shkak të Zotit,
Nuk ka ndonjë partner me Të,
Nuk ka asnjë që meriton me të drejtë të adhurohet përveç Atij,
Dhe tek Ai është tubimi final.
(Muhamedi a. s.)

***

Jeto në këtë botë
sikur të ishe një udhëtarë, një kalimtarë,
me rrobat dhe këpucët plot pluhur.
Ndonjëherë i ulur nën hijen e pemës,
ndonjëherë duke ecur nëpër shkretëtirë.
Jeto gjithnjë si kalimtarë,
sepse kjo botë nuk është shtëpia jonë.
(Hadith)

Nisu ngadalë në udhëtimin tënd

Para se të përfundoja në këtë burgë të botës,
Isha me Ty përherë.
Ah sa do të dëshiroja që kurrë të mos kisha rënë
Në këtë grackë të botës.

Saherë e saherë unë të thoja Ty:
"Unë jam mjaftë I lumtur këtu.
Nuk dua të shkoj askund.
Të udhëtosh nga kjo lartësi poshtë në tokë
Thjeshtë, është udhëtim shumë I vështirë"

Prapë se prapë Ti më dërgove:
"Shko, mos u frikëso.
Asgjë e keqe nuk do të ndodhë ty.
Unë gjithmonë do të jem me ty. "

Ti ma mbushe mendjen duke më thënë:
"Në qoftë se shkon, do të fitosh përjetime të reja.
Do të përparosh në udhëtimin tënd.
Do të bëhesh shumë më I pjekur
Kur të kthehesh prapa në shtëpi. "

Unë ia ktheva: "O Esenca e Njohurisë,
Ç'farë të mire ka I gjithë ky mësim dhe informim
Pa Ty?
Cili do të linte Ty për njohurinë,
Veq në qoftë se ai nuk do të kishte njohuri për ty?"

Kur pi venë nga dora jote,
Nuk kamë asnjë brengë në botë.
Bëhem I dehur dhe I lumtur.
Nuk mërzitem aspak për fitim apo humbje,
Apo për cilësitë e mira e të këqija të njerëzve.

Sulltani më pështpëriti disa fjalë në veshin tim.
Ishin sikur fjalët e banditëve
Dhe më lanë të habitur dhe jashtë kontrolle.

Ky është një tregim I gjatë për "mashtrimet"e Tij.
Në qoftë se me të vërtetë Ai dëshiron të ma bëj një të mirë,
Ta lejon një agim të hershëm ta mbarojë këtë natë të errët.
(Rumi r. a.)

***

Eventualisht kur mallëngjimi ynë rritet në një thellësi të mjaftueshme,
na sjell në prezencën e intelegjencës kulluese që ka
për detyrë të rigjej Thesarin e Fshehur, "të vërtetën e thellë
brenda në gënjeshtër. "Ky është këshillëdhënësi ynë i
brendshëm, i Shenjti. Mendja jonë e shkapërderdhur dhe
dëshirat e paplotësuara rrezistojnë, por natyra e
Këshillëdhënësit është një dashuri që nuk mund të rrezistohet.
Pse mos të bëhesh i fresket nga butësia e zemrës së pranverës?
Pse mos të buzëqeshësh si një trëndafil?
Pse mos të shpërndash aromë?

Në veprimin suprem të njeriut duke iu nënshtruar
Këshillëdhënësit, puna e lirimit fillon.
Përderisa dinamika e ndarjes së impulseve
të elementeve tona kuptohet,
nevoja të bëhesh Vetëvete e unifikuar
bëhet një obligim që shpërndahet në
jetën tonë.

Zgjuarsia e lindur nga natyra
fillon ta pastrojë zemrën
nga papastërtitë në mënyrë që shkëlqimi
madhështor i Nurit të Muhamedit a. s.
të shkëlqejë përpara.
Në prezencën e një parimi më të lartë
organizues të dritës,
elementet bëhen krijuese të metriksit të jetës.
(Bawa M. r. a.)

***

Kënga e Fyellit

Dëgjo fyellin dhe këngën që po e këndon,
Po vajton për ndarjen:

Prej se më shkëputën nga shtrati I fyellit
Klithjet e mia I kanë vënë meshkujt dhe femrat në vaj.

E dua një zemër të shqyer hapur me përmallim
Ta ndaj dhimbjen e kësaj dashurie.

Kushdo që është ndarë nga burimi I tij
Vuan që të kthehet në atë gjendje bashkimi.

Në çdo mbledhi e shpreh dëshpërimin tim.
Unë jam shok edhe I gëzimit edhe I pikëllimit.

Të dy më shoqëruan mua për arsyet e tyre,
Po asnjëri nuk I kërkoi sekretet që unë I mbaj.

Sekreti im nuk është ndryshe nga vuajtja ime
Por kjo nuk është për shqisat që ta perceptojnë.

Trupi nuk është I fshehur nga shpirti
E as shpirti nuk është I fshehur nga trupi
Por shpirti nuk është për çdonjërin që ta sheh.

Fyllit I be me zjarr, jo me erë
Dhe pa këtë zjarr ti nuk do të ekzistoje.

Eshtë zjarri I dashurisë që e inspiron fyellin.
Eshtë eksitimi I dashurisë që e kompleton venën.

Fyelli sjell rehati tek të gjithë dashuruesit e huaj.
Muzika e tij I shqyen perdet andej. A ke parë
Ndonjëherë helm apo antidotë sikur fyellin?
A ke parë ndonjëherë shoqërues dhe dashurues më intim?

Këndon për udhën e gjakut;
E tregon pasionin e Mangjunit.

Vetëm atyre pa ndjenja shqisat u janë zënë rob.
A ka gjuha ndonjë zot përveq veshit?

Ditët tona po plaken çdo herë e më shumë në pa sezona,
Këto ditë që përzihen me dhimbje e pikëllim...

Por në qoftë se nuk kanë mbetur edhe shumë ditë,
Leri le të ikin; nuk ka rëndësi. Por Ti,
Ti mbetesh,
Se asgjë nuk është më e dëlirë se Ti.

Të gjithë përveq peshqëve shpejt marrin hise nga
Uji I Tij;
Dhe dita është e gjatë pa bukën e Tij të
Përditshme.

Të papjekurit nuk e kuptojnë gjendjen e të pjekurve
Prandaj po I bie shkurt.

Thyej zingjirët, bëhu I lirë, fëmiu im!
Edhe për sa kohë argjenti dhe ari do të robërojnë?

Në qoftë se e mbush të gjithë detin në një kënatë
A do ta mbante më shumë se një ditë e shitores?

Syri lakmiqar, sikurse kënata, kurr nuk mbushet.
Derisa e kënaqur, guaska nuk mban margaritarë.

Vetëm ai që është zhveshur nga Dashuria
Është I lirë nga defekti dhe dëshira.

O Lumturi, O Dashuri, partneri ynë në shkëmbim,
Shëruesi I të gjitha sëmundjeve tona, Plato dhe Galeni ynë,
Ilaqi I mendjemadhësisë dhe zbrazësirës sonë.

Me dashuri ky trup I tokës mund të lundrojë
Në ajër;
Bjeshkët mund të ngriten dhe të vallëzojnë me lehtësi.

Dashuria I dha jetë Malit Sinai, O dashurues.
Sinai ishte pirë. Musa e humbi vetëdijen.
I shtypur tek buzët e njërit në harmoni me
Veten time,
Po mund edhe të them krejt çka është për të thënë;
Por pa një gjuhë të përbashkët, Unë jam budalla,
Edhe në qoftë se kam njëqind këngë për të kënduar.

Kur trëndafili nuk është më dhe kopshti është mjegulluar,
Më nuk do ta dëgjosh këngën e bilbilit.

I Dashuri është e tëra; dashuruesi vetëm perde.
I Dashuri jeton; dashuruesi send I vdekur.

Po qe se dashuria është e shtypur nga kujdesja e saj e fortë
Dashuruesi mbetet sikur një zog pa krahë

Si do të zgjohem dhe të vetëdijësohem
Në qoftë se drita e Dashuruesit mungon?
Dashuria dëshiron që kjo fjalë të dalë jashtë.

Në qoftë se pasqyra e zemres tënde është pa interes,
Ndryshku nuk është hequr nga fytyra.

O shokët e mi, dëgjoni këto fjalë,
Esenca e gjendjes së brendshme.
(**Xhelaledin Rumi**)

***

Pash se shpirti im i kishte lindur hyjnores. Nuk shikonte në asgjë dhe pa interesë, edhe pse Parajsa dhe Ferri i ishin shfaqur, sepse ishte liruar nga fenomeni i perdeve.

Mandej u bëra zog, që e kishte trupin e Njëshmërisë dhe që krahët i kishte nga e Përhershmja, dhe vazhdova të fluturojë në ajrin e Absolutit, derisa kalova në sferën e Pastrimit, dhe shikova në fushën e Përjetësisë dhe e përjetova aty pemën e Njëshmërisë.

Kur shikova, unë vetë isha të gjitha ato. Thirra O Zot, me egoizmin tim nuk mund të të arrijë Ty, dhe nuk mund të ikë nga vetë-vetja ime. Çka duhet të bëj?

O Ebu Jezid, ti duhet të fitosh lirim nga vetë-vetja jote duke e përcjellur të Dashurin tim (Muhamedin a. s.). Fshijë sytë e tu me pluhurin e këmbëve të tij dhe përcillle atë vazhdimishtë?
(Bistami r. a.)

***

Porosi nga Rumi:

Përmallimi

Dimri bie në ne
që pranvera të sjell një lindje të re.

Qaj lotët!
Lejo përmallimin!
Mallëngjimi sjell dorëzimin
dhe nga thellë një dëshirë të bëhesh i Lirë

***

A nuk të kam thënë?

A nuk të thashë, "Mos shko atje; Unë jam shoku yt.
Në këtë mirazh të ekzistencës, Unë jamë burimi I
Jetës. "
Edhe në qoftë se zemërimi të dërgonë
Njëqind mijë vite largë,
Në fund do të kthehesh, sepse Unë jamë caku yt.
A nuk të thashë, "Mos u kënaq me
Trajtat e tokës;
Unë jam dizajneri I dhomës intime që
Të sjell kënaqësinë tënde. "

A nuk të thashë, "Unë jamë deti, dhe ti je një peshk
I vetëm.
Mos rri në tokë të thatë; Unë jamë deti yt
I dëlirë. "

A nuk të thashë, "Mos bie
Në kurthë, si një zogë I pandihmuar;
Unë jamë fuqia e fluturimit – këmbët dhe
Krahët e tu. "

A nuk të thashë, "Ata do të zbrapsin dhe
Do të bëjnë të ftohtë;
Unë jam zjarri yt dhe dëshira e ngrohtë"

A nuk të thashë, "Ata do ti mbjellin kualitetet e
Tyre në ty

Derisa ti të harrosh se kualitetet më të mira janë këtu. "

A nuk të thashë, "Ti nuk e din nga
Cili drejtim
Punët e tua janë renditur. "
Unë jamë Krijuesi përtej drejtimeve.
Në qoftë se drita është në zemrën tënde,
gjej udhën për në shtëpi.
Në qoftë se je nga Zoti, njihe Mbështetësin tënd.

***

Shto nevojën

Shpirti i miut nuk është asgjë më shumë se një grimcues.
Miut i është dhënë një mendje
në proporcion me nevojat e tij
sepse pa nevojë, i Gjithë-Fuqishmi
nuk i jep kujtë asgjë.
Nevoja, pra, është rrjeti për të gjitha gjërat që ekzistojnë:
Një person ka mjete në proporcion me nevojën e tij.
Prandaj, shpejt, shto nevojën tënde, o nevojtarë,
që deti e bollëkut
të ngre dallgë në butësi-dashurie.
(Mathnawi II, 3279-80; 3292)

***

Afrohu

Me c'fardo që dëshiron të martohesh,
Shko, mbushe veten me atë e dashur,
Merr formën dhe kualitetet e tij.

Në qoftë se dëshiron dritën, përgadite veten
ta marrësh atë; po të dëshirosh të jesh larg nga Zoti,
ushqeje egoizmin tënd dhe largohu.

Po deshirove të gjesh një rrugë jashtë
nga ky burg I rrënuar,
mos kthe koken larg nga Ai që të do,
por përkulu me adhurim dhe afrohu.
(Mathnawi I, 3605-07)

***

Krahët e Dëshirave

Njerëzit janë hutuar nga objektet e dëshirave,
dhe mandej pendohen nga epshet në të cilat
e kanë zhytur vetë-veten,
sepse jane dhënë pas një fantomi
dhe janë larguar edhe më larg Realitetit
se sa qe ishin më parë.

Dëshira jote për një iluzion është nje krah
me anë të të cilit kërkuesi mund të ngritet
Tek Realiteti.

Kur je dhënë mbas një epshi, krahu yt
bie;
Bëhesh I caluar dhe ajo fantazi të ikën.
Ruaje krahun dhe mos u jep pas këtyre epsheve,
në mënyrë qe krahu I dëshirës të të bart
gjer në Parajsë.

Njerëzit imagjinojnë se po e kënaqin vetë-veten,
por në fakt po I thyejnë krahët e tyre
për hir të një iluzioni.
(Mathnavi III, 2133-38)

***

Si e ke shpenzuar jetën

Në Ditën e Ringjalljes Zoti do të pyet,
Gjatë kësaj kohe që të dhashë,
Cka ke prodhuar për Mua?

Me c'farë pune e ke arritur
Fundin e jetës tënde?

Për c'farë qëllimi buka
Dhe fuqia jote janë konsumuar?

Ku e ke shpenzuar shikimin në sytë e tu?
Ku I ke harxhuar të pesë shqisat?

Ti e ke shpenzuar, shikimin, dëgjimin,
Intelektin
Dhe substancat e dëlira hyjnore;
C'farë ke blerë nga toka?

Të kam dhuruar duar dhe këmbë si lopatë dhe shatë,
Për të prashitur dheun e punëve të mira;
Kur u bënë ato vetë ekzistente?
(Mathnawi III, 2149-53)

***

Esenca e të gjitha shkencave

Në qoftë se e njeh vlerën e cdo artikulli të
mallrave,
por nuk e njeh vlerën e shpirtit tënd,
I tërë mundi mund të jetë I kotë.
Ti arrite të njohësh yjet fatëmir dhe
ata fatëkeq,
por për vete se di në
je me fatë apo pa fatë.
Kjo, kjo është esenca e të gjitha shkencave –
qe të kuptosh se kush do të jesh
kur Dita e Llogarisë të arrijë.

***

Libri nuk është jastëk

Nuk I kam krijuar xhindët dhe njeriun
për asgjë tjetër vetëm që të më adhurojnë Mua.

Objektivi finalë I kesaj bote nuk është
asgjë më shumë se adhurimi hyjnorë.
Edhe pse objektivi kryesorë I librit
është njohuria të cilen e përmban
mund ta përdoresh edhe si jastëk që të pushosh në të;
të shërben edhe për atë punë, gjithashtu.
Por që të jetë jastëk, nuk ka qenë qëllimi I vërtetë.
Ne të vërtetë ishte destinuar për të mësuar,
dhe për njohuri
si dhe dobitë që burojnë nga këto.
***

Rrobat

Kur njëri është shumë i preokupuar me diçka,
Ai është i pavetëdijshëm për dhimbjen në atë moment.
E përmend këtë pandjeshmëri ndaj dhimbjes
Që ta dish se si
Trupi I përngjanë rrobave.
Shko kërkoje atë që ka veshur rrobat;
Mos e puthë një copë të rrobës.
(Mathnawi III, 1610)

***

Pse po e mjelë tjetrin

Zhvishe veshjen e krenarisë nga trupi yt:
në mësim, vish rrobat e përuljes.
Shpirti e merr nga shpirti njohurinë
e përuljes,
jo nga librat apo fjalimet.

Edhe pse misteriet e përuljes shpirtërore
janë brenda në zemrën e kërkuesit,
ajo ende nuk posedon njohurinë e këtyre
misterieve.
Lere le të pret derisa zemra e saj të zgjerohet dhe mbushet
me Dritë:
Zoti tha: "A nuk e zgjeruam zemrën tënde... ? **(K. 94:1)**
sepse kemi vënë iluminim aty,
Ne e kemi vënë zgjerimin në zemrën tënde. "
Kur je një burim i qumështit,
përse po e mjelë një tjetër?

Një fontanë e pafund e qumështit gjendet brenda në ty:
Pse po kërkon qumësht me enë?
Ti je një liqe me një kanal që shkon në detë:
bëhu i turpshëm të kërkosh ujë nga liqeni;
se a nuk ua zgjeruam ne gjoksin tuaj... ?
Prapë, a nuk e zotëron zgjerimin?
Pse endesh andej sikur një lypës?
Kuptoje zgjerimin e zemrës
brenda në ty,
që të mos pyetesh me fjalt,
A nuk sheh? **(K. 51:21)**

***

Rubin

Në çajin e mëngjezit i dashuri e pyet të dashurën,
"Kë e do më shumë, veten apo mua?"

"Që nga koka e deri në fund të këmbëve unë jam bërë ti.
Asgjë nuk mbeti nga unë, pos emrit.
Tu plotsua dëshira. Vetëm ti ekziston.
Unë u zhduka sikur një pikë e uthullës
në oqeanin e mjaltës. "

Një gurë që u bë rubin
është mbushur me kualitetet e diellit.
Asnjë pikë gurëzimi nuk mbeti aty.
Në qoftë se e don vetë-veten, e donë diellin.
Dhe në qoftë se don diellin, e don vetë-veten.
Nuk ka ndryshim në mes të këtyre dy dashurive.

Para se guri të bëhet rubin, është armiku
i vetë-vetes.
Jo një por dy ekzistojnë.
Guri është i errët dhe i verbër ndaj dritës se ditës.
Në qoftë se don vetëveten, është tradhtarë:
me intensitet e reziston diellin.
Në qoftë se thotë "Unë, "është krejt errësirë.
Faraoni shpall veten hyjnorë dhe shkatërrohet.
Hallaxhi e thotë të njëjtën dhe shpëtohet.
Njëra Unë mallkohet, tjetra bekohet.
Njëra Unë është guri, tjetra kristal.
Njëra armik i dritës, tjetra reflektim i saj.
Në konshiencën më të thellësishme,
jo përmes ndonjë doktrine,
është një me dritën.

Puno në kualitetet e tua të gurit
dhe bëhu i shëndritshëm si një rubin.
Praktiko refuzim-vetes dhe prano vështirësitë.
Gjithmonë shiko jetën infinite kur e len veten të vdesësh.
Gurëzimi yt do të zvogëlohet:
Natyra jote e rubinit do të rritet.
Shenjat e vetë-ekzistencës do ta lëshojnë trupin,
dhe ekstaza do të dominojë.

Bëhu i tëri dëgjim sikur një vesh dhe fito një
vathë rubini.
Gërmo një bunarë në tokën e këtij trupi,
madje edhe para se bunari të gropohet,
lere Zotin ta sjell ujin lartë.

Rri gjithnjë në punë duke gërryer baltën
nga bunari.

Tek të gjithë që vuajnë,
këmbëngulja sjell pasurinë.
Profeti ka thënë qe secila sexhde e
faljes së namazit
është një trokitje në derën e parajsës.
Kur ndonjëri vazhdimishtë troket,
lumturia gjithnjë e shfaqë fytyrën e buzëqeshur.

Jetoja në buzë të
ç'mendurisë
Duke kërkuar arsyet
Trokitja në derë.
U hap.
Po Trokitja për nga Brenda
(Rumi r. a.)

***

Uniteti i Qenies së Zotit

"Nga Zoti është, prandaj dëgjo!
Dhe tek Zoti do të kthehesh!
Kur të dëgjosh ç'farë kam sjellur,
Mëso!
Mandej me kuptim shiko detajet në tërësi
Dhe gjithashtu shikoj ato si pjesë të tërësisë.
Mandej tua japësh atyre
Që e kërkojnë, dhe mos hezito.
Kjo është mëshira që
Të përqafonë dhe ty; prandaj përcille. "
(Ibn Arabiu r. a.)
***

Të gjitha fetë,
I gjithë ky këndim,
Janë vetëm një këngë.

Dallimet janë vetëm
Iluzion dhe zbrazëtirë

Drita e diellit duket pak më ndryshe
Në këtë murë sesa në këtë tjetrin,
Dhe shumë më ndryshe në këtë tjetrin,
Por prap është vetëm një dritë.

Ne kemi huazuar këto rroba,
Këtë kohë dhe vend personalitetesh,
Nga një dritë, dhe kur ne falënderojmë,
I fusim brenda ato.
(Rumir. a.)

***

Brenda në zemrën tënde
Gjendet një vend I mëshirës
Dhe qiejve të kaltërt
Destinacion I paprekur e I shpëtuar
Vend I fshehjes për ty

Eshtë në dorën tënde
ke kontroll
për këtë vend të përjetshëm
një udhe për te krenaria dhe dinjiteti
Elezi hyjnorë

Brenda në zemrën tënde
Gjendet një vend I mëshirës
Dhe qiejve të kaltërt
Destinacion I paprekur e I shpëtuar
Vend I fshehjes për ty

Eshtë në dorën tënde
Mos e le të të bie
Eshtë si një pejsazh sekret
Mjaft I sigurtë dhe I pafund
Elezi hyjnorë.
(Keltike)

***

Kërkoj strehim tek Zoti
Nga errësira e djallit
Në emër të Zotit
Të GjithëMëshirshmit, MëshirëPlotit
Thuaj: Ai, Zoti është Unike, Një (Ahad)
Allahu është Mbështetja dhe Strehimi Universal (Samed)
Ai nuk Lind kë, as nuk është i Lindur
Dhe nuk ka asnjë sikur Ai
Të lutem ty, përmes misteries me të cilën
Ti i bashkon të kundërtat, që Ti të bashkosh
për mua atë që nuk është e bashkuar me qenien
time, në një bashkim që Ti më shkakton
të dëshmojë Njëshmërinë e Qenies Tënde.
Më investo në rrobat e Tua të bukura,
dhe më kurorëzo me Madhërinë Tënde.
(Ibn Arabiu)

***

Një kopsht në mes të flakëve

Oh Ç'mbrekulli!
Një kopsht në mes të flakëve!
Zemra ime u bë e aftë të marrë ç'fardo trajte:
U bë një livadhë për gazella,
Dhe një mbledhi e murgjëve të Krishterë,
Dhe një tempull I idoleve, dhe një udhëtim për në Qabe,
Dhe pllakat e Tevratit, dhe libra e Kur'anit.
Unë e përcjell fenë e Dashurisë:
Ç'fardo rruge
Të merrë karavani i deve të Dashurisë,
Ajo është feja dhe besimi im.
(Ibn El-Arabiu)

***

Ilaçi është brenda në Ty

Ilaçi është brenda në ty, por ti nuk e ndjenë.
Sëmundja vie nga ti, por ti nuk e percepton.
Ti mendon se je një entitet i vogel,
Por brenda teje shtrihet i tërë universi.

Ti në të vërtetë je libër i evidencës,
Me të cilin alfabet e fshehura manifestohet.
Prandaj nuk ke nevojë të shikosh përtej vetes,
Ç'farë kërkon është brenda në ty, po të reflektosh.
(Ali Ibn Abi Talib r. a.)

***

Gjejë Burimin e Ujit

Bëhu guximtarë dhe diciplino veten.
Puno. Vazhdo së gropuari, gjej burimin e ujit tënd.
Mos të shkoj mendja të largohesh nga puna.
Uji është aty gjëkundi.
Nënshtrohu praktikës së përditshme.
Besnikshmëria juaj tek ky nënshtrim
Është një këmbanë në derë.
Vazhdo, trokitë, dhe kënaqësia brenda
Eventualisht do të hapë një dritare
Mandej shiko kush është atje!
(Rumi r. a.)

***

Pse nuk më vë re Mua?

E dashura ime të kam thirrur sa shpesh
Por ti nuk më dëgjove Mua

Të kam treguar veten Time sa shpesh
Por ti nuk më shikove Mua

E bëra veten Time me aromë të këndshme sa shpesh
Por ti nuk më morre erë Mua

Ushqim shpëtimi u bëra
Por ti nuk më shijove Mua

Pse nuk më arrin Mua
Përmes objektit që prekë

O më merr frymë
Përmes parfumit të ëmbël

Pse nuk më sheh Mua
Pse nuk më dëgjon Mua

Pse? Pse? Pse?

Për ty kënaqësia Ime
I kalon të gjitha kënaqësit e tjera

Dhe kënaqësinë që ta dhuroj ty
I kalon të gjitha kënaqësitë e tjera.

Për ty Unë jam më I preferuar se të gjitha
Të mirat e tjera,

Unë jam bukuri, Unë jam hir,

Më duaj, Më duaj vetëm Mua
Duaje veten në Mua, vetëm në Mua

Lidhe veten tënde me Mua
Askush nuk është më I brendshëm se Unë

Të tjerët të duan për veten e tyre
Unë të dua për veten tënde.

Dhe prap, ti ikën nga Unë
E dashura ime
Nuk mund të më trajtosh drejt Mua,
Sepse po të më afrohesh Mua
Është vetëm se Unë tu afrova ty

Unë jam më afër teje se vetë vetja jote,
Se shpirti yt,
Se fryma jote,

Kush në mes të krijesave
Do të trajtonte kështu si Unë?

Unë jam xheloz në ty,
Për ty,
Unë dua që ti mos ti takosh askujt tjetër
Madje as vetes tënde.

Bëhu I Imi,
Bëhu për Mua ashtu si je në Mua
Edhe pse ti as që je I vetëdijshëm për këtë.

E dashura ime të shkojmë drejt bashkimit
Dhe në qoftë se e gjejmë rrugën
Që na drejton tek ndarja,
Ne do ta shkatërrojmë ndarjen.

Te shkojmë dorë për dore
Le të hymë në prezencën e së vërtetës.

Le të bëhet gjykuesi ynë
Dhe një vulë e rrënjosur
Përgjithmonë, e bashkimit tonë.
(Ibn Arabi r. a.)

***

Një Tregim i Lashtë

Tani do të ju tregoj një tregim shumë të lashtë,
Si filloi së pari Besimi, dhe si lulëzoi
Tek perfeksioni i plotë; po, dhe do të ju tregoj
Si mandej filloi të thahet, deri sa u bë
I errët si një rrobë e shlyer. Pas kësaj
Unë kam për ju vet xhevahirin e njohurisë
Që ju mund ta fitoni, në qoftë se do ti dëgjoni fjalët e mija,
Njohuri e pasur, që ta liron zemrën
Nga njollat dhe ndryshku, dhe ta bën të pastërt dhe të ndritshme,
E vërtetë njohuria ime është, e çartë dhe elokuente,
E çmuar si margaritarë dhe rruza të çmimit të lartë;
Përmes Mëshirës Hyjnore e tregoj të vërtetën,
I mësuar nga Zoti Vetë, sepse jetoj
Brenda një gjenerate e bërë shumë e huaj,
E pamëshirshme dhe e tmerrshme, ketu ne kemi nevojë
Urgjentisht për një deklaratë nga besimi ynë
Dhe argumentet intelektuale gjithashtu:
Islami ka qenë më fisniku për tu lavdëruar -
Derisa vajtuesit falënderojnë të dashurit, të larguar të vdekur!
(Asim el-Antaki (757-830)

***

Njëshmëria e Zotit

Kërkoj strehim tek Zoti
Nga errësira e djallit
Në emër të Zotit
Të GjithëMëshirshmit, MëshirëPlotit
Thuaj: Ai, Zoti është Unike, Një (Ahad)
Allahu është Mbështetja dhe Strehimi Universal (Samed)
Ai nuk Lind kë, as nuk është i Lindur
Dhe nuk ka asnjë sikur Ai
Të lutem ty, përmes misteries me të cilën
Ti i bashkon të kundërtat, që Ti të bashkosh
për mua atë që nuk është e bashkuar me qenien
time, në një bashkim që Ti më shkakton
të dëshmojë Njëshmërinë e Qenies Tënde.
Më investo në rrobat e Tua të bukura,
dhe më kurorëzo me Madhërinë Tënde.
(Ibn Arabiu)

Kthimi

Qielli u ndriçua
Nga shkëlqimi i hënës
Me aq fuqi saqë u rrëzova në tokë
Dashuria jote më ka bërë të sigurtë
Se jam i gatshëm ta lë
Këtë jetë të botës
Dhe të dorëzohem
Tek Madhëria e Qenies Tënde.
(Rumi)

***

O Ju që qeshni në formën e vajtuesit!
për ne ti je ankesa dhe ankuesi.

A është agjerimi abstenim pa lartësim
apo lartësim pa kontroll?

Ato janë të dyja bashkë
se ai që e pranon teudin (njëshmërinë) me shoqërim

Intelektet I janë kurthëruar dhe ndaluar
nga liria e tyre e të vepruarit pa rrjetë apo grackë.

Intelektet i janë dobësuar nga liria e tyre e veprimit,
rreptësisht të prera nga Sheriati.

Ata dorëzohen tek ajo që faktet e tyre I hedhin poshtë
dhe besojnë pa perceptim.

Ylli këshillues I bartë ata me vete
duke notuar në mes të engjujve dhe sferave.

Për vete, mos të ishte për ty, unë nuk do të isha
sikur unë të isha Ai, po mos të ishe ti! Po mos të ishe ti!

Agjero nga qeniet fenomenale dhe mos e prish agjerimin!
Zoti I krijimit do të të sjell afër, të merr në mbrojtje ty me atë.

Meqenëse është agjerim, bëje njet (vendos)
nga natyra është ushqimi yt.

Në qoftë se do të reflektosh në të, ka një kuptim në agjerim
kurdoherë një krijesë ndriqon në vendbanimin tënd.

"Nuk ka asgjë sikur agjerimi. "
Ligjëdhënësi mi tha këto fjalë mua, prandaj reflekto!

Kjo është kështu sepse është mos-veprim. Ku është
ajo ç'farë ke bërë dhe ku është kërkesa jote?

Çështja është kthyer tek rrënjët e saj.
Zoti im të ka marrë në kontrollë ty përmes saj.

Në qoftë se reflekton në parimin e agjerimit
dhe bazën e domethënies së saj nga kuptimi yt,

Dikush me lajme erdhi nga Ai
për porosinë e agjerimit tënd që do të zhvesh ty.

Agjerimi I takon Allahut, prandaj mos u bë injorant.
ti je thjesht vend I manifestimit.

Agjerimi I takon Allahut,
megjithatë ti je ai që po vdes nga uria, prandaj dije këtë!

I Mëshirshmi të bëri femërorë për shkak të asaj çka shfaqet
nga ti kur Ai të dha formë ty (vetja).

Lavdia qoftë e Atij që të dha formë? Mirëprite Atë!
Ai të dha vetëm atë ty!

Ti, sikur toka, je një shtratë për të
dhe ujë-burimi (syri) yt përshkruhet sikur kur loton.

E sheh burimin e punimit me dorë të Allahut
ne mes ju të dy, atëherë ku është manifestimi yt?

Kur e thirre Allahun nga përulja për Të, I Lartësuari,
Ai tha, "Në shërbimin tënd"për ty.

Kalemi më I lartë në Tabletën e Tij
I shkruajti përshkrimet e tua të dëlira nga Ai.

Ti je burimi I të tërës, jo burimi I Tij.
Ai të solli afër nga një aspektë dhe të dërgoi largë nga një tjetër.

Ke kujdes kur je I gëzuar me atë që të kënaqë ty
për hir të asaj ç'farë Ai e bën të kënaqshme për ty.

Rri me rrënjët e tua në të gjitha që Ai dëshiron.
Mos harro ashtu që të mos harrohesh.

Kjo është njohuria
që më erdhi mua nga ai që nuk gënjen.

Ai e zbriti poshtë me komandën e Atij që posedon më së shumti
njohuri të asaj çka është në mes të asketit dhe të devotshmit.

Lavdia qoftë e Allahut që më dhuroi mua
njohurinë e dritës dhe errësirës.
Ai më dha një formë ku përsosja
e saj është vetëm përmes strehimit tënd.
(Shejl el-ekber Ibn Arabi)

Mos iu frikëso vdekjes!
(Amaneti i el-Gazaliut r. a.)

"Thuaj shokëve të mi, kur të më shikojnë mua, të vdekur
Duke qarë dhe vajtuar me pikëllim për mua
Mos besoni që ky trup që po e shikoni jam unë
Në emër të Perëndisë, ju them, nuk jam unë,
Unë jam një shpirtë, dhe ky trup nuk është asgjë më shumë se mish
Ishte banimi im dhe rrobat e mija për një kohë
Unë jam një thesarë, që hajmalia e mbante të fshehur,
I formuar nga pluhuri, që më shërbeu si një altar
Unë jam një margaritarë, që la guaskën të braktisur,
Unë jam një zog, dhe ky trup ishte kafazi im
Prej nga kam shkuar unë tani dhe është lënë vetëm shenjë
Falenderimi i takon Zotit, që tani më liroi
Dhe e përgaditi vendin tim për mua në parajsën më të lartë,
Deri sot isha i vdekur, edhe pse i gjallë në mesin tuaj
Tani jetoj me të vërtetën, me varrin – rrobat e hedhura
Sot bisedojë me të shenjtët lartë
Pa perde në mes, E shoh Zotin ball për ball
Shikojë në "Loh – I – Mahfuz"dhe atje lexojë
Të kaluarën, të tanishmën, dhe të ardhshmen.
Ma leni shtëpine të bie në gërmadha, lëshojeni kafazin tim në tokë
Hidheni hajmalinë, nuk është shenjë më tutje
Ma leni anash mantelin, ishte vetëm rroba ime e jashtme.
Vendosni të gjitha në varrë, leni që të harrohen,
Unë kalova në rrugën time dhe ju keni mbetur prapa
Vendbanimi juaj nuk ishte më një vendqëndrim për mua
Mos mendoni se vdekja është vdekje, JO, është JETË,
Një jetë që tejkalon, çdo gje që ne vetëm mund të ëndrrojmë.
Derisa në këtë botë, ne na është lejuar gjumi
Vdekja është një gjumë, një gjumë që do të zgjatet
Mos u frikësoni kur vdekja u është afruar
Është vetëm një udhëtim për këtë shtëpi të bekuar
Kujtoni mëshirën dhe dashurinë e Zotit
Falënderojeni për mëshirën e Tij, dhe ejani pa frikë
Çka jam unë tani, edhe ju do të jeni
Sepse e di se ju jeni ashtu si jam edhe unë
Shpirtërat e gjithë njerëzve burojnë nga Zoti
Trupat e të gjithëve janë përbërë nga njëllojë
E mira dhe e keqja, gjithashtu ishte e jona
Ua solla tani një mesazh gëzimi
Paqja dhe kënaqësia e Zotit qoftë gjithmonë me ju.
(Al-Gazali)

***

Pikëpyetja Atomike

Pse erdha këtu. Unë nuk e di;
Ku do të shkoj nuk ia vlen të kërkoj –
Në mes të morive të botërave
të të gjallëve dhe të vdekurve
yje, sisteme, e pafundmja,
pse të merakosem për një atom?
(Lord Byron)

***

Njohuri perfekte

Njohuria e të lashtëve ishte perfekte.
Sa perfekte?
Së pari, ata nuk e dinin se kishte sende.
Kjo është njohuria më perfekte;
Asgjë nuk mund të shtohet.
Mandej, ata e ditën se kishte sende,
Por ende nuk bënin dallime në mes tyre.
Mandej, ata bënë dallime në mes tyre,
Por ende nuk e vunë gjykimin mbi ta.
Kur gjykimi zuri vend, "Udha"u shkatërrua.
(Quang-Tzu)

***

Kur shpirti për herë të parë veshi rrobat e trupit,
Oqeani ngriti lart të gjitha dhuratat.
Kur dashuria për herë të parë shijoi buzët
E të qenurit njeri, filloi të këndojë.
Ne jemi nga një vend përtej këtij universi,
Por prap supozojmë se jemi nga toka dhe hiu.
Ne shkojmë duke trokitur tek dyert e të panjohurve të kuptojmë se kush jemi.
Ne e kërkojmë këtë botë për zgjidhjen e madhe
Të asaj që u martua me ne gjatë lindjes
Dhe shkurorëzohet në vdekje.

***

Të mallëngjyerë

Me të vërtetë ka disa rob në mesin e robëve të Mi
Që më donë Mua
Dhe Unë I dua ata

Dhe ata janë përmallueshëm për Mua
Dhe Unë përmallohem për ta

Ata më shikojnë Mua
Dhe Unë I shikojë ata

Dhe shenjat e tyre janë
Se e ruajnë hijen gjatë ditës

Me aq kujdes
Si bariu që I ruan delet e tij

Dhe përmallohen për perëndimin e diellit
Sikur zogu që mezi pret ti kthehet foles në mbrëmje

Dhe kur nata të vij
Dhe kur hijet përzihen
Dhe krevatet shtrihen

Dhe kur çdo dashurues është I vetëm me të Dashurin
Atëherë ata cohen në këmbët e tyre
Dhe I vënë fytyrat në tokë

Më thërrasin me fjalët e Mija
Dhe më mahnitin me hirin Tim

Gjysma çajnë, gjysma të mallëngjyer
Gjysma të hutuar, gjysma duke u ankuar

Her qëndrojnë në këmbë, e her rrin ulur
Her rrin në gjunjë dhe her vënë kokën në tokë

Dhe e shoh çka bartin në supet e tyre për hir Timin
Dhe I dëgjoj ankesat e tyre për dashurinë Time.

***

Dhuratë e Dashurisë nga Rumi

Të vdes për të dashuruar

Vdis, në këtë dashuri
Në qoftë se do të vdesësh në këtë dashuri
Shpirti yt do të ripërtërihet
Vdis, mos u frigo vdekjes, e asaj që veq dihet.
Në qoftë se do të vdesësh tek e përkohshmja
Do të bëhesh I përjetshëm
Vdis, thyej ata zingjirë
Që po të mbajnë të burgosur
Tek bota e lidhjeve
Vdis tek e pavdekshmja
Dhe do të bëhesh I përjetshëm.
Vdis, dilë jashtë nga kjo re,
Kur të lësh renë
Do të bëhesh si hëna e ndricuar
Vdis nga zhurma dhe brengat monotone
Të kësaj bote
Në heshtjen e dashurisë
Do ta gjesh shkëndijen e jetës.

Zemra që digjet

Zemra më digjet nga dashuria
Të gjithë mund ta shohin këtë zjarr
Zemra më rreh me pasion
Sikur valët në oqean
Shokët e mi u bënë të huaj
Dhe jamë rrethuar nga armiqë
Por jam I lirë sikur era
Më nuk lëndohem nga ata që më fyejnë
Jam në shtëpi kudo që jam
Dhe në dhomën e dashuruesve
Mund ta shohë me sy të mbyllur
Bukurinë që vallëzon
Prapa perdes I intoksikuar me dashuri
Edhe unë vallëzoj me ritmin
E kësaj bote në lëvizje
I kam humbur shqisat
Në botën e dashuruesve.

E ëmbëla e hidhur

Në halucinacionet e mija
E pash kopshtin me lule të të Dashurit tim
Në marramendjen time,
Në mjegullën e dehjes,
Duke u rrotulluar dhe vallëzuar
Si një rreth që sillet
E pash veten time si burim I ekzistencës
Isha atje që në fillim, dhe isha shpirti I dashurisë
Tani jam I c'pirë, ka mbetur vetëm kujtimi I dashurisë
Dhe vetëm mallëngjimi
Vuaj për lumturinë, u luta për ndihmë, dua mëshirë
Dhe I Dashuri im më tha:
Unë jam hëna jote
Dhe drita e hënës gjithashtu
Unë jam kopshti I lulishtes tënde dhe
Uji gjithashtu
E kam bërë gjithë këtë udhëtim për këtu
Pa këpucë I brengosur për ty
Dua që ti të buzëqeshësh
Ti vrasësh të gjitha brengat
Dua të të dua, të të ushqej
O e ëmbëla e hidhur,
Do të të freskoj dhe shëroj
Do të të sjell trëndafila
Unë gjithashtu isha mbuluar
Me thepat gjembave dikur.

Agoni dhe ekstazë për Hyjnoren

Në pyllin e kopshtit të trëndafilave,
Përmallohem të ta shoh fytyrën,
Në shijimin e të ëmblës vuaj të të ti puth buzët.
Nën hijen e degëve
Përmallohem për dashurinë Tënde
O Dashuri Supreme
Më lejo që ti lë prapa brengat e mia,
Lulet po qelin
Nga euforia e shpirtit Tënd
Në Emër të Allahut
Po vuaj për të ikur nga burgu I egos sime
Dhe ta humbë veten time në male e shkretëtira.

Më kanë lodhur
Këta njerëz të mërzimë dhe të vetmuar
Vuaj që të festoj në pasionet
E dehjes së dashurisë Tënde
Dhe të ndiej Fuqinë Tënde fëshfëritëse në duart e mia.
U sëmura më nga mbretërit mortalë
Jam përmalluar për dritën Tënde.
Me llampa në duar shejhët dhe mullahët
Sillen nëpër luginat e errëta
Të këtijë vendi
Duke mos gjetur atë që janë duke kërkuar
Ti je esenca e esencës
Dashuria e intoksikuar
Jam përmalluar të ti këndoj falenderimet
Por mbetem pa fjalë
Me agonin e dëshirës
Dhe zemrës sime.

I zënë në Flakën e Dashurisë

Zemrën ma ka kapluar zjarri,
Në cmendurinë time
Endem nëpër shkretëtirë,
Shkëndijat e pasionit tim
E shkrijnë erën dhe qiellin
Thirrjet e mia të përmallimit
Klithjet e dhembshurisë
Po ma mundojnë shpirtin
Ti pret me durim
Duke më shikuar në sytë e mi të intoksikuar
Ti e pranon pasionin tim
Me qetësinë e dashurisë.
Ti je Zot I ekzistencës.
Një ditë do të bëhem dashurues sikur Ti.

Duke kërkuar Fytyrën Tënde

Që nga fillimi i jetës time
Jam duke kërkuar fytyrën Tënde
Por sot e pashë.

Sot e pashë tërheqjen,
Bukurinë,
Mëshirën e papërshkruar
Të fytyrës që po e kërkoja
Ditën që të gjeta Ty.

Dhe ata që dje më qeshnin
Dhe më fyenin
Tu vie keq
Që nuk kërkuan ashtu si kërkova unë.

Jam mahnitur nga madhëria e bukurisë Tënde
Dhe do të dëshiroja të shikoja me njëqind sy.

Zemra më është djegur me pasion
Dhe e ka kërkuar përherë
Këtë bukuri të mahnitshme që tani e mbajë.

Më vie turp ta quaj këtë dashuri njerëzore
Dhe kam frikë nga Zoti ta quaj Hyjnore.

Era e aromës tënde, sikurse flladi i mëngjezit
Erdhi tek qetësia e kopshtit.

Më fryve jetë të re në mua
Jam bërë hija dhe rrezja jote e diellit.

Shpirti im thërret në ekstazë.
Çdo fije në qenien time ka rënë në dashuri me Ty.
Shkëlqimi Yt ka ndezur një zjarr në zemrën time
Dhe e ke bërë të qartë për mua Tokën dhe Qiellin.
Shigjeta ime e dashurisë arriti cakun.
Jam në shtëpinë e mëshirës.
Dhe një një vend lutjesh zemra ime u bë.

Domethënia e Dashurisë

Të dyja, drita dhe hija janë valltarë të dashurisë.
Dashuria nuk ka shkakë
Eshtë një astrologe e sekreteve të Zotit.
Dashuruesi dhe i Dashuri janë të pandarë
Dhe të përjetshëm.

Edhe pse dua ta përshkruaj dashurinë
Kur e përjetojë mbetem pa fjalë.

Edhe pse dua të shkruaj për dashurinë
Gjithnjë e gjej veten pa ndihmë,
Lapsi më thyhet,
Dhe letra më rreshqet andej
Tek ai vend i pashmangshëm
Ku dashuruesi, i dashuri dhe
Të dashurit janë një.

Çdo moment është bërë i lavdishëm
Nga drita e dashurisë.

Dashuruesit e privilegjuar

Hëna është bërë valltare
Tek ky festival i dashurisë.

Ky vallëzim i dritës
Ky bekim hyjnorë
Kjo dashuri hyjnore
Na thërret tek një botë e
Përtejme që vetëm
Dashuruesit mund ta shohin
Me sytë e tyre të zjarrtë nga pasioni.

Ata janë të zgjedhurit
Që janë nënshtruar
Njëherë ishin grimca të dritës
Tani janë dielli rrezatues.

E lanë prapa botën e lojrave mashtruese
Ata janë dashuruesit e privilegjuar
Që krijuan botë të re
Me sytë e tyre të zjarrtë
Nga pasioni.

I mundur nga Dashuria

Qielli u ndriçua
Nga shkëlqimi i hënës
Me aq fuqi saqë u rrëzova në tokë
Dashuria jote më ka bërë të sigurtë
Se jam i gatshëm ta lë
Këtë jetë të botës
Dhe të dorëzohem
Tek Madhëria e Qenies Tënde.

I humbur në shkretëtirë

O dashurues,
Ku jeni duke shkuar
Kë po e kërkoni?
I Dashuri është këtu.
Jeton në lagjën tënde
Fytyra e sajë është e mbuluar
Ajo fshehet prapa perdeve
Dhe të thërret ty
Derisa ti e kërkon
dhe e humb vetë-veten në shkretëtirë.

Mos kërkoni të metat
Ka një kopshtë të lulëzuar
Në shtëpinë tënde.
Derisa ti kërkon xhingërima
Shtëpia e thesarit të pret
Në qenien tënde.
Nuk ka nevojë për vuajtje
Zoti është këtu.

11. Shënime për Sufistët

Sufizmi është lëvizje mistike në kuadër të islamit. Insistojnë në nocionin miraxh (dalldi mistike) në të cilën, sipas tyre, ka qenë edhe vetë profeti kur ka përjetuar zbulesën. Dalldia është baza e mësimit të tyre. Qëllimi është që të tejkalohet Uni me teknika te ndryshme të asketizmit shpirtëror të zhvillimit gradual. Metafizika e tyre në bazë e ka poseduar panteizmin neoplatonik të veçant. Ajo metafizikë është quajtur irfan. Në këtë mënyrë krijohet trijada metafizike: sherija – forma letrare e zbulesës i mishëruar në Kur'an dhe ligjeve besimplotë mbi suksesionin e profetit, mandej tarikit – rruga mistike, dhe hakikit – procesit shpirtëror të realizimit personal dhe bashkimit me hyjninë. Nga kjo, ky libër, në harmoni me mendimin islam në formën e tij folklorik, tregon unitetin e formës dhemendimit u fjalët e shkruara të sufistëve, e kjo është, me fjalë të tjera, gjithmonë ka qenë virtyt e jetës së brendshme të pasur harmonike të njerëzve të urtë.

Sufistët e kanë marrë emrin prej fjalës arabe ***suf*** (lesh). Janë veshur me pallto nga leshi i bardhë - ***kirga***.

Sufist: kështu janë quajtur antarët e parë të një grupe shiite nga Kufa (Iran) në mes shekullit II/VIII dhe III/IX. (shënimi i parë është sipas vitit islamik egjiri). Njëfarë Abdak nga Bagdati është i pari që është quajtur me këtë emër(sufist). "Velajet"– largimi i Imamit tek sufistat suni që i përgjigjet përafërsisht krishtenizëm pa Krisht. Sheik e zë vendin e Imamit. Ekzistojnë disa shkolla të rëndësishme: shkolla e Bagdadit, Korosane etj.

Mësuesi i parë i madh – Abu Jazid Bastami ka vdekur 261/874; nuk ka shkruar, përmbledhjen e maksimave Shatahat e kanë përpiluar të tjerët.

Xhonaid i lindur në Nehavandu (Iran) gjithë kohën ka jetuar në Bagdad. Ka vdekur 297/909. Themelues i shkollës së Bagdadit; tahvid – unitet mistik me Zotin.

Al-Halaxh – sufi mësues më i njohur iranian. Përmes marrëdhënies së llojit të vet me Zotin krijon unitet mistik; thënja: Zoti është Unë, Unë është Zot. I djegur në turrë drush si heretik, 309/922.

Gazali dhe "dashuria e pastër"– ka vdekur 520/1126. Themelues i lëvizjes "virginalista"– Bani Odra – njerëzit të cilët vdesin nga dashuria – në të vërtetë është interpretimi sufist i dashurisë së përkryer të Platonit përmes të cilës individi mëshirohet përmes ndjenjës hyjnore.

12. Ç'është Sufizmi?

Fjala Tesewuf dhe Sufije nuk kanë qenë të njohura gjatë gjeneratës së parë Islame. Madje, këto qenë prezantuar në të [islam] vetëm pasi që u përvetësuan në Islam nga popujt tjerë.

Shejhul Islam Ibn Tejmije, Allahu pastë mëshirë ndaj tij, tha në Mexhmu-ul-Fetaua:"Përsa i përket termit Sufije [Sufizëm], kjo s'ka qenë e njohur gjatë tre gjeneratave të para të Islamit. Dhe, të folurit rreth kësaj u bë e njohur vetëm pas tre gjeneratave të para. Disa imamë dhe dijetarë folën rreth kësaj më pas, siç ishte imam Ahmed bin Hanbel, Ebu Sulejman ed-Darani dhe të tjerë. Po ashtu është transmetuar nga Sufjan eth-Theuri të ketë folur rreth kësaj. Disa nga ata po ashtu përmendën këtë në autoritetin e el-Hasan el-Basrit. Ata dalluan në pikëpamjet e tyre mbi domethënien se çkaje ia atribuon veten një Sufi, meqë fjala 'Sufi' është një emër që tregon një atribuim, siç është el-Kurshi, el-Medini dhe kështu me radhë.

Thuhet se ky është një atribuim ndaj Ehlus-Suffeh, por kjo është gabim, meqë po të ishte kështu, ata do ta quanin veten Sufij. Po ashtu është thënë se kjo është atribuim ndaj Saff [radhës] e cila është me e shquara para Allahut, por edhe kjo është gabim, meqë po të ishte kështu, ata do ta quanin veten Saffij. Po ashtu është thënë se kjo është atribuim ndaj sefweh [më të mirës] nga krijimi i Allahut. Por, edhe kjo po ashtu është gabim, meqë po të ishte kështu, ata do ta quanin veten Safwij.

Është thënë poashtu se kjo është atribuim ndaj Sufeh bin Bishr bin Udd bin Tabikheh, një fis Arab që gjindej pranë Mekes në të kaluarën, të cilit ia atribuonin veten asketët. Ndonëse atribuimi i Sufi-t është në pajtim me emrin e këtij personi [Sufeh] nga pikëpamja gramatikore, ky poashtu është opinion i pasaktë, meqë këta njerëz nuk kanë qenë të njohur mirë për shumicën e asketëve dhe për shkak se po t'iu atribuoheshin asketikët atyre, do të kishte qenë e mundshme që ata t'ia atribuonin veten atyre gjatë epokës së Sahabëve, Tabi'inëve dhe Atba' et-Tabi'inëve [por nuk e kanë bërë këtë].

Po ashtu kjo është për shkak se shumica e atyre që flasin ne emër të Sufive s'janë të vetëdijshëm për ekzistencën e këtij fisi dhe ata nuk e pëlqejnë që t'i atribuohen një fisi të Ditëve të Injorancës [xhahilijeh], i cili nuk ekzistonte gjatë epokës Islame. Poashtu është thënë që ky është opinioni më i mirënjohur: se Sufi është një atribuim ndaj suf [leshit, rrobës së leshtë]. Kjo meqë hera e parë kur Sufitë u shfaqën ishte në Basra, Irak.

Njerëzit e parë që vendosën rolin e Sufizmit kanë qenë disa shoqërues të Abdul-Uahid bin Zejd. Abdul-Uahid ka qenë një nga shoqëruesit e el-Hasan el-Basrit i cili jetonte në Basra, dhe aq shumë zhytej në asketizëm [zuhd], adhurim [ibadet], frikë ndaj Allahut [khauf] dhe kështu me radhë, saqë një shembull i tillë nuk mund të gjindej në banorët e vendeve tjera.

Ebush-Shejh el-Esbehani transmetoi me një zinxhir transmetimi të lidhur me Muhamed ibn Sirinin, se i ka mbërri atij që një grup njerëzish parapëlqenin të vishnin rrobe të leshta, kështu që ai tha:'Janë disa njerëz që parapëlqejnë të veshin rrobe të leshta duke pohuar se i gjasojnë Mesisë, të birit të Merjemes. Mirëpo, udhëzimi i pejgamberit tonë [salallahu alejhi ue selam] është më i dashur për ne, dhe ai [salallahu alejhi ue selam] mbartte rroba të pambukut dhe të tjera lloje të rrobes'. Apo është shprehur ngjashëm me këtë".

Pas kësaj, Ibn Tejmije tha: "Këta njerëz ia atribuojnë veten rrobeve të jashtme, e cila në këtë rast është rrobë e leshtë [suf]. Kështu që mund të thuhet për ndonjërin nga ata se është një Sufi. Mirëpo, metodologjia e tyrë s'është e kufizuar vetëm në mbartjen e rrobës së leshtë, e as që e bëjnë të detyrueshme këtë për ndonjë. Ata i atribuohen kësaj për shkak të qenit të kësaj gjendje e jashtme".

Pastaj ai tha:"Pra, kjo është origjina e Sufizmit. Pas kësaj, Sufizmi u degëzua dhe u shumëfishua. "

Fjalët e Ibn Tejmijes, Allahu pastë mëshirë ndaj tij, tregojnë që Sufizmi zuri fill në tokat Islame nga disa adhurues shumë të devotshëm nga Basra si rezultat i thellimit të tyre në asketizëm dhe adhurim. Pas kësaj, Sufizmi evuloi dhe ndryshoi.

Përfundimi të cilin e kanë nxjerrë disa autorë modernë – se Sufizmi u zvarrit brenda në vendet Islame nga fetë tjera si Hinduizmi dhe monasticizmi i Krishterë – është pranuar bazuar në atë çfarë transmetoi Ibn Tejmie nga Muhamed Ibn Sirini te ketë thënë:"Janë disa njerëz që parapëlqejnë të veshin rroba të leshta duke pohuar se i gjasojnë Mesisë, të birit të Merjemes. Mirëpo, udhëzimi i pejgamberit tonë [salallahu alejhi ue sleam] është më i dashur për ne!"Kjo tregon që Sufizmi ka një lidhje me fenë e të Krishterëve!

Dr. Sabir et-Tu'eimeh tha në librin e tij "Sufizmi – Besimet dhe Metodologjitë e tij": "Me sa duket Sufizmi u shfaq nga ndikimi i monasticizmit të Krishterë, në të cilin murgjit mbartnin rrobe të leshta dhe jetonin në manastiret e tyre. Kishte shumë nga ata që praktikonin këtë gjithandej vendeve të cilat Islami i çliroi me anë të Teuhidit... "

Shejh Ihsan Ilahi Dhahir, Allahu pastë mëshirë ndaj tij, ka thënë në librin e tij "Sufizmi – Burimi dhe Origjina e Tij": "Kur shikojmë thellë në mësimet e Sufijve të parë dhe të vonshëm dhe thëniet që kanë qenë cituar dhe transmetuar nga ata në librat Sufite të vjetra dhe ato të sotshmet, ne shohim një dallim të madh mes kësaj dhe mësimeve të Kur'anit dhe Sunetit. Njëlloj, ne s'i gjejmë rrënjët apo farat e tij në historinë e udhëheqësit të të gjitha krijesave [pejgamberit Muhamed, salallahu alejhi ue selam] e as në të Shoqëruesve bujarë të tij, të cilët janë ndër krijesat më të mira të Allahut. Madje, në kundërshtim me këtë, ne shohim që Sufizmi

është përftuar dhe mësuar nga monasticizmi i Krishter, Brahmanizmi, Hinduizmi, devocioni fetar i Judaizmit dhe asketizmi i Budizmit".

Shejh Abdur-Rahman el-Uekil, Allahu pastë mëshirë ndaj tij, ka thënë në hyrjen e librit "Rënia e Sufizmit": "Vërtet, Sufizmi është makinacioni më i ulët dhe më i ndyrë, të cilin e ka shpikur Dreqi në mënyrë që robërit e Allahut të mund të përqeshin dhe qësendisin së bashku me të në luftën e tij kundër Allahut dhe të dërguarve të Tij. Kjo është vello e Zjarrputistëve [Mexhusëve], e cila lë përshtypjen se është hyjnore. Madje, kjo është maskë e çdo armiku të fesë së vërtetë. Këqyrni atë dhe do të gjeni në të Brahmanizëm, Budizëm, Zoroastrianizëm, dhe bësimet Manikiane. Ju do të gjeni Platonizëm në të. Madje mund të gjeni edhe Judaizëm, Krishterizëm, dhe idhujtari të ditëve të Injorancës".

Nëpërmjet prezantimit të pikëpamjeve të këtyre shkrimtarëve modernë lidhur me Sufizmin, dhe poashtu edhe shumë shkrimtarëve të tjerë që s'po i përmendim këtu e të cilët kanë pikëpamje të njëjta, na bëhet e qartë se Sufizmi është një koncept i huaj që është futur në Islam. Kjo tregohet me praktikat e atyre që ia atribuojnë veten Sufizmit; praktika të cilat janë të huaja për Islamin dhe janë shumë larg nga udhëzimi i tij. Me këtë ne mendojmë në ithtarët e vonë të Sufizmit, iluzionet mistike dhe fantazitë e të cilëve janë bërë të shumta dhe të mëdha.

Por, përsa u përket paraardhësve të kaluar si el-Fudejl bin Ijad, el-Xhunejd, Ibrahim bin Adham dhe të tjerëve, ata kanë qenë mesatarë.

1. A është Sufizmi Religjion? Kult Okultist? Mënyrë e jetesës?

A është Sufizmi Religjion? Kult Okultist? Mënyrë e jetesës? Krejt çka u tha kjo është pjesërisht dhe asënjëra nga to. Në mesin e më shumë se 400 e më tepër milionë idhëtarëve të Islamit, Tesavufin e udhëheqë një Fuqi, të cilën asnjë shoqëri politike dhe ekonomike nuk e udhëheqë më mirë në botë.

Ku janë burimet e këtij kulti të quditshëm? Hulumtuesit bashkohorë edhe tani Tesavufin-Sufizmin e konsiderojnë si fuqij më të madhe të lindjes së Mesme. Megjithatë ka shumë literaturë në botë për Sufizmin, por thuaja ka pakë ose hiqë matrial të besueshëm në lidhje me këtë kultë. Historianët e Sufizmit e përshkruajnë se themelimin bazë të Sufizmit e ka formuar profeti Muhamed (nga pesë aliaba:profeti Muhamed, e shejta Fatime, i shejti Ali, imam Hasani dhe imam Hyseni. Pastaj vijnë 12 imamët. Imami i parë ka qenë imam Alija dhe i fundit ka qenë Al- Mahdi-a. Besohet se i shejti Mahdi nuk është dukur fare në popull dhe gjithashtu dhe është zhdukur plotësisht nga dheu me tërë trupin e tij fizikë dhe ka me u kthyrë më vonë.

Ka shum teori në bot ne lidhje me kthimin e Imamit te 12 Al- Mahdi-a, disa thojn se ai ka me u kthyr (në Mekë me gjith trup dhe prej atij momenti ka me filluar besimi në tërë botën në një Zotë- islamizëm të vërtetë).

Une jam plotsisht i bindur se imami i 12 Al- Mahdi-a- që do të thot: Me dije-Medija (fjal Ilire). Ai gjendet tash ne Kosovë ku po pregadit qe ta qes ne dritë dijen ma të lartë Hyjnora që ne këtë Epokë njerzimi ende nuk e ka pasur, dije e cila shpejt do ta shof driten ku ter njerzimi do te shpëton prej errsirës së vërtetë dhe e tërë bota edhe nji herë do të bëhet Ilire Siç ka qen para kesaj Epoke dhe do ta ket vetem nje gjuh dhe ajo gjuhë do të quhet gjuha Ilire. Me dijen Hyjnore njerzit nuk do të jenë profet po do ta kanë dijen e profetit.

2. TESAVUFI

Tesavufi është menquri e mësheft, dije, njohuri dhe dije hyjnore, është rrugë dhe lidhe, (besnikri ose ai i cili është dhanë shumë pas kësaj rruge) ata të cilët plotsisht anojn kah kjo rrugë dhe vetin ja kan kushtuar plotsisht gjendjes shpirtrore nëpërmes gjendjes dhe dashurisë për Zotin të lartmdhërishëm dhe pejgamerit Muhamet a. s. Tesavufi është themel i të gjitha Tarikateve të larta. Në Keshful Mahgjubu thuhet se azreti (i shejti) Ebu Bekr është udhëheqsi (Imami) i tërë botës në rrugën e Tesavufit.

3. Njohja e vehtes dhe largimi i të këqijave

El-Munavi thot: "Shehi Iben Arabi ka thanë: "Shejhet tanë me vetvehten janë llogaritur më të gjitha fjalët, me të gjitha veprat e veta dhe sjelljet e veta të ditës. Të gjitha këto të i kanë shkruar në fletoret e tyre atëher kur ka ardhur mbramjadhe këte pasë namazit të jacisë dhe mu atëherë i kanë bërë llogaritë me vetvehten. Pastai i kan marrur fletoret e tyre dhe e kan shiquar të gjitha ato vepra që i kanë bërë tërë ditën atë ditë, çka kanë folur, vepruar apo menduar. Për çdo vepër të keqe e kan kthyrë me mendime në të kundërtën dhe ate në të mirë. Për veprat apo fjalët apo mendimet e këqija i kan kërkuar falje Zotit. Pra kanë kërkuar pendim për ato vepra që është dashur me u kërkuar pendim, i kanë bërë faliminderim Zotit për ato vepra që është dashur të bëhet faliminderimi, e atëher pasë kësaj kanë ra me fjetur. Pra këta sheh jo vetëm që i kanë shkruar vetem fjalët dhe veprat e ditës, por ata i kan hulumtuar detalisht edhe mendimet e ditës si të mira dhe të këqija, ku mendimet e këqija i kanë njohur dhe i kanë eliminuar.

4. Lutje e pendimit- lutja e zemrës

O Zot më i mëshirshmi, pendohemi për të gjitha mëkatet tona, për çdo mendim që ka qenë i rrejshëm, i pa arsyeshëm, i pa pastër; për çdo fjalë që është folur dhe e cila nuk është guxuar të flitet, për çdo vepër që është bërë dhe e cila nuk është dashur të bëhet.

Pendohem për të gjitha veprat, fjalët dhe mendimet që janë me urrejtje dhe egoizëm.

Posaqërisht pendohem për çdo mendim të epshit dhe për çdo veprim epsharak, për çdo gënjeshtër, për çdo dyftyrsi, për çdo mosplotësim të premtimit, për çdo intrigë(fitme) dhe shpifje.

Veqënarisht pendohem për çdo veprim i cili ju ka pru shkatrrim të tjerve, për të gjitha fjalët e veprat të cilat ju ka shkaktuar dhimtë të tjerve, dhe për çdo dëshirë që të tjerve ju ka shkaktuar dhimtë.

Në mëshirën tënde të pa kufishme, o Zot të lutëm të na falish për të gjitha këto mëkate që i kemi bërë, dhe të na falish për mos sukseset e gjithnjëshme që të mendojmë, të folim dhe të veprojmë në harmoni në vullnetin Tënd.

5. Adhuruesit e idolëve dhe Qabja/Kaaba

Deri edhe muslimanët të cilët kanë qenë kundra çdo adhurimi të idoleve(adhurim i zotnave prej gurit si statu apo objekteve të ndryshme - përkthyesi), i kan formuar adhurimin e idolëve personale. Si po duket mendja e njeriut nuk mundet të i largohet provokimit apo thirrjes. Tash Qabja(Kaaba)me Gurin e Zi është bërë idol. Njerzit shkojn në Qabe(Kaaba) në hagj (haj) hagjillëk. Njerzit e mjerë tërë jetën mbledhin pare që të shkojnë vetëm një herë që ta puthin Gurin e Zi. E çka është kjo pra? Kjo është idoletrerij (adhurim i idoleve) e çka tjeter?

6. Tregimi mbi Shiblijen – Mësuesi shpirtëror sufist

Tregimi mbi Shiblijen është shumë i bukur. Ai është një nga mësuesat shpirtzror të njohur. Dua të ua tregoi këte tregim. Emri i Shiblijes për të parën herë përmendet kur Mistiku shum i lart Hillaj Mansoor-i(Mensur) ka qenë vrarë. Shiblija ka qen mik i Mansoorit. Shum njerz jan vrarë në të kaluarën prej njerëzve të ashtuqujtur religjioz. Isa apo Jezusi njejt ka qen i vrar. Po kurr nuk ka ndodhur aso vrasje si me al – Hillajen. Ajo vrasje e tij është më mizorja që njifet. Jesusin e kan gozhdu në kryq, por al – Hillja nuk ka qen vetem i gozhduar. Së pari ia kan pre këmbët, pastai duert, po prap ka qen gjallë. Me të vërtetë e kan munduar. Pas kësaj ia kan prerë gjuhen dhe ia kan nxjerur syt, por ai prap ka mbet gjallë. Atëher ia kan pre kokën dhe e kan pre në copa copa.

Atëherë për të parën her është ndëgju për Shiblijën. Jan mbledhur me qindra vet që të hedhin gur mbi Mansoorin dhe që ta ndëshkojn me fymje dhe pshtymje. Po, qfar të keqe ai ka bërë? Çfar mëkati ky ka bërë. Nuk ka bër kurfar krimi, asë që e ka bërë ndonjë mëkat. Të vetmin krim që ka bërë është atë që e ka than: „Ana`l Haq"(Anal Hak), që don me than: „Une jam e Vërteta, une jam Zot". Sikur të jetonte në Indij, njerzit e kishin nderuar me shekuj. Të gjith ata që i studjojn Upanishadet (libër i shenjt si Kurani) deklarojn: „Aham Brahmasi"– Une jam Brahma, qenja më e lartë! Ana`l Haq në të vërtet në përkthim don me than Aham Brahmasi. Pra muslimanet këtë nuk kan muajtur kursesi me toleruar.

Te tri religjionet të cilat kan lindur në përëndim jan shum jotolerante. Izraeltet apo çifutet jan shum jotoleran. Dhe për ket e kan gozhduar Jesusin në kryq. Muslimanet gadi jan të verbërt prej jotolerimit. Krishteret gjithnjë flasin për tolerimin, por kjo është vetem prrallë. Aspak nuk jan tolerant. Deri edhe në tolerim gjendet jotolerimi i thellë. Dhe te tri këti religjione janë vrasëse, dhunuese dhe agresive. I vetmi argument i tyre është tiranija, sikur që dikend mund ta bind vetem nëse e vret.

Mansoori është një sufi i madh. Askush nuk mundet me u krahasuar me te në tradicionet e sufizmit. Ka qen i vrarë. Njerzit në te kan hedhur gur. Shiblia ka qendruar në masë. Mansuri ka qeshur dhe asht kënaqur. Kur ia kan pre kamt, e ka marr gjakin me duer dhe me te i ka ly këmbët. Në të njejtën mënyrë muslimanet i lajn durt me ujë(namaz) kur shkojn në lutje nëpër gjamija. Kjo quhet wazu. Dhe dikush prej masës e ka pyetur. „Çka po bën Mansoor?"Dhe ai i thot „Si mund të bëni Wazu me uij? Si mund të lahi me uij kur keni bër krim me gjakun tuaj? – keni bër mëkat me gjak, pra si mund të pastrohi me uij? Vetem me ujë mund të pastrohi. Une po i laj duert e mija dhe po pregaditna për lutje. "

Dikush ka qeshur dhe ka than: „Ti je i qmendur! Po pregaditesh për lutje apo që të vritesh?"

Mansoori ka qeshur dhe ka than: „Mu në këtë është lutja – në vdekje. Ju po më ndihmoni mu te lutja e ime e fundit. Asgjë ma mirë nuk mund të bëhet me këtë trup. Ky trup nuk mund të shfrytzohet në mënyrë më të mirë. Po më bëni kurban në altar të hyjnive. Kjo ka me qenë lutja ime e fundit në këtë botë. "

Kur kan filluar me ja shkurtu durt, ka than: „ Vetem pak. Më lejoni që të un të lutem sepse kur mi preni durt ka me qen pak vështir. "Dhe ka shiquar kah qielli, dhe ju ka lutur Zotit dhe ka thanë: „Ua falë gabimet këtyre njerzve se këta nuk jan duke e ditur se qka jan duke bërë. "Kurse Zotit i thot: „Nuk mundesh mem mashtru, ti mashtrues i madh. Po te shof në të gjith këta njerz që jan këtu. Po mundohesh mem mashtru apo? Ke ardh si vrasës, si armik apo? Po të them, ti mu nuk mund të më mashtrosh. Pa marrë parasyshë se në cilën formë ke ardhë, une kam met njohur – mu për ate që të kam njohur në vete. Nuk ka shans mem mashtruar. "

Njerzit gjunin gur dhe shanin, kurse Shiblija qendronte në atë masë njerzish. Mansoori qeshte dhe buzëqeshte. Përnjëher filloi të qaj dhe të rënkoi sepse Shiblia e hedhi një drandafil mbi te. Kur i kan hedhur gur Mansoorit ka qeshur, dhe kur është hedhur drandafili, ka filluar me qajt dhe të rënkoi. Dikush e ka pyetur: „Për çka është puna? Kur po të hedhin gur po qesh. A je qmendur? Shiblija e ka hedhur drandafilin. Pse po qanë dhe vajton?"Mansoori thot: „Njerzit të cilët po gjujn gur mbi mua nuk jan duke e ditur çka po bëjnë, por Shiblija e din. Këtij ka me i qenë vështirë me marrë falje prej Zotit. "Shiblija ka qen dijetar. I ka njohur shkrimet e shejta.

Ka qenë njeri i dijes. Mansoori thot: „Të tjerve ka me ju falur sepse keto po i bëjnë prej mosdijës.

Nuk mund të ju ndihmohet. Çka do që bëjnë, në rregull është. Në verbësin e tyre kjo është e tëra çka munden. Prej tyre ma nuk pritet. Dhe nuk mund të pritet. Por, Shiblija, njeriu i cili din, njeriu me dije, këti vështir është të i falet gabimi. Për shkak tina po qaj dhe po vajtoi. Ai i vetmi din të bëj mëkat. Ai këtë e din, për këtë po qai. "Këtë duhet me e kuptuar. Nuk mundesh me bër mëkat nëse nuk je i dishem.

Si mund të bësh mëkat nëse nuk je i dishem? Përgjegjsija nuk qendron në ty. Por ku ke dije, atëher je përgjegjës. Dija është përgjegjsija më e madhe. Dija të bën përgjegjës. Kjo thanje e Mansoorit plotsisht e ka ndrruar Shiblijen. Ai është bërë plotsisht tjetër. E ka gjujtur Kuranin, shkrimet e shejta dhe ka than: „ Ato nuk kan muajtur mem mësuar asë që ta kuptoi që e tërë dija është e pa vlefshme. Tash dua të hulumtoi për dijen e vërtetë. "

Më von, kur i kan kërkuar që ta komentoi deklaratat e Mansoorit: „Ku është puna? Pse e ke gjuajt lulen?", Shiblija thot: „Kam qendruar në masë të njerzve dhe jam friguar. Nëse nuk hedhi asgjë, masa ka me menduar që i takoi grupes së Mansoorit. Masa kishte me muajtur me besuar se jam mik i tina dhe ata kishin me muajtur me sulmuar me dhunë ndaj meje.

Nuk kam muajtur me hedhur gur sepse e kam ditur që Mansoori është i pa fajshëm. Por nuk kam pasur trimri që mos të gjuaj mbi te asgjë. Për këte kam gjuajtur lule. Kjo ka qen kompromis. Dhe Mansoori ka pasë të drejt që ka qajtur. Ka qajtur për shkak të frigës time, frigen time të mjerë. Ka qajtur sepse e tërë dija ime që tër jetes time e kam arritur ka qenë e kotë sepse kam bërë kompromis me masen e njerzve. "

Të gjith njerzit e shkolluar bëjn kompromis me masën. Të gjithë panditet bëjnë kompromisë me masën. Për këtë kurrë nuk keni ndëgjuar që aso njeriu është gozhduar në kryq. Ata e ndjekin masën. Gjithmonë bëjnë kompromise. Dhe kompromiset e tyre jan që vazhdojnë. Kur shkojnë te Buddha apo Mansoori, i përkulen, por njejt i përkulen edhe masës. Ata jan shumë njerëz dhelpnak.

Por Shiblia plotsisht është ndrruar. Ai e ka kuptuar. Çka Mansoori ka ndij për te dhe për çka ka qajtur për te, e ka transformuar. Më von vet Shiblija është bër Mësues shpirtror. Ju kan nevoitur 20 vjet. Ka bredhur si lyps, endacak. Dhe njerzit e kan pyetur: „Pse je bër endacak rrugaq? Qka po hulumton", sepse Shiblia tër kohes si endacak i ka ra gjoksit dhe ka qajtur. Kur hynte në gjami ka qajtur dhe ka vajtuar ashtu që tër fshati është mbledhur. Vaji i tij aqë mallëngjyes dhe aqë vajtues ka qenë ku njerzit e kan pyetur: „Qka po bën? Qfar mëkati ke bërë?"Kurse ai ju ka thanë: „E kam mbytur Mansoorin.

Askush tjetër nuk ka qenë përgjegjës. Vetem une kam muajtur me e kuptuar dhe i kam hedhur lule mbi atë njeri. Kamë bërë kompromis me

masen e njerzve. Une kam qenë masa e njerzve. Kam muajtur me e pshtuar ate, por e kam lshuar atë moment. Dhe për këtë tash po pendohem. “

Tër jetën Shiblia është penduar. Pendimi mundet me qenë gjë shumë me rëndësij, nëse e kuptoni këtë përgjegjësij. Atëherë edhe imtësija më e vogël, nëse bëhet pendim dhe kjo jo vetem verbalisht dhe sipërfaqësisht – nëse ky pendim mbërrinë deri te rrënjet tuaja dhe nëse pendohi prej thellsisë së shpirtit, nëse tërë qenja e juaj shkundet, dhe dridhet e qanë dhe lotët rrjedhin jo vetëm prej syve por edhe prej çdo stacion të trupit tënd – vetem atëherë pendimi mund të te bjen deri te transformimi. E till është domethanja kur Jesusi gjithnjë e ka përsëritur: „Pendohuni“.

Mësuesi i Jesusit Ivan Kristiteli, nuk ka pasur shum fjalë. Porosija e tij e tërë ka qenë: „Pendohuni sepse mbretrija Hyjnore është afër. Ajo vjen, e ju pendohuni para se mbretrija hyjnore të vjen. “

Pendimi, jo vetem mentalisht po shpirtrisht plotsisht pastron dhe ripastron. Asgjë nuk mundet me ju pastruar se sa kjo mënyrë. Ky është zjarri i cili shkatron të tërë bërllogun në ju.

Pendimi i Mansoorit e ka ndjekur Shiblijen tër jetës dhe ate a ka qenë zgjut apo fjetur, lotët e Mansoorit pa ndërpre e kan ndjekur ku ka shkuar. Dhe kjo e ka pru te transformimi. Një gjë të tillë vetem mësuesit e mëdhenjë mund ta bëjnë. Kurse Mansori këtë e ka bërë. Deri edhe sa ka vdekur, e ka ndërruar njeriun siç ka qenë Shiblia. Deri edhe sa ka vdekur, e ka shfrytëzuar vdekjen e vet që ta ndërroi atë njeri. Mësuesi kurr nuk ndalet. I gjallë apo i vdekur, apo gati i vdekur. Mësuesi e shfrytzon çdo rast që t’i transferojë dhe t’i ndërrojë njerëzit.

IV - ZHUAN FALUN – LIGJI I BUDHËS

1. Leksioni i Parë

(…..)

Gjërat që u ndodhin njerëzve të zakonshëm, sipas Shkollës së Buddhës, kanë të gjitha lidhje të paracaktuara nga fati. Lindja, plakja, sëmundjet dhe vdekja ekzistojnë si të tilla për njerëzit e zakonshëm. Për shkak të ***karmës*** (Karmë, -a - një substancë e zezë në trup me ekzistencë materiale në një dimension tjetër) së grumbulluar nga veprimet e këqija të mëparshme, njeriu ka sëmundje apo fatkeqësi; vuajtja është shpagim i borxhit karmik dhe për rrjedhojë askush nuk mund ta ndryshojë këtë sipas dëshirës. Ta ndryshosh këtë do të thotë që dikujt nuk do i duhet të paguajë borxhin pasi të jetë në borxh dhe kjo nuk mund të bëhet sipas dëshirës. Të bësh këtë është njësoj sikur të kryesh një vepër të keqe.

(…..)

Në Buddhizëm, flitet për natyrën e Buddhës. Kur dikush fillon të shfaqë natyrë Buddhe, Qëniet e Shumëlartësuara mund ta ndihmojnë atë. Çfarë do të thotë kjo? Po të më pyesni mua, meqenëse unë po jap mësim praktike të niveleve të larta, kjo ka të bëjë me parime të niveleve të larta si dhe me çështje të një rëndësie të madhe. Ne dimë që në këtë univers jeta e njeriut nuk krijohet në shoqërinë e zakonshme njerëzore; krijimi i jetës së vërtetë të dikujt ndodh në hapësirën e universit. Meqenëse ekzistojnë plot materie të llojeve të ndryshme në këtë univers, kjo materie mund të prodhojë jetë nëpërmjet ndërveprimeve të saj. Me fjalë të tjera, jeta më e hershme e dikujt vjen nga universi. Hapësira e universit është pikë së pari mëshirëplotë dhe përmban karakteristikën Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Në lindje, ai i asimilohet karakteristikës së universit. Por ndërsa numri i jetëve rritet, një formë kolektive marëdhëniesh shoqërore krijohet në të cilat disa mund të zhvillojnë egoizëm dhe gradualisht niveli i tyre bie. Nëqoftëse nuk mund të qëndrojnë në këtë nivel, ata duhet të bien më poshtë. Por edhe në këtë nivel, ata përsëri mund të bëhen jo aq të mirë dhe nuk mund të qëndrojnë as aty. Ata do të vazhdojnë të bien poshtë e më poshtë derisa, në fund, ata arrijnë këtë nivel të qënieve njerëzore.

E tërë shoqëria njerëzore është në të njejtin nivel. Nga pikëpamja e aftësive mbinatyrale apo e Qënieve të Shumëlartësuara, këto jetë duhet të ishin zhdukur me të rënë në këtë nivel. Megjithatë, nga zemërmirësia mëshirplotë e tyre, Qëniet e Shumëlartësuara u dhanë atyre dhe një mundësi dhe ndërtuan këtë mjedis dhe dimension të veçantë. Të gjitha jetët në këtë dimension janë të ndryshme nga ato të dimensioneve të tjera të universit. Jetët në këtë dimension nuk mund t'i shohin jetët e dimensioneve të tjera apo të vërtetën e universit. Kështu, qëniet njerëzore janë në fakt të humbura si në labirinth. Në mënyrë që të shërojnë sëmundjet apo zhdukin fatkeqësitë dhe karmën, njerëzit duhet të

praktikojnë kultivim dhe të kthehen në origjinë, në veten e tyre të vërtetë. Kështu e shohin këtë çështje të gjitha shkollat e ndryshme kultivuese. Njeriu duhet të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë; ky është qëllimi i vërtëtë i të qenit njeri. Prandaj, sapo një person dëshiron të praktikojë kultivim, kjo konsideroret si shfaqje e natyrës së Buddhës. Një mendim i tillë është shumë i çmuar, sepse ky njeri dëshiron të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë dhe të dalë nga niveli njerëzor.

Mbase të gjithë e kanë dëgjuar këtë thënie në Buddhizëm: "Kur dikujt i shfaqet natyra e Buddhës, kjo trondit botën e ***dhjetë drejtimeve*** (sipas konceptit Buddhist universi ka dhjetë drejtime). "Kushdo që e shikon këtë do të vijë të kontribojë e ta ndihmojë këtë person pa kushte. Kur i afron shpëtim njerëzimit, Shkolla e Buddhës nuk vë kushte apo kërkon ndonjë shpërblim dhe do të ndihmojë pa u kursyer.

(…..)

Çfarë është qigong? Shumë mjeshtër qigongu flasin për këtë. Ajo që them unë është e ndryshme nga ajo që thonë ata. Shumë mjeshtër qigongu flasin për të nga niveli i tyre, ndërsa unë flas mbi kuptimin e qigongut nga një nivel më i lartë që është plotësisht i ndryshëm nga të kuptuarit e tyre. Disa mjeshtër qigongu thonë se qigong ka një histori prej dy mijë vjetësh në vendin tonë. Ka gjithashtu njerëz që thonë se qigong ka një histori prej tre mijë vjetësh. Disa njerëz thonë se qigong ka një histori prej pesë mijë vjetësh, që i afrohet asaj të qytetërimit tonë kinez. Akoma të tjerë thonë se bazuar në gërmimet arkeologjike, ai ka një histori prej shtatë mijë vjetësh dhe kështu e tejkalon historinë e qytetërimit tonë kinez. Por pamvarësisht si e kuptojnë ata, qigongu nuk do të ekzistonte shumë më herët se historia e qytetërimit njerëzor. Sipas teorisë së evolucionit të Darvinit, njerëzit evoluan nga bimë ujore në kafshë ujore. Më pas, ata kaluan të jetojnë në tokë dhe mbi pemë. Në tokë, ata u shndrruan në majmunë dhe së fundi evoluan në njerëzit modernë me kulturë dhe mendim. Në bazë të kësaj llogaritjeje, nuk kanë kaluar as dhjetë mijë vjet që nga dalja e qytetërimit njerëzor. Duke parë akoma më herët, nuk kish as shkrim nëpërmjet lidhjes së nyjeve. Këta njerëz visheshin me gjethe pemësh dhe hanin mish të gjallë. Duke parë akoma dhe më herët, ata ishin plotësisht njerëz të egër dhe primitivë. Ata nuk do dinin as të përdornin zjarrin.

Megjithatë konstatojmë një problem. Plot relike kulturore në shumë vende të botës datojnë shumë më herët se historia e qytetërimit tonë njerëzor. Këto gjetje antike kanë një nivel relativisht të përparuar punimi. Përsa i përket vlerës artistike, ato janë mjaft të përparuara. Njerëzimi modern thjesht po imiton artet e popujve të vjetër dhe këto arte të tyre janë me vlerë të madhe artistike. Megjithatë ato janë relike nga më shumë se njëqind mijë vjet më parë, disa qindra mijra vjet më parë, disa miliona vjet, apo dhe mbi njëqind milion vjet më parë. Mendojeni pak: A nuk e bëjnë ato qesharake historinë e sotme? Në fakt nuk është për të qeshur sepse

njerëzimi vjen duke e përmirësuar dhe rizbuluar veten. Kështu zhvillohet shoqëria. Të kuptuarit fillestar mund të mos jetë plotësisht i saktë.

Shumë njerëz kanë dëgjuar për "kulturën parahistorike", gjithashtu e njohur si "qytetërim parahistorik". Le të flasim për qytetërimin parahistorik. Në këtë tokë, kemi kontinentet e Azisë, Evropës, Amerikës së Jugut, Amerikës së Veriut, Oqeanisë, Afrikës dhe Antarktikës. Gjeologët i quajnë këto pllaka kontinentale. Që nga formimi i pllakave kontinentale deri më sot, kanë kaluar disa dhjetëra milionë vjet. Me një fjalë, shumë kontinente kanë dalë nga fundi i oqeaneve dhe gjithashtu shumë kontinente janë fundosur në fund të tyre. Kanë kaluar mbi dhjetëra miliona vite që kurse ato u stabilizuan në gjendjen e tanishme. Nën ujin e shumë oqeaneve janë zbuluar disa objekte arkitekturore të lashta, të larta e të mëdha. Këto ndërtesa janë punuar shumë bukur dhe nuk janë trashëgim kulturor i njerëzimit tonë modern. Atëhere ato duhet të kenë qenë ndërtuar para se të fundoseshin në fundin e oqeanit. Kush i krijoi këto qytetërime dhjetëra milionë vite më parë? Në atë kohë, raca jonë njerëzore nuk ishte as majmunë. Si mund të krijonim ne gjëra me kaq mençuri? Arkeologët në botë kanë zbuluar një organizëm të quajtur trilobit që pat ekzistuar ndërmjet 600 dhe 260 milionë vjet më parë. Ky lloj organizmi u zhduk 260 milionë vjet më parë. Një shkencëtar amerikan ka zbuluar një fosil trilobiti me një gjurmë njeriu mbi të; duket qartë se gjurma ishte vënë mbi fosil nga një njeri me këpucë. A nuk i qesh kjo historianët? Sipas teorisë së evolucionit të Darvinit, si mund të kishte njerëz 260 milionë vjet më parë?

Në muzeun e Universitetit Kombëtar të Perusë gjendet një shkëmb i skalitur me një figurë njeriu. Pas investigimit ishte përcaktuar se kjo figurë njerëzore ishte skalitur tridhjetë mijë vjet më parë. Megjithatë, kjo figurë njeriu është e veshur me rroba, kapele dhe këpucë, me një teleskop në dorë dhe ai po vëzhgon trupat qiellorë. Si mund të tjerrnin pëlhurë dhe bënin rrobe njerëzit tridhjetë mijë vjet më parë? Akoma më e papërceptueshme, ai po vëzhgonte trupat qiellorë me teleskop dhe kishte një fare njohurie astronomike. Ne kemi menduar gjithmonë se ishte Galileo, një Evropian, ai që zbuloi teleskopin, duke i dhënë një histori prej vetëm më shumë se treqind vjetësh. Atëhere kush e zbuloi teleskopin tridhjetë mijë vjet më parë? Ka akoma shumë të panjohura të pazgjidhura. Për shembull, ka piktura të gdhendura në shumë shpella të Francës, Afrikës Jugut dhe të Alpeve që duken shumë reale dhe si të gjalla. Figurat e gdhendura aty janë jashtëzakonisht të bukura dhe janë të ngjyrosura me një lloj boje minerali. Të gjithë këta njerëz kanë veshur rroba bashkëkohore që duken pak si veshje perëndimore dhe ata kanë veshur pantallona të ngushta. Disa njerëz mbajnë diçka të ngjashme me llullat, ndërsa të tjerë mbajnë bastonë dhe kanë kapele. Si munden majmunët e disa qindra mijra viteve më parë të arrijnë një nivel artistik të përparuar të tillë?

Le të japim një shembull tjetër të një kohe më të largët, Republika e Gabonit në Afrikë ka mineral uraniumi. Ky vend është relativisht i pazhvilluar. Ai nuk mund të prodhojë uranium vetë dhe e eksporton mineralin në vendet e zhvilluara. Në vitin 1972, një prodhues francez importoi mineralin e tyre të uraniumit. Pas testimesh në laborator, minerali uraniumit doli që kish qënë gërmuar dhe përdorur më parë. Atyre ju duk kjo mjaft e pazakontë dhe dërguan shkencëtarë për ta studjuar këtë. Shkencëtarë nga shumë vende të tjera shkuan atje të investigonin. Në fund, kjo minierë uraniumi u verifikua të ishte një reaktor nuklear i përmasave të mëdha me një shtrirje shumë racionale. Edhe njerëzit modernë nuk do të mund ta krijonin atë. Atëhere kur ishte ndërtuar ajo? Ishte ndërtuar dy miliard vjet më parë dhe kish qënë në operim për 500 mijë vjet. Këto janë thjesht numra astronomikë dhe nuk mund të shpjegohen aspak me teorinë e evolucionit të Darvinit. Ka shumë shembuj të tjerë të ngjashëm. Ato që ka zbuluar komuniteti shkencor dhe teknologjik i sotëm janë të mjaftueshme të ndryshojne tekstet tona aktuale. Kur të menduarit konvencional të njerëzimit formon një mënyrë sistematike të punës dhe të të menduarit, idetë e reja e kanë shumë të vështirë të pranohen. Kur e vërteta del në pah, njerëzit nuk guxojnë ta pranojnë dhe instinktivisht e refuzojnë atë. Për shkak të ndikimit të marreveshjeve tradicionale, asnjë sot nuk i ka përmbledhur në mënyrë sistematike këto gjetje. Kështu, konceptet njerëzore gjithmonë mbesin prapa zhvillimeve. Sapo të flasësh për këto gjëra, ka njerëz që i quajnë ato paragjykime dhe i refuzojnë ato pavarësisht nga fakti që ato janë zbuluar tashmë. Ato veçse nuk janë publikuar gjërësisht.

Shumë shkencëtarë të guximshëm jashtë vendit e kanë pranuar publikisht tashmë këtë si kulturë parahistorike dhe një qytetërim para këtij tonit. Me fjalë të tjera, kanë ekzistuar më shumë se një periudhë qytetërimi para qytetërimit tonë. Nëpërmjet relikeve të nxjerra nga toka, kemi gjetur prodhime që nuk janë vetëm prej njërës nga periudhat e qytetërimit. Kështu besohet se pas çdo here kur qytetërimet njerëzore u zhdukën, vetëm një numër i vogël njerëzish mbijetuan dhe ata bënë një jetë primitive. Më pas, ata gradualisht u rritën në numër dhe krijuan rracën e re njerëzore, duke filluar një qytetërim të ri. Më vonë, ata përsëri u zhdukën dhe përsëri krijuan një racë të re njerëzore. Historia kalon thjesht përmes këtyre ndryshimeve në perudha të ndryshme. Fizikantët thonë se lëvizja e materies ndjek ligje të caktuara. Gjithashtu edhe ndryshimet e gjithë universit tonë ndjekin ligje.

Është e pamundur që planeti jonë Tokë, në këtë gjithësi të pamasë dhe në Kashtën e Kumtrit, të jetë rrotulluar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha kohët. Mund të jetë përplasur me ndonjë planet tjetër apo të ketë pasur probleme të tjera që çuan në shkatërrime të mëdha. Nga pikëpamja e aftësive tona mbinatyrale, ishte planifikuar në atë mënyrë. Unë bëra një

investigim të kujdesshëm një herë dhe gjeta se njerëzimi ka kaluar zhdukje të plota tetëdhjetë e një herë. Me pak mbetje nga qytetërimi i mëparshëm, vetëm një numër i vogël njerëzish mbijetonin dhe hynin në periudhën tjetër, duke bërë përsëri një jetë primitive. Me rritjen e popullsisë, qytetërimi do të lindte përsëri. Njerëzimi ka kaluar ndryshime të tilla nga koha në kohë tetëdhjetë e një herë dhe akoma nuk i kam zbuluar deri në fund. Kombi kinez flet për kohë kozmike, kushte të favorshme të tokës dhe harmoni njerëzore. Transformime të ndryshme kozmike dhe kohëra të ndryshme kozmike mund të sjellin kushte të ndryshme në shoqërinë njerëzore. Sipas fizikës, lëvizja e materies ndjek ligje të caktuara dhe kjo është e vërtetë edhe për lëvizjen e universit.

Referenca e mësipërme për kulturën parahistorike në radhë të parë tregon se qigong nuk u zbulua nga ky njerëzimi jonë. Ai u trashëgua nga një epokë shumë e largët dhe është gjithashtu një lloj kulture parahistorike. Nga shkrimet e shenjta Buddhiste mund të gjejmë disa thënie në lidhje me këtë. Sakyamuni pat thënë një herë se ai e kish përfunduar praktikën kultivuese disa qindra milionë ***kalpa*** më parë (kalpa=periudhë që zgjat dy miliard vjet). Një numër kaq i madh është thjesht i pa përceptueshëm. Nëse është e vërtetë, a nuk përkon kjo me historinë e njerëzimit dhe ndryshimet e tokës? Po ashtu, Sakyamuni përmend se kanë ekzistuar gjashtë Buddha primitivë para tij, se ai kishte mësues etj. , të cilët kishin përfunduar të gjithë praktikën kultivuese disa qindra milionë kalpa më parë. Nëqoftëse e gjitha kjo është e vërtetë, a ka lloje praktikash nga ato praktika tradicionale dhe mësime të vërteta që mësohen në shoqërinë tonë sot? Po të më pyesni mua, sigurisht që ka, por ato shihen rrallë. Në kohën tonë, qigongu i rremë e mashtrues dhe njerëz të zotëruar nga shpirtrat kanë shpikur gjëra nga vetja që të gënjejnë njerëzit dhe numri i tyre e tejkalon shumë herë atë të praktikave të vërteta të qigongut. Të dallosh të vërtetën nga gënjeshtra është e vështirë. Një praktikë qigongu e vërtetë nuk është e lehtë të dallohet dhe as e lehtë që të gjehet.

Në fakt, nuk është vetëm qigong që ka ardhur këtu nga një epokë e largët, por edhe ***Taiji*** (Taiji (tai-çi) - simboli i Shkollës Tao, që njihet gjërësisht në Perëndim si "simboli yin-yang"(jin-jang).

Hetu, Luoshu (Hetu, Luoshu - diagrame parahistorike që u shfaqën në Kinën e lashtë dhe mendohet të tregojnë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës.), ***Libri i Ndryshimeve*** (Libri i Ndryshimeve - libër profecie i lashtë kinez që daton në Dinastinë Zhou (1100 - 221 p. e. r.), ***Tetë Triagramet*** (Tetë Triagramet - nga Libri i Ndryshimeve, një diagram parahistorik që mendohet të tregojë të vërtetën e ndryshimeve të kursit të natyrës)…, etj. , të gjitha këto janë trashëguar nga parahistoria. Kështu, po t'i studjojmë dhe t'i kuptojmë ato nga pikëpamja e njeriut sot, ne nuk do të mundim t'i kuptojmë ato aspak. Nga niveli, perspektiva dhe pikëpamja e njeriut të zakontë, ti nuk mund të kuptosh gjëra të vërteta.

(…..)

Gjatë gjithë historisë, çështja nëse materia përcakton mëndjen apo anasjelltas është diskutuar e debatuar vazhdimisht në botën e filozofisë. Në fakt, më lejoni t'ju them të gjithëve se materia e mëndja janë e njejta gjë. Në fushën e kërkimit shkencor të trupit të njeriut, shkencëtarët e sotëm thonë se mendimi i prodhuar nga truri njerëzor është një substancë. Nëqoftëse qenka diçka me ekzistencë materiale, a nuk është ajo gjithashtu diçka prej mëndjes njerëzore? A nuk janë ato e njejta gjë? Po kështu dhe universi që përshkrova, nuk ka vetëm ekzistencën materiale, por në të njejtën kohë edhe karakteristikën e vet. Një njeri i zakonshëm nuk mund ta dallojë ekzistencën e kësaj karakteristike, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), në univers sepse njerëzit e zakonshëm janë të gjithë në të njejtin nivel. Kur ti ngrihesh mbi nivelin e njeriut të zakonshëm, ti do të jesh në gjendje ta dallosh atë. Si e dallon ti atë? E gjithë materia në univers, duke përfshirë dhe të gjitha substancat që e përbëjnë universin, janë qënie të gjalla me mëndje që mendojnë dhe të gjitha ato janë forma ekzistence të Ligjit të universit në nivele të ndryshme. Ato nuk të lënë ty të ngjitesh në nivele. Megjithëse ti don të ngjitesh, ti nuk mundesh. Ato thjesht nuk të lejojnë të ngjitesh lart. Pse nuk të lejojnë të ngjitesh lart? Sepse karakteri jot nuk është përmirësuar. Çdo nivel ka kriteret e veta. Nëqoftëse dëshiron të ngjitesh në një nivel më të lartë, ti duhet të braktisësh mendimet e këqija dhe të pastrosh gjërat e tua të papastërta që tu nënshtrohesh kërkesave të standartit në atë nivel. Vetëm duke bërë këtë mundesh ti të ngjitesh.

Me të përmirësuar karakterin, trupi juaj do të pësojë një ndryshim të madh. Me përmirësimin e karakterit, materia e trupit tuaj është e garantuar që do të transformohet. Çfarë ndryshimesh do të ndodhin? Ti do të heqësh dorë nga ato gjëra të këqija pas të cilave ti je i dhënë. Për shembull, nëse një shishe e mbushur me gjëra të papastra është e mbyllur fort dhe hedhur në ujë, ajo do të fundoset direkt e në fund. Ti nxjerr jashtë disa nga përmbajtjet e pista. Sa më shumë që e zbraz ti shishen, aq më lart do notojë ajo mbi ujë. Po të boshatiset plotësisht, ajo do të notojë plotësisht mbi sipërfaqe. Gjatë kohës tënde të praktikës kultivuese, ti duhet të pastrosh shumë gjëra të këqija në trupin tënd në mënyrë që të ngjitesh lart. Kjo karakteristikë e universit luan pikërisht këtë rol. Nëqoftëse ti nuk kultivon karakterin tënd, nuk përmirëson standartin tënd moral, apo nëse mendimet e substancat e tua të këqija nuk janë hequr, ajo nuk do të të lejojë që të ngjitesh.

Komuniteti i kultivuesve beson se Shpirti Primordial i njeriut nuk zhduket. Në të kaluarën, njerëzit mund ta konsideronin si paragjykim diskutimin mbi Shpirtin Primordial të njeriut. Dihet se kërkimi mbi trupin e njeriut në fizikë ka zbuluar molekula, protone, elektrone e deri poshtë tek kuarket, neutrinot etj. Në këtë pikë, mikroskopi nuk mund t'i dallojë më ato. Megjithatë këto grimca janë larg origjinës së jetës dhe origjinës së materies. Të gjithë e dinë se duhet një sasi e konsiderueshme fërkimi

energjie dhe një sasi e madhe nxehtësie që të bëhet e mundur bashkimi apo ndarja e bërthamës. Si munden bërthamat e një trupi të zhduken pasi dikush vdes? Prandaj, ne kemi parë se kur një njeri vdes, vetëm elementet molekulare më të mëdha në këtë dimensionin tonë vdesin, ndërsa trupat në dimensionet e tjera nuk degjenerojnë. Mendojeni pak të gjithë: Si duket trupi i njeriut nën mikroskop? I gjithë trupi i njeriut është në lëvizje. Ndërsa ju rrini aty pa lëvizur, i tërë trupi juaj është në lëvizje. Qelizat molekulare janë në lëvizje dhe i gjithë trupi është i palidhur sikur të ishtë i përbërë prej rëre. Një trup njerëzor duket pikërisht kështu nën mikroskop dhe kjo është shumë e ndryshme nga si duket ai me sy. Kjo ndodh sepse këta dy sy njerëzorë krijojnë një pamje të rreme për juve dhe nuk ju lejojnë që t'i shikoni këto gjëra. Kur dikujt i hapet Syri Qiellor (tianmu) (gjithashtu i njohur si "syri i tretë"i ndodhur në mes të ballit, pak sipër vetullave), ai mund t'i shikojë gjërat duke i zmadhuar ato; kjo është në fakt një aftësi e lindur njerëzore që tani quhet aftësi supernormale. Nëqoftëse dëshironi të zhvilloni aftësi supernormale, ju duhet të ktheheni tek origjina, vetja juaj e vërtetë dhe të ktheheni nëpërmjet kultivimit.

(…..)

Le të flasim për virtytin. Çfarë lidhje të veçantë ka ai? Ne do e analizojmë atë në detaj. Si qënie njerëzore, ne kemi një trup në secilin nga dimensionet e shumta. Kur e examinojmë trupin e njeriut, elementet më të mëdha janë qelizat dhe ato përbëjnë trupin fizik të njeriut. Po të mund të hynit në hapësirën ndërmjet qelizave e molekulave apo në hapësirën ndërmjet molekulave, juve do t'ju duket se jeni në një dimension tjetër. Kujt i ngjan ajo formë ekzistence e trupit? Sigurisht ju nuk mund të përdorni konceptet e këtij dimensioni që ta kuptoni atë dhe trupi juaj duhet të përputhet me kërkesat e formës së ekzistencës së atij dimensioni. Së pari trupi në një dimension tjetër mund të bëhet i madh apo i vogël. Në atë kohë juve do t'ju duket gjithashtu një dimension i pafund. Kjo është një formë e thjeshtë si dimensionet e tjera ekzistojnë njëkohësisht në të njejtin vend. Çdo njeri ka një trup të veçantë në secilin nga dimensionet e shumta. Në një dimension të caktuar ekziston një fushë që rrethon trupin e njeriut. Çfarë lloj fushe është ajo? Kjo fushë është virtyti që e përmendëm më parë. Virtyti është një substancë e bardhë dhe jo siç besonin në të kaluarën diçka shpirtërore e abstrakte - ajo absolutisht ka një formë ekzistence materiale. Kështu në të kaluarën, të moçmit flisnin për akumulim të virtytit dhe ata flisnin me shumë mençuri për këtë. Ky virtyt formon një fushë që rrethon trupin e njeriut. Në të kaluarën, Shkolla Tao besonte që mjeshtri zgjedh dishepullin dhe jo dishepulli zgjedh mjeshtrin. Çfarë do të thotë kjo? Një mjeshtër do të kontrollonte nëse trupi i atij dishepulli përmbante një sasi të madhe virtyti. Nëqoftëse ky dishepull kishte shumë virtyt, do të ishte më e lehtë për të të praktikonte kultivim. Përndryshe, ai nuk do e kishte të lehtë dhe ai do të kishte mjaft vështirësi të zhvillonte gong drejt niveleve të larta.

Në të njejtën kohë, ekziston një lloj substance e zezë që ne e quajmë "karma"dhe që Buddhismi e quan "karmë mëkatare". Këto substanca të zeza dhe të bardha ekzistojnë njëkohësisht. Çfarë lloj lidhjeje kanë këto dy substanca? Ne e marrim virtytin nëpërmjet vuajtjeve, duke duruar vështirësi dhe duke kryer vepra të mira; substanca e zezë mblidhet nga kryerja e veprave të këqija dhe nga trajtimi keq i njerëzve. Sot disa njerëz jo vetëm që e kanë mëndjen vetëm tek fitimi por ata shkojnë deri aty sa kryejnë të gjitha të këqijat. Ata bëjnë çdo lloj të keqe për para deri tek kryerja e vrasjeve, paguajnë dikë që të vrasë, praktikojnë homoseksualitet dhe përdorin drogë. Ata bëjnë gjithë llojet e gjërave. Njeriu humb virtyt kur ai bën keq. Si e humb njeriu virtytin? Kur dikush ofendon dikë, ai mendon se ja kaloi tjetrit dhe ndjehet mirë. Ekziston një parim në këtë univers që quhet "pa humbje nuk ka fitim". Që të fitosh duhet të humbësh. Po nuk deshe të humbësh ti do të detyrohesh të humbësh. Kush e luan këtë rol? Është pikërisht karakteristika e universit që e merr këtë rol. Kështu, është e pamundur që ti të duash vetëm të marrësh gjëra. Çfarë do të ndodhte atëhere? Kur dikush ofendon apo kërcënon një person tjetër, ai i jep virtyt atij personi. Përderisa personi tjetër është pala që keqtrajtohet dhe ka humbur diçka e vuan, ai kompensohet siç duhet. Ndërsa një person është këtu duke sharë, me të dalë ofendimi nga goja e tij, një copë virtyti nga fusha e tij dimensionale largohet e i shkon personit tjetër. Sa më shumë që ai e shan tjetrin, aq më shumë virtyt ai i jep atij. Kjo është e vërtetë dhe kur dikush rreh apo kërcënon të tjerët. Ndërsa dikush godet apo shkelmon një person tjetër, ai do t'i japë atij virtyt nga vetja në varësi nga sa keq ai e rreh tjetrin. Një njeri i zakonshëm nuk e shikon këtë parim në këtë nivel. Ngaqë ndjehet i përulur, ai nuk mund ta durojë këtë dhe mendon, "Përderisa ti më godite, unë duhet të ta kthej me të njejtën mënyrë. ""Bam", ai i jep atij personi një të goditur mbrapsht dhe i kthen atij virtyt. Asnjeri nuk fitoi apo humbi ndonjë gjë. Ai mund të mendojë, "Ti më godite një here, kështu unë duhet të të godas dy herë. Përndryshe, unë nuk mora hak. "Ai do e godasë atë përsëri dhe një copë tjetër nga virtyti i tij do t'i jepet personit tjetër.

Pse vlerësohet kaq shumë virtyti? Çfarë lloj lidhjeje ekziston në transformimin e virtytit? Fetë thonë: "Me virtyt njeriu do të fitojë diçka në jetën tjetër në mos në këtë jetë. "Çfarë do të fitojë ai? Me shumë virtyt, njeriu mund të bëhet zyrtar i një rangu të lartë apo të bëjë pasuri të madhe. Ai do të arrinte çfarë të donte dhe ato shkëmbehen me këtë virtyt. Fetë gjithashtu thonë se nëse dikush nuk ka virtyt, si trupi ashtu dhe shpirti i tij do të eliminohen. Shpirti Primordial i tij do të eliminohet dhe kur të vdesë ai do vdesë plotësisht e nuk do t'i mbetet asgjë. Në komunitetin tonë të praktikuesve, ne besojmë se virtyti mund të trasformohet direkt në gong.

(…..)

Kjo praktika jonë është praktikë kultivuese e vërtetë e mëndjes dhe e trupit. Gongu që ne kultivojmë ruhet në çdo qelizë të trupit dhe ky gong me energji të lartë ruhet madje dhe në grimcat më të vogla të origjinës në një nivel jashtëzakonisht mikroskopik. Ndërsa potenciali i gongut tënd rritet, dendësia dhe fuqija e gongut gjithashtu rriten. Një lëndë energjie kaq e lartë ka intelligjencë. Meqenëse ruhet në çdo qelizë të trupit të njeriut deri tek origjina e jetës, ajo do të marrë gradualisht të njëjtën formë si dhe qelizat e trupit tuaj, duke marrë të njëjtin kombinim molekular dhe formë të bërthamave. Esenca e trupit ka ndryshuar tashmë sepse ky trup nuk është më i përbërë nga qelizat fizike origjinale. A nuk je ti përtej Pesë Elementeve? Sigurisht praktika jote kultivuese nuk ka mbaruar dhe ti akoma duhet të praktikosh kultivim në mes të njerëzve. Prandaj, në sipërfaqe ti përsëri do të dukesh si njeri i zakonshëm. I vetmi ndryshim është se ti dukesh më i ri sesa ata të moshës tënde.

2. Leksioni i Dytë

Shumë mjeshtër qigongu kanë folur mbi Syrin Qiellor. Por Ligji ka manifestime të ndryshme në nivele të ndryshme. Një praktikues, kultivimi i të cilit ka arritur një nivel të caktuar, mund të shikojë vetëm manifestimet e atij niveli. Ai nuk mund të shikojë të vërtetën përtej nivelit të tij dhe as që ka për ta besuar atë. Prandaj, ai konsideron si të saktë vetëm atë që ai sheh në nivelin e tij. Para se kultivimi i tij të arrijë një nivel më të lartë, ai mendon se ato gjëra nuk ekzistojnë dhe nuk janë të besueshme; kjo përcaktohet nga niveli i tij dhe mëndja e tij nuk mund të lartësohet. Me fjalë të tjera, mbi çështjen e Syrit Qiellor, disa njerëz flasin për të në një mënyrë dhe të tjerë flasin në një mënyrë tjetër. Si rezultat, ata e kanë ngatërruar çështjen dhe së fundi asnjë nuk mund ta shpjegojë atë qartë. Syri Qiellor, në fakt, është diçka që nuk mund të shpjegohet qartë në nivel të ulët. Në të kaluarën, struktura e Syrit Qiellor i përkiste sekretit të sekreteve dhe njerëzit e zakonshëm ishin të ndaluar ta dinin atë. Kështu, gjatë gjithë historisë askush nuk fliste për të. Por këtu ne nuk e trajtojmë atë në bazë të teorive nga e kaluara. Ne përdorim shkencën moderne dhe gjuhën më të thjeshtë të kohës së sotme për ta shpjeguar atë dhe ne do të shtjellojmë çështjet kryesore të tij.

Syri Qiellor për të cilin po flasim është i vendosur pak më sipër dhe në mes të vetullave dhe lidhet me gjendrën pineale të trurit. Ky është kanali kryesor. Trupi njëriut ka shumë sy të tjerë. Shkolla Tao thotë se çdo hapje është sy. Shkolla Tao quan një pikë akupunkture në trup "hapje"ndërsa mjekësia kineze e quan atë pikë akupunkture. Shkolla Buddhës beson se çdo pore djerse është sy. Prandaj disa njerëz mund të lexojnë me veshë dhe disa mund të shikojnë me duar apo nga mbrapa kokës; akoma të tjerë mund të shikojnë me këmbë apo bark. Është plotësisht e mundur.

Me që po flasim për Syrin Qiellor, do flasim së pari për këta palë sy fizikë njerëzore. Në kohën tonë, disa njerëz mendojnë se këta palë sy mund të shikojnë çdo materie apo objekt në këtë botë. Prandaj, disa njerëz kanë zhvilluar nocionin kokëfortë se vetëm çfarë mund të shihet me sy është e vërtetë dhe konkrete. Ata nuk besojnë atë që nuk e shohin. Në të kaluarën, këta njerëz konsideroheshin të kishin cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror, megjithëse njerëzit nuk mund ta shpjegonin qartë pse cilësia e ndriçmit shpirtëror të këtyre njerëzve ishte e varfër. Po nuk e pashë, nuk e besoj. Kjo mund të duket shumë e arsyeshme. Megjithatë nga pikëpamja e një niveli më të lartë, nuk është e arsyeshme. Çdo kohë-hapësirë është e përbërë prej materie. Sigurisht, kohë-hapësira të ndryshme kanë struktura fizike të ndryshme dhe forma të shumta manifestimi jetësh të ndryshme.

Le t'ju jap një shembull. Në Buddhizëm, thuhet se çdo fenomen në shoqërinë njerëzore është vegim dhe jo i vërtetë. Si janë ato vegime? Objekte të vërteta dhe konkrete janë të vendosura tamam para jush, pra kush do të pretendonte që janë të rreme? Forma fizike e paraqitjes së objektit duket ashtu, por mënyra e vërtetë e ekzistencës së tij nuk është ashtu. Sytë tanë kanë aftësinë të stabilizojnë objekte fizike në dimensionin tonë fizik në formën që ne i shikojmë tani. Objektet nuk janë në fakt në këtë gjendje dhe ato nuk janë në atë gjendje madje edhe në dimensionin tonë. Për shembull, si duket njeriu nën mikroskop? I tërë trupi tij është i përbërë nga molekula të lira dhe të vockla, tamam si kokrrizat e rërës që janë në lëvizje. Elektronet rrotullohen rreth bërthamës dhe i tërë trupi është në lëvizje. Sipërfaqja e trupit nuk është as e lëmuar e as e rregullt. Çfarëdo materie në univers, si çeliku, hekuri dhe shkëmbinjtë janë po ashtu në lëvizje dhe brenda tyre të gjitha elementet molekulare të tyre janë në lëvizje. Njeriu nuk mund ta shikojë formën e tyre të plotë dhe ato nuk janë në fakt në qetësi. Kjo tavolinë po ashtu është në lëvizje, megjithatë sytë tuaj nuk mund ta shikojnë këtë të vërtetë. Këta palë sy mund të na japin përshtypje të rreme si kjo.

Nuk është se ne nuk mund të shikojmë gjërat në nivelin mikroskopik, apo që njerëzit nuk e kanë këtë aftësi. Njerëzit lindin me ketë aftësi dhe ata mund të shikojnë gjërat në një nivel të caktuar mikroskopik. Pikërisht pse në këtë dimension fizik ne kemi këto palë sy, njerëzit marrin përshtypje të rreme dhe i ndalohet të shikojnë gjërat. Kështu, në të kaluarën thuhej se kur njerëzit nuk besonin ato gjëra që nuk mund t'i shikonin, këta njerëz konsideroheshin nga komuniteti i kultivuesve se kishin cilësi ndriçimi shpirtëror të varfër, se ishin të gënjyer nga pamjet fallso të njerëzve të zakonshëm dhe se ishin të humbur në mes të njerëzve të zakonshëm. Kjo është thënie e bërë historikisht nga fetë. Aktualisht, ne gjithashtu kemi konstatuar të jetë shumë e arsyeshme.

Këto palë sy mund të stabilizojnë gjërat në dimensionin tonë fizik në gjendje të tillë. Përveç kësaj, ata nuk kanë ndonjë aftësi tjetër të

rëndësishme. Kur dikush shikon diçka, imazhi nuk formohet direkt në sy. Sytë janë si lentet e aparatit fotografik, ato veprojnë vetëm si përçues. Kur shikon nga larg, lentja zmadhohet; sytë tanë po ashtu marrin këtë funksion. Kur shikon në errësirë, bebet e syrit zmadhohen. Kur një aparat merr një foto në arrësirë, objektivi i tij po ashtu zmadhohet. Përndryshe, foto do të ishte e errët me ekspozim drite të pamjaftueshme. Kur ti del në një vend shumë të ndritshëm jashtë, bebet e tua zvogëlohen menjëherë. Përndryshe sytë e tu do të verboheshin nga drita dhe ti nuk do të mund të shikoje qartë. Një aparat punon mbi të njejtin parim dhe objektivi po ashtu duhet të zvogëlohet. Syri mund të kapë vetëm pamjen e një objekti dhe kështu është thjesht një vegël. Kur ne shohim gjëra aktualisht, një person apo kur shohim formën e ekzistencës së një objekti, imazhet formohen në tru. Domethënë, çfarë shohim me sy dërgohet në gjendrën pineale në fund të trurit nëpërmjet nervit optik dhe pastaj reflektohet si pamje në atë pjesë. Kjo është si të thuash që pamjet aktuale të reflektuara shihen në gjendrën pineale të trurit. Mjekësia moderne gjithashtu e ka pranuar këtë.

Hapja e Syrit Qiellor që ne po trajtojmë shmang përdorimin e nervit optik njerëzor dhe hap një kalim ndërmjet vetullave kështu që gjendra pineale e trurit mund të shikojë direkt jashtë. Kjo quhet hapje e Syrit Qiellor. Disa njerëz mund të gjykojnë: "Kjo nuk është realiste. Mbi të gjitha, këta palë sy prapseprap mund të shërbejnë si mjet dhe ata mund të kapin pamjet e objekteve, diçka e pamundur pa sytë. "Anatomia e mjekësisë moderne, ka zbuluar tashmë se pjesa ballore e gjendrës pineale të trurit është e pajisur me një strukture të plotë të një syri njerëzor. Meqenëse rritet brenda kafkës, thuhet se është sy rudimentar. Nëse është sy rudimentar apo jo, komuniteti i kultivuesve ka rezervime. Megjithatë mjekësia moderne ka pranuar mbi të gjitha se ekziston një sy në mes të trurit njerëzor. Kalimi që ne hapim synon pikërisht atë vend dhe kjo është në përputhje të plotë me të kuptuarin e mjekësisë moderne. Ky sy nuk krijon imazhe fallco si pala e syve tanë fizikë, sepse shikon si natyrën e materies ashtu dhe esencën e materies. Prandaj, një person me Sy Qiellor të nivelit të lartë mund të shikojë përtej dimensionit tonë në kohë-hapësira të tjera dhe mund të shikojë skena të cilat njerëzit e zakonshëm nuk mund t'i shohin. Një person me Sy Qiellor të nivelit të ulët mund të ketë shikim penetrues e mund të shikojë gjëra përtej një muri apo shikojë brenda trupit të njeriut. Ai ka pikërisht këtë aftësi supernormale.

Shkolla e Buddhës flet për pesë nivele të shikimit: Shikim Mishtor, Shikim Qiellor, Shikim Mençurie, Shikim Ligji dhe Shikim Buddhe. Këto janë pesë nivelet kryesore të Syrit Qiellor dhe secili ndahet në nivel të sipërm, mesëm dhe ulët. Shkolla Tao flet për nëntë herë nëntë apo tetëdhjetë e një nivele të Shikimit të Ligjit. Ne po hapim Syrin Qiellor për secilin këtu, por ne nuk e hapim atë tek apo më poshtë se Shikimi Qiellor. Pse? Megjithëse ti je këtu dhe ke filluar të praktikosh kultivim, ti je, mbi të

gjitha, duke e filluar nga niveli i njeriut të zakonshëm me shumë nga dëshirat e njeriut të zakonshëm akoma të pabraktisura. Nëqoftëse Syri jot Qiellor hapet poshtë Shikimit Qiellor, ti do të kesh atë që njerëzit e quajnë aftësi supernormale, sepse ti mund të shikosh tejpërtej murit dhe trupit të njeriut. Po ta shpërndanim këtë aftësi supernormale gjërësisht dhe nëqoftëse Syri Qiellor i të gjithëve do të hapesh në këtë nivel, kjo do të shqetësonte në mënyrë serioze shoqërinë njerëzore dhe do të prishte gjendjen e zakonshme të shoqërisë njerëzore: sekretet shtetërore do të viheshin në rrezik; do të ishte njësoj sikur njerëzit të ishin pa rroba veshur, ti mund të shikoje njerëzit brenda në shtëpi që nga jashtë; ndërsa shëtit në rrugë, ti mund të kapje çmimet fituese të llotarisë me një shikim. Kjo nuk mund të lejohet! Mendojeni pak, secili: A do të ishte kjo akoma shoqëri njerëzore nëqoftëse Syri Qiellor i të gjithëve do të hapej në Shikimin Qiellor? Të shqetësosh seriozisht gjendjen e shoqërisë njerëzore është absolutisht e ndaluar. Po t'ja u hapja Syrin Qiellor në atë nivel, ju mund të bëheshit mjeshtër qigongu menjerëherë. Disa njerëz endërronin më parë të bëheshin mjeshtër qigongu. Nëqoftëse Syri tyre Qiellor do hapesh papritmas, ata do të ishin të aftë të kuronin pacientë. A nuk do t'ju çoja unë në një rrugë të keqe në këtë rast?

Atëhere, në cilin nivel ja u hap unë Syrin Qiellor juve? Unë do t'jua hap Syrin Qiellor direkt e në nivelin e Shikimit të Mençurisë. Po të hapej në një nivel më të lartë, karakteri juaj nuk është i përshtatshëm. Po të hapej në një nivel më të ulët, kjo do të shqetësonte seriozisht gjendjen e shoqërisë njerëzore. Me Shikim Mençurie, ju nuk keni aftësinë të shikoni gjërat përmes murit apo shikoni brenda trupit të njeriut, por ju mund të shikoni skena që ekzistojnë në dimensione të tjera. Çfarë përfitimi ka kjo? Ajo mund të përforcojë besimin tuaj tek praktika. Kur ju me të vërtetë shikoni diçka që njerëzit e zakonshëm nuk mund ta shikojnë, ju do të mendoni që ekziston me siguri. Pamvarësisht nëse mund të shikoni qartë tani, Syri juaj Qiellor do të hapet në këtë nivel dhe kjo është mirë për praktikën tuaj. Një praktikues i vërtetë i Dafës mund të arrijë të njejtin rezultat duke lexuar këtë libër, me kusht që të jetë i rreptë me veten në përmirësimin e karakterit.

Çfarë e përcakton nivelin e Syrit Qiellor të personit? Nuk është e thënë që me t'u hapur Syri juaj Qiellor, ju do të mund të shikoni çdo gjë—nuk është ashtu. Ekziston edhe një klasifikim nivelesh. Atëhere çfarë i përcakton nivelet? Janë tre faktorë. I pari është që Syri Qiellor i dikujt duhet të ketë një fushë që shkon nga brenda jashtë dhe ne e quajmë këtë esenca e qi-së. Për çfarë shërben ajo? Është si ekran televizori: Pa fosfor, pasi një televizor ndizet, ai është akoma një llampë drite. Do të ketë vetëm dritë, por jo pamje. Pamjet dalin në sajë të fosforit. Sigurisht, ky nuk është shembull shumë i përshtatshëm sepse ne i shikojmë gjërat direkt ndërsa një televizor i paraqet pamjet nëpërmjet ekranit. Kjo është idea në vija të gjëra.

Kjo pjesë esence qi-je është jashtëzakonisht e çmuar dhe përbëhet nga një substancë tej e imët që përpunohet nga virtyti. Normalisht, esenca e qi-së e çdo personi është e ndryshme. Mbase dy në dhjetë mijë veta janë në të njejtin nivel.

Niveli i Syrit Qiellor është manifestim direkt i Ligjit të universit tonë. Është diçka supernormale dhe e lidhur ngushtë me karakterin e personit. Nëqoftëse niveli i karakterit të një personi është i ulët edhe niveli i tij është i ulët. Për shkak të nivelit të ulët të karakterit, shumica e esencës së qi-së së këtij personi ka humbur. Nëqoftëse niveli i karakterit të personit është i lartë dhe në shoqërinë njerëzore ai që nga fëminija deri në moshë të rritur nuk është dhënë pas famës, fitimit, konflikteve me njerëzit, fitimit personal dhe ndjenjave e dëshirave të ndryshme njerëzore, esenca e tij e qi-së mund të jetë ruajtur relativisht më mirë. Prandaj, pasi Syri i tij Qiellor hapet, ai mund t'i shikojë gjërat më qartë. Një fëmijë nën moshën gjashtë vjeç mund të shikojë shumë qartë sapo t'i hapet Syri Qiellor. Është gjithashtu e lehtë të hapësh Syrin e tij Qiellor. Po të them unë një fjalë, do të hapesh.

Për shkak të ndotjes nga korrupsioni i shoqërisë njerëzore, gjërat që njerëzit i quajnë të drejta janë, në fakt, shpesh të gabuara. A nuk duan të gjithë të jetojnë një jetë të mirë? Dëshira për një jetë të mirë mund t'i hyjë në pjesë interesave të të tjerëve, të stimulojë interesat e tua egoiste, të marrë fitimet e të tjerëve apo të çojë në dominimin dhe dëmtimin e të tjerëve. Njeriu konkuron dhe lufton për fitim personal mes njerëzve të zakonshëm. A nuk është kjo të shkosh në drejtim të kundërt me karakteristikën e universit? Kështu, ajo që njerëzit e konsiderojnë të drejtë mund të mos jetë e drejtë në të vërtetë. Kur edukon fëmijën, një i rritur shpesh e mëson atë, "Mësohu të bëhesh i zoti, "kështu që në të ardhmen ai të ecë më i sigurtë në shoqërinë njerëzore. Nga pikëpamja e universit tonë, "të jesh i zoti"është gabim, sepse ne kërkojmë ndjekjen e rrjedhës së natyrshme të gjërave dhe të mos merakosesh për fitim personal. Duke qënë i zoti, ai do të ndjekë interesin personal. "Kushdo që të rrahë, shko tek mësuesi i tij dhe gjeja prindët. ""Merri lekët që gjen në rrugë. "Fëmija mësohet në këtë mënyrë. Nga fëminija deri në moshë të rritur, ndërsa ai merr gjithnjë e më shumë gjëra, ai do bëhet gradualisht gjithnjë e më shumë egoist në shoqëri. Ai do të përfitojë nga të tjerët dhe do të humbë virtyt.

Kjo substancë, virtyti, nuk zhduket pasi dikush e humb atë. Ajo transferohet tek një person tjetër. Ndërsa kjo esencë qi-je mund të zhduket. Nëqoftëse dikush është shumë dinak nga fëminija deri në moshë të rritur, me një dëshirë të fortë për interes vetjak dhe vetëm kërkon fitim, Syri Qiellor i këtij personi nuk do të funksionojë normalisht apo shohë gjërat qartë pasi të hapet. Megjithatë kjo nuk do të thotë se nuk do të funksionojë kurrë më. Pse? Sepse gjatë kursit të praktikës kultivuese ne përpiqemi të kthehemi në origjinë, në veten tonë të vërtetë dhe nëpërmjet praktikës këmbëngulëse ne do të jemi të aftë ta kompensojmë vazhdimisht dhe ta

rifitojmë atë. Prandaj, njeriu duhet t'i kushtojë vëmendje karakterit. Ne theksojmë përmirësim të gjithanshëm dhe ngritje të gjithanshme. Po të ngrihet karakteri, çdo gjë tjetër do të ndjekë atë. Nëqoftëse karakteri nuk ngrihet, as ajo pjesë e esencës së qi-së nuk do të rikuperohet. Ky është parimi.

Faktori i dytë është se kur një person praktikon qigong vetë, Syri tij Qiellor mund të hapet nëqoftëse cilësia e tij e lindur është e mirë. Shpesh, disa njerëz frikësohen në momentin kur u hapet Syri Qiellor. Pse frikësohen ata? Sepse njerëzit zakonisht praktikojnë qigong në mesnatë, kur është errët dhe qetësi. Ndërsa personi praktikon, ai mund të shikojë papritmas një sy të madh para syve të tij, që e frikëson atë menjëherë. Kjo frikë është jashtëzakonisht e madhe dhe ai nuk do të ketë guxim të praktikojë qigong pas kësaj. Sa e frikëshme! Një sy që hapet e mbyllet që është aq i madh të shikon dhe është shumë i qartë. Për pasojë, disa njerëz e quajnë atë syri demonit, ndërsa të tjerë e quajnë syri Buddhës etj. Në fakt, është syri jot. Sigurisht, kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. I tërë proçesi i transformimit të gongut është shumë kompleks dhe ndodh në dimensione të tjera. Trupi nuk ndryshon vetëm në një dimension, por në të gjitha dimensionet e ndryshme. A mund ta bësh ti këtë vetë? Ti nuk mundesh. Këto gjëra janë rregulluar nga mjeshtri dhe kryhen nga mjeshtri. Prandaj, thuhet se kultivimi varet nga përpjekjet e secilit, ndërsa transformimi i gongut bëhet nga mjeshtri. Ju mund të keni vetëm dëshirën dhe të mendoni për të, por është mjeshtri i cili i bën në fakt këto gjëra.

Disa njerëz e hapin Syrin Qiellor vetë nëpërmjet praktikës së tyre. Ne e konsiderojmë atë si syrin tënd, por ti nuk je në gjendje ta zhvillosh atë vetë. Disa njerëz kanë mjeshtër të cilët, me të parë që Syri i tyre Qiellor është hapur, do të transformojnë një për ta. Ky quhet syri i vërtetë. Sigurisht disa njerëz nuk kanë mjeshtër, por mund të jetë ndonjë mjeshtër që enkas kalon andej. Shkolla Buddhës thotë: "Buddhat janë të gjithëpranishëm. "Ata janë kaq të shumtë sa gjenden kudo. Disa njerëz thonë: "Gjenden shpirtra tre pëllembë sipër kokës njerëzve", që do të thotë se ata janë thjesht të panumërt. Nëqoftëse një mjeshtër që kalon andej shikon që ti ke praktikuar shumë mirë me Syrin Qiellor të hapur dhe se ty të duhet një sy, ai apo ajo do të transformojnë një për ty, që mund të konsiderohet gjithashtu si rezultat i praktikës tënde. Kjo ndodh sepse kur i afrojnë njerëzve shpëtim, ata nuk vënë kushte apo mendojnë për çmim, shpërblim, apo famë. Kështu ata janë shumë më tepër fisnikë sesa heronjtë midis njerëzve. Ata e bëjnë këtë plotësisht nga zemërmirësia e tyre mëshiruese.

Pas hapjes së Syrit Qiellor, do të ndodhë kjo situatë: sytë do të verbohen keq nga drita dhe do të irritohen. Në fakt nuk janë sytë që irritohen. Por është gjendra pineale në trurin tuaj që është irrituar, megjithëse juve ju duket sikur janë irrituar sytë. Kjo ndodh për shkak se ju

nuk jeni pajisur akoma me këtë sy. Pasi ju jepet ky sy, sytë fizikë nuk janë më të irrituar. Disa nga praktikuesit tanë do të jenë në gjendje ta ndjejnë apo shikojnë këtë sy. Meqenëse manifeston të njejtën natyrë si të universit, ai është shumë i pafajshëm dhe gjithashtu kurioz. Shikon brenda për të parë nëse kanali i Syrit Qiellor është hapur dhe në mund të shohë. Po ashtu shikon dhe brenda trupit tuaj. Në këtë moment Syri juaj Qiellor është hapur. Ndërsa të shikon ty, ti do të frikësohesh kur papritmas ta shohësh. Në fakt, ky është syri jot. Që këtej e tutje, kur të vështrosh gjërat, do t'i shikosh nëpërmjet këtij syri. Edhe sikur Syri Qiellor i jot të ishte hapur, ti nuk do të ishe në gjendje të shikoje pa këtë sy.

Faktori i tretë janë ndryshimet që manifestohen në dimensione të ndryshme pasi dikush bën ngjitje në nivele. Kjo është çështja që me të vërtetë përcakton nivelin e dikujt. Përveç kanalit kryesor për të parë gjërat, njerëzit gjithashtu kanë dhe shumë nënkanale. Shkolla Buddhës thotë se çdo pore djerse është sy, ndërsa Shkolla Tao beson se çdo hapje e trupit është sy. Domethënë, të gjitha qendrat e akupunkturës janë sy. Sigurisht, këto që thonë ato janë veçse një formë e transformimit të Ligjit në trup; njeriu mund të shikojë nga çdo pjesë e trupit.

Niveli të cilit i referohemi ne është i ndryshëm nga këto. Përveç kanalit kryesor, ka gjithashtu disa nënkanale të mëdha në disa vende, më saktë, sipër dy vetullave, sipër dhe poshtë qepallave dhe në pikën ***shangen*** (qendër akupunkture që ndodhet në mes të vetullave). Ato përcaktojnë çështjen e ngjitjes në nivele. Sigurisht, për një praktikues mesatar, nëqoftëse ai mund të shikojë nga këto vende të ndryshme, ai ka arritur tashmë një nivel shumë të lartë. Disa njerëz mund të shikojnë gjithashtu dhe me sytë fizikë. Dhe ata kanë arritur të kultivojnë këta sy që janë gjithashtu të pajisur me forma të ndryshme aftësish supernormale. Nëqoftëse syri fizik nuk përdoret mirë, dikush do të shohë një objekt pa parë tjetrin. Dhe kjo nuk funksion. Kështu, disa njerëz shpesh shikojnë njërën anë me njërin sy dhe anën tjetër me syrin tjetër. Megjithatë nuk ekziston nënkanal poshtë syrit të djathtë sepse ai lidhet drejtpërdrejt me Ligjin. Njerëzit kanë tendencë ta përdorin syrin e djathtë për të kryer vepra të këqija; kështu nuk ka nënkanal poshtë syrit të djathtë. Këto ishin nënkanalet kryesore që zhvillohen në kultivimin e Ligjit-Në-Botën-Trefishe.

Pas arritjes së një niveli jashtëzakonisht të lartë dhe në kultivimin e Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, një sy që i ngjan një syri të përbërë do të formohet. Më saktësisht, në pjesën e sipërme të fytyrës do të shfaqet një sy i madh me sy të vegjël të panumërt në të. Disa Qënie të Shumëlartësuara shpirtësisht të niveleve shumë të larta kanë kultivuar kaq shumë sy saqë i kanë në tërë fytyrën e tyre. Të gjithë sytë shikojnë nëpërmjet këtij syri të madh dhe ata mund të shikojnë çfarë të duan. Me një shikim, ata mund të shikojnë të gjitha nivelet. Sot, zoologët dhe entomologët kryejnë kërkime

mbi mizat. Syri i një mize është shumë i madh; nëpërmjet mikroskopit është parë që ai përmban shumë sy të vegjël në të dhe ky quhet sy i përbërë. Pasi praktikuesit arrijnë një nivel jashtëzakonisht të lartë, kjo situatë mund të ndodhë. Personi duhet të jetë disa herë më lart se niveli i Tathagatës që kjo të bëhet e mundur. Megjithatë një person i zakonshëm nuk mund ta shikojë këtë sy. Edhe njerëzit në nivel të mesëm nuk mund ta shikojnë ekzistencën e tij për shkak se ai ekziston në një dimension tjetër dhe ata mund të shikojnë vetëm që personi është njeri normal. Kjo shpjegon kapërcimet në nivele. Me një fjalë, ka të bëjë me faktin nëse dikush mund të arrijë dimensione të ndryshme.

Kam përshkruar kështu strukturën e Syrit Qiellor për të gjithë. Ne e hapim Syrin tuaj Qiellor me një forcë të jashtme, kështu është relativisht më e shpejtë dhe më e lehtë. Kur po flisja për Syrin Qiellor, secili nga ju mund të ndjente ballin që i tkurrej; i ndjenit muskujt sikur po ju paloseshin mbi njeri tjetrin dhe shtynin drejt brendësisë. Ishte kështu apo jo? Kështu ishte. Për sa kohë që ju me të vërtetë i futeni studimit të Falun Dafës, të gjithë do ta ndjeni këtë; forca e jashtme vjen shumë e fortë kur depërton drejt brendësisë. Unë kam lëshuar energjinë e posaçme që hap Syrin Qiellor. Ndërkohë, kam lëshuar gjithashtu Falun që të riparojnë Syrin tuaj Qiellor. Ndërsa flisja për Syrin Qiellor, po ja u hapja atë të gjithëve, me kusht që ju të praktikoni kultivim në Falun Dafa. Megjithatë, nuk është e thënë që të gjithë mund të shikojnë qartë dhe jo të gjithë mund të shikojnë gjë me të. Kjo ka të bëjë direkt me vetë ju. Mos u shqetësoni sepse nuk ka rëndësi nëqoftëse ju nuk mund të shikoni me të. Kushtojini kohën ta kultivoni. Ndërsa ju vazhdimisht ngrini nivelin, ju do të bëheni të aftë gradualisht të shikoni gjëra dhe pamja e mjergullt do të bëhet gjithnjë dhe më e qartë. Për sa kohë që ju praktikoni kultivim dhe e vendosni në mëndje të praktikoni kultivim, ju do të rimerrni çdo gjë që keni humbur.

Është relativisht e vështirë të hapësh Syrin Qiellor vetë. Më lejoni të flas për disa forma të hapjes së Syrit Qiellor vetë. Për shembull, kur shikoni ballin dhe Syrin Qiellor gjatë meditimit, disa nga ju ndjejnë që është errësirë brenda në ballë dhe se nuk ka asgjë atje. Me kalimin e kohës, do të shikoni që gradualisht zbardhet brenda ballit. Pas një kohe praktike kultivuese, do të zbuloni që gradualisht fillon dhe ndriçohet brenda ballit dhe pastaj kthehet në të kuqe. Në këtë kohë, do të çelët si lulet që shihen në televizor apo në një film ku lulet çelin në një sekondë. Skena të tilla do të shfaqen. Ngjyra e kuqe do fillojë e plotë dhe pastaj papritmas do të qëndrojë në mes dhe rrotullohet papushim. Po të doni ta rrotulloni vetë deri në fund, edhe tetë apo dhjetë vjet mund të mos jenë të mjaftueshëm meqenëse i gjithë Syri Qiellor është i bllokuar.

Syri Qiellor i disa njerëzve nuk është i bllokuar, por ata janë të pajisur me një kalim. Por në kalim nuk ka energji sepse ata nuk praktikojnë qigong. Kështu, kur ata praktikojnë qigong, një top i zi do të shfaqet

papritmas para syve të tyre. Pasi ata të praktikojnë për disa kohë, ai do të shndrrohet ngadalë në të bardhë dhe pastaj do të bëhet i ndritshëm. Së fundi, do të ndriçojë gjithnjë e më shumë dhe sytë do të ndjehen pak si të verbuar. Prandaj, disa njerëz thonë, "Pashë diellin", apo "Pashë hënën". Në fakt, ata nuk panë as diellin dhe as hënën. Çfarë panë ata atëhere? Ishte kalimi i tyre. Disa njerëz arrijnë ngjitje të shpejta në nivelet e tyre. Me t'ju dhënë syri ata mund të shikojnë menjëherë. Për të tjerë është mjaft e vështirë. Kur ata praktikojnë qigong, ata do të ndjejnë sikur vrapojnë drejt daljes përgjatë këtij kalimi, që është si një tunel apo pus. Edhe në gjumë, ata ndjejnë sikur po vrapojnë drejt daljes. Disave mund t'i duket sikur po i japin një kali; disave mund t'i duket sikur fluturojnë; disave sikur vrapojnë; dhe disave u duket sikur ecin me makinë. Ngaqë është e vështirë të hapësh Syrin Qiellor vetë, atyre u duket gjithmonë sikur nuk arrijnë fundin. Shkolla Tao e konsideron trupin e njeriut një univers të vogël. Nëqoftëse është një univers i vogël, pa mendojeni, është më shumë se 108 mijë ***li*** (një njësi kineze gjatësie, 1 1 ***li***=0. 5 km, në gjuhën kineze, "108 mijë li"është një shprehje e zakonshme që përdoret për një distancë shumë të largët) nga balli deri tek gjendra pineale e trurit. Kështu, ty të duket sikur gjithmonë po shtyn drejt daljes dhe nuk e arrin dot fundin.

Është plotësisht e arësyeshme që Shkolla Tao e konsideron trupin e njeriut një univers të vogël. Kjo nuk do të thotë që përbërja dhe struktura e saj janë të ngjashme me ato të universit dhe as i referohet kjo formës së ekzistencës së trupit në dimensionin tonë fizik. Ne pyesim, "Sipas të kuptuarit të shkencës moderne, në një nivel më mikroskopik, si shfaqet trupi fizik që përbëhet nga qelizat?"Ekzistojnë përbërje molekulare të ndryshme. Më të vogla se molekulat janë atomet, protonet, bërthamat, elektronet dhe kuarket. Grimcat më mikroskopike që studjohen sot janë neutrinot. Atëhere, cila është grimca më mikroskopike? Është me të vërtetë tepër e vështirë për t'u studjuar. Në vitet e tij të fundit, Sakyamuni bëri këtë deklaratë: "Është kaq e pamasë sa nuk ka konture të jashtme dhe kaq e vogël sa nuk ka konture të brendshme. "Çfarë do të thotë kjo? Në nivelin e Tathagatës, universi është kaq i pamasë saqë kufijtë e tij janë të paarritshëm, por po ashtu dhe kaq i vogël saqë as grimcat e tij më mikroskopike të përbërjes nuk janë të dukshme. Për pasojë, ai tha: "Është kaq e pamasë sa nuk ka konture të jashtme dhe kaq e vogël sa nuk ka konture të brendshme. "

Sakyamuni gjithashtu foli për teorinë e tre mijë botëve. Ai tha se, në universin tonë dhe në Kashtën tonë të Kumtrit, ka tre mijë planete me qënie të gjalla që kanë trupa fizikë si raca jonë njerëzore. Ai gjithashtu tha se ka tre mijë botë të tilla në një kokrrizë rëre. Një kokrrizë rëre është kështu një univers me vete, me njerëz që kanë intelligjencë si ne, planete, male dhe lumenj. Duket plotësisht e pakonceptueshme! Po qe kështu, pa mendojeni pak: A ka rërë në ato tre mijë botë? Dhe nuk do të ketë tre mijë

botë të tjera në secilën nga ato kokrriza rëre? Atëhere, a ka rërë në vetë këto tre mijë botët e tjera? Atëhere a nuk do të ketë tre mijë botë edhe në secilën nga këto kokrriza rëre të rërës? Kështu, edhe në nivelin e Tathagatës, nuk mund t'i shohësh fundin.

E njejta gjë është e vërtetë me qelizat molekulare njerëzore. Njerëzit pyesin sa i madh është universi. Më lejoni t'ju them se ky univers ka kufijtë e tij. Por edhe në nivelin e Tathagatës, ai do të duket i pakufi dhe i pamasë në pafundësi. Megjithatë brendësia e trupit të njeriut është e madhe sa dhe ky univers, që nga molekulat tek pjesëzat mikroskopike. Kjo mund të duket shumë e pakonceptueshme. Kur një qënie njerëzore apo një jetë krijohet, elementet unike të jetës dhe cilësitë qenësore të saj janë tashmë të formuara që nga niveli tepër mikroskopik. Kështu, në studimin e kësaj sfere, shkenca jonë moderne është shumë prapa. Në krahasim me ato jetë të një inteligjence më të lartë në planetet e gjithë universit, niveli shkencor i racës sonë njerëzore është shumë i ulët. Ne nuk mund as të arrijmë dimensione të tjera që ekzistojnë njëkohësisht në të njejtin vend, ndërsa objekte fluturuese nga planete të tjera mund të udhëtojnë në dimensionin tonë. Koncepti i asaj kohë-hapësire është plotësisht i ndryshëm. Kështu, ata mund të shkojnë e vijnë sipas dëshirës dhe me një shpejtësi kaq të madhe saqë mëndja njerëzore nuk mund ta pranojë.

Kur fola për Syrin Qiellor, unë solla rastin kur ju ndjeni sikur po dilni jashtë përgjatë një tuneli e do t'ju duket sikur ai është i pakufi dhe i pafund. Disa njerëz mund të shohin një situatë tjetër, ku ata nuk ndjejnë sikur po vrapojnë përgjatë një tuneli, por sikur vrapojnë përgjatë një rruge të pakufi dhe të pafund. Ndërsa sulen për të dalë ka male, lumenj dhe qytete në të dy anët. Kjo mund të duket dhe më e pakonceptueshme. Më kujtohet që një mjeshtër qigongu bëri një deklaratë të tillë: "Ka një qytet në çdo pore djerse të trupit të njeriut dhe trena dhe makina që ecin në të. "Me të dëgjuar këtë, të tjerët habiten dhe u duket e pakonceptueshme. Ju e dini që grimcat mikroskopike të materies përfshijnë molekulat, atomet dhe protonet. Kur kërkon më tutje, po të shikosh planin e secilit nivel në vend të një pike dhe të shikosh planin e molekulave, atomeve, protoneve dhe atë të bërthamave, do të shikosh format e ekzistencës në dimensione të ndryshme. Gjithë materia, duke përfshirë trupin e njeriut, ekziston njëkohësisht në lidhje me nivelet dimensionale të hapësirës kozmike. Kur fizika jonë moderne studjon grimcat mikroskopike të materies, ajo vetëm studjon një grimcë mikroskopike nëpërmjet ndarjes dhe shpërbërjes së saj. Ajo i studjon elementet e saj pas shpërbërjes bërthamore. Po të ekzistonte një instrument i tillë nëpërmjet të cilit ne mund të zgjeronim dhe shikonim nivelin në të cilin të gjitha elementet atomike apo elementet molekulare mund të manifestoheshin në tërësinë e tyre, apo sikur kjo skenë të vëzhgohej, ju do të arrinit përtej këtij dimensioni dhe shikonit skenat e vërteta që ekzistojnë në dimensionet e tjera.

Ka dhe disa situata të tjera kur dikush hap Syrin Qiellor vetë. Ne kemi biseduar kryesisht rreth disa fenomeneve mjaft të zakonshme. Disa njerëzve gjithashtu u duket sikur Syri i tyre Qiellor rrotullohet. Ata që praktikojnë në Shkollën Tao shpesh shikojnë diçka që rrotullohet brenda Syrit të tyre Qiellor. Pasi pllaka Taiji kriset dhe hapet me një të kërcitur, ata do të shikojnë imazhe; megjithatë, nuk është se ka ndonjë Taiji në kokën tuaj. Ishte mjeshtri që kishte vendosur një komplet gjërash për ty që në fillim, një nga të cilat ishte Taiji. Ai e vulosi Syrin tuaj Qiellor. Në kokën kur Syri juaj Qiellor hapet çahet edhe pllaka. Mjeshtri me qëllim e kishte bërë atë në këtë mënyrë dhe nuk ishte diçka që gjendej në kokën tuaj.

Megjithatë disa njerëz kërkojnë të hapin Syrin e tyre Qiellor. Sa më shumë që ata e praktikojnë këtë, aq më e pamundur është që ai të hapet. Cila është arsyeja? As ata vetë nuk e kuptojnë. Kjo ndodh kryesisht ngaqë Syri Qiellor nuk mund të kërkohet; sa më shumë që dikush e dëshiron, aq më pak ai arrin. Kur një person e dëshiron atë jashtë mase, jo vetëm që nuk do të hapet por përkundrazi diçka as e zezë dhe as a bardhë do të dalë nga Syri i tij Qiellor. Kjo do ta mbulojë Syrin e tij Qiellor. Me kalimin e kohës, ajo do të formojë një fushë shumë të madhe. Sa më shumë që del jashtë, aq më shumë grumbullohet. Sa më shumë që ai ta dëshirojë atë, aq më e pamundur është që Syri Qiellor të hapet, e aq më shumë nga kjo substancë do të dalë jashtë. Si rezultat, ajo do të mbulojë gjithë trupin e tij deri sa të bëhet shumë e trashë dhe me një fushë shumë të madhe. Edhe sikur Syri Qiellor i këtij personi të hapet me të vërtetë, ai nuk do të mund të shikojë gjë sepse është bllokuar nga vetë dëshira e tij. Vetëm nëqoftëse ai nuk mendon më për të në të ardhmen dhe heq dorë plotësisht nga kjo përndjekje e tij, substanca do të zhduket gradualisht. Megjithatë do t'i duhet një periudhë tepër e dhimbshme dhe e gjatë praktike kultivuese për ta hequr atë. Kjo është tepër e panevojshme. Disa njerëz nuk e dinë këtë. Megjithëse mjeshtri u thotë që të mos e kërkojnë apo përndjekin atë, ata nuk besojnë. Ata vazhdojnë ta kërkojnë dhe së fundi rezulton pikërisht e kundërta.

Një aftësi supernormale e lidhur drejpërdrejt me Syrin Qiellor quhet ***shikim në distancë***. Disa njerëz pretendojnë: "Ndërsa rri ulur këtu, unë mund të shikoj skena në Beijing dhe në Amerikë, si dhe në anën tjetër të tokës. "Disa njerëz nuk mund ta kuptojnë këtë dhe kjo as që mund të shpjegohet shkencërisht. Si është e mundur? Disa njerëz e shpjegojnë në këtë apo në atë mënyrë dhe nuk mund ta shpjegojnë në mënyrë të kuptueshme. Ata habiten si bëhen disa njerëz kaq të aftë. Nuk është kështu. Një praktikues në nivelin e kultivimit të Ligj-Në-Botën-Trefishe nuk e ka këtë aftësi. Ajo që sheh ai duke përfshirë shikimin në distancë dhe shumë aftësi të tjera supernormale, të gjitha funksionojnë brenda një dimensioni specifik. Të paktën, ato nuk janë jashtë këtij dimensioni fizik ku

ekziston rraca jonë njerëzore. Në mënyrë tipike ato nuk janë as dhe përtej fushës dimensionale të vetë personit.

Brenda një dimensioni specifik, trupi njeriut ka një fushë e cila është e ndryshme nga fusha e virtytit. Ato nuk janë në të njejtin dimension, por janë të një madhësie të njejtë. Kjo fushë korrespondon me universin. Çfarëdo që ekziston në univers reflektohet aty. Çdo gjë mund të reflektohet. Është një lloj imazhi, por nuk është real. Për shembull, ekziston në këtë tokë Amerika dhe Washington D. C. Brenda fushës së një personi, Amerika dhe Uashington, D. C. janë të reflektuara, por ato janë imazhe të reflektuara. Imazhet e reflektuara janë megjithatë një formë e ekzistencës së materies dhe ato janë rezultat i një reflektimi korrespondues që ndryshon sipas ndryshimeve atje. Kështu, aftësia supernormale e shikimit në distancë që i referohen disa njerëz është të shikosh gjërat brenda fushës tënde dimensionale. Kur një person praktikon kultivim në Ligj-Përtej-Botës-Trefishe, ai nuk do t'i shikojë më gjërat në këtë mënyrë. Ai do t'i shikojë gjërat direct dhe kjo quhet fuqija hyjnore e Ligjit të Buddhës. Është diçka me fuqi të pamasë.

Pra si funksionon aftësia supernormale e shikimit në distancë në kultivimin e Ligjit-Në-Botën-Trefishe? Unë do ta shpjegoj këtë për çdo njeri. Brenda kësaj fushe, në ballin e secilit gjendet një pasqyrë. Pasqyra e një njeriu që nuk praktikon është e kthyer drejt vetes, por pasqyra e një praktikuesi kthehet në anën tjetër. Kur aftësia supernormale e shikimit në distancë të një personi është gati të shfaqet, pasqyra do të rrotullohet para dhe mbrapa. Dihet që një film shfaq njëzet e katër poza për sekondë në mënyrë që të krijojë figura në lëvizje. Nëqoftëse tregohen më pak se njëzet e katër poza për sekondë, pamjet do të mungojnë dhe nuk shfaqen në vazhdim. Shpejtësia e rrotullimit të pasqyrës është më e shpejtë se njëzet e katër poza për sekondë dhe reflekton çfarë sheh dhe e kthen atë që ta shikoni ju. Me t'u kthyer përsëri, figurat do të fshihen. Reflekton dhe kthehet dhe pastaj i fshin imazhet. Rrotullimi vazhdon pa ndërprerje. Kështu, ajo që shikoni është në lëvizje. Ajo të lejon të shikosh atë që reflektohet brenda fushës tënde dimensionale dhe i korrespondon asaj që gjendet në univers.

Atëhere si mund ta shikojë njeriu atë që është mbrapa trupit të vet? Me një pasqyrë kaq të vogël, si mund të reflektojë çdo gjë rreth trupit të njeriut? Ju e dini që kur Syri Qiellor i dikujt hapet përtej Shikimit Qiellor dhe është gati të arrijë Shikimin e Mençurisë, ai është gati të arrijë përtej dimensionit tonë. Në këtë pikë kur kalimi duket i afërt, Syri Qiellor do të pësojë një ndryshim. Kur shikon objektet fizike, ato do duken sikur zhduken. Njerëzit dhe muret do duken sikur zhduken—çdo gjë do zhduket. Domethënë, me një shikim më të përqëndruar, ti do të shohësh se në këtë dimension njerëzit nuk ekzistojnë më; ekziston vetëm një pasqyrë që qëndron brenda fushës tënde dimensionale. Megjithatë kjo pasqyrë në

fushën tënde dimensionale është e madhe sa e gjithë fusha jote dimensionale. Kështu, kur rrotullohet para e mbrapa, reflekton çdo gjë kudo që ndodhet. Brenda fushës tënde dimensionale, mund të të tregojë ty çdo gjë, me kusht që t'i korrespondojë asaj që gjendet në univers. Kjo është ajo që ne e quajmë aftësia supernormale e shikimit në distancë.

Kur ata që studjojnë shkencën e trupit të njeriut e vënë në prove këtë aftësi supernormale, ata mund ta përgënjeshtrojnë atë me lehtësi. Arsyeja për refuzimin është si vijon: Për shembull, kur një person e pyesin për kushërirën e dikujt në Beijing, "Çfarë po bën kushërira në shtëpi?"pasi i jepet emri i kushërirës dhe informacioni i përgjithshëm, personi mund ta shikojë atë. Ai do të përshkruajë ndërtesën, si të futesh në të dhe mobiljet e dhomës. Çfarë thotë ai është e gjitha e saktë. Çfarë po bën kushërira? Ai thotë se kushërira po shkruan. Për ta verifikuar këtë, ata do të pyesin kushërirën, "Çfarë po bën tani?""Po ha. "A nuk do ta përgënjeshtronte kjo atë që pa ai? Në të kaluarën, kjo ishte arsyeja për të mos e pranuar këtë aftësi supernormale. Megjithatë, ambjenti që ai pa, nuk ishte aspak gabim. Meqenëse hapësira dhe koha jonë, që ne i quajmë "kohë-hapësirë", ka kohë të ndryshme nga kohë-hapësira e dimensionit ku ekziston aftësia supernormale, konceptet e kohës janë të ndryshme në të dy vendet. Ajo po shkruante diçka pak më parë dhe tani ajo po han; është ky ndryshim kohe. Si rezultat, nëqoftëse ata që studjojnë trupin e njeriut deduktojnë hipoteza dhe bëjnë studime bazuar në teoritë konvencionale dhe shkencën moderne, edhe pas dhjetë mijë vjetësh të tjera përpjekjet e tyre do të jenë të kota, sepse këto janë para së gjithash diçka përtej njerëzve të zakonshëm. Kështu, njerëzimi duhet të ndryshojë mentalitetin e vet dhe nuk duhet t'i kuptojë më këto gjëra në këtë mënyrë.

Një aftësi tjetër supernormale drejtpërdrejt e lidhur me Syrin Qiellor quhet ***parashikim i fatit***. Sot për sot, njihen gjashtë tipe aftësish supernormale publikisht në botë, ku përfshihen Syri Qiellor, shikimi në distancë dhe parashikimi i fatit. Çfarë është parashikimi i fatit? Kjo do të thotë që dikush mund të jetë i aftë të tregojë të kaluarën dhe të ardhmen e dikujt. Me një aftësi të fuqishme, dikush është i aftë të tregojë lulëzimin dhe rënien e një shoqërie. Me një aftësi akoma më të madhe, personi mund të shikojë ligjin e gjithë ndryshimeve kozmike. Kjo është aftësia supernormale e parashikimit të fatit. Për shkak se materia është në lëvizje dhe ndjek një ligj të caktuar, në një dimension të veçantë, e gjithë materia ka formën e vet të ekzistencës në shumë dimensione të tjera. Për shembull, kur trupi i një njeriu lëviz, qelizat në trup po ashtu do të lëvizin dhe në nivelin mikroskopik të gjitha elementet, si molekulat, protonet, elektronet dhe pjesëzat më mikroskopike gjithashtu do të lëvizin. Megjithatë ato kanë format e veta të pavarura të ekzistencës dhe format e trupit në dimensione të tjera do të pësojnë gjithashtu ndryshime.

A nuk e kemi trajtuar çështjen që materia nuk zhduket? Brenda një dimensioni të caktuar, atë që një person ka bërë apo bën me një të lëvizur të dorës është e gjitha ekzistencë materiale dhe çdo gjë që ai bën do të lërë një pamje dhe një mesazh. Në një dimension tjetër ato nuk zhduken dhe do të qëndrojnë atje përgjithmonë. Një person me aftësi supernormale do të dijë çfarë ka ndodhur duke parë pamjet ekzistuese të së kaluarës. Pasi ti të kesh aftësinë supernormale të parashikimit të fatit, forma e leksionit tim sot do të ekzistojë akoma atje kur ti t'i hedhësh një shikim. Ai ekziston atje njëkohësisht. Kur lind një njeri, brenda një dimensioni të caktuar që nuk ka konceptin e kohës, e tërë jeta e tij apo e saj ekziston atje njëkohësisht. Për disa njerëz edhe më shumë se një jetë ekziston atje.

Disa njerëz mund të pyesin, "Do të thotë kjo se përpjekjet tona individuale për ndryshimin e vetes janë të panevojshme?" Ata nuk mund ta pranojnë këtë. Në fakt, përpjekjet individuale mund të ndryshojnë gjëra të vogla në jetën e dikujt. Disa gjëra të vogla mund të ndryshohen pakëz nëpërmjet përpjekjeve individuale, por është pikërisht nga përpjekjet e tua për ndryshim që ti merr karmë. Përndryshe, çështja e shkaktimit të karmës nuk do të ekzistonte dhe as çështja e kryerjes së veprave të mira apo të këqija nuk do të ekzistonte. Kur dikush insiston në kryerjen e gjërave në këtë mënyrë, ai do të përfitojë nga të tjerët dhe do të kryejë vepra të këqija. Prandaj, kjo është aryeja që praktika kultivuese kërkon gjithmonë që njeriu të ndjekë rrjedhën e natyrshme të gjërave meqenëse përndryshe ti do të dëmtosh të tjerët me përpjekjet e tua. Nëqoftëse jeta jote nuk e përmban diçka që në fillim dhe ti e merr atë që duhej t'i përkiste dikujt tjetër në shoqëri, ti do i hysh atij personi në borxh.

Përsa i përket ngjarjeve të mëdha, një person i zakonshëm nuk mund t'i ndryshojë ato aspak. Ka vetëm një mënyrë për ta bërë këtë. Kjo ndodh kur ky person kryen vetëm vepra të këqija dhe asgjë veçse vepra të këqija, ai mund ta ndryshojë jetën e tij. Veçse çfarë e pret atë është shkatërrimi i plotë. Nga një nivel i lartë, ne kemi parë që kur një person vdes, Shpirti Primordial i tij nuk zhduket. Pse nuk zhduket Shpirti Primordial? Në fakt, ne kemi parë se pasi një person vdes, kufoma e tij në morg nuk është veçse një trup prej qelizash njerëzore në dimensionin tonë. Në këtë dimension, përbërjet e qelizave të ndryshme të organeve të brendshme dhe të gjitha qelizat në tërë trupin e njeriut bien, ndërsa në dimensione të tjera trupat e përbërë nga pjesëza më mikroskopike se molekulat, atomet, protonet, etj. , nuk kanë vdekur aspak. Ato ekzistojnë në dimensione të tjera dhe akoma jetojnë në dimensionet mikroskopike. Ai që kryen gjithë llojet e veprave të këqija e pret shpërbërja totale e të gjitha qelizave të tij, që Buddhizmi e quan zhdukje e trupit dhe e shpirtit.

Ka dhe një mënyrë tjetër që një person mund ta ndryshojë jetën e tij dhe kjo është mënyra e vetme: Kjo ndodh kur personi merr rrugën e praktikës kultivuese që nga ky moment e tutje. Pse mund të ndryshohet

jeta e dikujt kur ai merr rrugën e praktikës kultivuese? Kush mund ta ndryshojë atë? Sapo ky person mendon të marrë rrugën e praktikës kultivuese dhe kur ky mendim shfaqet, ai shkëlqen si ar dhe tund botën e dhjetë drejtimeve. Në pikëpamjen e vet mbi universin, Shkolla e Buddhës ka teorinë e botës me dhjetë drejtime. Në sytë e qënieve të larta, jeta e një njeriu nuk është krijuar për të qenë njeri. Ato mendojnë se jeta e një individi lind në hapësirën e universit dhe mishëron të njejtën cilësi si dhe universi; jeta është mëshirëplotë dhe e përbërë nga materia Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë). Megjithatë një jetë krijon gjithashtu marëdhënie shoqërore. Gjatë marëdhënieve shoqërore në komunitete, disa jetë korruptohen dhe kështu bien në një nivel më të ulët. Kur ato nuk mund të qëndrojnë më në atë nivel dhe përsëri bëhen më të këqinj, ata do të bien në një nivel akoma më të ulët. Ato vazhdojnë të bien derisa, në fund, arrijnë këtë nivel të njerëzve të zakonshëm.

Në këtë nivel, këta njerëz duhet të zhdukeshin dhe eliminoheshin. Megjithatë nga mirësia mëshiruese e tyre e madhe, Qëniet e Shumëlartësuara posaçërisht krijuan një dimension pikërisht si kjo e shoqërisë njerëzore. Në këtë dimension të gjithësisë, njeriut i jepet një trup fizik njerëzor shtesë dhe këta palë sy që mund të shohin vetëm gjërat në këtë dimension fizik. Kështu, njeriu humbet në këtë mjergull dhe nuk i lejohet të shikojë të vërtetën e universit, diçka që mund të shikohet në të gjitha dimensionet e tjera. Në këtë mjergull dhe në këto kushte, njeriut i është dhënë kjo lloj mundësie. Për arsye se ai është në mjergull, ekzistenca e tij është dhe shumë e dhimbshme. Me këtë trup, ai bëhet që të vuajë. Nëqoftëse një person dëshiron të kthehet nga ky dimension në origjinën e tij, Shkolla Tao thotë se ai duhet të praktikojë kultivim që të kthehet në origjinë, në veten e vet të vërtetë. Po qe se ai ka dëshirën për praktikë kultivuese, thuhet se i është shfaqur natyra e Buddhës. Kjo zemër konsiderohet më e çmueshmja dhe qëniet e larta do ta ndihmojnë atë. Në kushte kaq të vështira, ky person megjithatë nuk ka humbur dhe dëshiron të kthehet. Si rezultat, qëniet e larta do ta ndihmojnë atë dhe do t'i japin një dorë pa kushte—ata do ta ndihmojnë atë me çdo gjë. Pse mund ta bëjmë ne këtë për një praktikues por jo për një njeri të zakonshëm? Kjo është arsyeja.

Përsa i përket një njeriu të zakonshëm që dëshiron të shërojë sëmundje, ne nuk mund ta ndihmojmë atë me asgjë. Një njeri i zakonshëm mbetet veçse një njeri i zakonshëm. Një njeri i zakonshëm duhet t'i përshtatet kushteve të shoqërisë së zakonshme njerëzore. Shumë njerëz thonë që Buddha i afron shpëtim gjithë qënieve dhe Shkolla Buddhës u mëson shpëtim gjithë qënieve. Më lejoni t'ju them se ju mund të kontrolloni të gjitha shkrimet e shenjta Buddhiste dhe asnjë prej tyre nuk thotë se të trajtosh sëmundje për njerëzit e zakonshëm do të thotë t'u afrosh shpëtim gjithë qënieve. Janë ata, mjeshtërit e rremë qigong të viteve të fundit që e kanë ngatërruar këtë çështje. Ata mjeshtrit e vërtetë qigong, ata

që hapën rrugën në fillim, nuk ju thanë aspak juve të kuroni sëmundjet e të tjerëvë. Ata vetëm ju mësuan të praktikoni, shëroni sëmundjet dhe të mbaheni të shëndetshëm vetëm për veten tuaj. Ti je një njeri i zakonshëm. Si mund të shërosh sëmundje ti pas një studimi prej dy ditësh? A nuk është kjo të mashtrosh të tjerët? A nuk inkurajon kjo dëshirën tënde? Kjo do të thotë të shkosh pas famës, interesit personal dhe gjërave mbinatyrale që të mburresh para njerëzve të zakonshëm! Kjo është absolutisht e ndaluar. Prandaj, sa më shumë disa njerëz ndjekin diçka, aq më pak ata arrijnë. Juve nuk ju lejohet ta bëni këtë gjë dhe as nuk ju lejohet të shqetësoni gjendjen e shoqërisë së zakonshme njerëzore sipas dëshirës.

Ekziston një parim i tillë në këtë univers që kur ju dëshironi të ktheheni në origjinë, në veten tuaj të vërtetë, të tjerët do t'ju ndihmojnë. Ata mendojnë që një jetë njerëzore duhet të kthehet nga ku ka ardhur në vend që të qëndrojë me njerëzit e zakonshëm. Nëqoftëse një njeriu i lejohej që të mos kishte asnjë sëmundje dhe të jetonte rehatshëm, ai nuk do të kishte interes të bëhej i pavdekshëm edhe sikur t'a pyesje. Sa mirë do të ishte sikur njeriu të mos vuante nga asnjë sëmundje apo vështirësi dhe të kishte çfarë të donte! Do të ishte me të vërtetë një botë qëniesh të pavdekshme. Por ti re tek ky nivel sepse u korruptove, prandaj ti nuk do të jesh kurrë rehat. Njeriu mund të kryejë gjëra të këqija me lehtësi kur është në mjergull dhe Buddhizmi e quan këtë shpagim karmik. Prandaj, kur njerëzit kanë vështirësi apo fatkeqësi, ata paguajnë karmën e tyre sipas shpagimit të karmës që kanë. Buddhizmi thotë se Buddhat gjenden kudo. Nëqoftëse një Buddhë lëviz dorën një herë, të gjitha sëmundjet e njerëzimit mund të zhdukeshin; kjo është absolutisht e arritshme. Me kaq shumë Buddha përreth, pse nuk e ka bërë ndonjë këtë? Për shkak se një person ka bërë keq në të kaluarën, që ai vuan këto vështirësi. Po të shërosh sëmundjen e tij, do të ishte njësoj sikur të shkelje parimin e universit, sepse ai kështu mund të kryejë vepra të këqija dhe t'i ketë borxh të tjerëve pa ju dashur të paguajë për to. Kjo nuk lehojet. Kështu, të gjithë ruajnë gjendjen e shoqërisë njerëzore dhe askush nuk don ta shqetësojë atë. Praktika kultivuese është e vetmja mënyrë për të jetuar rehatshëm, pa sëmundje dhe të arrish qëllimin e të qenit me të vërtetë i çliruar! Vetëm duke bërë njerëzit të praktikojnë një mënyrë të vërtetë mund të ketë shpëtim për të gjitha qëniet.

Pse munden disa mjeshtër qigongu të shërojnë sëmundje? Pse flasin ata për shërim sëmundjesh? Disa njerëz mund t'i kenë menduar këto pyetje. Shumica e këtyre mjeshtërve qigong nuk janë nga praktika të vërteta. Lejohet që gjatë periudhës së kultivimit të tij, një mjeshtër qigongu i vërtetë i cili i konsideron të gjitha qëniet e gjalla qënie që vuajnë, ndihmon dikë nga zemërmirësia dhe keqardhja e tij. Megjithatë ai nuk mund të shërojë sëmundje dhe vetëm mund t'i kufizojë apo shtyjë ato përkohësisht. Ti nuk i ke ato tani, por do t'i kesh më vonë sepse ai e shtyn sëmudjen

tënde për më vonë. Ai do t'i transferojë ato gjetkë apo në trupin e të afërmve të tu. Ai nuk është i aftë që me të vërtetë të eliminojë plotësisht karmën tënde. Atij nuk i lejohet që ta bëjë këtë për një njeri të zakonshëm por vetëm për një praktikues. Ky është parimi.

Në Shkollën e Buddhës, thënia "shpëtim i të gjitha qënieve"do të thotë që ta nxjerrësh individin nga gjendja më agonuese e njerëzve të zakonshëm dhe ta ngjitësh atë drejt nivele të larta kështuqë ai nuk do të vuajë më dhe do të çlirohet—ky është kuptimi. A nuk foli Sakyamuni për anën tjetër të nirvanës[45]? Ky është kuptimi i vërtetë i shpëtimit të gjitha qënieve. Po sikur të jetoje rehat në mes të njerëzve të zakonshëm, të kishe shumë para madje dhe krevatin ta kishe plot me para dhe të mos kishe vuajtje, ti nuk do të ishe i interesuar edhe sikur të të pyesnin që të bëheshe qënie qiellore. Si praktikues, kursi i jetës tënde mund të ndryshohet. Vetëm nëpërmjet praktikës kultivuese mund të ndryshohet jeta jote.

Mënyra si funksionon aftësia supernormale e parashikimit të fatit është sikur ke një ekran të vogël televizori në ballë. Disa njerëz e kanë atë në ballë, disa të tjerë e kanë atë afër ballit. Disa e kanë brenda ballit. Disa njerëz mund të shikojnë gjëra me sy mbyllur. Nëqoftëse aftësia është e fortë, personi mund të shikojë me sy hapur. Ndërsa të tjerët nuk mund t'i shikojnë ato sepse ato janë diçka brenda hapësirës së fushës dimensionale të individit. Me fjalë të tjera, pasi zhvillohet kjo aftësi supernormale, duhet të jetë një tjetër që shërben si përçues për të reflektuar skenat nga dimensionet e tjera. Për rrjedhojë, ato mund të shihen nga Syri Qiellor. Dikush mund të shikojë me shumë saktësi të ardhmen dhe të kaluarën e një personi. Pamvarësisht sa mirë parashikojnë fatin fallxhoret, ato nuk mund të tregojnë ngjarjet e vogla dhe detaje të tjera. Ndërsa ky person është i aftë t'i shikojë gjërat shumë qartë duke përfshirë dhe kohën e vitin. Detajet e ndryshimeve janë të gjitha të dukshme meqenëse ajo që ai shikon është reflektim i vërtetë i njerëzve dhe gjërave nga dimensione të ndryshme.

Për aq kohë sa secili nga ju do të praktikojë Falun Dafën, unë do t'ju hap Syrin Qiellor. Por aftësitë supernormale që trajtuam më sipër nuk do të jepen. Me ngritjen e vazhdueshme të nivelit tuaj, aftësia e parashikimit të fatit do të shfaqet natyrshëm. Kjo gjë do të ndodhë në të ardhmen tuaj të praktikës kultivuese dhe ju do të dini çfarë po ndodh kur të zhvillohet kjo aftësi. Prandaj, po jua mësojmë këto parime të Ligjit.

(…..)

Çfarë do të thotë "***të kalosh përtej Pesë Elementeve dhe Tre Hapësirave?***"Kjo është një çështje shumë delikate për të ngritur. Më parë, shumë mjeshtër qigongu kanë folur për këtë çështje por atyre u mbyllej goja nga pyetjet e atyre që nuk besonin në qigong, "Cili nga ju që praktikon qigong i ka tejkaluar Pesë Elementet dhe nuk është brenda Tre Hapësirave?"Disa njerëz nuk janë mjeshtër qigongu dhe e quajnë veten

mjeshtër qigongu. Nëqoftëse ata nuk janë të qartë mbi këtë çështje, ata duhet të mos flasin fare. Megjithatë, ata përsëri guxojnë dhe flasin dhe ata që i pyesin i zënë nga fjalët. Kjo i ka sjellë shumë dëm komunitetit të kultivueve duke shkaktuar kaos të madh. Shumë njerëz e përdorin këtë si shkak për të sulmuar qigongun. "Të kalosh Pesë elementët dhe Tre Hapësirat"është një thënie në komunitetin e kultivuesve. Është e rrënjosur në fe dhe vjen nga feja. Prandaj, ne nuk mund ta shqyrtojmë këtë çështje pa marrë parasysh kushtet historike dhe rrethanat në atë kohë.

Çfarë do të thotë të kalosh Pesë Elementet? Si fizika e lashtë kineze ashtu dhe fizika moderne e quajnë teorinë e Pesë Elementeve të saktë. Është e vërtetë që Pesë Elementet—metali, druri, uji, zjarri dhe toka—përbëjnë çdo gjë në universin tonë. Kështu, ne flasim për teorinë e Pesë Elementeve. Kur themi se një njeri ka kaluar pesë elementet, në gjuhën moderne do të thotë që ai ka arritur përtej botës sonë fizike. Kjo tingëllon krejt e pabesueshme. Mendojeni këtë çështje të gjithë: Një mjeshtër qigongu ka gong. Unë kam marrë pjesë në një eksperiment dhe shumë mjeshtër të tjerë qigongu po ashtu i janë nënshtruar këtij eksperimenti për të matur energjinë e tyre. Elementet materialë në gong mund të kapen nga shumë aparatura të kohës së sotme. Kjo do të thotë se për aq kohë sa ekziston një aparaturë e tillë, elementet e rrezatuara nga një mjeshtër qigongu dhe ekzistenca e gongut të tij mund të kapen. Aparaturat moderne mund të zbulojnë rrezet infra të kuqe, rrezet ultravioletë, valët ultrasonike, valët infrasonike, elektricitetin, forcën magnetike, rrezet gama, atomet dhe neutronet. Një mjeshtër qigongu i ka të gjitha këto substanca dhe ekzistojnë edhe disa substanca të tjera të rrezatuara nga mjeshtrit e qigongut që janë të pakapshme sepse nuk ekziston ndonjë aparat i tillë. Por nëqoftëse ekziston aparatura e përshtatshme, çdo gjë është e kapshme. Substancat e lëshuara nga mjeshtrit e qigongut janë parë se janë të shumëllojshme.

Nën efektin e veçantë të fushës magnetike, një mjeshtër qigongu mund të rrezatojë një kurorë drite të fuqishme dhe shumë të bukur. Sa më e madhe fuqija e gongut të tij, aq më e madhe fusha e energjisë së lëshuar. Edhe një njeri i zakonshëm ka një kurorë drite, por ajo është shumë e vogël dhe e dobët. Në fushën e kërkimit të fizikës së energjisë së lartë, njerëzit besojnë se energjia është e përbërë nga pjesëza si neutronet dhe atomet. Shumë mjeshtër qigongu, duke përfshirë dhe ata të mirënjohurit, i janë nënshtruar testimit. Edhe unë jam testuar dhe radiacioni i kapur i lëshuar nga rrezet gama dhe neutronet termike ishte tetëdhjetë deri njëqind e shtatëdhjetë herë më shumë se materia normale. Në këtë pikë, treguesi i aparatit të testimit arriti limitin ndërsa gjilpëra e tij ndaloi në pikën maksimale. Në fund aparati nuk mund të tregonte sa energji unë kisha. Është thjesht e pabesueshme që një person të ketë neutrone kaq të fuqishme! Si mundet një njeri të çlirojë kaq neutrone të fuqishme? Kjo

gjithashtu vërteton se ne, mjeshtrit qigong, kemi gong dhe energji. Kjo është verifikuar nga komuniteti shkencor dhe teknologjik.

Që të kalosh Pesë Elementet, duhet një praktikë kultivuese e mëndjes dhe e trupit. Nëqoftëse një praktikë nuk është e mëndjes dhe e trupit dhe vetëm përmirëson gongun e nivelit të një personi pa kultivuar trupin, ajo nuk merret me këtë çështje dhe nuk kërkon kalim të Pesë Elementeve. Një praktikë kultivuese e mëndjes dhe e trupit ruan energji në gjithë qelizat e trupit. Praktikuesi mesatar apo ata që sapo kanë filluar të zhvillojnë gong prodhojnë kokrriza shumë të ashpra energjie me boshllëqe dhe densitet të ulët. Kështu, ajo ka fuqi të vogël. Kur niveli i dikujt bëhet më i lartë, është plotësisht e mundur që densiteti i energjisë së tij të bëhet njëqind herë, njëmijë herë apo njëqind milion herë më i lartë se i molekulave të ujit të zakonshëm. Sa më i lartë niveli i personit, aq më e dendur, aq më e imët dhe aq më e fuqishme energjia e tij. Në këto kushte, energjia ruhet në çdo qelizë të trupit. Kjo energji nuk ruhet vetëm në çdo qelizë të trupit në këtë dimension fizik, por gjithashtu mbush molekulat, atomet, protonet dhe elektronet e të gjithë trupave në dimensione të tjera, derisa arrin qelizat jashtëzakonisht mikroskopike. Me kalimin e kohës, i gjithë trupi i individit do të mbushet me këtë materie energjie të lartë.

Kjo materie energjie të lartë ka inteligjencë dhe është shumë e aftë. Me t'u rritur dhe bërë më e dendur, ajo do të mbushë të gjitha qelizat në trupin e njeriut dhe do të kufizojë qelizat fizike njerëzore, që janë dhe qelizat më të paafta. Me kufizimin e qelizave, ato nuk do të kenë më metabolizëm. Në fund, qelizat fizike njerëzore do të zëvendësohen plotësisht. Sigurisht, është e thjesht për mua ta them ketë. Që të arrish në këtë pikë në kultivim është një proçes gradual dhe i ngadaltë. Kur kultivimi juaj ka arritur këtë pikë, materia e energjisë së lartë do të zëvendësojë të gjitha qelizat në trupin tuaj. Mendojeni pak këtë: A është më trupi juaj i përbërë nga Pesë Elementet? Është kjo akoma materie nga ky dimensioni jonë? Ajo është tashmë e përbërë nga materie energjie të lartë e mbledhur nga dimensione të tjera. Elementi virtytit është gjithashtu materie që ekziston në një dimension tjetër. Ai nuk është i kufizuar nga fusha e kohës në dimensionin tonë.

Shkenca moderne beson se koha ka fushë. Nëqoftëse diçka nuk është brenda rrezes së kësaj fushe kohe, ajo nuk kushtëzohet nga ajo kohë. Në dimensione të tjera, konceptet e kohë-hapësirës janë të ndryshme nga ato tonat këtu. Si mundet që koha këtu të komandojë materien nga dimensionet e tjera? Nuk është aspak e mundur. Mendojeni pak të gjithë: A nuk do t'i kishit kaluar ju Pesë Elementet atëhere? A do të ishte trupi juaj akoma ai i një njeriu të zakonshëm? Nuk do të ishte aspak por njerëzit e zakonshëm nuk mund ta dallojnë atë. Megjithëse trupi i dikujt do të ishte transformuar deri në atë shkallë, ky nuk është fundi i praktikes kultivuese. Ai duhet të vazhdojë të bëjë ngjitje drejt niveleve më të larta të kultivimit.

Kështu, ai duhet të vazhdojë të praktikojë kultivim në mes të njerëzve; kjo nuk mund të bëhet në rast se njerëzit nuk mund ta shohin këtë person.

Çfarë do të ndodhë më vonë? Megjithëse gjatë kursit të kultivimit të gjitha qelizat e këtij personi në nivelin molekular janë zëvendësuar nga materie energjie të lartë, atomet kanë mënyrën e tyre të renditjes dhe kombinimet molekulare dhe konfiguracionet atomike nuk do të ndryshojnë. Kombinimet molekulare të qelizave janë në një gjendje të tillë që ato duken të buta kur i prek. Kombinimet molekulare të kockave kanë densitet të lartë dhe kockat janë të forta. Densiteti i molekulave të gjakut është shumë i ulët, kështu ai është i lëngët. Një njeri i zakonshëm nuk mund të shohë ndryshim tek ty nga jashtë, sepse molekulat e qelizave të tua ruajnë akoma strukturën dhe kombinimin e tyre origjinal; struktura e tyre nuk ka ndryshuar. Megjithatë energjia brenda ka ndryshuar. Kështu, që nga ky moment ky person nuk do të plaket natyrshëm dhe qelizat e tij nuk do të vdesin. Për pasojë ai do të qëndrojë vazhdimisht i ri. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, ai do të duket i ri dhe së fundi do të qëndrojë ashtu.

Sigurisht, kockat e tij përsëri mund të thyhen kur goditet nga një makinë. Ai përsëri do të gjakoset kur pritet me thikë, sepse kombinimet molekulare nuk kanë ndryshuar. Veçse qelizat e tij nuk do të vdesin apo plaken si më parë. Nuk do të ketë metabolizëm. Kjo është ajo që ne e quajmë "të kalosh Pesë Elementet". Çfarë paragjykimi ka këtu? Kjo mund të shpjegohet edhe nga ana shkencore. Disa njerëz nuk janë në gjendje ta shpjegojnë atë, prandaj bëjnë komente shkarazi. Ndërsa të tjerë do thonin se ne përhapim paragjykime. Meqenëse kjo thënie vjen nga fetë, nuk është një term i krijuar nga qigongu ynë modern.

Çfarë do të thotë të "kalosh Tre Hapësirat"? Unë përmenda dje se çelësi për të rritur gongun qëndron tek kultivimi ynë i karakterit dhe asimilimi në karakteristikën e universit. Karakteristika e universit nuk do të kushtëzojë ty atëhere. Me të ngritur karakterin tuaj, elementi virtyt do të transformohet në gong që vazhdimisht rritet lart drejt një niveli më të lartë, duke formuar kështu një kolonë gongu. Lartësia që arrin kolona gongut, tregon dhe lartësinë e nivelit tënd të energjisë. Thuhet kjo thënie: "Ligji i madh është i pakufishëm. "Kultivimi në të varet tërësisht nga zemra juaj. Përsa i përket lartësisë së nivelit që mund të arrijë kultivimi juaj, kjo varet nga durimi dhe aftësia juaj për të duruar vështirësi. Kur ta keni përdorur gjithë substancën tuaj të bardhë, substanca juaj e zezë mund të transformohet në të bardhë duke kaluar vuajtje. Po të mos jetë e mjaftueshme, ju mund të mbani mëkatet e miqve apo të afërmve tuaj që nuk praktikojnë kultivim dhe ju mund ta rrisni kështu gongun tuaj. Kjo kërkon që dikush të ketë arritur një nivel jashtëzakonisht të lartë në praktikën kultivuese; një praktikues i zakonshëm nuk duhet as të mendojë të shlyejë mëkatet për të afërmit. Me atë sasi të madhe karme, një njeri

mesatar nuk do të mundte të arrinte sukses në kultivim. Unë po shpjegoj këtu parimet e niveleve të ndryshme.

Tre Hapësirat që përmendin fetë i referohet nëntë niveleve të Qiellit apo thridhjetë e tre niveleve të Qiellit—domethënë, Qielli, Toka dhe Ferri përfshijnë të gjitha qëniet brenda Tre Hapësirave. Fetë besojnë se të gjitha qëniet brenda tridhjetë e tre niveleve të Qiellit kalojnë në ciklin e ringjalljes së samsarës. "Samsara"do të thotë që dikush është njeri në këtë jetë dhe mund të jetë kafshë në jetën tjetër. Thuhet në Buddhizëm: "Njeriu duhet ta përdorë mirë kohën e kufizuar në këtë jetë. Po të mos praktikosh kultivim tani, kur do të mundesh ti?"Kjo ndodh sepse kafshët janë të ndaluara të praktikojnë kultivim dhe as nuk lejohen ta dëgjojnë Ligjin. Edhe sikur të praktikojnë kultivim, ato nuk do të arrinin Shkallën e Duhur në kultivim. Nëqoftëse niveli i gongut të tyre do të rritej, perënditë do t'i vrisnin ato. Ti mund të mos kesh një trup njeriu për qindra vjet; mbase do e kesh për njëmijë vjet. Kur ti merr një trup njeriu, ti nuk ja din vlerën. Po të ringjallesh në një copë shkëmb, ti nuk do të mund të çlirohesh për dhjetë mijë vjet. Nëqoftëse ajo copë shkëmbi nuk copëtohet apo thërmohet, ti nuk do të dalësh dot kurrë. Të marrësh një trup njeriu është kaq e vështirë! Nëqoftëse një person mundet që me të vërtetë të njohë Dafën, ky person është thjesht me shumë fat. Trupi njerëzor është i vështirë për t'u marrë - ky është kuptimi.

Në praktikën kultivuese ne flasim për çështjen e niveleve dhe kjo varet plotësisht nga praktika kultivuese e individit. Nëqoftëse ti dëshiron të kalosh Tre Hapësirat dhe nëqoftëse kolona e gongut tënd është kultivuar në një nivel shumë të lartë, a nuk je ti përtej Tre Hapësirave? Kur Shpirti Primordial i dikujt lë trupin gjatë meditimit ulur, ai mund të arrijë një nivel shumë të lartë menjëherë. Një praktikues shkruante në rrëfimin e eksperiencës së vet, "Mësues, unë kam arritur shumë nivele të Qiellit dhe kam parë shumë skena. "Unë i thashë të ngjitej akoma. Ai tha, "Nuk e bëj dot. Nuk ma mban të ngjitem më lart dhe nuk mundem të ngjitem më lart. "Pse? Sepse kolona e gongut të tij ishte aq e lartë dhe ai kishte arritur atje duke u ulur në majë të kolonës së tij të gongut. Kjo është Shkalla e Arritjes që përmend Buddhizmi dhe kultivimi i tij kish arritur këtë nivel. Megjithatë për një praktikues nuk është akoma kulmi i Shkallës së Arritjes të tij. Ai vazhdon të ngjitet vazhdimisht lart dhe vazhdimisht rrit veten. Nëqoftëse gongu yt arrin përtej kufirit të Tre Hapësirave, a nuk je ti përtej Tre Hapësirave? Ne kemi zbuluar dhe parë se Tre Hapësirat e përmendura nga fetë janë vetëm brenda hapësirës së nëntë planeteve kryesore. Disa njerëz flasin për dhjetë planete kryesore. Unë do të thosha se nuk është aspak e vërtetë. Unë kam parë se disa nga ata mjeshtrit qigong në të kaluarën kishin kolona gongu shumë të larta që arrinin përtej Kashtës së Kumtrit; ata kishin kaluar përtej Tre Hapësirave. Deri tani kam folur për kalimin e Tre Hapësirave. Është në fakt çështje nivelesh.

Pas arritjes së Ligjit-Përtej-Botës-Trefishe, personi duhet të fillojë kultivim nga e para. Trupi i tij është trup që ka kaluar Pesë Elementet, siç e thashë pak më parë. Ai është trup Buddhe. A nuk duhet të quhet një trup i tillë trup Buddhe? Ky trup Buddhe duhet të praktikojë kultivim nga e para dhe gjithashtu të zhvillojë nga fillimi aftësitë supernormale. Në vend që të quhen "aftësi supernormale", ato quhen tani "fuqi hyjnore të Ligjit të Buddhës". Ato janë pa masë të fuqishme dhe mund të veprojnë në dimensione të ndryshme, duke pasur shumë rezultat. A ja vlen të kërkosh aftësi supernormale? Përsa i përket atyre që ndjekin aftësitë supernormale, a nuk keni ju në plan t'i përdorni ato të mburreni para njerëzve? Përndryshe, përse i donit ju ato? Ato janë të padukshme dhe të pakapshme. Edhe sikur të ishin për dekorim, njeriu gjen diçka që duket bukur. Është e garantuar se thellë në ndërgjegje ju keni qëllimin që t'i përdorni ato. Ato nuk mund të kërkohen si aftësitë e zakonshme njerëzore. Ato janë diçka plotësisht mbinatyrore dhe ju e keni të ndaluar që t'i tregoni para njerëzve. Vetë mburrja është një dëshirë shumë e fortë dhe një dëshirë shumë e keqe që një praktikues duhet ta çrrënjosë. Nëqoftëse ti don të bësh para dhe pasuri me to, apo të arrish qëllimet e tua personale mes njerëzve me anë të tyre, kjo është e ndaluar. Kjo do të thotë të përdorësh gjëra të një niveli të lartë për të shqetësuar dhe dëmtuar shoqërinë e zakonshme njerëzore. Ky mendim është akoma dhe më i keq. Prandaj ato ndalohen të përdoren spontanisht. Normalisht, aftësitë supernormale janë më të mundura të zhvillohen për dy grupe njerëzish; fëmijët dhe të moshuarit. Veçanërisht, gratë e moshuara zakonisht paraqesin karakter të mirë pa ndonjë dëshirë në mes të njerëzve të zakonshëm. Pasi zhvillohen aftësitë e tyre supernormale, ato mund ta kontrollojnë veten me lehtësi dhe nuk kanë dëshirë të mburren me to. Pse është e vështirë për të rinjtë që të zhvillojnë aftësi supernormale? Veçanërisht, një mashkull i ri më shumë se të tjerët, akoma dëshiron të arrijë disa qëllime në shoqërinë njerëzore! Me të pasur aftësi supernormale, ai do t'i përdorë ato për të arritur qëllimet e tij. Përdorimi i tyre si mjet për të arritur qëllimet e tij është absolutisht i ndaluar, kështu ai nuk do të zhvillojë aftësi supernormale.

Çështja e praktikës kultivuese nuk është lojë fëmijësh dhe as teknikë e njerëzve të zakonshëm—ajo është një çështje shumë serioze. Nëse ju doni të praktikoni kultivim apo jeni i aftë të praktikoni kultivim varet plotësisht nga si e përmirësoni ju karakterin tuaj. Do të ishte e tmerrshme sikur dikush të mund të arrinte aftësitë supernormale duke i përndjekur ato me qëllim. Ju do të shihnit se atij nuk do i bëhej vonë për kultivim apo as që e mendon atë. Ngaqë karakteri i tij është në nivelin e njerëzve të zakonshëm dhe aftësitë supernormale të tij vijnë si pasojë e përndjekjes me qëllim, ai mund të kryente çdo lloj vepre të keqe. Ka plot para në bankë dhe ai do të merrte ca. Ka plot bileta llotarie për shitje në rrugë dhe ai do merrte çmimin e parë. Pse nuk kanë ndodhur këto gjëra? Disa mjeshtër qigongu

thonë: "Kur nuk është i virtytshëm, njeriu mund të kryejë gjëra të këqija me lehtësi pasi zhvillon aftësitë supernormale. "Unë them se kjo është një thënie e gabuar—nuk është aspak ashtu. Nëqoftëse ti nuk vlerëson virtytin apo nuk kultivon karakterin tënd, ti thjesht nuk do të zhvillosh ndonjë aftësi supernormale. Me karakter të mirë, disa njerëz zhvillojnë aftësi supernormale në nivelet e tyre. Më vonë, ata nuk e kontrollojnë veten dhe bëjnë gjëra që nuk duhet t'i bëjnë. Ekziston gjithashtu kjo situatë. Por me të bërë diçka të keqe, aftësitë e tij supernormale do të dobësohen apo zhduken. Me t'u zhdukur, ato janë humbur përgjithmonë. Për më tepër, e keqja është se ato e bëjnë individin të zhvillojë dëshira.

(…..)

3. Leksioni i Tretë

(…..)

Qigongu i Shkollës së Buddhës nuk është feja Buddhiste. Unë duhet t'ja u bëj të qartë këtë pikë të gjithëve. Në fakt, as qigongu i Shkollës Tao nuk është feja Taoiste. Disa prej jush i ngatërrojnë gjithmonë këto gjëra. Disa individë janë murgj nga tempuj dhe disa janë besimtarë Buddhistë. Ata mendojnë se dinë pak më shumë për fenë Buddhiste, kështu ata predikojnë me entuziazëm Buddhismin tek praktikuesit tanë. Më lejoni t'ju them se ju nuk duhet ta bëni një gjë të tillë sepse ato janë diçka nga një shkollë tjetër kultivimi. Feja ka forma fetare. Këtu ne po mësojmë pjesën e kultivimit të shkollës sonë. Përveç atyre murgjëve dhe murgeshave që janë dishepujt të Falun Dafës, asnjë tjetër nuk duhet të mbajë forma fetare. Prandaj, shkolla jonë nuk është Buddhismi në Periudhën e Fund-Dharmës.

Dharma në Buddhizëm është veçse një pjesë e vogël e Ligjit të Buddhës. Ekzistojnë shumë lloje të tjera Ligjesh të niveleve të larta. Nivele të ndryshme kanë gjithashtu Ligje të ndryshme. Sakyamuni pat thënë se janë tetëdhjetë e katër mijë mënyra kultivimi. Feja Budhiste përfshin vetëm pak mënyra kultivimi si Sektin Tiantai, Sektin Huayan, Sektin Zen, Tokën e Pashkelur, Tantrizmin, etj. Këto nuk përbëjnë veçse një numër të vogël! Prandaj, Buddhizmi nuk mund ta përfaqësojë të gjithë Ligjin e Buddhës dhe është vetëm një pjesë e vogël e këtij Ligji. Falun Dafa jonë është gjithashtu një nga tetëdhjetë e katër mijë mënyrat e kultivimit në Shkollën e Buddhës dhe nuk ka të bëjë aspak me Buddhizmin origjinal apo Buddhizmin në Periudhën e Fund-Dharmës dhe as që ka lidhje me fetë moderne.

Buddhizmi u themelua nga Sakyamuni në Indinë e lashtë 2500 vjet më parë. Kur Sakyamuni arriti momentin e Çbllokimit të Gongut dhe u lartësua shpirtërisht, ai rikujtoi atë çfarë kish kultivuar më parë dhe e bëri atë publike për të shpëtuar njerëzit. Pamvarësisht nga sa mijra volume shkrimesh të shenjta kanë dalë nga ajo shkollë, në fakt ajo konsiston në tre fjalë. Karakteristikat e kësaj shkolle janë: "kanun, samadhi[51], mençuri".

Kanunet janë për heqjen dorë nga të gjitha dëshirat e njeriut të zakonshëm dhe ato të detyrojnë të braktisësh ndjekjen e interesit personal duke të shkëputur nga çdo gjë e botës materiale e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, mëndja e dikujt do jetë bosh pa asnjë mendim dhe kështu mund të bëhet e qetë. Ato plotësojnë njera tjetrën. Duke qënë i aftë të arrijë qetësinë mendore, ai mund të qendrojë në meditim për të kultivuar dhe të mbështetet në meditimin në kllapi për të përparuar në kultivim. Kështu kjo është pjesa e vërtetë e praktikës kultivuese në këtë shkollë. Nuk ka ushtrime dhe as që ndryshon benti[52]-in e njeriut. Personi vetëm praktikon atë gong që përcakton lartësinë e nivelit të tij. Prandaj, ai vetëm kultivon karakterin e tij. Ai nuk kultivon trupin e vet, kështu ai nuk kërkon transformim të gongut. Ndërkaq nëpërmjet meditimit ai forcon aftësinë e vet për të qëndruar në gjendje meditimi në kllapi dhe qëndron në meditim për të vuajtur dhe eliminuar karmën. "Mençuri"i referohet asaj që njeriu lartësohet shpirtërisht me arrin mençuri të madhe. Ai mund të shikojë të vërtetën e universit si dhe të vërtetën e dimensioneve të ndryshme në univers. Të gjitha fuqitë e tij hyjnore do të shfaqen. Arritja e zgjimit të mençurisë dhe lartësimit shpirtëror quhet gjithashtu dhe Çbllokim i Gongut. Kur Sakyamuni themeloi këtë mënyrë kultivimi, ekzistonin tetë fe mbizotëruese në Indi në atë kohë. Ekzistonte një fe me rrënjë të thella e quajtur Brahmanizëm. Gjatë gjithë jetës së tij, Sakyamuni luftoi në parim me fetë e tjera. Meqenëse ajo që Sakyamuni mësoi ishte një mënyrë e drejtë, Dharma Buddhiste që mësoi ai u bë gjithnjë e më popullore gjatë mësimdhënies së tij ndërsa fetë e tjera u dobësuan gjithnjë e më shumë. Edhe Brahmanizmi i ngulitur thellë arriti në buzë të zhdukjes. Megjithatë, pas nirvanës së Sakyamunit, fetë e tjera, sidomos Brahmanizmi, rifituan popullaritet. Por çfarë situate u krijua në Buddhizëm? Disa murgj arritën stadin e Çbllokimit të Gongut dhe arritën lartësimin shpirtëror në nivele të ndryshme, por nivelet e tyre të lartësimit shpirtëror ishin mjaft të ulta. Sakyamuni arriti nivelin e Tathagatës por shumë nga murgjit nuk arritën atë nivel.

(…..)

Çfarë është "***gjuha kozmike***"? Kjo është kur papritmas një person mund të flasë një gjuhë të panjohur. Ai mërmërit diçka që as ai vetë nuk e kupton. Dikush me aftësi telepatike mund të kapë idenë e përgjithshme por nuk mundet të thotë në mënyrë specifike çfarë po flet ky person. Gjithashtu, disa njerëz mund të flasin disa gjuhë të ndryshme. Disa madje e quajnë këtë si një gjë të jashtëzakonshme dhe e konsiderojnë atë si zotësi apo aftësi supernormale. Kjo nuk është as aftësi supernormale dhe as aftësi e zotësi e një praktikuesi; dhe as nuk mund të përfaqësojë nivelin e personit. Atëhere, çfarë është kjo? Kjo ndodh ngaqë mëndja juaj po kontrollohet nga një shpirt i huaj. Megjithatë juve mund t'ju duket përsëri gjë e mirë dhe mund ta dëshironi atë, sepse jeni i gëzuar që e keni. Sa më

shumë që jeni i kënaqur, aq më mirë ju kontrollon ai juve. Si praktikues i vërtetë, si mund ta lejoni ju atë t'ju kontrollojë? Aq më tepër, ai vjen nga një nivel shumë i ulët. Si praktikues të vërtetë, ne nuk duhet t'i ftojmë këto probleme.

Meqenëse janë shpirti i të gjithë materies, qëniet njerëzore janë tepër të çmuara. Si mund të kontrolloheni ju nga këto gjëra? Sa keq që ju u jepni atyre trupin tuaj! Disa nga këto gjëra i ngjiten trupave të njerëzve. Disa nuk e bëjnë këtë por qëndrojnë në një distancë nga njerëzit, por ato përsëri ju manipulojnë dhe kontrollojnë juve. Kur ti don ta flasësh atë, ata do të lejojnë ta flasësh dhe mërmëritësh. Gjuha mund t'i kalohet dhe një personi tjetër nëse personi don ta mësojë atë. Kur ky person ka guximin ta provojë, ai apo ajo gjithashtu do e flasë atë. Në fakt, këto gjëra vijnë në grupe. Kur ti dëshiron ta flasësh atë, një do të vijë dhe do të të lejojë ta flasësh atë.

Pse ndodh kjo? Siç e kam thënë, ata duan të ngrenë nivelin e tyre. Por atje tek ata nuk ka vështirësi, kështu ata nuk mund të praktikojnë kultivim dhe përmirësojnë veten. Ata kanë dalë me një ide—t'i ndihmojnë njerëzit të bëjnë vepra të mira për të tjerët. Por ata nuk dinë si ta bëjnë këtë. Mëgjithatë ata e dinë se energjia që lëshojnë mund të kufizojë sëmundjen e një pacienti dhe mund ta lehtësojë vuajtjen e pacientit për momentin megjithëse nuk mund ta kurojë sëmundjen. Në bazë të kësaj, ata e dinë që kjo mund të arrihet duke përdorur gojën e një personi për të lëshuar energji. Kështu pra shfaqet ky fenomen. Disa njerëz e quajnë këtë gjuhë qiellore dhe ka të tjerë të cilët e quajnë atë gjuha Buddhës. Unë e quaj këtë çmenduri të plotë! Dihet se një Buddha nuk e hap gojën rastësisht për të folur. Po ta hapte ai gojën dhe të fliste në dimensionin tonë, ai mund t'i shkaktonte një tërmet njerëzimit. Me zë kaq të lartë, si mund të lejohej kjo? Disa njerëz thonë, "Syri im Qiellor ka parë një Buddha që fliste me mua. "Ai nuk fliste me ty. Gjithashtu disa njerëz panë fashën tim duke folur. As ai nuk po fliste me ju. Mesazhi që ai jep është në tingull stereo. Kur ti e dëgjon atë, të duket sikur ai të flet. Ai zakonisht flet në dimensionin e vet. Megjithatë, pasi transmetohet këtu, ti nuk mund të dëgjosh qartë çfarë ai thotë sepse konceptet e kohës dhe hapësirës janë të ndryshme në dy dimensionet. Një ***shichen*** (një njësi kineze kohe prej dy orësh) në dimensionin tonë është dy orë. Në atë dimension të madh, një shichen i jonë është një vit dhe koha jonë është më e ngadaltë se sa koha atje.

Ekzistonte një thënie në të kaluarën: "Vetëm një ditë në qiell, por kanë kaluar një mijë vjet në tokë. "Kjo i referohet parajsave të veçanta të cilat nuk kanë konceptin e kohës dhe hapësirës. Më saktë ato janë parajsa ku rrinë Qëniet e Shumëlartësuara, si Parajsa e Lumturisë Absolute, Parajsa e Xhamtë, Parajsa e Falunit dhe Parajsa e Lotusit. I referehet këtyre vendeve. Megjithatë, në atë dimension të madh, koha është më e shpejtë se koha jonë. Nëqoftëse je i aftë të marrësh mesazhin, ti mund të dëgjosh dikë duke folur. Disa njerëz kanë aftësinë e dëgjimit nga dimensione të tjera dhe ju

janë hapur Veshët Qiellorë. Ata janë të aftë të dëgjojnë dikë duke folur por jo qartë. Çfarëdo që ti dëgjon do të të ngjajë me cicërimën e zogut apo me mbledhjen e një shiriti manjetofoni me shpejtësi; nuk mund ta dallosh çfarë thuhet. Sigurisht, disa njerëz mund të dëgjojnë muzikë dhe të folur. Por ndryshimi i kohës duhet eliminuar nëpërmjet një aftësie supernormale e cila shërben si përçues. Atëhere zëri mund të arrijë ty në vesh dhe ti mund ta dëgjosh atë qartë. Ndodh pikërisht kështu. Disa njerëz e quajnë gjuha e Buddhës, Por nuk është aspak kështu.

Kur dy Qënie të Shumëlartësuara takohen me njëri tjetrin, ata mund të kuptojnë çdo gjë me një buzëqeshje. Kjo ndodh për shkak të telepatisë mendore dhe ajo që merret është në tingull stereo. Kur ata buzëqeshin, idetë e tyre janë komunikuar tashmë. Kjo nuk është metoda e vetme që ata përdorin, sepse ngandonjëherë ata përdorin një mënyrë tjetër. Ju e dini që në Tantrizëm, lamat tibetanë i kushtojnë shumë vëmendje përdorimit të shenjave me duar. Por po e pyete një lama çfarë janë shenjat e duarve, ai do të përgjigjet se ato janë joga më e lartë. Për çfarë janë ato më saktësisht? As ai nuk e di. Në fakt, ato janë gjuha e Qënieve të Shumëlartësuara. Kur ka shumë njerëz, ata përdorin shenjat e mëdha të duarve; ato janë shumë të bukura dhe përbëhen nga disa shenja të mëdha duarsh. Kur ka vetëm pak njerëz, ata përdorin shenjat e vogla të duarve; dhe ato janë shumë të bukura dhe përbëhen nga disa shenja të vogla duarsh. Ato janë shumë të sofitikuara dhe të pasura sepse përbëjnë një gjuhë. Në të kaluarën, ky ka qënë një sekret qiellor dhe tani unë e zbulova para jush. Ato që përdoren në Tibet janë vetëm pak lëvizje për praktikë dhe njerëzit i kanë klasifikuar e i kanë kthyer ato në një sistem. Ato vetëm shërbejnë si gjuhë në praktikë dhe janë vetëm pak forma për praktikë. Lëvizjet e vërteta të duarve janë tepër të sofistikuara.

4. Leksioni i Katërt

(…..)

Ekziston një proçes transformimi ndërmjet substancës së bardhë dhe substancës së zezë. Kur ndodh një konflikt ndërmjet dy personave, ndodh dhe ky proçes transformimi. Kur një individ kryen një vepër të mirë, ai merr substancë të bardhë, virtyt. Kur një individ kryen një vepër të keqe, ai merr substancë të zezë, ***karmë***. Ekziston gjithashtu dhe një proçes trashëgimie. Dikush mund të pyesë, "A ndodh kjo për shkak se individi ka bërë gjëra të këqija në jetën e tij të mëparshme?"Mund të mos jetë pikërisht kështu sepse karma nuk akumulohet vetëm gjatë një jete. Komuniteti i kultivuesve beson që Shpirti Primordial nuk zhduket. Nëse një Shpirt Primordial nuk zhduket, atëhere personi me siguri ka pasur lidhje shoqësore përpara kësaj jete. Kështu, personi mund t'i ketë borxh dikujt tjetër, të ketë keqtrajtuar dikë, apo të ketë bërë gjëra të tjera të këqija, si vrasje, e cila do të shkaktonte këtë karmë. Këto gjëra mblidhen në një

dimension tjetër dhe njerëzit i mbartin ato gjithmonë me vete. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për substancën e bardhë. Ky nuk është burimi i vetëm pasi ekziston gjithashtu dhe një situatë tjetër. Gjatë gjithë brezave të një familjeje, paraardhësit gjithashtu mund të akumulojnë karmë për brezat e mëvonshëm. Në të kaluarën, të moshuarit thonin: "Njeriu duhet të bledhë virtyt dhe të parët e dikujt kanë mbledhur virtyt. Ky person po fal virtyt dhe ky po shpërdoron virtyt. "Këto ishin thënie shumë të sakta. Në ditët e sotme, njerëzit nuk ia venë më veshin këtyre thënieve. Nëse ju i flisni të rinjve për humbje virtyti apo mungesë virtyti, ata nuk do të preken fare. Në fakt, kuptimi i saj është me të vërtetë shumë i thellë. Virtyti nuk është thjesht një koncept apo standart shpirtëror i njerëzve modernë por është në fakt një material që ekziston me të vërtetë. Trupat tanë fizikë i kanë të dyja këto lloj substancash. Dikush pyet, "Është e vërtetë që nëse një njeri ka shumë substance të zezë është e pamundur për të që të praktikojë në nivele të larta?"Mund të jetë ashtu sepse me tepër substancë të zezë, cilësia e ndriçimit shpirtëror të personit do të ndikohej. Meqenëse ajo formon një fushë rreth trupit të njeriut dhe e mbështjell njeriun drejt e në mes, ai është kështu i shkëputur nga Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), karakteristika e universit. Pra, ndriçimi shpirtëror i këtij njeriu mund të jetë i ulët. Kur njerëzit flasin për praktikë kultivuese dhe qigong, ky individ do t'i konsiderojë të gjitha këto si paragjykime dhe nuk do t'i besojë ato aspak. Ai do t'i shohë ato si qesharake. Zakonisht ndodh kështu por kjo nuk është absolute. A do të ishte tepër e vështirë për këtë person që të praktikonte kultivim dhe se ai nuk do të ishte në gjëndje të arrinte gong të nivelit të lartë? Jo, nuk është ashtu. Ne kemi thënë se Ligji i Lartë është i pakufishëm dhe se varet plotësisht nga zemra juaj për të praktikuar kultivim. Mjeshtri ju çon deri tek porta dhe varet nga vetë ju për të praktikuar kultivim. Gjithçka varet nga ju vetë sesi praktikoni kultivim. Nëse ju mund të praktikoni kultivim varet e gjitha nga sa ju mund të duroni, sakrifikoni dhe vuani. Nëse ju e vendosni në mëndje, asnjë vështirësi nuk mund t'ju ndalojë. Unë do të thoja që nuk do kishte asnjë problem.

Një personi me shumë substance të zezë normalisht do t'i duhet të sakrifikojë me shumë se sa një personi me shumë substance të bardhë. Pasi substanca e bardhë është drejtëpërdrejtë e asimilueshme në karakteristikën e universit, Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), për aq kohë që një person përmirëson karakterin e tij gjatë konflikteve, gongu i tij do të rritet. Është kaq e thjeshtë. Një person me shumë virtyt ka cilësi të mirë ndriçimi shpirtëror. Ai mund të vuajë dhe durojë si vështirësi fizike ashtu dhe mendore. Edhe sikur ky njeri të vuajë më shumë fizikisht sesa mendërisht, gongu përsëri do t'i rritet. Kjo nuk ndodh për një person me shumë substance të zezë sepse ai së pari duhet të kalojë gjatë këtij proçesi: Ai duhet të transformojë substancen e zezë në substancë të bardhë. Ky proçes është gjithashtu shumë i dhimbshëm. Prandaj, një person me cilësi

të ulët ndriçimi shpritëror zakonisht duhet të vuajë më shumë vështirësi. Me shumë karmë dhe cilësi të ulët ndriçimi shpirtëror është më e vështirë për këtë person të praktikojë kultivim.

Marrim një rast të veçantë si shembull. Le të shohim se si praktikon kultivim ky person. Meditimi ulur kërkon vendosjen e të dyja këmbëve mbi njëra tjetrën për një periudhë kohe të gjatë. Këmbët do të dhëmbin dhe mpihen pasi të marrin këtë pozicion. Me kalimin e kohës, personi do të fillojë të mos ndjehet rehat dhe më pas dhimbja bëhet e padurueshme. Vuajtja fizike dhe mendore mund të bëjnë që si mëndja ashtu dhe trupi, të vihen në gjendje mjaft të parehatshme. Disa njerëz nuk mund ta durojnë dhimbjen kur ulen me këmbët kryq dhe ata do të duan të heqin dorë duke ulur këmbët. Disa të tjerë nuk durojnë dot pasi rrinë ulur për një kohë pak më të gjatë. Po u ulën këmbët, praktika është e kotë. Kur këmbët fillojnë të dhëmbin, personi do të bëjë disa shtriqje të këmbëve para së të rimarrë pozicionin e meditimit. Për mendimin tim kjo nuk ka asnjë vlerë. Kjo për arsyen se ne kemi parë që kur këmbët dhëmbin, substanca e zezë ka lëvizur tek këmbët. Substanca e zezë është karmë që mund të eliminohet nëpërmjet vuajtjes e më pas ajo mund të transformohet në virtyt. Sapo fillon dhimbja, karma fillon të eliminohet. Sa më shumë karmë vjen aq më shumë dhëmbin këmbët. Prandaj dhimbja në këmbë nuk fillon pa shkak. Zakonisht, gjatë meditimit këmbët tuaja do ta ndjejnë dhimbjen me intervale. Pas një momenti dhimbjeje të padurueshme, ajo mbaron dhe ka pak lehtësim. Menjëherë dhimbja fillon përsëri. Zakonisht ndodh kështu.

(…..)

Në këtë univers, ka një parim që thotë: "pa humbje, s'ka fitim. "Që të fitosh duhet të humbesh. Ai person ju vuri në një situatë të keqe mes njerëzve dhe ai është pala që ka fituar në kurrizin tuaj. Sa më e keqe situata që ai të vë, sa më të mëdha pasojat dhe sa më shumë duron ti, aq më shumë virtyt do të humbë ai. Ky virtyt do t'ju jepet i gjithi juve. Ndërsa ju jeni duke duruar gjithë këtë, ju nuk doni t'ja dini dhe nuk e merrni me shumë seriozitet në mëndje.

Në këtë univers, ekziston dhe një parim tjetër: Nëse ju vuani shumë, karma në trupin tuaj do të transformohet. Ngaqë ju keni vuajtur, aq sa shumë keni vuajtur aq do të transformohet në virtyt. A nuk është ky virtyt ajo që dëshiron një praktikues? Ju do të fitoni dyfish, sepse dhe karma juaj do të eliminohet. Nëqoftëse ky person nuk do e kishte krijuar këtë situatë për ju, si mundet që ju të përmirësoni karakterin tuaj? Nëqoftëse ju dhe unë jemi të mirë me njëri-tjetrin dhe në harmoni, si mund të jetë e mundur të rrisim gongun? Është pikërisht sepse ai person ka krijuar këtë konflikt për ju që krijohet kjo mundësi përmirësimi karakteri dhe ju mund ta përdorni atë për të përmirësuar karakterin tuaj. A nuk ngrihet karakteri juaj në këtë mënyrë? Ju keni fituar trefish. Ju jeni praktikues. Me ngritjen e karakterit, a nuk do të rritet edhe gongu juaj? Ju keni fituar katërfish me një

të shtënë. Pse të mos e falenderoni atë person? Ju sinqerisht duhet ta falenderoni atë nga thellësia e zemrës—në fakt është kështu.

Natyrisht, qëllimi i atij personi nuk ishte i ndershëm, përdryshe ai nuk do të të jepte ty virtyt. Por ai me të vërtetë krijoi një mundësi për të përmirësuar karakterin tuaj. Me fjalë të tjera, ne duhet ti kushtojmë vëmendje kultivimit të karakterit. Në të njëjtën kohë që karakteri kultivohet, karma eliminohet dhe transformohet në virtyt kështu që ju mund të ngjiteni në nivel më të lartë; këto shkojnë njëra me tjetrën. Nga pikëpamja e një niveli të lartë, këto parime janë të gjitha të ndryshme. Një njeri i zakonshëm nuk do t'i kuptojë ato. Kur i shikoni këto parime nga nivele të larta, çdo gjë do të jetë ndryshe. Për njerëzit e zakonshëm këto parime mund të jenë të drejta, por në fakt ato nuk janë të drejta. Vetëm ajo që shikohet nga nivele më të larta është me të vërtetë e drejtë. Normalisht është kështu.

(…..)

Përveç Shkollës Buddhës dhe Shkollës Tao, ekziston dhe Shkolla Qimen, e cila e quan veten praktika kultivuese Qimen. Përsa i përket praktikave kultivuese, njerëzit e zakonshëm kanë këtë perceptim: Që nga Kina e lashtë deri më sot njerëzit e kanë konsideruar Shkollën e Buddhës dhe të Taos si mënyra kultivimi ortodokse dhe i quajnë ato shkolla të vërteta të praktikës kultivuese. Kjo Shkolla Qimen nuk është bërë kurrë e njohur publikisht dhe shumë pak njerëz kanë dëgjuar për ekzistencën e saj, me përjashtim të veprave letrare.

A ekziston pra kjo Shkollë Qimen? Po, ekziston. Gjatë kohës së praktikës sime kultivuese veçanërisht në vitet e fundit, unë jam takuar me tre mjeshtër shumë të arrirë nga Shkolla Qimen. Ata më kaluan mua thelbin e praktikave të tyre, gjëra shumë të veçanta dhe të mira. Thjesht për arsye se ajo është shumë e veçantë, ajo që ajo kultivon është shumë e pazakontë dhe nuk mund të kuptohet nga shumica e njerëzve. Përveç kësaj, ata pohojnë që nuk janë as nga Shkolla Buddhës dhe as nga Shkolla Tao. Ata nuk kultivojnë Buddha apo Tao. Me të dëgjuar se ata nuk kultivojnë Buddha apo Tao, njerëzit e quajnë atë "Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët"(pangmen zuodao). Ata e quajnë veten Shkolla Qimen. Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët ka një nënkuptim ofendues, por këtu nuk ka kuptim negativ, sepse ajo nuk e akuzon shkollën si një praktikë të keqe—kjo është e sigurt. Edhe përkufizimi letrar i këtij termi nuk nënkupton një praktikë të keqe. Historikisht Shkolla Buddhës dhe Shkolla Tao kanë qenë quajtur "shkolla ortodokse"të praktikës kultivuese. Kur kjo praktikë nuk kuptohet nga publiku, njerëzit e quajnë atë "Derë Anësore"ose rrugë anësore dhe një shkollë joortodokse. Çfarë është atëhere "Rruga e Ngathët"? "E ngathët"nënkupton përtacëri apo mënyrë të ngadaltë. Një term i ardhur nga Kina e lashtë, "i ngathët"shpesh i referohej të qënit të ngadaltë. Derë Anësore dhe Rrugë e Ngathët mbart këtë kuptim.

Pse nuk është ajo një praktikë e keqe? Kjo për arsye sepse ajo ka gjithashtu kërkesa të rrepta mbi karakterin. Praktika e saj kultivuese ndjek gjithashtu karakteristikën e universit. Ajo nuk shkel karakteristikën apo ligjin e universit dhe as nuk kryen vepra të këqija. Prandaj, ajo nuk mund të quhet një praktikë e ligë. Shkolla Buddhës dhe Shkolla Tao janë shkolla ortodokse, jo sepse karakteristika e universit i përshtatet praktikës së tyre, por sepse praktikat e të dy shkollave i përmbahen karakteristikës së universit. Nëqoftëse praktika kultivuese e Shkollës Qimen gjithashtu i përmbahet karakteristikës së universit, ajo nuk është një praktikë e ligë por një shkollë e drejtë. Kjo për arsye se kriteri për të dalluar të mirën nga e keqja dhe mirësinë nga ligësia është karakteristika e universit. Kultivimi i saj i përmbahet karakteristikës së universit, kështu që ajo është një rrugë e drejtë, pavarësisht nëse kërkesat e saj ndryshojnë nga ato të Shkollës Buddhës dhe të Taos. Ajo nuk mëson shumë dishepuj por i mësohet vetëm një grupi shumë të vogël njerëzish. Shkolla Tao mëson shumë dishepuj, por vetëm një dishepull merr mësimin e vërtetë. Shkolla Buddhës beson në shpëtimin e të gjitha qënieve, kështu që kushdo që mund të praktikojë mund ta arrijë atë. Shkolla Qimen nuk mund të trashëgohet nga dy persona, sepse ajo i transmetohet vetëm një personi të zgjedhur gjatë një periudhë të gjatë historike. Prandaj, gjatë gjithë historisë gjërat e saj nuk mund të njiheshin nga njerëzit e zakonshëm. Natyrisht kur qigong ishte popullor, unë konstatova që pak njerëz nga kjo shkollë dolën për të mësuar. Megjithatë, pas disa mësimeve në publik, ata kuptuan që kjo nuk ishte e arritshme sepse mjeshtri nuk lejonte që disa gjëra t'i trasmetoheshin publikut. Nëqoftëse doni të mësoni publikun, ju nuk mund të zgjidhni nxënësit. Ato që vijnë për të mësuar do të sjellin nivele të ndryshme karakteri dhe mentalitete të ndryshme sepse ato janë njerëz nga të gjitha llojet. Do të jetë e pamundur për ju që të zgjidhni dishepujt për t'i mësuar. Prandaj, Shkolla Qimen nuk mund të mësohet gjërësisht në publik. Duke vepruar kështu mund të jetë me rrezik sepse praktika e saj është shumë e veçantë.

Disa njerëz mundohen të kuptojnë: ndërsa Shkolla Buddhës kultivon Buddhë dhe Shkolla Tao kultivon Tao, çfarë do të bëhet një praktikues në Shkollën Qimen pasi të përfundojë kultivimin? Ky person do të jetë një Zot shëtitës pa ndonjë kufi të caktuar në univers. Dihet nga të gjithë se Tathagata Sakyamuni ka Parajsën Saha, Buddha Amitabha ka Parajsën e Lumturisë Absolute dhe Buddha Bhaishajyaguru ka Parajsën e Xhamtë. Çdo Tathagata apo Buddha i madh ka parajsën e tij. Çdo Qënie e Shumëlartësuar ndërton mbretërinë qiellore të tij dhe shumë nga dishepujt e tij jetojnë atje. Ndërsa një nga Shkolla Qimen nuk ka ndonjë kufi të caktuar në univers dhe ky person do të jetë si një Zot shëtitës apo i Pavdekshëm i vetmuar.

(…..)

Çfarë është ***disiplina e magjisë***? Në komunitetin e kultivuesve, gjatë mësimit të qigongut shumë njerëz e mësojnë atë si një kategori kultivimi. Në fakt, nuk është diçka që i përket kategorisë së praktikës kultivuese. Ajo është mësuar në formën e aftësive, e lutjeve dhe teknikave. Ajo përdor forma vizatimi të simboleve, djegje ere të mirë, djegje letrash, këndim lutjesh etj. Ajo mund të shërojë sëmundje dhe metodat e kurimit të saj janë shumë të veçanta. Për shembull, nëse dikush ka një lungë të fryrë në fytyrë, praktikuesi do të vizatojë një rreth në tokë me një pendë të lyer me bojë dhe vizaton një kryq në mes të rrethit. Ai do t'i kërkojë personit që të qëndrojë në qëndër të rrethit. Pastaj ai do të fillojë të këndojë lutjet. Ai vazhdon të vizatojë derisa bën një pikë mbi lungë me pendë dhe këndimi i lutjeve mbaron aty. Ai do t'i thotë asaj se tani e ka mirë. Kur ajo e prek lungën, kjo do të jetë me të vërtetë më e vogël dhe nuk i dhëmb më, sepse kjo mënyrë mund të ketë efekt. Ai mund të shërojë sëmundje të vogla por jo të mëdha. Çfarë do të bëjë ai nëse ju dhemb krahu? Ai do të fillojë të këndojë lutje, ndërkohë ju kërkon që të ngrini krahun. Ai do të fryjë në pikën hegu[87] të kësaj dore dhe do e nxjerrë atë nga pika hegu e dorës tjetër. Ju do të ndjeni një rrymë ajri dhe kur ju të prekni krahun tuaj, nuk do të ndjeni më dhimbje si më parë. Përveç kësaj, disa njerëz përdorin metodat e djegjes së letrave, vizatimit të simboleve, vendosjes së simboleve, etj. Ata bëjnë gjëra të tilla.

Praktikat e njohura të rrugëve anësore të Shkollës Tao nuk kultivojnë jetë. Ato i dedikohen kryesisht kallëzimit të fatit, fengshui (feng-shuei - praktikë e lashtë kineze e të jetuarit në harmoni me energjinë e ambjentit rrethues; një lloj arti i interpretimit të truallit dhe natyrës), largimit të shpirtrave të këqinj dhe shërimit të sëmundjeve. Shumica e këtyre përdoren nga praktikat tokësore të rrugëve anësore. Ato mund të shërojnë sëmundje por metodat e përdorura nuk janë të mira. Ne nuk do të tregojmë se çfarë përdorin ata për të shëruar sëmundjet por praktikuesit e Dafës sonë nuk duhet t'i përdorin ato përderisa ato mbartin mesazhe shumë të ulëta dhe të këqija. Në Kinën e lashtë, metodat e shërimit ishin ndarë në disiplina si metoda e rregullimit të frakturave, akupunktura, masazhi, kiropraktika (metodë trajtimi sëmundjesh duke manipuluar nyjet e kockave, sidomos atyre të shtyllës kurrizore), shtypja me duar, shërimi qigong, kurimi me bimë mjekësore, e kështu me radhë. Ato klasifikoheshin në shumë ndarje. Çdo metodë shërimi quhej një disciplinë. Kjo disiplina e magjisë është klasifikuar si disiplina e trembëdhjetë. Prandaj, emri i saj i plotë është "Disiplina e Trembëdhjetë e Magjisë. "Disiplina e Magjisë nuk është diçka brenda kategorisë sonë të kultivimit, për arsye se nuk është gong i arritur nëpërmjet praktikës kultivuese. Përkundrazi është një lloj teknike.

(……..)

5. Leksioni i Shtatë

Çështa ***e vrasjes*** është shumë sensitive. Për praktikuesit, ne kemi vënë kërkesën e rreptë që ata nuk duhet të vrasin jetë. Qoftë Shkolla e Buddhës, Shkolla Tao, apo Shkolla Qimen, pamvarësisht se cila shkollë apo praktikë është, nëqoftëse janë praktika kultivuese të vërteta, do e konsiderojë këtë çështje shumë absolute dhe e ndalojë vrasjen - kjo është e sigurtë. Meqë pasojat e vrasjes së një jete janë kaq serioze, ne duhet ta sqarojmë atë në detaj. Në Buddhizmin origjinal, vrasja kryesisht i referohej marrjes së një jete njeriu, e cila konsiderohej vepra më serioze. Më pas, vrasja e kafshëve të mëdha, kafshëve të mëdha shtëpiake, apo kafshëve relativisht të mëdha konsideroheshin të gjitha si tepër serioze. Pse është konsideruar kaq serioze çështja e vrasjes në komunitetin e kuitivuesve? Në të kaluarën, Buddhizmi thoshte se jetët që nuk duhet të vdisnin po të vriteshin do të ktheheshin në shpirtra të vetmuar dhe fantazma pa shtëpi. Më parë, kryheshin rite për të çliruar shpirtrat e këtyre njerëzve nga vuajtjet. Pa këto shërbesa, këta shpirtra do të vuanin nga urija dhe etja, duke jetuar në një gjendje tepër të ashpër. Këtë thoshte Buddhizmi në të kaluarën.

Ne besojmë se kur dikush i bën keq dikujt tjetër, ai duhet të japë plot virtyt si kompensim. Këtu ne i referohemi zakonisht asaj kur dikush ka marrë gjërat që i takojnë njerëzve të tjerë etj. Ndërsa nëqoftëse një jetë merret papritur, qoftë kafshë apo krijesë tjetër, kjo do të krijojë plot karmë. Në të kaluarën, vrasja i referohej kryesisht marrjes së një jete njeriu që do të shkaktonte një sasi karme të madhe. Megjithatë vrasja e jetëve të tjera nuk është mëkat më i vogël, sepse ajo gjithashtu shkakton plot karmë. Veçanërisht për një praktikues, gjatë praktikës kultivuese juve ju jepen disa vështirësi në çdo nivel të ndryshëm. Ato shkaktohen të gjitha nga karma juaj dhe janë vështirësitë tuaja, të cilat vendosen në nivele të ndryshme në mënyrë që ju të përmirësoni veten. Po e përmirësuat karakterin tuaj, ju do të mundni t'i mposhtni ato. Por nëqoftëse ju papritmas merrni kaq shumë karma nga vrasja, si mundet t'i mposhtni ju ato? Me nivelin tuaj të karakterit ju nuk do mundni t'ja arrini aspak. Kjo mund ta bëjë të pamundur që ju të praktikoni kultivim.

Ne kemi parë që kur një njeri lind, lindin shumë prej tij njëkohësisht brenda një pjese të caktuar të hapësirës kozmike. Ata ngjajnë me njeri tjetrin, kanë të njejtin emër dhe bëjnë gjëra të ngjashme. Prandaj, edhe ata mund të quhen pjesë të qënies së tij të plotë. Kjo ka lidhje me çështjen që vijon: në rast se njeri prej tyre (kjo është e njejtë dhe për rastin e jetës së kafshëve të mëdha) vdes papritur ndërsa të tjerët në dimensione të ndryshme kanë akoma kohë për të përfunduar udhëtimin e tyre të jetës të paracaktuar nga fati dhe akoma kanë shumë vite për të jetuar, personi i vdekur do të jetë i pashtëpi dhe do të sorrollatet në hapësirën e universit. Thuhej në të kaluarën se shpirtrat e vetmuar dhe fantazmat pa strehë

vuajnë nga urija, etja dhe vuajtje të tjera. Kjo mbase është e vërtetë. Por ne me të vërtetë kemi konstatuar gjendjen e tmerrshme në të cilën vuan një person ngaqë ai duhet të presë për fatin e tij përfundimtar ku çdonjeri prej tij në çdo dimension përfundon jetën e vet. Sa më gjatë të shkojë, aq më shumë vuan ai. Sa më shumë vuan ai, aq më shumë karmë e krijuar nga vuajtjet e tij do t'i shtohet trupit të vrasësit. Mendoheji pak: Sa shumë karmë mund të grumbulloni? Këtë kemi konstatuar ne nëpërmjet aftësive supernormale.

Ne gjithashtu kemi vënë re këtë situatë: Kur një person lind, një profil i tërë jetës së tij do të ekzistojë në një dimension të caktuar. Me fjalë të tjera, ku ai ndodhet në jetë dhe çfarë duhet të bëjë janë të tëra të përfshira në të. Kush e ka paracaktuar jetën e tij? Është bërë me sa duket nga një jetë më e lartë. Për shembull, në shoqërinë tonë njerëzore, pas lindjes dikush i përket një familjeje të caktuar, një shkolle të caktuar dhe pasi rritet një vendi pune të caktuar; kontakte të ndryshme në shoqëri vendosen nëpërmjet punës së personit. Domethënë, tërë përbërja e shoqërisë është rregulluar në këtë mënyrë. Megjithatë nëqoftëse një jetë vdes papritmas dhe jo sipas renditjes origjinale dhe specifike, apo nëqoftëse ndryshohen gjërat, jeta më e lartë nuk do t'ja falë prishësit. Pa mendojeni njëherë të gjithë: Si praktikues, ne duam të praktikojmë kultivim drejt niveleve të larta. Ajo jetë e nivelit të lartë nuk do t'ja falë vrasësit. A mendoni se ky person mund të praktikojë më kultivim? Nivelet e disa mjeshtërve nuk janë aq të lartë sa ajo jetë e lartë që ka bërë planifikimin. Prandaj, edhe mjeshtri i personit do të ndëshkohet dhe do të ulet në nivel të ulët. Veç mendojeni pak: A është kjo një çështje e rëndomtë? Kështu sapo një person të ketë bërë një gjë të tillë, do jetë shumë e vështirë për të që të praktikojë kultivim.

Në mes të praktikuesve të Falun Dafës mund të ketë disa që kanë luftuar në kohë luftërash. Ato luftëra ishin rrethana që u shkaktuan nga ndryshime kozmike më të mëdha në tërësinë e fenomeneve qiellore dhe ju ishin vetëm një element në ato rrethana. Pa pjesëmarrjen e njerëzve nën efektin e ndryshimeve kozmike, këto situata nuk do të ndodhnin në shoqërinë njerëzore dhe as do të quheshin ato ndryshime kozmike. Këto ngjarje u shkaktuan si pasojë e ndryshimeve më të mëdha dhe nuk ishin për fajin tuaj. Ajo që po diskutojmë këtu është karma që rezulton nga këmbëngulja e njeriut për të bërë gjëra të këqija kur kërkon fitim personal, të kënaqë interesin personal, apo kur preket interesi i tij. Për aq kohë sa kjo lidhet me ndryshimet e gjithë universit të pamasë dhe ndryshimet themelore në shoqëri, nuk është faji juaj.

Vrasja mund të sjellë karmë kolosale. Dikush mund të mendojë: "Ne nuk mund të vrasim jetë, por unë jam kuzhinieri në familje. Çfarë do të hajë familja ime nëqoftëse unë nuk vras dot? Kjo çështje specifike nuk më përket mua sepse unë po u mësoj Ligjin praktikuesve e nuk jam këtu duke ju treguar njerëzve të zakonshëm si të jetojnë. Në lidhje me çështjen si

duhet të trajtoni ju çështje të veçanta, ju duhet të gjykoni sipas Ligjit të Lartë. Ju duhet të veproni si ta shihni të arsyeshme. Njerëzit e zakonshëm do të bëjnë çfarëdo që duan dhe kjo është puna e tyre; nuk është e mundur për çdo njeri të praktikojë kultivim me të vërtetë. Megjithatë, si praktikues, ju duhet të ndiqni një standart më të lartë, kështu unë këtu po parashtroj kërkesat për praktikuesit.

Përveç njerëzve dhe kafshëve, bimët kanë jetë gjithashtu. Jeta e çdo lloj materieje mund të manifestohet në dimensione të tjera. Kur Syri yt Qiellor arrin nivelin e Shikimit të Ligjit, ju do të zbuloni se gurët, muret, apo çdo gjë tjetër mund t'ju flasë dhe t'ju përshëndesë. Mbase dikush mund të mendojë: "Drithërat dhe zarzavatet që hamë janë gjithashtu jetë. Po ashtu ka miza dhe mushkonja në shtëpi. Çfarë të bëjmë? Nuk do ishte aspak e këndshme që të pickoheshe nga një mushkonjë në verë dhe një person do rrinte e vështronte si po pickohesh pa bërë gjë. Nëqoftëse dikush do shihte një mizë duke ndotur mbi ushqimin e tij, ai nuk do të mund ta vriste atë. Më lejoni t'ju them se ne nuk duhet të marrim jetë sipas dëshirës pa ndonjë arësye. Por as dhe nuk duhet të bëhemi njerëz me kujdes të tepruar, duke u përqëndruar gjithmonë tek vogëlsirat, apo duke kërcyer këtu e aty kur ecim nga frika se mos po shtypim mbi milingona. Do thoja se do jetonit kështu një jetë të lodhshme. A nuk do ishte ky dhe një ves? Edhe sikur duke kërcyer nuk do vrisje asnjë milingonë, ju prapseprapë mund të keni vrarë shumë mikroorganizma. Ka shumë jetë edhe më të vogla në nivel mikroskopik, duke përfshirë mikrobet dhe bakteriet; mbase ju keni shkelur dhe vrarë shumë prej tyre. Kështu, ne po ndalojmë më mirë së jetuari. Ne nuk duam të bëhemi njerëz të tillë, sepse kjo e bën praktikën kultivuese të pamundur. Njeriu duhet të ketë këndvështrim më të gjërë dhe të praktikojë kultivim në mënyrë të hapur dhe dinjitoze.

Si qënie njerëzore, ne kemi të drejtë të bëjmë jetë njerëzish. Prandaj, ambjenti ynë jetësor duhet të plotësojë nevojat e jetësës njerëzore. Ne nuk mund të dëmtojmë apo marrim jetë me qëllim, por ne as nuk duhet të shqetësohemi me tepri me këto gjëra të vogla. Për shembull, zarzavatet dhe drithërat që rrisim janë të gjitha jetë. Ne nuk mund të ndalojmë së ngrëni apo së piri për shkak se ato kanë jetë, sepse si mund të praktikojmë ne kultivim pastaj? Njeriu duhet të shikojë përtej këtyre gjërave. Për shembull, ndërsa ti je duke ecur, disa milingona apo insekte mund të bien nën këmbët e tua dhe të vriten. Mbase ato ishin për të ngordhur përderisa ti nuk i vrave ato me qëllim. Në botën e organizmave dhe mikroorganizmave, ekziston edhe çështja e ekuilibrit ekologjik—çdo lloj specie me tepricë do të ishte problematike. Ne duhet kështu të praktikojmë kultivim në mënyrë dinjitoze dhe të hapur. Kur mizat dhe mushkonjat janë në shtëpi, mund t'i nxjerrim ato përjashta apo të vendosim një rrjetë në dritare që të mos hyjnë brenda. Shpesh, ato nuk duan të dalin dhe në rast se shtypen, ashtu qoftë. Nëqoftëse do të pickonin apo dëmtonin njerëzit në

vendin ku ata jetojnë, ne sigurisht duhet t'i nxjerrim ato përjashta. Nëqoftëse ato nuk nxirren dot jashtë, ti nuk mund të rridh e t'i shikosh ato kur pickojnë njerëzit. Si praktikues, ju nuk i kushtoni vëmendje atyre dhe nuk ju gjen gjë prej tyre, por pjesëtarët e familjes nuk praktikojnë kultivim dhe janë njerëz të zakonshëm që kanë problemin e sëmundjeve ngjitëse. Ne nuk mund të vëzhgojmë dhe të mos bëjmë asgjë kur një mushkonjë pickon një fëmijë në fytyrë.

Më lejoni t'ju jap një shembull. Ekziston një histori për Sakyamunin në vitet e tij të hershme. Një ditë Sakyamuni do të bënte banjë në një pyll dhe i kërkoi një dishepulli të pastronte vaskën. Dishepulli i tij shkoi tek vaska dhe e gjeti plot me insekte që ecnin gjithandej. Insektet do të vriteshin nëqoftëse ai pastronte vaskë. Dishepulli u kthye tek Sakyamuni dhe i tha: "Vaska është plot me insekte. "Sakyamuni ju përgjigj pa e parë: "Ti duhet të shkosh e të pastrosh vaskën. "Dishepulli u kthey tek vaska dhe nuk dinte si ta pastronte atë, sepse po të bënte ashtu do të vriste insektet. Ai u kthye përsëri tek Sakyamuni dhe i tha: "Mjeshtër, vaska është plot me insekte. Po ta pastroj, insektet do të vriten. "Sakyamuni e pa dhe i tha: "Ajo që të kërkova të bësh është të lash vaskën. "Dishepulli e kuptoi këtë herë dhe shkoi dhe e pastroi vaskën menjëherë. Kjo histori tregon një parim: Ne nuk duhet të ndalojmë së bëri banjo sepse ka insekte dhe as duhet që të gjejmë një vend tjetër të jetojmë sepse ka mushkonja. Ne po ashtu nuk duhet të qepim gojën e të mos hamë e pijmë sepse si drithërat dhe zarzavatet janë jetë. Nuk duhet të jetë kështu. Ne duhet ta zgjidhim këtë çështje siç duhet dhe praktikojmë kultivim në mënyrë dinjitoze. Nuk ka problem për aq kohë sa ne nuk dëmtojnë ndonjë jetë me qëllim. Ndërkohë, njerëzit gjithashtu duhet të kenë hapësirën dhe kushtet e jetesës dhe këto duhet gjithashtu të ruhen. Qëniet njerëzore kanë nevojë të vazhdojnë jetën dhe të jetojnë normalisht.

Në të kaluarën, disa mjeshtër të rremë qigongu thonin: "Mund të vrasësh jetë në ditën e parë dhe të pesëmbëdhjetë të çdo muaji të kalendarit hënor. "Disa prej tyre madje pretendonin se nuk ishte gjë e keqe të vrisje kafshë me dy këmbë sikur ato të mos ishin jetë. A nuk konsiderohen si marrje jete vrasjet që bëhen në ditën e parë apo të pesëmbëdhjetë? Pra kjo na qënka si të grish sallatë ë? Disa mjeshtër qigongu të rremë mund t'i tregosh nga fjalët dhe veprat, apo nga ajo që thonë dhe çfarë qëllimi kanë. Të gjithë ata mjeshtër qigongu që bëjnë deklarata të tilla zakonisht janë zotëruar nga shpirtra apo kafshë. Veç të shikoni se si një mjeshtër qigongu i zotëruar nga dhelpra ha mish pule. Kur ky person e kullufit atë, ai nuk i nxjerr jashtë as kockat.

Vrasja nuk shkakton vetëm shumë karmë, por ajo gjithashtu lidhet me çështjen e mëshirës. A nuk duhet të jemi ne mëshirues si praktikues? Kur mëshira jonë shfaqet, ne me siguri do të na duken të gjitha qëniet e gjalla dhe të gjithë njerëzit të vuajnë. Kjo do të ndodhë.

Ngrënia ***e mishit*** është gjithashtu një çështje shumë sensitive, por të hash mish nuk do të thotë të vrasësh jetë. Megjithëse të gjithë ju keni studjuar Ligjin për kaq kohë, ne nuk ju kemi kërkuar të ndaloni ngrënien e mishit. Shumë mjeshtër qigongu ju thonë të ndaloni ngrënien e mishit sapo ju hyni në klasat e tyre. Ju mund të mendoni: "Unë nuk jam akoma i pregatitur mendërisht të ndaloj ngrënien e mishit menjëherë. "Ushqimi i servirur sot në shtëpi mund të jetë pulë e pjekur apo peshk i fërguar. Megjithëse ato kanë aromë shumë të mirë, juve nuk ju lejohet t'i hani ato. Kjo është e vërtetë dhe me praktikat kultivuese fetare që i detyrojnë njerëzit të mos hanë mish. Praktikat konvencionale në Shkollën e Buddhës dhe disa praktika në Shkollën Tao gjithashtu thonë të njejtën gjë dhe i ndalojnë njerëzit të hanë mish. Ne nuk ju kërkojmë juve këtu të bëni të njejtën gjë, por edhe neve na intereson kjo çështje. Atëhere, çfarë kërkojmë ne? Meqenëse në praktikën tonë është Ligji që kultivon praktikuesit, kjo do të thotë që disa gjendje do të lindin nga gongu dhe Ligji. Në periudhën e praktikës, nivele të ndryshme prodhojnë situata të ndryshme. Një ditë apo pas leksionit tim sot, disa njerëz mund të hyjnë në këtë gjendje: Ata nuk mund të hanë mish dhe nuk ja durojnë dot erën. Po të hanë mish, atyre do t'ju vijë për të vjellë. Kjo nuk vjen sepse ju detyron njeri dhe as sepse e detyroni ju veten të mos hani mish. Përkundrazi, kjo vjen nga mëndja juaj. Pas arritjes së këtij niveli, ju nuk do të jeni të aftë të hani mish, sepse është gongu juaj që e sjell këtë gjendje. Nëqoftëse e përcillni mishin, ju me të vërtetë do të villni.

Praktikuesit tanë veteranë të gjithë e dinë që kjo situatë do të ndodhë në praktikën kultivuese të Falun Dafës, sepse nivele të ndryshme sjellin gjendje kultivimi të ndryshme. Disa praktikues kanë një dëshirë të madhe dhe një ves të fortë ndaj ngrënies së mishit—ata zakonisht hanë shumë mish. Kur të tjerëve ju duket mishi shumë i pështirshëm, atyre nuk ju duket kështu dhe akoma mund ta hanë atë. Në mënyrë që t'ja heqim këtë ves, çfarë mund të bëhet? Ky person do të ketë dhimbje stomaku sapo të hajë mish. Kur nuk ha mish, ai apo ajo nuk do të ketë dhimbje. Kjo situatë do të ndodhë dhe do të thotë që personi nuk duhet të hajë mish. A do të thotë kjo se pas kësaj shkolla jonë e praktikës nuk do ketë të bëjë fare me mishin? Nuk është kështu. Si ta trajtojmë ne këtë çështje? Kur nuk je në gjendje të hash mish, kjo vjen nga brenda teje. Cili është qëllimi? Praktikat kultivuese në tempuj e detyrojnë personin të mos hajë mish. Si kjo ashtu dhe gjendja e të mos ngrënit mish që shfaqet në praktikën tonë, të dyja kanë për qëllim të heqin këtë dëshirë njerëzore apo vesit e të ngrënit mish.

Nëqoftëse nuk kanë mish në pjatë, disa persona thjesht nuk e hanë ushqimin e tyre. Kjo është një dëshirë prej njeriu të zakonshëm. Një mëngjes kur unë po kaloja në hyrjen e pasme të Parkut të Triumfit në Changchun, tre persona dolën nga hyrja e pasme duke folur me zë të lartë. Njëri prej tyre tha: "Çfarë lloj qigongu qenka ky që nuk të lejon të hash

mish? Unë më mirë jap dhjetë vjet nga jeta ime se sa të lë mishin!"Çfarë dëshirë e fortë kjo! Mendojeni pak të gjithë: A nuk duhet të hiqet kjo dëshirë? Patjetër që duhet. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, personi duhet të heqë dorë nga dëshirat dhe veset e ndryshme. Që ta themi hapur, nëqoftëse dëshira për të ngrënë mish nuk është hequr, a nuk do të thotë kjo që vesi nuk është braktisur? Si mundet personi ta përfundojë kultivimin? Prandaj për aq kohë sa një gjë është ves, ai duhet të hiqet. Por kjo nuk do të thotë se personi nuk do të ha më kurrë mish. Heqja dorë nga të ngrënit e mishit nuk është qëllimi. Qëllimi është të mos ju lejojmë juve të keni këtë ves. Nëqoftëse ju mund të hiqni dorë nga vesi gjatë kohës kur nuk mund ta hani mishin, ju mund të jeni në gjendje ta hani atë përsëri. Mishi atëhere nuk do t'ju mbajë erë të keqe apo të ketë shije të përshtirshme.

Kur ju mund të hani mish përsëri, si vesi dhe dëshira juaj për mish do të jenë zhdukur. Megjithatë, do të ketë një ndryshim të madh: mishi nuk do t'ju shijojë më. Nëse është gatuar në shtëpi, ju do e hani me familjen tuaj. Nëse nuk është gatuar në shtëpi, ju nuk do e ndjeni mungesën. Po ta hani atë, nuk do t'ju shijojë. Kjo gjë do të ndodhë. Por të praktikosh kultivim në mes të njerëzve është tepër e komplikuar. Nëqoftëse familja juaj gatuan gjithmonë mish, pas një periudhe kohe, juve do të fillojë t'ju shijojë përsëri. Të tilla kthime mbrapa do të ndodhin në të ardhmen dhe ato do të përsëriten disa herë gjatë gjithë periudhës së praktikës kultivuese. Ju mund të jeni në gjendje të hani mish përsëri papritmas. Ju nuk duhet ta hani kur nuk mundni ta hani dot. Ju me të vërtetë nuk do jeni në gjendje ta hani dhe me ta ngrënë ju do të villni. Pritni derisa të mund të hani mish përsëri dhe ndiqni rrjedhën e natyrshme të gjërave. Qëllimi nuk është të hash apo të mos hash mish—thelbi është të heqësh dorë nga vesi.

Shkolla jonë e Falun Dafës e aftëson personin të bëjë përparim të shpejtë. Për aq kohë sa ju përmirësoni karakterin tuaj, ju do të bëni kapërcime të shpejta në çdo nivel. Disa njerëz nuk janë të dhënë pas mishit dhe nuk duan t'ja dinë nëse ka mish në pjatat e tyre apo jo. Do i duhet atyre disa javë ta heqin këtë ves. Disa njerëzve mund t'ju duhet një, dy, apo tre muaj apo mbase gjysmë viti për ta arritur këtë. Përveçse në raste shumë të veçanta, një personi nuk do i duhet më shumë se një vit që të jetë në gjendje të hajë mish përsëri. Kjo ndodh ngaqë mishi është bërë tashmë ushqim i rëndësishëm për njerëzit. Pamvarësisht nga kjo, praktikuesit profesionistë në tempuj nuk duhet të hanë mish.

Le të flasim për atë se si e konsideron të ngrënët e mishit Buddhizmi. Buddhizmi origjinal më i hershëm nuk e ndalonte ngrënien e mishit. Kur Sakyamuni i mori dishepujt e tij në pyje të praktikonin kultivim përmes vështirësive, nuk kishte një rregull të tillë që ndalonte ngrënien e mishit. Pse nuk kishte? Kjo ndodhte ngaqë kur Sakyamuni u mësoi njerëzve Dharmën e tij 2500 vjet më parë, shoqëria njerëzore ishte shumë e pazhvilluar. Disa zona kishin bujqësi ndërsa të tjerat akoma nuk kishin gjë.

Tokat e kultivuara ishin shumë të pakta dhe pyjet ishin kudo. Drithërat ishin të pakta dhe shumë të radha. Njerëzit sapo kishin dalë nga shoqëria primitive dhe jetonin kryesisht me gjueti; shumë zona ushqeheshin kryesisht me mish. Me qëllim që të braktisnin veset njerëzore sa më shumë që të ishte e mundur, Sakyamuni ia ndaloi dishepujve të tij të pasurit e pasurisë, gjërave materiale etj. Ai i mori dishepujt me vete për të lypur për ushqim. Ata hanin çfarëdo gjë që u jepej, sepse si praktikues ata nuk mund ta zgjidhnin ushqimin që i jepej që mund të kishte dhe mish.

Disa ushqime u quajtën tabu në Buddhizmin origjinal. Ky ndalim i disa ushqimeve erdhi nga Buddhizmi origjinal por tani thuhet se edhe të ngrënit e mishit është tabu. Në fakt, në atë kohë ndalimi i ushqimeve nuk i referohej mishit por gjërave si qepë, xhinxher[95] dhe hudhër. Pse konsideroheshin ato tabu? Në ditët e sotme, shumë murgjër gjithashtu nuk mund ta shpjegojnë këtë qartë. Ngaqë shumë prej tyre nuk praktikojnë kultivim me të vërtetë, ata nuk janë të qartë për shumë gjëra. Ajo që Sakyamuni u mësoi njerëzve përmblidhet në "kanun, samadhi, mençuri". Kanuni i referohet braktisjes së të gjitha veseve të njeriut. Samadhi do të thotë që një praktikues praktikon kultivim duke qënë plotësisht në meditim në kllapi—personi duhet të jetë plotësisht i pandërgjegjshëm. Çfarëdo që do të ndikonte në meditimin në kllapi dhe kultivimin do të konsiderohej si ndërhyrje serioze. Kushdo që hante qepë, xhinxher apo hudhër do të kundërmonte erë të fortë. Në atë kohë, murgjit zakonisht qëndronin në pyje apo shpella. Shtatë apo tetë vetë rrinin ulur në rreth dhe formonin disa rrethe për të medituar. Nëqoftëse dikush i hante këto gjëra, ata do të lëshonin një erë shumë irrituese që do të ndikonte tek të tjerët që meditonin, duke ndërhyrë kështu seriozisht me praktikën e tyre. Kështu u vendos ky rregull; ushqime të tilla u konsideruan tabu dhe u ndaluan. Shumë prej qënieve të kultivuara nga trupi i personit u vjen ndot nga erëra të tilla të forta. Qepët, xhinxher dhe hudhrat gjithashtu mund të stimulojnë oreksin e personit. Nëse dikush i han ato me tepri, ai gjithashtu mund të obsesohet me to dhe kështu ato u konsideruan tabu.

Në të kaluarën, pasi arrinin nivele shumë të larta në kultivim dhe hynin në stadin e Çbllokimit të Gongut apo gjysmë Çbllokimi të Gongut, shumë murgj gjithashtu e kuptonin se këto rregulla nuk kishin shumë rëndësi gjatë kursit të praktikës kultivuese. Nëqoftëse hiqej dorë nga një ves, vetë materiali nuk kishte ndonjë efekt. Ajo që me të vërtetë ndërhyn tek personi është dëshira apo vesi. Prandaj, gjatë gjithë historisë murgjit që arritën të konsumohen gjithashtu kishin kuptuar se çështja nëse dikush han apo nuk han mish nuk është çështje kritike. Çështja kryesore është nëse vesi mund të braktiset. Nëqoftëse dikush nuk ka ndonjë dëshirë të tepruar për diçka, është normale të hajë çfarëdo që të jetë për të mbushur stomakun. Meqenëse praktikat kultivuese në tempuj e kishin vënë këtë rregull, shumë njerëz janë mësuar me të. Po ashtu, nuk është më thjesht një

rregull, por një rregullore e institucionalizuar në tempuj sipas së cilës askush nuk mund të hajë mish fare. Kështu njerëzit janë mësuar me këtë mënyrë kultivimi. Le të flasim pak për Murgun Jigong[96] i cili u bë i famshëm nga veprat letrare. Murgjit nuk duhet të hanë mish, por ai hante mish dhe u bë kështu shumë i njohur. Në fakt, që kur ai u dëbua nga Tempulli Linguin, natyrisht ushqimi u bë problem i madh për të sepse mbijetesa ishte në rrezik. Për të mbushur stomakun, ai hante çfarëdo që ai gjente; kjo nuk kishte rëndësi sepse ai veç donte të mbushte stomakun dhe nuk kishte dëshirë për ndonjë ushqim të caktuar. Në atë nivel kultivimi, ai e kish kuptuar këtë parim. Në fakt, Jigong hëngri mish vetëm në një a dy raste. Me të dëgjuar për një murg që hante mish shkrimtarët u entuziazmuan. Sa më sensacional subjekti, as më shumë të interesuar do të ishin lexuesit. Veprat letrare bazohen në fakte nga jeta dhe pastaj shkojnë përtej tyre; kështu ai u publikua. Në fakt, nëse personi braktis dëshirën me të vërtetë, nuk ka rëndësi çfarë ai ha për të mbushur stomakun.

Në Azinë juglindore apo në krahinat jugore të Kinës si Guangdong dhe Guangxi, disa Buddhistë që nuk janë murgj nuk e quajnë veten Buddhistë në bisedë, sikur kjo të tingullonte jashtë mode. Ata thonë se hanë ushqim Buddhist apo se janë vegjetarianë, që sugjeron se ata janë Buddhistë vegjetarianë. Ata e marrin kultivimin e Buddhës si diçka kaq të thjeshtë. Si mund të qënit vegjetarian ta bëjë një person të kultivohet në Buddhë? Të gjithë e dinë se të ngrënit e mishit është veçse një ves dhe një dëshirë—ai është veçse një ves. Të qënit vegjetarianë heq vetëm këtë ves. Personit akoma i duhet të heqë dorë nga zilia, mentaliteti i konkurencës, zelli i tepruar, mentaliteti për t'u dukur dhe shumë vese të tjera; ekzistojnë vese të shumta njerëzore. Vetem duke i hequr të gjitha veset dhe dëshirat mundet një njeri të përfundojë praktikën kultivuese. Si mund të kultivohet në një Buddhë një person duke hequr dorë vetëm nga dëshira për të ngrënë mish? Kjo nuk mund të bëhet.

Përsa i përket ushqimit, përveç të ngrënit e mishit personi nuk duhet të jepet pas asnjë ushqimi tjetër. Kjo është e vërtetë dhe për çdo gjë tjetër. Disa njerëz thonë se atyre u pëlqen të hanë një ushqim të caktuar—edhe kjo është një dëshirë. Pasi arrin një nivel të caktuar në kultivim, një praktikues nuk do ta ketë këtë dëshirë. Sigurisht, Ligji ynë u mësohet njerëzve në nivel shumë të lartë dhe u mësohet duke integruar nivele të ndryshme. Është e pamundur që dikush ta arrijë këtë shkallë menjëherë. Ti pretendon se vetëm dëshiron të hash atë lloj ushqimi, por kur kultivimi juaj të arrijë kohën për të hequr dorë me të vërtetë nga ky ves, ju nuk do të jeni në gjendje ta hani atë. Nëqoftëse ju e hani atë, ai nuk do të ketë shije të mirë dhe mund t'ju duket si shija e çfarëdo gjëje tjetër. Kur unë shkoja në punë, menca e punës gjithmonë humbte para dhe më vonë u mbyll fare. Pasi u mbyll, të gjithë e sillnin drekën me vete. Ishte bela e madhe dhe goxha punë për të pregatitur ushqim në mëngjes. Ngandonjëherë, unë bleja

dy kuleçë të gatuar në avull dhe një copë tofu[97] në salcë soje. Në teori, ky duhej të ishte ushqim shumë i lehtë, por të hash atë gjithmonë përsëri nuk ishte mirë sepse dëshira duhet të braktisej. Kështu sapo shihja tofu me sy, më vinte pështirë. Nuk e haja dot kur e provoja gjë që nuk më lejonte të zhvilloja vesin. Sigurisht, kjo do të ndodhë vetëm kur personi të ketë arritur një nivel të caktuar ne praktikën kultivuese. Nuk do të jetë kështu që në fillim.

Shkolla Buddhës nuk e lejon ***pirjen e alkolit***. A keni parë ndonjëherë një Buddha duke mbajtur një shishe me verë? Kurrë. Unë kam thënë se një person mund të mos jetë në gjëndje të hajë mish, por pasi ai heq dorë nga vesi gjatë praktikës kultivuese në mes të njerëzve, nuk ka problem që ai ta hajë atë përsëri. Por pasi heq dorë nga pirja alkolit, një individ nuk duhet të pijë përsëri. A nuk ka një praktikues gong në trup? Forma të ndryshme gongu dhe disa aftësi supernormale shfaqen në sipërfaqe të trupit tuaj dhe ato janë të tëra të pastra. Sapo të pish alkol, ato do të largohen të gjitha nga trupi menjëherë. Për një sekondë dhe trupit tuaj nuk do t'i mbetet asgjë, sepse ato nuk e durojnë dot erën. Është shumë e pështirshme po të jepesh pas këtij zakoni, sepse pirja e alkolit mund ta bëjë personin të humbë arsyen. Pse disa praktika kultivuese Taoiste të Mëdha kërkojnë të pish alkol? Kjo ndodh sepse ato nuk kultivojnë Shpirtin Kryesor të personit dhe të pirët mund ta bëjnë Shpirtin Kryesor të humbë vetëdijen.

Disa njerëz e duan alkolin sa dhe jetën a tyre. Disa njerëzve u pëlqen të pinë alkol. Disa njerëz janë tashmë të helmuar nga pirja alkolit dhe nuk hanë asnjë ushqim pa pirë—ata nuk jetojnë dot pa pirë. Si praktikues, ne nuk duhet të jemi kështu. Pirja alkolit është pa dyshim një ves. Është dëshirë dhe stimulon nervat e vesit të personit. Sa më shumë një personi pin, aq më shumë jepet ai pas tij. Le të mendojmë pak: Si praktikues, a nuk duhet të heqim dorë ne nga ky ves? Ky është ves që duhet hequr. Dikush mund të mendojë: "Kjo është e pamundur sepse unë jam përgjegjes për të kënaqur klientët, "apo "Unë kam përgjegjësinë për të kryer kontaktet e biznesit. Nuk është e lehtë të bësh pazar pa pirë alkol. "Unë do të thoja se mund të mos jetë me të vërtetë ashtu. Zakonisht, në kryerjen e një marëveshjeje biznesi, veçanërisht në biznes me të huajt, ti mund të kërkosh një pije freskuese, ai apo ajo mund të kërkojë një ujë mineral dhe një person tjetër mund të kërkojë një birrë. Askush nuk do t'ju detyrojë të pini alkol. Ti e zgjedh vetë dhe pin aq sa don. Veçanërisht midis intelektualësh, një gjë e tillë ndodh rallë. Zakonisht është kështu.

Pirja e duhanit është gjithashtu një ves. Disa njerëz thonë se pirja e duhanit i shplodh, por unë e quaj këtë të gënjesh veten dhe të gënjesh të tjerët. Kur ndjehet i lodhur nga puna apo nga të shkruajturit e diçkaje, një personi mund të dojë të bëjë pushim duke pirë një cigare. Pasi pin cigaren, ai ndjehet i shplodhur. Në fakt, nuk është e vërtetë. Kjo ndodh ngaqë ai bëri pushim. Mëndja njerëzore mund të krijojë një ndjesi të rreme dhe

iluzion që më pas mund të bëhet me të vërtetë koncept apo ndjesi e rreme se të pirit e duhanit të freskon. Ajo nuk e bën aspak këtë dhe as që mund të ketë këtë efekt. Pirja duhanit nuk i bën ndonjë të mirë trupit të njeriut. Nëqoftëse një person pin për një kohë të gjatë, në kohën e autopsisë një mjek do të gjejë që trakea dhe mushkëritë janë të komplet të zeza.

A nuk duam ne praktikuesit të pastrojmë trupat tanë? Ne duhet që vazhdimisht të pastrojmë trupat tanë dhe vazhdimisht të përparojmë drejt niveleve të larta. E megjithatë ti akoma i fut trupin tënd atë, a nuk po shkon ti kështu në drejtim të kundërt nga ne? Për më tepër, kjo është dhe një dëshirë e fortë. Disa njerëz e dinë që nuk është i mirë, por nuk e lënë dot. Në fakt, më lejoni t'ju them se ata nuk kanë mendime të drejta që të udhëheqin veten dhe nuk do jetë e lehtë për ta që të heqin dorë. Si praktikues, pse nuk e konsideron ti atë si ves që duhet të hiqet dhe të shikosh nëse mund ta heqësh? Ju këshilloj të gjithëve që nëse me të vërtetë doni të praktikoni kultivim ju duhet të leni duhanin që nga ky çast dhe është e garantuar se mund ta leni. Në fushën e kësaj klase, askujt nuk i shkon mëndja të pijë cigare. Nëse doni ta leni, është e garantuar se mund ta bëni këtë. Kur të pini përsëri cigare, ajo do të ketë shije të keqe. Po të lexoni këtë leksion në libër, do të ketë të njejtin efekt. Sigurisht, nëqoftëse nuk doni të praktikoni kultivim, ne nuk do të kujdesemi për ju. Unë mendoj se si praktikues, ju duhet të hiqni dorë. Unë kam përdorur këtë shembull më parë: A keni parë ndonjëherë një Buddha apo Tao me cigare në gojë? Si mund të jetë kjo e mundur? Si praktikues, cili është qëllimi juaj? A nuk duhet ta leni ju atë? Prandaj, unë kam thënë se nëse doni të praktikoni kultivim, ju duhet ta leni duhanin. Ai ju dëmton trupin dhe është gjithashtu një ves. Ajo është plotësisht e kundërta e asaj që duhet të bëjë një praktikues.

Kur unë u mësoj njerëzve Ligjin, unë shpesh përmend çështjen ***e zilisë.*** Pse e bëj unë këtë? Sepse zilia është shumë e fortë në Kinë. Është kaq e fortë saqë është bërë e natyrshme dhe njerëzit as që e kuptojnë këtë. Pse kanë kinezët kaq zili të madhe? Kjo ka rrënjët e veta. Kinezët në të kaluarën janë ndikuar shumë nga Konfucionizmi dhe ata zhvilluan një temperament të mbyllur. Kur janë të zemëruar apo të gëzuar, ata nuk e shprehin këtë. Ata besojnë në vetkontroll dhe tolerancë. Ngaqë janë mësuar në këtë mënyrë, kombësia kineze në tërësi ka zhvilluar një temperament shumë të mbyllur. Sigurisht, kjo ka avantazhet e veta, sepse një person i tillë nuk mburret për fuqitë e brendshme. Por ka gjithashtu dhe disavantazhe dhe mund të sjellë efekte negative anësore. Veçanërisht në këtë Periudhë të Fundit-Dharmës, aspektet e saj negative kanë dalë më në pah dhe mund të inkurajojnë thellimin e zilisë së personit. Nëqoftëse dikush ka lajmet e mira dhe ja bën të ditur të tjerëve, të tjerët menjëherë do bëhen xhelozë. Disa njerëz kanë frikë të përmendin çmimet apo fitimet e tyre nga puna apo gjetkë, se mos të tjerët ndjehen keq pasi dëgjojnë lajmin. Perëndimorët e

quajnë këtë "zili orientale"apo "zili aziatike". I gjithë rajoni i Azisë është pak a shumë kështu, prej influencës së Konfucionizmit kinez. Veçanërisht në Kinë ajo shfaqet akoma më e fortë.

Kjo zili lidhet në një farë mënyre me barazinë absolute që ne praktikonim dikur: Nëqoftëse toka përmbyset, në fund të fundit, të gjithë do të vdesin; të gjithë duhet të marrin një pjesë të barabartë nëqoftëse ka ndonjë gjë të mirë; të gjithë duhet të marrin rritje të barabartë rroge, pamvarësisht nga përqindja e rritjes. Ky mentalitet duket sikur është i drejtë kur secili trajtohet i barabartë. Në fakt, si qenkan njerëzit të njejtë? Puna që bëjnë është e ndryshme, po ashtu dhe mënyra si i kryejnë ata përgjegjësitë e tyre. Ekziston një parim në këtë univers që quhet, "po nuk humbe nuk fiton". Që të fitojë, njeriu duhet të humbë. Njerëzit besojnë se njeriu nuk fiton po nuk punoi për diçka. Sa më shumë punë, aq më shumë fitim, më pak punë do të thotë më pak fitim. Sa më shumë të përpiqet njeriu, aq më shumë fitim meriton. Barazia absolute e praktikuar në të kaluarën pretendonte se njerëzit kanë lindur të barabartë dhe është jeta pas lindjes që e ndryshon atë. Mua më duket kjo shprehje tepër absolute. Kur çfarëdolloj gjëje bëhet absolute, ajo bëhet e gabuar. Pse atëhere disa njerëz lindin meshkuj e disa femra? Pse nuk ngjajnë njësoj ata? Njerëzit nuk lindin të njejtë, sepse disa lindin të sëmurë e disa të shtrembëruar. Nga nivele të larta, ne shikojmë se e tërë jeta e një personi ekziston atje në një dimension tjetër. Si mund të jenë njerëzit të njejtë atëhere? Të gjithë njerëzit kanë dëshirë të jenë të barabartë. Nëqoftëse diçka nuk është pjesë e jetës së dikujt, si mund të bëhen ata të barabartë atëhere? Njerëzit nuk janë njëlloj.

Personalitetet e njerëzve nga vendet perëndimore janë relatisht më të hapur. Mund ta kuptosh kur ata janë të gëzuar apo kur janë të zemëruar. Kjo ka avantazhet e veta, por ka gjithashtu dhe disavantazhe dhe mund të rezultojë në mungesë vetpërmbajtjeje. Meqenëse dy temperamentet janë të ndryshme në mënyrën e të menduarit, ato sjellin dhe rezultate të ndryshme në kryerjen e gjërave. Nëqoftëse një kinez lavdërohet nga përgjegjësi apo i jepet ndonjë gjë e mirë, mëndjet e të tjerëve do humbin qetësinë. Kur ai merr një bonus më të madh, ai më mirë e fut në xhep fshehurazi pa ja treguar njeriu. Sot, është e vështirë të jesh punëtor i dalluar. "Ti je punëtor model. Ti je më i miri në punë. Ti duhet të vish herët në mëngjes dhe të ikësh natën vonë. Ti duhet ta bësh të gjithë punën meqenëse je i zoti. Ne nuk jemi kaq të mirë sa ty. "Njerëzit do bëhen sarkastikë dhe cinikë dhe kështu nuk është e lehtë as të jesh njeri i mirë.

Nëqoftëse kjo ndodh në vende të tjera, do ishte krejtësisht e kundërta. Nëqoftëse përgjegjësi do të shohë se ky punëtor bën punë të mirë, ai mund t'i japë atij një bonus më të madh. Ky i fundit me gëzim numëron paratë para të tjerëve: "Ej, kapo më dha gjithë këto para sot. "Ai gjithë gëzim i tregon të tjerëve për to pa ndonjë pasojë. Nëqoftëse kjo do ndodhte në Kinë që dikush të fitonte një bonus ekstra, përgjegjësi madje do t'i thonte

personit që ta fshihte dhe të mos lejonte të tjerët që t'ja shihnin. Në vende të tjera, nëqoftëse një fëmijë merr njëqind pikë në një provim, ai do vrapojë për në shtëpi me gëzim duke thirrur: "Mora njëqind pikë sot! Mora njëqind!"Fëmija do vrapojë për në shtëpi gjithë rrugës nga shkolla. Një komshi do hapë deren dhe thotë: Hej, Tom, djalë i mbarë. "Një komshi tjetër mund të hapë dritaren: "Hej, Jack, të lumtë. Djalë i mbarë. "Po të ndodhte kjo në Kinë, do të ishte katastrofike. "Kam marrë njëqind, kam marrë njëqind. "Fëmija vrapon për në shtëpi nga shkolla. Që para se të hapte derën, një komshi do kish filluar të mallkonte nëpër shtëpi: "E ç'ka këtu për t'u mburrur që ke marrë njëqind? Mburravec! E kush nuk ka marrë njëqind!"Dy mentalitetet do sjellin rezultate të ndryshme. Kështu kjo mund të nxisë xhelozinë e të tjerëve, sepse kur dikujt po i ecën mbarë, në vend që të ndjehen të gëzuar për të, mëndja e njerëzve do fillojë të humbë qetësinë. Mund të sjellë pra këtë problem.

Pak vite më parë, praktikohej barazia absolute dhe kjo i ka prishur mëndjet dhe vlerat e njerëzve. Më lejoni t'ju jap nje shembull konkret. Në vendin e punës, një personi mund t'i duket se të tjerët nuk janë aq të zotë sa ai. Çfarëdo që ai bën, ai e bën mirë. Atij me të vërtetë i duket vetja i jashtëzakonshëm. Ai mendon me vete: "Jam i kualifikuar për t'u bërë drejtor fabrike apo përgjegjës, apo dhe një pozitë më të lartë. Mendoj se mund të bëhem edhe kryeministër. "Edhe përgjegjësi mund të thotë se ky person është me të vërtetë i aftë dhe mund të bëjë çdo gjë. Kolegët po ashtu mund të shprehen se ai është me të vërtetë i aftë dhe i talentuar. Por mund të jetë një person tjetër në të njejtin grup pune apo në të njejtën zyrë me atë i cili është i pazoti për të bërë gjë apo nuk ja thotë fare. Megjithatë një ditë ky person i paaftë ngrihet në përgjegjësi në vend të tjetrit madje bëhet dhe përgjegjësi i tij. Ai do preket në zemër dhe do i duket e padrejtë dhe ankohet tek shefi dhe kolegët me një ndjenjë zemërimi të madh dhe me mjaft xhelozi. Unë po ju them këtë parim që njerëzit e zakonshëm nuk janë në gjendje ta kuptojnë. Ju mund të mendoni se jeni i mirë në çdo gjë, por nuk është fati juaj. Ai personi tjetër nuk është për asgjë, por është fati i tij dhe ai bëhet përgjegjës. Pamvarësisht se çfarë mendojnë njerëzit, kjo është vetëm pikëpamja e njerëzve të zakonshëm. Nga perspektiva e një jete më të lartë, zhvillimi i shoqërisë njerëzore ecën sipas një ligji specifik të zhvillimit. Prandaj, ajo që personi bën në jetë nuk përcaktohet në bazë të aftësive të personit. Buddhizmi beson në parimin e shpagimit karmik. Jeta e një personi përcaktohet sipas karmës së tij. Pamvarësisht sa i zoti je, po nuk pate virtyt, mbase ti nuk do të kesh asgjë në këtë jetë. Ti mendon se një person tjetër nuk është për asgjë, por ai ka plot virtyt. Ai mund të bëhet një ushtarak i lartë apo të bëjë pasuri të madhe. Një njeri i zakonshëm nuk e sheh këtë pikë dhe gjithmonë beson se ai duhet të bëjë atë që është i aftë të bëjë. Prandaj, ai konkuron dhe lufton tërë jetën e vet me zemër të lënduar keq. Ai mund të ndjehet shumë i zemëruar dhe lodhur, duke ju dukur

gjërat gjithmonë të padrejta. Duke mos qënë në gjendje të hajë e flejë mirë, ai ndjehet i trishtuar dhe i zhgënjyer. Kur plaket, ai përfundon me shëndet të keq dhe të gjitha llojet e sëmundjeve do i shfaqen.

Kështu, praktikuesit tanë nuk duhet të jenë të tillë, sepse një praktikues duhet të ndjekë rrjedhën e natyrshme të gjërave. Nëqoftëse diçka është e juaja, ju nuk do ta humbni atë. Nëqoftëse diçka nuk është e juaja, ju nuk do ta merrni edhe sikur të luftoni për të. Sigurisht, kjo nuk është absolute. Po të ishte aq absolute, nuk do ekzistonte çështja e bërjes keq. Me fjalë të tjera, ekzistojnë disa faktorë të pastabilizuar. Por si praktikues, ju jeni në parim të mbrojtur nga Fashen i Mësuesit. Të tjerët nuk mund të marrin atë që është juaja edhe sikur të donin. Prandaj ne besojmë në ndjekjen e rrjedhës së natyrshme të gjërave. Shpesh, ju mendoni se diçka duhet të jetë e juaja dhe të tjerët gjithashtu ju thonë se ju takon. Në fakt, nuk është kështu. Ju mund të besoni se është e juaja, por në fund të fundit nuk është e juaja. Me anë të kësaj, do shihet nëse ju mund të hiqni dorë. Nëqoftëse nuk e lëshoni dot, kjo është dëshirë. Kjo metodë duhet përdorur për t'ju hequr dëshirën për interest personal. Kështu është çështja. Ngaqë njerëzit nuk e kuptojnë këtë parim, ata do të konkurojnë dhe luftojnë për fitim.

Në mes të njerëzve, zilia shfaqet haptas. Është shumë e dukshme edhe në komunitetin e kultivuesve. Nuk ka respekt në mes të praktikave të ndryshme të qigongut, si për shembull "praktika jote është e mirë"apo "praktika e tij nuk është e mirë"—bëhen si komente pozitive ashtu edhe negative. Sipas mendimit tim, ato të gjitha i takojnë nivelit të shërimit dhe mbajtjes së trupit në formë. Nga ato praktika që shajnë njëra tjetrën, shumica janë praktika kaotike, shpirtrash zotërues apo të krijuara në bazë të lëvizjeve të kafshëve dhe ato nuk duan t'ja dinë për karakterin. Një person mund të ketë praktikuar qigong për më shumë se njëzet vjet pa zhvilluar asnjë aftësi supernormale, ndërsa një person tjetër i merr ato sapo fillon praktikën. Ky person do ta shikojë këtë si të padrejtë: "Unë kam praktikuar për mbi njëzet vjet pa zhvilluar asnjë aftësi supernormale ndërsa ai i zhvillon ato menjëherë.

Çfarë lloj aftësish supernormale ka marrë ai?"Ky person do të tërbohet: "Atë e ka zënë ndonjë shpirt apo kafshë zotëruese dhe po kalon në marrosje nga kultivimi!"Kur një mjeshtër qigongu mëson një klasë, dikush mund të ulet atje me mosrespekt: "Oh, e ç'mjeshtër qigongu është ky? As nuk jam i interesuar të dëgjoj çfarë thotë. "Mjeshtri qigongut me të vërtetë mund të mos jetë i aftë të flasë më mirë se ky person. Por ato që thotë mjeshtri i qigongut janë diçka nga shkolla e tij e praktikës. Ky person studjon çdo gjë dhe ka ndjekur klasat e çdo mjeshtri qigong me një tufë çertifikatash mbarimi kursesh. Me të vërtetë, ky person din plot gjëra më shumë sesa ky mjeshtër qigongu. Por për çfarë vlejnë ato? Ato janë të gjitha për shërim dhe mbajtje trupit në formë. Sa më shumë mbushet personi me

to, aq më rrëmujë dhe komplekse bëhen mesazhet dhe aq më e vështirë do jetë që ai të praktikojë kultivim—është bërë lëmsh e li. Praktika kultivuese e vërtetë mëson se duhet të ndjekësh vetëm një mënyrë kultivimi dhe të mos shkosh në rrugë të gabuar. Ky fenomen gjithashtu ndodh edhe në mes të praktikuesve të vërtetë, sepse mosrespekti për njeri-tjetrin dhe mos eliminimi i dëshirës për të konkuruar mund të çojnë me lehtësi në zili.

(…..)

6. Leksioni i Tetë

Disa njerëz kanë ngritur çështjen e agjërimit ***bigu*** (një term i lashtë që do të thotë të heqësh dorë nga ushqimi dhe uji). Ekziston ky fenomen i quajtur agjërim bigu. Jo vetëm që ekziston në komunitetin e kultivuesve, por e kanë provuar edhe shumë njerëz në shoqëri. Disa njerëz nuk hanë apo pijnë për disa vjet apo për më shumë se një dhjetëvjeçar, megjithatë ata jetojnë shumë mirë. Ka njerëz që flasin për bigun sikur të ishte tregues i një niveli të caktuar, ndërsa të tjerë e marrin si shenjë të pastrimit të trupit. E akoma të tjerë pretendojnë se është pjesë e proçesit të kultivimit të niveleve të larta.

Në fakt, nuk është asnjë nga këto. Çfarë është atëhere? Bigu në fakt i referohet një metode kultivimi të veçantë në një ambjent special. Në cilat kushte përdoret ai? Në Kinën e lashtë para se të themeloheshin fetë, shumë praktikues përdornin formën e praktikës sekrete apo kultivimin e vetmuar në male të largëta apo shpella shumë larg nga vendbanimet e njerëzve. Me të zgjedhur këtë mënyrë, dilte problemi i furnizimit me ushqim. Nëqoftëse personi nuk do të përdorte metodën e bigut, ai nuk do të mund të praktikonte aspak kultivim dhe do të vdiste atje nga uria e etja. Unë shkova nga qyteti Chongqing deri në qytetin Wuhan për t'u mësuar njerëzve Ligjin dhe mora një anije që shkonte në lindje mbi lumin Jance. Pashë disa shpella në të dy anët e Tre Grykave në mes të maleve; edhe shumë male të tjera të mirënjohura i kanë ato. Në të kaluarën, pasi ngjitej në shpellë me ndihmën e një litari, një praktikues do e priste litarin për të praktikuar në shpellë. Nëqoftëse ky person nuk do kishte sukses në kultivim, ai do të vdiste brenda. Pa ushqim apo ujë, vetëm në këto kushte shumë të veçanta, ai do të zgjidhte këtë metodë kultivimi të veçantë.

(…..)

7. Leksioni i Nëntë

(…..)

Përsa i përket ***mendimeve***, kjo i referohet aktiviteteve të mëndjes sonë njerëzore. Në komunitetin e kultivuesve, si shikohen aktivitetet mendore në tru? Si i shikojnë ata format e ndryshme të të menduarit të njeriut? Dhe si shfaqen ato? Shkenca moderne akoma nuk mund të zgjidhë shumë pyetje në studimin e vet të trurit njerëzor, sepse nuk është aq e lehtë sa studimi i sipërfaqes së trupave tanë. Në nivele më të thella, dimensione të ndryshme marrin forma të ndryshme. Por gjithashtu nuk është si thonë disa mjeshtër qigongu. Disa mjeshtër qigongu nuk e dinë as vetë çfarë ndodh dhe as nuk mund ta shpjegojnë ata atë qartë. Ata mendojnë se me të përdorur mëndjen e tyre dhe të kenë një mendim, ata do të mundin të bëjnë diçka. Ata pretendojnë se këto gjëra arrihen nga mendimet e tyre apo nga qëllimi që kanë në mëndje. Në fakt, ato gjëra nuk kryhen aspak nga mendimet e tyre.

Para së gjithash, le të flasim për origjinën e mendimeve të njeriut. Në Kinën e lashtë, ekzistonte shprehja "të mendosh me zemër". Pse quhej se zemra mendon? Shkenca e lashtë kineze ishte shumë e përparuar sepse kërkimet e saj kishin për objekt studimi të drejtpërdrejtë gjëra të tilla si trupin e njeriut, jetën dhe universin. Disa njerëz me të vërtetë ndjejnë se mendojnë me zemer, ndërsa të tjerë ndjejnë se mendojnë me tru. Pse ndodh kjo situatë? Është shumë e arsyeshme kur disa njerez flasin për mendim që vjen nga zemra. Kjo ndodh ngaqë siç e kemi konstatuar ne, Shpirti Primordial i një personi është shumë i vogël dhe mesazhet nga truri njeriut nuk janë funksion i vetë trurit të njeriut—ato nuk prodhohen nga truri, por nga Shpirti Primordial i personit. Shpirti Primordial i personit nuk qëndron vetëm në Pallatin Niwan. Shkolla Taoiste quan Pallati Niwan atë që shkenca moderne e quan gjendër pineale. Nëqoftëse Shpirti Primordial i personit është në Pallatin Niwan, atij do t'i duket se është truri ai që mendon apo po dërgon mesazhet. Nëqoftëse Shpirti Primordial është në zemrën e personit, atij do t'i duket se është zemra që po mendon.

Trupi i njeriut është një univers i vogël. Shumë qënie të gjalla në trupin e një praktikuesi janë të afta të shkëmbejnë vendet. Kur Shpirti Primordial ndryshon vendin e vet, nëse zhvendoset në bark, personit do t'i dukej se është barku ai që mendon. Nëqoftëse Shpirti Primordial zhvendoset tek pulpa apo thembra, personit do t'i dukej sikur me të vërtetë po mendon me pulpë apo thembër. Është e garantuar të jetë kështu, megjithëse duket shumë e pabesueshme. Edhe kur niveli juaj i kultivimit nuk është dhe aq i lartë, ju do ta ndjeni kur kjo ndodh. Nëqoftëse trupi i njeriut nuk ka Shpirtin Primordial dhe gjëra si temperamentin, karakterin dhe personalitetin, është vetëm një copë mishi dhe jo një person i plotë me individualitet. Kështu çfarë funksionesh ka truri i njeriut? Po të më pyesni mua, në këtë dimension fizik, truri i njeriut është vetëm një fabrikë

përpunuese. Mesazhi në fakt prodhohet nga Shpirti Primordial. Megjithatë, ajo që transmetohet nuk është gjuhë, por një mesazh që ka një kuptim të caktuar. Me të marrë këtë komandë, truri ynë do e përpunojë atë në gjuhën e tanishme apo në forma të tjera të shprehjes; ne e shprehim atë nëpërmjet lëvizjeve të duarve, kontaktit me sy dhe me gjithë lëvizjet e trupit. Truri bën vetëm këtë. Në fakt komandat dhe mendimet vijnë nga Shpirti Primordial i personit. Njerëzit zakonisht mendojnë se ato janë funksione të drejtpërdrejta dhe të pavarura të trurit. Në fakt, Shpirti Primordial ngandonjëherë është në zemër kështu disa njerëz me të vërtetë ndjejnë sikur mendojnë me zemër.

Në kohën tonë, njerëzit që kryejnë kërkime mbi trupin e njeriut besojnë se ajo që transmeton truri njeriut është diçka si një valë elektrike. Ne nuk do flasim tani për çfarë transmetohet faktikisht, por ata e kanë pranuar se është një lloj ekzistence materiale. Kështu, nuk është supersticion. Çfarë efekti ka ky material? Disa mjeshtër qigongu pretendojnë: "Unë mund të lëviz gjëra me forcën e mëndjes time. "apo "Unë mund të hap Syrin tuaj Qiellor. "apo "Unë mund të shëroj sëmundjet tuaja. "etj. Në fakt, përsa i përket disa mjeshtërve qigong, ata as vetë nuk e dinë dhe as janë të qartë se çfarë aftësish supernormale kanë. Ata vetëm dinë që mund të bëjnë çfarë të duan vetëm duke e menduar atë. Në realitet, është mëndja e tyre në punë: Aftësitë supernormale drejtohen nga qëllimi mendor dhe ato kryejnë veprime të caktuara nën komandën e mëndjes. Megjithatë mëndja nuk mund të kryejë gjë vetë. Kur një praktikues bën diçka specifike, janë aftësitë e tij supernormale që e kryejnë veprimin.

Aftësitë supernormale janë aftësi të mundshme të trupit të njeriut. Me zhvillimin e shoqërisë sonë njerëzore, mëndja njeriut po bëhet gjithnjë e më e komplikuar, duke i dhënë më rëndësi "realitetit"dhe duke u bërë më e varur nga të ashtuquajturat vegla moderne. Për pasojë, aftësitë e lindura njerëzore janë atrofizuar gradualisht. Shkolla Tao mëson kthimin në veten e vërtetë dhe origjinale. Gjatë kursit të praktikës kultivuese, ju duhet të kërkoni të vërtetën dhe në fund të ktheheni në origjinë, tek vetja tuaj e vërtetë dhe tek natyra juaj e brendshme. Vetëm atëhere mund t'i zbuloni këto aftësi të lindura tuajat. Sot, ne i quajmë ato "aftësi mbinatyrale"kur në fakt ato janë të gjitha aftësi të lindura njerëzore. Shoqëria njerëzore duket sikur ecën përpara, por në fakt po ecën prapa dhe po shkon më larg karakteristikës së universit. Dje përmenda se Zhang Guolao i jepte gomarit mbrapsht, por njerëzit mund të mos e kenë kuptuar çfarë do të thoshte kjo. Ai zbuloi se të ecësh përpara do të thotë të shkosh prapa dhe se njerëzimi është duke ju larguar akoma më shumë karakteristikës së universit. Gjatë kursit të evolucionit të universit dhe veçanërisht pas hyrjes në rrymën e madhe të ekonomisë materialiste, shumë njerëz janë bërë shumë të korruptuar moralisht dhe ata po shkojnë gjithnjë e më larg Zhen-Shan-Ren (Ndershmërisë-Mirësisë-Tolerancës), karakteristikës së universit. Ata që

shkojnë me rrymën e njerëzve nuk mund ta kuptojnë shkallën e korrupsionit moral të njerëzimit. Kështu disa njerëz madje mendojnë se gjërat po shkojnë mirë. Vetëm ata njerëz, morali i të cilëve është ngritur nëpërmjet kultivimit, do kuptojnë se vlerat morale njerëzore janë prishur deri në këtë shkallë të tmerrshme.

Disa mjeshtër qigongu pretendojnë: "Unë mund të zhvilloj aftësi supernormale. "Çfarë aftësish supernormale mund të zhvillojnë ata? Pa energji, aftësitë supernormale të personit nuk do të kenë efekt. Si mund t'i zhvilloni ju ato pa energji? Kur aftësitë supernormale nuk formohen dhe mbështeten nga energjia juaj, si mund t'i zhvilloni ju ato? Është plotësisht e pamundur. Ajo që thonë ata, se mund të zhvillojnë aftësi supernormale, nuk është gjë tjetër veçse ata lidhin aftësitë e tua supernormale tashmë të formuara me trurin tuaj. Atëhere ato do të veprojnë nën komandën e trurit tuaj. Këtë bëjnë ata përsa i përket zhvillimit të aftësive supernormale. Në fakt, ata nuk kanë zhvilluar ndonjë prej aftësive tuaja supernormale, por veçse kanë bërë kaq pak gjë.

Për një praktikues, është mëndja ajo që i komandon aftësitë supernormale për të kryer veprime. Për një person të zakonshëm, mëndja drejton katër gjymtyrët dhe organet e shqisave, ashtu si një zyrë drejtuese në një fabrikë: Zyra drejtorit lëshon urdhërat për çdo repart me funksione të ndryshme për të kryer detyra të caktuara. Apo është si shtabi i një ushtrie që jep urdhërat dhe e drejton gjithë ushtrinë për të kryer një mision. Kur unë dilja jashtë qytetit për të dhënë leksione, unë shpesh e diskutoja këtë çështje me administratorët e shoqatave lokale të qigongut. Ata u habitën të gjithë: "Ne diskutojmë sa potencial energjie dhe vetëdijë ka mëndja njeriut. "Në realitet, nuk është ashtu. Ata ishin larg së vërtetës që në fillim. Unë kam thënë se që të studjojnë trupin e njeriut, njerëzit duhet të ndryshojnë të menduarit e tyre. Që të kuptojë gjërat supernormale, një person nuk mund të aplikojë metodat deduktive të njerëzve dhe mënyrat e tyre të të kuptuarit të gjërave.

Me që flasim për mendimet, ka dhe shumë forma të tjera. Për shembull, disa njerëz ngrenë çështjen e vetëdijes, të nën-ndërgjegjes, frymëzimit, ëndrrave, etj. Të flasim për ëndrrat, asnjë mjeshtër qigongu nuk don t'i shpjegojë ato. Kur ti linde, në të njejtën kohë, lindi një "ti"në shumë dimensione të universit dhe ata përbëjnë një qënie të plotë dhe të integruar dhe janë të ndërlidhur duke qënë mendërisht të lidhur. Po ashtu, në trup ju keni Shpirtin Kryesor, Shpirtin Ndihmës dhe qënie të tjera. Si forma ekzistence në dimensionet e tjera, çdo qelizë dhe të gjitha organet e tua të brendshme kanë mesazhin e imazhit tënd. Kështu, është jashtëzakonisht komplekse. Në ëndërr, gjërat janë kështu për një moment dhe ndryshe në një moment tjetër. Nga vijnë ato? Thuhet në mjekësi që kjo ndodh ngaqë korteksi cerebral i personit ka pësuar ndryshime. Ky është reaksion që manifestohet në këtë dimension fizik. Në fakt, ajo rezulton nga

marrja e mesazheve nga një dimension tjetër. Prandaj, kur ëndërroni ju ndjeheni me kokë të turbullt. Kjo nuk ka fare të bëjë me ju dhe ju nuk keni pse i kushtoni vëmendje. Është një lloj tjetër ëndrre që ka lidhje direkt me ju. Ne nuk duhet ta quajmë një ëndërr të tillë "ëndërr". Ndërgjegja juaj Kryesore apo Shpirti Kryesor mund të ketë parë në ëndërr që një pjesëtar i familjes ka ardhur tek ju, sikur ju keni pësuar diçka, apo sikur ju keni parë apo bërë diçka. Në këto raste, ndodh me të vërtetë që Shpirti juaj Kryesor ka bërë apo parë në fakt diçka në një dimension tjetër ndërsa ndërgjegja juaj ishte e qartë dhe reale. Këto gjëra ekzistojnë në fakt, veçse ato ndodhin në një dimension tjetër fizik dhe kryhen në një hapësirë kohore tjetër. Si mund ta quani ju atë ëndërr? Ajo nuk është ëndërr. Trupi juaj fizik është në fakt këtu në gjumë, kështu ju vetëm mund ta quani atë ëndërr. Vetëm ëndrra të tilla kanë të bëjnë direkt me ju.

Përsa i përket frymëzimit njerëzor, nën-ndërgjegjes, vetëdijes e kështu me radhë, unë do thoja se këto terma nuk janë krijuar nga shkencëtarët. Ato janë terma të sajuara nga shkrimtarë dhe bazohen në gjendjet mendore që njeh njeriu—ato nuk janë shkencore. Çfarë është "vetëdija"të cilës i referohen njerëzit? Ajo është e vështirë të shpjegohet qartë dhe është shumë e papërcaktuar meqenëse shumë mesazhe të ndryshme të njeriut janë komplekse dhe ato duken si copa kujtimesh të turbullta. Përsa i përket nën-ndërgjegjes së cilës i referohen njerëzit, ne mund ta shpjegojmë atë me lehtësi. Sipas përkufizimit të nën-ndërgjegjes, ajo i referohet zakonisht asaj kur një person bën diçka pa e ditur. Njerëz të tjerë do të thonë zakonisht se ky person e bëri këtë pa vetëdije dhe jo me qëllim. Nën-ndërgjegja është e njejtë me Ndërgjegjen Ndihmëse për të cilën kemi folur. Kur Ndërgjegja Kryesore e personit rilaksohet dhe nuk e kontrollon trurin, personi nuk ka ndërgjegje të qartë dhe është sikur ka rënë në gjumë. Në ëndërr, apo në një gjendje të pandërgjegjshme, personi do të kontrollohej lehtësisht nga Ndërgjegja Ndihmëse apo Shpirti Ndihmës. Në atë kohë, Ndërgjegja Ndihmëse është në gjendje të bëjë disa gjëra që do të thotë se ju do të bëni gjëra pa qënë i vetëdijshëm. Megjithatë këto gjëra shpesh kanë tendencë të bëhen shumë mirë, sepse Ndërgjegja Ndihmëse mund të shikojë nga një dimension tjetër esencën e materies dhe nuk do të gënjehej nga shoqëria jonë njerëzore. Prandaj, pasi individi sheh çfarë ka bërë, ai do e rishikojë e thotë: "Si e bëra kaq keq?"Nuk do ta kisha bërë kështu me mëndje të kthjellët. "Tani ti mund të thuash se nuk është e mirë, por kur e rishikon pas dhjetë ditësh apo gjysmë muaji më vonë ju do të thonit: "Uau! Qënka bërë kaq mirë! Si e bëra unë këtë atëhere?"Këto gjëra ndodhin shpesh. Ngaqë Ndërgjegja Ndihmëse nuk don t'ja dijë për rezultatin në atë moment, ajo do të ketë rezultat të mirë në të ardhmen. Ka gjithashtu disa gjëra që nuk kanë efekt në të ardhmen dhe vetëm kanë një farë efekti në atë moment. Kur Ndërgjegja Ndihmëse i bën këto gjëra, ajo mund të bëjë një punë shumë të mirë në atë kohë.

Ka dhe një formë tjetër: Domethënë, ata prej jush që kanë cilësi të lindur shumë të mirë mund të kontrollohen nga qënie të larta me lehtësi për të kryer gjëra. Sigurisht, kjo është një çështje tjetër dhe nuk do ta trajtojmë këtu. Ne kryesisht diskutojmë mendimet që vijnë nga vetja jonë.

Përsa i përket "frymëzimit', edhe ky është një term i sajuar nga shkrimtarët. Në përgjithësi besohet se frymëzimi, si grumbullim i njohurive të personit gjatë gjithë jetës, shpërthen për një sekondë si një shkëndijë që shkëlqen. Unë do të thoja se sipas perspektivës materialiste, sa më shumë njohuri individi grumbullon në jetë, aq më shumë ai përdor mëndjen dhe aq më e mprehtë bëhet ajo. Në kohën kur personi e përdor mëndjen, ajo duhet të prodhojë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk duhet të ketë nevojë për frymëzim. Ajo që njerëzit quajnë frymëzim, kur vjen, nuk është në këtë formë. Zakonisht kur një person përdor mëndjen, ai vazhdon ta përdorë derisa atij i duket sikur i është sosur dija dhe sikur i janë shteruar mendimet. Ai do të jetë i paaftë të vazhdojë të shkruajturit, i janë shteruar idetë për të kompozuar një pjesë muzikore, apo do të jetë i paaftë të mbarojë një projekt kërkimi shkencor. Në këtë pikë, një person zakonisht ndjehet i lodhur me trurin të mpirë dhe bishta cigaresh të shpërndara në dysheme. Ai ka ngecur, ka dhimbje koke dhe akoma nuk i vjen ndonjë ide. Së fundi, në cilat kushte shfaqet frymëzimi? Nëqoftëse ai është i lodhur, ai do mendojë: "Harroje. Do bëj pak pushim. "Ngaqë sa më shumë që Ndërgjegja Kryesore kontrollon trurin e tij aq më pak qënie të tjera mund të ndërhyjnë, me këtë pushim dhe shplodhjen e mëndjes, menjëherë ai mund pa dashje të kujtojë diçka nga truri i tij. Shumica e frymëzimeve vjen kështu.

Pse vjen frymëzimi në atë kohë? Sepse kur mëndja individit kontrollohet nga Ndërgjegja Kryesore, sa më shumë ai e përdor trurin, aq më shumë kontroll ka nga Ndërgjegja Kryesore dhe aq më pak mundet Ndërgjegja Ndihmëse të ndërhyjë. Kur dikush po mendon, ka dhimbje koke dhe vuan, Ndërgjegja Ndihmëse gjithashtu vuan dhe ka një dhimbje koke shumë të madhe. Si pjesë e këtij trupi dhe i lindur në të njejtën kohë nga e njejta nënë, ai gjithashtu kontrollon një pjesë të këtij trupi. Kur Ndërgjegja Kryesore e personit rilaksohet, Ndërgjegja Ndihmëse do të projektojë çfarë din në tru. Meqenëse mund të shohë natyrën e materies në një dimension tjetër, puna do të bëhet siç duhet, artikulli do të shkruhet apo muzika do të kompozohet.

Disa njerëz do të thonë: "Në se është kështu, ne duhet ta fusim në punë Ndërgjegjen Ndihmëse. "Kjo është e njejtë me çfarë dikush sapo pyeti në një letër: "Si të komunikojmë me Ndërgjegjen Ndihmëse?"Ju nuk mund të kontaktoni me të sepse ju sapo keni filluar praktikën dhe ju nuk keni aftësi. Ju më mirë të mos e kontaktonit sepse qëllimi juaj me siguri do të jetë ndonjë dëshirë. Disa njerëz mund të mendojnë: A mund ta përdorim Ndërgjegjen Ndihmëse për të krijuar pasuri për ne dhe për të përshpejtuar

zhvillimin e shoqërisë njerëzore?"Jo! Pse jo? Sepse atë që din Ndërgjegja juaj Ndihmëse është përsëri shumë e kufizuar. Me kompleksitetin e dimensioneve dhe kaq shumë nivele, struktura e universit është tepër komplekse. Ndërgjegja Ndihmëse mund të dijë vetëm ato që janë në dimensionin e vet dhe nuk do të dijë gjë jashtë atij dimensioni. Po ashtu, ka dhe shumë nivele dhe dimensione të ndryshme vertikale. Zhvillimi i njerëzimit mund të kontrohet vetëm nga jetët më të larta të një niveli shumë të lartësuar dhe përparon sipas ligjit të zhvillimit.

Shoqëria jonë njerëzore përparon sipas ligjit të zhvillimit të historisë. Ju mund të doni të zhvillohet në një mënyrë të caktuar dhe të arrini një qëllim të caktuar, por ato jetët e larta nuk e mendojnë ashtu. Pse nuk menduan njerëzit në kohë të lashta për avionët, trenat dhe biçikletat e sotme? Unë do të thoja se do ishte e pabesueshme që ata të mos i kishin menduar ato. Ngaqë historia nuk u zhvillua deri në atë shkallë, ata nuk mund t'i shpiknin ato. Në sipërfaqe, apo nga perspektiva e teorive konvencionale dhe njohuritë e sotme njerëzore, kjo ndodh ngaqë shkenca njerezore në atë kohë nuk e kishte arritur akoma këtë nivel dhe kështu ata nuk mund t'i shpiknin ato. Në fakt, si shkenca njerëzore duhet të zhvillohet është gjithashtu e caktuar sipas planit të historisë. Nëqoftëse ju dëshironi të arrini një qëllim të caktuar si njeri, ai nuk mund të arrihet. Sigurisht, ka njerëz Ndërgjegja Ndihmëse e të cilëve mund të luajë një rol me lehtësi. Një shkrimtar pretendon: "Unë mund të shkruaj dhjetëra mijra fjalë në ditë për librin tim pa u lodhur fare. Po të dua, unë mund të shkruaj shumë shpejt dhe të tjerët mund ta konsiderojnë shumë të mirë kur ta lexojnë. "Pse ndodh kështu? Ky është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Ndërgjegjes së tij Kryesore me Ndërgjegjen Ndihmëse, sepse Ndërgjegja Ndihmëse e tij gjithashtu mund të marrë përsipër gjysmën e punës. Por nuk është gjithmonë kështu. Shumica e Ndërgjegjeve Ndihmëse nuk përzihen fare. Nuk është mirë nëqoftëse ju doni që të bëjë diçka sepse ju do të merrni rezultatet e kundërta.

(…..)

Cilësia e lindur e personit përcaktohet nga sasia e substancës së virtytit në një trup të tij në një dimension tjetër. Me më pak virtyt dhe me më shumë substancë të zezë, fusha karmike e personit do të jetë e madhe. Në këtë rast, personi është me cilësi të lindur të dobët. Me shumë virtyt apo substancë të bardhë, fusha e tij karmike do të jetë e vogël. Kështu, ky person është me cilësi të mirë të lindur. Substanca e bardhë dhe substanca e zezë mund të konvertohen në njëra tjetrën. Si konvertohen ato? Kur kryen vepra të mira merr substancën e bardhë, sepse substanca e bardhë merret nëpërmjet durimit të vështirësive, vuajtjeve apo nga kryerja e veprave të mira. Substanca e zezë krijohet kur i bën njerëzve keq dhe kur kryen vepra të këqija dhe ajo është karmë. Ndodh ky proçes transformimi. Ndërkohë, mund dhe të trashëgohet. Ngaqë shkojnë drejtpërdrejt pas

Shpirtit Primordial të personit, nuk janë diçka vetëm nga një jetë por grumbullohen nga një kohë e largët. Prandaj, njerëzit flasin për akumulim karme dhe grumbullim virtyti. Po ashtu, ato mund të merren dhe nga paraardhësit. Shpesh, më kujtohet çfarë thonin kinezët e lashtë apo të moçmit: "Të parët e dikujt kanë grumbulluar virtyt, grumbullo apo humb virtyt. "Kjo që thuhej ishte shumë e saktë! Është shumë e drejtë me të vërtetë.

Cilësia e lindur e mirë apo e varfër e personit mund të përcaktojë nëse cilësia e tij e ndriçimit shpirtëror është e mirë apo e varfër. Cilësia e varfër e lindur e një personi mund ta bëjë dhe ndriçimin e tij shpirtëror shumë të varfër. Pse ndodh kjo? Ndodh sepse një person me cilësi të mirë të lindur ka plot substancë të bardhë që asimilohet në univers dhe në karakteristikën Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë) pa kurrfarë pengese. Karakteristika e universit mund të shfaqet direkt në trupin tuaj dhe të jetë në kontakt të menjëhershëm me trupin tuaj. Ndërsa substanca e zezë është pikërisht e kundërta. Meqenëse merret nga kryerja e veprave të këqija, ajo shkon në drejtim të kundërt nga karakteristika e universit tonë. Prandaj, kjo substancë e zezë ndahet nga karakteristika e universit tonë. Kur kjo substancë e zezë grumbullohet në një sasi të madhe, ajo do të formojë një fushë që e rrethon trupin e personit dhe e mbështjell atë nga brenda. Sa më e madhe fusha, aq më i madh densiteti dhe trashësia e saj dhe kjo do ta bëjë cilësinë e ndriçimit shpirtëror të varfërohet. Kjo ndodh ngaqë personi nuk është në gjendje të jetë në kontakt me karakteristikën e universit Zhen-Shan-Ren (Ndershmëri-Mirësi-Tolerancë), ngaqë ai e ka marre substancen e zezë nga kryerja e veprave të këqija. Zakonisht, është më e vështirë për një individ si ky të besojë në praktikën kultivuese. Sa më e varfër cilësia e tij e ndriçimit shpirtëror, aq më e madhe rezistenca karmike që ai do të gjejë. Sa më shumë vështirësi që ai kalon, aq më pak do ta besojë ai atë dhe aq më e vështirë do jetë për të që të praktikojë kultivim.

Është më e lehtë për dikë me shumë substancë të bardhë për të praktikuar kultivim. Kjo ndodh ngaqë gjatë kultivimit, për aq kohë sa ky person i asimilohet karakteristikës së universit dhe përmirëson karakterin të tij, virtyti i tij do të transformohet drejt e në gong. Por për dikë me shumë substancë të zezë ka një procedurë shtesë. Është si një produkt që bën fabrika: Të tjerët vijnë me material të gatshëm, ndërsa ky person vjen me lëndë të parë që duhet të përpunohet. Duhet të kalojë një proçes shtesë. Prandaj, ai duhet së pari të vuajë në vështirësi dhe të eliminojë karmë, në mënyrë që ta transformojë atë në substancë të bardhë dhe formojë këtë substancë virtyti. Vetëm atëhere mundet ai të zhvillojë gong të nivelit të lartë. Por një person si ky zakonisht nuk ka cilësi ndriçimi shpirtëror të lindur të mirë. Po t'i kërkohet që të vuajë më shumë, ai do e besojë atë më pak dhe do jetë më e vështirë për të ta durojë atë. Prandaj, është e vështirë për dikë me shumë substancë të zezë të praktikojë kultivim. Prandaj,

Shkolla Tao apo një shkollë praktike që mëson vetëm një dishepull kërkonte që mjeshtri të kërkonte për një dishpull e jo e kundërta. Kjo përcaktohej nga sa nga këto gjëra kishte trupi i këtij dishepulli.

Cilësia e lindur përcakton cilësinë e ndriçimit shpirtëror të personit, por kjo nuk është absolute. Disa njerëz nuk kanë cilësi shumë të mirë të lindur, por ambjenti i tyre familjar është shumë i mirë; shumë pjesëtarë të familjes praktikojnë kultivim. Disa prej tyre janë gjithashtu besimtarë fetarë dhe besojnë shumë në praktikën kultivuese. Në këtë ambjent, personi mund të kthehet në besues dhe kjo e bën cilësinë e ndriçimit të tij shpirtëror të përmirësohet. Pra nuk është absolute. Disa njerëz kanë shumë cilësi të mirë të lindur, por për shkak të arsimimit me ato pak njohuri nga shoqëria dhe veçanërisht për shkak të metodave absolute të edukimit ideologjik pak vite më parë, ata janë bërë me mëndje shumë të ngushta dhe nuk do besojnë asgjë përtej njohurive të tyre. Kjo mund ta influencojë seriozisht cilësinë e tyre të ndriçimit shpirtëror.

Për shembull, unë mësova hapjen e Syrit Qiellor në ditën e dytë të një klase. Menjëherë, një personi me cilësi të mirë të lindur ju hap Syri Qiellor në një nivel shumë të lartë. Ai pa skena të shumta që shumë njerëz të tjerë nuk mund t'i shihnin. Ai i tregoi të tjerëve: "Uau, pashë Falun që binin si flokë bore mbi trupat e publikut në gjithë auditorin. Pashë si duket Trupi i Vërtetë i Mësuesit Li, aurorën e Mësuesit, si duken në të vërtetë Falunët dhe sa Fashen janë këtu. "Ai pa se Mësuesi po jepte mësime në nivele të ndryshme dhe se si Falunët po rregullonin trupat e praktikuesve. Ai gjithashtu pa se gjatë leksionit gongshen (trup i përbërë prej gongu) të Mësuesit po jepnin mësime në çdo nivel të ndryshëm. Po ashtu ai pa bukuroshet qiellore që hidhnin lule rreth e rrotull e të tjera gjëra si këto. Ai pa disa gjëra kaq të mrekullueshme si këto, që tregonin se cilësia e tij e lindur ishte shumë e mirë. Ndërsa ai vazhdonte kështu e ashtu, së fundi ai tha: "Nuk i besoj këto gjëra. "Disa nga këto gjëra janë provuar tashmë nga shkenca dhe shumë gjëra gjithashtu mund të shpjegohen nga shkenca moderne; ne i kemi diskutuar disa prej tyre këtu. Kjo ndodh ngaqë ajo që mund të kuptohet nga qigongu është me të vërtetë përtej kuptimit të shkencës moderne—kjo është e sigurtë. Në bazë të kësaj, cilësia e lindur e dikujt nuk përcakton të gjithë cilësinë e ndriçimit shpirtëror të personit.

Çfarë është "***ndriçimi dhe lartësimi shpirtëror***"? Ndriçimi dhe lartësimi shpirtëror janë terma nga fetë. Në Buddhizëm do të thonë të kuptuarit nga ana e një praktikuesi të Mësimeve Buddhiste, ndriçim shpirtëror në kuptimin e aftësisë për të kuptuar të vërtetat e Ligjit ndërsa lartësim shpirtëror do të thotë lartësimi shpirtëror përfundimtar apo arritja e mençurisë. Megjithatë, përdoren sot nga njerëzit e zakonshëm për të nënkuptuar që një person është shumë i zoti dhe mund të lexojë mëndjen e manaxherit të tij. Ai ua merr dorën gjërave shpejt dhe din si t'ja bëjë qejfin menaxherit të tij. Njerëzit e quajnë këtë cilësi të mirë të kuptuari dhe

zakonisht kuptohet kështu. Megjithatë, sapo dikush ngrihet pak më lart se niveli i njerëzve të zakonshëm, ai do të kuptojë se parimet në këtë nivel siç kuptohen nga njerëzit janë zakonisht të gabuara. Kjo nuk është aspak aftësia për të kuptuar të cilës i referohemi ne. Përkundrazi, cilësia e ndriçimit shpirtëror të një personi të zotë nuk është diçka e mirë, sepse një person që është shumë i zoti do të bëjë vetëm punë sipërfaqësore në mënyrë që të vlerësohet nga menaxheri apo përgjegjësi i tij. Në këtë rast a nuk do të bëhej puna nga dikush tjetër? Kështu ky person do t'i detyrohesh të tjerëve. Ngaqë ai është i zoti dhe din si të kënaqë të tjerët, ai do të marrë më shumë përfitime ndërsa të tjerët do të pësojnë më shumë humbje. Ngaqë ai është i zoti, ai nuk do të pësojë humbje dhe ky person as nuk do të humbë kollaj gjëra të tjera. Për pasojë të tjerët duhet të pësojnë humbje. Sa më shumë që ai kujdeset për këtë pak përfitim praktik, aq më mëndje ngushtë bëhet ai dhe aq më shumë ai mendon se përfitimet materiale të njerëzve janë diçka që ai nuk mund t'i lejojë t'i ikin nga dora. Kështu ai do ta ndjejë veten se është shumë praktik dhe nuk do të pësojë humbje.

Disa njerëz madje e kanë zili këtë person! Po ju them të mos e keni zili atë. Ju nuk e dini sa jetë të lodhshme ai bën: Ai nuk ha apo fle mirë; ai ka frikë mos i dëmtohen interesat edhe në gjumë dhe ai bën çdo gjë për përfitim personal. A nuk do thonit dhe ju se ai bën një jetë të lodhshme sepse e tërë jeta e tij i është përkushtuar kësaj? Ne themi se kur ju bëni një hap mbrapsht në një konflikt, ju do të gjeni një det e qiell të pa kufi dhe patjetër kjo do të sjellë një situatë tjetër. Por një person si ai nuk do të heqë dorë dhe bën jetën më të lodhshme. Ju nuk duhet të mësoni prej tij. Thuhet në komunitetin e kultivuesve: "Një person i tillë është plotësisht i humbur. Ai është komplet i humbur në mes të njerëzve dhe përfitimeve materiale. "Nuk do jetë e lehtë për të që të ruajë virtyt! Po t'i thuash të praktikojë kultivim, ai nuk do t'ju besojë: "Të praktikoj kultivim? Si praktikues, ju nuk kundërpërgjigjeni kur ju godasin apo shajnë. Kur të tjerët ju sjellin probleme, në vend që t'i trajtoni në të njejtën mënyrë, ju madje duhet t'i falenderoni ata. Ju jeni bërë të tërë budallenj! Të gjithë jeni të sëmurë mendorë!"Një person si ky nuk mund ta kuptojë praktikën kultivuese në asnjë mënyrë. Ai do të thotë se ju jeni i paimagjinueshëm dhe i metë. A nuk do të thonit ju se ai është i vështirë për t'u shpëtuar?

Ky nuk është ndriçimi shpirtëror të cilit i referohemi ne. Përkundrazi, është ajo çfarë ky person e quan "budallallëk"përsa i përket interesit personal që quhet ndriçim shpirtëror nga ne. Sigurisht, një person i tillë nuk është me të vërtetë i metë. Ne thjesht e trajtojmë çështjen e interesave personale me indiferencë, ndërsa në aspektet e tjera ne jemi shumë të mençur. Përsa i përket kryerjes së projekteve kërkimore shkencore apo kryerjes së detyrave nga menaxherët apo detyra të tjera, ne jemi mëndje mprehtë dhe i kryejmë ato shumë mirë. Vetëm kur është fjala për përfitime personale apo për konflikte me të tjerët, ne nuk i vëmë atyre rëndësi. Kush

do t'ju quaj juve të lënë nga mendtë? Askush nuk do të thotë se jeni të lënë nga mendtë—është e garantuar të jetë kështu.

Le të flasim për një person me të vërtetë të metë, sepse e vërteta e kësaj situate është plotësisht e kundërt në nivele të larta. Mundësia që një i metë të kryejë ndonjë vepër shumë të keqe në mes të njerëzve të zakonshëm është shumë e vogël dhe as nuk do të konkuronte apo luftonte ai për interes personal. Ai nuk kërkon famë e nuk humb virtyt, ndërsa të tjerët do t'i japin atij virtyt dhe kjo substancë është jashtëzakonisht e vlefshme. Në universin tonë, ekziston ky parim: pa humbje nuk ka fitim. Që të fitosh, duhet të humbësh. Kur të tjerët e shikojnë këtë person kaq budalla, ata do ta shajnë atë: "Ej budallë. "Me këto sharje, një copë virtyti do t'i jepet atij. Duke e marrë nëpër këmbë atë ju jeni pala fituese, kështu që ju duhet të humbni diçka. Nëqoftëse dikush shkon dhe e godet atë me shkelm: "Ti je idiot. "Epo mirë, një copë e madhe virtyti do t'i kalojë atij. Kur dikush e mërzit apo e godet atë, ai vetëm do buzëqeshë: "Jepini. Ju po më jepni mua virtyt dhe unë nuk do të refuzoj as dhe një copë prej saj!"Atëhere sipas parimeve të niveleve të larta, mendoje pak, kush është i mençur? A nuk është ky person i mençur? Ai është më i mënçuri sepse ai nuk humb virtyt. Kur ju i jepni atij virtyt, ai nuk e refuzon atë aspak. Ai do e marrë të gjithë atë dhe do e pranojë me një buzëqeshje. Ai mund të jetë i metë në këtë jetë, por jo në tjetrën—Shpirti i tij Primordial nuk është i metë. Thuhet nga fetë që kur ka shumë virtyt, një person do të bëhet zyrtar i lartë apo do të bëjë pasuri të madhe në jetën tjetër; këto shkëmbehen me virtytin tënd.

Ne themi se virtyti mund të transformohet direkt e në gong. A nuk varet lartësia nivelit të kultivimit tënd nga transformimi i këtij virtyti? Ai mund të transformohet direkt e në gong. A nuk transformohet gongu që përcakton nivelin e personit dhe fuqinë e gongut të tij nga kjo substancë? A nuk do të thonit ju se ai është shumë i vyer? Mund të vijë me ju kur lindni dhe ju shoqëron në vdekje. Thuhet në Buddhizëm se niveli juaj i kultivimit është Shkalla juaj e Arritjes. Sa më shumë që ju do të sakrifikoni, aq më e madhe është edhe ajo që do të fitoni—pikërisht, ky është parimi. Thuhet në fe se me virtyt, personi do të bëhet zyrtar i lartë apo do të bëjë pasuri të madhe në jetën tjetër. Me pak virtyt, ai do ta ketë të vështirë dhe për të lypur për ushqim sepse nuk ka virtyt për të shkëmbyer. Pa humbje nuk ka fitim! Kur nuk ka fare virtyt, personi do të zhdukej me trup e shpirt; ai do të vdiste me të vërtetë.

Në të kaluarën, ishte një mjeshtër qigongu niveli i të cilit ishte shumë i lartë kur ai doli në publik për herë të parë. Ky mjeshtër qigongu më vonë u dha pas famës dhe interesit personal. Mësuesi i tij ja mori Shpirtin Ndihmës meqenëse ai i përkiste atyre që kultivojnë Shpirtin Ndihmës. Kur Shpirti i tij Ndihmës ishte akoma i pranishëm, ky person kontrollohej nga Shpirti Ndihmës. Për shembull, një ditë vendi i tij i punës po shpërndante apartamente. Përgjegjësi tha: "Të gjithë ata që kanë nevojë për apartament

të vijnë këtu të përshkruajnë kushtet e tyre dhe të shpjegojnë pse keni nevojë për apartament. "Të gjithë dhanë arsyet e tyre ndërsa ky person nuk tha asnjë fjalë. Së fundi, përgjegjësi mori vesh se ky person kishte nevojë më të madhe sesa të tjerët dhe se apartamenti duhej t'i jepej atij. Të tjerët thanë: "Jo, apartamenti nuk duhet t'i jepet atij. Duhet të më jepet mua sepse unë kam më shumë nevojë. "Ky person tha: "Atëhere merre ti. "Një person i zakonshëm do ta quante atë të metë. Disa njerëz e dinin që ai ishte praktikues dhe e pyetën: "Si praktikues, ti nuk don asgjë. Çfarë dëshiron ti?"Ai u përgjigj, "Unë do marr çfarëdo që nuk e duan të tjerët. "Në fakt, ai nuk ishte aspak i metë përkundrazi, ishte shumë i zgjuar. Vetëm përsa i përket interesave personale sillej ai ashtu. Ai besonte në ndjekjen e rrjedhës së natyrshme të gjërave. Të tjerët e pyetën atë përsëri: "E çfarë është ajo që njerëzit nuk e duan sot?"Ai u përgjigj: "Asnjeri nuk dëshiron copat e gurit në tokë që goditen andej e këtej. Kështu unë do t'i mbledh ato. "Njerëzit e zakonshëm e shohin një gjë të tillë si të pakonceptueshme dhe nuk mund t'i kuptojnë praktikuesit. Ata nuk mund t'i kuptojnë ata sepse nivelet e tyre të të menduarit janë shumë larg dhe ndryshimi ndërmjet niveleve të tyre është gjithashtu tepër i madh. Sigurisht, ai nuk do të mblidhte gurët. Ai tha një parim që një njeri i zakonshëm nuk mund ta kuptojë: "Unë nuk do të kërkoj asgjë në mes të njerëzve. "Le të flasim pak për gurin. Ju e dini që thuhet në shkrimet e shenjta të Buddhizmit: "Në Parajsën e Lumturisë Absolute, pemët janë prej floriri dhe po kështu është toka, zogjtë, lulet dhe shtëpitë. Madje dhe trupi i Buddhës është prej floriri dhe plot shkëlqim. "Nuk mund të gjesh as dhe një copë guri atje. Monedha që përdoret atje thuhet se është guri. Ai nuk do të shkonte atje dhe të merrte me vete një copë gur, por ai tha një parim që një njeri i zakonshëm nuk mund ta kuptojë. Me të vërtetë, praktikuesit do të thonin: "Njerëzit e zakonshëm kanë gjërat e tyre që ata përndjekin dhe ne nuk i kërkojmë ato. Përsa i përket atyre gjërave që njerëzit kanë, ne nuk jemi të interesuar. Megjithatë atë që ne kemi është diçka që njerëzit e zakonshëm nuk mund ta marrin dot edhe sikur të donin. "

Në fakt, ndriçimi shpirtëror për të cilin sapo folëm i referohet akoma llojit të ndriçimit shpirtëror gjatë kursit të praktikës kultivuese dhe kjo është pikërisht e kundërta me atë për të cilën flasin njerëzit e zakonshëm. Ndriçimi shpirtëror të cilit i referohemi ne do të thotë, nëse gjatë kursit të praktikës kultivuese një person mund të arrijë të kuptojë dhe pranojë Ligjin e mësuar nga mjeshtri apo Taon e mësuar nga mjeshtri Taoist, nëse ai mund sillet si praktikues kur has në vështirësi dhe nëse ai mund të sillet në përputhje me Ligjin kur praktikon kultivim. Përsa i përket disa njerëzve, pamvarësisht si ja shpjegon këtë, ata nuk do ta besojnë dhe do të mendojnë se është më praktike të jesh njeri i zakonshëm. Ata do të kapen fort pas mendimeve të tyre dhe kjo i bën ata që të mos besojnë dot. Disa njerëz vetëm duan të shërojnë sëmundje. Sapo unë përmend këtu se qigong nuk

përdoret aspak për të shëruar sëmundje, mëndja e tyre do të reagojë negativisht dhe për pasojë ata nuk do të besojnë çfarë mësohet më pas.

Disa njerëz nuk mund ta përmirësojnë fare cilësinë e të kuptuarit të tyre. Ata shkruajnë mbi librin tim si t'u teket. Praktikuesit tanë me Syrin Qiellor të hapur mund të shikojnë që ky libër është i shumëngjyrshëm, i artë dhe me shkëlqim. Çdo fjalë ka imazhin e Fashen-it tim. Nëqoftëse do t'ju thoja gënjeshtra, unë do t'ju mashtroja juve. Ajo shenjë që ti bëre duket shumë e errët. Si guxon të shkruash mbi të si të të teket? Çfarë po bëjmë ne këtu? A nuk po ju udhëheqim që të praktikoni kultivim drejt niveleve të larta? Ka disa gjëra që dhe ju duhet t'i mendoni. Ky libër mund të udhëheqë praktikën tuaj kultivuese. A nuk mendoni se është i çmuar? A mundeni ju që me të vërtetë të praktikoni kultivim duke ju falur Buddhës? Ti je shumë adhurues dhe nuk guxon as dhe ta prekësh pak statujën e Buddhës për të cilën djeg erë të mirë çdo ditë, megjithatë ti guxon të prishësh Dafën që mund të udhëheqë me të vërtetë praktikën tënde kultivuese.

Me që po flasim për çështjen e cilësisë së ndriçimit shpirtëror të personit, kjo i referohet thellësisë së të kuptuarit të diçkaje që ndodh në nivele të ndryshme gjatë kursit të praktikës kultivuese, apo të atij Ligji që mjeshtri ka mësuar. Megjithatë, ky nuk është lartësimi shpirtëror themelor të cilit i referohemi ne. Lartësimi shpirtëror themelor për të cilin ne flasim do të thotë që gjatë jetës, nga fillimi i praktikës kultivuese, personi do të ngjitet vazhdimisht lart dhe heqë dorë nga përndjekjet njerëzore dhe nga dëshirat e ndryshme dhe gongu i tij gjithashtu do të rritet derisa arrin në hapin final të praktikës kultivuese. Kur substanca e virtytit të jetë transformuar plotësisht në gong dhe udhëtimi i kultivimit të këtij personi i pregatitur nga mjeshtri të ketë arritur fundin, "Bam!"të gjithë çelsat do të shpërthehen e hapen në sekond. Syri i tij Qiellor do të arrijë pikën më të lartë të nivelit të tij dhe ai mund të shikojë në nivelin e tij të vërtetën e dimensioneve të ndryshme, format e ekzistencës së qënieve dhe materieve të ndryshme në hapësira-kohe të ndryshme dhe të vërtetën e univesit tonë. Të gjitha fuqitë e tij hyjnore do të shfaqen dhe ai do të mund të kontaktojë lloje të ndryshme jete. Tashmë, a nuk është ky person një person i shumëlartësuar shpirtërisht apo një person i lartësuar shpirtërisht nëpërmjet praktikës kultivuese? E përkthyer në gjuhën e lashtë indiane, ai është një Buddha.

Lartësimi shpirtëror të cilit i referohemi ne është ky lartësim shpirtëror themelor që i përket formës së arritjes së lartësimit shpirtëror të menjëhershëm. Lartësim shpirtëror i menjëhershëm do të thotë që një person është i kyçur gjatë viteve të kultivimit të tij dhe ai nuk din gjë sa i lartë është niveli i gongut të tij apo në çfarë forme shfaqet gongu i kultivuar prej tij. Ai nuk ndjen asgjë fare dhe të gjitha qelizat në trupin e tij janë të kyçura. Gongu që ai ka kultivuar është kyçur deri në hapin final

dhe vetëm atëhere ai mund të çlirohet. Vetëm dikush me cilësi shumë të mirë të lindur mund ta bëjë këtë, sepse një praktikë kultivuese e tillë është shumë e dhimbshme. Personi duhet ta fillojë duke qënë njeri i mirë. Ai duhet të përmirësojë vazhdimisht karakterin, gjithmonë të vuajë përmes vështirësive, të ngjitet vazhdimisht në kultivim dhe gjithmonë të kërkojë të përmirësojë karakterin edhe pse ai nuk mund ta shikojë gongun e tij. Kultivimi është tepër i vështirë për këtë person dhe ai apo ajo duhet të jetë dikush me cilësi shumë të mirë të lindur. Ky person do të praktikojë kultivim për shumë vite pa ditur gjë.

Ekziston dhe një formë tjetër lartësimi shpirtëror i quajtur lartësim shpirtëror gradual. Që nga fillimi, shumë njerëz e kanë ndjerë rrotullimin e Falunit. Po ashtu, unë i kam hapur atyre Syrin Qiellor. Për arsye të ndryshme, disa njerëz do të mund të shohin në të ardhmen nëqoftëse nuk shohin tani. Ata do të jenë në gjendje të shkojnë nga të shikuarit e gjërave turbullt në të shikuarit më qartë dhe ata do të kalojnë nga paaftësia për ta përdorur atë në diturinë si ta përdorin. Niveli i personit do të rritet vazhdimisht. Ndërsa karakteri juaj përmirësohet dhe përndjekjet e ndryshme braktisen, do të zhvillohen aftësi supernormale të ndryshme. I gjithë proçesi i transformimit të praktikës kultivuese dhe proçesi i transformimit të trupit do të ndodhë në kushtet kur ti mund t'i shikosh apo ndjesh ato. Ndryshimet do të vazhdojnë deri në hapin final kur ti mund të kuptosh plotësisht të vërtetën e universit dhe kur ti të kesh arritur pikën më të lartë që duhet të arrish në kultivim. Transformimi i trupit dhe përforcimi i aftësive supernormale do të kenë arritur secili një shkallë të caktuar dhe kjo do të arrihet gradualisht. Ky është lartësimi shpirtëror gradual. Dhe metoda e kultivimit të arritjes së lartësimit shpirtëror gradual nuk është e lehtë. Me aftësi supernormale të shfaqura, disa njerëz nuk heqin dorë dot nga dëshirat e tyre dhe ka mundësi të mburren para të tjerëve apo të bëjnë vepra të këqija. Ju do të humbisni kështu virtyt dhe praktika juaj kultivuese do të shkojë dëm e ju do të përfundoni të shkatërruar. Disa njerëz mund të shikojnë manifesimet e jetëve të ndryshme në nivele të ndryshme. Dikush mund t'ju kërkojë të bëni këtë apo atë gjë. Ai person mund t'ju kërkojë të praktikoni gjërat e tij dhe t'ju marrë si dishepull, por ai nuk mund t'ju ndihmojë të arrini Shkallën e Duhur meqenëse ai vetë nuk e ka arritur Shkallën e Duhur.

Po ashtu, të gjitha qëniet në dimensione të larta janë qënie hyjnore që mund të bëhen shumë të mëdhenj dhe të shfaqin tërë fuqitë e tyre mbinatyrale. Nëqoftëse mëndja juaj nuk është e pastër, a nuk do t'i shkoni ju atyre nga prapa? Me t'i ndjekur ata, praktika juaj kultivuese do të shkojë dëm. Edhe sikur ajo qënie të jetë një Buddha apo Tao e vërtetë, ju përsëri duhet ta filloni praktikën kultivuese nga e para. A nuk janë ato qënie qiellore pamvarësisht nga cili nivel i qiellit vijnë? Vetëm kur dikush arrin një nivel shumë të lartë kultivimi dhe ja arrin qëllimit, mundet ai të ngrihet

mbi gjithshka. Megjithatë, një personi të zakonshëm, një qënie qiellore mund t'i duket me siguri e lartë, gjigande dhe shumë e zonja. Megjithatë kjo qënie mund të mos e ketë arritur Shkallën e Duhut. Me ndërhyrjen e mesazheve të ndryshme dhe me tërheqjen e vëmendjes nga skena të ndryshme, a mundet të mbeteni të paturbulluar? Prandaj, është gjithashtu e vështirë të praktikosh kultivim me Syrin Qiellor të hapur dhe është më e vështirë të kontrollosh karakterin tënd. Për fat të mirë, shumë nga praktikuesit tanë do t'i kenë aftësitë e tyre supernormale të çbllokuara në gjysmë të proçesit të kultivimit të tyre dhe ata pastaj do të arrijnë stadin e lartësimit shpirtëror gradual. Syri Qiellor i të gjithëve do të hapet por aftësitë supernormale të shumicës nuk lejohen të shfaqen. Kur karakteri juaj të arrijë gradualisht një nivel të caktuar dhe ju të mund të silleni mirë e me mëndje të qëndrueshme, ato do të shpërthehen hapur të gjitha menjëherë. Në një nivel të caktuar, ju do të hyni në gjendjen e lartësimit shpirtëror gradual dhe në atë kohë do të jetë më e lehtë për ju të silleni mirë. Aftësi të ndryshme supernormale do të shfaqen. Ju do të ngjiteni në kultivim vetë derisa në fund të gjitha ato do të çbllokohen. Juve do t'ju lejohet t'i keni ato në gjysmë të praktikës suaj kultivuese. Shumë nga praktikuesit tanë i përkasin këtij grupi, kështu ju nuk duhet të jeni të paduruar të shikoni gjëra.

Të gjithë mund të keni dëgjuar që sekti Zen flet gjithashtu për dallimet ndërmjet lartësimit shpirtëror të menjëhershëm dhe atij gradual. Huineng, patriarku i gjashtë i sektit Zen, mësoi lartësimin shpirtëror të menjëhershëm ndërsa Shenxiu[119] nga Shkolla Veriore e sektit Zen mësoi lartësimin shpirtëror gradual. Mosmarrëveshja ndërmjet të dyve mbi studimet Buddhiste zgjati një kohë shumë të gjatë në histori. Unë e quaj atë të kotë. Pse? Sepse ajo të cilës i referoheshin ata ishte vetëm të kuptuarit e një parimi gjatë proçesit të praktikës kultivuese. Përsa i përket këtij parimi, disa mund ta kuptojnë atë menjëherë, ndërsa të tjerët mund ta arrijnë e kuptojnë atë gradualisht. A ka rëndësi si dikush arrin lartësimin shpirtëror? Është më mirë kur ai mund ta kuptojë të gjithën menjëherë, por është gjithashtu mirë nëqoftëse dikush arrin gradualisht të lartësohet shpirtërisht. A nuk janë të dyja rastet lartësim shpirtëror? Të dyja janë lartësim shpirtëror, kështu asnjëra nuk është e gabuar.

Çfarë është një person me ***"cilësi shpirtërore të lindur të madhe"***? Ka dallim edhe ndërmjet dikujt me cilësi shpirtërore të lindur të madhe dhe dikujt me cilësi shpirtërore të lindur të mirë apo të varfër. Është jashtëzakonisht e vështirë të gjesh dikë me cilësi shpirtërore të lindur të madhe, sepse do të duhej një periudhë shumë e gjatë historike që të lindte një person i tillë. Sigurisht, një person me cilësi shpirtërore të lindur shumë të madhe duhet së pari të ketë një sasi të madhe virtyti dhe një fushë shumë të madhe të kësaj substance të bardhë—kjo është e sigurtë. Ndërkohë, ky person duhet gjithashtu të jetë i aftë të durojë vështirësinë e

vështirësive. Ai gjithashtu duhet të ketë një mëndje me durim të madh dhe të jetë në gjendje të sakrifikojë. Ai duhet të jetë i aftë të ruajë virtyt, të ketë cilësi ndriçimi shpirtëror të mirë e kështu me rallë.

Cila është vështirësia e vështirësive? Besohet në Buddhizëm se të jesh njeri do të thotë të vuash—për aq kohë sa ju jeni njerëz, ju duhet të vuani. Besohet se jetët në gjithë dimensionet e tjera nuk kanë trupa si trupat njerëzore. Prandaj ata nuk sëmuren dhe as nuk kanë problemet e lindjes, plakjes dhe vdekjes. As që do të kenë vuajtje të tilla. Njerëzit në dimensione të tjera mund të ngrihen në ajër, sepse ata janë pa peshë dhe është me të vërtetë një mrekulli. Për shkak të këtij trupi, njerëzit e zakonshëm do të hasin në vështirësi. Ata nuk mund të durojnë të ftohtët, të nxehtët, etjen, urinë apo lodhjen e për më shumë kanë lindje, plakje, sëmundje dhe vdekje. Sidoqoftë ata nuk do të kenë rehati.

Unë lexova në një gazetë se në kohën e tërmetit në qytetin Tangshan, shumë njerëz u vranë nga tërmeti, por disa i sollën në jetë nga vdekja klinike. Një anketim i veçantë u krye me këtë grup njerëzish. Ata u pyetën: "Si ndjeheshit në gjendjen e vdekjes?"Për habi, këta njerëz të gjithë folën për të njejtën situatë të veçantë. Domethënë, pikërisht në momentin e vdekjes ata nuk ndjenë frikë; përkundrazi, ata papritmas ndjenë një ndjenjë lehtësimi, me një lloj gëzimi në nën-ndërgjegje. Disa njerëz u ndjenë të çliruar nga barra e trupit dhe mund të ngriheshin në ajër me lehtësi dhe me një ndjenjë mrekullie; ata gjithashtu mund të shihnin dhe trupat e tyre. Disa njerëz mundën të shihnin gjithashtu dhe jetë në dimensione të tjera dhe disa të tjerë shkuan në vende të ndryshme. Të gjithë përmendën një ndjenjë lehtësimi në atë moment dhe një lloj gëzimi në nën-ndërgjegje pa ndonjë ndjenjë vuajtjeje. Kjo sugjeron se me këtë trup fizik njeriu, personi do të vuajë, por ngaqë të gjithë dalin nga nëna në këtë mënyrë, askush nuk e din se kjo është vuajtje.

Unë e thashë më parë se personi duhet të kalojë vështirësinë e vështirësive. Dje thashë se koncepti i hapësirë-kohës së njerëzimit është i ndryshëm nga ai i një hapësirë-kohe tjetër më të madhe. Këtu, një shichen është dy orë, që është një vit në atë hapësirë. Nëqoftëse një person praktikon kultivim në kushte të tilla të ashpra, ai do të quhej me të vërtetë i jashtëzakonshëm. Kur këtij personi i lind në zemër Tao dhe dëshiron të praktikojë kultivim, ai është thjesht i madh. Me vështirësi të tilla, ai akoma nuk e ka humbur natyrën e tij origjinale dhe dëshiron të kthehet ne origjinë nëpërmjet praktikës kultivuese. Pse mund të ndihmohen praktikuesit pa rezerva? Është pikërisht për këtë arsye. Kur ky person ulet në meditim për një natë rresht në këtë dimension, me ta parë këtë, ata do të thonë se ai është me të vërtetë i jashtëzakonshëm sepse kjo do të thotë atje që ai ka ndenjur ulur për gjashtë vjet. Kjo ndodh ngaqë një shichen e joni është një vit atje. Dimensioni i njerëzimit është jashtëzakonisht i veçantë.

Si i duron një person vështirësitë e vështirësive? Për shembull, një ditë personi shkon në punë dhe vendi i punës nuk po shkon mirë. Situata nuk mund të vazhdojë sepse njerëzit nuk po bëjnë punën. Ndërmarrja do të riorganizohet dhe do të përdorë punëtorë me kontratë. Personeli i tepërt do të hiqet nga puna dhe ky person është një nga ata të cilëve i hiqet buka e gojës papritur. Si do ndjehet ai? Nuk ka vende të tjera pune. Si mund ta sigurojë ai jetesën? Ai nuk ka aftësi të tjera kështu ai shkon në shtëpi i mërzitur. Sapo ai arrin në shtëpi, gjen prindin e moshuar të sëmurë në shtëpi dhe në kushte serioze. I shqetësuar, ai do të nxitojë ta shpjerë prindin në spital. Ai heq gjithë ato vështirësi e merr para borxh për shtrimin në spital. Ai do kthehet pastaj në shtëpi që të pregatisë ushqim për prindin. Sapo kthehet në shtëpi, një mësues do vijë e trokasë në derë: "Fëmija juaj ka dëmtuar dikë në përleshje e sipër dhe duhet të vish menjëherë ta shohësh vetë. "Pasi ai merret me këtë situatë dhe kthehet në shtëpi, sapo ulet, i thonë në një telefonatë: "Bashkëshortja jote po e dredh me njërin. "Sigurisht, ju nuk do të hasni në të njejtin skenar. Një person i zakonshëm nuk mund ta durojë vuajtjen nga këto probleme dhe do të mendojë: "Për çfarë jetoj unë? Pse nuk marr një litar e të var veten e ti jap fund të gjithave?"E kam fjalën se personi duhet të jetë i aftë të vuajë vuajtjen e vuajtjeve. Sigurisht, ato nuk është e thënë të jenë njëlloj me këto. Megjithatë konfliktet midis njerëzve, përplasjet që kalisin karakterin tënd dhe konkurenca për përfitim personal nuk janë më të lehta se këto. Shumë njerëz vetëm jetojnë për të provuar se kanë të drejtë apo për të mos u turpëruar dhe do e varnin veten kur nuk ja dalin dot më gjërave. Kështu ne duhet të praktikojmë kultivim në këtë ambjent kompleks dhe të jemi të aftë të durojmë vështirësinë më të madhe. Ndërkohë, ne duhet të kemi një zemër me durim të madh.

Çfarë është një ***"zemër me durim të madh"***? Si praktikues, gjëja e parë që ju duhet të bëni është të mos luftoni mbrapsht kur ju godasin apo shajnë—ju duhet të jeni tolerant. Përndryshe çfarë lloj praktikuesi jeni ju? Dikush thotë: "Është shumë e vështirë të jesh tolerant dhe unë kam një temperament të keq. "Nëqoftëse temperamenti juaj nuk është i mirë, ju duhet ta ndryshoni atë, sepse një praktikues duhet të jetë tolerant. Disa njerëz e humbin gjakftohtësinë kur disiplinojnë fëmijët dhe i ulërijnë atyre duke krijuar një skenë të keqe. Ju nuk duhet të jeni ashtu në disiplinimin e fëmijëve dhe as nuk duhet që ju vetë të mërziteni me të vërtetë. Ju duhet t'i edukoni fëmijët me arsye kështu që t'i mësoni ata të sillen mirë. Nëqoftëse ju nuk kaloni as dhe një gjë kaq të vogël dhe e humbni gjakftohtësinë kaq shpejt, si doni që të rrisni gongun tuaj pastaj? Dikush thotë: "Nëqoftëse dikush më bie me shkelm ndërsa po kaloj në rrugë e askush rreth e rrotull nuk më njeh, unë mund ta duroj atë. "Unë them se kjo nuk është e mjaftueshme. Mbase në të ardhmen ty mund të të bien me shuplakë në futyrë dhe ti do turpërohesh para dikujt që ti nuk do të deshe kurrë ta

shihte këtë. Kjo ndodh që të shohim si do ta trajtosh këtë situatë dhe nëse mund ta durosh atë. Nëqoftëse ti mund ta durosh por prapseprap të mbetet mëndja aty, kjo nuk është e mjaftueshme. Siç e dini, kur një person arrin nivelin e Arhatit, ai nuk ka asnjë shqetësim në zemër. Ai nuk shqetësohet aspak për problemet njerëzore dhe gjithmonë është i qeshur dhe në humor. Pamvarësisht sa humbje pëson, ai përsëri do të jetë i buzëqeshur dhe me humor pa asnjë shqetësim. Nëqoftëse ju mund ta bëni me te vërtetë këtë, ju keni arritur nivelin e hyrjes të Shkallës së Arritjes së Arhatit.

Disa njerëz thonë, "Po të praktikohej toleranca deri në këtë shkallë, njerëzit e zakonshëm do të thonin se ne jemi frikacakë dhe mund të merremi nëpër këmbë me lehtësi. "Unë nuk e quaj këtë të jesh frikacak. Mendojeni pak: Edhe në mes të njerëzve të zakonshëm të moshave të thyera e atyre me arsim të lartë ushtrohet vetpërmbajtje dhe kufizim në zënkat me të tjerët, jo pastaj të flasim për praktikuesit tanë. Si mund të merret kjo se je frikacak? Unë them se është reflektim i një durimi të madh dhe një shprehje vullneti të fortë. Vetëm një praktikues mund të ketë një zemër të tillë durimi të madh. Ekziston kjo thënie, "Kur një njeri mesatar turpërohet, ai do nxjerrë shpatën të luftojë. "Për një njeri të zakonshëm, është vetëm e natyrshme që nëqoftëse ti më shan mua, unë të shaj ty dhe po më godite mua unë të godas ty. Ky është një njeri i zakonshëm. A mund të quhet ai praktikues? Si praktikues, pa vullnet të fortë dhe pa vetkontroll, ju nuk do jeni në gjendje të veproni si duhet.

Ju e dini që në kohë të lashta ishte një njeri i quajtur Han Xin, [120] i cili thuhej se ishte shumë i aftë si gjeneral i lartë për Liu Bang[121] dhe mbështetje për vendin. Pse i pati ai gjithë ato arritje? Thuhet se Han Xin ishte një njeri i rrallë që në moshë të re. Është një histori për Han Xin ku thuhet se ai duroi përuljen e zvarritjes në mes të këmbëve të dikujt. Han Xin-it i pëlqente të praktikonte artet marciale kur ish i ri dhe një ushtrues i artit marcial zakonisht mbante shpatë. Një ditë ndërsa po ecte në rrugë, një rrufian i bllokoi rrugën me duart në mes: "Për çfarë e mban atë shpatë? A ta mban të vrasësh njeri? Po ta mbajti, prite kokën time. "E ndërsa thonte këtë, ai zgjati kokën. Han Xin mendoi: "Pse të ta pres kokën?"Në atë kohë të vrisje dikë raportohej tek qeveria dhe personit do i duhej ta paguante jetën e marrë. Si mund të vriste njeriu tjetrin kur t'i tekej? Kur rrufiani pa që Han Xin nuk guxonte ta vriste, ai tha: "Po nuk ta mbajti të më vrasësh, do të të duhet të zvarritesh në mes të këmbëve të mia. "Han Xin me të vërtetë u zvarrit në mes të këmbëve të tij. Kjo tregon se Han Xin kishte një zemër me durim të madh. Meqenëse ishte i ndryshëm nga njerëzit e zakonshëm, ai mundi të realizonte gjithë ato arritje. Është motoja e një njeriu të zakonshëm që njeriu duhet të jetojë për të provuar se ka të drejtë apo për të mos u turpëruar. Pa mendojeni pak: Të jetosh për të provuar se ke të drejtë apo për të mos u turpëruar—a nuk është e lodhshme kjo? A

nuk është e dhimbshme? A ja vlen? Megjithatë Han Xin ishte një njeri i zakonshëm. Si praktikues, ne duhet të jemi shumë më lart se ai. Qëllimi ynë është të dalim mbi nivelin e njerëzve të zakonshëm dhe të çajmë përpara drejt niveleve të larta. Ne nuk do të biem në një situatë të ngjashme. Megjithatë përulja dhe turpi që një praktikues duron në mes të njerëzve nuk është e thënë të jenë më të lehta se ajo. Unë do të thoja se grindja në mes njerit tjetrit që kalit karakterin tuaj nuk është më e lehtë sesa ajo dhe madje mund të jetë më e vështirë—është me të vërtetë e zorshme.

Ndërkohë, një praktikues duhet gjithashtu të bëjë sakrifica, të braktisë përndjekjet e ndryshme dhe dëshirat e njerëzve të zakonshëm. Është e pamundur të jesh i aftë ta arrish këtë menjëherë, kështu ne e arrijmë këtë gradualisht. Po ta arrije ta bëje këtë sot, ju do ishit tani një Buddhë. Praktika kultivuese merr kohë, por ju nuk duhet të dembeloseni. Ju mund të thoni: "Mësuesi ka thënë se praktika kultivuese merr kohë—le ta marrim shtruar. "Kjo nuk bën! Ju duhet të jeni i rreptë me veten. Në kultivimin e Ligjit të Buddhës, ju duhet të çani përpara me këmbëngulje.

Ju duhet gjithashtu të jeni të aftë të ruani virtytin, të mbani lart karakterin tuaj, dhe të mos bëni gjë sipas dëshirës. Ju nuk duhet që të bëni çfarë të doni dhe duhet të jeni të aftë të ruani karakterin tuaj. Tek njerëzit e zakonshëm, dëgjohet shpesh kjo thënie: "Të kryesh vepra të mira grumbullon virtyt. "Një praktikues nuk praktikon të grumbullojë virtyt, sepse ne besojmë në ruajtjen e virtytit. Pse besojmë ne në ruajtjen e virtytit? Sepse kemi konstatuar këtë situatë: Të grumbullosh virtyt është besimi i njerëzve të zakonshëm sepse ata duan të grumbullojnë virtyt dhe të kryejnë vepra të mira kështu që ata mund të jetojnë mirë në jetën tjetër. Por ne nuk e kemi këtë problem. Nëqoftëse ju arrini sukses në praktikën kultivuese, ju do keni arritur Taon dhe nuk do të keni problemin e jetës tjetër. Kur ne flasim këtu për ruajtjen e virtytit, ka dhe një nuancë tjetër kuptimi. Dhe pikërisht, këto dy substanca që mban trupi jonë nuk janë grumbulluar në një jetë—ato janë trashëguar nga një periudhë e hershme. Edhe sikur t'i binit qytetit kryq e tërthor me biçikletë, ju mund të mos hasnit asnjë vepër të mirë për të bërë. Edhe sikur ta praktikonit një gjë të tillë çdo ditë, ju mund të mos hasnit në mundësira të tilla.

Kjo përmban akoma dhe një nuancë tjetër kuptimi: Duke u përpjekur për të grumbulluar virtyt, ti mund të mendosh se diçka është vepër e mirë, por po ta bësh, mund të dalë që është e gabuar. Po të ndërhysh në diçka që ti e konsideron si diçka të keqe, ajo mund të dalë se ishte gjë e mirë. Pse? Sepse ju nuk mund të shikoni lidhjen karmike. Ligjet rregullojnë punët e njerëzve të zakonshëm, e kjo nuk paraqet ndonjë problem. Por të jesh praktikues do të thotë të jesh mbinjerëzor, kështu si njeri mbinjerëzor, ju duhet të silleni sipas parimeve mbinjerëzore në vend që ta masni veten me standartet e njerëzve të zakonshëm. Nëqoftëse ju nuk e dini lidhjen karmike të një gjëje, ka shumë mundësi që ju ta trajtoni atë në mënyrë jo

korrekte. Prandaj, ne mësojmë wuwei dhe ju nuk duhet të bëni diçka vetëm sepse keni dëshirën ta bëni. Disa njerëz thonë: "Unë dua vetëm të disiplinoj njerëzit e këqinj. "Do të thoja se ju më mirë bëhuni polic. Por ne nuk ju kërkojmë juve të qëndroni jashtë gjërave kur ju hasni ndonjë vrasje apo vënie zjarri. Po ju them të gjithëve se kur ndodh ndonjë konflikt midis personave apo kur dikush shkelmon apo godet dikë tjetër, ka shumë mundësi që këta njerëz ia kishin borxh njeri tjetrit në të kaluarën dhe po lajnë një borxh. Po të ndërhyni që ta ndaloni, ata nuk do të kenë mundësi ta lajnë borxhin dhe duhet të presin për një rast tjetër. Kjo do të thotë se nëqoftëse ju nuk mund të shikoni lidhjen karmike, ju mund të kryeni vepra të këqija me lehtësi dhe të humbisni virtyt si pasojë.

Nuk ka rëndësi nëse një person i zakonshëm ndërhyn në punët e njerëzve të zakonshëm, sepse ai apo ajo do të zbatojë parimet e njerëzve të zakonshëm për ta zgjidhur situatën. Ju duhet të përdorni parimet e larta për të gjykuar gjërat. Është çështje karakteri nëse ju nuk ndihmoni të ndaloni një vrasje apo zjarr me qëllim kur i shihni ato. Përndryshe si do të demostronit se ju jeni një njeri i mirë? Po të mos ndihmonit të ndalonit nje vrasje apo vënie zjarri, në çfarë gjëje tjetër do të ndërhynit ju? Megjithatë duhet theksuar një pikë: Këto gjëra me të vërtetë nuk do të kenë të bëjnë me praktikuesit tanë. Ato mund të mos jenë planifikuar që t'i hasni ju. Ne kemi thënë se ruajtja e virtytit e bën dikë të evitojë bërjen e gabimeve. Mbase nëqoftëse ti bën diçka, ti mund të kryesh një vepër të keqe dhe atëhere do të humbasësh virtyt. Me të humbur virtyt, si mund ta rrisësh ti nivelin tënd pastaj? Si mund të arrish qëllimin tënd përfundimtar? Kjo ka lidhje me këto çështje. Po ashtu, ti duhet të kesh dhe cilësi të mirë ndriçimi shpirtëror. Cilësia shpirtërore e mirë e lindur mund ta bëjë dikë që të ketë ndriçim të mirë shpirtëror. Ndikimi i ambjentit gjithashtu mund të ketë një lloj ndikimi.

Ne gjithashtu kemi thënë se nëse të gjithë ne kultivojmë veten tonë të brendshme, ekzaminojmë karakterin tonë për të parë për shkaqet e gabimit në mënyrë që të veprojmë më mirë herën tjetër dhe të marrin në konsideratë të tjerët para se të bëjmë ndonjë veprim, shoqëria njerëzore do të bëhej më e mirë dhe standartet e saj etike do të ngriheshin përsëri. Qytetërimi shpirtëror (term popullor ne Kinën e kohës së sotme që do të thotë lartësim i mendjes së njerëzve dhe moralit. Në Kinë, ky term përdoret si kontrast ndaj "qytetërimit material") do të përmirësohej dhe po ashtu dhe sigurimi publik. Mbase nuk do të kishte polici. Askush nuk do të kishte nevojë që të qeverisej sepse të gjithë do të disiplinonin veten dhe do ta kërkonin arsyen brenda vetes. A nuk do thonit ju që kjo do të ishte e hatashme? Ju e dini se ligjet janë bërë më përmbledhëse e më të perfeksionuara. Megjithatë pse ka njerëz që akoma kryejnë vepra të këqija? Pse nuk zbatojnë ata ligjet? Sepse ju nuk mund të qeverisni zemrat e tyre. Kur nuk i sheh njeri, ata përsëri do të kryejnë vepra të këqija. Nëqoftëse

dikush kultivon veten e vet të brendshme, do të jetë plotësisht ndryshe. Nuk do kishte nevojë për askënd që të siguronte drejtësi.

Ky Ligj mund të jepet vetëm deri në këtë nivel. Varet nga kultivimi juaj që të merrni ato që janë në nivele të larta. Pyetjet e bëra nga disa persona janë bërë më specifike. Nëqoftëse unë ju shpjegoj të gjitha pyetjet në jetën tuaj, çfarë do të mbetet që të kultivohet nga ju? Ju duhet të praktikoni kultivim dhe të lartësoheni shpirtërisht vetë. Po t'ju tregoj çdo gjë, nuk mbetet asgjë për t'u kuptuar gjatë kultivimit tuaj. Për fat të mirë, Dafa është bërë tashmë publike dhe ju mund t'i bëni gjërat në përputhje me Dafën.

V - ASTROLOGJIA

1. Astrologjia – E thellë si gjumi, e bukur si ëndrrat

Parashikimi i së ardhmes është gjuhë më vete. Cilido qoftë dialekti që përdoret – sfera e kristalt, gjeomancia, tiparet e fytyrës, numrat e shenjtë – kjo gjuhë, gjuha e arketipave dhe simboleve, ofron një lloj komunikimi jashtëzakonisht krijues, me kushte që të mbetesh i hapur, do me thënë, i prirur për të pranuar të panjohurën, të papriturën, mahnitjen që të shkaktojnë ato.

Njësoj si racionalja, edhe joracionalja ka përkthyesit e vet të cilët e shndërrojnë mesazhin, metaforën vizionare, me fjalë të kuptueshme, në një lloj fletëpalosjeje të kapshme nga të gjithë. Bëhet fjalë po aq për një lloj folklori fillestar, një lloj nervopze ndaj okultes, sa edhe për një lloj bestytnie shkencore. Arratia, gjetja e një strehe, shpërblimi, parashikimi i fatit, të gjitha këto kanë iluzionistët e vet dhe panairet e veta. Edhe muzika, sado e lartë qoftë, i ruan disa lëvizje e tinguj nga vallet e lashta popullore: për këtë arsye Mozarti dhe Bahu nuk ka se si të mos quhen realë. A ka ndonjë fushë në të cilën të mos jetë i nevojshëm talenti?

Në fakt, qasja parashikuese apo fatthënëse është një sfidë e vazhdueshme ndaj prirjes sonë fosilizuese. Rëndësia nuk qëndron te sasia e informacioneve që të ofron, por te fakti që të hap një portë, të lejon të kërcesh "përtej"konkretes, të njeh me një gjë tjetër e cila nuk mund të përshkruhet sipas normave të mendimit logjik.

Shkenca sot pohon se nuk mund ta ndajë vëzhguesin nga dukuria e vëzhguar. Kjo na bën ta shohim botën si një projektim të stërmadh, si lojën fantazmagorike të një "uni"thelbësor, të një realiteti që i shpëton gati çdo lloj përkufizimi.

Çdo lloj njohurie quhet atëherë si ndonjë shëtitje, pak a shumë e organizuar mirë, brenda këtij "uni", mes peisazheve që duken krejt të ndryshme, në varësi të mjetit që zgjedh për të lëvizur, në varësi të shpejtësisë dhe itinerarit të zgjedhur. E thënë ndryshe, të gjitha botët bashkëjetojnë ndërsa secili duhet ta zgjedhë vetë makinën për të eksploruar misterin.

Artet parashikuese janë prototipa të një mënyre veprimi që duket si pa lidhje, por fusha e eksplorimit të tyre është e thellë si gjumi dhe e bukur si ëndrrat.

2. Origjina e Astrologjisë

Njerëzit e parë mbi tokë të quajtur ***homosapiens*** kishin frikë nga të gjitha fenomenet natyrore që shikonin. Në në vërtetë, shtërngatat, stuhitë, vetëtimat, tërmetet, vullkanet, eklipset, Dielli, Hëna, yjet, kometat etj. ishin

dukuri që ata nuk i kuptonin. Këto dukuri (fenomene) që ata nuk kuptonin dhe që nuk dinin se si t'i kontrollonin (mposhtnin) u kthyen në forca të mbinatyrshme, në perëndi. Qielli që për ata ishte i paarritshëm, ishte vendbanimi i zotave. Pra, që prej mijëra vitesh, njerëzit kanë vëzhguar qiellin për të kuptuar mesazhet e perëndive (zotave).

Dokumentat më të lashta që njihen deri sot e kanë burimin nga Mesopotamia rreth 3. 800 vjet pr. e. s. Janë gjetur tabela të pozicioneve planetare nga Egjipti i lashtë që janë shumë të vjetra dhe që mund të datojnë pak a shumë në të njëjtën epokë si tabletat e argjilit të Mesopotamisë. Sfinksi lidhet (përshtatet) me lindjen e Diellit në yllësinë e Luanit dhe ndoshta nuk ka qënë ndërtuar nga egjiptianët, por vetëm i rimodeluar prej tyre, mendohet që Sfinksi ka një moshë 12 000 vjeçare. Nëse kjo datë është e saktë astrologjia është akoma më e vjetër nga sa mendohet. Piramida e Keopsit është orientuar drejt njëfarë kulmi të Siriusit dhe disa kulmeve të yjeve të mëdhenj të Orionit. Gjithashtu mund të shohim simbole astrologjike te varri i faraonit Ramsesi II (1304- 1234 pr. e. s).

Në Europë, gjejmë gjurmë të astrologjisë në Angli "Stonehenge"dhe në Francë "Carnac"(2000 pr. e. s). Në shekullin e tretë pr. e. s në Kinë, astrologët këshillonin perandorin sipas cikleve hënore. Gjejmë gjithashtu gjurmë të astrologjisë në civilizimet parakolombiane pikërisht tek aztekët, në Indi, në Kinë etj.

3. Historia e Astrologjisë

Astrologjia perëndimore ka lindur në Mesopotami (Babiloni), pikerisht në Irakun e sotëm, rreth 3000 vjet para Krishtit (5000 vjet më parë) dhe është trashëguar deri në ditët e sotme nga grekët dhe romakët. Natyrisht, që njerëzit parahistorikë janë ndër më të parët që i vëzhgonin këto fenomene natyrore. Njerëzit e parë duke vështruar qiellin, plot kuriozitet, e llogarisnin kohën me anë të Diellit dhe Hënës kur ende nuk ishin shpikur kalendarët. Përveç Hënës dhe Diellit, planetet që shikoheshin me sy të lirë ishin Venusi (Afërdita), Marsi dhe Jupiteri, të cilët janë më afër Tokës. Dhe me anë të vëzhgimeve të këtyre planetëve njerëzit e parë vunë re se këta trupa qiellorë ndikojnë fuqishëm në Tokë. Vetë Dielli, i pari, ka ndikimin kryesor, pasi pa Diellin nuk ka jetë, gjallëria do të ishte e pamundur. Bimët nuk do të rriteshin, akujt nuk do të shkrinin për të formuar ujin e jetës... Po ashtu dhe Hëna ndikon shumë në Tokë. Ajo, jo vetëm që na furnizon me dritën e pasqyruar prej Diellit për të ecur natën, por ndikon edhe në lumenjtë dhe detet: si baticat dhe zbaticat, peshkimi dhe ciklet e grave. Njësoj si Hëna, edhe Venusi kur kishte një shkëlqim të veçantë ushtronte ndikimin e tij duke i bërë njerëzit më të lumtur dhe të dukeshin më romantikë e të qetë. Ndërsa kur planeti i kuq, Marsi, (që dukej i egër dhe

luftarak) ndriçonte më qiell, atëherë njerëzit parahistorikë vunë re se në Tokë mbizotëronte dhuna, lufta, gjaku (i kuq si Marsi) dhe egërsia. Pra kështu njerëzit e parë filluan të krijonin imazhe që lidheshin me astrologjinë parahistorike.

"Dokumenti"më i rëndësishëm i kohës antike, (i ruajtur deri sot) është shkruar rreth 900 vjet para Krishtit në Mesopotami. Ai përbëhet nga 70 tableta, pllaka të shkruara (dërrase) dhe titullohet: "***Enuma Anu Emil***". Nga Mesopotamia (Babilonia e lashtë), kjo astronomi-astrologji u përhap në Greqi pas pushtimit të Aleksandrit të Madh. Më vonë u përhap në të gjithë perandorinë greke të atëhershme, Indi, Egjipt, në Romën e lashtë si dhe në Persi, Kinë e Arabi. Gjithnjë duke u bërë më e strukturuar, më pak fetare dhe më shumë popullore. Ndarja e qiellit në 12 shenja zodiakale dhe horoskopët e parë të njohur datojnë në vitin 410 para Krishtit. Ku shenjat u ndanë me nga 30 gradë secila dhe kështu janë formuar tabelat planetare dhe është vendosur llogaritja hënore. Astrologët babilonas ishin të parët që kanë dalluar planetet lëvizës dhe të cilët kanë dëshmuar ndikimin e planetëve mbi njerëzit. Më pas grekët dhe romakët e zhvilluan astrologjinë deri në pafundësi. Gjatë shekullit të XIII (13-të) astrologjia favorizohej nga vetë papa, princat apo sovranët e asaj kohe. Në Francë, Katerina De Mediçi e mbrojti dhe e nxiti astrologjinë, duke mbledhur rreth saj astrologë, ku ndër më të famshmit mbetet Nostradamusi. Në shkollën e mjekësisë në Bolonja, që ishte ndër me të famshmet në Europë, qarkullonte thënia: "*Një mjek pa astrologji është si njeriu pa njërin sy.*

Astrologjia gjatë shekujve, ka kaluar periudha kulmore dhe rënieje. Ajo vjen në fuqi midis vitit 30 para Krishtit dhe 100 pas Krishtit... për të tejkaluar të gjitha besimet e tjera. Në shekullin e II dhe të V astrologët viheshin shpesh në krye të shoqërisë. Në 533, shpallej edhe dënim me vdekje për ata që ishin kundër matematicienëve (që në fakt ishin astrologët). Koha e artë e astrologjisë ishte nga viti 1450 deri në 1650. U botuan (publikuan) në këtë periudhë shumë libra dhe almanakë astrologjikë.

Në vitin 1666, meqë u krijua akademia e shkencave, astrologjia u përjashtua nga disiplinat e tjera, duke ndaluar kështu astrologët të praktikonin astrologjinë. Ishte Isak Njutoni ai që ndau përfundimisht astronominë me astrologjinë. Kjo ndodhi edhe për vetë faktin se astrologjia e ka bazën e saj nga pikëpamja gjeocetrike. Astrologjia u kthye në tabu dhe në vitin 1850, u konsiderua si një supersticion i së kaluarës. Astrologjia Qëndroi në hije pothuajse gjatë dy shekujve, duke u ndaluar rreptësisht nga kisha (e cila e ndalon edhe sot). Në vitin 1896 Alan Leo themeloi revistën e parë shkencore të astrologjisë me titull: "***Astrologjia moderne***". Në vitin 1936 u shfaq në Amerikë një revistë javore me horoskopin e 12 shenjave. Në vitin 1938 u krijua federata e astrologëve amerikanë. Ndërsa në Francë, më 1946, u themelua Qendra Ndërkombëtare e Astrologjisë. Që

nga ajo kohë astrologjia vazhdon të zhvillohet dhe të pasurohet falë shumë kërkimeve dhe zbulimeve të reja në këtë fushë.

Pra, nga antikiteti deri në shekullin e XVIII, astrologjia konsiderohej si një shkencë dhe nuk bënte dallim me astronominë.

***

Nga të gjitha astrologjitë e lashta, ajo që i ngjan më shumë astrologjisë sonë perëndimore është ajo e bërë nga priftërinjtë në Mesopotami. Mund të gjeni dokumentacione mbi këtë vend në këtë epokë në librin e Georges Roux "La Mésopotamie édition Le Seuil, Paris, 1985". Priftërinjtë përshkruanin të gjitha vëzhgimet e qiellit, yjet fikse dhe planetët e dukshëm të cilët konsideroheshin si yje endacakë. Të gjitha këto vëzhgime janë shkruar në tableta prej argjili. Mbi disa nga këto tableta, gjejmë lëvizjet e Diellit dhe të Hënës me një saktësi të mahnitshme. Janë gjetur katalogje yjesh që datojnë më shumë se 2000 vjet pr. e. s. Në Elba, është gjetur një mbishkrim që daton që prej 2400 vjet pr. e. s. që flet për Plejadat.

Në këtë epokë mendohej që Toka ishte qendra e gjithçkaje dhe që të gjithë trupat qiellorë sillen rreth saj. Yjet silleshin përreth Tokës por qëndronin të fiksuar në një drejtim përveç 5 trupave qiellorë që dukeshin sikur lëviznin përpara apo ktheheshin mbrapa por gjithmonë në të njëjtën trajektore (rrugë). Këta 5 trupa qiellorë që konsideroheshin si yje endacakë nuk ishin tjetër veçse pesë planetët që shiheshin me sy të lirë, Merkuri, Venusi, Marsi, Jupiteri dhe Saturni.

Në Mesopotami, astrologjia praktikohej nga priftërinjtë të cilët vëzhgonin qiellin për të kuptuar mesazhet e perëndive në mënyrë që të mbronin familjen mbretërore dhe vendin. Këta zota nuk premtojnë shpëtimin, parajsën, merren me jetën në tokë dhe me situatat aktuale, marrëdhëniet me fatin, raportet me forcat e natyrës. Mesopotamët nuk kanë besuar kurrë që yjet (planetët) duke qënë të tillë mund të ushtronin një ndikim mbi jetën njerëzore. Forcat e natyrës qeverisen nga perënditë dhe perënditë janë planetët. Për mesopotamët qielli ishte tregues i vullnetit hyjnor. Shembuj të teksit të gjetur: Nëse Venusi shfaqet në Lindje në muajin Airu dhe nëse Binjakët e Mëdhenj dhe të Vegjël e rrethojnë të katërt, dhe nëse është i zymtë, atëherë mbreti i Elamit do të bjerë i sëmurë dhe do të vdesë. Ja eklipsi i Diellit, vendi i princit do të shkatërrohet dhe do të bëhet gjëma, mbreti do të vdesë, perënditë do të zemërohen, gratë shtatëzëna do ta humbasin fëmijën e tyre, do të ketë tornado shkatërrues, prindërit do të shesin fëmijët e tyre për parà.

Nëse Venusi ndodhet nga lindja e Diellit në zonën e Virgjëreshës, domethënia e tij është po njësoj si te Peshqit kur afrohen me yllin në veprim, korrjet do të jenë me bollëk dhe bagëtitë do të rrinë nëpër fusha.

Kur Merkuri bën retrogradë në qiell, apo nëse Merkuri është përkrah Marsit, do të shtohen hajdutët në vend.

Kur priftërinjtë astrologë shikonin në qiell shenja të këqija (për shembull një eklips), ata krijonin figura të mbinatyrshme dhe rituale, bënin sakrifica për të pasur përkrahjen e zotave. Nëse kishte rrezik për mbretin, ata bënin sakrifica zëvendësimi. Dikush do të trajtohej si mbret gjatë një periudhe kohe (maksimumi 100 ditë), pastaj ai do të flijohej. Gjatë kësaj kohe, mbreti do të quhej 'kultivues'. Pas kësaj sacrifice mbreti merrte përsëri vendin e tij. Kështu ata çliroheshin nga eklipsi (shpirti i keq).

Në Mesopotaminë e lashtë, është vënë re që pothuajse e gjithë simbolika e planetëve është tashmë aty, megjithëse me ndryshime të mëdha. Hëna ka më shumë rëndësi se Dielli, e quanin frut që ha vetveten, është ylli i kohës, është sidomos raporti i saj me rritjen dhe me bimësinë që vihet më shumë në dukje. Dielli konsiderohej gjykatës i qiellit dhe i tokës, është e kundërta e vdekjes, armiku i errësirës. Ai që mbretëron në mitologjinë babilonase, është Venusi (Ishtar). Venusi perëndesha e pjellorisë, por dhe perëndeshë luftëtare, është një planet i rëndësishëm në astrologji. Ka njëfarë fuqie, njëfarë dhune. Kjo na tregon që me kohën, çdo kulturë ka futur brenda vetes elementë të simbolizmit të astrologjisë. Gjëja më misterioze në rrafshin e teorisë së astrologjisë përsa i përket Mesopotamisë së lashtë, është teoria e ngritjeve (planetët në ngritje). Kjo teori e ngritjeve ka kaluar në çdo epokë dhe në Mesjetë, derisa thuhej që Saturni në ngritje te Peshorja ishte më i fortë se Venusi në shtëpinë e tij në Peshore. Kjo teoria e ngritjeve ka mbetur shumë e rëndësishme.

1000 vjet pr. e. s. - Datë e përafërt me teksin e Mul-Apinit me hartën e 66 yllësive të shpërndara në 3 udhët paralele me ekuatorin. Çdo grup (konfigurim) është konsideruar si rruga e një perëndie që hyn nga portat e vendosura në horizont.

Teksti i Mul-Apinit tregon shumë gjëra:

1. Datën e ngritjeve heliake;
2. Lindjen, kalimin në zenit dhe perëndimin e yjeve;
3. Përshkrimin e udhës së Hënës;
4. Të dhëna mbi planetët;
5. Si të përshtasim vitet hënore me vitet diellore?
6. Një tabelë që jep ndryshimet e orës (hijes diellore) gjatë gjithë vitit;
7. Udhëzime për të përdorur një sahat prej uji;
8. Një listë e ogurëve (shenjave).

Ky tekst na flet për 18 yjësi në të cilat gjejmë tashmë edhe shenjat e zodiakut:

1. Argati (Dashi) 2. Yjet (Plejadat)
3. Demi i qiellit (Demi)
4. Bariu besnik i Anusë (Orioni)
5. Plaku (Perseu)

6. Shkopi i thyer (Karrocieri)
7. Binjakët e mëdhenj (Binjakët)
8. Gaforrja
9. Luani
10. Kalliri i elbit (Virgjëresha)
11. Peshorja
12. Akrepi
13. Pabilsagu (Shigjetari)
14. Dhia-peshk (Bricjapi)
15. Gjiganti (Ujori)
16. Bishtat (Peshqit)
17. Dallëndyshja (Peshqit Jug-perëndimor)
18. Anunitu (Peshqit Veri-lindor)

900 vjet pr. e. s -Datë e përafërt me shumë rëndësi për listën e ogurëve. Përbëhet nga 70 tableta të gdhëndura që mbledhin 7000 ogure të grumbulluara që prej mijëvjeçarit të dytë. Gjatë shekujve që ndiqnin babilonasit sipas listave (të ngjarjeve të vërtetuara më parë) dhe cikleve planetare arriten të parashikonin pozicionin e një planeti në të ardhmen. Janë gjetur tabela të lëvizjeve planetare (efemeridet) që kaldeasit kishin formuar nën mbretërimin e mbretit Asurbanipal të Asirisë në shekullin VII pr. e. s. Babilonasit ishin të parët që e ndanë vitin duke ndjekur 12 shenjat e zodiakut. Ky zodiak është formuar sipas pozicionit të yjeve, pra është një zodiak sideral. Në atë epokë shënohej çdo gjë që ndodhte në qiell më shumë sesa shikoheshin fenomenet e rralla. Van Der Waerden e përcakton këtë epokë ndërmjet 630 dhe 450 pr. e. s.

570- 490 pr. e. s. - Pitagora, filozof dhe matematicien grek, i lindur në ishullin e Samosit, u stërvit (arsimua) në moshën 20 vjeçare në Egjipt, kaloi gjithashtu shumë kohë në Kretë, thuhet që ai ka takuar druidë, jogis, që ka shkuar në Lindjen e Mesme dhe në Krotonë (koloni greke në Italinë e Jugut) dhe ka themeluar shkollën filozofike nën emrin e pitagorizmit. Pitagoristët thonin që lëvizja e sferave është burimi i një tingulli muzikor, "harmonia e sferave". Kjo ide do të përshtatej dhe do të përshkonte astrologjinë.

420 pr. e. s -Data e temave më të vjetra individuale të gjetura në Kaldé. Kemi parë që këto fillime të astrologjisë lidheshin me punët e shtetit dhe ngjarjet e mëdha të vendit (thatësirat, përmbytjet, luftrat, etj). pas vendosjes së zodiakut, u shfaq astrologjia e aplikuar për individët. Fëmijëve të porsalindur u bënin përcaktime (ogure) sipas shenjës astrologjike, planetëve dhe yjeve që shfaqeshin në qiell direkt pas lindjes së tij (tashmë dihet që ajo që shfaqej direkt pas lindjes, është në shtëpinë e parë në hartën e lindjes) etj. Në tekstet e vjetra gjenden parashikime që janë bërë nga kaldeasit të cilat rezultojnë jashtëzakonisht të sakta, veçanërisht Aleksandri

fitimtar ndaj Dariusit dhe pastaj mbretërit Antigonos dhe Selekos Nikatori pasardhësit e tij.

428 – 347 pr. e. s Platoni thoshte: forma e përkryer është rrethi dhe sfera. Gjithçka që është frymëzuar sidomos në mënyrë rrethore, ndryshon shpirtin. Trupat qiellorë janë sferik dhe vizatojnë rrathë të rregullt, ata lëvizin duke ndjekur ligjin e rrethit dhe të spheres dhe që ky ligj i harmonisë është i njëjti me atë që përbën shpirtin njerëzor.

Prandaj, shpirtrat dhe yjet janë kushërinj dhe në yje ekzistojnë të njëjtat substanca si tek njeriu. Shpirti jeton me perënditë mbi planin e arketipave, ai jeton mbi sferën e yjeve fikse dhe aty, përkulet mbi botë, ka parë lëndë me ngjyra dhe dhe të larmishme dhe ka dëshiruar të njohë këtë lëndë dhe dëshirën për të angazhuar këtë proces në mishërim. Ka zbritur përmes sferave astrologjike deri mbi planin e elementëve përpara se të marrë një trup mbi tokë. Ekzistojnë dy porta, porta e perëndive dhe porta e njerëzve. Kur shpirti u josh nga lënda ai braktisi sferën e yjve fikse, u fut nga porta e Gaforres e cila është porta e njerëzve dhe rrëshqet mbi zodiak, pi me gotën e Dionisit dhe aty, humbet kujtimin e kushteve të tij hyjnore dhe kalon në sfera të ndryshme planetare deri në botën e mishërimit.

1. Nga Saturn, merr arsyetimin, inteligjencën dhe aftësitë soditëse.
2. Nga Jupiteri, merr forcën e veprimit.
3. Nga Marsi, merr iniciativën, guximin dhe afshin.
4. Nga Dielli, merr vetëdijën, aftësitë që të bëjnë të ndjesh dhe të imagjinosh.
5. Nga Venusi, merr lëvizjen e dëshirave.
6. Nga Merkuri merr aftësinë e të shprehurit, dhe të thotë atë që ndjen.
7. Nga Hëna, merr ngjizjen dhe rritjen e trupit.

Pastaj shpirti arrin në sferën e elementëve, në botën tokësore në të cilën jetojmë dhe aty, ai lind.

Kur astrologu e shikon klientin që do të këshillohet, e shikon si një seri rrobash dhe jo si dikë që identifikohet me problemet dhe komplekset e tij. Ai e shikon si një qënie të gjallë që vjen nga një tjetër nivel (niveli shpirtëror, hyjnor), ai i shikon veshjet e ndryshme astrologjike si mbivendosje të fatit dhe të karakterit të tij, dhe karakteri është fati i tij.

Për astrologët e lashtësisë, raporti me fatalitetin vendoset në një mënyrë krejtësisht ndryshe meqënëse secili është një shpirt hyjnor dhe që shprehjet e personalitetit nuk janë tjetër veçse veshje (rroba), mbulesa trupore.

1. Te Hëna, braktis forcën e rritjes dhe zvogëlimit.
2. Te Merkuri, braktis shpirtligësinë, dinakërinë.
3. Te Venusi, brakits iluzionin e dëshirave.
4. Te Dielli, braktis krekosjen e komandimit dhe idetë ambicioze.

5. Te Marsi, braktis paturpësinë dhe guximin e tepruar.
6. Te Jupiteri, braktis orekset që jep pasuria.
7. Te Saturni, braktis gënjeshtrat që ngrihen nga kurthet.

Tema yjore është një udhë e huazuar nga një ndërgjegje që vjen nga një tjetër plan, që është e pajisur nga funksione të ndryshme dhe që operon mbi planin tokësor përmes këtyre funksioneve. Vetëdija (ndërgjegja) pasi i është nënshtruar fatit të lidhur me këto funksione do të thërritet në një moment të dhënë për të tejkaluar dhe për të rigjetur kushtin e saj të ndërgjegjës së pastër. Harta qiellore është një itinerar (udhë) e asaj që duhet të jetojë mbi planin tokësor dhe vullneti i lirë nuk njihet në këtë botë, përndryshe do të ishte në hartë.

Kjo nuk do të thotë që shpirti nuk është i gjallë, pikërisht është i gjallëruar nga kjo fuqi hyjnore që i mundëson të çlirohet nga të gjitha mbulimet planetare.

Në shekullin e tretë pr. e. s:

Qytetërimi grek u interesua për astrologjinë kaldease dhe e bëri atë të veten. Kaldeasit ua kalojnë grekëve njohuritë e tyre të mëdha në astronomi dhe astrologji. Grekët i japin astrologjisë kaldease llogjikën e tyre racionale, filozofinë e tyre, teorinë e katër elementëve, vendndodhjen dhe shtëpitë.

Një prift astrolog me emrin Barod i dha secilit planet emrin e një perëndie të panteonit grek. Grekët ishin të parët që e përhapën astrologjinë. Ata futen nocionin e studimit të fatit dhe parashikimeve individuale.

280 pr. e. s -Kaldeasit krijuan shkollën e parë të astrologjisë në ishullin e Kosit. Kontributi i qytetërimit grek ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ishte ky i fundit që vendosi bazat kryesore astrologjike që ne përdorim sot. Praktikisht në të njëjtën epokë, kaldeasit vendosen në Aleksandri të Egjiptit e cila në atë periudhë ishte nën sundimin grek. Me sa duket është në Aleksandri që janë bërë më shumë horoskope, gjë që i ka bërë disa historianë të mendojnë që origjina e horoskopeve ishte egjiptiane. Egjiptianët i shikonin shumë yjet, por në Egjiptin e lashtë, nuk gjejmë asnjë gjurmë të zodiakut.

Filozofia ndryshon, perënditë anohen (mbështeten) mbi një individ, dalim nga universi magjik ku perënditë ishin të gjithëpushtetshëm dhe vijmë në fushën e pyetjeve të mëdha:

A ndikohemi nga yjet (planetët)?
A është shumë i fortë ndikimi i yjeve?

Filozofia zhvillohet dhe sipas shkollës së mendimeve, do të kemi përgjigje të ndryshme. Në këtë moment shfaqet një ndarje e cila duket mjaft e rëndësishme, astrologjia ndahet në dy degë.

Një astrologji e parashikimit të së ardhmes e cila mbetet e lidhur me këtë univers magjik të Mesopotamisë dhe të Egjiptit të lashtë. Një astrologji e ndikimit të yjeve.

Simbolizmi i Jupiterit dhe Saturnit në këtë epokë:

Në Greqi, Zeusi (Jupiteri) është një zot i fuqishëm dhe i tmerrshëm, ishte rrufeja. Zeusi ishte i pajisur me një fuqi shkatërrimtare që rrënonte gjithçka. Zeusi është një atlet, është kënaqësia për të jetuar, është fuqia e gëzimit. Jupiteri është një energji që na habit, ky ngjan me Dionisin, forcat primitive të mahnisë. Ai lidhet gjithashtu me shërbimet fetare. *Kronosi (Saturni*) është planeti më i ngritur, sfera e ndërgjegjës më të ngritur (zhvilluar) në raport me dimensionin tokësor. Kur shpirti mishërohet, në fillim kalon nga Saturni. Saturni është forca që ndan njësinë e shpirtit të sferës së yjeve fikse dhe që e detyron të mishërohet duke kaluar nga një seri procesi. Te Saturni ka një dualitet, një ambivalencë të jashtëzakonshme njëkohësisht edhe një forcë deformimi. Është ky që thotë jo, ai është realiteti i ashpër material, ai që ndërpret, dhe njëkohësisht është kalimi i detyrueshëm mbi udhën e pleqërisë. Në Mesopotaminë e lashtë, Saturni është një hero që luftonte kundër fuqive të kaosit për të shpëtuar tabletat e ligjit.

Kaos: në greqisht, është personifikimi i Zbrazëtisë themelore, që ekzistonte përpara krijimit. Tabletat e ligjit i jepnin atij që i zotëronte ato një fuqi (pushtet) mbi fatin. Forca e Saturnit është një fuqi që na pengon të biem në kaos, prandaj është ai që mban rregullin. Është nën ndikimin e monoteizmit që Saturni bëhet satanik.

200 vjet pr. e. s -Datë që përkon me pikturën më të vjetër të zodiakut të gjetur sot. Zodiaku i Esnas.

125 vjet pr. e. s -Astrologu dhe astronomi Hiparku i Nikeas zbulon lëvizjen e ekuinokseve. Ai vuri re që ka një hapësirë kohore (ndryshim) ndërmjet zodiakut sidereal (që lidhet me yjësitë) dhe zodiakut tropikal të bazuar mbi lëvizjen e dukshme të Diellit.

Në shekullin e parë të erës sonë, gjuha e astrologjisë ishte greqishtja, gjë që siguroi suksesin e saj. Megjithëse perandoria perse kishte qënë kozmopolite, asnjë gjuhë nuk mbizotëronte aty. Falë pushtimeve të Aleksandrit të Madh, një udhëtar që njihte greqishten mund të shkonte nga Kreta në Indi, nga Egjipti në Afganistan, duke qënë i kuptuar. Në këtë epokë, stoikët, përkrahësit (pasuesit) e astrologjisë, do të zhvillonin idenë e një astrologjie fataliste dhe deterministe (përcaktuese).

Në shekullin e dytë të erës sonë, Vettius Valens udhëtonte në Egjipt për të kërkuar mjeshtrat e traditave "të vjetra"astrologjike!

Vitet 120 – 180: Klaud Ptolemeu, astronom dhe astrolog grek, ka bërë një përmbledhje të dijeve astronomike dhe astrologjike greko-babilonase. Pikërisht ai formoi një katalog prej 1022 yjesh. Ai vendosi rregull sepse përziheshin supersticionet dhe traditat fetare. Ai do ta riorganizonte

krejtësisht astrologjinë. Të gjitha këto kërkime mbi astrologjinë u shkruan në veprën e tij *Tetrabiblos*, manuali (udhëzuesi) i parë i madh i astrologjisë. Sot, ky manual mbetet një referencë për ne. Një përkthim shumë i mirë francez është botuar në vitin 2000 nën titullin "Libri unik i astrologjisë".

Është sistemi astronomik i Ptolemeut që do të influencojë Perëndimin. Ptolemeu hedh poshtë astrologjinë parashikuese, ai e konsideron atë si një nën-produkt, një nën-kulturë të astrologjisë, dhe krijon astrologjinë "shkencore". U paraqit me një mendim, një formë kaq elegante, ku nuk ndihet gjithmonë determinizmi që është mbrapa. Astrologjia e Ptolemeut është një astrologji shumë deterministe, gjithçka është shkruar në qiell.

Në të njëjtën kohë, disa astrologë bëjnë astrologjinë horare. Kjo është një astrologji parashikuese dhe zhvillohet në një kontekst kryesisht fetar, përpara se të kryejmë një veprim, pyesim zotat. I bëhet pyetja astrologut dhe ky konsultohet me qiellin, nxjerr përfundimet e tij dhe jep përgjigjen. Astrologjia horare nuk është një astrologji deterministe, sepse nëse mund të bëjmë një pyetje, kjo nënkupton që mund të merremi me problemin në mënyra të ndryshme. Pra, ka liri zgjedhjeje.

Një hendek hapet përherë e më shumë ndërmjet përkrahësve të astrologjisë shkencore dhe asaj të astrologjisë parashikuese. Astrologjia horare nuk ka të njëjtat rregulla, është një tjetër astrologji, një tjetër sistem mendimi. Që atëherë astrologjia që rrjedh nga qytetërimi mesdhetar shtrihet në të gjithë Europën. Ajo hyn në Romë në dy shekujt e parë të erës sonë; ajo do të përdorej për qëllime politike dhe sociale, por do të përhapej gjithashtu edhe nga temat individuale.

Gjatë periudhës romake astrologët lartësoheshin ose hidheshin në gropat e luanëve. Pra astrologjia kishte interes të mos gabonte. Për këtë arsye progresi dhe efektshmëria e astrologëve kanë bërë një hap përpara.

Viti 180: Pak pas vdekjes së Klaud Ptolemeut, në kohën e rënies së perandorisë romake, astrologjia u dobësua dhe ra në duart e supersiticionit (bestytnive).

Në shekullin e tretë, Diogenes Laertius raporton që sipas Aristotelit, një kaldeas kishte parashikuar vdekjen e Sokratit me temën e tij të lindjes dhe që babai i Euripidit kishte mësuar karrierën e tij të ardhshme të shkëlqyer nga interpretimi i temës së të birit.

Nga shekulli III deri në shekullin X astrologjia u luftua ashpër nga kisha e cila e akuzoi atë se kishte lidhje me djallin (të keqen). Vetëm Zoti e di të ardhmen, dhe askujt nuk mund t'ia tregojë këtë sekret. Njeriu është një krijesë, ai duhet të përmbushë jetën e tij. Pjesa më e madhe e dënimeve të astrologëve ndodhen nga frika se mos Kisha do të humbiste pushtetin.

Viti 381: Këshilli i Laodikeas ndaloi klerikët e kishës të studionin astrologjinë.

Shekulli V: Këshilli i Toledos kërcënoi me shkishërim (mallkim) këdo që "mendon që duhet t'i besohet astrologjisë apo parashikimeve të fatit".

Megjithatë, pak a shumë në fshehtësi, astrologjia vazhdonte të zhvillohej në Europë. Ashtu si në Romë disa shekuj më herët, në atë periudhë ishte në modë që zotërinjtë e mëdhenj të kishin astrologun e tyre.

Viti 529: Perandori Justiniani, nën ndikimin e gruas së tij perandoreshës Teodora, mbyll Shkollën e Athinës ku praktikohej akoma astrologjia shkencore. Të gjithë astrologët u ndoqen nga Bizanti dhe nga Greqia dhe mërguan pikërisht në Persi.

Duke nisur nga shekulli VII, arabët rikuperuan trashëgimin astrologjik kaldeo-grek, ku tekstet u përkthyen në arabisht. Ky qytetërim dallohej më shumë për mjekësinë dhe astrologjinë; qendra studimi, një observator i madh, dhe një bibliotekë u krijuan në Bagdad, që atëherë u bë kryeqyteti botëror i astronomisë dhe astrologjisë.

Ata përkthyen një numër të madh veprash antike që kodifikonin astrologjinë, ndërtuan astrolabe, dhe pasuruan këtë dije me zbulimet e tyre. Ata janë përgjegjësit e Pjesëve Arabe që përdoren edhe sot nga disa astrologë. Ata ishin kujdestarët e dijes astrologjike në Mesjetë, ashtu si edhe në fusha të tjera të kulturës.

Vitet 805 – 855: Albumas'ar ishte astrologu më i madh arab; traktati i tij "introductorium", ishte një nga librat e tij të parë që arriti në Europë, nëpërmjet Spanjës, në fillim të Mesjetës.

Shekulli XI: Pierre Abélard për t'i shpëtuar rrufeve të Kishës, armike me fatalizmin e astrologjisë, bëri një dallim midis fenomeve natyrore të parashikueshme dhe gjërave të paparashikueshme, që varen nga perëndia hyjnore dhe lidhen vullnetarisht me njeriun.

Shekulli XII: Kalimi i shkencës (dijes) astrologjike nga arabët drejt Perëndimit mesjetar falë përkthimeve arabo-latine.

Viti 1125: Astrologjia jepej si mësim në Fakultetin e Bolonjës dhe që prej atëhere do të vendosej në të gjitha universitetet europiane, mbretërit dhe papati i jepnin mbështetjen e tyre, disa papë arriten madje ta studionin dhe ta praktikonin atë.

1225 – 1274: Saint-Thomas D'Aquin për të cilin vetëm pjesa fizike dhe e dëshirueshme e njeriut është e prirur nga ndikimi i yjeve, ndërsa shpirti u shpëton atyre. Për të, është e dukshme që ka një pjesëz hyjnore brenda nesh, ekziston një liri që na mundëson të shkëputemi nga determinizmi ynë astrologjik. Krishti ka ardhur për të na shpëtuar, ai na ka çliruar nga fati, nga djajtë, nga kaosi, pra nuk mund të ketë determinizëm.

1214 – 1294: Murgu anglez Roger Bacon ka dashur të bëjë një ndarje ndërmjet astrologjisë legjitime dhe astrologjisë që i kushtohet ndikimit djallëzor. Por inkuizicioni e burgosi atë për shumë vite.

1257 – 1315: Perre d'Abano, kundërshtar i madh i pushtetit pontifikal (peshkopal), e nxiti fatalizmin astrologjik deri në mohimin e vullnentit të lirë të njeriut dhe pra të mrekullive hyjnore. Sipas tij, të gjitha ngjarjet do të

shpjegoheshin përmes revolucionit të planetëve. Vepra e tij duke u gjykuar si e rrezikshme nga Kisha, portreti i tij iu dogj pasi ai vdiq.

1270: Determinizmi absolut i astrologjisë arabe është i papërputhshëm me doktrinën e kishës, e cila e dënoi atë.

1320: Gjoni XXII dënon fallxhorët. Astrologu Cecco Ascoli autor i Acerba-s u dogj në 1327 ngaqë u përpoq të përcaktonte lindjen e Krishtit nën dritën e yjeve.

1450: Astrologjia jepet mësim në Sorbonë dhe në universitetet e tjera europiane.

1453: Gutenberg shtypshkrues gjerman perfeksionoi shtypshkronjën duke vënë për fije karakteret tipografike prej metali të lëvizshëm e cila shënon fillimin e shtypit. Kjo shpikje mundësoi përhapjen e trakteve astrologjike, almanakëve dhe efemerideve (kalendarëve astrologjikë). Këto publikime lehtësuan shumë llogaritjet e lodhshme të astrologëve dhe e përhapen astrologjinë në një publik të gjerë.

1463 – 1494: Xhovani Pik i Mirandolës së Fiorences, i cili megjithëse ishte një kabalist shenjtor i nderuar dhe i dalluar si një dijetar, një enciklopedist i tmerrshëm dhe që menjëherë hedh pamfleta duke thënë që astrologjia është marrëzi, thotë gjithashtu që Krishtërimi është rezultat i të gjitha rrjedhave të mendimeve të mëparshme. Ai u shpall heretik në 1487.

1473 – 1543: Nikolla Koperniku, astronom dhe matematicien polak vuri në dyshim sistemin gjeocentrik të Ptolemeut, duke konfirmuar që Dielli, dhe jo Toka, ishte qendra e universit. Teoria e tij mbi heliocentrizmin u verifikua nga Galileo në shekullin XVII falë shpikjes së dylbive. Ai e konsideonte megjithatë astrologjinë si pjesë përbërëse të fushës së tij. Madje i bëri apel astrologut Rhaeticus për të bërë parathënien e veprës së tij prej mjeshtri.

1493 – 1541: Paraklesi, filozof dhe mjek, ia kushtoi gjithë jetën e tij studimit dhe praktimimit të filozofisë dhe mjeksisë. Ai këshillonte studimin e astrologjisë.

1503 – 1566: Francezi Mishel de Notredame, i quajtur Nostradamus, mjek astrolog dhe profet, nxiti interesin e mbretëreshës Katerina de Mediçi për astrologjinë duke parashikuar aksidentin vdekjeprurës të burrit të saj mbretit Henri II, që atëherë u plagos në një ndeshje kalorësish. Vepra e tij përbëhet kryesisht nga "Shekujt' astrologjikë, profeci shumë të njohura për të ardhmen e botës. Sipas deklaratave të tij, parashikimet që ai bënte frymëzoheshin njëkohësisht nga njohuritë astrologjike dhe nga besimi i tij në Zot. Një astrolog gjerman i shkruajti atij një ditë: 'si mund ta keni parashikuar këtë gjë kur llogaritjet tuaja janë të gabuara?' Ishte padyshim nga mendjemprehtësia? Disa pretendojnë që 'shekujt' nuk janë të atij sepse janë shkruar në një frengjishte që daton nga shekulli XIV? Nostradamus kishte parashikuar vdekjen e tij një ditë përpara!

1520: Papati themeloi një katedër të astrologjisë në Romë.

1550: Astrologjia dhe shtimi i almanakëve, shoqërohej nga magjia e të gjitha llojeve. Kështu që Fransua I nxori një dekret që dënonte autorët e almanakëve. Disa astrologë u dënuan me djegie në turrën e druve nga inkuizicioni. Michel Servet në Xhenova, Jean Huss, i djegur në Bohemë dhe të tjerë akoma.

Shekulli XVI: Kepler dhe Galileo, të dy astronomë dhe astrologë, vendosen bazat e astronomisë dhe të fizikës moderne. Astrologjia ripërqëndrohet mbi origjinën e saj greke dhe mësohet në universitet. Les Valois (familja mbretërore e Henrit II) përkrahës të astrologjisë krijuan detyrën e mjekut astrolog të mbretit. Astrologjia u pranua përsëri në oborrin mbretëror.

1571 – 1630: Johan Kepler, astronom i madh, astrolog, matematicien dhe teolog, ishte gjithashtu astrolog në oborrin mbretëror të Pragës. Ai zbuloi që lëvizja e planetëve nuk ishte qarkore, por një lëvizje elipsi, ai ka edhe ligjet nëpërmjet të cilave mund të llogarisim këtë lëvizje. Këtyre ligjeve u referohemi akoma edhe sot. Duke kritikuar gabimet e disa astrologëve, ai e konsideroi astrologjinë si "një shkencë themelore të njerëzimit". Ai e praktikoi atë deri në vdekje.

Ai zbuloi "aspektet kepleriane", aspektet e vogla si gjysëm-kuadrat (450) dhe mbikatrorin (1350), këto aspekte përdoren shumë edhe sot nga astrologët. Nga fundi i jetës së tij ai shkruajti: "besimi në efektin e yjeve vjen fillimisht nga përvoja, është kaq bindës, saqë vetëm ata që nuk e kanë studiuar mund ta mohojnë".

1583 – 1656: Jean-Batiste Morin nga Villefrance-sur-saone, shkrimtar, teolog dhe astrolog, një nga shkencëtarët e fundit që ka dashur të merret me astrologji. Ishte kundër ideve moderne. Ai shkroi një manual të madh për astrologjinë: "Astrologia Gallica".

1596 – 1650: Deskarti, filozof, matematicien dhe fizikant francez, përzien alkiminë, magjinë dhe astrologjinë sëbashku dhe i hedh poshtë për mungesë të shpjegimit racional të funksionimit të tyre.

1666: Ngritja e një shkencëtarizmi rigoroz (Deskarti) do të shtyjë Kolbertin të nxjerrë një ligj që përndjek astrologjinë nga universitetet. Në të njëjtin vit ai themeloi Akademinë e Shkencave dhe në 1667 krijoi Observatorin, një institucion për kërkime astronomike. Që prej asaj kohe, astrologjia dhe astronomia ishin dy fusha që dalloheshin nga njëra-tjetra.

1675: Përurimi i Observatorit të Greewich-it në Angli institucion i kërkimeve astronomike që u themelua nga astronomi i oborrit mbretëror J. Flamstead. Pasi formoi horoskopin nga Observatori, përfundoi duke thënë: mos qeshni miqtë e mi. Edhe aty kishte ndarje ndërmjet astrologjisë dhe astronomisë.

1682: Nën ndikimin e Zonjës Maintenon, Luigji IV hoqi detyrën e mjekut astrolog të mbretit.

1710: Publikimi i efemerideve ndalohet nga pushteti mbretëror. Pa këto të dhëna mbi pozicionin e trupave qiellorë, puna e astrologëve u bë pothuajse e pamundur.

NB: në Angli, almanakët dhe efemeridet vazhdonin të publikoheshin rregullisht.

Nga fundi i shekullit XIX, astrologjia filloi të rishfaqej gradualisht, por shumë tekste kishin humbur pjesërisht gjë që shkakton shumë gabime. Ajo rikthehet pra me orientimin e saj fetar dhe lindor. Astrologët flisnin sidomos për të ardhmen e shpirtit, për kushtëzimin karmik. Pra është një astrologji e orientuar që nuk merret seriozisht, përveçse nga okultistët.

1856 – 1939: Zigmund Frojd, në 1885 vë për fije psikanalizën, duke vënë kështu në diskutim pavarësinë e vullnetit.

1875 – 1961: Psikanalisti Karl Gustav Jung futi nocionin e të pavetëdijshmit kolektiv, ai ka bërë gjithashtu kërkime astrologjike duke thënë: "Nëse njerëzit tek të cilët arsimimi lë për të dëshiruar, kanë besuar se munden deri në kohët e fundit, të tallen me astrologjinë, duke e konsideruar si një pseudo-shkencë të eleminuar që prej 1666, sot tre shekuj më vonë, kjo astrologji që del nga thellësia e shpirtit të popullit troket në dyert e universiteteve tona.

1879 – 1955: Gauquelin ka bërë shumë kërkime shkencore, statistika etj, për të vërtetuar që astrologjia është shkencë.

1930: 'Sunday Express' propozon një rubrikë astrologjike të suksesshme. Franca rizbulon astrologjinë dhe botimet janë të shumta. Në Shtetet e Bashkuara Evangelina Adams jep në radio horoskopin e parë bazuar në shenja.

1955: Michel Gauquelin, psikolog, boton "Ndikimi i yjeve". Ai ndërmerr një hetim të gjerë statistikor me qëllim për të luftuar astrologjinë. Rezultatet e hetimit të tij (deri tani të pakundërshtuara nga të gjitha kundër-hetimet të kryera nga shkencëtarët), dëshmojnë të kundërtën dhe vërtetojnë ekzistencën e një efekti astrologjik.

1935: Horoskopi, forma popullore e astrologjisë, shfaqet në Paris-soir.

1967: Astrologu mundet me ndihmën e një kompjuteri dhe të një programi të përshtatur, të formojë një hartë qiellore, dhe kështu e gjen veten të lehtësuar nga llogaritjet e shumta.

1968: Astroflash, një kompjuter me programe astrologjike vendoset në bulevardin Champs Elisée. Ai jep studime astro-psikologjike. Është një sukses shumë i madh. Shtypi amerikan zbulon se Nancy Reagan këshillohet me një astrolog për presidentin.

1970: Astrologjia popullore nga zonja Soleil (Diell) në "Antenne d'Europe nr 1", ajo merr mijëra thirrje telefonike në ditë.

1997: Në librin e saj "Nën shenjën e Mitterrandit", Elisabeth Tessier zbulon interesin që presidenti i vjetër kishte për astrologjinë.

4. Çka është Astrologjia

Nëse ndalemi në etimologjinë e kësaj fjale, 'Astrologjia' vjen nga një fjalë e lashtë greke: "astro"që do të thotë "yll"dhe "logia"që ka kuptimin ". Në fakt, i vetmi yll që ndikon në astrologji është Dielli (si dhe yllësitë nga të cilat kanë marrë emrat shenjat e zodiakut), të tjerët janë planetë. Por dhe planetët duken si yje për shkak të rrezatimeve të Diellit që bie mbi ta dhe ndoshta njerëzit e lashtë mendonin se yjet dhe planetet ngjajnë me njëri-tjetrin. Disa fjalorë e përshkruajnë konceptin e astrologjisë disi të gabuar duke e konsideruar atë si "artin e parashikimit". Për ne astrologjia ka një qëllim shumë më të ngritur sesa parashikimin e së ardhmes.. Astrologjia është përcaktuar edhe si gjuha e simboleve.

1. Para së gjithash astrologjia është një *gjuhë* e përgjithshme që jo vetëm që na flet për veten tonë por na bën të flasim midis nesh, dhe akoma më mirë të kuptohemi. Të rinjtë fillestarë duhet në fillim të mësojnë alfabetin e saj (simbolet), zgjedhimet e saj (aspektet), pastaj njeriu fillon të ndërtojë fjalitë e tij të para (interpretimi), në vazhdim mund të pasurojë fjalorin e tij (shtimin e pikave imagjinare për shembull) dhe të perfeksionojë gramatikën (përdorimi i aspekteve dytësore, përcaktimi i dominuesve etj…).

Si çdo gjuhë e gjallë, sigurisht që astrologjia lidhet me epokën e saj dhe me njerëzit që e praktikojnë atë, gjithashtu ajo përkeqësohet në dialekte të ndryshme, ku secili ka theksin e tij (të nxitura nga disa kritere) dhe rregullat specifike: bëhet fjalë për shkolla të ndryshme (karmike, kushtëzuese, kozmobiologjike…) por edhe astrologji të ndryshme (indiane, kelte, kineze, maja…) që përfundimisht të gjitha flasin për të njëjtin realitet dhe për të njëjtin vullnet (deshirë) për të përkthyer paralelisht parimet (standartet) e mëdha të jetës nga një seri simbolesh sfiduese që përputhen pafundësisht. Ashtu si çdo gjuhë, astrologjia ka edhe përjashtime në rregullat e saj dhe më duket gjithmonë e tepruar dhe e kotë të vendosësh parime (standarte) dhe teori definitive që refuzojnë pak apo provojnë vullnetin që ka natyrën për të qënë fantazuese dhe e pakuptueshme (e pakapshme) sepse rigjen ripërtëritje. Astrologjia evoluon (zhvillohet) përkrah njeriut dhe nuk do të dinte të ndalet në çdo lloj momenti të historisë.

Përfundimisht, astrologjia i përgjigjet një strukture të interpretimit piramidal (gradual) në mënyrë të rrumujshme: baza përbëhet nga rregulla të përgjithshme, vijnë më pas rregullat më të spikatura, pastaj rregullat e shkollës dhe epokës së saj dhe në fund rregullat e vet individit. Sepse çdo individ shprehet në mënyrën e tij unike, me shprehjet e veta sipas një shembulli kompleks që pasqyron njëherësh natyrën e tij (temën e tij), edukimin e tij dhe mjedisin që e rrethon. Gjithashtu për të kuptuar mirë gjuhën e bashkëbiseduesit të saj, astrologjia duhet gjithmonë të përpiqet,

nëse ka mundësi, të përvetësojë fillimisht funksionimet (interpretimet) dhe riveprimet lidhur me një person në mënyrë që puna e tij e interpretimit të përkthejë sa më saktë cilësitë dhe delikatesën e secilit prej nesh.

Të gjithë flasin të njëjtën gjuhë por jo në të njëjtën mënyrë, çdo punë e astrologut konsiston për të gjetur origjinalitetin dhe të veçantitë e çdo individi duke marrë përsipër të klasifikojë personat në kategori artificiale.

2. Astrologjia është sigurisht edhe *art* sepse i nevojiet të jetë nën dëgjimin e botës dhe nënkupton (përfshin) vullnetin për të rikrijuar botën nën një formë të ndryshme dhe origjinale. Praktika astrologjike përafrohet me praktikën artistike: ashtu si ***muzikanti,*** duhet të njohë e të dijë të përdorë tonalitetet/notat muzikore (elementet), ritmet (trefishësitë), heshtjet (shenjat e ndërprera, planetet pa aspekte) dhe të arrijë në një harmoni në interpretimin e tij. Ashtu si ***piktori***, astrologu duhet të jetë i aftë të kuptojë përzierjen e ngjyrave dhe rezultatet që lindin nga këto kombinime komplekse (aspekte të shumëfishta) në mënyrë që të përmirësojë një realitet që duket njëkohësisht kaq i thjeshtë dhe kaq i mistershëm. Ashtu si ***fotografi,*** astrologu duhet të dijë të punojë me fotografitë e çastit (tema dhe harta e lindjes) duke lënë të shprehen të gjitha nuancat vetëm duke theksuar temën kryesore (dominuese). Ashtu si ***kërcimtari***, astrologu duhet të drejtohet nga melodia e një teme dhe të mund të bëjë që të lindë një koreografi origjinale, e paqëndrueshme (fluide) dhe e përshtatur (interpretimi i saj). Ashtu si ***aktori***, astrologu duhet të shfaqë (tregojë) prekshmëri dhe të mund të rrëshqasë në lëkurën e personit që përpiqet të interpretojë, duhet të mësojë të ekuilibrojë në mënyrë të matur atë që vjen prej atij dhe atë që vjen prej tjetrit, duke qënë njëherësh një zbulues dhe analist në mënyrë që të nxjerrë në dritë natyrën e thellë të njerëzve dhe situatave. Ashtu si ***shkrimtari***, astrologu duhet të dijë të zgjedhë fjalët dhe të ndërtojë fjalitë e tij, në mënyrë që t'i paraqesë saktësisht mendimet dhe intuitën e tij. Tregimet e tij duhet të jenë gjithnjë të kuptueshme (koherente) dhe realiste dhe duhet të mundë të parashikojë të ardhmen (horoskopi). Metaforat për këtë temë sigurisht që do të mund të shtoheshin por ne nuk do të mbanim në fund veçse këtë përcaktim *të thjeshtë* nga Francis Bakon, i cili vetëm do të kishte mundur të fliste po aq mirë edhe për astrologjinë: "arti, është njeriu që i bashkangjitet natyrës. "

3. Astrolgjia sigurisht që është edhe shkencë. Ajo përputhet me disa teorema të sakta (llogaritja e pikave imagjinare për shembull), mbështetet mbi studimin e mekanizmave natyrorë (tranzitet planetare) dhe për më tepër frymëzohet gjithmonë nga natyra për të vendousur bazat e saj të punës (analogjia midis natyrës së planetëve dhe funksioneve të tyre apo edhe ritmeve të stinëve dhe zodiakut). Si çdo shkencëtar, astrologu duhet në fillim të jetë një vëzhgues dhe një eksperimentues: asnjë teori nuk mund të jetë e vlefshme pa qënë e ekzaminuar, (e testuar) dhe e rikontrolluar dhe sa për mua unë përdor me gjithë qejf parimin e kundër-përvojës (që na

lejon të zbulojmë se pse kjo në përgjithësi funksionon por që rregulli nuk vihet në zbatim ose përdoret ndryshe në disa raste speciale). Si çdo shkencëtar, astrologu duhet të jetë edhe origjinal (unik) ose, të paktën të japë një mendim origjinal që e bën, duke qënë shumë realist, të ketë deshirën dhe vullnetin të shkojë më larg dhe të zbulojë rrugë të reja (që, duhet thenë se, nganjëherë nuk të çojnë asgjëkundi). Cilësitë që kërkon praktika e astrologjisë janë, me pak fjalë, edhe shumë "shkencore": do të duhet gjithmonë të jesh objektiv, i saktë, i duruar, i hapur, këmbëngulës dhe imagjinar. Është pra një punë për çështjet e të tjerëve (të botës) dhe njëkohësisht një punë për veten tënde.

4. Por astrologjia është edhe ***besim*** gjithashtu. Nëse nuk është fe (besim) në kuptimin që nuk përfaqëson një qënie superior dhe të brendshme (imanente), ajo posedon shumë pika të përbashkëta me të gjitha lëvizjet shpirtërore. Jam shumë i bindur që nevoja për astrologjinë është po aq e fortë sa nevoja për fenë dhe fakti që të vendosësh t'i përkushtohesh astrologjisë ringjall njëkohësisht kërkesa dhe sqarime (me kuptimin e një zbulimi të mirëkuptuar…). Astrologjia posedon dukshëm një dimension metafizik jo të parëndësishëm (sidomos në karmikë), dhe studimin e vetëm të përsosmërisë së natyrës, dhe të kompleksitetit të saj, përmes astrologjisë mjafton të shfaqësh disa çështje dhe pyetje të ndryshme, origjinën dhe ekzistencën e botës. Ndonëse kam shumë vështirësi të kuptoj që disa shkencëtarë, megjithëse të zhytur në analizën e mprehtë të universit, nuk zhvillojnë sistematikisht një ndërgjegje të mprehtë të bukurisë dhe të "mrekullisë"së botës sonë (ashtu siç pritet, tema e këtyre njerëzve tregon një problematikë nga ana shpirtërore dhe nga aftësia për të kapërcyer kushtet njerëzore dhe materiale). Sipas mendimit tim, mendoj që besojmë në astrologji ashtu siç besonim në një Zot i cili do të na shfaqte çdo ditë provat e ekzistencës së tij. Nga ana tjetër, praktikimi i astrologjisë nuk bie në kundërshtim me praktikimin e çdo lloj besimi apo feje, përkundrazi duke qënë se besimtari do të shohë me gjithë qejf në themelin e astrologjisë "dorën e Zotit".

5. Për të përfunduar, astrologjia është gjithashtu një element i domosdoshëm në ***lidhjet shoqërore*** (kohezionin social). Është një mjet që i kushtohet njohjes dhe deshirës për të kuptuar të tjerët. Praktikuesi i astrologjisë duhet të jetë gjithnjë në shërbimin e të tjerëve duke paraqitur cilësitë e tij të tolerancës dhe objektivitetit. Praktika e astrologjisë, larg hipokrizisë (zhargoneve), rezulton shpesh e lodhshme për atë që *zhytet* në të: qoftë se ai nuk arrin gjithmonë në rezultate ulëta, qoftë sepse e kundërta e saj është, qëllimisht apo jo, në kundërshtim me këshillat dhe analizat e saj. Astrologu duhet gjithashtu të mësojë të ulë krahët dhe të lërë secilin të ndjekë rrugën e tij sado e mirë t'i duket atij. Po përmendim këtu dy fjali të veprës *sartriane*:

"Për të mësuar, çdo të vërtetë mbi mua, duhet të kaloj përmes të tjerëve"* dhe *"Njeriu është qënie që nuk mund të dalë nga vetvetja, që nuk njeh të tjerët veçse në vetvete dhe që, duke thënë të vërtetën, gënjen".

1. Astrologjia nuk është dhe nuk do të jetë kurrë ***fall***. Falli bëhet me intuitë të pastër dhe jo me analiza. Falli nuk ndahet në pjesë, nuk përshtatet me debatet dhe nuk është njohuri që i nënshtrohet pasurimit apo evolucionit. Falli është një dhunti, astrologjia një praktikë. Nëse disa astrologë janë edhe fallxhorë, një fallxhor nuk është detyrimisht astrolog. Një astrolog nuk ka në përgjithësi "sinjale, vizione", ai punon përmes rezultateve (llogaritjeve) dhe intuita nuk është veçse një plus në interpretimin e tij.

2. Astrologjia nuk duhet të jetë një mjet ***detyrues*** dhe aq më pak një mjet diskriminimi. Astrologu përkundrazi duhet ta kërkojë të drejtën tek ndyshimi dhe të mos transmetojë kurrë gjykime vlerash. Gjithashtu astrologu duhet të mos pranojë të luajë "kodrat e hirta" dhe, qoftë kjo edhe në kategorinë e individit, të familjes, të komunitetit apo të kombësisë. Astrologu është, dhe duhet të mbetet, një këshillues. Ai është një analist i jetës dhe i njeriut: ai nuk mund dhe nuk duhet të kërkojë asnjë pushtet apo epërsi në zanatin e tij.

3. Astrologjia nuk duhet të jetë një mjet ***"i pacipë"***për t'u pasuruar (dhe aq më pak kur punët e kryera janë bërë pa ndërhyrjen njerëzore!). Nëse astrologu i vë taksë (çmim) punës së tij, është që secili duhet të mund të mbështetet tek nevojat e tij duke bërë, në mënyrë ideale, atë që i duket më e mira e mundshme. Një punë astrologjike serioze kërkon në përgjithësi, orë të tëra meditimi, kërkimi dhe formulimi (hartimi), gjë që justifikon çmimet që mund të duken të mëdha tek personat më të varfër. Do të vihet re që shumica e astrologëve, krahas punëve të tyre me pagesë, dinë të bëhen të dobishëm në mënyrë të vullnetshme.

5. Elementet themelore të jetës
- Elementet themelore të zodiakut

Dymbëdhjetë shenjat e Zodiakut i përfshijmë në grupe në bazë të karakteristikave të përbashkëta. Njëra nga mënyrat e kategorizimit të tyre është që ato t'i përmbledhim në grupe në bazë të temperamentit. Një kategorizim të tillë e quajmë si grupim sipas elementit.

Katër elementet themelore te zodiakut janë: Zjarri, Toka, Ajri dhe Uji dhe këta janë arketipat e energjisë, të cilët e formojnë temperamentin e ndokujt, ndërsa temperamenti përbën elementin dominues të horoskopit.

Shenjat e Zjarrit



Dashi -Luani - Shigjetari

Zjarri përfaqëson energjinë vitale, burimin e aktivitetit të gjithmbarshëm, burimin e tërë jetës. Forca, komunikueshmëria, energjia dhe vitaliteti, ngrohtësia dhe entuziazmi – këto janë cilësitë e zjarrit. Ajri dhe zjarri ngjiten përpjetë; esenca e tyre është ekspansioni. Toka dhe uji zbresin poshtë, duke u përpjekur që të zënë një vëllim sa më të vogël.

Njerëzit, te të cilët mbizotëron ky element, shprehin një natyrë afirmative, të pavarur, të guximshme dhe të fortë. Dispozitat e të lindurve në këtë shenjë janë të orientuara nga krenaria, besimi, trimëria, guximi. Kanë një shpirt pushtues, i cili lakmon që më shumë të urdhërojë e më pak të jetë i dëgjueshëm. Ata janë shpesh agresivë, mund të thuhet edhe arrogantë; kërkojnë sherre dhe i besojnë vetëm vetes; janë shumë mosbesues. Gjithnjë kanë dëshira të mëdha dhe synime të pangopura. Ata janë "pjekur në vullnetin e tyre". Njerëzit e tillë vetë e krijojnë fatin e tyre, ose të paktën e kanë bindjen se e bëjnë atë.

Zjarri është element që u përgjigjet syrit dhe vizionit – nga të pesë shqisat syri është shqisa që i arrin caqet më të largëta. Yjet në qiell janë zjarre të mëdha, të cilat shihen në largësitë prej disa miliarda vitesh drite. Të lindurit në shenjën e zjarrit, sipas kësaj, kanë prirje për gjëra të largëta, abstraksione. Ata kanë, më shumë ose më pak të shprehura, aspirata spirituale në varësi nga fakti se a janë të udhëhequr nga zjarri, apo vetëm janë djegur nga ai. Në përgjithësi, planetët janë më aktivë në këtë triciplitet kundruall të tjerëve. Elementi kimik që i përgjigjet zjarrit është oksigjeni; ai bashkohet pothuajse me të gjithë trupat e tjerë gjatë djegies.

Shenjat e Tokës

Demi - Virgjeresha - Bricjapi

Toka paraqet përbërjen materiale, e cila është e pranishme në të gjitha gjërat, madje edhe në ato më të imëtat. Maturia, stabiliteti, pesha dhe pjelloria janë karakteristika e këtij elementi.

Ajri dhe zjarri ngjiten përpjetë; esenca e tyre është ekspansioni. Toka dhe uji zbresin poshtë, duke u përpjekur që të zënë një vëllim sa më të vogël. Shenjat e tokës paraqesin natyrën e kujdesshme, praktike, emocionale dhe misterioze. Të lindurit me elemente të theksuara të tokës janë të ngadalshëm dhe të mbyllur, të rezervuar dhe të përmbajtur, ekonomikë dhe metodikë. Ata i bartin gjatë shenjat e të ndodhurave; por edhe janë më të aftë se sa të tjerët që për një kohë të gjatë ta lënën shenjën e tyre në atë që e prekin. Toka, parimisht, është e plogësht, e butë dhe e errët; por ajo mund të bëhet e përhershme dhe transparente sikur një diamant. Toka i përgjigjet shqisës së të prekurit, e cila pranon sinjale tepër të afërta, të shkaktuara nga objektet e vendosura në periferi të trupit.

Të lindurit në shenjën e tokës dëshirojnë t'i prekin gjërat; me fjalë të tjera t'i ndiejnë njëkohësisht ngjashmëritë dhe ndryshimet. Vlera e tyre spirituale mund të vijë nga ky distinksion, të cilin ata janë të aftë ta bëjnë ndërmjet asaj që prekin (gjegjësisht, asaj që kanë, që duan, ose që bëjnë) dhe asaj që janë vetë. Por, kur e harrojnë këtë distinksion, ata jetojnë vetëm për t'i mbushur xhepat dhe stomakun. Materializmi, kryeneçësia, frika e cila paralizon, pakënaqësia e tepruar, dembelia – janë disa nga të metat e tyre më të mëdha. Përndryshe, elementi kimik, i cili i përgjigjet tokës është karboni, lidhjet e forta të të cilit forcojnë strukturën e molekulave organike.

Shenjat e Ajrit



Binjaket - Peshorja - Ujori

Ajri është element i relacionit. Ai paraqet diçka më tepër sesa një përzierje e gazrave – që sajohet nga azoti, oksigjeni, hidrogjeni dhe në sasi minimale edhe nga substanca të tjera – që e bëjnë të përshtatshme për jetë një ambient në të cilin ndodhemi. Ajri si element ndërambiental është substanca e përkryer dhe e pashkatërrueshme, e cila përmban materien, por që nuk përzihet kurrë me të. Me këtë rast mendohet edhe për hapësirën intersiderale (ndëryjore) dhe zbrazëtirën ndëratomike. Në këtë kontekst, mbase ajrit më shumë do t'i përgjigjej emri eter. Elasticiteti grandioz, stërhollimi, aftësia që të plotësojë çdo gjë, ose më parë ta bëjë të pakufishëm mungesën e formës, por edhe ekzistimin e substancës nga e cila është krijuar çdo gjë, pavarësia – këto janë vetitë themelore të këtij elementi.

Ajri dhe zjarri ngjiten përpjetë; esenca e tyre është ekspansioni. Toka dhe uji zbresin poshtë, duke u përpjekur që të zënë një vëllim sa më të vogël. Të lindurit në shenjën e këtij tripliciteti dhe të përbërësve të tij më të rëndësishëm janë subtilë, të rafinuar, me prirje që të kultivohen, kureshtarë, kënaqen në shprehjen e kujdesit. Parë në përgjithësi, kanë sjellje të mirë dhe janë matur. Vitaliteti i tyre lë shumë për të dëshiruar, ndërsa baraspesha e tyre nervore shpesh është e pasigurt. Rëndom shprehin ndonjë talent artistik, por jo edhe shkencor. Shenjat e ajrit paraqesin një natyrë mjaft humane, të gëzuar, zbavitëse, të dashur dhe simpatike. Kanë intelekt të madh dhe imagjinatë të bujshme.

Paqëndrueshmëria, jokonsekuenca, plogështia, shkujdesja, sipërfaqësia – këto janë disa nga të metat e tyre. Ajri si element u përgjigjet shqisave të transmetimit në distancë, në rend të parë shqisës së të dëgjuarit. Kjo është logjike, pasi që ajri është element i relacionit; sepse meqenëse krijesat njerëzore merren vesh nëpërmjet fjalës së folur, të dëgjuarit paraqet organin e marrëveshjes, pajtimit (edhe më tutje kolektivisht përdoret fjala dëgjoj si sinonim për kuptoj – për dallim nga shprehja jonë "hyn për njërin vesh dhe del për tjetrin "). Vlera spirituale e të lindurve te të cilët mbizotëron elementi i ajrit mund të jetë shumë e madhe, nëse ata në atë komunikim gjurmojnë edhe për gjëra të tjera dhe jo vetëm për burimin e fitimit. Të dëgjuarit merr sinjale mjaft të largëta, por gjithnjë me vonesë të vogël kundruall shqisës së të parit; zëri nganjëherë na vjen shumë më vonë sesa drita. Nëse nuk merret parasysh kjo zmbrapsje, kumtimi nëpërmjet fjalëve bëhet i pamjaftueshëm, mjegull që bie mbi natyrën e vërtetë të gjërave dhe shndërrohet në pengesë në rrugën drejt dijes. Elementi kimik që i përgjigjet ajrit është azoti – substanca inerte e cila e përbën esencën e atmosferës së tokës.

Shenjat e Ujit



Gaforrja - Akrepi - Peshqit

Uji paraqet tërësinë e brendshme të të gjithë organizmave të gjallë, por gjithashtu edhe esencën e jashtme të numrit më të madh të llojeve të gjalla. Në ujë, para mijëra shekujsh, kishte filluar jeta, në të e ka fillin çdonjëri prej nesh. Uji, sipas kësaj, del se është edhe më shumë i lidhur me jetën kundruall tokës, ajrit, por edhe zjarrit. Elementi i ujit është i brumosur me shumë domethënie simbolike – misteri i jetës, lashtësia e rrënjëve të tij,

thellësia oqeanike. Ajri dhe zjarri ngjiten përpjetë; esenca e tyre është ekspansioni. Toka dhe uji zbresin poshtë, duke u përpjekur që të zënë një vëllim sa më të vogël. Nëpërmjet përroskave, lumenjve dhe lumëmëdhenjve, ujërat që janë të njëkahshme dhe të ngjashme, në rënien e tyre përfundojnë në dete. Uji, pra, është element, i cili në mënyrë më kuptimplote synon unitetin. Natyra e tij është e butë dhe dashamirëse. Uji qarkullon nëpër trupin tonë sikur ta përkëdhelte atë, por uji di ta ketë edhe anën tjetër; marinarët e dinë se pikërisht kur uji duket shumë i padjallëzuar e i qetë, ekziston rreziku që të tërbohet. Dykuptimësia, misterioziteti, qetësia, pjelloria, përshtatshmëria – këto janë disa nga karakteristikat e këtij elementi. Zjarri spastron çdo gjë – por ky spastrim vret – për dallim nga spastrimi nëpërmjet ujit, i cili ringjall. Të lindurit me cilësi të theksuara të këtij tricipliteti kanë natyrë të prekshme, të ndjeshme, të lëndueshme dhe konteplative. Ata, rëndom janë të rezervuar dhe të turpshëm, të qetë dhe misteriozë, pak të dhënë pas aksionit. Më shumë interesohen për anën e fshehtë të gjërave sesa për aspektet e prekshme dhe më shumë rëndësi u japin domethënieve të ngjarjeve sesa vetë realitetit. Janë të dhënë pas komentimit të çdo gjëje, qoftë fjala për gjëra të mëdha, qoftë për të vogla. Janë shumë të larguar nga planet e vërteta materiale. Kanë një natyrë mjaft të pjellore dhe imagjinatë të bujshme.

Fuqia e tyre e ripërtëritjes është shumë e dobët (duke e përjashtuar akrepin); por ata nuk kanë ndonjë nevojë të theksuar për energji të madhe. Zakonisht shprehin disa talente të "paranormalitetit". Mund të bëhen artistë të mëdhenj ose mendimtarë të mëdhenj, sepse nganjëherë dëshmohen në fushat e dijes në të cilat shumica e vdekatarëve nuk kanë qasje. Rrallëherë janë të lumtur për shkak të hipersensibilitetit të tyre dhe mungesës evidente te energjisë e entuziazmit.

Dobësia në të gjitha nivelet, shpirtngushtësia, konfuzioni dhe inertësia – janë disa nga të metat më serioze të shenjave të ujit. Ky element u përgjigjet shijeve dhe aromave që janë tejet të veçanta dhe të pashoqërueshme. Shija është shqisa me "afërsi”më të madhe, më e afërta që mund të ekzistojë, ngase është lëndë e cila emeton sinjal vetëm nëse e prekim me buzë. Vlera spirituale e ujit është e madhe, sepse ky element u përgjigjet bashkimeve kulmore. Elementi i cili i përgjigjet ujit është hidrogjeni, i cili bashkohet me ujin nëpërmjet djegies...

6. Astrologjia Mesopotame



Astrologjia është një praktikë e lashtë që civilizime të ndryshme me sa duket kanë zhvilluar në mënyrë të pavarur. Kaldeasit që jetonin në Babiloni konsultoheshin me të që prej 3000 vjet pr. e. s. (ndërsa kinezët e praktikonin që rreth 2000 vjet pr. e. s).

Duke vëzhguar Siriusin që ngrihej, egjiptianët parashikonin fryrjen e lumit Nil. Kur Siriusi ngrihej në qiell, ata e dinin që cikli vjetor rifillonte. Nga Egjipti, Siriusi nuk është i dukshëm në qiell veçse në një pjesë të vitit. Ata e dinin që shfaqja e Siriusit në qiell përkonte me stinën e fryrjeve të Nilit. Edhe pse i vëzhgonin ngjarjet qiellore, egjiptianët nuk ishin astrologë të theksuar, siç mendohet. Astrologjia perëndimore, ajo që njohim ne sot, ka nisur në Mesopotami rreth 2000 vjet pr. e. s. , në Irakun e sotëm. Ka mundësi që të ketë nisur edhe më përpara, por dokumentat e para që përmendin astrologjinë, të gjetura përmes kërkimeve astrologjike, datojnë nga kjo epokë. Në Babiloni, dijetarët mesopotamë vëzhgonin qiellin. Në çdo aspekt planetar, ata shikonin një ndeshje (dyluftim) ndërmjet zotave. Dhe meqë ajo që është lart ndodh edhe poshtë, ata kërkonin gjithmonë një incidencë sinkronizmi. Në këtë epokë, mitologjia dhe astrologjia përziheshin plotësisht. Planetët ishin zota (perëndi). Astrologjia ishte në shërbim të shtetit. Dëshmitë e shkrimeve më të vjetra të gjetura që flasin për astrologjinë datojnë që nga viti 1700 pr. e. s. Astrologët i bënin raporte mbretit. Qendrat astrologjike formonin një rrjet perandorak. Raportet e shkruar ishin mbi të gjitha një punë kolektive. Biblioteka në Ninivë ishte veçanërisht e orientuar drejt nevojave të astrologëve të mbretit. Sot, na mungojnë shumë dokumenta për të treguar këto histori. Nuk kishte asnjë formë të astrologjisë popullore që të jetë identifikuar (rregjistruar). Tabletat prej argjili kuneiformë janë vetëm dokumenta zyrtarë, që mund t'i përdorte vetëm mbreti. Këto informacione qarkullonin edhe mbi tableta

prej dylli ose me letra papirusi, por këto materiale janë delikate, që i rezistojnë shumë pak kohës. Shumë dokumenta qenë shkatërruar nga pushtimi persian në vitin 538 pr. e. s. Për më tepër, edhe niveli i ujrave është ngjitur përgjatë shekujve deri në atë zonë, duke shkatërruar informacionet. Na mbeten praktikisht vetëm dokumenta që janë caktuar për astrologjinë mbretërore. Astrologjia ishte një besim (fe); zotat e mitologjisë ishin planetët. Priftërinjtë mesopotamë i ruanin me fanatizëm privilegjet e tyre dhe nuk i linin dijet e tyre të dilnin nga tempujt.

Forma të ndryshme astrologjie ekzistonin gjithashtu në Indinë antike dhe tek Majatë e Amerikës qëndrore. Rreth vitit 500 pr. e. s, astrologjia u përhap në Greqi, ku filozofët si Pitagora i referoheshin asaj në studimet e tyre fetare dhe astronomike.

7. Astrologjia Kineze



Rrënjët e astrologjisë kineze gjenden në historinë e lashtë të njerëzimit. Legjenda thotë se Buda i kishte ftuar të gjitha shtazët që ta vizitonin për Vitin e Ri, por vetëm 12 shtazë i ishin përgjigjur ftesës së tij dhe ato ishin: miu, bualli, tigri, kali, dhia, gjeli, lepuri, dragoi, gjarpri, majmuni, qeni dhe derri.

Në shenjë mirënjohje, Buda kishte urdhëruar që secili vit të identifikohej me ndonjërën nga këto shtazë, ndërkaq tiparet e kësaj shtaze të zotëronin atë vit.

Kjo legjendë është bartur nga gjenerata në gjeneratë, ndërkaq astrologjia kineze sot është njëra prej astrologjive më të famshme në botë.

Kjo astrologji përbëhet nga 5 elementet e filozofisë kineze: druri, zjarri, toka, metali dhe uji; si dhe prej 12 shtazëve simbolike, që përfaqësojnë nga një vit të caktuar.

Horoskopi kinez paraqet një interpretim të ndërlikuar të ciklit 10-vjeçar të diellit dhe të hënës, që është hartuar në bazë të kalendarit të vjetër kinez. Në këtë astrologji ndikon edhe fuqia kozmike pozitive mashkullore dhe ajo negative femërore, të cilat i paraqet principi Jang-Jing; një shprehje për baraspeshën dhe harmoninë univerzale.

Astrologjia kineze është e njohur më shumë si shkencë që ua mundëson t'i mësoni karakteret e personave që u rrethojnë, por njëkohësisht edhe ta njihni fuqinë tuaj personale dhe të metat tuaja.

Horokopi Kinez bazohet mbi bashkimin e dates se lindjes me nje cikel te vecante te kohes, e cila percaktohet nga levizjet e henes. Cdo cikel ka nje zgjatje prej 60 vjetesh, gjate te ciles alternohen 12 sektoret, secila me nje zgjatje te nje viti henor qe konsiston ne 354 dite, sipas elementeve: **Uji, Metali, Zjarri, Toka dhe Druri**.

Uji – Te lindurit jane nen influencen e Ujit, jane ekstremisht te manovrueshem dhe fluide, ashtu siç e tregon edhe elementi I tyre. Jane shume krijues dhe per kete gje jane me shume te dhene pas artit dhe per nje jete te levizshme. Te arsyeshem dhe altruiste ju pelqen te udhetojne dhe te zbulojne kultura te reja.

Ngjyra e bashkangjitur: **E Zeze**.

Metali – Te lindurit e influencuar nga Metali jane te forte dhe virtuoze, ju pelqen te kene objektiva ambicioze, pretendojne shume nga vetja dhe nga kush i rrethon. Ne jete luftojne per te afirmuar vlerat e drejtesise dhe te ndershmerise, siç ndodh shpesh, fatkeqesisht pa arritur rezultatet e deshiruara, duke qene larg mundesive te tyre.

Ngjyra e bashkangjitur: **E Bardhe.**

Zjarri – Te lindurit nen elementin e Zjarrit jane plot energji dhe per kete edhe marrin "zgjarr"shume shpejt. Nga temperamenti jashtezakonisht I vendosur, ju pelqejne aktivitetet fizike dhe jetojne shume fizikisht raportet e tyre interpersonale. Adhurojne te rrijne ne ajrin e paster dhe shpesh jane mbrojtes te vendosur te ceshtjeve mbi ambientin.

Ngjyra e bashkangjitur: **E Kuqe**.

Toka – Ata qe kane lindur ne nje vit te influencuar nga elementi i Tokes jane te karakterizuar, nga nje kapacitet i madh per te perballuar ngarkesa te medha pune. Ne qofte se jane te motivuar ne menyren e duhur, do dine te arrijne cfaredolloj rezultati. Durimi eshte nje nga cilesite kryesore te tyre, edhe se e tejkalojne kufirin duke ja lene vendin rrembimeve te medha zemerimi.

Ngjyra e bashkangjitur: **Kafe**.

Druri – Ata qe kane lindur nen influencen e Drurit jane te lindur per te qene drejtues (leadership). Inteligjente dhe racionale, xhentile dhe

zemermedhenj, jane shpesh miq ideale, ose partnere shume te mire. Per te pasur sa me shume rezultate ne zotesine e tyre per te drejtuar, ata duhet te veprojne se bashku me nje grup personash, ku mund te gjejne se kush eshte me i zoti nder ta per te kryer detyren e drejtuesit.

Ngjyra e bashkangjitur: **Jeshile**.

8. Astrologjia Indiane/Vedike

Astrologjia vedike

Astrologjia Hindu (e njohur gjithashtu si astrologjia indiane dhe së fundmi si astrologjia vedike) është një sistem i lashtë indian i astronomisë dhe astrologjisë.

Astrologjia indiane është një shkencë e vjetër e bazuar në njohuritë e trashëguara nga dijetarët e lashtë indianë në ndikimet planetare. Ajo është zhvilluar shumë kohë përpara lindjes së astronomëve dhe astrologëve perëndimorë. Rrënjët e saj i kan ë Vedas dhe daton 1500 vjat para Krishtit.

Jyotish-Jyothisha ose Drita

Asnjënjë shkëncë tjetër nuk mund të jetë interesante, udhëzuese dhe e dobishme për njerëzimin për të ndihmuar në përparimin moral dhe material se sa astrologjia indiane. Astrologjia indiane bazohet në parashikimet e së ardhmes tek individët, kombet apo ngjarje të tjera që kidhen me lëvizjet planetare. Në sanskritisht, njihet si Jyotisha ose Drita.

Astrologjia indiane interpreton se çfarë thuhet për të ardhmen e njerëzimit në bazë të kohës së lindjes.

Degët e astrologjisë indiane

Astrologjia vedike ka tri degë kryesore:

1. Siddhanta (Astronomia): astronomia dhe përdorimi i saj në astrologji.

2. Samhita (Astrologjia e zakonshme): parashikon ngjarje të rëndësishme lidhur me vendet si luftërat, tërmetet, ngjarjet politike, meteorologjia (moti), gjendjet finansiare, përzgjedhjet, kafshët, paralajmërimet dhe oguret.

3. Hora (Astrologjia parashikuese).

Tekniket astrologjike indiane përdoren shumë në Indi dhe në botë për parashikimin e lindjeve, natyrës së martesave, karrierën, financën, sëmundjen, vdekjen e njërëzve. Përdoret gjithashtu në analizat e zakonshme për të parashikuar të ardhmen e vendeve, katastrofat natyrore.

Astrologjia indiane përdorë një zodiac ndryshe nga astrologjia perëndimore dhe është degë e shkencës vedike. Në Indi besimi në astrologji është shumë I përhapur dhe përdoret plotësisht në jetën e

zakonshme. Në perëndim kjo astrologji nisi të nxiste interes në fillim të viteve '90-të.

Ndryshe nga astrologjia perëndimore, astrologjia vedike lidhet më shumë me shkaqet natyrore dhe nuk përdoret për lotari dhe numra fati. Kohët e fundit, shkencëtarët indianë kanë propozuar që paratë e shtetit të përdoren edhe për kërkime në astrologjinë vedike, meqë është pjesë e trashëgimisë indiane dhe një shkencë që vazhdimisht mësojmë prej saj.

9. Horoskopi dhe Kalendari Maja

1. Horoskopi Maja

TZOOTZ – Lakuriqi i nates (26 korrik – 22 gusht)

Ne dashuri Lakuriqi i nates kalon neper faza te ndryshme; ai eshte protektiv, rojtar i shtepise, dhe drejtues i mire i shtepise. Por ndonjehere ata qe i perkasin kesaj shenje kane nevoje per vetmi per te ruajtur pavaresine e tyre. Ata duan te jene te barabarte me partnerin dhe te kene miqte dhe jeten e tyre me te cilen te jene te lidhur. Keta njerez kane nevoje ta adhuroje personin qe ka ne krah dhe te ndieje qe jane ne lartesine e dashurise se tjetrit. Ka nevoje t'i dale zot vetes por pa u lene pas dore nga partneri.

DZEC – Akrepi (23 gusht – 19 shtator)

Ne dashuri, te lindurit e kesaj shenje preferojne ta demostrojne dashurine e tyre me fakte dhe jo me fjale. Ndoshta nuk ju thote cdo pese minuta qe ju do shume, por e demostron kete duke ju ndenjur prane ne cdo moment qe ju mund te keni nevoje. Pergjithesisht jane njerez shume te drejte dhe besnike. Ata jane besnike ndaj partnerit dhe presin te njejten gje

prej tij. Dikush ka thene qe Akrepat kane "dhuraten e memories", ata mbajne mend cdo gje qe ju keni bere; qofte kjo e mire apo e keqe. Nese ju keni beret e mira, do jua kthejne plotesisht, por nese j keni beret e keqija, shpejt ose vone do ju beje ta paguani dyfish. Nje akrep nuk e harron kurre pabesine e te tjereve, dhe e ka te veshtire ta kaloje.

KEH – Dreri (20 shtator – 17 tetor)

Ne dashuri, dreri eshte nje shenje romantike nga natyra. Ata evonojne renien ne dashuri, dhe enderrojne nje dashuri ngjyre roze, ashtu si neper filmat e vjeter me fund te lumtur. Por kur bien ne dashuri me dike, Dreri e ka shume te veshtire te ndahet dhe te harroje personin qe i ka vjedhur zemren. Keshtu jane te gatuar dreret. Te mundoheni t'i ndryshoni do te ishte nje mission i pamundur.

MOAN – Bufi (18 tetor – 14 nentor)

Eshte nje person romantic por pak i veshtire. Dashuria per te nuk do te jete e lehte dhe do ta perplase shpesh deri ne momentin qe do te gjeje nje person qe korrepondon me te dhe ta doje tamam ashtu si Bufi e meriton te dashurohet. Jane njerez shume te dahsur ne fakt, dhe dashurohen edhe me ajrin qe marrin fryme, dhe eshte per kete arsye qe jo gjithmone zgjedhin personin e duhur me te cilin te dashurohen. Zakonisht, personat e kesaj shenje kalojne disa martesa ose lidhje deri sa me ne fund gjejne personin e duhur per to.

KUTZ – Palloi (15 nentor – 12 dhjetor)

Nese nje Pallua ju ka zgjedhur juve si mikun e tij, atehere ju duhet te jeni nje person me te vertete shume i vecante. Zakonisht, nese ndodh keshtu, ju duhet te jeni aq te cuditshem sa zakonisht eshte edhe vete ai. Ne nje lidhje dashurore Palloi ka nevoje te dashurohet dhe te adhurohet nga personi qe ata kane krah tyre.

KIBRAY – Hardhuca (13 dhjetor – 9 janar)

Te lindurit e shenjes se hardhuces gati gjithmone duan gjera qe te ndodhin me qetesi dhe nuk duan te bejne shume zhurme. Ata preferojne njerez te thjeshte dhe qe dine ta qepin gojen, ashtu si edhe ata vete. Kerkojne persona qe nuk u vene gjerat ne dukje dhe nuk ushtrojne presion mbi ta.

BATZ KIMIL – Majmuni (10 janar – 6 shkurt)

Ne cift, ata qe i perkasin shenjes se majmunit nuk jane aq te mire sa jane ne marredheniet shoqerore. Ata deshironin te ishin besnike dhe t'ja jepnin veten vetem nje personi, por… ne kete pike ata jane njerez shume jokonstante, levizin nga nje person tek tjetri dhe nga nje dashuri tek nje dashuri tjeter. Nese doni ta mbani nje majmun perhere krah jush, ju duhet t'i beni vazhdimisht surpriza, te jeni creative me jeten ne cift dhe te mbani gjithmone nje fare misteri. Kurioziteti e vret majmunin, dhe per aq kohe sa mendon se do te kete dicka per te zbuluar, ai do te rrije gjithmone prane jush.

KICK – Skifteri (7 shkurt – 6 mars)

Njerezit qe i perkasin kesaj shenje bien ne dashuri vetem nje here dhe kjo dashuri u zgjat per gjithe jeten. Dashuria e tyre e madhe, dashuria e pare do te ngelet gjithmone ne zemren e tyre dhe nuk do te mund ta harrojne kurre. Ata mund te provojne edhe nje lidhje apo martese, edhe nje te trete, por ne zemren e tyre e para do te kete gjithmone nje vend special. Dhe ata pas dashurise se pare, nuk do te mund kurre t'ja japin veten plotesisht nje dashurie tjeter, sado te provojne.

BALAM – Xhaguari (7 mars – 3 prill)

Ne dashuri, njerezit qe i perkasin kesaj shenje nuk heqin dore lehte. Ata do te provojne cfaredo te kene ne dore per t'ju bere per vete, dhe ka shume mundesi qe ju te bini te lodhur ne kembet e tyre. Do te filloni te pyesni veten se si ju beri te arrinit deri ketu. Personat e kesaj shenje bejne per vete dhe ato persona qe mendonin qe kurre nuk do te terhiqeshn nga persona te tille. Xhaguari eshte nje dashnor ekspert pasi di te gjitha sekretet e seksit. Eshte nje nga aftesite e tyre me te mira dhe ata jane te ndergjegjshem per kete.

FEX – Dhelpra (4 prill – 1 maj)

Te lindurit e shenjes se Dhelpres jante protective, menyra e tyre e te dashuruarit eshte e kujdesshme, dhe japin te gjithe vemendjen per te cilen dikush mund te kete nevoje. Te jeni te saigurt qe nje dhelper nuk e harron kurre nje dtelindje apo nje pervjetor. Njerezit te lindr ne kete shenje jane paqesore, dhe nevrikosen shume rralle. Ata preferojne te qetesohen, te dalin ne ajer te paster dhe te mendohen mire perpar se te bejne dicka jot e mire kunder nje personi. Por duhet treguar kujdes, pasi nese tejkalohen limitet, Dhelpra mund te nxjerre kthetrat dhe dhembet dhe te behet e rrezikshme. Megjithate nuk duhet te shqetesoheni shume pasi inati i tyre nuk zgjat shume dhe shume shpejt ata rikthehen tek fytyra e tyre e meparshme dhe behen serish te dashur. Do ju cudiste qe nje person aq i forte a nje dhelper, do te prekej me aq lehtesi perpara nje filmi dashurie.

KAN – Gjarperi (2 maj – 29 maj)

Kaq te sigurt ne vetvete ne jeten e tyre dhe ne profeionin e tyre, dhe ne dashuri jane krejt e kunderta. Gjarpri kerkon perkedhelje dhe dashuri. Dashuria per ta eshte ajri qe ju lejon te kuptojne qe jane gjalle. Ata do te ndryshonin te gjithe parate e tyre, famen e tyre, dhe fuqine e tyre, vetem per pak dashuri. Jane shume romantike. Kur bien ne dashuri ata lidhen shume me partnerin e tyre, dhe pa dashur e mbysin ate. Duhet patur shume kujdes dhe takt me nje gjarper te lenduar, pasi ai do t sulmoje ne menyren dhe ne momentin me te papritur, pasi jane te afte te vrasin dhe te vdesin nga dashuria.

KAN – Gjarperi (2 maj – 29 maj)

Kaq te sigurt ne vetvete ne jeten e tyre dhe ne profeionin e tyre, dhe ne dashuri jane krejt e kunderta. Gjarpri kerkon perkedhelje dhe dashuri.

Dashuria per ta eshte ajri qe ju lejon te kuptojne qe jane gjalle. Ata do te ndryshonin te gjithe parate e tyre, famen e tyre, dhe fuqine e tyre, vetem per pak dashuri. Jane shume romantike. Kur bien ne dashuri ata lidhen shume me partnerin e tyre, dhe pa dashur e mbysin ate. Duhet patur shume kujdes dhe takt me nje gjarper te lenduar, pasi ai do t sulmoje ne menyren dhe ne momentin me te papritur, pasi jane te afte te vrasin dhe te vdesin nga dashuria.

TZUB – Ketri (30 maj – 26 qershor)

Persa i perket dashurise te lindurit e kesaj shenje jane magnetike, i terheqin njerezit sikur te ishin magnet. Por ama nese dashurohen me nje person, ata bien ne kembet e atij personi. Ketri adhuron perkujdesje te vogla, dhe di te vleresoje nje gjest dashurie, edhe nese partneri shfaqet me nje lule te vyshkur, nje cokollate te thjeshte, apo me nje poezi te shkruar me gabime. Asgje nga keto nuk do ta shqetesoje, mjafton qe te di qe gjesti eshte bere me dashuri, dhe kjo do t'i shtoje drite dhe ngjyra gjithshkaje per te. Keshtu jane ketrat, romantike dhe enderimtare.

AAK – Breshka (27 qershor – 25 korrik)

Ju mund te mbeshteteni gjithmone ne nje mik te shenjes se breshkes. Kur vjen puna tk dashuria ata jane pak te turpshem, dhe nese prisni qe ikush i kesaj shenje te deklaroje ndienjat per ju, eshte gati e pamundur. Nje keshile do ishte qe te mos prisni shume fjale dashurie prej te lindurve te kesaj shenje. Dashurine qe ndieni beni mire te jeni ju qe t'ia shprehni.

2. Kalendari Maja

Simbolet e Zodiakut Maja janë një sistem astrologjik i krijuar nga majatë e lashtë, i bazuar në përllogaritje astronomike. Majatë përdornin tre sisteme kalendarike: Numërimi i Gjatë, Tzolkin dhe Haab.

Sistemi kalendarik Numërimi i Gjatë përllogariste kohën dhe datat sipas ngjarjve astronomike. Historianët mendojnë se data e fillimi të këtij sistemi ishte 5000 vjet më parë, 6 Shtator 3114 p. e. s, ndërsa data e fundit

21 Shtator 2012. Kalendari Tzolkin është 260 ditë, kohë e njëjtë me zgjatjen një shtatzanie, 20 shenja dite kombinuar me numrat 1 deri 13. Nuk përputhet me një vit kalendarik, pra nuk është i vlefshëm për çështje astronomike.

Kalendari Haab është i vetmi që ndjek atë standard, me afërisht 365 ditë në vit. Këtij kalendari i referohen smbolet zodiake të mëposhtme. Haab ka 18 muaj, me 20 ditë secili dhe një muaj të fundit që përmban 5 ditë pa emër në fund.

Shenjat astrologjike Maya

Kalendari Maja nuk duhet ngatërruar me atë Aztek. Shenjat astrologjike Maya ndahen në 19 shenja. Ka ende shumë mistere rreth astrologjisë majane. Kuptimi i saktë i shenjave astrologjike është i paqartë. Shumë interpretime moderne janë bërë, megjithëse jo të bazuara në kulturën dhe simbolikën maja. Dihet që shumë prej kuptimeve janë aspekte të kulturës së tyre, kohës, katër drejtimeve, astronomisë etj. , gjë që nuk ka kuptim për majatë e sotëm.

Ch'en: 2-21 Janar

Kuptimi: stuhi e zezë, qiell i zi, Hëna, një lule, Perëndim

Interpretimi: Të lindurit në shenjën Ch'en jan njerëz të natës. Kanë afrimitet m energji hënore. Drejtimi kryesor është Perëndimi dhe nëse drejtohen andej gjatë meditimit, kanë shumë përfitime.

Yax: 22 Januar – 10 Shkurt

Kuptimi: stuhi jeshileJug, Venus, dy lule, Jug

Interpretimi: Të lindurit në shenjën Yax kanë afrimitet me të lindurit në shenjën Yaxk'in. Venusi është planeti dominues dhe janë të butë e të dashur. Është dhuratë e madhe të jesh paqeruajtës në këto kohë dhe mund të bëjnë të mira në botë. Drejtimi kryesor është Jugu.

Sac: 11 Shkurt – 2 Mars

Kuptimi: stuhi e bardhë, bretkosë, konstelacioni i Bretkosës, tre lule, Veri

Interpretimi: Afrimitet me orët e ditës, mëngjesi është orë fuqie, pasi mund të përdoret për të fuqizuar dijen. Veriu është drejtimi kryesor dhe bretkosa është shenjë fuqie, përshtatshmërie dhe ndryshimi. Bretkosa simbolizon edhe kërcimin e lehtë nga një gjendje vetëdijeje në tjetrën. Fuqia qëndron në ndryshim.

Keh: 3 – 22 Mars

Kuptimi: stuhi e kuqe, pemë, dre, Lindje

Interpretimi: Të lindurit e kësaj shenje kanë simpati për natyrën dhe balncën e saj dhe mnund të ndihmojnë në kthimin e rendit natyral në planet me shembullin e vet. Kanë energjinë e zjarrit dhe të kuqen shenjë fuqie. Meditimi në pyje u zhvillon fuqi natyrore. Drejtimi kryesor është Lindja dhe kafsha totem fisniku i pyjeve, dreri.

Mak: 23 Mars – 11 Prill

Kuptimi: i mbyllur, mbulesë, zot i numrit 3

Interpretimi: Të linduritnë shenjën Mak janë një nga misteret e shenjave të astrologjisë majane, pasi kuptimi është shumë i errët, pra, edhe të lindurit janë mister. E mira është të rrinë pak larg të tjerëve, pasi vetë fjalët mbulesë dhe i mbyllur nënkuptojnë fshehje e largim. Duhet shpenzuar kohë në meditim e reflektim, pasi vetëm kështu zbulohen misteret e ekzistencës. Numri i fuqisë është 3: hyjnitet, balancë dhe plotësi.

K'ank'in: 12 Prill – 1 Maj

Kuptimi: Toka, qen, i verdhë, nëntokë, diell i verdhë

Interpretimi: Të lindurit në K'ank'in janë njerëz të Tokës dhe Diellit, me afrimitet për vendin ku vënë këmbët dhe rrezet diellore nga sipër. Meditimi në diell është dije, gjithashtu në tokë, mundësisht në shpellë, si në barkun e nënës tokë. Kafsha totem është qeni i verdhë. Qentë njihen për besnikëri e fuqi të brendshme.

Muwan: 2 – 21 Maj

Kuptimi: buf, zog vajtues, zot i shiut e reve, zjarr

Interpretimi: Të lindurit në shenjën Muëan kanë afri me zjarin dhe ujin, sidomos gjatë stuhive, ku zjarri dhe uji shfaqen me shi dhe rrufe. Bufi është totemi, i njohur nga majatë si zog vajtues, që ka aftësi vizuale dhe mund të shohë të vërtetën.

Pax: 22 Maj – 10 Qershor

Kuptimi: kohë mjelljesh, puma, avull, shigjetë, daulle

Interpretimi: Ata të shenjës Pax kanë totem Jaguarin, tepër i rëndësishëm për kulturën Maja. Ai përfaqëson lidershipin. Fuqia juaj qëndron si lider i njerëzve, përqafojeni këtë fuqi, bashkë me natyrën e drejtë të një shigjete dhe tingullin e fortë të një daulleje. Elementi juaj është avulli, përzierje mes tokës, ujit e zjarrit. Kombinojini këta elementë në jetë.

Kayab: 11- 30 Qershor

Kuptimi: breshkë, perëndesha e Hënës, Një

Interpretimi: Të lindurit në këtë shenjë kanë afrimitet natyor me Hënën dhe përpjekjet spirituale, duke gjetur veten në kërkime për kuptime të thella çdo ditë. Breshka është totemi, që është simbol i përcjelljes së dijes dhe mbajtëse të Tokës.

Kumk'u: 1 – 20 Korri

Kuptimi: drithë, kërrmill mbi misër, dy zota, errësirë, Itzamnas zoti i shiut dhe bimëve

Interpretimi: Të lindurit në shenjën e Kumk'u kanë natyrë të dyzuar, duke parë shpesh qartë të kundërtat dhe dijen që ato ofrojnë me nderim. Totemi është krokodili. Kanë dhuratën e mbijetesës, kohës dhe durimit. Krokodilët janë të paktët nga reptilët që i mbijetuan kohës së Mesozoikut, kur të dinosaurët u zhdukën. Nuk ndjekin çastin, megjithatë, fati është rreth tyre. Kjo është një dhuratë e mrekullueshme.

Wayeb: 21 – 25 Korrik

Kuptimi: ditë ters, zoti i Tokës, spektër, ditët e munguara (muaj i shkurtuar me 5 ditë)

Interpretimi: Të lindurit e kësaj shenje janë të çrregulltit e astrologjisë maja. Koha e Wayen është vetëm 5 ditë në vit, në ndryshim me 20 ditët që shoqërojnë shenjat e tjera zodiake maja. Gjatë ditëve të Wayeb, majatë ndjenë balancën natyrale të ndryshonte, kohë kur forca të tjera u futën në lojë, gjë e ngjashme m konceptim Samhain, ku shpirtrat ecnin mbi tokë. Megjithatë, të lindurit e kësaj shenje nuk është se janë të pafat, vetëm se janë të lidhur me botë e realitete të tjera. Shfrytëzojeni këtë, pasi keni aftësi ndjesore më shumë, esp, dhe vajtje-ardhje mes kësaj bote e tjetrës.

Pop: 26 Korrik – 14 Gusht

Kuptimi: jaguar, kryetar, lider, tokë e butë

Interpretim: Të lindurit nën Pop janë liderë. Jaguari dhe kryetari janë pozicione të fuqishme për majatë antikë. Mund të sllni qartësi dhe drejtim për të afërmit, ndërsa jeni të ndjeshëm ndaj tyre. Aftësia juaj fuqizohet duke medituar në tokë, me të cliën keni afrimitet.

Wo: 15 Gusht – 3 Shtator

Kuptimi: qiell i zi, jaguar i zi, stuhi e zezë, natë, bretkosë, 2 toka të buta

Interpretim: Të lindurit e kësaj shenje janë të afërt me ata të shenjës Che'n dhe Sac. Mund të merrni dije nga orët e natës dhe totem keni bretkosën, me të cilën kaloni nga një gjendje vetëdijeje në tjetrën. Jeni si një njeri mistik që kërkon për dije e mistere të fshehura.

Sip: 4 – 23 Shtator

Kuptimi: ndërthurje e kuqe, qiell i kuq, dre, mashkull

Interpretimi: Të lindurit në Sip kanë dobësi për zjarrin dhe ajrin. Kafsha totem është dreri, sidomos ai mashkull, simbol i hijeshisë dhe lidhjes me pyllin. E kuqja është ngjyra juaj.

Sotz: 24 Shtator – 13 tetor

Kuptimi: lakuriq nate, peshk, 2 myshqe, fillim dimri

Interpretation: Të lindurit e shenjës së Sotz kanë dy kafshë totem: lakuriqin e natës dhe peshkun, lëvizjen në ajër dhe në ujë, të cilët janë elementët tuaj. Nga totemët tuaj merrni ndjesinë, intuitën dhe aftësinë të shikoni përmes iluzionit, ndërgjegjen dhe thellësinë, gjëra që nuk janë të përhapura ndër shumë njerëz.

Sec: 14 Tetor – 2 Nëndor

Kuptimi: Qiell dhe Tokë

Interpretimi: Ata të shenjës Sec janë veçanërisht të lidhur me tokën dhe qiellin (erën, ajrin). Jeni të interesuar për gjërat që vijnë nga lart. Ajri është element energjish mendore dhe toka element prakticiteti. Mes këtyre, keni aftësinë të ekzaminoni mirë situata dhe të gjeni zgjidhje efektive, dhuratë shumë e madhe kjo, që ju ndihmon të lëvizni me këmbë në tokë.

Xul: 3 – 22 Nëndor

Kuptimi: qen, ditët e zogut, qeni zot

Interpretimi: Të lindurit e kësaj shenje janë shumë të lidhur me qenin, si totem të tyrin. Qeni ishte kafshë e rëndësishme për majatë, që besonin se i shoqëronte të vdekurit e tyre në jetën e përtejme. Të lindurit nën Xul janë besnikë, të fortë, të dedikuar. Gjithashtu kanë lidhje të formta me botën tjetër dhe ndihmojnë ata që janë afër tyre të mos kenë frikë nga vdekja.

Yaxk'in: 23 Nëndor – 12 Dhjetor

Kuptimi: diell i ri, zoti diell, re të kuqe, jeshile

Interpretimi: Të lindurit e Yaxk'in kanë lidhje me zotin majan diell Ah Kin. Ai siguron mbrojtje nga errësira, thatësira e sëmundjet, prandaj këta të lindur janë shërues, qoftë me fjalë ose me vepra. E vetmja e keqe e tyre është dyshimi, si Ah Kin. Mësoni të besoni në vendimet tuaja dhe të atyre që ju rrethojnë.

Mol: 13 Dhjetor – 1 Janar

Kuptimi: ujë, bashkim resh, jaguar

Interpretimi: Të lindurit e kësaj shenje janë të lidhur me elementin kardinal të ujit. Thuhet se ata "bëjnë shiun të bjerë". Kushtojini vëmendje sesi ju bën të ndiheni koha, pasi fuqia juaj qëndron në ujë dhe shi. Totemi është jaguari, kafshë e fuqishme për majat, dhe përfaqëson misteret e shamanit e fuqinë e liderëve. Kjo mund t'ju çojë në rolin e një lideri shpirtëror në jetë.

10. Astrologjia dhe religjioni

Krishtërimi është një parodi e kultit të Diellit, ku në vend të këtij të fundit vendoset një njeri i quajtur Jezu Krisht, njeri që adhurohet në të njëjtën mënyrë sikurse në zanafillë adhurohej Dielli.

Tek testamenti i Ri i vendoset krishtërimit një sfidë provokuese, shumë serioze. Duke qenë se është diçka e lidhur pikërisht me argumentin e trajtuar prej nesh, do ta citojmë drejtpërdrejt nga burimi : "…nëse Krishti nuk është ringjallur, atëherë është i kotë predikimi ynë dhe është i kotë edhe besimi juaj. Ne, mandej, rezultojmë deshmitarë të rremë të Zotit….

Nëse Krishti nuk është ringjallur, është i kotë besimi juaj dhe ju jeni ende në mëkatet tuaja". (Letra e parë e Shën Palit drejtuar korinthasve, 15, 14-17). Le të analizojmë me vëmendje se cilat janë konceptet themelore që qëndrojnë në bazën e besimit dhe le të nxjerrim pastaj rrjedhimet tona. Për të bërë këtë nuk është e nevojshme të kthehemi dy mijë vjet përpara tek lindja e Krishtit, por duhet të arrijmë deri tek dhjetë mijë apo pesëmbëdhjetë mijë vjet më parë, deri tek lindja e njeriut modern, sepse për të përcaktuar themelet e diçkaje është e nevojshme të shkohet pikërisht tek zanafilla.

Mijëra vjet më parë, në atë që zakonisht e quajmë "bota primordiale"e njerëzve të lashtë, jeta njerëzore ishte një përvojë shumë e ndryshme nga ajo e ditëve tona.

Edhe pse në krahasim me epokën tone zotërojmë më pak dokumenta në lidhje me botën parahistorike, njohim megjithatë një numër të mjaftueshëm tekstesh të lashta, nga të cilat mund të nxjerrim një kuadër mjaft të qartë të atyre kohërave të largëta.

Nëse kemi mësuar vërtetë diçka, ajo është kjo: "Sa më shumë ndryshojmë, aq më shumë mbetemi të njëjtë"; si dëshmim i kësaj nuk ka asgjë më të mire se sa kërkimi i vazhdueshëm i njerëzve për një "përëndi"dhe besimet e lashta që ende sot i quajmë të shenjta.

Sipas asaj që kemi mundur të kuptojmë prej dokumenteve të disponueshme, jeta e të parëve tanë më të largët ishte një përzierje mrekullie dhe frike. Çdo ditë, kërkimi i ushqimit për familjen e vet, pa u bërë ushqim për dikë tjetër, ishte një luftë kundër vdekjes, dhe qëndron pikërisht në këto kushte të vështira e të ankthshme fakti që njeriu filloi të kërkonte perëndi dhe domethënien e fundit të jetës.

Që në fillim njeriu kërkonte përgjigje për pyetjet e tij. Në çastin që njeriu e kuptoi se nga universi nuk do të kishin ardhur përgjigje të qarta, ai vështroi brenda vetes dhe i trilloi vetë. Studimi i kësaj fushe quhet Astro-Teologji, ose nderim i qiejve. Njeriut të lashtë pastaj nuk iu desh shumë të kuptonte se armiku më i madh, prej të cilit duhet të kishte frikë, ishte errësira e natës: pikërisht kështu, armiku i parë i njeriut ishte errësira.

Duke kuptuar këtë, mund të merret vesh me lehtësi se përse aleati më besnik i njeriut ishte dhurata më e madhe e qiellit për botën, ylli i lavdishëm që lind ditën: Dielli. Pasi është qartësuar kjo e vërtetë, mundemi tani të fillojmë të tregojmë një histori të lashtë e të mrekullueshme që, ashtu sikurse ndodh që në kohët që s'mbahen mend, është treguar përsëri: historinë e krishtërimit, "historinë më të madhe"të treguar ndonjëherë.

Por është e nevojshme të kuptohet se ngjashmëritë midis metaforave të krishtera dhe natyrës së Diellit e të qiellit janë aq të qarta saqë përfaqësojnë vërtetë krejt historinë.

Krishtërimi modern shpesh i ka zvogëluar të parët tanë, të cilët nuk janë më këtu për t'u mbrojtur, duke i akuzuar se nuk kanë që asgjë tjetër veçse ithtarë injorantë të një vargu të larmishëm perëndishë.

Si pasojë, shkurt mund të hedhim poshtë katërmbëdhjetë mijë vjet spiritualiteti njerëzor, sikur të ishte fjala thjesht për mite prej budallai, tek të cilat besonin njerëz primitive qëllimmirë, por pak naivë. Ka pasur tepër arrogancë shpirtërore dhe mendjemadhësi fetare, pa thënë gjë askush…deri tani! Ka ardhur koha për t'i vënë gjërat në vendin e tyre.

Le të shohim atëherë se për çfarë flet "historia më e madhe"e botës. Njerëzit e lashtë mendonin se askush nuk mund të ngrinte pretendime zotërimi mbi yllin e madh të ditës, pasi ai i përkiste krijuesit të panjohur të

universit. Në mënyrë metaforike, mund të thuhet se ai ishte perëndia Diell, dhe jo njeri: "perëndia Diell"ishte "drita e botës".

Sikurse është thënë më lart, në errësirën e ftohtë të natës njeriu u bë i vetëdijshëm për dobësinë e tij absolute kundrejt elementeve të natyrës: çdo natë njerëzit ishin të detyruar të prisnin lindjen e Diellit, për të dëbuar atë ndjenjë pasigurie fizike e mendore që sillte errësira. Kështu që, falë Diellit, njeriu e kuptoi se sa shumë varej nga qielli ekzistenca e tij e brishtë dhe e shkurtër nëTokë. Ja përse Dielli u bë një simbol i përshtatshëm për të përfaqësuar dashamirësinë qiellore.

Mendohej se perëdia Diell ishte pjesa e dukshme e krijuesit të padukshëm, që banonte në qiell; për këtë arsye thuhej: "Kur sheh Birin, sheh dhe Atin", ose: "Ati është lëvduar tek Biri i tij".

Njerëzit e lashtë e kishin kuptuar se jeta varej nga energjia e dhënë nga Dielli dhe se, si rrjedhojë, ata nuk mund të jetonin pa Diellin: si përfundim Perëndia Diell ishte shpëtimtari i tyre.

Llogjikisht, edhe pse sidoqoftë njerëzit vdesin, gjer atëherë kur Dielli do të vazhdojë të lindë, jeta në Tokë do të vazhdojë përgjithmonë. Prandaj tekstet e lashta thoshin se jeta e përjetshme ishte "dhurata"që atij jep nëpërmjet Diellit të tij. Jo për dike në mënyrë të veçantë, por për tërë Tokën: jetën e përjetshme!

Por duke qënë se gjëra të këqija vazhdonin të ndodhinin në errësirën e frikshme të natës, të gjitha veprimet e liga dhe të dhimbshme i atribuoheshin natyrisht "errësirës". Dhe, natyrisht, ishte "princi i errësirës"ai që shkaktonte të keqën që ndodhte natën, e keqja pra ishte errësira, djalli.

Ja pra ku ishin dy vëllezërit kozmikë: njëri shumë i mirë (Dielli/drita = Zoti), tjetri shumë i keq (errësira = djalli). Njëri është ai që nxjerr të vërtetën në dritë nëpërmjet "dritë së të vërtetës", tjetri është ai që i kundërvihet dritës, "kundërshtari", princi i botës së errët.

Në këtë pikë gjendemi në Egjipt. Këtu, më shumë se tre mijë vjet para se të lindte krishtërimi, "Dielli/shpëtimtari"i mëngjesit paraqitej figurativisht si një i porsalindur shpëtimtar dhe emri tij ishte Horus.

Në agim, ky i porsalindur i mrekullueshëm, natyrisht, "lind përsëri"(haleluja), Horusi lind në horizont.

Dhe, natyrisht, "perëndia Diell"ndeshet me vdekjen duke mbajtur një "kurorë me gjëmba"apo një "brerore". E kini parasysh Statujen e Lirisë? Ende sot e kësaj dite mbretërit mbajnë kurora me maja që simbolizojnë rrezet e Diellit!

Egjiptianët e dinin se Dielli ndodhej në pikën më të lartë të qiellit në mesditë, ku piramida nuk projektonte asnjë hije, dhe në atë çast i gjithë Egjipti i lutej perëndisë më të madhe, Diellit. Dhe, sikurse u tha më lart, njerëzit e lashtë e konsideronin qiellin si selinë, ose si tempullin qiellor, të

perëndisë më të madhe: kështu që perëndia Diell bënte punën e atit të tij qiellor në tempull në mesditë!

Njerëzit e lashtë i përcaktonin kohën dhe stinët në bazë të lëvizjes së Diellit, duke caktuar në këtë mënyrë ditë, muaj, vite; instrumenti i përdorur ishte ora diellore (vija e mesditës), që rregjistronte jo vetëm lëvizjen ditore të Diellit, por edhe krejt vitin, që tregohej në një kalendar të rrumbullakët.

Popuj të ndryshëm të lashtë e përdorinin orën diellore: meksikanët e lashtë, majatë, inkasit, aztekët, sumerët, babilonasit, asirët, egjiptianët, keltët, arianët etj. Kjo mënyrë për të matur kohën bëri që të lindnin ide të reja në mendjen e njerëzve të lashtë.

Duke qënë se toka ka katër stinë të ndryshme të njëjta në të gjithë vitet, kalendari I rrumbullakët qe ndarë në katër pjesë të barabarta, që përfaqësonin historinë e plotë të jetës së perëndisë Diell. Në pikurë e famshme të Darkës së fundit paraqiten dymbëdhjetë apostujt e birit të Zotit, të ndarë me katër grupe me nga tre: janë pikërisht katër stinët e vitit me nga tre muaj secila!

Nëse mbi sipërfaqen e rrumbullakët të kalendarit vjetor vizatohet një vijë vertikale që e pret rrethin në mes, në njërin skaj të kësaj vije do të jetë solstici i dimrit, në tjetrin solstici i verës; nëse vizatohet pastaj një tjetër vijë horizontale që formon një kryq me të parën, në njërin skaj të kësaj vije të re do të jetë ekuinoksi i pranverës dhe në tjetrin ekuinoksi i vjeshtës.

Ja pra ku janë paraqitur katër pikat e fillimit të katër stinëve. Në të gjitha enciklopeditë më të rëndësishme dhe edhe në librat, qofshin të vjetër apo modern, i referohen këtij kryqi si "Kryqi i Zodiakut". Për këtë arsye jeta e perëndisë Diell zhvillohet në kryq; ja përse mbi kryqet e kishave të krishtera është rrethi diellor: kur të shkoni në kishë vëreni mendjen tek Dielli që është në kryq.

11. Astrologjia sipas fesë islame

Dijetarët e hershëm muslimanë e quanin fushën e yjeve dhe llogarive planetare në tërësi me emrin Tenxhim dhe ata e ndanin atë në tre kategori kryesore për qëllim analizimi dhe klasifikimi sipas ligjit Islam.

1. Kategoria e parë paraqet besimin se qëniet tokësore influencohen nga trupa qiellorë dhe çfarë do ndodhë në të ardhmen mund të parashikohet nga vëzhgimi i lëvizjeve të këtyre trupave. [104] Ky besim, që njihet me emrin astrologji dhe që e ka origjinën e tij në Mesopotami në mijëvjeçarin e tretë p. e. s. , arriti zhvillim të plotë në civilizimin grek. Gjithashtu forma më e vjetër Mesopotamiane e tij arriti në Indi dhe Kinë në shekullin e 6 p. e. s. , por në Kinë u adoptua vetëm parashikimi i të ardhmes nga yjet. nga shenjat në qiell. Besimi bazë në Mesopotami ishte se

trupat qiellorë ishin zota të fuqishëm. Kur këto yje-zota u paraqitën në Greqi, në shekullin e 4 p. e. s. , u bënë burim për besimin planetar grek. Gjithashtu në Greqi astrologjia si një "shkencë"e përcaktimit të së ardhmes u përhap dhe jashtë oborrit mbretëror te ata që mund t'a kapnin atë. [105] Për më shumë se 200 vjet astrologjia kishte një influencë dominuse mbi fenë, filozofinë dhe shkencën pagane e më pas pati ndikim të madh te Europa kristiane. Të dy Dante dhe sh. Thomas Aquinas, evpropianë të shekullit të 13, pranuan shkakun astrologjik në filozofitë e tyre respektive (d. m. th. pranuan astrologjinë sh. p.). Ky besim mbahej edhe nga Sabianët tek të cilët u dërgua i dërguari Ibrahim a. s. Sabianët hyjnizonin diellin, hënën dhe yjet dhe i bënin sexhde atyre. Gjithashtu ata ndërtonin vende të veçanta adhurimi në të cilat vendoseshin statuja dhe piktura që paraqisnin trupa qiellorë. Ata besonin se shpirtrat e trupave qiellorë zbritnin te idhujt, komunikonin me ta dhe plotësonin kërkesat apo nevojat e njerëzve. [106] Kjo formë e astrologjisë konsiderohet kufër sepse shkatërron teuhidin Esmaa ues-Sifaat. Besime të tilla i japin planeteve, yjeve dhe galaktikave disa prej cilësive të Zotit. (Cilësia e Zotit që i jepet më shumë krijesave në këto besime është Kaderi). Ata që praktikojnë astrologjinë janë kafira sepse ata deklarojnë se dinë të ardhmen e cila dihet vetëm nga Allahu. Duke ia atribuar vetes disa prej cilësive të Allahut ata iu "ofrojnë"atyre që besojnë te ta një mundësi fallse për të mënjanuar të keqen të cilën Allahu e ka përcaktuar për ta dhe për të fituar të mirën të cilën Allahu nuk e ka përcaktuar për ta. Astrologjia klasifikohet harram bazuar në hadithin e Ibn Abasit ku resuli s. a. u. s. ka thënë: "Kushdo që merr dije nga ndonjë degë e astrologjisë ka marrë dije nga një degë e magjisë. Sa më shumë që e shton (rrit, zmadhon) dijen në këtë gjë aq më shumë ai e shton (rrit, zmadhon) gjynafin. "[107].

2. Në kategorinë e dytë futen ata që thonë se Allahu ka dashur (ka bërë) që lëvizja e trupave qiellorë të tregojë ngjarjet që ndodhin në tokë. [108] Ky është edhe besimi i astrologëve muslimanë të cilët mësuan dhe praktikuan shkencën babilonase të astrologjisë. Astrologjia u shfaq në oborrin mbretëror nga halifët e vonshëm Emevij ashtu siç u shfaq te Abasitë e parë. Secili halif, nga këta që u përmendën më sipër, kishte një grup astrologësh që duhet t'a këshillonin atë për punët e ditës dhe t'a paralajmëronin për rreziqet që afroheshin. Për shkak se masat muslimane e dinin se astrologjia në formën e saj origjinale ishte kufër këta muslimanë që donin t'a praktikonin atë bënë një kompromis që ajo të dukej nga ana Islame e pranueshme. Dhe ky kompromis ishte thënia se parashikimet astrologjike ishin sipas dëshirës së Allahut. Por edhe kjo formë e astrologjisë është harram dhe ai që e praktikon atë konsiderohet kafir. Sepse në të vërtetë nuk ka ndryshim në esencë midis këtij besimi dhe atij të paganëve. Në këtë lloj besimi fuqia e Allahut i jepet trupave qiellorë dhe ata që thonë se interpretojnë informacionin e këtyre trupave pohojnë se

kanë dije për të ardhmen, dije e cila i përket vetëm Allahut. Megjithatë disa dijetarë të vonshëm u bënë të dobët në zbatimin e ligjeve hyjnore dhe lejuan këtë formë të astrologjisë për shkak se ky besim ishte bërë i pranueshëm nga shumë muslimanë.

3. Në kategorinë e tretë dhe të fundit futet përdorimi i informacionit të yjeve nga lundërtarët ose udhëtarët e shkretëtirave në mënyrë që të përcaktojnë drejtimet, ose nga fermerët për të përcaktuar arritjen e stinëve në mënyrë që ata të dinë kur të kultivojnë drithërat etj. [109] Këto ose praktika të ngjashme me to paraqesin aspektin e vetëm të astrologjisë që është hallall për muslimanët në përputhje me Kur'anin dhe sunnetin. Argumenti për këtë është ajeti i mëposhtëm i Kur'anit:

"Ai është, që krijoi yjet për ju që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det ..." (6:97)

Buhari transmeton thënien e mëposhtme nga Kataadeh:[110] "Allahu i bëri yjet për të treguar drejtimin (e udhëtimit) dhe për goditjen e shejtanëve. Kështu që, kushdo që kërkon ndonjë gjë përtej kësaj ka spekulluar. Ai ka lënë fatin e tij, ka humbur pjesën e tij të jetës së mirë, dhe ka marrë përsipër atë për të cilën ai nuk ka dije. Me të vërtetë, ata që e bëjnë këtë janë njerëz injorantë ndaj urdhërave të Allahut. Ata kanë shpikur hyjnizimin për yjet, duke thënë se kush martohet sipas filan ylli do t'i ndodhë kjo ose ajo gjë, ose kush udhëton sipas filan ylli do të gjejë këtë ose atë gjë. As yjet, as kafshët e as shpendët nuk dinë ndonjë gjë prej të padukshmes. Allahu duhet t'ia kishte mësuar atë Ademit n. q. s. Ai do donte t'ia mësonte atë dikujt. Allahu e krijoi Ademin me duart e Tij, i bëri melekët t'i përkuleshin atij dhe i mësoi atij emrat e gjërave." Kufizimet e vëna nga Kataadah për përdorimin e yjeve bazohen mbi ajetin 98 të sures En'aam që u përmend më sipër. Gjithashtu ajo bazohet në ajetin e mëposhtëm:

"Ne qiellin me të afërt e kemi zbukuruar me kandila (yje ndriçues) dhe ata i kemi bërë gjuajtës kundër djajve, ..." (67:5)

Resuli s. a. u. s. ka shpjeguar se xhinët ndonjëherë udhëtojnë në qiell dhe përgjojnë melekët kur ata bisedojnë midis tyre për ngjarje që do të ndodhin në tokë. Xhinët pastaj kthehen në tokë dhe informojnë ata që merren me parashikimin e të ardhmes. Ai gjithashtu ka shpjeguar se Allahu përdor goditjet me yje për t'i larguar ata (xhinët) dhe për të parandaluar përgjimin përveç rasteve të rralla. Resuli s. a. u. s. ka thënë edhe se parashikimet e fallxhorëve janë përzierje e pak të vërtetave me qindra gënjeshtra. [111] Prandaj muslimanët janë të detyruar të ruhen nga përdorimi i yjeve për qëllime të tjera veç atyre që janë përcaktuar qartë nga Allahu.

12. Astrologjia bimore

Astrologjia ka qënë përdorur për një kohë të gjatë në profesionet mjekësore për diagnozat e sëmundjeve dhe për të zbuluar sëmundjet e mundshme. Nicholas Culpeper (1616 – 1654) mjek dhe herbalist i famshëm e përdori astrologjinë për ilaçet e tij barnore (herbale). Harta e lindjes do të përdorej për diagnozë dhe Culpeper do ta trajtonte sëmundjen duke iu përshtatur asaj. Ai njihet për thënien e tij: "Vetëm astrologët janë të përshtatshëm për ta studiuar mjekësinë dhe një mjek pa astrologji është si llampa pa energji (si kandili pa vaj)".

Duke iu referuar njerëzve të lashtë, një planet i vendosur në një shenjë të caktuar mund të tregojë një dobësi (ligështi), e cila i nënshtrohet kushteve të duhura, mund të tregohet me dëmtime, sëmundje, madje dhe me ngjarje fatale. Kjo varet kryesisht në aspektet midis planetëve në hartën e lindjes dhe në tranzitet që formojnë midis tyre. Për shembull, Saturni duke qënë i pozicionuar në Bricjap dhe duke qënë njëkohësisht sundues i kësaj shenje, mund të tregojë një prirje për sëmundje të keqe apo dëmtime që prekin kockat/gjunjët.

Secila shenjë zodiakale përfaqëson një pjesë (fushë) të trupit, duke nisur me Dashin që sundon kokën, Demin që sundon pjesën e fytit dhe kështu me radhë. Shenjat vazhdonjë me radhë duke zbritur natyrshëm përgjatë trupit dhe duke përfunduar tek Peshqit që kanë këmbët.

Harta e lindjes dhe astrologjia mjekësore

Pikat kryesore që duhet të merren parasysh kur studjojmë një hartë lindje nga pikëpamja mjekësore janë:

Shenja diellore – kjo është një forcë e natyrshme jetësore tepër e rëndësishme. Pozicioni i Diellit shpesh tregon një pikë të dobët, siç ndodh te Dashi që sundon kokën, Demi qafën dhe me radhë. Kjo ndikon më shumë kur Dielli ndodhet në pozicion negativ.

Hëna - Rrjedha e forcave të jetës përmes trupit, lëngjet që ndihmojnë të ruajnë (mbajnë) trupin. Gjithashtu mirëqënia emocionale. Hëna është veçanërisht e rëndësishme tek hartat e femrave meqë përfaqëson të gjitha aspektet e cikleve të femrave dhe nënave (grave). Edhe Hëna përfaqëson një pikë të dobët në lidhje me shëndetin, sidomos nëse është në pozicion të keq.

Ashendenti – Ky sundon trupin në tërësi, pamjen e jashtme (formën) dhe mirëqënien e përgjithshme. Planetët kuadrat ose opozitë Ashendentit, ose një planet i keq përkrah tij, shpesh tregojnë dëmtim të mundshëm ose sëmundje që mund të theksohet nga tranzitet.

Shtëpia e gjashtë – Kjo është shtëpia e shëndetit, lidhur natyrshëm me Virgjëreshën. Shenja ku bie pika e kësaj shtëpie dhe planeti i saj drejtues është sundues i shëndetit në hartë. Planetët e vendosur në këtë shtëpi

përshkruajnë gjithashtu shëndetin dhe sëmundjet e mundshme apo aksidentet. Planeti që sundon shenjën në pikën e shtëpisë së gjashtë do të tregojë me anë të pozicionit të tij në hartë një tjetër pikë të dobët. Për shembull, Bricjapi duke qënë në pikën e shtëpisë së gjashtë, që sundohet nga Saturni, dhe Saturni duke qënë i pozicionuar në shenjën e Peshqve tregon një mundësi sëmundjeje në lidhje me këmbët. Në mënyrë të ngjashme, shenja në pikën e kësaj shtëpie mund të tregojë këtë ashtu siç ndodh te Bricjapi që sundon kockat dhe lëkurën. Aspektet me këto pika të hartës tregojnë natyrën e mundshme të një sëmundjeje apo të trajtimit dhe kurimit. Nga aspekti mund të shikohet se çfarë duhet bërë për të shmangur sëmundjen apo për t'u shëruar.

Harta decumbiture (e momentit kur bie i sëmurë në shtrat) në astrologjinë mjekësore

Kjo është një lloj harte e veçantë që ndërtohet në bazë të vendit dhe kohës kur fillon sëmundja apo kur ndodh dëmtimi (plagosja). Mund të përdoret më vete si harta e sëmundjes për diagnozë dhe trajtim apo për hartën e lindjes thjesht si hartë tranzitesh. Teknikat e përdorura përhartën decumiture (e momentint e sëmundjes) janë shumë të ngjashme me ato që përdoren në astrologjinë horare dhe atë të përzgjedhjes.

Shtëpitë në hartën e momentit të sëmundjes (harta decumbiture = moment kur sëmuret njeriu)

Në hartën e momentit kur njeriu bie i sëmurë (shtrihet në shtrat) vëmendja përqëndrohet në pesë shtëpi në veçanti. Të cilat janë:

- Ashendenti/ shtëpia I: trupi i pacientit, gjallëria dhe shëndeti i përgjithshëm.
- Shtëpia VI: sëmundjet (dobësitë) apo dëmtimet.
- Shtëpia VII: vlerësimi (mendimi) i mjekut apo i cilitdo që kujdeset për pacientin.
- Shtëpia VIII: vdekja e pacientit.
- Shtëpia X: ilaçt e nevojshme / e duhura

Janë sunduesit planetarë të këtyre shtëpive që bëhën domethënës për çdo gjë. Gjithashtu, ashtu si në astrologjinë horare, e rëndësishme është edhe Hëna. Meqë Hëna sundon lëngjet e trupit, ajo përfaqëson rrjedhën e forcës jetësore (Diellin) përgjatë trupit. Hëna me lëvizjet e saj tregon se çfarë ndodh kur formon aspekte me planetët duke treguar kështu rrjedhën (motivin) e një sëmundjeje, trajtimin e saj dhe rezultatin e mundshëm.

Të gjesh domethënës të përshtatshëm – Planetët

Vetëm shtatë planetët tradicionalë (Dielli, Hëna, Merkuri, Venusi, Marsi, Jupiteri dhe Saturni) përdoren në këtë lloj astrologjie mjekësore. Domethënësi i pacientit është sunduesi i shenjës që bie në Ashendent. Për shembull: nëse shenja ashendent është Binjakët, domethënësi do të jetë Merkuri meqë është planeti sundues i kësaj shenje. Merkuri do të përfaqësojë pra pacientin dhe gjendjen e shëndetit të tij në përgjithësi duke u varur nga pozicioni dhe aspektet që formon. Domethënësi i sëmundjes apo dëmtimit të pacientit do të jetë sunduesi i shenjës që bie në pikën e shtëpisë së gjashtë. Për shembull: nëse shenja që zë pika e shtëpisë së gjashtë është Akrepi, domethënësi do të jetë Marsi meqë është planeti sundues i asaj shenje (tradicionalisht përpara zbulimit të Plutonit, dhe tani bashkë-sundimtar). Marsi lidhet me temperaturën e trupit dhe si pasojë me ethet, pezmatimet etj. Dhe me vendosjen e tij mund të lokalizojë zonën problematike të shëndetit. Nga gjendja e Marsit në lidhje me Vlerësimet (Dignity), është e mundur të përcaktohet serioziteti i sëmundjes apo dëmtimit. Çdo domethënës përkatës është gjetur siç përshkruhet më sipër. Rendi i 12 shtëpive lidhet me rregullin natyror të shenjave të zodiakut në lidhje me anatominë dhe lidhet aq fort me pjesët e trupit. Pra domethënësi për ndonjë pjesë të trupit do të jetë sunduesi i çdo shenje që i ndodh të bie në pikën e shtëpisë përkatëse.

Për shembull: domethënësi i gjunjëve (qeverisur nga Bricjapi) do të jetë planeti sundues i shenjës në pikën e shtëpisë së dhjetë (shtëpia natyrore e Bricjapit). Nëse Dashi do të ishte në pikën e shtëpisë së dhjetë, domethënësi do të ishte Marsi (sundues i Dashit). Pra Marsi do të ishte domethënësi i gjunjëve.

Fuqia e planetëve

Sapo domethënësit përkatës të jenë gjetur hapi tjetër është të merret në konsideratë fuqia e tyre. Fuqia e planetëve varet nga pozicioni i tyre. Nëse planetët janë në shenjën e tyre, në ngritje, rënie apo mërgim si dhe në vlera të tjera.

Shikoni gjendjen e përgjithshme të pacientit duke gjetur domethënësin dhe duke përcaktuar fuqinë e tij, d. m. th a është sunduesi i ashendentit i fortë apo i dobët si pozicion?

Vlerësoni nivelin e energjisë së pacientit, duke shqyrtuar gjendjen e Diellit, symbol i forcës jetësore dhe gjallërisë së përgjithshme. Vlerësoni nivelin emocional të pacientit duke shqyrtuar gjendjen e Hënës, meqë ajo do të tregojë aftësinë e përballjes me anën emocionale të sëmundjes si edhe të rrjedhës së përgjithshme të forcës së jetës.

Aspektet midis sunduesit të ashendentit dhe planetëve të këqinj Marsit dhe Saturnit tregojnë një dobësim të gjallërisë së pacientit. Nëse sunduesi i ashendentit është retrogradë, edhe kjo gjithashtu tregon një

dobësim. Aspektet ndërmjet sunduesit të Ashendentit dhe planetëve të mirë Venusit dhe Jupiterit tregojnë një përforëcim të gjallërisë se pacientit.

Treguesit se cila pjesë e trupit është prekur

Hemisfera lindore e hartës (domethënë ana e Ashendentit), tregon anën e majtë dhe lidhet me dorën e majtë, krahun, këmbën e majtë dhe çfarëdoqoftë. Hemisfera perëndimore e Hartës (domethënë ana e Deshendentit), tregon anën e djathtë, dorën e djathtë, krahun, këmbën e djathtë dhe çfarëdoqoftë tjetër.

Trajtime

Çdo bimë dhe barishte i nënshtrohet sundimit të një planeti të veçantë. Sëmundja e lidhur me një planet të veçantë do të trajtohet me ilaçin që vjen nga bima që lidhet me po të njëjtin planet. Shpesh dy ose më shumë bimë përdoren në përputhje me karakteristikat e tyre për të zbutur simptomat që lidhen me sëmundjen si edhe me trajtimin e vet sëmundjes.

Bimët e lidhura me planetët:

DIELLI

Ushqimorët: Orizi, mjalti dhe bimët aromatike që përdoren si aromatizues, erëzat.

Lulet: kumaku, luledielli, bozhuret etj.

Pemët: Dafina, hurma, arra, dhe palma.

HËNA

Ushqimorët: Lakra, pjepri, kastravecat, kungujt, rrepat, këpurdhat, marulet, lakërishtet.

Lulet: Lulet që rriten natën, trëndafili i bardhë.

Pemët: Tradicionalisht, ato që janë të pasura me ujth, siç është panja.

MERKURI

Ushqimorët: bimët me shumë fara; karotat, majdanoza, bajamet.

Lulet: Lulet më të egra, livando, trumza e butë, qimnoni.

Pemët: Lajthia, arrat, dhe pemët e ngjashme me to.

VENUSI

Ushqimorët: kulumbri dhe manaferrat e tjera, gruri, dhe erëzat.

Lulet: Narcisi i lëndinës, thupra e artë, manushaqja, trëndafili, zambaku, trumza, lisna.

Pemët: Molla, dardha, pjeshka, fiku, bajamet, frashëri, selvia, verri dhe hardhia.

MARSI

Ushqimorët: Pothuajse të gjitha ushqimet "e nxehta", si xhenxhefili, dhe

piperi, dhe ato me shije të forte si qepa, hudhra etj.
Lulet: Lulet e shndritshme disi të ashpra dhe të pazakonshme.
Pemët: asnja, bredhi dhe të gjitha ato me gjëmba, apo shkurre.
JUPITERI
Ushqimorët: Perimet si shërbela, prasi, shpargu; raveni, mendra dhe frutat si luleshtrydhet dhe rrushi i thatë.
Lulet: margaritat dhe lulet e ngjashme, shtara, trëndafili i kuq, hisopi.
Pemët: Bliri, limoni i athët, mështekëna, mani, frashëri, lisi, dushku.
SATURNI
Ushqimorët: shumica e perimeve, si patatet etj. ; pastinaku, spinaqi dhe elbi.
Lulet: Dredhka, kukuta, beladona, syza, ato që rriten ngadalë, bimët me veti narkotike, me substanca të trasha si dhe ato me ferra, shkurre dhe kaçube. *Pemët:* Pisha, bërsheni, shelgu, vidhi.
URANI dhe NEPTUNI janë të ngjashëm me ato të Venusit dhe Hënës.

13. Horoskopi më i vjeter

Horoskopi me i vjeter u gjend ne vitin 2000 nga nje ekspedite e perbashket Ruso – Franceze ne nje shpelle ne Kaukaz, prane kufirit midis Rusise dhe Gjeorgjise.

Ne nje rreth te madh prej guri jane vizatuar simbolet e njohura nga te gjithe te 12 shenjave te horoskopit. Analizat paraprake treguan se ky horoskop eshte 10. 000 vjet i lashte! Ai eshte moshatar i vizatimeve te njerezve ne shkembinj gjate epokes se gurit, si dhe nje deshmi e faktit, se sa e lashte eshte astrologjia. Ka shume mundesi qe ky horoskop te jete katragjush i te gjithe horoskopeve. Por puna qendron jo aq ketu, sa ne faktin qe rrethi dhe muret e shpelles jane mbushur me shenime hieroglifesh ne gjuhe te panjohur.

Kompjutera te fuqishem ne France gjeten celesin per deshifrimin e nje pjese te ketyre shenimeve, sepse disa hieroglife ngjajne me shenjat e shkronjave te grekerve dhe fenikasve te vjeter. Shkenctaret mbeten pa mend nga permbajtja: parashikimet e ngjarjeve te njerzimit qe duhet te ndollin pas mijera vjetesh. Hieroglifet enigmatike tregojne per historine e njerezimit te kohrave te ndertimit te piramidave te medha. Lindjes se Krishtit, Zbulimit te Amerikes nga Kolombi etj, duke perfshire jo vetem zhvillimin e vrullshem teknik ne shekullin XX, kohen e dy luftrave boterore, por dhe dhjetevjecaret e pare te shekullit XXI. Por historia nuk mbaron me kaq, sepse shume gjera ende nuk jane deshifruar.

Ja disa nga profecite e zbuluara, siç i trajton ato Zh. Fabia dhe profesori rus Vladimir Lvov. Per 20 vjetet e ardhshem:

1. Do te ndodhe kolonizimi i Henes dhe i Marsit.

2. Shkencetaret do te gjejne ilacin universal te te gjitha semundjeve ekzistuese.

3. Njerzimi do te hyje ne periudhen katastrofike ekologjike e cila do te vazhdoje derisa qyteterimi i Tokes te mos kuptoje domosdoshmerine e ndryshimit te rruges se zgjedhur.

4. Me ne fund do te realizohet takimi i tokesoreve me perfaqsuesit e qyteterimeve jashtetokesore.

Shume e shume te fshehta te horoskopit te Kaukazit ende nuk jane zbuluar, thote profesor Lvov. Por do te doja ta drejtoj vemendjen tek nje hollesi tjeter: shenimet me hieroglife ne muret e shpelles fillojne me paraqitjen e jashtetokesorve dhe po me ate mbydhen. Ky fakt ka dy shpjegime te mundshme. Ndoshta te ardhurit nga kozmosi kane qene ne cakun e civilizimit tokesor dhe se shpejti ai do te arije nivelin, kur ata do te jene gati ta pranojne ne bashkesine e tyre. Shpjegimi tjeter qendron ne faktin qe e gjithe historia e Tokes eshte programuar nga jashtetokesoret, nga fillimi ne fund, per cka deshmojne dhe parashikimet e sakta te 20 vjeteve te ardhshme.

14. Çka përfaqësojnë planetët dhe shenjat zodiake

Planetet:

Dielli – Një yll i madh i zjarrtë përfaqëson influencën e fuqishme për vitalitet dhe autoritet, ai sundon Luanin duke e bërë atë njeri me autoritet dhe udhëheqës, planet i jetës.

Hëna – Konsiderohet si nëna e madhe e qiejve, drejton Gaforren dhe e bën atë shumë të ndjeshme, familjare dhe e dashur për të afërmit.

Mërkuri – Planeti i inteligjencës dhe i arsyes sundon dhe drejton Binjakët dhe Virgjëreshën duke i bërë ata inteligjentë dhe të arsyeshëm.

Venusi (Afërdita) – Planeti apo Perëndesha e bukurisë, e dashurisë, artit dhe kënaqësisë, sundon Demin dhe Peshoren duke i bërë ata njerëz të dashur, artistë dhe me ndjenja estetike.

Marsi – Planeti i energjisë fizike, i seksit, i agresionit, luftës dhe forcës. Ai sundon Dashin dhe Akrepin duke i bërë ato njerëz të fortë, hakmarrës, luftarak dhe ekstremist në dashuri.

Jupiteri – Planeti i fatit të mirë, i optimizmit, i suksesit dhe bujarisë, sundues i Parajsës ai drejton Shigjetarin dhe Peshqit duke i bërë ata njerëz me fat, bujarë, optimistë dhe të drejtë.

Saturni – Planeti i përgjegjësisë, i maturisë, i disiplinës ai sundon Bricjapin dhe e bën atë të matur, serioz, ambicioz dhe të përgjegjshëm.

Urani – Planeti i zbulimit, shkencës, origjinalitetit dhe ndryshimeve, simbolizon surprizat në jetën tuaj, ai sundon Ujorin duke i dhënë atij prirje shkencore dhe unike.

Neptuni – Planeti i misterit, fantazisë, iluzionit (së bashku me Jupiterin) ai sundon Peshqit duke i bërë ata misteriozë dhe me plot fantazi.

Plutoni – Planeti i botës së nëndheshme, i djallit dhe vdekjes, i fuqisë së frikës, ai sundon Akrepin (bashkë me Marsin) dhe e bën atë dinak dhe hakmarrës.

Shenjat zodiake:
DASHI – Shenja e forcës fizike, e luftës, agresionit e pavarësisë.
DEMI – Shenja e pronës, e parasë, e bukurisë dhe vlerave.
BINJAKËT – Shenja e mendimit, e rinisë dhe e komunikimit.
GAFORRJA – Shenja e familjes dhe e atdhedashurisë.
LUANI – Shenja e udhëheqjes, e dashurisë dhe krijimtarisë.
VIRGJERESHA – Shenja e punës, e përmirësimit dhe e shëndetit.
PESHORJA – Shenja e drejtësisë, e martesave dhe bashkëpunimit.
AKREPI – Shenja e trashëgimisë, e seksualitetit dhe ekstremeve.
SHIGJETARI – Shenja e udhëtimeve të largëta dhe e zbulimeve.
BRICJAPI – Shenja e karrierës, e reputacionit dhe disiplinës.
UJORI – Shenja e shpresës, miqësisë, urimeve dhe humanizmit.
PESHQIT – Shenja e sekreteve, e altruizmit, iluzionit dhe mistiçizmit.

15. Të fshehtat e jetëve të kaluara, sipas Astrologjisë Karmike

Procesi i shkaqeve dhe i pasojave, i cili emërtohet si ***k a r m a***, nganjëherë interpretohet si dora e pamëshirshme e Zotit, por në fakt njeriu vetë e krijon karmën e tij, ose të paktën e liron me veprat e tij të mira...

... Çdo jetë lind me një personalitet të caktuar, i cili përbëhet nga elementet e matricës së shpirtit dhe, sikundër aktorët, edhe ne luajmë role të ndryshme, por gjithnjë në përputhje me karakterin tonë. Personaliteti ynë zhvillohet gjatë jetës.

Ai përparon ose ngec në varësi nga fakti se si reagon ndaj rrethanave jetësore në të cilat ndodhet. Çdo gjë që na ngjan në jetë, gëzimet ose fatkeqësitë, janë veçse mësime të cilat duhet t'i marrim në rrugën drejt përsosurisë dhe lirimit të shpirtit nga lidhjet me këtë botë.

Për aq kohë sa janë dëshirat në njeriun është e pamundur të shmanget lindja e sërishme. Dëshirat janë ato që na lidhin për këtë botë. Shpirtërat e lirë vijnë në planet si mësues, por nuk janë të lidhur me këtë botë.

Shkaktar i të gjitha problemeve dhe shqetësimeve është fakti se e kemi humbur pushtetin mbi ndjenjat tona. I lëmë që të shpërthejnë dhe kështu pushojmë të gjykojmë drejt. Hidhërimi, mendjemadhësia dhe ndjesi të tjera i japin njeriut shprehi demoni dhe nganjëherë madje edhe e bastardojnë deri në nivelin e kafshës.

Sa herë kemi qenë të përfshirë në veprime të gabueshme dhe me këtë edhe më shumë jemi lidhur me zinxhirët e karmës. Mllefi është sikurse droga. Duhet të bëjmë përpjekje që të lirohemi nga ai. Për ta bërë këtë është

e domosdoshme që ta zbulojmë forcën e inteligjencës së lartë, që fshihet thellë në ne…

Kur vjen koha e lindjes, zgjidhet një lloj i veçantë i trupit që do të jetë i përshtatshëm për shpirtin e caktuar. Llojet e ndryshme të elementeve kimike nga të cilat përbëhet trupi, sikundër edhe mënyra se si kombinohen ato, përbëjnë realizimin e ndikimit të sundimtarëve planetarë, ndërsa lindja bëhet në momentin kur planetët ndodhen në pozitat që duhet t'i marrin në pajtim me planin paraprakisht të caktuar, të cilin e harton vetë horoskopi.

Kështu pozitat planetare janë përcaktuese të përkryera si për trupin që lindet, ashtu edhe për karakterin, për këtë është përgjegjës Hëna/, i cili do ta pushtojë për një periudhë të caktuar jetësore. Pozita e Hënës në kohën e lindjes shpreh tërësinë e përvojave të jetëve të kaluara, ndërsa Dielli na udhëzon për atë se në çka duhet të orientohemi tani, ndërsa kjo është rruga drejt vetëdijesimit dhe arritjes së nivelit më të lartë të vetëdijes në jetën e tanishme.

Nëse jeni të lindur në Shenjën e:

DASHIT - Në jetët e mëhershme keni qenë emocionalisht të pavendosur dhe të varur nga të tjerët, kështu që tani për ju është shumë e rëndësishme që në jetën emocionale ta ndërmerrni iniciativën, të insistoni për nevojat dhe dëshirat tuaja, në mënyrë që ta gjeni identitetin tuaj të humbur. Megjithatë, mos shkoni në ekstremin tjetër, në pavarësinë e tepruar, e cila mund të kalojë në egoizëm. Këmbëngulësia dhe besimi në vete është ajo që ju duhet më së shumti.

DEMIT - Jetët e kaluara, të cilat i kemi lënë pas, në aspektin emocional kanë qenë jostabile dhe të ashpra. Keni njohur shkatërrimet e vuajtjes, frikës dhe ndjenjave të mëdha. Jeta e tanishme ju është dhënë si një rast që të stabilizoheni dhe të shkelni në tokë. Stabiliteti, qëndrueshmëria dhe lidhja e veprave dhe praktikës për ju janë të një rëndësie të veçantë. Është koha që t'ia lejoni qenies suaj shpirtërore që të manifestohet nëpërmjet punës, në mënyrë që të mund të piqet dhe ta mësojë atë që diku në rrugën e jetëve të kaluara e ka harruar.

BINJAKËVE - Problemet në jetën e kaluar për ju kanë qenë probleme që kanë lindur si pasojë e komunikimit të keq me njerëzit e tjerë. Kjo jetë përbën një rast që të bindeni se sa është e rëndësishme të thuhet ajo që ndihet…Korrigjoni rastet e humbura në mënyrë që ta realizoni kuptimin emocional dhe harmoninë. Posesiviteti, largimi nga njerëzit e tjerë dhe tërheqja në botën vetjake tani do të duhej të kapërceheshin me modelin e ri të përgjigjes emocionale dhe komunikimit të drejtë.

GAFORRES - Në këtë jetë mësoni që të bëheni besnikë dhe stabilë, që sipërfaqësinë dhe paqëndrueshmërinë nga jeta e kaluar tani ta ktheni në qëndrueshmëri dhe përkrahje si për të tjerët, ashtu edhe për veten. Pavarësisht se si veproni nga jashtë, natyra juaj e brendshme është e butë,

sikur guaskë. Mësimet e shumta nga kjo jetë ju udhëzojnë që t'i kuptoni drejt marrëdhëniet familjare dhe mu për këtë për ju janë shumë të rëndësishëm prindërit dhe fëmijët. Megjithatë, nuk bën që ta harroni edhe veten!

LUANIT - Në mishërimet (inkarnimet) e kaluara keni mësuar që të doni në mënyrë të paanshme, që të mos i veçoni njerëzit, por tani duhet të mësoni që energjinë tuaj emocionale dhe forcën t'i orientoni drejt njerëzve të caktuar dhe fushave të jetës, të cilat janë të rëndësishme për ju. Keni pothuajse aftësinë fëmijërore që ta përjetoni lumturinë në situatat kur të tjerët ju falënderojnë dhe kur jeni në qendër të vëmendjes…, por mos u zemëroni kur nuk ju kushtojnë vëmendjen dhe respektin e duhur. Mësimi juaj në këtë jetë është vetëbesimi dhe respekti për veten.

VIRGJËRESHËS - Jeta e tanishme ju mëson ta keni të drejtën e zgjedhjes të asaj që ju kënaq, si dhe faktin se emocionet e vërteta ndërtohen shkallë-shkallë, gur, gur bëhet mur…Duhet të mësoheni që të mos mbështeteni në të tjerët, por vetëm në veten, madje këtë do ta arrini kur të mësoheni që plotësisht ta pranoni veten me të gjitha të metat dhe cilësitë. Ndjenja e fajit ju përcjell nga jetët e kaluara…lirohuni nga ia! Edhe më tej brengoseni për njerëzit e tjerë, fatin e tyre dhe për atë se si do të mund t'i ndihmonit.

PESHORES - Në jetët e kaluara keni pasur probleme në marrëdhëniet me të tjerët, sikurse edhe me gjininë e kundërt, ndaj edhe në jetën e sotme mund t'ju shoqërojë frika /thellë e fshehur dhe e ndrydhur/ nga njerëzit, refuzimi ndaj ekipit të punës dhe mosbesimi. Në mënyrë që ta përmirësoni këtë gabim, kjo jetë do t'ju ofrojë një numër të madh partnerësh të dashurisë dhe një rreth të gjerë miqsh, ashtu që të mësoni si ta zhvilloni harmoninë me njerëzit e tjerë.

AKREPIT - Keni krijuar një pamje të madhe emocionale dhe intuitive mbi esencën e jetës. Intuita juaj ofron ndjenjën e detyrës që e keni përpara dhe udhëzuesin se në cilën rrugë do të duhej të niseshit, sikundër edhe elementin e nxitjes që është i domosdoshëm për t'u nisur në një rrugë. Frikat irracionale nga jeta e kaluar janë frika që shkaktohen nga sëmundja dhe vuajtja, si dhe nga humbja e të afërmve, ndaj në këtë botë mund të shkoni në skajin tjetër, në posesivitet ndaj miqve të afërm dhe partnerit, ndonjëherë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, në gjakimin që t'i mbani vetëm për vete.

SHIGJETARIT - Në jetën e tanishme keni ardhur për t'i çrrënjosur paragjykimet tuaja dhe që të mësoni të bëheni fleksibël, ashtu që në këtë aspekt të porsazbuluar të personalitetit ta gjeni lirinë tuaj. Çrrënjosja e të gjitha trajtave të paragjykimeve dhe përhapja e tolerancës është diçka që konsiderohet përcaktim i jetës tuaj, ndaj edhe jeta do t'ju çojë në këtë drejtim. Prandaj, për ju janë të rëndësishme udhëtimet, njohja me kultura të ndryshme dhe me modele sjelljes dhe të besimit.

BRICJAPIT - Përvojat nga jetët e kaluara ju kanë shkaktuar konflikt me autoritetet, ndaj në vete bartni frikën nga ajo se dikush tjetër do t'i kontrollojë ose do t'i shfrytëzojë dobësitë tuaja dhe besnikërinë ndaj tyre. Në jetën e tanishme mësoni që vetes t'i bëheni autoritet dhe se si të bëheni përgjegjës ndaj emocioneve tuaja dhe të të tjerëve. Kjo jetë është jetë e stabilizimit dhe e të kuptuarit të së vërtetës jetësore, sipas së cilës të jesh i përgjegjshëm dhe i disiplinuar nuk do të thotë të jesh i ftohtë dhe i distancuar.

UJORIT - Kjo pozitë tregon se në jetët e kaluara ka pasur shumë xhelozi dhe posesivitet në planin emocional. Nxitja e jetës së tanishme qëndron në ndarjen nga pasqyrimet e rrejshme dhe xhelozia, posesiviteti dhe gjakimi që ta drejtojmë atë që e duam. Duhet t'ia ofroni lirinë vetes dhe të tjerëve. Detyra e juaj është që të zhvilloni marrëdhënie Miqteësore me të gjithë, sikundër që duhet t'i zhvilloni edhe humanizmin, shpirtgjerësinë dhe tolerancën.

PESHQVE - Në jetën e kaluar nuk keni mundur që sa duhet ta vlerësoni emocionin e vërtetë, ashtu sikurse nuk keni pasur kohë që t'u dorëzoheni emocioneve…Jeta e tanishme, nëpërmjet kësaj shenje tepër fine dhe intuitive, jua ofron mundësinë që "ta prekni fundin"dhe të mësoheni t'u dorëzoheni emocioneve, në mënyrë që ta pasuroni veten dhe vetë përmbajtjen e jetës. Këtu jeni që të mësoni se ne të gjithë jemi pjesë e Njërit dhe nëpërmjet kësaj të dhëne ta përmbyllni ciklin e hapjes emocionale që ka filluar para shumë jetëve.

16. Vlera e astrologjisë

Disa mendojnë se astrologjia është vetëm bestytni (supersticion) dhe që astrologët e lashtë kanë jetuar në një epokë primitive dhe injorance. Ata harrojnë se paraardhësit e tyre ishin mjaft kompetentë për të ndërtuar piramidat e Egjiptit, të cilat që prej 4000 vitesh akoma janë në vendin e tyre, dhe Stonehenge, që arkeologët sot besojnë se ka qenë një orë shumë e saktë e bazuar në lëvizjet e Diellit, Hënës dhe yjeve.

Isaac Newton, një nga shkencëtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, nuk e përbuzte astrologjinë. E praktikonte edhe vetë atë, dhe kur një nga miqtë e tij e pyet se pse ai besonte në gjëra të tilla, ai u përgjigj: "zotëri, unë e kam studiuar këtë lëndë, ndërsa ju jo!"Kohët e fundit, psikiatri i famshëm Karl Jung u interesua shumë në astrologji dhe shkroi për të në librat e tij. Dhe disa shkencëtarë modernë nuk qeshin me astrologjinë. Ata janë duke përdorur disa metoda kërkimi për të zbuluar se pse bindjet (besimet) në astrologji duket se janë të vërteta. Janë duke zbuluar gjëra interesante në lidhje me energjitë e ndryshme që secili planet lëshon dhe kanë vëretetuar për shembull, se Hëna në fakt ushtron një efekt

të fuqishëm mbi qeniet e gjalla. Hulumtimet të tyre një ditë do të mund të shpjegojnë se pse astrologjia funksionon.

Ndërkohë, gjithmonë e më shumë njerëz kanë filluar të kuptojnë se njohuritë në astrologji mund të ndihmojnë për të kuptuar veten dhe të tjerët. Në vende si India Astrologjia është përdorur për mijëra vjet për të ndihmuar njerëzit të zgjedhin partnerin e tyre apo kohën më të mirë të vitit, për t'u martuar. Sot, psikologët mund të studiojnë horoskopin e pacientëve të tyre që të kuptojnë më mirë karakterin e personit dhe disa kompani kanë filluar ta përdorin astrologjinë si një ndihmë në zgjedhjen e personelit meqënëse horoskopi mund të na tregojë se për çfarë është i prirur më shumë një person. Një gjë e rëndësishme për të kujtuar është se në studimin e astrologjisë asnjë shenjë nuk është më e mirë ose më keqe se një tjetër. Është mirë të jesh Luan njësoj si të jesh Akrep dhe Virgjëresha ka cilësi të rëndësishme po aq sa Bricjapi dhe Binjakët. Çdo shenjë ka talentet dhe aftësitë e veta, dhe dy njerëz kurrë nuk mund të kenë të njëjtat cilësi dhe personalitet sepse në çdo rast, përveç Diellit, duhet të merren në konsideratë edhe pozicioni e Hënës dhe i planetëve të tjerë. Ku mund të mësoni më shumë për astologjinë perëndimore? Disa universitete kryesisht amerikane tashmë e japin atë mësim në një mënyrë shumë serioze dhe në të gjithë botën mund të merren mësime me korrespondencë në qoftë se ju nuk mund të merrni pjesë në seminare apo kurse. Ka edhe shumë libra që ju mund t'i lexoni. Disa janë shkruar nga një francez, Michel Gauquelin, i cili ka bërë disa statistika interesante për të provuar se sa e saktë mund të jetë astrologjia në formimin e personalitetit dhe aftësive të njerëzve. Librat e tij, si shumë të tjerë, kanë bërë që astrologjia të shikohet në mënyrë të re dhe serioze për shumë njerëz dhe janë të disponueshëm nëpër librari dhe biblioteka. Mundohuni t'u hidhni një sy! Dhe mos u shqetësoni nëse dikush ju thotë se astrologjia është pa kuptim. Ndoshta ata nuk e kanë idenë si funksionon ajo. Në botën e sotme ne e dimë shumë mirë se si bëhen disa gjëra, siç janë motoçikletat, frigoriferët dhe televizorët, por jemi të prirur të injorojmë misteret e mëdha të jetës dhe të vdekjes. Shumë njerëz janë të vetëdijshëm për këtë dhe janë vërtetë të interesuar për të studiuar lëndët antike, duke përfshirë edhe astrologjinë.

Ka një tjetër mënyrë për ta marrë në konsideratë astrologjinë. Astrologët e lashtë besonin se i gjithë universi ishte në të vërtetë një qenie e gjallë gjigande, që e quanin Zot. Besonin se pjesët e këtij universi ishin të lidhura së bashku kështu që nëse njerëzit mendonin se ishin ndonjëherë të vetmuar, në realitet nuk ishte e vërtetë. Ata ishin pjesë e kësaj qënieje të gjallë të madhe që, në çfarëdo mënyre u quajt, Zot, Jezus, Allah, Krishna, Buda, Mitra ose në ndonjë mënyrë tjetër. Astrologët e lashtë gjithashtu besonin se kjo qenie e madhe rritej dhe bëhej gjithnjë dhe më e përkryer. Ata besonin se ishte një shkëndijë e jetës së përjetshme e secilit prej nesh që

nuk vdes kur vdes trupi ynë. Vazhdon të jetojë dhe të kthehet në organe të ndryshme, jetë pas jete, dhe në çdo jetë bëhet më e ditur, më e bukur dhe e përsosur.

Mundet që sot astrologjia ka diçka për të na ofruar sepse ajo lidhet me vlerat e njeriut më shumë se çdo shkencë tjetër. Ndoshta ka diçka të vërtetë në besimet e lashta dhe që ne dhe planetet jemi pjesë e një kozmosi të bashkuar. Njohuritë në astrologji mund të na ndihmojnë për të hapur sytë në shumë gjëra dhe gjëja më e rëndësishme është të kuptojmë se çfarë ne jemi thellë, brenda nesh. Dhe ndoshta kjo është kuptimi i jetës.

17. Arabët që shpëtuan astrologjinë

Në shekullin IV, të krishterët mendonin që praktika e astrologjisë ishte në kufirin e një akti përdhosës (sakrilegj). Perëndimi e hidhte poshtë atë. Nuk kishte më mendimtarë të mëdhenj në Perëndim. Persianët ishin të vetmit që e zhvilluan këtë dije. Ishte në Lindje që grekët vazhduan ta përmirësojnë astrologjinë. Në shekullin III, mbreti Shapur I ishte një mbrojtës i filozofëve, ai përkrahte kërkimet. Shumë përkthime tekstesh astrologjike ndodhen në atë epokë. Arabët ishin më tolerantë sesa të krishterët apo romakët. Mësimdhënia astrologjike arriti kulmin rreth vitit 750. Në vitin 777, u themelua shkolla e parë astrologjike në Bagdad. Albunasar e drejtoi këtë shkollë në mesin e shekullit IX. Ky njihej shumë për përkthimet e tij të teksteve të vjetra. Është përmes Spanjës që puna e astrologëve arabë u përhap në Europë. Njerëzit e Galisë (Francës së sotme), dhe të Italisë shkuan në Kordu (Kordova) për t'u mësuar nga arabët. Arabët nga ana intelektuale ishin më të përparuar se europianët fund-mijëvjeçarit të parë. Puna e astrologëve arabë ishte e rëndësishme. Megjithatë, pak vepra të astrologjisë arabe janë përkthyer në kohët e sotme.

Në Europë, disa dokumenta u ruajtën në manastire. Në shekullin IX, astrologjia u shfaq përsëri në Europë. Shumë dijetarë i kanë konsideruar astrologjinë dhe astronominë si shkenca plotësuese të njëra-tjetrës deri në fillim të shekullit XVI.

Duke nisur nga shekulli VII, arabët rikuperuan trashëgimin astrologjik kaldeo-grek, ku tekstet u përkthyen në arabisht. Ky qytetërim dallohej më shumë për mjekësinë dhe astrologjinë; qendra studimi, një observator i madh, dhe një bibliotekë u krijuan në Bagdad, që atëherë u bë kryeqyteti botëror i astronomisë dhe astrologjisë.

Ata përkthyen një numër të madh veprash antike që kodifikonin astrologjinë, ndërtuan astrolabe, dhe pasuruan këtë dije me zbulimet e tyre. Ata janë përgjegjësit e Pjesëve Arabe që përdoren edhe sot nga disa astrologë. Ata ishin kujdestarët e dijes astrologjike në Mesjetë, ashtu si edhe në fusha të tjera të kulturës. Në shekullin e 12-të u bë kalimi i

shkencës (dijes) astrologjike nga arabët drejt Perëndimit mesjetar falë përkthimeve arabo-latine.

Ja disa autorë të shquar arabë të cilët kontribuan në përforcimin e astrologjisë dhe në ruajtjen e saj pasi Krishtërimi nën udhëheqjen e Justinianit ndaloi rreptësisht praktikimin e saj në të gjithë perandorinë bizantine:

Mash'Allah (Mash'Allah ibn Athari al-Basri), i vdekur rreth vitit 815. Astrolog arab i Bagdadit. 18 nga tekstet e tij astrologjike njihen përmes përkthimeve latine.

Alfraganus (Omar Mohamed ibn al-Farrakan al-Tabari, Omar Alfraganus Tiberiadis), i vdekur rreth vitit 815. Astrolog arab që ka punuar në Bagdad në shërbim të kalifit al-Mamoun; dy nga veprat e tij njihen përmes përkthimeve latine. Ai i bazoi shkrimet e tij veçanërisht mbi veprat e Doroteut të Sidonit.

Zahel Benbriz (Sahn ibn Bishr ibn Habib ibn Hani), shekulli VIII. Astrolog çifut që shkruan në arabisht, vezir i kalifit al-Mamoun në Khorasan (Iran). ; 16 nga shkrimet e tij astrologjike ruhen edhe sot përmes përkthimeve në latinisht.

Al-Kindi (ose Alckinde, Ja'kub ibn Ishak al-Kindi), rreth viteve 800 – 870. Një nga baballarët e astrologjisë arabe, të cilën e ushtroi në Bagdad; mësues i Albumasarit; 90 shkrime të tij që flasin për astrologjinë dhe astro-mjekësinë njihen përmes përkthimeve latine.

Isaac ibn Hunein, shekulli IX. Astrolog arab dhe autori i përkthimit më të vjetër të njohur të 'Tetrabiblos' së Ptolemeut.

Razes (Mohammed ibn Zakaria ar-Razi), 865 -932. Astrolog arab me punë në Bagdad; tre nga tekstet e tij ruhen përmes përkthimeve në latinisht; ai u interesua gjithashtu në filozofinë e natyrës dhe ishte mjeku i parë personal mysliman i kalifit al-Muktadir.

Alkasan Albubater (Abu Bakr al-Hasan), fillimi i shekullit IX. Astrolog arab dy shkrimet e të cilit mbi astrologjinë individuale ruhen edhe sot përmes përkthimeve latine.

Albumasar (ose Aboassar, Abu Ma'shar al-Balkhi), rreth viteve 805-886. Astrolog islamik i Khorasanit (Iran) me punë në Bagdab, shumë i vlerësuar në Europën mesjetare. ; ai shkroi një traktat të plotë për astrologjinë si edhe disa tabela astronomike dhe një vepër mbi bashkimet e mëdha (aspektet 'përkrah'); 27 prej këtyre shkrimeve astrologjike në arabisht janë përkthyer në latinisht.

Alkhait Albohali (Yahya ibn Ghalib Aku'Ali al-Khaiyat), rreth vitit 850. Astrolog arab astrologjia individuale (e lindjes) e të cilit ruhet edhe sot përmes përkthimeve latine.

Alcabitius (Abd al-Aziz ibn Uthman ibn Ali, Ubu asSakr al-Quabisi), i vdekur rreth vitit 967. Astrolog i shquar arab që ka punuar në Mosul; 8 nga shkrimet e tij astrologjike janë përkthyer në latinisht.

Ali Embrani (Ali ibn Ahman al-imrami), +/- 955. Astrolog arab me punë në Mosul; shkrimet e tij mbi astrologjinë horare dhe përzgjedhjet ruhen edhe sot përmes përkthimeve latine.

Maslema. Astrolog mavritan i fundit të shekullit X.

Ali Albohazen (Mohamed ibn al-Hasan ibn al-Haitham al-Basri al-Misr ose Abu'Ali), +/- 965 në 1038. Fizikant arab, astrolog dhe komentues, punoi në Egjipt dhe në Tunizi. Veprat e tij astrologjike vlerësoheshin shumë në Europë në shekullin XIII.

Aliboron (Mohamed ibn Ahmad Abu ar-Rajhan al-Biruni), 973 – 1048. Astronom i cili shkruante në arabisht, astrolog, gjeograf, kronolog, që kaloi 40 vjet në Indi; u interesua për kulturën greke; autor i shumë shkrimeve astrologjike ku njëri prej tyre është përkthyer edhe në anglishten moderne.

Ali Abenragel (Ali ibn Abi ar-Rijal), 1016 – 1062. Astrolog arab me punë në Kordu dhe në Tunizi; 12 nga shkrimet e tij njihen përmes përkthimeve latine.

Kaika'us, 1021 -1099. Emir dhe shkrimtar Persian, nipi i Kabusit; vepra e tij 'Libri i këshillave' flet edhe për astrologjinë.

Ali Abenrudian (Rodan Ali ibn Ridvan), 1068. Astrolog arab dhe mjek, komentues i 'Tetrabiblos' së Ptolemeut të cilin e përktheu dhe e redaktoi (botoi); 12 nga traktatet e tij astrologjike njihen përmes përkthimeve latine.

Platoni i Tivolit, 1110 – 1145. Bën pjesë te ai brez përkthyesish që transmetojnë njohuritë e astrologëve arabë dhe klasikë drejt Europës. Ai ka përkthyer në latinisht shumë vepra arabe dhe hebraike.

18. Aleksandri i Madh në Astrologji

Çfarë është ajo që e bën Aleksandrin e Madh kaq figurë unike në historinë botërore? Para së gjithash ai përmbushi disa gjëra për një kohë mjaft të shkurtër. Në moshën 20 vjeçare ai u bë mbreti i Maqedonisë. Nën komandën e tij ai çoi një ushtri prej 30 000 burrash në fund të botës që njihej atëherë në toka të huaja e të rrezikshme.

Në përputhje me faktet historike, ai luftoi në më shumë se njëqind beteja pa e humbur asnjërën. Ai formoi perandorinë më të madhe që është formuar ndonjëherë nga një njeri i vetëm në lashtësi dhe vdiq në kulmin e lavdisë së tij pa mbushur akoma 33 vitet e jetës së tij. Aleksandri i Madh është njëkohësisht një person heroik dhe tragjik.

Kam përshtypjen se ai prek disa fije të ndjeshme shumë të veçanta tonat, disa fije që kanë të bëjnë me parimet më të thella të jetës. Për disa arsye që nuk janë të lehta për t'u përcaktuar/ shpjeguar (njëra prej të cilave duhej të ishte vdekja e tij tragjike rreth moshës 33 vjeç, një moshë që lidhet disi me atë të Krishtit).

Unë besoj që në zemrat tona Aleksandri është shndërruar në një farë martiri (dëshmori), në një martir të rracës njerëzore. Ai ishte i ri, i pashëm, i fortë dhe guximtar, por prapëseprapë ai ishte njeri prej mishi dhe gjaku pikërisht siç jemi edhe ne. Kështu ai u bë një përfaqësues i rracës sonë që tejkaloi kufijtë e dimensioneve njerëzore dhe arriti pothuajse zotërimet hyjnore, një njeri që guxoi të sfidonte hyjnitë dhe ndoshta për këtë arsye vdiq.

Për të gjithë ne që merremi me astrologji do të ishte e dukshme të pyesim nëse harta e Aleksandrit të Madh është ruajtur. A do të mund të ishte aty, për shembull, ndonjë zbulim arkeologjik në Maqedoni, në atdheun e Aleksandrit të Madh, që lidhet me hartën e tij? Si fillim, do doja të qartësoja diçka këtu.

Që në kohët e lashta krahina veriore e Greqisë ka qënë quajtur Maqedoni. Kohët e fundit një republikë ish-jugosllave pretendon emrin Maqedoni. Kjo republikë e përbërë nga popullsitë, që e kanë prejardhjen nga Ballkani të paktën njëmijë vjet pas vdekjes së Aleksandrit, nuk ka të bëjë fare me Maqedoninë për të cilën po flasim.

Në çdo rast, as në Maqedoni as në ndonjë pjesë të Greqisë nuk ka elemente që janë gjetur për astrologjinë të asaj periudhe. Personalisht, kam studiuar me qindra statuja antike, urna, mbishkrime pllakash, monedha etj. dhe në asnjërën prej tyre nuk kam gjetur simbole astrologjike.

Jam bindur që deri në fundin e shekullit të katërt p. K astrologjia nuk mbizotëronte në Greqi. Megjithatë, nga fundi i shekullit të katërt p. K ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme, një ngjarje që doli se ishte shumë domethënëse në historinë e astrologjisë. Kjo ishte ekspedita, kryesisht luftarake (ushtarake), por edhe me disa nivele kulturore, e Aleksandrit të Madh në Azi dhe veçanërisht në Mesopotami, në djepin e astrologjisë.

Duhet të theksoj këtu se Aleksandri, duke qënë fëmija i një priftëreshe dhe veç kësaj një fëmijë shpirtëror i filozofit Aristotel, nuk ishte i interesuar vetëm për të pushtuar kombe, por edhe për të mësuar për kulturën e tyre. Me këtë fakt, ai solli me vete shkencëtarë grekë (gjeografë, historian, botanistë, astronomë, filozofë etj.). Deshira e tij e zjarrtë ishte të eksploronte, të pushtonte dhe pastaj të bashkonte të gjithë popujt, të gjitha vendët dhe të gjithë botën e njohur.

Për shkak të zgjuarsisë së tij, ai e dinte se nëse do të kishte sukses do të tregonte tolerance për kulturën e secilit vend dhe do të lejonte rrjedhjen e ideve midis tyre. Pra, në kohën kur ushtria e Aleksandrit hyri plot fitore në qytetin e Babilonisë, astrologjia, në formën e saj jo-horoskopike, kishte arritur zhvillim të plotë në Mesopotami. Grekët u interesuan menjëherë për astrologjinë.

Ata u bënë disi trashëgimtarë të pikëpamjeve të gjëra astrologjike të grumbulluara gjatë shekujve ndërmjet dy lumenjve të mëdhenj. Me mendjet e tyre filozofike dhe sajuese, ata i shqyrtuan këto pikëpamje, vunë

në përdorim forma matematikore dhe gjeometrike për vete dhe përfundimsiht e transformuan astrologjinë mesopotamike në astrologjinë horoskopike që kemi ne sot. Dhe e gjitha nisi me Aleksandrin e Madh.

Sigurisht që mbështetja e astrologjisë nuk ishte një nga qëllimet e tij kur ai bëri fushatë kundër persianëve në Lindjen e Mesme. Sidoqoftë, me sa dimë ne astrologjia nuk ishte në kundërshtim me besimet e tij. Akeksandri ishte marrë me mistere të ndryshme kështu që ai mund të kishte njohuri në astrologji. Fakti është që jo vetëm që nuk e ndaloi atë, por ndiqte edhe traditat e vendit dhe i mbajti astrologët në oborrin e tij mbretëror.

Kështu që jam mjaft i sigurtë që disa nga këta astrologë mbretërorë "formuan"hartën astrologjike të Aleksandrit dhe ndoshta i pasuan pozicionet planetare të tij edhe tek kolegët e tjerë. Identiteti astrologjik i këtij pushtuesi bjond supreme që erdhi nga perëndimi duhet të ketë qënë çështje interesi kryesore ndërmjet astrologëve babilonas të asaj kohe. Sidoqoftë, gjer tani asnjë nga këto harta të supozuara nuk është gjetur.

Duke mos pasur në dispozicion hartën e "dorës së parë"të Aleksandrit të Madh për nevojë duhet të kthejmë vëmendjen tek ajo e "dorës së dytë". Dy harta të tilla të supozuara të Aleksandrit u publikuan në shekullin e 17-të. E para u formua nga "Ptolemeu i vogël"Andrea Argoli në 1652.

Në të mund të lexojmë: "Genitura Alexandri Magni, 12 Augusti 355 Anno Christum, 16:40 P. M". Duke llogaritur pozicionet planetare për këtë datë p. K. Vura re që përgjithësisht ato janë të sakta (Kishte vetëm një devijim të pozicionit të Hënës dhe Merkurit).

Sidoqoftë, kjo nuk ishte harta e vërtetë e Aleksandrit, sepse ne dimë që ai ka lindur në 356 p. K. dhe jo ne 355. Rasti i dytë ishte horoskopi që përfshihej në "Collection of divers choice Nativities"të Gadbury-t i publikuar në 1662.

Në të lexojmë: "Alexander Magnus, born 357 years ante Christu, July 1, 9h. 26 m. P. M". I llogarita pozicionet planetare edhe për këtë datë dhe zbulova se, edhe pse janë shumë të sakta, data ishte e pasaktë sepse Aleksandri nuk kishte lindur në 357 p. K. Duke parë që këto dy harta janë të pasakta lind përsëri pyetja se si astrologët e shekullit të 7-të mund të llogarisnin me një saktësi të tillë pozicionin planetar për datat e së kaluarës së largët.

Fatkeqësisht, nuk ka zbulime historike që mund të hedhin dritë mbi identitetin astrologjik të Aleksandrit të Madh, prandaj alternative e vetme është të përcaktojmë datën e lindjes së tij dhe si pasojë të formojmë horoskopin e tij. Shumë historianë të lashtë kanë shkruar për Aleksandrin, por vetëm veprat e pesë prej tyre janë ruajtur, ato të Plutarkut, Arrianit, Diodorus Siçulus, Quintus Curtius dhe Justinit, të gjithë pas periudhës së Aleksandrit.

Midis pesë prej këtyre historianëve vetëm Plutarku përmend datën e lindjes së Aleksandrit. Ai thotë: "Aleksandri ka lindur me gjashtë të muajit të quajtur Hekatombaion nga athiniotët dhe Lóos nga Maqedonasit". Ky është treguesi kryesor që kemi për datën e lindjes së Aleksandrit. Sidoqoftë, ky tregues nuk e zgjidh automatikisht problemin tonë.

Para së gjithash, Plutarku jetoi katër shekuj të plotë pas Aleksandrit. Si mund të jemi të sigurtë që ai e dinte datën e saktë të lindjes të Aleksandrit? Dhe pastaj, edhe nëse ishim të sigurtë për saktësinë e datës që jep Plutarku, përsëri do të kishim vështirësi ta konvertojmë atë datë (me 6 të Lóos të 356 p. K.) në datën që i korrespondon kalendarit tonë.

Ju e shikoni që kalendarët e popujve të lashtë ishin me plot gabime! Ishte teknikisht e pamundur për ta të përcaktonin me saktësi revolucionin vjetor të Tokës përreth Diellit (që sot e dimë që është i barabartë me 365. 242217 ditë. Tek të lashtit ky numër do të ishte i shenjtë, ata i erdhën afër atij por kurrë nuk e arritën atë).

Kalendari i tyre bazohen në një vit me kohëzgjatje më të ndryshme se sa i lartpërmenduri; kështu me afat të gjatë ata ose i kanë ngrënë disa ditë ose i kanë shtuar ato. Mund të ndodhë, për shembull, që në përputhje me kalendarin e tyre ata ishin në një muaj që korrespondonte me qershorin tonë, ndonëse përjashta ata mund të shikonin dëborë (në Mesdhe).

Fakte si këto, kur përsëriten shpesh, i bënë ata të kuptojnë se diçka ishte gabim në kalendarin e tyre. Por përsëri, nuk mund të bënin shumë për këtë! Për të mbajtur muajt e kalendarit të tyre në sinkronizëm me stinët e vitit, ata fusnin nga një muaj shtesë herë pas here.

Parregullsia e një shtimi të tillë është pengesa kryesore e secilit që përpiqet të konvertojë një datë antike në një moderne. Dhe për t'i bërë gjërat edhe më të komplikuara, marrim në konsideratë faktin që secila prej qytet-shteteve greke, kishte kalendarin e vet i cili ishte rregulluar pavarësisht qytet-shteteve të tjera. Ndoshta tani është më e qartë se pse data që jep Plutarku nuk e zgjidh automatikisht problemin tonë.

Personalisht, mendoj se ajo datë është e saktë. Plutarku, siç njihet nga veprat e tij, ishte një historian shumë serioz dhe i kultivuar. Ai nuk do të përmendte një datë vetëm sa për ta thënë atë. Ai ishte grek, prandaj ai futej lehtësisht në shkrimet e "dorës së parë"të ruajtura në epokën e historianëve dhe oficerëve të Aleksandrit të Madh.

Përveç kësaj, ne kemi një burim tjetër historik që në një farë mënyre vërteton datën e përmendur nga Plutarku. Ky burim vjen nga shkrimtari romak Claudius Aelianus (Aelian), i cili jetoi midis shekullit të dytë dhe të tretë A. D. Aeliani thotë në "Varia Historia"-n e tij: "data 6 e muajit Thargelion konsiderohet si një ditë shumë fatsjellëse për grekët…ata fituan shumë beteja në atë datë…edhe Aleksandri i Maqedonisë, biri i Filipit kishte lindur në atë datë".

Faktikisht, Aeliani nuk e përcakton nëse kjo nënkupton 6-tën e muajit Thargelion apo përgjithësisht 6-tën e një muaji të rastësishëm si datëlindjen e Aleksandrit. Mendoj se është kjo e fundit, jemi mjaft të sigurt që Aleksandri nuk lindi në muajin Thargelion. Aeliani i cili jetoi pas Plutarkut, nuk e ka kopjuar Plutarkun sepse në këtë rast ai do të shkruante që Aleksandri lindi me 6 të muajit Hekatombaion. Kështu që kemi dy historianë të lashtë që theksojnë 6-tën e një muaji të caktuar si datëlindjen e Aleksandrit (dhe muaji i tij nuk mund të jetë tjetër veçse Hekatombaion – Loos siç e shohim më vonë).

Por edhe nëse ky është rasti, kur kemi ende nevojë t'i bëjmë një tjetër pyetje vetes sonë: ai ishte data e lindjes një datë e rëndësishme për grekët e lashtë? Për t'u përgjigjur, do të mjaftone të citojmë një rresht nga testamenti i filozofit Epikurus (bashkëkohës i Aleksandrit): ".. dhe të lë ty një shumë të konsiderueshme parash kështuqë mund të festojmë çdo vit datëlindjen time, me 10 të muajit Gamelion, siç kemi bërë kur isha gjallë".

Grekët e lashtë e festonin datëlindjen e tyre pikërisht siç bëjmë ne sot. Ky fakt konfirmon supozimin tim që data e lindjes së Aleksandrit njihej nga publiku i gjithanshëm, le pastaj nga oficerët që shkruajtën biografinë e tij. Për gjitha këto arsye unë mendoj si pikë referimi datën e dhënë nga Plutarku.

Plutarku bën diçka më tepër sesa thjesht na tregon datën e lindjes së Aleksandrit. Ai na informon që Aleksandri ka lindur në një muaj maqedonas (Lóos) që korrespondon me muajin Atintan (dialekt i greqishtes, Athinës) Hekatombaion. Kjo është një pjesë informacioni e rëndësishme meqënëse kemi një bibliografi relativisht të gjerë të kalendarit Atintan mund të dimë që Hekatombaion korrespondon afërsisht me periudhën mes Korrik – mes Gusht.

Aleksandri i Madh mund të ketë lindur me një hapësirë kohore ndërmjet Korrikut dhe Tetorit të vitit 356 p. K. Dielli i tij duhet të jetë në një nga këto shenja zodiakale: Gaforre, Luan, Virgjëreshë apo Peshore. Hapi tjetër është që ta vërtetojmë këtë hapësirë kohore me shpresë që ta shkurtojmë atë. Historiani Arrian do të na ndihmojë në këtë drejtim.

Duke përmendur Aristobulus-in, një nga oficerët dhe historianët e Aleksandrit, Arrian thotë që Aleksandri jetoi 32 vjet e 8 muaj – dhe këto 8 muaj të plotë (3). Fakti është që ne e dimë me saktësi të mjaftueshme datën e vdekjes së Aleksandrit (e cila është ruajtur veçmas nga kronikat mbretërore greke në shkrimet babilonase dhe egjiptiane). Aleksandri, sipas Aristobulus, vdiq në ditën e fundit të muajit maqedonas Daisios në vitin 323 p. K.

Disa kronologjistë dhe historian modernë pohojnë se data e vdekjes së Aleksandrit korrespondon përafërsisht me datën 12 qershor të vitit 323 p. K. , ndoshta 10 ose 13 qershor. Kështu që nëse nga ajo ditë e 323-it ai jetoi 32 vjet e 8 muaj të plotë të muajve maqedonas, atëherë ai duhet të ketë

lindur midis 7 Shtatorit dhe 9 Tetorit 356 p. K. një periudhë që përputhet absolutisht me hapësirën kohore që parapërcaktuam.

Tashmë kemi një tjetër referim historik që barazvlerësohet me muajin Loos të Maqedonisë të periudhës Shtator – Tetor. Është një citim nga Demosteni, në fjalimin e tij "në majë", të një cope letre nga mbreti Filip II drejtuar peleponezianëve në 339 p. K. Në letër, mbreti Filipi II u kërkon peleponezianëve ta takojnë atë në Fokis "në muajin Loos që athiniotët e quanin Boedromion dhe Corinthians Panemos".

Meqë Boedromion ishte muaji i tretë i kalendarit të Athinës (që nis në solsticin e verës), do të korrespondonte përafërsisht me shtator/tetorin. Por nuk e dimë nëse barazimi Loos = Boedromion ishte i vërtetë për të gjitha apo shumicën e viteve në shekullin e katërt p. K. apo nëse ishte i vërtetë vetëm për disa vite të caktuara siç është një nga ato në të cilin mbreti Filip shkroi letrën e lartpërmendur.

Gjithsesi tre provat e tjera, që vijnë nga Plutarku, Diodorus Siçulus dhe nga një kronikë e hershme byzantine, flasin për një lindje më të mëparshme.

Plutarku konstaton që Filipi, i ati i Aleksandrit, mori njëkohësisht tre lajme të mira ndërsa po drejtonte një ekspeditë ushtarake në Potidea, në Greqinë Veriore: 1) që një nga gjeneralët e tij korri një fitore, 2) që një nga kuajt e tij fitoi garën në lojrat olimpike dhe 3) që Aleksandri lindi.

Atëherë, lojrat olimpike zhvilloheshin në verë (historian britanik George Thomson konstatoi se lojrat olimpike zhvilloheshin ose në muajin e Apollonit ose atë të Parthenius.

Apolloni ishte (në kalendarin e Olimpias) muaji i tetë pas solsticit të dimrit dhe Parthenius i nënti. Kështu që këta dy muaj i korrespondojnë përafërsisht Gushtit apo Shtatorit tonë. Atëherë, normalisht do të duhej një javë që lajmëtari t'i çojë Filipit në Potidea lajmin që kali i tij fitoi.

Por lajmi i fitores së kalit dhe lindja e Aleksandrit i erdhen Filipit në të njëjtën kohë, kështu që Aleksandri nuk mund të ketë lindur në fund të shtatorit dhe aq më pak në Tetor (Thomson tregon edhe më me hollësi, duke sugjeruar se lojrat olimpike zhvilloheshin me 9 ose me 22 gusht, ose me 6 shtator, duke u varur nga viti.

Prova e dytë që Aleksandri u bë mbret direkt pas vrasjes së babait të tij Filipit, po t'i referohemi Plutarkut, ai sapo kishte mbushur 20 vitet e jetës së tij. Filipi u vra gjatë një ceremonie në një teatër të hapur, në mëngjes. Diodorus Siçulus përshkruan me hollësi detajet që lidhen me këtë vendngjarje.

Nga përshkrimi i tij, mund të kuptojmë që dita kur u vra Filipi ishte mjaft e nxehtë. Mund të ishte një ditë vere ose fillim shtatori. Mos harroni që jemi në Greqinë veriore, qytet që shtrihet pothuajse në gjerësinë e Nju Jork Sitit. Mëngjeset e fund shtatorit dhe tetorit janë vërtetë të freskëta atje,

jo ideale për një ceremoni në një arenë të hapur. Kështu që Filipi është vrarë në fund të gushtit ose në fillim të shtatorit.

Menjëherë pas kësaj, populli maqedonas dhe ushtria e shpallën Aleksandrin si mbretin e tyre të ri. Duke iu referuar kronologjistit të mirënjohur gjerman Ideler, Aleksandri u bë mbret në shtator 336 p. K. Pra nëse ai tashmë i kishte mbushur 20 vitet e tij (siç konstaton Plutarku), atëherë ai duhet të kishte lindur në fillim të shtatorit ose në gusht.

Përfundimisht, prova e rëndësishme është ruajtur në "Chronicon Paschale"një kronikë e hershme byzantine. Meqë kemi mundësinë të shohim në këtë kronikë, kalendari maqedonas ishte ende në përdorim në shekullin e katërt A. D në Kostandinopojë (dhe ndoshta në tërë ish- botën helenistike).

Në një nga dëshmitë e saj kronika "Paschale"lidhet me ne: "dhe në të njëjtin vit (367 AD) Gratianus Augustus u shpall perandor në Francë, në muajin Loos, 9 ditë përpara "kalendave"(hënes së plotë) të shtatorit. Pra, shpallja e tij është e rëndësishme (edhe pse vjen nga një periudhë pasuese) sepse është një nga të parët që barazvlerësohet me muajin Loos të gushtit maqedonas!

Duke marrë në konsideratë të gjitha këto dëshmi, do të thonim që gjysma e dytë e gushtit është periudha që korrespondon më shumë me kushtet paraprake që përmendëm më përpara. Kjo periudhë shtrihet ndërmjet dy rasteve ekstreme të lindjes së Aleksandrit në korrik ose në tetor. Duke u rikthyer tek Aristobulus, mendoj se ai është mashtruar nga kalendari maqedonas, i cili ishte me plot rregullime dhe kështu i hoqi një muaj kohëzgjatjes së jetës së Aleksandrit.

Në vend të 32 vjet e 8 muaj të plota ne duhet të kishim thënë 32 vjet e 9 muaj të plota (duke nënkuptuar që nga momenti i vdekjes së tij Aleksandri faktikisht po shkonte drejt muajit të dhjetë pas datëlindjes së 32-të të tij).

Një tjetër fakt që mund të tregojë prova të vlefshme për ne është që kalendari maqedonas ishte soli-lunar. Secili prej muajve të tyre zakonisht rregullohej në përputhje me fazat hënore. Kështuqë data e parë e çdo muaji duhej të përputhej me Hënën e Re apo të paktën me duken e saj të parë kur Hëna po rritet në qiell. Ata e mbanin mend gjithmonë këtë, sidomos kur rregullonin kalendarin e tyre. Hëna e Re në gushtin e 356 p. K. bie me datën 13.

Pra, nën kushtet ideale, data 6 e muajit maqedonas Lóos do të korrespondonte me datën 19 gusht të atij viti (13 6=19). Me 19 gusht 356 p. K. Dielli ishte në Luan dhe Hëna po kalonte përmes Peshores dhe Akrepit. Por personalisht do të zgjidhja një tjetër datë: 24 gushtin. Një fakt tjetër se pse Aleksandri mund të jetë i shenjës së Luanit është se Plutarku thoshte se ai ishte Bjond. Zakonisht meshkujt Luanë janë biondë. Gjë që tek Gaforrja nuk ndodh, ose ndohd rrallë herë.

Një devijim prej vetëm pesë ditësh nga 19 gushti, data që do të kishim pranuar po të ishim të sigurtë që dita e parë e muajit Lóos të 356 p. K. ishte dita e Hënës së Re, është, në përshtatje me atë çfarë kemi thënë tashmë në kalendarin e lashtë maqedonas, më se i pranueshëm.

Më 24 gusht 356 p. K Dielli ishte në Luan, Hëna po shkonte përmes Shigjetarit dhe Bricjapit, Merkuri dhe Venusi ishin përkrah njëri-tjetrit në Virgjëreshë duke formuar gjashtëkëndësh me Marsin dhe Trekëndësh me Uranin, Marsi ishte në Gaforre katërkëndësh me Jupiterin në Peshore, në një opozitë të fortë me Uranin në Bricjap dhe në opozitë me Hënën (karakterin gjaknxehtë të Aleksandrit?).

Saturni ishte në Dem katërkëndësh me Diellin e tij (marrëdhënia e vështirë që kishte me të atin?) Nëse do kisha për të bërë një zgjedhje ndërmjet Peshores, Akrepit, Shigjetarit dhe Braicjapit si shenja të mundshme hënore të Aleksandrit do të zgjidhja pa hezitim Shigjetarin!

Hëna në Shigjetar përfaqëson shumë mirë shpirtin e pasur (e gjallë) të Aleksandrit të Madh, ekspeditat e tij ndërkontinentale, interesat e tij në letërsi, besimin e tij të thellë në Perendi, nënën e tij Olimpia e cila ishte një priftëreshë, dhe tri gratë e tij të cilat ishin të gjitha të huaja. Në atë kohë pra, Hëna ishte në Shigjetar nga ora 20:00 e datës 21 gusht dei në 07:00 me 24 gusht.

Zgjodha 24 gushtin sepse vetëm atëherë Hëna, megjithëse mbetet në Shigjetar, i afrohet aksit Marsi opozitë Uranit, një aks shumë shpërthyes i cili mund të ketë të bëjë me natyrën shpërthyese (të vrullshme) të Aleksandrit. Por nëse data e tij e lindjes është 24 gushti dhe Hëna e tij është në Shigjetar atëherë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kemi vendosur një hapësirë kohore për orën e lindjes së tij.

Ai duhet të ketë lindur midis orëve 00:00 – 07:00. Në realitet nuk kemi dëshmi të sigurta për orën e lindjes së Aleksandrit. Pseudo – Kallisthenes i cili shkroi një fare biografie romantike të Aleksandrit në shekullin e 3-të AD se ai kishte lindur kur po lindte Dielli dhe vdiq kur po perëndonte ai. Atëherë, meqënëse Plutarku konstatoi se Aleksandri vdiq vërtet gjatë mbrëmjes (perendimit të Diellit) ai mund të ketë lindur në agim.

Në këtë rast do të kemi Luanin si Ashendent që i përshtatet atij shumë më tepër se Binjakët apo Gaforrja. Veç kësaj do preferonim që Dielli i tij të ishte afër Ashendentit, në shtepinë e tij të pare dhe kjo mund të ndodhte nëse ai ka lindur rreth ores 05:30 të mëngjesit.

Në një rast të tillë do të kishim Diellin, Merkurin, Venusin dhe Neptunin të vendosur në shtepinë e tij të pare (një skemë e rrallë e cila mund të shpjegojë forcën tërheqëse të jashtëzakonshme të këtij djaloshi, magnetizmin që rrezatonte rreth tij dhe kjo i bëri ushtarët e tij ta ndiqnin atë deri në fund të botës së njohur deri atëherë sikur të ishin hipnotizuar).

Saturni i tij i lindjes do të ishte në shtepinë e tij të dhjetë, përkrah MC të tij, ndërsa sunduesi i shtepisë së tij të dhjetë do të ishte në shtepinë e tij

të parë. Këto pozicione planetare përputhen plotësisht me faktin që në moshë shumë të re Aleksandri pranoi përgjegjësitë dhe me faktin e famës së tij të përhershme. Mund të themi që kjo hartë astrologjike spekulative e Aleksandrit të Madh paraqet tiparet kryesore të karakterit të tij në mënyrë shumë të kënaqshme (të pranueshme). Theksimi i shtepisë së tij të pare pasqyron qartë impulsivitetin e tij, shpirtin e tij luftarak, dhe deshirën e tij për të qënë i pari i të parëve në çdo situatë. Edhe në seriozitetin (vetëpërmbajtjen) e tij në çështjet për sa i përket ushqimit dhe kënaqësive sensuale mund të shpjegohej nga Venusi në Virgjëreshë.

Por testi final do të konsistonte në verifikimin e hartës së tij me anë të Tranziteve dhe Progresioneve Dytësore për ngjarjet më madhore të jetës së Aleksandrit. Le të fillojmë me ngjarjen me rëndësinë më të madhe, vdekjen e tij. Data më e besueshme e vdekjes së tij është 10 qershor 323 p. K. Tranzitet planetare për këtë date janë shumë domethënëse: Plutoni dhe Urani janë në tranzit përkrah njëri-tjetrit 21 gradë tek Demi, që formojnë kuadrat me aspektin e supozuar të Aleksandrit Diellin 25 gradë në Luan.

Tranziti i Neptunit 28 gradë në Akrep formon gjithashtu aspekt kuadrat me Diellin e tij (një aspekt që bëhet më domethënës nëse konsiderojmë Neptunin si sunduesin e shtepisë së 8-të të hartës së lindjes së Aleksandrit). Tranziti i Saturnit 29 gradë tek Binjakët formon opozitë me Hënën e tij të lindjes, aspektin përkrah me Marsin e lindjes së tij, dhe kuadrat me Jupiterin e lindjes së tij.

Tranziti i Jupiterit 15 gradë në Gaforre formon kuadrat me Plutonin e lindjes. Marsi tranzit në shtepinë e tij të parë është përkrah Venusit të lindjes (sunduesin e shtepisë së tij të dhjetë) dhe Neptunit të tij. Venusi formon tranzit kuadrat me aksein e tij nyjor.

Tranziti i Merkurit është përkrah Marsit të tij dhe në opozitë me Uranin e tij. Së fundmi, tranziti i Diellit, që në ditën fatale ishte 14 gradë tek Binjakët formon kuadrat me Neptunin e lindjes së Aleksandrit (një aspekt midis shumë të tjerëve që tregon vdeken e tij të përfolur nga helmi. Përgjigja e kësaj harte të lindjes spekulative të Aleksandrit të madh në tranzitet e vendosura për datën e tij të vdekjes është vërtetë mbresëlënëse.

E njëjta gjë mund të thuhej për përgjigjje përsa i përket Progresioneve: Hëna e progresuar në opozitë me Neptunin e lindjes (sunduesin e shtepisë së tetë), Dielli i progresuar kuadrat me Hënën e lindjes (sunduesen e shtepisë së 12-të), Merkuri dhe Venusi i progresuar në opozitë me Plutonin e lindjes dhe Marsi i progresuar kuadrat me Plutonin e lindjes.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme është vrasja e babait të Aleksandrit, Filipit, nga fillimi i Shtatorit 336 p. K. Urani që atëherë ishte tranzit në shtepinë e tetë të Aleksandrit formonte një kuadrat të përkryer me Hënën e tij të lindjes (një vdekje e papritur dhe mjaft e rastësishme që po ndryshonte gjendjen e tij familjare?).

Tranziti i Jupiterit ishte përkrah Marsit të lindjes ndërsa Saturni formonte opozitë me Marsin e tij. Ky ndikim dipolar i Jupiterit dhe Saturnit me Marsin e lindjes tregon përgjegjësitë që bien mbi Aleksandrin pas vdekjes së të atit dhe deshirën e tij të zjarrtë për t'u bërë udhëheqës, për të marrë iniciativa, për të vepruar. Një konfigurim dypolar i ngjashëm rezulton nga Progresionet e vendosura për këtë ngjarje: Dielli i progresuar përkrah Neptunit të lindjes (sundues I i shtepisë së 8-të) ndërsa Hëna e progresuar shumë afër Jupiterit të lindjes.

Në një ditë të nxehtë vere të 333 p. K (ndoshta në mesin e gushtit) Aleksandri bëri not në ujrat e akullta të lumit Kydnos, në Turqinë e sotme. Menjëherë pas kësaj u sëmur dhe qëndroi në shtrat disa ditë. Atëherë Saturni formonte opozitë me Diellin e tij të lindjes, ndërkohë që mundet që tranziti i Diellit dhe Marsit ishin në shtepinë e tij të 12-të të lindjes.

Në fillim të vitit 325 p. K Aleksandri kishte arritur pozicionin më të largët të ekspeditës së tij (Indi), por prapëseprapë donte të shkonte më tej (tranziti i Jupiterit ishte në shtepinë e tij të nëntë). Ushtarët e tij refuzuan ta ndiqnin atë. Në janar të atij viti, gjatë një beteje kundër popullit të Mallonit, Aleksandri vepronte me shumë pakujdesi dhe ishte dëmtuar rëndë në kraharor nga një shigjetë.

Ai mezi i shpëtoi vdekjes dhe si pasojë qëndroi në barelë për disa javë. Tranziti i Neptunit atëherë ishte 25 gradë tek Akrepi, në kuadrat të përkryer me Diellin e tij të lindjes ndërsa tranziti i Saturnit 23 gradë tek Demi formonte kuadrat me Diellin e tij të lindjes. Marsi ishte tranzit në shtepinë e tij të 12-të të lindjes dhe Dielli tranzit në shtepinë e gjashtë të tij.

Si ngjarje e fundit për të verifikuar këtu do të marrim martesat kolektive të kremtuara në Suza midis 10 mijë ushtarëve grekë dhe atë të disa grave aziatike. Këto martesa ndodhen rreth ditëve të para të prillit 324 p. K. dhe ishin idetë e Aleksandrit (në rastin kur ai u martua vetë).

Duke shqyrtuar Progresionet Dytësore shohim që Hëna e progresuar është përkrah Deshendentit të lindjes së Aleksandrit dhe sapo kishte hyrë në shtepinë e tij të 7-të. Duke iu referuar mësimeve të Dane Rudhyar Hëna e progresuar sapo kishte plotësuar këtu gjysëm-fazën e vetëdijes (ndërgjegjës) subjektive dhe po hynte në gjysëm-fazën e vetëdijes objective.

Besoj që ky interpretim pasqyron në mënyrë të përkryer gjendjen e brendshme të mendjes së Aleksandërit gjatë asaj periudhe. Nga tipi individual i vetëdijes ai po kalonte pra në atë kolektiv dhe shndërrimi i tij i brendshëm shprehet jashtëzakonisht nga martesat kolektive që kremtoi (shpalli) në Suza. Për sa i përket Tranziteve është interesante të përmendim Venusin që me të gjitha mundësitë ishte tranzit në shtepinë e tij të shtatë opozitë me Neptunin e tij të lindjes, ndërsa tranzititi i Jupiterit dhe Saturnit përkrah njëri-tjetrit formojnë kuadrat me Venusin e tij të lindjes.

Ky aspekt i fundit thekson gjithashtu një ndryshim në mënyrën se si Aleksandri i sheh marrëdhëniet e tij me të tjerët. Së fundmi, tranziti i

Uranit sunduesit të shtepisë së tij të shtatë të lindjes ishte përkrah Mesqiellorit të tij. Ky përshkrim astrologjik pasqyron, si të thuash, shumë qartë këto martesa kolektive të pazakonshme të pajtimit (harmonisë).

Ishte në pasardhësit e këtyre 10. 000 çifteve (bashkimeve) greko-aziatike që Aleksandri po planifikonte të ndërtonte formën e së ardhmës së perandorisë së tij, një perandori të cilën ai e përfytyroi homogjene (të njëtrajtshme), të suksesshme dhe gjithmonë të qëndrueshme!

19. Shenjat e njerëzve të famshëm

Personazhe të lindur në shenjen e Dashit:

Sharlemanj, Çarli Çaplin, Van Gog, Rasell Krou, Sadam Hysein, Elton Xhon, Bismark, Sharl Bodler, Maraja Keri, Selin Dion, Valeria Marini, Xhulian Lenon, David Frost, Ema Tompson, Pat Robertson, Papa Benedikti XVI, Ronaldinjo, Leka Zogu, Ilir Meta, Vaçe Zela, Vera Grabocka, Luiza Xhuvani, Shpëtim Saraçi, Adi Krasta, Andi Bushati, Genta Ismaili, Erjon Bogdani, Kledi Kadiu, Ilir Shaqiri, Jonida Maliqi, Eneida Tarifa.

Personazhe të Demit:

Platoni, Mark Aureli, profeti Muhamed, Leonardo Da Vinçi, Zigmund Frojd, Skënderbeu, Uilliam Shekspir, Car Nikolla II, Adolf Hitler, Papa Gjon Pali, Honore de Balzak, Xhorxh Kluni, Elizabeta e II e Anglisë, Katerina e Rusisë, Karl Marks, Vladimir Lenin, Mikele Plaçido, Enrik Inglezias, Sher, Uma Thurman, Al Paçino, Xhek Nikolson, Toni Bler, Robert Patinson, Ana Oksa, Kakà, Vojo Kushi, Timo Flloko, Shpat Kasapi, Rovena Dilo, Anjeza Shahini, Mariza Ikonomi, Arian Çani, Gili, Eli Fara, Bleona Qerreti, Bamir Topi, Agron Llakaj, Valbona Selimllari, Arbana Osmani, Hashim Thaçi, Juliana Pasha, Alban Skënderaj.

Personazhet e shenjes së Binjakëve:

Sokrati, Merilin Monro, Xhon Kenedi, Dante Aligeri, Pipo Baudo, Anxhelina Zholi, Nikol Kidman, Kajli Minog, Xhoni Dep, Rafaela Karra, Kolin Farell, Ban Ki Mun, Meril Strip, Izabela Roselini, Helen Hunt, Brus Dern, Klint Istvud, Pol Adrian, Mishel Platini, Jorgo Papandreu, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Ardit Gjebrea, Jorgo Papingji, Meda, Lulëzim Basha, Ornela Bregu.

Personazhe të lindur në shenjën e Gaforres:

Jul Çezari, Henri VIII, Lejdi Diana, Majk Tajson, Silvester Stalone, Zinedin Zidan, Tom Hënks, Kristofor Kolombi, Ursula Southeil, Zhan de la Fonten, Franc Kafka, Ernest Heminguej, Tom Kruis, Xhorxh W. Bush, Harrison Ford, Nikola Tesla, Alfredo di Stefano, Lionel Mesi, Xhorxh Majkëll, Angela Merkel, Havier Solana, Gabriel Garko, Pamela Anderson,

Sebastian Ruli, Edi Rama, Alma Bektashi, Rudina Xhunga, Sonila Meço, Elsa Lila.

Personazhe të shenjes së Luanit:

Aleksandri i Madh, Perandori Klaudius, Napoleon Bonaparti, Karl G. Jung, Ana e Anglisë, Arnold Shvarceneger, Bill Klinton, Antonio Banderas, Zhaklinë Kenedi, Madona, Benito Musolini, Neil Armstrong, Xhenifer Lopez, Lorenco Krespi, Raul Bova, Robert De Niro, Ben Aflek, Sllobodan Millosheviç, Fidel Kastro, Aleksandër Dyma, Barak Obama, Daniel Still, Mbretëresha Geraldinë, Rexhep Mejdani, Sabri Godo, Rajmonda Bulku, Ema Andrea, Lorik Canaj.

Personazhe të Virgjëreshës:

Pompeu i Madh, Perandori August (Oktaviani), Kaligula, Majkëll Xhekson, Elisabeta I, Sofia Loren, Luigji XIV, Ivani i Tmerrshëm, Tolstoi, Jaser Arafat, Luiz Ronaldo, Oliver Ston, Kameron Diaz, Riçard Gir, Klaudia Shifer, David Koperfild, Rajan Filips, Uilliam Levi, David Zepeda, Liz Grin, Nënë Tereza, Fatos Nano, Reshat Arbana, Parashqevi Simaku, Alberie Hadërgjonaj.

Personazhe të Peshores:

Xhuzepe Verdi, Luçano Pavaroti, Silvio Berluskoni, Zhan Klod Vandam, Mili Karluçi, Brixhid Bardo, Renato Zero, Katerinë Z. Xhons, Tarkan, Alfred Nobel, Xhon Lenon, Mihael Balak, Monika Beluçi, Fridrih Niçe, Pelé, Vladimir Putin, Keti Uinslet, Majkëll Dagllas, Ahmet Zogu, Enver Hoxha, Ramiz Alia, Sali Berisha, Migjeni, Gjergj Fishta, Dritëro Agolli, Aurela Gaçe, Hygerta Sako.

Personazhe të Akrepit:

Perandori Tiberius, Pablo Pikaso, Eros Ramazoti, Xhulia Roberts, Leonardo Di Kaprio, Maria Antoneta, Volter, Princi Çarls, Sharl dë Gol, Albert Kamy, Alen Delon, Bernard Kushner, Martin Luter, Luis Hamon, Homer Lea, Hilari Klinton, Maradona, Meg Rajan, Kristofer Noth, Demi Mur, Alen Delon, Xhodi Foster, Roza Anagnosti, Ina Rama, Pandeli Majko, Mihrije Braha.

Personazhet e Shenjës së Shigjetarit:

Neroni (perandor romak), Antinous, Frenk Sinatra, Brus Li, Jozef Stalin, Bred Pit, Mark Tuejn, Britni Spiërs, Zhak Shirak, Xhim Morrison, Dalai Lama, Bet'hoven, Paolo Meneguci, Antoni Hopkins, Xhon Abraham, Xhonatan Keiner, Alisa Milano, Gustav Flobert, Gabriela Spanik, David Vija, Petro Marko, Ibrahim Rugova, Adem Jashari, Tinka Kurti, Jozefina

Topalli, Alfred Moisiu, Zhani Ciko, Elvira Diamanti, Redon Makashi, Adelina Ismajli, Erion Veliaj.

Personazhe të Bricjapit:

Kleopatra e Egjiptit, Mark Antoni, Nostradamus, Isak Njuton, Luis Pasteur, Elvis Presli, Adriano Çelentano, Domeniko Modunjo, Zhan d'Ark, Riçard Nikson, Molieri, Johan Kepler, Stefen Hauking, Riki Martin, Mikael Shumaker, Zhan Dikson, Kevin Kostner, Nikolas Sparks, Sakis Ruvas, Mel Gibson, Eliza Dushku, Zherar Depardië, Orlando Blum, Nikolas Keixh, Denzel Uashington, Fan Noli, Robert Ndrenika, Ben Blushi.

Personazhe të shenjës së Ujorit:

Perandori Adrian, Çarls Darvin, Moxart, Lord Bajron, Frederiku i Madh, Abraham Linkoln, Tomas Edison, Xhenifer Aniston, Brendon Li, Robi Uilliams, Zhak Prever, Pol Njuman, Xhon Travolta, Shakira, Karla Del Ponte, Xhastin Timberlejk, Ashton Kutçer, Nikolas Sarkozi, Nexhmije Hoxha, Ismail Qemali, Ismail Kadare, Ndriçim Xhepa, Frederik Ndoci, Ledina Çelo, Elvana Gjata.

Personazhe të shenjës së Peshqve:

Jezus Krishti, Xhorxh Uashington, Car Aleksandri i III, Albert Ajnshtajn, Nikolla Kopernik, Galileo Galilei, August Renuar, Elizabet Tejlor, Mikelanxhelo, Viktor Hygo, Liza Mineli, Ornela Muti, Frederik Shopen, Sharon Ston, Xhon Bon Xhovi, Mishel dë Montenj, Edgar Keisi, Osama Bin Laden, Çak Norris, Maite Perroni, Billi Zane, Rihana, Xhastin Biber, Violeta Manushi, Leonora Jakupi, Arta Dade, Luigj Gurakuqi, Faik Konica, Aleksandër Xhuvani, Panajot Pano, Nik Xhelilaj, Amarda Toska.

20. Personalitete shtetesh që u besonin astrologëve

Nga Reagan, Roosvelt, Napoleoni dhe Hitleri që ishte i fiksuar

Politikanët në përgjithësi, kanë një dobësi të veçantë për astrologjinë. Ronald dhe Nancy Reagan janë të famshëm për konsultat e tyre me një astrologe. Po ashtu dhe presidentët francezë, Charles de Gaulle dhe Francois Miterrand. Presidenti, Roosevelt nuk udhëtonte kurrë ditë të premte.

Politikanët e vendeve totalitare janë më të ndjeshëm ndaj fenomenit, se ato demokratikë.

Sa më totalitar regjimi aq më të mëdha janë gjasat për kërkimin e shpjegimeve dhe shenjat tek yjet. Thuhet se Napoleoni kishte frikë nga macet e zeza dhe besonte se nëse hante pulë dhe karkaleca deti, do fitonte në betejë. Leonid Brezhnev këshillohej me një astrolog me emrin Dzhuna,

gjatë momenteve kyçe të Luftës së Ftohtë dhe u kurua nga një mjek besimtar gjeorgjian, në vitet e fundit të jetës së tij.

Catherine de'Medici konsultohej me vetë Nostradamusin, ndërsa perandori Rudolf II e merrte parashikimin e fatit nga Johannes Kepler, astrologu i famshëm gjerman.

Që nga perandorët romakë, nazistët, e deri tek gjeneralët e Birmanisë, tiranët kanë ndjerë nevojën për të besuar se ka qenë fati, e jo rastësia, ai që u ka dhënë pushtetin dhe i ka mbajtur aty. Duke qenë se fama e tyre është e parapërgatitur, ato synojnë t'i japin formë dhe të parashikojnë të ardhmen.

Për pjesën më të madhe prej nesh, horoskopi ditor është një kalim kohë i padëmshëm dhe pa kuptim, por në duart e një diktatori, ai ushqen lehtësisht paranojën dhe megalomaninë.

Për asnjë despot, s'është aq e vërtetë kjo gjë, sa për Hitlerin, fiksimi i të cilit me okultin i dha formë një regjimi, që në mënyrë të vullnetshme refuzoi racionalizmin në favor të determinizmit mistik. "Ne qëndrojnë në skaj të epokës së arsyes. Një epokë e re, që shpjegon botën me anë të magjisë, po lind", deklaroi Hitleri.

Në korrik 1933, astrologu më i famshëm i Berlinit, Erik Jan Hannussen, u thirr për t'i lexuar dorën Hitlerit në hotelin "Kiaserhof". Si shumë mistikë, ai parashikoi pikërisht atë që klienti donte të dëgjonte. "Shoh fitore për ty. Nuk mund të shmanget", i tha ai. Por kjo s'i shërbeu aspak, pasi hebreu Hanussen, nuk mundi të parashikonte fatin e tij të zi, vrasjen nga SS-të.

Gjatë luftës, Inteligjenca britanike u përpoq të shfrytëzonte fiksimin e Hitleri me astrologjinë, duke nxjerrë parashikime të rreme mbi vdekjen e tij të afërt, në gazetat anembanë botës, me shpresën se kjo do destabilizonte atë dhe regjimin e tij. Oficeri i Inteligjencës që drejtoi këtë plan shkruante: "Kjo është gjëja më kurioze që më është dashur të bëj, por gjithashtu më e rëndësishmja". Ai kishte të drejtë për të dyja. Ashtu si fiksimi i juntës së Birmanisë, fiksimi i Hitlerit me mbinatyroren ishte shenjë e destabilitetit dhe dobësisë, si dhe një dritare në regjimin e tij të çuditshëm dhe tiran.

Gilbert Murray shkroi njëherë: "Terreni më i përshtatshëm për supersticionin është një shoqëri, në të cilën fati i njeriut duket se nuk ka lidhje me meritat dhe përpjekjet e tij". Kjo ishte e vërtetë për Gjermaninë naziste, dhe është po aq e vërtetë për Birmaninë moderne, ku e mira vuan dhe shtypësit lulëzojnë. Rudyald Kipling njëherë shkroi: "Kjo është Birmania dhe do jetë ndryshe nga çdo vend që keni njohur".

Me mahnitjen e pambarim ndaj supersticionit, diktatorët e Birmanisë duket sikur kthehen në një epokë tjetër. Secili prej klaneve udhëheqëse të juntës ka një astrolog të familjes. Ushtria ka ekspertin zodiak, por është punë e rrezikshme.

Astrologët, të cilët bëjnë parashikime negative zakonisht arrestohen.

Besimi i Juntës në Astrologji, përfaqëson pjesërisht çudinë kapriçoze të një regjimi të egër në mënyrë të pazakontë, të izoluar nga pjesa tjetër e botës dhe të ndarë nga realiteti. Dy forma besimi po përplasen sot në Birmani. Nga njëra anë murgjit, ndjekës të një besimi të lashtë dhe në kërkim të lirisë demokratike e reformës ekonomike, dhe nga ana tjetër një makineri ushtarake moderne që ecën sipas një kodi mesjetar profecish, oguresh astrologjie dhe simbolizmi supersticioz.

Astrologët në politikë

Për shumë njerëz, përdorimi i astrologjisë nga politikanët në ditët moderne, doli në dritë, kur presidenti amerikan Ronald Reagan dhe bashkëshortja e tij, Nancy bënë të ditur se i planifikonin aktivitetet e tyre, sipas këshillave të një astrologeje. Por, astrologjia ka qenë prej shekujsh faktor i rëndësishëm, në mendjen e shumë liderëve të mëdhenj botërorë.

Liderët e lashtë

Disa burime historike mendojnë se Aleksandri i Madh përdorte astrologjinë për të udhëhequr fushatat ushtarake e mëdha. Çezari nuk besonte në astrologji, por pasardhësi i tij, Augustusi po. Ai madje kërkoi gdhendjen e shenjës së tij të horoskopit, tek monedhat, por nuk u përfshi shumë me astrologët, për shkak të frikës nga tallja publike. Tiberi, pasardhësi i Augustusit, dinte të interpretonte horoskopin dhe kishte si këshilltar një astrolog. Pasardhësi i Tiberit, Klaudius, gjithashtu kishte këshilltar një astrolog.

Monarkia angleze

John Dee ishte një matematikan, astronom, gjeograf dhe astrolog britanik, i shekullit të 16-të. Ai ishte emëruar që të parashikonte horoskopin e mbretëreshës Mary (Mary e Përgjakshme) dhe të burrit të saj të mundshëm, princit Filip të Spanjës.

Sidoqoftë, kur ai krijoi horoskopin për gjysmë motrën e mbretëreshës Mary, princeshën Elizabeth, ai u burgos për pak kohë, në vitin 1555, për shtrigëri. Ai u bë mik me Elizabeth-ën dhe sapo ajo mori fronin, ai u bë astrologu i saj i besuar. Ai zgjodhi dhe datën e kurorëzimit të saj. Shumë njerëz u çuditën, nga besimi që mbretëresha i jepte atij, sapo mori fronin.

Liderët amerikanë

Amerikanët mund të çuditen, kur të zbulojnë se baballarët e kombit, kanë pasur besim të madh në astrologji. Se sa ato besonin tek astrologët, nuk dihet mirë, por ka shumë imazhe astrologjie në ndërtesat qeveritare në Uashington. Në vitet '80, amerikanët zbuluan faktin se astrologjia shërbente për planifikimin e lëvizjeve të presidentit. Nancy Reagan konsultohej me astrologen, Joan Quigley për këshilla.

Rasputini

Rasputini ka pasur një influencë të madhe në familjen e carit Nikolla II. Ka qenë e shoqja e carit, Aleksandra, e cila kishte besim tek njeriu misterioz, i cili thuhej se kishte aftësi të mbinatyrshme dhe mund të parashikonte të ardhmen.

Influenca e tij mbi carin u rrit në vitin 1912, kur djali, Aleksei gati vdiq pasi u plagos, teksa kalonin pushimet me familjen, pranë Polonisë. E dëshpëruar, Aleksandra thirri Rasputinin, i cili u përgjigj, "Zoti i ka parë lotët e tu si shpresën e fundit dhe përgjigja erdhi. Mos vajto. I vogli nuk do vdesë. Mos i lër doktorët ta bezdisin". Djali u shërua si për mrekulli dhe që atëherë, Aleksandra do e mbronte Rasputinin dhe do tërbohej ndaj kujtdo, që e sulmonte atë.

21. Thënie për Astrologjinë

Është e tmerrshme kur pret dhe shpreson diçka kot,
por më e tmerrshme është kur nuk pret dhe nuk shpreson asgjë.

"Gjithçka është shkruar në qiel"
-Klaud Ptolemeu

"Astrologjia është një shkencë në vetvete, ndriçuese. Kam mësuar shumë prej saj dhe unë i kam shumë borxh asaj. Njohuria gjeofizike nxjerrë në pah fuqinë e yjet dhe planeteve në fatin tokësor. Nga ana tjetër, astrologjia e përforcon këtë.
- Albert Einstein

"Astrologjia është një shkencë themelore e njerëzimit
- Johannes Kepler

"**Një mjek pa astrologji, është si njeriu pa njërin sy. "**
- Hipokrati, babai i mjekësisë.

"Tranzitet planetare dhe pozicionet e lindjes nxisin vetëm prirje, por kur, në të njëjtën pikë, bëhen disa prirje së bashku ato kthehen në forca detyruese duke i bërë ngjarjet konkrete. " - Nikolas Herceku

"Astrologjia është si një gjuhë e huaj, ku astrologu përkthen aq sa di dhe ndoshta jo aq sa mund të kërkojë klienti. "– Nikolas Hercek

"Astrologjia është e bija e mitologjisë, nëna e astronomisë dhe motra e madhe e psikologjisë". - N. Hercek

“Kush ka nevojë për astrologjinë? Njerëzit e zgjuar ecin para me biskotat e fatit”.
- Eduard Abei

Astrologjia: bëjmë ne hulabalu mes yjeve apo ata bëjnë hulabalu këtu poshtë?”.
- Mezon Kulei

″Një njeri i zgjuar do t'i mbizotërojë yjet e tij dhe do të ketë një ndikim më të madh mbi përmbajtjen e tij sesa të gjitha yjësitë dhe planetet e kupës së qiellit”.
- Xheremi Teilor

“Unë nuk besoj në astrologji. Jam Shigjetari dhe ne jemi mosbesues”.
- Artur C. Klark

″Astrologjia është thjesht një gisht i drejtuar realiteti”t.
- Stiven Fores

“Një fëmijë lindet në atë ditë dhe atë orë kur rrezet qiellore janë në harmoni matematike me karmën e tij individuale. ″
- Sri Juktesuar

″Astrologjia është një ndër përpjekjet e para të bëra nga njeriu për të gjetur rregullin e fshehur mbas ose mes kaosit të turbull dhe të dukshëm që ekziston në botë. ″
- Karen Hamaker-Xondag

″S'duhet të kemi turp të flirtojmë me zodiakun. Zodiaku ia vlen per te flirtuar”.
- D. H Laurence

″Kupola yjore e qiellit është në të vërtetë libri i hapur i projektimit kozmik”.
- Karl Jung

S'ka varkë më të mirë se një horoskop për të ndihmuar një njeri të kalojë detin e jetës. ″
- Varaha Mihira

“Fati ynë nuk përmbahet në yjet por në veten tonë, ne jemi vartës. ″
- Uilliam Shekspir

"**Supersticioni është për fenë si astrologjia për astronominë: vajza e çmendur e një nëne të urtë. "** - Volteri

"**Endrrat dhe parashikimet e astrologjisë, duhet të shërbejnë por për bisedë dimri rreth zjarrit. "**
- Frensis Bekon

"**Kushdo mund të bëhet një milioner, por që të bëhesh një miliarder të duhet një astrolog. "**
- Xhon Pierpont Morgan (miliarderi i parë)

"**Astronomia për egoistët bëhet astrologji. "**
- Ralf Ualdo Emerson

"**Trupat qiellorë janë shkaku i gjithçkaje që prodhohet në këtë botë tokësore, ato ndikojnë në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë mbi veprimet njerëzore, por të gjitha efektet që ato prodhojnë, nuk janë të pashmangshme. "**
- Saint Thomas D'Aquin

"Astrologjia serioze është matematikë e përzier me psikologji. "
- Nikolas Hercek

"Nuk ka as edhe një njeri që të ketë lindur me yll të keq. Fajin e kanë njerëzit që nuk dinë të lexojnë qiellin".
- Dalai Lama

"Nëse do të më pyesnin se cila është feja ime, do të përgjigjesha: astrologjia".
- Alexandre Volguine

"Astrologjia është një gjuhë e huaj. Po e kuptove këtë gjuhë, qielli flet me ty".
- Dani Rudhyar

22. Astrologjia sot

Astrologjia zë një vend më vete mes arteve parashikuese të së ardhmes. Mund ta quajnë edhe sit ë parën mes tyre, çka i jep një farë rëndësie apo e njerr, sit a thuash, në krye të listës. Vlera e saj si shkencë kundërshtohet nga ndjekësit e racionalizmit, megjithëse askush nuk mund t'ia heqë atë lloj rrezatimi të nderuar që i jep lashtësia dhe as të mohojë faktin se në kohërat e vjetra ajo vlerësohej, mësohej në universitete, kalohej

si njohuri nga mësuesi te nxënësi… Për më tepër, qe e pandashme nga astronomia. Përfytyroni pak se si do t'i ziente koka ndonjë dijetari të atyre kohërave po të dëgjonte argumentet "pro"dhe "kundër"që transmetohen sot për astrologjinë ngado nëpërmjet "dritareve tona të vogla në botë". Këto diskutime do t'i dukeshin kundër natyrës. Edhe sot ka njerëz të cilëve ju duken pa kuptim këto debate. Mund të thuhet se astrologjia ngjallë gjithçka, përveç indifferences. Mbështetësit e "idesë së shkencës" kërkojnë të mohojnë e t'i heqin misticizmin gjithçkaje që duket sot e pashpjegueshme. Në fakt, argumentet shkencore që përdoren kundër astrologjisë janë mjaft të varfëra. Franca dhe vendet europiane frankofone mbajnë vendine parë në luftën kundër astrologjisë. Në Shtet e Bashkuara të Amerikës astrologjia është ende pjesë e librave universitarë, ndërsa në Angli ka edhe një fakultet astrologjie.

Sidoqoftë, astrologjia vazhdon të qëndrojë mes racionales dhe joracionales. Ajo që duket më pak e shpjegueshme është fusha e parashikimit, prirjet e karakterit, potencialet, mjediset dhe rrethanat që do të ndeshë një qenie në rrugën e ekzistencës së saj. Deri këtu nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Në të vërtetë mund të pohojmë se temperamenti ynë i vërtetë projektohet në disa gjendje që i përshtaten më të tepër. Por aty ku shkon më larg astrologjia në këtë drejtim është pretendimi se mund të caktojë datat kryesore të ngjarjeve të një ekzistence, pa dhënë shumë hollësira mbi këto ngjarje, por duke dhënë vetëm llojin e tyre. Kjo i irriton më tepër ndjekësit e teorisë së "njeriut si zoti i vetvetes". Megjithatë, po këta njerëz ia lejojnë vetes të njohin ndikimin e trupave qiellorë mbi baticat, bimët, dukuritë gjeologjike…, pa folu për Diellin, pozicioni i të cilit lidhur me Tokën përcakton ritmin e ditëve tona, të netëve, të klimës… atëherë, pse nuk ndikoka edhe mbi vetë njeriun? Edhe njeriu në Tokë jeton, njësoj si bimët… Nga natyra e tij, njeriu zotëron ndërgjegje dhe pikërisht ky fakt i bën marrëdhëniet e tij me astrologjinë kaq të larmishme dhe të pasura me domethënie. Ky pozicion i paqëndrueshëm bën që astrologjia të mos ketë status të përkufizuar, i cili mund ta fuste përfundimisht te artet parashikuese ose te shkencat. Në të vërtetë ajo nuk është art parashikues, sepse astrologu nuk hamendëson, ai vetëm interpreton duke u nisur nga të dhëna reale, matematikore dhe simbolike në të njëjtën kohë. Por nuk është as shkencë në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse të njëjtat shkaqe nuk sjellin gjithnjë të njëjtat pasoja, njeriu fut aty bagazhin e vet dhe një pafundësi nuancash. Ndoshta do të ishte më i drejtë për astrologjinë cilësimi - "shkencë njerëzore", sepse hapi i parë i astroligjisë është t'i japë qenies njerëzore një mjet për të njohur më mirë vetveten. Hapi i dytë i saj është parandalimi. Është e rëndësishme "të njohësh embrionin"dhe astrologjia mund të na vijë në ndihmë me qëllim që të mësojmë të *parandalojmë* dhe jo të *kurojmë*, duke shfrytëzuar në maksimum periudha të caktuara.

VI - MAGJIA

1. Ç'është Magjia?

Magji do të thotë: mrekulli, çudi, aftësi e jashtëzakonshme që ka dikush për të ndikuar tek tjetri etj. , e sipas Franc Bardonit, ajo konsiderohet edhe si shkencë e shenjtë.

Ky nocion, që ka një të kaluar shumë të largët e që përdoret edhe sot e kësaj dite në mbarë rruzullin tokësor, interpretohet në mënyra nga më të ndryshmet dhe zakonisht merret si sinonim i së keqes, por që në fakt nuk është plotësisht e vërtetë.

Magji do të thotë: mrekulli, çudi, aftësi e jashtëzakonshme që ka dikush, për të ndikuar tek tjetri etj. , e sipas Franc Bardonit, ajo konsiderohet edhe si shkencë e shenjtë.

Siç dihet, në natyrë gjithçka rrezaton. Njeriu si qenie me komplekse ka llojin e veçantë të rrezatimit. Rrezatimi, sipas parimit të përgjithshëm të antipolaritetit, mund të jetë pozitiv ose negativ, tërheqës ose dëbues, i mirë ose i keq etj. Gjithashtu, rrezatimet varen edhe nga shkalla e zhvillimit të jetës shpirtërore të personit.

Mendimet, dëshirat, ndjenjat tona paraqesin burim shumë të madh të energjisë rrezatuese. Në qoftë se jeta jonë shpirtërore ka një drejtim të caktuar, atëherë edhe rrezatimet përkatëse kanë karakterin e vet të caktuar. E në qoftë se në të kundërtën, u nënshtrohen labiliteteve të ndryshme, atëherë edhe rrezatimet pasuese do t'u nënshtrohen oscilimeve të përhershme dhe dobësimit të tyre.

Drejtimi i caktuar i mendimeve (energjisë psikike), i drejtuar qoftë për të mirë, qoftë për të keq, në qoftë se ka karakter stabël, formon rrymë të fortë psikike, e cila rrezaton në rreth dhe formon tek rrethi ndjenjën e simpatisë ose antipatisë, dashurisë ose urrejtjes etj.

Kjo energji psikike është sikurse çdo lloj tjetër i energjisë, neutrale: as e mirë as e keqe, i mirë ose i keq është përdorimi i saj. Të dy këto komponentë e ndjekin njëri-tjetrin. Sikurse nata, që në mënyrë të pashmangshme ndjek ditën, po kështu edhe e mira zëvendëson të keqen në çdo hap. Dallimi qëndron vetëm në kuptimet individuale, sepse derisa diçka në sytë e dikujt është e mirë, për tjetrin ajo mund të ketë kuptim negativ.

Parimi i përgjithshëm natyror formohet nga e mira, ndërsa e keqja është prodhim i mospranimit të së mirës. Këtu pra, qëndron edhe esenca e magjisë. Në fushën e "Magjisë së Bardhë", vihen në dukje në rend të parë, lutjet e ndryshme, në të cilat: dëshira, besimi, dashuria dhe shpresa e koncentruar veprojnë në mënyrë magjike.

Kështu pra, secili mendim, në qoftë se është i pastër, intensiv dhe stabël, ka tendenca që të realizohet. Në qoftë se në këtë bindje ekziston

edhe besimi i patundur se ajo do të plotësohet dhe se dëshira e caktuar do të realizohet, atëherë veç janë të plotësuara kushtet kryesore që të vijë gjer te realizimi i qëllimit.

"Magjinë e Bardhë"mund ta aplikojë vetëm ai individ, që ka arritur ta njohë vetveten, i cili ka transparent mendimin dhe esencën e jetës, si dhe me ushtrime të gjata dhe të mundimshme, ka arritur të koncentrojë gjithë forcën e vet psikike dhe ta përkryejë deri në atë masë mendimin sa që qëllimisht dhe vetëdijshëm ta përdorë me qëllim që t'i shërbejë së mirës.

Pra, "Magjia e Bardhë"vjen si rezultat i produktit të së mirës dhe operimet e saj janë: shërimet psikike, lutjet, largimet e vetive të paqendrueshme të karakterit, zhvillimin e aftësive mentale etj.

Ndërsa, për dallim nga kjo, "Magjia e Zezë"si rezultat ka produktin e së keqes. "Magjia e Zezë"ka për qëllim që të prishë dhe të shkatërrojë gjithçka që është lartësuar si e bukur dhe si e mirë, ashtu që e keqja të triumfojë mbi të mirën.

Veprimet e individit që zbaton "Magjinë e Zezë"janë të lidhura ngushtë me interesat materiale dhe plotësimin e motiveve nga sferat më të ulëta shpirtërore e sidomos ajo seksuale, nëpërmjet së cilës instiktet e shëmtuara dhe nervat e topitura duhet të gjejnë kënaqësi. I lidhur për këto veprime të llojit më të ulët, ai gjen kulmin e kënaqësisë në dhimbjet e huaja. Nderi, dinjiteti, dhembshuria, keqardhja janë ndjenja, të cilat qysh në fillim i shuan në vete.

Për lexuesin e rëndomtë kjo gjendje është e vështirë të kuptohet, sepse ajo është transcendentale, një gjendje e cila shumë vështirë kapet nëpërmjet pesë shqisave që i pranon shkenca bashkëkohore. Si krahasim mund të merret orgazma ku humbin kufijtë midis objektives dhe subjektives.

Në kohën e sotme, kur shkenca ka arritur përparime të mëdha në kërkimet teknike, industri, mjekësi etj, njeriu modern vështirë edhe pajtohet me këtë dukuri, që në biseda formale vlerësohet si marrëzi supersticioze (besim i kot), por, prapëseprapë në thellësitë e shpirtit të tij fshihet një dozë e misteriozitetit.

Lind pyetja përse?

Sepse gati të gjitha arritjet shkencore i plotësojnë vetëm nevojat tona materiale, fizike etj. ! Po shpirti (psika) ku mbeti?

Ai mbeti në prapavijë. Gjithashtu, në prapavijë mbeti edhe ana etike e njeriu! Pra, shkenca harroi se pranë kauzalitetit fizik, ekziston edhe ai psikik dhe ai është shumë më i rëndësishëm për jetën e njeriut (këtë e vërtetojnë edhe kërkimet më të reja në lidhje me trurin, nga të cilat rezulton se truri i njeriut është një gjigant i fjetur dhe se kapaciteti i tij shfrytëzohet vetëm 4%).

Njeriu modern mashtrohet kur mendon se shkenca e kompjuterizimit do t'i zgjidhë të gjitha dilemat tona. Ajo me të vërtetë lehtëson jetën tonë

elementare, por nuk i zgjidh dot të gjitha mungesat, përkundrazi, ajo na bën që t'i ndiejmë edhe më qartë ato... !

Por, edhe përkundër këtij mosbesimi, njeriut modern nuk i pengon që edhe sot, si para disa mijëra vjetësh, të lidhet ngushtë me disa dukuri për të cilat pikërisht ai shpreh dyshim, e në anën tjetër ato i ruan me xhelozi, si: bartjen e unazës në gisht, zinxhirit, shamisë etj. (si dhuratë nga më e dashura, nga miku, shoku etj.), për t'i sjellë, kujtim, fat, disponim, dashuri etj.

Po të shikohen zakonet e popullit, do të vërejmë se ato janë të mbushura me rituale magjike, të cilave ju përmbahet edhe ai, pra, njeriu modern. Në ato rituale dihet saktësisht secili veprim dhe kush duhet ta bëjë. Të gjitha këto veprime në të shumtën e rasteve kanë karakter pozitiv. Mirëpo, sikurse "Magjia e Bardhë", që disponon me veprime të shumëllojshme dhe shumëdrejtimëshme, ashtu edhe "Magjia e Zezë"operon me shumëllojshmëri ceremonish, rrjedhash e kahjesh për orientimin e mendimeve.

Për rituale magjike zakonisht përdoren pjesë të trupit dhe të rrobave. Duhet të vëmë re se të gjitha sekrecionet, si: jashtëqitja, urina, djersa, por edhe thonjtë, flokët, dhëmbët e sidomos gjaku e sperma, pas ndarjes, mbesin në gjendje okultike në raport me trupin, nga i cili e kanë prejardhjen, pasi ato përmbajnë energjinë rrezatuese të po atij trupi.

E siç e pamë edhe më lart, energjia e gjithmbarëshme natyrore përshkon në masë më të madhe ose më të vogël gjithçka që ndodhet në natyrë, pavarësisht se a janë qenie të gjalla apo të vdekura. Pasi që të gjitha këto gjëra (edhe njeriu me gjithë përbërjen e tij), u nënshtrohen këtyre lëvizjeve të pandërprera të grimcave, ato e pranojnë këtë energji, e absorbojnë, e transformojnë dhe në raste të caktuara, siç ndodh tek rastet e operacioneve magjike, edhe e emetojnë atë.

Këto operime magjike, të cilat në esencën e vet bazohen në aktivizimin e energjisë, nuk duhet të na çudisin, e sidomos sot, në kohën e zbulimeve të mëdha elektronike. Në mënyrë të njëjtë sikurse energjia e emetuar nëpërmjet radio-valëve, që bartet nëpër eter, që në radioaparatet pranuese të shndërrohet në zë ose fotografi, po kështu edhe energjia e pjesëve të ndryshme të trupit, e sidomos ajo psikike mund të shërbejë si detektor ose indikator.

Duhet të theksojmë se të gjitha dëshirat dhe mendimet tona paraqesin energjinë, e cila aq sa është e fortë, po aq nxit ndjeshmëri të pastër dhe të fortë. Gjithashtu, suksesi i ritualit është i lidhur ngushtë me kualifikimin moral, si të personit që operon me këtë lloj energjie, ashtu edhe të atij kundër të cilit është drejtuar ajo.

Sikurse te radio-valët, mendimi mund të rrezatojë më fortë ose më dobët, varësisht nga fuqia e energjisë me të cilën është i përcjellë. Në qoftë se emetimi është më i fuqishëm, edhe radio-valët do të transmetohen më

larg, edhe pranimi i tyre do të jetë më i mirë. Kështu pra, edhe mendimi kur është më intensiv, veprimi i tij do të jetë më i fuqishëm...

Dhe së fundi dua të theksoj se, pavarësisht nga tempoja e jetës në shoqëritë e sotme ku ne jetojmë, e cila është aq e shpejtë, dinamike, automatike dhe e ngarkuar me mendime materialiste (sidomos në perëndim), synim themelor i secilës qenie njerëzore duhet të mbetet kultivimi i mendimeve dhe veprimeve pozitive.

Forca krijuese e njeriut, qoftë psikike apo fizike, është e pakufishme. Jeta e tij është shesh ku zhvillohen procese të panumërta emocionale, mendore e trupore, prandaj varet plotësisht prej tij se çfarë fare do të hedhë në kopshtin shpirtëror.

2. Magjia - dukuri qe tmerron njerëzimin

Sekretet e saj

Magjia është dukuri e cila e tejkalon horizontin e dijenisë së shoqërisë në të cilën shumica e njerëzve jeton.

I pari që futi termin "magjistar"në fjalorin e Greqisë ishte Euriditi, i cili e përdori këtë fjalë për të treguar një prift të Persisë Antike.

Që nga shekulli VI p. e. s. termi "mageia"përdorej për të përkufizuar praktika ose rituale të trashëguara nga Persia. Pikërisht, kultura helene shkriu elementet magjike me ato astrologjike e alkimike, për t i dhënë shkas lindjes së shumë spekulimeve në shekujt që do të pasonin

Magjistari përdor aftësitë e tij për qëllime të mira ose jo, për këtë arsye ka dy magji, e bardhë dhe e zezë. Shkenca e magjisë vepron përmes simboleve, qofshin këto fjalë, mendime, figura, gjeste, kërcime apo tinguj. Teknikat e magjisë mund të ndahen në 4 kategori: Magjia omeopatike, e cila kryhet nëpërmjet përdorimit të imazheve ose objekteve të ndryshme si personifikim i personit, mbi të cilin do të bjerë magjia (afërsisht siç ndodh në ritet Voodoo).

Magjia me kontakt, që kryhet nëpërmjet përdorimit të substancave të ndryshme të përgatitura me përbërës natyrorë. Hipnotizimi me anë të formulave magjike. Parashikimet si astrologjia, leximi i letrave, leximi i fatit në dorë etj. Gjatë riteve magjike, këto ndarje edhe mund të kombinohen me njëra- tjetrën. Në rastet kur magjistari kërkon ndihmën e shpirtrave dhe forcave të errëta atëherë kjo disiplinë e magjisë quhet spiritualizëm dhe demonologji.

Në shumicën e kulturave antike, besimet dhe praktikat magjike kanë ekzistuar që në lindjen e qytetërimeve. Karakteristikat janë të ngjashme, ndërsa mënyra e zbatimi ndryshon. Njerëzit ishin shumë supersticiozë ndaj magjive, por edhe fenomeneve natyrore, të cilat nuk arrinin t i shpjegonin. Në Francë janë gjetur disa piktura të periudhës së paleolitit të

cilat provojnë përdorimin e magjisë për ndihmë në aktivitete të ndryshme si gjuetia ose për mënjanimin e reshjeve.

Magjia në Egjipt, formulat magjike për të zgjatur jetën

Në shoqërinë e Egjiptit antik besohej shumë në magji. Në panteonin egjiptian, përveç Veret-Hekau, perëndesha e magjisë, dhe shumë njerëz të tjerë që kanë qeverisur vendin zotëronin të tilla aftësi. Këtë e tregojnë dokumentet dhe papiruset e shumta që janë gjetur, të cilat përmbajnë formula magjike në gjendje për të zgjatur jetën, të zgjidhin çështje dashurie dhe për të luftuar të këqijat.

Magjia në Lindjen e Mesme, andej nga erdhi shkopi magjik

Në Mesopotami, në të ashtuquajturën toka e magjistareve, janë gjetur shumë dokumente që faktojnë jo vetëm ekzistencën e magjisë, por edhe praktikumin e saj masiv, deri te kryerja e ritualeve në grup. Këto burime japin shembuj të llojeve të ndryshme të praktikave gjatë magjisë, ku mund të përmenden: Përdorimi i "fjalëve magjike"; Përdorimi i shkopit magjik ose medaljoneve të ndryshme; Krijimi i një rrethi njerëzish për të mbrojtur magjistarin nga shpirtrat; Përdorimi i simboleve misterioze për të kërkuar ndihmën e fuqive të mbinatyrshme. Megjithatë, në Lindjen e Mesme, magjia lidhej ngushtë me astrologjinë e cila shpjegonte çdo lloj fenomeni natyror ose jo.

Magjia në botën greko-romake, tek veprat letrare

I pari që futi termin "magjistar"në fjalorin e Greqisë ishte Euriditi, i cili e përdori këtë fjalë për të treguar një prift të Persisë Antike. Që nga shekulli VI p. e. s. termi "mageia"përdorej për të përkufizuar praktika ose rituale të trashëguara nga Persia. Pikërisht, kultura helene shkriu elementet magjike me ato astrologjike e alkimike, për t i dhënë shkas lindjes së shumë spekulimeve në shekujt që do të pasonin. Në letërsinë latine janë gjetur shumë dëshmi në lidhje me magjinë. Vrasje të mistershme, kafshë që flasin, statuja që ecin, metamorfoza, medaljone që kurojnë, janë vetëm disa nga elementet që citohen në veprat e Horacit, Plinit apo Virgjilit. Në panoramën letrare të magjisë latine, vendin e parë e zënë pa dyshim "Metamorfozat". Apuleio është një nga shkrimtarët e parë të asaj epoke që ka folur për magji në librin e tij "Gomari i Artë". Në fakt, vetë Apulieo është gjykuar për ushtrim magjie pasi u përpoq që me anë të disa formulave, të bindte një vejushë që të martohej me të, në mënyrë që të përfitonte nga pasuria e saj. Sipas ligjeve të Romës, çdokush që përdorte magjinë për qëllime përfitimi, ndëshkohej rëndë deri në vdekje.

Rënia e magjisë, iluminizmi godet shpjegimet absurde

Në shekullin XVII, kur magjia ishte në kulmin e saj dhe pritej të merrte një zhvillim akoma më të madh, ndodhi krejt e kundërta. Shkenca përparonte dhe vazhdonte tu jepte shpjegime fenomeneve që deri në atë moment, ishin abstrakte. Një nga emrat që u dallua për sulmin e ashpër ndaj doktrinës së magjisë ishte Francis Bacon (Frensis Bekon). Rënia e magjisë u përshpejtua dhe nga mendimtarë të shquar si Dekarti dhe Hobbes (Hobi). Gjithashtu, në shekullin XVII, iluminizmi e mundi magjinë, por pa arritur ta zhdukte përfundimisht atë.

Magjia në shekullin XIX, rizgjimi i interesit

Në historinë e njerëzimit, gjatë gjysmës së dytë e viteve 1800 pati një rilindje të interesit ndaj magjisë. Një nga emrat më të spikatur të kohës në këtë fushë, ishte pa dyshim Eliphas Lévi. Veprat e shumta letrare që ky njeri shkroi, patën një ndikim të rëndësishëm në brezat pasardhës. Në dekadën e fundit të 1800-ës u themeluan dhe disa organizatat ose grupime me prirje magjie. Ndër më të njohurat mund të përmenden Hermetic Order of the Golden Dawn apo Teosofic Society.

Magjia sot, objekt studimesh dhe paqartësish

Imazhi i magjisë në ditët e sotme nuk është fort i qartë. Kjo, falë dhe e kaosit që ekziston mbi doktrinën magjike apo të tjera të kësaj natyre. Teorikisht, gjërat janë si në lashtësi, kushtet për të bërë magji janë pak a shumë të njëjtat, por gjithnjë të varura nga yjet, formulat, shpirtrat dhe sendet magjike.

Tematikat që hasen gjatë studimit të magjisë, kryesisht kanë të bëjnë me lidhjen e saj me shkencën dhe fenë, por dhe funksionin e saj shoqëror. Magjia është një fenomen që ka lindur njëherësh me qytetërimet më të lashta, ndërsa sot është kthyer dhe në objekt studimi të antropologjisë kulturore, etnologjisë dhe psikologjisë.

Ezoterika dhe alkimizmi, ndërthurje besimesh e filozofish

Alkimia është pjesë e traditës mistikore dhe së fshehtës si në Lindje ashtu edhe në Perëndim.

Ezoterika (nga greq. εσωτερικός, esoterikos, – "i brendshëm"), është mësimi ose dija e së fshehtës. Këto mësime mbaheshin nga mjeshtrat, të cilëve u mundësohej zbulimi (çvelimi) i së vërtetës okultike (së fshehtë).

Në filozofi, emërtimi ezoterikë karakterizon mësimin e lënë nga filozofët e lashtë grekë, veçanërisht nga Pitagora dhe Aristoteli, nxënësve të tyre; në kundërshtim me eksoterikën, "e jashtmja"emërtim që përdorej për njerëzit që nuk bënin pjesë në grupet ezoterike, pra njerëzit e thjeshtë, të cilët nuk kishin njohuri mbi gjuhën dhe kuptimin e mjeshtrave.

Sot me ezoterizëm tregohet zakonisht ndërthurja e sistemeve të mendimit filozofik dhe fetar që shfaqen në dukuritë kulturore si: magjia, alkimia, kabalah dhe besimet misterike dhe gnostike. Megjithëse dituria ezoterike mbahej në të kaluarën e fshehtë, tani mësohet kudo haptazi. Ezoterika dallohet përgjithësisht nga fetë e organizuara, të cilat mësojnë më haptazi.

Ndërsa ezoterizmi anon në përqendrimin e (mendje) ndriçimit vetjak dhe ushtrimin e brendshëm shpirtëror, feja e organizuar përqendrohet në ushtrimin e ritualitetit të jashtëm shpirtëror dhe mbi ligjet që qeverisin shoqërinë. Shumë grupe apo shkolla të mendimit përqafojnë një traditë ose filozofi ezoterike, si: Alkimia (arab: الخيمياء, al-khimia) është një ushtresë e lashtë e shkencës fillestare që merrej me vëzhgimin e natyrës dhe filozofisë dhe ndërthurte elemente të kimisë, fizikës, astrologjisë, artit, metalurgjisë, mjekësisë, misticizmit dhe fesë.

Alkimia është një mënyrë e lashtë e pastrimit shpirtëror dhe shndërrues; zgjerimit të ndërgjegjes dhe zhvillimit të brendashikimit dhe intuitës. Ajo bazohet në idenë se rendi hyjnor është vendosur në gjithësi me "lëndën e parë"apo prima materia. Çdo gjë është krijuar nga kjo lëndë, e cila është në thelb, Guri i Filozofit. Thuhet se ai është kudo, dhe nëse "guri"mund të përgatitet (krijohet), atëherë një send mund të shndërrohet në diçka më të përsosur, p. sh. në argjend apo ar, pasi që ari është produkti më i përsosur dhe pasqyron më afër përsosmërinë e Perëndisë. Alkimistët besonin po ashtu se me ndihmën e "gurit"mund të prodhohej edhe "bari i mrekullueshëm"(eliksiri) që dhuron jetën e amshuar.

Alkimia është lidhur gjithnjë me misticizmin dhe misterin. Fillimet e veta ajo i ka pasur me sistemin e së amshuarës, ëndrrës, simboleve ezoterike që kanë fuqinë për të ndryshuar ndërgjegjen dhe të lidhin shpirtin njerëzor me Hyjnoren.

Alkimia është pjesë e traditës mistikore dhe së fshehtës si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Disa filozofë të mëdhenj grekë mendonin se çdo gjë përbëhet nga katër "elemente"themelore: zjarri, ajri, toka (dheu) dhe uji, dhe të gjitha sendet kanë në vete këta përbërës të përzier në përpjesëtime të ndryshme. Prandaj besohej se të gjitha gjërat mund të shndërrohen në diçka tjetër nga ndryshimi i përpjesëtimeve të përzierjes së katër elementeve themelore të natyrës. «Alkimia shërben për të ndarë të vërtetën nga e rremja. "– Teofrasto Paracelso

Agnosticizmi, një rrugë e mesme mes ateizmit dhe besimit

Agnosticizmi (trajtë e latinizuar e greqishtes "agnostikismos", agnoin, mosdije; mosnjohje) përkufizon pikëpamje filozofike, që hamendësi të caktuara – në veçanti të llojit teologjik, të cilat merren me Qenësinë (ekzistencën) ose mosqenësinë e një "Qenieje të Epërme"si p. sh. të një Perëndie – ose të panjohur, në themel kanë pamundësinë e njohjes së Tij.

Pyetja "A ka Zot?"do të përgjigjet nga agnosticizmi përkatësisht jo me "po"ose "jo", por me "nuk është e njohur", "nuk është e përgjigjshme"ose me "s ka rëndësi". Ai paraqet një botëvështrim, që në veçanti thekson kufizimin (cakun) e dijes (diturisë) njerëzore. Nga pikëpamja e tij e njohurive të pamjaftueshme, agnosticizmi hedh poshtë dhe s`pranon një besim në qenësinë apo mosqenësinë e perëndive.

Në dallim me trajtën e fuqishme të ateizmit, agnosticizmi nuk përjashton në parim tërësisht mundësinë e qenësisë (ekzistencës) së një Qenijeje Hyjnore. Agnostika është vendosur kështu si këndvështrim i tretë midis teizmit dhe ateizmit.

Por në këtë kuptim, agnosticizmi ka të përbashkëta edhe me teizmin, se besimi në Zot është i mundshëm, edhe atëherë kur mohon mundësinë arsyetore të njohjes së Zotit. Emërtimi agnosticizëm ka mundësi të jetë mbruajtur nga Tomas Henri Haksli (1869). Megjithëse bëhet fjalë mbi një krijim emërtimi ende të ri, ky emërtim është dukshëm më i vjetër dhe gjendet ndër të tjera tek Buda, Laoce dhe disa parasokratikë dhe sofistë.

3. Magjia e realizimit të dëshirave jetësore

T'i njohim teknikat dhe metodologjinë e magjisë, me anën e të cilave do t'i realizonim shumë qëllime dhe synime tona jetësore pa ndonjë vështirësi të caktuar. Këto metoda, deri dje, janë konsideruar si të fshehta, ashtu që me to për herë të parë do të njoftoheni vetëm përmes revistës sonë.

Nocioni magji, te shumica prej nesh, shkakton keqkuptim dhe frikë. Gjithnjë kur përmendet kjo urtësi e lashtë, aludohet në "sehire", "të bëme"etj. , me veprimin e së cilave i shkaktohet dëm vetëm dikujt tjetër. Magjia, në realitet, është urtësi dhe njohuri e caktuar e veprimit të ligjeve shpirtërore, dhe komunikim përmes aplikimit të tyre për arritjen e qëllimeve të caktuara në realitetin tonë objektiv.

E keqja, si përjetim nga realiteti, është relative dhe ajo varet se në çfarë drejtimi është orientuar realizimi i qëllimit të caktuar, andaj edhe vetë magjia është neutrale dhe funksionin varësisht se sa e orientojmë: nga pozitivja (magjia e bardhë), për realizimin e dëshirave të caktuara praktike, si dhe nga negativja (magjia e zezë), duke i shkaktuar dëm personit të caktuar pa dijen dhe vullnetin e tij. Edhe pse teorikisht, metodat e magjisë janë mistike dhe ruhen si fshehtësi dhe privilegje, ato realisht, shpeshherë në përditshmërinë tonë zbatohen në mënyrë spontane nga ana e shumicës prej nesh, pa ditur se janë metoda të një njohurie shumë të lashtë dhe mistike. Në këtë kontest, kemi njerëz që kanë shumë suksese në jetë dhe deri te qëllimet e tyre arrijnë pa ndonjë vështirësi të caktuar.

Si të arrijmë sukses dhe si t'i realizojmë dëshirat dhe synimet tona pa ndonjë vështirësi të caktuar?

Njëra ndër ligjet themelore të magjisë është ligji i vizualizimit dhe principet themelore të saj. Ky ligj mbështetet në formimin e sa më të qartë të figurës psikike, e cila duhet të krijohet në mendime në formë të parafytyrimit. Përmes këtij principi mund të realizohen të gjitha dëshirat si dhe mund të eliminohen shumë dobësi të personalitetit te çdo individ, kuptohet, nëse do të zbatohet në mënyrë parimore, duke iu përmbajtur ligjshmërive dhe elementeve të saj të përcaktuara praktike.

Cilat janë elementet themelore të vizualizimit?

Për ta zbatuar në mënyrë sa më të suksesshme këtë ligjshmëri, si dhe për ta pasur atë përherë si praktikë në rrugën e realizimit të dëshirave tona, do t'i prezantojmë pjesë principe parimore dhe konstruktive të kësaj ligjshmërie, të cilat deri në kohën e fundit janë ruajtur në fshehtësi (nën betimin rigoroz) nga ana e shumë shkollave dhe kulteve të edukimit psikik:

1. Principi i Parë i ligjshmërive së vizualizimit është formimi i figurës së qartë dhe precize të dëshirës që kërkojmë ta realizojmë në botën materiale. Kjo ka të bëjë me aftësinë e madhe të koncentrimit të mendimeve në figurën e porsaformuar psikike. Qartësia e një figuracioni psikik, varet shumë nga koncentrimi, që nuk e kanë të zhvilluar dhe ushtruar disa persona, apo, në anën tjetër, disa të tjerë e kanë të lindur. Figura psikike e porsaformuar, duhet të jetë aq e qartë, sikurse ajo të ketë ndodhur, vërtet, në botën materiale. Shpeshherë, te fillestarët paraqitet tendenca e shëtitjes së mendimeve, që është proces normal. Nëse gjatë formimit të figuracionit tonë psikik të dëshirës që duhej realizuar, paraqitet kjo dukuri, atëherë nuk duhet shqetësuar, përsëritni edhe një herë në mendime filmin psikik dhe dukuria e "shëtitjes së mendimeve”me kohë do të zhduket.

2. Principi i Dytë i ligjshmërisë së vizualizimit është mbushja dhe energji psikike e figuracionit psikik të dëshirës që pritet të realizohet. Kjo nënkupton ndjenjën e kënaqësisë dhe të sigurisë se dëshira e paramenduar është realizuar me të vërtetë. Edhe dyshimi më i vogël në suksesin e realizimit të vetë këtij procesi, shkakton kundër efekt dhe fillimi i dëshirës sonë, shndërrohet në fantazi të thjeshtë. Ndjenja e sigurisë dhe besimit në sukses mbush figurën tonë psikike me energji pozitive. Sa më e madhe është mbushja me energji e figurës psikike, aq më shpejt do të realizohet dëshira e kërkuar. Andaj, gjithnjë në bindje duhet ta keni si parim: teoria e Ajnshtajni se materia është vetëm energji e koncentruar në një cak, mbështet plotësisht qëllimin e veprimit të këtij principi.

3. Principi i Tretë i ligjshmërisë së vizualizimit është kapshmëria e dëshirës, që nënkupton mundësinë reale praktike, se dëshira e caktuar mund të realizohet. Ta zëmë: studenti posa e ka regjistruar fakultetin e mjekësisë, nuk mund të vizualizojë veten si kirurg të famshëm botëror me prejardhje nga Kosova, sepse kjo dëshirë për momentin është e

pakapshme. Shumë më reale është që studenti jonë i mjekësisë ta vizualizojë dhënien e provimit të parë, regjistrimin e semestrit, likuidimin e vitit etj.

4. Principi i Katërt i ligjshmërisë së vizualizimit është njohja e teknikave të psiko-magjisë. Ky princip nënkupton se për zbatimin e plotë dhe me sukses të ligjeve të caktuara të magjisë, duhet të kemi një njohuri elementare për teknikat e ndryshme të ritualeve të cilat aplikohen praktikisht. Me përpunimin e këtij artikulli, ju lexues të nderuar, njiheni me njërën prej teknikave që për fillim me njërën prej teknikave që për fillim është e mjaftueshme në zbatimin e ligjit të vizualizimit (atë ju veç jeni duke e bërë nëpërmjet këtij artikulli).

5. Principi i Pestë dhe i fundit i ligjshmërisë së vizualizimit është dhënia e mundit apo veprimit të përhershëm. Pa mund dhe lodhje të caktuar nuk ka as rezultat. "Asgjë nuk bie, vetvetiu, nga qielli"- thotë populli, ose, "nuk kryhet fakulteti pa e nxe karrigen". Andaj, pa mund dhe besim të sinqertë se dëshira e caktuar duhet patjetër të realizohet, nuk ka as sukses me këtë ligjshmëri.

Koha e zgjatjes së realizimit të dëshirave përmes vizualizimit varet nga përpikëria e zbatimit të vetë këtyre principeve

Para se ta zbatoni teknikën e përshkruar të vizualizimit, si hap i parë që duhet ta bëni është definimi i qartë i dëshirës jetësore që duhet realizuar. Hapi tjetër është analiza e kapshmërisë së dëshirës, dhe së fundi, duhet ta krijoni skenarin e filmit psikik që duhet ta vizualizoni si dëshirë në mendimet e juaja. Ta zëmë se një kohë të gjatë jeni pa banesë dhe dëshira juaj e flaktë është që ta zgjidhni këtë çështje. Por, kot! Vitet kalojnë dhe ju jeni ende me qira, në bodrume me lagështi.

Ja ky është momenti më i përshtatshëm që përmes magjisë së vizualizimit ta realizoni dëshirën e kamotshme. P. sh. vizualizojeni banesën e juaj mentale me orendi të reja në to, kuzhinën dhe erën e gjellëve që gatuhen në të, ndejeni qartë zhurmën e fëmijëve si luajnë në hapësirën e veçantë të dhomës së tyre, parafytyroni pamjen e bukur piktoreske që shihet nga ballkoni, miqtë dhe mysafirët që ju përgëzojnë për banesën e re dhe detajet tjera që juve ju shkaktojnë kënaqësinë e ndjenjës së një realiteti të vetë filmit psikik.

Vizualizimi i kësaj skene të dëshirës sonë të paraqitur si shembull, duhet të jetë sa më i qartë në parafytyrimet tona... aq qartë, sa që të duket sikur reale në botën tonë materiale. Duke e shikuar këtë film në mendimet tuaja, regjisori i së cilës jeni ju vetë, kënaquni dhe përcilleni atë me emocionin e lumturisë. Mos dyshoni! Dyshimi sado i vogël shkakton kundërefekt.

Filmin tuaj psikik të vizualizimit përsëriteni së paku dy herë në ditë, preferohet patjetër në mëngjes posa të zgjoheni të shtriheni të flini, ose do të ishte e preferueshme ta praktikoni edhe gjatë ditës kur ndjeheni të

disponuar dhe të relaksuar, pa ngarkesat e problemeve të së përditshmes. është me rëndësi ta dini se duhet të jeni të parapërgatitur që gjatë zbatimit të metodës së vizualizimit për realizimin e dëshirës së caktuar, do të hasni në dukurinë e ashtuquajtur të "periodave të thata". Gjatë shfaqjes së këtyre periodave, do të krijohet dyshimi se e tërë kjo që bëni janë "dokrra", "pallavra", "humbje e kotë e kohës", si dhe dyshimet e tjera të ngjashme. Mos u shqetësoni! Këto janë të natyrshme dhe do të largohen brenda një dite. Ju vazhdojeni procedurën edhe mekanikisht, duke e bërë atë si një shprehi të së përditshmes. Mos e harroni kurrë një urtësi kineze e cila thotë: "Para agimit është terri më i madh". Dëshirat tona që realizohen nëpërmjet metodës së vizualizimit, nuk vijnë kur ne me padurim i presim, por ato vijnë spontanisht.

P. sh. e takoni papritmas një shok të vjetër që ju ofron të holla me kushte shumë të volitshme të kthimit, ose ai është vendosur jashtë vendlindjes dhe banesën e vetë ua mundëson ta paguani me këste mujore për një afat më të gjatë etj. Përveç dëshirave materiale, me metodën e vizualizimit mund të eliminohen edhe shumë dobësi të ndryshme të personalitetit tonë. Procedura është plotësisht e njjtë, por dallohet vetëm filmi psikik që duhet ta zbatoni posaçërisht për këtë qëllim. Ta zëmë, jeni koprrac ose keni tremë para auditoriumit të gjerë. Ky problem u mundon kaherë dhe ju nuk keni zgjidhje, edhe pse ju e dini se paraqitja e vetë problemit është e panevojshme për atë moment. Në këtë rast mjafton ta krijoni një film psikik që duhet ta vizualizoni në mendimet e juaja, si, p. sh. , gjendeni në një shoqëri ku jeni në qendër të vëmendjes. Nuk ndjeni tremë apo frikë dhe paraqiteni përplot guxim para njerëzve. Mbusheni këtë figuracion me kënaqësi dhe ndiejeni atë si reale. Pas një kohe të zbatimit të këtij vizualizimit, spontanisht do të vëreni se nga ju largohet frika dhe trema për t'u paraqitur para njerëzve tjerë. Me këtë metodë mund t'i evitoni edhe shumë mangësi tjera psikike sikurse janë, fobitë (frikët), varshmëria nga duhani, alkoolizmi, narkomani, përtacia, koprracia etj.

Funksionimi i ligjshmërisë së vizualizimit

Njeriu, përveçse është qenie fizike me të gjitha organet materiale të përsosura të funksionimit, është edhe qenie psikike që përbëhet prej pjesës së saj të vetëdijshme dhe të ndërvetëdishme. Për pjesën e vetëdijshme të njeriut dihet mjaft, e errët dhe e papërpunuar mjaft. Hermetizmi dhe Okultizmi, si shkenca të kulturave të hershme, shumë e shumë para shkencës bashkëkohore, e ka njohur ndërvetëdijen dhe për të komunikuar me të ka kultivuar shumë metoda psikike të ruajtura (dhe që ende ruhen) si fshehtësi. Njëra prej metodave që ende, deri në kohën e fundit, është konsideruar si e fshehtë ka qenë edhe metoda e vizualizimit. Te kjo metodë asgjë nuk është e komplikuar dhe e paqartë. Fjala është vetëm për gjuhën, me anën e së cilës njeriu komunikon me inteligjencën e tij të paskajshme, që ndryshe ne e kemi definuar edhe si ndërvetëdije.

Ndërvetëdija njeh dhe me përpikëri i zbaton të gjitha urdhëratë, pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre, me kusht që ato të vijnë në mënyrë të pastër dhe precize. Gjuha e vetme e komunikimit me ndërvetëdijen është figuracioni psikik, gjegjësisht parafytyrimi i të gjitha veprimeve që më parë krijohen në mendjen tonë. Nëse këto mendime të vizualizuara qartë mbushen me energji të fortë emocionale, ndërvetëdija me përpikëri do t'i realizojë në tërësi.

Pra, metoda e vizualizimit është vetëm gjuha të cilën e kupton dhe e njeh ndërvetëdija jonë. Ne, si qenie njerëzore, gjatë aktivitetit tonë ditor mu përmes kësaj metode, ndërvetëdijes sonë i japim urdhra të ndryshme pa qenë të vetëdijshëm për to. çdo mendim ynë, së pari, krijohet si figuracion psikik në mendjen tonë, e pastaj ekziston në realitetin material. Prandaj, duhet të keni kujdes se çfarë urdhra i jepni ndërvetëdijes suaj. Fatin njeriu vetë e krijon, pikërisht, përmes mendimeve tona pozitive ose negative. Mendimet janë të pashlyeshme dhe regjistrohen në ndërvetëdijen tonë, duke pritur momentin e përshtatshëm të realizimit të tyre. Nëse ndërvetëdijes i japim urdhra përmes mendimeve tona negative, atëherë ato varësisht nga mbushja energjetike e tyre, në momentin më të përshtatshëm do të realizohen.

Nuk jemi në këtë botë, rastësisht, të marrshëm, përtacë, koprracë, pa banesë, të varfër etj. Këtë realitet e kemi kërkuar vetë. Ndërvetëdija jonë i ka realizuar, sepse ashtu ka marrë urdhra nga mendimet tona pesimiste dhe negative.

Prandaj, për fund mendoni vetëm pozitivisht, sepse çelësi kyç i realizimit të dëshirave tuaja jetësore është në ju, gjegjësisht, te mendimet tuaja pozitive dhe negative që ju i krijoni për veten.

4. Magjia e zezë dhe magjia e bardhë

Magjia e bardhë dhe magjia e zezë janë vetëm dy pole të energjisë. Të dyjat janë: ekzistojnë, por duhet ditur t'i përdorim. Liria e njeriut është e madhe, prandaj NJOHJA ia mundëson njeriut të zgjedh polin pozitiv apo negative. Këtu është çelësi për hyrje në LUMTURI apo në MJERIM.

Ja si krijohen: me përsëritje, me përsëritje dhe vetëm me përsëritje. (Në këtë bazë është CD-ja jonë "Dëshirat…"që krijon polin pozitiv ose magjinë e bardhë).

Sikur zgjimi prej gjumit me orën me zile: bie zilja e orës ose alarmit të telefonit në orën 7 të mëngjesit – ti zgjohesh. 21 ditë kur përsëritet kjo zile – nëpër trupin e njeriut krijohet "shtrati"rruga e ecjes së energjisë. Të 22-tën ditë, pa zile apo alarm, në orën 7 nis qarkullimi i lëngjeve nëpër trup dhe ti do të zgjohesh – patjetër, pa kurrfarë mjeti ndihmës.

Keni parasysh këtë fakt: çdo gjë lindë nëpër vijen shpirtërore: në shpirt lind idea, idea formësohet në mendim, mendimi shprehet me fjalë, fjala KRIJON energji që ndërton apo rrënon jetën e njeriut.

Përsëritja e fjalës krijon aq shumë energji që – me të vërtetë – e fuqizon jetën e njeriut deri në majat e suksesit e të lumturisë apo e rrënon deri në fundin e gërminës apo të mjerimit. (Këtu është PIKA qëndrore ku e thërras mendjen tuaj të ndiçohet!)

Sepse (po e përsëris): me përsëritje të fjalëve (ose mendimeve) pozitive (afirmimeve pozitive) krijohet energjia që ndërton jetën dhe tejkalon TË GJITHA pengesat.

Keni dëgjuar ndonjëherë për SHTRIGAT? Çka është shtriga? Asgjë. Një grua normale, që në moshë të thyer, e dëshpëruar, gjeloze ndaj jetës së shoqeve, e lodhur nga vuajtja, nis të mendojë keq për shkatërrimin e jetës së ndonjë shoqeje. Dhe, ajo grua, prodhon aq shumë mendime negative, aq shumë dërgon sugjestione të zeza sa – ia shkatërron jetën dikujt.

Por e shkatërron edhe jetën e vet: mendimet e saj, mendimet apo fjalët negative, ia ndryshojnë metabolizmin e trupit të saj (secila fjalë krijon një emocion, secili emocion krijon një ndryshim metabolistik!) dhe, përditë ngapak, ajo grua shëmtohet: i deformohen mollëzat e faqeve, hunda, mjekëra – tërë fytyra dhe – kur është tepër negative – nuk mund të jetojë më mes njerëzve – sepse bëhet tepër e shëmtuar…dhe populli e quan: shtrigë. Sepse njëmend e meriton këtë epitet. (Populli nuk gabon kurrë, sepse mësimet i merr nga përvoja!)

E kundërta e SHTRIGËS, njerëzit e mirë, njerëzit shpirtbardhë, hajde t'iu themi: të SHENJTË, përqëndrohen në polin pozitiv - në prodhimin e mendimeve dhe fjalëve pozitive, që krijojnë BUKURINË e qenies fizike, bukurinë e qenies shpirtërore, shijen e jetës, suksesin, shëndetin, fatlumërinë e tërësishme.

Kjo është liria e njeriut: zgjidh e merr! Do shmëti apo shenjtëri?

Për qartësim të plotë për FUQINË E PËRSËRITJES po e përmendi shembullin më të tmerrshëm të historisë së njerëzimit. Lufta e dytë botërore. 52 milionë viktima i ka shkaktuar PËRSËRITJA E NJË GËNJESHTRE.

Vetë Hitleri ka thënë: kur kam thënë se gjermanët janë racë fisnike që duhet të komandojnë botën, e kam ditur se është gënjeshtër e pastër (të gjitha racat në start janë të barabarta!), por e kam ditur se kur ta përsëris unë 100 herë këtë gënjeshtër - unë do t'i besojë gënjeshtrës sime, kur të përsëritet 1000 herë – do t'i besojë gjeneralshtabi, kur ta merr Gebellsi e ta përsëritë me miliarda herë – nuk do të ketë gjerman të gjallë që nuk do t'i besojë.

Dhe, e dini të gjithë: KËSHTU NDODHI. Nuk ka pasë ushtar gjerman që nuk ka shkuar drejt në vdekje – në bazë të cilit fakt: në bazë të një

gënjeshtre të PËRSËRITUR. Dhe PËRSËRITJA e kësaj gënjeshtre shkaktoi Luftën e Dytë Botërore dhe shkaktoi 52 milionë viktima.

E keni të qartë tash çfarë fuqie tmerruese (por edhe MREKULLI mahnitëse) krijon PËRSËRITJA E FJALËS.

Populli nuk është fajtor që bie viktimë e mashtrimeve të ndryshme, SEPSE POLET E ENERGJISË ekzistojnë, JANË. Fajtor jemi NE që nuk e ndihmojmë vetveten dhe popullin tonë - që ta ketë NJOHJEN.

Prandaj unë këmbgul dhe JU FTOJ të vini me mua. Dhe të jeni qindpërqind të sigurtë: askush nuk do të këtë ASNJË humbje – TË GJITHË DO TË FITOJMË.

5. Simptomat (shenjat) e magjisë

Mendoni se dikush ju ka bërë magji. Më poshtë po japim simptomat se si ju ndjeheni nga magjia që ju kanë bërë:

Dridhje në trup ose të disa pjesëve të trupit

Lëvizje të muskujve jo natyrore

Mos-përqendrim

Mos-koncetrim

Vështirësim gjatë dëgjimit të këmbanës së kishës apo ezanit

Bërja e gjynaheve

Ngushtim në gjoks

Ndjenja e mërzisë në shumicën e kohës

Mpirje të disa pjesëve të trupi. Nxehtësi në trup, ose ftohje

Shpuarje në pjesët e trupit

Vështirësi në të ecur

Dhimbje në fund të shpinës

Dhimbje në pjesë të ndryshme të trupit ndonjëherë paraqiten ndonjëherë humbin

Dhimbje këmbe

Dhimbje në shputat e këmbëve

Dhimbje të kokës të vazhdueshme nëpër gjithë kokën

Vështirësi në frymëmarrje

Shtypja e lartë

Shkëlqim në sy

I molisur

Dëgjim i zërave të pakuptueshëm

Ndjenja që po përcillesh dhe kontrollohesh

Ndjenja qe po të thërret dikush dhe kur shikon s'ka asgjë

Ëndrra të trishtueshme të çfarë do lloji, veçanërisht qen ose gjarpërinj apo mace

Dëshirë tejmase për marrëdhënie

Ndjehet se është dyfytyrësh në fe

Humbja e shpresës
Njolla me ngjyrë të kaltër në trup
Nxehtësi në trup tërë ditën
Urrejtje për tu pastruar me ujë të ftohtë
Dyshim në çdo send
Sillje andej këndej
Bredhje
I hutuar
Harresa e tepërt
Urrejtja për të punuar
Urrejtje e të qëndruarit me njerëz
Rrahje e shpejtë e zemrës e papritur(befasisht)
Qarje pa shkak
Hidhërim i shpejtë dhe kriza nervore.

6. Hajmalia - teorizimi dhe praktikat shpirtërore

Hajmalia është mjet magjik i cili bëhet apo shkruhet në letër i cili mbahet me veti ose lihet në vendin e caktuar për ta mbrojtur individin apo tërë familjen prej ndikimeve të ndryshme psikike të errëta. Hajmalia është mbrojtës pasiv prej ndikimeve të tilla të errëta.

Hajmalia i neutralizon këto sulme të errëta psikike. Hajmalia bëhet edhe për drejtime të tjera ne jetë si për fat martesë, punë etj. Fuqia e saj nuk është aq efikase në mbrojtje.

Efikasiteti i Hajmalisë varet prej fuqisë apo dijes të ndonjë personi me ngritje të lartë shpirtërore. Nëse personi nuk e ka këtë fuqi e dije, Hajmalia ndikon shumë pakë te personi ose nuk ndikon fare.

Në botë gjithçka lëvizë. Asgjë nuk është e qetë. Lëvizja është relative, qetësi vetëm në dukej relative. Relative është gjithashtu gjithçka që ne perceptojmë nëpërmjet shqisave tona, kurse absolute është vetëm ajo që mund ta kuptojmë me ndodhitë e drejtpërdrejta mistike.

Pikërisht për këto arsyeje, pasi shqisat tona na mashtrojnë pandërprerë, bota e jashtme na paraqitet në këtë apo atë trajtë, kështu që dukuritë natyrore nuk mund t'i definojmë dhe sqarojmë në esencën e plotë të tyre.

Pa marrë parasysh se sa njeriu është materialisht i orientuar dhe në jetën e përditshme i drejtuar tek mendimet e logjikshme, gjykimet racionale etj. prapëseprapë në thellësitë e shpirtit të tij fshihet një dozë e misteriozitetit.

Njeriu modern me admirim ndjek zhvillimet gjigante të shkencës dhe nuk pranon, ose nuk do të pranojë, kurrfarë dukurie transcendentale, edhe pse ato ndonjëherë janë mjaft bindëse. Kjo, megjithatë, nuk i pengon atij që edhe sot, si para disa mijëra vjetësh, të lidhet ngushtë me disa dukuri, të

cilat, në biseda formale, vlerësohen si marrëzi supersticioze (besime të kota).

Dallimi qëndron në atë se këto dukuri më herët ishin të njohura dhe të pranuara, kurse sot njeriu i "intelektualizuar"turpërohet nga vetvetja për to e të mos flasim se si do të dukej në sytë e të tjerëve. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, po ky njeri i shekullit XXI ende me xhelozi ruan shaminë, unazën, zinxhirin, fotografinë apo imtësi të tjera, të cilat ia dhuron ndonjë familjarë, ndonjë mik, ndonjë shok, apo edhe dashnori/ja, për t'i sjellë atij, kujtim, fat, disponim, dashuri, lumturi etj.

Të gjitha këto imtësira janë të njohura me emrin: hajmali, amulet, talisman etj. Hajmalitë kanë për qëllim që personin përkatës ta ruajnë nga të këqijat, fatkeqësitë, sëmundjet; t'i sjellin fat, lumturi, dashuri etj. krejtësisht është e parëndësishme se çfarë është ky send - a është ndonjë simbol, pjesë e rrobave, qime floku, stoli ari, thua, gurë i çmuar, lodër fëmijësh ose diçka tjetër. Kryesorja është se me çfarë qëllimi i është dedikuar personit përkatës.

Shpesh na ndodh që ndonjë send të blerë nga personat, të cilët kanë qenë të detyruar nga nevoja e jetës ta shesin, ta zëmë: orë, pallto etj. , të na sjellin pengesa të ndryshme në jetën e përditshme, në punë ose të na humbin fare. Për këtë arsye, shumë njerëz edhe nuk blejnë gjëra të tilla, pavarësisht nga çmimi i ulët i tyre; sepse i konsiderojnë si gjëra "ters".

Populli këtë dukuri e njeh dhe e çmon, sepse në shumë vendime të veta shërbehet më shpesh me instinkte të lindura se sa me kuptimin dhe logjikën.

Me zhvillimin e kulturës materialiste dhe të civilizimit bashkëkohorë, këto instinkte të lindura gjithnjë e më shpesh lihen në prapavijë. Është dukuri shumë e vjetër dhe me arsye psikologjike që gjatë shitblerjes së tokës ose të ndonjë gjëje tjetër, të shtrihet dora dhe të thuhet: "Të qoftë hallall!"Kjo fjali ka forcë të madhe magjike (psikologjike), sepse me fat dhe terse ndeshemi gjithkund, në çdo hap.

Në natyrë asgjë nuk ndodh rastësisht, prandaj as kjo për të cilën u fol më lartë. Së këndejmi, duke filluar nga hajmalitë e ndryshme e deri të gjërat më të llojllojshme, që i përdorim gjatë jetës së përditshme, secili e ka fatin e vet, historinë e vet dhe secili send, në rrethana, po e quaj magjike, mund të ndikoj. Në botë gjithçka lëvizë. Asgjë nuk është e qetë. Lëvizja është relative, qetësi vetëm në dukej relative. Relative është gjithashtu gjithçka që ne perceptojmë nëpërmjet shqisave tona, kurse absolute është vetëm ajo që mund ta kuptojmë me ndodhitë e drejtpërdrejta mistike.

Pikërisht për këto arsyeje, pasi shqisat tona na mashtrojnë pandërprerë, bota e jashtme na paraqitet në këtë apo atë trajtë, kështu që dukuritë natyrore nuk mund t'i definojmë dhe sqarojmë në esencën e plotë të tyre. Duhet të pranohet se shkenca, decenieve të fundit, është larguar

nga këto dukuri dhe sado që përpiqet të gjejë shkakun e fundit, pas secilës "zgjidhje"të re të problemit lajmërohen me qindra enigma të reja.

Njeriu, gjithnjë e më shumë po largohet nga ajo që është themelore dhe më e rëndësishme, që të humb në labirintin sekondar të pakuptimtë të gjërave. Sot e dimë se secila pjesë e materies nuk përbëhet vetëm nga molekulat dhe atomet, si pjesë përfundimtare e më të imta të saj, por se edhe secili atom për vete duhet të konsiderohet si një botë e veçantë. Fjala "atom"që në greqisht do të thotë "i pandarë"nuk është më qëndrueshme. Atomi përbehet edhe nga protonet, elektronet dhe grimcat tjera.

Marrëdhëniet midis tyre, pozicioni dhe lëvizja i përngjajnë Sistemit Diellor në miniaturë. Është llogaritur se protoni pozitivisht i elektrizuar ka diametrin i cili është disa miliona herë më i vogël se milimetri, ndërsa elektronet e ngarkuara negativisht, që në shtigjet e përcaktuara rrotullohen rreth tij, janë edhe 1800 herë më të vogla.

Sipas kësaj, atë që shqisat tona e perceptojnë si materie të ngurtë, ajo në realitet krijohet nga një sërë vrimash, në të cilat materia pothuaj as që vjen në konsideratë. Këto mes hapësira paraqesin një fushë të posaçme të energjisë rrezatuese, e cila rrjedh nga lëvizjet e elektroneve.

Rezultatet e fundit shkencore lidhur me shkaterrimin e atomit, kanë rëndësi të posaçme, veçanërisht për t'u kuptuar më mirë rrezatimet e ndryshme. Këto kërkime të reja na argumentojnë se gjërat të "vdekura", në kuptim të plotë të kësaj fjale, as që ka dhe se secila pjesë dhe secili lloj i materies ka zhvillim të posaçëm të jetës, i cili i varur nga veprimet dinamike të energjisë së gjithmbarshme të natyrës.

Ngase të gjitha gjërat u janë të nënshtruara lëvizjve të pandërprera të grimcave, ato pranojnë dhe emetojnë energji si dhe ndikojnë reciprokisht në rrezatime të shumëllojshme, kështu që edhe gjërat e vdekura janë në gjendje që të t'i thithin rrezatimet e rrethit, atë energji të absorbuar ato mund ta mbajnë, ta transformojnë dhe në rastet e dhëna, ta emetojnë.

Energjia e gjithmbarshme natyrore përshkon në masë më të madhe ose më të vogël gjithçka që ndodhet në natyrë, pavarësisht në janë qenie të gjalla apo të vdekura. Flora dhe fauna në tërësi si dhe bota minerale në pjesët e veta më të imta, paraqesin ndërtim dhe parim të njëjtë të ndikimit. Vetëm nga numri i radhitjeve, distancës në mes vete dhe shpejtësisë së rrotullimit të elektroneve rreth bërthamës qendrore në atom, varet se a do kemi para vetës bakër, ar, natrium, karbon apo ndonjë element tjetër, kështu që gjatë diferencimit të mëvonshëm, nën ndikimin e faktorëve të shumët, arrihet deri te materia organike.

Gjithashtu, në këtë vijë, ligjeve të njejta të natyrës u nënshtrohen edhe materiet organike edhe ato inorganike. Pasi që çdo ndodhi dhe çdo proces natyror është i bashkuar në mënyrë të pashmangshme me pranimin dhe emetimin e energjisë, kështu çdo send, në dukje i vdekur, ku bëjnë pjesë

edhe hajmalitë dhe talismanët, detyrohen t'i nënshtrohen, më shumë a më pak, ndikimit të asaj energjie, me të cilin vjen në kontakt.

Objekti përkatës (pra edhe hajmalitë), mbushen, ngarkohen me sasi të mjaftueshme nga ajo energji, ndikim të së cilës i është ekspozuar. Ajo energji (e bartur) mund të mbetet latente, por, në rrethana të caktuara dhe në kushte të volitshme, mund të transformohet dhe të bëhet aktive, siç ndodh në rastet e operacioneve të ndryshme magjike.

Personat sensibilë, gjatë kontaktit me gjëra të tilla, janë në gjendje që atë energji të akumuluar të atij objekti, ta shndërrojnë në paraqitje vizuale dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet "shqisës së gjashtë", ta lexojnë apo ta shohin gjithë historikun e tij.

Sot, në kohën e zbulimeve të ndryshme elektronike, këto dukuri nuk duhet të na duken të çuditshme apo fantastike, në mënyrë të njëjtë sikurse energjia e emetuar përmes radio valëve apo valëve e formave tjera rrezatuese, që bartën nëpër eter, që në radioaparatet pranuese të shndërrohen në zë, fotografi, dritë etj. , po kështu edhe truri ynë mundet që në rastet e volitshme të shërbej si psikodetektor, cili në vetëdijen tonë, energjinë e pranuar mund ta shndërrojë në ndjenë, përfytyrim, zë, fotografi etj.

Të gjitha dëshirat dhe mendimet tona paraqesin energjinë, e cila aq sa është e fortë, po aq nxit ndjeshmëri të pastër dhe të fortë. Por, në qoftë se ato janë në konflikt mes veti, gjithsesi vjen deri te dis'harmonia dhe atëherë edhe rrezatimet e tyre do të jenë të parregullta dhe të shkëputura, ashtu që edhe në rreth do të ndikojnë në mënyrë antipatike.

Tempoja e jetës sonë është shumë e shpejtë, automatike dhe e ngarkuar me mendime materialiste, sa që njeriu sot as që e konsideron të nevojshme që edhe kujdesin më të vogël t'ia kushtoj asaj që nuk përputhet me mënyrën e rëndomtë të të kuptuarit dhe të gjykimit të tij.

Megjithatë, në qoftë se dikush gjendet që, i shtyrë nga vullneti i tij i mirë, do të mundohet që në këto dukuri "irracionale"të jap pak dritë e kuptim, atëherë në mënyrë të çuditshme do të hasi në mungesë të madhe tolerance dhe në gjykime abuzuese të masës, sa që gjithsesi do të jetë i detyruar të tejkalojë dëshirën e vullnetin e vet për punë të mëtutjeshme.

7. Magjia dhe mjekësia
A ndikojnë në organizmin e njeriut?

Në të gjitha qytetërimet e lashta: të Egjiptit, Persisë, Indisë dhe Kinës, dijet mbi mjekësinë dhe artet e kurimit vlerësoheshin shumë. E njëjta mund të thuhet edhe për komunitetet primitive, shumë prej të cilave ekzistojnë edhe sot, ku roli i shaman-it si shëronjës është i një rëndësie kryesore.

Natyrisht, arti i mjekësisë është akoma edhe më i vjetër dhe shkon më larg se sa dokumentat që zotërojmë sot. Padyshim që disa forma të këtij

arti praktikoheshin nga shumica e paraardhësve tanë të lashtë. Receta më e hershme mjekësore datohet rreth vitit 1500 p. e. r dhe vjen nga Egjipti. Përmbajtja e saj sugjeron se doktorët egjiptianë punonin duke u mbështetur në parimin se efektiviteti i një ilaçi është në proporcion me shijen e tij të keqe. Megjithatë, kjo mund të ketë qënë një nga ato shërimet popullore 'sharlatanësh' që kanë gjetur treg në të gjitha epokat. Ka shumë arsye për të besuar se egjiptianët e lashtë kishin një art shërimi shumë të zhvilluar, ndoshta të natyrës ezoterike dhe transmetohej gojë pas goje nga mësuesi te nxënësi.

Dhe këtu vijmë në atë që është mjaft e rëndësishme për të kuptuar artin shëronjës të botës së lashtë. Zbulojmë se mjekësia ka qënë thellësisht e mbrujtur në disa tradita magjike ose ezoterike ku rolin kryesor e luanin forcat e larta kozmike ose shpirtrat dhe energjitë e fshehura të qiellit dhe Tokës. Ja pse artet e shërimit konsideroheshin jashtëzakonisht të shenjta dhe sekret. Për të kuptuar nocionin e këtij sekreti, mjaft t'i referohemi fshehtësisë së madhe me të cilën rrethoheshin praktikat e çuditshme të shamanit primitiv. Shkurt, mjekësia ka qënë pjesë e traditës mistike dhe mbinatyrore që ka ekzistuar në themel të shoqërisë njerëzore në çdo epokë dhe në të gjitha rajonet e globit.

Ka qënë shumë i përhapur besimi se sëmundja është shkak i veprimit të forcave të papara – shpirtrat e këqinj të cilët prekin personin që, në një farë mënyre, prish rendin natyror të gjërave. Sipas botkuptimit të sotëm, këto s'janë gjë tjetër veçse gjepura. Megjithatë, po t'i mendojmë gjërat me kujdes, ka diçka në to që nuk ndryshon shumë nga idetë që mbrohen nga një numër gjithnjë e më i madh terapistësh të sotëm.

Ruajtja e ekuilibrit

Çështja kryesore që ka lindur në teorinë dhe praktikën mjekësore në këto dekadat e fundit është ajo se shëndeti varet nga një ekuilibër ose harmoni e caktuar e forcave ku përfshihen, jo vetëm aspektet thjesht fizike të shëndetit, por edhe faktorët mendorë, emocionalë, të mjedisit dhe ato shoqërore. Të gjithë këta faktorë luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e sëmundjes. Nuk është thjesht çështje e mosfunksionimit të molekulave dhe kimikateve brenda trupit të njeriut dhe e korrigjimit të sjelljes së tyre me anën e ilaçeve.

Sëmundja shihet tashmë si maja e një ajsbergu, si rezultat i një sëmundjeje më të thellë që mund të jetë akumuluar për vite e vite me radhë për shkak të sjelljeve, zakoneve dhe emocioneve të këqija që kanë sjellë nga ana e tyre bllokimin e rrjedhjes dhe harmonisë së energjive të jetës. Pra, në vend që të shihet sëmundja si një cënim i ndonjë rendi të padukshëm demonik, shihet si një cënim i ekuilibrit dinamik që influencon jo vetëm mbi jetën njerëzore, por edhe mbi jetën e planetit dhe të gjithë kozmosit. Në një farë mënyre, kjo është të dalësh nga akordimi.

Po të merret në mënyrë metaforike, atëherë, ideja e vjetër e zbutjes së inatit të zotit ose të demonit, ndoshta nuk është shumë larg të vërtetës. Në epokën moderne, këto forca të padukshme kanë ndryshuar thjesht veshjen dhe operojnë sot me emra të tjerë si p. sh. bakterie, viruse, stres, neuroza etj. Po ashtu, në ngjashmëri me pikëpamjet e vjetra, sot thuhet gjithmonë e më shumë se këto gjëra nuk e sulmojnë njeriun nga jashtë, por se njeriu e predispozon veten ndaj sëmundjeve të tilla duke jetuar në një mënyrë negative dhe aspak harmonike. Këtu mund të përfshihen faktorë të tillë si relacionet e vështira emocionale, ndjenjat e pakënaqësisë dhe inatit, shqetësimi dhe frika, ose amullia në çfarëdo forme e njeriut.

Sipas pikëpamjeve të vjetra magjike, të gjitha gjërat në univers, me frymë dhe pa frymë, janë, në një farë mënyre, të lidhura me një rrjet të hollë energjish të fshehura. Poeti Uollt Uitman thoshte: "Një ngjashmëri e madhe na bashkon të gjithëve". Njohja e këtij rrjeti të fshehtë e bën të mundur që një person t'i manipulojë forcat e holla të jetës dhe të sjellë efekte pozitive (nganjëherë negative). P. sh. , shumë antropologë që kanë studjuar aktivitetet e shamanit primitiv kanë qënë të detyruar të pranojnë se këta individë punojnë me një lloj fuqie të panjohur për pikëpamjet tona racionale dhe shkencore.

Lidhjet e padukshme

Ka shumë besime të vjetra ku mund të gjesh gjurmë të këtyre njohurive rreth mbinatyrores. Një nga këto është dhe zakoni për të lidhur një shall të kuq rreth qafës për të mos u sëmurur nga të ftohtit ose zakoni për të varur rroba të kuqe në një dhomë për të ndihmuar në shërimin e një të sëmuri. Po pse ngjyra e kuqe? Sepse sipas filozofisë së mbinatyrores, që është e bazuar në parimet astrologjike, e kuqja është ngjyra e Marsit dhe, së bashku me metalin e këtij planeti (hekuri), është konsideruar si e fuqishme në largimin e shpirtrave të këqinj.

Dhe kjo ka llogjikë sepse Marsi është planeti i energjisë, i shoqëruar me gjakun, dhe prandaj mjaft i rëndësishëm në shërimin e pacientit dhe kthimin e fuqisë te ai.

Ideja se ka forca të padukshme që depërtojnë në univers dhe që lidhin të gjitha gjërat, gjëndet në filozofitë mistike të të gjitha epokave. Në Kinë, këto forca, quheshin CH'i; në Indi quheshin prana; në misticizmin e Hebrejve njihej me emrin Od kurse në traditën Hermetike Perëndimore është njohur me emra të ndryshëm: kuintesencë (thelb), drita e natyrës ose Spiritus Vitae (shpirti i jetës). Okultisti i shekullit të 19-të, Elifas Levi, i referohej me emrin Drita Yjore.

Paracelsus, doktori i famshëm i shek. 16-të, që thuhet se ka bërë mrekullira, e njihte këtë fuqi të padukshme. Ai e quante atë Arkaeus, me te cilën nënkuptonte energjinë primare jetësore të natyrës, forcën jetësore që mban të gjitha gjërat e gjalla në kushte shëndeti të mirë. Është pikërisht kjo

fuqi që reagon ndaj influencës kozmike, duke rezonuar në të gjithë trupin fizik. Kjo fuqi nuk është e mbyllur në trupin fizik, por rrezaton jashtë si një sferë luminishente. Paracelsus thotë se individi mund të ndikojë së tepërmi mbi këtë energji të ndjeshme, për mirë ose për keq, me anë të imagjinatës dhe kjo mund të ketë pasoja të theksuara mbi shëndetin dhe sëmundjen. "Imagjinata, "thotë ai, "mund ta helmojë esencën e jetës dhe të shkaktojë sëmundje ose mund ta pastrojë atë, pasi është ndotur, dhe t'i kthejë asaj shëndetin".

Shkaqet bazë

Pra, doktori i famshëm i shek. 16 ka thënë: "Imagjinata mund ta helmojë esencën e jetës dhe të shkaktojë sëmundje ose mund ta pastrojë atë, pasi është ndotur, dhe t'i kthejë asaj shëndetin". Këto janë, ndoshta, fjalët më të zgjuara të shkruara ndonjëherë lidhur me shëndetin dhe sëmundjen. Sidoqoftë, vetëm dekadat e fundit terapistë të caktuar kanë filluar që t'i marrin këto ide me seriozisht. Është gjithashtu i rëndësishëm fakti se biologët e sotëm, të cilët akoma nuk janë në gjëndje të shpjegojnë dukuritë misterioze të jetës që lidhen me konfiguracionet specifike të molekulave dhe elementeve kimike, tani kanë filluar të përdorin koncepte të tilla si Fusha e Jetës ose Fushat Plazmike Biologjike që u referohen diçkaje tej aspekteve thjesht fizike ose materiale të organizmave të gjalla.

Le të përmendim vetëm faktin se çdo atom i trupit zëvendësohet plotësisht periodikisht për të kuptuar se nën këtë proces ndodhen ndoshta disa faktorë të tjerë. Çfarëdo emri që t'i japim, gjithshka varet nga ruajtja e një rrjedhjeje të lirë dhe harmonike të kësaj energjie jetësore të padukshme sepse ajo mund të sabotohet lehtë nga faktorë negativë që funksionojnë nëpërmjet zakoneve dhe sjelljeve tona. Kohët e fundit, po i kushtohet një vëmendje gjithnjë e më e madhe idesë së vjetër së një esence të padukshme jetësore që mund të manipulohet me metoda të caktuara, ose nga një shëronjës që ka njohuritë e nevojshme ose nga vetë personi nëpërmjet metodave psikologjike. Rezultatet dobiprurëse të metodave të tilla si akupuntura ose meditimi empirik njihen sot zyrtarisht nga komuniteti mjeksor.

Shpesh, kohët e fundit, kjo energji e padukshme dhe në dukje magjike, u ka dalë përpara njerëzve aksidentalisht. Një nga këto raste është ai i Kenelm Digby i cili, nga mesi i shek. 17, bëri disa mjekime të famshme duke përdorur një pluhur që ai e quante 'pluhuri simpatik'. I ati i Kenelmit e kishte mësuar këtë metodë nga një murg që kishte udhëtuar shumë në Lindjen e Largët. Kjo procedurë, që përdorej kryesisht në mjekimin e plagëve, konsistonte në marrjen e një cope rrobe të lagur me gjakun e plagës dhe në zhytjen e asaj rrobe në një tretësirë të pluhurit simpatik (që Digby e quante vitriol). Efekte të ngjashme mund të arriheshin duke lagur me këtë tretësirë armën që kishte shkaktuar plagosjen.

Metoda funksiononte sipas parimit të veprimit simpatik në largësi midis gjakut të personit dhe plagës nga ishte marrë ky gjak. Sipas Digby, plagët shëroheshin pa patur nevojën që të prekeshin ose shikoheshin. Mjekimi më i famshëm që ka bërë Digby me këtë metodë është ai i një farë Xhejms Howell, sekretar i Dukës së Bakingamit, i cili kërkoi ndihmën e Digby me që kishte plagosur dorën. Digby i kërkoi fashën e lagur me gjak dhe një legen me ujë. Ndërkohë, Howell, duke menduar se doktori po bënte përgatitjet për kurimin e tij, bisedonte me një mik në cepin e dhomës duke mos vënë re se Digby kishte hedhur në ujë pluhurin special dhe po fuste fashon e tij duke vëzhguar me vëmendje Howellin.

"Papritur, "tregon Digby në raportin e tij, "ai u drodh dhe bëri një lëvizje sikur të ndjente një shtysë të brendshme. "Nuk e di, "tha Howell, "por unë tani nuk ndjej asnjë dhimbje. Më duket sikur më është shpërndarë mbi dorë një freski e këndshme sikur të kisha një beze të lagur mbi të. Më duket se më është larguar i gjithë infeksioni. "Brenda pesë ose gjashtë ditëve plaga e tij u mbyll tërësisht.

Digby ka përdorur parimet shumë të vjetra të magjisë simpatike ku një gjë mund të ndikojë mbi një tjetër nëpërmjet një lloj rezonance të fshehur, vënë në lëvizje nga mendja. Metoda e mirënjohur dhe mjaft efektive e shërimit të lytheve funksionon sipas të njëjtit parim. Natyrisht kjo energji mund të përdoret edhe negativisht, si në rastin e njohur të nguljes së gjilpërave në një figurinë dylli ose etj. që ka diçka që i përket viktimës së zgjedhur.

Magnetizmi

Më dramatik ka qënë aktiviteti i Anton Mesmerit i cili, në gjysmën e dytë të shek. 18, shkaktoi sensacion me zbulimin e Magnetizmit të Kafshëve (siç e quajti). Mesmerit i kishte bërë përshtypje të madhe ideja e një 'shpirti jetësor' që përshkonte të gjithë natyrën dhe që ishte përmendur vazhdimisht nga mistikët dhe filozofët e shkuar. Nga viti 1679 u botua një libër, shkruar nga Uilliam Maksuell, me titull "De Medicina Magnetica"(mjekësia magjike), ku ai flet për një shpirt jetësor, që ekziston në gjithshka dhe që mund të manipulohet nga një person që ka aftësitë dhe njohuritë e duhura, që mund të veprojë si një ilaç universal.

Në përputhje me këtë, Mesmer besonte se ndërmjet trupave qiellorë, Tokës dhe organizmave të gjalla ekziston një influencë e ndërsjelltë. Mekanizmi i kësaj influence është një lloj energjie magnetike (ose fluid) e cila, besonte ai, mund të identifikohet, të grumbullohet dhe të përdoret si forcë shëruese.

Raporte të ndryshme thonë se Mesmeri mund të magnetizonte pacientët, nganjëherë me një nga gishtrinjtë e tij, ose duke përdorur një shufër hekuri. Pacienti hynte në një gjëndje somnabulike, duke patur

nganjëherë konvulsione të fuqishme, dhe si rezultat ndodhte shpesh kurimi i tij i suksesshëm.

Mesmer sajoi, gjithashtu, një tub magnetik rrethor e të madh nga ku dilnin shufra të ndryshme metalike. Pacientët uleshin rreth e qark këtij tubi duke kapur secili nga një shufër. Mesmer pastaj u thoshte që të formonin një zinxhir duke prekur njëri tjetrin me majat e gishtave të dorës. Pothuaj menjëherë, disa nga pacientët hynin në konvulsione ose në ekstazë nga e cila dilnin me një vitalitet të ripërtëritur të trupit të tyre, të çliruar nga çfarëdo lloj gjëje që i mundonte.

Rrjedhja e lirë

Çfarë përfundimi mund të nxjerrim atëherë nga gjithë këto dukuri misterioze? A ka vërtetë një forcë magjike që mund të ndikojë mbi shëndetin dhe sëmundjet? Meqënëse jemi rritur në një epokë që supozohet shkencore, shumë prej nesh e kanë të vështirë t'i gëlltisin këto gjëra. Megjithatë, kur kemi parasysh se fizika moderne, më kokëfortja nga shkencat, tashmë i shikon këto dukuri si një proces valësh dhe energjish të padukshme, ndoshta pikëpamjet e vjetra të forcave mbinatyrore që depërtojnë të gjithë universin dhe që influencojnë mbi jetën, nuk janë pa baza. Shumë mjekë të sotëm, ortodoksë dhe jo ortodoksë, po i marrin më seriozisht efektin e asaj që mjekët dhe mistikët e hershëm e quanin Spiritus Vitae, rrjedhja e lirë dhe harmonike e të cilës konsiderohej si sekret i shëndetit, jetës dhe zgjuarsisë intuitive.

Nocioni se sëmundja, fizike ose psikologjike, rezulton nga bllokimi i rrjedhjes së kësaj energjie jetësore, shkaktuar nga emocione dhe sjellje negative, po merret sot më seriozisht. A mos konvulsionet violente të pacientëve të Mesmerit janë rezultat i një çlirimi të menjëhershëm i bllokimit të rëndë të rrjedhjes së jetës së padukshme – një bllokim që ekziston në themelin e të gjitha sëmundjeve fizike, nënvleftësuar nga terapia moderne, që lehtëson sëmundjen, por nuk e kuron atë?

8. Magjia te shqiptarët

Mbijetojat e besimeve të lashta, me rrënjë nga kohët e paganizmit, që janë të shumta në popullin tonë, janë ruajtur kryesisht në rite e nëpërmjet riteve, në skenarë mitiko-ritualë, praktikuar në ditë të caktuara të vitit, në festa, në ngjarje të shënuara të jetës së njeriut, sipas rastit, me qëllime shërimi e parandalimi të sëmundjes, të së keqes, për mbarësi në familje, në ekonomi e më tej.

Si i vërejmë nga shqyrtimi i brendësisë së tyre, ato janë ruajtëse e përforcuese të kodeve të të besuarit e përjetimit të tyre, të fshehtësive të pakuptueshme (mistereve), në ndjenja e në mendime të njerëzve.

Në shqyrtimet e mëposhtme në këtë monografi ritet e skenarëve mitiko-ritualë do të zënë një vend të gjerë, ndaj edhe sqarimi paraprak i disa prej këtyre dukurive dhe praktikave me natyrë religjioze u quajt i nevojshëm për t'i bërë gjërat edhe më të qarta.

Rite, ceremoni, doke, zakone, tradita: të tëra janë terma, emërtime a kategori që shënojnë veprime, ide, sinteza e rregulla me natyrë sociale, praktikuar në familje, në bashkësitë fshatare a urbane, në qytete ose në bashkësitë mbi baza pune, zejesh e mjeshtërish të caktuara.

Është krejt e natyrshme që çdo rit të emërtohet me termat përkatës, të afërme me të, por jo çdo ceremoni, doke, zakon a traditë është rit; ta zëmë, një ceremoni tepër e gjerë e dasmës ose e vdekjes mund të ketë vetëm elementë të veçantë që hyjnë në përmbajtjen e ritit, të tjerat janë thjeshtë doke, zakone, tradita e aspak rite.

Këngët, vallet, lojnat, skenat humoristike, bisedat pyetje-përgjigje me natyrë arsyetuese, në përgjithësi nuk janë rite, po veprime për t'u argëtuar, si pjesë të ceremonive të dasmës.

Zakonet për të larë fytyrën çdo mëngjes ose për të larë duart në çdo rast para ngrënies, nuk janë aspak rite, por vetëm zakone me natyrë higjienike.

Janë rite vetëm ato veprime, në thelbin e të cilave qëndron besimin në të mbinatyrshmen, në hyjnoren, ose të paktën, në rrënjët e tyre të origjinës, kanë lidhje me kuptimin e përmendur më sipër.

Kanë natyrë riti veprime të tilla: Në rrugë brenda fshatit të dhëndrrit kalon nusja me krushqit e dy gra shkojnë duke kërcyer, duke vallëzuar pas krushqve që ecin me nusen, e me kërcim prishin gjurmët e kalit me synim që të mos mund të bëjnë magji dashakeqët.

Pasi zbret nusja nga kali në oborr të shtëpisë, një burrë i fuqishëm, kalorës i zoti, i hypën kalit e i jep atij me trok (me shpejtësi) andej e këtej për disa minuta; edhe kjo bëhet kundër magjive që mund të jenë bërë për të dëmtuar çiftin që martohet. Ka ndodhur që në natën e parë të fjetjes së dhëndrrit me nusen, nga kontakti seksual nusja të ketë pasur shumë hemoragji e të jetë sëmurë, madje, sidomos kur nusja ishte në moshë tepër të re, edhe të ketë vdekur, pra për shkaqe veprimesh thjeshtë fiziologjike të rënduara. Në raste të tjera, burri për disa ditë ose dhe dy a tre muaj, nuk ka bërë dot veprim seksual me nusen, ndoshta për arsye emocionesh, për shkak papjekurie seksuale ose nga difekte të tjera fiziologjike, thjeshtë të natyrshme; ka ngjarë dhe kështu, pas martesës është sëmurë burri ose kanë ndodhur fatkeqësi të ndryshme në familje, në jetën bashkëshortore, çka është krejt e natyrshme të ndodhin këto gjëra të dhimbshme në raste të veçanta. Ka ndodhur që gruaja për vite të tëra nuk ka lindur fëmijë, aq të kërkuar në jetën patriarkore.

Të tëra fatkeqësitë e këtij lloji janë shpjeguar, sipas besimeve popullore, me magjitë e bëra nga dashakëqinjtë, nga njerëz që janë të prirur t'ju sjellin brenga, sëmundje, dhimbje të tjerëve.

Kundër këtyre fatkeqësive veprohet me rite, magji mbrojtëse e shëruese, me magji të bardha më të cilat besohet se mund të bëhen jo vepruese magjitë dëmtuese, magjitë e zeza.

Janë rite dasme për mbarësi, për pllenim në lindje fëmijësh, veprimet që kryhen me kulaçin e nuses ku hanë nga pak të gjithë prej tij; posa zbret nusja nga kali, marrin një djalë të vogël (5-8 vjeç) dhe e sjellin për nën bark të kalit e mbi shpinë të tij, pra në formim rrethi, tre herë me radhë; kjo quhet të kapërcyerit e kalit; ato që bëhen posa zbret nusja nga kali: duke e lënë në këmbë pranë portës së shtëpisë e sipër kokës së saj venë disa kësula burrash, njëra mbi tjetrën, mundësisht e para duhej të ishte e dhëndrit.

Me rite lidhen edhe veprimet që kryhen pasi e fusin nusen në vatër dhe e vendosin në karrige, i venë mbi gjunjë djalin që ka kërcyer kalin, mandej ai zbret nga gjunjët e i zbath opingat nuses e aty gjen një monedhë; zakonisht një a dy lekë. Rit është dhe "të lëshuarit e nuses më ujë", pra: të çuarit e nuses te burimi a te përroi: nusja, e shoqëruar nga krushqit e dasmorët shkon e mbushën ujët që e pinë nga pakë të gjithë duke bërë urime. Para se të flenë bashkë çifti i posamartuar, të afërmit e dhëndrrit bëjnë të rrokulliset një djalë në krevatin e tyre. Në krevat të nuses së re venë një armë ose mjete të tjera që mbajnë burrat, po kurrë gjëra të grave. Të tëra këto rite e të tjera si këto bëhen për mbarësi në jetën e çiftit të ri e sidomos me synim që nusja të lindë fëmijë, veçanërisht djem e jo vajza.

Me anë të ritit përforcohet ndjenja e besimit, lidhja shpirtërore me hyjnoren; ripërtërihet kujtesa për domosdoshmërinë e zbatimit të kodit të besimit me një fisnikëri e përkushtim të veçantë.

Në rite, në skenarë mitiko-ritualë, shprehen simbolikisht e, si ide më të përgjithshme, kërkesa ndaj hyjnores për mbrojtje nga fatkeqësitë, për mbarësi, për begati në ekonomi e mirëqënie në jetën familjare.

Pra me rite veprohet praktikioht e kërkohet të përmbushen synime të caktuara, të thuash konkrete.

Riti në jo pak raste, ashtu si na paraqitet në shek. XIX-XX, në përgjithësi e ka humbur funksionin e dukshëm të zanafillës e të kohëve të herëshme dhe praktikohet vetëm si një normë, si një doke e trashëguar ndër shekuj e që ruhet me arsyen se “kështu na e kanë lënë të parët”. Po edhe në këto raste ekziston doemos një ndjenjë e dukshme, edhe pse e mjegulluar, mbarësi-prurëse, mbrojtëse, përtë mënjanuar rrezikun nga e keqja.

Ritet përgjithësisht kanë natyrë magjike. Ato janë veprime që bëhen për të plotësuar dëshirat përmes rrugëve jo të natyrshme: me mjete misterioze (të pakuptueshme), pasqyrë e një mendësietepërfëminore, me anë të përgjasimit (mimetikë), me anë të shoqërimit (asocizrai), me anë të

fjalëve (lutje, urime, mallkime ose formula të ndryshme magjike pa kuptim), me anë veprimesh frikësuese ("me pre lungën"): bëhen veprime magjike sikur gjoja po e prët atë, për ta bërë që nga frika ajo të zhduket e i sëmuri të shërohet. Në popull magjistaret e magjistarët quhen me emrat: magjistare, mgjicë, mgjitare, shtrigë e tjerë, dhe vetëm ato që bëjnë veprime për t'u bërë keq njerëzve.

Në Kosovë, në Rrafsh të Dukagjinit, Lugu i Drinit, besohet se Natën e Këshëndellave, kush i hyp shkopit kaluer e merr dhé prej bashtinet të huaj, dhe e qet në të vetën e thotë: "Këtu ngarko, këtu shkarko", e kjo dihet se sjell bereqetin në arën e tij tue e tërhequn nga ara e tjetrit. (M. Prelaj, Kosova... , f. 186).

Ka dhe veprime rituale magjike të kësaj natyre, me të njëjtat synime, po me strukturë pak ndryshe.

Kështu, në viset Dibër, Mat, Mirditë, në ditët e Shën Gjergjit një grua e zhveshur lakuriq shkon me një kosh para duarsh, në mesnatë në errësirë e qëndron në kufi të arës së saj dhe të asaj të fqinjit. Drejton grykën e koshit nga ana e arës së fqinjit e thotë: "Ngarko! Ngarko! Ngarko!"e pastaj e kthen nga ara e saj e thotë: "Shkarko! Shkarko! Shkarko!"me besimin se ara e saj do të thithë dhe bereqetin e arës së fqinjit, kështu do të bëjë drithë shumë për familjen. Ajo nuk arsyeton se për të prodhuar më shumë duhet që toka të ketë strukturë të përshtatshme për ato lloje bimësh që mbillen aty, duhet mandej puna e bujkut, plehu e ujitja aq sa e ka të nevojshme rritja e bimëve.

Ka dhe plaka që bëjnë veprime magjike me penj, me qime, me jashtëqitje mini, maceje, qeni a njeriu, për t'u bërë keq armiqve të shtëpisë, të lagjes a të fshatit të saj. Kanë ekzistuar ndër Shqiptarë gjithfarë skenarësh magjiko-ritualë keqbërës.

Po sjellim dy gjedhe: "Njeni po pat inad kundra shoqit e këtij don me i marrë shëndetin, do të ketë me doemos një fije folkut t'anmikut të vet, qi do ta ven mbi nji vorr, ase nën kryet të ndo'i të dekunit. Me të shpejtë njeri i atij folkut ka me u thithë emeu zverdhë në ftyrë, si i dekuni, mandej ka me mbetë ashtu e me lëngue përgjithmonë". (Z. Harapi, Mënijt, Folklorë I, Shkodër, "Sht. Z. P", 1940, f. 79)

Për të mbyllur fatin e një goce ose të një djali (që të mos gjejnë burrë a nuse), marrin një pë dhe matin një gomar nga kryeja e ne bishti, pastaj dhe nga kurrizi, ijë më ijë; këtë pë e venë në nji hok (kuti), duke thënë tri herë: "Mbyll fatin e akcilit ose akcilës!"(Përmendin emrin përkatës). Kutinë e mbajnë të mbyllur, dhe ditën e Shën Gjergjit e hedhin në gropë të nevojtores". (I. Dalliu, Magjitë... , "Dituria", 1928, nr. 4, f. 149).

Në disa raste e, këta jo të paktë, magjitë e magjistarët keqbërës ekzistojnë vetëm në besimet popullore, në fantazi, po jo në të vërtetë si veprime rituale-magjike. Kështu, dikur, për fatkeqësi të ndryshme që ndodhnin në fshat, si vdekje fëmijësh, vdekje grash në lindje e sipër,

natyrisht për arsye kushtesh të një niveli të ultë në jetesë, ose ngordhje të bagëtive, ta zëmë: e kaut të lavrës, sëmundje e epidemi që preknin njerin e tjetrin a grupe të tjera njerëzish, thuhej se këto fatkeqësi i kanë shkaktuar mgjitoret ose shtrigat.

Ndërsa shtrigat, ashtu si na paraqitën në besimet popullore, kanë disa funksione tërësisht të veçanta në krahasim me magjistarët.

Në jo pak raste i vërejmë me funksione të përziera, funksione të njëjta, pra këtu kemi një fuzionim figurash të ndryshme të mitologjisë popullore, si mbijetoja të një kohe të lashtë.

Në raste të këtij lloji, si më sipër, çdo fatkeqësi mundoheshin ta shpjegonin me veprime magjish, me syrin e keq. Në disa raste mund të përcaktohen magjistricat, natyrisht në përfytyrimet popullore e jo në të vërtetë. Ka raste që në fshat të ketë një a dy plaka të shkreta, pa burra e pa djem, të varfëra e të mbyllura në punët e tyre, që nuk i bëjnë njeriut asnjë të keqe, nuk bëjnë asnjëfarë lloji magjie. Edhe pse të tilla, krejt të pafajshme, për çdo fatkeqësi që ndodhte në fshat, fajësonin si shkaktare të ashtuquajturat magji që qënkan bërë nga këto plaka.

Në raste të veçanta, me të njëjtat arsye, për fatkeqësi në persona, kafshë a gjëra të veçanta fajsojnë njerëz të veçantë, burra a gra, që paskan syrin e keq e që me anë të të shikuarit shplakuakan, sëmurkan qenësa të veçantë, prandaj dhe ruheshin prej tyre ose bënin kundërmagji me synim që syri i keq i këtyre njerëzve të caktuar të mos mundet të shplakojë fatkeqët. Kështu, për këtë u varnin fëmijëve në trup hudhra, kripë ose dhëmbë ujku, guacka deti a ndonjë send tjetërqë konsiderohej prishës i magjisë.

Në disa raste përdorej bloza e thëngjijt përtë ruajturfëmijët, kryesisht nga magjitë, nga syri i keq, në disa raste të tjera atyre u nxihej në disa vende fytyra me thëngjij.

Gratë apo burrat e veçantë, "të specializuar"si magjibërës, në magji shëruese, në prishje magjish "të bëra nga magjicat", apo shtrigat, e këta natyrisht ishin më të rrallë, quheshin: dis a disë, distara distare, shefcë, shtjeskë e me emra të tjerë, por kurrë midis besimtarëve nuk thuhej e as nuk besohej se edhe këta bënin veprime me natyrë magjike të keqe.

Këta njerëz profesionistë, distarë, mëtojnë se me veprimet e tyre (që doemos janë magjike): me fjalë e formula të fshehta që i pështërisin, me disa lëngje e përgatitje të ndryshme, me prekje të trupit të të sëmurit, me nxirje të fytyrës së fatkeqit, me lëvizje a veprime të ndryshme të tyre, shërojnë njerëzit; gratë që nuk lindin fëmijë i bëjnë të lindin; këta a këto prishin magjitë keqbërëse dhe të shplakuarit nga syri i keq: Dikush ka lëshuar grindje në një familje e ata me veprimet e tyre rituale-magjike "prishin magjitë"e, si rrjedhojë, grindja në familje pushon.

Zakonisht, ritet që mund t'i kryejë çdo njeri, siç janë ato për Ditë Vere, për Nevruz, për Shën Gjergj, për Shën Gjon, në pelegrinazhet në msle, në

Një Shtator, Kolendarët e Nata e Buzmit, rite të lindjes, të martesës, të vdekjes, rite në sëmundje a në inicime, quhen thjeshtë rite, ndonëse në brendinë e tyre kanë natyrë magjike.

Shpesh herë edhe studjuesit i trajtojnë si rite, duke përmendur tepër rrallë fjalën magjike. Ndër mitologë ka mendime të ndryshme për përcaktimet rit dhe magji. Disa thonë se jo çdo rit është magji. Kështu ritet, lutje të animizuara që lidhen thjeshtë me shpirtra të shenjtë e me shenjtorë, sipas tyre, nuk janë magji. Disa studiues mendojnë se nuk janë rite me natyrë magjike ato që bëhen për mirë.

Të tjerë mendojnë se ritet, lutjet që u përkasin feve monoteiste nuk kanë të bëjnë aspak me dukuri magjie, se këto lidhen me perëndinë supreme të gjithëpushtetëshme, të gjithëfuqishme, që sipas tyre, është një realitet i qartë, i dukshëm.

Nëse disa rite të monoteizmit në jetën familjare duket se përfshijnë brenda edhe elementë magjikë, kjo, sipas tyre, ndodh sepse këtu kemi një sinkretizëm në mes të riteve pagane që në përgjithësi kanë dhe natyrë magjike dhe riteve të fesë monoteiste që nuk janë tjetër veçse lutje përfalje mëkatesh, lutje perëndisë supreme që t'u sjellë mbarësi e mirëqenie.

Në të vërtetë, si e mendojmë ne, problemi është mjaft i ngatërruar, po të nisemi nga synimet që duan të arrijnë besimtarët me anë të këtyre riteve e këtyre lutjeve. Disa specialistë të mitologjisë janë të mendimit se edhe pse magjia i ka rrënjët shumë të lashta në periudha para religjoze, para animiste, ajo jeton në shoqërim me tërë religjionet, qofshin ato pagane, qofshin dhe ato monoteiste; ata theksojnë se në fetë monoteiste ritet magjike janë më të pastruara nga elementë primitivë, më të fisnikëruara e të lidhura me ide të jetës shpirtërore e morale.

Monoteizmi, magjitë e egra e primitive siç janë: sakrifica njerëzore, shëmtim, damkosje e deformim i trupit, rite torturuse të njerëzve e tjerë, i ka luftuar e i ka fshirë me kohë nga jeta e shoqërisë, për ku ka mbizotëruar ndikimi i tij.

Kulti në rite magjike

Gurët e kultit, të veçuar në natyrë, të ngulur në tokë a si zgjatim vertikal i një shkëmbi, quhen : Guri i Shejtë, Guri i Mirë, po dhe Guri i Gjallë ose dhe me emra të tjerë.

Në Sellcë të Sharrit (Malësi e Tetovës, në Maqedoni) kemi vërejtur Gurin e Gjallë.

Ai ndodhej jo larg nga varret e fshatit. Aty shkonin gratë për të gjetur shërim. Çonin aty fëmijën "e ndërruem"dhe thonin: "Merrni ket si keni laan e bini at si keni marrël". Po u shërua fëmija, ka qenë "i ndërruar"; po nuk u shërua, besohet se ka pasur sëmundje tjetër dhe i duhet gjetur derman tjetër.

Mendohet se Ato të Malit, Fatmirata Zanat, natën i marrin fëmijtë e vegjël dhe luajnë me to. Po, kur i kthejnë te djepi a te shtresat e tyre natën, ndodh disa herë që t'i ndërrojnë. Pra, nuk u çojnë nënave fëmijët e tyre, po tjetër për tjetër. Këta fëmijë bëhen të sëmurë e qajnë shumë.

Gratë për këtë bëjnë rite e lutje të caktuara që t'u kthehen fëmijët. Rite të tilla e dhurata kushtimi bëhen dhe pranë Gurëve të Shejtë ose te Guri i Gjallë. Kur një gruaje nuk i jetojnë fëmijët, tri vajza të mëdha shkojnë te Guri i Gjallë në Sellcë, hipin mbi atë gur e aty qepin këmishën e fëmijës që do të lindë, nga tri copa pëlhure; atë ia veshin kur lind fëmija, me besimin se kështu ka për të jetuar. Edhe ndorta (gjalm me të cilin lidhin fëmijën) bëhet te ky Gur, po nga këto tri vajza. Besohet se forca e Gurit të Gjallë do të ndikojë në shëndetin e fëmijës, që ai të jetojë. Pra, nga shpirti i Gurit kalon diçka e fuqishme në shpirtin e fëmijës. Ndoshta Guri i Gjallë ndryn në vetvete forcën e shpirtit të të vdekurve e cila kalon te të gjallët; shpirti i të vdekurit i jep forcë e energji fëmijës për të jetuar, për të mos e marrë vdekja. Në fshatin Orashë të Sharrit (Tetovë) është Guri i Gjallë ku bënin rite të ndryshme. Kur shtatzënës i kanë vdekur fëmijët e lindur më parë, vjehrra e saj kërkon pëlhurë dy copa nga dy vajza të fejuara, dhe një copë nga një vajzë e pafejuar. Trupi i këmishës, para dhe prapa, qepet nga pëlhura e dy vajzave të fejuara dhe mëngët nga copa e pëlhurës: së vajzës së pafejuar. Këmishën e qepin vajzat mbi Gurin e Gjallë. E qep një vajzë e fejuar. Ato pyesin: "Ç'po ban aty?"Qepësja përgjigjet: "E qepi këtë kmijshë, ç'ai cull si t'i leje Aishes sa u kalbtë ki guri, ç'aq rroft coulli i Aishes!"(E. Osmani, Rite... "Kult. pop. ", 1999, f. 210).

Në jo pak raste bëhen rite të ndryshme pranë këtyre gurëve të shenjtë Ditën e Verës a Ditën e Shën Gjergjit, përkatësisht tri të enjte para Shën Gjergjit, po dhe në raste të veçanta, në ndonjë ditë feste tjetër të vitit, më së shumti në pranverë ose në verë, ashtu si ndodh me ritet në shpella a pranë gurrave. Në afërsi të fshatit Kapaçindoll (Malësi e Dervenit të Tetovës) në vendin e quajtur Majë-Zebel ndodhet Guri i Kapaçindollit, që ndryshe quhet dhe Zanza e Malit.

Aty bëhen rite të ndryshme në kohë të Ditës së Shën Gjergjit a në ditët e afërme të tij.

Po japim një prej këtyre riteve: Shtatzëna, së cilës nuk i jetojnë fëmijët, kryen këtu veprime magjike tri të enjte para Shën Gjergjit. Duke qepur këmishën e foshnjës mbi këtë Gur, përsërit fjalët: "T'rrojë ki coulli si ki Guri". Ajo, pasi e qep, e len të qëndrojë aty 24 orë; këmishën e bërë për fëmijën që do të lindë, pastaj e lag me ujin që gjendet aty afër. Së fundi, e merr dhe e çon në shtëpi. Kur lind fëmija, ia veshin këtë këmishë me besimin se kështu fëmija do të bëhet i fortë e ka për të jetuar. (E. Osmani, Shtatzania... , fq. 6).

Shënojmë se, jo larg nga ky gur gjenden rrënojat e një kishe. Ka mundësi që Guri i Kultit aty, me ato atribute, do të jetë shumë më i lashtë

nga koha kur ka qenë bërë kisha. Dhe kisha do të jetë bërë pikërisht pranë këtij Guri të Shenjtë të kohës së paganizmit, siç ka ndodhur, si na e thonë dijetarë të ndryshëm, dhe në vise të ndryshme të Europës në shekujt e Mesjetës. Në Kalisht të Gostivarit (Maqedoni) ka disa gurë e shpella të shenjta. Aty ndodhet dhe Guri i Shën Gjergjit. Në afërtinë të Ditës së Verës vajzat hipin mbi këtë gur e thurin kurora me degë thane. Pastaj ato i sjellin në shtëpi. Kur vajzat ulen mbi këtë shkëmb, thonë fjalët: T'bohena t'forta si Guri! T'na shkojë vera mbarë! T'na hecë shëndeti! T'rrojmë sa Guri i Shën Gjergjit!, fjalë që përsëriten nga secila nga tri herë, duke ndërruar tri herë vendin dhe duke u ulur e ngritur.

Afër Gurit të Shën Gjergjit Ndodhet Guri i Vajzës. Thuhet se aty në një kohë të vjetër po kalonin motër e vëlla. Vëllai aty paska dashur të kapë motrën. Motra ka thënë: "O AIIah, banëm ma mirë gur!". Kështu motër e vëlla janë gurëzuar. Sot shkëmbi ka formën e dy njerëzve, ndarë nga njëri tjetri me një të çarë. Në disa raste besohet se gurët e veçuar e me atribute kulti kanë mbirë nga toka apo kanë ardhur aty nuk dihet se prej nga. Pra, sipas këtyre besimeve, në një kohë nuk kanë qenë aty e më vonë janë dukur. Ata kanë në vetvete diçka të veçantë. Nuk janë si gurët e tjerë të zakonshëm që gjenden në atë vend, në ato afërsi. Ndoshta janë të ardhur me akullnajat dhjetra, qindra, mijëra vite më parë, ose janë pasojë e fenomeneve gjeologjike të stërlashta, po mund të jenë dhe mbeturina meteoritesh. Në jo pak raste, gurë me elementë kulti, te të cilët zhvillohen ose nuk zhvillohen rite, janë objekte legjendash mitike të ndryshme. Ata kanë dhe emra nga qënie të ndryshme mitike të panteonit shqiptar, si: Gurët e Dragojve në Malësi të Deçanit (Kosovë), Gurët e Dragojve te Ura e Vezirit pranë Kukësit, Vrima e Dragojve në Shpirag (Berat), Guri i Dragonit në Mal të Zi të Preshevë- Kumanovës, Rrasa e Zanës në Kelmend, Shkambi i Zanave në breg të Drinit (Tropojë), Guri i Bollës (fshati Vorë jo larg qytetit Vorë, Tiranë. Shih: "Kultura popullore. ", nr. 1, 1991, f. 219).

Vrima e Kuçedrës në Sirakë (Berat). Lugu i Zërës (Vuno), Shpella e Zërës (Paramithi, Çamëri). Emra të tillë ka dhe plot të tjerë.

Ndoshta këta emra dhe legjendat mitike përkatëse i takojnë një kohe të lashtë, në të njëjtat vende. Mbase këto vende kulti mund të kenë lindur dhe në Mesjetë, por gjithsesi sipas modelesh e kodesh të besimeve tepër të lashta. Edhe guralecë të çfarëdoshëm përdoren në rite të ndryshme e atyre u jepen forca të mbinatyrshme. Në malësitë shqiptare, gruaja që nuk kishte qumësht gjiri për t'i dhënë fëmijës, mbante në gji një gur duke besuar se kështu do t'i vinte qumështi. Ky quhej Guri i Gjirit, Guri i Qumshtit (Guri i Tamlit).

Në fshatra të komunës së Tetovës është vërejtur ky rit: Gruaja që nuk mbetet shpejt me barrë, mban të varur në gjoks një hajmeli e aty janë futur nëntë gurë të marrur nga nëntë ura, nën të cilat kalon ujë i rrjedhshëm. Pasi

kalon viti, gruaja do t'i hedhë gurët në lumin e rrjedhshëm duke besuar se kështu do të ketë fëmijë (E. Osmani, Rite... , "Kult. pop. ", 1999, f. 209).

Kur gruas nuk i jetojnë fëmijët, tri të enjte para Shën Gjergjit shtatëzëna shkon pranë tyrbes së Ali Babës (Tetovë) në fshatin Çiflik. Aty merr një gur dhe e mban të lidhur në bel deri kur të lindë. Pastaj atë gur e var në tojën e foshnjës (në djep). Pas tre muajsh ajo e kthen gurin në vendin ku e mori dhe thotë tri herë fjalët: "Me niet t'Allahit të më rrojnë coullëtl". Po këtë veprim e bën dhe kur më parë i kanë lindur vetëm vajza e, me këtë rast, kur e kthen gurin në vendin e vet thotë: "Me niet t'Allahit të më kthehen djemt!".

Në anë të Krajës, kur nusja arrin në oborr të shtëpisë, marrin në tokë nga ana e djathtë e këmbës së kalit tre gurë dhe, të mbështjellur në një shami, nusja i fut në gjoks, ku i mban për një kohë të gjatë.

Kuptohet se dhe këta janë për mbarësi në jetën e çiftit e për frytnim të nuses në të ardhmen. Forca magjike e gurëve do të ndikojë në plotësimin e dëshirave të nuses e të të afërmëve të dhëndrit. Po kështu, në shumë raste, në vise të ndryshme shqiptare nëna, së cilës nuk i rrojnë fëmijët, merr një gur aq të rëndë, sa t'i barazohet peshës së fëmijës e, si ta ketë vënë në peshë e të vijë në baraspeshë me fëmijën, beson se me këtë veprim fëmija do t'i jetojë. (Sh. Gjeçovi: "Bet'e Shqiptarëvet", Bota Shqiptare, 1943, f. 63).

Vërehet se, herë-herë, në çfarëdolloj rreziku e dyshimi në fatkeqësi, banorët e malësive kërkojnë ndihmën çudibërëse të gurit. Në Baze e Pëshkash të Kthellës (Mirditë), kur banorët e atyshëm duan të kalojnë lumin e Matit dhe shohin se ky ka ujë shumë, si vëren Gjeçovi më 1903, marrin një papërdhok dhe e vënë në cep të krahut dhe kështu e kalojnë ujin në këmbë, duke besuar se ai do t'ua lehtësojë mundimin dhe t'i ruajë nga rreziku i mbytjes. (Sh. Gjeçovi, e dhënë e regjistruar më 1903. Shih: "Kanun i L. Dukagjinit", 1989, f. 495).

Një forcë magjike të posaçme në besimet e tij populli u ka dhënë gurëve me vrimë. Për të pushuar dhimbja e kokës, shihnin diellin përmes vrimës së gurit. Hidhnin farën e arës përmes vrimës së gurit që ajo të jepte në të ardhmen prodhimin e dëshiruar. Përshkohej bagëtia përmes vrimës së ndonjë shkëmbi (ku hyhet në një anë e dilet në anën tjetër) në pranverë që ajo të ketë shëndet, të mos dëmtohet e që të japë prodhim të mbarë atë vit. Gurët me vrimë, në disa raste i varin në portë të banesës ose dhe te bletët, për mbarësi, pjellori.

Kjo e dëshmuar në disa vende po më shumë në Kolonjë, si na e dëshmon Dh. Qiriazi. "Kur e ndigjojnë fëmijët së pari kangën e qyqes, marrin nji gur, e venë mbi krye e thonë: Qyqe, koka ime gur e koka jote qull! Bajnë kështu që të jenë të fortë si guri dhe të mos ndiejnë dhimbë kreje e trupi. Barijtë marrin atë ditë tre gurë pa folun e ia venë tundsit, pse besojnë që qet ma shum gjalp qumshti i rrahun, kur të ket ksij gurësh".

VII – ASGJË MË HYJNORE SE JETA NUK KA

1. Absurd! E palogjikshme!

Një nga enigmat më të mëdha gjithmonë ka qenë: çfarë do të bëhet me mëkatarët, me ata njerëz që kanë devijuar nga rruga? Çfarë raporti ekziston midis Hyjnores dhe mëkatarit? A ka për të qenë ai i dënuar? A ka për ta hedhur Zoti në ferr? – pasi që të gjithë priftërinjtë prejgjithmonë me këmbëngulje kanë pohuar se – mëkatari duhet të jetë i dënuar me zjarrin e përjetshëm të ferrit. Por, a është Zoti në gjendje ta dënojë këdoqoftë? Mos, vallë, po i munguaka përdëllimi? Dhe nëse Zoti nuk është ai që tregon dhembshuri, kush atëherë është në gjendje ta shprehë atë?

Ka shumë përgjigje, por ajo e Isait gjithsesi është më e bukura. Para se të kalojmë tek fjalurta, disa gjëra që tani duhet t'i sqarojmë. Ky sqarim i gjërave juve ka për të jua dhënë prapavijën e cila këtu është vërtet e domosdoshme.

Kurdo që e dënojmë ndonjë person, ne e fshehim arsyen e vërtetë prapa njëmijë e një racionalizimeve. Është shumë me rëndësi ta kuptoni dallimin në mes të racionalizimeve dhe arsyes. Ndoshta jeni baba apo nënë, dhe ndoshta fëmija ka bërë diçka që nuk ju shkon për dëshire. Nuk është me rëndësi se a është vepra e fëmijës e mirë apo e keqe, se kushedi çfarë është çfarë? Por sidoqoftë, ju disa gjëra s'i lejoni, dhe pikërisht ato gjëra bëhen ajo që është "e keqe". Ndoshta ajo vërtet është e keqe, ndoshta edhe nuk është, por theksi nuk është në këtë. Theksi është në këtë që pason – çfarëdo që JU lejoni është në rregull. Pra, krejt varet nga lejimi dhe moslejimi.

Dhe kur fëmija devijon nga rruga, kur bën diçka që nuk është mirë nga këndi juaj, ju e dënoni. Arsyeja themelore është ajo se ju nuk ju ka dëgjuar, e jo ajo se ka bërë diçka të keqe. Arsyeja më e thellë ndodhet në atë se: egoja juaj është tmerrësisht e goditur. Fëmija është grindur me ju, dhe për këtë ju ka thënë "jo"– babait, nënës, autoriteteve, atyre që janë të fuqishëm. Ju e dënoni shkaku se egon e keni të lënduar, dhe dënimi është vetëm trajtë e hakmarrjes.

Por racionalizimi është tjetërndryshe: ju thoni se fëmija ka gabuar dhe se për atë duhet t'i tërhiqet vërejtjen me dënim; nëse nuk dënohet, si s'ka për ta ditur se çfarë është në rregull e çfarë e gabueshme? Dhe për këtë fëmija duhet të jetë i kufizuar, në çfarëdo mënyre, sa herë që devijon nga rruga, sakaq i shpërblyer nëse shkon hapave tuaj. Ja sesi fëmija kushtëzohet për një jetë të drejtë! Ky është racionalizim i pastër, kështu ju të gjithë e kuptoni këtë, por kjo fare nuk është shkak themelor i pavetëdijshëm.

Shkaku themelor është plotësisht tjetërndryshe: të vendoset fëmija në atë vend që i takon, t'i shpjegohet se cili është zot shtëpie në shtëpi, dhe se

ju, si zot shtëpie natyrisht, do të vendosni se çfarë është në rregull e çfarë jo, se jeni ju ai që do t'ia tregoni drejtimin. Ju atij ia shpjegoni se ai nuk është i lirë, se jeni ju ai që e posedoni, se jeni pronari i tij – dhe, nëse nuk dëgjon, ka për ta pësuar.

Nëse i pyetni psikologët e thellë, ata do të ju thonë se në sjellje duhet të dallohen dy gjëra: shkaku dhe racionalizimi. Racionalizimi është mjet tepër dinak – ai e fsheh shkakun burimor dhe jua jep maskën e rrejshme, por kjo nga jashtë duket krejt në rregull. Dhe e njëjta gjë nuk ndodh vetëm në mes të prindërve e fëmijëve, por edhe në mes të shoqërisë e "fëmijëve"të cilët kinse kanë devijuar nga rruga. Për këtë arsye aq shumë burgje e ligje – kjo është hakmarrje, revanshizëm social.

Shoqëria nuk mundet kohë të gjatë t'i durojë ata që janë rebelues, sepse nëse iu lejohet, ata do t'i rrënojnë vetë themelet e shoqërisë. Athina nuk ka mundur ta durojë Sokratin, dhe atë jo se ka gabuar – e jo vetëm se nuk ka gabuar, por ka pasur plotësisht të drejtë – athinasit nuk kanë mundur ta durojnë shkaku se struktura shoqërore do të shkatërrohej po ta linin të punonte si ia kishte ëndja. Sokrati ka qenë dashur të vdesë që të mos vdiste shoqëria.

Isai është kryqëzuar, por jo shkaku se ka qenë e gabuar ajo që ka thënë – fjalë të tilla të vërteta kurrë në rruzullin e Tokës nuk janë dëgjuar – por është viktimizuar shkaku i shoqërisë e cila nuk ka mundur ta tolerojë praninë e tij dhe thëniet e tij: ka qenë i rrezikshëm për të gjitha.

Shoqëria nuk mund të durojë nëse jeni rebelues, dhe menjëherë ju dënon. Por, ajo vazhdon me racionalizim: ajo ju dënon për të mirën tuaj personale, por askë në esencë nuk e ka brengosur se a ka nxjerrë vallë dikush ndonjëherë diçka të mirë prej tërë atij mundimi. I kemi dënuar kriminelët me mija vite, dhe askush nuk interesohet se – a janë bërë ata kriminelë më të mirë shkaku i dënimit apo jo. Sakaq kriminelë ka për çdo ditë e më tepër, të burgosur ka sa "nuk u dihet numri": sa më shumë ligje, aq më shumë shkelës të ligjit; sa më shumë gjyqe, aq më tepër e më tepër dënime. Rezultati përfundimtar është plotësisht absurd: krimi është në rritje të përhershme.

E ku është problemi? Krimineli e ndien se krejt kjo është racionalizim, dhe se po e dënojnë shkaku i një gjëje të dhjetë – po e dënojnë shkaku se e kanë zënë. Edhe ai është po ashtu racionalizues shumë i shkathtë: herën tjetër ka për të qenë më dinak, më i kujdesshëm, dhe kjo është e tëra. Kësaj here e kanë zënë shkaku se nuk ka qenë mjaft i vëmendshëm, e jo shkaku se ka bërë diçka që është e gabuar. Shoqëria ka dalur më dinake se ai, por herën tjetër ka për ta parë – ka për t'i treguar ai se cili është më dinak, më inteligjent, më i shkathtë. Krimineli gjithmonë mendon se po e dënojnë shkaku se e kanë zënë, e jo shkaku i asaj se ka bërë ndonjë të keqe. Dhe përfundimi i vetëm që do ta nxjerrë është: "Herën tjetër nuk kanë për të më zënë!"

Dhe kështu ndodh: secilën herë kur njeriu del nga burgu, ai prej tij del si kriminel larg më i mirë dhe më efikas. Ka jetuar me njerëz me shumë përvojë, e ka pjekur zanatin prej të urtëve të mëdhenj të hajdutërisë, prej atyre që nga njëqind herë janë dënuar dhe paraqesin guru të vërtetë në rrugën e krimit. Duke jetuar me ta, duke u shërbyer, njeriu mëson. Mëson nga përvoja e të tjerëve që të mos jetë i zënë – herën tjetër. Dhe kështu, me kohë, lindet krimineli më i mirë e më i mirë.

Kurrkush me të dënuar nuk është ndalur, por shoqëria edhe më tutje mendon t'i pengojë - me dënime natyrisht – njerëzit që përsëri të mos devijojnë nga rruga. As shoqëria e as kriminelët nuk kanë të drejtë. Shoqëria po hakmerret, e edhe i dënuari po ashtu – egoja e vogël dhe egoja e madhe po flasin me të njëjtën gjuhë, mor sido që të jetë komunikimi i pavetëdijshëm. Krimineli po ashtu mendon: "Në rregull, le të më godasin, por unë do t'u hakmerrem kur të vijnë pesë minutat e mi. Keni për ta parë se çfarë kam për të ju bërë kur të dal prej këtuhi. "

Vallë, a është Zoti i njëjtë – mu si gjyqi, si avokati, mu si babai apo shefi? Mos vallë Zoti është i vrazhdë si shoqëria në të cilën jetojmë? Mos vallë Zoti diku thellë në vete është i njëjti egoist si edhe ne të gjithë? A ka për të ju dënuar, vallë? Nëse këtë e bën, atëherë nuk është më Hyjni, atëherë është idiot si gjithë të tjerët.

Kjo është një nga vështirësitë bindshëm më të thellat: si ka për t'u sjellë Zoti me personat që njëherë kanë devijuar nga rruga? A do të jetë i dashur? E me këtë të lidhura janë edhe shumë gjëra të tjera. Nëse dëshiron të jetë i drejtë, atëherë nuk mund të jetë i mëshirshëm, pasi që dhembshuria dhe drejtësia kundërshtohen në mes veti. Dhembshuria paraqet falje të pakusht, e ajo gjithsesi nuk është e drejtë.

Se, kjo është e mundur: një shenjtor ditë e natë lutet dhe kurrgjë të keqe nuk bën. Tërë jetën e tij ai frikësohet t'i thejë dofarë kufizimesh; jeton në kazamatin e vetimponuar, dhe nuk ia lejon vetes asnjë sekondë kënaqësish shqisore. Gjithnjë lufton që të jetë i pastër, asketisht i qëndrueshëm dhe përplot virtyte. Dhe tash, ta shohim edhe njeriun tjetër që ka bërë krejt çfarë i ka rënë ndër mend: ka lejuar që shqisat ta udhëheqin me të veten, ka marrë nga bota sa ka mundur, ka gabuar në të gjitha mënyrat e mundshme, e atëherë – çfarë? Edhe njëri, edhe tjetri po mbërrijnë në mbretërinë qiellore, në botën e Perëndisë.

Çfarë ka për të ndodhur? Nëse shenjtori nuk është i shpërblyer e mëkatari i dënuar, ajo do të ishte shumë e padrejtë. Nëse Zoti e shpërblen edhe nëjrin edhe tjetrin, edhe kjo nuk është bash më e drejta, kurse shenjtori ka për të menduar: "E kam jetuar një jetë të pastër, por kurrgjë të veçantë nuk kam fituar". Dhe nëse mëkatari i fiton të gjitha që i fiton edhe një i shenjtë, ç'dobi ka prej asaj të jesh shenjtor? E tërë çështja bëhet plotësisht e pakuptimtë. Në këtë rast, Zoti ka dhembshuri, porse është i padrejtë.

Por, nëse Zoti është i drejtë, atëherë aritmetika përbrenda trurit tonë është plotësisht e qartë: mëkatari duhet të jetë i dënuar, kurse shenjtori i shpërblyer. Por, jo: nëse është ashtu, Zoti atëherë nuk është i mëshirshëm – i drejti gjithmonë në njëfarë dore duhet të jetë i vrazhdë për t'u realizuar drejtësia. Njeriu i cili është i tëri për drejtësi jeton në kokë – kurrë në zemër. Gjyqtari paqëtor nuk guxon të gjykojë me zemër – meqë atëherë drejtësia ka për të qenë jostabile. Po ashtu, as dhembshuri nuk guxon të tregojë, shkaku se edhe dashamirësia më e imët është pengesë në rrugën e realizimit të "veprës së ndershme". Gjykatësi paqëtor vërtet duhet të jetë si kalkulator në trajtë njeriu, si kokë pa zemër: ligjet, shpërblimet, dënimet – kurrfarë përdëllimi nuk guxon të kalojë, ndjenjave nuk iu lejohet vullneti. Ai duhet të mbetet i pangatërruar, si vrojtues, pa kurrfarë emocionesh – mu sikur të ishte i shtangur nga koka e gjer në thembra. Por, tash lajmërohet një proces shumë i ndërlikuar, meqë me shekuj popujt pohojnë se Zoti në të njëjtën kohë është edhe i mëshirshëm edhe i drejtë; është përplot me dashuri, por nuk falë. Kjo është kundërthënie e kulluar, paradoks – si të zgjidhet?

Isai e jep një përgjigje, dhe kjo është vërtet më e bukura. Tash është koha që të provoni të kuptoni se çfarë thotë ai. Do të jetë vështirë për ta kuptuar Isanë, meqë e tërë çështja ka për t'jua rrënuar mendimet e mëparme – ai ka për të shkuar tej të gjitha paragjykimeve tuaja, parabindjeve, për arsye se Isai fare nuk beson në ndëshkime. Askush i ngjashëm me të nuk mund t'u besojë sistemeve aq të ashpra, meqë thellë në vete, secili dënim është trajtë e hakmarrjes dhe asgjë më tepër. As Buda, as Krishna, as Mahaviri – asnjëri prej tyre nuk beson në dënime. Në të kundërtën e kësaj, ata kualitetin çfarë është drejtësia nuk ia përshkruajnë fare Zotit, por për këtë dhembshuria vërtet është veti hyjnore. Drejtësia, ky është ideal njerëzor, por jo hyjnor, pasi që ai në vete bart kushte të caktuara: "Bëje këtë dhe ke për ta realizuar atë. Mos e bëj atë sepse atëherë ka për të gjetur kjo"– e të tjera e të tjera. Dhembshuria e vërtetë nuk qet kurrfarë kushtesh.

Zoti është i mëshirshëm, i dhimbshëm, por, jo: që ta kuptojmë Zotin si të atillë duhet të fillojmë nga mëkatari.

Isai thotë: "Mbretëria është si bariu i cili ka pasur njëqind dele. Njëra prej tyre e ka devijuar rrugën, dhe atë mu ajo më e madhja. Bariu i ka lënë të nëntëdhjetë e nëntë delet, dhe ka zënë ta kërkojë atë njërën, gjithnjë derisa nuk e ka gjeyur. Duke qenë i lodhur, ai i ka thënë deles: Të dua më tepër se gjithë të tjerët. "

Absurde! Jologjike! – por e vërtetë. Përpiquni që këtë ta kuptoni sa më mirë që mundeni: "Mbretëria – mbretëria e Perëndisë – është si bariu i cili ka pasur njëqind dele. Njëra prej tyre e ka devijuar rrugën, dhe atë mu ajo më e madhja. "

Prejgjithmonë kështu ka qenë – ai i cili shtrembëron rrugën, që del nga binarët, gjithmonë është më i miri. Po qe se rastësisht jeni baba dhe nëse i keni pesë fëmijë, të jeni të sigurt se fëmija më i mirë ka për t'u rebeluar i pari, ka për të provuar ta kundërshtojë autoritetin tënd dhe të dëshmohet. Mesatari gjithmonë ka për ta ndjekur turmën, gjersa ai mbi mesataren gjithmonë ka për të qenë rebelues, meqë vetë kualiteti i mendjes është rebelimi. Kjo është e lidhur me inteligjencën: sa më inteligjentë të jini, jeni aq më rebelues. Ata të cilët secilit ia thonë nga një "po"të dobët gati janë të vdekur. Juve ata mund të ju pëlqejnë, por jetë në ta nuk ka. Ata ju përcjellin, por jo shkaku se ju duan, por për atë se thjesht janë të dobët, të frikësuar, dhe nuk mund të qëndrojnë në këmbët e veta – të gjithë ata janë njerëz të dobët që nuk janë në gjendje të ecin në të kundërtën e erës.

Shikoni pak rreth vetes: njerëzit të cilët i merrni si të mirë janë pikërisht ata më të dobëtit. Nëse mirësia e tyre buron nga fuqia e tyre, ata janë të mirë vetëm shkaku se nuk vendosin të jenë të këqij. Por, çfarë është ajo mirësi që buron nga dobësia? Ajo duhet të vijë si rezultat i një tejbegatie të fuqisë – dhe vetëm atëherë mirësia është vërtetë e mirë, meqë atëherë është e mbushur me jetë. Mirësia e tillë në të vërtetë është vërshimë e jetëshmërisë.

Dhe për këtë, kurdo që mëkatari bëhet i mirë, shenjtëria e tij është më e shndritshmja, gjersa shenjtria e njeriut të rëndomtë është e vdekur, e hirtë, e pangjyrë, meqë nuk ka jetë në të. Pra, mbajeni në mend këtë – po qe se bëheni shenjtor nga dobësia, keni për të lënë shumë mangu, meqë vetëm shenjtëria si pasojë e fuqisë është vërtetë e vlefshme. Njeriu që është i mirë shkaku se nuk mund të jetë i keq nuk është fare i mirë. Në atë moment që forcohet pakëz, mirësia e tij ka për t'u zhdukur. I jepni pushtet dhe ai ka për t'u prishur shumë shpejt.

Kjo i ka ndodhur Indisë: Gandi ka pasur vërtet shumë pasues, por mirësia e atyre që e kanë dëgjuar nuk ka qenë pasojë e fuqisë por e dobësisë. Të gjithë pasuesit kanë qenë të mirë kur nuk kanë qenë në pushtet, por kur janë bërë të pushtetshëm, automatikisht janë prishur.

A mundet pushteti ta prishë një njeri të fuqishëm? Kurrë! – pasi që njeriu përplot fuqi edhe ashtu është i pushtetshëm. Nëse pushteti mund ta prishë, atëherë ai kaherë e ka prishur. Pushteti e prishë njeriun vetëm kur është i dobët, dhe nëse mirësia e tij buron nga dobësia e tij.

Lordi Ekton ka shkruar diku: "Pushteti i prish të gjithë, dhe atë absolutisht". Por, unë kësaj ia kisha shtuar një gjë të vogël, pasi që kjo deklaratë nuk mund të jetë as e pakushtëzuar e as kategorike. Me fjalë të tjera, pushteti prish vetëm nëse mirësia buron nga dobësia. Nuk ka aso pushteti i cili do ta prishte njeriun që është i mirë shkaku se është i fuqishëm. E si do të mundej? – meqë ju atë fuqi veçse kaherë e njihni në

vete, ajo është aty. Por, të mos mashtrohemi, është shumë vështirë t'ia gjejmë burimin – prej nga po vjen ajo mirësi juaja?

Në qoftë se nuk jeni bërë hajn shkaku se jeni frikësuar se kanë për të ju zënë, po atë ditë kur do të jeni të bindur se nuk kanë për të ju privuar nga liria, keni për t'u bërë hajn – se kush mund të ju pengojë atëherë? Frika juaj e mëparme ju ka penguar. Nuk dëshironi t'i vrisni armiqtë tuaj shkaku se e dini se kanë për të ju zënë dhe kanë për të ju privuar nga liria herët apo vonë. Por, nëse situata është e tillë që të mund t'i kryeni vrasjet e të mos ju dënojnë, ju po atë moment keni për t'u bërë vrasës. Domethënë, të mirë jeni për shkak të dobësisë, e jo për asgjë tjetër.

Por si mundet mirësia të mbijë nga dobësia? Për mirësinë është e nevojshme një energji e madhe, se mirësia është luks, këtë mos e harroni. Edhe shenjtëria është luks – edhe ajo vjen nga tejbegatia e brendshme. Kur të keni shumë energji, aq energji sa ajo thjesht të ju vërshojë, filloni të ndani. Atëherë nuk jeni në gjendje të shfrytëzoni, sepse për këtë nuk ka kurrfarë nevoje. E jepni nga zemra, pasi që edhe ashtu keni më tepër sesa duhet, për atë se gati jeni të rënduar me begati. Ah, ju kështu do të kishit dëshiruar që nga çdo gjë të hiqni dorë e që vetëm të ndani, të shpërndani çdo gjë rreth vetes, por siç mendoni ju, kjo thjesht është e pamundur.

Kur vërtet keni diçka, ju atëherë dëshironi ta jepni – mbajeni në mend këtë ligj: lidheni vetëm për atë të cilën në esencë nuk e posedoni; nëse diçka vërtet është juaja, mund ta jepni. Vetëm nëse jeni në gjendje që diçka të gëzueshme t'i dorëzoni dikujt tjetër në dorë, keni qenë pronar. Po qe se diku në vete akoma jeni të lidhur me gjënë e caktuar, kjo është vetëm shkaku i asaj se e dini që nuk jeni pronari i saj. Ju disi e ndieni se ajo nuk ju përket juve, siç e parandieni se çdo gjë, pak nga pak, do të ju merret. Për këtë nuk jeni në gjendje që të ndani. Për këtë është argumenti më i mirë se njeriu e do atë moment kur e dhuron dashurinë e vet, dhe vetëm kur tërë jetën e vet ia dorëzon çfarëdoqoftë, ai është vërtet gjallë. Nuk ka mënyrë tjetër që të dihet sesi qëndrojnë gjërat.

Nga dobësia buron mirësia, por ajo është si monedhë e rrejshme, lule artificiale. Kur pema të lulëzojë ajo këtë e bën vetëm shkaku se është përmbushur me energji. Lulja në pemë paraqet tejbegati të pastër – ajo shfaqet vetëm kur pema është në gjendje që vetvetes t'ia lejojë një gjë të tillë. Nëse ujë nuk ka pasur mjaft, nëse pleh nuk ka pasur aq sa duhet apo nëse toka ka qenë jopjellore, atëherë në pemë mund të çelin disa gjethe, por ajo thjesht nuk do të mund të lulëzojë.

Në krejt këtë ekziston kierarkia: ajo më e larta mund të ekzistojë vetëm nëse ka mjaft energji që të realizohet maja. Nëse nuk jeni mjaft të majmë, inteligjenca e para ka për t'u zhdukur, se ajo është begati e pastër, lulëzim i njeriut. Në vendet e varfëra nuk është varfëri e trupit ajo që manifestohet, por mungesë inteligjence para së gjithash. Kur të gjitha nevojat e trupit janë të kënaqura, energjia lëviz telart, por nëse kjo në

radhë të parë nuk është e realizuar, atëherë energjia lëviz në këtë drejtim – që mungesa të zvogëlohet. Baza gjithmonë duhet të mbrohet: rrënjët, domethënë trupi. Nëse rrënja zihet asgjë, lulëzimi nuk mund të pritet. Nëse trupi është i hedhur në plan të dytë, si ka për t'u shfaqur inteligjenca atëherë? Kurse dhembshuria ndodhet edhe përmbi vetë inteligjencën, meditimi po ashtu.

Në Indi, Buda dhe Mahaviri janë lajmëruar kur vendi vërtet ka qenë i pasur. Prej asaj kohe e gjithnjë deri më sot kemi shenjtorë, por jo edhe ndonjë qenie të ngjashme me Budën – vështirë, tepër vështirë! Meqë, lulëzimi i tillë është i mundshëm vetëm kur në pemë ekziston ENERGJIA E PADOBISHME – dhe vetëm atëherë, po ajo e njëjta energji zë ta kënaqë vetveten. Kështu krijohet kthesa e brendshme, meditimi, kurse prej tij vjen ekstaza, lind Buda.

Mos u qitni, ta zëmë, rrënjve ujë... së pari kanë për t'u zhdukur lulet, pastaj gjethet, mandej degët, dhe më në fund rrënjët – pasi që me rrënjët janë të mundshme rilindjet, prandaj druri në radhë të parë i mbron rrënjët. E ato janë më të ulëtat, por, jo: të tilla janë shkaku se janë themeli i tërë drurit. Kur të vjen koha e volitshme, periudha me shira, rrënja përsëri ka për të gufuar telart me forcë të re; gjethet kanë për t'u gjelbëruar, ashtu që në fund do të vie edhe gjer tek lulëzimi. E njëta kierarki ekziston edhe përbrenda teje.

Jini të mirë nga forca juaj, e jo nga dobësia e frika. Shikoni, unë nuk ju them të jini të këqij – se si i dobëti do të jetë i keq? E keqja kërkon energji sa edhe mirësia. Nuk mund të jeni të këqij pa energji, nuk mund të jeni të mirë pa energji – meqë që të dya gjendjet janë reale. E çfarë, pra, mund të jeni pa këto forcat burimore? Mund të bartni fytyrë të rrejshme; nuk keni për të qenë kurrgjë tjetër pos fasadë e hollë, mashtrim, hije njeriu, fanitje dhe farsë. Kjo është ajo e cila që nga kohët e lashta ndodh. Atëherë keni për ta treguar mirësinë e rrejshme, shenjtërinë e pavërtetë. Mendoni se jeni shenjtorë shkaku se nuk e keni bërë as edhe një mëkat të vetëm, e jo shkaku i asaj se vërtet e keni realizuar natyrën tuaj hyjnore.

Kur e realizoni hyjnoren, ajo është atëherë realizim i energjisë pozitive, e atëherë jeni me Zotin të ngjashëm. Por, në këtë nuk ka përpjekje – zhvillimi rrjedh spontanisht. Mund ta kundërshtoni, por ajo është dukuri negatie. Nëse kundërveproni, ajo është shenjë e sigurt se diku në ju është e pranishme dëshira. Nëse ajo dëshirë që të bëni keq është në ju, atëherë ajo është mëkati, e nëse po ajo e njëjta energji materializohet, atëherë kemi të bëjmë me krimin. Nga kjo përbëhet i tërë dallimi në mes të krimit dhe mëkatit.

Mëkati është vepër, por ju mundeni edhe të mendoni – asnjë gjyq nuk ka për të ju dënuar për të gjitha ato çmenduri mentale, pasi që asnjë gjyq nuk e ka në kompetencat e veta sferën e mendjes. Me trupin dhe me veprat të cilat janë të lidhura me ekzistencën fizike gjyqi di çfarë të bëjë.

Unë mundem hollësisht të mendoj sesi po e vras mbarë njerëzimin: mundem madje edhe të kënaqem me këtë, e askush nuk mund të më gjykojë shkaku i mendimit. Dorën në zemër, kënaqem vërtet, por askë bukfalisht nuk e kam vrarë. Veprimet dalin në gjyq, e jo mendimet.

Mëkati është mëkat, pavarësisht se a zhvillohet në nivelin fizik apo mental, pavarësish se a është vepër apo mendim. Ju mendoni për këtë – dhe kjo është fara; se a ka për të mbirë kjo në aksion konkret nuk ka fare rëndësi. Nëse mendimi tejrritet në trup, ai bëhet krim, pra: po qe se e keni vetëm mendimin, mëkati është i bërë – për hyjnoren kjo është shenjë e mjaftueshme se keni devijuar nga rruga. Por, një gjë është tepër vështirë ta kuptojmë: se ata që kanë dalur nga binarët janë shumë më të fuqishëm sesa ata që e pasojnë turmën në hap. Ata që kanë devijuar nga rruga përherë janë më të mirët. Dilni pak nëpër çmendina dhe vini mendjen: janë çmendur vetëm njerëzit më inteligjentë. Në shtatëdhjetë vitet e fundit asnjë nuk është çmendur – kanë shkalluar pa dyshim vetëm më inteligjentët. Niçeja është çmendur – një nga njerëzit më mendjemprehtë të cilin kjo botë ndonjëherë e ka parë – dhe atë sepse ka pasur begati energjitike e cila nuk ka mundur të përmbahet, andaj energjia persoanle thjesht edhe e ka gllabëruar. Ju atë as rastësisht nuk mund ta zbutni - ajo energji ta përkujton oqeanin e egërsuar. Njizhinski është çmendur, edhe Niçe, dhe plot të tjerë. Në shtatëdhjetë vjetët e fundit elitën intelektuale keni për ta gjetur jo jashtë, në botë, por nëpër çmendina. Mediokritetet janë gjithmonë të shëndosha, dhe gjithmonë janë në liri.

E tërë kjo duket tepër absurde: ata mesatarët janë të shëndoshë, kurse mbimesatarët përherë shkallojnë. Përse ai njeriu më i zakonshëm kurrë nuk shkallon? Përse? Sepse nuk ka mjaft energji që të devijojë nga rruga. Fëmija bëhet problem shkaku se është më i egër sesa forca e egër të cilën e ndien në vete – ai me të diçka duhet të bëjë. Vetëm fëmijët e pagjak mbeten të qetë e të padëgjuar në qoshen e tyre. Po qe se gjysmëtëvdekurit të tillë i thuani: "Ulu aty dhe përsërite Ram, Ram, Ram", ai do të fillojë t'i numërojë kokrrat posa t'ia hidhni tespihet. Por, jo: po qe se fëmija është vërtetë i gjallërishëm, ai ka për t'i hedhur tespihet si edhe lojërat tjera, dhe ka për të thënë: "Po kjo është marrëzi! Shkova unë të luaj e të kacavirrem nëpër drunj, të bëj diçka, nuk ka as rëndësi çfarë. "

Jeta është energji. Vetëm një mendje anemike ka për të mbetur në "rrugën e drejtë", meqë mendja e tillë nuk ka mjaft forcë madje as për të humbur, për të devijuar në "të paprekshmen", për të rënë në greminë. Por, ata që kanë ndërmarrë një hap të tillë - nëse fare ka të tillë – kanë për t'u bërë buda. Po qe se Niçe ndonjëherë ka për të hyrë në meditim, nga i krisuri ka për t'u bërë edhe një qenie e përndritur. Ai ka mjaft energji për çmendje, e mjaft ka edhe për përndritje. Buda do të ishte çmendur po të kishte shkuar në kahjen e kundërt – sepse energjia domosdoshmërisht duhet të lëvizë. Nëse nuk mund të jeni kreativë, atëherë energjia të cilën e

posedoni ka për të rrënuar çdo gjë. Shkoni nëpër çmendina, seriozisht po ju them; do t'i gjeni njerëzit më inteligjentë në to. Ata njerëz janë të çmendur shkaku se nuk janë mesatarë, shkaku se shohin shumë më thellë sesa ju, e kur vështrimi është ashtu i thellë, atëherë tëra iluzionet zhduken.

E tërë jeta është gjë aq enigmatike, saqë po të hyni vërtetë në thellësi, do ta keni mjaft vështirë që të mbeteni shëndosh. Njerëzit nuk janë të çmendur vetëm shkaku se të gjithë shohin cektësisht: shihni vetëm dy për qind, gjersa nëntëdhjetë e tetë për qind, në kuptimin psikologjik, sytë i keni të mbyllur. Po qe se i ekspozoheni të tërës, ka për të qenë ajo një derdhazë e tillë saqë mendja nuk ka për të qenë e aftë ta përmbajë ekuilibrin më se të nevojshëm – do të çmendeni, kjo është krejt e sigurt.

Tash shumë psikologë, të cilët tejet larg kanë shkuar në studimin e njerëzve – R. D. Leng e të tjerët – kanë hasur në fakte të caktuara. Njëri nga faktet është edhe ky: njerëzit të cilët janë të çmendur janë ndoshta edhe më të mirët, derisa ata që bëjnë krime janë ndoshta më të rebeluarit. Shumë prej tyre bëhen edhe mendimtarë të mëdhenj, siç në Indi ishte rasti – me Valmikun.

Valmiku ka qenë kriminel, vrasës, dhe ka jetuar nga vrasjet e rrëmbimet. I ka ndodhur zgjimi – më në fund – në një moment të vetëm.

Një i urtë ka kaluar pyllit, dhe Valmiku nga pusia i është hedhur.

"Çfarë ke për të më bërë tash?", e ka pyetur i urti pa trohë frike.

Valmiku i ka thënë se do t'ia merrte të gjitha që kishte.

"Nëse mund ta bësh këtë", ka qeshur i urti, "unë atëherë do të jem tepër i lumtur, meqë ajo që posedoj është plotësisht e brendshme – për këtë arsye me tërë fuqinë përshëndes vendimin tënd që të më robërosh. "

Valmiku nuk ka arritur ta kuptojë këtë. "Nuk po të kuptoj", i ka thënë. "Mua më interesojnë vetëm gjërat e jashtme. "

"Por gjërat e tilla fare nuk do të mund të të ndihmojnë", duke buzëqeshur i ka thënë i urti. "E edhe të të pyes: Pse ti fare e bën këtë?"

Shkaku i familjes: i nënës, gruas, fëmijëve – ata do të mbesin të uritur nëse e ndali këtë punë. Përndryshe, kjo është krejt ajo që di të bëj. "

Kur e ka dëgjuar përgjigjen e Valmikut, i urti i ka propozuar: "A di çfarë – ti lidhmë mua për druri, kurse vetë kthehu në shtëpi dhe pyeti nënën, gruan e pasardhësit e tu, vetëm një gjë: a janë të gatshëm që barabarësisht ta ndajnë dënimin për atë që ti po bën në emrin e tyre?

Kur të vijë Dita e Gjykimit – pyeti lirisht – se a janë në gjendje t'i ndajnë baras gjithë mëkatet e tua? Meqë, ti të gjitha po i bën për ta, siç po thua. "

Për të parën herë në jetën e vet Valmiku është menduar thellësisht:

"Ndoshta vërtet ke të drejtë. Shkova të shoh sesi qëndrojnë gjërat. "

Kur ka shkuar në shtëpi, aty së pari e ka hasur gruan. Kur ia ka shtruar pyetjen, ajo gati se e ka mahnitur: "Unë t'i ndaj mëkatet E TUA?

Për ç'arsye? Unë nuk kam bërë kurrfarë mëkati. Ti je përgjegjës për çdo vepër tënden – askush tjetër nuk mund ta ndajë fajin. "

Nëna i tha: "Përse unë do të vuaja shkaku i mbrapshtive tua? Unë të kam lindur dhe e ke për borxh të më ushqesh e të kujdesesh për mua. Mua nuk më intereson se në ç'mënyrë ti vjen gjer tek mjetet për jetë, por është përgjegjësi jotja, jotja si im bir, që të kujdesesh për jot ëmë. "

Fëmijët kanë qenë të të njëjtit mendim. Asnjëri nuk ka qenë i gatshëm që me Valmikun me përgjegjësi të plotë t'i ndante mëkatet. Në momentin e parë ka qenë i habitur, por kur pakëz e ka marrë veten, është kthyer tek i urti, me ballë i ka prekur këmbët e tij, dhe me zemër të thyer e ka lutur: "Të lutem jepma atë begatinë e brendshme për të cilën më fole, meqë gjërat e jashtme nuk më interesojnë më. Më lejo që të jem grabitës i botës së brendshme, shkaku se pak më parë e kam kuptuar se jam vetëm, dhe se çdo vepër imja është vetëm përgjegjësia ime – askush nuk dëshiron ta ndajë me mua atë që unë po e bëj. Kam lindur i vetmuar, vetë kam për të vdekur, ndaj krejt çfarë bëj është ekskluzivisht përgjegjësia ime individuale. Për këtë është koha e fundit që të nisem kah brendësia dhe ta gjej se kush jam. Me marrëzira përfundoi!"

Njeriu ka ndryshuar në çast.

Gati diçka identike i ka ndodhur njëherë edhe Budës: një njeri ka qenë plotësisht i krisur, dhe është betuar se ka për t'i vrarë një mijë njerëz – as më pak e as më shumë – meqë shoqëria nuk është sjellë mirë ndaj tij. Për këtë shkak ka vendosur që të hakmerrej dhe që në shenjë hakmarrjeje t'i likuidonte të paktën një mijë njerëz. Po ashtu ka vendosur që çdo të vdekuri t'ia prente një gisht që në atë mënyrë të krijontë tespihet me një mijë gishtërinj njerëzish. Shkaku i këtyre dëshirave të tij njerëzit e kanë quajtur Angulimala: njeri që bart tespihet nga gishtat e njerëzve.

Por pse mu ata më të mirët duhet të devijojnë nga rruga? Pse mu ata e humbasin rrugën? Këtu ekziston një fshehtësi e vogël që duhet të kuptohet. Procesi i rritjes është i tillë që ju në radhë të parë duhet të realizoni ego tejet unike. Po qe se egoja juaj nuk është në plotni e dendësuar, përkushtimi nuk është i mundur.

I ka mbytur nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë njerëz. Askush nuk ka pasur guxim të kalojë nëpër zonën ku ka jetuar Angulimala. Posa që dikush do të lajmëronte se vrasësi i krisur ka zbritur në qytet, komunikacioni automatikisht do të ndalej. Për këtë ai e kishte shumë vështirë ta gjente atë njënjeriun e mbetur – e vetëm një i është dashur.

Kur Buda ka kaluar nëpër pyllin e afërt, njerëzit e panikosur të qytetit e kanë takuar: "Mos shko më tutje! Mos shko më tutje, të lutemi. Angulimala është në afërsi, ai vrasësi i çmendur. Ai nuk mendon shumë – vetëm vret. Për atë as nuk ka rëndësi se kush jeni ju; i nevojitet vetëm gishti juaj. Mos shkoni kësaj rruge nëpër pyll. Nisuni cilësdoqoftë, por kësaj mos ia mbani assesi!"

"Nëse unë nuk kaloj këtej", u tha Buda, "kush do të kalojë? Dhe meqë ai e pret vetëm një njeri, do të shkoj unë. "

Kurse Angulimala gati e kishte përmbushur betimin e vet – ka qenë njeri energjik, dhe e tërë shoqëria është dridhur nga frika para tij. Mëkëmbësit e mbretit i janë frikësuar, edhe gjeneralët – një njeri ua ka marrë jetën qindëra njerëzve – edhe qeveria, edhe ligjdhënësit, edhe policia. Të gjithë kanë qenë të pafuqishëm të bënin diçka për ta ndalur Angulimalin. Por Buda iu drejtua njerëzve të stërfrikësuar: "Edhe ai është njeri, ndaj, natyrisht, edhe ai na duhet. Duhet të rrezikoj – ose ai do të më vrasë mua, ose unë kam për ta vrarë atë – në një kuptim tjetër. "

Kjo është ajo që secili Budë e bën: rrezikon, do t'i fitojë të gjitha ose të humbë çdo gjë. Madje edhe ata nxënës që kishin folur se do ta pasonin në hap filluan të dridheshin – meqë vetëm ideja për të kish zënë të marrë tiparet e rrezikut!

Në çastin kur Buda ishte në rrëzën e kodrinës mbi majën e së cilës ndodhej Angulimala, as një nxënës i vetëm nuk kishte mbetur me të – ishte plotësisht i vetmuar. Nxënësit "e patrembshëm"janë zhdukur pa gjurmë. Angulimala e ka vënë re Budën që nga largësia, dhe ky njeri i është dukur skajshmërisht i shkujdesur, miturak, i ngjashëm me fëmijën, ashtu që edhe vrasësi i çmendur ndjeu përdëllim të sinqertë për të. Angulimala mendoi: "Ky njeri siç duket është plotësisht i pavetëdijshëm për faktin se ndodhem në afërsi – se askush i shëndoshë dhe i tërë nuk do të gjykonte që të kalonte këtejpari. "

Buda është dukur ashtu i bukur dhe i pastër, saqë madje edhe një kriminel i rrënjosur ka menduar me veten: "Nuk është mirë ta vras këtë njeri. Këtë do ta lë të jetojë – edhe ashtu mund ta gjejë një tjetër në vend të tij. "

Kur Buda është ofruar, Angulimala i tha: "Ndal! Kthehu në çast andej nga ke ardhur – asnjë hap përpara! Nuk di a je i njoftuar se unë jam Angulimala, vrasës që kam vrarë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë herë gjatë jetës sime. Këto që po sheh rreth qafës sime janë gishtërinjtë e njerëzve. Më nevojitet vetëm edhe një gisht i vetëm për t'i plotësuar tespihet gjer në fund – por edhe që me këtë ta përmbush betimin tim. Bile edhe nëna ime të kalonte tash këtej, nuk do të hamendesha – gishti është gisht, qoftë edhe nga nëna. Ndaj po ta përsëris: mos m'u ofro! Jam shumë i rrezikshëm, dhe nuk besoj në kurrfarë shpirti, religjioni, e çka di unë. Unë as që e kam dert se kush je ti. Mund të jesh edhe murg, shenjtor, por, jo: mua më intereson vetëm gishti, dhe asgjë më shumë – gishti yt, gishti i ndokujt tjetër, për mua është pa rëndësi. Prandaj, mos m'u ofro, përndryshe, gati je, po të them seriozisht. Ndalohu!"

Por Buda ka vijuar t'i ofrohet, duke mos u ndalur.

"Ky njeri është ose i çmendur ose plotësisht i shurdhër", ka menduar Angulimala.

"More ndalohu njëherë"klithi ai drejt Budës. "Ndalohu!"

"Unë", i tha buda devotshmërisht, "kaherë jam ndalur – ti je ai që lëviz. Lëvizjet e mia kanë pushuar atë moment kur motivet më janë zhdukur. Unë nuk kam kurrfarë qëllimi, dhe meqë të gjitha i kam realizuar, pse do të kisha lëvizur? Ti je ai që lëviz, prandaj po ta përsëris: TI ndalu!"

Angulimala thjesht ka qenë i hutuar, por pas pak sekondash ka filluar të qeshej si bubullimë. "Paj ti vërtet qenke rast i çuditshëm", i tha ai, sinqerisht i habitur. "Qe, unë këtu po rri, nuk po lëvizi as një centimetër, kurse ti, që po bën hapa të mëdhenj, MUA po më thua që të ndalem. Mandej, po më thua se je ndalur që moti. Paj ti vërtet qenke i paimagjinueshëm. Kush je ti – a je i çmendur apo torollak, vërtet nuk e kam të qartë. "

Kur i është ofruar krejt afër, Buda i tha: "Kam dëgjuar se po të nevojitet vetëm edhe një gisht i vetëm, dhe, sa më përket mua, meqë i kam realizuar të gjitha që duhet, për mua ky trup është i padobishëm. Kur do të vdes, njerëzit kanë për ta ndezur, por atëherë për askë nuk do të jetë i dobishëm. Ti mund ta përdorësh trupin tim për ta përmbushur betimin tënd; ma prej gishtin lirisht. Kam ardhur tek ti thjesht me këtë qëllim, meqë kjo ndoshta është rasti i fundit që trupi im për dikë të jetë i dobishëm. Njerëzit edhe ashtu së frikti kanë për ta ndezur. "

"Ç'thua?!"u habit Angulimala. "Po unë kam menduar se jam i krisuri i vetëm në këtë kodër... të lutem, mos shit mend, se jam vërtet i rrezikshëm, dhe mund të të vras si duke u mahitur. "

I patrazuar, Buda qetësisht e luti: "Para se të vrasësh, unë të lus sinqerisht të ma plotësosh dëshirën e fundit. Merre shpatën në dorën tënde dhe preje degën e këtij druri. "

Në po atë moment, shpata u ndodh në dorën e Angulimalës, dhe degëza me dridhërimë ra në tokë.

"Të lus vetëm edhe një gjë", shtoi Buda në nxitim. "Tash këtë degë të njëjtë ta kthesh përsëri në dru. "

"Tash e kam përsosmërisht të qartë", e ngriti vrasësi dorën e tij, "se qenke plotësisht i krisur – unë jam në gjendje të ndaj, por jo edhe të bashkoj. "

Tash Buda qeshi në kupë të qiellit: "Kur mundesh vetëm të shkatërrosh, por jo edhe të krijosh, atëherë shkatërrimi yt nuk është i jashtëzakonshëm. Këtë munden edhe fëmijët e vegjël – kurrfarë guximi nuk ka në këtë. Rëndom edhe fëmija është në gjendje ta këpusë degën nga lisi, por nevojitet i urti që degën përsëri ta kthejë në vendin e vjetër. Nëse nuk je në gjendje që një degëz ta kthesh në trung, pse atëherë lavdërohesh me vrasjet e tua? A ke menduar ndonjëherë për këtë?"

Si i magjepsur nga fjalët e Budës, Angulimala i ka mbyllur sytë dhe me zë rrëqethës është lutur: "Udhëhiqmë!"Ka qenë pothuajse i zgjuar nga ajo që ka dëgjuar.

Që ditën tjetër është bërë bikhu, lypsar i shenjtë. Ka filluar të lypë si edhe çdo murg tjetër budist, por kurdo që lëshohej në qytet, të gjitha shitoret mbylleshin, çepengat lëshoheshin nëpër dritaret e shtëpive, kurse nëpër rrugë nuk kishte as njeri të gjallë. Njerëzit në frikë pëshpërisnin: "Atij njeriu nuk i besohet as kur vjen me çininë e lypsarit. "Angulimala gati vuante urie, meqë të gjithë hezitonin t'i ofronte mëshirë. Njerëzit qëndronin nëpër ballkone dhe nga lart i hidhnin gurë. Vështirë mund të gjendej në qytet familje që nuk kishte dëgjuar për të, ndaj të gjithë ishin të pezmatuar.

Njëherë kur gati e mbytën me gurë, Buda kaloi pranë tij. Angulimala qëndronte shtrirë në gjak dhe trupin e kishte me plagë. "Si po ndihesh?"e pyeti Buda. Me të kishte edhe disa nxënës.

"Aq shumë të falënderohem", belbëzoi Angulimala duke i hapur sytë; "gurët e tyre po depërtojnë vetëm deri tek trupi im, por jo edhe deri tek unë – kurse unë kam jetuar aq shumë vite e kurrë nuk e kam njohur këtë fakt të thjeshtë. "

Buda atëher iu drejtohet pasuesve të vet më të afërt: "Angulimala është zgjuar, është bërë Bramin, njohës. "

Kjo mund të ndodhë në moment – po qe se ekziston mjaft energji për diçka të këtillë. Çështja bëhet e vështirë, në të vërtetë e pamundshme, vetëm nëse energjia nuk është e pranishme. I tërë sistemi i Yogës ka vetëm një qëllim: të krijohet energji e mjaftueshme për transformim. Po ashtu, edhe ushtrimet tantrike dinamike e dëshirojnë vetëm një gjë: të krijojnë tepricë energjitike, ashtu që fuqia e brendshme të bëhet vërshimë. Vetëm pas kësaj, ju bëheni ose vërtet të mirë ose vërtet të këqij.

Isai tha: "Njëra prej tyre e ka devijuar rrugën, dhe atë mu ajo më e madhja. "

Vetëm ata që janë të mëdhenj, që janë më të mirët, njëherë kanë për të devijuar nga rruga. Mëkatarët janë njerëzit më të bukur në botë, edhe pse, natyrisht, kanë shkuar në kahjen e kundërt. Por, jo: ata mund të bëhen shenjtorë kur të duan, gati si në lojë. Tejet të bukur janë edhe shenjtorët edhe mëkatarët, gjersa shëmtia u takon vetëm atyre të mesit. Dobësia është i vetmi objekt turpi që ekziston: kur nuk keni kurrfarë energjie në vete, kur jeni barrë e vdekur, kufomë që lëvizë dosido...

Por pse mu ata më të mirët duhet të devijojnë nga rruga? Pse mu ata e humbasin rrugën? Këtu ekziston një fshehtësi e vogël që duhet të kuptohet. Procesi i rritjes është i tillë që ju në radhë të parë duhet të realizoni ego tejet unike. Po qe se egoja juaj nuk është në plotni e dendësuar, përkushtimi nuk është i mundur. Duket paradoksale, por kështu qëndrojnë gjërat. Së pari duhet të keni diçka – që të mund t'i jepni

dikujt. Kurrë nuk keni për të arritur gjer tek përkushtimi nëse nuk keni realizuar diçka që është e denjë të jepet. Por edhe si kishit për të dhënë diçka që nuk e keni?

Pasaniku mund të hjek dorë nga pasuria e tij, por çfarë lypsari do të mund të bënte? Çfarë ai mund të hedh nga vetja? Dijetari i madh mund ta hedhë diturinë e tij intelektuale, por çfarë një i topitur kishte për të dorëzuar? Si ka për ta hedhur ai atë që s'e ka? Nëse keni dituri ju atë mund ta hidhni dhe të bëheni të përunjur, por nëse jeni të paditur, çfarë keni për të mohuar?

Sokrati mund të thotë: "Unë nuk di asgjë". Kjo është ajo pjesa e dytë e së vërtetës: së pari ka ditur aq shumë, por: më në fund e ka kuptuar kotësinë e diturisë. Por kjo njohje iu vjen vetëm njerëzve të madhësisë së Sokratit. Intelekti duhet të ushtrohet, njeriu duhet të arrijë dituri dhe ego që është plotësisht e kristalizuar – prej kësaj përbëhet pjesa e parë e jetës. Kur të gjitha i keni mbërritur, atëherë mohojini. Vetëm atëherë jeni në gjendje që diçka të hidhni nga vetja. E dallimi është vërtet i madh.

Edhe skamnori në rrugë edhe Buda në rrugë janë lypsarë, por kualiteti i tyre dallon: Buda është lypsar sipas vullnetit të tij personal. Askush nuk e ka detyruar për këtë – kjo është liria e tij. Ai i ka shijuar të gjitha, ka provuar shumëçka, e ka ndier aromën e pasurisë, dhe në fund e ka njohur fuqinë e tillë sesa e cekët dhe e pakuptimtë është. Ai është lypsar shkaku se e ka kuptuar idiotizmin e kësaj bote, marrëzinë e mbretërive tokësore. Lypësia e tij posedon pasuri të pamarrur me mend në vete – në krahasim me Budën, asnjë mbret nuk është ashtu i pasur, meqë secili akoma është në gjysmë të rrugës, gjersa Buda e ka mbyllur rrethin e vet.

Kurse lypsari nga rruga kurrë nuk e ka shijuar pasurinë, dhe lypësia e tij është bosh. Si ai mund të heqë dorë nga dëshirat të cilat kurrë nuk kanë qenë të plotësuara? Si ai mund të pohojë se pallatet janë të pakuptimta, se pushteti është i padobishëm? – kur lypsari nuk ka përvojë kur në pyetje janë këto gjëra. Prej nga atij guximi që të thotë sesi gratë e bukura janë teveqele? Ai nuk ka lidhje sesi gjërat qëndrojnë. Vetëm përvoja e drejtpërdrejtë mund t'i ndihmojë të mbledhë guxim dhe të heqë dorë nga të gjitha. Pa përvojë, ju vetëm mund të ngushëlloheni me racionalizime – shumë lypsarë këtë e bëjnë, lypsarë në kuptimin bukfal dhe figurativ.

Po qe se nuk keni qenë me ndonjë grua të bukur, prej nga tek ju guximi të pohoni: "Trupi është vetëm trup dhe asgjë më tepër. Ai është i vdekshëm dhe ka për t'u thërrmuar herët a vonë!"Sakaq, thellë në ju, dëshira edhe më tej gjallon. Vetëm pas përvojës, dëshira zë të zbehet. Pa njohje – krejt çka i thoni vetes është ngushëllim dhe asgjë më tepër. Lypsari dhe skamnori mund ta bindin veten se nuk ka gjë prej pallateve, por sidoqoftë, ata e dinë se diçka në krejt këtë megjithatë ekziston - përndryshe, përse të gjithë do të ngjiteshin pas pasurisë si mizat në mjaltë?

Lypsari është gati i çmendur pas gjërave të tila: në ëndrrat e veta ai e sheh veten se si shëtit nëpër pallatet madhështore, se si rri në fron dhe me lëvizjen e dorës i lumturon apo i fatkeqëson masat e gjera popullore. Por, jo: posa të zgjohet, fytyra ndryshon, dhe dëgjohet zëri që lajmëron: "Unë nuk kam dert, çfarë dreq pasurie – unë kam hequr dorë nga të gjitha!"Ngushëllimet e tilla e të ngjashme jo që janë vetëm të padobishme; lirisht mund të thuhet se ato fshehin rrezik të paparë në vetvete.

Në pjesën e parë të jetës një person i pjekur duhet ta realizojë egon, kurse në pjesën e dytë - vetëm kur rrethi të jetë skicuar - ai duhet të hedhë krejt çka ka arritur.

Fëmija rritet vetëm kur i kundërvihet ndikimit ë prindërve, kur iu del nga dora, kur e ngreh zërin e vet përkundër vullnetit të tyre – me të gjitha këto mënyra, fëmija e arrin pjekurinë, individualitetin dhe fortësinë e egos. Nëse vazhdon të jetë i varur nga prindërit dhe të qëndrojë nën banrrën e tyre, ai kurrë nuk ka për t'u bërë qenie e pavarur. Ai duhet që në një momet të devijojë nga rruga, të humbasë. Me fjalë të tjera, fëmija thjesht duhet të bëhet i pavarur, kurse dhembja është pjesë përbërëse e asaj rritjeje. Këtu është lufta, e vetëm nëse luftoni, ju e ndieni se JENI. Dhe kjo është ai rrethi për të cilin gjithë kohën po ju flas: nëse e ndieni se jeni, kundërviheni me fuqi më të madhe, dhe sa më e madhe të jetë fuqia, aq më shpejt bëheni, aq më thellë e ndieni "UNË JAM". Fëmija e arrin pjekurinë e plotë individuale vetëm pasi të jetë liruar nga çdo varësi. Për këtë pavarësim ai vërtet duhet ta humbasë rrugën.

Ndoshta mëkatari kërkon pavarësi nga shoqëria, nga nëna dhe babai – por ai të gjitha këto gjëra i dëshiron – pavarësinë, individualitetin, egon dhe pjekurinë – në një mënyrë plotësisht të gabuar. Edhe shenjtori kërkon pavarësi, por mënyra të cilën e ka zgjedhur është plotësisht në rregull. Mënyrat janë të ndryshme, por ajo e gabuara gjithnjë është shumë më e lehtë. Është vështirë të jesh shenjtor, meqë kjo do të thotë se njeriu së pari duhet të bëhet mëkatar. Provoni ta fuqizoni aftësinë tuaj të kuptimit: për t'u bërë mëkatarë nuk është e domosdoshme që së pari të bëheni shenjtorë, por nëse dëshironi të jeni shenjtorë, atëherë në fillim duhet të gaboni, të humbisni, të devijoni nga rruga. Nëse kjo rrugë hyrëse nuk ekziston, shenjtëria juaj ka për të qenë shumë e varfër, e pagjak, e hirtë – kurrfarë jete nuk do të ketë në të. Shenjtëria juaj do t'i ngjajë një korite të thatë, e jo lumit që vërshon dhe kaltërson çdo gjë përreth.

"Njëra prej tyre e ka devijuar rrugën, dhe atë mu ajo më e madhja. "

Sa jam i njoftuar lidhur me këto gjëra, fjala "më e madhja"në botën e dhenve domethënë si edhe "më e mira". Delja më e madhe është delja më e mirë: ajo kushton më shumë, jep më shumë lesh, ka më tepër mish, e të tjetra e të tjera. Nëse delen e tillë e shitni, keni për të fituar shumë. Sa më e madhe aq më e mirë. Dhe vërtet, delja më e madhe domethënë delja më e mirë – kurse më e madhja është arratisur. Simbolika është e dukshme.

Bariu "... i lë të nëntëdhjetë e nëntë delet... ", se ato nuk janë të vlefshme.

Pse Isai në tregimet e veta gjithmonë i përmend bariun dhe delet. E veçanërisht – përse e përdorë këtë simbolikë në këtë tregim? Tufa më e madhe e mendjeve mesatare jeton në kope – si dhentë. Shikoni se si lëvizin dhentë nëpër ndonjë livadh – do të ju duket se kanë tru të përbashkët: sikur nuk kemi të bëjmë me jetëra individuale. Dhentë palohen njëra për tjetrën, mbështeten, gjithmonë në frikë se mos po mbeten vetëm. Për këtë, lëvizin ekskluzivisht nëpër tufa.

Njëherë kam dëgjuar: një mësues e ka pyetur vogëlushin, babai i të cilit ishte bari: "Thuajmë, vogëlush... Nëse i ke dhjetë dele, dhe nëse në ndonjë rrethanë njëra prej tyre kërcen në greminë, sa dhen kanë për të mbetur në jetë?"

"Asnjë", shkrepi vogëlushi si pushka e ngrehur.

"Po për çfarë po flet ti?"– u habit mësuesi. "Ky është problem aritmetike. Shiko: i ke dhjetë dele, dhe vetëm njëra e vetme kërcen – sa atëherë po mbesin?

"Asnjë", e përsëriti djaloshi. "Ju ndoshta e njihni aritmetikën, por nuk po i njihni dhentë. Ato gjithmonë lëvizin në grigjë: nëse njëra hidhet në greminë, të gjitha kanë për të rënë në të. "

Bariu e ka lënë pas vetes tërë grigjën - nëntëdhjetë e nëntë dele - dhe ka filluar kërkimin e asaj deles së ikur e cila vlen më së shumti. A e keni arritur vetëdijshmërinë tuaj? Apo thjesht i përcillni vlerat që shoqëria jua ka imponuar? Ju jeni ndoshta Hindus, i Krishterë, ndoshta jeni Xhain apo Muhamedan, ateist apo hebre - po a jeni njeri? Njeri sigurisht nuk jeni, se njeriu nuk ka shoqëri. Sokrati është njeri, Isai është njeri, gurui Nanak është njeri – por ju nuk jeni. Ju edhe më tej i takoni kopesë së deleve. Njeriu askujt nuk i takon – ai fuqimisht qëndron në këmbët e veta. Isai thotë se Zoti gjithmonë ka për të shkuar pas kërkimit të mëkatarëve, por kurrë nuk ka për t'i kërkuar mesatarët, atë klasën e mesme – meqë ajo nuk është e denjë për përpjekje të tilla, ajo nuk e ka merituar nderin e tillë. E çka është edhe më me rëndësi, personi mesatar është gjithmonë në rrugë – nuk ka nevojë që kushdoqoftë ta kërkojë – ai thjesht nuk mund të humbasë. Për këtë shkak bariu ka mundur që tërë atë kope ta lërë në pyll, edhe pse ka qenë natë plot errësirë - dhentë do të blegërojnë në kope, gjersa bariu do të kalojë kodra e lugina vetëm për ta gjetur atë më të mirën. Sepse, mu ajo dele është bërë individ, e ka arritur shkallën e egos së veçantë. Për nga fuqia, për nga vlerat e brendshme, e tërë kopeja është më e dobët sesa ajo dele që është arratisur. Shikojeni qenien tuaj: a është ajo ende turmë? Apo jeni bërë ego? Nëse jeni bërë çfarëdoqoftë, atëherë Zoti ka për të ju kërkuar herët apo vonë, se ju këtë e keni merituar – do të jeni të gjetur, qoftë edhe në pyll, qoftë edhe në natën e errët. E keni arritur gjysmën e rrethit, dhe tash keni filluar ta skiconi atë pjesën tjetër – ajo

pjesa tjetër është përkushtim, devocion. Ju mund ta arrini vetëm gjysmën e rrethit me fuqinë tuaj – tjetra është e Perëndisë. Hyjnorja ka për ta skicuar rrethin, në këtë nuk mund të dyshoni. Kurdo që ta keni realizuar egon, Perëndia e fillon kërkimin, meqë ajo që ju ka takuar juve ju veçse e keni bërë: jeni bërë të pavarur, jeni bërë të posaçëm. Tash, nëse lejoni që edhe kjo veçanti të ju merret, do të behëni universal.

Ky është dallimi: para arritjes së veçantisë ju jeni turmë e zakonshme, masë lokale. Pas kësaj, po e realizoni individualitetin dhe devijoni nga rruga – gjersa më në fund nuk e hidhni egon dhe nuk bëheni një me të Tërën.

Në këtë moment, ju jeni si të mos kishit qenë, dhe për këtë nuk mund të jeni një me Tërësinë. Tash vetëm turma të ndryshme ekzistojnë, kurse ju jeni vetëm pjesë të tëra këtyre masave të paparashikueshme. Në armatë me gjithë këto turma disponojnë me shumë sukses: iu japin numra – një, dy, tre, katër – e kur ndokush vdes apo vritet në luftë, në tabelën e lajmërimit shënohet numri nën të cilin është i evidentuar. Të gjithë këta njerëz janë numra të rëndomtë, kurse njëri numër me lehtësi mund të zëvendësohet me tjetrin. Kur ndonjë numër vdes nga plumbi, personi tjetër e zëvendëson dhe bëhet "numri një". Në armatë të gjithë janë vetë dhentë, kurse armata është vërtet një shoqëri e përsosur, thnegëltore e pashembullt, turmë. Nëse dëshironi të shihni sesi duket mendja kolektive, mendja e turmës, shkoni në armatë: ata do të ju disiplinojnë pa problem, dhe kjo në atë mënyrë saqë së shpejti keni për ta humbur çdo ndjenjë se jeni individ, se jeni të pavarur në çfarëdo aspekti. Urdhri është urdhër, dhe për këtë as nuk duhet menduar. Kryeje dhe pikë! Çfarëdo që të ju urdhërohet, ju e realizoni në vepër pa kundërshtim. E tërë kjo shtrihet vërtet në thellësi.

Gruaja e një koloneli ka qenë shumë e brengosur, meqë ky ka gërhitur pabesueshmërisht shumë – kurdo që binte në anën e majtë. Gruaja thjesht është thinjur nga vuajtjet, ka qenë tërësisht e rraskapitur nga pagjumësia – se koloneli ka gërrhitur si ari, dhe krevati thjesht është dridhur prej tij. Porse, kurdo që koloneli flinte – e edhe kjo ka ndodhur ngandonjëherë – në anën e djathtë gjer tek gërrhitja nuk ka ardhur. Gruaja veçse është molisur nga vuajtjet, ka shkuar tek psikiatri. "Më thuani çfarë të bëj se kështu më nuk shkon. "

"Kurrfarë problemi, vërtet", i tha psikiatri; "vetëm kthejeni në anën e djathtë, dhe gërhitja përfundoi. "

"Por, zotëri", i tha gruaja, "ju nuk e dini se si është burri im. Ai është dyfish më i rëndë se ne të dy, dhe unë thjesht nuk kam fuqi ta lëkund. E edhe sikur të kisha, ç'do të më duhej - ashtu do ta zgjoja, e kur ndokush e zgjon, ai është në gjendje të vrasë, aq shumë tërbohet. "

"Nuk ka problem", qeshi psikiatri; "atëherë na mbetet vetëm një gjë. Kurdo që të flejë në anën e majtë, ju vetëm i bërtitni në vesh: "Djathtas!"dhe koloneli menjëherë ka për t'u kthyer. "

Ashtu edhe ka qenë. Urdhri është urdhër – kjo ka vepruar, se të gjithë jemi të pavetëdijshëm.

Shoqëria ekziston si turmë – mund ta tërhiqni në luftë kur të doni – problem nuk ka. Për këtë arsye Hitleri ka mundur që tërë vendin ta shndërrojë në llogor ushtarak; edhe Mao Ce Dun ia ka arritur kësaj, e edhe shumë të krisur të tjerë. Shoqëria flen në anën e majtë, dhe mjafton që t'i urdhërosh: "Djathtas kthehu!"– urdhërimi - ekzekutimi! Vetëm pak disiplinë të hekurt dhe shoqëria ka për t'u shndërruar në llogor ushtarak. Individualiteti nuk ekziston, ai nuk lejohet. Kjo është mendja kolektive, grigjë dhensh.

A e keni arritur vetëdijshmërinë tuaj? Apo thjesht i përcillni vlerat që shoqëria jua ka imponuar? Ju jeni ndoshta Hindus, i Krishterë, ndoshta jeni Xhain apo Muhamedan, ateist apo hebre - po a jeni njeri? Njeri sigurisht nuk jeni, se njeriu nuk ka shoqëri. Sokrati është njeri, Isai është njeri, gurui Nanak është njeri – por ju nuk jeni. Ju edhe më tej i takoni kopesë së deleve. Njeriu askujt nuk i takon – ai fuqimisht qëndron në këmbët e veta.

Prandaj Isai thotë: "Delja më e mirë ka devijuar nga rruga", e kur ndodh që ajo ta humbasë rrugën, bariu i le gjithë ato të nëntëdhjetë e nëntat dhe fillon ta kërkojë, "... gjithnjë derisa nuk e gjen. "

Ju e lutni Perëndinë, por ai fare nuk është në kërkim TUAJIN – për këtë shkak lutjet asgjë nuk godasin. Së pari bëhuni individë, diçka të posaçëm, dhe atëherë për lutje nuk ka kurrfarë nevojash – sepse Zoti ka për të ju kërkuar. E pse kishim për ta lypur Zotin? Dhe si do ta realizonim këtë? Adresën e keni të panjohur, telefonin s'e dini dot. I dini vetëm fjalët dhe teorinë, e krejt ajo është e pakuptimtë, dhe nuk mund të ndihmojë.

E kam dëgjuar tregimin për një prift që kishte mbërritur në qytetin e ri. Taksistët bënin grevë, kurse ai patjetër duhej ta gjente kishën, meqë atë ditë kishte predikim. Në rrugë ka takuar një vogëlush, të cilin e ka lutur që t'i tregonte se ku ishte kisha.

Djaloshi jo vetëm që i ka treguar se ku ndodhej kisha, por personalisht e ka dërguar tek ajo. Kur kanë ardhur tek dera, prifti i kënaqur i ka thënë: "Jam shumë i lumtur që u mundove të më ndihmosh. Nëse fare pak të intereson se ku ndodhet mbretëria e qiellit, eja sonte në predikim, dhe unë pikërisht këtë kam për ta sqaruar se ku ajo ndodhet. "

"O nuk vjen në shprehje", ia preu djaloshi duke ia bërë "papa"me dorë; "ti nuk po ke lidhje ku është kisha, e do ta dërgosh dikë në mbretërinë qiellore!"

Por unë ju them: madje edhe po ta dinit rrugën gjer tek kisha, kjo nuk do të ju ndihmojë. Të gjithë edhe e dinë se ku është kisha, ku është ky apo

ai tempull, por kurrfarë dobie s'ka prej këtij lloji diturie. Zotin nuk mund ta gjeni shkaku se nuk e dini se ku ndodhet ai. Ai ju kërkon ju, se ai ju njeh - dhe ky është një nga mësimet më themelore të Isait: njeriu nuk mund ta gjejë Hyjninë, por për këtë Hyjnia mund ta gjejë njeriun. Ai ju gjen kurdo që të jeni gati.

Pra, çështja nuk është aty që ju të kërkoni e të kërkoni. Çështja qëndron në këtë që pason: vetëm jini gati dhe pritni. Gatishmëria e parë është: të bëheni të veçantë, "të devijoni nga rruga", të jeni rebelë, se vetëm si të tillë e ngjishni egon. Pra, gjëja e parë është ta tejkaloni turmën - të "devijoni"nga rruga, pra të tejkoalohet kopeja dhe ajo jetë "shpinë për shpine". Të devijosh nga rruga do të thotë të shkosh përmbi tëra kufizimet e çdo shoqërie, të dalësh nga modelet e imponuara, meqë përmbi tërë ata binarë ndodhet egërsia, gjersa përmbi të vetëm pafundësia e "Zotit të gjallë".

Shoqëria është si çeltina në mesin e një pylli. Kjo çeltinë e vogël është vepër njerëzore. Të gjitha ligjet tona iu takojnë njerëzve, dhe tërë atë që e quajmë virtyt apo mëkat e ka trilluar dikush i ngjashëm me ju. Ju lidhje nuk keni se çfarë është ai virtyti i vërtetë? Kjo fjalë "virtyti"("virtue"– vër. e përkth.) është me origjinë greke, dhe do të thotë "burrërore"("virile"në origjinal – vër. e përkth.), i fortë, i fuqishëm, me mundësi.

Jini të fuqishëm, dëshmojeni veten, drejtojeni kurrizin! Mos u bëni viktimë e një kopeje të frikësuar! Filloni të mendoni me kokën tuaj, jini ai që jeni! Dhe nisuni rrugës suaj – mos jini dele gjatë gjithë shekullit të jetës!

Nëntëdhjetë e nëntë mund të lihen në pyll – nuk ka nevojë që bariu të frikësohet, meqë gjithë kohën do të mbështeten njëra në tjetrën, e për të ikur nuk do të ikin as në ëndërr. Problem nuk ka kur ato janë në pyetje – por ajo më e mira ka devijuar nga rruga. Kurdo që delja arrin ta lëshojë kopenë, kjo është shenjë se forcë dhe guxim i madh ekziston në të – nuk i frikësohet pyllit, vetmisë, errësirës, bishave të egra, askujt. Është bërë e patrembshme, kurse patrembshmëria është shenja e parë se dikush është gati.

Egoja është hapi i parë deri tek përkushtimi. Unë mirë e di se krejt kjo tingëllon absolutisht paradoksale, dhe ndoshta do të mendoni se jam i marrë, se përvujtnia është ai përbërsi i domosdoshëm, por unë jua përsëris: JO! JO! JO! Egoja është më e nevojshmja, meqë nëse ajo nuk është realizuar në radhë të parë, përvujtnia juaj ka për të qenë vetëm paraqitje e zbrazët, maskë dhe mashtrim. Së pari është e nevojshme egoja e mprehtë si shpatë – ajo ka për të jua dhënë atë qartësinë e domosdoshme të qenies. Vetëm kur kjo kthjelltësi të realizohet, mund ta hidhni – se vetëm kur ta kini, atëherë mohimi ju bie ndër mend! Dhe atëherë lajmërohet përvujtnia, por, jo: ajo është plotësisht tjetërndryshe nga ato përvujtnitë e rrejshme. Kjo më nuk është pëvujtni e një skamnori, lypsari, dobëtaku - veçse vepër e të fuqishmëve, e më të fortëve, e më të mirëve. Atëherë mund të hidhni,

të ndani, të hiqni dorë prej kësaj apo asaj, por kurrë para kësaj shkalle (të pjekurisë).

"Bariu i ka lënë të nëntëdhjetë e nëntë delet, dhe ka zënë ta kërkojë atë njërën, gjithnjë derisa nuk e ka gjetur. "

Mbajeneni në mend këtë: nuk ka nevojë që JU ta kërkoni Zotin – ai vjen vetvetiu. Krejt çka duhet të bëni nga ana juaj është: bëhuni të denjë për vëmendjen e tij. Ka për të ju gjetur, me siguri, qind për qind. Në momentin kur dikush është i kristalizuar, e tërë energjia hyjnore derdhet pingul mbi të. Ajo mund të ju gjejë si Mjeshtër, si guru, mësues – mund të ju ofrohet në nja një milon mënyra. Ju nuk duhet të çani kokë për këtë: se si Hyjnia ka për të ju gjetur. Mos u brengosni. E juaja është që ta dendësoni egon, që të bëheni të vetvetes, dhe posa këtë ta arrini, universalja ka për të ju ndodhur.

"Duke qenë i lodhur, ai i tha deles: Të dua më tepër se gjithë të tjerët. "

Zoti më së tepërmi i do ata që janë bërë rebelues. Priftërinjtë do të bërtasin: "Çfarë marrëzie!"– si Zoti i do më së shumti ata që kanë devijuar nga rruga! Pa kuptim. "Ata në këtë nuk mund të besojnë, por kjo është fakt. Isai është dele e arratisur. Edhe Mahaviri. Edhe Buda. Edhe Muhamedi. Shoqëria lëviz nëpër shtigjet e veta, por gjithë më të mirët janë larguar nga kopeja – posa që këtë e sheh, Perëndia zë kërkimin pas tyre.

Budës përndritja i ka ndodhur nën drurin bodhi. Ka qëndruar ulur si individi përsosmërisht i ndarë, në qetësi të plotë, i devotshëm, të gjitha prangat e shoqërisë, të religjionit e kulturës janë të zgjidhura nën këmbët e tij – ka qenë absolutisht vetëm. Atëherë Zoti i është qasur nga të gjitha drejtimet, nga të gjitha përmasat. Dhe buda vetvetiu është bërë Zot. Në fund ka thënë se kurrfarë Zoti nuk ekziston – se kjo është mënyra e tij "e devijimit nga rruga". Ka folur se nuk beson në Hyjninë, se ajo nuk ekziston, e të tjera e të tjera. Mandej ka folur se nuk ka shoqëri, se nuk ka religjion, se sistemi i kastave është i pakuptimtë – nuk ka Braminë, as Shundra s'ekzistojnë. E ka mohuar tërë sistemin, të tërë strukturën e të menduarit hinduist. "Unë nuk jam hindus", ka thënë Buda, "dhe nuk i takoj asnjë shoqërie. Nuk besoj në teoritë tuaja, dhe gjithnjë derisa nuk e zbuloj të vërtetën, nuk kam për t'i dhënë as pesë para për gjithë tregimet tuaja!"

Ka vazhduar me mohime, me kundërshtime, ndaj dhe ka ardhur momenti kur ka mbetur plotësisht vetëm, plotësisht i izoluar – është shndërruar në ishull të vetmuar të vetëdijes. Para njëzet e pesë shekujve, nën një dru, Zoti është lëshuar me vrull kah ai njeri, kah ajo "dele e humbur", dhe, duke qenë i lodhur, i ka thënë: "Të dua më tepër se gjithë të tjerët. "Të njëjtat fjalë edhe Isai i ka dëgjuar sesi i vinin nga goja hyjnore, e kështu ka qenë përgjithmonë – ky është ligji themelor spiritual: Zoti e kërkon njeriun, e jo njeriu Zotin... Ai vetëm duhet të bëhet, dhe të jetë gati.

Si të jeni gati? Të bëheni të veçantë, revolucionarë të botës së brendshme, ta tejkaloni shoqërinë, të jeni të patrembshëm, t'i këputni prangat, të gjitha marrëdhëniet, ama bash të gjitha! Të jeni vetëm dhe të ekzistoni si qendër e universit! Atëherë Zoti derdhet drejt jush, dhe në atë derdhazë të tijën egoja juaj zhduket, dhe ishulli zhduket në oqean – përnjëherësh më nuk ekzistoni.

Shoqëria duhet të hidhet në radhë të parë - e këtillë është mekanika e brendshme – sepse egoja juaj ekziston vetëm kur është e lidhur me shoqërinë. Nëse vazhdoni ta hidhni shoqërinë, ka për të ardhur momenti kur egoja juaj do të jetë plotësisht vetëm. Por, tash as ajo vetë nuk mund të ekzistojë, sepse shoqëria është ajo që i ndihmon egos të mbijetojë. Themeli i ekzistencës së egos zhduket posa të hidhet shoqëria. Kur "Ti"zhduket, zhduket edhe "Unë". Në atë momentin e fundit zhduket "Un", pasi që "Ti"është hedhur në plotni. Kur nuk je "Ti", "Unë"nuk ekzistoj. Çdo gjë që është jashtë "Un"-it duhet të hidhet – më në fund edhe egoja zhduket. Por, jo: në fillim me mohimin e asaj "Ti", "Un"-i bëhet gjithnjë e më i mprehtë e më i mprehtë, kristalizohet, bëhet i furishëm, i tejmrekullueshëm, i fuqishëm. Dhe atëherë anulohet - me praninë e energjisë hyjnore.

Isanë e kanë kryqëzuar shkaku i thënieve të tij. Ai njerëzit pa ndalim i ka hutuar, gjithmonë i ka nxitur dhe gati i ka shtrënguar të rebelohen - i ka mësuar të "devijojnë nga rruga". Ka folur se Zoti më së shumti i do "delet e humbura"– mëkatarët, rebeluesit, egoistët. Hebrenjtë këtë nuk kanë mundur ta durojnë përjetë - vërtet e ka tepruar. Ky njeri ka qenë dashur të ekskomunikohet - "ka shkuar tepër larg, e edhe pak i duhet që t'i asgjësojë vetë themelet e shoqërisë sonë!"– meqë ka krijuar situatë të tillë të cilën priftërinjtë thjesht nuk kanë mundur ta durojnë, kurse organizata kishtare veçse ka zënë të lëkundej.

Ka qenë kundër turmës me tërë qenien e tij - kurse turmë është krejt kjo afër jush – dhe ajo vërtet nuk ka mundur ta tolerojë, meqë ka qenë e tëra e panikosur nga fjalët e tij. Të gjithë kanë menduar: "Ky i krisur është armik, se i prenë vetë rrënjët e kësaj shoqërie. Si kemi për të jetuar pa turmat?"Por kështu vërtet duhet të jetë: nëse i mëson dhentë të ndahen, ato edhe më tepër do të mbështeten në njëra-tjetrën. Dhe po qe se je këmbëngulës me mësimet e tua, dhentë kanë për t'u hakmarrë, do të të vrasin, se vërtet kë për t'i sfiduar keq.

Ne jetojmë në turmë, jemi pjesë e saj, dhe thjesht nuk dimë të jemi vetëm – gjithmonë na nevojitet "ai tjetri". Shoqërimi nuk është zgjedhje jona, se kjo është domosdoshmëri, se kush jeni ju pa të tjerët. Identiteti në vetmi humbet.

Ky është problemi: nëntëdhjetë e nëtë dele i kanë krijuar nëntëdhjetë e nëntë religjione të rrejshme, gjersa spiritualiteti i vërtetë i ka ndodhur vetëm asaj njërës dele të arratisur.

Jini të guximshëm! Shkoni në egërsi, duke lënë tëra ato çeltina prapa vetes. Vetëm në kushtet natyrore do të mund të rriteni dhe të zhvilloheni. Ndoshta vetmia ka për të ju shkaktuar dhembje, por vuajtja është pjesë përbërëse e pjekurisë. Ndoshta do të përfundoni në kryq, por edhe ajo është rritje – e nëpërmjet kryqëzimit një shoqëri vetëm se ju hakmerret. Kështu duhet të jetë, se kur ajo delja më e mirë të kthehet në kopenë e mjerë, atëherë të gjitha nëntëdhjetë e nëntë delet kanë për të blegërur me një zë të vetëm: "Ky është mëkatari! Kryqëzojeni, mbërthejeni në kryq, ai nuk na përket neve!"

Por kopeja fare nuk mund ta kuptojë – se përse bariu e bartë atë dele të arratisur mbi shpatullat e veta? – pasi që ajo ka humbur dhe përsëri është gjetur.

Kurse Isai thotë se bariu ka për t'u kthyer në shtëpi, dhe ka për t'i ftuar miqtë që me të ta kremtojnë kthimin e deles. Dhe kur mëkatari hyn në parajsë, kremtimi vazhdon – se delja ka humbur dhe përsëri është e gjetur.

Bhagwan Rajneesh – OSHO: Pjesë nga libri - **"Fara Hyjnore"**

2. Shtatë nivelet që ndërtojnë qenien tonë

Psikologjia e ëndrrave

Ne kemi shtatë trupa: ***fizik, eterik, astral, mendor, shpirtëror, kozmik dhe nirvanik.*** Çdo trup ka llojin e vet të ëndrrës. Trupi fizik njihet në psikologjinë perendimore si vetëdije apo i vetëdijshëm, trupi eterik si nënvetëdiije apo i pavetëdijshëm, dhe trupi astral si nënvetëdije kolektive.

-Trupi fizik – trupi i parë -, krijon ëndrrat e veta. Nëse stomaku juaj është i çrregulluar, një lloj i veçant i ëndrrës krijohet. Nëse jeni të sëmurë, me ethe, trupi fizik krijon llojin e vet të ëndrrës. Një gjë është e sigurtë: ëndrra është krijuar nga një sëmundje.

Parehatia fizike, sëmundja fizike, krijon fushën e vet të ëndrrave, kështu një ëndërr fizike mund edhe të stimulohet nga jashtë. Jeni duke fjetur. Nëse një leckë e lagësht ju vendoset rreth këmbëve, ju do të filloni të ëndërroni. Ju mund të ëndërroni se jeni duke kaluar një lum. Nëse një jastëk ju vihet në gjoks, ju filloni të ëndërroni. Ju mund të ëndërroni se dikush është ulur mbi ju, apo një gur ka ra mbi ju. Këto janë ëndrrat që vijnë përmes trupit fizik.

-Trupi eterik - trupi i dytë –, ëndërron në mënyrën e vet. Këto ëndrra eterike kanë krijuar shumë konfuzion në psikologjinë Perëndimore. Frojd i ka keqkuptuar ëndrrat eterike për ëndrrat e shkaktuara nga dëshirat e shtypura. Këto ëndrra janë të shkaktuara nga dëshirat e shtypura, por këto ëndrra i përkasin trupit të parë, trupit fizik. Nëse, për shembull, ju keni agjeruar – atëherë ka gjasë që ju të ëndërroni ushqimin. Apo, nëse ju e keni shtypur dëshirën seksuale, atëherë është çdo mundësi që ju të keni fantazi

seksuale. Por këto ëndrra i përkasin trupit të pare. Trupi eterik është lënë jashtë hetimeve psikologjike.

Trupi eterik mund të udhëtoj në ëndrra. Ekziston çdo mundësi që ky të lë trupin tuaj. Kur kujtohet kjo, ju e kujtoni si ëndërr, por kjo nuk është një ëndërr në të njëjtin kuptim si ëndrrat e trupit fizik. Trupi eterik mund të lergohet nga ju kur ju jeni në gjumë. Trupi juaj fizik do të jetë aty, por trupi juaj eterik mund të del jasht dhe të udhëtojë në hapësirë. Aty nuk ka asnjë hapësirë të kufizuar, nuk bëhet fjalë për asnjë distancë në të. Ata që nuk e kuptojnë këtë, që nuk e njohin trupin eterik, mund ta interpretojnë këtë si një fushë e nënvetëdijes. Ata e ndajnë mendjen e njeriut në të vetëdijshme dhe pavetëdijshme. Mandej ëndërrimi fiziologjik është quajtur "i vetëdijshëm"dhe ëndërrimi eterik është quajtur "i pavetëdijshëm". Kjo nuk është e pavetëdijshme, kjo është po aq e vetëdijshme sa edhe ëndërrimi fiziologjik, por e vetëdijshme në një tjetër nivel. Nëse ju jeni të vetëdijshëm trupit tuaj eterik, ëndërrimi shqetësues në këtë fushë bëhet i vetëdijshëm.

Njëjtë siç krijohen ëndrrat fiziologjike nga jashtë, kështu edhe ëndrrat eterike mund të krijohen duke u stimuluar. Mantra është një nga metodat për të krijuar vizione eterike. Një mantra e veçant apo një zbrazësi e veçant – një fjalë e veçant, zëshëm që përsëritet në qendrën eterike – mund të krijojë ëndrra eterike. Ka aq shumë metoda. Zëri apo tingulli është një prej tyre.

Sufitë e kanë përdorur parfumin për të krijuar vizione eterike. Vetë Muhamedi ishte shumë i dhënë pas parfumit. Një parfum i veçantë mund të krijojë një ëndërr të veçantë.

Ngjyrat gjithashtu mund të ndihmojnë. Leadbeater (këngëtar amerikan i bluzit dhe folkut. prano shpjegimin e përkthyesit) njëherë kishte pasur një ëndërr eterike të kaltërsisë – vetëm kaltërsi, por me një hije të veçant. Ai filloi të kërkojë atë kaltërsi të veçant nëpër të gjitha shitoret e botës. Pas disa vitesh kërkimi, ai më në fund e kishte gjetur një të tillë në një shitore në Itali - një kadife e asaj hije të veçant. Mandej këtë ngjyrë kadifeje ai kishte përdorur për të krijuara endrra të tjera të bukura eterike.

Pra, kur dikush shkon thellë në meditim dhe sheh ngjyra, përvojat e parfumeve, tingujëve, muzikës apsolutisht të panjohura, këto gjithashtu janë ëndrra, ëndrra të trupit eterik. Të ashtuquajturat vizionet shpirtërore i përkasin trupit eterik, ato janë ëndrra eterike. Zbulimi i vetë Guru-ve para nxënësve të tyre nuk është asgjë tjetër përpos një udhëtim eterik, ëndërrimi eterik. Por për shkak se ne e kemi kërkuar mendjen në një nivel të ekzistencës, fiziologjike, këto ëndrra përndryshe kanë qenë të interpretuar në gjuhën fiziologjike ose janë hedhur, janë lënë pas dore.

Apo, është vendosur në nënvetëdije. Duke thënë se çdo gjë është pjesë e nënvetëdijes, në të vërtetë ne vetëm kemi pranuar se nuk dimë asgjë për

të. Ky është vetëm një formalitet, një truk. Asgjë nuk është e pavetëdijshme, por çdo gjë që është e vetëdijshme në një nivel më të thellë është e pavetëdijshme në nivelin e mëparshëm, Kështu pra për trupin fizik, trupi eterik është i pavetëdijshëm, për trupin eterik trupi astral është i pavetëdijshëm, për trupin astral trupi mendor është i pavetëdijshëm. I vetëdijshëm do të thotë të jesh i njohur me të njohurën. E pavetëdijshma do të thotë ajo që akoma nuk njihet, e panjohura.

- Trupi astral – trupi i tretë -, aty janë edhe ëndrrat astrale. Në ëndërrimin astral ju shkoni në lindjen e juaj të mëparshme. Ky është dimensioni i tretë i ëndërrimit tuaj, Nganjëherë në ëndrrën e zakonshme, pjesa eterike apo pjesa astrale mund të jenë prezent. Atëherë ëndrra bëhet kaotike, një rrëmujë; dhe nuk mund ta kuptoni këtë, sepse shtatë trupat tuaj ekzistojnë në të njëjtën kohë, diçka nga një fushë mund të kalojë në fushën tjetër, mund të depërtojë nëpër të. Kështu që, nganjëherë, edhe në ëndrrat e zakonshme, ka fragmente nga pjesët eterike apo astrale.

Në trupin e parë, atë fizik, ju nuk mund të udhëtoni as në kohë e as në hapësirë. Ju jeni të mbyllur në gjendjen fizike dhe atë në kohë të veçant siç është – themi ora dhjetë e natës. Trupi juaj fizik mund të ëndërrojë në këtë kohë dhe hapësirë të veçant, por jo përtej kësaj. Në trupin eterik ju mund të udhëtoni në hapësirë por jo në kohë. Ju mund të shkoni kudo, por koha është ende 10:00 e natës. Në fushën astrale, në trupin e tretë, ju mund të udhëtoni jo vetëm në hapësirë por gjithashtu edhe në kohë. Trupi astral mund ta kapërcej barierën e kohës – por vetëm nga e kaluara, jo nga e ardhmja. Mendja astrale mund të shkojë nëpër të gjitha seritë të pafundme të së kaluarës, prej amebës tek njeriu.

Në psikologjinë e Jungut, mendja astrale është quajtur nënvetëdije kolektive. Ajo është historia juaj individuale e lindjeve. Ndonjëherë ajo depërton në ëndrrat e zakonshme, por më shpesh në gjendjet patologjike sesa në ato të shëndetshme. Tek një person që është mendërisht i sëmurë, tre trupat e pare zakonisht humbin veçorit e tyre njëri nga tjetri. Një person që është i sëmurë mendërisht mund të ëndërrojë lindjet e tij të mëparshme, por askush nuk do të besojë atë. Ai vetë nuk do të besojnë atë. Ai do të thonë se kjo është vetëm një ëndërr.

Kjo nuk është e ëndërruar në planin fizik. Ky është ëndërrim astral. E ëndërrimi astral ka shumë më shumë kuptime, më shumë domethënje. Por, trupi i tretë mund të ëndërrojë vetëm për të kaluarën, e jo për atë se çfarë domethënë me qenë.

-Trupi mendor – trupi i katërt -, është mendor. Ai mund të udhëtojë në të kaluarën dhe në të ardhmen. Në një urgjencë akute, nganjëherë edhe një person i zakonshëm mund të ketë një paraqitje të shkurtër të së ardhmes. Nëse dikush i afërt dhe i dashur për ju është duke vdekur, porosia mund të ju shpërndahet edhe në ëndërr të zakonshme, sepse ju

nuk dini asnjë dimension tjetër të ëndërrimit, sepse ju nuk i dini mundësitë tjera, porosia do të depërtojë tek ju në ëndrrën e zakonshme.

Por ëndrra nuk do të jetë e qartë për shkak të pengesave që ka për të kaluar para se porosia të mund të bëhet pjesë e gjendjes së ëndrrës suaj të zakonshme. Çdo pengesë eliminon diçka, transformon diçka. Çdo trup ka simbolikën e vetë vetjake, kështu që sa herë një ëndërr kalon nga një trup në tjetrin ai është i përkthyer në simbolikën e atij trupi. Pastaj, çdo gjë bëhet konfuze.

Nëse keni ëndërr në trupin e katërt, në një mënyë të prerë dhe të qartë – jo përmes ndonjë trupi tjetër por përmes vetë trupit të katërt – pastaj ju mund të depërtoni në të ardhmen, por vetëm në të ardhmen tuaj. Kjo ende është individuale, ju nuk mund të depërtoni në të ardhmen e një personi tjetër.

Për trupin e katërt, a kalura është shumë më e pranishme sesa e ardhmja që është prezente. E kaluara e ardhmja dhe e tashmja bëhen një. Çdo gjë bëhet në të tashmen, e tashmja që hynë në të kaluarën, e tashmja që hynë në atë ardhmen. Aty nuk ka të kalur dhe të ardhme, por, koha ende është prezente. Koha. madje edhe si "e tashme", ende është një rrjedhë e kohës. Ju ende duhet ta fokusoni mendjen tuaj. Ju mund të shikoni nga e kaluara, por ju prapë duhet ta fokusoni mendjen tuaj në atë drejtim. Atëherë e ardhmja dhe e kalura do të mbahen në pritje. Kur ju fokusoheni drejt së ardhmes – dy të tjerat – e kaluara dhe e tashmja – do të mungojnë, nuk do të jenë të pranishme. Ju do të jeni në gjendje të shihni të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, por jo sikur një. Dhe ju do të jeni në gjendje të shihni vetëm ëndrrat tuaja individuale, ëndrrat që ju përkasin juve si individ.

-Trupi shpirtëror - trupi i pestë-, është shpirtëror, e kalon fushën e individualitetit dhe fushën e kohës. Tani ju jeni në përjetësi. Ëndërrimi nuk ka të bëj me ju si të tillë, por me tërë vetëdijen. Tani ju e dini të kaluarën e gjithë ekzistencës, por jo të ardhmen.

Përmes këtij trupi të pestë, të gjitha mitet e krijimit janë zhvilluar. Të gjitha ato janë të njëjta. ndryshojnë simbolet, ndryshojnë pak tregimet, por qoftë ato krishtere apo indiane apo hebraike apo egjiptase janë mitet e krijimit – se si u krijua bota, se si ajo erdhi në ekzistencë – të gjitha janë paralele; ato të gjitha kanë një rrymë nënujore të ngjajshmërisë. Për shembull, tregimet e ngjashme mbi përmbytjen e madhe ekzistojnë në gjithë botën. Nuk ka dokument historik për këtë, por, megjithatë, është një dokument. Ai dokument i takon mendjes së pestë, trupit shpirtëror. Mendja e pestë mund të ëndërrojë mbi ato.

Sa më shumë që depërtoni brenda, ëndrra vjen afër e më afër realitetit. Ëndërrimi fiziologjik nuk është aq real. Ai ka realitetin e vet, por kjo nuk është aq reale. Ëndrra eterike është shumë më reale, ajo astrale është edhe më reale, ëndrra mendore i afrohet reales dhe në fund, në trupin e pestë, ju

bëheni realist autentik në ëndërrimin tuaj. Kjo është mënyra për ta njohur realitetin. Të quhet kjo ëndërrim nuk është adekuat. Por, në njëfarë mënyre ky është ëndërrim, sepse realiteti objektivisht nuk është present. Kjo e ka objektivitetin e vet, por ajo vjen si një përvojë subjektive.

Dy persona të cilët e kanë realizuar trupin e pestë mund të ëndërrojnë të njëjtën kohë, që nuk është e mundur më heret. Zakonisht nuk ka gjasë të ëndërrohet një ëndërr e përbashkët, por prej trupit të pestë e tutje, një ëndërr mund të ëndërrohet në të njëjtën kohë nga shumë persona. Kjo është arsyeja pse ëndrrat janë objektive në një mënyrë. Ne mund të krahasojmë shënimet. Kjo është se si kaq shumë persona, duke ëndërruar në trupin e pestë, kanë arritë të njohin të njëjtat mite. Këto mite nuk janë krijuar prej një individi të vetëm. Ato janë krijuar nga shkolla të veçanta, traditat të veçanta që punojnë së bashku.

Kështu që lloji i pestë i ëndërrimit bëhet shumë më real. Në njëfarë kuptimi katër llojet e mëparshme të ëndërrimit janë joreale sepse ato janë individuale. Nuk ka asnjë mundësi që një person tjetër të ndaj përvojën; nuk ka asnjë mënyrë për të gjykuar vlefshmërinë e saj – se a është ajo fantazi apo jo. Fantazia është diçka që ju e keni projektuar; ëndrra është diçka që nuk është në ekzistencë si e tillë, por që ju keni arritur ta njihni. Duke shkuar nga brenda, ëndërrimi bëhet më pak imagjinar, më pak fantazi – më shumë objektiv, më shumë real dhe më shumë autentik.

Të gjitha konceptet teologjike janë krijuar nga trupi pestë. Ata ndryshojnë për nga gjuhën e tyre, terminologjia e tyre, konceptualizimi i tyre, por ato në thelb janë të njëjta. Ato janë ëndrrat e trupit të pestë.

- Trupi kozmik – trupi i gjashtë -, ju e kaloni pragun e vetëdijes - nënvetëdijes, materies - mendjes. Ju i humbni të gjitha format, karakteristikat. Trupi i gjashtë ëndërron mbi kozmosin. Ju e kaloni pragun e vetëdijes dhe bota e nënvetëdijes gjithashtu bëhet e vetëdijshme. Tani çdo gjë është e gjallë dhe e vetëdijshme, madje edhe ajo që ne e quajm materie është pjesë e vetëdijes.

Në trupin e gjashtë, ëndrrat e miteve kozmike janë realizuar. Ju keni kapërcyer individualitetin, ju keni kapërcyer të vetëdijshmën, ju keni kapërcyer kohën dhe hapësirën, por gjuha është ende e mundur. Ajo shkon në drejtim të diçkahit; ajo tregon diçka. Teoritë e Brahmës, maja, teoritë e unitetit të infinitit, të gjitha kanë qenë të realizuara në llojin e gjashtë të ëndërrimit. Ata që kanë ëndërruar në dimesionin kozmik, kanë qenë krijues të sistemeve të mëdha, religjioneve të mëdha.

Përmes llojit të gjashtë të mendjes, ëndrrat janë në aspektin apo shprehjen e qenies, e jo në aspektin e jo-qenies. Aty është endje një kapje me ekzistencën, dhe një frikë nga mos-ekzistenca. Materia dhe mendja janë bërë një, por jo edhe ekzistenca dhe jo ekzistenca, qenia dhe jo-qenia. Ato ende janë të ndara. Kjo është pengesa e fundit.

-Trupi nirvanik - trupi i shtatë -, kalon kufirin e pozitives dhe hedhet në hiçësi (mosqenie). Kjo i ka ëndrrat e veta: ëndrrat e jo-ekzistencës, ëndrrat e hiçësisë, ëndrrat e jo-qenies, ëndrrate zbrazëtisë. "Po"është lënë mbrapa, madje edhe "Jo"nuk është më jo; zbrazëtia apo hiçësia më nuk është hiç. Më sakt, hiçësia është edhe më shumë se infiniti. Pozitivja duhet të ketë kufi, ajo nuk mund të jetë infinit(e pafund). Vetëm negativja është infinit.

Pra, trupi i shtatë i ka ëndrrat e veta. Tani aty nuk ka simbole, nuk ka formë. Vetëm paforma është. Tani aty nuk ka zë, pazëshëm është. Aty është qetësi absolute. Këto ëndrra mbi qetësinë janë totale, të pa-infinit.

Këta janë shtatë trupat. Secili prej tyre ka ëndrrat e veta. Por, këto shtatë dimensioned e ëndrrave mund të bëhen pengesë të njohjes së shtatë llojeve të realiteteve.

***

Trupi juaj fiziologjik ka vetëm një mënyrë për të njohur realitetin dhe vetëm një mënyrë për të ëndërruar mbi të. Kur ju hani, ky është një realitet, por kur ju ëndërroni se po hani, ky nuk është realitet. Ëndrra është një zëvendësim për ushqimin e vërtetë. Pra, trupi fiziologjik ka realitetin e vet dhe mënyrën e vet të ëndërrimit. Këto janë dy mënyra të ndryshme në të cilat funksionon trupi fiziologjik, dhe ato janë shumë larg njëra nga tjetra. Ngjajshëm me vijat e vizatuara nga periferia drejt qendrës të një rrethi që afrohen dhe ashtu e kalojnë qendrën, dhe tutje vazhdojnë drejt periferisë, në të njëjtën mënyrë edhe ëndrra dhe realiteti afrohen shumë e më shumë, sa ju të shkoni drejtë qendrës suaj dhe ato bëhen të largëta e më të largëta sa më shumë që ju shkoni drejtë periferisë. Kështu që po aq sa është trupi fiziologjik i shqetësuar, ënëdrrimi dhe realiteti bëhen më të largët. Distanca mes tyre është e madhe. Ëndrrat bëhen vetëm fantazi.

Kjo ndarësi nuk do të jetë aq e madhe në trupin eterik. Realiteti dhe ëndrra do të jenë më afër, por, për të njohur se çfarë është realitet dhe çfarë është ëndërr do të jetë shumë më e vështirë sesa në trupin fiziologjik. Por prapë, dallimet mund të mësohen. Nëse udhëtimi juaj eterik ka qenë udhëtim real, kjo do të ndodhë derisa ju jeni të zgjuar. Nëse kjo ka qenë një ëndërr kjo do të ndodhë kur ju jeni në gjumë. Për të ditur dallimin, ju do të duhet të jenë të zgjuar në trupin eterik.

Ka metoda për të qenë të vetëdijshëm në trupin tuaj eterik. Të gjitha metodat e punës së brendshme siç është japa – përsëritja e një mantre – ju shkëput nga bota e jashtme. Nëse bini në gjumë, përsëritja konstante mund të krijojë një gjumë të hipnotizuar. Pastaj, ju do të ëndërroni. Por, nëse nuk mund t'i qëndroni të vetëdijshëm jap-ës suaj dhe kjo nuk mund të krijojë një efekt hipnotik brenda jush, atëherë ju do të njihni realitetin derisa trupi eterik të jetë i shqetësuar.

Në trupin e tretë, astral, ajo është edhe më e vështirë për t'u dalluar sepse dy trupa afrohen edhe më afër. Nëse keni njohur trupin real astral e

jo vetëm ëndërrimin astral, atëherë ju do të shkoni përtej frikës nga vdekja. Nga këtu, mëson pavdeksin e dikujt. Por, nëse astrali është një ëndërr e jo realitet, atëherë ju do të gjymtoheni nga frika prej vdekjes. Kjo është pika e dallimit, gur prove e frikës nga vdekja.

Një person i cili beson se shpirti është i pavdekshëm dhe vazhdon të përsëritë e të përsëritë këtë, duke bindur vetën, nuk do të jetë në gjendje të dinë dallimin midis asaj që është e vërtetë në trup astral dhe çfarë është një ëndërr astrale. Njeriu nuk duhet të besojë në pavdekësi, ai duhet të dini këtë. Por, para se ta mësojë këtë, ai duket të ketë dyshime, pasiguri në lidhje me këtë. Vetëm atëherë ju do të dini se a e dini me të vërtetë, apo mos ndoshta vetëm keni projektuar atë. Nëse ky është besimi juaj se shpirti është i pavdekshëm, besimi mund ta përshkojë mendjen tuaj astrale. Pastaj ju do të filloni të ëndërroni, por kjo do të jetë vetëm një ëndërr. Por, nëse ju nuk keni besim, vetëm një etje për të ditur – për të gjurmuar – pa ditur se çfarë ka për të gjurmuar apo kërkuar, pa e ditur se çfarë mund të gjendet, pa asnjë prejudikim ose paragjykim – nëse ju gjurmoni vetëm në një vakum, atëherë ju do ta mësoni dallimin. Kështu që njerëzit që besojnë në pavdeksinë e shpirtit, në jetën e kaluar, ata që këtë e pranojnë si besim, vetëm mund të ëndërrojnë në planin astral dhe të mos e njohin realitetin.

Në trupin e katërt, mendor, ëndrra dhe realiteti bëhen fqinjë. Fytyrat e tyre janë aq të ngjashme sa që ekziston mundësia që njëri të gjykohet se është tjetri. Trupi mendor mund të ketë ëndrra që janë aq realiste sa edhe reale. dhe ka disa metoda për të krijuar ëndrra të tilla – jogiste, tantriste dhe metoda tjera. Një person që praktikon agjërimin, vetminë, errësirën, do të krijojë llojin e katërt të ëndrrave, ëndrra mendore. Ato do të jenë aq reale, shumë më reale sesa realiteti që na rrethon.

Në trupin e katërt, mendja është plotësisht kreative, e papenguar nga asnjë objekt, e papenguar nga kufijtë material. Tani ajo është plotësisht e lirë për të krijuar. Poetë, pikëtor, të gjithë jetojnë në llojin e katërt të ëndërrimit, i gjithë arti është krijuar nga lloji i katërt i ëndërrimit. Një person i cili mund të ëndërrojë në sferën e katërt mund të bëhet një artist i madh. Por ai nuk e di këtë.

Në trupin e katërt, njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për çdo lloj të krijimit mendor. Ai nuk duhet të projektojë diçka. Ai nuk duhet të dëshirojë diçka; përndryshe aty ka mundësi që çdo dëshirë të jetë e plotësuar. Jo vetëm për Brenda, por edhe nga jashtë dëshira mund të jetë e plotësuar. Në trupin e katërt mendja është aq e fuqishme, aq kristalisht e qartë, sepse trupi i katërt për mendjen është shtëpia e fundit. Përtej kësaj, jo-mendja fillon.

Trupi i katërt është burim origjinal i mendjes, kështu që ju mund të krijoni çdo gjë. Një gjëje ju vazhdimisht duhet të jeni të vetëdijshëm se aty nuk ka dëshira, nuk ka imagjinatë, nuk ka imazhe, nuk ka Zot, nuk ka guru. Përndryshe, të gjitha këto duhet ditur se janë krijuar nga ju. Ju do të

jeni creator, Kjo është aq e hareshme për të pare ata që dëshirojnë aq shumë për t'i krijuar ato. Kjo është pengesa e fundit e "sadhaka"– gjurmuesit, Nëse ju jeni të vetëdijshëm, nëse ju jeni vetëm një dëshmitar në trupin e katërt, atëherë ju e mësoni realitetin, Përndryshe, ju vazhdoni me ëndërrimin. Dhe nuk ka realitet që krahasohet më këto ëndrra. Ato do të jenë ekstatike, dhe nuk ka ekstazë krahasuese. Kështu që njeriu duhet të jetë i vetëdjshëm ekstazisë, lumturisë, hareshmës, dhe ai duhet të jetë vazhdimisht i vetëdijshëm për çdo lloj imazhi. Në momentin kur një imazh, mendja e katërt fillon të rrjedhë në një ëndërr. Një imazh të çon tek tjetri, dhe ju shkoni në ëndërrim.

Lloji i katërt i ëndërrimit mund të parandalohet vetëm në qoftë se ju jeni një dëshmitar. Dëshmitari bën dallimin, sepse nëse ëndërrimi është aty ju do të identifikoheni me të. Identifikimi është ëndërrimi derisa trupi i katërt është i shqetësuar. Në trupin e katërt, vetëdija dhe mendja dëshmuese janë rrugë drejtë reales.

Në trupin e pestë ëndrra dhe realiteti bëhen një. Çdo lloj dualiteti është i larguar. Këtu tani nuk bëhet fjalë për asnjë lloj vetëdijeje. Madje edhe nëse ju jeni të vetëdijshëm, ju do të jeni të vetëdijshëm vetëdijes suaj. Tani ëndërrimi bëhet vetëm një reflektim i realitetit. Ka një dallim por jo ndryshim. Nëse unë e shoh veten time në pasqyrë, nuk ka dallim mes meje dhe reflektimit, por është një ndryshim, unë jam real dhe reflektimi nuk është real.

Mendjen e pestë, nëse ajo ka kultivuar konceptin e ndryshimit, mund të ketë iluzionin e njohjes së vetes së saj sepse ajo e ka parë reflektimin e vetes në pasqyrë. Kjo do të jetë njohje e vetes, por jo ashtu siç është, por vetëm si reflektim. Ky është i vetmi ndryshim. Por në një mënyrë, kjo është e rrezikshme. Rreziku është se ju mund të jeni të kënaqur me reflektimin, dhe imazhi i reflektuar në pasqyrë do të merret si real.

Sa i përketë vetë trupit të pestë ai mund të jetë i shqetësuar, nuk ka asnjë rrezik nëse kjo ndodhë, por do të jetë rrezik nëse trupi i gjashtë është i shqetësuar. Nëse ju veten tuaj e keni pare vetëm në pasqyrë, atëherë nuk mund ta kaloni kufirin e të pestës dhe të dilni në të gjashtën. Nuk mund ta kaloni asnjë kufi nëpër pasqyrë. Kështu që ka pasë persona që kanë mbetur në mendjen e pestë. Ata që thonë se ka shpirta pa kufijë dhe se çdo shpirt ka individualitetin e vet – këta persona kanë mbetur në mendjen e pestë. Ata kanë njohur veten e tyre, por jo në mënyrë imediate, jo në mënyë direkte - por vetëm përmes pasqyrës.

Ku të çon kjo pasqyrë e ardhur nga? Ajo vjen përmes kultivimit të konceptit: "Unë jam shpirti. I amshuar, i pavdekshëm. Përtej vdekjes, përtej lindjes. "Ta konceptosh veten si shpirt pa e ditur, kjo është krijim i një pasqyre. Atëherë ju nuk do ta njihni veten me të vërtetë se kush jeni, por vetëm pasqyrimin e vetes suaj përmes konceptit tuaj. I vetmi ndryshim do të jetë ky: nëse njohja vjen përmes pasqyrës ajo është një ëndërr dhe

nëse është direkte, imediate, pa asnjë pasqyrë, atëherë ajo është reale. Ky është i vetmi ndryshim, por ky është ndryshim i madh – jo në raport me trupat që ju i keni kaluar, por në relacion me trupat që presin të përshkohen.

Si mund të jetë dikush i vetëdijshëm se a ëndërron në të shtatën apo përjeton realitetin? Ka vetëm një mënyrë, të largohet çdo shkrim i shenjët, të braktiset çdo lloj i filozofisë. Tani më nuk duhet të ketë më guru, përndryshe guru mund të bëhet pasqyrë. Nga këtu e tutje, ju jeni krejtësisht të vetëm. Askush nuk mund të merret si udhëzues apo udhërrëfyes sepse bëhet pasqyrë.

Nga tani e tutje, vetmitaria është totale dhe e plotë. Jo vetmia por vetmitaria. Vetmia gjithmonë ka të bëj me të tjerët; vetmitaria ka të bëj me vetveten. Unë ndihem i vetmuar kur nuk ka asnjë lidhje mes meje dhe të tjerët, por ndihem i vetëm kur Unë jam.

Tani personi duhet të jetë i vetëm në çdo aspekt: fjalë, koncepte, toeria, filozofi, doktrina, guruve, shkrimeve të shenjëta; krishtrimit, hinduizmit, Buda, Krishti, Krishna, Mahaviri…Njeriu duhet të jetë i vetëm tani, përndryshe çdo gjë që është prezente do të bëhet një pasqyrë. Buda do të bëhet një pasqyrë tani. Shumë i dashur, por shumë i rrezikshëm.

Nëse jeni absolutisht vetëm, nuk ka asgjë në të cilën ju do të mund të reflektoheni. Pra, meditimi është fjalë për trupin e pestë. Kjo do të thotë me qenë plotësisht vetëm, i lirë nga çdo lloj procesi i të menduarit. Kjo do të thotë me qenë pa mendje. Nëse aty është çfarëdo lloji i mendjes ajo do të bëhet një pasqyrë dhe ju do të reflektoheni në atë. Njeriu tani duhet të jetë një jo-mendje, pa procesin e të menduarit, pa shqyrtime.

Në trupin e gjashtë nuk ka pasqyrë. Tani vetëm universi është. Ju keni qenë të humbur. Ju më nuk jeni, ëndërrimtari nuk është më. Por ëndrra akoma mund të ekzistojë pa ëndërrimtarin. E kur atje është një ëndërr pa ëndërrimtarin, ajo duket si realitet autentik. Aty s'ka mendje, asnjë njeri për të menduar, kështu që]farëdo që është njohur – është njohur. Kjo bëhet njohja juaj. Mitet e krijimit vijnë, ato rrjedhin, ju nuk jeni, gjërat vetëm rrjedhin. Nuk ka askush aty për të gjykuar; askush nuk është aty për të ëndërruar.

Por një mendje që nuk është, akoma ekziston. Një mendje që është asgjësuar akoma jeton – jo si e veçant, por si një tërësi kozmike. Ju nuk jeni, por Brahma është. Kjo është arsyeja pse ata thonë se e tërë bota është një ëndërr e Brahmës. E tërë kjo botë është një ëndërr, maya. Jo një ëndërr e çdo individi, por një ëndërr e totales, e tërësisë. Ju jo, por e gjithë tërësia ëndërron.

Tani i vetmi ndryshim është nëse endrra është positive. Nëse ajo është positive, ajo është iluzore, ajo është një ëndërr, sepse në njëfarë kuptimi përfundimtar vetëm negativja ekziston. Kur çdo gjë bëhet pjesë e pa-formës, kur çdo gjë është kthyer mbrapa në burimin original, atëherë çdo

gjë është dhe në të njëjtën kohë nuk është. Pozitivja është i vetmi faktor i mbetur. Ajo duhet të jetë a kapërcyer.

Kështu që nëse, në trupin e gjashtë, pozitivja është humbur, ju depërtoni në trupin e shtatë. Realja e trupit të gjashtë është derë për në trupin e shtatë. Nëse aty nuk ka asgjë positive – s'ka mit, s'ka imazh – atëherë ëndrra ka pushuar. Atëherë aty është vetëm ajo çfarë është: tillësi. Tani asgjë nuk ekziston përpos ekzistencës. Gjërat nuk janë, por burimi është. Pema nuk është, por fara është.

Ata që kanë arritur ta njohin këtë e kanë quajtur 'samad'hi' mendje me fare ose 'sabixh'. Çdo gjë ka qenë e humbur; çdo gjë është kthyer në burimin origjinal, farën kozmik. Pema nuk është, por fara është. Por nga burimi, ëndërrimi akoma është i mundur, kështu që edhe fara duhet të jetë e shkatërruar.

Në trupin e shtatë, nuk ka as ëndërr e as realitet. Ju mund të shihni vetëm diçka reale mbi pikën ku ëndërrimi është i mundur. Nëse aty nuk ka mundësi të shfaqen ëndrrat, atëherë as realj ae as iluzionet nuk ekzistojnë. Kështu që në qendrën e trupit të shtatë. Tani, ëndrra dhe realiteti janë bërë një. Nuk ka ndryshime. Ose keni ëndrrën e hiçësisë ose ju e dini hiçësinë, por hiçësia mbetet e njëjtë.

Nëse ju ëndërroj juve, ky është një iluzion. Nëse ju shoh unë juve, ky është realitet. Por nëse unë ju ëndërroj në mungesën tuaj apo ju shoh në mungesën tuaj, nuk ka asnjë ndryshim. Nëse ju ëndërroni në munges të çdo gjëje, ëndrra do të jetë e njëjtë si vetë mungesa. Vetëm në aspektin e diçkaje positive është një ndryshim real. Pra, mbi trupin e gjashtë është një ndryshim. Në trupin e shtatë mbetet vetëm hiçësia. Aty është një mungesë edhe e farës. Kjo është 'nirbixh samad'hi' samad'hi pa farë. Tani nuk ka asnjë mundësi ëndërrimi.

Pra, ka shtatë lloje të ëndrrave dhe shtatë lloje të realiteteve. Ato depërtojnë njëra në tjetrën. Për shkak të kësaj, ka kaq shumë konfuzion. Por nëse ju bëni një dallim në mes të states, nëse ju jeni të qartë në lidhje me këtë, kjo do të ndihmojë shumë. Psikologjia ende është shumë larg nga njohuria mbi ëndrrat. Atë çfarë di ajo ka të bëj me ëndërrimin fiziologjik, nganjëherë edhe atë eterik. Por edhe ato eterike gjithashtu interpretohen si ato fiziologjike.

Jung ka depërtuar pak më thellë se Frojdi, por analiza e tij e mendjes njerëzore trajtohet si mitologjike, religjioze, Megjithatë, ai ka farën. Nëse psikologjia perëndimoare do të zhvillohet, kjo do të bëhet përmes Jungut e jo Frojdit. Frojdi ka qenë një pioner, por çdo pioner bëhet një pengesë për përparimin e tutjeshëm nëse dashuria për favorizimin e tij bëhet një obsesion. Edhe pse Frojdi tani është dal nga moda, psikologët perëndimor ende janë të preokupuar me fillimet e tij Frojdiane. Frojdi duhet të bëhet pjesë e historisë tani. Psikologjia duhet të vazhdojë edhe më tej.

Në Amerikë, ata janë duke u përpjekur për të mësuar rreth ëndërrimit përmes metodave laboratorike. Ka shumë laboratore ëndrrash, por metodat e përdorura kanë lidhje vetëm me fiziologjinë. Joga, Tantra dhe trajnimet e tjera ezoterike duhet të mësohen nëse duam të njohim tërë botën e ëndrrave. Çdo lloj i ëndrrës ka llojin paralel të realitetit dhe nëse e tërë 'MAYA' nuk mund të jetë e njohur, nëse e tërë bota e iluzioneve nuk mund të jetë e njohur, atëherë është e pamunudr të njihet realja.

Por, mos e merrni atë që kam thenë si një teori, një sistem. Bëjeni atë vetëm si një pikë fillestare, dhe filloni të ëndërroni me një mendje të vetëdijshme. vetëm kur të bëheni të vetëdijshëm në ëndërrat tuaja realja mund të njihet.

Ne nuk jemi të vetëdijshëm madje as për trupin tonë fizik, Ne mbesim në pavetëdijen e tij. Vetëm kur një pjesë është e sëmurë ne bëhemi të vetëdijshëm. Njeriu duhet të bëhet i vetëdijshëm në trupin e shëndetshëm. Të bëhet i vetëdijshëm në trupin e sëmurë është vetëm një masë emergjente. Ky është një proces i ndërtuar natyror. Mendja juaj duhet të jetë e vetëdijshme kur një pjesë e trupit është e sëmurë për të qenë në gjendje të kujdeseni, por në momentin kur çdo gjë bëhet mirë ju përsëri bëheni të përgjumër në lidhje me të.

Ju duhet të bëheni të vetëdijshëm për vetë trupin tuaj: për funksionimin e tij, për ndjesitë e tij delikate, muzikën e tij, qetësinë e tij. Nganjëherë trupi është i heshtur; nganjëherë është i zhurmshëm; nganjëherë i relaksuar. Ndjenja është aq e ndryshme në çdo gjendje që është për keqardhje pse ne nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Kur ju shkoni për të fjetur, janë do ndryshime delikate. Kur zgjoheni nga gjumi në mëngjes, prapë janë do ndryshime. Njeriu duhet të bëhet i vetëdijshëm për këto. Kur i çelni sytë në mëngjes, ju nuk i hapni ato përnjëherë. Kur jeni bërë të vetëdijshëm se gjumi ka përfunudar, jeni bërë të vetëdijshëm trupit tuaj. Mos i hapni sytë akoma. Çfarë po ndodh? Një ndryshim i madh po zë vend brenda. Gjumi po ju le dhe zgjimi po vjen. Ju keni për ta parë lindjen e diellit në mëngjes, por kurrë lindjen e trupit tuaj. Ai e ka bukurinë e vet. Ai është në mëngjes dhe në mbrëmje në trupin tuaj. Ai quhet 'sandhya'momenti i transformimit, momenti i ndryshimit.

Kur shkoni për të fjetur, në heshtje shikoni se çfarë po ndodhë. Gjumi do të vijë, do të jetë duke ardhur. Jini të vetëdijshëm! Vetëm atëherë mund të bëheni me të vërtetë i vetëdijshëm trupit tuaj fizik. Dhe në momentin kur ju të bëheni të vetëdijshëm për këtë, ju do të dini se çfarë është ëndërrimi fiziologjik. Pastaj në mëngjes do të jetë në gjendje të mbani mend se çfarë ishte një ëndërr fiziologjike dhe çfarë nuk ishte. Nëse ju i njihni ndjenjat e brendshme, kërkesat e brendshme, ritmet e brendshme të trupit tuaj, pastaj kur këto të reflektohen në ëndrrat tuaja ju do të jeni në gjendje të kuptoni gjuhën.

Ne nuk e kemi kuptuar gjuhën e trupave tonë. Trupi e ka urtësinë e vet personale, ai ka mijëra e mijëra vjet experience. Trupi im ka përvojën e babit dhe nënës sime, e ata përvojën e babait dhe nënës së tyre e keshtu me radhë, shekuj me shekuj gjatë të cilave fara e trupin tim nuk është zhvilluar në atë që sot është. Ai ka gjuhën e vet. Njeriu së pari duhet të kuptojë këtë. Kur e kuptoni këtë, ju do ta dini se çfarë është ëndrra fiziologjike. Dhe pasataj, në mëngjes ju mund t'i ndani ëndrrat fiziologjike nga ëndrrat jo-fiziologjike.

Vetëm atëherë është një mundësi e re për ngritje: të jeni vetëdijshëm trupit tuja eterik. Vetëm atëherë, jo më heret. Ju bëheni më delikat. Ju mund të përjetoni nivele më delikate të tingujëve, parfumeve, dritave. Pastaj, kur të ecni, ju do të dini se trupi fiziologjik është duke ecur; trupi eterik nuk është duke ecur. Dallimi është kristal i qartë. Ju jeni duke ngrënë. Trupi fiziologjik është duke ngrënë, jo trupi eterik. Ka etje eterike, uri eterike, dëshira eterike, por këto gjëra mund të shihen vetëm kur të njihet plotësisht trupi fiziologjik. Pastaj, një nga një, trupat e tjerë do të bëhen të njohur.

Ëndërrimi është një nga subjektet më të mëdha. Ajo është ende e pazbuluara, e panjohur, e fshehur. Kjo është pjesë e njohurisë sekrete. Por tani ka ardhur momenti kur çdo gjë që është e fshehtë duhet të jetë e zbuluar dhe nuk guxon më të mbahet e fshehur sepse ajo mund të dëshmohet si e rrezikshme.

Në të kaluarën ishte e domosdoshme që disa gjëra të mbeten sekret, sepse dituria në duart e injorantit mund të jetë e rrezikshme. Kjo është ai që po ndodhë me diturinë shkencore në Perëndim. Tani shkencëtarët janë të vetëdijshëm për krizën dhe ata duan të krijojnë shkenca të fshehta. Armët bërthamore nuk do të duhet të jenë të njohura për politikanët. Zbulimet e tutjeshme duhet të mbesin të panjohura. Ne duhet të presim për kohën kur njeriu bëhet aq i aftë që njohuritë të bëhen të hapura dhe kjo nuk do të jetë e rrezikshme.

Ngjashëm, në fushën shpirtërore, kishte shumë njohuri në Lindje. Por nëse kjo do të kishte ra në duart e injorantëve do të kishte paraqitë një rrezik, kështu që çelsi ishte fshehur. Njohuria ishte bërë sekrete, ezoterike. Ajo është përcjellur person pas personi në mënyrë shumë të vëmendshme, Por tani, për shkak të përparimit shkencorë, momenti ka ardhur që këto të jenë të hapura. Shkenca do të bëhet e rrezikshme nëse të vërtetat shpirtërore, ezoterike mbesin të panjohura. Ato dhet të bëhen të zbuluara në mënyrë që njohuria shpirtërore të jetë në gjendje për të mbajtur ritmin me njohuritë shkencore.

Ëndrra është një nga sferat më të mëdha ezoterike. Unë thash diçka rreth saj në mënyrë që ju të filloni të bëheni të vetëdijshëm për këtë, por unë nuk ua tregova gjithë njohurinë. Kjo nuk është as e nevojshme e as e dobishme, Unë e kam lenë zbrazëtinë. Nëse ju vazhdoni në të, kjo zbrazëti

do të plotësohet automatikisht. Ajo që kam thënë është thjesht shtresë e jashtme. Kjo nuk është e mjaftueshme për ju që të jeni në gjendje për të bërë një teori për këtë, por e mjaftueshme për ju që të filloni.

Bhagwan Shree Rajneesh – OSHO:

Pjesë nga libri **- Psikologjia e ezoterisë**

3. Copëza mendimesh të arta nga Osho

1. Jeto tërësisht, jeto bujshëm, dhe ashtu çdo çast yti do të jetë i artë dhe e tërë jeta jote do të bëhet vargan çastesh të arta. Personi që jeton kështu kurrë edhe nuk vdes, sepse ka fituar prekjen magjike: Çfarëdo që ai prekë në ar shndërrohet.

2. E vetmja përgjegjësi e vërtetë është ajo që buron nga mundësitë e tua individuale, inteligjenca jote, vetëdija jote – dhe vepron në harmoni me to.

3. Duke ardhur në botë ti nuk ke lindur si pemë, por ke lindur vetëm si farë. Prandaj duhet të rritesh gjithnjë deri në atë pikë ku ke për të lulëzuar dhe ai lulëzim do të jetë përmbushja jote, kuptimi yt. Ky lulëzim nuk ka asnjë lidhje me pushtetin, me paranë, me politikën. Ai ka lidhje vetëm me ty; ai është përparimi yt individual. Prandaj, bëju kremtja e vetvetes!

4. Gjakimi për utopi në esencë është gjakimi për harmoni, si te individi, ashtu edhe te bashkësia. Harmonia kurrë nuk ka ekzistuar, gjithmonë ka ekzistuar vetëm kaosi. Shoqëria pandërprerë është e ndarë në kultura të ndryshme, religjione të ndryshme, kombe të ndryshme – dhe të gjitha ato dallime bazohen mbi mashtrimet. Por këto dallime tregojnë se njeriu është i ndarë përbrenda vetes. Ato janë projeksione të konflikteve të tij të brendshme personale. Njeriu nuk është unik përbrenda vetes dhe kjo është arsyeja pse nuk mund të krijojë bashkësi unike, njerëzim unik në botën e jashtme. Shkaku nuk ndodhet jashtë. Jashtësia është vetëm shprehje e brendësisë së njeriut.

5. Askush nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme individit. Dhe kjo është shkaktari themelor i të gjitha problemeve. Por për atë se individi duket aq i imët, kurse shoqëria aq e madhe, njerëzit mendojnë se, po e ndryshuan bashkësinë, atëherë edhe individi do të ndryshohet. Por kjo është marrëzi – sepse "shoqëria"është vetëm fjalë; në realitet ekziston vetëm individi, shoqëria nuk ekziston. Atë që quajmë "shoqëri"është vetëm fjalë pa substancë dhe aty nuk ka se çfarë të ndryshohet. Ti mund ta ndryshosh vetëm individin, more sado i imët të duket ai. Dhe kështu përnjëherë do ta kuptosh shkencën me të cilën ndryshon njeriu – ajo vepron në çdo individ, more kudo qoftë ai. Po ndjej se do të vijë dita kur do të jetojmë në shoqërinë harmonike, dhe ajo do të jetë më e mirë se të gjitha idetë të cilat utopia i ka krijuar gjatë mija viteve. Dhe atëherë realiteti do të jetë shumë më i bukur.

6. Shoqëria është e rregulluar ashtu që t'i pengojë njeriut të mendojë ndonjëherë mbi mundësitë e veta personale. Dhe e tërë vuajtja rrjedh prej asaj se njeriu nuk bëhet ai që vërtet është. Ti vetëm ji ai që je dhe atëherë nuk do të ketë vuajtje, as vrazhdësi, as parehati lidhur me atë se a janë të tjerët më të mirë se ti apo jo. Nëse do që bari të jetë më i gjelbër, nuk është e nevojshme që ta shikosh nga ana tjetër e rrethojës; bëj që bari të jetë më i gjelbër nga ana jote e rrethojës. Kjo vërtet është e thjeshtë të bëhet. Njeriu vetëm duhet të jetë i rrënjosur në mundësitë e veta personale, more çfarëdo qofshin ato. Dhe çdo gjë atëherë do të jetë më e bukur, sado që kjo të duket e pabesueshme.

7. Ti kurrë nuk je krejtësisht i kënaqur me atë që je, as me atë që ta ofron realiteti, dhe shkaku i kësaj je i parehatuar. Kishe për të qenë më i kënaqur me vetveten po ta kuptoje natyrën tënde të vërtetë. Kjo është arsyeja pse nuk mund t'i zhvillosh të gjitha mundësitë e tua. Ti po provon të jesh ai që të tjerët po kërkojnë prej teje, por kjo nuk mundet me të kënaqë. Duke qenë se kjo është kështu, është e logjikshme të thuash: "Duhet të ekzistojë diçka më shuamë se krejt kjo". Mandej nisesh tutje dhe vështron botën rreth vetes. Por çfarë sheh? Sheh se njerëzit kryesisht po shfaqen me maskat në fytyrë të cilat qeshin, duke u dukur bajagi të lumtura, kurse të gjithë në të vërtetë shtirën se janë dikush tjetër. Ti gjithashtu shfaqesh me maskën tënde dhe ata mendojnë se je më i lumtur se ata; ti, megjithatë, mendon se ata janë më të lumtur se ti. Bari duket më i gjelbër në anën tjetër të rrethojës. Të tjerët shohin luadhin tënd dhe ai iu duket më i gjelbër se i tyri. Ai vërtet duket më i gjelbër, më i bukur, më i mirë. Por kjo është vetëm iluzion të cilin e krijon distanca. Kur ofrohesh më pranë, ti atëherë vëren se ajo nuk është ashtu siç është dukur. Por njerëzit qëndrojnë në distancë nga njëri-tjetri. Madje edhe miqtë e dashnorët qëndrojnë në distancë; afërsia së tepërmi e madhe do të ishte e rrezikshme, se gjërat do të shiheshin ashtu siç janë. Ti atëherë do të vije re se gabimisht je i orientuar që nga lindja dhe se krejt ajo që deri tash ke bërë në të vërtetë është e mjerë. Prandaj sheh njerëzit që kanë plot para dhe mendon se paratë sigurisht ofrojnë lumturi. I shikon ata njerëz dhe të bëhet se vërtetë janë të lumtur. Pastaj lëshohesh në garën për para. Dikush të duket më i shëndetshëm se ti – dhe ti atëherë vrapon pas shëndetit. Kurdo që dikush tjetër të duket se është më i suk- sesshëm se ti – ti e imiton. Por ata janë gjithnjë vetëm të tjerë, por jo ti.

8. Ta jetosh atë do të thotë të kesh sens për humor, të kesh kualitet të pamatshëm të dashurisë, të kesh gëzim. Unë jam absolutisht kundër çdo qëndrimi jetësor negativ; madje edhe zotnderimi mund të jetë qëndrim jetësor negativ. Për të ndërtuar qëndrim jetësor pozitiv duhet patjetër të kesh gëzim, sens për humor, dashuri dhe respekt – të gjitha së bashku. Zotnderimi i vetëm i vërtetë është nderimi i jetës, sepse asgjë më hyjnore se vetë jeta nuk ka.

9. Njeriu është i lindur me thesar të madh shpirtëror, por ai gjithashtu është i lindur edhe me trashëgimi të plotë animale. Megjithatë, ndonjëherë na shkon për dore që ta heqim anash trashëgiminë animale dhe të krijojmë hapësirë që thesari shpirtëror të vijë në vetëdijen tonë dhe atëherë ta ndajmë me të tjerët. Kjo po ashtu është një nga kualitetet e çdo thesari: Sa më shumë e ndan, aq më tepër e ke.

10. Shumë probleme tonat ekzistojnë shkaku se kurrë nuk merremi me to, shkaku se kurrë me sytë tanë nuk i vështrojmë ashtu siç vërtet janë.

11. Jepjau jetën gjërave të bukura. Mos ua jep jetën gjërave të shëmtuara. Ti nuk ke shumë kohë, shumë energji për t'i derdhur. Jetë aq e pakët, burim aq i pakët energjie – thjesht është marrëzi t'i derdhësh në vuajtje, pikëllim, urrejtje, xhelozi. Përdori për dashuri, për vepra kreative, për miqësi, për meditim. Bëj diçka me energjinë tënde të të ngrisë në nivel më të lartë. Dhe sa më lart që ke për t'u ngjitur, burimet e tua të energjisë do të jenë më të mëdha. Çdo gjë është në duart e tua.

12. Asnjë njeri nuk është ujdhesë. Këtë duhet mbajtur mend si një nga të vërtetat themelore të jetës. Unë e theksoj këtë sepse ekziston prirja që kjo e vërtetë të harrohet. Të gjithë ne jemi pjesë e një force jetësore – pjesë e një ekzistence oqeanike. Thënë esencialisht, po qe se të gjithë ne, thellë në rrënjët tona, jemi NJË, mundësia për dashuri do të ekzistojë. Po qe se nuk jemi, mundësia për dashuri nuk do të ekzistojë.

13. Njeriu akoma posedon shumë instinkte shtazore, siç është hidhërimi, urrejtja, xhelozia, posesiviteti, dinakëria. Krejt kjo është thellësisht e rrënjosur në ndërdijen e tij dhe duhet gjithsesi të jetë e mënjanuar. E tërë puna e alkimisë shpirtërore merret me këtë se si të shkëputemi me të kaluarën animale. Nëse nuk shkëputet me të kaluarën animale, njeriu do të mbetet në dysh i ndarë. E kaluara animale dhe humanizmi njerëzor nuk mund të ekzistojnë së bashku – shkaku se humanizmi është kualitet plotësisht i kundërt me animalitetin. Prandaj, çfarëdo që njeriu bën kthehet në hipokrizi. Kur në pyetje janë trajtat formale të sjelljes, njeriu ndjek idealin e humanitetit – dashurinë, të vërtetën, lirinë, shpirtmadhësinë, përdëllimin. Por, edhe përkundër kësaj, ai mbetet vetëm gënjeshtar i pabindur, dhe bisha e fshehur në të mund të shfaqet në çdo moment; çfarëdo incidenti mund ta provokojë. Por, pa marrë parasysh se a shfaqet bisha apo jo, vetëdija më e thellë është e ndarë.

Vetëdija kështu e përçarë prodhon ankthin dhe pyetjen: si individi mund ta krijojë harmoninë me tërësinë? E njëjta pyetje vlen edhe për bashkësinë: si mund ta ndërtojmë shoqërinë harmonike – në të cilën nuk do të ketë luftë, nuk do të ketë konflikt, nuk do të ketë klasa, e as ndasi në raca, kasta, religjione, kombe? Në vend se të mendojmë mbi revolucionin dhe transformimin e shoqërisë, domethënë të strukturave të saj, do të duhej më shumë të mendonim mbi meditimin dhe transformimin e individit. Kjo është mënyra e vetme e mundshme që, një ditë, t'i

eliminojmë gjithë ndasitë në shoqëri. Por së pari duhet të eliminohen ndasitë në individin – atëherë edhe ndasitë në shoqëri do të zhduken vetvetiu.

14. Nuk ekziston kurrfarë kutie me etiketën në të cilën do të shkruante "E VËRTETA", e të cilën ti një ditë do të mund ta gjeje, ta shihje

përmbajtjen e saj dhe të thoshe: "Super, e gjeta të vërtetën!"Jo, kuti e tillë vërtet nuk ekziston.

15. Është e qartë arsyeja se përse njerëzit flasin mbi të vërtetën, e mbesin të jetojnë në botën e gënjeshtrës. Në zemrat e tyre ekziston gjakimi i sinqertë për të vërtetën; ata turpërohen para vetvetes shkaku se nuk jetojnë në të vërtetën, por vetëm flasin mbi të. Por ato janë vetëm fjalë. Të jetosh në përputhje me të vërtetën është së tepërmi rrezik dhe ata i frikohen rrezikut. E njëjta vlen edhe kur liria është në pyetje. Çdo njeri e do të lirinë – së paku flet shumë për të – por askush realisht nuk është i lirë.

Dhe askush vërtet nuk dëshiron të jetë i lirë, sepse liria bart me vete përgjegjësi; ajo nuk vjen vetëm. Nga ana tjetër, të jesh i varur është e thjeshtë; atëherë përgjegjësia nuk është tek ti, ajo është në personin prej të cilit je i varur. Kështu njerëzit krijojnë mënyrë skizofrenike të jetës. Ata flasin mbi të vërtetën, flasin mbi lirinë – kurse jetojnë në gënjeshtra, jetojnë në robëri... në trajta të ndryshme të robërisë, pasi që cilado trajtë e robërisë është liri nga ndonjë përgjegjësi. Njeriu i cili me të vërtetë dëshiron të jetë i lirë merr mbi vete përgjegjësi të madhe. Ai nuk mund ta hedhë përgjegjësinë e vet në askënd tjetër. Çfarëdo që të bëjë, sido që të jetë, ai është përgjegjës.

16. Njeriu vërtet jo i dhunshëm është ai i cili nuk vret askënd dhe nuk e lëndon askënd, sepse ai është kundër vrasjeve dhe kundër lëndimeve. Por, po qe se dikush do të provojë ta lëndojë atë, ai edhe atëherë do të jetë kundër lëndimit. Po qe se dikush do të provojë ta vrasë, ai do të jetë kundër vrasjes: ai këtë nuk do të mund ta lejojë. Ai kurrë nuk do të shkaktojë kurrfarë dhune, por po qe se dhuna do të shkaktohet kundër tij, ai atëherë do të luftojë me dhëmbë e me thonj. Vetëm ashtu njerëzit jo të dhunshëm mund të mbeten të pavarur; në të kundërtën ata do të jenë robër, dhe skamnorë, dhe viktima të përhershme plaçkitësish.

17. Që të jesh i pavarur ofroji vetes krejt atë që është e nevojshme për t'u ndjerë i përmbushur, krejt atë që është e nevojshme që jeta jote të jetë e kuptimshme, që të jetë me domethënie. Pikërisht ajo që do të jesh autonom dhe do të zhvillohesh në harmoni me natyrën tënde, ka për të sjellë përmbushjen e fatit tënd.

18. Ji në ndryshim dhe përparim të përhershëm. Kurrë mos pusho së ndryshuari dhe kurrë mos pusho që të jesh i paparashikueshëm: vetëm atëherë jeta jote mund të jetë gëzim. Në atë çast që bëhesh i parashikueshëm, do të jesh makinë. Makina është e parashikueshme. Ajo ka qenë e njëjta dje, e njëjta është sot dhe e njëjta do të jetë nesër. Ajo është

e pandryshueshme. Epërsia e vetme njerëzore mbi makinën qëndron në atë se mund të ndryshohet në çdo moment. Atë qitë që do të pushosh së ndryshuari, në një mënyrë subtile do të jesh i vdekur.

19. Vërë në rrezik të gjitha. Ji kumarxhi! Rreziko të gjitha, se çasti tjetër nuk është i sigurt. Pse atëherë të brengosesh? Pse të mërzitesh? Jeto rrezikshëm, jeto dehurish. Jeto pa frikë, jeto pa fajësi. Jeto pa frikë nga ferri dhe pa gjakim për parajsën. Vetëm JETO!

20. Çdo gabim është rast për të mësuar. Vetëm mos përsërit të njëjtat gabime gjithnjë nga fillimi – ajo veçse është kokëtrashësi. Por bëj sa më shumë që të mundesh gabime të reja – mos iu frikëso kësaj – kjo është e vetmja mënyrë që të mësosh.

21. Religjioziteti thjesht do të thotë shtytje për të përparuar, shtytje që nxit farën të shprehet gjer në mundësitë e veta ekstreme; që të shpërthejë në mijëra lule dhe ta lirojë aromën e cila ka qenë në të. Ajo aromë – është religjioziteti.

22. Çdo njeri është aq fatkeq saqë, një çast, provon të gjejë ndonjë arsye me të cilën do t'ia arsyetonte vetes se përse është fatkeq.

Shoqëria na ofron strategji të mirë për këtë: Gjykimin. Natyrshëm, ti së pari e gjykon vetveten lidhur me çdo gjë. As njeri nuk është i përsosur, dhe asnjë njeri asnjëherë nuk do të jetë i përsosur – sepse përsosmëria nuk ekziston – gjykimi i tillë është gjithnjë i mundur. Ti je i papërsosur dhe ekzistojnë situata në të cilat tregohet papërsosmëria jote. Për këtë arsye je i hidhëruar. I hidhëruar je në veten dhe i hidhëruar je në gjithë botën. Shtron pyetjen: pse unë nuk jam i përsosur? Atëherë një ide të bie ndër mend - që papërsosmërinë ta gjesh tek të gjithë njerëzit. E atëherë dëshiron ta hapësh zemrën tënde – kjo është e natyrshme, sepse gjithnjë derisa nuk hap zemrën tënde, në jetën tënde nuk ka për të hyrë gëzimi, jeta jote do të jetë gati se e vdekur. Por ti nuk mund ta bësh këtë menjëherë. Më parë duhet patjetër të heqësh gjithë mashtrimet e tua që në rrënjë. Gjëja e parë në këtë rrugë është që të pushosh së gjykuari vetveten. Hidhe gjykimin, fillo ta pranosh vetveten me të gjitha papërsosmëritë e tua, me të gjitha gabimet, me të gjitha manitë dhe dobësitë. Mos kërko nga vetvetja që të jesh i përsosur. Ajo thjesht është kërkim i diçkahi të pamundur, prandaj ndjehesh i frustruar. Ndërkaq, ti para së gjithash je qenie njerëzore.

23. Vetëm vështroji shtazët, vështroji zogjtë; asnjë prej tyre nuk është e brengosur, asnjë nuk është e mërzitur, asnjë e frustruar. Vallë, a ke parë ndonjëherë buall që të ketë fërshëllyer nga zemërimi? Ai me të njëjtën kënaqësi të përsosur do ta hajë barin e njëjtë për çdo ditë. Ai sikur të ishte i përndritur! Tek ai nuk ka tendosje, por vetëm harmoni të përsosur me natyrën, me vetveten, me çdo gjë që ekziston. Buajt nuk krijojnë parti të cilat do ta revolucionarizonin botën, e cila do t'i transformonte buajt në super-buaj, e cila do t'i bënte ata religjiozë, të moralshëm. Dhe asnjë shtazë nuk u jep rëndësi ideve të njeriut. Përkundrazi, ato do të duhej të qeshin

me të: "Çfarë po ndodh me ty? Përse nuk mund të jesh vetëm ai që je? Pse duhet të jesh diçka tjetër?"Prandaj, më e rëndësishmja prej të gjithave është – ta pranosh vetveten plotësisht ashtu siç je.

24. Mos e gjyko sensualitetin. Ai ka qenë i gjykuar nga e gjithë bota, dhe prej atij gjykimi energjia e cila ka mundur të lulëzojë nga sensualiteti, është kthyer në perversion, xhelozi, hidhërim, urrejtje – në mënyrë jetese e cila është e thatë, pa lëng. Sensualiteti është një nga gjërat më të çmuara të njerëzimit. Ai është ndjesia jote. Ai është vetëdijshmëria jote. Ai është vetëdijshmëria jote që rrjedh nëpër ty.

25. Që nga kohët më të lashta prindërit ruajnë idenë se fëmijët janë pronë e tyre dhe se duhet të jenë vetëm kopja besnike e tyre. Kopja nuk është gjë dhe aq e bukur dhe ekzistenca nuk beson në kopjen – ajo i gëzohet vetëm origjinalit. Ti duhet t'u ndihmosh fëmijëve të tu të rriten të pavarur. Duhet t'u ndihmosh që mos me të imituar. Kjo është detyra e vërtetë e prindërve – t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre që të mos rrëshqasin në imitim. Fëmijët janë imitues natyrorë dhe kë ata do të imitonin nëse jo prindërit e tyre, pasi që këta janë njerëzit më të afërm në rrethin e tyre. Gjithnjë deri sot prindërit për së tepërmi janë kënaqur me atë që fëmijët po u ngjajnë atyre me sjellje. Babai është ndjerë krenar që djali aq shumë po i ngjan. Dhe ashtu e ka shpërdoruar jetën e djalit; babait të tillë djali nuk i duhet, ai i mjafton vetvetes. Shkaku i këtij koncepti të gabueshëm të krenarisë që fëmijët po na imitojnë, ne krijojnë shoqërinë e imititatorëve.

26. Dëgjueshmërisë nuk i duhet inteligjenca. Të gjitha makinat janë të dëgjueshme, kurrë askush nuk ka dëgjuar për makinat e padëgjueshme. Dëgjueshmëria është e thjeshtë. Ajo nuk ndez në ty çfarëdo qoftë ndjenje të përgjegjësisë. Ajo nuk kërkon reaksion, veçse kërkon që ti ta bësh vetëm atë që të është thënë. Përgjegjësia është groposur me ardhjen e rendit (shoqëror). Në mënyrën e caktuar ti je tepër i lirë, sepse nuk mund të jesh i gjykuar për veprimet e tua.

27. Religjioziteti nuk është ajo në çfarë duhet të besosh, por ajo të cilën do të duhej ta jetosh, ajo që do të duhej shijuar... Mosbesimi në mendjen tënde, veçse është lulëzim i tërë qenies sate.

28. Mendja nuk mund e të mos sjell gjykime morale. Nëse ushtron dhunë mbi mendjen në këtë kuptim, do ta bllokosh inteligjencën dhe atëherë mendja nuk do të mund të jetë e lirë. Të përmbajturit nga gjykimi moral nuk është diçka që është në domenin e mendjes. Vetëm njeriu që arrin andej mendjes mund të jetë i lirë nga kjo; në rastet tjera ajo që shfaqet në mendjen tënde ajo është fakt, qëndrim i vlefshëm, ajo është shfaqje reale. Çfarëdo qëndrimi që mendja cakton, çfarëdo vendimi që sjellë do të jetë i ndotur me kushtëzimet e saj, me parabindjet e saj – kjo në të vërtetë është ajo që e ndërton gjykimin moral. Për shembull, e sheh një hajn. Sheh se diçka ka vjedhur – ajo është fakt që nuk vihet në pyetje – dhe krijon gjykimin mbi atë se ai gjithsesi është hajn, se hajnia është diçka e keqe. Kur

e emërton ndonjë njeri hajn, mendja jote thotë: "Ke të drejtë, gjykimi yt është i vlefshëm". Por përse hajni përgjithësisht është i keq? Dhe ç'është e keqja? Pse ai ka qenë i shtrënguar të vjedhë? Ai moment i hajnisë është i veçuar nga të gjitha momentet tjera; në bazë të një momenti të veçuar ti po krijon gjykimin mbi personalitetin e përgjithshëm. Po e quan hajdut edhe pse ai posedon edhe shumë veti tjera, dhe jo vetëm atë. Ai mund të jetë piktor i mirë, mund të jetë zdrukthëtar i mirë, këngëtar i mirë, valltar i mirë – në të vërtetë, një mijë e një kualitete mund ta stolisin atë njeri. Në tërësinë e vet njeriu është i madh, hajnia është vetëm një pjesëz e tij. Në bazë të një pjese të ndarë, ti nuk mund të krijosh gjykim mbi tërësinë e personit. Ti nuk e njeh atë person në plotëninë e vet, por ti gjithashtu nuk e njeh as atë veprim të veçuar, nën çfarë rrethanash ka ndodhur. Ndoshta në rrethana të tilla vjedhja nuk është diçka e keqe. Ndoshta edhe ti në rrethana të tilla kishe për të vjedhur. Shkaku se çdo veprim është produkt i rrethanave relative. Po e shikove botën rreth vetes, do të shohësh se njerëzit ndodhen në rrethana të llojllojshme, e gjithashtu edhe idetë e tyre mbi të mirën dhe të keqen, korrekten dhe jokorrekten. Për të parën herë ti do të jesh në mundësinë që të kuptosh se mendja jote është gjithashtu vetëm pjesëz e rrethanave të caktuara njerëzore. Ajo nuk reprezenton kurrfarë të vërtete; ajo reprezenton vetëm rrethana të caktuara. Dhe çfarëdo të pashë me mendje të tillë, ajo është vetëm gjykim moral.

29. Ekzistenca është një, por manifestohet në miliona mënyra. Esenca që në atë mënyrë manifestohet është e njëjta. Një pe hyjnor zgjatet nëpër të gjitha trajtat e krijimit.

30. Paraja është fenomen i çuditshëm. Nëse nuk ke para, ajo është gjë e thjeshtë – nuk ke dhe pikë – aty probleme nuk ekzistojnë. Por nëse ke, atëherë me siguri problemet ekzistojnë! Një nga problemet më të mëdha që krijon paraja është ai që kurrë nuk di se a je i dëshirueshëm ti apo është e dëshirueshme paraja jote. Atëherë e ke vështirë ta paramendosh se dikush të do ty e jo paranë tënde. Kurse jeta mund të jetë aq e thjeshtë. Ndërkaq, ajo që ka shkaktuar kënaqësinë e madhe, si për shembull paraja, mundet përnjëherë të kthehet në vuajtje të madhe. Por kjo nuk është produkt i parasë, veç i mendjes. Paraja është e dobishme, të poseduarit e parasë nuk duhet të shkaktojë as ndjesi mëkati, as ndjesi fajësie.

31. Ja, një mënyrë sesi mendja e prodhon vuajtjen. Ti ke para dhe kënaqesh me to. Dhe kështu ndokush të do, këtë ti nuk e vë në pyetje, sepse ti atëherë atë person do ta vije në situatë tejet të pakëndshme; nëse ai thotë se të do ty, ti ende nuk do t'i besosh, e po qe se thotë se e do paranë tënde, atëherë romanca juaj në atë çast ka përfunduar. Kurse thellë në vete ti dyshon se ai është me ty vetëm për atë se do paranë tënde – e jo ty. Por nuk ka asgjë të keqe në këtë; ato para janë të tuat, pikërisht siç është jotja hunda e jote, siç janë të tutë sytë e tu, siç janë të tuat flokët e tua. Dhe ai person të do në tërësinë tënde. Paraja jote është gjithashtu pjesë jotja. Mos e

ndaj këtë nga të tjerat dhe nuk do të ketë probleme. Provo ta jetosh jetën sa më thjesht dhe sa më me pak probleme – dhe do të jetë krejt në rregull.

32. Ta njohësh gjithë botën nuk është asgjë në krahasim me njohjen e të fshehtave më të thella të jetës tënde.

33. Thënë esencialisht, ideja e krahasimit është plotësisht e gabuar. Çdo person është unik sepse askush tjetër nuk është si ai. Krahasimi do të mund të ishte i drejtë vetëm po qe se gjithë personat ndërmjet veti do të ishin të njëjtë – por kjo nuk është kështu. Madje as binjakët nuk janë plotësisht të njëjtë. Nuk është e mundur të gjesh person që do të ishte identik me ty. Së këndejmi, të krahasosh njerëzit unikatë do të thotë të krijosh probleme të gjithmbarshme.

34. Një nga gjërat më të vështira, por edhe më e rëndësishmja në jetë është ajo që të mos e ndajmë jetën në gjëra të mira dhe idiotike, që të mos e ndajmë fare. Të gjitha ato gjëra janë pjesë e së njëjtës tërësi. E nevojshme është të kemi vetëm pak ndjesi për humor. Për mua, ndjesia për humor është shumë e rëndësishme që njeriu të jetë tërësor. Çfarë ka të keqe në gjërat e vogla, idiotike? Pse nuk mund të qeshësh dhe të kënaqesh me to? Tërë kohën ti vetëm gjykon mbi atë se çfarë është mirë, e çfarë keq. Tërë kohën ti vetëm rri në karrigen e gjyqtarit – dhe ajo të bën aq serioz. Lulja është e bukur, por ç'duhet gjembi? Ai është pjesë e pandashme në ekzistencën e lules. Lulja nuk mund të ekzistojë pa gjembin, ai e mbron. Gjembi ka rëndësinë e vet, qëllimin e vet, kuptimin e vet. Ndërkaq, ti bën ndarjen – lulja është e bukur, kurse gjembi i shëmtuar. Porse në vetë trungun është i njëjti lëng që ushqen edhe lulen edhe gjembin. Në jetën e drurit nuk ekziston ndarja, nuk ekziston gjykimi. Lulja nuk është vetëm e mbrojtura, kurse gjembi vetëm ai që mbron; të dy së bashku janë tërësi e pranueshme. Dhe këtë do të duhej zbatuar në jetë. Ekzistojnë gjëra, gjëra të vogla të cilat, po i gjykove, duken marroqe, idiotike. Por kjo është vetëm shkaku se i gjykon; mos e bëj atë dhe do të shohësh se edhe ato e kanë kuptimin e ekzistencës.

35. I tërë roli i mendjes është që të bëjë ndarje, gjersa roli i zemrës është t'i shohë lidhjet e për- bashkëta për të cilat mendja është plotësisht e verbër. Mendja nuk mund të kuptojë atë që është jashtë fjalëve; ajo mund të kuptojë vetëm atë që është linguistike, logjikisht e drejtë. Ajo nuk ka kurrfarë lidhjeje me ekzistencën, me jetën, me realitetin. E marrë në vetvete mendja është fiksion. Që njeriu të jetojë nuk nevojitet mendja, por i nevojitet zemra. Që të jetosh sa më plotësisht, fut më tepër zemër në jetë.

36. Jeta është rrjedhë; ajo është lumë, zhvillim i pandërprerë. Njerëzit për vetveten mendojnë se janë statikë. Por vetëm gjësendet janë statike, vetëm vdekja është e pandryshueshme – jeta është ndryshim i pandërprerë. Më shumë jetë – më shumë ndryshim. Begatia e jetës nënkupton ndryshimin e madh në çdo moment.

37. Askush nuk është më i mirë, askush nuk është më i keq, askush nuk është identik me dikë tjetër. Secili është unikat. Njëjtësia është psikologjikisht e gabuar. Nuk mundet secili njeri të jetë Albert Ajnshtajn dhe nuk mundet secili njeri të jetë Rabindranat Tagore. Por kjo nuk do të thotë se Rabindranat Tagore është më i mirë shkaku se ti nuk mund të jesh ai. Por as Rabindranati nuk mund të jetë ti. I tërë qëndrimi im është në atë se çdo njeri në vetvete është manifestim unik. Së këndejmi, duhet ta zhdukim idenë e gjithmbarshme të së lartës e të së ulëtës, të së njëjtës e të jo së njëjtës, dhe ta zëvendësojmë atë me konceptin e ri të unikes. Secili person është unik. Vetëm shiko me dashuri dhe do të shohësh se çdo individ ka diçka të veçantë që s'e ka asnjë tjetër.

38. Bëje vetëm atë që është e këndshme – e këndshme për ty dhe e këndshme për rrethin tënd. Bëje vetëm atë që do t'i japë impuls këngës në ty dhe do të krijojë ritëm feste rreth teje. Një jetë të tillë unë e quaj religjioze. Ajo nuk ka parime, nuk ka disiplinë, nuk ka ligje. Ajo kërkon një të vetmen qasje – të jetohet në mënyrë inteligjente.

39. Dëgjueshmëria është e thjeshtë; mosdëgjueshmëria kërkon nivel pak më të lartë inteligjence. Cilido idiot qoftë mund të jetë i dëgjueshëm – në të vërtetë, vetëm idioti edhe mund të jetë i dëgjueshëm. Personi inteligjent shtron pyetje: "Pse? Pse prej meje pritet ta bëjë këtë? Dhe duke qenë se i di shkaqet dhe pasojat e kësaj pritjeje, nuk dëshiroj të marr pjesë në të. "Dhe kështu ai bëhet përgjegjës.

40. Plotësisht është e pamundur që shenjtori të bëhet horr – por është e mundur që horri të bëhet shenjtor.

41. Njeriu akoma nuk është i mësuar që ta njohë bukurinë e vetmisë. Ai, në të vërtetë, përherë gjakon për ndonjë lidhshmëri, të jetë me dikë – me mikun, me babanë, me gruan, me burrin, me fëmijën... me dikë. Ai ka themeluar shoqëri, ai ka themeluar klube – Klubi Lajons, Klubi Rotari. Ai ka themeluar parti – politike, ideologjike. Ai ka themeluar religjione dhe kisha. Por qëllimi kryesor i gjithë kësaj është që njeriu të harrojë se është vetëm. Duke u fshehur në bashkësinë sa më të madhe, njeriu tenton të harrojë atë që në errësirë befas i kujtohet – se ka lindur vetëm, se ka për të vdekur i vetëm, dhe se, çfarëdo që të bëjë, ai ka për të jetuar i vetëm. Kjo vetmi është aq esenciale në ekzistencën e njeriut saqë ai nuk mundet assesi që t'i shpëtojë.

42. Çdo përpjekje e deritashme i orientuar kah ajo që t'i ikim vetmisë – ka përjetuar pasueses, e kështu do të jetë edhe në të ardhmen, sepse ajo është i drejtuar kundër esencës së jetës. Ty nuk të nevojitet diçka që të mund ta harrosh vetminë tënde, ty të nevojitet diçka që të mund të ishe i vetëdijshëm për veçantinë tënde – sepse ajo është realiteti. Është aq bukur ta shijosh, ta ndjesh veçantinë, sepse ajo është liria jote nga turma, nga të tjerët. Ajo është, njëherazi, liria jote nga frika për të qenë i vetmuar. Vetë fjala "vetmi"menjëherë ta përkujton plagën: ke nevojë të vësh diçka mbi të.

Ajo është zbrazëti, dhe ajo zbrazëtia të dhemb. Diçka të nevojitet për ta mbushur atë zbrazëtirë. "Veçantia"– sipas esencës së fjalës – nuk shkakton të njëjtën ndjesi të lëndimit, të zbrazëtisë të cilën duhet përmbushur. Veçantia thjesht do të thotë përmbushje. Ti je tërësor; nuk të nevojitet askush me të përmbushur. Provo ta kuptosh qendrën tënde më të brendshme në të cilën përherë je vetëm, në të cilën përherë ke qenë vetëm. Në jetë, në vdekje, kudo që të jesh, ti do të jesh i vetëm. Por ajo është aso përmbushje, dhe jo zbrazëti, ajo është aso plotënie dhe integriteti që të vërshon me të gjitha lëngjet e jetës, me gjithë bukurinë dhe bekimin e ekzistencës, saqë përnjëherë ndjen veçantinë e cila do të eliminojë çdo dhembje nga zemra. Vërtet, ka me të vërshuar ritmi i ri i ëmbëlsisë, i qetësisë, i gëzimit dhe lumturisë së pamatur. Kjo ndërkaq, nuk do të thotë se njeriu që është i përqendruar në veçantinë e vet, që është i integruar në vetvete, nuk mund të ketë miq – përkundrazi, vetëm ai edhe mund të ketë miq, sepse atij më asgjë nuk i duhet, ai jep. Vetëm ai që ka plot, vetëm ai mund të japë.

43. Të gjithë ne jemi pjesë e një ekzistence. More cilindo që e lëndojmë, ne në të vërtetë e lëndojmë vetveten në lojën e pafund të ekzis- tencës. Ti sot ndoshta këtë nuk e kupton, por një ditë, kur do të jesh më i vetëdijshëm, ndoshta ke për të thënë: "O imzot! Këtë plagë ia kam shkaktuar vetvetes!"Ti ke mundur të lëndosh ndonjë tjetër gjithnjë derisa ke menduar se njerëzit janë të ndryshëm. Por nuk ekziston tjetërfarësia. E tërë ekzistenca është një, unitet kozmik. Nga ky kuptim rezulton jo-dhuna.

44. Kur je i hidhëruar, ti e ndëshkon vetveten. Ti e kallë dhe shkatërron zemrën tënde dhe kualitetet e saj të larta – dhe bëhesh përplot urrejtje.

45. Njeriu është i përmbushur nëse është në harmoni me universin. Nëse nuk është në harmoni me universin, atëherë ai është i zbrazët, tmerrësisht i zbrazët; e nga ajo zbrazëtirë lind lakmia. Domethënë, lakmia është përmbushje e asaj zbrazëtie – me të holla, me shtëpi, me mobile, me miq, me seks dhe me çfarëdo qoftë tjetër – thjesht sepse nuk mund të jetosh me zbrazëtinë. Kjo është tmerruese. Kjo është jetë fantazmash. Po qe se je i zbrazët dhe s'ka asgjë në ty, atëherë është vërtet e pamundur të jetosh. Për të pasur ndjesi duhet gjithsesi të jesh i pasur në vetvete. Në të vërtetë, ekzistojnë vetëm dy mënyra. Ose jeton në harmoni me universin... dhe atëherë je i përmbushur, të gjitha lulet dhe të gjithë yjet janë në ty – dhe kjo është përmbushje e vërtetë. Ose nëse nuk jeton në harmoni me universin – e miliona njerëz nuk jetojnë ashtu – atëherë e përjeton vetveten si me qenë pleh. Lakmia thjesht tregon se ti thellë në vetvete ndjen zbrazëti dhe dëshiron ta përmbushësh me çfarëdo qoftë; nuk është me rëndësi se çfarë do të mund të ishte ajo. Po qe se vetëm njëherë e kupton këtë mësim, nuk nevojitet të bësh asgjë me lakminë. Duhet vetëm të bësh diçka që në bashkësi të vish me përmbushje, dhe zbrazëtia e brendshme vetvetiu do të zhduket.

46. E tërë e kaluara njerëzore e ka festuar varfërinë dhe e ka quajtur të barabartë me të qenit shpirtëror, gjë që plotësisht është e pakuptimtë. Të qenit shpirtëror është pasuria më e madhe që mund t'i ndodhë njeriut. Ajo në vetvete përmban të gjitha pasuritë tjera, dhe anasjelltas: ajo është kundërshtar i çdo lloji të varfërisë. Nga njëra anë, njerëzit do ta nderojnë varfërinë, kurse në anën tjetër do të thonë: "Shërbeji skamnorit!"Çudi! Po qe se varfëria është aq shpirtërore, atëherë gjërat më shpirtërore kanë për ta bërë çdo njeri të pasur të varfër. Ndihmo që njeriu i pasur të bëhet i varfër. Ashtu do të mund të jetë shpirtëror. Pse atëherë të ndihmohet njeriut skamnor? Vallë, dëshiron ta asgjësosh të qenit e tij shpirtëror?! Të jetosh në begati është e vetmja gjë shpirtërore në botë.

47. Paraja është barrë e rëndë nga arsyeja e thjeshtë se deri më tash nuk ia kemi dalë që të ngrehim një sistem të shëndoshë në të cilin ajo e njëjta para do t'i shërbente njerëzimit, në vend se të zotërojë ajo në duart e një numri të vogël njerëzish lakmitarë. Paraja është barrë e rëndë shkaku se psika e njeriut është përplot lakmi. E shikuar nga ana tjetër, paraja thjesht do të thotë ndërrim i gjërave, mjet i përsosur, dhe në këtë nuk ka asgjë të keqe. Por mënyra sesi ne e përdorim këtë mjet në çdo pikëpamje është e keqe. Po qe se nuk ke para, ti je i nëmur, e tërë jeta jote është e zbrazët. Dhe e tërë jeta jote atëherë është vetëm përpjekje për të ardhur gjer tek paraja në çfarëdo mënyre. Nëse, megjithatë, ke para ai fakt nuk e ndryshon gjënë esenciale – ti dëshiron më tepër dhe kjo nuk ka fund. Më në fund, ti ke aq shumë para – megjithëqë ato nuk janë mjaft, ato kurrë nuk janë mjaft pa marrë parasysh se ato janë më shumë se cilido që mund të ketë – saqë zë të ndjesh fajësi, shkaku se mjeti që ke grumbulluar, paraja, në të vërtetë është i shëmtuar, johuman, i dhunshëm. Ke eksploatuar njerëz, ua ke pirë gjakun, ke qenë parazit. Duke iu falënderuar kësaj ti tash ke para, por e ke edhe gjithë krimin të cilin e ke bërë për ta grumbulluar atë para. Kjo ndjenjë fajësie formon dy lloje njerëzish: një lloj, të cilët japin donacione për institucionet bamirëse që të heqin qafe fajësinë, dhe të tjerët, të cilët kanë ndjenjë aq të fuqishme fajësie saqë shkaku i saj ose çmenden ose vetëvriten. E tërë jeta e tyre, së andejmi, bëhet vetëm vuajtje. Çdo frymëmarrje bëhet e rëndë. E gjëja më e çuditshme në krejt këtë është ajo se ai ka punuar gjithë jetën për të mbledhur atë para, meqë shoqëria e provokon dëshirën, ambicien, pasurinë dhe fuqinë. Kurse paraja vërtet sjell fuqi; ajo mund t'I blejë të gjitha, përpos një numri gjërash të cilat nuk mund të blihen. Por kush po interesohet për ato gjëra? Meditimi nuk mund të blihet, dashuria nuk mund të blihet, miqësia nuk mund të blihet, falënderimi po ashtu – por kush akoma po çan kokën për to?

48. Vetëm vështroje ekzistencën dhe begatinë e saj. Ç'nevojë ka për aq shumë lule të gjithfarëllojshme në botë? Vetëm trëndafilat do të mund të ishin mjaft. Por ekzistenca është bollëk – miliona e miliona lulesh të llojllojshme, zogjsh, shtazësh – të gjitha janë bollëk. Natyra nuk është

varfanjake, ajo vallëzon në të gjitha – në oqean, në dru. Ajo këndon në të gjitha – në erën që fryn nëpër pishnajë, në zogj... Çfarë është nevoja për miliona sistemet diellore, prej të cilëve secili në vetvete përmban miliona yje? Siç duket nuk ka kurrfarë nevoje, përpos nëse mbushullimi nuk është natyra esenciale e ekzistencës; ajo begati është bërthama esenciale. Prandaj nuk beson në varfërinë.

49. Unë nuk konsideroj se lakmia është ndonjë lloj dëshire. Ajo është më parë ndonjë sëmundje ekzistenciale. Ti nuk je në harmoni me tërësinë; vetëm harmonia me tërësinë mund të të bëjë të përmbushur. Sipas meje, lakmia nuk është ndonjë trajtë dëshire, prandaj ti nuk di çfarë të bësh me të. Ti vetëm vëren zbrazëtinë të cilën provon ta përmbushësh dhe shtron pyetjet: "Pse unë jam i zbrazët? Ndoshta për atë se kam humbur drejtimin? Kaherë nuk shkoj në atë drejtim, nuk jam në ekzistencë... Kjo është arsyeja e zbrazëtisë sime. "Për këtë ji në ekzistencë, shko, ji afër me ekzistencën në qetësi dhe paqe, në meditim. Dhe një ditë do të vësh re se je aq i përmbushur, i stërmbushur, i vërshuar nga gëzimi, lumturia dhe përdëllimi. Ke aq shumë gjëra të çmuara në vetvete saqë mund t'ia japësh tërë botës, e që kurrë të mos mbetesh pa to. Atë ditë, të parën herë në jetë, nuk ke për të ndjerë kurrfarë lakmie – për paranë, për ushqimet, për gjërat - për çfarëdo qoftë. Ti do të jetosh natyrshëm, e jo me lakminë të cilën nuk do të mund ta ushqesh, me plagën të cilën nuk do të mund ta shërosh, dhe çfarëdo që do të kesh nevojë, do ta arrish pa problem.

50. Secili njeri ndjehet inferior në këtë apo në atë mënyrë. Arsyeja e kësaj është se nuk e pranojmë faktin se secili njeri është unik. Gjatë një qëndrimi të tillë nuk shtrohet pyetja e inferioritetit apo superioritetit. Çdonjëri është unik në llojin e vet – dhe aty nuk ka vend për krahasim. Ne nuk jemi të gatshëm ta pranojmë vetveten si të tillë. Në çastin që e pranon vetveten të tillë siç je, pa kurrfarë krahasimi, të gjitha inferioritetet dhe superioritetet do të zhduken. Në pranimin e plotë të vetvetes, ti do të jesh i lirë prej këtyre kompleksеve – të inferioritetit dhe superioritetit. Në të kundërtën, ke për të vuajtur tërë jetën. Unë nuk mund ta paramendoj personin i cili do të mund t'i kishte të gjitha në këtë botë. Shumë këtë e kanë provuar, por në fund kanë dështuar. Vetëm ji i vetvetes, dhe kjo mjafton. Të tillë siç je të pranon dielli, të pranon hëna, të pranon druri, të pranon oqeani, të pranon toka. Çfarë do më tepër se kaq? Të pranon e tërë bota. Gëzoju kësaj.

51. Çdo njeri ndjen nevojën që të jetë me vlerë dhe ta konfirmojë vlerën e vet. E tërë jeta jonë është ashtu e strukturuar që të konsiderojmë se po qe se askush nuk na pranon, ne jemi asgjë, ne jemi të pavlerë. Puna të cilën e kryejmë nuk është shumë e rëndësishme, por së paku merr mirënjohje. Premisa e këtillë e gjërave e bën jetën rrëmujë. Puna jonë duhet të merret e rëndësishme, sepse prodhon gëzim të brendshëm. Ti duhet të punosh jo që puna jote të jetë e pranuar, por që të kënaqesh në kreativitetin tënd. Ti e do

atë punë shkaku i vetë asaj. Po e punon atë, sepse po e do atë. Mos kërko mirënjohje. Nëse mirënjohja megjithatë vjen, pranoje atë i relaksuar. Nëse nuk vjen, kurrgjë kurrkujt. Kuptimi i punës tënde duhet të jetë në vetë punën.

52. Sikur çdo njeri ta mësonte këtë art të thjeshtë – që ta dojë punën e vet çfarëdo që të jetë, që të kënaqet në të duke mos pritur kurrfarë

mirënjohjeje – do të kishim botë shumë më të bukur dhe shumë më të lumtur; në rast të kundërt, bota do t'ju mbërthejë në kurthine jetesës së mjerë skamnore. Ajo që e punon nuk është e mirë shkaku se e do atë punë, shkaku se e bën atë përsosmërisht, por është e mirë nëse bota e pranon, e shpërblen, i jep medalje të artë, i ndan çmimin Nobel. Kështu e kanë çrrënjosur gjithë vlerën esenciale të krijimtarisë dhe në këtë mënyrë kanë asgjësuar miliona njerëz – sepse nuk munden që një numri të tillë njerëzish t'ia ndajnë çmimin Nobel. E atëherë tek secili njeri ata krijojnë dëshirën për mirënjohje, ashtu që askush më nuk mund të punojë në paqe, në qetësi, nuk mund të kënaqet në atë që e punon, çfarëdo që të jetë ajo. Kurse jeta përbëhet prej gjërave të vogla. Për ato gjëra të vogla nuk ekzistojnë mirënjohjet, ato nuk titullohen nga ana e qeverisë, universitetet nuk u ndajnë doktorata nderi. Ai njeri që jeton për dashurinë e vet, për punën e vet personale, duke mos çarë kokën për mendimet e huaja, ai ka individualitetin e vet personal.

53. Kënaqësia nuk është në atë që të bëjmë diçka veç sa për ta bërë; kënaqësia është në atë që ti atë ta duash, ta duash atë me krejt fuqinë, të harrosh çdo gjë kur merresh me të, e harron mbarë botën; dhe vetëm ajo mbetet në objektivin e mbarë ekzistencës tënde. Dhe kjo është lumturia jote dhe shpërblimi yt – e jo sasia apo përhershmëria e diçkahit. Në secilin çast të rrjedhës së ndryshueshme të ekzistencës do ta gjejmë shpërblimin tonë personal. Çfarëdo që bëjmë, ta bëjmë atë më së miri që mundemi, e jo me gjysmë zemre. Nëse nuk japim çdo gjë prej vetes, asgjë me vlerë nuk mund të bëjmë. Në këtë është e tërë fatkeqësia jonë.

54. Është fakt i thjeshtë se çdo njeri është unik dhe se ka individualitet të veçantë. Me këso qëndrimi, ne në të vërtetë hedhim poshtë idenë se njeriu do të duhej të ishte ky apo ai, dhe e zëvendësojmë atë me filozofinë se njeriu është i bukur more sido që të jetë. Qëndrimi "do të duhej"është i gabuar, se kush jemi ne që t'ia imponojmë ndonjë "duhet"kujtdo qoftë? Po qe se ekzistenca të ka pranuar të tillë siç je, kush jam unë që këtë të mos e bëj?! Prandaj, vetëm ndrysho qëndrimin dhe një gjë shumë e thjeshtë në çast do të vijë në horizontin tënd: Secili njeri është unikat; secili njeri është i tillë çfarë është, dhe duhet të jetë i tillë çfarë është. Atij nuk i duhet të jetë dikush tjetër për të qenë i pranuar; ai është i pranuar përgjithmonë. Unë këtë e quaj nderim të individu- alitetit, nderim të njerëzve – të tillë siç janë. I tërë njerëzimi do të mund të ishte bashkësi aq e bukur dhe e gëzuar vetëm sikur të mund t'i pranonim njerëzit të tillë siç janë.

55. Pse nuk krijojmë jetë në të cilën paraja nuk do të krijojë hierarki, por, përkundrazi, do të japë më tepër shanse për gjithsecilin.

56. Njerëzit autoritarë janë ata të cilët vuajnë nga kompleksi i inferioritetit. Sa më i fshehtë që të jetë inferioriteti i tyre, aq më tepër ata ekspozojnë kinse superioritetin e vet. Ata duan të konfirmojnë se janë dikush, se fjala e tyre është me peshë, se fjala e tyre është ligj. Por thellë në vetvete ata janë krijesa tejet inferiore.

57. Natyra sigurisht se nuk është hierarki. Hierarkia është lojë mentale e njeriut, pasi që pa hierarki egoja nuk mund të ushqehet – ajo vdes. Në natyrë, megjithatë, secili merr shansin e vet, pjesën e vet të hapësirës dhe aty askush nuk është kryesori. Askush nuk është zotëriu dhe askush nuk është shërbëtori. Natyra vepron gati si organizëm unik në të cilin individualiteti nuk është zhdukur, por në të cilën egoja nuk ka gjasë që të zhvillohet; prandaj druri nuk ka ego, zogjtë nuk kanë ego. Shtazët more të cilitdo lloj, nuk kanë ego. Pra, ky është vetëm problem i njeriut!

58. Privilegj i njeriut – vetëm privilegj i njeriut është që të mbesë vetëm, që të qëndrojë i vetëm kundruall gjithë botës nëse ndjen se e

vërteta është me të. Nëse ti ndjen se ajo është mënyrë e cila të dërgon në liri, prano cilëndo formë të përgjegjësisë. Asnjë prej atyre përgjegjësive nuk ka me të sjellë dëm. Secila prej tyre ka me të bërë person më të pjekur, më të përqendruar, më të integruar dhe më të bukur.

59. Ti ke vetëm një çast në duart e tua – çastin e tanishëm. Dhe ky çast është i papërsëritshëm. Së këndejmi, përjetoje atë ose hiçit je duke ia falur të papërjetuar.

60. Secili fëmijë e kupton atë se pikëpamja e tij ndaj botës është tjetër ndryshe nga pikëpamja e prindërve të tij. Për çfarëdo që interesohet, ajo është plotësisht unike. Vlerësimi i tij është tjetër fare. Ai mund të mbledhë guaca deti në plazh, megjithëqë prindërit do t'i thonë: "Hiqu tyre. Pse humb kohë me marrëzira?"Por për të, guacat janë tepër të bukura. Ai i sheh tjetër ndryshe, ai e sheh vlerën e tyre në tjetër mënyrë. Prindërit e tij nxitojnë pas parasë; ai, ndërkaq, dëshiron të mbledh flutura. Ai nuk mund të kuptojë se përse prindërit e tij aq shumë interesohen për para: "Çfarë do të bëni me ato para?"Prindërit e tij, prapë, nuk mund të kuptojnë se çfarë ai dëshiron të bëjë me ato flutura, apo lule. Çdo fëmijë vjen gjer tek njohja se ekzistojnë dallime midis tij dhe prindërve të tij, problemi i vetëm është në atë se ai frikohet ta vërë në pah të drejtën e tij. More për çfarëdo që interesohet, ai do të duhej të ishte i veçantë. Në pyetje është vetëm pak guxim – i cili akoma nuk është ndrydhur në fëmijën, përkundër asaj se e tërë shoqëria është e orientuar në atë mënyrë që madje edhe një kualitet i tillë i mrekullueshëm, siç është guximi tek fëmija, të jetë i gjykuar. Po qe se prindërit vërtet e duan fëmijën e tyre, ata do t'i ndihmojnë të bëhet i guximshëm – i guximshëm madje edhe përballë tyre. Ata do t'i ndihmojnë

të jetë i guximshëm kundruall mësuesve, kundruall shoqërisë, kundruall kujtdo qoftë që provon t'ia asgjësojë individualitetin e tij.

61. Mbaje në mend! Kurrë mos bëj kompromis. Kompromisi është në kundërshti absolute me vizionin tim të përgjithshëm. Shikoji njerëzit. Ata janë fatkëqij shkaku se bëjnë kompromis në çdo situatë dhe nuk mund t'ia falin vetvetes shkaku se janë të tillë. Ata e dinë se kanë mundur të mbledhin guxim, por ata janë qyqe të verifikuara. Ata janë poshtëruar në sytë e vet, e kanë humbur nderimin e vetvetes. Qe, çfarë bën kompromisi! Pse na nevojitet kompromisi? Çfarë mund të humbasim? Në këtë jetë të vogël jeto sa më plotësisht që mundesh. Mos u frikëso të shkosh gjer në fund. Nuk mund të shkosh më larg sesa plotësia – ajo është linja e fundit. Dhe mos bëj kompromis. E tërë mendja jote do ta kërkojë kompromisin, sepse ashtu jemi edukuar, ashtu jemi kushtëzuar. "Kompromis"është një nga fjalët më të shëmtuara në gjuhën tonë. Ajo do të thotë: "Unë po e jap gjysmën, ti jepe gjysmën; unë po lëshoj pe përgjysmë, ti lësho pe përgjysmë. "Po përse? Nëse mund ta hash tërë ëmbëlsirën, pse atëherë do ta haje vetëm gjysmën? Prandaj, përse kompromisi? Të nevojitet vetëm pak trimëri, pak guxim – dhe do të jesh në fillim. Menjëherë do ta shijosh bukurinë e të mos lëshuarit pe dhe të zgjimit të dinjitetit, do ta shijosh integritetin dhe individualitetin, dhe për të parën herë do të ndjesh se e ke esencën dhe se ajo akoma ekziston në qendrën tënde personale.

62. Personin fatkeq është lehtë ta robërosh. Por personin me gjallëri dhe të lumtur është e pamundur ta robërosh.

63. Mendja është thjesht grumbull kujtimesh për të kaluarën dhe – përpos atij kujtimi – fantazim mbi ardhmërinë.

64. Shfrytëzo çdo rast në jetë që ta lartësosh inteligjencën tënde, vetëdijen tënde. Ajo që rëndom bëjmë në jetë është se shfrytëzojmë çdo rast që vetë-vetes t'ia ndërtojmë ferrin. Shkaku i kësaj ti vuan, kurse vuajtja jote u krijon vuajtje të tjerëve. E kur aq shumë njerëz jetojnë së bashku, dhe të gjithë i krijojnë vuajtje njëri-tjetrit, kjo shumëfishohet. Ja se në ç'mënyrë e tërë bota bëhet ferr. Kjo do të mund të ndryshonte menjëherë vetëm po qe se do të kuptohej gjëja themelore: pa inteligjencë nuk ka parajsë.

65. Siç unë e kuptoj, roli i prindërve nuk është në atë që t'i ndihmojnë fëmijës të rritet; ai do të rritet edhe pa ndihmën e prindërve. Roli juaj është në atë që ta përkrahni, ta edukoni, ta ndihmoni, që fëmija juaj të jetë pikërisht ai që veç po bëhet. Mos i ofroni direktiva, mos i ofroni ideale. Mos i flisni se çfarë është në rregull e çfarë gabim – lejojeni që ai vetë atë ta zbulojë përmes rrugës së përvojës personale.

66. Ideja e përgjithshme se fëmijët janë pronë e juaja është e gabuar. Fëmijët kanë lindur nëpërmjet jush, por ata nuk janë pronë e juaj. Ju keni tërë të kaluarën, ata kanë vetëm ardhmërinë. Ata nuk do të jetojnë sipas kritereve tuaja. Sikur të jetonin sipas kritereve tuaja, ajo do të thoshte se

nuk jetojnë pothuajse fare. Ata dëshirojnë të jetojnë sipas kritereve të tyre – lirshëm, me përgjegjësi, duke u sfiduar.

67. Kuptojeni njëherë se fëmijët tuaj nuk ju përkasin juve; ata i përkasin ekzistencës kurse ju jeni vetëm dalje. Dhe duhet t'i jini falënderues ekzistencës që ju ka zgjedhur ju të jeni dalje për disa fëmijë të mrekullueshëm. Por ju nuk guxoni ta pengoni zhvillimin e tyre, mundësinë e tyre. Ju nuk guxoni t'ua impononi vetveten. Ata nuk kanë për të jetuar në kohën tuaj, ata nuk kanë për t'u përballur me të njëjtat probleme me të cilat ju përballeni. Ata do të jenë pjesë e botës tjetër. Mos i përgatitni për këtë botë, për këtë shoqëri, për këtë kohë, se asisoj ju do t'u krijoni probleme. Do të jenë të papërgatitur për të, do të jenë të paaftë.

68. Mizoria është gabim në të kuptuar. Ajo lindnë ne si pasojë e frikës nga vdekja. Ne nuk dëshirojmë të vdesim, prandaj para se dikush të na vrasë ne, ne dëshirojmë ta vrasim atë – se sulmi është mbrojtja më e mirë. Ti edhe nuk di se kush në të vërtetë e ka ndërmend me të vra. Në mbretërinë shtazore, në botën njerëzore zhvillohet garë e tmerrshme në të cilën njerëzit thjesht sulmojnë, duke mos pasur dert se kë sulmojnë dhe se a është ajo e bazuar. Kjo s'është as me rëndësi – me rëndësi është të mos i japim shans askujt. E kur e sulmon dikë, zemra jote gradualisht bëhet gjithnjë e më e fortë e më e fortë dhe ti zë të ndjesh kënaqësi në sulm. Dukuria e njëjtë mund të vihet re tek bota shtazore, se edhe atje zhvillohet gara (për ushqim, për fuqi...). Mizoria nuk është asgjë tjetër pos garë në atë se kush do të jetë i pari. Nëse dhuna është mjet për të ardhur tek kjo, atëherë do të ketë dhunë; por çfarëdo që duhet, ai duhet gjithsesi të jetë i pari. Kjo është kështu tek shtazët, e kështu është edhe tek njerëzit. Po përse ajo nervozë për të qenë i pari? Kjo çon në konstatimin se vdekja është qëllimi i jetës.

69. Në harmoni me konstatimin tim mbi lindjen e mizorisë – mizoria zhduket vetëm atëherë kur e ke njohjen se vdekja nuk ekziston. Kur e shijon pavdekësinë në vete – mizoria zhduket. Atëherë ajo nuk ka kuptim; ti atëherë nuk ke nevojë të nxitosh dhe tjerët lirisht mund të jenë përpara teje, sepse ato krijesa të shkreta nuk dinë se bota është e pafundme, se jeta është e pafund. E kur është ashtu, atëherë nuk ka gjasa që dikë ta lëshosh të dalë përpara teje; nëse kjo nuk ndodh sot, do të ndodhë nesër. Por nëse ke kuptim të drejtë, asgjë nuk mund të të dalë nga dora.

70. Në realitet, nëse luftojmë në mes veti, nëse jemi mizor dhe të dhunshëm, mund të humbasim shumëçka, se i tërë ai proces ka me të zhvidhosur, do të bëjë që zemra jote të gurëzohet. E po qe se zemra gurëzohet, ajo do të humbas gjithçka që është e madhe, gjithçka që është e bukur, gjithçka që është e gëzuar. Kjo është vështirë t'u shpjegohet shtazëve. Por, problemi i vërtetë është në atë se kjo është po ashtu vështirë t'i shpjegohet edhe njeriut; përmes rrugës së zilisë, ambicies së furishme, gjakimit që gjithkund të mbërrish i pari, ti krijon botë të çmendurish në të

cilën askush në asgjë nuk kënaqet, por gjithsecili bëhet i skamur. Ekziston vetëm një mënyrë që njeriu ta arrijë mirëkuptimin, e kjo është t'i ndihmosh të ndjejë unin e vet të pavdekshëm dhe e tërë ashpërsia do të zhduket në vend. Jeta është shumë e shkurtër për t'u bërë probleme. Po e shikove pafundësinë nga të dyja skajet – e kaluara dhe e ardhmja – nuk do të kesh nevojë të nxitosh, as që do të kesh nevojë të bësh garë me këdo qoftë. Jeta është aq e begatshme dhe aq përmbajtësore saqë nuk mund ta shterrosh.

71. Për ata që dëshirojnë vetëm të mendojnë mbi jetën, mbi të jetuarit, mbi dashurinë – për ta e kaluara dhe e ardhja janë përsosmërisht të bukura shkaku se u ofrojnë horizont të pafundmë. Ata mund ta stolisin të kaluarën e tyre, mund ta bëjnë po aq të bukur sa ata dëshirojnë – edhe pse kurrë nuk kanë jetuar në të; kur ajo e kaluar ka qenë e tashmja, ata nuk kanë qenë aty. Ata janë vetëm hije, vetëm shprehje. Ata pandërprerë kanë nxituar, dhe derisa ashtu kanë nxituar, kanë parë një sërë gjërash për të cilat mendojnë se janë vetë jeta. Në të kaluarën, vetëm vdekja është realitet, por jo edhe jeta. Në të ardhmen, gjithashtu, vetëm vdekja ka realitet, por jo edhe jeta. Për ata që e kanë huqur jetën në të kaluarën, si zëvendësim për atë zbrazëtirë automatikisht vihet në lëvizje ëndrra mbi ardhmërinë. Ardhmëria është vetëm projeksion i lindur nga e kaluara. Çfarëdo që njeriu të ketë huqur në të kaluarën, ai shpreson se atë do ta kompensojë në ardhmëri; në mes të këtyre dy mosekzistencave ndodhet një çast I vogël i ekzistencës – vetë JETA.

72. Është i rrënjosur mendimi se koha përbëhet prej tri segmenteve – së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes; ndërkaq, ky mendim është i gabuar. Koha përbëhet vetëm nga e kaluara dhe e ardhmja. Jeta përbëhet nga e tashmja. Për ata që dëshirojnë të jetojnë, për ta nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër përveçse ta jetojnë çastin e tanishëm. Vetëm e tanishmja e posedon ekzistencën. E kaluara është vetëm koleksion kujtimesh, kurse e ardhmja nuk është gjë tjetër përveçse imagjinata jote, ëndrrat e tua. Realiteti është këtu dhe tash.

73. E tashmja nuk ka kurrfarë lidhjeje me kohën. Po qe se ndodhesh pikërisht këtu dhe në këtë çast, atëherë aty nuk ekziston koha. Ekziston vetëm qetësia e pamatshme, heshtimi, palëvizshmëria, asgjë nuk pipëtinë, çdo gjë ekzistuese befasisht ka ndaluar. E tashmja ta jep rastin të zhytesh thellë në ujin e jetës, apo të fluturosh lart në qiellin e jetës. Por mbi të dyja këto skajshmëri del para rreziku – "e kaluara"dhe "e ardhmja"janë fjalët më të rrezikshme në gjuhën njerëzore. Midis së kaluarës dhe së ardhmes, jeta në të tashmen duket gati si ecja nëpër litarin e ngrehur; nga të dyja anët përgjon rreziku. Por, njëherë, ti ke për t'i shijuar lëngjet e së tashmes dhe s'ke për ta përfillur rrezikun. Njëherë ke për t'u harmonizuar me jetën dhe asgjë tjetër nuk ka me qenë e rëndësishme. Për mua, jetë është krejt çfarë ekziston.

74. Për atë që dëshiron të jetojë – e jo të mendojë mbi jetën; që dëshiron të dashurojë, e jo të mendojë mbi dashurinë; që dëshiron të ekzistojë, e jo të filozofojë mbi ardhmërinë – për të nuk ka alternativë përpos se t'i pijë lëngjet e çastit të tanishëm. Piji në tërësi, se ato nuk kanë për t'u kthyer përsëri. Ajo që njëherë ka shkuar, ka shkuar përgjithmonë.

75. Jeta zgjatet gjatë shtatëdhjetë, tetëdhjetë vjetëve, kurse vdekja ndodh në një sekondë. Ajo është aq e kondensuar saqë nëse e jeton jetën tënde vlefshmërisht, guximshëm, do të jesh në gjendje të penetrosh në misterin e vdekjes. E misteri i vdekjes është në atë se ajo është vetëm mbulesë: nën të është pavdekësia jote, jeta jote e amshueshme.

76. Unë nuk mendoj shumë mbi ardhmërinë, se ajo lind nga e tashmja. Nëse mund të kujdesemi për të tashmen, do të mund të kujdesemi për të ardhmen. Ardhmëria nuk mund të vijë prej askund, ajo lind prej këtij çasti. Momenti i ardhshëm do të lind nga i tashmi. Po qe se ky çast është i bukur, i qetë, i bekuar, çasti tjetër duhet të jetë patjetër edhe më i qetë, edhe më i bekuar.

77. Të jesh serioz, për mua do të thotë – të jesh i sëmurë. Kuptimi për humor ka me të ba më human, më modest. Sipas meje, kuptimi për humor është pjesa më esenciale e religjiozitetit.

78. Njeriu nuk duhet ta transcendentojë natyrën. Përkundrazi, njeriu duhet ta realizojë natyrën – gjë të cilën asnjë shtazë nuk mund ta bëjë. Këtu është dallimi. Ti je i lindur si qenie natyrore. Ti nuk mund të shkosh përmbi vetveten. Kjo është si të dëshiroje ta ngritje vetveten gjithsesi, ashtu që do t'i kapësh këmbët e tua dhe do të ngrihesh përpjetë. Këtë mund ta provosh pak, por herët apo vonë ke për të rënë në tokë dhe ke për t'u thyer. Ti nuk mund të fluturosh. Kjo është ajo që ndodh deri më sot: njeriu ka provuar ta ngritë vetveten mbi natyrën, që do të thotë mbi vetveten. Por ai nuk mund të ndahet nga natyra. Njeriu ka aftësinë, ka inteligjencën, ka lirinë për të hulumtuar – dhe po qe se e hulumton natyrën në plotësi, ka për t'iu kthyer shtëpisë së vet. Natyra është shtëpia e njeriut.

79. Ky është një nga ligjet themelore të jetës: krejt ajo që është më e lartësuar ajo është më e lëndueshme. Rrënja e drurit është shumë e fortë, por lulet e tij nuk janë. Lulet janë tejet të ndjeshme – e mjaftueshme është një puhi pak më e fortë dhe ato do të asgjësohen. E njëjta vlen edhe për vetëdijen njerëzore. Urrejtja është shumë e fortë, por dashuria nuk është. Dashuria është mu si lulet – lehtë I ndrydh ndonjë gur apo i asgjëson ndonjë shtazë. Vlerat e larta të jetës duhet të jenë të mbrojtura. Vlerat e ulëta e mbrojnë vetveten. Gurit nuk i nevojitet mbrojtja, por vetëm pak përtej tij trëndafilit në kaçubë i duhet mbrojtja. Guri është i vdekur dhe ai nuk mund të jetë më i vdekur sesa që është. Prandaj atij nuk i duhet mbrojtje. Por, trëndafili është aq i gjallërishëm, aq i bukur, aq tërheqës. Në këtë është fuqia e tij – por, kjo provokon edhe rrezikun. Dikush mund ta këpusë. Askush nuk ka për të mbledhur gurë, por trëndafilin do ta këpusë.

80. Dashuria duhet të ngrihet gjer në kulmin më të lartë – por kjo kërkon disiplinë të caktuar. Njerëzit e shfrytëzojnë disiplinën, por jo edhe kur bëjnë dashuri. Unë e preferoj disiplinën për bërjen e drejtë të dashurisë, ashtu që ajo mos të jetë vetëm çështje biologjike e cila kurrë nuk ka me të ngritë në botën tënde shpirtërore. Dashuria ka potencial me të ngritë madje gjer tek bota jote shpirtërore, kulmi i saj e ka këtë mundësi.

81. Liria thjesht të bën përgjegjës ndaj gjithë asaj që je dhe gjithë asaj që synon të jesh.

82. Ekzistojnë njerëz që janë të hidhëruar për nga natyra; njerëzit e tillë ngritin revolucione, e transformojnë shoqërinë, e transformojnë shtetin. Por, të gjitha revolucionet e tyre falimentojnë, meqë ajo që buron nga hidhërimi, buron nga padituria. Ajo nuk është në gjendje të krijojë ndryshim autentik.

83. Ndryshimi kah e mira, që lind nga hidhërimi – është i pamundur. Do të dëshiroja të mbanit mend një gjë – pikëllimi është, në të vërtetë, hidhërimi i kthyer mbrapsht. Ai nuk është gjë tjetër përpos hidhërim i ndrydhur. Nëse e analizoni çështjen, do të shihni se kjo është fakt. Pikëllimi mund të shndërrohet në hidhërim shumë lehtë; në të njëjtën mënyrë hidhërimi mund të shndërrohet në pikëllim. Ato nuk janë dy gjëra të ndryshme... veçse, me siguri, dy anët e së njëjtës medalje.

84. Bota është pikëllim, bota është mërzi. Në zemrat e njerëzve ka vuajtje të madhe. Por ti nuk duhet të jesh i pikëlluar shkaku i kësaj, sepse duke u bërë i pikëlluar ti iu bashkëngjitesh, ashtu që vetëm sa e rrit pikëllimin. E kjo nuk është ndihmesë. Kjo është si kur njerëzit janë të sëmurë: ti e provon sëmundjen e tyre, e atëherë edhe vetë bëhesh i sëmurë. Ndërkaq, të kesh ndjenja për sëmundjen e tyre do të thotë të gjurmosh për shkaktarin i cili ka prodhuar gjithë vuajtjen dhe mërzinë e tyre dhe t'u ndihmosh ta eliminojnë atë shkaktar. Në të njëjtën kohë, ti do të duhej të mbeteshe i lumtur për aq sa kjo është e mundur, sepse atyre do t'u ndihmojë lumturia jote – e jo pikëllimi yt. Ti do të duhej të ishe plot gjallëri, për të mundur ata ta kuptojnë se është e mundur të jenë të gjallërishëm në këtë botë të pikëlluar...

85. Zemërimi është përherë shenjë dobësie.

86. Periudhat e fatkeqësisë të bëjnë të vetëdijshëm për realitetin i tillë çfarë ai është. Realiteti është përherë i thyeshëm, secili është përherë në rrezik. Kjo ndodh pikërisht në kohët e zakonshme kur njeriu lehtësisht luhatet dhe nuk e sheh rrezikun. Ai atëherë kotet, duke ëndërruar mbi gjërat e bukura të cilat do të ndodhin në ardhmëri. E në momentin kur rreziku kanoset, njeriu befas bëhet i vetëdijshëm se ndoshta nuk do të ketë as lumturi, as të nesërme, dhe se ai moment është i vetmi moment që posedon. Periudhat e fatkeqësisë janë shumë zhdehëse. Ato nuk sjellin asgjë të re në botë; ato bëjnë vetëm që të jemi të vetëdijshëm për botën ashtu siç ajo është. Ato të zgjojnë. Nëse këtë s'e kupton, atëherë ke për t'u

çmendur; nëse e kupton, atëherë mund të bëhesh i vetëdijshëm. Nuk është poenta në atë që ti shkaku i kësaj të jesh i brengosur, sepse ashtu, ti vetëm ke për ta huqur çastin, e atëherë nuk do të mund t'I ndihmosh askujt. Poenta është në atë se ekziston fshehtësia si mund të mbizotërohet rreziku. E fshehtësia është si në vijim: fillo të jetosh më plotësisht, më tërësisht, më i përgatitur ashtu që në vetvete të mund të gjesh diçka të cilën vdekja nuk do të mund ta arrijë. Ajo është e vetmja strehimore, e vetmja mbrojtje, e vetmja siguri. Së këndejmi, shtrohet vetëm një pyetje – si ta përdorim tërësinë, gjithëpërfshirësen? Çfarëdo që ajo të jetë, ta përdorim në mënyrë të drejtë. Fatkeqësia është e madhe, rreziku është i madh, por edhe momenti i volitshëm është po ashtu i madh.

87. Asnjë mashtrim nuk mund të qëndrojë përballë realitetit. Realiteti do ta shlyejë herët apo vonë.

88. Roli i babait apo i nënës është i madh, sepse ata sjellin mysafirin e ri në botë – i cili nuk di asgjë, por i cili bart disa potenciale në vete. Po qe se potencialet e tij nuk zhvillohen, ai do të bëhet fatkeq; asnjë prind nuk mund as ta mendojë atë që fëmija i tij do të mbetet fatkeq. Ata ua dëshirojnë fëmijëve të tyre që të jenë të lumtur – dhe pikërisht në këtë pikë të menduarit e tyre është gabim. Ata mendojnë se – nëse fëmija i tyre do të bëhet mjek, nëse do të bëhet profesor, apo inxhinier, apo shkencëtar, atëherë ai do të jetë I lumtur. Por ata s'i kanë as dy lidhje me këtë. Fëmija i tyre mund të jetë i lumtur vetëm nëse bëhet ai që duhet të bëhet. Ai mund të zhvillohet vetëm ashtu siç është fara që bart në vetvete.

89. Gjykimi është i shëmtuar – ai lëndon njerëzit. Nga njëra anë, ti i lëndon, u shkakton plagë, kurse në anën tjetër e dëshiron dashurinë e tyre, respektin e tyre. Kjo është e pamundur. Duaji njerëzit, respektoji ndaj dashuria jote dhe respekti yt pa dyshim do të mund t'u ndihmojnë t'i ndryshojnë shumë nga dobësitë e tyre, shumë nga manitë e tyre – sepse ajo dashuri do t'u japë energji të re, mjete të reja, fuqi të re. Dashuria do t'u japë rrënjë të reja të qëndrojnë kundër frymës së fuqishme, të qëndrojnë përkundër diellit të fortë, rrebesheve të mëdha.

90. Kurdo që në pyetje është zgjedhja, koka nuk guxon të bëjë zgjedhje kundër zemrës. Zemra jote është në farefisni me ekzistencën, kurse koka jote është në farefisni me bashkësinë shoqërore.

91. Kur je i mërzitur, kjo do të thotë se je në gabim; kur je i gëzuar, kjo do të thotë se s'ke të sharë.

92. Kur të them ji i hareshëm, ji i lumtur, gëzoju faktit që nuk je në situatën të jesh fatkeq dhe i mërzitur, unë kam qëllimin e caktuar tej këtyre. Qëllimi është në atë që ti të bëhesh shembull për ata njerëz të cilët në tërësi kanë harruar se jeta gjithashtu mund të jetë GËZIM. Përkundër gjithë muzgut ti akoma mund të jesh i pangarkuar me të, akoma mund të vallëzosh. Errësira nuk mund ta pengojë vallëzimin tënd; ajo nuk do ta pengojë fuqinë. Për mua, kjo është shërbëtore e vërtetë.

93. Mendja do të duhej të mësohej t'i shërbejë mendjes. Logjika do të duhej t'i shërbente dashurisë. Vetëm atëherë jeta do të mund të bëhej festival drite.

94. Mësimi i lashtë: "Si lart, ashtu poshtë", apo thënë anasjelltas, përmban njërën nga të vërtetat më fundamentale të misticizmit.

Domethënia i kësaj është në atë se nuk ekziston as lart, as poshtë, por se ekziston vetëm një ekzistencë. Ndarjen e bën mendja. Ekzistenca është e pandarë. Ndarja është projeksion yni, dhe ne aq shumë jemi identifikuar me ndarjen saqë e kemi humbur lidhjen me tërësinë. Mendja jonë është vetëm dritare e vogël që është e hapur kundruall gjithësisë gjigante. Por nëse ti pandërprerë shikon për dritare, korniza e dritares do ta kornizojë qiellin përjashta. E duke qenë se nuk ka kornizë në qiell – ai është i pakornizuar – vështrimi yt I kornizës së dritares do të bëhet kornizë e ekzistencës.

95. Qe një shembull të vërtetë: ndodh ngan- donjëherë që njerëzit të cilët bartin syze t'i kërkojnë ato, kurse ato u qëndrojnë mbi hundë. Ata madje harrojnë se nuk mund të shohin pa syze, ndaj sillen dhe i kërkojnë, të bindur plotësisht se megjithatë do t'i shohin në ndonjë vend.

Po qe se i përdorë syzet për disa vite, pak nga pak ato bëhen pjesë jotja, ato bëhen sytë e tu. Ti për to nuk mendon si për të ndara nga ti. Kështu çdo lloj syzesh mund t'u japë ngjyrën e vet të veçantë gjërave që shikojnë. Ti je ai vështruesi tej syzeve – ato nuk mund të shikojnë të pavarura. Gjërat e jashtme nuk kanë atë ngjyrë të cilën syzet e kanë future ndërmjet, por ti ngadalë zë të identifikohesh me syzet e tua... Mendja e njeriut është po ashtu vetëm një instrument. Syzet qëndrojnë mbi kafkë, derisa mendja ndodhet në kafkë, ndaj nuk mund ta heqësh për çdo ditë. Për këtë bëhesh shumë i afërt me atë përbrenda, ashtu që vjen gjer tek identifikimi. Për këtë, çfarëdo që mendja të shohë ti mendon se është realiteti. Por mendja nuk mund ta shohë realitetin; mendja mund t'i shohë vetëm paragjykimet e veta. Ajo mund të shohë projeksionet e veta të veçanta të ekspozuara në billbordet e botës.

96. Armiku më i madh i së vërtetës në këtë botë është njeriu i ditur, kurse miku më i madh i së vërtetës është ai që di se nuk diasgjë.

97. Ne kemi qenë të shtrënguar të flasim, mendojmë, veprojmë në këtë mënyrë saqë edhe dukuritë si dashuria ka qenë dashur t'i nënshtrohen mendjes. Dashuria në esencë i përket zemrës, por e, tërë bashkësia jonë provon ta shmangë zemrën, për atë se zemra nuk është logjike, nuk është racionale, kurse mendja jonë nëpërmjet rrugës arsimore është trajnuar se është e keqe krejt ajo që është jologjike, se është e keqe krejt ajo që është irracionale, e se vetëm gjërat logjike janë të mira. Në programin tonë arsimor nuk ka pasur vend për zemrën, por vetëm për mendjen. Zemra gati se është hedhur nga ekzistenca, është shukatur. Nuk i është dhënë shansi të zhvillohet, të realizohen mundësitë e saj. Kështu që mendja ka

mbizotëruar. Mendja është e mirë kur është në pyetje paraja, kur është në pyetje lufta, mendja është e mirë kur në pyetje është ambicia, por mendja është plotësisht e padobishme kur në pyetje është dashuria. Paraja, lufta, gjakimi, ambicia – ti nuk mund ta vësh dashurinë në të njëjtën kategori me to. Dashuria ka burim të veçantë në qenien tënde, aty ku nuk ka konflikte.

98. Arsimimi autentik nuk do ta stërvitë vetëm mendjen tënde – sepse mendja mundet me të ofruar vetëm të ardhura të mira për jetë, por jo edhe jetë të mirë. Zemra, megjithatë, nuk mund të të ofrojë të ardhura të mjaftueshme për jetë, por mund të të japë jetë të mirë; nuk ka nevojë të bëhet përzgjedhje midis këtyre dyjave: shfrytëzo mendjen për atë, kurse zemrën për këtë.

99. Njerëzit religjiozë dhe afaristë, politikanët dhe luftëtarët – të gjithë këta kërkojnë mendje të stërvitur. Zemra mund të jetë e shqetësuar, ajo dëshiron të jetë e shqetësuar. Nëse je ushtar, dhe ke zemër, ti atëherë nuk do të mund ta vrasësh armikun. Në çastin kur e merr pushkën me qëllimin për të vrarë dikë, zemra jote ka për të thënë: "Siç ti ke gruan që të pret dhe ke fëmijë, nënë dhe baba – ai njeriu i shkretë po ashtu ka gruan që e pret, ka fëmijën, ka nënën dhe babanë të cilët presin që djali t'iu kthehet në shtëpi. "Ai nuk të ka bërë asgjë të keqe, kurse ti po synon ta vrasësh. Përse? Për të marrë medalje nga akademia ushtarake? Që kjo të festohet?

100. Kur mendon mbi atë se shoqëria mund të bëhet shoqëri ideale, parajsë, kjo të duket e pamundur. Në të ka aq shumë konflikte ndaj duket sikur nuk ka mënyrë që ato të harmonizohen. Ta harmonizosh bashkësinë njerëzore është e mundur, do të duhej të ishte e mundur, shkaku se bashkësia e tillë do të ishte rasti më i mirë që secili t'i zhvillojë potencialet e veta, rasti më i mirë që secili të jetë i vetvetes. Mundësitë më të mira do të ishin të arritshme për gjithsecilin. Edhe pse duket se ekziston mënyra e duhur, bashkësia mbetet plotësisht marroqe. Utopistët nuk janë ëndërrimtarë, por janë të ashtuquajturit realistët tuaj të marrë, të cilët i gjykojnë utopistët. Por edhe të parët, edhe të dytët, pajtohen në pikën e njëjtë – se diçka duhet bërë me bashkësinë. Të gjithë këta janë të brengosur me bashkësinë – dhe pikërisht në këtë pikë ndodhet gabimi i tyre. Siç unë e shoh, utopia nuk është diçka që nuk do të mund të realizohej – ajo është diçka që është e realizueshme, por duhet shkuar gjer tek shkaku, e jo gjer tek simptoma. Atëherë kemi për ta kuptuar se shkaku është në individin, dhe jo në shoqërinë.

101. Njeriu ka harruar çka ai vërtet është. Ai është bërë gati se i autohipnotizuar me idetë e caktuara mbi vetveten dhe ato ide ai i bart gjatë gjithë jetës së tij, duke mos kuptuar se ato ide nuk janë vetë ai, por se ato janë vetëm hija e tij. E nuk mund t'i japësh kuptim hijes tënde.

102. Nuk ka nevojë për kurrfarë lufte, për kurrfarë beteje, xhelozie, urrejtje. Jeta është aq e shkurtër, kurse dashuria aq e çmueshme. Dhe kurdo që je në mundësi, mbushe jetën tënde me dashuri, me harmoni, me gëzim;

kurdo që je në mundësi, bëj nga jeta poezi për veten – madjeedhe nëse e huq, vetëm ti je përgjegjës për këtë, askush tjetër. Kuptoje vetëm një gjë: nevojitet një kuptim i thjeshtë e që t'i pengosh forcat e errësirës, të negativitetit, destruksionit të të tërheqin teposhtë. Vetëm pak zgjuarsi nevojitet që t'i përkushtohesh krijimtarisë, dashurisë, përdëllimit - ashtu që nga kjo jetë e imët të bësh gërshetë këngësh – që ajo të jetë vallëzim, kurse vdekja jote të jetë kreshendo e vallëzimit tënd; të jetosh në plotëni dhe të vdesësh në plotëni, pa mërzi, veçse i gëzuar dhe falënderues ekzistencës.

103. Ajo çfarë gjatë një mijë vjetëve të kaluara burri i ka bërë gruas, thënë thjesht, është monstruoze. Ajo nuk ka guxuar të mendojë për veten se është e barabartë me burrin. Dhe ky kushtëzim është mbjellë aq thellë në të saqë madje edhe po i thatë se është e barabartë me ju, ajo nuk do të mund të besojë në këtë. Kjo është rrënjëzuar në mendjen e saj, domethënë, ky kushtëzim është bërë vetë mendja e saj – se ajo është më e ulët në çdo gjë - ashtu si për nga forca fizike, ashtu edhe për nga kualitetet intelektuale. Kurse burri që e ka sjellë gruan në një gjendje të tillë, ai nuk mund as ta dojë. Dashuria mund të ekzistojë vetëm në barazi, vetëm në miqësi.

104. Po qe se e kërkon pikëpamjen time të dashurisë... atëherë më nuk do të ketë fjalë mbi dialektikën, mbi kundërshtitë. Mashkulli dhe femra janë të ndryshëm, por edhe komplementarë. Mashkulli është njëra gjysmë, femra tjetra. Vetëm së bashku, në ndjenjën e thellë të njëjtësisë, ata do të bëjnë që për të parën herë ta ndjejnë plotësinë, përsosmërinë.

105. Evolucioni vepron përmes polariteteve. Pikërisht si ti që nuk mund të ecësh vetëm në njërën këmbë, porse të nevojiten dy, ashtu edhe ekzistencës i nevojiten polet e të kundërtave – burri dhe gruaja, jeta dhe vdekja, dashuria dhe urrejtja – për të krijuar vrull; në të kundërtën krejt do të ishte e vdekur. Nga njëra anë kundërshtia të tërheqë, kurse nga ana tjetër bën që të ndjehesh i varur. Ndërkaq, askush nuk dëshiron të jetë i varur; prandaj, ekziston lufta e pandërprerë në mesin e dashnorëve. Ata provojnë të dominojnë njëra palë mbi tjetrën. Ajo është dashuri vetëm për nga emri, derisa esenca e asaj loje në të vërtetë është politika. Mashkulli investon tepër shumë përpjekje në atë që ta nënshtrojë gruan, për ta sjellë në pozitë inferiore, për t'ia pamundësuar zhvillimin që të mbetet vazhdimisht e retarduar. Çlirimi i gruas nga robërimi do të jetë gjithashtu liri edhe për burrin, që të shijojë diçka të re. Prandaj unë them se Lëvizja për Çlirimin e Gruas nuk është vetëm liri për gratë, ajo është po ashtu edhe lëvizje për çlirimin e meshkujve: të dy do të jenë të çliruar. Robëria prangos edhe mashkullin edhe femrën, prandaj ekziston lufta e pandërprerë në mes tyre. Gruaja ka gjetur strategjinë e vet personale e cila bazohet në atë që ta atakojë burrin, që ta mërzisë, që ta pengojë; mashkulli, prapë, ka strategjinë e vet. Dhe në mes të këtyre dy fuqive ndërluftuese ne kemi shpresuar se ka për të ndodhur dashuria. Shekujt kanë kaluar dashuria nuk ka ndodhur,

përveçse ngandonjëherë. E këtillë është situata në dashuritë e përçdoditshme, të cilat vetëm sa quhen ashtu, por realisht nuk janë ajo.

106. Secili dëshiron të jetë i dashuruar. Por kjo vetëm sa flet mbi edukatën e gabuar. E ajo zë fill ashtu që fëmija, fëmija i vogël, nuk guxon të dojë, nuk guxon të thotë asgjë, nuk guxon të bëjë asgjë, nuk guxon të ofrojë asgjë – ai guxon vetëm të fitojë. Përvoja e dashurisë të fëmijës së vogël është te fitimi – fitim nga nëna, fitim nga babai, fitim nga vëllezërit, motrat, fitim nga mysafirët, të huajt, por përherë është vetëm fitimi. Kjo është përvoja e tij e parë, thellësisht e ngulitur në ndërdijen e tij – se duhet vetëm ta fitojë dashurinë. Por problemet shfaqen shkaku i asaj se secili prej nesh ka qenë fëmijë, dhe shkaku i asaj se secili ka nevojë të njëjtë për ta fituar dashurinë; e askush nuk ka lindur me kod tjetërfare. Së këndejmi të gjithë kërkojnë: "Na jepni dashuri", e nuk ekziston ai që do ta japë, meqë edhe personat tjerë janë të edukuar në të njëjtën mënyrë. Prandaj njeriu do duhej të kthjellet dhe të bëhet i vetëdijshëm se një rast, siç është të lindurit, nuk guxon të mbetet gjendje vazhdimisht mbizotëruese e mendjes së tij. Në vend se të kërkojë: "Më jepni dashuri", duhet të fillojë të japë dashuri. Harrojeni fitimin, vetëm jepni dhe unë ju garantoj – keni për të fituar shumë.

107. Nëse mund të duash pa xhelozi, nëse mund të duash pa posesivitet, nëse mund ta duash ndonjë person aq shumë saqë lumturia e tij me qenë edhe lumturia jote – madje edhe po qe se ai, i dashuri yt, ta zëmë, do të ishte i lumtur me ndonjë femër tjetër, kjo edhe ty me të bërë të lumtur, sepse e do aq shumë. Ti do të ishe e lumtur shkaku se ai është i lumtur, dhe ti do t'i ishe falënderuese femrës e cila ka bërë që personi, të cilin ti e do, të jetë e lumtur – e nuk do të ishe xheloze. Vetëm në këtë mënyrë dashuria do të spastrohet. Dashuria e këtillë nuk mund të krijojë pranga. Ajo thjesht ua hap zemrën të gjitha erërave dhe gjithë qiellit.

108. Xhelozia është fenomen tepër i ndërlikuar. Ajo përmban shumë përbërës në vetvete. Qyqanllëku është njëri prej tyre; egoizmi i dyti; mandej aty është edhe dëshira për monopol – në të cilën nuk ka kurrfarë përvoje të dashurisë por vetëm të posesivitetit; mandej tendenca kah rivaliteti, si dhe frika thellë e rrënjëzuar nga ajo se do të jesh i varur në lidhje. Aq shumë gjëra janë të përfshira në xhelozi.

109. Rreziku do të duhej të ishte një nga parimet kryesore të njeriut të vërtetë. Kur sheh se gjërat kanë ngecur, ti shkundi ato.

110. Ti je vetëm turmë, vetëm shumësi. Nëse shikon më sinqerisht, më thellë në vetvete, ke për të parë atje shumë njerëz. Të gjithë ata kohë pas kohe shtiren si ti, të aktrojnë ty. Kur zemërohesh, për shembull, personi i caktuar të posedon dhe të aktron ty. Kur dashuron, po ashtu, personi tjetër të posedon dhe aktron. Jo vetëm se është rrëmujë në ty, rrëmujë është edhe në secilin prej atyre që vjen në kontakt me ty, sepse nuk do të mund të luajë lojë zaresh. Secili prej tyre atëherë edhe vetë bëhet turmë. Kështu

edhe në çdo lidhje dashurie, martesë nuk lidhin dy persona, veçse dy turma. Nga kjo lind lufta e madhe e cila zhvillohet pandërprerë, shkaku se rrallë ndodh – krejt rastësisht – që, ta zëmë, personit tënd të dashur, t'i bijë çdo gjë me masë dhe ty çdo gjë me masë. Në gjithë situatat tjera ti dështon. Ty të ka ardhur qejfi për dashuri, por personi yt i dashur është e pikëlluar apo e hidhëruar apo e brengosur. Ndodh dhe anasjelltas, asaj i ka rënë qejfi për dashuri, por ty jo, dhe nuk ekziston mënyra të harmonizosh gjithë ato personalitete, sepse ato sillen e mbështillen sipas trilleve të veta personale.

111. E vetmja vendlindje e vërtetë është ajo që gjejmë në vetvete.

112. Dhënia e dashurisë është përvojë vërtet e mrekullueshme, se ti atëherë je si perandor. Pranimi i dashurisë është përvojë tepër e imët, dhe ajo është përvojë lypsaraku. Mos u bëj lypsar. Së paku sa i përket dashurisë, ji perandor, se dashuria është kualitet i pashterueshëm në ty; mund të vazhdosh të japësh sa të duash. Mos u frikëso se ajo do të shterojë, se një ditë befas do të kuptosh: "Imzot, më fare nuk kam dashuri për tëdhënë". Dashuria nuk është sasi, ajo është kualitet, kualitet i llojit të caktuar që rritet me dhënien, dhe vdes po qe se e mban. Nëse je koprrac në dhënie, ajo vdes. Prandaj ji shkapërdar i vërtetë, shpenzues pa masë! Mos u lodh me pyetjen se kujt po i jep. Vetëm mendja koprrace e ka idenë se do t'u "jap personave të caktuar me veti të caktuara". Ti nuk po e kupton se ke tepër shumë, se je si re shiu. Reja e shiut nuk pyet se kah do ta lëshojë shiun – në shkëmbinj, në kopshtie, oqeane – kjo për të nuk ka rëndësi. Ajo dëshiron të shkarkohet, dhe ajo shkarkesë është lehtësim i madh. Për këtë, e fshehta e parë është në atë që të mos kërkosh dashuri. Mos prit, duke menduar se ke me dhënë nëse dikush do ta kërkojë – por jepe!

113. Gjëja më themelore të cilën do duhej mbajtur mend është: "kur të ndjehesh mirë, kur je në disponim ekstatik, mos fillo të mendosh se ajo do të jetë gjendje jotja e vazhdueshme. Jetoje atë moment me gëzim, sa më hareshëm që është e mundur, duke e ditur përsosmërisht mirë se ai ka ardhur dhe se do të shkojë – pikërisht siç puhiza hyn në shtëpinë tënde, me gjithë aromën dhe freskinë e saj, dhe del në derën tjetër. Nëse zë të preokupohesh se si çastet e tua ekstatike t'i bësh të vazhdueshme, veç ke filluar t'i shkatërrosh. Kur të vijnë, ji falënderues; kur shkojnë, falënderoju ekzistencës. Qëndro I hapur. Kjo ka për të ndodhur shumë herë. Mos gjyko, mos ji nazeli, qëndro pa zgjedhje. Po, do të ketë çaste kur do të ndjehesh fatmjerë. E çfarë do të thuash? Ka njerëz që janë të mjerë e të cilët kurrë nuk kanë njohur asnjë çast ekstaze. Ti je i lumtur. Madje edhe në mjerimin tënd, kujtohu se ai nuk do të jetë i vazhdueshëm; edhe ai do të shkojë. Pikërisht për këtë le të të mos shqetësojë. Qëndro i relaksuar. Mu siç ekziston dita dhe nata, ekzistojnë edhe çastet e gëzimit edhe çastet e pikëllimit. Pranoji si pjesë të dysisë së natyrës, si mënyrë në të cilën bota ekziston. Kurse ti thjesht je vështrues; ti nuk bëhesh as lumturia as

pikëllimi. Lumturia vjen e shkon, pikëllimi vjen e shkon. Një gjë përherë mbetet, përherë e përherë – e ai është vështruesi, ai që dëshmon.

114. Meditimi merret me vetë bërthamën esenciale të qenies tënde, e cila nuk mund të ndahet në mashkullore e femërore. Vetëdija është thjesht vetëdije. Pasqyra është pasqyrë – ajo nuk është mashkullore, ajo nuk është femërore, ajo thjesht pasqyron. Vetëdija është mu si pasqyra që pasqyron. Kurse meditimi i lejon pasqyrës tënde të pasqyrojë, që thjesht ta pasqyrojë mendjen në aksion, trupin në aksion. S'ka rëndësi se a është ai trup mashkull apo femër, nuk është me rëndësi sesi mendja funksionon – emocionalisht apo logjikisht. Sido që të jetë, vetëdija vetëm duhet të kujdeset për to. Ai kujdes, ajo vetëdije, është meditimi.

115. Ngadalë, ngadalë, gjithnjë e më shumë përqendrohu në vështruesin. Do të vinë ditët e do të vinë netët, do të vinë jetët e do të vinë vdekjet, do të vijë suksesi, do të vijë pasuksesi. Por po qe se je i përqendruar në vështruesin – meqë ky është realiteti i vetëm në ty – të gjitha këto janë fenomene kalimtare. Së paku për një çast provo ta ndjesh këtë që po flas: thjesht ji vështrues. Mos u lidh për asnjë çast sepse është i bukur dhe mos e hidh asnjë çast sepse është i mjerë. Ndërprite ta bësh këtë. Këtë e ke bërë gjatë shumë jetëve dhe akoma nuk ke pasur sukses në këtë, dhe kurrë s'do të kesh. E vetmja mënyrë që t'i tejkalosh të gjitha është të mbetesh në të andejmen e çdo gjëje, të gjesh vendin prej nga mund t'i vështrosh të gjitha këto dukuri të ndryshueshme, e që të mos identifikohesh (me to).

116. Përvoja vjen dhe shkon – mos u mbështet në të. Po qe se nuk e ke zbuluar atë i cili e ndjen gëzimin, i cili e ndjen dhembjen, i cili e ndjen shëndetin, i cili e ndjen pikëllimin, atë I cili është ajo vetëdije... Do të duhej të jepje krejt nga vetja të zësh vetë qendrën e ciklonit. E tërë qenia jote është ciklon ndryshimi, skena të cilat ndryshojnë, ngjyra të cilat ndryshojnë: por, pikërisht në mesin e këtij cikloni ekziston qendra e qetë. Aty je ti.

117. Kur njëherë identifikohesh me ndonjë ide, ti je i sëmurë. Çdo identifikim është sëmundje mentale. Në të vërtetë, mendja është sëmundja jote. Ta lësh mendjen anash dhe thjesht të shikosh realitetin – pa kurrfarë mendimi, pa kurrfarë paragjykimi – kjo është mënyrë e shëndoshë për t'u njohur me realitetin. Ashtu do të zbulosh realitet plotësisht të ri. Zbulimi i dëshirës së vërtetë ka me të liruar nga shumë marrëzi, nga shumë besëtytni. Ajo do ta pastrojë zemrën tënde prej çfarëdo plehu që brezat e kanë hedhur në ty. Sëmundjet barten nga brezi në brez; ti e trashëgon gjithë të kaluarën me të gjitha idetë e saj të marra. Përndryshe, nuk do të ishin ndryshimet, nuk do të ishin krahasimet. E kur njëherë çlirohesh prej krahasimit, ti je i lehtë, e tërë qenia jote është e lehtë. E humb gjithë rëndesën tënde. Bëhesh aq i lehtë saqë mund t'i hapësh krahët e të fluturosh.

118. Çdo gjë shkon, por ti mbetesh – ti je realiteti. E tëra është vetëm ëndërr: ka ëndrra të mrekullueshme, ka ankthe. Por nuk ka rëndësi se a kemi të bëjmë me ëndërr të bukur apo me ankthin, i rëndësishëm është ai që e sheh atë ëndërr. Ai vështrues është i vetmi realitet. Ai vështrues është diçka absolutisht e përjetshme. Vetëm pak qasje në të dhe gjithë problemet e tua do të fillojnë të zhduken, se do të shfaqet një perspektivë plotësisht e re, një vizion i ri, një mënyrë e re jetese, një mënyrë e re e shikimit të gjërave, e shikimit të njerëzve, të reaksioneve, të situatave. E ai vështrues është përherë i pranishëm, njëzet e katër orë në ditë. Çfarëdo të bësh apo të mos bësh, ai është aty. Ka qenë aty me shekuj, gjatë përjetësisë, duke pritur që atë ta vëresh. Ndoshta e ke harruar pikërisht shkaku se përherë ka qenë aty. Është e qartë se ai përherë harrohet – kujtoje. Kur ndjen mirëqenien, euforinë, kujtoje. Kur je në mjerim, në mundime, kujtoje. Në të gjithë nënqiejt, në të gjitha disponimet, vazhdo ta kujtosh. Së frikti do të jesh në gjendje të mbetesh i përqendruar në të, nuk do të ketë nevojë ta kujtosh. E ajo është dita më e madhe në jetën e njeriut.

119. Po të them, nuk ka të keqe dhe nuk ka forca të këqija në botë. Ekzistojnë vetëm njerëzit e vetëdijshëm dhe ekzistojnë njerëzit që thellësisht flenë – kurse gjumi nuk ka fuqi. E tërë energjia është në duart e njerëzve të zgjuar. Kurse një njeri i zgjuar mund ta zgjojë gjithë botën. Një qiri i ndezur mund të ndezë miliona qirinj, e që dritën e vet të mos e humbas.

120. Hidhërimi e ushqen egon – për këtë shohim aq shumë njerëz të mjerë në botë. Pika e tyre themelore, qendrore është egoja.

121. Për ta kuptuar dashurinë, së pari do të duhej të duash: vetëm atëherë mund ta kuptosh dashurinë. Miliona njerëz vuajnë; ata dëshirojnë të jenë të dashur, por nuk dinë sesi të duan. Kurse dashuria nuk mund të ekzistojë si monolog; ajo është dialog, një dialog tejet harmonik. Nuk sjell kënaqësi ajo që njerëzit të japin, kënaqësi sjell ajo që ti u jep njerëzve. Nuk mund të jesh i kënaqur që do të jesh lypsar, por se do të jesh perandor. Ti mund të japish aq shumë, aq pashterueshëm, saqë sa më shumë që jep, aq më e rafinuar, më e kulturuar, më aromatike bëhet dashuria jote.

122. Atë çast kur e kupton se ç'është dashuria – kur e përjeton se ç'është dashuria – ti bëhesh dashuri. Atëherë nuk ka nevojë që të jesh i dashur dhe nuk do të ketë detyrime në ty që të duash: dashuri do të jetë ekzistenca jote e thjeshtë, spontane, vetë frymëmarrja jote. Nuk do të mund të bësh asgjë tjetër, por fare thjesht ke për të dashur. Tash, po qe se dashuria nuk të vjen si kundërshpërblim, nuk do të ndjehesh i lënduar, thjesht shkaku i asaj se vetëm personi që është bërë dashuri mund të dojë. Mund të japësh vetëm atë që ke. Ti kërkon prej njerëzve të të duan – prej njerëzve që nuk kanë dashuri në jetën e tyre, të cilët nuk kanë arritur gjer tek burimi I qenies së tyre, ku dashuria ka altarin e vet. E si mund të duan ata? Ata mund të shtiren. Ata mund të thonë se po të duan. Ata madje

edhe mund t'i besojnë kësaj. Por, herët apo vonë ka për t'u ditur se ajo është vetëm shtirje, se ajo është vetëm aktrim, se ajo është vetëm hipokrizi.

Ndoshta ata nuk e kanë për qëllim me të mashtruar, por ç'mund të bëjnë? Ti kërkon dashuri, edhe personi tjetër po ashtu e do dashurinë. Që të dytë këtë e kuptoni – se mund të merrni dashuri vetëm kur prej jush pritet që të doni – ndaj që të dytë përpiqeni në çdo mënyrë. Ajo është pozë, por ajo pozë është e zbrazët. Që të dytë keni për ta zbuluar këtë dhe që të dytë keni për t'iu ankuar njëri-tjetrit se kjo nuk është e drejtë. Që nga fillimi, kemi pasur të bëjmë me dy lypsarë të cilët lypin njëri prej tjetrit, e që të dytë kanë çinitë e zbrazëta prej lypsari.

123. Egoja është robëria më e madhe, i vetmi ferr për të cilin unë di.

124. Ata të cilët e kanë zbuluar burimin e dashurisë në vetvete, më nuk kanë nevojë që të jenë të dashur – sepse ata do të japin dashuri. Ata do të duan vetëm shkaku i asaj se dashuri kanë edhe tepër – mu siç reja e shiut dëshiron ta lëshojë shiun, mu siç lulja dëshiron ta lirojë aromën e saj, pa dëshirën që çfarëdo qoftë të fitojë. Shpërblimi për dashurinë është në dhënien e dashurisë, jo në marrjen e dashurisë. Kurse ekzistojnë edhe misteret e jetës që, po qe se dikush me të drejtë është i shpërblyer me atë që t'i dojë të tjerët, shumë do ta donë atë, sepse, pasi që janë në kontakt me të, ngadalë do të fillojnë ta zbulojnë atë burim në vete. Tani ata e njohin së paku një person i cili shfaq dashuri e dashuria e të cilit nuk buron prej kurrfarë nevoje. E sa më tepër që ai jep dhe shpërndan pa hesap dashurinë e vet, aq më tepër ajo rritet.

125. Mos mendo mbi të vërtetën si mbi objektin – ajo nuk është objekt. Ajo nuk është atje – ajo është këtu.

126. Mendja funksionon në mënyrën ose-ose; ose kjo mund të jetë e saktë, ose mund të jetë e saktë ajo që është e kundërt. Sa i përket mendjes, logjikës së saj, rracionalitetit të saj, të dyja gjërat nuk mund të jenë të sakta. Zemra nuk ka logjikë, veçse ndjeshmëri, mirëkuptim. Ajo mund të shohë jo vetëm se ato dy gjëra mund të jenë së bashku, por se, në të vërtetë, ato edhe nuk janë dy. Ajo është vetëm një dukuri, e parë nga dy aspekte të ndryshme. E po qe se kemi të bëjmë me zgjedhjen midis mendjes dhe zemrës, zemra ka përherë të drejtë, sepse mendja është sajesë e shoqërisë. Ajo ka lindur me arsimimin. Ta ka dhënë shoqëria, dhe jo ekzistenca. Zemra është e pandotur. Zemra është ekzistencë e pastër, ndaj së andejmi ka mirëkuptim. Shiko nga perspektiva e zemrës, dhe kundërshtitë do të zënë të shkrihen mu si akulli.

127. Po të them: për të qenë një me universin, ti duhet të zhdukesh, dhe e lejon ekzistencën që të jetë. Thjesht duhet të mungosh, që qenia të jetë e pranishme në tërësinë e vet. Por, personi për të cilin them se duhet të zhduket nuk është 'ti' i vërtetë, ai është vetëm personaliteti yt; ajo është vetëm një ide në ty. Në realitet ti veç je një me ekzistencën. Nuk mund të ekzistosh në kurrfarë mënyre tjetër – ti je ekzistencë. Por, personaliteti

krijon mashtrimin dhe bën që të ndjehesh i ndarë. Ti mund të supozosh se je i ndarë – ekzistenca ta jep lirinë e plotë, madje edhe që të jesh kundër saj. Ti mund të mendosh mbi veten si mbi entitetin e ndarë, egon. E kjo është pengesa që të pengon të shkrihesh me hapësirën që të rrethon në çdo moment.

128. Kur sodit perëndimin e Diellit, së paku për një sekondë ti e harron ndasinë tënde: ti je perëndimi i Diellit. Ai është çasti kur e ndjen bukurinë e tij. Por, atë çast kur thua se ai është perëndim i mrekullueshëm i Diellit, ti më nuk e ndjen; i je kthyer entitetit tënd të veçantë, të mbyllur të egos. Tani mendja flet. Dhe ky është një nga misteret – se mendja mund të flasë, e nuk di asgjë; kurse zemra i di të gjitha, e nuk mund të flasë. Ndoshta është vështirë të flitet nëse edhe di së tepërmi; e mendja di aq pak, ndaj mund të flasë. Asaj i mjafton gjuha, por zemrës jo. Por nganjëherë, nën mbresën e çastit të caktuar – natës me yje, daljes së diellit, lules së bukur – së paku për një çast ti harron se je i ndarë. E madje edhe harresa ndaj saj liron bukuri të madhe dhe ekstazë.

129. Në jetë asgjë nuk është e qëndrueshme, asgjë nuk mund të jetë e qëndrueshme. Ti nuk je në mundësi që çfarëdo qoftë të bësh të qëndrueshme. Vetëm gjërat e vdekura mund të jenë të qëndrueshme. Sa më e gjallë që të jetë një gjë, aq më kalimtare është. Sot është dashuria e pranishme, nesër kushedi; ndoshta do të jetë aty, ndoshta jo. Nuk je në mundësinë që ta kontrollosh. Ajo është ndodhi. Ti nuk mund të bësh asgjë; nuk mund ta krijosh nëse nuk është e pranishme. Ose është e pranishme ose nuk është e pranishme – ti këtu thjesht je i pandihmë. Guri mund të jetë i qëndrueshëm. Lulja nuk mundet. E dashuria nuk është gur. Ajo është lule, dhe atë shumë e veçantë.

130. Zemra është tejkalim i dualiteteve. Zemra i sheh gjërat me dashamirësi, kurse dashuria është vetia e saj e natyrshme – jo diçka të cilën do të duhej mësuar. E kjo dashuri nuk e ka urrejtjen si moshatare të veten.

131. Ti mund t'i tejkalosh dualitetet e vetive dashuri – urrejtje.

Në këtë çast, ato në jetën tënde shkojnë dorë për dore. Ti e do të njëjtin person të cilin njëkohësisht edhe e urren, ndaj në mëngjes aty është urrejtja, kurse në mbrëmje dashuria – e kjo shkakton konfuzion të madh. Ti madje as nuk e kupton se po e dashuron apo urren atë person, meqë i bën që të dyja këto gjëra në mënyrë alternative. Por, kështu funksionon mendja; ajo funksionon përmes kundërthënieve. Evolucionigjithashtu vepron rrugës së të kundërtave, por ato të kundërta në ekzistencë nuk janë kundërthënëse, ato plotësohen.

132. Urrejtja po ashtu është një lloj dashurie e cila është e kthyer kokëposhtë.

133. Dashuria që vjen nga mendja është përherë dashuriurrejtje. Ato nuk janë dy fjalë, veçse një fjalë: "dashuriurrejtje"– nuk i ndan madje as vijëza. Kurse dashuria që vjen prej zemrës sate është përmbi të gjitha

dualitetet... Të gjithë gjurmojnë pas kësaj dashurie e cila tejkalon dashurinë dhe urrejtjen – por e kërkojnë me mendjen, prandaj për këtë janë të mjerë. Çdo dashnor e ndjen pasuksesin, mashtrimin, tradhtinë, por kjo nuk është faji i askujt. Në realitet ti përdor instrument të gabueshëm. Kjo është si kur dikush do t'I shfrytëzonte sytë për të dëgjuar muzikë, e pastaj të nervozohej pse nuk ka muzikë. Por, sytë nuk janë të dedikuar për dëgjim, mu ashtu siç veshët nuk janë të dedikuar për shikim. Mendja është shumë afariste, mekanizëm llogaribërës; ajo s'ka të bëjë asgjë me dashurinë. Dashuria do të ishte kaos, ajo do t'i çrregullontetë gjitha në të. Zemra nuk ka të bëjëasgjë me punën – ajo është përherë në pushim. Ajo mund të dojë, dhe atë të dojë ashtu që dashuria e saj kurrë mos të kthehet në urrejtje; ajo nuk ka helm të urrejtjes. Të gjithë e kërkojnë dashurinë, por thjesht me instrument të gabuar: prandaj gjithë ky pasukses në botë. Dhe shkallë-shkallë, shkallë-shkallë, pasi shohin se dashuria sjell vetëm mërzi, njerëzit mbyllen: "Dashuria është absurditet i plotë". Ata krijojnë mur të trashë ndaj dashurisë. Por, ata do t'i huqin të gjitha gëzimet e jetës, do të huqin çdo gjë që vlen...

134. Miqësia është dashuria më e pastër. Ajo është trajta më e lartë e dashurisë – në të cilën asgjë nuk kërkohet, s'ka kushte, ku njeriu thjesht kënaqet duke dhënë. Ai edhe merr shumë; por, kjo është sekondare dhe ndodh vetëm spontanisht.

135. Guximi më i madh është të jetosh pa ardhmëri. Vetëm, qyqet jetojnë në të ardhmen. E kaluara e njeriut ka qenë tejet qyqare. Ai ka jetuar jo në të tashmen, veçse në të ardhmen: "Krejt çka duhet të ndodhë, do të ndodhë nesër". Dhe kështu njerëzit kanë jetuar dhe kështu kanë vdekur. Ajo që kanë pritur kurrë nuk ka ndodhur: është dëshmuar se ajo është pritje e Godosë. E tashmja ka mbetur e pahulumtuar, e pajetuar – e ajo është i vetmi realitet që ekziston.

136. Lejo që jeta jote të jetë pikërisht e tillë siç dëshiron të jetë vdekja jote – meqë vdekja nukështë e ndarë nga jeta. Vdekja nuk është fund i jetës, ajo është vetëm ndryshim. Jeta vazhdon, ka vazhduar dhe përgjithmonë do të vazhdojë. Por, format janë bërë të papërdorshme, më tepër barrë sesa gëzim: atëherë më mirë është t'i jepet jetës trajtë e re, e freskët. Vdekja është bekim, e jo mallkim.

137. Metoda më e zakonshme e meditimit është thjesht qëndrimi i vështruesit. Ka njëqind edymbëdhjetë mënyra meditimi, por të vështruaritështë pjesa esenciale e gjithë njëqind e dymbëdhjetë metodave. Prandaj, sa më përket mua, vështrimi është metoda e vetme. Ato njëqind e dymbëdhjetë metoda janë zbatim I ndryshëm i të vështruarit. Preokupimi esencial, vetë fryma e meditimit, është që të mësosh sesi të vështrosh. Ti e shikon drurin; ti je këtu, druri është atje, po a nuk mund të kuptosh edhe diçka? – se derisa e shikon drurin, në ty ekzistonvështruesi i cili sheh se ti

po e shikon drurin. Bota nuk është e ndarë vetëm në objektdhe subjekt. Ekziston diçka që i tejkalon – e kjo është meditimi.

138. Të jesh i pastrehë do të thotë të jesh i lirë, ajo është liria. Ajo do të thotë se nuk ka ngujim, nuk je i lidhur me asgjë nga jashtë: domethënë se nuk ke nevojë të marrësh ndonjë ngrohtësi nga jashtë, por se ngrohtësia jote është në ty. Ti e ke burimin e asaj ngrohtësie; më shumë se aq ty nuk të nevojitet. Prandaj, kurdo që je pa shtëpi, për habi të mrekullueshme, ti je në shtëpi.

139. Njerëzit që kërkojnë shtëpi përherë bien në dëshpërim, dhe në fund do të ndjejnë: "Të mashtruar jemi, jeta na ka mashtruar. Disi na e ka dhënë dëshirën të kërkojmë shtëpi – kurse shtëpi fare nuk ka, ajo thjesht nuk ekziston". Ne përpiqemi të krijojmë shtëpi në të gjitha mënyrat e mundshme: dikush gjen burrë, dikush gjen grua, lind fëmijë... Njeriu provon të krijojë familje – domethënë, shtëpi psikologjike. Njeriu jo vetëm se ndërton shtëpi, por tenton që prej saj të bëjë ndonjë farë qenie të gjallë. Njeriu provon ta ndërtojë shtëpinë në harmoni me ëndrrat e veta, të cilat do të jenë mbushje me ngrohtësi në këtë ftohtësi... Kurse ftohtësia e ekzistencës është e madhe. I tërë universi është i ftohtë, aq indiferent, saqë ti dëshiron të krijosh pak strehë për veten në të cilën mund të ndjesh se je i siguruar, se diçka po të mbron, se është ajo diçka që të përket ty, se ti je pronar, e jo bredhëritës i pastrehë. Por, në realitet kjo ide ka me të sjellë ankth, pasi që një ditë do të zbulosh se je i huaj në raport me burrin me të cilin ke jetuar, me gruan me të cilën ke jetuar. Madje edhe pasi që të keni mbijetuar së bashku pesëdhjetë vjet, ai tëhuajësim nuk është zhdukur; përkundrazi, ai është zgjuar. Më pak keni qenë të huaj ditën e parë kur jeni takuar.

140. Koha ka kaluar dhe ju keni qenë së bashku, jeni bërë gjithnjë e më tepër të huaj për njëri-tjetrin, sepse gjithnjë e më tepër e më tepër e keni njohur njëri-tjetrin – kurse tash fare nuk e kupton se kush është ai personi tjetër. Sa më tepër që e ke njohur, aq më pak di për të. Duket sikur sa më shumë që e ke njohur dikë, aq më i vetëdijshëm je bërë se padituria jote për të është absolute; nuk ka mënyrë që ta shfuqizosh atë.

Fëmijët e tu – menduar ke se ata janë fëmijët e tu, e një ditë ke për ta zbuluar se ata nuk janë fëmijët e tu. Ti ke qenë vetëm shtegu nëpër të cilin ata kanë ardhur. Ata e kanë jetën e tyre të veçantë - ata janë plotësisht të huaj. Ata nuk të përkasin. Ata do të gjejnë rrugët e veta dhe jetën e vet. Kush është me ty? Askush nuk është me askënd. Ti je përherë në turmë, por vetëm. E është krejt një se a je vetëm apo në turmë, është krejt një se a je në shtëpi apo thjesht je bredhacak.

141. Për egon, vetmia kurrë nuk është gëzim. Egoja jeton vetëm kur dikë e nënshtron, kur mund të thotë: "Jam më i lartë se ti, jam më i madh ti". Egoja kurrë nuk mund të kënaqet në vetmi; e ç'kuptim ka të kesh ego në vetmi?

142. Jeto dhe dashuro, dhe dashuro plotësisht dhe fuqishëm – por kurrë në dëm të lirisë. Liria duhet të mbetet vlera më e lartë.

143. Gjithmonë na kanë mësuar se dashuria është marrëdhënie, ndaj jemi mësuar me këtë ide. Por kjo nuk është e vërtetë. Ky është lloji më i ulët i dashurisë – tepër e ndotur. Dashuria është gjendje e qenies.

144. Çdoherë kur njeriu kupton ndonjë pjesë të së vërtetës, në zemrën e tij diçka zë të luajë. Zemra është i vetmi argument i së vërtetës. E ajo nuk mund t'i dëshmojë fjalët e vërteta. Zemra mund të dëshmojë në mënyrën e vet të veçantë: nëpërmjet dashurisë, nëpërmjet lojës, nëpërmjet muzikës – joverbalisht. Ajo flet, por nuk flet me gjuhë dhe me logjikë.

145. Koha është gjithmonë e pasigurt. Kjo është problem me mendjen: mendja do siguri – kurse koha është gjithmonë e pasigurt. Prandaj, kur mendja në koincidencë të plotë gjen një pjesëz të sigurisë, ajo ndjehet e shtëpisë; e rrethon një lloj qëndrueshmërie iluzore. E prirur është të harrojë natyrën e vërtetë të ekzistencës dhe jetës: ajo zë të jetojë në një lloj bote nga ëndrrat, e cila fillon të marrë dukje të realitetit. Kjo ia kënda mendjes, se mendja përherë u frikësohet ndryshimeve, nga arsyeja e thjeshtë se nuk di çfarë do të sjellë ndryshimi: mirë apo keq. Një gjë është e sigurt, se ndryshimi ka për të fshirë botën tënde të iluzioneve, pritjeve, ëndrrave. Mendja është mu si fëmija i cili luan në bregun e detit, duke bërë kështjella prej rëre. Një çast duket sikur pallati është i kryer, por është i bërë nga rëra që zhbëhet. Në çdo rast mjafton një puhi e që ajo të rrënohet të bëhet thërrmija. Por, ne zëmë të jetojmë në atë pallat prej rëre. Zëmë të ndjejmë sikur kemi gjetur diçka që gjithmonë do të mbetet me ne. Ndërkaq, koha pandërprerë vazhdon ta pengojë mendjen tonë. Kjo duket e vështirë, por ekzistenca në të vërtetë është tejet e mëshirshme, se përherë mbetet me ne. Ajo nuk na lejon që të ndërtojmë realitet nga fanitjet. Ajo nuk na e jep shansin të pranojmë maskat si fytyrë tonën të vërtetë, si fytyrë

tonën burimore.

146. Njerëzit mendojnë se ajo që janë të qëndrueshëm në parimet e veta u jep njëfarë fuqie. Mashtrohen. Kjo thjesht ua thith gjithë fuqinë. Ata janë njerëzit më të dobët në botë. Ata janë si fëmijët e vegjël që janë rritur, e akoma i përdorin pizhamet të cilat janë bërë për ta derisa kanë qenë bebe. Tashmë duken të trashë nga mendja, ndjejnë të njëjtat probleme. Ata vazhdimisht mbajnë pizhamet e tyre se ato iu bien poshtë e më poshtë, kurse njerëzit qeshin me ta. Jo, duke u rritur, edhe pizhamet e tua do të duhej të rriteshin. Por, pasi që pizhamet nuk po rriten, duhet t'i ndërrosh. Prandaj unë në këtë nuk shoh kurrfarë problemi. Por, ti mund të shohësh se kjo nuk është situatë vetëm e një personi – miliona njerëz jetojnë në këtë mënyrë. Ata i përmbahen disiplinës, e pastaj bien në vështirësi. Askush nuk ua imponon vështirësitë – ato janë parimet e tyre personale. Po qe se i heqin qafe, ndjehen keq: po qe se u përmbahen, atëherë vuajnë. Unë po ta mësoj bukur mënyrën joprincipele të jetës, të jetës inteligjente e cila

ndryshon me çdo ndryshim rreth teje, po të mësoj të mos kesh ndonjë princip i cili do të pengonte të ndryshoheshe. Ji absolutisht joparimor dhe thjesht pasoje jetën, kështu në jetën tënde nuk do të ketë mërzi.

147. Do të duhej t'i qëronim hesapet me të kaluarën – ajo ka qenë plotësisht e sëmurë. Njeriu ka jetuar jetë tejet të sëmurë, meqë ka krijuar filozofi tepër të sëmurë dhe tepër seriozisht i është përmbajtur asaj.

Do të duhej t'i qëronim hesapet me këtë sëmundje – more sado që duket e nderuar e sado që të jetë e lashtë – dhe përsëri zbulojmë integritetin e njeriut. E kjo mund të bëhet vetëm kur me respekt i qasemi joshjes për vallëzim; kur joshja për vallëzim bëhet nderim i thellë; kur ai nderim nuk të shtynë të vdesësh, të heqësh dorë, por të gëzosh, të vallëzosh, të festosh.

148. Jeto si luftëtar, në këtë apo në atë mënyrë, por kurrë me kompromise. Më mirë është të jesh i mundur, por plotësisht, sesa të fitosh rrugës së kompromisit. Ajo fitore nuk ka me të sjellë asgjë përpos nënçmimit; kurse humbja pa kompromis ka me të sjellë dinjitet. Jeta është e çuditshme. Këtu fitorja ndonjëherë është e turpshme, e humbja dinjitoze, sepse njeriu nuk dëshiron të bëjë kompromise.

149. Në ndonjë marrëdhënie, të jesh i matur do të thotë se ti mund të mos kesh të drejtë, e se gruaja mund të ketë të drejtë. Çështja se je mashkull s'është garanci se ke fuqi dhe autoritet të kesh të drejtë. E nuk i ka as gruaja. Sikur të ishim vetëm pak më njerëzor dhe pak më miqësor, njëri-tjetrit do të mund t'i thoshim: "Më fal". E ç'janë ato gjëra për të cilat lufton? – aq të vogla, aq të parëndësishme, saqë do të turpërohesh nëse ndokush ka me të pyetur në këtë mënyrë. Thjesht hidhe idenë se çdo gjë duhet të përputhet; hidhe idenë se do të vijë gjer tek harmonia e plotë – se këto nuk janë gjëra të mira. Sikur çdo gjë të përputhej, do t'i mërziteshit njëri-tjetrit. Nëse çdo gjë është harmonike, keni për ta humbur gjithë ëmbëlsinë e marrëdhënies. Është mirë që gjërat nuk përputhen. Është mirë që përherë ekziston jazi, ashtu që gjithmonë ka diçka të hulumtohet, diçka të kalohet, të ndërtohet ndonjë urë. Gjithë jetët tona mund të jenë hulumtime të mëdha reciproke po qe se i pranojmë dallimet, veçantinë bazike të çdo individi, dhe po qe se nga dashuria nuk bëjmë ndonjë lloj robërie, veçse miqësi.

150. Mendja mund të funksionojë vetëm me të priturën, vetëm me të diturën. Kur aty ka diçka të papritur, ajo duhet të ndalojë. Kurse ndalimi i mendjes është tingulli i një dore që thurë. Kjo është heshtja.

151. Kush ka me të mësuar të rrish i qetë? Kjo është gjëja më e vështirë në botë. Krejt mund t'i bësh fare lehtë, por gjëja më e lehtë – të rrish qetë – duket se është më evështira.

152. Dashuria duhet të jetë marrëdhënie miqësore në të cilën askush nuk është i mbifuqishëm, në të cilën askush nuk do të mashtrojë, në të cilën të dyja palët janë plotësisht të vetëdijshme se janë të ndryshëm, se qasja e

tyre ndaj jetës është e ndryshme, semendojnë ndryshe, e megjithatë – me gjithë këto dallime – ta duan njëri-tjetrin. Atëherë nuk do të ketë kurrfarë problemesh. Probleme bëjmë ne. Mos provo të krijosh diçka mbinjerëzore. Ji krijesë njerëzore dhe pranoje njerëzoren e personit tjetër, me gjithë brishtësinë ndaj së cilës njeriun është i prirur. Ai tjetri do të bëjë gabime pikërisht siç i bën ti – e që të dy duhet të mësoni. Të jesh së bashku është dituri e madhe – në ndjesë, në mirëkuptimin se ai tjetri është njeri siç je ti. Nevojitet vetëm pak ndjesë...

153. Kur njerëzit flasin, ata dëshirojnë që atë ta kthejnë në mendim të tyre. Kjo është si sprovë për të përhapur një perandori subtile. Kur njerëzit flasin, ata duan të të indoktrinojnë, sepse secili që ka ndonjë doktrinë – thellë në vete frikësohet se a është ajo e vërtetë apo jo. Mënyra e vetme sipas të cilës mund të ndjejë se ajo është e vërtetë është – nëse mund të indoktrinojnë shumë njerëz dhe në sytë e tyre të shohë bindjen, ndryshimin. Atëherë e kanë më lehtë, meqë llogaria është kjo: "Po qe se kaq shumë njerëz gjejnë kaq shumë ngushëllim në këtë që po ua them unë, duhet gjithsesi që aty të ketë ndonjë të vërtetë". Njerëzit u flasin të tjerëve që vetë të mund të besojnë në atë që thonë.

154. Mund të ekzistojnë dy lloje miqësish. Njëra miqësi është ajo ku ti je lypsar: të nevojitet diçka nga tjetri që t'i ndihmojë vetmisë tënde. Personi tjetër është po ashtu lypsar, ai e do të njëjtën gjë prej teje. Dhe natyrisht, dy lypsarë nuk mund t'i ndihmojnë njëritjetrit. Së frikti ata vërejnë se lëmosha prej lypsari ka dyfishuar apo shumëfishuar nevojat e tyre. Në vend se aty të jetë vetëm një lypsar, tashmë janë dy. E po qe se, për fat të keq, kanë edhe fëmijë, aty është shoqata e lypsarëve që lypin – e askush asgjë nuk ka për të dhënë. Për këtë të gjithë janë të frustruar dhe të mllefosur dhe të gjithë ndjehen të mashtruar, të manipuluar. E në të vërtetë askush nuk mashtron, askush nuk manipulon, se çfarë ti ke fituar për me mujt me dhanë? Lloji tjetër i miqësisë, lloji tjetër i dashurisë, ka kualitet krejtësisht tjetërfare. Ajo nuk është nga nevoja; ajo buron prej asaj se ke tepër shumëçka në vetvete që dëshiron ta ndash. Lloji i ri i gëzimit ka hyrë në qenien tënde – gëzimi i dhënies – për të cilin kurrë më parë nuk ke qenë i vetëdijshëm, shkaku se përgjithmonë ke lypur lëmoshë. Kur u jep të tjerëve, aty nuk kemi të bëjmë me përputhje. Ti rrjedh me ekzistencën, Ti rrjedh me ndryshimin, sepse nuk ka rëndësi se me kë e ndan. Ai mund të jetë personi i njëjtë edhe nesër, personi i njëjtë i tërë jetës tënde, por mund të jetë edhe ndonjë tjetër – nuk ka rëndësi. Ajo nuk është kontratë, ajo nuk është martesë; ajo vjen thjeshtë nga plotësia jote të cilën dëshiron ta ndash. Për këtë, kushdo që është në afërsinë tënde, ti ia ndan. Kurse dhënia është gëzim i madh.

155. Njeriu është i lindur si i pastrehë (i pashtëpi) dhe tërë jetën mbetet i pastrehë. Pranimi i kësaj të vërtete sjell transformim të madh. Atëherë më nuk gjurmon pas shtëpisë – sepse shtëpia është diçka atje, larg, diçka që

nuk je ti. E të gjithë gjurmojnë pas shtëpisë. Kur ta kuptosh iluzoritetin e shtëpisë, në vend se të gjurmosh pas saj, fillon të gjurmosh pas qenies e cila ka lindur si e pastrehë, fati i së cilës është pastrehësia. Nuk ka mënyrë që të krijohet shtëpi. Dhe kjo është e çuditshme: atë çast që e kupton se nuk ka mënyrë që të krijosh shtëpi, shtëpi jotja bëhet e tërë ekzistenca. Atëherë, kudo të jesh, ti je në shtëpi.

156. Në botën e shprehive, e tëra është përsëritje. Në botën e vetëdijes nuk ka përsëritje.

157. Në jetë, krejt çka është e rëndësishme është e pakuptimtë.

158. Asnjë person inteligjent nuk është i interesuar që të dominojë mbi të tjerët. Ai më parë është i interesuar që ta njohë vetveten. Prandaj, inteligjenca më kualitative e synon misticizmin, kurse ajo skajshmërish mediokre fuqinë. Ajo fuqi mund të jetë laike, politike, mund të jetë me para... mund të përbëhet dhe nga dominimi shpirtëror mbi miliona njerëz – por është impulsi i saj themelor që të dominojë mbi një numër sa më të madh e më të madh njerëzish. Ai impuls shfaqet shkaku se nuk e njeh vetveten dhe nuk do t'ia dish se nuk e njeh vetveten. Frikësohesh fort të bëhesh i vetëdijshëm për paditurinë e cila dominon mbi vetë qendrën e qenies sate, dhe prej asaj errësire ikën me ndihmën e këtyre metodave – me lakminë për fuqi, me lakminë për konsideratë, nderim. Kurse njeriu që në vetvete bart errësirë, mund të bëjë çfarëdo qoftë destruktive. Personi i tillë nuk mund të krijojë, meqë kreativiteti vjen nga ajo se je i vetëdijshëm, deri diku i zgjuar, që ke dritë, dashuri. Kreativiteti nuk është i interesuar fare për dominim mbi këdo qoftë – e për çfarë qëllimi? Tjetri është tjetri. As ti nuk dëshiron të dominosh mbi këdo qoftë, as nuk dëshiron që kushdo qoftë të dominojë mbi ty. Liria është pikërisht ajo shije që ke kur je së paku paksa i zgjuar.

159. Liria është lulëzimi yt, lotosi yt që hapet në diellin e mëngjesit. E derisa kjo nuk ndodh, nuk mund ta ndjesh kënaqësinë, përmbushjen, qetësinë të cilën njeriu e ndjen kur vjen në shtëpi. Kurse të gjithë e bartin shtëpinë e vet në vetvete. Ti nuk është e thënë të shkosh askund; duhet ta ndërpresësh të shkosh që të mund të mbetesh aty ku je, që të mund të mbetesh ai që je. Thjesht ji. Dhe në atë qetësi të skajshme të qenies, të fshehura janë të gjitha të fshehtat e ekzistencës.

160. Mos kërko shtëpi, se nuk ka. Kërko vetveten, se dikush i tillë ekziston!

161. Dashuria të ndihmon ta arrish vendin në të cilin besimi është i mundur. Pa dashuri, besimi nuk është i mundur. Dashuria është gati si ura e cila mund të shembet në secilin moment, por megjithatë është urë. Nëse mund ta përdorësh, ajo mundet me të dërguar gjer tek besimi, por pa të nuk mund të vish tek besimi drejtpërdrejt. Për këtë dashuria është absolute, por vetvetiu nuk është e mjaftueshme. Përdore si mjet: besimi është fundi.

162. Atë moment kur zë të besosh në qëndrimin "le të shkojë", atë çast që pushon së luftuari kundër ekzistencës, nuk duhet brengosur mbi asgjë. Ekzistenca brengoset. E tërë vështirësia me mendjen njerëzore është në atë se ajo përherë lufton, se provon të notojë lumit përpjetë. Ka arsye pse e bën këtë; vetëm notimi lumit përpjetë e përmbushë egon. Me lëvizjen e thjeshtë nëpër rrjedhën e jetës, pa kurrfarë lufte, duke i lejuar jetës me të dërguar kudo të dëshirojë, egoja jote do zhduket. Ti do të jesh, do të jesh më tepër sesa je tash – më i vërtetë, më i real – por nuk do të jetë ndjesia "unë". E atëherë do të mund të shohësh se ku po shkon. Ata të cilët nuk kanë ego mund të shohin madje edhe gjurmët (në ajër) që i lë kur lëvizë. Mund të shohësh madje edhe gjurmët e këmbëve të zogjve në qiell. Ata nuk lënë kurrfarë gjurmësh. Por, kur mendja pastrohet prej egos, e tërë qenia bëhet pasqyrë aq e pastër saqë madje edhe gjurmët e tilla shihen në të. Një gjë e di. Ekzistenca nuk ka qëllim, dhe si pjesë e ekzistencës unë nuk mund të kem kurrfarë qëllimi. Atë çast që ke qëllim, ti vetveten e shkëput nga ekzistenca. Atëherë pika e vesës provon të luftojë kundër oqeanit. E panevojshme është ajo vuajtje, e pakuptimtë ajo luftë.

163. Me besimin nënkuptohet krejt çfarë është e bukur në dashuri. "Besim"është ndoshta më e bukura fjalë në gjuhën e njeriut. E besimi është aq shumë afër së vërtetës saqë, nëse është i plotë, atë çast besimi yt personal bëhet e vërteta jote, zbulim, revolucion.

164. Dashuria është e mrekullueshme, por e ndryshueshme. Ajo është e mrekullueshme, por në të nuk mund të mbështetesh. Sot është këtu, nesër nuk është më. Dashuria është më e lëngshme se besimi, më e natyrshme se besimi, por besimi është kualitet më i lartë. Në fjalorë "besimi"gati se gabimisht është prezantuar; ai do të thotë besim në dikë që është i denjë për besimin; ai më tepër është objekt – sepse dikush është i denjë për besim, ndaj ti po i beson. Kjo nuk është veti jotja; vetia e personit tjetër është ajo prej së cilës varesh ti. E pasi që njerëzit e denjë për besim janë të rrallë, miliona njerëz kanë harruar se ç'është besimi, për të nuk ka gjasë. I nevojshëm është personi i denjë për besim, kurse persona të denjë për besim nuk ka askund. Askush nuk i beson askujt; prandaj "besimi"është bërë fjalë e thatë, e papërjetuar – fjalë e varfër, pa lëng, pa shije. Kur e them fjalën "besim", ajo është plotësisht tjetërfare: unë nuk mendoj në atë t'i besosh dikujt që është i denjë për besim. Ai nuk është besim. Ai njeriu është i denjë për besimin, ndaj merita nuk është jotja. Kur them "besim", mendoj në atë që të kesh besim pavarësisht prej njeriut, pavarësisht asaj se a është i denjë për besim apo nuk është. Në të vërtetë, kur nuk është i denjë për besim, atëherë beso... vetëm atëherë, për të parën herë, do të pashë se diçka e re po lind në vetëdijen tënde. E atëherë besimi do të bëhet dukuri tejet e ndritshme, larg më tepër se dashuria, se atij nuk i nevojitet asgjë nga ai tjetri.

165. Vetëm një qenie e pavarur, plotësisht autonome që jeton në liri mund ta arrijë përvojën e së vërtetës.

166. Kur thua: "Të dua", ekziston rrymimi subtil i posesivitetit. Edhe nëse nuk thuhet, nënkuptohet: "Ti tash je pronë imja – askush tjetër nuk duhet të të donjë". Kur është në pyetje besimi, nuk kemi të bëjmë me posedimin e personit në të cilin ke besim. Përkundrazi, ti thua: "Të lutem, posedomë. Më shkatërro mua si ego. Më ndihmo që të zhdukem dhe të shkrihem në ty ashtu që me ty të mos ketë kurrfarë kundërshtie. "Dashuria është konflikt i përhershëm, luftë. Dashuria kërkon. "Të dua"do të thotë: "Ti duhet të më duash mua. Në të vërtetë, të dua vetëm për atë se dua që edhe ti të më duash mua". Kjo është biznes i kulluar: së këndejmi edhe frika – "Nuk duhet të duash askënd tjetër, askush tjetër nuk duhet të të dojë ty, sepse nuk dua që askush të marrë pjesë në dashurinë time, ta ndajë dashurinë time". Njeriu i pavetëdijshëm vazhdon të mendojë sikur dashuria të ishte një sasi, pothuajse ekziston sasia e caktuar e dashurisë: "Nëse unë të dua, ti do të duhej të merrje gjithë sasinë. Nëse dua disa njerëz të tjerë, atëherë ajo sasi do të shpërndahet; nuk do ta kesh të tërën". Prandaj, xhelozi, luftë, fyerje - gjithçka që është e shëmtuar fshihet prapa kësaj fjale të bukur – "dashuri". Tek besimi nuk vjen në shprehje kurrfarë lufte. Ai në të vërtetë është dorëzim. Kur thua: "Të besoj", kjo do të thotë: "Nga ky çast, lufta ime me ty përmbyllet. Tashmë jam yti".

167. Besimi nuk është garë; prandaj s'ka xhelozi. Ti mund të më besosh mua; miliona njerëz mund të më besojnë. Në të vërtetë, sa më shumë njerëz që më besojnë, ti do të jesh aq më i lumtur. Do të gëzohesh që kaq shumë njerëz më besojnë. Me dashurinë nuk është kështu.

168. Besimi është gjithsesi vlerë më e lartë se dashuria. Tek besimi, dashuria nënkuptohet, por në dashuri besimi nuk nënkuptohet. Kur thua: "Unë të besoj", nënkuptohet se e do. Por, kur thua se e do, besimi me këtë nuk ka lidhje. Në të vërtetë, dashuria jote është tejet e dyshimtë, tejet e frikësuar, përherë vigjilente, duke vëzhguar personin që do. Dashnorët gati se janë bërë dedektivë. Ata spiunojnë njëri-tjetrin. Dashuria është e mrekullueshme nëse shfaqet si pjesë e besimit, sepse besimi nuk mund të ekzistojë pa dashuri.

169. E vërteta është se, kur thua "Të dua", ajo nuk është dorëzim, ajo nuk është gatishmëri për t'u zhdukur. Ajo nuk është gatishmëri për t'u dërguar në hapësirat e panjohura e të pakuptueshme. Kur thua "Të dua", ti mbetesh identik me veten, e në atë njëjtësi ekziston vija e caktuar agresive. Por, kur thua: "unë po të besoj", ajo është dorëzim i thellë, hapje, ndjeshmëri, shpallje vetvetes dhe universit se: "Madje edhe nëse ai njeri më çon në ferr, për mua ajo është në rregull. Nëse ajo mua më duket si ferr, me siguri se nuk shoh mirë. Ai nuk mund të më dërgojë në ferr". Kur në pyetje është besimi, gjithmonë të metat do t'i kërkosh në vetvete. Kur në pyetje është dashuria, gjithmonë të metat do t'i kërkosh tek personi që dashuron.

Kur në pyetje është besimi ti përherë, megjithëqë nuk e thua, kërkon ndjesë: "Unë jam i padituri, unë po fle, i pavetëdijshëm jam. Është e mundur të them diçka gabim, të bëj diçka gabim, ndaj ki mëshirë ndaj meje, ki dhembshuri". Besimi nënkupton jashtëzakonisht shumë. Ai është thesar i madh.

170. Në udhëtimin e vërtetë të jetës, intuita jote personale është mësuesi yt i vetëm.

171. Në vend që të nxitosh për atë që kërkon, gjurmo pas atij i cili kërkon. E kur e gjen gjurmuesin, befasisht do të kuptosh se e tërë ekzistenca është shtëpia jote; për këtë, kudo që të jesh, ti je tek shtëpia. Vetëm nëse e gjen vetveten, do të zbulosh se e tërë ekzistenca është shtëpia jote.

172. Bota që quhet: "jep më tepër", është bota e njeriut të zakonshëm. Bota në të cilën nuk kërkohet më tepër, nuk kërkohet kurrfarë qëllimi që është para teje veçse thjesht shikohet çasti në të cilin je dhe në të cilin ndodh zhytja në praninë e vetëdijes tënde - ky është revolucioni i vetëm, dhe religjioni i vetëm, dhe vetëm këtu është devocioni.

173. Kjo jetë e vogël që ke fituar mund të shndërrohet në parajsë. Vetë kjo tokë është lotosi-parajsë.

174. Kjo tokë është një tërësi unike. Do të duhej të ishim krenarë që ky është planeti ynë në këtë gjithësi të pafundme, ku miliona sisteme diellore kanë miliona e miliona planetë... Planeti ynë është i vetmi që ka zhvilluar jo vetëm jetë, jo vetëm vetëdije, por madje ka prodhuar edhe lulëzën e fundit të vetëdijes tek njerëzit siç janë Gautam Buda, Lao Ce, Tilopi dhe shumë të tjerë. Do të duhej që të ishim krenarë në planetin Tokë.

175. Kur them se krejt përpos njeriut është e vërteta e gjallë –oqeani, retë, yjet, gurtë, lulet – se krejt është vetë vërtetësia, asgjë tjetër pos ajo që është, pa maskë, se vetëm njeriu është në gjendje t'i mashtrojë të tjerët, ta mashtrojë veten – duhet ta kemi parasysh se kjo, në të vërtetë, është shansi i tij i madh. Kjo nuk guxon të gjykohet, kjo duhet të lavdërohet, sepse edhe po qe se kaçuba e trëndafilit apo e lotosit do të donin të gënjenin, nuk do të mund ta bënin këtë. E vërteta e tyre nuk është liri; e vërteta e tyre është robëri. Ata nuk mund ta tejkalojnë atë kufizim. Njeriu ka mandatin, ka privilegjin që të jetë jo i vërtetë. Kjo do të thotë se njeriu e ka lirinë që të zgjedhë. Nëse zgjedh që të jetë i vërtetë, ai nuk e zgjedh robërinë, ai e zgjedh të vërtetën dhe lirinë. Liria është privilegji i tij. Në gjithë ekzistencën, lirinë s'e ka askush tjetër. Por, kur e ke shansin, të pranishme janë edhe rreziqet. Kur e ke lirinë, mund të devijosh. Asnjë trëndafil nuk mund të devijojë, asnjë shkëmb nuk mund të devijojë. Ti mund të devijosh: prandaj edhe mund të të përshkojë vetëdija e thellë mbi çdo veprim, mbi çdo mendim, mbi çdo ndjenjë. Vetëm njeriut i duhet të gjurmojë pas së vërtetës; gjithë të tjerët veç e kanë fituar, por në atë nuk ka lavdi, nuk ka

liri. Ti duhet të gjurmosh pas saj dhe ta gjesh; dhe në vetë këtë kërkim dhe gjetje ti je i lavdishëm, ti je vetë kurora e ekzistencës.

176. Mërzia është vetëm zgjedhje e njëanshme. Ti zgjedh përvojën e dashurisë, ndjenjën e ekstazës, por me atë se zgjedh, ty të harron një proces natyral. Ti do të rrokesh për ato ndjenja – kurse ato nuk janë të qëndrueshme; ato janë pjesë e rrotës e cila sillet. Mu si dita e nata: po qe se e zgjedhim ditën, çfarë mund të bëjmë që t'i ikim natës? Nata ka për të rënë. Nata nuk sjell mërzi, por zgjedhja jote e ditës përkundrejt natës sjell mërzi. Çdo zgjedhje ka gjithsesi për të përfunduar me gjendje mërzie. Mosekzistimi i zgjedhjes është lumturi. Kurse mosekzistimi i zgjedhjes është qëndrimi "Lëre të rrjedh". Kjo do të thotë se vjen dita, se vjen nata, vjen suksesi, vjen mossuksesi, vijnë ditët e lavdisë, vijnë ditët e gjykimit – e pasi që nuk ke zgjedhur asgjë, krejt çfarë vjen është në rregull për ty, ti gjithnjë e ke super. Ngadalë, ngadalë ke për të parë sesi në ty rritet një distancë: rrethi do të vazhdojë të sillet, por ti nuk je i zënë në të. Për ty nuk ka rëndësi se a është ditë apo natë. Qendra jote është në ty: ti nuk përputhesh me asgjë tjetër, nuk e krijon qendrën tënde në ndonjë vend tjetër. E tërë çështja është në atë se a mund të jetosh pa kurrfarë zgjedhjeje. Çfarëdo që vjen, kënaqu në të. Kur të shkojë, e pastaj vjen diçka tjetër, prapë kënaqu në të. Dita është e mrekullueshme, por nata është e mrekullueshme në mënyrën e vet – pse të mos kënaqesh në të dyja? E mund të kënaqesh me të dyja vetëm nëse nuk je i lidhur me asnjërën prej tyre.

177. Prandaj vetëm personi që nuk bën zgjedhje, në plotësi shtrydhë lëngun e jetës. Ai kurrë nuk është i mjerë. Çfarëdo që të ndodhë, ai gjen mënyrë të kënaqet në të. Dhe në këtë është i tërë arti i jetës – të gjesh mënyrë të kënaqesh në të. Por, duhet të mbash mend kushtin themelor: mos zgjidh. Mund të mos zgjedhësh vetëm nëse do të jesh i zgjuar, i kujdesshëm; përndryshe do të lëshohesh në ndonjë zgjedhje. Jeta gjithsesi është art, arti më i madh – kurse formula e tij më e shkurtër është vetëdija pa zgjedhje, e cila mund të zbatohet në të gjitha situatat, në të gjitha problemet.

178. Kur njëherë e pranon jetën në tërësinë e vet - jeta e përfshin edhe vdekjen – vdekja atëherë nuk është kundërvënie jetës, por është vetëm shërbëtor i saj, mu siç është i tillë edhe gjumi. Jeta jote është e përjetshme – ajo do të jetë këtu përgjithmonë dhe përgjithmonë – por trupi nuk është i përjetshëm; ai duhet të ndryshohet. Ai plaket, e atëherë është më mirë të kesh trup të ri, trajtë të re, sesa që pas vetes ta bartim të vjetrin. Për mua, njeriu që kupton, nuk do të ketë kurrfarë problemesh. Përndryshe vetëm qartësi shikimit - dhe problemet zhdavariten. Qetësia e madhe ka mbetur në prapavijë, qetësia e bukurisë së madhe dhe e bekimit të madh.

179. E vërteta lëndon më së tepërmi.

180. Dituria e huazuar është padituri. Përvoja e së vërtetës nuk të bën të ditur, veçse modest. Sa më tepër që e di (të vërtetën), aq më pak shpall se e di. Atë ditë që të vërtetën përsosmërisht ke për ta ditur, do të thuash: "Unë jam skajshmërish i paditur. Unë jam vetëm fëmijë që mbledh guaca në plazh. Nuk di asgjë". "Nuk di"mund të thotë vetëm njeriu që përsosmërisht di. Njerëzit që thonë: "Ne dimë"janë skajshmërish të paditur, kurse memorien e kanë plot. Por, ato kujtesa janë të vdekura, sepse nuk kanë prodhuar kurrfarë përvoje të tyren.

181. Për mua, të jesh i natyrshëm do të thotë të jesh shpirtëror. Unë investoj përpjekje ta krijoj njeriun natyral – njeriun pa faj, i cili i pranon të gjitha dobësitë, mossukseset të cilave iu nënshtrohet qenia njerëzore. Në atë pranim të thellë të qenies tënde natyrale gjendet fara e transformimit tënd.

182. Ne i kemi mbushur jetët tona me gjëra tokësore, vepra tokësore, sepse nuk e njohim të fshehtën e thjeshtë sesi ta transformojmë kualitetin e çdo gjëje që bëjmë. Dhe mbaje në mend, nëse nuk e di të fshehtën e transformimit, midis atyre gjërash tokësore edhe ti je tokësor – përveç nëse ke vetëdi- je e cila të bën të përkushtuar dhe të shenjtë dhe e cila çdo gjë që bën do ta transformojë në të njëjtën gjendje në të cilën je ti. Atëherë gjithçka që prek do të bëhet e shenjtë. Çfarëdo që bën, do të bëhet e përkushtuar.

183. Krejt çka është bukur, krejt çka ta përkujton të andejmen, do të krijojë në ty gjakim, gjakimin për të cilin nuk do të mund të kuptosh se përse është. Ti nuk e di objektin e tij, sepse në të vërtetë, ai nuk ka lidhje me kurrfarë objekti. Kur dëgjon muzikë të bukur, sodit perëndimin e Diellit apo thjesht zogun në fluturim apo trëndafilat e mrekullueshëm, apo gjersa rri në qetësi, mund të ndjesh ndonjë dhembje të ëmbël. Gjakon që të tretesh në atë gjendje ndjenjash, që ajo të mos mbetet dukuri kalimtare e cila vjen dhe shkon, por diçka që mbetet me ty, që mbetet vetë ti. Po ajo muzikë që dje ka qenë e ëmbël, sot ndoshta nuk do të jetë e ëmbël, nesër a pasnesër ndoshta do të bëhet e mërzitshme. Prandaj nuk është në pyetje muzika, veçse diçka tjetër që është vu në lëvizje në ty – gjakimi për të qenë përplot qetësi, për të qenë muzikal, për ta pasur gjithë bukurinë e ekzistencës dhe për ta pasur përgjithmonë. Ky është gjakim shpirtëror, gjakim për të andejmen, për anën tjetër tej të gjitha përvojave kalimtare; gjakim për t'u ndalur koha dhe për të qenë tash dhe këtu, përjetësisht në këtë moment. Kjo është religjiozitet i vërtetë.

184. Kur e ndjen ekzistencën drejtpërsëdrejti – pa kurrfarë ndërmjetësuesi, pa mendjen tëcilën dikush tjetër ta ka dhënë – ti shijon diçka që ka me të transformuar, që ka me të përndritur, gjuar, që ka me të përcjellë gjer tek maja më e lartë e vetëdijes. Përmbushje më të madhe nuk ka. Më tepër kënaqësi nuk ka. Relaksim më të thellë nuk ka. Ke ardhur në shtëpi. Jeta bëhet gëzim, këngë, vallëzim, shenjtëri – dhe atë jetë unë e quaj religjioze.

185. Nevojitet njeriu që është i edukuar pa kurrfarë sistemi religjioz të besimit, pa kurrfarë ideologjie politike. Arsimimi i tij do të ishte

vetëm mprehje e inteligjencës, që një ditë të mund ta gjejë të vërtetën personale. Dhe mbaje në mend, po qe se e vërteta nuk është e jotja personale, ajo nuk është e vërtetë. Për të qenë e vërtetë, ajo duhet të jetë jotja personale, përvojë jotja – nuk mund ta huazosh prej tjetrit.

186. Zoti mund të vdesë, religjionet mund të zhduken, por religjioziteti është diçka që është thurur në vetë ekzistencën. Ai është bukuria e perëndimit Diellor, ai është bukuria e zogut krahëhapur. Ai është bukuria e lotosit që mugullon. Ai ka krejt çfarë është e vërtetë, krejt çfarë është e sinqertë dhe burimore, krejt çfarë është plot dashuri dhe përdëllim. Religjioziteti përmban krejt çfarë të ngrit përpjetë, që bën që të mos ndalesh aty ku je, veçse përherë ta përkujton se duhet të shkosh edhe shumë më larg. Çdo vend që ndalesh për të pushuar është vetëm pushim për të bujtur; në mëngjes përsëri e vazhdon pelegrinazhin. E ky është pelegrinazh i amshuar.

187. Do të dëshiroja që të gjithë të bëheshin Ciganët e ekzistencës. Nuk të nevojitet rrënja – ti nuk je lis. Ti je qenie njerëzore.

188. Natyra nuk është agoni, ajo është lumturi. Ajo nuk është sëkëlldi, mërzi, vuajtje. Ajo është dashuri, ajo është gëzim. Ajo është përherë kremtim. Kemi lindur nga natyra, jemi pjesë e saj – trashëgojmë të njëjtat veti në vetëdijen tonë.

189. Besim thjesht do të thotë se jemi në harmoni me gjithçka që ndodh. Jo të pagëzuar, jo si të shkretë – atëherë e kemi huqur poentën –por me qejfin më të madh për vallëzim, me këngë, me hare, me dashuri. Çfarëdo që të ndodhë, është për qëllime të mira. Ekzistenca nuk mund të kthehet mbrapsht. Nëse nuk na i plotëson dëshirat tona, kjo thjesht do të thotë se dëshirat tona kanë qenë të gabuara.

190. Nevoja më e madhe e njeriut është që për të - të kenë nevojë të tjerët. Nëse për ty ka nevojë dikush, ndjehesh i shpërblyer. Por, nëse për ty ka nevojë mbarë ekzistencës, atëherë lumturia jote nuk njeh kufij. E kjo ekzistencë ka nevojë si për yllin më të madh, ashtu edhe për fijen e vogël të barit: këtu nuk bëhet fjalë mbi pabarazinë. Askush nuk mundet me të zëvendësuar. Nëse nuk je këtu, ekzistenca do të jetë jo e plotë dhe përherë do të mbetet jo e plotë – kurrë nuk ka për të qenë e plotë. Kjo ndjesi – se i nevojitesh kësaj tërësie, ekzistencës gjigante – i eliminon të gjitha mërzitë e tua. Për herë të parë ti ke ardhur në shtëpi.

191. Përmes njerëzimit evolucioni provon të mbërrijë majën më të lartë të vetëdijes. Pak njerëz e kanë mbërritur: ata janë argument i mjaftueshëm se secili mund ta mbërrijë – vetëm pak angazhim, vetëm pak sinqeritet, vetëm pak hulumtim. Gjithçka po të flet se mënyra në të cilën po jeton nuk është e mjaftueshme, se gjërat që po i bën nuk janë e tëra: se jeta jote tokësore është vetëm sipërfaqësore – jeta jote e vërtetë, në numrin më të

madh të rasteve, mbetet e paprekur. Njerëzit linden, jetojnë dhe vdesin, e duke mos e ditur se kush janë. E tërë ekzistenca është e qetë. Nëse edhe ti mund të jesh i qetë, ke për ta ditur se cila është ajo vetëdije në ty. E kur këtë e di, jeta bëhet gëzim, hare e pandërprerë, kremte drite e cila nuk ka të sosur kurrë.

192. Ekziston vetëm një lutje e vërtetë, e kjo është të jetosh ashtu që të fillosh të ndjesh falënderimin kundrejt ekzistencës. Ekzistenca të ka dhënë shansin e madh – të cilin kurrë nuk e ke kërkuar, të cilin kurrë nuk e ke merituar, e megjithatë e ke fituar. Duke iu falënderuar kësaj ti ke lulëzuar në mijëra lule dhe ke lënë aromën e shenjtë të falënderimit.

193. Vepro më vetëdijshëm dhe gjithnjë e më shumë i afrohesh vetisë që quhet njeriu hyjnor - jo Zot, jo ndonjë person, veçse veti e hyjnisë.

Vepro pavetëdijshëm dhe gjithnjë e më tepër do t'i afrohesh diçkaje që nuk mund të personifikohet si djall, veçse mund të quhet veti e – ligësisë. Njeriu i pavetëdijshëm sillet në mënyra të gabueshme, njeriu i vetëdijshëm sillet në mënyrat e duhura. Kurse religjioni i vetëm që ekziston është arti i shndërrimit të mendjes së pavetëdijshme në të vetëdijshmen, ashtu që të mos e kesh dysinë e së vetëdijshmes dhe së pavetëdijshmes, por e ke vetëm një – dritën e pastër, vetëdijen e pastër. E me vetëdije të tillë, çdo gjë është hyjnore.

194. Përherë ji i gatshëm që të lëvizësh nga e njohura kah e panjohura – në të gjitha, në çdo përvojë. Kjo është më mirë madje edhe nëse e panjohura tregohet më e keqe se e njohura – nuk është poenta aty. I rëndësishëm është vetëm ndryshimi yt prej së njohurës në të panjohurën, gatishmëria jote që të kalosh prej asaj që njeh në të panjohurën. Kjo është me vlerë tepër të madhe. Përherë kije në mendje se e reja është më e mirë se e vjetra. Unë them, madje edhe po qe se e vjetra është e artë, harroje. Zgjidhe të renë – se a është e artë apo jo, kjo s'ka rëndësi. E rëndësishme është zgjedhja jote; zgjedhja jote të mësosh, zgjedhja jote të përjetosh, zgjedhja jote t'i rashë errësirës.

195. Meditimi është përgjigjja e vetme në të gjitha pyetjet e njeriut. Ndoshta është në pyetje frustrimi, ndoshta është në pyetje depresioni, ndoshta vuajtja, ndoshta marrëzia, ndoshta agonia; probleme mund të ketë shumë, por përgjigjja është një. Meditimi është zgjidhja.

196. Gjithkund në botë kanë provuar të bëjnë shoqëri njerëzore harmonike, por askush nuk ia ka dalë kësaj, nga arsyeja e thjeshtë se askush nuk ka shtruar pyetjen se përse ajo për nga natyra nuk është harmonike. Ajo nuk është harmonike shkaku se secili individ përbrenda është i ndarë, kurse ndasitë e tij projektohen në shoqëri. Dhe derisa nuk i shthurim ato ndasi të brendshme të individit, nuk ka gjasa që vërtet ta realizojmë utopinë dhe të krijojmë shoqëri harmonike në botë. Prandaj rruga e vetme kah utopia është që vetëdijesimi yt të rritet edhe më tepër, kurse jo-vetëdijesimi yt të zvogëlohet, ashtu që në fund të vijë momenti që

të mos mbetet asgjë që është e pavetëdijshme: ti atëherë je thjesht një vetëdije. Atëherë më nuk ka ndasi.

197. Natyrisht, në botë nevojitet veprimi, e jo mosveprimi. Për të arritur çfarëdo suksesi, i nevojshëm është veprimi, e jo mosveprimi. Për të gjitha ambiciet i nevojshëm është veprimi. Prandaj gjithë bota shpejt është përqendruar në aktivitet. Por, pjesa aktive do të krijojë tension; ajo do të krijojë agoni, vuajtje. Madje edhe po earrite qëllimin tënd, ke për të parë se nuk ke mbërritur asgjë – thjesht e ke harxhuar kohën tënde dhe energjinë tënde. Pjesa aktive e mendjes tënde nuk mundet me të lejuar që të jesh në gjendje qetësie, relaksimi, të jesh në paqe, në shtëpi. Për mendjen aktive kjo nuk është e mundur. Mendja jovepruese është ajo që mundet me ta dhënë shtëpinë në të cilën do të pushosh dhe ndjenjën e mrekullueshme se asgjë nuk është e thënë të bëhet; se je mirë ashtu siç je, se je veç në cak, se nuk duhet madje as të luash vendit.

198. Bota mund të vijë tek harmonia po qe se meditimi përhapet kudo dhe njerëzit bihen tek gjendja e vetëdijes unike. Ky do të ishte dimension plotësisht i ri i punës. Deri tash ky ka qenë evolucioni. Poentë ka qenë shoqëria, struktura e saj. Kjo gjithnjë rishtas në mënyra të ndryshme ka përjetuar mossuksese. Tani ky do të duhej të ishte individi; dhe jo evolucioni, por meditimi, transformimi. E kjo nuk është gjithaq vështirë sa njerëzit mendojnë. Kjo është vetëm çështje mirëkuptimi e vlerave të meditimit. Atëherë është lehtë e mundur që miliona njerëz të heqin ndarjen përbrenda vetes. Ata do të jenë grupi i parë në kuadrin e njerëzimit që do të bëhen harmonikë. Kurse harmonia e tyre, bukuria e tyre, përdëllimi i tyre, dashuria e tyre – të gjitha vetitë e tyre – në mënyrë të pashmangshme do të oshtijnë nëpër botë.

199. Njerëzimi është në rrezik në çdo çast. Po qe se mbijetojmë gjer në fund të këtij shekulli, kjo do ishte çudi.

200. Kjo është diçka themelore të cilën do të duhej kuptuar - se e vërteta mund të jetë vetëm përvojë jotja personale. Nuk ka mënyrë tjetër ta fitosh. Gënjeshtra mund të fitosh me bollëk – gjithfarë gënjeshtrash, të të gjitha trajtave dhe madhësive, çfarëdo që i dëshiron. Ato janë në dispozicion dhe të përgjigjen. Ti nuk është e thënë të harmonizohesh me to, ato i ke tamam. Kjo është tepër lehtë; ato janë të bëra për ty, ato janë të sajuara për ty. E vërteta është gjë krejtësisht tjetërfare. Ti duhet të përputhesh në të. E vërteta nuk di për kompromise. Ti duhet të ndryshohesh në harmoni me të – ti duhet të përjetosh transformim.

201. Njeriu me mendjen religjioze ka për të qenë religjioz në të gjitha veprimet e veta, në të gjitha marrëdhëniet, mendimet, ndjenjat. Atij nuk i duhet kisha apo sinagoga apo tempulli. I nevojitet qartësia e vizionit, qetësia e zemrës, përvoja e qenies së tij personale – pasi që përvoja e qenies së tij ka për ta bërë të vetëdijshëm për atë se e tërë bota është hyjnore; se gjithçka që ekziston është e ndarë në nivele të ndryshme të evolucionit, por

se edhe në atë më të ulëtin ekziston potenciali i jetës dhe potenciali i vetëdijes.

202. Mendja nuk di për tri kohët e foljes. Ajo di vetëm për dy: të kaluarën dhe të ardhmen. E tashmja për mendjen është joekzistuese. Ajo që ekziston është joekzistuese për mendjen; kurse ajo që nuk ekziston, për mendjen është kzistuese. Së këndejmi i tërë angazhimi përbëhet prej asaj se si të dalim nga mendja, të dalim prej asaj që nuk ekziston dhe të ndalemi në mes – aty ku është ekzistenca. Si të jemi në të tashmen? – këtu është e gjithë shkathtësia e meditimit. Në çastin kur do jesh në të tashmen, përndritja është nusprodukt i tij.

203. Të gjitha artet kanë buruar prej meditimit; dhe të gjitha artet janë larguar prej meditimit – e kjo është fatkeqësia. Përndryshe çdo artist, more me çfarëdo arti specifik që do të merret, do të duhej të gjente rrugën kah meditimi. Por, duket sikur kjo nuk është kështu. Përkundrazi, numri më i madh i artistëve bashkëkohorë, muzikantëve, valltarëve, poetëve, piktorëve, skulptorëve, në vend se të vënë dorë mbi meditimin, përfundojnë në çmenduri – kjo është skajshmëria tjetër e meditimit. E arsyeja e kësaj është se në artin burimor kanë qenë të rëndësishme pauzat, e jo fjalët. Por, siç koha ka kaluar, fjalët janë bërë më të rëndësishme se pauzat.

204. Asnjë njeri që ka qenë meditativ nuk ka bërë kurrë vetëvrasje, kurrë nuk është çmendur, nga arsyeja e thjeshtë se ai lëvizë kah baraspesha më e madhe, kah harmonia e brendshme më e madhe, dhe më në fund, kah harmonia absolute – kjo është harmonia e jo-mendjes. E ta mbërrish jo-mendjen do të thotë t'i arrish të gjitha. Nuk ka asgjë më të lartë se kjo, sepse kjo është paqja, kjo është qetësia, kjo është lumturia. Jo-mendja është devotshmëri, ajo është pavdekësi, ajo është amshim.

205. Psikologjia perëndimore akoma sorollatet rreth rrënjës. Ajo madje as nuk i ka çikur gjethet, lulet, frutat. Nuk bëhet as fjalë që ajo të kalojë në jo-mendje; ajo nuk ka qenë në gjendje madje as ta vërë re gjithë mendjen. Kurse pa njohjen e gjithë mendjes, nuk mund të kërceni në jo-mendje. Jo-mendja është realizim. Jo-mendja është përndritje. Jo-mendja është çlirim.

206. Shkencëtarët kurrë nuk do të jenë në gjendje t'i kuptojnë thellësitë e pafundme, errësirën dhe pjesët misterioze të mendjeve të tyre personale.

207. Nëse ekziston vetëm një shkencë, atëherë mund të ekzistojë edhe vetëm një religjion. Nëse një shkencë është e mjaftueshme të hulumtojë botën objektive, një religjion është i mjaftueshëm të hulumtojë botën e brendshme të njeriut; e ai religjion i vetëm nuk është e thënë të ketë kurrfarë përcaktori – i krishterë, hinduist, taoist, apo cilido qoftë tjetër.

Mu siç shkenca thjesht është shkencë, religjioni thjesht është religjion. Në të vërtetë, për mua, ekziston vetëm shkenca, me dy dimensionet: njëri dimension punon në botën e jashtme, dimensioni tjetër punon në të brendshmin. Mundemi madje edhe të lirohemi nga fjala "religjion". Është

rregull themelore e shkencës se do të duhej shfrytëzuar minimumin e hipotezave. Prandaj, pse t'i përdorim dy fjalë? – e mjaftueshme është vetëm njëra. E "shkencë"është fjalë e mrekullueshme; ajo do të thotë "të njohësh". Të njohësh të tjerët është njëri aspekt: të njohësh unin tënd është aspekti i dytë: por shprehja "të njohësh"i mbulon që të dyja.

208. Po qe se je i gatshëm të hapësh dyer të reja në qenien tënde, po qe se je i gatshëm ta dëgjosh zemrën, atëherë çdo gjë që them është aq e rëndomtë saqë nuk ka nevojë të besosh në të, thjesht shkaku se nuk ka mënyrë që në të të mos besosh. Kjo është aq e thjeshtë saqë nuk ka mënyrë që të dyshosh në të. Prandaj jam kundër të besuarit, thjeshtë shkaku se nuk është i nevojshëm besimi për krejt mësimet e mia. Jam plotësisht për dyshimin, sepse në mësimet e mia të thjeshta nuk mund të dyshosh.

209. Kushtëzimet tona nuk na lejojnë të jemi të natyrshëm. Kushtëzimet tona ne, që nga vetë fillimi, na mësojnë se duhet të jemi diçka më lart se natyra, se të jesh i natyrshëm do të thotë të jesh shtazë - ndaj nga kjo arsye, ne duhet të jemi mbinatyror. Dhe kjo duket mjaft logjike. Të gjitha religjionet na e kanë mësuar këtë – se të jesh njeri do të thotë të ngrihesh përmbi natyrën. Dhe ato gjatë shekujve e kanë bindur njerëzimin që të ngrihet mbi natyrën. Askush nuk ia ka dalë që të ngrihet mbi natyrën. Të gjithë që këtë e arrijnë, e asgjësojnë bukurinë e tyre natyrale, të pafajshme, pafajësinë e tyre.

210. Kur një person i rritur përsëri bëhet fëmijë... ekziston dallimi midis fëmijës së zakonshëm dhe përsëri të lindurit. Rëndom fëmija është i pafajshëm shkaku se është i paditur; kurse pafajësia rishtas e lindur është nga vlerta më të mëdha të jetës, sepse ajo nuk është padituri, ajo është inteligjencë e kulluar. Pafajësia, kur është vetëm, bëhet padituri. Inteligjenca, kur është vetëm, bëhet dinakëri. Që të dyja së bashku nuk janë as padituri as dinakëri, veçse thjesht ndjeshmëri, çiltërsi... zemra atëherë është e aftë t'i çuditet edhe gjësë më të imët në jetë. Kurse njeriu që di për ndjenjën e çudisë për mua është njeriu i vetëm religjioz. Përmes çudisë ai e kupton se ekzistenca nuk është vetëm materie, se kështu nuk mund as të jetë. Për të kjo nuk është ndonjë konstatim logjik, nuk është besim, veçse përvojë e vërtetë. Një përvojë e tillë e mrekullueshme, aq misterioze, aq e paarritshme – tregon se në të ekziston një inteligjencë e hatashme. Por, ekzistenca nuk është dinake. Ajo është tepër e thjeshtë, ajo është e pafajësi. Prandaj, po qe se njeriu i ruan këto dy veti së bashku – pafajësinë dhe inteligjencën – nuk i nevojitet asgjë tjetër. Ato do ta dërgojnë tek caku i fundit i vetënjohjes.

211. Do të doja të të thosha se vetëm një gjë vendos se kush është mësues i vërtetë, e kjo është se prania e tij mundet që befasisht të ngjallë mendjen tënde të fjetur; ajo mund ta ndezë atë. Ajo mund të bëjë që të lulëzosh në mijëra lule, në një çast të vetëm. Ai çast bëhet aq intensiv saqë

gati është i barabartë me amshimin. Kjo është mënyra e vetme të kuptosh – çdo gjë tjetër është e parëndësishme.

212. Mendja i sheh gjërat bardh-zi – në mes nuk ka asgjë. Dita dhe nata, asgjë në mes. Dashuria dhe urrejtja, asgjë në mes. Mendja thjesht ndan në dysh, përgjysmon, pret ndonjë gjë në dy realitete të ndara, të kundërvëna, i bën aq të kundërta, saqë duket se nuk është e mundur të ekzistojë ndonjë mënyrë në të cilën ato nuk do të ishin të ndara, në të cilën do të ishin një realitet I vetëm. Mendja ka marrë vetëm dy skajet e një realiteti. Kjo që thuhet në vijim e provon këtë. Logjikisht, dashuria dhe urrejtja janë kundërshti, kundërthënie, por kjo në esencë nuk është e saktë. Dashuria lehtë mund të kalojë në urrejtje pa kurrfarë pengese. Urrejtja mund të kalojë në dashuri mu siç tallazet hyjnë në tallazet tjera pa kurrfarë pengese. Është parafytyrim yni se drita dhe errësira janë dy realitete kundërthënëse. Kjo nuk është e vërtetë. Nuk ka kundërshti. Më së tepërmi që mund të themi është se drita është më pak e errët, kurse errësira më pak e ndritshme. Por, duhet të shfrytëzojmë diçka që e bën dallimin vetëm në shkallë, e nuk krijon kurrfarë kundërthënieje. Për çdo ditë shohim sesi jeta kalon në vdekje aq qetësisht, aq heshturazi, pa kurrfarë pipëtime. Nuk mund ta dëgjosh madje as çapëritjen e hapave të vdekjes. Aty nuk mund të ketë kurrfarë kundërthëniesh. E ata që dinë, e dinë anën tjetër – se vdekja që vjen shndërrohet në trajta tjera jete. Të gjitha dallimet i ka bërë njeriu. Ekzistenca është pa dallime. Kur zëmë të mendojmë mbi padallimësinë, mbi një realitet të vetëm – duke mos e ndarë atë në dualitete, dikotomi – kryqi zhduket nga mendja jonë. Askush nuk të ka kryqëzuar; vetë je përgjegjës, shkaku se mund ta heqësh kryqin nga vetja dhe gjithë mendja jote mund të bëhet unitet.

213. Mendimet janë surrogate të vetëdijesimit.

214. Kjo është diçka që duhej mbajtur mend – kurdo që përjeton diçka për të cilën nuk ekziston kundërshtia, ke ardhur në shtëpi. Derisa ekzistojnë kundërshtitë, gjithmonë do të jesh i plasaritur. Do të jesh vetëm top futbolli në mes të atyre dy përvojave – ngandonjëherë duke u ndier i lumtur, ngandonjëherë i mërzitur, por kurrë nuk ke për ta ditur se ekziston diçka që është përmbi edhe të bukurën edhe depresiven. Prandaj kjo nuk mund të shprehet me fjalë, sepse të gjitha fjalët janë dyfytyrëshe: përndryshe nuk do të kishin kurrfarë domethënieje.

215. Dy persona që mendojnë janë dy; dy persona që nuk mendojnë janë një, sepse nuk ka dallime, nuk ka kufij – të dytë janë në gjendje të njëjtë. Mendimet do të jenë tjetër ndryshe, ato do ta tërheqin linjën e demarkacionit. Por, jomendimet nuk e kanë kufirin dhe nuk kanë demarkacion, nuk kanë dallime. Dy qenie të pafajësi janë një.

216. Fenomeni i paemër tek i cili çon besimi i plotë nuk është ndonjë marrëdhënie. Ai është pajtim. Dysia zhduket... është bërë një rreth, një pol. Dhe kjo përherë vjen pa kurrfarë informacioni paraprak, thjesht befas,

ngjashëm me puhinë. Por, kur njëherë provon – që edhe dashuria edhe besimi duken tepër të qartë – e ke njohur pasurinë. Kjo mund të ndodhë vetëm për disa sekonda, nuk ka rëndësi. Dashuria nuk është shumë e besueshme, por është e dobishme. Shfrytëzoje dhe kalo në besim. Por, as besimi gjithashtu nuk është argument i qindpërqindtë. Tejkaloje atë.

Atëherë më nuk mund të rashë: atëherë nuk ka mënyrë për t'u kthyer. Atëherë ajo është diçka që i bashkohet amshimit.

217. Në të andejmen e dashurisë dhe besimit është një hapësirë e cila nuk është as objektive as subjektive, e cila thjesht është aty. Ka shumë gjëra në ekzistencë të cilat nuk mund të emërtohen, kurse ato janë gjëra të vërteta. Ajo që mund të emërtohet paraqet kualitet të ulët të shtresës së ulët. Ajo e paemërtuara, hapësirë e qetë... ajo përmban dashuri, ajo përmban besim dhe diçka edhe më shumë. E ajo "më shumë"është aq e gjerë. Por, ajo mund të vijë vetëm vetë, ti nuk mund t'i grahësh.

218. Ta përjetosh këtë çast, njëkohësisht do të thotë edhe të përjetosh krejt çfarë ka qenë dhe krejt çfarë do të jetë, meqë ky çast i përmban të dyja. Ai e përmban gjithë të kaluarën, se ku ka për të shkuar e kaluara? Ajo shkon tutje dhe hyn në çastin e tanishëm. Kurse ai përmban edhe gjithë të ardhmen, se prej nga e ardhmja ka për të buruar? Ajo do të rritet prej këtij çasti, edhe në çastin tjetër edhe në çastin tjetër, dhe gjithë amshimin. Momenti i tashëm është fara që përmban gjithë drurët e së kaluarës, gjenerata e gjenerata drurësh. Ajo farë nuk ka ardhur prej askund, ajo ka ardhur prej drurit. Ai dru ka lindur prej ndonjë fare tjetër, kurse ajo farë ka ardhur prej ndonjë druri tjetër. Po qe se ktheheni prapa, farërat do të ju çojnë gjer tek vetë fillimet – nëse ka pasur farë fillimesh. Ajo përgjithmonë ka qenë aty. Kurse ajo farë gjithashtu përmban drurin e ardhshëm. Prej asaj fare ka për t'u rritur një dru i ri, kurse ai dru do të lindë mijëra fara dhe mijëra trungje. Një e vetmja farë mund ta gjelbërojë gjithë Tokën; e madje edhe mund të thuhet se ajo mund të gjelbërojë gjithë universin – aq shumë përmban një farë kaq e vogël.

219. Çasti i tanishëm është fara e kohës. Ajo është e padukshme – prandaj nuk dimë se çfarë përmban. Ajo përmban gjithë të kaluarën; ajo përmban gjithë të ardhshmen. Për këtë insistoj në këtë që vijon: mos mendo mbi të shkuarën, mos mendo mbi të ardhmen. Thjesht ji në çastin e tanishëm – dhe gjithë e kaluara është jotja, gjithë e ardhmja është jotja.

220. E panjohura përherë pandërprerë hyn në botën tënde të njohur dhe e shqetëson. Por, ajo e shqetëson vetëm për atë se ti nuk e pret me mirëseardhje. Nëse mund ta përshëndesësh të panjohurën, dhe nëse mund ta lësh të njohurën... Nëse je i gatshëm ta përshëndesësh të panjohurën, ti e di të fshehtën si të mbesësh fitues në të gjitha disfatat dhe në gjithë mossukseset.

221. Errësira ka qetësinë dhe errësira ka thellësinë. Errësira ka heshtjen dhe errësira merr gjithë diturinë tënde, merr krejt atë që mendon se të ka

takuar. Ajo të dërgon absolutisht në të panjohurën dhe në misteriozen. Për mua, errësira është një nga misteret më të mëdha të ekzistencës – larg më i madh se drita. Ata të cilët i frikësohen errësirës kurrë nuk do të mund të hyjnë në qenien e tyre. Ata kanë për të shkuar rreth e rrotull dhe kurrë nuk kanë për të ardhur tek vetvetja. E kjo duhet të jetë errësirë, dhe jo dritë, sepse drita vjen e shkon: e kur njëherë e zbulon pikën e errësirës në vetvete, ke zbuluar diçka që është e përjetshme, diçka të paasgjësueshme, diçka që është më shumë se ajo që ti di mbi jetën. Ajo është substanca themelore nga e cila është bërë ekzistenca.

222. Koha është një enigmë që nuk mund të zgjidhet; nuk ka mënyrë që ajo të zgjidhet. Ajo është strategji me të cilën lodhet mendja jote aktive – aq shumë saqë nga lodhja bie; vetëm ashtu ajo e njeh mossuksesin e vet. Në ato momente fokusi shumë lehtë mund të zhvendoset. Pasi që mendja nuk ka pasur sukses, ti lëvizë kah jomendja.

223. Ka ekzistuar arsye e besueshme që mistikët meditimin ta quajnë "jo-mendje", sepse po u quajt meditim, mendja përsëri prej tij bën një qëllim. Atëherë duhet ta arrish meditimin. Prandaj nuk ka dallim se a është cak përndritja apo meditimi: qëllimi mbetet, ardhmëria mbetet dhe ato vazhdojnë ta asgjësojnë të tashmen. Mistikët të cilët për herë të parë e kanë ndërruar termin "meditim"në "jomendje"kanë pasur vizion të hatashëm. Tashmë, jomendja nuk mund të bëhet qëllim. Mendja nuk mund të bëjë qëllim prej saj. Kjo thjesht është absurd – si mendja mund të thotë se qëllim është jo-mendja? Ajo thjesht do të thotë se kjo nuk është e mundur, mendja është gjithçka, nuk ekziston jo-mendja. Kjo ka qenë strategjia që mos me t'u lejua ta shndërrosh në qëllim. Tepër pak njerëz e kanë kuptuar këtë strategji; për këtë e kanë quajtur jo-mendje – që të pengohet mendja që prej saj të bëjë qëllim. Prandaj - ji - gjithnjë e më tepër e më tepër në gjendjen e jo-mendjes. Thjesht vazhdo të mënjanosh kujtimet, fantazinë, ta pastrosh dhe ta kthjellosh çastin e tanishëm. Dhe ashtu si kjo do të shkojë duke u thelluar, ashtu si ti shkon duke u bërë gjithnjë e më i aftë e më i aftë për ta pasur jomendjen, përndritja do të vijë nga vetvetja.

224. Mu siç dashuria shërben si mjet besimi, besimi i shërben si mjet diçkahi të cilin e tejkalon – për ç'gjë në asnjë gjuhë nuk ekziston fjala. Ajo është përvojë. Ajo nuk është çështje dashurie, nuk është çështje besimi, veçse diçka absolutisht e panjohur për mendjen. Dashuria dhe besimi të ndihmojnë ta arrish. Prandaj mbaje në mend, ato janë vetëm mjete për t'u arritur qëllimi për të cilin nuk ekziston emër. Por, befasisht, kur besimi të jetë i plotë, ti mund ta pashë për një çast. Ai është vërshues; ti thjesht zhdukesh.

225. E vërteta nuk mund të thuhet, ndaj krejt çfarë mund të thuhet do të jetë rrenë e bukur – e bukur shkaku se mundet me të sjellë tek e vërteta. Për këtë unë e bëj dallimin ndërmjet rrenave: rrenat e bukura dhe rrenat e shëmtuara – rrenat e shëmtuara, të cilat ju zvarritin për tek e vërteta dhe

rrenat e bukura, të cilat ju afrojnë kah e vërteta. Por, sa i përket përcaktimit të tyre, që të dyja janë rrena. Por, ato rrena të bukura veprojnë: së andejmi në njëfarë mënyre përmbajnë shijen e së vërtetës.

226. Lëngu i vërtetë i jetës është përbrenda teje. Mu në këtë çast mund të kthehesh përbrenda vetes, të shikosh në vetvete. Nuk nevojitet kurrfarë liturgjie, nuk nevojitet kurrfarë lutjeje. Krejt çfarë është e nevojshme është udhëtimi i qetë në qenien tënde personale. Unë atë e quaj meditim, pelegrinazh i qetë në qenien tënde personale. E atë çast kur e zbulon qendrën tënde, e ke zbuluar qendrën e gjithë universit.

27. Ekstremisti është përherë egoist.

228. Në momente të caktuara je më i vetëdijshëm; në momente të caktuara, më pak i vetëdijshëm. Është e mundur ta krijosh situ- atën në të cilën do të jesh më i vetëdijshëm. Për këtë vetëdijesimi është bërë bazë e meditimit. E me vetëdijesim ka ardhur befasia – mendimet janë zhdukur. Kur je plotësisht i vetëdijshëm, atëherë nuk ka më mendime dhe, befas, koha është ndalur.

229. Si mund të vdesësh natyrshëm nëse jeton jonatyrshëm?

230. Vdekja është mendimi i të tjerëve për ty.

231. Vetëm njeriu i zgjuar mund të vdesë me vdekje të natyrshme; përndryshe të gjitha vdekjet janë të panatyrshme, sepse të gjitha jetët janë të panatyrshme.

232. Vdekja është vetëm kulmi, kreshendoja e jetës tënde. Ajo nuk është kundër jetës, ajo nuk e asgjëson jetën. Për të vdekur bukur, njeriu duhet të jetojë bukur. Për të vdekur në mënyrë të admirueshme, në ekstazë, njeriu duhet ta përgatisë gjithë jetën e vet për ekstazë, trazim, mahnitje.

233. Kur them se duhet të zhdukesh për ta kuptuar atë të skajshmen, nuk mendoj në ty; mendoj në atë që ti s'je. Mendoj në ty siç ti mendon se je. Uni që njeh kur je një me ekzistencën nuk është uni yt i vjetër. Ai ka qenë personi yt – kurse ky individualiteti yt. Atë ta ka dhënë shoqëria, kurse ky është natyrë, realitet, dhuratë e ekzistencës.

234. E vërteta nuk është objekt të cilin do ta gjesh ndokund kur je i qetë. E vërteta është subjektiviteti yt. Thjesht provo ta kuptosh. Ti je këtu dhe bota është këtu: krejt çfarë ti sheh është objekt, por ai që sheh është subjekti. Në qetësi, të gjitha objektet zhduken – ti e ke gjithë përjetësinë dhe qetësinë. Ajo është plot vetëdije; ajo është plot prani; ajo është plot me qenien tënde. Por, nuk ke për të gjetur asgjë të tillë që do të ishte e vërteta. Ajo do të bëhej objekt – kurse e vërteta në asnjë mënyrë nuk është objekt. E vërteta është subjektivitet. Ta zbulosh subjektivitetin tënd – të papenguar, të cilin askush nuk e kundërshton – në pafundësinë dhe përjetësinë e vet të plotë – ajoështë e vërteta.

235. Dëshmimi është si kur e gjen veten në pasqyrë. E kur kjo ndodh, zënë të ndodhin çuditë. Kur thjesht i sodit mendimet e tua, mendimet

zhduken. Pastaj befas lind qetësia e llahtarshme në ty, për të cilën kurrë më herët nuk ke ditur. Kur i shikon disponimet e tua – zemërimin, pikëllimin, lumturinë – ato befasisht zhduken, dhe ti e përjeton një qetësi edhe më të madhe. E kur nuk ka asgjë çfarë do të vështroje, ja revolucioni: energjia e të vështruarit lëviz në vetvete, sepse nuk ka asgjë që në këtë do ta pengonte, nuk ka mbetur asnjë objekt. Fjala "objekt"është e bukur. Ajo thjeshtë do të thotë ajo që të pengon, të kundërshton. Kur nuk ka objekte, të vështruarit tënd thjesht lëvizë për një rreth të plotë kah vetvetja – kah burimi – dhe kjo është pika në të cilën njeriu bëhet i përndritur.

236. Përndritja thjesht është njohje e qenies tënde, njohje e përjetësisë së qenies tënde, njohje se më herët nuk ka pasur vdekje e as që ndonjëherë prapë do të ketë vdekje – se vdekja është e trilluar. Të pamurit e qenies tënde në lakuriqësinë e vet të skajshme, në bukurinë e vet absolute, në madhështinë e vet, qetësinë e vet, ekstazën e vet – fjala "përndritje"përfshin të gjitha këto. Kur njëherë e shijon atë lëng, mendja fillon me të lëshuar nga kthetrat e veta, sepse ke gjetur diçka që për nga kualiteti është aq lart, aq përmbushës, kënaqësi aq e madhe, saqë mendja e ndjen se roli i saj ka përfunduar. Mendja duket e shëmtuar, shkaku se të ka sjellë vetëm mërzi, brenga, shqetësim. Me çfarë ajo ka kontribuar? Shtrëngimi i saj lëshon pe; ajo zë të fshihet në hije dhe gradualisht zhduket.

Ti vazhdon të jetosh, por jeta jote tash është valëvitëse; e ajo që ke fituar si nusprodukt në atë pauzë të vogël të jo-mendjes vazhdon të rritet. Asaj rritjeje nuk i shihet fundi. Përndritja vetëm fillon, ajo kurrë nuk përfundon.

237. Nuk po provoj me të dhënë kurrfarë idealesh – se do të duhej të bëheshe i këtillë apo i atillë. Thjesht përpiqem me të ndihmuar me pa se ti veç je ai çfarë ke nevojë të jesh. Thjesht hidhi të gjitha gjakimet, të gjitha dëshirat, të gjitha ambiciet për të qenë dikush tjetër, që të mund të jesh pikërisht ai që je. Nuk dua me të tërheqë nga qenia jote. Dua që gjithnjë e më tepër t'i ofrohesh qenies tënde, që në fund të mbetesh vetëm ti në vetveten.

238. Dëshira, si e tillë, përherë është joshpirtërore. Prandaj, nuk mund të ekzistojë kurrfarë dëshire e përshpirtshme.

239. Njeriu është eksperimenti më i madh i ekzistencës. Në këtë univers të gjerë e të pafund, vetëm në këtë Tokën e vogël ekzistenca ia ka dalë ta prodhojë njerëzimin – i cili ka aftësinë që të bëhet plotësisht i vetëdijshëm. Ekzistenca pret shumë prej teje.

240. Në ty, nga koha në kohë, ndodh ndërrimi i caktuar i personalitetit, përpiqu vetëm ta vështrosh këtë, por mos u përziej me ato personalitete sepse ashtu do të krijosh konfuzion edhe më të madh, hutesë edhe më të madhe. Vetëm vështro, se gjersa i vështron gjithë ato personalitete, ti bëhesh i vetëdijshëm se ekziston gjithashtu edhe një vështrues, që nuk është asnjëri prej atyre personaliteteve, por që para tij të gjitha ata vijnë dhe

shkojnë. Ai nuk është asnjëri prej atyre personaliteteve, për atë se ato nuk mund të vështrohen në mes veti. Kjo është tejet interesante dhe tejet thelbësore – që një personalitet nuk mund ta vështrojë tjetrin, sepse ata nuk e posedojnë shpirtin. Ajo është si veshja jote. Ti mund ta ndërrosh veshjen, por veshja jote nuk mund ta dijë se është ndërruar, se në vend të saj tash është përdorur një tjetër pjesë e veshjes. Ti nuk je veshja, prandaj mund ta ndërrosh, ti nuk je personaliteti – andaj mund të jesh i vetëdijshëm për të gjitha ato personalitete të shumta. Kjo, po ashtu, e bën një gjë tepër të qartë, se ekziston diçka e pandryshueshme që e vështron gjithë këtë lojë të personaliteteve që ndërrohen në ty. E kjo mosndryshueshmëri, kjo je ti.

241. Vetëm vështroji ato personalitete, por mbaje në mend se zgjimi yt është realiteti yt. Dhe po qe se do të mund ta mbash vëmendjen në personalitetin e caktuar në ty, të gjithë ata do të zënë të zhduken, nuk do të mund të jetojnë. Atyre iu nevojitet që me diçka të identifikohen për të mbetur në jetë. Po qe se, për shembull, ti hidhërohesh, ajo kërkon prej teje që të harrosh natyrën tënde të vërtetë dhe që të identifikohesh me hidhërimin, nëse nuk identifikohesh – atëherë hidhërimi nuk ka jetë: ai bëhet i vdekur, vdes, zhduket. Së këndejmi bëhu sa më shumë që mundesh i mbledhur, i koncentruar në zgjimin tënd, dhe të gjitha ato personalitete në ty do të zhduken. E kur të mos mbetet më asnjë, atëherë realiteti yt – zotëriu yt – do të vijë në shtëpi. i atëherë bëhesh i vërtetë, autentik. Dhe çfarëdo që bën, e bën atë tërësish, i dhënë pas saj – pa kurrfarë ankimi, përherë i hareshëm, me disponim.

242. Shumë nga problemet tona – në të vërtetë shumica prej tyre – lindin sepse kurrë me to nuk jemi përballur, kurrë me to nuk jemi konfrontuar; dhe kjo se me to nuk jemi përballur u jep energji. Frika prej tyre u jep energji, përherë kur duam t'u shmangemi i ushqejmë me energji – sepse ashtu iu dorëzohemi. Dorëzimi yt i vërtetë u jep jetë. Nëse nuk dorëzohesh, ato nuk mund të jetojnë. Ti e ke burimin e energjisë në vetvete.

Çfarëdo që ndodhë në jetën tënde, atë e kërkon energjia jote. Po qe se nuk e ndërpret atë burim energjie – kjo është ajo që unë, me fjalë tjera, e quaj identifikim – dhe po qe se nuk identifikohesh me ngjarjet, ato menjëherë vdesin, sepse nuk e posedojnë energjinë e tyre vetanake. Ai mos-identifikim është ana tjetër e zgjimit.

243. Lehtë është të arrish shprehinë, vështirë është ta arrish vetëdijesimin – por vetëm në fillim.

244. Ne kurrë nuk çajmë kokë për rrënjën e dashurisë, por gjithmonë flasim për lulet e saj. U flasim njerëzve që të mos bëhen të dhunshëm, që të jenë të ndjeshëm, të dashur – aq shumë sa të mund t'i duan armiqtë e tyre, të mund t'i duan madje edhe të afërmit e tyre. Ne flasim mbi lulen, por askush nuk çan kokë për rrënjën. Së këndejmi lind pyetja: pse ne nuk e duam ekzistencën? Pyetja nuk ka të bëjë me atë se a e do ti këtë person apo atë tjetrin, këtë të dytin, këtë armikun; veçse (ka të bëjë) me atë – se a do ti

apo nuk do fare? Vallë, a e do trupin tënd personal? A je kujdesur ndonjëherë për të me dashuri? A e do vetveten? Ti je i pavyeshëm, kurse do të doje të ishe I mirë. Je mëkatar, kurse do të doje të bëheshe shenjtor. Si mund ta duash vetveten nëse nuk mund ta pranosh vetveten ashtu siç je. E në të vërtetë kjo është rrënja. Lulja plastike është e pandryshueshme – dashuria e mbyllët është e pandryshueshme. Lulja natyrale është e ndryshueshme; ajo ndryshon prej çastit në çast. Ajo sot është këtu, vallëzon në erë, nëpër diell e nëpër shi. Por nesër ti nuk do të mund ta gjesh. Ajo zhduket po aq mistershëm siç është lajmëruar. Dashuria e vërtetë është si lulja natyrore.

245. Zemra nuk di asgjë mbi të kaluarën, asgjë mbi të ardhmen; ajo di vetëm për të tashmen. Zemra nuk ka kurrfarë ideje mbi kohën.

246. Kupto se e kaluara dhe e ardhmja nuk ekzistojnë. E vetmja që ke ai është një çast me të vërtetë i vogël: ky çast. Ti nuk ke asnjë çast tjetër. Ti përherë e ke vetëm një çast në duart e tua, e ai është aq i pavërejtshëm dhe afatshkurtër saqë do të ikën me vrap nëse do të mendosh mbi të kaluarën dhe të ardhmen. E vetë ai çast është jeta dhe vetë ai çast është realiteti.

247. Politika është sëmundje, dhe do të duhej trajtuar pikërisht ashtu. Ajo është më e rrezikshme se kanceri; nëse operacioni është i domosdoshëm, duhet bërë. Por, politika është e ndytë në esencën e vet. Dhe duhet të jetë e tillë sepse mijëra njerëz gjakojnë, kanë dëshirë të zjarrtë të zënë të njëjtin pozicion kyç. Së këndejmi është krejtësisht e natyrshme se ata do të luftojnë, se do të vrasin, se do t'i bëjnë të gjitha për hir të saj. I tërë programi ynë mental është i gabuar sepse jemi programuar për të qenë ambiciozë – e kjo është ajo që e përbën esencën e politikës. Dhe kjo nuk ngjan vetëm në botën e përditshme të politikës, por kjo e ndotë edhe jetën tënde të përditshme.

248. Madje edhe fëmija i vogël zë t'u buzëqeshë nënës dhe babait me buzëqeshje të shtirur. Nuk ka ndonjë domethënie më të thellë përtej saj, por fëmija thjesht e di se, po qe se buzëqesh, do të marrë shpërblimin për të. Ai e ka mësuar rregullën e parë nga shkencat politike. Ai ende është në djep, kurse ju e mësoni të jetë politikan. Dhe së këndejmi politika është e pranishme në të gjitha marrëdhëniet njerëzore. Mashkulli e ka sakatuar femrën. Kjo është politikë. Femra e përbën gjysmën e njerëzimit dhe mashkulli nuk ka të drejtë ta sakatojë kështu deri në fund; por, gjatë shekujve, mashkulli e ka sakatuar femrën. Ai nuk e ka lejuar të arsimohet, nuk e ka lënë madje as t'i dëgjojë mësimet e shenjta. Në shumë konfesione mashkulli nuk u ka lejuar femrave që të hyjnë në faltore; po qe se, në ndonjë rrethanë, edhe do t'ia lejonte, ajo atje ka qëndruar në vend të izoluar. Ato as para Zotit nuk mund të jenë të barabarta me meshkujt.

249. Mashkulli ka provuar t'ia shkurtojë femrës lirinë në të gjitha mënyrat e mundshme. Kjo është politikë; kjo nuk është dashuri. Ti e do femrën, por nuk ia jep lirinë. Ç'lloj dashurie është ajo e cila frikësohet ta

japë lirinë? Ti e ke mbyllë në kafaz femrën si papagallin. Ti mund të thuash se e do papagallin, por nuk e kupton se ashtu je duke e varë atë. Ti ia ke suprimuar papagallit tënd gjithë qiellin e tij, kurse ia ke dhënë vetëm kafazin. Kafazi mund të jetë i ndërtuar nga ari, por madje edhe kafazi i artë nuk mund të krahasohet me lirinë të cilën papagalli e ka në qiell, ashtu që fluturon nga lisi në lis dhe e këndon këngën e tij – por jo ashtu siç ti do ta detyrosh të këndojë, por ashtu që ajo është sipas natyrës së vet dhe është shprehje autentike e tij.

250. Gjysma e njerëzimit në secilin shtet, në secilin civilizim është e shkatërruar si pasojë e politikës së familjes. Por kjo është esenca e vetë politikës. Kudo që ekziston nevoja për të pasur pushtet mbi personin tjetër – ajo është politikë. Pushteti është përherë politik, madje edhe mbi fëmijët e vegjël. Prindërit mendojnë se i duan fëmijët e tyre, por ajo është vetëm në mendjet e tyre; në të vërtetë, ata i duan fëmijët për t'i përulur. E çfarë do të thotë ajo përulje? Ajo do të thotë se e tërë fuqia është në duart e prindërve. Po qe se përulja është kualitet aq i lartë, përse atëherë prindërit nuk u përulen fëmijëve të tyre? Po qe se ajo është gjë aq religjioze, prindërit do të duhej t'u përuleshin fëmijëve të vet. Pushteti nuk ka kurrfarë lidhjeje me religjionin. E vetmja lidhje në mes tyre mund të jetë në atë që ta fshehin politikën në këtë botë të bukur. Njeriu duhet të zbulojë secilën pikë ku është futur politika – kurse ajo është futur gjithkund, në secilën marrëdhënie. Ajo e ka ndotur jetën e gjithmbarshme, e edhe më tej

pa ndalim e ndot.

251. Është krijuar ambicie e tillë që ti duhet të bëhesh dikush në këtë botë, ta dëshmosh se nuk je vetëm një person i rëndomtë, por se je i pazakonshëm. Por përse kjo? Cilit qëllim i shërben kjo? Kjo i shërben vetëm një qëllimi: që ti të bëhesh i pushtetshëm, kurse gjithë të tjerët të jenë të nënshtruar. Ti do të doje ta tredhje gjithë njerëzimin në mënyra të ndryshme – dhe kjo tredhje është esenca e politikës.

252. Njerëzit e duan lirinë – por askush nuk e do përgjegjësinë. Kurse liria dhe përgjegjësia shkojnë së bashku dhe nuk mund të jenë të ndara.

253. Pse brengosesh rreth asaj që të jesh i pëlqyer? Ka kuptim të brengosesh rreth saj vetëm nëse nuk e do punën tënde; vetëm atëherë ajo e ka kuptimin e vet të plotë, në të kundërtën kjo është vetëm surrogat. Ti e urren punën tënde, nuk e do, porse e kryen shkaku se ajo ka me të sjellë mirënjohje; ti do të jesh i pranuar, do të jesh i çmuar. Por, në vend se të mendosh mbi këtë, rishqyrtoje punën tënde. A e do për ta punuar? Dhe kjo është e tëra. Nëse nuk e do, atëherë ndërroje atë. Prindërit, mësuesit përherë insistojnë në atë se duhet të jesh i pranuar, se duhet të jesh i pëlqyer. Kjo është strategji tepër dinake që njerëzit të mbahen nën kontroll.

Mësoje një gjë themelore. Bëje vetëm atë që dëshiron ta bësh, që do ta bësh, dhe kurrë mos kërko të jesh i pëlqyer. Ai është fillimi. Përse do të kërkoje që dikush me të pëlqyer? Përse do të gjakoje që dikush me të

pranuar? Shiko thellë në vete. Ti sigurisht nuk e do atë që bën. Ti me siguri frikohesh se ndodhesh në rrugë të gabuar. Pranimi ka me të ndihmuar ta ndjesh se je në rrugën e duhur. Aprovimi do të bëjë që ta ndjesh se po shkon kah qëllimi i drejtë. Qe pyetje për ndjenjat e tua më të thella, kjo nuk ka kurrfarë lidhjeje me botën e jashtme: Përse varesh nga të tjerët? – Atëherë të gjitha këto gjëra varen nga të tjerët dhe ti vetë bëhesh i varur. Nëse i ikën kësaj varësie, ti atëherë bëhesh individual dhe do të jesh individ, ashtu që do të jetosh në liri të plotë mbi këmbët e tua, duke u furnizuar nga burimet e tua individuale – e kjo është ajo që bën që njeriu të jetë vërtet në qendrën e vet, bimuar nga rrënja e vet. Dhe ky është fillimi i lulëzimit të tij më të bujshëm.

254. Po qe se inteligjenca mbetet e padjallëzuar, ajo është gjëja më e bukur e cila mund të ndodhë. Por po qe se inteligjenca është kundër padjallëzisë, atëherë ajo është thjesht ligësi dhe kurrgjë tjetër: ajo në të vërtetë edhe nuk është inteligjencë. Në çastin kur çiltërsia zhduket, shpirti i inteligjencës shkon dhe mbetet vetëm kërma. Ajo atëherë është më mirë të quhet, thjesht, "intelekt". Në këtë mënyrë ti mund të bëhesh intelektual i madh, por kjo nuk ka me ta ndryshuar jetën dhe nuk ka me të hapur ndaj mistereve të ekzistencës. Ai mister është i hapur vetëm ndaj inteligjencës së fëmijës. Dhe, në të vërtetë, personi inteligjent e ruan fëmijërinë e vet, e jeton deri në frymën e fundit. Kurrë nuk e lë ajo – çudia të cilën fëmija e ndjen duke shikuar zogjtë, duke soditur lulet, qiellin... Inteligjenca, po ashtu, duhet të jetë, në njëfarë mënyre, fëmijërore.

255. Pak është e pazakonshme ajo se e vërteta nuk është demokratike. Mbi atë se ç'është e vërteta nuk kanë për të vendosur votuesit në zgjedhje; në këtë mënyrë ne, përkundrazi, kurrë nuk kishim për të ardhur tek e vërteta. Njerëzit do të votojnë për atë që është komode – e gënjeshtra është tepër komode, se ti nuk dëshiron të investosh kurrfarë mundi rreth saj, por dëshiron vetëm të besosh. E vërteta, megjithatë, kërkon angazhim të madh, zbulim, rrezik, e kjo kërkon që vetë të ecësh shtegut të cilit askush para teje nuk ka ecur.

256. Cilësitë e personit të rritur janë tepër të. çuditshme. E para, ai nuk është personalitet, e nuk është as unë i vërtetë. Ai është i pranishëm, por nuk është personalitet. E dyta, ai më tepër është si ndonjë fëmijë – i thjeshtë dhe naiv. Për këtë unë them se cilësitë e njeriut të rritur janë tejet të çuditshme, sepse "rritja"jep iluzionin se, nëse ai apo ai tjetri është me përvojë, ai sipas moshës është i vjetër. Psikikisht kjo mund të jetë kështu, por shpirtërisht ai është një fëmijë naiv. Rritja e tij nuk do të thotë se ai ka zënë vetëm përvojë jetësore – atëherë ai nuk do të mund të ishte i pranishëm. Ai do të mund të ishte vetëm person me përvojë – i shkathtë, por jo edhe i pjekur. Pjekuria nuk ka kurrfarë lidhjeje me përvojën jetësore. Ajo ka lidhje me udhëtimin tënd të brendshëm, me përvojën e brendshme.

257. Sa më tepër ndonjë person futet më thellë në brendësinë e vet, ai do të jetë më i pjekur. Kur arrin gjer tek vetë qendra e qenies së vet, ai do të jetë përsosmërisht i pjekur. Por, në atë çast personaliteti zhduket, kurse mbetet prania; uni zhduket, mbetet vetëm qetësia. Përvoja zhduket, mbetet mituria. Për mua, pjekuri është vetëm emër tjetër për realizimin. Ti mund ta arrish realizimin e mundësive të tua. Ato mund të bëhen reale. Fara e ka përfunduar udhëtimin e vet të gjatë dhe ka lulëzuar. Pjekuria është aroma e lules. Ajo i jep bukuri të pafund individit. Ajo i jep inteligjencë, mundësinë më të mprehtë të inteligjencës. Ajo në njeriun, në individin krijon vetëm dashuri. Veprimi i tij është dashuri, mosveprimi i tij është dashuri. Jeta e tij është dashuri, vdekja e tij është dashuri. Ai, në të vërtetë, është lule e dashurisë.

258. Muzika bashkëkohore e ka humbur magjinë shkaku se e ka harruar qëllimin e vet themelor. Ajo e ka harruar origjinën e vet. Ajo nuk e di se ka bazë të njëjtë me meditimin. E njëjta gjë vlen edhe për artet tjera. Të gjitha ato bëhen meditative, dhe të gjitha ato njeriun e çojnë në çmenduri. Artisti ashtu e krijon rrezikun si për vetveten gjithashtu edhe për gjithë ata të cilët do ta dëgjojnë. Ai mund të jetë edhe piktor, por edhe pikturimi i tij po ashtu do të jetë çmenduri – shkaku se gjithë ai art nuk rrjedh nga të medituarit.

259. E tërë mendja vepron ashtu që krijon ndasi. Zemra vepron ashtu që i sheh lidhjet bashkuese për të cilat mendja është plotësisht e verbër.

260. Mendja e mediokritetit nuk mund të çmendet.

261. Mendimi mbi qetësinë dhe qetësia nuk shkojnë së bashku. Ky nuk është problem yti personal; ky është problem i mendjes njerëzore si e tillë, sepse për të qenë e qetë, për të pasur qetësi, do të duhej të ishte në gjendjen e jomendjes. Mendja nuk mund të jetë e qetë. Ajo duhet pa ndalim të mendojë, të brengoset. Mendja punon si biçikleta. Nëse i sjell pedalet e saj, ajo sillet; në atë moment që pushon së bëri atë, ke për të rënë poshtë. Mendja është automjet në dy rrotë, mu si biçikleta; kurse të menduarit tënd është sjellje e pandërprerë e pedaleve. Madje nëse ndonjëherë je vetëm pak më i qetë, ti menjëherë zë të brengosesh: "Përse jam i qetë?"E pastaj i bën të gjitha që të krijosh brengosje, mendueshmëri, sepse mendja mund të ekzistojë vetëm në një mënyrë – në nxitim, përherë në vrap për diçka, apo në ikje prej diçkahi, por përherë në nxitim. Pikërisht ai nxitim, ajo është mendja. Në çastin kur ndalon, mendja zhduket.

262. Në çdo mënyrë ne provojmë ta mënjanojmë ndjenjën se jemi të vetmuar në ekzistencë. Nga kjo arsye ne sajojmë të gjithë llojet e titujve. Ndonjë njeri, ta zëmë, merr nuse; e ç'është martesa tjetër përveçse titull? Por përse? Sepse ata dëshirojnë ta zotërojnë atë vetmi dhe disi të ndërtojnë urë. Por ura kurrë nuk është e ndërtuar; ata vetëm mendojnë se njëri është burri, kurse tjetra gruaja, ndërkaq ata mbesin vetëm të vetmuarit. Tërë jetën ata do të jetojnë, por edhe përkundër kësaj nuk do të jenë kurrgjë

tjetër përveçse të vetmuar, shkaku se askush nuk mund të depërtojë në vetminë e huaj. Ti nuk duhet të jesh i vetmuar nëse mund të depërtosh në vetminë time, apo nëse unë mund ta gjej rrugën deri tek vetmia jote – por kjo nuk është e mundur, ekzistencialisht nuk është e mundur. Ne mund të avitemi tepër afër, por sa më të afërt që bëhemi ne, bëhemi më të vetëdijshëm për vetminë, sepse nga ajo afërsi mund të shohim më mirë: "Tjetri për mua është i pakuptueshëm dhe, sigurisht, i pamundësi për njohje".

263. Secili prej nesh ka një lloj panciri. Ekziston arsyeja për këtë. Si e para, fëmija lindet skajshmërish i pandihmë në botën në të cilën nuk di asgjë. Natyrshëm, ai i frikohet së panjohurës e cila ndodhet para tij. Ai akoma nuk ka harruar nëntë muajt e mbrojtjes së plotë, të sigurisë – atje ai ka qenë pa probleme, pa përgjegjësi, pa frikë për të nesërmen. Për ne ajo është nëntë muaj, por për fëmijën ajo është përjetësi. Ai nuk di asgjë për kalendarin; ai nuk di asgjë për minutat, orët, ditët, muajt. Ai ka jetuar në përjetësi, plotësisht i mbrojtur dhe i sigurt, pa kurrfarë përgjegjësie. E atëherë, befas, ai gjendet në botën e panjohur, në të cilën është i varur prej secilit, prej të tjerëve. Dhe është e natyrshme se ka për të ndjerë frikë. Secili është më i madh dhe më i fuqishëm se ai, dhe ai nuk mund të jetojë pa ndihmën e huaj. Ai e di se është i varur, se e ka humbur pavarësinë e tij, lirinë e tij. Nga kjo pikëpamje, panciri mund të jetë I domosdoshëm; sigurisht edhe është. Por kur rritesh, nëse jo vetëm je plakur, por edhe je pjekur – rritur në pjekuri – ti ke për të parë se çfarë bart me vete. Shiko më mirë dhe ke për të parë frikë prapa saj. Krejt çfarë është në lidhje me frikën, personi i pjekur duhet vetë ta zgjidhë me vetveten. Ky është tregues se është pjekur. Vetëm shiko të gjitha veprimet e tua, të gjitha besimet e tua dhe vërej se a janë ato të bazuara mbi realitetin, mbi përvojën, apo, megjithatë, mbi frikën. E çfarëdo qoftë e themeluar mbi frikën, duhet të hidhet në këtë çast, pa u menduar gjatë. Ai është panciri yt.

264. Pancirin tënd psikik askush nuk mund ta heqë prej teje sepse ti do të luftosh për të. Vetëm ti mund të bësh diçka për ta hedhur. E kjo do të thotë ta hulumtosh deri në detaje. Po qe se është i themeluar mbi frikën, hidhe atë. Nëse, megjithatë, është i themeluar mbi arsyen, përvojën, kuptimin, atëherë ai është diçka që nuk duhet hedhur por diçka që do të duhej të bëhej pjesë e qenies tënde. Por një gjë, e cila është e themeluar mbi përvojën, ti nuk ke për ta gjetur në pancirin tënd. Ajo është frika, nga A deri në ZH. E tërë jeta jonë nuk është asgjë tjetër veçse frikë; dhe kjo është arsyeja se përse helmojmë të gjitha përvojat tona tjera. Ne e dashurojmë ndokënd, por ajo dashuri është e themeluar mbi frikën. Për këtë ajo është e pasinqertë, e helmatisur. Ne gjurmojmë për të vërtetën, por nëse ajo rrjedh nga frika nuk do të mund ta gjejmë. Çfarëdo të punosh mbaje në mend një gjë: Nëse veprimi yt rrjedh nga frika, ti kurrë nuk do të piqesh, por ke për t'u venitur dhe vdekur. Frika është shërbëtori i vdekjes.

265. Personi i pafrikueshëm ka për t'i fituar si shpërblim të gjitha dhuratat e jetës. Dhe atëherë më nuk do të ketë pengesa; ato do të thyhen nga furia e dhuratave dhe çfarëdo që të bëjë ai do të jetë veprim i fuqisë, i pushtetit, i besimit në vetvete – një ndjesi e pafund autoriteti.

266. Atë që duhet ta kuptosh gjithsesi është ajo se ndokush mund të identifikohet me diçka që, për nga natyra e vet, nuk është. Në të vërtetë tash ti je identifikuar me mendjen tënde. Ti mendon se je ajo. E pikërisht nga ky identifikim lind frika. Nëse je identifikuar me mendjen, atëherë, natyrshëm, po qe se ajo ndalet, edhe ti ke mbaruar, nuk ekziston më. Sepse, përveç mendjes për ty nuk ekziston asgjë tjetër. Por realiteti është pikërisht ai se ti nuk je mendja, ti je diçka jashtë mendjes; së këndejmi është absolutisht e domosdoshme që mendja të ndalet, ashtu që për herë të parë do të mund të kuptosh se ti nuk je mendja – për arsye se kur mendja ndalet, ti edhe më tutje mbetesh këtu. Mendja ka shkuar, por ti akoma je këtu dhe atë me gëzimin më të madh, me lavdinë më të madhe, me shkëlqimin më të madh, me vetëdijen më të madhe, me origjinalitetin më të madh.

267. E vërtetë është se ne jemi të vetmuar, se jemi të huaj – dhe bota do të ishte larg më e mirë po qe se do ta pranonim këtë të vërtetë themelore: se jemi të huaj. E çfarë ka të keqe në atë nëse dashurohesh në personin e panjohur? Çfarë nevojitet para se të dashurohesh në personin e panjohur? Ta asgjësosh të panjohurën si të tillë? Njëra nga bukuritë jetësore është ajo se të gjithë ne jemi të panjohshëm, dhe nuk ekziston mënyrë që ta ndryshojmë këtë realitet. Bukur është ajo që personi i panjohur të të dashurojë, që personin e tillë ta kesh mik, se të panjohurit janë kudo në botë. Kështu e tërë bota bëhet fshehtësi – e ajo edhe është fshehtësi.

268. Kjo është gjë e njohur: ti dashurohesh në ndonjë njeri, por nuk dashurohesh në njeriun e vërtetë, porse dashurohesh në njeriun nga imagjinata jote. Kjo është kështu derisa nuk e kaloni njëfarë kohe së bashku. Fillimisht ti nga ballkoni yt e sheh ndonjë njeri, apo shkurtimisht e takon në plazh, apo mbaheni dorë për dore në kinema dhe atëherë zë të ndjesh: "Ne jemi të krijuar njëri për tjetrin". Por nuk ekziston diçka e tillë si – të krijuar njëri për tjetrin. Ti vazhdon të projektosh edhe më shumë fantazi në atë njeri – pavetëdijshëm. Ti krijon aurën e caktuar rreth atij njeriu, kurse ai atë njësoj e krijon rreth teje. Çdo gjë duket sikur do të jetë përrallore, sepse ti e ke bërë atë përrallore, e ke thurur me ëndrra, pavarësisht realitetit. Dhe të dy përpiqeni, në të gjitha mënyrat e mundshme, të mos ia rrezikoni njëri-tjetrit ëndërrimet. E atëherë gruaja sillet ashtu siç burri i saj dëshiron, kurse burri sillet ashtu siç gruaja e tij dëshiron. Por ti nuk mund ta bësh atë më gjatë se disa minuta apo, megjithatë, disa orë. Njëherë kur jeni kurorëzuar, ti ke dëshiruar të jetoni së bashku njëzet e katër orë në ditë. Por kjo është bërë barrë e padurueshme, sepse më nuk mund të shtiresh se je ai që nuk je. Kur shteron imagjinata

jote mbi burrin apo mbi gruan, edhe sa gjatë do të mund të shtiresh? Herët apo vonë kjo ka me t'u bë barrë, e pastaj do të fillosh të hakmerresh. Do ta shkatërrosh gjithë atë imagjinatë të cilën burri yt e ka thurur rreth teje shkaku se nuk dëshiron më të jesh e burgosur në të; ti dëshiron të jesh e lirë dhe të jesh vetëm e vetvetes. E njëjta situatë është me burrin; ai dëshiron të jetë i lirë dhe t'i përkasë vetëm vetvetes. Dhe në këtë pasqyrohet konflikti i pandalshëm në mesin e gjithë dashnorëve dhe në të gjitha marrëdhëniet.

269. Dashuria jep liri. Dashuria i lejon të gjitha; atë që tjetri ndjen se do të dëshironte ta bënte, e ka të lirë ta bëjë. Çfarëdo që ai ndjen – nëse ajo e bën të lumtur – ajo është zgjedhja e tij. Nëse e do dikë, atëherë mos u përziejë në privatësinë e tij. Lëre privatësinë e personit të dashur në qetësi. Mos përpush nëpër të vërtetën e tij. Qëndrimi themelor i dashurisë thotë: "Unë e pranoj personin tjetër ashtu siç ai është". Dashuria kurrë nuk tenton ta ndryshojë personin e dashur sipas idesë që ai tjetri ka për të. Mos provo ta presh atë këtu e atje dhe ta fusësh në qepjen tënde – megjithëqë ai është fenomen i cili ndodh në çdo centimetër të kësaj bote... Nëse dashuron, atëherë nuk ke për të vënë kushte. Nëse nuk dashuron, kush je atëherë ti që të vësh kushte? Që të dyja rastet janë të qarta, nëse dashuron, atëherë nuk bëhet fjalë për kushtëzim. E do personin e caktuar ashtu siç është. Nëse nuk e do, kjo po ashtu nuk është problem. Ai është për ty askush dhe asgjë dhe prapë nuk bëhet fjalë për kushtëzimin. Ai mund të bëjë çfarëdo që të dojë. Po qe se xhelozia zhduket dhe mbetet vetëm dashuria, do të kesh diçka të qëndrueshme dhe të çmueshme në jetën tënde.

270. Kur e ndan lumturinë tënde me dikë, mos krijo prej kësaj burg për të tjerët; veçse thjesht jepe. Mos prit as që dikush me t'u përkulur dhe falënderuar për atë se ti diçka po jep – mos prit kurrgjë për të, madje as falënderim. Ti jep shkaku se je i tejpasur, sepse dëshiron me dhënë. Po qe se dikush duhet të jetë falënderues, atëherë je ti falënderues ndaj personit që dëshiron ta pranojë dashurinë tënde, i cili dëshiron ta pranojë dhuratën tënde. Ai nuk të kushtëzon, ai ta lejon të hapesh para tij. Dhe sa më shumë që je në gjendje të ndash, sa më shumë që je në gjendje të dhurosh, aq më shumë ke. Në këtë mënyrë kurrë nuk ke për t'u varfëruar, nuk ke për të krijuar frikë të re të ngjashme me atë: "Kam mundur të hup këtë apo atë". E vërteta është, ndërkaq, se sa më shumë që humb, aq më shumë ujë i freskët rrjedh nga burimi për të cilin më parë nuk ke qenë i vetëdijshëm.

271. Po qe se e tërë ekzistenca është një, dhe po qe se ekzistenca brengoset mbi drurin, mbi kafshët, mbi malet, mbi oqeanet – brengoset si për më të voglën tufë të barit, ashtu edhe për yllin më të madh – atëherë kjo do të brengoset edhe për ty. Përse të jesh posesiv? Posesiviteti shpreh një gjë të thjeshtë – se ti nuk mund të besosh në ekzistencë. Ti dëshiron të rregullosh mbrojtje të veçantë për vete, siguri për veten, dhe nuk mund t'i besosh ekzistencës. Jo-posesiviteti është besim themelor në ekzistencë. Atëherë nuk ka nevojë për posesivitet, sepse ne jemi një me ekzistencën.

272. Largoje idenë se lidhshmëria dhe dashuria janë e njëjta gjë. Ato, në të vërtetë, janë armiq, lidhshmëria është ajo që asgjëson çdo dashuri. Nëse e ushqen, nëse e kultivon lidhshmërinë, dashuria do të jetë e asgjësuar; nëse e ushqen dhe e kultivon dashurinë, lidhshmëria do të zhduket vetvetiu. Dashuria dhe lidhshmëria nuk janë e njëjta gjë; ato janë dy entitete të ndara, armiqësisht të orientuara njëra kundrejt tjetrës.

273. Mbaje mend njëherë e përgjithmonë rregullën themelore të jetës: Nëse e adhuron dikë, bëhu gati për hakmarrjen e tij një ditë.

274. Ji i vetëdijshëm dhe mos lejo që kushdo qoftë të manipulojë me ty, more sado qofshin qëllimet e tij të mira. Do të duhej ta mbrosh vetveten prej aq shumë njerëzve qëllimmirë, bamirësve, të cilët pa ndalim të japin këshilla të jesh i këtillë, të jesh i atillë. Ti vetëm dëgjo dhe falënderoji. Ata nuk mendojnë kurrgjë keq – por keq është ajo që bëjnë.

Dëgjoje vetëm zemrën tënde. Ajo është mësuesi yt i vetëm.

275. Njerëzit të gjykojnë dhe ti i pranon gjykimet e tyre pa rezervë. Ti vuan shkaku i gjithë atyre gjykimeve, e atëherë të njëjtën gjë e bën ndaj të tjerëve; ajo lojë është bërë aq e shfrenuar saqë i tërë njerëzimi vuan prej saj. Po qe se dëshiron të ikësh nga çmenduria e tillë, gjëja e parë të cilën duhet ta bësh është kjo që do të them: mos e gjyko vetveten. Pranoje shtruar mospërsosmërinë tënde, mangësitë e tua, gabimet e tua, manitë e tua. Nuk ka nevojë ta aktrosh dikë tjetër. Vetëm ji ai që je, ashtu si je: "I tillë jam unë – plot frikë. Nuk guxoj të hyj në errësirë të dendur. Nuk guxoj të hyj në pyll të dendur". Çfarë ka të keqe në këtë? – është njerëzore të ndjesh frikë. Njëherë kur ta pranosh vetveten, do të jesh në gjendje t'i pranosh të tjerët, sepse do të kesh vetë përfytyrim të qartë se ata vuajnë prej së njëjtës sëmundje. Me atë se i pranon të tillë çfarë janë, do t'u ndihmosh që ta pranojnë vetveten. Ti mund ta vësh në lëvizje tërë procesin duke u bërë i aftë që t'i pranosh të tjerët. Dhe për atë se dikush po i pranon, ata e mësojnë bukurinë e pranimit për herë të parë – sa pajtimtare është kjo ndjesi – dhe ata zënë t'i pranojnë të tjerët. Po qe se i tërë njerëzimi do ta arrinte atë nivel ku secili do ta prananote vetveten ashtu siç është, gati se nëntëdhjetë për qind e mjerimit do të zhdukej - do të mbetej pa pikëmbështetje – dhe zemra jote do të hapej për akordin e vet të veçantë, kurse dashuria jote do të gufonte prej tij.

276. E vërteta është gjithnjë e pastër, lakuriqe, unike. Dhe kjo është diçka më së bukuri, sepse e vërteta është esenca e vërtetë e jetës, e ekzistencës, e natyrës. Përpos njeriut, askush tjetër nuk gënjen. Gjembi i trëndafilit nuk mund të gënjejë. Ai di të lindë trëndafila; ai nuk mund të lind kumak – ai nuk mund të mashtrojë. Ai nuk është I aftë të jetë diçka tjetër përveçse ai që është. Përpos njeriut, e tërë ekzistenca jeton në të vërtetën. E vërteta është religjioni i gjithë universit. Atë çast kur njeriu vendos të jetë pjesë e ekzistencës, e vërteta do të bëhet edhe religjion i tij.

Ky është revolucioni më i madh i cili njeriut mund t'i ndodhë. Ky është çast lavdie.

277. Ti nuk e sheh botën ashtu si ajo është – ti e sheh ashtu si ta imponon mendja jote. Gjëra të ngjashme mund të pash anembanë botës. Njerëzit e ndryshëm janë të kushtëzuar në mënyra të ndryshme; mendja nuk është gjë tjetër përveçse kushtëzim. Njerëzit i shohin gjërat në mënyrën e cila është e kushtëzuar me vetë kushtëzimin e tyre – ai kushtëzim krijon koloritin e caktuar në gjërat. Ne prodhojmë dallime; ne bëjmë që dikush të jetë i mbiçmuar, kurse dikush i nënçmuar; burri është më i fuqishëm, gruaja më e dobët; dikush është më i mençur, dikush më budalla. Sundimtarët kanë shpallur se ata janë njerëz të zgjedhur nga Zoti. Secili religjion shpall se librin e tij të shenjtë e ka shkruar vetë Zoti, të gjitha këto gjëra, rrena mbi rrenat, i prodhon mendja jote. Gjithnjë derisa nuk je bërë i aftë që gjithë mendjen tënde ta veçosh anash dhe ta shikosh botën drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësim, nga vetëdija e pastër, nuk do të jesh kurrë i aftë ta pash të vërtetën. Në këtë botë, nevojitet guxim i madh që mendja të shtyhet anash. Njeriu më i guximshëm është ai i cili mund të shohë botën pa pengesat e mendjes, ashtu siç ajo në të vërtetë është. Ajo është katërçipërisht ndryshe, pafundësisht e bukur. Në botën e tillë askush nuk është i mbirenditur dhe askush nuk është i nënrenditur – në botën e tillë nuk ekzistojnë dallimet.

278. Mendimi ynë i zakonshëm është se intelektualët janë njerëz inteligjentë. Kjo nuk është e vërtetë. Intelektualët jetojnë vetëm nga fjalët e vdekura. Inteligjenca nuk guxon të veprojë në të njëjtën mënyrë. Inteligjenca e hedh fjalën – se fjala është kufomë – dhe merr vetëm vibrimin e gjallë prej saj. Rruga e njeriut inteligjent është rruga e zemrës, për arsye se zemra nuk interesohet për fjalët; ajo interesohet vetëm për lëngun që vjen nga ena e fjalës. Ajo nuk mbledh enë, por e pi vetëm lëngun, kurse enën e hedh në pleh.

279. Për mua, njeri religjioz nuk është ai që është përmbi natyrën, veçse ai që është I natyrshëm në plotësi, në tërësi, dhe i cili e hulumton natyrën në të gjitha dimensionet e saj, asgjë duke mos lënë të pahulumtuar.

280. Njeriu që jeton jetë të natyrshme arrin vdekje të natyrshme. Vdekja e natyrshme është kulmimi i jetës e cila është jetuar natyrshëm, pa kurrfarë pengese, pa kurrfarë depresion – pikërisht në mënyrën në të cilën jetojnë shtazët; pa kurrfarë plasaritjeje. Duhet jetuar jetën që rrjedh e pranuar natyrën e cila rrymon nëpër ty pa kurrfarë pengimi nga ana jote, sikur ti të mos ishe, sikur jeta të ketë lëvizur nga vetvetja. Në vend se ti ta jetosh jetën lejo që jeta të të jetojë ty; ti je dytësor. Kulmimi i kësaj do të jetë vdekja e natyrshme. Vdekja ka për të shprehur kulmimin përfundimtar, kreshendon e jetës tënde të gjithmbarshme. Në formë të kondensuar ajo është e tëra që ka qenë dashur ta jetosh. Kështu vetëm numër i vogël

njerëzish në botë vdesin me vdekje të natyrshme, shkaku se numër tejet i vogël njerëzish jetojnë në mënyrë natyrore.

281. Ne i frikësohemi vdekjes shkaku se e dimë se duhet të vdesim, e nuk e dëshirojmë atë. Ne nuk dëshirojmë t'i mbyllim sytë. Ne dëshirojmë të jetojmë në atë mënyrë që "gjithë të tjerët le të vdesin, vetëm jo ne". Kjo është psikologjia e zakonshme e të gjithë njerëzve: "Unë nuk dua të vdes". Të shtrosh pyetje për vdekjen është tabu. Njerëzit bëhen të frikësuar për atë se ajo ua përkujton vdekjen e tyre personale. Ata janë aq të përqendruar në imtësirat e tyre, kurse vdekja do të mbërrijë; ata dëshirojnë t'i mbajnë vogëlsirat e tyre që të jenë të punësuar me diçka. Kjo u shërben si strehimore; ata nuk dëshirojnë të vdesin, së paku jo tash, ndoshta më vonë: "Kur do të ndodhë, do të shohim e bëjmë". Duke e pranuar vetveten në tërësi, ti e pranon edhe vdekjen; ajo është vetëm pushim. Gjithë ditën ti ke punuar, e kur ka ardhur nata, a dëshiron të pushosh apo jo? Gjumi ditor të ka rinuar, të ka bërë përsëri të aftë të punosh më mirë, më me efikasitet. E gjithë lodhja është zhdukur dhe ti je përsëri i ri. Vdekja e bën të njëjtën gjë, vetëm se në nivel më të thellë – ajo e ndërron trupin, sepse tashmë trupi nuk mund të rinohet vetëm me anë të gjumit të zakonshëm; ai është bërë tepër i vjetër, i nevojitet ndryshimi më drastik, i nevojitet ripërtëritja e plotë. Energjia jote jetësore kërkon trajtë të re. Vdekja është thjesht vetëm gjumë me të cilin mundesh lehtësisht të kalosh në trajtë të re.

282. Njeriu i cili jeton në frikë përherë fërgëllon në zemrën e vet. Ai është përherë në kufirin për t'u çmendur, për atë se jeta është e madhe, e nëse përherë je i frikësuar, atëherë ajo është e mbushur me të gjitha llojet e frikës. Ti mund ta bësh listë të madhe dhe të jesh i befasuar sesa shumë frikësime bartë në vete e akoma je gjallë. Gjithkund rreth teje ekzistojnë infeksione, sëmundje, rreziqe, kidnapime, terrorizëm – kurse jeta është aq e vogël. Në fund vjen vdekja, së cilës nuk mund t'I bishtërosh. E tërë jeta jote ka për t'u bërë errësirë. Hidhe frikën. Ajo është rrënjosur në ndërdijen tënde qysh se në fëmijërinë tënde. Tash hidhe vetëdijshëm atë frikë dhe rritu. Atëherë jeta mund të bëhet dritë e cila depërton gjithnjë e më thellë ashtu siç ti piqesh.

283. Përgjegjësia nuk është lojë. Ajo është një nga mënyrat më burimore të jetesës - por edhe më e rrezikshmja, gjithashtu.

284. Për mua, mosdëgjimi është revolucion i madh. Kjo nuk do të thotë të thuash absolutisht JO në çdo situatë. Kjo thjesht do të thotë të vendosësh se a vlen të bëhet diçka apo jo, a është ajo e dobishme të bëhet apo nuk është. Kjo është marrje e përgjegjësisë mbi vete.

285. Gjithnjë derisa nuk e mëson të vërtetën mbi qenësinë tënde, kurrë s'ke për ta ndjerë bekimin e madh të jetesës. Kurrë nuk do të jesh në gjendje të ndjesh sesi të vërshon gëzimi i së vërtetës reale të ekzistencës. Po qe se nuk e shijon të vërtetën, nuk do të kesh mundësi që të lidhesh me këtë gjithësi gjigante – që është shtëpia jote. Ajo ta ka dhënë jetën, dhe ajo

ka pritje të mëdha prej teje - se do ta zhvillosh pikën e fundit të vetëdijesimit, sepse përmes teje ekzistenca mund të bëhet e vetëdijshme.

Nuk ka mënyrë tjetër.

286. Intelekti është mendim – kurse vetëdijesimi ka zbuluar gjendjen pa mendime, deri në atë masë e qetë saqë madje as një mendim nuk lëviz për të krijuar shqetësim. Në këso qetësieti shpall natyrën tënde të vërtetë – ajo është e pafund si qielli. Kurse njohja e saj është vërtet njohja e diçkahi të çmueshme; çdo gjë tjetër që ke mësuar është pleh i zakonshëm.

Dituria jote mund të jetë e dobishme, praktike, por ajo nuk ka me të ndihmuar ta transformosh qenien tënde. Ajo nuk mund me të sjellë gjer tek përmbushja, gjer tek kënaqësia, gjer tek përndritja, gjer tek ajo pikë ku do të thuash: "Kam arritur në shtëpi".

287. Dhënia e dashurisë është përvojë e vërtetë dhe e bukur, sepse atëherë ti je perandor. Marrja e dashurisë është përvojë tepër e parëndësishme, sepse ajo është përvojë lypsari. Mos u bëj lypsar!

F U N D

ARTIKUJT E KËTIJ LIBRI JANË ARTIKUJ TË PËRZGJEDHUR NGA KËTO LIBRA, GAZETA, REVISTA, VEB FAQE, PORTALE...

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. ***BIBLA e Shenjtë***
2. ***KURANI i Madhërishëm***
3. Ernest Gombrik: **Histori e Shkurtër e Botës, Tiranë 1999**
4. Plutarku: **Jetë paralele, Tiranë 1980**
5. Enciklopedia Britanica
6. Li Hongzhi: **Zhuan Falun – Ligji i Budhës,** (Leksione:1992-1996)
7. OSHO – **Asgjë më hyjnore se jeta nuk ka**, Prizren 2011
8. A.J. Arberri: **Sufizmi – Një llogari e mistikëve të Islamit**
9. Llevellin Li: **Sufizmi – Transformimi i zemrës**
10. Sri Sri Ravi Shankar: **The Language of the Heart** (Gjuha e Zemrës), Prishtinë 2003
11. Catherine Aubier: **Astrologjia**, Tiranë 2011
12. Nikolas Herceku: **Astrologjia moderne**, Tiranë 2012

Nga Gazetat:

1. Gazeta - La Repubblica
2. Gazeta Bota Sot
3. Gazeta Express
4. Gazeta Rilindja Demokratike
5. Gazeta Shekulli
6. Gazeta Shqip
7. Gazeta Tirana Observer
8. Gazeta Metropol – Tiranë 2010
9. Gazeta Standard – Tiranë 2009
10. Gazeta Panorama – Tiranë 2009
11. Gazeta MAPO
12. N. Scientist

Nga Faqet e Internetit:

1. www. exploreruniver. com
2. www. forumishqiptar. com
3. www. syri3. com
4. www. sa-kra. ch
5. www. pashtriku. org
6. www. albeu. com

7. www. hermesnews. org
8. www. mesazhi. com
9. www. udhaezemres. com
10. www. zemrashqiptare. net
11. www. shkenca. org
12. www. lapsi. al
13. www. illyriapress. com
14. www. everteta. al
15. www. bota. al
16. www. koha. net
17. www. tiranaobserver. al
18. www. syri. net.
19. www. kosovasot. com
20. www. flori-press. blogspot. com

P Ë R M B A J T J A

I. MISTIKA, MAGJIA DHE BUKURIAE UNIVERSIT

1. John Dobson..... 5
2. Njësitë arkitekturore të Universit..... 7
3. Si u krijua Universi?..... 9
4. Teoritë mbi lindjen e Gjithësisë..... 12
5. Krijimi i Universit sipas shkencës..... 15
6. Origjina e botës..... 19
7. Edhe njëherë mbi origjinën e Universit..... 23
8. Materiae Errët në Univers..... 37
9. Errësirë në kufinjtë e Universit..... 48
10. Universi mistik dhe magjik..... 49
11. Astronomët fotografojnë ''Syrin e Zotit''..... 53
12. Zbulohet ''Toka'' e re 20 vite drite larg Botës sonë..... 55
13. Vrimat e Zeza..... 56
14. Astronomët amerikanë deklarojnë:
Vrimat e zeza mund të mos ekzistojnë..... 59
15. Shërimi yjor..... 60
16. A ekziston qytetërimi në Mars?.....63
17. Të rejat e fundit nga Planeti i Kuq (Marsi).....73
18. Strukturë me fytyrë njeriu në Mars.....75
19. A e sundon botën kaosi?.....77
20. Hawking: Universi nuk ka nevojë për krijuesin.....78
21. Sa të vegjël dhe të papërfillshëm jemi në Univers.....79
22. Zbulohet Ylli gjigant.....81
23. Së shpejti shpërthimi i yllit që do të ndriçojë Tokën dy javërresht.....82
24Asteroidet..... 83
25. Zbulohet Galaktika më e vjetër..... 84
26. Galaktika jonë – Rruga e Qumshtit..... 85
27. Universi – Pasqyrë e ndjenjave tona..... 87

II – PLLAKAT E SMERALDTA TË THOTIT TË ATLANTIDËS

1. Universi mendor..... 91
2. Parathënie nga Maurice Dorial..... 95
3. Parathënie nga Alessandro Marcon..... 98
Pllaka I: Historia e Thotit – Atlantidasit..... 98
Pllaka II: Sallat e Amentit..... 102
Pllaka III: Çelësi i mençurisë..... 105
Pllaka IV: I lindur në hapësirë.....108
Pllaka V: Banori i Undalit..... 111

Pllaka VI: Çelësi i magjisë..... 114
Pllaka VII: Shtatë Zotat.....117
Pllaka VIII: Çelësi i mistereve..... 120
Pllaka IX: Çelësi për të qenë të lirë në hapësirë..... 123
Pllaka X: Çelësi i kohës..... 126
Pllaka XI: Çelësi i të sipërmes dhe të poshtmes..... 129
Pllaka XII: Çelësi i profecisë..... 132
Pllaka XIII: Çelësat e jetës dhe të vdekjes..... 135
Shtesë-Pllaka XIV: Duke u bërë tre herë i madhërishëm..... 137
Shtesë-Pllaka XV: Sekreti i sekreteve..... 140

III – MISTIKA SUFISTE (THOTIANE)

1. Para Krijimit – Fillimi - Dikur ishim Një me Zotin..... 143
2. Harresa - Ndarja nga Zoti..... 153
3. Kujtimi i Zotit..... 153
4. Kthimi – Pendimi – Dorëzimi..... 161
5. Vdekja klinike..... 198
6. Raste të vdekjeve klinike..... 208
7. Urtësi..... 226
8. Pyetje – Përgjigje..... 261
9. Sufizmi në syrin e njeriut modern..... 274
10. Vjershërime sufiste..... 276
11. Shënime për Sufistët..... 306
12. Ç'është Sufizmi?..... 307

IV – ZHUAN FALUN – LIGJI I BUDHËS

1. Leksioni i Parë..... 315
2. Leksioni i Dytë..... 323
3. Leksioni i Tretë..... 345
4. Leksioni i Katërt..... 348
5. Leksioni i Shtatë..... 354
6. Leksioni i Tetë..... 367
7. Leksioni i Nëntë..... 368

V – ASTROLOGJIA

1. Astrologjia – E thellë si gjumi, e bukur si ëndrrat..... 388
2. Origjina e Astrologjisë..... 388
3. Historia e Astrologjisë..... 389
4. Çka është Astrologjia?..... 402

5. Elementet themelore të jetës – Elementet themelore të Zodiakut..... 405
6. Astrologjia Mesopotame..... 411
7. Astrologjia Kineze..... 412
8. Astrologjia Indiane /Vedike..... 414
9. Horoskopi dhe Kalendari Maja..... 415
10. Astrologjia dhe Religjioni..... 422
11. Astrologjia sipas fesë Islame..... 425
12. Astrologjia bimore..... 428
13. Horoskopi më i vjetër..... 432
14. Çka përfaqësojnë planetët dhe shenjat zodiake..... 433
15. Të fshehtat e jetëve të kaluara, sipas astrologjisë karmike..... 434
16. Vlera e Astrologjisë..... 437
17. Arabët që shpëtuan Astrologjinë..... 439
18. Aleksandri i Madh në astrologji..... 441
19. Shenjat e njerëzve të famshëm..... 451
20. Personalitete shtetesh që u besonin astrologëve..... 453
21. Thënie për Astrologjinë..... 456
22. Astrologjia sot..... 458

VI – MAGJIA

1. Ç'është Magjia?..... 460
2. Magjia, kjo dukuri që tmerron njerëzimin. Sekretet e saj..... 463
3. Magjia e realizimit të dëshirave jetësore..... 467
4. Magjia e zezë dhe magjia e bardhë..... 471
5. Simptomat (shenjat) e magjisë..... 473
6. Hajmalia, teorizimi dhe praktikat shpirtërore..... 474
7. Magjia dhe Mjekësia. A ndikojnë në organizmin e njeriut..... 477
8. Magjia te Shqiptarët..... 482

VII – ASGJË MË HYJNORE SE JETA NUK KA

1. Absurd! E palogjikshme!..... 491
2. Shtatë nivelet që ndërtojnë qenien tonë..... 512
3. Copëza mendimesh të arta nga Osho..... 524

***

- Literatura..... 586
- Përmbajtja..... 588